Publikuar nga:

Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH

Përgatitur nga:

Avokatura Ibrahimaga - Osmani - Tigani (I.O.T),

Kontribuesit:

Flakron Sylejmani, në emër të Projektit për Reformë Ligjore – GIZ

© **2014** Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH dhe Avokatura Ibrahimaga Osmani Tigani (I.O.T)

Të gjitha të drejtat e rezervuara. Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH nuk e merr asnjë përgjegjësi për përmbajtjen e paraqitur dhe nuk është përgjegjës për aktualitetin, saktësinë, plotësinë ose kualitetin e informatave të paraqitura. Prandaj, të gjitha pretendimet për dëmin e shkaktuar nga përdorimi i informatave të paraqitura, duke përfshirë edhe informatat që janë jo të plota ose të pasakta, do të refuzohen.

Nuk lejohet shumëzimi ose përdorimi i pjesëve të publikimit si fotografitë, etj. në publikimet tjera, pa lejen e veçantë të GIZ-it dhe autorëve.

Nëse ndonjë pjesë ose shprehje individuale në tekst nuk është e ligjshme ose e saktë, përmbajtja ose vlefshmëria e pjesëve tjera mbetet e pandikuar nga ky fakt.

Mars 2014

Publikuar në Prishtinë

Hartimi dhe publikimi i përmbledhjes së ligjeve u mundësua nga Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH, Projekti për Reformë Ligjore në Kosovë, në emër të Ministrisë Federale Gjermane për zhvillim ekonomik dhe bashkëpunim (BMZ).

PARATHËNIE

Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH, në emër të Ministrisë Federale Gjermane për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (BMZ), në bashkëpunim me autorët e këtij publikimi, duke synuar përmirësimin e gjendjes me literaturën ligjore në Kosovë, ka kënaqësinë që t'ju ofrojë Komentarin e Ligjit për Familjen në Kosovë.

Nisur nga fakti se ka probleme të ndryshme rreth zbatimit të ligjeve në Kosovë, të interpretimit të dispozitave- ndonjëherë edhe për përmbajtjen e dispozitave të caktuara, është parë si më se e domosdoshme që nga ekspertët të bëhet komentimi i ligjit dhe nxjerrja e kuptimit të duhur dhe të drejtë.

Komentari ofron sqarime dhe shtjellime të neneve të ligjit si dhe jep udhëzime për zbatimin e drejtë dhe adekuat të tij, sipas teorisë dhe praktikës vendore dhe ndërkombëtar, duke mos lënë anash edhe të arriturat juridike në këtë drejtim.

Gjithashtu, ky komentar do të ndihmojë profesionistët e fushës juridike në institucionet e Kosovës, që nga Ministria, Gjykatat, Prokuroritë, Fakultetin juridik si dhe të gjithë bashkëpunëtorët profesionalë në kryerjen e detyrave të tyre gjatë zbatimit dhe kuptimit të drejtë të këtij ligji. Kjo do t'i kontribojë krijimit të sigurisë juridike, mbrojtjes së interesave të palëve në procedurë si dhe ngritjen e besueshmërisë së qytetarëve në institucionin e Drejtësisë.

Presim që Komentari të bëhet një mjet i çmueshëm për komunitetin e profesionistëve juridikë, duke qenë i pari i këtij lloji, madje edhe si një kontribut i vlershëm për drejtësinë në Kosovë.

GIZ - Projekti për reformën ligjore në Kosovë- falënderon autorët e këtij komentari dhe personelin akademikë, ekspertët juridikë dhe bashkëpunëtorët e tyre të cilët ndihmuan në këtë punë, që ky publikim dhe të tjerat në të ardhmen do të jenë të dobishme për profesionistët e fushës së drejtësisë, shkencat juridike, gjithashtu do të jenë të dobishme edhe për popullin e Kosovës në përgjithësi.

Aktiviteti legjislativ në Kosovë në vitet e fundit ka rezultuar me miratimin e ligjeve të shumta nga Parlamenti i Kosovës, si legjislacion primar, që kanë pasur ndikim në shumë fusha të jetës sonë të përditshme. Vënia në dispozicion e legjislacionit primar është një nga parakushtet e vendosjes së sundimit të ligjit në Kosovë.

Për më tepër, mungesa e literaturës juridike ka nxitur Projektin e GIZ-it për Reformë Juridike dhe të ndërmarr iniciativën për përgatitjen e edicionit të parë të përmbledhjes së ligjeve në vitin 2009 i cili u botua përfundimisht në vitin 2012.

Përgjigjet e dhëna në pyetësorin e shpërndarë për komunitetin juridik treguan se rezultatet ishin shumë pozitive. Të gjithë të anketuarit vlerësuan punën e Projektit të GIZ-it për Reformë Juridike në botimin e përmbledhjeve të ligjeve. Përveç kësaj, për

shkak të zhvillimit dinamik të legjislacionit, të anketuarit sugjeruan botimin e edicionit të ri të pakos së përditësuar të përmbledhjes së ligjeve.

Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH, në emër të Ministrisë Federale të Gjermanisë për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (BMZ) në bashkëpunim me Firmën Juridike Ibrahimaga - Osmani - Tigani (I.O.T), me kënaqësi prezanton edicionin e dytë të Përmbledhjes së Ligjeve të Aplikueshme në Kosovë me synim të përmirësimit të situatës në fushën e botimeve juridike në Kosovë dhe me qëllim që komunitetit juridik t'i sigurohen mjetet efektive të punës.

Në këtë përmbledhje mund t'i gjeni të gjitha ligjet me ndryshime dhe plotësime gjer në datën e botimit të përmbledhjes.

Përdoruesit mund të shfrytëzojnë tekstin e ligjeve nga përmbledhja, si versione të aplikueshme pa pasur nevojë të kërkojnë gjetiu tekstet e ligjeve. Legjislacioni i përfshirë në këtë përmbledhje i referohet burimit origjinal të ligjit, titullit dhe numrit të ligjit si dhe datës së botimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Përmbledhja është e ndarë në katër fusha kryesore: E drejta Civile, Penale, Administrative dhe Komerciale - Administrative. Me qëllim të lehtësisë në gjetjen e tekstit përkatës, secila fushë është e ndarë në nënfusha të fushës përkatëse.

Ligjet janë përmbledhur në 7 libra të organizuara sipas fushave:

Përmbledhja e ligjeve në fushën administrative ndahet në tri vëllime, me këtë përmbajtje:

Vëllimi I Legjislacioni: Interesat shtetërore, rendi publik dhe siguria, të drejtat e njeriut, statusi civil, mjedisi dhe ndërtimtaria;

Vëllimi II Legjislacioni: Kujdesi shëndetësor, puna dhe shoqëria, ekonomia dhe industria, administrata publike, drejtësia, pushteti lokal;

Vëllimi III Legjislacioni: Mediet dhe publikimi, punët e jashtme dhe humanitare, kultura dhe sporti, komunikimi, arsimi dhe shkenca, inspektoratet dhe konventat ndërkombëtare.

Përmbledhja e ligjeve në fushën civile ka një vëllim me këtë përmbajtje: E drejta civile sistemike, ligjet procedurale dhe ligjet e procedurës jokontestimore.

Përmbledhja e ligjeve penale ka një vëllim me këtë përmbajtje: ligjet materiale dhe procedurale.

Përmbledhja e ligjeve ekonomike është e ndarë në dy vëllime:

Vëllimi I Legjislacioni: Sektori i tregtisë dhe industrisë, kompanitë, privatizimi, koncesionet dhe format tjera të investimit, sektori i pronësisë industriale, aktivitetet në fushën e botimeve, bujqësia, blegtoria, ujërat, pylltaria, peshkataria, bletaria dhe gjuetia;

Vëllimi II Legjislacioni: Sektori i energjisë dhe minierave, sektori i bankave dhe financave, legjislacioni për tatime dhe dogana, marrëveshjet ndërkombëtare për zhvillim ekonomik, financat publike dhe auditimi.

Këto përmbledhje janë në dispozicion në versionin e shtypur në gjuhën shqipe, kurse versionet në anglisht dhe në serbisht janë në dispozicion në CD-ROM.

GIZ – Projekti për Reformë Juridike në Kosovë falënderon Firmën Juridike Ibrahimaga - Osmani -Tigani dhe të gjithë bashkëpunëtorët e tyre të cilët ndihmuan në realizimin e kësaj pune, me shpresë se ky botim dhe botimet e ardhshme të përmbledhjeve do t'i ndihmojnë profesionistëve në fushën juridike në shfrytëzimin e ligjeve të aplikueshme (në fushat e tyre përkatëse), dhe do t'ua lehtësojnë qytetarëve gjetjen e ligjeve që u interesojnë.

Volkmar Theobald

Menaxher i projektit
Projekti për Reformë Juridike - GIZ
Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH

PËRMBAJTJA

LIGJET MATERIALE

Kodi Nr. 04/L-082 Kodi Penal i Republikës së Kosovës 3
Ligji Nr. 04/L-129 për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit Penal të Republikës së Kosovës Nr. 04/L-082 180
Kodi Nr. 03/L-193 i drejtësisë për të mitur 181
Ligji Nr. 2004/34 kundër korrupsionit 227
Ligji Nr. 04/L-030 për përgjegjësinë e personave juridik për vepra penale 241

LIGJET PROCEDURALE

Kodi Nr. 04/L-123 i procedurës penale 257
Ligji Nr. 03/L-196 për parandalimin e shpërlarjes së parave dhe financimit të terrorizmit 493
Ligji Nr. 04/L-178 për ndryshimin dhe plotësimit e Ligjit nr. 03/L-196 për parandalimin e shpërlarjes së parave dhe parandalimin e financimit të terrorizmit 528
Ligji Nr. 03/L-182 për mbrojtje nga dhuna në familje 543
Ligji Nr. 0/L-149 për ekzekutimin e sanksioneve penale 556
Ligji Nr. 04/L-140 për kompetencat e zgjeruara për konfiskimin e pasurisë së përfituar me vepër penale 636
Ligji Nr. 04/L-043 për mbrojtjen e informatorëve 644
Ligji Nr. 04/L-115 për mbrojtjen e dëshmitarëve 648
Ligji Nr. 04/L-136 për parandalimin dhe luftimin e krimit kibernetikë 662
Ligji Nr. 04/L-213 për bashkëpunim juridik ndërkombëtar në çështje penale 672
Ligji Nr. 04/L-218 për parandalimin dhe luftimin e trafikimit me njerëz dhe mbrojtjen e viktimave të trafikimit 709
Ligji Nr. 04/L-209 për amnistinë 735

LIGJET MATERIALE

KODI Nr. 04/L-082
KODI PENAL I REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Përmbajtja

Pjesa e përgjithshme 4
Kapitulli I: Dispozitat e përgjithshme 4
Kapitulli II: Veprat penale dhe përgjegjësia penale 5
Kapitulli III: Dënimet 14
Kapitulli IV: Vërejtja gjyqësore 31
Kapitulli V: Masat e trajtimit të detyrueshëm 32
Kapitulli VI: Dispozitat e përgjithshme për ekzekutimin e dënimeve dhe lirimi me kusht 34
Kapitulli VII: Konfiskimi i dobisë pasurore të fituar me anë të kryerjes së veprave penale 36
Kapitulli VIII: Pasojat juridike të dënimit 37
Kapitulli IX: Rehabilitimi dhe zbulimi i të dhënave nga dosja penale 37
Kapitulli X: Parashkrimi 39
Kapitulli XI: Falja 42
Kapitulli XII: Zbatimi i legjislacionit penal të Republikës së Kosovës sipas vendit të kryerjes së veprës penale 42
Kapitulli XIII: Domethënia e shprehjeve në kodin penal 44
Kapitulli XIV: Veprat penale kundër rendit kushtetues dhe sigurisë së Republikës së Kosovës 47
Kapitulli XV: Veprat penale kundër njerëzimit dhe vlerave të mbrojtura me të drejtën ndërkombëtare 56
Kapitulli XVI: Veprat penale kundër jetës dhe trupit 75
Kapitulli XVII: Veprat penale kundër lirive dhe të drejtave të njeriut 80
Kapitulli XVIII: Veprat penale kundër të drejtave të votimit 86
Kapitulli XIX: Veprat penale kundër të drejtave në marrëdhëniet e punës 89
Kapitulli XX: Veprat penale kundër integritetit seksual 91
Kapitulli XXI: Veprat penale kundër martesës dhe familjes 102
Kapitulli XXII: Veprat penale kundër shëndetit publik 106
Kapitulli XXIII: Veprat penale të narkotikëve 113
Kapitulli XXIV: Krimi i organizuar 116
Kapitulli XXV:Veprat penale kundër ekonomisë 116
Kapitulli XXVI: Veprat penale kundër shërbimeve komunale 131
Kapitulli XXVII: Veprat penale kundër pasurisë 132
Kapitulli XXVIII: Veprat penale kundër mjedisit, kafshëve, bimëve dhe objekteve kulturore 141
Kapitulli XXIX: Veprat penale kundër sigurisë së përgjithshme të njerëzve dhe pasurisë 147
Kapitulli XXX: Veprat penale të armëve 151
Kapitulli XXXI: Veprat penale kundër sigurisë së trafikut publik 153
Kapitulli XXXII: Veprat penale kundër administrimit të drejtësisë dhe administratës publike 155
Kapitulli XXXIII: Veprat penale kundër rendit publik 164
Kapitulli XXXIV: Korrupsioni zyrtar dhe veprat penale kundër detyrës zyrtare 168
Kapitulli XXXV: Dispozitat kalimtare dhe përfundimtare 174

Kuvendi i Republikës së Kosovës

Në bazë të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton

KODI PENAL I REPUBLIKËS SË KOSOVËS

PJESA E PËRGJITHSHME

KAPITULLI I
DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1
Bazat dhe kufijtë e sanksioneve penale

1. Veprat penale dhe sanksionet penale parashihen vetëm për ato sjellje me të cilat cenohen apo dëmtohen në atë masë liritë dhe të drejtat e njeriut si dhe të drejtat tjera dhe vlerat shoqërore të garantuara dhe të mbrojtura me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe me të drejtën ndërkombëtare, mbrojtja e të cilave nuk do të mund të realizohej pa dhunën penalo juridike.
2. Parashikimi i veprave penale si dhe llojet e masave dhe lartësia e sanksioneve penale për kryesit e veprave penale bazohen në domosdoshmërinë e sanksionit penalo juridik dhe proporcionalitetit të shkallës dhe natyrës së rrezikshmërisë për liritë dhe të drejtat e njeriut dhe të vlerave shoqërore.

Neni 2
Parimi i ligjshmërisë

1. Veprat penale, sanksionet penale dhe masat e trajtimit të detyrueshëm përcaktohen vetëm me ligj.
2. Askujt nuk mund t'i shqiptohet sanksioni penal ose masa e trajtimit të detyrueshëm për një vepër nëse para kryerjes së saj nuk është përcaktuar me ligj si vepër penale dhe nuk është paraparë sanksioni penal ose masa e trajtimit të detyrueshëm për atë vepër.
3. Përkufizimi i një vepre penale duhet të përcaktohet në mënyrë të saktë dhe nuk lejohet interpretimi sipas analogjisë. Në rast paqartësie, përkufizimi i veprës penale interpretohet në favor të personit ndaj të cilit zhvillohet procedura penale.

Neni 3
Zbatimi i ligjit më të favorshëm

1. Ndaj kryesit zbatohet ligji që ka qenë në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale.
2. Në rast se ligji në fuqi ndryshon para shqiptimit të vendimit të formës së prerë, atëherë ndaj kryesit zbatohet ligji që është më i favorshëm.
3. Nëse ligji i ri nuk e inkriminon veprën, por kryesi është dënuar me aktgjykim të

formës së prerë në pajtim me ligjin e mëparshëm, sanksioni penal nuk fillon të ekzekutohet ose ndërpritet në rast se ka filluar.

4. Një ligj i cili shprehimisht ka qenë në fuqi vetëm për një kohë të caktuar, zbatohet për ato vepra penale që janë kryer gjatë kohës kur ai ligj ka qenë në fuqi edhe në rastin kur nuk është më në fuqi, përveç nëse vetë ligji shprehimisht përcakton ndryshe.

Neni 4
Sanksionet penale dhe masat e trajtimit të detyrueshëm

1. Sanksionet penale janë:
   1.1. dënimet kryesore;
   1.2. dënimet alternative;
   1.3. dënimet plotësuese; dhe
   1.4. vërejtja gjyqësore.
2. Masat e trajtimit të detyrueshëm, të cilat mund t'i shqiptohen kryesit që nuk është penalisht i përgjegjshëm ose është i varur nga droga, ose nga alkooli, janë:
   2.1. trajtimi i detyrueshëm psikiatrik me ndalim në institucionin e kujdesit shëndetësor;
   2.2. trajtimi i detyrueshëm psikiatrik në liri; dhe
   2.3. trajtimi me rehabilitim të detyrueshëm të personave të varur nga droga apo alkooli.

Neni 5
Kufizimet në ekzekutimin e sanksioneve penale dhe masave të trajtimit të detyrueshëm

Me ekzekutimin e sanksionit penal ose masës së trajtimit të detyrueshëm, kryesit të veprës penale mund ti mohohen ose kufizohen të drejtat e caktuara vetëm deri në atë masë e cila i përgjigjet natyrës apo përmbajtjes së sanksionit ose masës dhe vetëm në mënyrën me të cilën sigurohet respektimi i dinjitetit njerëzor të tij apo saj, në pajtim me të drejtën ndërkombëtare.

Neni 6
Zbatimi i pjesës së përgjithshme të këtij Kodi

Dispozitat e pjesës së përgjithshme të këtij Kodi zbatohen për të gjitha veprat penale të përcaktuara me ligjet e Republikës së Kosovës.

KAPITULLI II
VEPRAT PENALE DHE PËRGJEGJËSIA PENALE

Neni 7
Vepra penale

Vepra penale është vepër e kundërligjshme e cila është e përcaktuar me ligj si vepër penale, tiparet e së cilës janë të përcaktuara me ligj dhe për të cilën me ligj është përcaktuar sanksioni penal ose masa e trajtimit të detyrueshëm.

Neni 8
Mënyra e kryerjes së veprës penale

1. Vepra penale mund të kryhet me veprim ose me mosveprim.
2. Vepra penale kryhet me mosveprim vetëm kur kryesi nuk e ndërmerr veprimin të cilin ka qenë i obliguar ta ndërmerr.

Neni 9
Koha e kryerjes së veprës penale

Vepra penale kryhet në kohën kur kryesi ka vepruar apo ka qenë i detyruar të veprojë pa marrë parasysh kohën kur është shkaktuar pasoja.

Neni 10
Vendi i kryerjes së veprës penale

1. Vepra penale kryhet në vendin ku kryesi ka vepruar apo ka qenë i detyruar të veprojë ashtu si dhe në vendin ku është shkaktuar pasoja.
2. Vepra penale është tentuar në vendin ku kryesi ka vepruar si dhe në vendin ku kryesi ka dashur që të shkaktohet pasoja.

Neni 11
Vepra e rëndësisë së vogël

Nuk përbën vepër penale ajo vepër e cila edhe pse përmban tiparet e veprës penale të përcaktuar me ligj, paraqet vepër të rëndësisë së vogël. Vepra është e rëndësisë së vogël kur rrezikshmëria e saj është e parëndësishme për shkak të natyrës ose peshës së veprës; mungesës ose pasojave të dëmshme të parëndësishme; rrethanave në të cilat është kryer vepra; shkallës së ulët të përgjegjësisë penale të kryesit; ose rrethanave personale të kryesit.

Neni 12
Mbrojtja e nevojshme

1. Vepra e kryer në mbrojtje të nevojshme nuk është vepër penale.
2. Mbrojtja e nevojshme është mbrojtja e cila është e domosdoshme për të zmbrapsur sulmin e kundërligjshëm, real dhe të atëçastshëm ndaj vetes ose personit tjetër me kusht që karakteri i mbrojtjes të jetë në proporcion me shkallën e rrezikut që paraqet sulmi.
3. Disproporcioni ndërmjet sulmit dhe zmbrapsjes së sulmit konsiderohet tejkalim i kufijve të mbrojtjes së nevojshme.
4. Kryesi i cili i tejkalon kufijtë e mbrojtjes së nevojshme mund të dënohet më lehtë. Nëse kryesi tejkalon kufijtë për shkak të tronditjes së fortë apo frikës së shkaktuar nga sulmi, ai mund të lirohet nga dënimi.

Neni 13
Nevoja ekstreme

1. Vepra e kryer në kushtet e nevojës ekstreme nuk është vepër penale.
2. Nevoja ekstreme ekziston nëse personi e kryen veprën për të zmbrapsur prej vetes ose tjetrit rrezikun e atëçastshëm e të paprovokuar, i cili nuk mund të evitohet në mënyrë tjetër, me kusht që e keqja e shkaktuar të mos jetë më e madhe se e keqja që është kanosur.
3. Kur kryesi e shkakton rrezikun nga pakujdesia apo i tejkalon kufijtë e nevojës ekstreme, dënohet më butë. Kur kryesi i tejkalon kufijtë në rrethana veçanërisht lehtësuese, ai mund të lirohet nga dënimi.
4. Nuk ekziston nevoja ekstreme nëse kryesi ka qenë i obliguar me ligj që t'i ekspozohet rrezikut.

Neni 14
Dhuna ose kanosja

1. Vepra e kryer nën ndikimin e dhunës së papërballueshme ose kanosjes së papërballueshme nuk është vepër penale vetëm nëse personi menjëherë pas pushimit të rrezikut e lajmëron shtrëngimin dhe veprën e kundërligjshme tek organet kompetente.
2. Nëse vepra penale është kryer nën ndikimin e dhunës së përballueshme apo kanosjes së përballueshme, dënimi mund të zbutet vetëm nëse personi menjëherë pas pushimit të rrezikut e lajmëron shtrëngimin dhe veprën e kundërligjshme tek organet kompetente.
3. Kushdo që përdor dhunën ose kanosjen sipas paragrafit 1. dhe 2. të këtij neni konsiderohet kryes i veprës penale.

Neni 15
Veprat e kryera nën shtrëngim

1. Vepra e kryer nën shtrëngim nuk është vepër penale.
2. Vepra kryhet nën shtrëngim kur personi i ballafaquar me dhunën e pashmangshme apo kanosjen e dhunës që nuk mund të shmanget e që rrezikon jetën, trupin ose lirinë, kryen vepër të kundërligjshme për të mënjanuar rrezikun nga vetja ose personi me të cilin ka lidhje familjare. Vepra do të konsiderohet se është kryer nën shtrëngim vetëm nëse personi menjëherë pas pushimit të rrezikut e lajmëron shtrëngimin dhe veprën e kundërligjshme tek organet kompetente.
3. Vepra nuk kryhet nën shtrëngim nëse dhe deri në masën që nga kryesi mund të pritet në rrethanat e shkaktuara që të pranojë rrezikun, në veçanti nëse ai ka shkaktuar rrezikun ose nëse ka qenë i detyruar ligjërisht që të ballafaqohet me një dhunë të tillë të atëçastshme apo me kërcënim të dhunës. Në rrethana të tilla dënimi mund të zbutet.

Neni 16
Urdhrat nga lartë

1. Kur vepra penale është kryer nga një person në bazë të një urdhri qeveritar ose të një eprori, qoftë ushtarak ose civil, kryesi nuk lirohet nga përgjegjësia penale, përveç kur:
   1.1. personi ka qenë i detyruar ligjërisht që t'i bindet urdhrit të tillë;
   1.2. personi nuk e ka ditur se urdhri i tillë ka qenë i paligjshëm; dhe
   1.3. urdhri i tillë nuk ishte në mënyrë të dukshme i paligjshëm.
2. Urdhrat për të kryer gjenocid ose krime të tjera kundër njerëzimit janë të paligjshëm në të gjitha rrethanat.

Neni 17
Përgjegjësia penale

1. Kryesi i veprës penale është penalisht përgjegjës nëse është mendërisht i aftë dhe veprën penale e ka kryer me dashje apo nga pakujdesia.
2. Një person është penalisht përgjegjës për veprën penale të kryer nga pakujdesia vetëm nëse këtë shprehimisht e përcakton ligji.
3. Personi nuk është penalisht përgjegjës nëse në kohën e kryerjes së veprës penale është nën moshën katërmbëdhjetë (14) vjet.

Neni 18
Paaftësia mendore dhe aftësia e zvogëluar mendore

1. Personi i cili ka kryer vepër penale konsiderohet i paaftë mendërisht nëse në kohën e kryerjes së veprës penale lëngonte nga një sëmundje mendore e përkohshme ose e përhershme, nëse kishte çrregullim mendor apo ngecje në zhvillimin mendor që e ka prekur funksionimin e tij mendor dhe si pasojë e kësaj, nuk ka qenë në gjendje të kuptojë natyrën dhe rëndësinë apo pasojën e veprimeve ose mosveprimeve të tij ose nuk ka qenë në gjendje t'i kontrollojë veprimet ose mosveprimet e tij apo të kuptojë se kryen vepër penale.
2. Personi i cili ka kryer vepër penale konsiderohet se ka aftësi të zvogëluar mendore nëse në kohën e kryerjes së veprës penale aftësia e tij për të kuptuar natyrën dhe rëndësinë apo pasojën e veprimeve ose mosveprimeve të tij ka qenë esencialisht e zvogëluar për shkaqet e cekura në paragrafin 1. të këtij neni. Personi i tillë konsiderohet penalisht përgjegjës, por këto rrethana merren parasysh nga gjykata kur vendos për kohëzgjatjen dhe llojin e sanksionit ose masës së trajtimit të detyrueshëm.

Neni 19
Kryerja e veprës penale në gjendje të dehur

Personi është penalisht përgjegjës nëse duke përdorur alkool, narkotik apo me ndonjë mënyrë tjetër e sjell veten në një gjendje të tillë që nuk mund të kuptoj rëndësinë e veprimit apo të mosveprimit të vet ose të kontrollojë sjelljen e vet, nëse para se të ketë

sjellë veten në gjendje të tillë, veprimet ose mosveprimet e tij kanë qenë të përfshira në dashjen e tij apo nëse është i pakujdesshëm ndaj veprës penale dhe ligji parasheh përgjegjësi penale për kryerjen e kësaj vepre penale nga pakujdesia.

Neni 20
Lidhja shkakore

Personi nuk është penalisht përgjegjës kur midis veprimit ose mosveprimit të tij dhe pasojës mungon lidhja shkakore.

Neni 21
Dashja

1. Vepra penale mund të kryhet me dashje direkte ose eventuale.
2. Personi vepron me dashje direkte kur është i vetëdijshëm për veprën e vet dhe e dëshiron kryerjen e saj.
3. Personi vepron me dashje eventuale kur është i vetëdijshëm se pasoja e ndaluar mund të shkaktohet si rezultat i veprimit ose i mosveprimit të tij dhe ai pranon shkaktimin e saj.

Neni 22
Dijenia, dashja, pakujdesia ose qëllimi

Dijenia, dashja, pakujdesia ose qëllimi i kërkuar si element i veprës penale mund të nxirret nga rrethanat faktike.

Neni 23
Pakujdesia

1. Vepra penale mund të kryhet me pakujdesi të vetëdijshme apo të pavetëdijshme.
2. Personi vepron me pakujdesi të vetëdijshme kur është i vetëdijshëm se pasoja e ndaluar mund të shkaktohet si rezultat i veprimit ose të mosveprimit të tij, por me mendjelehtësi mendon se ajo nuk do të shkaktohet apo se ai do të mund ta parandalojë shkaktimin e saj.
3. Personi vepron me pakujdesi të pavetëdijshme kur nuk është i vetëdijshëm se pasoja e ndaluar mund të shkaktohet si rezultat i veprimit ose mosveprimit të tij edhe pse në rrethanat dhe sipas vetive të tij personale ka mund të ishte apo do duhej të ishte i vetëdijshëm për këtë mundësi.

Neni 24
Përgjegjësia për pasojat më të rënda

Nëse kryerja e një vepre penale shkakton pasoja të cilat e tejkalojnë qëllimin e kryesit dhe për këtë ligji përcakton një dënim më të rëndë, dënimi më i rëndë mund të shqiptohet në rast se pasoja i atribuohet pakujdesisë së kryesit.

Neni 25
Lajthimi faktik

1. Personi nuk është penalisht përgjegjës nëse në kohën e kryerjes së veprës penale nuk ka qenë i vetëdijshëm për ndonjë nga tiparet e asaj vepre ose gabimisht ka menduar se ekzistojnë rrethanat, të cilat faktikisht po të ekzistonin, kjo vepër do të ishte e lejuar.
2. Personi i cili për shkak të pakujdesisë ka qenë në lajthim është penalisht përgjegjës për veprën penale të kryer nga pakujdesia nëse ligji në mënyrë specifike parashikon përgjegjësinë penale për kryerjen e veprës së tillë nga pakujdesia.

Neni 26
Lajthimi juridik

1. Personi i cili për shkaqe të arsyeshme nuk e ka ditur ose nuk ka mundur ta dijë se vepra është e ndaluar nuk është penalisht përgjegjës.
2. Nëse lajthimi ka qenë i evitueshëm, personi është penalisht përgjegjës por dënimi mund të zbutet.
3. Lajthimi juridik është i evitueshëm nëse çdo person ka mundur lehtësisht që ta dijë se vepra është e kundërligjshme ose nëse kryesi duke marrë parasysh profesionin, thirrjen ose detyrën e tij ka qenë i obliguar ta dijë se vepra është e kundërligjshme.

Neni 27
Përgatitja e veprës penale

1. Kushdo që me dashje përgatit kryerjen e veprës penale do të dënohet vetëm nëse parashihet shprehimisht me ligj.
2. Kur ligji parasheh dënimin për përgatitjen e veprës penale të caktuar, përgatitja e veprës penale përfshin furnizimin ose aftësimin e mjeteve për kryerjen e veprës penale; mënjanimin e pengesave për kryerjen e veprës penale; marrëveshjen, planifikimin ose organizimin me personin tjetër për kryerjen e veprës penale si dhe veprimet tjera me të cilat krijohen kushtet për kryerjen e drejtpërdrejt të veprës penale por të cilat nuk përbëjnë veprimin e kryerjes.

Neni 28
Tentativa

1. Kushdo që me dashje ndërmerr veprime për kryerjen e veprës penale por vepra nuk është kryer ose elementet e veprës penale nuk janë realizuar, konsiderohet se ka tentuar të kryejë vepër penale.
2. Tentativa për të kryer vepër penale për të cilën mund të shqiptohet dënimi me tre ose më shumë vjet burgim dënohet. Tentativa për të kryer ndonjë tjetër vepër penale dënohet vetëm nëse shprehimisht parashihet me ligj.
3. Personi që tenton të kryejë vepër penale dënohet si të kishte kryer veprën penale, por dënimi mund të zbutet.

Neni 29
Tentativa e papërshtatshme

Gjykata mund ta lirojë nga dënimi personin i cili tenton të kryejë vepër penale me mjet të papërshtatshëm ose ndaj objektit të papërshtatshëm.

Neni 30
Heqja dorë vullnetare

1. Gjykata mund ta lirojë personin nga dënimi për tentativë të dënueshme të veprës penale nëse personi i tillë heq dorë vullnetarisht nga kryerja e veprës penale të cilën e ka filluar, ndonëse është i vetëdijshëm se në pajtim me të gjitha rrethanat ai mund të vazhdonte veprën ose nëse pas kryerjes së një vepre të tillë parandalon shkaktimin e pasojave.
2. Në rastin e cekur në paragrafin 1. të këtij neni, kryesi dënohet për ato veprime të cilat përbëjnë vepër tjetër të veçantë penale.

BASHKËPUNIMI NË KRYERJEN E VEPRËS PENALE

Neni 31
Bashkëkryerja

Nëse dy apo më shumë persona së bashku kryejnë veprën penale duke marrë pjesë në kryerjen e veprës penale ose thelbësisht duke i kontribuar kryerjes së saj në ndonjë mënyrë tjetër, secili prej tyre është përgjegjës dhe dënohet me dënimin e paraparë për vepër penale.

Neni 32
Shtytja

1. Kushdo që me dashje e shtytë personin tjetër të kryejë vepër penale dënohet sikurse ta kishte kryer vet atë vepër penale nëse vepra penale është kryer.
2. Kushdo që me dashje shtytë personin tjetër të kryejë vepër penale dënohet sikurse ta kishte kryer vet atë vepër penale nëse vepra penale është tentuar por nuk është kryer.
3. Kushdo që me dashje shtytë personin tjetër të kryejë vepër penale të dënueshme me së paku pesë (5) vjet burgim dhe vepra penale as që është tentuar, shtytësi dënohet për tentativë.

Neni 33
Ndihma

1. Kushdo që me dashje ndihmon personin tjetër për kryerjen e veprës penale dënohet më dënim më të butë.
2. Ndihma për të kryer një vepër penale përfshin, por nuk kufizohet në: dhënien e këshillave ose udhëzimeve se si të kryhet vepra penale; vënien në dispozicion të

mjeteve për kryerjen e veprës penale; krijimin e kushteve ose mënjanimin e pengesave për kryerjen e veprës penale; ose premtimi paraprak se do të fshehë provat e kryerjes së veprës penale, kryesin apo identitetin e kryesit, mjetet e përdorura për kryerjen e veprës penale ose përfitimet që rrjedhin nga kryerja e veprës penale.

Neni 34
Bashkimi kriminal

1. Kushdo që shprehimisht apo në mënyrë të heshtur merret vesh me një apo me më shumë persona për të kryer ose për të nxitur kryerjen e një vepre penale të dënueshme me së paku pesë (5) vjet burgim dhe ndërmerr veprime përgatitore për realizimin e marrëveshjes së tillë, dënohet me dënimin e paraparë për atë vepër penale.
2. Gjykata mund ta zbusë dënimin ose ta liroj nga dënimi personin i cili është penalisht përgjegjës sipas paragrafit 1. të këtij neni nëse personi i tillë:
   2.1. vullnetarisht heq dorë nga marrëveshja;
   2.2. vullnetarisht ndërmerr veprime për parandalimin e ekzistencës së vazhdueshme të bashkimit kriminal ose të kryerjes së veprës penale në pajtim me qëllimet e saj; ose
   2.3. vullnetarisht ia zbulon policisë njohuritë e marrëveshjes në kohën kur vepra penale e planifikuar ende mund të parandalohet.

Neni 35
Marrëveshja për të kryer vepër penale

1. Kushdo që merret vesh me një apo me më shumë persona për të kryer vepër penale dhe një apo më shumë nga ata persona ndërmerr çfarëdo veprimi të rëndësishëm për kryerjen e veprës penale dënohet me dënimin e paraparë për atë vepër penale.
2. Për qëllime të këtij neni, shprehja **"veprim i rëndësishëm drejt kryerjes së veprës penale"** nuk duhet të jetë veprim penal por duhet të jetë hap i rëndësishëm përgatitor drejtë kryerjes së veprës penale të cilën personat janë pajtuar që ta kryejnë.

Neni 36
Kufijtë e përgjegjësisë penale dhe ndëshkimi për bashkëpunim

1. Bashkëkryesi është penalisht përgjegjës brenda kufijve të dashjes apo të pakujdesisë së vet.
2. Personi i cili shtytë ose ndihmon në kryerjen e veprës penale është penalisht përgjegjës brenda kufijve të dashjes së tij.
3. Rrethanat personale, përfshirë marrëdhëniet dhe cilësitë të cilat mund të rezultojnë në përjashtimin nga përgjegjësia penale, lirimin nga dënimi, ekzistimin e formave të rënda apo të lehta të veprës penale ose që ndikojnë në përcaktimin e dënimit, mund të merren parasysh vetëm ndaj personit për të cilin vlejnë. Nëse rrethanat personale të cilat ndërlidhen me kryesin kanë ndikim në zbutjen ose ashpërsimin e dënimit

dhe këto rrethana konstituojnë element të veprës penale, bashkëkryesi, shtytësi ose ndihmësi është përgjegjës për dënimin e paraparë për vepër penale kur ai ka ditur për këtë rrethanë, edhe nëse nuk ka pasur lidhshmëri me të.

DISPOZITAT E POSAÇME MBI PËRGJEGJËSINË PENALE PËR VEPRAT PENALE TË KRYERA ME ANË TË MEDIAVE

Neni 37
Përgjegjësia penale e kryeredaktorëve, botuesve, shtyp shkronjësve ose prodhuesve

1. Autori i informacionit është penalisht përgjegjës nëse vepra penale është kryer përmes publikimit të informatës në gazetë ose në lloj tjetër të shtypit periodik, radio, televizion, internet ose mjete tjera të komunikimit.
2. Kryeredaktori përgjegjës ose personi i cili e zëvendëson atë në kohën e publikimit të informatës është penalisht përgjegjës kur:
   2.1. autori nuk mund të gjendet apo të gjykohet në Gjykatën e Kosovës;
   2.2. publikimi i informacionit është bërë pa dijeninë e autorit ose kundër vullnetit të tij; ose
   2.3. nëse gjatë kohës së publikimit të informatës kanë ekzistuar pengesa faktike dhe juridike për fillimin e procedurës penale ndaj autorit dhe të cilat ende ekzistojnë.
3. Kryeredaktori ose personi i cili e zëvendëson atë në kohën e publikimit të informatës nuk është penalisht përgjegjës nëse për shkaqe të arsyeshme nuk ka ditur për ndonjë rrethanë të paraparë në paragrafin 2. të këtij neni.
4. Botuesi i gazetës ose llojit tjetër të shtypit periodik është penalisht përgjegjës nëse kryeredaktori ose personi që e zëvendëson atë në kohën e publikimit të informatës në gazetë ose llojin tjetër të shtypit periodik është penalisht përgjegjës sipas paragrafit 2. të këtij neni.
5. Kur botuesi është penalisht përgjegjës sipas paragrafit 4. të këtij neni dhe për shkak të pengesave juridike ose faktike nuk është e mundur të dënohet botuesi, atëherë personi i cili e ka shtypur informatën është penalisht përgjegjës nëse ai e ka ditur se pengesat e tilla ligjore ose faktike kanë ekzistuar.
6. Prodhuesi është penalisht përgjegjës kur kryeredaktori ose personi që e zëvendëson atë në kohën e publikimit të informatës me anë të shiritit manjetik, filmit, diapozitivave, fotografive ose pajisjeve tjera audio dhe video të dedikuara për mediat masive ose për prezantim publikut apo për një numër të madh të personave janë penalisht përgjegjës sipas paragrafit 2. të këtij neni.
7. Nëse botuesi, shtypshkronjësi ose prodhuesi i cili është penalisht përgjegjës sipas këtij neni është person juridik apo organ publik, personi përgjegjës për shtypjen ose aktivitetin prodhues është penalisht përgjegjës.
8. Personat e cekur në këtë nen nuk janë penalisht përgjegjës nëse publikimi i informatës është raport i saktë nga një mbledhje e organit publik ose nga deklarata e një personi zyrtar.

Neni 38
Mbrojtja e burimit të informatës

1. Personi i cili merr pjesë si profesionist në publikimin e informacionit ose si anëtar i bordit redaktues të mediave dhe ndihmësi i tij nuk janë penalisht përgjegjës nëse refuzojnë ta tregojnë autorin e publikimit ose burimin e informatës.
2. Personat e cekur në paragrafin 1. të këtij neni janë penalisht përgjegjës nëse gjykata konstaton se:
   2.1. zbulimi i informatave është i domosdoshëm për të parandaluar sulmin që përbën kërcënim të pashmangshëm ndaj jetës apo integritetit trupor të ndonjë personi.

Neni 39
Zbatimi i dispozitave të përgjithshme për përgjegjësinë penale

Dispozitat për përgjegjësinë penale të personave të cekur në nenet 37 dhe 38 të këtij Kodi janë të zbatueshme vetëm nëse ata persona nuk janë penalisht përgjegjës sipas dispozitave të përgjithshme për përgjegjësinë penale të përcaktuar në këtë Kod.

Neni 40
Përgjegjësia penale e personave juridik

1. Personi juridik është përgjegjës për veprën penale të personit përgjegjës, i cili ka kryer vepër penale duke vepruar në emër të personit juridik brenda autorizimeve të tij, me qëllim të përfitimit të dobisë apo ka shkaktuar dëm për atë person juridik. Përgjegjësia e personit juridik ekziston edhe nëse veprimet e personit juridik kanë qenë në kundërshtim me politikat e afarizmit ose me urdhrat e personit juridik.
2. Sipas kushteve të parapara në paragrafin 1. të këtij neni, personi juridik po ashtu është përgjegjës për veprën penale në rastin kur personi përgjegjës që ka kryer vepër penale nuk dënohet për atë vepër penale.
3. Përgjegjësia e personit juridik bazohet në fajësinë e personit përgjegjës.
4. Elementi subjektiv i veprës penale i cili ekziston vetëm për personin përgjegjës, vlerësohet në lidhje me personin juridik, nëse është përmbushur baza e përgjegjësisë e paraparë në paragrafin 1. të këtij neni.

KAPITULLI III
DËNIMET

Neni 41
Qëllimi i dënimit

1. Qëllimet e dënimit janë:
   1.1. të parandalojë kryesin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij;
   1.2. të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale;
   1.3. të bëjë kompensimin e viktimave ose të komunitetit për humbjet ose dëmet e shkaktuara nga vepra penale; dhe

1.4. të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Neni 42
Llojet e dënimeve

1. Llojet e dënimeve janë:
   1.1. dënimet kryesore;
   1.2. dënimet alternative; dhe
   1.3. dënimet plotësuese.

DËNIMET KRYESORE

Neni 43
Dënimet kryesore

1. Llojet e dënimeve kryesore janë:
   1.1. dënimi me burgim të përjetshëm;
   1.2. dënimi me burgim dhe
   1.3. dënimi me gjobë.

Neni 44
Dënimi me burgim të përjetshëm

1. Ligji mund të parasheh dënimin me burgim të përjetshëm për veprat më të rënda penale të kryera në rrethana veçanërisht rënduese ose për vepra penale që kanë shkaktuar pasoja shumë të rënda.
2. Ligji nuk mund të parasheh dënimin me burgim të përjetshëm si të vetmin dënim kryesor për një vepër të veçantë penale.
3. Dënimi me burgim të përjetshëm nuk mund t'i shqiptohet personit i cili në kohën e kryerjes së veprës penale nuk i ka mbushur njëzetenjë (21) vjet ose personit i cili në kohën e kryerjes së veprës penale ka pasur aftësi esencialisht të zvogëluar mendore.

Neni 45
Dënimi me burgim

1. Dënimi me burgim nuk mund të shqiptohet në kohëzgjatje më pak se tridhjetë (30) ditë e as më tepër se njëzet e pesë (25) vjet.
2. Dënimi me burgim shqiptohet në vite dhe në muaj të plotë, e në rastet kur dënimi është deri në gjashtë (6) muaj, dënimi shqiptohet në ditë të plota.

Neni 46
Dënimi me gjobë

1. Dënimi me gjobë nuk mund të jetë më pak se njëqind (100) Euro evropiane (në tekstin e mëtejmë "EURO"). Dënimi me gjobë nuk mund të tejkalojë njëzet e

pesëmijë (25.000) Euro ndërsa për veprat penale lidhur me terrorizëm, trafikim me njerëz, krim të organizuar ose veprat penale të kryera me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore nuk mund të tejkalojë pesëqind mijë (500.000) Euro.

2. Në aktgjykim caktohet afati i pagesës së dënimit me gjobë. Afati nuk mund të jetë më i shkurtër se pesëmbëdhjetë (15) ditë e as më i gjatë se tre (3) muaj, mirëpo në rrethana të arsyeshme gjykata mund të lejojë që dënimi me gjobë të paguhet me këste për një periudhë që nuk tejkalon dy (2) vjet. Aktgjykimi po ashtu duhet të përcaktojë se kur duhet të paguhen këstet dhe duhet të cek se mundësia e pagesës me këste do të revokohet nëse personi i dënuar nuk e paguan këstin me kohë.
3. Nëse personi i dënuar nuk dëshiron ose nuk mund të paguajë gjobën, gjykata mund të zëvendësojë dënimin me gjobë me dënim me burgim. Kur dënimi me burgim zëvendësohet me dënimin me gjobë, një ditë burgim llogaritet me njëzet (20) Euro gjobë. Dënimi me burgim nuk mund të tejkalojë tre (3) vjet.
4. Nëse personi i dënuar nuk dëshiron ose nuk mund të paguajë gjobën në tërësi, gjykata do ta zëvendësojë pjesën e mbetur të gjobës me dënim me burgim, siç parashihet në paragrafin 3. të këtij neni. Nëse personi i dënuar e paguan pjesën e mbetur të gjobës, ekzekutimi i dënimit ndërpritet.
5. Nëse personi i dënuar nuk dëshiron ose nuk mund të paguajë gjobën, gjykata mundet, me pëlqimin e personit të dënuar, në vend të shqiptimit të dënimit me burgim, ta zëvendësojë dënimin me gjobë me urdhër për punë në dobi të përgjithshme. Urdhri për punë në dobi të përgjithshme llogaritet ashtu që tetë (8) orë të punës në dobi të përgjithshme llogariten me njëzet (20) Euro gjobë. Kohëzgjatja e punës në dobi të përgjithshme nuk mund të tejkalojë dyqind e katër dhjetë (240) orë.
6. Dënimi me gjobë nuk ekzekutohet pas vdekjes së personit të dënuar.

Neni 47
Zëvendësimi i dënimit me burgim me dënim me gjobë

Kur gjykata shqipton dënimin me burgim deri në gjashtë (6) muaj, gjykata njëkohësisht mund të vendosë që dënimi me burgim të zëvendësohet me dënim me gjobë, me pëlqimin e personit të dënuar.

Neni 48
Zëvendësimi i dënimit me burgim me urdhrin për punë në dobi të përgjithshme

1. Gjykata, me pëlqimin e personit të dënuar, mund të zëvendësojë dënimin me burgim deri në gjashtë (6) muaj me urdhrin për punë në dobi të përgjithshme.
2. Nëse e shqipton urdhrin për punë në dobi të përgjithshme, gjykata e urdhëron personin e dënuar të kryejë punë në dobi të përgjithshme pa pagesë për një periudhë të caktuar kohore prej tridhjetë (30) deri në dyqind e katërdhjetë (240) orë pune. Shërbimi sprovues vendos për llojin e punës në dobi të përgjithshme që duhet kryer nga personi i dënuar, cakton organizatën e veçantë për të cilën personi i dënuar do të kryejë punën në dobi të përgjithshme, vendos për ditët e javës gjatë të cilave puna në dobi të përgjithshme duhet të kryhet dhe e mbikëqyrë kryerjen e punës në dobi të përgjithshme.

3. Puna në dobi të përgjithshme duhet të kryhet brenda kohës së caktuar nga gjykata dhe kjo kohë nuk mund të jetë me gjatë se një (1) vit.
4. Nëse pas kalimit të kohës së caktuar personi i dënuar nuk e ka kryer punën në dobi të përgjithshme ose e ka kryer vetëm pjesërisht punën e tillë në dobi të përgjithshme, gjykata urdhëron dënimin me burgim. Një ditë burgim do të urdhërohet për çdo tetë (8) orë pune në dobi të përgjithshme që nuk është kryer.

DËNIMET ALTERNATIVE

Neni 49
Dënimet alternative

1. Dënimet alternative janë:
   1.1. dënimi me kusht;
   1.2. gjysmëliria; dhe
   1.3. urdhri për punë në dobi të përgjithshme.
2. Kur shqipton dënimin me kusht, gjykata po ashtu mund të shqiptojë:
   2.1. urdhrin për trajtim të detyrueshëm rehabilitues; dhe
   2.2. urdhrin për mbikëqyrje nga shërbimi sprovues.

Neni 50
Qëllimi i dënimit me kusht

Qëllimi i dënimit me kusht është që të mos zbatohet dënimi për vepra të lehta penale, kur vlerësohet se tërheqja e vërejtjes me kërcënimin e dënimit është e nevojshme të ndalojë që kryesi të mos kryejë vepër penale.

Neni 51
Dënimi me kusht

1. Gjykata mund t'ia shqiptojë kryesit dënimin me kusht në përputhje me dispozitat e këtij Kodi.
2. Me dënimin me kusht, gjykata ia cakton kryesit të veprës penale dënimin dhe në të njëjtën kohë urdhëron që ky dënim të mos ekzekutohet nëse personi i dënuar nuk kryen vepër tjetër penale për kohën e verifikimit të cilën e cakton gjykata. Koha e verifikimit nuk mund të jetë më e shkurtër se një (1) vit dhe as më e gjatë se pesë (5) vjet.
3. Në dënimin me kusht, gjykata mund të caktojë që dënimi të ekzekutohet, nëse në afatin e caktuar personi i dënuar nuk e kthen dobinë pasurore të fituar me kryerjen e veprës penale, nuk e kompenson dëmin që e ka shkaktuar me vepër penale ose nuk i përmbush detyrimet e tjera të parapara me dispozitat e këtij Kodi. Gjykata cakton afatin për përmbushjen e këtyre kushteve në kuadër të kohës së verifikimit.
4. Kur gjykata shqipton dënimin me burgim ose dënimin me gjobë, gjykata mund të shqiptojë dënimin me kusht për të dy këto dënime ose vetëm për dënimin me burgim.

Neni 52
Kushtet për shqiptimin e dënimit me kusht

1. Dënimi me kusht mund t'i shqiptohet kryesit të veprës penale për të cilën me ligj është paraparë dënimi me burgim deri në pesë (5) vjet.
2. Dënimi me kusht mund t'i shqiptohet kryesit të veprës penale për të cilën me ligj është paraparë dënimi me burgim deri në dhjetë (10) vjet, nëse zbatohen dispozitat e zbutjes së dënimit.
3. Dënimi me kusht mund t'i shqiptohet kryesit sipas paragrafit 1. dhe 2. të këtij neni nëse gjykata shqipton dënimin me gjobë ose me burgim deri në dy (2) vjet, qoftë për një vepër penale ose për disa vepra në bashkim.
4. Me rastin e marrjes së vendimit për shqiptimin e dënimit me kusht, gjykata merr posaçërisht parasysh qëllimin e dënimit me kusht, sjelljen e mëparshme të kryesit, sjelljen e tij pas kryerjes së veprës penale, shkallën e përgjegjësisë penale dhe rrethanat e tjera në të cilat është kryer vepra penale.
5. Kur gjykata shqipton dënimin me burgim ose dënimin me gjobë, gjykata mund të shqiptojë dënimin me kusht për të dy këto dënime ose vetëm për dënimin me burgim.

Neni 53
Revokimi i dënimit me kusht për shkak të veprave të reja penale

1. Gjykata e revokon dënimin me kusht nëse personi i dënuar gjatë kohës së verifikimit kryen një apo më shumë vepra penale për të cilat është shqiptuar dënimi me burgim prej dy (2) apo më tepër vjet.
2. Gjykata mund ta revokojë dënimin me kusht nëse personi i dënuar gjatë kohës së verifikimit kryen një apo shumë vepra penale për të cilat është shqiptuar dënimi me burgim me më pak se dy (2) vjet ose dënimi me gjobë, pasi t'i ketë vlerësuar të gjitha rrethanat të cilat u përkasin veprave penale të kryera si dhe personit të dënuar dhe sidomos ngjashmëritë e veprave penale të kryera, rëndësinë e tyre dhe motivet për kryerjen e veprave penale.
3. Kur revokon dënimin me kusht, gjykata shqipton dënimin unik për veprën penale të kryer më parë edhe për veprën e re penale, në pajtim me nenin 80 të këtij Kodi dhe trajton dënimin e revokuar me kusht si të përcaktuar.
4. Nëse gjykata nuk e revokon dënimin me kusht, mund ta shqiptojë dënimin me kusht apo dënimin me burgim ose dënimin me gjobë për veprën e re penale. Nëse gjykata shqipton dënim me kusht për veprën e re penale, gjykata zbaton dispozitat e nenit 80 të këtij Kodi për ta shqiptuar dënimin e bashkuar me kusht për veprën penale të kryer më parë dhe për veprën e re penale dhe po ashtu e cakton një periudhë të bashkuar të verifikimit e cila nuk mund të jetë më pak se një (1) vit e as më shumë se pesë (5) vjet, duke filluar prej ditës kur vendimi për dënimin bëhet i plotfuqishëm. Nëse gjykata shqipton dënim me burgim për veprën e re penale, periudha kohore që kalohet në mbajtjen e dënimit me burgim nuk hiqet nga koha e verifikimit e vendosur me dënimin me kusht për veprën penale të kryer më parë.

Neni 54
Revokimi i dënimit me kusht për shkak të veprave penale të kryera më parë

Gjykata e revokon dënimin me kusht nëse pas shqiptimit të dënimit me kusht, me aktgjykim të plotfuqishëm konstaton se personi i dënuar ka kryer një vepër penale tjetër para se të jetë dënuar me kusht dhe nëse gjykata vlerëson se nuk do të kishte bazë për shqiptimin e dënimit me kusht po të dihej për atë vepër penale. Në rastin e këtillë zbatohen dispozitat e paragrafit 3. të nenit 53 të këtij Kodi.

Neni 55
Revokimi i dënimit me kusht për shkak të mos përmbushjes së kushteve

Nëse dënimi me kusht është kushtëzuar me përmbushjen e një apo më shumë kushteve të paraparë me paragrafin 3. të nenit 51 dhe nenin 59 të këtij Kodi dhe personi i dënuar nuk përmbush kushtin apo kushtet brenda afatit të caktuar nga gjykata, gjykata mund ta vazhdojë afatin e përmbushjes së kushtit brenda afatit të verifikimit apo mund ta revokojë dënimin me kusht dhe ta ekzekutojë dënimin i cili është caktuar me dënimin me kusht. Nëse gjykata konstaton se personi i dënuar nuk ka mund ta përmbushë kushtin për shkaqe të arsyeshme, gjykata e heq përmbushjen e atij kushti ose e zëvendëson atë me një kusht tjetër përkatës të paraparë me ligj.

Neni 56
Afatet për revokimin e dënimit me kusht

1. Dënimi me kusht mund të revokohet gjatë kohës së verifikimit. Nëse personi i dënuar gjatë kësaj kohe kryen vepër penale për të cilën kërkohet revokimi i dënimit me kusht gjatë kohës së verifikimit, mirëpo kjo është konstatuar me aktgjykim të plotfuqishëm vetëm pas skadimit të kohës së verifikimit, dënimi me kusht mund të revokohet jo më vonë se një (1) vit nga skadimi i kohës së verifikimit.
2. Nëse personi i dënuar brenda afatit të caktuar nga gjykata nuk e përmbush kushtin e shqiptuar nga gjykata siç parashihet në paragrafin 3. të nenit 51 dhe nenit 59 të këtij Kodi, gjykata mund të revokojë dënimin me kusht jo më vonë se një (1) vit nga skadimi i kohës për përmbushjen e detyrimit.

Neni 57
Dënimi me kusht me urdhër për trajtim të detyrueshëm rehabilitues

1. Gjykata mund të shqiptojë dënim me kusht me urdhër për trajtim të detyrueshëm rehabilitues në rast se personi i dënuar e ka shkelur ligjin për herë të parë dhe është i varur nga droga ose alkooli, nëse gjykata, pas shqyrtimit të raportit të shërbimit sprovues, konsideron se faktori kryesor që ka motivuar kryerjen e veprës penale është i lidhur me varësinë e tij nga droga ose alkooli dhe se trajtimi i suksesshëm do ta zvogëlonte rrezikun për kryerjen e veprës së re penale. Gjykata cakton periudhën gjatë së cilës programi për trajtim të detyrueshëm duhet të fillojë dhe të përfundojë. Periudha e trajtimit të detyrueshëm nuk mund të jetë më pak se tre (3) muaj apo më tepër se dymbëdhjetë (12) muaj.

2. Programi i trajtimit rehabilitues mbikëqyret nga shërbimi sprovues.
3. Dënimi konsiderohet se është mbajtur me kryerjen e suksesshme të programit të trajtimit rehabilitues siç kërkohet nga shërbimi sprovues.
4. Nëse personi i dënuar largohet nga programi i trajtimit rehabilitues, nuk mban kontaktin me shërbimin sprovues ose nuk i përmbush detyrimet lidhur me urdhrin për trajtim, gjykata mund të zëvendësojë detyrimin e mëparshëm me një tjetër, ta shtyj kohëzgjatjen e urdhrit për trajtim ose ta revokojë dënimin me kusht dhe të urdhërojë ekzekutimin e dënimit të caktuar në dënimin me kusht.

Neni 58
Dënimi me kusht me urdhër për mbikëqyrje nga shërbimi sprovues

1. Gjykata mund të shqiptojë dënimin me kusht me urdhër për mbikëqyrje nga shërbimi sprovues nëse konsideron se integrimi i të dënuarit në shoqëri ose përmbushja e kushteve të shqiptuara nga gjykata arrihet më mirë përmes mbikëqyrjes nga ana e shërbimit sprovues.
2. Kur shqipton dënimin me kusht me urdhër për mbikëqyrje nga shërbimi sprovues, gjykata e urdhëron personin e dënuar që të mbajë kontaktin me shërbimin sprovues. Gjykata, po ashtu mund të shqiptojë një apo më shumë nga kushtet e parapara me paragrafin 3. të nenit 51 ose nenit 59 të këtij Kodi. Kohëzgjatja e një kushti të shqiptuar nuk mund të jetë më pak se gjashtë (6) muaj e as më shumë se tre (3) vjet.
3. Me rastin e zgjedhjes midis detyrimeve të parapara me nenin 59 të këtij Kodi, gjykata në veçanti merr parasysh moshën e personit të dënuar; gjendjen e tij të përgjithshme shëndetësore dhe mendore; mënyrën e jetesës dhe nevojat e tij, veçanërisht nevojat në lidhje me familjen, shkollën dhe punën; motivet për kryerjen e veprës penale; sjelljen e tij pas kryerjes së veprës penale; sjelljen e tij të kaluar; rrethanat e tij personale dhe ato në lidhje me familjen; dhe rrethanat tjera që janë të rëndësishme për zgjedhjen e llojit dhe kohëzgjatjes së mbikëqyrjes.
4. Nëse personi i dënuar nuk mban kontaktin me shërbimin sprovues ose nuk e përmbush detyrimin e paraparë me nenin 59 të këtij Kodi siç është urdhëruar nga gjykata, gjykata mund ta zëvendësojë detyrimin e mëparshëm me një tjetër, ta shtyjë kohëzgjatjen e mbikëqyrjes në kuadër të kohës së verifikimit ose ta revokojë dënimin me kusht.

Neni 59
Llojet e detyrimeve të caktuara në dënimin me kusht

1. Dënimi me kusht mund të përfshijë edhe urdhrin për të përmbushur një apo më shumë nga detyrimet e mëposhtme:
   1.1. mjekimi ose rehabilitimi në entin e kujdesit shëndetësor;
   1.2. nënshtrimi në programin e trajtimit mjekësor ose të rehabilitimit;
   1.3. vizita te psikologu ose te këshilluesit e tjerë dhe veprimi në pajtim me rekomandimet e tyre;
   1.4. aftësimi profesional në një profesion të caktuar;
   1.5. kryerja e aktiviteteve punuese;
   1.6. shfrytëzimi i pagës dhe i të ardhurave apo pasurisë tjetër për përmbushjen e detyrimeve familjare;

1.7. mos ndërrimi i vendbanimit pa informuar shërbimin sprovues;
1.8. heqja dorë nga përdorimi i alkoolit apo i drogës;
1.9. heqja dorë nga frekuentimi i vendeve apo lokaleve të caktuara;
1.10. heqja dorë nga shoqërimi ose kontaktimi me persona të caktuar;
1.11. heqja dorë nga mbajtja e çfarëdo lloji të armëve;
1.12. të kompensojë ose dëmshpërblejë viktimën e veprës penale;
1.13. të kthejë dobinë pasurore të fituar me kryerjen e veprës penale;
1.14. të mos posedojë apo përdor kompjuterin ose të mos qaset në internet siç kërkohet nga gjykata ose
1.15. të ofrojë raporte financiare siç kërkohet nga gjykata.

Neni 60
Dënimi me urdhër për punë në dobi të përgjithshme

1. Gjykata mund t'ia shqiptojë personit të dënuar dënimin me urdhër për punë në dobi të përgjithshme nëse kryesit i shqipton dënim me gjobë deri në dymijepesëqind (2.500) Euro ose me burgim deri në një (1) vit. Puna në dobi të përgjithshme mund të caktohet vetëm me pëlqimin e personit të dënuar.
2. Nëse e shqipton dënimin me urdhër për punë në dobi të përgjithshme, gjykata e urdhëron personin e dënuar të kryejë pa pagesë, punë në dobi të përgjithshme për një periudhë të caktuar prej tridhjetë (30) deri në dyqind e katërdhjetë (240) orë pune. Shërbimi sprovues vendos për llojin e punës në dobi të përgjithshme që duhet të kryhet nga personi i dënuar, cakton organizatën e veçantë për të cilën personi i dënuar do të kryejë punën në dobi të përgjithshme, vendos për ditët e javës gjatë të cilave puna në dobi të përgjithshme duhet të kryhet dhe mbikëqyrë kryerjen e punës në dobi të përgjithshme.
3. Puna në dobi të përgjithshme kryhet brenda një periudhe kohore të përcaktuar nga gjykata, e cila nuk e tejkalon një (1) vit.
4. Nëse e shqipton dënimin me urdhër për punë në dobi të përgjithshme, gjykata, po ashtu, mund t'i urdhërojë personit të dënuar të mbajë kontaktin me shërbimin sprovues ose kryerjen e një apo më shumë prej detyrimeve të parapara me paragrafin 3. të nenit 51 ose me nenin 59 të këtij Kodi. Kohëzgjatja e detyrimit të paraparë me nenin 59 nuk duhet të jetë më e shkurtë se gjashtë (6) muaj ose më e gjatë se sa tri (3) vjet. Neni 58 paragrafi 3. i këtij Kodi zbatohet përshtatshmërisht për detyrimin e urdhëruar me këtë paragraf.
5. Nëse personi i dënuar nuk e kryen punën në dobi të përgjithshme, ose e kryen pjesërisht gjykata mund ta shtyjë kohëzgjatjen e mbikëqyrjes brenda kohës së verifikimit ose ta revokojë dënimin.
6. Nëse pas kalimit të kohës së caktuar personi i dënuar nuk e ka kryer punën në dobi të përgjithshme ose e ka kryer vetëm pjesërisht punën e tillë në dobi të përgjithshme, gjykata urdhëron dënimin me burgim. Një (1) ditë burgim do të urdhërohet për çdo tetë (8) orë pune në dobi të përgjithshme që nuk është kryer.

Neni 61
Gjysmëliria

1. Kur shqipton dënimin me burgim deri në një (1) vit, gjykata mund të urdhërojë ekzekutimin e dënimit në gjysmëliri për shkak të detyrimeve të personit të dënuar lidhur me punën, arsimimin ose aftësimin profesional, përgjegjësitë esenciale familjare apo nevojën për trajtim mjekësor ose rehabilitues.
2. Gjatë vuajtjes së dënimit në gjysmëliri, personi i dënuar detyrohet të kthehet në burg pas kryerjes së detyrimeve jashtë burgut brenda kohës së caktuar nga gjykata.
3. Kur personi i dënuar nuk i përmbush detyrimet nga paragrafi 1. i këtij neni, gjykata e revokon urdhrin për ekzekutimin e dënimit në gjysmëliri dhe urdhëron mbajtjen e dënimit të mbetur në burg.
4. Kur gjykata urdhëron ekzekutimin e dënimit në gjysmëliri, ajo po ashtu mund të shqiptojë një apo më shumë nga kushtet e përcaktuara me nenet paragrafin 3. të nenit 51 ose nenin 59 të këtij Kodi.

DËNIMET PLOTËSUESE

Neni 62
Dënimet plotësuese

1. Dënimi plotësues mund të shqiptohet së bashku me dënimin kryesor ose alternativ.
2. Dënimet plotësuese janë:
   2.1. heqja e të drejtës për t'u zgjedhur;
   2.2. urdhri për kompensimin e humbjes apo dëmit;
   2.3. ndalimi i ushtrimit të funksioneve në administratën publike ose në shërbimin publik;
   2.4. ndalimi i ushtrimit të profesionit, i veprimtarisë ose detyrës;
   2.5. ndalimi i drejtimit të automjetit;
   2.6. marrja e lejes së vozitjes;
   2.7. konfiskimi;
   2.8. urdhri për publikimin e aktgjykimit dhe
   2.9. dëbimi i të huajit nga territori i Republikës së Kosovës.
3. Dënimi plotësues me ndalimin e drejtimit të automjetit ose marrjen e sendit mund të shqiptohet së bashku me dënimin me kusht, me vërejtjen gjyqësore ose me lirimin nga dënimi.

Neni 63
Heqja e të drejtës për t'u zgjedhur

Gjykata ia heq kryesit të veprës penale të drejtën për tu zgjedhur prej një (1) deri në katër (4) vjet, nëse ai person, me qëllim që të zgjidhet, kryen ndonjë nga veprat penale kundër të drejtave të votimit ose vepër tjetër penale për të cilën është paraparë dënimi me së paku dy (2) vjet burgim.

Neni 64
Urdhri për kompensimin e humbjes apo dëmit

1. Kur gjykata dënon personin i cili është shpallur fajtor për çfarëdo vepre penale që përfshin vjedhjen, humbjen, dëmtimin apo shkatërrimin e pasurisë, gjykata do të urdhërojë kryesin që të bëjë dëmshpërblimin e viktimës së veprës penale.
2. Dëmshpërblimi përfshin vlerën e shpenzimeve që janë të barabarta me vlerën e çfarëdo pasurie të vjedhur, humbur, dëmtuar apo shkatërruar. Dëmshpërblimi do të urdhërohet gjithashtu edhe për çfarëdo humbje të të ardhurave të cilat viktima i përjeton si rezultat i veprës penale dhe procedurave hetimore dhe gjyqësore lidhur me atë vepër.

Neni 65
Ndalimi i ushtrimit të funksioneve në administratën publike ose në shërbimin publik

1. Gjykata ia ndalon kryesit ushtrimin e funksioneve në administratën publike ose në shërbimin publik prej një (1) deri në pesë (5) vjet pas mbajtjes së dënimit me burgim, nëse personi i tillë ka keqpërdorur këto funksione dhe është dënuar me burgim.
2. Gjykata mund t'ia ndalojë kryesit ushtrimin e funksioneve në administratën publike ose në shërbimin publik prej një (1) deri në tre (3) vjet, nëse personi i tillë i ka keqpërdorur këto funksione dhe është dënuar me gjobë ose me dënim me kusht.

Neni 66
Ndalimi i ushtrimit të profesionit, veprimtarisë ose detyrës

1. Gjykata mund t'ia ndalojë kryesit të veprës penale ushtrimin e profesionit të caktuar, veprimtarisë së pavarur, detyrës menaxhuese apo administrative ose detyrave që janë të lidhura me sistemimin, menaxhimin apo shfrytëzimin e pasurisë në pronësi publike apo mbrojtjen e pasurisë së tillë, nëse ai person e ka keqpërdoruar pozitën e tij, veprimtarinë apo detyrën me qëllim të kryerjes së veprës penale ose nëse ka arsye të pritet që ushtrimi i profesionit, veprimtarisë apo detyrës së tillë nga ai mund të keqpërdoret për kryerjen e veprës penale.
2. Gjykata e cakton kohëzgjatjen e dënimit të caktuar sipas paragrafit 1. të këtij neni, i cili nuk mund të jetë më i shkurtër se një (1) vit e as më i gjatë se pesë (5) vjet, duke llogaritur nga dita kur vendimi merr formën e prerë. Koha e mbajtur në burg ose në institucionin e kujdesit shëndetësor nuk llogaritet në kohëzgjatje të këtij dënimi.
3. Kur shqipton dënimin me kusht, gjykata mund të vendosë që ky dënim me kusht të revokohet nëse kryesi nuk e respekton ndalesën e ushtrimit të profesionit, veprimtarisë apo detyrës.

Neni 67
Ndalimi i drejtimit të automjetit

1. Kryesit të veprës penale, i cili rrezikon sigurinë në trafikun publik, gjykata mund t'ia ndalojë drejtimin e automjetit të llojit apo të kategorisë së caktuar.

2. Gjykata cakton kohëzgjatjen e dënimit të urdhëruar sipas paragrafit 1. të këtij neni, kohëzgjatja e të cilit nuk mund të jetë më e shkurtë se një (1) vit e as më e gjatë se pesë (5) vjet, duke llogaritur nga dita kur vendimi merr formën e prerë. Koha e kaluar në burg apo në institucionin e kujdesit shëndetësor nuk llogaritet në kohëzgjatjen e këtij dënimi.
3. Kur shqipton dënimin me kusht, gjykata mund të vendosë që dënimi i tillë të revokohet nëse kryesi e shkel ndalesën e drejtimit të automjetit. Ky paragraf nuk zbatohet nëse paraqiten rrethana të jashtëzakonshme të cilat kërkojnë nga kryesi që të drejtojë automjetin.
4. Nëse dënimi nga paragrafi 1. i këtij neni i është shqiptuar personit i cili ka leje të huaj për drejtimin e automjetit, ky dënim do të konsistojë në ndalimin për përdorimin e lejes së huaj në territorin e Republikës së Kosovës.

Neni 68
Marrja e lejes së vozitjes

1. Kryesit të veprës penale që e rrezikon sigurinë në trafikun publik, gjykata mund t'ia marrë lejen e vozitjes për llojin apo kategorinë e caktuar të automjetit dhe mund t'ia ndalojë kryesit marrjen e lejes së re gjatë periudhës prej një (1) deri në pesë (5) vjet. Nëse kryesi nuk ka leje të vozitjes, gjykata ia ndalon kryesit marrjen e lejes së vozitjes brenda afatit prej një (1) deri në pesë (5) vjet.
2. Gjykata mund të shqiptojë dënimin nga paragrafi 1. i këtij neni nëse kryesi ka kryer vepër penale duke shkaktuar lëndim të rëndë trupor apo vdekjen e personit ose nëse gjykata konstaton se pjesëmarrja e mëtejshme e kryesit në trafikun publik është e rrezikshme për sigurinë e trafikut publik për shkak të paaftësisë së tij për drejtimin e sigurt të automjetit.
3. Leja e vozitjes merret me vendim të formës së prerë të gjykatës. Koha e mbajtur në burg apo në institucionin e kujdesit shëndetësor nuk llogaritet në kohëzgjatjen e këtij dënimi.
4. Pas skadimit të afatit të caktuar nga gjykata, kryesi mund ta marrë lejen e re të vozitjes sipas kushteve të përgjithshme të parapara për marrjen e lejes përkatëse të vozitjes.

Neni 69
Marrja e sendit

1. Sendet e përdorura apo të destinuara për kryerjen e veprës penale apo sendet të cilat janë rezultat i kryerjes së veprës penale do të konfiskohen.
2. Sendet nga paragrafi 1. i këtij neni mund të konfiskohen edhe kur nuk janë pronë e kryesit nëse kjo është në dobi të sigurisë së përgjithshme ose për arsye të moralit, nëse kjo nuk ndikon dëmshëm mbi të drejtat e palës së tretë për të marrë nga kryesi kompensimin e çfarëdo dëmi.
3. Me ligj mund të përcaktohet marrja e detyrueshme e sendit.

Neni 70
Urdhri për publikimin e aktgjykimeve

1. Gjykata mund të urdhërojë publikimin e aktgjykimit kur çmon se publikimi është në interes të përgjithshëm, të të dëmtuarit ose të personave të tjerë.
2. Urdhri për publikimin e aktgjykimit kërkon që aktgjykimi të publikohet, tërësisht ose pjesërisht, në gazetë apo të transmetohet në radio ose televizion. Publikimi bëhet me shpenzimet e të dënuarit.
3. Data dhe kohëzgjatja e publikimit caktohen nga gjykata.
4. Gazeta, radiostacioni ose stacioni televiziv e publikojnë aktgjykimin të cilin ua ka dërguar gjykata.
5. Publikimi i aktgjykimit nuk urdhërohet nëse publikimi i tillë e rrezikon fshehtësinë zyrtare, privatësinë e personave apo moralin e shoqërisë.

Neni 71
Dëbimi i të huajve nga territori i Republikës së Kosovës

1. Gjykata mund të urdhërojë dëbimin e të huajit nga territori i Republikës së Kosovës në kohëzgjatje prej një (1) deri në dhjetë (10) vjet.
2. Kur gjykata vendos për shqiptimin e dënimit nga paragrafi 1. i këtij neni dhe kohëzgjatjen e këtij dënimi, gjykata merr parasysh llojin dhe peshën e veprës penale, motivet e kryerjes së veprës penale dhe lidhjen e kryesit me Republikën e Kosovës.
3. Dënimi nga paragrafi 1. i këtij neni nuk shqiptohet nëse ekzekutimi i dënimit është në kundërshtim me të drejtën ndërkombëtare.
4. Kohëzgjatja e dëbimit llogaritet nga dita kur vendimi gjyqësor merr formën e prerë. Koha e mbajtur në burg ose në institucionin e kujdesit shëndetësor nuk llogaritet në kohëzgjatjen e këtij dënimi.

Neni 72
Ekzekutimi i dënimeve plotësuese

1. Në pajtim me paragrafin 2. të këtij neni, ekzekutimi i dënimeve plotësuese të parapara në nenin 62 të këtij Kodi fillon së bashku me ekzekutimin e dënimit kryesor ose të dënimit alternativ.
2. Ekzekutimi i dënimeve plotësuese nga nën-paragrafët 2.1; 2.2; 2.3; 2.4; 2.5; dhe 2.8 të paragrafit 2. të nenit 62 të këtij Kodi fillon pas mbajtjes së dënimit me burgim. Gjatë kohës së mbajtjes së dënimit me burgim, personi i dënuar nuk mund t'i gëzojë të drejtat e kufizuara nga dënimet plotësuese.

MATJA E DËNIMIT

Neni 73
Rregullat e përgjithshme për matjen e dënimit

1. Kur cakton dënimin për vepër penale, gjykata duhet të ketë parasysh minimumin dhe maksimumin e dënimit të paraparë për atë vepër penale. Gjykata pastaj duhet të

merr parasysh qëllimin e dënimit, parimet e përcaktuara në këtë kapitull dhe rrethanat lehtësuese dhe rënduese lidhur me veprën penale të caktuar ose me dënimin.

2. Dënimi duhet të jetë në proporcion me peshën e veprës dhe me sjelljen dhe rrethanat e kryesit.
3. Me rastin e caktimit të dënimit, gjykata merr parasysh por nuk kufizohet në rrethanat e mëposhtme:
   3.1. shkallën e përgjegjësisë penale;
   3.2. motivet për kryerjen e veprës;
   3.3. intensitetin e rrezikimit apo të dëmtimit të vlerës së mbrojtur;
   3.4. rrethanat në të cilat është kryer vepra;
   3.5. sjelljen e mëparshme të kryesit;
   3.6. pranimin e fajit dhe
   3.7. rrethanat personale të kryesit dhe sjelljen e tij pas kryerjes së veprës penale.
4. Kur cakton dënimin për recidivistin, gjykata posaçërisht merr parasysh nëse kryesi më parë ka kryer vepër penale të njëjtë sikurse veprën e re, nëse të dy veprat janë kryer për të njëjtat motive dhe kohën e kaluar nga shqiptimi i dënimit të mëparshëm apo nga dënimi i mbajtur ose i falur.
5. Me rastin e caktimit të dënimit me gjobë, gjykata merr parasysh edhe gjendjen pasurore të kryesit dhe posaçërisht merr parasysh shumën e të ardhurave personale, të ardhurat e tjera, pasurinë dhe detyrimet e tij. Gjykata nuk cakton gjobë në lartësinë që është mbi mundësitë e kryesit.

Neni 74
Rregullat e përgjithshme për zbutjen ose ashpërsimin e dënimeve

1. Kryesit të veprës penale i shqiptohet dënimi i paraparë për veprën e kryer penale, ndërsa dënimi më i butë ose më i rëndë mund të shqiptohet vetëm në pajtim me kushtet e parapara me këtë Kod.
2. Me rastin e caktimit të dënimit, gjykata merr parasysh por nuk kufizohet në rrethanat e mëposhtme rënduese:
   2.1. shkallën e lartë të pjesëmarrjes së personit të dënuar në veprën penale;
   2.2. shkallën e lartë të dashjes nga ana e personi të dënuar, përfshirë çfarëdo prove të paramendimit;
   2.3. prezencën e dhunës ose kanosjes me dhunë në kryerjen e veprës penale;
   2.4. nëse vepra penale është kryer në mënyrë posaçërisht mizore;
   2.5. nëse vepra penale përfshin disa viktima;
   2.6. nëse viktima e veprës penale ka qenë posaçërisht e pambrojtur apo e ndjeshme;
   2.7. mosha e viktimës, nëse është i ri apo i moshuar;
   2.8. shkallën e dëmit të shkaktuar nga personi i dënuar, përfshirë vdekjen, lëndimin e përhershëm, transmetimin e sëmundjes tek viktima apo çfarëdo dëmi tjetër të shkaktuar viktimës ose familjes së tij;
   2.9. çfarëdo keqpërdorimi të pushtetit ose pozitës zyrtare nga personi i dënuar në kryerjen e veprës penale;
   2.10. dëshmi të shkeljes së besimit nga ana e personit të dënuar;

2.11. nëse vepra penale është kryer si pjesë e veprimtarisë së grupit të organizuar kriminal dhe/ose;
2.12. nëse vepra penale kryhet ndaj personit ose grupit të personave, ose pronës, për shkak të origjinës etnike ose kombëtare, shtetësisë, gjuhës, besimeve fetare, ose mungesës së besimeve fetare, ngjyrës, gjinisë, orientimeve seksuale, ose për shkak të afërsisë me personat me karakteristikat e lartpërmendura;
2.13. ndonjë dënim penal të mëparshëm të personit të dënuar.

3. Me rastin e caktimit të dënimit, gjykata merr parasysh por nuk kufizohet në rrethanat e mëposhtme lehtësuese:
3.1. rrethanat të cilat për pak nuk arrijnë të jenë bazë për përjashtimin e përgjegjësisë penale, si për shembull, aftësia e zvogëluar mendore;
3.2. dëshmia për provokim nga ana e viktimës;
3.3. rrethanat personale dhe karakteri i personit të dënuar;
3.4. dëshmia që personi i dënuar ka luajtur rol relativisht të vogël në veprën penale;
3.5. fakti që personi i dënuar ka marrë pjesë në veprën penale jo si kryes kryesor por përmes ndihmës, inkurajimit ose duke ndihmuar tjetrin në ndonjë mënyrë tjetër;
3.6. mosha e personit të dënuar, i ri apo i moshuar;
3.7. dëshmia që personi i dënuar ka bërë restituimin apo kompensimin e viktimës;
3.8. bashkëpunimi i përgjithshëm i personit të dënuar me gjykatën, përfshirë dorëzimin vullnetar;
3.9. bashkëpunimin vullnetar të personit të dënuar në hetimin ose ndjekjen penale;
3.10. pranimin e fajit;
3.11. keqardhjen e shfaqur nga personi i dënuar;
3.12. sjelljen e personit të dënuar pas konfliktit; dhe/apo
3.13. në rastet kur personi është i dënuar për veprën penale të marrjes së pengjeve, rrëmbimit apo privimit të kundërligjshëm nga liria ose siç përcaktohet në nenet 175, 194 ose 196 të këtij Kodi, kontributi në mënyrë efektive për lëshimin ose për ta sjellë të gjallë personin e rrëmbyer, marrë apo ndalur ose dhënia vullnetare e informatave që kontribuojnë në identifikimin e përgjegjësve të tjerë për vepër penale.

Neni 75
Zbutja e dënimeve

1. Gjykata mund të shqiptojë dënim nën kufirin e paraparë me ligj apo të shqiptojë lloj më të butë të dënimit:
1.1. kur ligji parasheh që dënimi i kryesit mund të zbutet apo të zvogëlohet;
1.2. kur gjykata konstaton se ekzistojnë rrethana posaçërisht lehtësuese të cilat tregojnë se qëllimi i dënimit mund të arrihet edhe me shqiptimin e dënimit më të butë; ose
1.3. në rastet kur kryesi pranon fajësinë ose ka arritur marrëveshje për pranimin e fajësisë. Në raste të tilla, gjykata merr parasysh mendimin e prokurorit,

mbrojtësit dhe palës së dëmtuar sa i përket zbutjes së dënimit dhe udhëzohet por nuk detyrohet nga kufizimet e parapara në nenin 76 të këtij Kodi.

Neni 76
Kufijtë e zbutjes së dënimeve

1. Kur ekzistojnë kushtet për zbutjen e dënimit nga neni 75 i këtij Kodi, gjykata mund të zbusë dënimin brenda kufijve në vijim:
   1.1. nëse për veprën penale është paraparë si masë më e ulët dënimi me burgim prej së paku dhjetë (10) vjet, dënimi mund të zbutet deri në pesë (5) vjet burgim;
   1.2. nëse për veprën penale është paraparë si masë më e ulët dënimi me burgim prej së paku pesë (5) vjet, dënimi mund të zbutet deri në tre (3) vjet burgim;
   1.3. nëse për veprën penale është paraparë si masë më e ulët dënimi me burgim prej së paku tre (3) vjet, dënimi mund të zbutet deri në një (1) vit burgim;
   1.4. nëse për veprën penale është paraparë si masë më e ulët dënimi me burgim prej dy (2) vjet, dënimi mund të zbutet deri në gjashtë (6) muaj burgim;
   1.5. nëse për veprën penale është paraparë si masë më e ulët dënimi me burgim prej një (1) viti, dënimi mund të zbutet deri në tre (3) muaj burgim;
   1.6. nëse për veprën penale është paraparë si masë më e ulët dënimi me burgim me më pak se një (1) vit, dënimi mund të zbutet deri në tridhjetë (30) ditë burgim;
   1.7. nëse për veprën penale nuk është paraparë masa më e ulët e dënimit, atëherë mund të shqiptohet dënimi me gjobë në vend të dënimit me burgim;
   1.8. nëse për veprën penale nuk është paraparë shuma më e ulët e gjobës, gjoba mund të zbutet deri në njëqind (100) Euro.
2. Me rastin e vendosjes së shkallës së zbutjes së dënimit sipas paragrafit 1. të këtij neni, gjykata në veçanti merr parasysh shkallën më të ulët dhe më të lartë të dënimit të paraparë për vepër penale.

Neni 77
Lirimi nga dënimi

1. Gjykata mund ta lirojë nga dënimi, kryesin e veprës penale vetëm kur kjo shprehimisht parashihet me ligj.
2. Kur gjykata është e autorizuar me ligj që kryesin e veprës penale ta lirojë nga dënimi, ajo mund t'ia zbusë dënimin pa marrë parasysh kufizimet e parapara për zbutjen e dënimit.

Neni 78
Bazat e posaçme të lirimit nga dënimi për vepra penale të kryera nga pakujdesia

1. Gjykata mund ta lirojë nga dënimi kryesin e veprës penale të kryer nga pakujdesia në rastet e mëposhtme:
   1.1. nëse pasojat e asaj vepre penale e godasin kryesin aq rëndë sa që dënimi është i panevojshëm për realizimin e qëllimit të tij; ose

1.2. nëse kryesi menjëherë pas kryerjes së veprës penale ka bërë përpjekje për evitimin ose zvogëlimin e pasojave të asaj vepre dhe nëse në tërësi apo në një masë të madhe e ka kompensuar dëmin e shkaktuar me atë vepër.

Neni 79
Ashpërsimi i dënimit për recidivizëm të shumëfishtë

1. Për veprën penale të kryer me dashje, për të cilën është paraparë dënimi me burgim, gjykata mund të shqiptojë dënim më të rëndë nga sa është paraparë me ligj në rastet në vijim:
   1.1. nëse kryesi është dënuar më parë dy (2) apo më shumë herë me burgim prej së paku një (1) vit për vepra penale të kryera me dashje dhe
   1.2. nëse nga dita e lirimit të kryesit ose e përfundimit të dënimit të mëparshëm deri në kryerjen e veprës së re penale kanë kaluar më pak se pesë (5) vjet.
2. Gjykata mund t'i shqiptojë dënim më të rëndë recidivistit duke shtuar jo më shumë se gjysmën e maksimumit të dënimit.
3. Me rastin e vlerësimit për shqiptimin e dënimit më të rëndë, gjykata posaçërisht merr parasysh pranimin e fajit, ngjashmërinë e veprave penale të kryera, motivet nga të cilat janë kryer, rrethanat në të cilat janë kryer si dhe nevojën për shqiptimin e dënimit të tillë për ta realizuar qëllimin e dënimit.
4. Ky nen nuk zbatohet për dënim me burgim të përjetshëm.

Neni 80
Dënimi për bashkim të veprave penale

1. Nëse kryesi me një apo me më shumë veprime kryen disa vepra penale për të cilat gjykohet në të njëjtën kohë, gjykata së pari shpall dënime për secilën nga këto vepra, e pastaj për të gjitha këto vepra e shqipton dënimin unik.
2. Gjykata shqipton dënimin unik sipas këtyre rregullave:
   2.1. nëse për ndonjërën prej veprave penale gjykata ka shqiptuar dënimin me burgim të përjetshëm, atëherë e shqipton vetëm këtë dënim;
   2.2. nëse për secilën prej veprave penale gjykata ka shqiptuar dënimin me burgim, dënimi unik duhet të jetë më i madh se çdo dënim i veçantë, por dënimi unik nuk mund ta arrijë shumën e të gjitha dënimeve të përcaktuara dhe as të tejkalojë periudhën prej njëzet e pesë (25) vjetësh;
   2.3. nëse gjykata e ka shqiptuar dënimin me burgim deri në tri (3) vjet për secilën nga veprat penale, dënimi unik me burgim nuk mund të jetë më i lartë se tetë (8) vjet;
   2.4. nëse gjykata ka shqiptuar dënime me gjobë për secilën nga veprat penale, dënimi unik me gjobë është shuma e dënimeve të shqiptuara por nuk mund të tejkalojë shumën prej njëzet e pesë mijë (25.000) Euro, përkatësisht pesëqind mijë (500.000) Euro kur një apo shumë vepra penale janë kryer me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore;
   2.5. nëse gjykata për disa vepra penale ka shqiptuar dënime me burgim, ndërsa për vepra të tjera ka shqiptuar dënimin me gjobë, gjykata shqipton dënim unik me burgim dhe me gjobë, në pajtim me nën-paragrafët 2.1. deri 2.4. të këtij paragrafi.

3. Gjykata shqipton dënimin plotësues nëse është shqiptuar së paku për një nga veprat penale të parapara në nën-paragrafin 2.4. të paragrafit 2. të këtij neni.

Neni 81
Dënimi për veprat penale në vazhdim

1. Vepra penale në vazhdim përbëhet nga disa vepra të njëjta ose të ngjashme të kryera në lidhshmëri kohore nga i njëjti kryes, dhe të cilat paraqesin tërësi për shkak të ekzistimit të së paku dy prej kushteve në vijim:
   1.1. viktimës së njëjtë të veprës penale;
   1.2. objekti i njëjtë i veprës;
   1.3. shfrytëzimi i situatës apo marrëdhënies së njëjtë kohore;
   1.4. vendi apo hapësira e njëjtë e kryerjes së veprës penale; dhe
   1.5. dashja e njëjtë e kryesit.
2. Veprat penale të kryera kundër personit mund të konsiderohen si vepër penale në vazhdim vetëm nëse janë kryer kundër të njëjtit person.
3. Veprat penale në vazhdim, të cilat për shkak të natyrës së tyre nuk mund të bashkohen në një vepër, nuk konsiderohen vepra penale në vazhdim.
4. Nëse vepra penale në vazhdim përfshin forma të rënda dhe të lehta të të njëjtës vepër, konsiderohet se vepra penale në vazhdim është kryer në formën e rëndë.
5. Nëse vepra penale në vazhdim përfshin veprat penale element i të cilave është shuma në para, vepra penale në vazhdim do të përcaktohet nga shuma e tërësishme e realizuar me të gjitha veprat e veçanta.
6. Vepra penale e cila nuk është përfshirë në veprën penale në vazhdim në aktgjykimin e plotfuqishëm të gjykatës, por është zbuluar më vonë, paraqet vepër penale të veçantë.

Neni 82
Llogaritja e dënimit të personave të dënuar

1. Nëse personi i dënuar gjykohet për vepër penale të kryer para se të ketë filluar mbajtjen e dënimit të shqiptuar me një dënim të mëparshëm, apo për vepër penale të kryer gjatë kohës së mbajtjes së dënimit me burgim, gjykata shqipton dënimin unik për të gjitha veprat penale (neni 80 i këtij Kodi), duke marrë parasysh dënimin e shqiptuar më parë. Dënimi ose pjesa e dënimit të cilin personi i dënuar e ka mbajtur llogaritet në dënimin e shqiptuar unik.
2. Për vepër penale të kryer gjatë kohës së mbajtjes së dënimit me burgim, gjykata ia cakton dënimin kryesit pavarësisht nga dënimi i shqiptuar më parë nëse zbatimi i dispozitave të nenit 80 të këtij Kodi nuk do ta arrinte qëllimin e dënimit, duke marrë parasysh kohëzgjatjen e pjesës së pa mbajtur të dënimit të shqiptuar më parë.

Neni 83
Llogaritja e paraburgimit dhe e dënimit të mëparshëm

1. Koha e kaluar në paraburgim, arrest shtëpiak si dhe çdo periudhë e heqjes së lirisë lidhur me veprën penale llogariten në dënimin e shqiptuar me burgim dhe me gjobë.

2. Dënimi me burgim ose me gjobë të cilin personi i dënuar e ka mbajtur, përkatësisht e ka paguar për kundërvajtje apo për delikt ekonomik, përfshihet në dënimin e shqiptuar për vepër penale, elementet e së cilës përfshijnë edhe elementet e kundërvajtjes apo të deliktit ekonomik.
3. Masa mbrojtëse e cila është shqiptuar për kundërvajtje ose për delikt ekonomik përfshihet në dënimin plotësues për vepër penale, elementet e së cilës i përfshijnë edhe elementet e kundërvajtjes apo të deliktit ekonomik.
4. Një (1) ditë paraburgim, një (1) ditë heqje lirie, një (1) ditë burgim, dhe njëzet (20) Euro të dënimit me gjobë barazohen për qëllime të llogaritjes sipas këtij neni.

Neni 84
Llogaritja e paraburgimit dhe e dënimeve të mbajtura në juridiksione të tjera

Paraburgimi, heqja e lirisë gjatë procedurës së transferimit të personit në një juridiksion tjetër dhe pjesa e dënimit të cilin e ka mbajtur kryesi sipas aktgjykimit të gjykatës së huaj do t'i llogaritet në dënimin e shqiptuar nga gjykata në Kosovë për të njëjtën vepër, e nëse dënimi i shqiptuar jashtë Kosovës nuk është i llojit të njëjtë, llogaritja do të bëhet sipas vlerësimit të gjykatës.

KAPITULLI IV
VËREJTJA GJYQËSORE

Neni 85
Qëllimi i vërejtjes gjyqësore

Qëllimi i vërejtjes gjyqësore është që t'i jepet kryesit qortimi kur, duke pasur parasysh të gjitha rrethanat në lidhje me veprën dhe kryesin, vërejtja gjyqësore është e mjaftueshme për të arritur qëllimin e dënimit.

Neni 86
Vërejtja gjyqësore

1. Me vërejtje gjyqësore kryesit i bëhet me dije se ka kryer një vepër të dëmshme dhe të rrezikshme, që përbën vepër penale dhe nëse kryen prapë vepër të tillë, gjykata do të shqiptojë sanksion më të rëndë penal.
2. Vërejtja gjyqësore mund të shqiptohet për vepra penale për të cilat është paraparë dënimi me burgim deri në një (1) vit ose dënimi me gjobë, në rastet kur veprat e tilla janë kryer në rrethana lehtësuese të cilat i bëjnë veprat penale veçanërisht të lehta.
3. Vërejtja gjyqësore mund të shqiptohet edhe për vepra penale të caktuara për të cilat është paraparë dënimi deri në tri (3) vjet, sipas kushteve të përcaktuara me ligj.
4. Gjykata mund të shqiptojë vërejtjen e gjykatës për më shumë se një vepër penale të kryer në bashkim, nëse për çdonjërën nga këto vepra ekzistojnë kushtet nga paragrafi 2. ose 3. i këtij neni.
5. Me rastin e vendosjes për shqiptimin e vërejtjes gjyqësore, gjykata veçanërisht merr parasysh qëllimin e vërejtjes gjyqësore, sjelljen e kryesit në të kaluarën, sjelljen e tij

pas kryerjes së veprës penale, shkallën e përgjegjësisë penale, rrethanat e tjera në të cilat është kryer vepra penale dhe pjesëmarrjen vullnetare të kryesit në programin e trajtimit.

KAPITULLI V
MASAT E TRAJTIMIT TË DETYRUESHËM

Neni 87
Parimet e përgjithshme

1. Kryesi me çrregullim mendor ose personi i cili është duke u trajtuar si i tillë, do të trajtohet me humanizëm dhe me respekt për dinjitetin e qenësishëm të njeriut.
2. Standardet ndërkombëtare të zbatueshme për personat me çrregullim mendor zbatohen për kryesin me çrregullim mendor për aq sa është e mundur, me ndryshime dhe përjashtime të kufizuara vetëm për aq sa janë të nevojshme sipas rrethanave.
3. Masa e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik nuk urdhërohet kur nuk është në proporcion me peshën e veprave të kryera, veprave që priten të kryhen nga kryesi dhe shkallën e rrezikut që paraqet kryesi.

Neni 88
Masat e zbatueshme dhe sanksionet penale

1. Masat e trajtimit të detyrueshëm të cilat mund ti shqiptohen kryesit i cili nuk është penalisht përgjegjës, ka aftësi esencialisht të zvogëluar mendore apo është i varur nga droga ose alkooli janë:
   1.1. trajtimi i detyrueshëm psikiatrik me ndalim në institucionin e kujdesit shëndetësor;
   1.2. trajtimi i detyrueshëm psikiatrik në liri; dhe
   1.3. trajtimi me anë të rehabilitimit të detyrueshëm të personave të varur nga droga ose alkooli.
2. Sanksioni penal, në pajtim me këtë Kod, mund t'i shqiptohet edhe kryesit i cili ka kryer vepër penale në gjendje të aftësisë së zvogëluar mendore, nëse ekzistojnë shkaqe për shqiptimin e sanksionit të tillë.

Neni 89
Trajtimi i detyrueshëm psikiatrik me ndalim në institucionin e kujdesit shëndetësor

1. Gjykata mund t'i shqiptojë masën e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik me ndalim në institucionin e kujdesit shëndetësor kryesit i cili ka kryer vepër penale në gjendje të paaftësisë mendore ose aftësisë esencialisht të zvogëluar mendore, nëse konstaton se:
   1.1. kryesi ka kryer vepër penale për të cilën është paraparë dënimi me së paku tre (3) vjet burgim;
   1.2. ekziston rrezik serioz se kryesi do të kryejë vepër tjetër penale;

1.3. trajtimi i detyrueshëm psikiatrik me ndalim është i nevojshëm për të shmangur kryerjen e veprës tjetër penale;
1.4. kryesi është i paaftë për t'u përballur me gjykimin dhe
1.5. trajtimi i detyrueshëm psikiatrik me ndalim është i nevojshëm për të shmangur rrezikun serioz.

2. Gjykata do ta pushojë masën e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik të paraparë në paragrafin 1. të këtij neni pasi të ketë vërtetuar se ka pushuar nevoja për trajtim në institucionin e kujdesit shëndetësor.
3. Kryesit i cili ka kryer vepër penale në gjendje të aftësisë esencialisht të zvogëluar mendore dhe i cili është dënuar me burgim, koha e kaluar në institucionin e kujdesit shëndetësor do t'i llogaritet në kohën e dënimit të shqiptuar për trajtim të detyrueshëm psikiatrik. Nëse koha e mbajtur në ndalim për trajtim të detyrueshëm psikiatrik është më e shkurtër se dënimi me burgim, gjykata mund të urdhërojë që kryesi të dërgohet në burgim për të mbajtur pjesën e mbetur të dënimit ose gjykata mund të urdhërojë lirimin me kusht.
4. Me rastin e vendosjes për lirimin me kusht sipas paragrafit 3. të këtij neni, gjykata përveç kushteve të përcaktuara në nenin 94 të këtij Kodi, veçanërisht do të merr parasysh suksesin e trajtimit të detyrueshëm të kryesit, gjendjen e tij shëndetësore, kohën e kaluar në institucionin shëndetësor dhe kohëzgjatjen e dënimit që nuk është mbajtur.

Neni 90
Trajtimi i detyrueshëm psikiatrik në liri

1. Gjykata mund t'i shqiptojë masën e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik në liri kryesit i cili ka kryer vepër penale në gjendje të paaftësisë mendore ose aftësisë esencialisht të zvogëluar mendore, nëse konstaton se:
   1.1. ekziston rrezik serioz se kryesi do të kryejë vepër penale;
   1.2. trajtimi i detyrueshëm psikiatrik në liri është i nevojshëm për të shmangur kryerjen e veprës tjetër penal; dhe
   1.3. trajtimi i detyrueshëm psikiatrik në liri është i mjaftueshëm për të shmangur rrezikun serioz.
2. Masat e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik në liri nga paragrafi 1. i këtij neni mund t'i shqiptohen kryesit ndaj të cilit është shqiptuar masa e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik me ndalim në institucionin e kujdesit shëndetësor, kur gjykata vërteton se ndalimi në institucionin e kujdesit shëndetësor nuk është më i nevojshëm dhe se masa e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik në liri mjafton për të adresuar situatat e përcaktuara në nën-paragrafët 1.1. deri 1.3.. të paragrafit 1. të këtij neni.
3. Varësisht nga kushtet e përcaktuara në paragrafin 1. të këtij neni, gjykata mund t'i shqiptojë trajtimin e detyrueshëm psikiatrik në liri kryesit me aftësi esencialisht të zvogëluar mendore dhe i cili është në liri me kusht, siç është paraparë në nenin 94 të këtij Kodi.
4. Trajtimi i detyrueshëm psikiatrik në liri nuk mund të tejkalojë tre (3) vjet nëse i është shqiptuar kryesit me aftësi esencialisht të zvogëluar mendore.
5. Gjykata mund të shqiptojë trajtimin e detyrueshëm psikiatrik me ndalim në institucionin e kujdesit shëndetësor:

5.1. kur kryesi nuk i nënshtrohet trajtimit të detyrueshëm psikiatrik në liri siç përcaktohet në paragrafët 1. deri 3. të këtij neni;
5.2. kur kryesi braktis trajtimin e detyrueshëm psikiatrik në liri; dhe
5.3. kur përkundër trajtimit të detyrueshëm psikiatrik me ndalim në institucionin e kujdesit shëndetësor, ka rrezik serioz se kryesi prapë do të kryejë vepër penale.

Neni 91
Trajtimi me anë të rehabilitimit të detyrueshëm i personave të varur nga droga ose alkooli

1. Gjykata mund t'i urdhërojë masën e trajtimit me rehabilitim të detyrueshëm në institucionin e kujdesit shëndetësor kryesit i cili ka kryer veprën penale nën ndikimin e drogës apo alkoolit, nëse plotësohen të dy kushtet e mëposhtme:
   1.1. gjykata ka shqiptuar dënim, vërejtje gjyqësore ose kryesin e ka liruar nga dënimi; dhe
   1.2. gjykata konstaton se faktori kryesor që e ka motivuar kryerjen e veprës penale ishte varësia e kryesit nga alkooli apo droga dhe nëse ka gjasa për mjekimin e tij të suksesshëm.
2. Nëse shqiptohet masa nga paragrafi 1. i këtij neni, krahas dënimit me gjobë, vërejtjes së gjyqësore apo lirimit nga dënimi, gjykata mund të vendosë, me pëlqimin e të dënuarit, që masa e tillë të ekzekutohet në liri. Nëse kryesi pa shkak të arsyeshëm nuk i nënshtrohet trajtimit në liri ose arbitrarisht e braktis trajtimin, gjykata mund të urdhërojë që trajtimi të ekzekutohet në institucionin e kujdesit shëndetësor.
3. Nëse masa nga paragrafi 1. i këtij neni është shqiptuar krahas dënimit me gjobë, vërejtjes gjyqësore apo lirimit nga dënimi, trajtimi nuk mund të zgjasë më tepër se dy (2) vjet.
4. Nëse masa nga paragrafi 1. i këtij neni është shqiptuar krahas dënimit me burgim, ajo mund të zgjasë derisa të kryhet dënimi. Koha e kaluar në institucionin e kujdesit shëndetësor do të llogaritet në dënimin e shqiptuar.
5. Gjykata duhet të shqyrtojë ekzekutimin e kësaj mase çdo dy (2) muaj për të vendosur nëse është e nevojshme të vazhdohet masa.

KAPITULLI VI
DISPOZITAT E PËRGJITHSHME PËR EKZEKUTIMIN E DËNIMEVE DHE LIRIMI ME KUSHT

Neni 92
Ekzekutimi i dënimit me burgim dhe me burgim të përjetshëm

1. Dënimi me burgim apo me burgim të përjetshëm mbahet në objekte të mbyllura, gjysmë të mbyllura apo objekte të hapura korrektuese ose në njësi të objekteve korrektuese.
2. Dënimi me burgim të përjetshëm fillon në objektet e mbyllura korrektuese ose në njësi të objekteve korrektuese.

3. Gjatë ekzekutimit të një dënimi, personi i dënuar nuk duhet t'i nënshtrohet trajtimit apo dënimit çnjerëzor ose poshtërues, përfshirë mundime të panevojshme mendore dhe fizike apo privimin nga trajtimi adekuat mjekësor ose nevojat tjera elementare.

Neni 93
Kufizimet në kufizimin e të drejtave të personave të dënuar

1. Të drejtat e personit të dënuar gjithmonë duhet të respektohen gjatë ekzekutimit të dënimit.
2. Të drejtat e personit të dënuar mund të kufizohen vetëm aq sa është e nevojshme dhe në përputhje me ligjin dhe standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut.

Neni 94
Lirimi me kusht

1. Personi i dënuar mund të lirohet me kusht në përputhje me këtë Kod dhe me Ligjin për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, nëse ka bazë të arsyeshme se ai nuk do të kryej vepër të re penale. Kur merret vendimi për lirimin me kusht, duhet të merret parasysh sjellja e personit të dënuar gjatë mbajtjes së dënimit.
2. Personi i dënuar për vepër penale për të cilën është paraparë dënim me të paktën pesë (5) vjet burgim, mund të lirohet me kusht pasi të ketë mbajtur dy të tretat (2/3) e dënimit të shqiptuar. Për vepra tjera penale, personi i dënuar mund të lirohet me kusht pasi të ketë mbajtur gjysmën e dënimit të shqiptuar.
3. Personi i dënuar me burgim të përjetshëm mund të lirohet me kusht pasi të ketë mbajtur dyzet (40) vjet nga dënimi me burgim i shqiptuar. Periudha minimale e mbikëqyrjes nga ana e shërbimit sprovues do të jetë së paku pesë (5) vjet.
4. Lirimi me kusht vendoset nga Paneli për Lirim me Kusht i themeluar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës, në pajtim me Ligjin për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale.

Neni 95
Revokimi i lirimit me kusht

1. Gjykata e revokon lirimin me kusht nëse personi i dënuar gjatë lirimit me kusht kryen një apo më shumë vepra penale për të cilat është shqiptuar dënimi më burgim me më tepër se një (1) vit.
2. Gjykata mund ta revokojë lirimin me kusht nëse personi i dënuar gjatë lirimit me kusht kryen një apo më shumë vepra penale për të cilat është shqiptuar dënimi me burgim deri në një (1) vit. Me rastin e vlerësimit se a duhet revokuar lirimin me kusht, gjykata posaçërisht merr parasysh ngjashmërinë e veprave penale të kryera, motivet për kryerjen e veprave penale dhe rrethanat e tjera të cilat tregojnë arsyeshmërinë e revokimit të lirimit me kusht.
3. Kur gjykata e revokon lirimin me kusht, ajo e shqipton dënimin në bazë të dispozitave nga neni 80 dhe paragrafi 2. i nenit 82 të këtij Kodi, duke e konsideruar dënimin e mëparshëm të shqiptuar si të përcaktuar. Pjesa e dënimit të shqiptuar më parë, të cilin personi i dënuar e ka mbajtur në bazë të dënimit të mëparshëm, do t'i llogaritet në dënimin e ri, ndërsa koha gjatë lirimit me kusht nuk llogaritet.

Aktgjykimi gjyqësor duhet të cek se lirimi me kusht është revokuar. Gjykata i dërgon kopjen e aktgjykimit Panelit për Lirim me Kusht.

4. Dispozitat nga paragrafët 1. deri 3. të këtij neni zbatohen edhe kur personi i liruar me kusht dënohet për veprën penale të kryer para lirimit me kusht.
5. Nëse personi i dënuar i cili është liruar me kusht dënohet me jo më shumë se një (1) vit burgim dhe nëse gjykata nuk e urdhëron revokimin e lirimit me kusht, lirimi me kusht vazhdohet për aq kohë sa personi i dënuar ka kaluar në mbajtjen e dënimit të tillë me burgim.

KAPITULLI VII
KONFISKIMI I DOBISË PASURORE TË FITUAR ME ANË TË KRYERJES SË VEPRAVE PENALE

Neni 96
Baza e konfiskimit të dobisë pasurore

1. Askush nuk mund ta mbajë dobinë pasurore të fituar me anë të kryerjes së veprës penale.
2. Dobia pasurore sipas paragrafit 1. të këtij neni konfiskohet nga gjykata e cila konstaton kryerjen e veprës penale, sipas kushteve të parapara me ligj.

Neni 97
Kushtet dhe mënyra e konfiskimit të dobisë pasurore

1. Kryesit i konfiskohet dobia pasurore apo kur konfiskimi nuk është i mundshëm, kryesi detyrohet të paguajë shumën e të hollave e cila i përgjigjet dobisë së fituar pasurore.
2. Dobia pasurore mund t'i konfiskohet personit të cilit i është bartur pa kompensim ose me kompensim që nuk i përgjigjet vlerës reale, nëse personi i tillë e ka ditur ose është dashur ta dijë se dobia pasurore është fituar me kryerjen e veprës penale. Kur dobia pasurore është bartur tek anëtarët e familjes, dobia konfiskohet nga anëtari i familjes, përveç nëse anëtari familjar dëshmon se si kompensim ka dhënë vlerën e plotë.

Neni 98
Mbrojtja e të dëmtuarit

1. Kur me procedurë penale i caktohet dëmi pasuror të dëmtuarit, gjykata urdhëron konfiskimin e dobisë pasurore nëse ajo e tejkalon shumën e dëmeve pasurore që i është caktuar palës së dëmtuar.
2. I dëmtuari i cili gjatë procedurës penale është udhëzuar të fillojë procedurën e kontestit civil për kërkesën pasurore juridike, mund të kërkojë kompensim nga dobia pasurore e konfiskuar. I dëmtuari i cili kërkon kompensim nga dobia pasurore e konfiskuar duhet të fillojë procedurën e kontestit civil brenda gjashtë (6) muajve nga dita e plotfuqishmërisë së vendimit që e udhëzon atë për inicimin e kontestit civil dhe brenda tre (3) muajve nga dita kur vendimi gjyqësor për vendosjen e kërkesës pasurore juridike është bërë i plotfuqishëm.

3. I dëmtuari i cili gjatë procedurës penale nuk e ka paraqitur kërkesën pasurore juridike, mund të kërkojë kompensim nga vlera e dobisë pasurore të konfiskuar nëse e ka filluar procedurën e kontestit civil në afatin prej tre (3) muajve nga dita kur ka mësuar për aktgjykimin me të cilin konfiskohet dobia pasurore dhe më së voni në afatin prej dy (2) vjetësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit mbi konfiskimin e dobisë pasurore, dhe nëse ka kërkuar kompensim nga vlera e dobisë pasurore të konfiskuar brenda afatit prej tre (3) muaj nga dita kur vendimi për caktimin e dobisë pasurore është bërë i plotfuqishëm.

Neni 99
Konfiskimi i dobisë pasurore nga personat juridikë

Kur me anë të veprës penale të kryer nga ana e kryesit përfiton dobi pasurore organizata e biznesit ose personi juridik, dobia pasurore konfiskohet nga organizata e biznesit ose personi juridik.

KAPITULLI VIII
PASOJAT JURIDIKE TË DËNIMIT

Neni 100
Lindja e pasojave juridike të dënimit

1. Pasojat juridike të dënimit mund të parashihen vetëm me ligj.
2. Pasojat juridike të dënimit nuk krijohen kur kryesit i shqiptohet gjoba, dënimi me kusht apo vërejtja gjyqësore ose kur kryesi lirohet nga dënimi.
3. Dënimet për disa vepra penale të caktuara mund të kenë si pasojë shuarjen apo humbjen e të drejtave të caktuara ose ndalimin e fitimit të të drejtave të caktuara.

Neni 101
Fillimi dhe kohëzgjatja e pasojave juridike të dënimit

1. Pasojat juridike të dënimit fillojnë në ditën kur aktgjykimi bëhet i plotfuqishëm.
2. Pasojat juridike të dënimit të cilat kanë të bëjnë me ndalimin e fitimit të disa të drejtave të caktuara nuk mund të zgjasin më tepër se dhjetë (10) vjet nga dita kur dënimi është mbajtur, falur ose kur është bërë parashkrimi, nëse ligji nuk parasheh kohëzgjatje më të shkurtër për pasoja juridike të caktuara.
3. Kur dënimi shlyhet atëherë pushojnë pasojat juridike të dënimit.

KAPITULLI IX
REHABILITIMI DHE ZBULIMI I TË DHËNAVE NGA DOSJA PENALE

Neni 102
Pozita juridike e personave të dënuar pas mbajtjes së dënimit, lirimit ose parashkrimit të dënimit

1. Pas mbajtjes së dënimit me burgim, faljes ose parashkrimit të dënimit, personi i dënuar i cili ka bërë dëmshpërblimin i gëzon dhe i fiton të gjitha të drejtat e

përcaktuara me Kushtetutë dhe me ligj, përveç nëse parashihet ndryshe me këtë Kod.

2. Ky nen gjithashtu zbatohet për personin e dënuar i cili është liruar me kusht.

Neni 103
Rehabilitimi ligjor

1. Me rehabilitimin ligjor dënimi shlyhet nga evidenca e personit të dënuar për herë të parë, siç parashihet në paragrafin 2. të këtij neni dhe personi i tillë nuk konsiderohet i dënuar.
2. Dënimi shlyhet nga evidenca e personit të dënuar për herë të parë pas skadimit të periudhave kohore vijuese, duke vepruar sipas ligjit, nëse personi i dënuar brenda afateve vijuese nuk kryen ndonjë vepër të re penale:
   2.1. një (1) vit nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit në rastin e vërejtjes gjyqësore ose të lirimit nga dënimi;
   2.2. një (1) vit nga dita e skadimit të periudhës së verifikimit në rastin e dënimit me kusht;
   2.3. një (1) vit nga dita e mbajtjes së dënimit, parashkrimit ose përfundimit me falje ose me ndryshim në ligj në rast të dënimit me gjysmëliri;
   2.4. tre (3) vjet pas mbajtjes së dënimit, parashkrimit ose përfundimit me falje ose me ndryshim të ligjit në rastin e dënimit me burgim deri në një (1) vit, dënimit me gjobë ose dënimit plotësues;
   2.5. pesë (5) vjet nga dita e mbajtjes së dënimit, parashkrimit ose përfundimit me falje ose me ndryshim të ligjit në rastin e dënimit me burgim prej një (1) deri në tre (3)vjet;
   2.6. tetë (8) vjet nga dita e mbajtjes së dënimit, parashkrimit ose përfundimit me falje ose me ndryshim të ligjit në rastin e dënimit me burgim prej tre (3) deri në pesë (5) vjet;
   2.7. dhjetë (10) vjet nga dita e mbajtjes së dënimit, parashkrimit ose përfundimit me falje ose me ndryshim të ligjit në rastin e dënimit me burgim prej pesë (5) deri në dhjetë (10) vjet;
   2.8. pesëmbëdhjetë (15) vjet nga dita e mbajtjes së dënimit, parashkrimit ose përfundimit me falje ose me ndryshim të ligjit në rastin e dënimit me burgim prej dhjetë (10) deri në pesëmbëdhjetë (15) vjet.
3. Dënimi me burgim mbi pesëmbëdhjetë (15) vjet ose me burgim të përjetshëm nuk mund të shlyhet.
4. Dënimi nuk mund të shlyhet gjatë kohëzgjatjes së dënimeve plotësuese dhe masave të trajtimit të detyrueshëm.

Neni 104
Rehabilitimi gjyqësor

Gjykata, me kërkesën e personit të dënuar, mund të vendosë që dënimi t'i shlyhet nga evidenca e personit të dënuar dhe ai person konsiderohet i padënuar nëse ka kaluar gjysma e afatit përkatës të paraparë me paragrafin 2. të nenit 103 dhe nëse personi i dënuar gjatë kësaj kohe nuk ka kryer vepër të re penale. Me rastin e vendosjes për

shlyerjen e dënimit të parashkruar ose përfunduar me falje ose me ndryshim të Kodit Penal, gjykata merr parasysh sjelljen e personit të dënuar pas mbajtjes së dënimit, natyrën e veprës penale dhe rrethanat e tjera të cilat mund të jenë të rëndësishme për vlerësimin e përshtatshmërisë së shlyerjes së dënimit.

Neni 105
Përmbajtja dhe zbulimi i të dhënave nga dosja penale

1. Në dosje penale përfshihen të dhënat në vijim: të dhënat personale mbi kryesin e veprës penale; të dhënat mbi dënimin, vërejtjen gjyqësore, masën e trajtimit të detyrueshëm ose lirimin e kryesit nga dënimi i shqiptuar; ndryshimet në të dhënat mbi dënimet që janë futur në dosjen penale; dhe të dhënat mbi dënimet e mbajtura si dhe mbi shlyerjen e dënimeve të gabueshme.
2. Të dhënat nga dosja penale mund të zbulohen vetëm në lidhje me dënimet të cilat nuk janë shlyer dhe mund t'i zbulohen gjykatës, prokurorisë dhe policisë lidhur me procedurën penale të zhvilluar kundër personit i cili më parë ka qenë i dënuar; organeve kompetente përgjegjëse për ekzekutimin e sanksioneve penale; dhe organeve kompetente që marrin pjesë në procedurën e dhënies së faljes apo shlyerjen e dënimeve.
3. Të dhënat nga dosja penale, në bazë të kërkesës së arsyetuar, mund t'u zbulohen organeve publike nëse dënimet plotësuese ose masat e trajtimit të detyrueshëm janë ende në fuqi në kohën e paraqitjes së kërkesës.
4. Në rastet kur është shlyer dënimi, të dhënat lidhur me atë dënim mund t'i zbulohen vetëm gjykatës, prokurorisë dhe policisë lidhur me procedurën penale e cila zhvillohet kundër personit të cilit i është shlyer dënimi i mëparshëm.
5. Çdo personi, me kërkesën e tij, mund t'i jepen të dhëna për dosjen e tij penale kur këto të dhëna i nevojiten, përveç nëse kjo do të rrezikonte sigurinë kombëtare apo sigurinë e përgjithshme ose do të rrezikonte parandalimin, hetimin, zbulimin dhe ndjekjen e veprave penale.

KAPITULLI X
PARASHKRIMI

Neni 106
Parashkrimi i ndjekjes penale

1. Përveç nëse shprehimisht parashihet ndryshe me këtë Kod, ndjekja penale nuk mund të ndërmerret nëse kanë kaluar afatet e mëposhtme:
   1.1. tridhjetë (30) vjet nga kryerja e veprës penale të dënueshme me burgim të përjetshëm;
   1.2. njëzetë (20) vjet nga kryerja e veprës penale të dënueshme me më shumë se dhjetë (10) vjet burgim;
   1.3. dhjetë (10) vjet nga kryerja e veprës penale të dënueshme me më shumë se pesë (5) vjet burgim;
   1.4. pesë (5) vjet nga kryerja e veprës penale të dënueshme me më shumë se tre (3) vjet burgim;

1.5. tre (3) vjet nga kryerja e veprës penale të dënueshme me më shumë se një (1) vit burgim; dhe
1.6. dy (2) vjet nga kryerja e veprës penale të dënueshme deri në një (1) vit burgim ose me dënim me gjobë.

2. Kur ligji parasheh më shumë se një dënim për një vepër penale, afati i parashkrimit caktohet sipas dënimit më të rëndë.

Neni 107
Fillimi dhe ndërprerja e parashkrimit të ndjekjes penale

1. Afati i parashkrimit të ndjekjes penale fillon nga dita kur është kryer vepra penale. Nëse ndonjë pasojë që përbën element të veprës penale shfaqet më vonë, afati i parashkrimit fillon të rrjedh nga ajo kohë.
2. Në rast se vepra penale është kryer kundër personit nën moshën tetëmbëdhjetë (18) vjet, afati i parashkrimit fillon të rrjedh nga dita kur viktima të ketë mbushur tetëmbëdhjetë (18) vjet.
3. Afati i parashkrimit nuk rrjedh për kohën gjatë të cilës ndjekja nuk mund të fillohet apo të vazhdohet sipas ligjit, përfshirë, por pa u kufizuar në rrethanat e mëposhtme:
   3.1. kur kryesi është jashtë Republikës së Kosovës dhe kjo shkakton vonesa në procedurë;
   3.2. kur kryesi kërkohet me urdhër arrest;
   3.3. kur Kryeprokurori i Shtetit, në pajtim me Kodin e Procedurës Penale, përpiqet të sigurojë dëshmi jashtë Republikës së Kosovës; ose
   3.4. gjatë kohës sa zgjatë procedura për pranimin e fajësisë.
4. Afati i parashkrimit nuk ndërpritet nëse vepra nuk ndiqet për shkak të mungesës së kërkesës apo autorizimit për të bërë ndjekjen ose për shkak të mungesës së kërkesës nga ana e shtetit të huaj për të bërë ndjekjen.
5. Afati i parashkrimit ndërpritet me çdo veprim i cili ndërmerret për qëllime të ndjekjes penale të veprës penale të kryer.
6. Afati i parashkrimit po ashtu ndërpritet kur kryesi para skadimit të afatit të parashkrimit kryen një vepër tjetër penale me peshë të njëjtë ose më të rëndë se sa vepra penale e mëparshme.
7. Pas çdo ndërprerje fillon të rrjedhë afati i ri i parashkrimit.
8. Ndjekja penale ndalohet në çdo rast kur të ketë kaluar dyfishi i kohës së afatit të parashkrimit.

Neni 108
Parashkrimi i ekzekutimit të dënimeve

1. Përveç nëse parashihet ndryshe me këtë Kod, dënimi i shqiptuar nuk mund të ekzekutohet pasi të kenë kaluar:
   1.1. tridhjetë (30) vjet nga dënimi me burgim të përjetshëm;
   1.2. njëzetë (20) vjet nga dënimi me mbi dhjetë (10) vjet burgim;
   1.3. dhjetë (10) vjet nga dënimi me mbi pesë (5) vjet burgim;
   1.4. pesë (5) vjet nga dënimi me mbi tri (3) vjet burgim;
   1.5. tri (3) vjet nga dënimi me mbi një (1) vit burgim; dhe

1.6. dy (2) vjet nga dënimi me burgim deri në një (1) vit apo dënimi me gjobë.

2. Parashkrimi i ekzekutimit të dënimeve ndërpritet kur personi i dënuar nuk paraqitet ose nuk dorëzohet për mbajtjen e dënimit me burgim.

Neni 109
Parashkrimi i ekzekutimit të dënimeve plotësuese dhe masave të trajtimit të detyrueshëm

1. Ndalohet ekzekutimi i dënimeve të tjera plotësuese kur të kenë kaluar pesë (5) vjet nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit me të cilin shqiptohet ky dënim.
2. Ndalohet ekzekutimi i masës së trajtimit të detyrueshëm kur të kenë kaluar tre (3) vjet nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit me të cilin shqiptohet kjo masë.
3. Parashkrimi i ekzekutimit të dënimeve plotësuese dhe masave të trajtimit të detyrueshëm ndërpritet kur personi nuk i përmbahet urdhrave të gjykatës lidhur me dënimet plotësuese dhe masat e trajtimit të detyrueshëm.

Neni 110
Fillimi dhe ndërprerja e afateve të parashkrimit të ekzekutimit të dënimit

1. Afati i parashkrimit të ekzekutimit të dënimit fillon të rrjedhë nga dita kur aktgjykimi merr formën e prerë, e në rast se dënimi alternativ është revokuar, parashkrimi fillon nga dita kur vendimi mbi revokimin merr formën e prerë.
2. Afati i parashkrimit nuk rrjedh gjatë kohës kur sipas ligjit ekzekutimi i dënimit nuk mund të fillohet.
3. Nëse dënimi zbutet me falje apo me vendim të gjykatës sipas mjetit të jashtëzakonshëm juridik, koha e fillimit të parashkrimit caktohet sipas dënimit të ri, derisa llogaritja e parashkrimit bëhet sipas dënimit fillestar.
4. Afati i parashkrimit ndërpritet me çdo veprim të filluar nga organi kompetent me qëllim të ekzekutimit të dënimit.
5. Pas çdo ndërprerjeje fillon të rrjedhë afati i ri i parashkrimit.
6. Ekzekutimi i dënimit ndalohet në çdo rast kur të ketë kaluar dyfishi i kohës së afatit të parashkrimit.
7. Dispozitat nga paragrafët 2. deri 5. të këtij neni po ashtu zbatohen për parashkrimin e ekzekutimit të dënimeve plotësuese dhe masave të trajtimit të detyrueshëm.

Neni 111
Moszbatueshmëria e parashkrimit për veprat penale kundër të drejtës ndërkombëtare dhe vrasjes së rëndë

1. Asnjë afat i parashkrimit nuk zbatohet për veprat penale të gjenocidit, krimeve të luftës, krimeve kundër njerëzimit, ose për vepra tjera penale të cilat sipas të drejtës ndërkombëtare nuk parashkruhen.
2. Vepra penale e vrasjes së rëndë nuk parashkruhet.

KAPITULLI XI
FALJA

Neni 112
Falja

1. Me falje dhe në pajtim me Ligjin për Falje, personave të caktuar emrat e të cilëve saktësohen u jepet lirimi i plotë ose i pjesërishëm nga ekzekutimit i dënimit, zëvendësimi i dënimit me një dënim më të butë apo dënimi me kusht ose shlyerja e dënimit.
2. Kryesi nuk mund të falet për çfarëdo dënimi për të cilin Paneli për Lirim me Kusht i ka refuzuar lirimin me kusht.

Neni 113
Efekti i faljes në personat e tretë

Me dhënien e faljes nuk preken të drejtat e personave të tretë, të cilat bazohen në dënimin apo aktgjykimin.

KAPITULLI XII
ZBATIMI I LEGJISLACIONIT PENAL TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS SIPAS VENDIT TË KRYERJES SË VEPRËS PENALE

Neni 114
Zbatimi i legjislacionit penal të Republikës së Kosovës në territorin e Republikës së Kosovës

1. Legjislacioni penal i Republikës së Kosovës zbatohet për secilin person i cili kryen vepër penale tërësisht ose pjesërisht në territorin e Republikës së Kosovës.
2. Legjislacioni penal i Republikës së Kosovës zbatohet ndaj secilit person i cili kryen vepër penale në çfarëdo mjeti të transportit ajror ose ujor i cili është i regjistruar në Republikën e Kosovës, pavarësisht nga vendi ku ndodhet mjeti i transportit ajror ose ujor në kohën kur kryhet vepra penale.

Neni 115
Zbatimi i legjislacionit penal të Republikës së Kosovës për veprat penale të caktuara që janë kryer jashtë territorit të Republikës së Kosovës

1. Legjislacioni penal i Republikës së Kosovës zbatohet ndaj çdo personi i cili kryen veprat penale në vijim jashtë territorit të Republikës së Kosovës:
   1.1. veprat penale të parapara në nenet 148-153, 157-160, 164, 165, 166-169, 171, 173-175, 238, 241, 273-280, 293, 294, 302-304, 336 dhe 337 të këtij Kodi; dhe
   1.2. veprat penale të cilat në bazë të marrëveshjes ndërkombëtare e cila e detyron Republikën e Kosovës, duhet të ndiqen edhe pse janë kryer jashtë vendit.
2. Legjislacioni penal i Republikës së Kosovës zbatohet ndaj cilitdo person që kryen

vepër penale nga nenet 136-145 të këtij Kodi jashtë territorit të Republikës së Kosovës, ku vepra e tillë paraqet tërësisht ose pjesërisht rrezik për sigurinë e Republikës së Kosovës ose popullsinë e saj.

3. Legjislacioni Penal i Republikës së Kosovës zbatohet ndaj çdo shtetasi të Republikës së Kosovës që kryen vepër penale jashtë territorit të Republikës së Kosovës dhe nëse kjo vepër po ashtu është e dënueshme në vendin ku është kryer.
4. Paragrafi 1. i këtij neni zbatohet po ashtu ndaj cilitdo person i cili pas kryerjes së veprës penale bëhet banor i Republikës së Kosovës.

Neni 116
Zbatimi i legjislacionit penal të Republikës së Kosovës ndaj personave të huaj të cilët kryejnë vepra penale jashtë territorit të Republikës së Kosovës

1. Legjislacioni penal i Republikës së Kosovës zbatohet ndaj cilitdo person të huaj nëse:
   1.1. personi i tillë ka kryer vepër penale jashtë territorit të Republikës së Kosovës kundër shtetasit të Kosovës, madje edhe atëherë kur vepra e tillë penale nuk është cekur në nenin 115 të këtij Kodi;
   1.2. kjo vepër penale është po ashtu e dënueshme në vendin ku është kryer; dhe
   1.3. kryesi është gjendur në territorin e Kosovës ose është transferuar në Kosovë.

Neni 117
Kushtet e posaçme për ndjekje të veprave penale të kryera jashtë territorit të Republikës së Kosovës

1. Në rastet e parapara me nenin 114 të këtij Kodi, nëse procedura penale është filluar por nuk është përfunduar në një juridiksion tjetër, procedura penale në Republikën e Kosovës do të fillohet vetëm me miratimin e Kryeprokurorit të Shtetit të Republikës së Kosovës.
2. Në rastet e parapara me nenin 115 dhe 116 të këtij Kodi, procedura penale nuk do të fillohet nëse:
   2.1. kryesi në tërësi e ka mbajtur dënimin e shqiptuar në një juridiksion tjetër;
   2.2. kryesi në një juridiksion tjetër është liruar me aktgjykim të plotfuqishëm apo është liruar nga dënimi ose dënimi është parashkruar; dhe
   2.3. procedura penale për veprën penale të kryer në një juridiksion tjetër mund të fillohet vetëm sipas kërkesës së të dëmtuarit dhe një kërkesë e tillë nuk është paraqitur.
3. Procedura penale sipas nenit 118 mund të fillohet në Kosovë vetëm me autorizimin e Kryeprokurorit të Shtetit të Kosovës.
4. Në rastet e parapara në nenin 114, ndjekja penale e personit të huaj mund t'i transferohet juridiksionit të huaj sipas kushteve të reciprocitetit.

Neni 118
Dispozitat e posaçme për fëmijët

Ky Kod zbatohet për personat nën moshën tetëmbëdhjetë (18) vjet vetëm nëse me Ligjin për të miturit nuk përcaktohet ndryshe.

Neni 119
Dispozitat e posaçme për personat juridikë

Veprat penale për të cilat personi juridik mund të jetë penalisht përgjegjës, përgjegjësia penale e personit juridik, sanksionet penale të cilat mund të zbatohen ndaj personit juridik dhe dispozitat e posaçme që rregullojnë procedurën penale të zbatueshme ndaj personit juridik parashihen me këtë Kod ose me ligj të veçantë.

KAPITULLI XIII
DOMETHËNIA E SHPREHJEVE NË KODIN PENAL

Neni 120
Përkufizimet

Për qëllim të këtij Kodi, shprehjet e mëposhtme kanë këto kuptime:

1. **Person** - personi juridik dhe personin fizik;
2. **Person zyrtar** - nënkupton:
   2.1. personi i zgjedhur ose i emëruar në një organ shtetëror;
   2.2. personi i autorizuar në një organ shtetëror, organizatë biznesi ose ndonjë person tjetër juridik i cili sipas ligjit apo ndonjë dispozite tjetër të nxjerrë në pajtim me ligj ushtron detyra të posaçme;
   2.3. personi i cili ushtron detyra të posaçme zyrtare në bazë të autorizimit të dhënë me ligj.
3. **Zyrtar i huaj publik** apo **person i huaj zyrtar -** nënkupton:
   3.1. cilido person që mban detyrë legjislative, ekzekutive, administrative apo gjyqësore në shtetin e huaj, qoftë i emëruar apo i zgjedhur;
   3.2. cilido arbitër që ushtron funksione sipas ligjit kombëtar mbi arbitrimin e shtetit të huaj;
   3.3. cilido person që ushtron funksion publik për shtetin e huaj, përfshirë për agjencinë publike ose ndërmarrjen publike;
   3.4. cilido zyrtar, punonjës apo përfaqësues i organizatës ndërkombëtare publike dhe organeve të tyre;
   3.5. cilido anëtar i asamblesë parlamentare ndërkombëtare; dhe
   3.6. cilido gjyqtar, prokuror apo zyrtar i gjykatës apo tribunalit ndërkombëtar që ushtron juridiksion mbi Republikën e Kosovës.
4. **Person nën mbrojtje ndërkombëtare -** ose **person i mbrojtur ndërkombëtarisht** - nënkupton:
   4.1. shefi i shtetit, përfshirë cilindo anëtar të organit kolektiv i cili ushtron funksionin e shefit të shtetit sipas kushtetutës së atij shteti;
   4.2. Kryeministri dhe Ministri i Punëve të Jashtme, çdoherë kur ata gjenden me detyrë jashtë shtetit të tyre, si dhe anëtarët e familjeve të tyre;
   4.3. çdo zyrtar i lartë ose përfaqësues i lartë i shtetit ose zyrtari i lartë apo përfaqësuesi tjetër i organizatës ndërkombëtare, i cili në kohën dhe në vendin kur ndaj tij, ndaj lokaleve zyrtare, banesës apo zyrës private ose mjetit transportues i cili ka shenja dalluese është kryer vepër penale, sipas të drejtës ndërkombëtare ka të drejtë në mbrojtje të veçantë nga sulmi ndaj jetës, lirisë dhe dinjitetit të tij.

Person nën mbrojtje ndërkombëtare përfshinë edhe anëtarët shoqërues të familjes.

5. **Person përgjegjës** - personi fizik në kuadër të personit juridik, të cilit i janë besuar detyra të caktuara, ose i cili është i autorizuar për të vepruar në emër të personit juridik si dhe ekziston bazueshmëria e lartë se është i autorizuar të veproj në emër të personit juridik.
6. **Person juridik** - subjekti juridik i vendit apo i huaj, i cili sipas legjislacionit të Kosovës në fuqi konsiderohet si person juridik.
7. **Organizatë biznesi** - person fizik apo juridik ose grup personash që merren me veprimtari ekonomike, siç përcaktohet dhe rregullohet me Ligjin për Shoqëritë Tregtare.
8. **Dokument** - çdo dokument apo send tjetër i përshtatshëm ose i caktuar që shërben si provë e ndonjë fakti përkatës për marrëdhëniet juridike.
9. **Para** - monedhë metalike dhe e letrës, e cila në bazë të ligjit është në qarkullim në Republikën e Kosovës ose në ndonjë juridiksion tjetër.
10. **Shenja me vlerë** - përfshin edhe shenjat e huaja me vlerë.
11. **Send i luajtshëm** - përfshin edhe energjinë e prodhuar apo të grumbulluar për ndriçim, ngrohje, qarkullim si dhe impulset telefonike dhe impulset tjera.
12. **Grup njerëzish -** tre ose më shumë persona.
13. **Grup kriminal i organizuar -** bashkim i strukturuar, që ekziston për një kohë të caktuar, i tre apo më shumë personave për kryerjen e veprave të caktuara penale, që vepron në bashkëpunim me qëllim të kryerjes së një apo më shumë veprave të rënda penale për përfitim të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të dobisë financiare apo dobisë tjetër pasurore.
14. **Bashkim i strukturuar -** bashkim i cili nuk është formuar rastësisht për kryerjen e menjëhershme të veprës penale, por nuk është e nevojshme që anëtarët e këtij bashkimi të kenë role formalisht të përcaktuara, vazhdimësi të anëtarësisë së tyre apo strukturë të ndërtuar.
15. **Forcë -** përfshin edhe zbatimin e hipnozës ose të mjeteve të tjera dehëse me qëllim të vënies së personit kundër dëshirës së vet në gjendje të pavetëdijshme apo të paaftësohet për rezistencë.
16. **Mjet motorik** - çdo mjet transportues i pajisur me motor për përdorim në transportin rrugor, ujor ose ajror.
17. **KFOR** - prania ndërkombëtare e sigurisë e vendosur në territorin e Republikës së Kosovës në pajtim me Rezolutën 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit që përbëhet nga Pakti i Organizatës së Veriatlantikut NATO, duke përfshirë shtetet e saj anëtare, organet e saj ndihmëse, shtabet e saj ushtarake dhe elementet ose njësitet kombëtare si dhe vendet kontribuuese që nuk janë në NATO.
18. **Polici -** Policia e Republikës së Kosovës, Doganat - oficerët doganorë sipas Kodit Doganor dhe Policia e EULEX-it.
19. **Shtetas i Kosovës -** personi i cili sipas Kushtetutës dhe Ligjit për Shtetësinë konsiderohet i tillë.
20. **Fëmijë** - person i cili nuk i ka mbushur tetëmbëdhjetë (18) vjet.
21. **I mitur** - personi i cili është ndërmjet moshës katërmbëdhjetë (14) dhe tetëmbëdhjetë (18) vjet.
22. **Madhor** - personi i cili i ka mbushur tetëmbëdhjetë (18) vjet.
23. **Marrëdhënie familjare -** marrëdhënie në mes të dy (2) personave:

23.1. që janë të fejuar ose të martuar me njëri-tjetrin ose që bashkëjetojnë me njëri tjetrin pa martesë;
23.2. që e kanë të përbashkët shtëpinë kryesore dhe që janë të afërm të gjakut, martesës, adoptimit ose janë në marrëdhënie të kujdestarit, duke përfshirë prindërit, gjyshin e gjyshen, fëmijët, nipat e mbesat nga vajza dhe djali, vëllezërit dhe motrat, hallat dhe tezet, dajët dhe axhallarët, mbesat dhe nipërit nga vëllai dhe motra, kushërinjtë; ose
23.3. që janë prindër të fëmijës së përbashkët.

24. **Bashkësi jashtëmartesore -** marrëdhënie siç përcaktohet me Ligjin për Familje.
25. **Territor i Republikës së Kosovës -** sipërfaqet tokësore dhe sipërfaqet ujore brenda kufijve dhe vijës kufitare si dhe hapësirën ajrore mbi Kosovë.
26. **Vijë kufitare e Republikës së Kosovës** - vijë e cila ndan territorin e Republikës së Kosovës nga territoret e shteteve fqinje.
27. **Kufiri shtetëror -** kufiri tokësor, ujor dhe ajror përfshirë aeroportet të cilat zhvillojnë komunikacion ndërkombëtar.
28. **Dëm** - çdo humbje deri në pesëmijë (5.000) EUR.
29. **Dëm i konsiderueshëm** - ose "humbje e konsiderueshme" nënkupton çdo humbje prej më shumë se pesëmijë (5.000) EUR deri në pesëmbëdhjetëmijë (15.000) EUR.
30. **Dëm i madh, dëm substancial**, ose **humbje substanciale -** humbje prej më shumë se pesëmbëdhjetëmijë (15,000) EURO deri në pesëdhjetëmijë (50.000) EURO.
31. **Dëm në shkallë të madhe**, **shkatërrim në shkallë të madhe**" ose **humbje në shkallë të madhe -** çdo humbje prej më shumë se pesëdhjetëmijë (50.000) EURO.
32. **Mjet i rrezikshëm -** çdo send i punuar apo i përdorur për t'i shkaktuar lëndim trupor personit ose për të kanosur personin me shkaktim të lëndimit.
33. **Anëtar i familjes -** prindi, prindi i adoptuar, fëmija, fëmija i adoptuar, vëllai ose motra, bashkëshorti ose bashkëshortja, i afërmi i gjakut që jeton në të njëjtën shtëpi ose personi me të cilin kryesi jeton në bashkësi jashtëmartesore.
34. **Dobi pasurore -** çfarëdo pasurie e cila fitohet drejtpërdrejtë ose tërthorazi nga vepra penale. Pasuria e cila fitohet tërthorazi nga vepra penale përfshinë pasurinë në të cilën pastaj është konvertuar, transformuar apo përzier çfarëdo pasurie drejtpërdrejtë e fituar nga vepra penale, si dhe të ardhurat, kapitalin apo dobitë tjera ekonomike të fituara ose realizuara për pasurinë e tillë në çfarëdo kohe që prej kryerjes së veprës penale.
35. **Vegël narkotike** - çdo pajisje, produkt apo material i çfarëdo lloji i cili kryesisht ka për qëllim ose është i krijuar për përdorim në fabrikimin, përzierjen, konvertimin, fshehjen, prodhimin, përpunimin, përgatitjen, injektimin, gëlltitjen, thithjen ose futjen në ndonjë mënyrë tjetër të narkotikëve në trupin e njeriut. Kjo përfshinë, por nuk kufizohet në sende siç janë tubat e metalit, drurit, xhamit, gurit, plastikës apo qeramikës, me apo pa filter, filterë permanent, filterë të hashishit ose enë metalike me vrima; tuba të ujit; nagjile të marihuanës; letra për mbështjelljen e cigareve, ose vegla për ndarjen e kokainës.
36. **Përgatitja e veprës penale** - furnizimi ose aftësimi i mjeteve kryesit për kryerjen e veprës penale, heqja e pengesave për kryerjen e veprës penale, marrëveshja, planifikimi ose organizimi me persona tjerë për të kryer vepër penale ose ndonjë veprimtari tjetër që krijon kushte për kryerjen e drejtpërdrejtë të veprës penale, por që nuk përbën vet veprën penale.

37. **Viktimë e ndjeshme** - fëmijë, person me aftësi të kufizuara fizike apo mendore, person me aftësi të zvogëluar, grua shtatzënë ose partner familjar.
38. **Armë** - çdo send ose vegël e punuar me qëllim që nën presionin e gazrave, të cilat lirohen gjatë djegies së materieve shpërthyese, elektrike, gazrave nën presion ose energjisë tjetër potenciale, hedhë predha në formë të një plumbi të vetëm, grumbulli prej saçmash, gazi, lëngu, shigjete ose përbërësish të tjerë, që krijohet dhe përdoret për të shkaktuar lëndime trupore ose dëm fizik, qoftë edhe psikologjik, si dhe secili send tjetër, qëllimi kryesor i të cilit është kryerja e sulmit fizik ndaj integritetit fizik të njerëzve ose ndaj pasurisë. Armë po ashtu përfshinë municionin, pjesët dhe përbërësit e armëve, si dhe armët nukleare, biologjike dhe kimike. Këto në vijim janë armë:
    38.1. armët e zjarrit;
    38.2. armët e koleksionit;
    38.3. armët pneumatike (ajrore);
    38.4. armët që përdoren për shpërndarjen e gazit irritues;
    38.5. armët shpërthyese;
    38.6. armët me shigjeta;
    38.7. armët e ftohta;
    38.8. armët për sinjalizim akustik dhe të dritës;
    38.9. armët elektroshok;
    38.10. armët me rrymë.

Këto në vijim nuk konsiderohen armë për qëllime të këtij Kodi;

    38.11. armët për qëllime industriale;
    38.12. armët dekorative;
    38.13. imitimi i armëve;
    38.14. armët e zjarrit të bëra të papërdorshme (deaktivizuara) në mënyrë permanente me aplikimin e procedurave teknike që garantohen nga organi kompetent ose që njihen nga organi kompetent;
    38.15. fuzhnjat për peshkim nën ujë.

KAPITULLI XIV
VEPRAT PENALE KUNDËR RENDIT KUSHTETUES DHE SIGURISË SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Neni 121
Sulmi kundër rendit kushtetues të Republikës së Kosovës

1. Kushdo që me përdorim të dhunës apo me kanosje të dhunës tenton që ta ndryshojë rendin kushtetues të Republikës së Kosovës apo të përmbysë institucionet më të larta të Republikës së Kosovës, dënohet me jo më pak se pesë (5) vjet burgim.
2. Kushdo që me përdorim të dhunës apo me kanosje të dhunës tenton që të pengojë vendosjen e rendit kushtetues të Republikës së Kosovës apo me përdorim të dhunës ose kanosjes së dhunës implementon rendin e huaj juridik në ndonjë pjesë të Republikës së Kosovës, dënohet me jo më pak se pesë (5) vjet burgim.
3. Kushdo që me përdorim të dhunës ose me kanosje të dhunës tenton të rrezikojë pavarësinë e Kosovës, sovranitetin dhe integritetin e saj territorial, tërësinë

territoriale dhe karakterin demokratik të shtetit, dënohet jo më pak se dhjetë (10) vjet burgim.

Neni 122
Kryengritja e armatosur

1. Kushdo që merr pjesë në kryengritje të armatosur e cila është e drejtuar kundër rendit kushtetues, sigurisë apo integritetit territorial të Republikës së Kosovës, dënohet me jo më pak se pesë (5) vjet burgim.
2. Organizatori i kryengritjes së armatosur nga paragrafi 1 i këtij neni, dënohet me jo më pak se dhjetë (10) vjet burgim.

Neni 123
Pranimi i kapitullimit dhe okupimit

Kushdo që nënshkruan apo pranon kapitullimin ose miraton okupimin e Republikës së Kosovës apo të ndonjë pjese të saj, dënohet me burgim së paku dhjetë (10) vjet ose me burgim të përjetshëm.

Neni 124
Tradhtia ndaj vendit

1. Kushdo që në cilësinë e Presidentit të Republikës nënshkruan pranimin e okupimit apo aktin e kapitullimit të shtetit dënohet me burgim së paku pesëmbëdhjetë (15) vjet ose me burgim të përjetshëm.
2. Kushdo që në cilësinë e Presidentit të shtetit nënshkruan marrëveshje ndërkombëtare ose ndonjë akt me të cilin pjesë të territorit të Republikës së Kosovës jepen apo lihen nën sovranitetin e ndonjë shteti tjetër dënohen me burgim së paku pesëmbëdhjetë (15) vjet ose me burgim të përjetshëm.
3. Kushdo që në cilësinë e Presidentit të Republikës së Kosovës braktisë vendin gjatë kohës së luftës ose gjendjes së jashtëzakonshme duke lënë forcat e armatosura pa sistem të komandimit dënohet me burgim së paku pesëmbëdhjetë (15) vjet ose me burgim të përjetshëm.

Neni 125
Rrezikimi i tërësisë territoriale të Republikës së Kosovës

Kushdo që me përdorim të dhunës apo me kanosje të dhunës tenton që ta shkëpus një pjesë të territorit të Republikës së Kosovës apo që ndonjë pjesë të territorit të saj t'ia bashkojë ndonjë shteti tjetër, dënohet me jo më pak se pesë (5) vjet burgim.

Neni 126
Vrasja e përfaqësuesve të lartë të Republikës së Kosovës

1. Kushdo që me qëllim të rrezikimit të rendit kushtetues apo sigurisë së Republikës së Kosovës, privon nga jeta një nga personat e mëposhtëm, dënohet me burgim së paku dhjetë (10) vjet ose me burgim të përjetshëm.

1.1. Kryetarin e Republikës së Kosovës;
1.2. Kryetarin e Kuvendit të Republikës së Kosovës;
1.3. Kryeministrin e Republikës së Kosovës;
1.4. Kryetarin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës;
1.5. Kryetarin e Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës ose
1.6. Kryeprokurorin e Shtetit të Republikës së Kosovës.

Neni 127
Rrëmbimi i përfaqësuesve të lartë të Republikës së Kosovës

Kushdo që me qëllim të rrezikimit të rendit kushtetues apo të sigurisë së Republikës së Kosovës, rrëmben një apo më shumë nga personat e saktësuar në nenin 126 të këtij Kodi, dënohet me jo më pak se pesë (5) vjet burgim.

Neni 128
Dhuna ndaj përfaqësuesve të lartë të Republikës së Kosovës

Kushdo që me qëllim të rrezikimit të rendit kushtetues apo sigurisë së Republikës së Kosovës, me përdorim të dhunës apo me kanosje të dhunës, pengon një apo më shumë nga personat e saktësuar në nenin 126 të këtij Kodi në ushtrimin e detyrave zyrtare apo i detyron të kryejnë apo të mos kryejnë ndonjë veprim nga fushëveprimi i detyrave të tyre, dënohet me burgim prej tre (3) deri në dhjetë (10) vjet.

Neni 129
Rrezikimi i rendit kushtetues me shkatërrimin apo dëmtimin e instalimeve dhe pajisjeve publike

Kushdo që me qëllim të rrezikimit të rendit kushtetues apo sigurisë së Republikës së Kosovës, djeg ose në çfarëdo mënyre tjetër shkatërron apo dëmton zonën industriale, bujqësore ose ndonjë zonë tjetër ekonomike, sistemin e trafikut, lidhjet e telekomunikimeve, pajisjet publike të ujit, ngrohjes, gazit apo energjisë, pendat, depot, apo ndonjë ndërtesë tjetër të rëndësishme për sigurinë, furnizimin e qytetarëve, ekonominë apo funksionimin e shërbimeve publike, dënohet me jo më pak se tre (3) vjet burgim.

Neni 130
Sabotimi

Kushdo që me qëllim të rrezikimit të rendit kushtetues apo të sigurisë së Republikës së Kosovës, nuk e kryen në mënyrë të ndërgjegjshme detyrën zyrtare apo kushdo që gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare dëmton mjetet e prodhimit; shkakton shkatërrimin apo dëmtimin e instalimeve ose ndërtesave; shkakton shkatërrimin apo dëmtimin në sasi të mëdha të produkteve, mallrave apo materialeve; ose shkakton ndërprerje në procesin e prodhimit dhe vlera e dëmeve apo shkatërrimit tejkalon pesëdhjetëmijë (50.000) Euro, dënohet me jo më pak se tre (3) vjet burgim.

Neni 131
Spiunazhi

1. Kushdo që sekretin shtetëror ia komunikon, ia dorëzon apo ia bënë të arritshme shtetit të huaj, organizatës së huaj apo personit që u shërben atyre, dënohet me burgim prej pesë (5) deri në dymbëdhjetë (12) vjet burgim.
2. Kushdo që për shtetin apo organizatën e huaj krijon shërbimin informativ në Republikën e Kosovës apo drejton shërbimin e tillë, dënohet me jo më pak se dhjetë (10) vjet burgim.
3. Kushdo që hyn në shërbimin informativ të huaj, mbledh të dhëna për të apo në ndonjë mënyrë tjetër e ndihmon punën e shërbimit të tillë, dënohet me jo më pak se pesë (5) vjet burgim.
4. Kushdo që mbledh të dhëna apo dokumente të klasifikuara me qëllim që t'ia komunikojë dhe dorëzojë shtetit të huaj, organizatës së huaj apo personit që u shërben atyre, dënohet me burgim prej tre (3) deri në dhjetë (10) vjet.
5. Nëse kryerja e veprës penale nga paragrafët 1., 2., 3. ose 4. i këtij neni ka shkaktuar pasoja të rënda për sigurinë ose fuqinë ekonomike apo ushtarake të shtetit, kryesi dënohet me burgim jo më pak se dhjetë (10) vjet.
6. Nëse vepra penale e saktësuar në paragrafin 1., 2., 3. ose 4. të këtij neni kryhet gjatë kohës së luftës, rrezikut të pashmangshëm për luftë, konfliktit të armatosur apo zbulimi i sekretit shtetëror ka të bëjë me sigurinë e Republikës së Kosovës, kryesi dënohet me jo më pak se dhjetë (10) vjet burgim ose me burgim të përjetshëm.
7. Për qëllime të këtij kapitulli, "sekret shtetëror" nënkupton të dhënat apo dokumentet ushtarake, ekonomike apo zyrtare të cilat janë shpallur si informata të klasifikuara me ligj apo me dispozita ose vendime tjera të organit kompetent të nxjerra në pajtim me ligjin.

Neni 132
Zbulimi i informacioneve të klasifikuara dhe mos ruajtja e informacioneve të klasifikuara

Kushdo që zbulon ose nuk ruan informacionin e klasifikuar dënohet sipas Ligjit për klasifikimin e informacioneve dhe verifikimin e sigurisë.

Neni 133
Veprat e rënda kundër rendit kushtetues dhe sigurisë së Republikës së Kosovës

1. Kryesi i veprave penale nga nenet 120-134 të këtij Kodi dënohet me jo më pak se dhjetë (10) vjet burgim ose me burgim të përjetshëm, nëse kryerja e veprës:
   1.1. rezulton në vdekjen e një apo më shumë personave;
   1.2. rrezikon jetën e një apo më shumë personave;
   1.3. vepra përcillet me dhunë të rëndë ose shkatërrim në shkallë të madhe; ose
   1.4. vepra ka rrezikuar sigurinë ekonomike dhe ushtarake të Republikës së Kosovës.
2. Nëse me rastin e kryerjes së veprës penale nga paragrafi 1. i këtij neni kryesi me dashje ka privuar nga jeta një apo më shumë persona, kryesi dënohet me burgim së paku dhjetë (10) vjet ose me burgim të përjetshëm.

3. Kushdo që kryen vepër penale nga paragrafi 1. i këtij neni gjatë kohës së luftës, rrezikut të pashmangshëm për luftë, konfliktit të armatosur apo gjatë gjendjes së jashtëzakonshme, dënohet me burgim se paku dhjetë (10) vjet ose me burgim të përjetshëm.

Neni 134
Bashkimi për veprimtari kundër kushtetuese

1. Kushdo që formon një grup apo ndonjë bashkim tjetër të personave për kryerjen e veprave penale nga nenet 121-134 të këtij Kodi, dënohet me dënimin e paraparë për atë vepër penale.
2. Kushdo që merr pjesë apo bëhet anëtar i grupit apo bashkimit nga paragrafi 1. i këtij neni, dënohet me burgim prej një (1) deri në pesë (5) vjet.
3. Anëtari i grupit apo bashkimit, që e lajmëron grupin para kryerjes së veprës penale nga paragrafi 1. i këtij neni, dënohet me burgim deri në tre (3) vjet ose mund të lirohet nga dënimi.

Neni 135
Përkufizimet për dispozitat e terrorizmit në nenet 121-145

Për qëllime të neneve 121-145 të këtij Kodi:

1. **Terrorizëm**, **veprim terrorist** apo **vepër e terrorizmit -** kryerja e një ose më shumë veprave penale të mëposhtme me qëllim të frikësimit serioz të popullsisë, të detyrimit të padrejtë të një organi publik, qeverisë apo organizatës ndërkombëtare për të kryer ose për të mos kryer ndonjë veprim, apo që seriozisht të destabilizojë ose të shkatërrojë strukturat themelore politike, kushtetuese, ekonomike apo shoqërore të Republikës së Kosovës, të një shteti tjetër apo të një organizate ndërkombëtare:
   1.1. vrasja apo vrasja e rëndë në shkelje të nenit 178 dhe 179 të këtij Kodi;
   1.2. shtytja apo ndihma në vetëvrasje në shkelje të nenit 183 të këtij Kodi;
   1.3. sulmi, sulmi me lëndim të lehtë trupor dhe sulmi me lëndim të rëndë trupor në shkelje të neneve 187-189 të këtij Kodi;
   1.4. veprat penale kundër integritetit seksual në shkelje të neneve 230-232, 235-239 ose 241 të këtij Kodi;
   1.5. marrja e pengjeve, rrëmbimi ose privimi i kundërligjshëm nga liria në shkelje të neneve 175, 194 ose 196 të këtij Kodi;
   1.6. ndotja e ujit të pijshëm ose e produkteve ushqimore; ndotja ose shkatërrimi i mjedisit në shkelje të neneve 270 dhe Kapitullit XXVII të këtij Kodi;
   1.7. shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm; zjarr vënia apo djegia ose shpërthimi nga pakujdesia në shkelje të neneve 334 ose 365 të këtij Kodi;
   1.8. shkatërrimi, dëmtimi ose heqja e instalimeve publike apo rrezikimi i trafikut publik në shkelje të neneve 129, 366, 378 ose 380 të këtij Kodi;
   1.9. furnizimi, transportimi, prodhimi, këmbimi ose shitja e paautorizuar e armëve, eksplozivit ose armëve nukleare, biologjike ose kimike në shkelje të neneve 176, 369 ose 372-377 të këtij Kodi;
   1.10. përvetësimi i paautorizuar, mbajtja në pronësi, kontroll, posedim ose

përdorimi i armëve, eksplozivit ose armëve nukleare, biologjike ose kimike, ose hulumtimet për ose ndërtimi i armëve biologjike ose kimike në shkelje të neneve 176, 369 ose 372-377 të këtij Kodi;

1.11. rrezikimi i personave të mbrojtur ndërkombëtarisht në shkelje të nenit 173 të këtij Kodi;
1.12. rrezikimi i personelit të Kombeve të Bashkuara dhe i personelit në marrëdhënie me to në shkelje të nenit 174 të këtij Kodi;
1.13. rrëmbimi i fluturakes ose marrja e kundërligjshme e fluturakes në shkelje të nenit 164 të këtij Kodi, ose rrëmbimi i mjeteve tjera të transportit publik apo të transportit të mallrave;
1.14. rrezikimi i sigurisë së aviacionit civil në shkelje të nenit 165 të këtij Kodi;
1.15. rrëmbimi i anijeve ose rrezikimi i sigurisë së lundrimit detar në shkelje të nenit 166 të këtij Kodi;
1.16. rrezikimi i sigurisë së platformave fikse të vendosura në pragun kontinental në shkelje të nenit 167 të këtij Kodi;
1.17. përvetësimi, përdormi, transferimi ose deponimi i paautorizuar i materialeve nukleare në shkelje të nenit 176 të këtij Kodi;
1.18. kanosja për përdorimin apo vjedhjen ose grabitjen e materialeve nukleare në shkelje të nenit 177 të këtij Kodi; ose
1.19. kanosja për kryerjen e ndonjërës prej veprave të saktësuara në nën-paragrafët 1.1 deri në 1.18 të këtij paragrafi.

2. Shprehja **"fonde"** përfshin pasurinë e çfarëdo lloji, qoftë e prekshme ose e paprekshme, e luajtshme ose e paluajtshme, sido që të jetë fituar, dhe dokumentet apo instrumentet ligjore në çfarëdo forme, përfshirë formën elektronike ose digjitale, të dëshmuarit e pronësisë ose të interesit në pasuritë e tilla, përfshirë por pa u kufizuar në, kreditë bankare, çeqet e udhëtarëve, çeqet bankare, urdhërpagesat, aksionet, letrat me vlerë, detyrimet, çeqet dhe letër kreditë.
3. Shprehja **"burime financiare"** përfshin, por nuk kufizohet në, dhënien me qira, objektet e trezorëve, dokumentacionin ose identifikimin e rrejshëm, shërbimet financiare, pajisjet, personelin, armët, mjetet e transportit, pajisjet e komunikimeve dhe pasurinë tjetër fizike, përveç medikamenteve të domosdoshme.
4. Shprehja **"grup terrorist**" nënkupton grupin e strukturuar prej më shumë se dy personave, që ekziston për një periudhe kohore dhe i cili vepron në bashkëpunim për kryerjen e terrorizmit. Grup i strukturuar nënkupton një grup i cili nuk është formuar rastësisht për kryerjen e menjëhershme të një vepre dhe i cili nuk ka nevojë të ketë role formalisht të përcaktuara për anëtarët e tij, vazhdimësinë e anëtarësisë ose strukturë të ndërtuar.

Neni 136
Kryerja e veprës terroriste

1. Kushdo që kryen një vepër terroriste dënohet me jo më pak se pesë (5) vjet burgim.
2. Kur vepra nga paragrafi 1. i këtij neni rezulton me lëndime të rënda trupore të një apo më shumë personave, kryesi dënohet me jo më pak se dhjetë (10) vjet burgim.
3. Kur vepra nga paragrafi 1. i këtij neni rezulton me vdekje të një apo më shumë personave, kryesi dënohet me burgim së paku pesëmbëdhjetë (15) vjet ose me burgim të përjetshëm.

Neni 137
Ndihma në kryerjen e terrorizmit

1. Kur vepra nga neni 385 ose 386 i këtij Kodi kryhet në lidhje me terrorizmin, kryesi dënohet me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet.
2. Kur vepra nga neni 388 i këtij Kodi kryhet në lidhje me terrorizmin, kryesi dënohet me burgim prej tre (3) deri në dhjetë (10) vjet.
3. Kushdo që e ndihmon kryesin apo bashkëpjesëmarrësin pas kryerjes së një vepre terroriste, duke i siguruar fonde ose burime të tjera materiale personave të tillë, dënohet me burgim prej tre (3) deri në dhjetë (10) vjet.

Neni 138
Lehtësimi në kryerjen e terrorizmit

1. Kushdo që në çfarëdo mënyre të drejtpërdrejtë ose të tërthortë ofron, kërkon, mbledh ose fsheh fonde apo mjete të tjera materiale me dashje, dijeni apo bazë të arsyeshme për të besuar se do të përdorën tërësisht ose pjesërisht për apo nga grupi terrorist, apo për kryerjen e veprës terroriste, dënohet me burgim prej pesë (5) deri në pesëmbëdhjetë (15) vjet.
2. Kushdo që e ndihmon kryesin apo bashkëpjesëmarrësin pas kryerjes së një vepre terroriste, duke i siguruar fonde ose burime të tjera materiale personit apo personave të tillë, dënohet me burgim prej tre (3) deri në dhjet (10) vjet.

Neni 139
Rekrutimi për terrorizëm

Kushdo që i bën thirrje personit tjetër për të kryer ose për të marrë pjesë në kryerjen e veprës terroriste, të marrë pjesë në aktivitetet e grupit terrorist apo të sigurojë fonde ose burime materiale, dënohet me burgim prej pesë (5) deri në pesëmbëdhjetë (15) vjet.

Neni 140
Trajnimi për terrorizëm

1. Kushdo që ofron ose pranon trajnim për terrorizëm, dënohet me burgim prej pesë (5) deri në pesëmbëdhjetë (15) vjet.
2. Për qëllime të këtij neni, shprehja "trajnim për terrorizëm" nënkupton trajnimin ose udhëzimin për prodhimin ose përdorimin e mjeteve shpërthyese, armëve të zjarrit ose armëve tjera apo substancave të dëmshme apo helmuese, ose me metoda apo teknika tjera specifike, me qëllim që të kryejë apo të kontribuojë në kryerjen e veprës terroriste, duke ditur se shkathtësitë e mësuara kanë për synim që të përdoren për këtë qëllim.

Neni 141
Shtytja për kryerjen e veprave terroriste

Kushdo që shpërndan, ose në ndonjë mënyrë tjetër mundëson mesazhin për publikun, me qëllim që të shtytë kryerjen e aktit terrorist, kur sjellja e tillë pavarësisht nëse

avokon drejtpërdrejtë ose jo aktet terroriste, shkakton rrezikun që një ose më shumë vepra të tilla të kryhen, dënohet me burgim prej një (1) deri në pesë (5) vjet.

Neni 142
Fshehja ose moslajmërimi i terroristëve dhe grupeve terroriste

1. Kushdo që fsheh ekzistimin e një grupi terrorist ose të anëtarëve të tij, e pengon zbulimin ose kapjen e grupit terrorist ose të anëtarëve të tij, dënohet me burgim prej tre (3) deri në dhjetë (10) vjet.
2. Nëse vepra nga neni 385 ose 386 i këtij Kodi kryhet në lidhje me terrorizmin, kryesi dënohet me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet.
3. Nëse vepra nga neni 388 i këtij Kodi kryhet në lidhje me terrorizmin, kryesi dënohet me burgim prej tre (3) deri në dhjetë (10) vjet.

Neni 143
Organizimi dhe pjesëmarrja në grup terrorist

1. Kushdo që organizon ose drejton një grup terrorist dënohet me gjobë deri në pesëqind mijë (500.000) Euro dhe me burgim prej dhjetë (10) deri në njëzet (20) vjet.
2. Kushdo që merr pjesë në veprimtaritë e grupit terrorist dënohet me burgim prej pesë (5) deri në dhjetë (10) vjet.

Neni 144
Përgatitja e veprave terroriste ose veprave penale kundër rendit kushtetues dhe sigurisë së Republikës së Kosovës

1. Kushdo që përgatit kryerjen e veprave penale nga nenet 135-142 të këtij Kapitulli, dënohet me burgim prej një (1) deri në pesë (5) vjet.
2. Për qëllime të këtij neni, shprehja "përgatitje e veprës penale" përfshin furnizimin apo aftësimin e mjeteve kryesve për kryerjen e veprës penale, eliminimin e pengesave për kryerjen e veprës penale, marrëveshjen, planifikimin apo organizimin me personat e tjerë për kryerjen e veprës penale, si dhe çfarëdo veprime tjera që krijojnë kushte për kryerjen e drejtpërdrejtë të veprës penale, por të cilat nuk e përbëjnë vet veprën penale.
3. Kushdo që dërgon apo bartë në apo jashtë territorit të Republikës së Kosovës armë, eksploziv, helme, pajisje, municion apo material tjetër për kryerjen e një apo më shumë veprave penale nga ky kapitull, dënohet me burgim prej pesë (5) deri në pesëmbëdhjetë (15) vjet.
4. Kushdo që me qëllim të kryerjes së një apo më shumë veprave terroriste nga ky Kapitull, dërgon apo bartë grupe te armatosura, pajisje ose burime tjera materiale në ose jashtë Republikës së Kosovës, dënohet me burgim prej dhjetë (10) deri në njëzet (20) vjet.

Neni 145
Parëndësia e kryerjes së veprës terroriste

Që një vepër të përbëjë vepër penale sipas neneve 135-144 të këtij Kapitulli, nuk është e nevojshme që vepra terroriste të jetë kryer.

Neni 146
Kalimi i paautorizuar i vendkalimeve kufitare ose i vijës kufitare

1. Kushdo që kalon kufirin apo vijën kufitare të Republikës së Kosovës në cilindo vend përveç në kufirin apo vendkalimet e autorizuara kufitare, dënohet me dyqind e pesëdhjetë (250) Euro gjobë ose me burgim deri në gjashtë (6) muaj.
2. Kur vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni kryhet nga kryesi i cili është i shoqëruar nga një fëmijë ose ndonjë person tjetër, kryesi dënohet me gjobë deri në dymijë e pesëqind (2.500) Euro ose me burgim deri në një (1) vit.
3. Kur vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni kryhet në një apo më shumë nga rrethanat e mëposhtme, kryesi dënohet me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në tre (3) vjet nëse:
   3.1. kryesi ka qenë më parë i dënuar për vepër penale nga ky nen;
   3.2. gjatë kohës së kapjes, kryesi ikë, përpiqet të ikë ose në ndonjë mënyrë tjetër i reziston kapjes nga policia ose KFOR-i;
   3.3. kalimi është bërë ndërmjet orës tetë (8:00) në mbrëmje deri në orën gjashtë (6:00) në mëngjes gjatë periudhës prej 1 prillit deri më 30 shtator, ose ndërmjet orës gjashtë (6:00) në mbrëmje deri në orën gjashtë (6:00) në mëngjes gjatë periudhës prej 1 tetorit deri më 31 mars; ose
   3.4. kryesi posedon armë, municion ose rroba ushtarake, furnizime apo pajisje.
4. Tentativa për të kryer vepër penale nga paragrafi 1. ose 2. i këtij neni është e dënueshme.
5. Personi nuk është penalisht përgjegjës sipas këtij neni për kalimin në një pikë kufitare të paautorizuar të kufirit shtetëror nëse kalimi ka ndodhur në një vendkalim i cili është hapur përkohësisht nga Komandanti i KFOR-it.
6. Kurrfarë procedure penale që përfshin veprën nga ky nen nuk mund të fillohet apo të vazhdohet kundër asnjë refugjati në mirëbesim ose kundër personit të zhvendosur brenda vendit, që vjen nga territori ku jeta apo trupi i tij ose liritë apo të drejtat themelore janë të rrezikuara, me kusht që ai t'i jetë paraqitur policisë apo KFOR-it brenda një kohe të arsyeshme dhe të tregojë arsye bindëse për kalimin e vendkalimit apo pikës kufitare të paautorizuar.

Neni 147
Nxitja e urrejtjes, përçarjes ose mos durimit kombëtar, racor, fetar apo etnik

1. Kushdo që nxit ose përhap publikisht urrejtje, përçarje ose mosdurim midis grupeve kombëtare, racore, fetare, etnike apo grupe tjera të tilla që jetojnë në Republikës e Kosovës, në mënyrën e cila mund të prishë rendin publik, dënohet me gjobë ose me burgim deri në pesë (5) vjet.
2. Kushdo që në mënyrë sistematike ose duke keqpërdorur pozitën apo autorizimet e

tij kryen veprën nga paragrafi 1. i këtij neni ose shkakton trazira, dhunë ose pasoja të tjera të rënda me kryerjen e veprës së tillë, dënohet me burgim prej një (1) deri në tetë (8) vjet.

3. Kushdo që kryen veprën penale nga paragrafi 1. i këtij neni përmes shtrëngimit, rrezikimit të sigurisë, përqeshjes së simboleve kombëtare, racore, etnike apo fetare, duke dëmtuar pasurinë e personit tjetër ose duke përdhosur monumentet apo varrezat, dënohet me burgim prej një (1) deri në tetë (8) vjet.
4. Kushdo që në mënyrë sistematike ose duke keqpërdorur pozitën apo autorizimet e tij kryen veprën penale nga paragrafi 3. i këtij neni ose shkakton trazira, dhunë ose pasoja të tjera të rënda me kryerjen e veprës së tillë, dënohet me burgim prej dy (2) deri në dhjetë (10) vjet.

KAPITULLI XV
VEPRAT PENALE KUNDËR NJERËZIMIT DHE VLERAVE TË MBROJTURA ME TË DREJTËN NDËRKOMBËTARE

Neni 148
Gjenocidi

1. Kushdo që me qëllim të asgjësimit të tërësishëm apo të pjesërishëm të ndonjë grupi kombëtar, etnik, racor apo fetar kryen një ose më shumë nga veprimet e mëposhtme, do të dënohet me burgim së paku pesëmbëdhjetë (15) vjet ose me burgim të përjetshëm:
   1.1. vrasjen e anëtarëve të grupit;
   1.2. shkaktimin e lëndimeve të rënda trupore apo mendore të anëtarëve të grupit;
   1.3. vënien e qëllimshme të grupit në kushte të tilla të jetës të cilat shpijnë në shfarosje të plotë apo të pjesërishme fizike;
   1.4. vënien e masave të cilat kanë për qëllim që të pengojnë lindjet brenda grupit;
   1.5. transferimin me dhunë të fëmijëve të grupit në një grup tjetër.

Neni 149
Krimet kundër njerëzimit

1. Kushdo që kryen një ose më shumë nga veprat e mëposhtme, duke ditur se vepra e tillë është pjesë e një sulmi të gjerë apo sistematik të drejtuar kundër popullsisë civile, dënohet me burgim së paku pesëmbëdhjetë (15) vjet ose me burgim të përjetshëm:
   1.1. vrasje;
   1.2. shfarosje;
   1.3. skllavërim;
   1.4. deportim ose përzënie me dhunë të popullsisë;
   1.5. burgosje ose privime të tjera të rënda të lirisë fizike në kundërshtim me rregullat themelore të së drejtës ndërkombëtare;
   1.6. torturë;
   1.7. dhunim, skllavëri seksuale, prostitucion të detyruar, shtatzëni me dhunë, sterilizim të detyruar ose çfarëdo forme tjetër po aq të rëndë të dhunës seksuale;

1.8. persekutim të një grupi ose kolektivi të identifikuar për arsye politike, racore, kombëtare, etnike, kulturore, fetare, gjinore apo në ndonjë baze tjetër e cila është botërisht e njohur si e palejueshme sipas të drejtës ndërkombëtare, në lidhje me veprat nga ky nen dhe nenet 148 dhe 150-153 të këtij Kodi;
1.9. zhdukja e detyruar e personave;
1.10. krimin e aparteidit; ose
1.11. vepra të tjera çnjerëzore të karakterit të ngjashëm që qëllimisht shkaktojnë vuajtje të mëdha, lëndime të rënda të trupit ose të shëndetit fizik apo mendor.

2. Për qëllime të këtij neni:
2.1. Shprehja "sulm i drejtuar kundër cilësdo popullsi civile" nënkupton një mënyrë veprimi që përfshin kryerjen e shumëfishtë të veprave të parapara në paragrafin 1 të këtij neni kundër cilësdo popullsi civile, në pajtim apo në përkrahje të një politike shtetërore apo të organizuar për të kryer një sulm të tillë.
2.2. Shprehja "shfarosje" përfshin shkaktimin me qëllim të kushteve jetësore, ndër të tjera, privimin e qasjes në ushqim dhe barëra, si pasojë e të cilave llogaritet se do të sjellin zhdukjen e një pjese të popullsisë.
2.3. Shprehja "skllavërim" nënkupton ushtrimin e një kompetence ose e të gjitha kompetencave që lidhen me të drejtën e pronësisë mbi një person, duke përfshirë ushtrimin e një kompetence të tillë në trafikimin e njerëzve, veçanërisht të grave dhe të fëmijëve.
2.4. Shprehja "depërtim apo transferim me dhunë i popullsisë" nënkupton zhvendosje të personave të caktuar me anë të dëbimit apo të akteve të tjera shtrënguese nga zona ku ata banojnë në mënyrë të ligjshme, pa arsye të cilat lejohen sipas të drejtës ndërkombëtare.
2.5. Shprehja "torturë" nënkupton shkaktimin e qëllimshëm të dhembjes apo vuajtjes së rëndë fizike apo mendore mbi një person i cili është në ndalim ose është nën kontrollin e kryesit; përjashtimisht, tortura nuk përfshin dhembjen apo vuajtjen karakteristike apo të pandarë që rezulton vetëm nga sanksionet e ligjshme.
2.6. Shprehja "shtatzëni e detyruar" nënkupton mbyllje e paligjshme e gruas së lënë shtatzënë me dhunë, me qëllim që të ndikojë në përbërjen etnike të ndonjë popullsie ose duke kryer shkelje të tjera të rënda të së drejtës ndërkombëtare.
2.7. Shprehja "persekutim" nënkupton privim i rëndë dhe me dashje nga të drejtat themelore për shkak të identitetit të grupit apo kolektivitetit në kundërshtim me të drejtën ndërkombëtare.
2.8. Shprehja "krim i aparteidit" nënkupton akte çnjerëzore që kanë karakter të ngjashëm me ato të parapara në paragrafin 1 të këtij neni, të kryera në kontekstin e një regjimi të institucionalizuar të shtypjes dhe sundimit sistematik nga një grup racorë mbi një grup tjetër racorë ose grupe të tjera dhe që kryhen me qëllim të mbajtjes së atij regjimi.
2.9. Shprehja "zhdukja e detyruar e personave" nënkupton arrestim, paraburgim ose rrëmbim i personave nga, ose me autorizimin, përkrahjen apo pajtimin e shtetit apo organizatës politike, shoqëruar me refuzimin e atij autoriteti ose organizate për të pranuar atë privim të lirisë apo për të dhënë informata mbi

fatin apo vendndodhjen e atyre personave, me qëllim që këta persona të mos gëzojnë mbrojte juridike për një periudhë të zgjatur kohore.

2.10. Shprehja "gjini" i referohet të dy gjinive, mashkullit dhe femrës, brenda kontekstit të shoqërisë.

Neni 150
Krimet e luftës në shkelje të rëndë të konventave të Gjenevës

1. Kushdo që shkel rëndë Konventat e Gjenevës të 12 gushtit 1949, dënohet me:
   1.1. burgim prej së paku dhjetë (10) vjet ose me burgim të përjetshëm, për veprat nga nën-paragrafët 2.4., 2.5., 2.6., 2.7. ose 8. të paragrafit 2. të këtij neni; ose
   1.2. burgim prej së paku pesëmbëdhjetë (15) vjet ose me burgim të përjetshëm, për veprat nga nën-paragrafët 2.1, 2.2 ose 2.3 të paragrafit 2. të këtij neni.
2. Shkelje e rëndë e Konventave të Gjenevës të 12 gushtit 1949 do të thotë një apo më shumë prej veprimeve vijuese të kryera gjatë kohës së luftës apo konfliktit të armatosur kundër personave ose pasurisë që janë të mbrojtura me dispozitat përkatëse të Konventave të Gjenevës:
   2.1. vrasja me qëllim;
   2.2. tortura ose trajtimi çnjerëzor, duke përfshirë eksperimentet biologjike;
   2.3. shkaktimi i qëllimshëm i vuajtjeve të mëdha ose i dëmtimeve të rënda trupore apo shëndetësore, dhunimi dhe ngacmimi seksual;
   2.4. shkatërrimi masiv dhe përvetësimi i pasurisë i pajustifikueshëm nga nevojat ushtarake dhe i kryer në mënyrë të kundërligjshme dhe të qëllimshme;
   2.5. detyrimi i robit të luftës ose personit tjetër të mbrojtur për të shërbyer në forcat e armikut;
   2.6. privimi i qëllimshëm i robit të luftës ose personit tjetër të mbrojtur nga e drejta për gjykim të drejtë dhe të rregullt;
   2.7. deportimi i kundërligjshëm apo transferimi ose mbyllja e kundërligjshme dhe
   2.8. marrja e pengjeve.

Neni 151
Krimet e luftës në shkelje të rëndë të ligjeve dhe zakoneve që zbatohen në konfliktin e armatosur ndërkombëtar

1. Kushdo që shkel rëndë ligjet dhe zakonet që zbatohen në konfliktet e armatosura ndërkombëtare, brenda kornizës së përcaktuar të së drejtës ndërkombëtare, dënohet me:
   1.1. burgim prej së paku pesë (5) vjet ose me burgim të përjetshëm, për veprat nga nën paragrafët 2.9, 2.13, 2.14, 2.15, 2.16, 2.26, 2.29, 2.30 ose 2.31 të paragrafit 2. të këtij neni; ose
   1.2. burgim prej së paku dhjetë (10) vjet ose me burgim të përjetshëm, për veprat nga nën-paragrafët 2.1, 2.2, 2.3, 2.4, 2.5, 2.6, 2.7, 2.8, 2.10, 2.11, 2.12, 2.17, 2.18, 2.19, 2.20, 2.21, 2.22, 2.23, 2.24, 2.25, 2.27 ose 2.28 të paragrafit 2. të këtij neni.
2. Shkelja e rëndë e ligjeve dhe e zakoneve që zbatohen për konfliktet e armatosura ndërkombëtare, brenda kornizës së përcaktuar të së drejtës ndërkombëtare, nënkupton një ose më shumë nga veprimet vijuese:

2.1. sulmet e drejtuara me qëllim kundër popullsisë civile ose ndaj individëve të veçantë civilë që nuk marrin pjesë drejtpërdrejt në konflikt;
2.2. sulmet e drejtuara me qëllim kundër objekteve civile që nuk janë objektiva ushtarake;
2.3. sulmet e drejtuara me qëllim kundër personelit, instalimeve, materialeve, njësive ose automjeteve të përfshira në misionet e ndihmës humanitare ose paqeruajtëse në përputhje me Kartën e Kombeve të Bashkuara, për aq kohë sa gëzojnë të drejtën për mbrojtjen e atyre civilëve ose objekteve civile sipas të drejtës ndërkombëtare për konfliktet e armatosura;
2.4. fillimi i sulmit të qëllimshëm, duke ditur se sulmi i tillë do të shkaktojë humbje aksidentale të jetës ose plagosje të civilëve, dëme të objekteve civile, dëme të gjëra, afatgjate dhe të rënda ndaj mjedisit natyror, që do të ishte haptazi tejkalim sa i përket përparësisë së gjithëmbarshme konkrete dhe të drejtpërdrejtë të parashikuar ushtarake;
2.5. sulmi ose bombardimi me çfarëdo mjete i qyteteve, fshatrave, vendbanimeve ose ndërtesave që janë të pambrojtura dhe të cilat nuk janë objektiva ushtarake;
2.6. vrasja ose plagosja e luftëtarit i cili është dorëzuar në mëshirë pasi ka dorëzuar armët ose që nuk ka më mjete mbrojtëse;
2.7. përdorimi i papërshtatshëm i flamurit të armëpushimit, i flamurit apo i shenjave dhe i uniformave ushtarake të armikut apo të Kombeve të Bashkuara ose i emblemave dalluese të Konventave të Gjenevës, që kanë si pasojë vdekjen ose plagosjet e rënda;
2.8. transferimi i drejtpërdrejt ose i tërthortë nga forcat pushtuese i pjesëve të popullatës së vet civile në territorin që e pushton, ose deportimi apo transferimi i tërësishëm apo i pjesërishëm i popullatës së territorit të pushtuar brenda ose jashtë këtij territori;
2.9. drejtimi me qëllim i sulmeve kundër ndërtesave fetare, shkollore, artistike, shkencore, me qëllime bamirëse, monumenteve historike, spitaleve dhe vendeve ku janë mbledhur të sëmurët dhe të plagosurit, me kusht që të mos jenë objektiva ushtarake;
2.10. nënshtrimi i personave nën autoritetin e një pale kundërshtare ndaj të cilëve kryhen gjymtime fizike ose eksperimente të ndryshme mjekësore apo shkencore, të cilat nuk arsyetohen në aspektin e trajtimit mjekësor, dental apo spitalor të personit përkatës dhe nuk janë në dobi të tij, e që shkaktojnë vdekje apo rrezik serioz ndaj shëndetit të një apo shumë personave të tillë;
2.11. vrasja apo plagosja dinake e individëve që i përkasin vendit apo ushtrisë armike;
2.12. deklarimi se nuk do të ketë mëshirë;
2.13. shkatërrimi apo marrja e pasurisë së armikut, përveç rasteve kur kjo kërkohet domosdoshmërisht për nevojat e luftës;
2.14. deklarimi se abrogohen, suspendohen apo nuk pranohen nga gjykata të drejtat dhe veprimet e pjesëtarëve të kombit që është palë e armikut;
2.15. detyrimi i qytetarëve të palës armike për të marrë pjesë në operacionet e luftës të drejtuara kundër vendit të tyre, madje edhe nëse kanë qenë në shërbimin e palës kundërshtare para fillimit të luftës;

2.16. plaçkitja e një qyteti ose e një vendi, qoftë edhe kur merret me anë të sulmit;
2.17. përdorimi i helmeve ose i armëve helmuese;
2.18. përdorimi i gazrave asfiksuese, helmuese ose i llojeve të tjera të gazrave dhe i të gjitha analogeve të lëngshme, materialeve ose mjeteve;
2.19. përdorimi i plumbave që përhapen apo rrafshohen lehtë në trupin e njeriut, siç janë plumbat me mbulesë të fortë që nuk e mbulojnë plotësisht bërthamën ose janë të çarë me prerje;
2.20. përdorimi i armëve, projektilave, materialeve dhe metodave të luftimit të një natyre të tillë që shkaktojnë plagosje të tepërta apo vuajtje të panevojshme ose të cilat nuk bëjnë dallim në shkaktimin e këtyre vuajtjeve, në shkelje me të drejtën ndërkombëtare për konfliktet e armatosura, duke përfshirë këtu armët kimike, armët biologjike, copëzat e padetektueshme, armët verbuese laserike ose minat mashtruese të përkufizuara në Protokollin II të Konventës mbi ndalimin ose kufizimin e disa armëve konvencionale të cilat konsiderohen se janë jashtëzakonisht dëmtuese ose kanë efekte pa i zgjedhur caqet, të datës 10 tetor 1980;
2.21. kryerja e akteve fyese ndaj dinjitetit personal, veçanërisht trajtimi nënçmues dhe poshtërues;
2.22. kryerja e dhunimeve, skllavëria seksuale, prostitucioni i detyruar, shtatzënia e dhunshme, steriliteti i detyruar ose ndonjë formë tjetër e dhunës seksuale, e cila përbën gjithashtu shkelje të rëndë të Konventave së Gjenevës;
2.23. përdorimi i qëllimshëm i pranisë së civilëve ose i personave të tjerë që gëzojnë mbrojtje me qëllim të mbajtjes së disa pikave, zonave apo forcave ushtarake të mbrojtura nga operacionet ushtarake;
2.24. drejtimi me qëllim i sulmeve kundër ndërtesave, materialeve, njësive mjekësore dhe transportit, personelit fetar dhe personelit që përdorin shenjën dalluese të Konventave të Gjenevës në pajtim me të drejtën ndërkombëtare;
2.25. vënia me qëllim e popullsisë civile në gjendje të urisë si metodë lufte, duke privuar ata nga mjetet e domosdoshme për ekzistencën e tyre, duke përfshirë këtu edhe pengimin e qëllimshëm të furnizimeve të paraparë me Konventat e Gjenevës;
2.26. rekrutimi apo mobilizimi i fëmijëve nën moshën pesëmbëdhjetë vjet në forcat e armatosura kombëtare ose duke i përdorur ata të marrin pjesë aktivisht në armiqësi;
2.27. drejtimi me qëllim i sulmeve kundër punimeve ose instalimeve që përmbajnë forca të rrezikshme duke e ditur se sulmi i tillë do të shkaktojë humbje të tepërta të jetës, lëndime të civilëve ose dëmtime të objekteve civile;
2.28. drejtimi me qëllim i sulmeve pa dallim, kur sulmi i tillë nuk drejtohet në një objektiv specifik ushtarak, shfrytëzon metoda apo mjete të luftës të cilat nuk mund të drejtohen në objekte specifike ushtarake ose metoda apo mjete të luftës efekti i të cilave nuk mund të kufizohet ashtu siç kërkohet me Protokollin i të Konventave të Gjenevës të datës 12 gusht 1949 dhe që, për pasojë, është i një natyre të tillë që godet objektivat ushtarake dhe civile ose objektet civile pa dallim;
2.29. skllavëria dhe tregtia me robërit;
2.30. shqiptimi i dënimeve kolektive;

2.31. ushtrimi i trysnisë mbi popullsinë e një territori të pushtuar për të ndërruar kombësinë ose për të dhënë betimin për forcat armike.

Neni 152
Krimet e luftës në shkelje të rëndë të nenit 3 të përbashkët të konventave të Gjenevës

1. Kushdo që shkel rëndë nenin 3, që është i përbashkët për katër Konventat e Gjenevës të datës 12 gusht 1949, dënohet me burgim së paku pesë (5) vjet ose me burgim të përjetshëm.
2. Shkelje e rëndë e nenit 3, të përbashkët për të katër Konventat e Gjenevës të 12 Gushtit 1949, do të thotë një ose më shumë nga veprat e mëposhtme të kryera në kontekstin e një konflikti të armatosur jo të një karakteri ndërkombëtar kundër personave që nuk marrin pjesë aktive në armiqësi, duke përfshirë edhe pjesëtarët e forcave të armatosura që i kanë dorëzuar armët dhe që nuk janë në gjendje të luftojnë për shkak të sëmundjes, plagëve, ndalimit ose për ndonjë shkak tjetër:
   2.1. dhuna ndaj jetës dhe personit, në veçanti vrasja e çdo lloji, gjymtimi, trajtimi mizor dhe tortura;
   2.2. kryerja e akteve fyese ndaj dinjitetit të personit, në veçanti poshtërimi dhe trajtimi nënçmues;
   2.3. marrja e pengjeve;
   2.4. shqiptimi i dënimeve dhe kryerja e ekzekutimeve pa aktgjykime paraprake të shpallura nga një gjykatë e rregullt që ofron të gjitha garancitë gjyqësore të cilat përgjithësisht njihen si të domosdoshme.
3. Ky nen zbatohet për konfliktet e armatosura që nuk janë të karakterit ndërkombëtar dhe nuk zbatohet për situatat e çrregullimeve dhe tensioneve të brendshme, siç janë trazirat, veprat sporadike dhe të izoluara të dhunës ose vepra të tjera të natyrës së ngjashme.

Neni 153
Krimet e luftës në shkelje të rëndë të ligjeve dhe zakoneve që zbatohen në konfliktet e armatosura që nuk janë të karakterit ndërkombëtar

1. Kushdo që shkel rëndë ligjet dhe zakonet që zbatohen në konfliktet e armatosura që nuk janë të karakterit ndërkombëtar, brenda kornizës së përcaktuar të së drejtës ndërkombëtare, dënohet me:
   1.1. burgim prej së paku pesë (5) vjet ose me burgim të përjetshëm, për veprat penale nga nën paragrafët 2.4, 2.5, 2.7, 2.12, 2.23 ose 2.24 të paragrafit 2. të këtij neni; ose
   1.2. burgim prej së paku dhjetë (10) vjet ose me burgim të përjetshëm, për veprat penale nga nën paragrafët 2.1, 2.2, 2.3, 2.6, 2.8, 2.9, 2.10, 2.11, 2.13, 2.14, 2.15, 2.16, 2.17, 2.18, 2.19, 2.20, 2.21 ose 2.22 të paragrafit 2. të këtij neni.
2. Shkelja e rëndë e ligjeve dhe e zakoneve që zbatohen për konfliktet e armatosura që nuk janë të karakterit ndërkombëtar, brenda kornizës së përcaktuar të së drejtës ndërkombëtare, nënkupton një ose më shumë nga veprimet vijuese:
   2.1. sulmet e drejtuara me qëllim kundër popullsisë civile ose ndaj individëve të veçantë civilë që nuk marrin pjesë drejtpërdrejt në konflikt;

2.2. drejtimi me qëllim i sulmeve kundër ndërtesave, materialeve, njësive mjekësore dhe transportit, personelit fetar dhe personelit që përdorin shenjën dalluese të Konventave të Gjenevës në pajtim me të drejtën ndërkombëtare;

2.3. sulmet e drejtuara me qëllim kundër personelit, instalimeve, materialeve, njësive ose automjeteve të përfshira në misionet e ndihmës humanitare ose paqeruajtëse në përputhje me Kartën e Kombeve të Bashkuara, për aq kohë sa gëzojnë të drejtën për mbrojtjen e atyre civilëve ose objekteve civile sipas të drejtës ndërkombëtare për konfliktet e armatosura;

2.4. drejtimi me qëllim i sulmeve kundër ndërtesave fetare, shkollore, artistike, shkencore, me qëllime bamirëse, monumenteve historike, spitaleve dhe vendeve ku janë mbledhur të sëmurët dhe të plagosurit, me kusht që të mos jenë objektiva ushtarake;

2.5. plaçkitja e një qyteti ose e një vendi, qoftë edhe kur merret me anë të sulmit;

2.6. kryerja e dhunimeve, skllavëria seksuale, prostitucioni i detyruar, shtatzënia e dhunshme, steriliteti i detyruar ose ndonjë formë tjetër e dhunës seksuale, e cila përbën gjithashtu shkelje të rëndë të nenit 3, të përbashkët për të katër Konventat e Gjenevës;

2.7. rekrutimi apo mobilizimi i fëmijëve nën moshën pesëmbëdhjetë vjet në forcat e armatosura kombëtare ose duke i përdorur ata të marrin pjesë aktivisht në armiqësi;

2.8. urdhërimi për zhvendosjen e popullatës civile për shkaqe që lidhen me konfliktin, përveç kur kjo kërkohet për shkak të sigurisë së civilëve të përfshirë ose për shkaqe imperative ushtarake;

2.9. vrasja ose plagosja dinake e luftëtarit kundërshtar;

2.10. deklarimi se nuk do të ketë mëshirë;

2.11. nënshtrimi i personave nën autoritetin e një pale kundërshtare ndaj të cilëve kryhen gjymtime fizike ose eksperimente të ndryshme mjekësore apo shkencore, të cilat nuk arsyetohen në aspektin e trajtimit mjekësor, dental apo spitalor ndaj personit përkatës dhe nuk janë në dobi të tij, e që shkaktojnë vdekje apo rrezik serioz ndaj shëndetit të një apo shumë personave të tillë;

2.12. shkatërrimi apo marrja e pasurisë së armikut, përveç rasteve kur kjo kërkohet domosdoshmërisht për nevojat e luftës;

2.13. sulmi ose bombardimi me çfarëdo mjete i qyteteve, fshatrave, vendbanimeve ose ndërtesave që janë të pambrojtura dhe të cilat nuk janë objektiva ushtarake;

2.14. sulmet e drejtuara me qëllim kundër objekteve civile që nuk janë objektiva ushtarake;

2.15. fillimi i sulmit të qëllimshëm, duke ditur se sulmi i tillë do të shkaktojë humbje aksidentale të jetës ose plagosje të civilëve, dëme të objekteve civile, dëme të gjëra, afatgjate dhe të rënda ndaj mjedisit natyror, që do të ishte haptazi tejkalim sa i përket përparësisë së gjithëmbarshme konkrete dhe të drejtpërdrejtë të parashikuar ushtarake;

2.16. drejtimi me qëllim i sulmeve pa dallim kur sulmi i tillë nuk drejtohet në një objektiv specifik ushtarak, shfrytëzon metoda apo mjete të luftës të cilat nuk mund të drejtohen në objekte specifike ushtarake ose metoda apo mjete të

luftës efekti i të cilave nuk mund të kufizohet dhe që, për pasojë, është i një natyre të tillë që godet objektivat ushtarake dhe civile ose objektet civile pa dallim;

2.17. përdorimi i qëllimshëm i prezencës së civilëve ose i personave të tjerë që gëzojnë mbrojtje me qëllim të mbajtjes së disa pikave, zonave apo forcave ushtarake të mbrojtura nga operacionet ushtarake;

2.18. vënia me qëllim e popullsisë civile në gjendje të urisë si metodë lufte, duke privuar ata nga mjetet e domosdoshme për ekzistencën e tyre, duke përfshirë këtu edhe pengimin e qëllimshëm të furnizimeve të parapara me Konventat e Gjenevës;

2.19. përdorimi i helmeve ose i armëve helmuese;

2.20. përdorimi i gazrave asfiksuese, helmuese ose i llojeve të tjera të gazrave dhe i të gjitha analogeve të lëngshme, materialeve ose mjeteve;

2.21. përdorimi i plumbave që përhapen apo rrafshohen lehtë në trupin e njeriut, siç janë plumbat me mbulesë të fortë që nuk e mbulojnë plotësisht bërthamën ose janë të çarë me prerje;

2.22. përdorimi i armëve, projektilave, materialeve dhe metodave të luftimit të një natyre të tillë që shkaktojnë plagosje të tepërta apo vuajtje të panevojshme ose të cilat nuk bëjnë dallim në shkaktimin e këtyre vuajtjeve, në shkelje me të drejtën ndërkombëtare për konfliktet e armatosura, duke përfshirë këtu armët kimike, armët biologjike, copëzat e padetektueshme, armët verbuese laserike ose minat mashtruese të përkufizuara në Protokollin II të Konventës mbi ndalimin ose kufizimin e disa armëve konvencionale të cilat konsiderohen se janë jashtëzakonisht dëmtuese ose kanë efekte pa i zgjedhur caqet, të datës 10 tetor 1980;

2.23. skllavëria dhe tregtia me robërit;

2.24. shqiptimi i dënimeve kolektive.

3. Ky nen zbatohet për konfliktet e armatosura që nuk kanë karakter ndërkombëtar dhe nuk zbatohet për situatat e trazirave dhe të tensioneve të brendshme, siç janë trazirat, veprat sporadike dhe të izoluara të dhunës ose aktet e tjera të natyrës së ngjashme. Dispozitat e këtij neni vlejnë për konfliktet e armatosura që ndodhin në territorin e një shteti kur ekziston një konflikt i armatosur i zgjatur midis organeve të pushtetit dhe grupeve të organizuara të armatosura ose midis grupeve të tilla.

Neni 154
Sulmet në konfliktet e armatosura që nuk kanë karakter ndërkombëtar kundër instalimeve që përmbajnë forca të rrezikshme

Kushdo që në shkelje të ligjeve dhe zakoneve që zbatohen në konfliktet e armatosura që nuk kanë karakter ndërkombëtar, me qëllim kryen sulm kundër punimeve ose instalimeve që përmbajnë forca të rrezikshme, me dijeninë se një sulm i tillë do të shkaktojë humbje të mëdha jetësh, lëndime për civilët ose dëme në objektet civile, dënohet me burgim së paku dhjetë (10) vjet ose me burgim të përjetshëm.

Neni 155
Rekrutimi ose regjistrimi i personave midis moshës pesëmbëdhjetë dhe tetëmbëdhjetë vjet në konfliktin e armatosur

Kushdo që rekruton ose regjistron personat midis moshës pesëmbëdhjetë (15) dhe tetëmbëdhjetë (18) vjet në forcat e armatosura ose në grupe apo i shfrytëzon ata për pjesëmarrje aktive në armiqësitë në një konflikt të armatosur të një karakteri ndërkombëtar ose në ndonjë konflikt të armatosur që nuk ka karakter ndërkombëtar, dënohet me burgim prej një (1) deri në dhjetë (10) vjet.

Neni 156
Përdorimi i mjeteve ose i metodave të ndaluara të luftimit

1. Kushdo që gjatë luftës apo konfliktit të armatosur përdorë armë, projektila dhe materiale e metoda të luftimit të cilat nuk parashihen me nën-paragrafin 2.20 të 151 ose me nën-paragrafin nenin 2.22 të nenit 153 të këtij Kodi dhe që janë në kundërshtim me të drejtën ndërkombëtare për konfliktet e armatosura, dënohet me jo më pak se pesë (5) vjet burgim.
2. Nëse vepra nga paragrafi 1. i këtij neni rezulton me vdekjen e një ose më shumë personave, kryesi dënohet me burgim së paku dhjetë (10) vjet ose me burgim të përjetshëm.

Neni 157
Shtyrja e paarsyeshme e riatdhesimit të robërve të luftës ose e civilëve

Kushdo që në shkelje të rregullave të së drejtës ndërkombëtare, urdhëron apo shqipton shtyrjen e paarsyeshme të riatdhesimit të robërve të luftës apo të civilëve pas përfundimit të luftës ose të konfliktit të armatosur, dënohet me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet.

Neni 158
Përvetësimi i kundërligjshëm i sendeve nga të vrarët ose të plagosurit në fushëbetejë

1. Kushdo që urdhëron përvetësimin e kundërligjshëm të sendeve nga të vrarët apo të plagosurit në fushëbetejë apo që kryen përvetësimin e tillë, dënohet me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet.
2. Kur vepra nga paragrafi 1. i këtij neni kryhet në mënyrë barbare, kryesi dënohet me burgim prej një (1) deri në dhjetë (10) vjet.

Neni 159
Rrezikimi i negociatorëve

Kushdo që në shkelje të së drejtës ndërkombëtare, gjatë kohës së luftës apo të konfliktit të armatosur e fyen, e keqtrajton ose e ndalon negociatorin apo përcjelljen e tij ose ua pengon kthimin apo në ndonjë mënyrë tjetër e cenon paprekshmërinë e tyre, dënohet me burgim prej (6) gjashtë muaj deri në pesë (5) vjet.

Neni 160
Organizimi i grupeve për kryerjen e gjenocidit, krimeve kundër njerëzimit dhe krimeve të luftës

1. Kushdo që organizon një grup me qëllim të kryerjes së ndonjë prej veprave penale nga nenet 148-156 të këtij Kodi, dënohet me burgim prej një (1) deri në dhjetë (10) vjet.
2. Kushdo që bëhet anëtar i grupit nga paragrafi 1. i këtij neni, dënohet me burgim prej një (1) deri në pesë (5) vjet.
3. Anëtari i grupit nga paragrafi 1. i këtij neni që e paraqet grupin para se të ketë kryer vepër penale, dënohet me burgim deri në tri (3) vjet ose mund të lirohet nga dënimi.

Neni 161
Përgjegjësia e komandantëve dhe përgjegjësve të tjerë

1. Komandanti ushtarak ose personi i cili në mënyrë efektive vepron si komandant ushtarak është penalisht përgjegjës për veprat penale të përcaktuara në nenet 148-156 të këtij Kodi të kryera nga forcat nën komandën dhe kontrollin e tij efektiv ose nën autoritetin dhe kontrollin efektiv si rezultat i dështimit të tij për të ushtruar kontrollin e duhur mbi forcat e tilla, ku:
   1.1. ai komandant ushtarak apo person ose e ka ditur ose për shkak të rrethanave të asaj kohe është dashur të dijë se ato forca po kryenin ose ishin përgatitur të kryenin vepra penale të tilla; dhe
   1.2. ai komandant ushtarak ose person nuk i ka ndërmarrë të gjitha masat e arsyeshme dhe të nevojshme brenda kompetencave të tij për të parandaluar ose për të ndalur kryerjen e tyre apo për të dorëzuar çështjen te organet kompetente për hetim dhe ndjekje.
2. Në lidhje me marrëdhëniet e eprorëve dhe të vartësve të tyre që nuk janë përshkruar në paragrafin 1 të këtij neni, eprori është penalisht përgjegjës për veprat penale të cekura në nenet 148-159 të këtij Kodi, të kryera nga vartësit nën autoritetin dhe kontrollin efektiv të tij si rezultat i dështimit të tij për të ushtruar kontrollin e duhur mbi vartësit e tillë, ku:
   2.1. eprori e ka ditur ose me vetëdije nuk e ka përfillur informatën e cila ka treguar qartë se vartësit e tij po kryenin ose ishin përgatitur të kryenin vepra penale të tilla.
   2.2. krimet kanë pasur të bëjnë me veprimet që kanë qenë brenda përgjegjësisë dhe kontrollit efektiv të eprorit; dhe
   2.3. eprori nuk i ka ndërmarrë të gjitha masat e arsyeshme dhe të nevojshme brenda kompetencave të tij për të parandaluar ose për të ndalur kryerjen e tyre apo për të dorëzuar çështjen te organet kompetente për hetim dhe ndjekje.

Neni 162
Shtytja për luftë agresive ose konflikt të armatosur

Kushdo që në mënyrë publike, në tubim ose me anë të shkrimeve, xhirimeve audiovizuele ose në ndonjë mënyrë tjetër thërret ose nxit për luftë agresive apo konflikt të armatosur, dënohet me burgim prej një (1) deri në pesë (5) vjet.

Neni 163
Keqpërdorimi i emblemave ndërkombëtare

Kushdo që keqpërdor ose mban pa autorizim flamurin apo emblemën e Kombeve të Bashkuara, të Kryqit të Kuq ose të Shoqërisë së Hënës së Kuqe apo simbolet që korrespondojnë me to apo ndonjë tjetër emblemë ndërkombëtare që njihet si mbrojtje e objekteve të caktuara nga operacionet ushtarake, dënohet me burgim deri në tre (3) vjet.

Neni 164
Rrëmbimi i fluturakes

1. Kushdo që në kundërshtim me Konventën mbi ndalimin e rrëmbimit të kundërligjshëm të fluturakes të datës 16 dhjetor 1970, në fluturake përvetëson apo kontrollon në mënyrë të kundërligjshme fluturaken me dhunë ose me kanosje apo në ndonjë mënyrë tjetër të frikësimit, dënohet me burgim prej dy (2) deri në dhjetë (10) vjet.
2. Kur vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni rezulton me vdekjen e një apo më shumë personave ose me shkatërrimin e fluturakes, kryesi dënohet me jo më pak se pesë (5) vjet burgim.
3. Kushdo që me dashje privon nga jeta personin tjetër me kryerjen e veprës penale nga paragrafi 1. i këtij neni, dënohet me burgim së paku dhjetë (10) vjet ose me burgim të përjetshëm.

Neni 165
Rrezikimi i sigurisë së aviacionit civil

1. Kushdo që në shkelje të Konventës mbi ndalimin e akteve të kundërligjshme kundër sigurisë së aviacionit civil të datës 23 shtator 1971, kryen një akt që rrezikon sigurinë e aviacionit civil dënohet me burgim prej një (1) deri në dhjetë (10) vjet.
2. Akt i rrezikimit të sigurisë së aviacionit civil nënkupton një ose më shumë nga veprat në vijim:
   2.1. kryerja e një akti të dhunës kundër personit në fluturake nëse ajo vepër ka gjasë të rrezikojë sigurinë e fluturakes;
   2.2. shkatërrimi i fluturakes në funksionim e sipër ose shkaktimi i dëmit që e bën fluturaken e tillë të paaftë për fluturim apo që ka gjasë të rrezikojë sigurinë e saj gjatë fluturimit;
   2.3. vendosja ose mundësimi i vendosjes në fluturaken e cila është në funksion e sipër, në çfarëdo mënyre, të ndonjë mjeti apo substance që ka gjasë për ta shkatërruar fluturaken ose për t'i shkaktuar dëm që e bën atë të paaftë për fluturim ose i shkakton dëm që ka gjasë të rrezikojë sigurinë e saj gjatë fluturimit;
   2.4. shkatërrimi ose dëmtimi i pajisjeve të navigimit ajror ose ndërhyja në operimin e tyre nëse cilido nga aktet e tilla ka gjasë të rrezikojë sigurinë e fluturakes gjatë fluturimit;
   2.5. kumtimi i informatës për të cilin kryesi e di se është e rrejshme, me çka rrezikon sigurinë e fluturakes gjatë fluturimit;

2.6. kryeja e një akti të dhunës kundër personit në aeroportin në shërbim të aviacionit civil ndërkombëtar, që shkakton ose ka gjasë të shkaktojë lëndime të rënda ose vdekje;

2.7. shkatërrimi ose dëmtimi i rëndë i pajisjeve të aeroportit që i shërben aviacionit civil ndërkombëtar ose fluturakes së vendosur aty që nuk është në shërbim, ose ndërprerja e shërbimeve të aeroportit, nëse akti i tillë rrezikon ose ka gjasë të rrezikojë sigurinë në atë aeroport.

3. Kushdo që e drejton fluturaken në një mënyrë jo të rregullt ose nuk i kryen detyrat ose nuk bën mbikëqyrjen në lidhje me sigurinë e aviacionit civil, dënohet me burgim prej një (1) deri në dhjetë (10) vjet.
4. Kur vepra penale nga paragrafi 1. ose 3. i këtij neni rezulton me vdekjen e një ose më shumë personave ose me shkatërrimin e fluturakes, kryesi dënohet me jo më pak se dhjetë (10) vjet burgim.
5. Kushdo që me qëllim e privon nga jeta personin tjetër me kryerjen e veprës penale nga paragrafi 1. ose 3. i këtij neni, dënohet me jo më pak se dhjetë (10) vjet burgim ose me burgim të përjetshëm.
6. Kushdo që nga pakujdesia kryen veprën penale nga paragrafi 1. ose 3. i këtij neni, dënohet me burgim deri në pesë (5) vjet.
7. Kur vepra penale nga paragrafi 6. i këtij neni rezulton me vdekjen e një ose më shumë personave ose me shkatërrimin e fluturakes, kryesi dënohet me burgim prej një (1) deri në (8) tetë vjet.

Neni 166
Rrezikimi i sigurisë së lundrimit detar

1. Kushdo që në shkelje të Konventës mbi ndalimin e akteve të kundërligjshme kundër sigurisë së lundrimit detar të datës 10 mars 1988 kryen një akt të rrezikimit të sigurisë së lundrimit detar, dënohet me burgim prej një (1) deri në dhjetë (10) vjet.
2. Akti i rrezikimit të sigurisë së lundrimit detar nënkupton një ose më shumë nga veprat e mëposhtme:
   2.1. pushtimi i anijes ose ushtrimi i kontrollit mbi të me dhunë apo me kanosje ose me ndonjë formë tjetër të frikësimit;
   2.2. kryerja e një akti të dhunës kundër personit në anije nëse ajo vepër ka gjasë të rrezikojë lundrimin e sigurt të anijes;
   2.3. shkatërrimi i anijes ose shkaktimi i dëmit anijes ose ngarkesës së saj që ka gjasë të rrezikojë lundrimin e sigurt të anijes;
   2.4. vendosja ose mundësimi i vendosjes në anije në çfarëdo mënyre, të ndonjë mjeti apo substance që ka gjasë për ta shkatërruar atë anije ose për t'i shkaktuar dëm anijes apo ngarkesës së saj që rrezikon ose ka gjasë të rrezikojë lundrimin e sigurt të anijes;
   2.5. shkatërrimi ose dëmtimi i rëndë i pajisjeve të navigimit detar apo ndërhyrja e rëndë në operimin e tyre, nëse një akt i tillë ka gjasë të rrezikojë lundrimin e sigurt të anijes;
   2.6. komunikimi i informatës për të cilin kryesi e di se është e rrejshme, me çka rrezikon lundrimin e sigurt të anijes.
3. Kur vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni rezulton me vdekjen e një ose më

shumë personave ose me shkatërrimin e anijes, kryesi dënohet me jo më pak se dhjetë (10) vjet burgim.

4. Kushdo që me qëllim e privon nga jeta personin tjetër me kryerjen e veprës penale nga paragrafi 1. i këtij neni, dënohet me jo më pak se dhjetë (10) vjet burgim ose me burgim të përjetshëm.
5. Kushdo që nga pakujdesia kryen veprën penale nga paragrafi 1. i këtij neni dënohet me burgim deri në pesë (5) vjet.
6. Kur vepra penale nga paragrafi 5. i këtij neni rezulton me vdekjen e një apo më shumë personave ose me shkatërrimin e anijes, kryesi dënohet me burgim prej një (1) deri në tetë (8) vjet.

Neni 167
Rrezikimi i sigurisë së platformave fikse të vendosura në pragun kontinental

1. Kushdo që në shkelje të Protokollit mbi ndalimin e akteve të kundërligjshme ndaj sigurisë së platformave fikse të vendosura në pragun kontinental të 10 marsit 1988 kryen një akt me të cilën rrezikon sigurinë e platformave fikse të vendosura në pragun kontinental, dënohet me burgim prej një (1) deri në dhjetë (10) vjet.
2. Akti i rrezikimit të sigurisë së platformave fikse të vendosura në pragun kontinental nënkupton një ose më shumë nga veprat në vijim:
   2.1. pushtimi ose ushtrimi i kontrollit mbi platformat fikse me dhunë apo me kanosje ose me ndonjë formë tjetër të frikësimit;
   2.2. kryerja e një akti të dhunës kundër personit në platformën fikse nëse ai akt ka gjasë të rrezikojë sigurinë e saj;
   2.3. shkatërrimi i platformës fikse ose shkaktimi i dëmit i cili ka gjasë të rrezikojë sigurinë e saj;
   2.4. vendosja ose mundësimi i vendosjes në platformën fikse në çfarëdo mënyre, të ndonjë mjeti apo substance që ka gjasë për të shkatërruar atë platformë fikse ose që ka gjasë të rrezikojë sigurinë e saj.
3. Kur vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni rezulton me vdekjen e një ose më shumë personave apo me shkatërrimin e platformës fikse, kryesi dënohet me jo më pak se dhjetë (10) vjet burgim.
4. Kushdo që me qëllim e privon nga jeta personin tjetër me kryerjen e veprës penale nga paragrafi 1. i këtij neni, dënohet me jo më pak se dhjetë (10) vjet burgim ose me burgim të përjetshëm.
5. Kur vepra penale nga paragrafi 5. i këtij neni rezulton me vdekjen e një apo më shumë personave ose shkatërrimin e platformës fikse, kryesi dënohet me burgim prej një (1) deri në tetë (8) vjet.
6. Kushdo që me qëllim të detyrimit të personit fizik ose juridik për të kryer ose për të mos kryer ndonjë veprim, kanoset se do të kryejë vepër penale nga nën-paragrafët 2.2 ose 2.3 të paragrafit 2. të këtij neni, dënohet me burgim prej një (1) deri në tetë (8) vjet.
7. Për qëllime të këtij neni, shprehja "platformë fikse" nënkupton ishull artificial, instalim ose godinë përherë e ngjitur për fundin e detit me qëllim të hulumtimit apo të shfrytëzimit të pasurive ose për qëllime të tjera ekonomike.

Neni 168
Piratëria

1. Anëtari i ekuipazhit ose udhëtari i anijes ose fluturakes, përveç anijes apo fluturakes ushtarake apo publike, i cili duke shkelur rregullat e së drejtës ndërkombëtare dhe me qëllim që vetes ose personit tjetër t'i sjell dobi pasurore apo dobi jopasurore apo për të plagosur rëndë personin tjetër, kryen dhunë të kundërligjshme ndaj anijes apo fluturakes tjetër ose kundër personit ose sendit në anije apo në fluturake në det të hapur apo në territorin i cili nuk është nën juridiksion të ndonjë shteti, dënohet me burgim prej një (1) deri në dhjetë (10) vjet.
2. Veprimi i kryer nga anëtari i ekuipazhit të anijes ose fluturakes ushtarake ose publike, i cili është rebeluar dhe ka uzurpuar autoritetet e anijes ose të fluturakes përbën vepër penale sipas paragrafit 1. të këtij neni.

Neni 169
Skllavëria, kushtet e ngjashme me skllavërinë dhe puna e detyruar

1. Kushdo që në shkelje të së drejtës ndërkombëtare, përfshirë Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, mban, ruan, vendos, blen apo shet një person tjetër në skllavëri, në kushte të ngjashme me skllavërinë, robëri ose në punë të detyruar, që përfshin por nuk kufizohet në mbajtjen e personit në pronësi, mohimin e fryteve të punës së tij, shtrëngimin e personit për të punuar ose mohimin e lirisë së një personi për të ndryshuar statusin e tij apo të kushteve të punës, dënohet me gjobë dhe me burgim prej dy (2) deri në dhjetë (10) vjet.
2. Kushdo që në shkelje të së drejtës ndërkombëtare, përfshirë Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, me qëllim të kryerjes së veprave nga paragrafi 1. i këtij neni shtyt një person tjetër të heqë dorë nga liria e tij ose ndërmjetëson në shitjen apo blerjen e një personi tjetër, dënohet me dënimin e paraparë në paragrafin 1. të këtij neni.
3. Nëse vepra penale nga paragrafi 1. ose 2. i këtij neni kryhet kundër personit me të cilin kryesi është në marrëdhënie familjare, kryesi dënohet me burgim prej tre (3) deri në dhjetë (10) vjet.
4. Kur vepra penale nga paragrafi 1. ose 2. i këtij neni kryhet ndaj fëmijës, kryesi dënohet me burgim prej tre (3) deri në pesëmbëdhjetë (15) vjet.
5. Kur vepra nga ky nen kryhet nga personi zyrtar me keqpërdorimin e detyrës së tij, kryesi dënohet me burgim prej pesë (5) deri në dymbëdhjetë (12) vjet për veprën nga paragrafët 1.-3.; ose me burgim prej pesë (5) deri në njëzet (20) vjet për veprën nga paragrafi 4. i këtij neni.

Neni 170
Kontrabandimi me migrantë

1. Kushdo që merret me kontrabandim të migrantëve dënohet me gjobë dhe me burgim prej dy (2) deri dhjetë (10) vjet.
2. Kushdo që me qëllim të përfitimit të drejtpërdrejtë apo të tërthortë të dobisë financiare apo dobisë tjetër pasurore, prodhon, furnizon, siguron ose posedon

dokument të rrejshëm të udhëtimit ose të identifikimit me qëllim të mundësimit të kontrabandimit me migrantë, dënohet me gjobë dhe me burgim deri në pesë (5) vjet.

3. Kushdo që i mundëson personit i cili nuk është shtetas i Republikës së Kosovës të qëndrojë në Republikën e Kosovës ose personit i cili nuk është shtetas apo banor i përhershëm për të qëndruar në shtetin në fjalë, pa i përfillur kushtet e domosdoshme ligjore për qëndrim, me mjetet nga paragrafi 2. i këtij neni ose me çfarëdo mjetesh tjera të paligjshme, dënohet me gjobë dhe me burgim deri në një (1) vit.
4. Tentativa për të kryer veprën penale nga paragrafi 3. i këtij neni është e dënueshme.
5. Kushdo që organizon ose drejton personat e tjerë për të kryer vepër penale nga paragrafi 1. ose 2 dënohet me gjobë deri në pesëqind mijë (500.000) Euro dhe me burgim prej shtatë (7) deri në njëzet (20) vjet, ose me burgim prej një (1) deri në dhjetë (10) vjet për veprën penale nga paragrafi 3. i këtij neni.
6. Kur vepra penale nga paragrafi 1., 2. ose 3. i këtij neni kryhet nga kryesi i cili vepron si anëtar i grupit ose në një mënyrë që rrezikon ose ka gjasë të rrezikojë jetërat apo sigurinë e migrantëve përkatës ose që përfshin trajtimin çnjerëzor apo poshtërues, duke përfshirë eksploatimin e migrantëve të tillë, kryesi dënohet me gjobë dhe me burgim jo më pak se pesë (5) vjet.
7. Nëse vepra penale nga paragrafi 1., 2. ose 3. i këtij neni rezulton me vdekjen e një apo më shumë personave, kryesi dënohet me gjobë dhe me burgim së paku dhjetë (10) vjet ose me burgim të përjetshëm.
8. Për qëllime të këtij neni:
   8.1. Shprehja "kontrabandim me migrantë" nënkupton çdo veprim me qëllim të përfitimit të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të një dobie financiare ose të një dobie tjetër pasurore nga hyrja e paligjshme e personit në Republikën e Kosovës, i cili nuk është shtetas i Republikës së Kosovës ose i një personi qoftë shtetas i Republikës së Kosovës apo shtetas i huaj në shtetin në të cilin personi i tillë nuk është banor i përhershëm ose shtetas i atij shteti.
   8.2. Shprehja "hyrje e paligjshme" nënkupton kalimin e kufirit ose vijës kufitare të Republikës së Kosovës pa i përfillur kushtet e domosdoshme për hyrje të ligjshme në Republikën e Kosovës ose kalim i kufijve të ndonjë shteti pa i përfillur kushtet e domosdoshme për hyrjen e ligjshme në atë shtet.
   8.3. Shprehja "dokument i rrejshëm i udhëtimit ose i identifikimit" nënkupton çfarëdo dokumenti i udhëtimit ose i identifikimit:
      8.3.1. Që është falsifikuar ose ndryshuar në ndonjë mënyrë të caktuar nga cilido person përveç nga personi ose organi i autorizuar në bazë të ligjit për të prodhuar ose lëshuar dokument udhëtimi ose identifikimi;
      8.3.2. Që është lëshuar ose është siguruar në mënyrë jo të duhur përmes keqinterpretimit, korrupsionit, trysnisë apo në ndonjë mënyre tjetër të kundërligjshme; ose
      8.3.3. Që shfrytëzohet nga personi i cili nuk është mbajtësi i tij i vërtetë.
9. Personi nuk është penalisht përgjegjës sipas këtij neni nëse ai është migrant që është objekt i veprës penale nga ky nen.
10. Është penalisht përgjegjës:
    10.1. personi i cili rekruton, nxit, organizon, strehon ose bart persona në shtetet anëtare të Bashkimit Evropian, ose në ato të Marrëveshjes Schengen, me qëllim të realizimit dhe të përfitimit ekonomik, social ose të të drejtave të

tjera, që janë në kundërshtim me të drejtën e Bashkimit Evropian dhe me rregullat e shteteve anëtare të Bashkimit Evropian, të Marrëveshjes Schengen dhe të së drejtës ndërkombëtare, dënohet së paku me katër (4) vjet burgim;

10.2. nëse personi vepron në kundërshtim me paragrafin 10.1 dhe/ose ka qene në dijeni se me bartjen do të realizohen përfitime ose ndonjë të drejte nga paragrafi 10.1, në kundërshtim me të drejtën e Bashkimit Evropian dhe me rregullat e shteteve anëtare të Bashkimit Evropian, të Marrëveshjes Schengen dhe me të drejtën ndërkombëtare, dënohet prej një (1) deri në pesë (5) vjet burgim;

10.3. nëse vepra është kryer për përfitime personale, kryesi do të dënohet për veprën, sipas paragrafit 10.1, me burgim, së paku tetë (8) vjet, ndërsa për veprën e kryer, sipas paragrafit 10.2, do të dënohet së paku me katër (4) vjet burgim;

10.4. nëse vepra është kryer nga personi juridik, do të dënohet me gjobë;

10.5. pajisjet dhe mjetet transportuese të përdorura për kryerjen e kësaj vepre do të konfiskohen.

10.6. ky paragraf fillon të zbatohet në momentin kur Këshilli i Bashkimit Evropian merr vendim për heqjen e regjimit të vizave për qytetarët e Republikës së Kosovës.

Neni 171
Trafikimi me njerëz

1. Kushdo që merr pjesë në trafikimin e njerëzve dënohet me gjobë dhe me burgim prej pesë (5) deri në dymbëdhjetë (12) vjet.
2. Kur vepra penale nga paragrafi 1 i këtij neni kryhet në një perimetër prej treqind e pesëdhjetë (350) metrash nga shkolla apo mjedisi tjetër i cili përdoret nga fëmijët ose kur vepra kryhet ndaj personit nën moshën tetëmbëdhjetë vjet, kryesi dënohet me gjobë dhe me burgim prej tre (3) deri në pesëmbëdhjetë (15) vjet.
3. Kushdo që organizon një grup personash për të kryer vepër nga paragrafi 1. i këtij neni dënohet me gjobë deri në pesëqind mijë (500.000) Euro dhe me burgim prej shtatë (7) deri në njëzet (20) vjet.
4. Nëse vepra penale nga ky nen kryhet nga personi zyrtar me keqpërdorimin e pozitës apo autorizimeve të tij, kryesi dënohet me:
   4.1. gjobë dhe burgim prej pesë (5) deri në pesëmbëdhjetë (15) vjet për vepër penale nga paragrafi 1. ose 2. i këtij neni;
   4.2. gjobë dhe burgim së paku dhjetë (10) vjet për vepër penale nga paragrafi 3. i këtij neni.
5. Nëse vepra penale nga paragrafi 1.-4. i këtij neni rezulton me vdekjen e një apo më shumë personave, kryesi dënohet me jo më pak se dhjetë (10) vjet burgim ose me burgim të përjetshëm.
6. Për qëllime të këtij neni dhe nenit 172 të këtij kodi:
   6.1. shprehja "trafikim me njerëz" nënkupton rekrutim, transportim, transferim, strehim ose pranim i personave me anë të kanosjes ose të përdorimit të forcës apo me forma të tjera të shtrëngimit, rrëmbimit, mashtrimit, lajthimit, keqpërdorimit të pushtetit apo të keqpërdorimit të një pozite të ndjeshme ose

me anë të dhënies ose marrjes së pagesave apo përfitimeve për të arritur pëlqimin e personit që ka kontroll mbi personin tjetër, me qëllim të shfrytëzimit.

6.2. shprehja ”shfrytëzim” ashtu siç është përdorur në nën-paragrafin 6.1. të këtij paragrafi, përfshin, por nuk kufizohet në, shfrytëzimin e prostitucionit të tjerëve, pornografisë ose formave tjera të shfrytëzimit seksual, lëmoshës, shërbimeve ose punës së detyruar, skllavërisë ose veprimeve të ngjashme me skllavërinë, robërisë ose heqjes së organeve apo qelizave.

6.3. pëlqimi i viktimës së trafikimit me njerëz për qëllime shfrytëzimi nuk merret parasysh kur cilado prej mjeteve të përcaktuara më lart në nën-paragrafin 6.1 të këtij neni është përdorur kundër viktimës së tillë.

6.4. rekrutimi, transportimi, transferimi, strehimi ose pranimi i fëmijës me qëllim të shfrytëzimit konsiderohet “trafikim me njerëz”, madje edhe nëse kjo nuk përfshin asnjërën nga mjetet e përcaktuara më lartë në paragrafin 6.1 të këtij neni.

Neni 172
Fshehja e dokumenteve të identifikimit të viktimave të skllavërisë ose trafikimit me njerëz

1. Kushdo që fsheh dokumentet personale të identifikimit apo pasaportën e personit për të cilin e din se është viktimë e veprës penale të paraparë në nenin 169 dhe 171 të këtij Kodi, dënohet me burgim prej një (1) deri në pesë (5) vjet.
2. Kur vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni kryhet nga personi zyrtar me keqpërdorimin e pozitës apo autorizimeve të tij, kryesi dënohet me burgim prej tre (3) deri në shtatë (7) vjet.

Neni 173
Rrezikimi i personave nën mbrojtje ndërkombëtare

1. Kushdo që me qëllim e privon nga jeta personin nën mbrojtje ndërkombëtare, dënohet me jo më pak se dhjetë (10) vjet burgim ose me burgim të përjetshëm.
2. Kushdo që kryen rrëmbimin ose sulmin mbi personin ose mbi lirinë e personit nën mbrojtje ndërkombëtare, dënohet me burgim prej tre (3) deri në dymbëdhjetë (12) vjet.
3. Kushdo që kryen një sulm të dhunshëm mbi objektet zyrtare, vendbanimin privat ose në mjetet e transportit të një personi nën mbrojtje ndërkombëtare, kur akti i tillë ka gjasë të rrezikojë personin ose lirinë e tij, dënohet me burgim prej një (1) deri në dhjetë (10) vjet.
4. Kushdo që bën kanosje serioze se do të kryejë vepër penale nga paragrafi 1., 2. ose 3. i këtij neni, dënohet me burgim prej një (1) deri në pesë (5) vjet.
5. Kushdo që organizon ose urdhëron personin të kryejë vepër penale nga paragrafi 1., 2. ose 3. i këtij neni, dënohet me burgim prej tre (3) deri në pesë (5) vjet.
6. Nëse vepra penale nga paragrafi 2. ose 3. i këtij neni rezulton me vdekjen e një ose më shumë personave, kryesi dënohet me jo më pak se dhjetë (10) vjet burgim.
7. Për qëllime të këtij neni, shprehja “person nën mbrojtje ndërkombëtare” ka të njëjtin kuptim siç përkufizohet në nenin 120 të këtij Kodi.

Neni 174
Rrezikimi i personelit të Kombeve të Bashkuara dhe i personelit në marrëdhënie me to

1. Kushdo që me qëllim e privon nga jeta personelin e Kombeve të Bashkuara ose personelin në marrëdhënie me to, dënohet me jo më pak se dhjetë (10) vjet burgim ose me burgim të përjetshëm.
2. Kushdo që kryen rrëmbimin apo sulmin mbi personin ose lirinë e personelit të Kombeve të Bashkuara apo mbi personelin në marrëdhënie me to, dënohet me burgim prej tre (3) deri në dymbëdhjetë (12) vjet.
3. Kushdo që kryen një sulm të dhunshëm mbi objektet zyrtare, vendbanimin privat apo mjetet e transportit të Kombeve të Bashkuara apo personelin në marrëdhënie me to, kur sulmi i tillë ka gjasë të rrezikojë personin ose lirinë e tij, dënohet me burgim prej një (1) deri në dhjetë (10) vjet.
4. Kushdo që bën kanosje serioze se do të kryejë vepër penale nga paragrafi 1., 2. ose 3. i këtij neni, dënohet me burgim prej një (1) deri në pesë (5) vjet.
5. Kur vepra penale nga paragrafi 2. ose 3. i këtij neni rezulton me vdekjen e një ose më shumë personave, kryesi dënohet me jo më pak se dhjetë (10) vjet burgim.
6. Për qëllime të këtij neni,shprehjet në vijim kanë këtë kuptim:
   6.1. Shprehja "personel i Kombeve të Bashkuara" nënkupton:
      6.1.1. persona të angazhuar dhe të vendosur nga Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara si pjesëtarë të komponentës ushtarake, policore ose civile të operacionit të Kombeve të Bashkuara; ose
      6.1.2. zyrtarë të tjerë dhe ekspertë të misionit të Kombeve të Bashkuara apo agjencive të specializuara të saj ose të Agjencisë Ndërkombëtare të Energjisë Atomike të cilët janë të pranishëm në cilësi zyrtare në zonën ku zhvillohet operacioni i Kombeve të Bashkuara.
   6.2. Shprehja "personel në marrëdhënie me to" nënkupton:
      6.2.1. persona të caktuar nga Qeveria ose nga një organizatë ndërqeveritare me marrëveshjen e organit kompetent të Kombeve të Bashkuara;
      6.2.2. persona të angazhuar nga Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara ose nga një agjenci e specializuar apo nga Agjencia Ndërkombëtare e Energjisë Atomike; ose
      6.2.3. persona të vendosur nga një organizatë humanitare joqeveritare ose agjenci sipas një marrëveshjeje me Sekretarin e Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara ose me një agjenci të specializuar apo me Agjencinë Ndërkombëtare të Energjisë Atomike për kryerjen e aktiviteteve në mbështetje të përmbushjes së mandatit të operacionit të Kombeve të Bashkuara.
   6.3. Shprehja "Operacion i Kombeve të Bashkuara" nënkupton operacionin e themeluar nga organi kompetent i Kombeve të Bashkuara në pajtim me Kartën e Kombeve të Bashkuara dhe i udhëhequr nga autoriteti dhe kontrolli i Kombeve të Bashkuara:
      6.3.1. kur operacioni ka për qëllim mbajtjen dhe rivendosjen e paqes dhe sigurisë ndërkombëtare; ose
      6.3.2. nëse Këshilli i Sigurimit ose Asambleja e Përgjithshme ka deklaruar

për qëllimet e Konventës mbi Sigurinë e Personelit të Kombeve të Bashkuara dhe të Personelit në Marrëdhënie me to të datës 9 dhjetor 1994 se ekziston rreziku i jashtëzakonshëm për sigurinë e personelit që merr pjesë në operacion.

Neni 175
Marrja e pengjeve

1. Kushdo që merr peng dhe kanos se do ta vrasë, do ta plagosë ose se do të vazhdojë ta mbajë personin e tillë me qëllim që ta detyrojë shtetin apo organizatën ndërkombëtare për të kryer apo për të mos kryer një vepër si kusht eksplicit apo implicit për lirimin e personit të marrë peng, dënohet me jo më pak se tre (3) vjet burgim.
2. Kushdo që me qëllim e privon nga jeta personin e zënë peng me kryerjen e veprës penale nga paragrafi 1. i këtij neni, dënohet me jo më pak se dhjetë (10) vjet burgim ose me burgim të përjetshëm.
3. Kur vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni rezulton me vdekjen e personit të zënë peng, kryesi dënohet me jo më pak se dhjetë (10) vjet burgim.

Neni 176
Përvetësimi i paligjshëm, shfrytëzimi, transferi dhe vendosja e materialeve nukleare

1. Kushdo që pa autorizim pranon, posedon, shfrytëzon, transferon, ndryshon, vendos ose shpërndan material nuklear dhe shkakton ose ka gjasë të shkaktojë vdekjen apo lëndimin e rëndë të ndonjë personi ose dëm të madh pasuror, dënohet me jo më pak se pesë (5) vjet burgim.
2. Kur vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni rezulton me vdekjen e një apo më shumë personave ose me dëm të madh material, kryesi dënohet me jo më pak se dhjetë (10) vjet burgim ose me burgim të përjetshëm.
3. Kushdo që kryen vepër penale nga paragrafi 1. ose 2. i këtij neni nga pakujdesia, dënohet me burgim deri në shtatë (7) vjet në rast se kryen vepër penale nga paragrafi 1. dhe me jo më pak se tre (3) vjet burgim për veprën penale nga paragrafi 2. i këtij neni.
4. Kushdo që kryen vjedhje, grabitje ose përvetësim të materialit nuklear ose kërkon material nuklear me anë të përdorimit të forcës apo kanosjes serioze ose me ndonjë formë tjetër të frikësimit, dënohet me jo më pak se pesë (5) vjet burgim.

Neni 177
Kanosja për përdorimin ose kryerjen e vjedhjes apo të grabitjes së materialit nuklear

1. Kushdo që kanos se do të përdor material nuklear për shkaktimin e vdekjes ose lëndimit të rëndë të ndonjë personi ose për të shkaktuar dëm substancial pasuror, dënohet me burgim prej një (1) deri në tetë (8) vjet.
2. Kushdo që me qëllim të detyrimit të personit fizik apo juridik për të kryer ose për të

mos kryer një vepër, kanos të kryejë vjedhje ose grabitje të materialit nuklear, dënohet me burgim prej pesë (5) deri në pesëmbëdhjetë (15) vjet.

3. Nëse vepra penale nga paragrafi 2. i këtij neni rezulton me vdekjen e një ose më shumë personave ose me dëm substancial material, kryesi dënohet me jo më pak se dhjetë (10) vjet burgim.

KAPITULLI XVI
VEPRAT PENALE KUNDËR JETËS DHE TRUPIT

Neni 178
Vrasja

Kushdo që e privon personin tjetër nga jeta dënohet me jo më pak se pesë (5) vjet burgim.

Neni 179
Vrasja e rëndë

1. Me dënim me jo më pak se dhjetë (10) vjet burgim ose me burgim të përjetshëm dënohet personi i cili:
   1.1. privon nga jeta fëmijën;
   1.2. privon nga jeta femrën shtatzënë;
   1.3. privon nga jeta anëtarin e familjes;
   1.4. privon nga jeta personin tjetër në mënyrë mizore apo dinake;
   1.5. privon nga jeta personin tjetër dhe me atë rast me dashje e vë në rrezik jetën e një ose më shumë personave tjerë;
   1.6. privon nga jeta personin tjetër me qëllim të fitimit të dobisë pasurore;
   1.7. privon nga jeta personin tjetër me qëllim të kryerjes apo të fshehjes së ndonjë vepre tjetër penale, ose për të ndaluar personin nga dhënia e dëshmisë ose sigurimi në ndonjë mënyrë tjetër të informatave për policinë apo në procedurë penale;
   1.8. privon nga jeta personin tjetër nga hakmarrja e paskrupullt apo nga motive të tjera të ulëta, përfshirë hakmarrjen për dhënien e dëshmisë ose sigurimin në ndonjë mënyrë tjetër të informatave për policinë apo në procedurë penale;
   1.9. privon nga jeta personin tjetër zyrtar gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare ose në lidhje me detyrën zyrtare;
   1.10. privon nga jeta personin tjetër për motive racore, kombëtare ose fetare.
   1.11. me dashje kryen dy apo më shumë vrasje, përveç veprave të cilat janë paraparë në nenin 180 dhe 182 të këtij Kodi; ose
   1.12. privon nga jeta personin tjetër dhe më parë ka qenë i dënuar për vrasje, përveç veprave të cilat janë të parapara në nenin 180 dhe 182 të këtij Kodi.

Neni 180
Vrasja e kryer në gjendje të tronditjes së fortë mendore

Kushdo që personin tjetër e privon nga jeta në gjendje të tronditjes së fortë mendore, të shkaktuar pa fajin e tij nga sulmi, keqtrajtimi apo fyerja e rëndë nga ana e personit të vrarë, dënohet me burgim prej një (1) deri në dhjetë (10) vjet.

Neni 181
Vrasja nga pakujdesia

Kushdo që e privon nga jeta personin tjetër nga pakujdesia, dënohet me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet.

Neni 182
Vrasja e foshnjës gjatë lindjes

Nëna që e privon nga jeta foshnjën e vet gjatë lindjes apo menjëherë pas lindjes, derisa te ajo vazhdon çrregullimi i shkaktuar nga lindja, dënohet me burgim prej tre (3) muaj deri në tre (3) vjet.

Neni 183
Shtytja në vetëvrasje dhe ndihma në vetëvrasje

1. Kushdo që shtytë ose ndihmon personin tjetër për të bërë vetëvrasje dhe vetëvrasja kryhet, dënohet me burgim prej një (1) deri në pesë (5) vjet.
2. Kushdo që kryen vepër penale nga paragrafi 1. i këtij neni ndaj të miturit ose ndaj personit aftësia e të cilit për të kuptuar peshën e veprës së vet ose për t'i kontrolluar sjelljet e veta ka qenë esencialisht e zvogëluar, dënohet me burgim prej një (1) deri në dhjetë (10) vjet.
3. Kushdo që kryen vepër penale nga paragrafi 1. i këtij neni ndaj personit nën moshën katërmbëdhjetë (14) vjet ose ndaj personit i cili nuk ka qenë i aftë për të kuptuar peshën e veprës së tij ose për të kontrolluar sjelljet e tij dënohet në pajtim me nenin 178 të këtij Kodi.
4. Kushdo që mizorisht ose në mënyrë çnjerëzore trajton personin tjetër i cili ndodhet në pozitë varësie dhe me këtë e shtytë personin e tillë që të bëjë vetëvrasje, dënohet me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet. Për qëllime të këtij paragrafi, shprehja "person në pozitë varësie" nënkupton personin i cili është nën mbikëqyrjen, gradën, kontrollin apo kujdesin e personit i cili ka vepruar në mënyrë mizore ose çnjerëzore.
5. Nëse si rezultat i veprës penale nga paragrafi 1. deri 4. i këtij neni vetëm është tentuar vetëvrasja, dënimi mund të zbutet.

Neni 184
Ndërprerja e palejuar e shtatzënësisë

1. Kushdo që në kundërshtim me ligjin për ndërprerjen e shtatzënësisë dhe me pëlqimin e gruas shtatzënë, ndërpret shtatzëninë, fillon ta kryej ndërprerjen e shtatzënisë ose i ndihmon që ta ndërpres shtatzëninë, dënohet me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në tre (3) vjet.
2. Kushdo që e ndërprenë ose fillon ta ndërpresë shtatzëninë pa pëlqimin e gruas shtatzënë, dënohet me burgim prej një (1) deri në tetë (8) vjet.
3. Kur vepra penale nga paragrafi 1. ose 2. i këtij neni rezulton me lëndim të rëndë trupor, me dëmtim të rëndë të shëndetit ose me vdekje të gruas shtatzënë, kryesi dënohet me:

3.1. burgim prej një (1) deri në dhjetë (10) vjet për veprën penale nga paragrafi 1 i këtij neni; ose
3.2. burgim prej pesë (5) deri në pesëmbëdhjetë (15) vjet për veprën penale nga paragrafi 2. i këtij neni.

Neni 185
Kanosja

1. Kushdo që seriozisht e kanos personin tjetër me fjalë, vepra apo gjeste se do t'i shkaktoj ndonjë të keqe me qëllim të frikësimit ose të shkaktimit të ankthit te personi i tillë, dënohet me gjobë ose me burgim deri në gjashtë (6) muaj.
2. Kushdo që seriozisht i kanoset personit tjetër me fjalë, vepra apo gjeste se do ta privojë nga jeta ose se do t'i shkaktojë lëndim të rëndë trupor, se do ta rrëmbejë ose privojë nga liria ndonjë person tjetër ose se do ta dëmtojë me armë zjarri, me shpërthim ose me mjete të tjera të rrezikshme, dënohet me gjobë ose me burgim deri në një (1) vit.
3. Kur vepra penale nga paragrafi 1. ose 2. i këtij neni kryhet ndaj personit zyrtar në lidhje me punën apo me pozitën e tij ose ndaj disa personave ose kur vepra kryhet nga kryesi i cili vepron si anëtar i grupit, kryesi dënohet me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet.
4. Kushdo që kryen vepër penale nga ky nen me përdorim të armës, mjetit të rrezikshëm ose ndonjë sendi tjetër me të cilin mund të shkaktohet lëndimi trupor ose dëmtimi i rëndë për shëndetin, dënohet me burgim prej një (1) deri në pesë (5) vjet.
5. Procedura penale për veprën penale nga paragrafi 1. ose 2. i këtij neni fillohet sipas propozimit.

Neni 186
Ngacmimi

1. Kushdo që përfshihet në një sjellje të vëmendjes së vazhdueshme dhe të padëshirueshme ose komunikon me qëllim të ngacmimit, frikësimit, lëndimit, dëmtimit të pasurisë apo vrasjes së personit tjetër ose fëmijëve të tij, familjes, të afërmve apo kafshëve shtëpiake ose kushdo që vë tjetrin nën vëzhgim me qëllim të ngacmimit, frikësimit, lëndimit, dëmtimit të pasurisë apo vrasjes së personit tjetër ose fëmijëve të tij, familjes, të afërmve apo kafshëve shtëpiake; dhe gjatë këtyre veprimeve vë atë person nën frikë të arsyeshme nga vdekja, lëndimi i rëndë trupor, dëmtimi i rëndë i pasurisë ose nën shqetësim të madh emocional, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet.
2. Kur vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni kryhet ndaj një personi me të cilin kryesi ka qenë apo është në marrëdhënie familjare ose ndaj një ish anëtari apo anëtari aktual të familjes, kryesi dënohet me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet.
3. Kur vepra penale nga paragrafi 1. ose 2. i këtij neni kryhet me armë, mjet të rrezikshëm apo ndonjë send tjetër që mund të shkaktojë lëndim të rëndë trupor ose dëmtim të rëndë të shëndetit, kryesi dënohet me burgim prej një (1) deri në pesë (5) vjet.

4. Vëmendja apo komunikimi nga paragrafi 1. i këtij neni mund të përfshijë përcjelljen apo qëndrimin në pritje; shfaqjen e vazhdueshme te shtëpia, shkolla, puna apo qendra rekreative; përsëritjen e thirrjeve telefonike; dërgimin apo lënien e porosive; dërgimin e mesazheve telefonike, letrave postare apo postës elektronike; ose lënien apo dërgimin e dhuratave të padëshiruara apo të gjësendeve tjera.

Neni 187
Sulmi

1. Kushdo që me dashje përdor forcën ndaj personit tjetër, pa pëlqimin e atij personi, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet.
2. Kur vepra penale nga paragrafi 1 i këtij neni është kryer me përdorimin e armës, mjetit të rrezikshëm apo ndonjë sendi tjetër që mund të shkaktojë lëndim të rëndë trupor apo dëmtim të rëndë të shëndetit, kryesi dënohet me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet.
3. Kur vepra penale nga paragrafi 1 i këtij neni kryhet ndaj viktimës së ndjeshme, kryesi dënohet me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në tre (3) vjet.

Neni 188
Lëndimi i lehtë trupor

1. Kushdo që personit tjetër i shkakton lëndim të lehtë trupor, i cili rezulton në:
   1.1. dëmtimin e përkohshëm ose dobësimin e një organi apo pjese të trupit të personit tjetër;
   1.2. zvogëlimin e përkohshëm të aftësisë së personit tjetër për të punuar;
   1.3. shëmtimin e përkohshëm të personit tjetër; ose
   1.4. dëmtimin e përkohshëm të shëndetit të personit tjetër, dënohet me gjobë ose me burgim deri në një (1) vit.
2. Kur vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni kryhet me armë, mjet të rrezikshëm apo me ndonjë send tjetër që mund të shkaktojë lëndim të rëndë trupor ose dëmtim të rëndë të shëndetit, kryesi dënohet me burgim deri në tre (3) vjet.
3. Kur vepra penale nga ky nen kryhet ndaj viktimës së ndjeshme, kryesi dënohet me:
   3.1. burgim prej tre (3) muaj deri në tre (3) vjet për veprën penale nga paragrafi 1.; ose
   3.2. burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet për veprën penale nga paragrafi 2. i këtij neni.
4. Gjykata mund të shqiptojë vërejtjen gjyqësore ndaj kryesit të veprës nga paragrafi 1 dhe 2 i këtij neni, nëse kryesi është provokuar nga sjellja çnjerëzore apo e vrazhdë e të dëmtuarit.

Neni 189
Lëndimi i rëndë trupor

1. Kushdo që i shkakton lëndim të rëndë trupor personit tjetër ose e dëmton shëndetin e personit tjetër deri në masën e tillë sa që mund të rezultojë me:
   1.1. dobësimin e përkohshëm ose esencial të një pjese vitale të trupit të personit tjetër;

1.2. paaftësimin e përkohshëm, zvogëlimin e përkohshëm dhe esencial ose zvogëlimin e përhershëm të aftësisë së personit tjetër për të punuar; ose
1.3. dëmtimin e përkohshëm dhe serioz të shëndetit të personit tjetër, dënohet me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet.

2. Kushdo që shkakton lëndim trupor ose e dëmton shëndetin e personit tjetër dhe kjo rezulton me:
2.1. rrezikim të jetës së personit tjetër;
2.2. paaftësimin ose dobësimin e përhershëm të një pjese vitale të trupit të personit tjetër;
2.3. paaftësimin e përhershëm të aftësisë së personit tjetër për çfarëdo lloj pune;
2.4. shëmtimin e përhershëm të personit tjetër; ose
2.5. dëmtimin e përhershëm të shëndetit të personit tjetër, dënohet me burgim prej një (1) deri në dhjetë (10) vjet.
3. Kur vepra penale nga ky nen kryhet ndaj viktimës së ndjeshme, kryesi dënohet me:
3.1. Burgim prej një (1) deri në pesë (5) vjet për veprën penale nga paragrafi 1. i këtij neni; ose
3.2. Burgim prej dy (2) deri në dhjetë (10) vjet për veprën penale nga paragrafi 2. i këtij neni.
4. Kur vepra penale nga paragrafi 1., 2 ose 3. i këtij neni rezulton me vdekjen e personit tjetër, kryesi dënohet me burgim prej dy (2) deri në dymbëdhjetë (12) vjet.
5. Kur vepra penale nga paragrafi 1., 2. ose 3. i këtij neni është kryer me armë, mjet të rrezikshëm apo me ndonjë send tjetër që mund të shkaktojë lëndim të rëndë trupor ose dëmtim të rëndë të shëndetit, kryesi dënohet me burgim jo më pak se tre (3) vjet.

Neni 190
Pjesëmarrja në rrahje

1. Kushdo që merr pjesë në rrahje, e cila rezulton me vdekje ose lëndim të rëndë trupor të personit, për pjesëmarrje në rrahje dënohet me gjobë ose me burgim deri në tri (3) vjet.
2. Kushdo që në ndonjë rrahje ose grindje me qëllim të frikësimit apo kanosjes së personit, rrok apo vringëllon armën, mjetin e rrezikshëm apo mjetin tjetër që është i përshtatshëm për të shkaktuar lëndim të rëndë trupor ose për të dëmtuar rëndë shëndetin e personit, dënohet me gjobë ose me burgim prej një (1) deri në tre (3) vjet.
3. Personi nuk është penalisht përgjegjës sipas paragrafit 1. i këtij neni nëse ka marrë pjesë në rrahje pa fajin e tij ose thjesht për të mbrojtur veten apo për t'i ndarë pjesëmarrësit e tjerë në rrahje.
4. Arma, mjeti i rrezikshëm apo mjeti tjetër konfiskohen.

Neni 191
Mosdhënia e ndihmës

1. Kushdo që nuk i ofron ndihmë personit jeta e të cilit ndodhet në rrezik të drejtpërdrejtë, edhe pse këtë ka mundur ta bëjë pa rrezik të madh për veten apo tjetrin, dënohet me burgim deri në një (1) vit.

2. Kushdo që nuk i ofron ndihmë personit në gjendje apo në rrethana të rrezikut për jetë të shkaktuara nga vetë kryesi, dënohet me burgim deri në tre (3) vjet.
3. Kur vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni rezulton me lëndim të rëndë trupor ose me dëmtim të rëndë të shëndetit të personit të rrezikuar, kryesi dënohet me burgim prej tre (3) muaj deri në tre (3) vjet.
4. Kur vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni rezulton me vdekjen e personit të rrezikuar, kryesi dënohet me burgim prej një (1) deri në tetë (8) vjet.

Neni 192
Braktisja e personave të paaftë

1. Kushdo që e lë personin e paaftë që i është besuar të përkujdeset për të, pa ndihmë në rrethana të rrezikshme për jetën apo për shëndetin, dënohet me burgim deri në tre (3) vjet.
2. Kur vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni rezulton me lëndim të rëndë trupor ose me dëmtim të rëndë të shëndetit të personit të cilit nuk i është dhënë ndihma, kryesi dënohet me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet.
3. Kur vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni rezulton me vdekjen e personit të cilit nuk i është dhënë ndihma, kryesi dënohet me burgim prej një (1) deri në tetë (8) vjet burgim.

KAPITULLI XVII
VEPRAT PENALE KUNDËR LIRIVE DHE TË DREJTAVE TË NJERIUT

Neni 193
Shkelja e statusit të barabartë të shtetasve dhe banorëve të Republikës së Kosovës

1. Kushdo që në mënyrë të kundërligjshme i mohon ose i kufizon liritë apo të drejtat e cilitdo person të Republikës së Kosovës të parapara me Kushtetutë, ligj apo akte ndërkombëtare ose kushdo që në mënyrë të kundërligjshme i jep ndonjë personi në Republikën e Kosovës çfarëdo privilegji ose përparësie mbi bazën e një dallimi ose përkatësie të tillë, dënohet me burgim deri në tre (3) vjet.
2. Kushdo që i mohon ose ia kufizon pjesëtarit të një bashkësie etnike, fetare ose gjuhësore në Republikën e Kosovës të drejtën për shprehje të lirë të identitetit të tij ose për të gëzuar autonominë e tij, dënohet me burgim deri në një (1) vit.
3. Kushdo që në kundërshtim me ligjin për përdorimin e gjuhës, ia mohon shtetasit të Republikës së Kosovës të drejtën që lirshëm të përdor gjuhën ose shkrimin e tij, dënohet me gjobë ose me burgim deri në një (1) vit.
4. Kur vepra penale nga paragrafi 1. dhe 2. i këtij neni kryhet nga personi zyrtar me keqpërdorim të pozitës apo autorizimeve të tij, kryesi dënohet me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet.
5. Kur vepra penale nga paragrafi 3. i këtij neni kryhet nga personi zyrtar me keqpërdorim të pozitës apo autorizimeve të tij, kryesi dënohet me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në tre (3) vjet.

Neni 194
Rrëmbimi

1. Kushdo që e merr apo e mban personin, me qëllim që mos ta liroj para se të nxjerr para, dobi pasurore apo dobi tjera nga ai apo personi tjetër, ose me qëllim që ta detyroj atë apo personin tjetër që të kryej ose mos të kryej një veprim ose të durojë diçka, dënohet me burgim prej një (1) deri në dhjetë (10) vjet.
2. Kur vepra penale nga paragrafi 1 i këtij neni kryhet në një apo më shumë prej rrethanave në vijim, kryesi dënohet me burgim prej tre (3) deri në dymbëdhjetë (12) vjet:
   2.1. kryesi i është kanosur personit të rrëmbyer me vrasje ose dëmtim të rëndë të shëndetit;
   2.2. kryesi ka kryer veprën duke vepruar si anëtar i grupit;
   2.3. kryesi ka kryer veprën duke përdorur armën, mjetin e rrezikshëm apo sendin tjetër që mund të shkaktojë lëndim të rëndë trupor ose dëmtim të rëndë të shëndetit;
   2.4. kryesi ka kryer veprën kundër viktimës së ndjeshme.
3. Kur vepra nga paragrafi 1. i këtij neni kryhet në një apo më shumë prej rrethanave në vijim, kryesi dënohet me pesëmbëdhjetë (15) vjet burg ose dënim me burgim të përjetshëm.
   3.1. kryesi ka kryer veprën duke vepruar si anëtar i grupit të organizuar;
   3.2. kryesi i ka shkaktuar personit të rrëmbyer lëndim të rëndë trupor ose vdekje gjatë kryerjes së veprës.
4. Për qëllime të paragrafit 1., personi i cili merr ose mban fëmijën konsiderohet se vepron pa pëlqimin e fëmijës.
5. Nëse kryesi në mënyrë vullnetare liron personin e rrëmbyer para se kërkesat për të cilat është kryer rrëmbimi, të jenë përmbushur, dënimi mund të zbutet.

Neni 195
Shtrëngimi

1. Kushdo që e detyron personin tjetër me forcë apo kanosje serioze që të kryejë ose të mos kryejë një veprim ose të pajtohet me një veprim, dënohet me gjobë ose me burgim deri në një (1) vit.
2. Kur vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni kryhet në një apo më shumë prej rrethanave në vijim, kryesi dënohet me burgim prej tre (3) muaj deri në pesë (5) vjet:
   2.1. kryesi i është kanosur personit të shtrënguar me vrasje ose dëmtim të rëndë të shëndetit;
   2.2. kryesi ka kryer veprën duke vepruar si anëtar i grupit;
   2.3. kryesi ka kryer veprën duke përdorur armën, mjetin e rrezikshëm apo sendin tjetër që mund të shkaktojë lëndim të rëndë trupor ose dëmtim të rëndë të shëndetit;
   2.4. kryesi ka kryer veprën ndaj viktimës së ndjeshme.
3. Kur vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni kryhet në një apo më shumë prej rrethanave në vijim, kryesi dënohet me burgim prej dy (2) deri në dhjetë (10) vjet:

3.1. kryesi ka kryer veprën duke vepruar si anëtar i grupit të organizuar;
3.2. kryesi ka shkaktuar lëndim të rëndë trupor ose vdekjen gjatë kryerjes së veprës.

Neni 196
Privimi i kundërligjshëm i lirisë

1. Kushdo që personin tjetër në mënyrë të kundërligjshme e burgos, e mban të mbyllur ose në ndonjë mënyrë tjetër e privon nga liria, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet.
2. Nëse vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni kryhet në një apo më shumë prej rrethanave në vijim, kryesi dënohet me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet:
   2.1. kur vepra kryhet ndaj viktimës së ndjeshme;
   2.2. kur vepra kryhet në mënyrë mizore;
   2.3. kur privimi i kundërligjshëm i lirisë zgjatë më tepër se pesëmbëdhjetë (15) ditë;
   2.4. kur vepra penale rezulton me dëmtim të rëndë të shëndetit të personit të mbajtur në mënyrë të kundërligjshme ose në rrethana tjera të rënda;
   2.5. kur vepra kryhet nga kryesi i cili vepron si anëtar i grupit.
3. Kur vepra penale nga paragrafi 1. dhe 2. i këtij neni kryhet nga personi zyrtar duke keqpërdorur detyrën apo autorizimet e tij, kryesi dënohet me burgim prej një (1) deri në tetë (8) vjet. Nëse kjo vepër kryhet me përdorim të armës, mjetit të rrezikshëm apo ndonjë sendi tjetër që mund të shkaktojë lëndim të rëndë trupor ose dëmtim të rëndë të shëndetit, kryesi dënohet me burgim prej një (1) deri në dhjetë (10) vjet.
4. Kur vepra penale nga paragrafi 1. ose 2. i këtij neni kryhet me përdorim të armës, mjetit të rrezikshëm apo ndonjë sendi tjetër që mund të shkaktojë lëndim të rëndë trupor ose dëmtim të rëndë të shëndetit, kryesi dënohet me burgim prej një (1) deri në tetë (8) vjet.
5. Kur vepra penale nga paragrafët 1. deri 4. të këtij neni rezulton me vdekjen e personit të privuar nga liria në mënyrë të kundërligjshme, kryesi dënohet me jo më pak se pesë (5) vjet burgim.

Neni 197
Marrja e deklaratave me anë të shtrëngimit

1. Personi zyrtar, i cili duke keqpërdorë detyrën apo autorizimet e tij, e përdorë forcën apo kanosjen serioze ose mjete apo mënyra të tjera të ndaluara me qëllim të detyrimit të të dyshuarit, të pandehurit, dëshmitarit, ekspertit apo personit tjetër për të dhënë ndonjë deklaratë, dënohet me burgim prej tre (3) muaj deri në pesë (5) vjet.
2. Kur vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni kryhet me përdorimin e dhunës së rëndë ose nëse të dyshuarit, të pandehurit, dëshmitarit, ekspertit apo personit tjetër i janë shkaktuar pasoja të rënda në procedurën penale si rezultat i deklaratës së marrë nga ai me shtrëngim, kryesi dënohet me burgim prej një (1) deri në dhjetë (10) vjet.

Neni 198
Keqtrajtimi gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare ose autorizimeve publike

1. Personi zyrtar, i cili duke keqpërdorur detyrën apo autorizimet e tij e keqtrajton, frikëson ose fyen rëndë dinjitetin e personit tjetër, dënohet me burgim deri në tre (3) vjet.
2. Kur vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni kryhet ndaj fëmijës, kryesi dënohet me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet.

Neni 199
Tortura

1. Personi zyrtar ose personi i cili duke vepruar nën ndikimin ose me pëlqimin apo pranimin e heshtur të personit zyrtar kryen aktin e torturës, dënohet me burgim prej një (1) deri në pesëmbëdhjetë (15) vjet.
2. Kur vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni kryhet ndaj fëmijës, kryesi dënohet me burgim prej tre (3) deri në pesëmbëdhjetë (15) vjet.
3. Për qëllime të këtij neni, akt i torturës nënkupton kryerjen ose moskryerjen e një akti me anë të të cilit me dashje personit i shkaktohet dhembja ose vuajtja e rëndë, qoftë fizike ose mendore, me qëllim të marrjes së informatës apo deklaratës nga personi i tillë ose nga personi i tretë, ose me qëllim të dënimin të personit të tillë për një vepër të cilën ai ose personi i tretë e ka kryer ose dyshohet se e ka kryer, ose për frikësimin apo shtrëngimin e personit ose të personit të tretë për arsye që kanë të bëjnë me diskriminim të çfarëdo lloji. Akti i torturës nuk përfshin asnjë veprim ose mosveprim që rrjedh vetëm nga aktet e pashmangshme apo karakteristike të sanksioneve të ligjshme.

Neni 200
Cenimi i paprekshmërisë së banesave dhe objekteve

1. Kushdo që pa autorizim apo në mënyrë të kundërligjshme hyn në banesë ose në objektin e mbyllur të personit tjetër apo nuk largohet nga objektet e tilla sipas kërkesës së personit të autorizuar, dënohet me burgim deri në tre (3) vjet.
2. Tentativa për të kryer veprën penale nga paragrafi 1. i këtij neni është e dënueshme.
3. Kur vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni kryhet nga personi zyrtar në keqpërdorim të pozitës apo autorizimeve të tij, kryesi dënohet me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet.
4. Kur vepra penale nga paragrafi 1.ose 2. i këtij neni kryhet me përdorim të armës, mjetit të rrezikshëm apo sendit tjetër që mund të shkaktojë lëndim të rëndë trupor ose dëmtim të rëndë të shëndetit, kryesi dënohet me burgim prej një (1) deri në pesë (5) vjet.
5. Për qëllime të këtij neni, objektet përfshijnë, por nuk kufizohen në banesën dhe kopshtin rrethues, biznesin, zyrën, dhomën e hotelit apo dhomën e marrë me qira.

Neni 201
Kontrollimi i kundërligjshëm

1. Personi zyrtar i cili me keqpërdorim të pozitës apo autorizimeve të tij bën kontrollim të kundërligjshëm të banesës, objekteve apo personit, dënohet me burgim prej tre (3) muaj deri në (3) tre vjet.
2. Për qëllime të këtij neni, objektet përfshijnë, por nuk kufizohen në banesën dhe kopshtin rrethues, biznesin, zyrën, dhomën e hotelit apo dhomën e marrë me qira.

Neni 202
Cenimi i fshehtësisë së korrespondencës dhe i bazave të të dhënave kompjuterike

1. Kushdo që pa autorizim e hap letrën, telegramin, faksimilin apo ndonjë dokument tjetër të mbyllur ose dërgesë apo komunikim elektronik të personit tjetër, ose në ndonjë mënyrë tjetër e cenon fshehtësinë e materialeve të tilla apo pa autorizim mban, fsheh, asgjëson ose i dorëzon personit tjetër letrën, telegramin, faksimilin, komunikimin elektronik apo ndonjë dokument tjetër të mbyllur ose dërgesë të personit tjetër, dënohet me gjobë dhe me burgim deri në gjashtë (6) muaj.
2. Kushdo që pa autorizim ndërhyn në bazën e të dhënave kompjuterike të personit tjetër ose ato të dhëna i shfrytëzon apo ia vë në dispozicion personit tjetër, dënohet me gjobë dhe me burgim deri në një (1) vjet.
3. Kur vepra penale nga paragrafi 1. ose.2 të këtij neni kryhet me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore për vete ose për personin tjetër apo për t'i shkaktuar dëm personit tjetër, kryesi dënohet me gjobë dhe me burgim deri në tre (3) vjet.
4. Kur vepra penale nga paragrafi 1., 2. ose 3. i këtij neni kryhet nga personi zyrtar në keqpërdorim të pozitës apo autorizimeve të tij, për veprën penale nga paragrafi 1. ose 2. i këtij neni kryesi dënohet me burgim prej tre (3) muaj deri në tre (3) vjet, ndërsa për veprën penale nga paragrafi 3 i këtij neni kryesi dënohet me burgim prej një (1) vjet deri në pesë (5) vjet.

Neni 203
Zbulimi i paautorizuar i informacionit konfidencial

1. Avokati, mbrojtësi, mjeku apo personi tjetër i cili pa autorizim zbulon informacionin konfidencial për të cilin është vënë në dijeni gjatë ushtrimit të profesionit të vet dhe që është ligjërisht i detyruar ta mbajë në fshehtësi, dënohet me gjobë ose me burgim deri në një (1) vit.
2. Personi nuk është penalisht përgjegjës sipas paragrafit 1. të këtij neni nëse e ka zbuluar informacionin konfidencial për interes publik nëse interesi i tillë peshon më shumë se mos zbulimi i informatës së fshehtë.
3. Procedura penale për veprën penale nga paragrafi 1. i këtij neni fillohet sipas propozimit.
4. "Interes publik" nënkupton që mirëqenia e përgjithshme e publikut mbipeshon interesin individual. Zbulimi i informacionit konfidencial është në interes publik nëse ka të bëjë me planifikimin, përgatitjen ose kryerjen e veprave penale kundër rendit kushtetues ose integritetit territorial të Republikës së Kosovës, ose vepra tjera penale që i shkaktojnë personit tjetër lëndim të rëndë trupor ose vdekjen.

Neni 204
Përgjimi i paautorizuar

1. Kushdo që pa autorizim, përgjon bisedën apo deklaratën ose i mundëson personit tjetër të jetë në dijeni për bisedën apo deklaratën e cila është përgjuar pa autorizim, dënohet me burgim prej një (1) deri në tre (3) vjet.
2. Kur vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni kryhet nga personi zyrtar në keqpërdorim të pozitës apo autorizimeve të tij, kryesi dënohet me burgim prej dy (2) vjet deri në pesë (5) vjet.
3. Pajisjet e përdorura për kryerjen e veprës penale nga paragrafi 1. i këtij neni konfiskohen.

Neni 205
Fotografimi dhe incizimet tjera të paautorizuara

1. Kushdo që pa autorizim fotografon, filmon, incizon me video ose në ndonjë mënyrë tjetër incizon personin tjetër në banesën e tij personale ose në ndonjë vend tjetër ku personi ka pritje të arsyeshme për privatësi dhe në këtë mënyrë thelbësisht cenon privatësinë e tjetrit, dënohet me gjobë ose me burgim prej një (1) deri në tre (3) vjet.
2. Kushdo që pa autorizim ia kalon, shfaq apo i jep qasje personit të tretë në fotografinë, filmin, videokasetën apo ndonjë incizim tjetër të marrë në shkelje të paragrafit të këtij neni, dënohet me burgim prej një (1) deri në tre (3) vjet.
3. Kur vepra penale nga paragrafi 1 i këtij neni kryhet nga personi zyrtar në keqpërdorim të pozitës apo autorizimeve të tij, kryesi dënohet me burgim prej dy (2) vjet deri në pesë (5) vjet.
4. Nuk ka përgjegjësi penale, nëse fotografimi ose incizimi bëhet me qëllim të zbulimit të veprës penale dhe të kryesit të veprës penale ose për t'i paraqitur si dëshmi në polici, prokurori ose në gjykatë dhe nëse fotografitë dhe incizimet i dorëzohen këtyre organeve.
5. Pajisjet e përdorura për kryerjen e veprës penale nga paragrafi 1. i këtij neni konfiskohen.

Neni 206
Shkelja e urdhrave për masat e fshehura ose teknike të vëzhgimit ose hetimit

1. Zyrtari policor i autorizuar i cili zbaton një urdhër gjyqësor ose prokurorial për masat e fshehura ose teknike të vëzhgimit ose hetimit në shkelje të ligjit, dënohet me burgim prej tre (3) muaj deri në tre (3) vjet.
2. Kushdo që zbulon informatën që do të dëmtojë efikasitetin e zbatimit të një urdhri për masat e fshehura ose teknike të vëzhgimit ose hetimit, dënohet me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në tre (3) vjet.
3. Personi përgjegjës për operimin e telekomunikimeve, rrjetave kompjuterike ose shërbimeve postare apo punonjësi i një institucioni financiar i cili nuk ndërmerr veprimet e duhura për të lehtësuar zbatimin e urdhrit për përgjimin e telekomunikimeve, për përgjimin e komunikimeve me anë të rrjetit kompjuterik, kontrollin e dërgesave postare, regjistrimin e thirrjeve telefonike ose zbulimin e të

dhënave financiare, dënohet me gjobë ose me burgim prej tre (3) muaj deri në (3) tre vjet.

Neni 207
Parandalimi ose pengimi i tubimit publik

1. Kushdo që me përdorimin e mashtrimit ose në ndonjë mënyrë tjetër parandalon ose pengon caktimin apo mbajtjen e tubimit publik në të cilin personat kanë të drejtë sipas ligjit, dënohet me gjobë ose me burgim deri në një (1) vit.
2. Kur veprën penale nga paragrafi 1 i këtij neni e kryen personi zyrtar në keqpërdorim të pozitës apo autorizimeve të tij, kryesi dënohet me burgim deri në dy (2) vjet.

Neni 208
Cenimi i së drejtës për ushtrimin e mjetit juridik

1. Kushdo që në mënyrë të kundërligjshme pengon personin tjetër që të shfrytëzoj të drejtën e tij për paraqitjen e lutjes, kallëzimit penal, padisë, ankesës, kundërshtimit apo të ndonjë mjeti tjetër juridik, dënohet me gjobë ose me burgim deri në një (1) vit.
2. Kur vepra penale nga paragrafi 1 i këtij neni kryhet nga personi zyrtar në keqpërdorim të pozitës apo autorizimeve të tij, kryesi dënohet me burgim prej tre muaj deri në tre (3) vjet.

Neni 209
Parandalimi i shtypjes ose i shpërndarjes së materialeve të shtypura dhe emetimit të programeve

1. Kushdo që në mënyrë të kundërligjshme parandalon shtypjen, incizimin, shitjen, shpërndarjen apo emetimin e librave, revistave, gazetave, audio dhe video kasetave, programeve të radios dhe televizionit, ose materialeve tjera të shtypura apo të incizuara, dënohet me gjobë ose me burgim deri në një (1) vit.
2. Nëse vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni kryhet nga personi zyrtar në keqpërdorim të pozitës apo autorizimeve të tij, kryesi dënohet me burgim deri në tre (3) vjet.

KAPITULLI XVIII
VEPRAT PENALE KUNDËR TË DREJTAVE TË VOTIMIT

Neni 210
Cenimi i së drejtës për të kandiduar

1. Kushdo që në mënyrë të kundërligjshme parandalon ose pengon ndonjë person nga kandidimi në zgjedhje, dënohet me gjobë ose me burgim deri në një (1) vit.
2. Nëse vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni kryhet me përdorim të forcës apo kanosjes serioze, kryesi dënohet me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në tre (3) vjet.

Neni 211
Kanosja e kandidatit

1. Kushdo që në mënyrë të kundërligjshme detyron ndonjë kandidat që të tërheq kandidaturën e tij, dënohet me gjobë ose me burgim deri në një (1) vit.
2. Kushdo që në mënyrë të kundërligjshme parandalon ose pengon ndonjë kandidat nga ushtrimi i ndonjë veprimtarie gjatë fushatës elektorale, dënohet me gjobë ose me burgim deri në një (1) vit.
3. Kushdo që kryen vepër penale nga paragrafi 1. ose 2. i këtij neni me përdorim të forcës apo kanosjes serioze, dënohet me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në tre (3) vjet.

Neni 212
Parandalimi i ushtrimit të së drejtës për të votuar

1. Kushdo që gjatë ushtrimit të detyrave të besuara lidhur me zgjedhjet, në mënyrë të kundërligjshme dhe me qëllim të pengimit të personit tjetër nga ushtrimi i së drejtës së tij për të votuar, nuk e regjistron personin e tillë në listën e regjistrimit të votuesve ose e heq personin e tillë nga lista e regjistrimit te votuesve, dënohet me burgim prej një (1) viti deri në tre (3) vjet.
2. Kushdo që gjatë votimit ose referendumit, në mënyrë të kundërligjshme parandalon, pengon ose ndikon në përcaktimin e lirë të votuesit ose në ndonjë mënyrë tjetër pengon personin tjetër në ushtrimin e së drejtës së tij për të votuar, dënohet me burgim deri në një (1) vit.
3. Kushdo që kryen vepër penale nga paragrafët 1. dhe 2. i këtij neni me përdorim të forcës apo kanosjes serioze, dënohet me burgim prej një (1) vjet deri në pesë (5) vjet.

Neni 213
Cenimi i përcaktimit të lirë të votuesve

Kushdo që me përdorim të forcës apo kanosjes serioze, ose me keqpërdorim të varësisë ekonomike dhe profesionale të votuesit ndikon ose detyron votuesin në Republikën e Kosovës që të votojë në mënyrë të caktuar ose të mos votojë në zgjedhje, dënohet me një (1) deri në pesë (5) vjet burg.

Neni 214
Keqpërdorimi i detyrës zyrtare gjatë zgjedhjeve

Çdo person zyrtar të cilit i janë besuar detyra lidhur me zgjedhjet, keqpërdor pozitën, detyrën apo autoritetin e tij duke urdhëruar, këshilluar ose kryer ndonjë vepër të kundërligjshme me qëllim të ndryshimit apo ndikimit të listës së regjistrimit të votuesve ose votimit të cilitdo person ose në ndonjë mënyrë tjetër vepron me qëllim që të ndryshojë, ndikojë ose pengojë ndonjë person nga ushtrimi i të drejtës së tij për të votuar, për të mos votuar, për të hedhur një votë të pavlefshme ose për të votuar në favor apo kundër një personi ose propozimi të caktuar, dënohet me gjobë dhe me burgim prej dy (2) deri në pesë (5) vjet.

Neni 215
Dhënia ose marrja e ryshfetit në lidhje me votimin

1. Kushdo që premton, ofron ose jep ndonjë përfitim ose dhuratë të pamerituar ndonjë personi, me qëllim që të ndikojë atë person për të votuar, për të mos votuar, për të votuar në favor apo kundër një personi apo propozimi të caktuar ose për të hedhur një votë të pavlefshme në zgjedhje apo në referendum, dënohet me burgim prej një (1) deri në pesë (5) vjet.
2. Kushdo që kërkon ose pranon ndonjë përfitim ose dhuratë të pamerituar për vete ose për ndonjë person tjetër, ose pranon ofertën apo premtimin për përfitim apo dhuratë të tillë, për të votuar ose për të mos votuar, për të votuar në favor apo kundër një personi apo propozimi të caktuar ose për të hedhur një votë të pavlefshme në zgjedhje apo në referendum, dënohet me burgim prej një (1) deri në pesë (5) vjet.
3. Kushdo që shërben si ndërmjetësues dhe shkel paragrafin 1. ose 2. të këtij neni, dënohet me burgim prej një (1) deri në pesë (5) vjet.
4. Nëse vepra penale nga paragrafët 1. deri 3. të këtij neni kryhet nga anëtari i Komisionit Zgjedhor ose ndonjë person tjetër gjatë ushtrimit të detyrave zyrtare në lidhje me votimin, kryesi dënohet me burgim prej tre (3) deri në pesë (5) vjet.
5. Dhurata konfiskohet.

Neni 216
Keqpërdorimi i të drejtës së votimit

1. Kushdo që kryen një ose më shumë nga veprat në vijim, dënohet me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në tre (3) vjet:
   1.1. voton ose tenton të voton në emër të personit tjetër;
   1.2. voton ose tenton të voton edhe pse ka votuar një herë; ose
   1.3. shfrytëzon më shumë se një listë votimi.
2. Anëtari i Komisionit Zgjedhor i cili i mundëson tjetrit të kryej ose të tentojë të kryej veprën penale nga paragrafi 1. i këtij neni dënohet me burgim prej tre (3) deri në pesë (5) vjet.

Neni 217
Pengimi i procesit të votimit

1. Kushdo që në mënyrë të kundërligjshme pengon ose ndërprenë procesin e votimit, dënohet me burgim prej një (1) deri në dy (2) vjet.
2. Kushdo që me përdorim të forcës apo kanosjes serioze, pengon votimin me nxitje të prishjes së rendit publik në qendrën e votimit, që rezulton me ndërprerje në procesin e votimit, dënohet me burgim prej një (1) vjet deri në tre (3) vjet.

Neni 218
Cenimi i fshehtësisë së votimit

1. Kushdo që në zgjedhje ose në referendum cenon fshehtësinë e votimit, dënohet me burgim deri në gjashtë (6) muaj.

2. Kushdo që me përdorim të forcës apo kanosjes serioze, ose në ndonjë mënyrë tjetër të kundërligjshme kërkon nga personi që të tregojë si ka votuar, dënohet me burgim deri në një (1) vit.
3. Kur vepra penale nga paragrafi 1. ose 2. i këtij neni kryhet nga anëtari i Komisionit Zgjedhor ose ndonjë person tjetër në keqpërdorim të detyrave, pozitës apo autorizimeve të tij në zgjedhje ose në votim, kryesi dënohet me burgim prej një (1) deri në pesë (5) vjet.

Neni 219
Falsifikimi i rezultateve të votimit

1. Kushdo që shton, heq apo fshin votat apo nënshkrimet, regjistron në mënyrë të pasaktë votën apo rezultatet e zgjedhjeve në dokumentet zgjedhore, ose publikon votën apo rezultatet e zgjedhjeve apo të votimit që nuk i përgjigjen votimit të vërtetë, ose në ndonjë mënyrë tjetër falsifikon votën apo rezultatet e zgjedhjeve, dënohet me burgim prej një (1) deri në tre (3) vjet.
2. Kur vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni kryhet nga anëtari i Komisionit Zgjedhor ose ndonjë person tjetër në keqpërdorim të detyrave, pozitës apo autorizimeve të tij lidhur me zgjedhjet, kryesi dënohet me burgim prej tre (3) deri në pesë (5) vjet.

Neni 220
Asgjësimi i dokumenteve të votimit

1. Kushdo që asgjëson, fsheh, dëmton apo merr fletën e votimit ose ndonjë tjetër send apo dokument lidhur me zgjedhjet ose referendumin, dënohet me burgim prej një (1) deri në tre (3) vjet.
2. Kur vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni kryhet nga anëtari i Komisionit Zgjedhor ose ndonjë person tjetër në keqpërdorim të detyrave, pozitës apo autorizimeve të tij lidhur me zgjedhjet, kryesi dënohet me burgim prej tre (3) deri në pesë (5) vjet.

KAPITULLI XIX
VEPRAT PENALE KUNDËR TË DREJTAVE NË MARRËDHËNIET E PUNËS

Neni 221
Cenimi i të drejtave në marrëdhëniet e punës

Kushdo që me vetëdije nuk e zbaton ligjin apo kontratën kolektive për punësimin apo ndërprerjen e marrëdhënies së punës; pagat apo të ardhurat e tjera; kohëzgjatjen e orarit të punës; punën jashtë orarit apo punën me ndërrime; pushimin apo mungesën nga puna; ose mbrojtjen e grave, fëmijëve apo personave me aftësi të kufizuara dhe kësisoj punëtorit ia mohon apo ia kufizon të drejtat që i takojnë, dënohet me gjobë ose me burgim deri në një (1) vit.

Neni 222
Cenimi i të drejtave të punësimit dhe papunësisë

1. Kushdo që ia mohon apo kufizon personave tjerë të drejtën në punësim në kushte të njëjta, ashtu siç që është përcaktuar me ligj, dënohet me gjobë ose me burgim deri në dy (2) vjet.
2. Kushdo që nuk vepron në pajtim me legjislacionin mbi të drejtat e personave të papunësuar dhe me këtë ia mohon apo ia kufizon të drejtat që iu takojnë atyre, dënohet me dënimin nga paragrafi 1. i këtij neni.

Neni 223
Cenimi i të drejtës në menaxhim

1. Kushdo që në mënyrë të kundërligjshme pengon apo ndalon trupin drejtues në vendimmarrje ose anëtarit të trupit drejtues ia bën të pamundshëm ushtrimin e të drejtës së tij për të marrë pjesë në vendimmarrje në atë trup, dënohet me gjobë ose me burgim deri në një (1) vit.
2. Nëse vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni kryhet nga personi zyrtar ose personi përgjegjës në keqpërdorim të pozitës apo autorizimeve të tij, kryesi dënohet me burgim deri në (2) dy vjet.
3. Kushdo që kryen vepër penale nga paragrafi 1. ose 2. i këtij neni me përdorim të forcës apo kanosjes serioze, dënohet me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet.

Neni 224
Cenimi i të drejtës në grevë

1. Kushdo që me përdorim të forcës apo kanosjes serioze ose në ndonjë mënyrë tjetër të kundërligjshme, parandalon ose pengon punëtorin nga organizimi, pjesëmarrja apo ushtrimi në ndonjë mënyrë tjetër i çfarëdo të drejte ligjore për grevë në pajtim me ligjin dhe për të marrë pjesë në grevë, apo në ndonjë mënyrë tjetër për të ushtruar të drejtën në grevë, dënohet me gjobë ose me burgim deri në dy (2) vjet.
2. Punëdhënësi ose personi përgjegjës i cili e largon nga puna të punësuarin për shkak të pjesëmarrjes së tij në grevën e organizuar në pajtim me ligjin ose i cili merr masa tjera me të cilat cenohen të drejtat e punëtorit nga marrëdhënia e punës, dënohet me gjobë ose me burgim deri në dy (2) vjet.

Neni 225
Keqpërdorimi i të drejtës në grevë

1. Kushdo që në shkelje të ligjit, organizon ose udhëheq grevën dhe nëse nuk ka elemente të ndonjë vepre penale tjetër, dënohet me gjobë ose me burgim deri në një (1) vit.
2. Kushdo që në shkelje të ligjit, organizon ose udhëheq grevën e cila shkakton dëm në shkallë të madhe, humbje në shkallë të madhe ose rrezikon jetën apo shëndetin e personave dhe nëse nuk ka elemente të ndonjë vepre penale tjetër, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet.

Neni 226
Cenimi i të drejtave nga sigurimi social

Kushdo që me vetëdije nuk e zbaton ligjin apo kontratën kolektive nga lëmi i sigurimit shëndetësor, pensional apo invalidor apo nga ndonjë formë tjetër e sigurimit social dhe me këtë ia mohon apo ia kufizon të drejtat që i takojnë punëtorit, dënohet me gjobë ose me burgim deri në një (1) vit.

Neni 227
Keqpërdorimi i të drejtave nga sigurimi social

Kushdo që duke u shtirur ose duke i shkaktuar vetes sëmundje apo paaftësim për punë ose në ndonjë mënyre tjetër të kundërligjshme arrin që të sigurojë ndonjë të drejtë nga sigurimi social ose pensioni shtetëror, që nuk i takon sipas ligjit, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet.

KAPITULLI XX
VEPRAT PENALE KUNDËR INTEGRITETIT SEKSUAL

Neni 228
Përkufizimet lidhur me veprat penale kundër integritetit seksual

Për qëllime të këtij kapitulli shprehjet në vijim kanë këtë kuptim:

1. Shprehja "pëlqim" nënkupton pajtim i vullnetshëm i personit i cili ka arritur moshën gjashtëmbëdhjetë vjet për të kryer aktin seksual. Nuk ekziston pëlqimi nëse:
   1.1. personi i tillë me fjalë ose me sjellje shpreh mungesë të pajtimit për të kryer aktin ose për ta vazhduar atë;
   1.2. pajtimi është shprehur me fjalë ose me sjelljen e një personi tjetër dhe jo të viktimës;
   1.3. pajtimi i viktimës është marrë me mashtrim, frikësim ose me kërcënim, nëse mënyrat e tilla nuk përfshijnë përdorimin e forcës, kanosjes serioze ose shfrytëzimin siç është paraparë në nenin 230 paragrafi 3. të këtij Kodi; ose
   1.4. personi i tillë është i paaftë për të dhënë pajtimin për aktivitet seksual për shkak të aftësisë së zvogëluar mendore apo fizike ose dehjes me alkool, drogë apo me substanca tjera.
2. Asgjë nga paragrafi 1. i këtij neni nuk duhet të interpretohet si kufizim i rrethanave në të cilat nuk ekziston pëlqimi.
3. Shprehja "akt seksual" nënkupton penetrim sado i vogël i organit seksual në cilëndo pjesë të trupit të personit ose penetrim sado i vogël në hapjen anale apo gjenitale të personit me ndonjë send ose me cilëndo pjesë tjetër të trupit.
4. Shprehja "detyrim i personit tjetër në kryerjen e aktit seksual" nënkupton kryerjen e aktit seksual mbi personin tjetër nga kryesi ose cytja e personit tjetër në kryerjen e aktit seksual me kryesin apo me personin e tretë ose cytja e personit të tretë për kryerjen e aktit seksual në personin tjetër.
5. Shprehja "pjesë intime" nënkupton gjinjtë e një femre, penisi, vagina dhe/apo anusi.

6. Shprehja "prekje" nënkupton kontakt direkt ose indirekt, pa penetrim, midis trupit të personit me cilëndo pjesë të trupit të personit tjetër apo me ndonjë send.
7. Shprehja "pornografi me fëmijët" nënkupton çfarëdo pamje vizuele apo shfaqje ose pasqyrim vizuel, duke përfshirë çdo fotografi, film, video, pamje apo imazh ose fotografi e krijuar me kompjuter, qoftë nëse është krijuar në mënyre elektronike, mekanike apo me mjete tjera, që paraqet ose pasqyron:
   7.1. gjenitalet (vagina, penisi ose anusi) apo zonën e ashtit mbivetor të një fëmije, kryesisht për qëllime seksuale;
   7.2. një fëmijë të vërtetë i cili është përfshirë në një sjellje seksualisht eksplicite të vërtetë apo të simuluar;
   7.3. një person i cili duket të jetë fëmijë i vërtetë i përfshirë në një sjellje seksualisht eksplicite të vërtetë apo të simuluar; ose
   7.4. pamje realiste të një fëmije joekzistues të përfshirë në një sjellje seksualisht eksplicite të vërtetë apo të simuluar.
8. Shprehja "prostitucion" nënkupton ofrimin ose dhënien e shërbimeve seksuale në këmbim të të hollave, mallrave ose shërbimeve, përfshirë, por pa u kufizuar në kryerjen e një obligimi për të paguar ose ofrimin e mallrave apo shërbimeve, përfshirë shërbimet seksuale falas apo me zbritje. Nuk është me rëndësi nëse pagesa, mallrat apo shërbimet i janë dhënë apo premtuar personit të përfshirë në shërbime seksuale apo personit të tretë.

Neni 229
Lajthimi në fakt lidhur me moshën e viktimës

1. Për qëllime të këtij Kapitulli, lajthimi lidhur me moshën e viktimës e cila është nën moshën gjashtëmbëdhjetë vjet nuk është lajthim në fakt sipas nenit 25 të këtij Kodi, nëse kryesi me vetëdije ka qenë i pakujdesshëm në vënien e vetës në lajthim të tillë.
2. Kryesi nuk është penalisht përgjegjës për shkak të lajthimit në fakt nga neni 25 i këtij Kodi nëse për arsye të justifikueshme nuk e ka ditur dhe nuk ka mundur ta dijë se viktima ka qenë nën moshën gjashtëmbëdhjetë (16) vjet.

Neni 230
Dhunimi

1. Kushdo që detyron personin tjetër për të kryer akt seksual pa pëlqimin e personit të tillë, dënohet me burgim prej dy (2) deri në dhjetë (10) vjet.
2. Kushdo që detyron personin tjetër për të kryer akt seksual duke e kanosur me zbulimin e një fakti që do të dëmtonte rëndë nderin ose reputacionin e personit të tillë apo të personit të lidhur ngushtë me personin e tillë, dënohet me burgim prej tre (3) deri në dhjetë (10) vjet.
3. Kushdo që detyron personin tjetër për të kryer akt seksual në një ose më shumë nga rrethanat në vijim, dënohet me burgim prej pesë (5) deri në dhjetë (10) vjet:
   3.1. me kanosje serioze ose me kanosje për përdorim të dhunës;
   3.2. me kanosje të rrezikimit të atëçastshëm të jetës ose trupit të personit të tillë apo të personit tjetër; ose
   3.3. duke shfrytëzuar situatën në të cilën personi është i pambrojtur dhe ku siguria e tij është në rrezik.

4. Kur vepra penale nga paragrafi 1. ose 2. i këtij neni kryhet në një ose më shumë nga rrethanat në vijim, kryesi dënohet me burgim prej pesë (5) deri në pesëmbëdhjetë (15) vjet:
   4.1. veprës i ka paraprirë, ajo është shoqëruar ose përcjellur nga tortura apo trajtimi çnjerëzor;
   4.2. kryesi e përdor forcën;
   4.3. kryesi shkakton lëndime të rënda trupore ose çrregullim të rëndë për shëndetin mendor apo fizik të personit;
   4.4. kryesi përdor ose kanos se do të përdor armë apo mjet të rrezikshëm;
   4.5. kryesi me dashje shkakton dehjen e personit me anë të alkoolit, drogës apo substancave tjera;
   4.6. vepra është kryer bashkërisht nga më shumë se një person;
   4.7. kryesi e di që personi është posaçërisht i ndjeshëm për shkak të moshës, aftësive të kufizuara mendore apo fizike, çrregullimit apo paaftësisë fizike apo mendore, ose shtatzënisë;
   4.8. kryesi është prindi, prindi adoptues, prindi birësues, njerku apo njerka, gjyshi ose gjyshja, daja apo axha, tezja apo halla, vëllai ose motra e personit dhe personi i tillë është midis moshës gjashtëmbëdhjetë (16) dhe tetëmbëdhjetë (18) vjet;
   4.9. kryesi është në marrëdhënie familjare me personin dhe personi i tillë është midis moshës gjashtëmbëdhjetë (16) dhe tetëmbëdhjetë (18) vjet;
   4.10. kryesi është mësimdhënës, udhëheqës fetar, profesionist i kujdesit shëndetësor, person të cilit i është besuar rritja apo kujdesi për personin e tillë ose që në ndonjë mënyrë tjetër ka autoritet ndaj personit.
5. Kur vepra nga ky nen rezulton me vdekjen e viktimës, kryesi dënohet me jo më pak se dhjetë (10) vjet burgim ose me burgim të përjetshëm.

Neni 231
Shërbimet seksuale të viktimës së trafikimit

1. Kushdo që shfrytëzon ose mundëson shërbimet seksuale të viktimës së trafikimit dënohet me burgim prej tre (3) muaj deri në pesë (5) vjet.
2. Kur vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni kryhet ndaj personit nën moshën tetëmbëdhjetë vjet, kryesi dënohet me burgim prej dy (2) deri në dhjetë (10) vjet.
3. Kur vepra penale nga ky nen kryhet nga personi zyrtar në keqpërdorim të pozitës apo autorizimeve të tij, kryesi dënohet me burgim prej dy (2) deri në shtatë (7) vjet për veprën penale nga paragrafi 1. ose me burgim prej pesë (5) deri në dymbëdhjetë (12) vjet për veprën penale nga paragrafi 2. i këtij neni.
4. Nëse vepra penale nga ky nen rezulton me vdekjen e një apo më shumë personave, kryesi dënohet me jo më pak se dhjetë (10) vjet burgim ose me burgim të përjetshëm.
5. Për qëllime të këtij neni, nuk është e rëndësishme nëse kryesi e ka ditur se personi është viktimë e trafikimit, përveç nëse për arsye të justifikueshme, kryesi nuk e ka ditur dhe nuk ka mundur ta dijë se personi është viktimë e trafikimit.
6. Për qëllime të këtij neni, shprehja "viktimë e trafikimit" nënkupton personin i cili është trafikuar sipas dispozitave të nenit 171 të këtij Kodi.

Neni 232
Sulmi seksual

1. Kushdo që prek personin tjetër me qëllim seksual ose e cyt personin e tillë të prekë kryesin apo personin tjetër për qëllim seksual, pa pëlqimin e personit të tillë, dënohet me gjobë ose me burgim deri në një (1) vjet.
2. Kushdo që prek personin tjetër me qëllim seksual ose e cyt personin tjetër të prekë kryesin apo personin e tretë për qëllim seksual në një ose më shumë prej rrethanave në vijim, dënohet me burgim prej një (1) deri në shtatë (7) vjet:
   2.1. me kanosje serioze ose me kanosje për përdorim të dhunës;
   2.2. me kanosje të rrezikimit të atëçastshëm të jetës ose trupit të personit të tillë apo të personit tjetër; ose
   2.3. duke shfrytëzuar situatën në të cilën personi i tillë është i pambrojtur dhe ku siguria e tij është në rrezik.
3. Kur vepra penale nga paragrafi 1. ose 2. i këtij neni kryhet në një ose më shumë nga rrethanat në vijim, kryesi dënohet me burgim prej tre (3) deri në dhjetë (10) vjet:
   3.1. veprës i ka paraprirë, ajo është shoqëruar ose përcjellur nga tortura apo trajtimi çnjerëzor;
   3.2. kryesi e përdor forcën;
   3.3. kryesi shkakton lëndime të rënda trupore ose çrregullim të rëndë për shëndetin mendor apo fizik të personit ose viktima tenton të bëjë vetëvrasje pas veprës penale;
   3.4. kryesi përdor ose kanos se do të përdor armë apo mjet të rrezikshëm;
   3.5. kryesi me dashje shkakton dehjen e personit me anë të alkoolit, drogës apo substancave tjera;
   3.6. vepra është kryer bashkërisht nga më shumë se një person;
   3.7. kryesi e di që personi është posaçërisht i ndjeshëm për shkak të moshës, aftësive të kufizuara mendore apo fizike, çrregullimit fizik apo mendor, paaftësisë ose shtatzënisë;
   3.8. kryesi është prindi, prindi adoptues, prindi birësues, njerku apo njerka, gjyshi ose gjyshja, daja apo axha, tezja apo halla, vëllai ose motra e personit dhe personi i tillë është midis moshës gjashtëmbëdhjetë dhe tetëmbëdhjetë vjet;
   3.9. kryesi është në marrëdhënie familjare me personin dhe personi i tillë është midis moshës gjashtëmbëdhjetë dhe tetëmbëdhjetë vjet;
   3.10. kryesi është mësimdhënës, udhëheqës fetar, profesionist i kujdesit shëndetësor, person të cilit i është besuar rritja apo kujdesi për personin e tillë ose që në ndonjë mënyrë tjetër ka autoritet ndaj personit.
4. Kur vepra penale nga paragrafi 1. ose 2. i këtij neni rezulton me vdekje të viktimës, kryesi dënohet me jo më pak se dhjetë (10) vjet burgim ose me burgim të përjetshëm.

Neni 233
Degradimi i integritetit seksual

1. Kushdo që cyt personin tjetër të ekspozojë pjesët intime të trupit të personit të tillë, të masturbojë ose të kryej ndonjë akt tjetër që degradon integritetin seksual të

personit të tillë, pa pëlqimin e personit të tillë, dënohet me gjobë ose me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në një (1) vit.

2. Kushdo që cyt personin tjetër të ekspozojë pjesët intime të trupit të personit të tillë, të masturbojë ose të kryejë ndonjë akt tjetër që degradon integritetin seksual të personit të tillë, në një apo më shumë nga rrethanat në vijim, dënohet me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në tre (3) vjet:
   2.1. me kanosje serioze ose me kanosje për përdorim të dhunës;
   2.2. me kanosje të rrezikimit të atëçastshëm të jetës ose trupit të personit të tillë apo të personit tjetër; ose
   2.3. duke shfrytëzuar situatën në të cilën personi është i pambrojtur dhe ku siguria e tij është në rrezik.
3. Kur vepra penale nga paragrafi 1. ose 2. i këtij neni kryhet në një ose më shumë nga rrethanat në vijim, kryesi dënohet me burgim prej një (1) deri në dhjetë (10) vjet:
   3.1. veprës i ka paraprirë, ajo është shoqëruar ose përcjellur nga tortura apo trajtimi çnjerëzor;
   3.2. kryesi e përdor forcën;
   3.3. kryesi shkakton lëndime të rënda trupore ose çrregullim të rëndë për shëndetin mendor apo fizik të personit ose viktima tenton të bëjë vetëvrasje pas veprës penale;
   3.4. kryesi përdor ose kanos se do të përdor armë apo mjet të rrezikshëm;
   3.5. kryesi me dashje shkakton dehjen e personit me anë të alkoolit, drogës apo substancave tjera;
   3.6. vepra është kryer bashkërisht nga më shumë se një person;
   3.7. kryesi e di që personi është posaçërisht i ndjeshëm për shkak të moshës, çrregullimit apo paaftësisë fizike apo mendore, ose shtatzënisë;
   3.8. kryesi është prindi, prindi adoptues, prindi birësues, njerku apo njerka, gjyshi ose gjyshja, daja apo axha, tezja apo halla, vëllai ose motra e personit dhe personi i tillë është midis moshës gjashtëmbëdhjetë dhe tetëmbëdhjetë vjet;
   3.9. kryesi është në marrëdhënie familjare me personin dhe personi i tillë është midis moshës gjashtëmbëdhjetë dhe tetëmbëdhjetë vjet; ose
   3.10. kryesi është mësimdhënës, udhëheqës fetar, profesionist i kujdesit shëndetësor, person të cilit i është besuar rritja apo kujdesi për personin e tillë ose që në ndonjë mënyrë tjetër ka autoritet ndaj personit.
4. Tentativa për të kryer vepër penale nga paragrafi 1. i këtij neni është e dënueshme.

Neni 234
Keqpërdorimi seksual i personave me çrregullime ose paaftësi mendore apo emocionale

1. Kushdo që detyron personin me aftësi të zvogëluar mendore ose fizike ose me çrregullime apo paaftësi mendore apo emocionale, në akt seksual me kryesin apo personin e tretë duke shfrytëzuar aftësinë e zvogëluar, çrregullimin ose paaftësinë e personit të tillë, dënohet me burgim prej një (1) deri në dhjetë (10) vjet.
2. Kushdo që prek për qëllime seksuale personin me aftësi të zvogëluar mendore ose fizike, çrregullim ose paaftësi mendore apo emocionale ose e cyt personin e tillë për të prekur kryesin ose personin e tretë me qëllim seksual duke e shfrytëzuar aftësinë

e zvogëluar, çrregullimin ose paaftësinë e personit të tillë, dënohet me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet.

3. Kushdo që cyt personin me aftësi të zvogëluar mendore ose fizike ose personin me çrregullim ose paaftësi mendore apo emocionale, t'i ekspozojë pjesët intime të trupit të tij, të masturbojë ose të kryejë një akt i cili e degradon integritetin e tij seksual, duke shfrytëzuar aftësinë e zvogëluar, çrregullimin ose paaftësinë e personit të tillë, dënohet me burgim deri në (1) një vit.
4. Kur vepra penale nga paragrafët 1., 2. ose 3. i këtij neni kryhet në një apo më shumë nga rrethanat në vijim, kryesi dënohet me burgim prej tre (3) deri në pesëmbëdhjetë (15) vjet për veprën penale nga paragrafi 1. ose 2. të këtij neni, ose me burgim deri në tre (3) vjet për veprën penale nga paragrafi 3. i këtij neni:
   4.1. veprës i ka paraprirë, ajo është shoqëruar ose përcjellur nga tortura apo trajtimi çnjerëzor;
   4.2. kryesi përdor forcë;
   4.3. kryesi shkakton lëndime të rënda trupore ose çrregullim të rëndë për shëndetin mendor apo fizik të personit ose viktima tenton të bëjë vetëvrasje pas veprës penale;
   4.4. kryesi përdor ose kanos se do të përdor armë apo mjet të rrezikshëm;
   4.5. kryesi me dashje shkakton dehjen e personit me anë të alkoolit, drogës apo substancave tjera;
   4.6. vepra është kryer bashkërisht nga më shumë se një person;
   4.7. kryesi e di se personi është posaçërisht i ndjeshëm për shkak të moshës apo shtatzënisë;
   4.8. kryesi është prindi, prindi adoptues, prindi birësues, njerku apo njerka, gjyshi ose gjyshja, daja apo axha, tezja apo halla, vëllai ose motra e personit dhe personi i tillë është midis moshës gjashtëmbëdhjetë (16) dhe tetëmbëdhjetë (18) vjet;
   4.9. kryesi është në marrëdhënie familjare me personin dhe personi i tillë është midis moshës gjashtëmbëdhjetë (16) dhe tetëmbëdhjetë (18) vjet; ose
   4.10. kryesi është mësimdhënës, udhëheqës fetar, profesionist i kujdesit shëndetësor, person të cilit i është besuar rritja apo kujdesi për personin e tillë ose që në ndonjë mënyrë tjetër ka autoritet ndaj personit.
5. Kur vepra penale nga paragrafët 1. deri 4. të këtij neni rezulton me vdekje të viktimës, kryesi dënohet me jo më pak se dhjetë (10) vjet burgim ose me burgim të përjetshëm.
6. Tentativa për të kryer vepër penale nga paragrafi 3. i këtij neni është e dënueshme.

Neni 235
Keqpërdorimi seksual i personave nën moshën gjashtëmbëdhjetë (16) vjet

1. Kushdo që kryen veprat penale në vijim ndaj personit nën moshën gjashtëmbëdhjetë (16) vjet, dënohet siç përcaktohet në vijim:
   1.1. kryesi i cili kryen veprën penale të dhunimit nga neni 230 i këtij Kodi ndaj personit nën moshën gjashtëmbëdhjetë (16) vjet, dënohet me burgim prej pesë (5) deri në (20) njëzet vjet.
   1.2. kryesi i cili kryen veprën penale të përdorimit të shërbimeve seksuale të

viktimës së trafikimit nga neni 231 i këtij Kodi ndaj personit nën moshën gjashtëmbëdhjetë (16) vjet, dënohet me burgim prej pesë (5) deri në njëzet (20) vjet.

1.3. kryesi i cili kryen veprën penale të sulmit seksual nga neni 232 i këtij Kodi ndaj personit nën moshën gjashtëmbëdhjetë (16) vjet, dënohet me burgim prej pesë (5) deri në (10) dhjetë vjet.

1.4. kryesi i cili kryen veprën penale të degradimit të integritetit seksual nga neni 233 i këtij Kodi ndaj personit nën moshën gjashtëmbëdhjetë (16) vjet, dënohet me burgim prej një (1) deri në pesë (5) vjet.

2. Kushdo që kryen veprat penale në vijim ndaj personit nën moshën katërmbëdhjetë (14) vjet, dënohet siç përcaktohet në vijim:

2.1. kryesi i cili kryen veprën penale të dhunimit nga neni 230 i këtij Kodi ndaj personit nën moshën katërmbëdhjetë (14) vjet, dënohet me jo më pak se dhjetë (10) vjet burgim.

2.2. kryesi i cili kryen veprën penale të përdorimit të shërbimeve seksuale të viktimës së trafikimit nga neni 231 i këtij Kodi ndaj personit nën moshën katërmbëdhjetë (14) vjet, dënohet me jo më pak se dhjetë (10) vjet burgim.

2.3. kryesi i cili kryen veprën penale të sulmit seksual nga neni 232 i këtij Kodi ndaj personit nën moshën katërmbëdhjetë (14) vjet, dënohet me burgim prej dhjetë (10) deri në (20) njëzet vjet.

2.4. kryesi i cili kryen veprën penale të degradimit të integritetit seksual nga neni 233 i këtij Kodi ndaj personit nën moshën katërmbëdhjetë (14) vjet, dënohet me burgim prej dy (2) deri në dhjetë (10) vjet.

3. Kur vepra nga paragrafi 1. i këtij neni është kryer me marrëveshjen e dy personave të cilët kanë arritur moshën katërmbëdhjetë (14) vjet dhe ku dallimi në moshën e tyre nuk tejkalon dy (2) vjet, akti i tillë nuk përbën vepër penale.

4. Kur vepra penale nga paragrafi 1., 2. ose 3. i këtij neni kryhet në një apo më shumë nga rrethanat në vijim, kryesi dënohet me jo më pak se pesëmbëdhjetë (15) vjet burgim:

4.1. veprës i ka paraprirë, ajo është shoqëruar ose përcjellur nga tortura apo trajtimi çnjerëzor;

4.2. kryesi përdor forcë;

4.3. kryesi shkakton lëndime të rënda trupore ose çrregullim të rëndë për shëndetin mendor apo fizik të personit ose viktima tenton të bëjë vetëvrasje pas veprës penale;

4.4. kryesi përdor ose kanos se do të përdor armë apo mjet të rrezikshëm;

4.5. kryesi me dashje shkakton dehjen e personit me anë të alkoolit, drogës apo substancave tjera;

4.6. vepra është kryer bashkërisht nga më shumë se një person;

4.7. kryesi e di se personi është posaçërisht i ndjeshëm për shkak të moshës apo shtatzënisë;

4.8. kryesi është prindi, prindi adoptues, prindi birësues, njerku apo njerka, gjyshi ose gjyshja, daja apo axha, tezja apo halla, vëllai ose motra e personit dhe personi i tillë është midis moshës gjashtëmbëdhjetë (16) dhe tetëmbëdhjetë (18) vjet;

4.9. kryesi është mësimdhënës, udhëheqës fetar, profesionist i kujdesit

shëndetësor, person të cilit i është besuar rritja apo kujdesi për personin e tillë ose që në ndonjë mënyrë tjetër ka autoritet ndaj personit.

5. Kur vepra penale nga paragrafi 1. ose 2. i këtij neni rezulton me vdekjen e viktimës, kryesi dënohet me jo më pak se njëzet (20) vjet burgim ose me burgim të përjetshëm.

Neni 236
Nxitja e akteve seksuale, prekjes apo aktiviteteve nga personat nën moshën gjashtëmbëdhjetë vjet

1. Kushdo që ndërmjetëson, ofron ose i mundëson personit nën moshën gjashtëmbëdhjetë (16) vjet të kryejë akt seksual me personin e tretë i cili ka mbushur moshën tetëmbëdhjetë (18) vjet, dënohet me burgim prej dy (2) deri në dhjetë (10) vjet.
2. Kushdo që ndërmjetëson, ofron apo i mundëson personit nën moshën gjashtëmbëdhjetë (16) vjet të prekë personin e tretë i cili ka arritur moshën tetëmbëdhjetë (18) vjet me qëllim seksual ose që t'i lejojë personit të tretë që ka arritur moshën tetëmbëdhjetë (18) vjet që të prekë personin nën moshën gjashtëmbëdhjetë (16) vjet me qëllim seksual, dënohet me burgim prej një (1) deri në pesë (5) vjet.
3. Kushdo që e bind, nxit, cyt apo shtrëngon personin nën moshën gjashtëmbëdhjetë (16) vjet që të përfshihet në ndonjë aktivitet seksual për të cilin cilido person mund të akuzohet për vepër penale, dënohet me jo më pak se pesë (5) vjet burgim.
4. Kushdo që ndërmjetëson, ofron ose i mundëson personit nën moshën katërmbëdhjetë (14) vjet që të kryejë akt seksual me personin e tretë i cili ka mbushur moshën tetëmbëdhjetë (18) vjet, dënohet me burgim prej pesë (5) deri në dhjetë (10) vjet.
5. Kushdo që ndërmjetëson, ofron apo i mundëson personit nën moshën katërmbëdhjetë (14) vjet që të prekë personin e tretë i cili ka arritur moshën tetëmbëdhjetë (18) vjet me qëllim seksual ose që t'i lejojë personit të tretë që ka arritur moshën tetëmbëdhjetë (18) vjet që të prekë personin nën moshën katërmbëdhjetë (14) vjet me qëllim seksual, dënohet me burgim prej dy (2) deri në dhjetë (10) vjet.
6. Kushdo që e bind, nxit, cyt apo shtrëngon personin nën moshën katërmbëdhjetë (14) vjet që të përfshihet në ndonjë aktivitet seksual për të cilin cilido person mund të akuzohet për vepër penale, dënohet me burgim prej tre (3) deri në pesëmbëdhjetë (15) vjet.

Neni 237
Ofrimi i materialit pornografik personave nën moshën gjashtëmbëdhjetë vjet

1. Kushdo që shet, ofron të shesë, shfaq ose në mënyrë tjetër i siguron personit nën moshën gjashtëmbëdhjetë (16) vjet fotografi, material audiovizuel apo sende të tjera me përmbajtje pornografike ose e lejon personin e tillë të shoh një shfaqje të gjallë me përmbajtje pornografike apo me dashje e sjell personin e tillë në një shfaqje të tillë, dënohet me gjobë dhe me burgim prej tre (3) muaj deri në tre (3) vjet.

2. Materiali pornografik sipas paragrafit 1. të këtij neni konfiskohet.

Neni 238
Keqpërdorimi i fëmijëve në pornografi

1. Kushdo që prodhon pornografi për fëmijë ose përdor apo përfshin fëmijën për krijimin ose për prodhimin e shfaqjeve të gjalla, dënohet me burgim prej një (1) deri në pesë (5) vjet.
2. Kushdo që shet, shpërndan, promovon, shfaq, transmeton, ofron ose e vë në dispozicion pornografinë për fëmijë, dënohet me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet.
3. Kushdo që siguron për vetveten apo personin tjetër ose posedon pornografi me fëmijë, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet.
4. Tentativa për të kryer vepër penale nga ky nen është e dënueshme.
5. Për qëllime të këtij neni, shprehja "shfaqje e gjallë" nënkupton ekspozimin aktual, përfshirë me anë të mjeteve të informimit dhe teknologjisë së komunikimit, të:
   5.1. një fëmije të përfshirë në sjellje seksualisht eksplicite, qoftë të vërtetë apo të simuluar; ose
   5.2. organeve gjenitale të një fëmije për qëllime kryesisht seksuale.

Neni 239
Keqpërdorimi seksual duke keqpërdorur pozitën, autoritetin apo profesionin

1. Përveç nëse parashihet ndryshe në këtë kapitull, kushdo që e detyron personin tjetër të kryejë akt seksual në një ose më shumë prej rrethanave në vijim, dënohet me burgim prej një (1) deri në pesë (5) vjet:
   1.1. duke keqpërdorur kontrollin e tij mbi gjendjen financiare, familjare, shoqërore, shëndetësore, të punësimit, shkollimit, fetare ose të rrethanave tjera të personit të tillë apo të personit të tretë;
   1.2. kur viktima mbahet në burg, paraburgim, qendër disiplinore, në një institucion të edukimit apo institucion edukativo-korrektues, është pacient në spital, qendër të shëndetit mendor apo rehabilitimit, banor i shtëpisë së kujdesit apo strehimores, ose mbahet apo është i mbyllur në çfarëdo vendi tjetër me urdhër të gjykatës apo prokurorisë ose sipas ligjit; ose
   1.3. duke keqpërdorur pozitën ose autoritetin e tij mbi viktimën, e cila është midis moshës gjashtëmbëdhjetë (16) dhe tetëmbëdhjetë (18) vjet dhe e cila i është besuar kryesit për rritjen, edukimin apo kujdesin.
2. Kushdo që e prek personin tjetër me qëllim seksual ose e cyt personin tjetër të prekë kryesin apo personin e tretë me qëllim seksual në një ose më shumë prej rrethanave në vijim, dënohet me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në tre (3) vjet:
   2.1. duke keqpërdorur kontrollin e tij mbi gjendjen financiare, familjare, shoqërore, shëndetësore, të punësimit, shkollimit, fetare ose të rrethanave tjera të personit të tillë apo të personit të tretë;
   2.2. kur viktima mbahet në burg, paraburgim, qendër disiplinore, në një institucion të edukimit apo institucion edukativo-korrektues, është pacient në spital, qendër të shëndetit mendor apo rehabilitimit, banor i shtëpisë së

kujdesit apo strehimores, ose mbahet apo është i mbyllur në çfarëdo vendi tjetër me urdhër të gjykatës apo prokurorisë ose sipas ligjit; ose

2.3. duke keqpërdorur pozitën ose autoritetin e tij mbi viktimën e cila është midis moshës gjashtëmbëdhjetë (16) dhe tetëmbëdhjetë (18) vjet dhe e cila i është besuar kryesit për rritjen, edukimin apo kujdesin.

3. Kushdo që e cyt personin tjetër që t'i ekspozojë pjesët intime të trupit të personit të tillë, të masturbojë apo të kryejë ndonjë akt tjetër që e degradon integritetin seksual të personit të tillë në një apo më shumë prej rrethanave në vijim, dënohet me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në (5) pesë vjet:

3.1. duke keqpërdorur kontrollin e tij mbi gjendjen financiare, familjare, shoqërore, shëndetësore, të punësimit, shkollimit, fetare ose të rrethanave tjera të personit të tillë apo të personit të tretë;

3.2. kur viktima mbahet në burg, paraburgim, qendër disiplinore, në një institucion të edukimit apo institucion edukativo-korrektues, është pacient në spital, qendër të shëndetit mendor apo rehabilitimit, banor i shtëpisë së kujdesit apo strehimores, ose mbahet apo është i mbyllur në çfarëdo vendi tjetër me urdhër të gjykatës apo prokurorisë ose sipas ligjit; ose

3.3. duke keqpërdorur pozitën ose autoritetin e tij mbi viktimën e cila është midis moshës gjashtëmbëdhjetë (16) dhe tetëmbëdhjetë (18) vjet dhe e cila i është besuar kryesit për rritjen, edukimin apo kujdesin.

Neni 240
Nxitja e akteve seksuale me premtim të rrejshëm të martesës

Kushdo që premton rrejshëm martesën në mënyrë që të nxisë personin i cili është në mes të moshës gjashtëmbëdhjetë (16) dhe tetëmbëdhjetë (18) vjet që të përfshihet në një akt seksual, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet.

Neni 241
Mundësimi ose detyrimi në prostitucion

1. Kushdo që rekruton, organizon, ndihmon ose kontrollon personin tjetër për qëllime të prostitucionit, dënohet me gjobë dhe me burgim deri në tre (3) vjet.
2. Kur vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni kryhet brenda perimetrit prej treqind e pesëdhjetë (350) metrash nga shkolla ose mjedisi tjetër i cili përdoret nga fëmijët, kryesi dënohet me gjobë dhe me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet.
3. Kushdo që me forcë apo kanosje serioze ose duke mbajtur personin tjetër në situatë të varësisë personale apo ekonomike e detyron personin e tillë që të merret me prostitucion, dënohet me gjobë dhe me burgim prej një (1) deri në tetë (8) vjet.
4. Kur vepra penale nga paragrafi 1., 2. ose 3. i këtij neni kryhet kundër personit të moshës mes gjashtëmbëdhjetë (16) dhe tetëmbëdhjetë (18) vjet, kryesi dënohet me gjobë dhe me burgim prej një (1) deri në dhjetë (10) vjet.
5. Kur vepra nga paragrafi 1., 2. ose 3. kryhet kundër personit nën moshën gjashtëmbëdhjetë (16) vjet, kryesi dënohet me gjobë dhe me burgim prej pesë (5) deri në njëzetë (20) vjet.
6. Kur vepra penale nga paragrafi 1., 2. ose 3. i këtij neni kryhet kundër personit nën

moshën katërmbëdhjetë (14) vjet, kryesi dënohet me gjobë dhe me burgim prej jo më pak se dhjetë (10) vjet.

Neni 242
Ofrimi i lokaleve për prostitucion

1. Kushdo që me dijeni ofron lokalin, qoftë si pronar i lokalit, qiradhënës, qiramarrës, shfrytëzues ose person përgjegjës, personit tjetër për qëllim të prostitucionit ose mundësimit të prostitucionit, dënohet me gjobë dhe me burgim deri në tre (3) vjet.
2. Kur vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni kryhet brenda perimetrit prej treqind e pesëdhjetë (350) metrash nga shkolla ose mjedisi tjetër i cili përdoret nga fëmijët, kryesi dënohet me gjobë dhe me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet.
3. Kur vepra penale nga paragrafi 1. ose 2. të këtij neni kryhet për qëllime të prostitucionit ose mundësimit të prostitucionit të një apo më shumë personave që janë midis moshës moshës gjashtëmbëdhjetë (16) dhe tetëmbëdhjetë (18) vjet, kryesi dënohet me gjobë dhe me burgim prej një (1) deri në dhjetë (10) vjet.
4. Kur vepra penale nga paragrafi 1. ose 2. i këtij neni kryhet për qëllime të prostitucionit ose mundësimit të prostitucionit të një ose më shumë personave nën moshën gjashtëmbëdhjetë (16) vjet, kryesi dënohet me gjobë dhe me burgim prej pesë (5) deri në njëzet (20) vjet.
5. Kur vepra penale nga paragrafi 1. ose 2. i këtij neni kryhet për qëllime të prostitucionit ose mundësimit të prostitucionit të një ose më shumë personave nën moshën katërmbëdhjetë (14) vjet, kryesi dënohet me gjobë dhe me burgim prej jo më pak se dhjetë (10) vjet.
6. Për qëllime të këtij neni shprehja "mundësim i prostitucionit" përfshin por nuk kufizohet në rekrutimin, organizimin, ndihmën, kontrollimin, mbajtjen ose fshehjen e personit tjetër për qëllim të prostitucionit.

Neni 243
Marrëdhëniet seksuale brenda familjes

1. Kushdo që kryen akt seksual me paraardhës ose pasardhës të familjes i cili ka mbushur moshën tetëmbëdhjetë (18) vjet ose me vëlla apo motër që ka mbushur moshën tetëmbëdhjetë (18) vjet, dënohet me gjobë ose me burgim prej tre (3) muaj deri në tre (3) vjet.
2. Kur prindi, prindi adoptues, prindi birësues, njerku ose njerka, gjyshi apo gjyshja, daja apo axha, tezja ose halla, kryen akt seksual me fëmijën e tij, me fëmijën e birësuar, me thjeshtrin e tij, me nipin ose me mbesën e vajzës apo të djalit, me nipin ose me mbesën e motrave apo të vëllezërve, mes moshave gjashtëmbëdhjetë (16) dhe tetëmbëdhjetë (18) vjet, dënohet me jo më pak se (3) tre vjet burgim.
3. Kur prindi, prindi adoptues, prindi birësues, njerku ose njerka, gjyshi apo gjyshja, daja apo axha, tezja ose halla, kryen akt seksual me fëmijën e tij, me fëmijën e birësuar, me thjeshtrin e tij, me nipin ose me mbesën e vajzës apo të djalit, me nipin ose me mbesën e motrave apo të vëllezërve, që është në mes të moshës katërmbëdhjetë (14) dhe gjashtëmbëdhjetë (16) vjet, dënohet me jo më pak se pesë (5) vjet burgim.

4. Kur prindi, prindi adoptues, prindi birësues, njerku ose njerka, gjyshi apo gjyshja, daja apo axha, tezja ose halla, kryen akt seksual me fëmijën e tij, me fëmijën e birësuar, me thjeshtrin e tij, me nipin ose me mbesën e vajzës apo të djalit, me nipin ose me mbesën e motrave apo të vëllezërve, nën moshën katërmbëdhjetë (14) vjet, dënohet me jo më pak se dhjetë (10) vjet burgim.
5. Kur vëllai apo motra më e madhe kryen akt seksual me vëllanë apo motrën, me vëllanë ose motrën e adoptuar, me vëllanë apo motrën e birësuar, që është midis moshës gjashtëmbëdhjetë (16) dhe tetëmbëdhjetë (18) vjet, motra apo vëllai më i madh dënohet me dënimin nga paragrafi 2. i këtij neni.
6. Kur vëllai apo motra më e madhe kryen akt seksual me vëllanë apo motrën, me vëllanë ose motrën e adoptuar, me vëllanë apo motrën e birësuar, që është në mes të moshës katërmbëdhjetë (14) dhe gjashtëmbëdhjetë (16) vjet, motra apo vëllai më i madh dënohet me dënimin nga paragrafi 3. i këtij neni.
7. Kur vëllai apo motra më e madhe kryen akt seksual me vëllanë apo motrën, me vëllanë ose motrën e adoptuar, me vëllanë apo motrën e birësuar, që është nën moshën katërmbëdhjetë (14) vjet, motra apo vëllai më i madh dënohet me dënimin nga paragrafi 4. i këtij neni.

KAPITULLI XXI
VEPRAT PENALE KUNDËR MARTESËS DHE FAMILJES

Neni 244
Bigamia

1. Kushdo që lidh martesë tjetër derisa është i martuar, dënohet me burgim deri në një (1) vit.
2. Kushdo që lidh martesë me personin për të cilin e di se është i martuar, dënohet me dënimin nga paragrafi 1. i këtij neni.
3. Nëse pas kryerjes së veprës penale nga ky nen, martesa e mëparshme nuk është më e vlefshme, është prishur ose është ndërprerë, ndjekja penale për veprën nga ky nen nuk fillohet, e nëse ndjekja është filluar duhet të ndërpritet.

Neni 245
Mundësimi i lidhjes së martesës së kundërligjshme

Personi i autorizuar zyrtar para të cilit lidhet martesa, i cili në keqpërdorim të pozitës apo autorizimeve të tij lejon lidhjen e martesës, ndonëse është në dijeni për pengesat ligjore të cilat e ndalojnë martesën, dënohet me burgim prej tre (3) muaj deri në tre (3) vjet.

Neni 246
Martesa e detyruar

1. Kushdo që e detyron personin tjetër të lidh martesë ose lidh martesë me personin për të cilin e di se është detyruar të hyj në martesë, dënohet me burgim prej një (1) deri në tetë (8) vjet.

2. Kur vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni kryhet kundër fëmijës, kryesi dënohet me burgim prej dy (2) deri në dhjetë (10) vjet.
3. Kur vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni kryhet nga prindi, prindi adoptues, kujdestari apo ndonjë person tjetër që ushtron autoritet prindëror ndaj personit në mes të moshës katërmbëdhjetë (14) dhe gjashtëmbëdhjetë (16) vjet, kryesi dënohet me burgim prej pesë (5) deri në dhjetë (10) vjet.
4. Kur vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni kryhet nga prindi, prindi adoptues, kujdestari apo personi tjetër që ushtron autoritet prindëror ndaj personit nën moshën katërmbëdhjetë (14) vjet, kryesi dënohet me burgim së paku pesëmbëdhjetë (15) vjet.
5. Kur vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni kryhet me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore, kryesi dënohet me gjobë dhe me burgim së paku pesë (5) vjet. Kur vepra penale nga paragrafi 2. ose 3. i këtij neni kryhet me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore, kryesi dënohet me gjobë dhe me burgim së paku pesëmbëdhjetë (15) vjet.

Neni 247
Bashkësia jashtëmartesore me personin nën moshën gjashtëmbëdhjetë (16) vjet

1. Personi madhor i cili bashkëjeton në një bashkësi jashtëmartesore me personin në mes të moshës katërmbëdhjetë (14) dhe gjashtëmbëdhjetë (16) vjet, dënohet me burgim prej pesë (5) deri në njëzet (20) vjet.
2. Prindi, prindi adoptues, kujdestari apo ndonjë person tjetër që ushtron autoritet prindëror, që i lejon ose e shtyn personin në mes të moshës katërmbëdhjetë (14) dhe gjashtëmbëdhjetë (16) vjet që të bashkëjetojë në një bashkësi jashtëmartesore me personin tjetër, dënohet me dënimin nga burgim pesë (5) deri në njëzet (20) vjet.
3. Kur vepra penale nga paragrafi 1. ose 2. i këtij neni kryhet ndaj personit nën moshën katërmbëdhjetë (14) vjet, kryesi dënohet me së paku pesëmbëdhjetë (15) vjet burgim.
4. Kur vepra penale nga paragrafi 2. ose 3. i këtij neni kryhet me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore, kryesi dënohet me gjobë dhe me burgim së paku pesëmbëdhjetë (15) vjet.

Neni 248
Ndryshimi i statusit familjar të fëmijës

Kushdo që e zëvendëson një fëmijë me një tjetër ose në ndonjë mënyrë tjetër ndryshon statusin familjar të fëmijës, përveç siç lejohet me ligj, dënohet me burgim prej tre (3) muaj deri në tre (3) vjet.

Neni 249
Marrja apo mbajtja e kundërligjshme e fëmijës

1. Kushdo që në mënyrë të kundërligjshme e merr, mban ose rrëmben fëmijën nga prindi, prindi adoptues, kujdestari apo personi tjetër i cili ushtron të drejtën prindërore mbi fëmijën, ose merr, mban ose rrëmben fëmijën nga enti të cilit i është

besuar fëmija ose pengon ekzekutimin e vendimit të detyrueshëm të organit kompetent mbi dhënien e fëmijës në besim të personit ose entit tjetër, dënohet me burgim deri në tre (3) vjet.

2. Kur kryesi i veprës penale nga paragrafi 1. i këtij neni është prindi, prindi adoptues, kujdestari apo personi tjetër i cili ushtron të drejtën prindërore mbi fëmijën ndaj të cilit organi kompetent ka shqiptuar vendim të detyrueshëm me të cilin i janë mohuar personit të tillë të drejtat prindërore apo të kujdestarisë për fëmijën apo kur organi kompetent ka shqiptuar vendim të detyrueshëm me të cilin edukimi dhe mbikëqyrja e fëmijës i besohet prindit tjetër apo personit tjetër, kryesi dënohet me burgim deri në një (1) vit.
3. Kushdo që kryen veprën penale nga paragrafi 1. i këtij nenit për përfitim material apo për motive tjera të ulëta, dënohet me gjobë dhe me burgim prej një (1) deri në dhjetë (10) vjet.
4. Kur kryesi i veprës penale nga paragrafi 2. i këtij neni vullnetarisht e kthen fëmijën, gjykata mund ta lirojë nga dënimi.

Neni 250
Keqtrajtimi apo braktisja e fëmijës

1. Prindi, prindi adoptues, kujdestari apo personi tjetër që ushtron autoritet prindëror mbi fëmijën, i cili keqtrajton fëmijën e tillë duke përdorur masa fizike apo mendore ose shkel detyrimin e tij për përkujdesje dhe edukim të fëmijës, dënohet me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në tre (3) vjet.
2. Prindi, prindi adoptues, kujdestari apo personi tjetër që ushtron autoritet prindëror mbi fëmijën, i cili keqtrajton fëmijën e tillë duke përdorur masa fizike apo mendore ose shkel detyrimin e tij për përkujdesje dhe edukim të fëmijës me pakujdesi të vetëdijshme, dënohet me burgim prej tre (3) muaj deri në tre (3) vjet.
3. Prindi, prindi adoptues, kujdestari apo personi tjetër që ushtron autoritet prindëror mbi fëmijën, i cili e braktis fëmijën e tillë në një mënyrë që rrezikon jetën e tij apo rrezikon ose dëmton rëndë shëndetin e tij, dënohet me burgim prej një (1) deri në pesë (5) vjet.
4. Prindi, prindi adoptues, kujdestari apo personi tjetër që ushtron autoritet prindëror mbi fëmijën, i cili e detyron fëmijën e tillë të punojë në mënyrë të tepruar ose të kryej punë që nuk është e përshtatshme për moshën e fëmijës ose e detyron fëmijën e tillë që në lëmoshë të lyp para ose dobi tjetër materiale, ose e detyron fëmijën e tillë që të përfshihet në aktivitete që e rrezikojnë apo dëmtojnë zhvillimin e fëmijës, dënohet me gjobë dhe me burgim prej një (1) deri në pesë (5) vjet.
5. Kur vepra penale nga ky nen rezulton me dëmtim të rëndë të shëndetit mendor apo lëndim të rëndë të fëmijës, kryesi dënohet me burgim prej dy (2) deri në tetë (8) vjet.

Neni 251
Shkelja e detyrimeve familjare

1. Kushdo që shkel detyrimet e tij ligjore familjare, duke lënë në gjendje të rëndë anëtarin e familjes i cili nuk është në gjendje të kujdeset për vetën e tij, dënohet me burgim prej tre (3) muaj deri në tre (3) vjet.

2. Kur vepra penale nga paragrafi 1. ka të bëjë me fëmijën, kryesi dënohet me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet.
3. Kur vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni rezulton me vdekjen e anëtarit të familjes apo me dëmtim të rëndë të shëndetit të tij, kryesi dënohet me burgim prej një (1) deri në tetë (8) vjet.
4. Nëse gjykata shqipton dënimin me kusht, ajo mund të urdhërojë si kusht që kryesi të paguajë dhe rregullisht t'i përmbush detyrimet e tij të kujdesit, arsimimit dhe mjeteve të jetesës.

Neni 252
Shmangia nga sigurimi i mjeteve të jetesës

1. Kushdo që i shmanget sigurimit të mjeteve të jetesës për personin për të cilin është i detyruar të kujdeset në bazë të vendimit të plotfuqishëm të gjykatës, marrëveshjes së plotfuqishme gjyqësore ose vendimit të organit tjetër kompetent, me anë të shmangies së punësimit, raportimit të rrejshëm të punësimit apo të të ardhurave, ndërrimit të vendit të punës, ndërrimit të vendbanimit apo vendqëndrimit, tjetërsimit të pasurisë ose në ndonjë mënyrë tjetër i shmanget sigurimit të mjeteve të jetesës për personin e tillë, dënohet me burgim deri në një (1) vit.
2. Kur vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni rezulton me vdekjen e anëtarit të familjes apo me dëmtim të rëndë të shëndetit të tij, kryesi dënohet me burgim prej një (1) deri në tetë (8) vjet.
3. Kur vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni ka të bëjë me fëmijën kryesi dënohet me burgim prej tre (3) muaj deri në tre (3) vjet.
4. Nëse gjykata shqipton dënimin me kusht, ajo mund të urdhërojë si kusht që kryesi rregullisht t'i përmbush detyrimet e tij të sigurimit të mjeteve të jetesës dhe të paguajë detyrimet e papaguara.
5. Nëse kryesi i veprës penale nga paragrafi 1. i këtij neni i përmbush detyrimet para se gjykata të shqiptojë aktgjykimin, gjykata mund ta lirojë nga dënimi.

Neni 253
Pengimi dhe mosekzekutimi i masave për mbrojtjen e fëmijëve

1. Kushdo që nuk e zbaton apo e pengon ekzekutimin e masave edukative dhe masave të tjera të përcaktuara nga gjykata ose nga një organ tjetër kompetent përgjegjës për mbrojtjen e fëmijëve, dënohet me gjobë ose me burgim deri në një (1) vit.
2. Kushdo që si person përgjegjës në punë, në organe apo në ente për mbrojtjen, arsimimin ose aftësimin profesional të fëmijëve, ushtron haptazi detyrat e tij në mënyrë të papërgjegjshme dhe me këtë rrezikon apo dëmton rëndë shëndetin apo zhvillimin e fëmijës, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet.

Neni 254
Mos raportimi i abuzimit të fëmijëve

1. Pavarësisht nga dispozitat tjera ligjore, kushdo që ka arsye për të dyshuar se një fëmijë ka pësuar një incident të abuzimit të fëmijës, keqtrajtimit, braktisjes apo

moskujdesit dhe nuk raporton menjëherë abuzimin ose moskujdesin, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet.
2. Kur vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni kryhet nga prindi, prindi adoptues apo kujdestari, kryesi dënohet me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në tre (3) vjet.
3. Kushdo që gjatë angazhimit profesional lidhur me fëmijën, ka arsye për të dyshuar se fëmija ka pësuar incident të abuzimit të fëmijës, keqtrajtimit, braktisjes apo moskujdesit ose ka qenë i nënshtruar ndaj dhunës apo kanosjes për përdorim të dhunës, dhe nuk e raporton menjëherë rastin, dënohet me gjobë ose me burgim prej tre (3) muaj deri në tre (3) vjet.
4. Kur vepra penale nga paragrafi 1., 2. ose 3. i këtij neni rezulton me vdekjen e fëmijës apo me dëmtim të rëndë të shëndetit të tij, kryesi dënohet me burgim prej një (1) deri në tetë (8) vjet.

KAPITULLI XXII
VEPRAT PENALE KUNDËR SHËNDETIT PUBLIK

Neni 255
Përhapja e sëmundjeve ngjitëse

1. Kushdo që nuk vepron sipas dispozitave apo urdhrave të organit publik kompetent në fushën e shëndetësisë, e cila ka për qëllim parandalimin apo luftimin e sëmundjeve ngjitëse te njerëzit apo kafshët dhe me këtë shkakton përhapjen e sëmundjes ngjitëse te njerëzit, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet.
2. Kushdo që nuk i përmbahet dispozitave apo urdhrave nga paragrafi 1. i këtij neni dhe me këtë shkakton përhapjen e sëmundjeve ngjitëse te kafshët, dënohet me gjobë ose me burgim deri në një (1) vit.
3. Kur vepra penale nga paragrafi 1. ose 2. i këtij neni kryhet nga pakujdesia, kryesi dënohet me gjobë ose me burgim deri në gjashtë (6) muaj.
4. Kur vepra penale nga paragrafi 1. ose 2. i këtij neni rezulton me vdekjen e një apo më shumë personave, kryesi dënohet me burgim prej një (1) deri në dymbëdhjetë (12) vjet.
5. Kur vepra penale nga paragrafi 1. ose 2. i këtij neni rezulton me lëndim të rëndë trupor apo dëmtim të rëndë të shëndetit, kryesi dënohet me burgim prej një (1) deri në tetë (8) vjet.
6. Kur vepra penale nga paragrafi 3. i këtij neni rezulton me lëndim të rëndë trupor apo dëmtim të rëndë të shëndetit, kryesi dënohet me burgim deri në tre (3) vjet.
7. Kur vepra penale nga paragrafi 3. i këtij neni rezulton me vdekjen e një apo më shumë personave, kryesi dënohet me burgim prej një (1) deri në tetë (8) vjet.

Neni 256
Mosveprimi sipas dispozitave shëndetësore gjatë epidemisë

Kushdo që gjatë kohës së epidemisë ose të ndonjë sëmundjeje ngjitëse nuk vepron sipas urdhrave apo vendimeve tjera të nxjerra në bazë të dispozitave të organit kompetent, i cili cakton masat që kanë për qëllim luftimin apo parandalimin e tyre, dënohet me burgim deri në dy (2) vjet.

Neni 257
Përhapja e sëmundjeve venerike

1. Kushdo që duke ditur se është i infektuar me sëmundje seksualisht të transmetueshme, nuk e zbulon këtë fakt dhe e infekton personin tjetër, dënohet me gjobë ose me burgim deri në një (1) vit.
2. Kur vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni rezulton me dëmtim të rëndë të shëndetit, kryesi dënohet me burgim prej një (1) deri në pesë (5) vjet.
3. Kur vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni rezulton me vdekje të personit, kryesi dënohet me burgim prej një (1) deri në tetë (8) vjet.
4. Procedura penale për vepër penale nga ky nen fillohet sipas propozimit.

Neni 258
Përhapja e virusit HIV

1. Kushdo që duke ditur se është i infektuar me HIV, nuk e zbulon këtë fakt dhe infekton personin tjetër, dënohet me burgim prej dy (2) deri në dymbëdhjetë (12) vjet.
2. Kur vepra vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni është kryer nga pakujdesia, kryesi dënohet me burgim prej gjashtë (6) muaj deri pesë (5) vjet.
3. Kur vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni rezulton me vdekjen e personit, kryesi dënohet me burgim prej pesë (5) deri në pesëmbëdhjetë (15) vjet.
4. Kur vepra vepra penale nga paragrafi 2. i këtij neni rezulton me vdekjen e personit kryesi dënohet me burgim prej një (1) deri tetë (8) vjet.

Neni 259
Punësimi i personave të infektuar me sëmundje ngjitëse

1. Kushdo që në kundërshtim me ligjet e shëndetësisë, në spital, në maternitet të spitalit, në shkollë, në restorant apo në punëtori ose në organizatë biznesi apo në ndonjë vend të ngjashëm pune ku përpunohen artikujt ushqimorë apo ku kryhen shërbime higjienike, e punëson apo e mban në punë personin për të cilin e di se lëngon nga sëmundja ngjitëse dhe me këtë shkakton përhapjen e sëmundjes ngjitëse, dënohet me gjobë ose me burgim deri në një (1) vit.
2. Kur vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni kryhet nga pakujdesia, kryesi dënohet me gjobë ose me burgim deri në gjashtë (6) muaj.
3. Kur vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni rezulton me dëmtim të rëndë të shëndetit të tjetrit, kryesi dënohet me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në tre (3) vjet.
4. Kur vepra penale nga paragrafi 2. i këtij neni rezulton me dëmtim të rëndë të shëndetit të tjetrit, kryesi dënohet me burgim deri në tre (3) vjet.
5. Kur vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni rezulton me vdekjen e një apo më shumë personave, kryesi dënohet me burgim prej një (1) deri në dhjetë (10) vjet.
6. Kur vepra penale nga paragrafi 2. i këtij neni rezulton me vdekjen e një apo më shumë personave, kryesi dënohet me burgim prej një (1) deri në pesë (5) vjet.

Neni 260
Trajtimi i pandërgjegjshëm mjekësor

1. Mjeku i cili me rastin e dhënies së ndihmës mjekësore përdor haptas një mjet apo metodë të papërshtatshme të mjekimit ose nuk përdor masat përkatëse higjienike dhe me këtë shkakton keqësimin e gjendjes shëndetësore të personit, dënohet me burgim deri në tre (3) vjet.
2. Punonjësi shëndetësor i cili me rastin e dhënies së ndihmës mjekësore përdor haptas një mjet apo metodë të papërshtatshme të mjekimit ose nuk përdor masat përkatëse higjienike dhe me këtë shkakton keqësimin e gjendjes shëndetësore të personit, dënohet me dënimin nga paragrafi 1. i këtij neni.
3. Kur vepra penale nga paragrafi 1. ose 2. i këtij neni rezulton me dëmtim të rëndë të shëndetit të personit, kryesi dënohet me burgim prej një (1) deri në tetë (8) vjet.
4. Kur vepra penale nga paragrafi 1. ose 2. i këtij neni rezulton me vdekjen e një apo më shumë personave, kryesi dënohet me burgim prej një (1) deri në dymbëdhjetë (12) vjet.

Neni 261
Mosdhënia e ndihmës mjekësore

1. Mjeku ose punonjësi tjetër shëndetësor, i cili në kundërshtim me detyrën e tij refuzon t'i ofrojë ndihmën mjekësore personit të cilit i nevojitet ndihma e tillë, ndonëse ai është i vetëdijshëm ose do duhej të ishte i vetëdijshëm se mosveprimi i tillë mund të rezultojë në lëndim të rëndë trupor apo dëmtim të rëndë të shëndetit ose vdekjen e personit, dënohet me burgim deri në tre (3) vjet.
2. Kur vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni rezulton me lëndim të rëndë trupor ose me dëmtim të rëndë të shëndetit të personit të cilit nuk iu është dhënë ndihma mjekësore, kryesi dënohet me burgim prej tre (3) muaj deri në tre (3) vjet.
3. Kur vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni rezulton me vdekjen e personit të cilit nuk iu është dhënë ndihma mjekësore, kryesi dënohet me burgim prej një (1) deri në tetë (8) vjet.

Neni 262
Ushtrimi i kundërligjshëm i veprimtarisë mjekësore ose farmaceutike

1. Kushdo që pa pasur kualifikimet profesionale apo autorizimet ligjore, kryen trajtime mjekësore, shërbime farmaceutike ose angazhohet në aktivitete tjera mjekësore për të cilat me ligj kërkohen kualifikime të posaçme, dënohet me gjobë ose me burgim deri në një (1) vit.
2. Kur vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni rezulton me lëndim të rëndë trupor ose me dëmtim të rëndë të shëndetit të personit, kryesi dënohet me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet.
3. Kur vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni rezulton me vdekjen e një apo më shumë personave, kryesi dënohet me burgim prej një (1) deri në dymbëdhjetë (12) vjet.

Neni 263
Eksperimentet e kundërligjshme mjekësore dhe testimi i barërave

1. Kushdo që pa autorizim ose në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm kryen eksperimente mjekësore, eksperimente të klonimit të njeriut apo eksperimente të ngjashme në njerëz, dënohet me burgim prej tre (3) muaj deri në pesë (5) vjet.
2. Kushdo që pa autorizim ose në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm kryen testime klinike të barërave, dënohet me burgim prej tre (3) muaj deri në tre (3) vjet.

Neni 264
Përgatitja dhe dhënia e pandërgjegjshme e barërave

1. Farmacisti apo personi tjetër që është i autorizuar të përgatisë apo të shpërndajë barëra, i cili i përgatit barërat në kundërshtim me standardet profesionale apo jep barëra në mënyrë të gabuar dhe me këtë rrezikon shëndetin apo jetën e personit, dënohet me gjobë ose me burgim deri në një (1) vit.
2. Kur vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni kryhet nga pakujdesia, kryesi dënohet me gjobë ose me burgim deri në gjashtë (6) muaj.
3. Kur vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni rezulton me lëndime të rënda trupore ose me dëmtim të rëndë të shëndetit, kryesi dënohet me burgim prej një (1) deri në tetë (8) vjet.
4. Kur vepra penale nga paragrafi 2. i këtij neni rezulton me lëndime të rënda trupore ose me dëmtim të rëndë të shëndetit, kryesi dënohet me burgim deri në tre (3) vjet.
5. Kur vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni rezulton me vdekjen e një apo më shumë personave, kryesi dënohet me burgim prej një (1) deri në dymbëdhjetë (12) vjet.
6. Kur vepra penale nga paragrafi 2. i këtij neni rezulton me vdekjen e një apo më shumë personave, kryesi dënohet me burgim prej një (1) deri në tetë (8) vjet.
7. Barërat e përgatitura sipas paragrafit 1. të këtij neni, konfiskohen.

Neni 265
Transplantimi i kundërligjshëm dhe trafikimi i organeve dhe qelizave njerëzore

1. Kushdo që pa arsye mjekësore, pa autorizim ose në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm, për qëllim transplantimi merr pjesë të trupit të njeriut me pëlqimin e dhënësit, dënohet me gjobë dhe me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet.
2. Kushdo që pa arsye mjekësore, pa autorizim ose në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm, transplanton pjesë të trupit të njeriut me pëlqimin e marrësit, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet.
3. Kur vepra penale nga paragrafi 1. ose 2. i këtij neni kryhet pa pëlqimin e dhënësit apo pa pëlqimin e marrësit, kryesi dënohet me gjobë dhe me burgim prej një (1) deri në tetë (8) vjet.
4. Kushdo që pa autorizim ose në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm, për qëllim transplantimi merr pjesë të trupit të personit të vdekur, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet.

5. Kushdo që pa autorizim ose në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm, posedon, blen, ndërmjetëson në blerje, shet, transporton, importon ose eksporton organe apo qeliza njerëzore për qëllim të transplantimit, dënohet më gjobë dhe me burgim prej dy (2) deri në dymbëdhjetë (12) vjet.
6. Kushdo që për shpërblim ose përfitime tjera, vepron si ndërmjetësues për të siguruar një trup apo pjesë të trupit të një personi tjetër të gjallë apo të vdekur, për qëllim të transplantimit, dënohet me gjobë ose me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në dy (2) vjet.
7. Nëse vepra penale nga paragrafi 1. ose 2. i këtij neni kryhet nga mjeku, kryesi dënohet me burgim prej një (1) deri në tetë (8) vjet.
8. Nëse vepra penale nga paragrafi 3. i këtij neni kryhet nga mjeku, kryesi dënohet me burgim prej tre (3) deri në dymbëdhjetë (12) vjet.

Neni 266
Prodhimi dhe shpërndarja e produkteve të dëmshme mjekësore

1. Kushdo që prodhon barëra të falsifikuara apo të dëmshme ose produkte tjera mjekësore të cilat janë të dëmshme për shëndetin, me qëllim që t'i shesë ato apo në ndonjë mënyrë tjetër t'i vë në qarkullim, dënohet me gjobë dhe me burgim deri në tre (3) vjet.
2. Kushdo që vë në qarkullim barërat ose produktet mjekësore pa u bërë kontrolli i nevojshëm nga personi apo enti i autorizuar, ose i vë në qarkullim ato pas datës së skadimit, dënohet me burgim deri në tre (3) vjet.
3. Kur vepra penale nga paragrafi 1. ose 2. i këtij neni kryhet nga pakujdesia, kryesi dënohet me gjobë dhe me burgim deri në dy (2) vjet.
4. Kur vepra penale nga paragrafi 1. ose 2. i këtij neni rezulton me lëndim të rëndë trupor ose me dëmtim të rëndë të shëndetit, kryesi dënohet me burgim prej një (1) deri në tetë (8) vjet.
5. Kur vepra penale nga paragrafi 3. i këtij neni rezulton me lëndim të rëndë trupor ose me dëmtim të rëndë të shëndetit, kryesi dënohet me burgim deri në tre (3) vjet.
6. Kur vepra penale nga paragrafi 1. ose 2. i këtij neni rezulton me vdekjen e një apo më shumë personave, kryesi dënohet me burgim prej një (1) deri në dymbëdhjetë (12) vjet.
7. Kur vepra penale nga paragrafi 3. i këtij neni rezulton me vdekjen e një apo më shumë personave, kryesi dënohet me burgim prej një (1) deri në tetë (8) vjet.
8. Produktet mjekësore dhe mjetet e prodhimit sipas këtij neni, konfiskohen.

Neni 267
Prodhimi dhe vënia në qarkullim e artikujve të dëmshëm ushqimor

1. Kushdo që prodhon me qëllim të shitjes, shet, ofron për shitje apo në ndonjë mënyrë tjetër vë në qarkullim artikuj ushqimor, pije apo produkte të tjera për të cilat kryesi e di se janë të dëmshme për shëndetin e njerëzve, dënohet me gjobë dhe me burgim prej tre (3) muaj deri në tre (3) vjet.
2. Kushdo që vë në qarkullim artikuj ushqimor ose pije pa u bërë kontrolli i nevojshëm nga personi apo enti i autorizuar, ose i vë në qarkullim artikujt pas datës së skadimit, dënohet me burgim deri në dy (2) vjet.

3. Kur vepra penale nga paragrafi 1. ose 2. i këtij neni kryhet nga pakujdesia, kryesi dënohet me gjobë ose me burgim deri në gjashtë (6) muaj.
4. Kur vepra penale nga paragrafi 1. ose 2. i këtij neni rezulton me lëndim të rëndë trupor ose me dëmtim të rëndë të shëndetit të ndonjë personi, kryesi dënohet me burgim prej një (1) deri në tetë (8) vjet.
5. Kur vepra penale nga paragrafi 3. i këtij neni rezulton me lëndim të rëndë trupor ose me dëmtim të rëndë të shëndetit të ndonjë personi, kryesi dënohet me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet.
6. Kur vepra penale nga paragrafi 1. ose 2. i këtij neni rezulton me vdekjen e një apo më shumë personave, kryesi dënohet me burgim prej një (1) deri në dymbëdhjetë (12) vjet.
7. Kur vepra penale nga paragrafi 3. i këtij neni rezulton me vdekjen e një apo më shumë personave, kryesi dënohet me burgim prej një (1) deri në tetë (8) vjet.
8. Artikujt dhe sendet e dëmshme konfiskohen.

Neni 268
Kontrolli i papërgjegjshëm i produkteve shtazore të destinuara për konsumim

1. Veterinari ose personi tjetër i autorizuar i cili gjatë kontrollit të kafshëve të destinuara për therje apo të mishit të destinuar për konsumim, vepron në kundërshtim me standardet profesionale ose në kundërshtim me dispozitat në fuqi të standardeve të praktikës veterinare ose nuk e kryen kontrollin dhe me këtë mundëson që të vihet në qarkullim mishi apo artikujt tjerë të dëmshëm për shëndetin e njerëzve, dënohet me burgim deri në tre (3) vjet.
2. Kur vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni kryhet nga pakujdesia, kryesi dënohet me gjobë ose me burgim deri në një (1) vit.
3. Kur vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni rezulton me lëndim të rëndë trupor ose me dëmtim të rëndë të shëndetit të ndonjë personi, kryesi dënohet me burgim prej një (1) deri në tetë (8) vjet.
4. Kur vepra penale nga paragrafi 2. i këtij neni rezulton me lëndim të rëndë trupor ose me dëmtim të rëndë të shëndetit të ndonjë personi, kryesi dënohet me burgim deri në tre (3) vjet.
5. Kur vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni rezulton me vdekjen e një apo më shumë personave, kryesi dënohet me burgim prej një (1) deri në dymbëdhjetë (12) vjet.
6. Kur vepra penale nga paragrafi 2. i këtij neni rezulton me vdekjen e një apo më shumë personave, kryesi dënohet me burgim prej një (1) deri në tetë (8) vjet.

Neni 269
Dhënia ose përdorimi i certifikatës së rreme të mjekut apo të veterinarit

1. Mjeku i cili lëshon certifikatë të rreme mjekësore ose veterinari i cili lëshon certifikatë të rreme veterinare, ndonëse ai e di se ajo është e rreme, dënohet me gjobë ose me burgim deri në një (1) vit.
2. Kushdo që përdor certifikatë të rreme mjekësore apo veterinare, ndonëse e di se është e rreme, dënohet me gjobë ose me burgim deri në gjashtë (6) muaj.

Neni 270
Ndotja e ujit të pijshëm

1. Kushdo që me ndonjë materie të dëmshme e ndot ujin të cilin njerëzit e përdorin si ujë të pijshëm dhe kështu rrezikon jetën apo shëndetin e njerëzve, dënohet me burgim deri në tre (3) vjet.
2. Kur vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni kryhet nga pakujdesia, kryesi dënohet me gjobë ose me burgim deri në një (1) vit.
3. Kur vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni rezulton me lëndim të rëndë trupor ose me dëmtim të rëndë të shëndetit, kryesi dënohet me burgim deri në tetë (8) vjet.
4. Kur vepra penale nga paragrafi 2. i këtij neni rezulton me lëndim të rëndë trupor ose me dëmtim të rëndë të shëndetit, kryesi dënohet me burgim deri në tre (3) vjet.
5. Kur vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni rezulton me vdekjen e një apo më shumë personave, kryesi dënohet me burgim prej një (1) deri në dymbëdhjetë (12) vjet.
6. Kur vepra penale nga paragrafi 2. i këtij neni rezulton me vdekjen e një apo më shumë personave, kryesi dënohet me burgim prej një (1) deri në tetë (8) vjet.

Neni 271
Ndotja e artikujve ushqimorë që përdoren nga njerëzit apo kafshët

1. Kushdo që me ndonjë materie të dëmshme i ndot artikujt ushqimorë që përdoren nga njerëzit apo kafshët dhe kështu rrezikon jetën apo shëndetin e njerëzve, dënohet me burgim deri në tre (3) vjet.
2. Kur vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni kryhet nga pakujdesia, kryesi dënohet me gjobë ose me burgim deri në një (1) vit.
3. Kur vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni rezulton me lëndim të rëndë trupor ose me dëmtim të rëndë të shëndetit të një apo më shumë personave, kryesi dënohet me burgim deri në tetë (8) vjet.
4. Kur vepra penale nga paragrafi 2. i këtij neni rezulton me lëndim të rëndë trupor ose me dëmtim të rëndë të shëndetit të një apo më shumë personave, kryesi dënohet me burgim deri në tre (3) vjet.
5. Kur vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni rezulton me vdekjen e një apo më shumë personave, kryesi dënohet me burgim prej së paku dhjetë (10) vjet.
6. Kur vepra penale nga paragrafi 2. i këtij neni rezulton me vdekjen e një apo më shumë personave, kryesi dënohet me burgim prej një (1) deri në tetë (8) vjet.
7. Kushdo që me ndonjë materie të dëmshme e ndot ushqimin e kafshëve të cilat janë të destinuara për konsumim nga njerëzit dhe kështu rrezikon jetën apo shëndetin e njerëzve, dënohet me gjobë ose me burgim prej tre (3) muaj deri në një (1) vit.
8. Kur vepra penale nga paragrafi 5. i këtij neni rezulton me ngordhjen e kafshëve në vlerë që tejkalon pesëmijë (5.000) Euro ose me ngordhjen e një numri të madh të kafshëve, kryesi dënohet me burgim deri në tre (3) vjet.

Neni 272
Shërbimi me pije alkoolike i personave nën moshën gjashtëmbëdhjetë vjet

1. Kushdo që në lokalin hotelier, në bar apo në ndonjë dyqan tjetër ku shiten pije alkoolike, e shërben me pije alkoolike personin nën moshën gjashtëmbëdhjetë (16) vjet, dënohet me gjobë ose me burgim deri në gjashtë (6) muaj.
2. Kur vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni kryhet nga pakujdesia, kryesi dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre (3) muaj.

KAPITULLI XXIII
VEPRAT PENALE TË NARKOTIKËVE

Neni 273
Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge

1. Kushdo që pa autorizim blen ose posedon me qëllim të shitjes apo shpërndarjes, ose ofron për shitje substanca apo preparate të cilat janë shpallur me ligj si narkotikë, substanca psikotrope apo substanca analoge, dënohet me gjobë dhe me burgim prej dy (2) deri në tetë (8) vjet.
2. Kushdo që pa autorizim shpërndan, shet, transporton, dorëzon, ndërmjetëson, dërgon ose dërgon në transit substanca apo preparate të cilat janë shpallur me ligj si narkotikë, substanca psikotrope ose substanca analoge, me qëllim të shpërndarjes, shitjes ose ofrimit për shitje, dënohet me gjobë dhe me burgim prej dy (2) deri në dymbëdhjetë (12) vjet.
3. Kushdo që pa autorizim eksporton ose importon substanca apo preparate të cilat janë shpallur me ligj si narkotikë, substanca psikotrope ose substanca analoge, dënohet me gjobë dhe me burgim prej tre (3) deri në dhjetë (10) vjet.
4. Për qëllime të këtij kapitulli, shprehja "analog" nënkupton çfarëdo substance e cila nuk është e autorizuar dhe struktura kimike e së cilës është esencialisht e ngjashme me atë të substancave apo preparateve që janë shpallur si narkotikë ose substanca psikotrope dhe efektet e të cilave i riprodhon.
5. Substancat narkotike, substancat psikotrope ose substancat analoge dhe mjetet për prodhimin, shpërndarjen apo transportimin e tyre konfiskohen.

Neni 274
Prodhimi dhe përpunimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope, analoge apo veglave, pajisjeve apo materialeve narkotike

1. Kushdo që pa autorizim prodhon, kultivon, përpunon, nxjerr ose përgatit substanca apo preparate që janë shpallur si narkotikë ose substanca psikotrope, dënohet me gjobë dhe me burgim prej një (1) deri në dhjetë (10) vjet.
2. Kushdo që pa autorizim prodhon, kultivon, përpunon, shet ose ofron për shitje substancën analoge, dënohet me gjobë dhe me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në tre (3) vjet.
3. Kushdo qe prodhon, transporton ose shpërndan preparate duke e ditur se ato do të

përdoren për prodhim ose përpunim të paautorizuar të narkotikëve apo substancave psikotrope, dënohet me burgim prej dy (2) deri në dhjetë (10) vjet.

4. Kushdo që pa autorizim prodhon, transporton, shpërndan, shet ose furnizon me vegla, pajisje apo materiale narkotike, duke ditur se këto janë përdorë ose do të përdoren për kultivim, prodhim, përpunim, trafikim apo përdorim të paautorizuar të çfarëdo substance ose preparati të cilat janë shpallur si narkotikë, substanca psikotrope apo analoge, dënohet me gjobë dhe me burgim prej një (1) deri në dhjetë (10) vjet.
5. Substancat narkotike, substancat psikotrope ose substancat analoge dhe mjetet për prodhimin, shpërndarjen apo transportimin e tyre konfiskohen.

Neni 275
Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge

1. Kushdo që pa autorizim posedon narkotikë, substanca psikotrope apo analoge, dënohet me gjobë dhe me burgim prej një (1) deri në tre (3) vjet.
2. Kryesi që kryen veprën nga paragrafi 1. i këtij neni për herë të parë dhe i cili posedon më pak se tre (3) gram të substancave narkotike apo substancave psikotropike ose analoge dënohet me gjobë ose me burgim deri në një (1) vit.
3. Substancat narkotike, substancat psikotrope ose substancat analoge konfiskohen.

Neni 276
Intoksikimi i personit tjetër me narkotikë ose substanca psikotrope

Kushdo që e intoksikon personin tjetër me narkotikë, substanca psikotrope apo substanca analoge pa dijeninë e personit të tillë, dënohet me burgim prej një (1) deri në pesë (5) vjet.

Neni 277
Lehtësimi i sigurimit apo përdorimit të narkotikëve, substancave psikotrope apo analoge

1. Kushdo që administron me narkotikë, me substanca psikotrope apo analoge dhe për shkak të detyrës që ka, lehtëson sigurimin ose përdorimin e tyre në kundërshtim me ligjin, dënohet me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet.
2. Drejtuesi ose pronari i lokalit apo i hapësirës tjetër të mbyllur që përdoret nga publiku, i cili lejon apo toleron përdorimin e narkotikëve, substancave psikotrope ose substancave analoge, dënohet me burgim prej tre (3) muaj deri në pesë (5) vjet.

Neni 278
Kultivimi i bimës së hashashit, shkurres së kokainës ose bimëve të kanabisit

1. Kushdo që pa autorizim kultivon bimën e hashashit, shkurren e kokainës ose bimën e kanabisit me qëllim të prodhimit të narkotikeve ose substancave psikotropike, dënohet me burgim prej një (1) deri në dhjetë (10) vjet.
2. Bima e hashashit, shkurrja e kokainës ose bima e kanabisit dhe furnizimet, pajisjet dhe materialet për kultivimin e tyre konfiskohen.

Neni 279
Organizimi, drejtimi apo financimi i trafikimit të narkotikëve apo substancave psikotrope

1. Kushdo që organizon, drejton apo financon ndonjë prej veprave penale nga ky Kapitull, dënohet me burgim prej dy (2) deri në dhjetë (10) vjet.
2. Kur vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni përfshin sasi të madhe të narkotikëve apo substancave psikotrope, kryesi dënohet me burgim prej tre (3) deri në pesëmbëdhjetë (15) vjet.

Neni 280
Konvertimi apo transferimi i pasurisë që rrjedh nga veprat penale nga ky kapitull

1. Kushdo që e konverton apo transferon pasurinë, duke e ditur se pasuria e tillë rrjedh nga kryerja e cilësdo vepre penale nga ky Kapitull ose nga pjesëmarrja në veprën apo veprat e tilla, dhe konvertimi apo transferimi i tillë bëhet për qëllim të fshehjes ose mbulimit të origjinës së paligjshme të pasurisë apo të ofrimit të ndihmës personit i cili është i përfshirë në kryerjen e veprës apo veprave të tilla për t'iu shmangur pasojave juridike të veprimeve të tij, dënohet me gjobë tre herë më të lartë se vlera e pasurisë së transferuar apo konvertuar dhe me burgim deri në dhjetë (10) vjet.
2. Pasuria e konvertuar apo e transferuar konfiskohet.

Neni 281
Dënimi për raste të rënda të veprave penale nga ky Kapitull

1. Nëse vepra penale nga nenet 273, 274, 275, 276 ose 278 të këtij Kodi kryhet në një ose më shumë nga rrethanat në vijim, kryesi dënohet me gjobë dhe me burgim prej tre (3) deri në pesëmbëdhjetë (15) vjet, nëse:
   1.1. kryesi vepron si anëtar i grupit;
   1.2. kryesi është person zyrtar në keqpërdorim të pozitës apo autorizimeve të tij;
   1.3. kryesi përdor ose kanos se do ta përdorë dhunën ose armën;
   1.4. vepra kryhet në dëm ose duke e shfrytëzuar viktimën e ndjeshme;
   1.5. dërgesa, ngarkesa, kontejneri ose mjeti i planifikuar për një operacion humanitar është përdorur për transportimin e paligjshëm të narkotikëve, substancave psikotrope ose substancave analoge;
   1.6. personi ka përzier substancat narkotike, substancat psikotrope ose substancat analoge me substanca të tjera të cilat e shtojnë rrezikun për shëndetin;
   1.7. vepra është kryer brenda perimetrit prej treqind e pesëdhjetë (350) metrash nga shkolla apo mjedisi tjetër që përdoret nga fëmijët ose brenda perimetrit prej treqind e pesëdhjetë (350) metrash nga cilido institucion i edukimit;
   1.8. vepra penale kryhet brenda institucionit korrektues;
   1.9. vepra penale përfshin sasi të mëdha të narkotikëve, substancave psikotrope ose substancave analoge.
2. Substancat narkotike, substancat psikotrope ose substancat analoge dhe mjetet për prodhimin, shpërndarjen apo transportimin e tyre konfiskohen.

Neni 282
Kompensimi ndaj zbatuesve të ligjit

Kur personi dënohet për ndonjë vepër penale nga ky Kod, gjykata mund ta urdhërojë personin e dënuar që të bëjë kompensimin e cilësdo agjenci për zbatimin e ligjit, për shpenzimet e arsyeshme të bëra nga agjencia përkatëse në blerjen e narkotikëve ose substancave psikotrope nga ai person ose nga agjenti i tij si pjesë e hetimit që shpie në dënimin e tij.

KAPITULLI XXIV
KRIMI I ORGANIZUAR

Neni 283
Pjesëmarrja ose organizimi i grupit kriminal të organizuar

1. Kushdo që me dashje dhe me dijeni qoftë të qëllimit dhe veprimtarisë së përgjithshme të grupit kriminal të organizuar ose qëllimit të grupit për të kryer një apo më shumë vepra penale të cilat janë të dënueshme me burgim prej së paku katër (4) vjet, aktivisht merr pjesë në veprimtaritë kriminale të grupit duke ditur se pjesëmarrja e tillë do të kontribuojë në realizimin e veprimtarive kriminale të grupit, dënohet me gjobë deri në dyqind e pesëdhjetë mijë (250.000) Euro dhe me burgim prej së paku shtatë (7) vjet.
2. Kushdo që organizon, themelon, mbikëqyr, menaxhon ose drejton veprimtaritë e grupit kriminal të organizuar, dënohet me gjobë deri në pesëqind mijë (500.000) Euro dhe me burgim prej së paku dhjetë (10) vjet.
3. Kur veprimtaritë e grupit kriminal të organizuar të parapara në paragrafin 1. ose 2. të këtij neni rezultojnë në vdekje, kryesi dënohet me gjobë deri në pesëqind mijë (500.000) Euro dhe me burgim prej së paku dhjetë (10) vjet ose me burgim të përjetshëm.
4. Gjykata mund të zbusë dënimin e anëtarit të grupit kriminal të organizuar i cili, para se grupi kriminal i organizuar të ketë kryer veprën penale, raporton në polici ose prokurori, ekzistimin, formacionin dhe jep informata për grupin kriminal të organizuar në detaje të mjaftueshme për të mundësuar arrestimin apo ndjekjen e grupit të tillë.
5. Për qëllime të këtij neni, "aktivisht merr pjesë" përfshin, por nuk kufizohet në ofrimin e informatave ose mjeteve materiale, rekrutimin e anëtarëve të rinj dhe të gjitha format e financimit të veprimtarive të grupit.

KAPITULLI XXV
VEPRAT PENALE KUNDËR EKONOMISË

Neni 284
Cenimi i barazisë në ushtrimin e veprimtarisë ekonomike

Personi zyrtar i cili duke keqpërdorur detyrën zyrtare apo autorizimet e tij, kufizon qarkullimin e lirë të kapitalit, njerëzve, mallrave, shërbimeve, punës apo mjeteve të

riprodhimit në territorin e Republikës së Kosovës, ose mohon apo kufizon të drejtën e organizatës së biznesit apo të personit juridik që në territorin e Republikës së Kosovës të merret me qarkullimin e mallit apo të shërbimeve, ose e vë organizatën e biznesit apo personin juridik në pozitë të pabarabartë ndaj organizatës së biznesit ose personit tjetër juridik lidhur me kushtet për punë apo qarkullimin e mallit apo të shërbimeve, ose e kufizon këmbimin e lirë të mallit ose të shërbimeve dhe me këtë realizohet fitim i konsiderueshëm për atë organizatë të biznesit ose person juridik ose shkaktohet dëm i konsiderueshëm për tjetrin, dënohet me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet.

Neni 285
Veprimtaria e pandërgjegjshme ekonomike

1. Personi përgjegjës i cili duke shkelur me dashje ligjin apo dispozitën tjetër të afarizmit, vepron në kundërshtim me standardet e rregullta të afarizmit dhe me këtë i shkakton dëm substancial material organizatës së biznesit apo personit juridik, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet.
2. Kur vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni rezulton me likuidim të detyrueshëm ose falimentim të asaj organizate të biznesit apo të personit juridik, kryesi dënohet me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet.

Neni 286
Shkaktimi i falimentimit

1. Kushdo që duke ditur borxhin e tepërt ose insolvencën aktuale apo të pashmangshme, përfshihet në një apo më shumë nga veprimtaritë në vijim, dënohet me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet, nëse:
   1.1. fsheh apo deformon ose në ndonjë mënyrë tjetër në kundërshtim me standardet e rregullta të afarizmit, e shkatërron, dëmton ose e bën të pashfrytëzueshëm ndonjë aset, i cili në rast të procedurave të insolvencës do ti takonte pronës falimentuese;
   1.2. në ndonjë mënyrë në kundërshtim me standardet e rregullta të afarizmit, hyn në sipërmarrje humbëse apo spekulative ose këmbime të mallrave apo letrave me vlerë ose konsumon shuma të tepërta ose bëhet debitor për shkak të shpenzimeve joekonomike, bixhozit ose vënies së basteve;
   1.3. prokuron mallra, shërbime apo kredi, ndërmerr veprimtari ekonomike të cilat krijojnë borxh tepër të madh, konkludon ose rinovon kontrata të paarsyeshme, nuk i mbledh borxhet që i kanë të tjerët, nuk i zbaton kërkesat me kohë dhe/ose i tjetërson mallrat apo shërbimet, letrat me vlerë apo gjërat e prodhuara nga këto të mira dukshëm nën vlerën e tyre në kundërshtim me standardet e rregullta të afarizmit;
   1.4. simulon ekzistimin e të drejtave të tjetrit ose me dijeni i njeh të drejtat e fabrikuara;
   1.5. nuk mban librat e kontabilitetit, të cilat me ligj është i detyruar t'i mbajë, ose i mban apo i modifikon ashtu që analizimi apo auditimi i aseteve neto të jetë më i vështirë;

1.6. deformon, fsheh, shkatërron ose dëmton librat e kontabilitetit apo dokumentacionin tjetër me qëllim që të bëjë analizimin apo auditimin e aseteve neto më të vështirë, të fsheh asetet apo të mashtrojë ndonjë person;
1.7. zvogëlon asetet neto ose fsheh marrëdhëniet aktuale të afarizmit në ndonjë mënyrë tjetër që është dukshëm në kundërshtim me standardet e rregullta të afarizmit;
1.8. merr përsipër detyrime të tepërta; ose
1.9. konkludon ose rinovon kontrata të paarsyeshme me subjekte insolvente.

2. Vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni dënohet vetëm nëse likuidimi i detyrueshëm ose procedura e falimentimit janë filluar.
3. Nëse vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni kryhet nga pakujdesia, kryesi dënohet me burgim deri në tre (3) vjet.

Neni 287
Shkaktimi i falimentimit të rrejshëm

1. Kushdo që përfshihet në një nga veprimet e mëposhtme me qëllim që të mos paguajë atë që është i detyruar të paguajë, ose me qëllim që të mashtrojë ose duke mashtruar ndonjë kreditor apo debitor, dënohet me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet:
   1.1. fsheh tërë pasurinë apo një pjesë të pasurisë së subjektit, kryen shitje të rrejshme, e shet nën vlerën e tregut ose ia transferon personit tjetër si kompensim;
   1.2. hyn në kontrata të rrejshme apo fiktive të borxhit; ose
   1.3. fsheh, shkatërron ose ndryshon librat e kontabilitetit të cilat është i detyruar me ligj që ti mbajë, ashtu që rezultati i veprimtarisë së tij ose gjendja e aseteve apo detyrimeve nuk mund të vërtetohet, ose përmes dokumenteve të rrejshme apo në ndonjë mënyrë tjetër krijon një situatë të tillë ku mund të realizohet falimentimi.
2. Veprat penale nga paragrafi 1. i këtij neni dënohen vetëm nëse likuidimi i detyrueshëm ose procedurat e falimentimit janë filluar.
3. Nëse vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni rezulton me humbje mbi pesëmbëdhjetëmijë (15.000) Euro për kreditorin, kryesi dënohet me burgim prej një (1) deri në dhjetë (10) vjet.

Neni 288
Mashtrimi në procedurën e falimentimit

1. Kushdo që lidhur me procedurën e falimentimit, përfshihet në një apo më shumë nga veprimtaritë në vijim me administratorin apo personin i cili vepron në cilësi të administratorit, dënohet me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet, nëse:
   1.1. paraqet deklaratë, dokument apo kërkesë të rrejshme, ose jep dëshmi të rrejshme;
   1.2. me dijeni dhe me mashtrim transferon, fsheh ose nuk ia kalon ndonjë pasuri apo dokument administratorit apo personit i cili vepron në cilësi të administratorit;

1.3. me dijeni dhe me mashtrim jep, ofron, pranon apo tenton të përfiton para, pasuri, pagesë, kompensim, shpërblim, përparësi apo premtim për një veprim ose shmangie nga veprimi në mënyrë që të përfitojë ndonjë përparësi në procedurën e falimentimit; ose

1.4. me dijeni dhe pa autorizim nga administratori i pronës, shet, pranon, vjedh, përvetëson, shkatërron, përdhosë ose blen, qoftë në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, ndonjë letër apo pasuri të pronës.

Neni 289
Mashtrimi ose dëmtimi i kreditorëve apo debitorëve

1. Kushdo që duke ditur borxhin e tepërt ose insolvencën aktuale apo të pashmangshme, vë një kreditor apo debitor në pozitë më të favorshme përmes pagesës së borxheve apo në ndonjë mënyrë tjetër dhe me këtë shkakton dëme prej më tepër se pesëmijë (5.000) Euro ose rezulton në humbje të kreditorëve tjerë prej më tepër se pesëmijë (5.000) Euro, dënohet me burgim deri në tre (3) vjet.
2. Kushdo që për të mashtruar ose shkaktuar dëm ndonjë kreditori apo debitori, pranon një kërkesë të rrejshme, lidhë kontrata të rrejshme ose kryen ndonjë veprim tjetër mashtrues me të cilin dëmton ndonjë kreditor apo debitor, dënohet me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet.
3. Kur vepra penale nga paragrafi 1. ose 2. i këtij neni rezulton me dëm që tejkalon dyqind e pesëdhjetëmijë (250.000) Euro ose rezulton me humbje që tejkalon dyqind e pesëdhjetëmijë (250.000) Euro, ose kur si rezultat i kësaj i dëmtuari detyrohet ti nënshtrohet procedurës së riorganizimit ose falimentimit, kryesi dënohet me burgim prej një (1) deri në dhjetë (10) vjet.

Neni 290
Keqpërdorimi i autorizimeve ekonomike

1. Personi përgjegjës që gjatë ushtrimit të veprimtarisë ekonomike kryen një nga veprimet në vijim me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për vete apo për ndonjë person tjetër, dënohet me gjobë dhe me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet:
   1.1. krijon apo mban fonde të palejuara në Republikën e Kosovës ose në ndonjë juridiksion tjetër;
   1.2. përmes përpilimit të dokumenteve me përmbajtje të rreme, me bilance të rreme, me vlerësime të rreme, inventarizim apo me prezantim tjetër të rremë ose përmes fshehjes së provave në mënyrë të rreme e prezanton qarkullimin e aseteve ose të rezultateve të veprimtarisë ekonomike dhe në këtë mënyrë i vë në lajthim organet drejtuese në organizatën e biznesit gjatë vendimmarrjes lidhur me veprimtaritë menaxhuese;
   1.3. nuk i paguan detyrimet tatimore ose detyrimet e tjera fiskale të parapara me ligj;
   1.4. mjetet me të cilat disponon i shfrytëzon në kundërshtim me qëllimin e tyre të paraparë; ose
   1.5. në ndonjë mënyrë tjetër e shkel ligjin apo rregullat e veprimtarisë afariste lidhur me tjetërsimin, përdorimin apo menaxhimin e pasurisë.

2. Kur vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni rezulton në dobi pasurore që tejkalon njëqindmijë (100.000) Euro, kryesi dënohet me burgim prej një (1) deri në tetë (8) vjet.

Neni 291
Lidhja e kontratës së dëmshme

1. Personi përgjegjës i cili ushtron veprimtari ekonomike që lidh kontratë për të cilën e di se është e dëmshme për organizatën e biznesit apo që lidh kontratë në kundërshtim me autorizimet e tij dhe me këtë i shkakton dëm organizatës së biznesit, dënohet me burgim prej tre (3) muaj deri në tre (3) vjet.
2. Kur kryesi i veprës nga paragrafi 1. i këtij neni merr ryshfet ose shkakton dëm në shumën që tejkalon njëqindmijë (100.000) Euro, kryesi dënohet me burgim prej një (1) deri në dhjetë (10) vjet.

Neni 292
Komunikimi i paautorizuar i sekretit tregtar

1. Kushdo që në shkelje të detyrave të tij për ruajtjen e sekreteve afariste apo tregtare, ia kumton apo ia përcjell personit tjetër të dhënat lidhur me sekretet afariste apo tregtare ose në ndonjë mënyrë tjetër ia mundëson ndonjë personi të paautorizuar qasjen në të dhënat e tilla ose mbledh të dhëna të tilla me qëllim që t'ia përcjell personit të paautorizuar, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet.
2. Kushdo që me qëllim të përdorimit në mënyrë të paautorizuar, arrin në mënyrë të kundërligjshme deri te të dhënat të cilat ruhen si sekrete të afarizmit apo të tregtisë, siç parashihet në paragrafin 1. të këtij neni, dënohet me dënimin nga paragrafi 1. i këtij neni.
3. Kur të dhënat nga paragrafi 1. ose 2. i këtij neni janë të një rëndësie të veçantë ose nëse të dhënat e këtilla i përcjellën personit tjetër me qëllim që këto të dhëna t'i nxjerrë jashtë Republikës së Kosovës, ose nëse vepra është kryer me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore, kryesi dënohet me gjobë dhe me burgim deri në pesë (5) vjet.
4. Kur vepra penale nga paragrafi 1. ose 3. i këtij neni kryhet nga pakujdesia, kryesi dënohet me gjobë ose me burgim deri në një (1) vit.
5. Kushdo që me qëllim të këmbimit të sekretit tregtar për përfitim ekonomik të cilitdo përveç pronarit të tij, vjedh ose merr pa autorizim, ose përmes mashtrimit apo lajthimit merr të dhënat sipas paragrafit 1. të këtij neni, dënohet me gjobë dhe me burgim deri në pesë (5) vjet.
6. Kushdo që pranon, blen apo posedon sekretin tregtar, duke ditur se ky sekret është vjedhur ose marrë pa autorizim, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet.
7. Për qëllime të këtij neni, shprehja "sekret afarist" nënkupton të dhënat që janë cilësuar si të tilla me ligj ose me dispozita të organizatës së biznesit ose të personi juridik dhe të cilat paraqesin sekretin e prodhuesit, rezultatin e punës hulumtuese ose të dizajnimit, të dhëna financiare, afariste, shkencore, teknike, ekonomike apo inxhinierike, përfshirë plane, formula, dizajne, prototipe, metoda, teknika, procese,

procedura, programe, kode ose të dhëna tjera për të cilat pronari ka ndërmarrë masa të arsyeshme për ti mbajtur sekret dhe zbulimi i tyre personit të paautorizuar mund të ketë efekte të dëmshme për interesat ekonomike të organizatës së biznesit apo të personit juridik.

8. Për qëllime të këtij neni, shprehja "sekret tregtar" nënkupton të dhënat që janë cilësuar si të tilla me ligj ose me dispozita të organizatës së biznesit ose të personi juridik dhe të cilat paraqesin sekretin e prodhuesit, rezultatin e punës hulumtuese ose të dizajnimit, të dhëna financiare, afariste, shkencore, teknike, ekonomike apo inxhinierike, përfshirë plane, formula, prototipe, metoda, teknika, procese, procedura, programe, kode ose të dhëna tjera për të cilat pronari ka ndërmarrë masa të arsyeshme për ti mbajtur sekret dhe zbulimi i tyre personit të paautorizuar mund të ketë efekte të dëmshme për interesat ekonomike të organizatës së biznesit apo të personit juridik.

Neni 293
Falsifikimi i letrave me vlerë dhe instrumenteve të pagesës

1. Kushdo që prodhon letra me vlerë të falsifikuara apo instrumente të pagesës të falsifikuara ose i ndryshon letrat me vlerë me qëllim që t'i përdorë si të vërteta, ose ia jep ato personit tjetër për përdorim ose i përdorë ato letra me vlerë si të vërteta, dënohet me burgim prej (6) gjashtë muaj deri në pesë (5) vjet.
2. Kushdo që përdorë letra me vlerë të falsifikuara apo instrumente të pagesës të falsifikuara, dënohet me burgim prej tre (3) muaj deri në tre (3) vjet.
3. Kushdo që duke ditur se letra me vlerë apo instrument i pagesës është i falsifikuar, pranon, transporton ose posedon letrën me vlerë apo instrumentin e pagesës të falsifikuar me qëllim që ta shpërndajë ose ta përdorë si të vërtetë, dënohet me burgim prej tre (3) muaj deri në pesë (5) vjet.
4. Nëse vepra penale nga paragrafi 1. ose 2. i këtij neni përfshinë letra me vlerë apo instrumente të pagesës me vlerë të cekur që tejkalon dhjetëmijë (10.000) Euro, kryesi dënohet me burgim prej një (1) deri në tetë (8) vjet.
5. Kushdo që ka pranuar si të vërteta letrat me vlerë apo instrumentet e pagesës të falsifikuara dhe i përdorë ato duke ditur se janë të falsifikuara, dënohet me gjobë ose me burgim deri në një (1) vit.
6. Tentativa për të kryer vepër penale nga paragrafi 5. i këtij neni është e dënueshme.
7. Letrat me vlerë, instrumentet e pagesës dhe pajisjet për prodhimin ose ndryshimin e tyre konfiskohen.
8. Shprehja "instrument i pagesës" nënkupton instrument fizik, përveç parave, që i mundëson nga natyra e tij specifike, vetë apo në bashkim me ndonjë instrument tjetër të pagesës, mbajtësit apo përdoruesit që të transferojë paratë apo vlerën monetare. Kjo përfshinë, por nuk kufizohet në fletë aksione, certifikata të aksioneve, aksione, kredit kartela, kartela të euroçeqeve, kartela tjera të lëshuara nga institucionet financiare, euroçeqe, çeqe tjera të udhëtarëve dhe kartëmonedha të këmbimit, të cilat janë të mbrojtura kundër imitimit apo përdorimit të rremë përmes dizajnit, kodimit, nënshkrimit apo ndonjë mjeti tjetër.
9. Letrat me vlerë ose instrumentet e pagesës përfshijnë letrat me vlerë ose instrumentet e pagesës të falsifikuara dhe letrat me vlerë ose instrumentet e pagesës

të vërteta të cilat janë ndryshuar në aspektin material dhe me qëllim që të përdoren për qëllime mashtruese.

Neni 294
Falsifikimi i shenjave me vlerë

1. Kushdo që prodhon shenja me vlerë të falsifikuara, i ndryshon ato me qëllim që t'i përdorë si të vërteta, ia jep personit tjetër për përdorim ose i përdor shenjat me vlerë të falsifikuara si të vërteta, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet.
2. Kushdo që duke ditur se shenja me vlerë është e falsifikuar, furnizon, shet, blen, shpërndan, transporton, pranon apo posedon shenjën e falsifikuar apo të anuluar me qëllim që ta shpërndajë ose ta përdorë si të vërtetë, dënohet me burgim deri në tre (3) vjet.
3. Kur vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni përfshin shenjën, vlera e të cilave tejkalon dhjetëmijë (10.000) Euro, kryesi dënohet me gjobë dhe me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet.
4. Kushdo që e heq pullën e vulosur nga shenja me vlerë nga paragrafi 1. i këtij neni, ose në ndonjë mënyrë tjetër dhe me qëllim të përdorimit të vazhdueshëm, mundohet që këtyre shenjave t'u jep pamjen sikur nuk janë përdorur asnjëherë më parë ose përdor prapë shenjën e përdorur apo e shet atë si të vlefshme, dënohet me gjobë ose me burgim deri në një (1) vit.
5. Kushdo që pranon si të vërtetë shenjën me vlerë dhe e përdorë duke ditur se është e falsifikuar, dënohet me gjobë ose me burgim deri në një (1) vit.
6. Kushdo që ka dijeni se shenja me vlerë e falsifikuar është duke u prodhuar ose përdorur dhe nuk e raporton një gjë të tillë, dënohet me gjobë ose me burgim deri në një (1) vit.
7. Shenja me vlerë e falsifikuar dhe pajisjet për prodhimin apo ndryshimin e tyre konfiskohen.

Neni 295
Cenimi i të drejtave të patentës

1. Kushdo që në kuadër të një veprimtarie ekonomike e përdor pa autorizim patentën e regjistruar ose të mbrojtur me ligj apo topografinë e regjistruar të një qarku të mbyllur të një gjysmëpërçuesi, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet.
2. Sendet nga paragrafi 1. i këtij neni të prodhuara për përdorim të paautorizuar konfiskohen.

Neni 296
Cenimi i të drejtave të autorit

1. Kushdo që nën emrin e tij apo të dikujt tjetër, shfaq apo në ndonjë mënyrë tjetër i kumton publikut punën e mbrojtur me të drejtat e autorit ose paraqitjen e tjetrit, në tërësi apo pjesërisht, dënohet me gjobë dhe me burgim prej tre (3) muaj deri në tre (3) vjet.
2. Kushdo që gjatë përdorimit të punës së mbrojtur me të drejtat e autorit ose

paraqitjes së tjetrit, qëllimisht nuk cek emrin, pseudonimin ose shenjën e autorit apo të performuesit kur kjo kërkohet me ligj, dënohet me gjobë dhe me burgim deri në një (1) vit.

3. Kushdo që e ndryshon, shtrembëron ose në ndonjë mënyrë tjetër e dëmton punën e mbrojtur me të drejtat e autorit ose paraqitjen e tjetrit, dhe e shfaq në atë formë ose në ndonjë mënyrë tjetër ia kumton në formë të tillë publikut, dënohet me gjobë ose me burgim deri në një (1) vit.
4. Kushdo që paraqet ose në ndonjë formë tjetër ia kumton publikut në mënyrë të papërshtatshme punën e mbrojtur me të drejtën e autorit ose paraqitjen e tjetrit, që është paragjykuese për nderin dhe autoritetin e autorit ose performuesit, dënohet me gjobë ose me burgim deri në një (1) vit.
5. Kushdo që pa autorizim përdor punën e mbrojtur me të drejtat e autorit ose temën e çështjes së ndërlidhur me këto të drejta, dënohet me burgim deri në tre (3) vjet.
6. Nëse gjatë kryerjes së veprës penale nga paragrafi 5. i këtij neni, kryesi ka përfituar për vete ose për personin tjetër së paku dhjetë mijë (10.000) Euro por më pak se pesëdhjetëmijë (50.000) Euro, kryesi dënohet me gjobë dhe me burgim prej tre (3) muaj deri në pesë (5) vjet.
7. Nëse kryesi i veprës penale nga paragrafi 5. i këtij neni përfiton për vete ose për personin tjetër më shumë se pesëdhjetëmijë (50.000) Euro, kryesi dënohet me gjobë dhe me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në tetë (8) vjet.
8. Sendet dhe pajisjet për prodhimin e tyre nga ky nen konfiskohen.

Neni 297
Shmangia e masave teknologjike

1. Kushdo që kryen vepër të shmangies së ndonjë prej masave efektive mbrojtëse të teknologjisë ose të heqjes apo ndryshimit të të drejtave elektronike për menaxhimin e të dhënave, siç parashihet në dispozitat e ligjit për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të përafërta dënohet me burgim deri në tre (3) vjet.
2. Sendet dhe pajisjet për prodhimin e tyre nga paragrafi 1. i këtij neni konfiskohen.

Neni 298
Mashtrimi i konsumatorëve

1. Kushdo që gjatë ushtrimit të veprimtarisë ekonomike dhe me qëllim të mashtrimit të blerësve apo konsumatorëve, përdor ose posedon me qëllim të përdorimit si emër apo shenjë të tij ose shenjë të veçantë të mallrave të tij, emrin apo shenjën e tjetrit, shenjën e mallrave apo shenjën e shërbimeve të tjetrit, ose shenjën e tjetrit që lidhet me prejardhjen gjeografike ose ndonjë shenjë tjetër të veçantë të mallrave apo përbërësve të tyre, dënohet me burgim deri në (3) tre vjet.
2. Kushdo që me qëllim të mashtrimit të blerësve apo konsumatorëve, përdorë gjatë prodhimit shenjën apo modelin e tjetrit pa autorizim, ose vë në qarkullim artikujt e prodhuar në këtë mënyrë, dënohet me dënimin nga paragrafi 1. i këtij neni.
3. Sendet dhe pajisjet për prodhimin e tyre nga ky nen konfiskohen.

Neni 299
Mashtrimi i blerësve

1. Kushdo që me qëllim të mashtrimit të blerësve vë në qarkullim prodhime me shenjën në të cilën janë shënuar të dhëna të cilat nuk i përgjigjen përmbajtjes, llojit, prejardhjes apo kualitetit të produktit, vë në qarkullim produkte të cilat për nga pesha apo kualiteti nuk i përgjigjen asaj që rregullisht parashihet te produktet e tilla apo vë në qarkullim produkte pa shenjat që tregojnë për përmbajtjen, llojin, prejardhjen apo kualitetin e produktit kur shenja e tillë kërkohet me ligj, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet.
2. Kushdo që me qëllim të mashtrimit të blerësve shpall rrejshëm se është zbritur çmimi i mallit apo se pritet rritja e çmimit të mallit ose në ndonjë mënyrë tjetër përdor haptazi reklamë të rreme, dënohet me gjobë ose me burgim deri në një (1) vit.

Neni 300
Organizimi i skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshëm

1. Kushdo që me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për vete apo për personin tjetër, organizon, merr pjesë apo ndihmon në organizimin e veprimtarive të skemave piramidale, dënohet me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet.
2. Kushdo që me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për vete apo për personin tjetër, organizon, merr pjesë apo ndihmon në organizimin e bixhozit, lojërave të llojit të kazinove apo lojërave të fatit siç përcaktohet me ligj, për të cilat nuk është dhënë licenca, leja apo koncesioni i organit kompetent, dënohet me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet.
3. Kur vepra penale nga paragrafi 1. ose 2. i këtij neni rezulton me fitim apo humbje që tejkalon njëzetepesëmijë (25.000) Euro, kryesi dënohet me burgim prej dy (2) deri në dymbëdhjetë (12) vjet.
4. Për qëllime të këtij neni, shprehja "skemë piramidale" do të thotë ofertë apo plan për investim mashtrues, ku paratë e kontribuara nga investitorët e mëvonshëm përdorën drejtpërdrejtë për të paguar ose ripaguar interesin ose bazën e investitorëve të mëhershëm, pa ndonjë veprimtari operative apo që prodhon burime të të ardhurave, përveç grumbullimit të vazhdueshëm të fondeve të reja.

Neni 301
Keqpërdorimi i pozitës së monopolit

1. Personi përgjegjës që ushtron një apo më shumë nga veprimtaritë ekonomike në vijim, të cilat keqpërdorin pozitën monopoliste apo dominuese në treg apo në një pjesë substanciale të tregut, duke u përfshirë në një apo më shumë nga veprimtaritë në vijim, dënohet me burgim deri në tre (3) vjet, nëse:
   1.1. në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë vë çmime të padrejta të blerjes apo të shitjes ose kushte tjera të padrejta tregtare;
   1.2. në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë rregullon çmimet e blerjes apo të shitjes ose kushtet tjera të tregtisë;

1.3. kufizon apo kontrollon prodhimin, tregjet apo zhvillimin teknik ose investimin;
1.4. aplikon kushte jo të njëjta për transaksione të barabarta me palë tjera tregtare, duke i vënë ato në disavantazh konkurrues;
1.5. bën që lidhja e kontratave të varet nga pranimi prej palës tjetër i detyrimeve shtesë, të cilat për nga natyra e tyre apo sipas përdorimit komercial, nuk kanë ndonjë lidhje me subjektin e kontratave të tilla;
1.6. në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë rregullon çmimet e blerjes apo të shitjes ose kushtet tjera të tregtisë në tregje të aksioneve ose burimet e furnizimit;
1.7. kërkon pagesa ose kushte tjera afariste më pak të favorshme se që kërkohet për blerje të ngjashme në tregje të krahasueshme, përveç nëse ka ndonjë arsyetim objektiv për një diferencim të tillë;
1.8. kërkon pagesa apo kushte tjera afariste që dallojnë nga ato që me gjasë do të ishin në rast se do të ekzistonte konkurrenca efektive.

2. Personi përgjegjës në organizatën e biznesit i cili merret vesh me personin në organizatën tjetër të biznesit nga e njëjta fushë e biznesit, me qëllim të rritjes, uljes apo ndikimit në ndonjë mënyrë tjetër të çmimit të mallrave ose shërbimeve që shiten apo blihen nga organizatat e biznesit, dënohet me burgim prej një (1) deri në pesë (5) vjet burgim dhe me gjobë të barabartë me njëzet e pesë përqind (25%) të vlerës së mallrave të shitura nga organizata e tij e biznesit e cila ka qenë subjekt i marrëveshjes së përbashkët.

Neni 302
Falsifikimi i parasë

1. Kushdo që prodhon para të falsifikuara me qëllim për t'i vënë në qarkullim si të vërteta, dënohet me burgim prej një (1) deri në dhjetë (10) vjet.
2. Kushdo që duke ditur se paraja është e falsifikuar merr, vë në qarkullim, transporton, pranon, përdorë ose posedon paranë e falsifikuar me qëllim që ta vë në qarkullim si të vërtetë, dënohet me burgim prej një (1) deri në tetë (8) vjet.
3. Kushdo që pranon paranë e falsifikuar prej pesëdhjetë (50) Euro ose më pak duke besuar se është e vërtetë dhe pastaj e përdorë duke ditur se është e falsifikuar, dënohet me gjobë ose me burgim deri në një (1) vit.
4. Kushdo që ka dijeni për prodhimin apo përdorimin e parave të falsifikuara dhe këtë nuk e raporton, dënohet me gjobë ose me burgim deri në një (1) vit.
5. Kur vepra penale nga paragrafi 1. dhe 2. i këtij neni ka të bëjë me një shumë të parave të falsifikuara që tejkalon njëqindmijë (100.000) Euro, kryesi dënohet me jo më pak se tre (3) vjet burgim.
6. Paraja e falsifikuar dhe pajisjet për prodhimin apo ndryshimin e saj konfiskohen.

Neni 303
Prodhimi dhe përdorimi i shenjave të etiketimit, masave dhe peshave të rreme

1. Kushdo që me qëllim të përdorimit të tyre si të vërteta, prodhon shenja të rreme për etiketimin e mallit, si dhe vula apo pulla për vulosjen e arit, argjendit, bagëtisë, drurit apo ndonjë malli tjetër të prodhuar vendor apo jashtë vendit, ose shenjat e rreme i përdor si të vërteta, dënohet me burgim prej tre (3) muaj deri në tre (3) vjet.

2. Kushdo që materialisht ndryshon masat apo peshat me qëllim që të përdoren si të sakta, dënohet sipas paragrafit 1. të këtij neni.
3. Shenjat, vulat, masat dhe peshat e falsifikuara dhe pajisjet për prodhimin dhe ndryshimin e tyre konfiskohen.

Neni 304
Prodhimi, furnizimi, shitja, posedimi ose dhënia në shfrytëzim e mjeteve për falsifikim

1. Kushdo që prodhon, furnizon, shet, pranon, posedon ose jep në shfrytëzim mjete për falsifikimin e parave, letrave me vlerë apo instrumenteve të pagesës, dënohet me burgim prej (1) një deri në pesë (5) vjet.
2. Kushdo që prodhon, furnizon, shet, pranon, posedon ose jep në shfrytëzim mjete për falsifikimin e pullave fiskale, pullave postare apo shenjave tjera me vlerë, shenjave për etiketimin e rremë të mallrave ose masa dhe pesha të pasakta, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet.
3. Për qëllime të këtij neni, shprehja "mjete për falsifikim" do të thotë instrumente, artikuj, programe kompjuterike dhe mjete tjera që adaptohen posaçërisht për falsifikimin ose ndryshimin e parave, letrave me vlerë apo instrumenteve të pagesës, pullave me vlerë, shenjave për etiketimin e mallrave, masave dhe peshave ose hologramëve apo përbërësve tjerë të valutës, letrave me vlerë apo instrumenteve të pagesës, të cilat shërbejnë për mbrojtje ndaj falsifikimit.
4. Artikujt, mjetet dhe pajisjet për prodhimin e tyre konfiskohen.

Neni 305
Tregtia e ndaluar

1. Kushdo që pa autorizim shet, blen apo bën shkëmbimin e mallrave sendeve apo shërbimeve, dënohet me burgim prej tre (3) muaj deri në tre (3) vjet.
2. Kur kryesi i veprës penale nga paragrafi 1. i këtij neni ka organizuar rrjetin e shitësve ose të ndërmjetësve apo ka realizuar përfitim që kalon shumën prej pesëmbëdhjetëmijë (15.000) Euro, kryesi dënohet me burgim prej një (1) deri në tetë (8) vjet.
3. Mallrat dhe sendet nga tregtia e ndaluar konfiskohen.

Neni 306
Prodhimi i ndaluar

1. Kushdo që pa autorizim prodhon apo përpunon mallrat, prodhimi apo përpunimi i të cilave është i ndaluar apo i kufizuar me ligj, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet.
2. Mallrat dhe pajisjet për prodhimin ose përpunimin e paautorizuar konfiskohen.

Neni 307
Lëshimi i çeqeve pa mbulesë ose të rremë dhe keqpërdorimi i kartelave të bankës apo të kreditit

1. Kushdo që me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për vete apo personin tjetër, e jep apo e vë në qarkullim çekun për të cilin e di se nuk ka mbulesë të mjeteve, çekun e rremë ose kartelën e falsifikuar të kredisë dhe në këtë mënyrë realizon dobi pasurore, dënohet me gjobë dhe me burgim deri në tre (3) vjet.
2. Kushdo që me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për vete apo personin tjetër, e përdor kartelën e kreditit apo çekun pa autorizim ose e përdor kartelën e bankës në automatin e bankës për tërheqjen e parave të gatshme duke e ditur se tërheqja e tillë nuk është e mbuluar nga bilanci i llogarisë apo nga overdrafti ose kushdo që përdor kartelën e kreditit ndonëse e di se në kohën e pagesës nuk do të jetë në gjendje të paguajë shumën përkatëse dhe kështu realizon dobi pasurore, dënohet me dënimin nga paragrafi 1. i këtij neni.
3. Kur vepra penale nga paragrafi 1. ose 2. i këtij neni rezulton në dobi pasurore që tejkalon shumën prej pesëmijë (5.000) Euro, kryesi dënohet me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në (5) pesë vjet.

Neni 308
Shpërlarja e parave

Kushdo që kryen vepër penale të shpërlarjes së parave, dënohet sipas Ligjit për parandalimin e shpërlarjes së parave dhe financimin e terrorizmit.

Neni 309
Marrëveshjet për kufizimin e konkurrencës përmes ftesave për tender

1. Kushdo që përmes ftesës për tender lidhur me mallra apo shërbime komerciale, bën një ofertë bazuar në një marrëveshje të kundërligjshme dhe qëllimi i ofertës së tillë është që organizatori të pranojë një ofertë të caktuar, dënohet me gjobë ose me burgim deri në pesë (5) vjet.
2. Dhënia private e kontratës pas pjesëmarrjes së mëparshme në konkurrim është ekuivalente me ftesën për tender sipas kuptimit të paragrafit 1. të këtij neni.

Neni 310
Mashtrimi në shkëmbimin e letrave me vlerë

Kushdo që në shkëmbimin e aksioneve apo letrave tjera me vlerë ose opsioneve, paraqet rrejshëm bilancin e aseteve, të dhënat e fitimeve dhe humbjeve apo të dhënat tjera që kanë ndikim të konsiderueshëm në vlerën e letrave me vlerë, kësisoj duke nxitur një apo më shumë persona që të bëjnë blerjen apo shitjen e letrave me vlerë të tilla, dënohet me gjobë dhe me burgim deri në pesë (5) vjet.

Neni 311
Keqpërdorimi i informatave të brendshme

Kushdo që në mospajtim me detyrat e tij për të mbrojtur informatat e brendshme të cilat i mëson gjatë kryerjes së aktivitetit ekonomik ose sipas detyrës zyrtare, i kumton personit të paautorizuar informatën e panjohur për publikun dhe që mund të ndikojë në çmimin e letrave me vlerë; ose kushdo që në ndonjë mënyrë tjetër përdor informatën e tillë për dobi personale ose për qëllim të sigurimit të avantazhit të padrejtë në tregun e letrave me vlerë për ndonjë person fizik apo person juridik, dënohet me gjobë dhe me burgim deri në pesë (5) vjet.

Neni 312
Marrëveshja dhe mashtrimi me letrat me vlerë të Qeverisë

1. Kushdo që merr pjesë në blerjen apo shitjen e letrave me vlerë në tregun e letrave me vlerë të Qeverisë dhe merret vesh me një apo më shumë nga pjesëmarrësit tjerë me qëllim të ndikimit të tregut në kuptimin e rendimentit, çmimit ose shumës së letrave me vlerë të Qeverisë të cilat shiten në ankand apo në tregun sekondar; ose kushdo që në ndonjë mënyrë tjetër merr pjesë në ndonjë transaksion, praktikë apo sjellje që operon për mashtrim të pjesëmarrësve të tjerë në treg, dënohet me gjobë dhe me burgim deri në pesë (5) vjet.
2. Kushdo që me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për vete apo personin tjetër merr pjesë në ndonjë transaksion, praktikë apo sjellje në blerjen ose shitjen e letrave me vlerë të Qeverisë që operon si mashtrim, ose që nxit ndonjë person për të kryer ose për të mos kryer ndonjë veprim në dëm të pasurisë së tij, dënohet me gjobë dhe me burgim deri në pesë (5) vjet.
3. Nëse vepra penale nga paragrafi 1. ose 2. i këtij neni rezulton me fitim pasuror që tejkalon dyqind e pesëdhjetëmijë (250.000) Euro, kryesi dënohet me gjobë dhe me burgim prej tre (3) deri në dymbëdhjetë (12) vjet.
4. Për qëllime të këtij neni, shprehja "marrëveshje" apo "merret vesh" do të thotë dy apo më shumë persona të cilët bëjnë marrëveshje për të bashkëpunuar për përfitimin e dyanshëm të tyre në mënyrë që të kufizojnë konkurrencën në tregun e lirë ose të fitimit të avantazhit të padrejtë. Kjo marrëveshje mund të jetë e heshtur dhe kështu që mund të nënkuptohet nga efekti që ka në tregun e letrave me vlerë të qeverisë gjatë një periudhe kohore.
5. Dobia pasurore e përfituar sipas dispozitave të këtij neni konfiskohet.

Neni 313
Shmangia nga tatimi

1. Kushdo që me qëllim që ai apo personi tjetër të fsheh apo t'i shmanget, pjesërisht apo tërësisht, pagesës së tatimit, tarifave apo kontributeve të tjera që kërkohen me ligj, jep të dhëna të pavërteta apo nuk i përfshin të dhënat lidhur me të ardhurat e tij, pasurinë, gjendjen ekonomike apo fakte të tjera relevante për vlerësimin e detyrimeve të tilla, dënohet me gjobë dhe me burgim deri në tre (3) vjet.
2. Kur detyrimi nga paragrafi 1. i këtij neni tejkalon shumën prej pesëmbëdhjetëmijë

(15.000) Euro, kryesi dënohet me gjobë dhe me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet.
3. Kur detyrimi nga paragrafi 1. i këtij neni tejkalon shumën prej pesëdhjetëmijë (50.000) Euro, kryesi dënohet me gjobë dhe me burgim prej një (1) deri në tetë (8) vjet.

Neni 314
Dokumentet e rrejshme lidhur me tatimin

1. Kushdo që jep deklaratë të rrejshme ose lëshon dokument të rrejshëm kur paraqitja e deklaratës apo dokumentit të vërtetë kërkohet me ligj, ose kushdo që nuk lëshon dokumentin lëshimi i të cilit kërkohet me ligj, dënohet me gjobë dhe me burgim deri në tre (3) vjet.
2. Nëse vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni përfshin numër të madh të dokumenteve, ose nëse vepra penale është kryer për të shmangur pagesën e tatimit prej pesëmbëdhjetë (15.000) Euro apo më shumë, kryesi dënohet me gjobë dhe me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet.

Neni 315
Pranimi i paarsyeshëm i dhuratave

1. Kushdo që gjatë ushtrimit të veprimtarisë ekonomike kërkon apo pranon shpërblim, dhuratë apo ndonjë përfitim tjetër joproporcional me qëllim të lënies anash të interesave të organizatës së tij të biznesit apo të personit juridik ose për t'i shkaktuar dëm organizatës së tillë të biznesit apo personit juridik me rastin e lidhjes së kontratës ose pajtimit për kryerjen e ndonjë shërbimi, dënohet me gjobë dhe me burgim deri në tre (3) vjet.
2. Kushdo që duke kryer vepër penale nga paragrafi 1. i këtij neni kërkon apo pranon shpërblim, dhuratë apo ndonjë fitim tjetër joproporcional për vete ose për personin tjetër në shkëmbim të lidhjes së ndonjë kontrate ose marrëveshjes për të kryer ndonjë shërbim, dënohet me gjobë dhe me burgim deri në tre (3) vjet.
3. Kushdo që duke kryer vepër penale nga paragrafi 1. i këtij neni, kërkon apo pranon shpërblim, dhuratë apo ndonjë fitim tjetër pas lidhjes së kontratës ose pas kryerjes së shërbimit, dënohet me gjobë dhe me burgim deri në një (1) vit.
4. Dhurata apo shpërblimi i pranuar konfiskohet.

Neni 316
Dhënia e paarsyeshme e dhuratave

1. Kushdo që jep, tenton të jep apo premton shpërblim, dhuratë apo ndonjë përfitim tjetër joproporcional personit i cili ushtron veprimtari ekonomike me qëllim të lënies anash të interesave të organizatës së tij të biznesit ose të personit juridik ose për t'i shkaktuar dëm organizatës së tillë të biznesit apo personit juridik me rastin e lidhjes së kontratës apo kryerjes së ndonjë shërbimi, dënohet me gjobë dhe me burgim deri në tre (3) vjet.
2. Kushdo që jep, tenton të jep apo premton shpërblim, dhuratë apo ndonjë përfitim

tjetër joproporcional personit i cili ushtron veprimtari ekonomike me qëllim të arritjes së ndonjë përparësie të paarsyetueshme për lidhjen e kontratës apo për kryerjen e ndonjë shërbimi, dënohet me gjobë dhe me burgim deri në tre (3) vjet.

3. Nëse kryesi i veprës penale nga paragrafi 1. ose 2. i këtij neni jep shpërblim apo dhuratë sipas kërkesës dhe nëse veprën e lajmëron para së të jetë zbuluar apo para se ai ta ketë kuptuar se është zbuluar, gjykata mund ta lirojë nga dënimi.
4. Dhurata apo shpërblimi i dhënë konfiskohen, përveç në rastin nga paragrafi 3. i këtij neni ku në rastin e tillë dhurata apo shpërblimi mund ti kthehen personit i cili e kishte dhënë.

Neni 317
Kontrabandimi i mallrave

1. Kushdo që duke kaluar vijën kufitare bartë mallra dhe shmang kontrollin doganor, ose kushdo që duke shmangur kontrollin doganor, kryen bartjen e mallrave dhe kalon vijën kufitare, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet.
2. Kushdo që pa leje përkatëse, shmang kontrollin doganor dhe kalon vijën kufitare duke bartur mallrat, eksportimi apo importimi i të cilave është i ndaluar, i kufizuar apo kërkon leje të posaçme nga organi kompetent, dënohet me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet.
3. Kur vepra penale nga paragrafi 1. ose 2. i këtij neni kryhet në një apo më shumë nga rrethanat në vijim, kryesi dënohet me burgim prej një (1) deri në dhjetë (10) vjet, kur:
   3.1. kryesi kalon kufirin me sende, mallra apo substanca të rrezikshme të cilat vënë në rrezik jetën apo shëndetin e njerëzve;
   3.2. kryesi kalon kufirin me sende, mallra apo substanca të rrezikshme të cilat paraqesin rrezik për sigurinë e përgjithshme;
   3.3. kryesi përdor forcën apo kanosjen serioze ose armën apo mjetin e rrezikshëm gjatë kryerjes së veprës.
4. Mallrat nga paragrafi 1. dhe 2. i këtij neni konfiskohen. Nëse mallrat nuk mund të gjinden ose për ndonjë arsye tjetër nuk mund të konfiskohen, paguhet ekuivalenti i shumës së mallrave.
5. Mjetet e transportit apo mjetet për bartjen e mallrave të cilat janë përdorur për transportimin e mallrave nga paragrafi 1. dhe 2. i këtij neni konfiskohen.

Neni 318
Shmangia nga pagesa e tarifave të detyrueshme doganore

1. Kushdo që me qëllim që vetes apo personit tjetër t'i mundësojë shmangien nga pagesa e tarifave tatimore doganore apo tarifave tjera ose detyrimeve doganore që paguhen me rastin e importimit apo eksportimit të mallrave, ose nëse doganës i paraqet dokument të rrejshëm lidhur me prejardhjen, vlerën, sasinë, cilësinë, llojin apo karakteristikat tjera te mallit, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet.
2. Nëse vlera e pagesës së shmangur nga paragrafi 1. i këtij neni tejkalon pesëmbëdhjetëmijë (15.000) Euro, kryesi dënohet me gjobë dhe me burgim deri në pesë (5) vjet.

3. Nëse vlera e pagesës së shmangur nga paragrafi 1. i këtij neni tejkalon tridhjetëmijë (30.000) Euro, kryesi dënohet me gjobë dhe me burgim prej një (1) deri në tetë (8) vjet.
4. Mallrat të cilat nuk janë deklaruar saktë apo vlera e pagesës së shmangur, cilado që të jetë më e lartë, konfiskohen.

KAPITULLI XXVI
VEPRAT PENALE KUNDËR SHËRBIMEVE KOMUNALE

Neni 319
Përkufizimet

1. Për qëllime të këtij Kapitulli, shprehjet e mëposhtme kanë këto kuptime:
   1.1. shprehja "furnizues i autorizuar" nënkupton personin apo subjektin juridik që është i autorizuar në pajtim me ligjin e zbatueshëm për furnizim me rrymë apo shërbim tjetër;
   1.2. shprehja "shërbim komunal" nënkupton gaz, ujë, rrymë apo ngrohje.

Neni 320
Vjedhja e shërbimeve komunale

Kushdo që merr, përdor, devijon, nxjerr ose përfiton nga ndonjë shërbim komunal që furnizohet nga ose përmes rrjetit përçues të rrymës apo rrjetit të shpërndarjes, pa autorizimin e furnizuesit të autorizuar, dënohet me gjobë dhe me burgim deri në tre (3) vjet.

Neni 321
Lidhja e paautorizuar në shërbime

Kushdo që lidhet apo rilidhet në përçues të rrymës apo në rrjetin për përçim ose shpërndarje të çfarëdo shërbimi komunal në çfarëdo mënyre, drejtpërdrejt apo tërthorazi, qoftë përmes përçueshmërisë ose induksionit, pa autorizim të furnizuesit të autorizuar, dënohet me gjobë dhe me burgim deri në tre (3) vjet.

Neni 322
Lejimi i lidhjes së paautorizuar në shërbime

1. Kushdo që lejon që lidhja ose rilidhja e paautorizuar në përçues të shërbimit ose në rrjet të shpërndarjes që gjendet në pronën e cila është në posedim, pronësi apo kontroll të tij; ose kushdo që mundëson lidhjen apo rilidhjen e paautorizuar në përçues të shërbimit komunal ose në rrjet të shpërndarjes në pronën e cila është në posedim, pronësi apo kontroll të tij, dënohet me gjobë dhe me burgim deri në tre (3) vjet.
2. Sjellja nga paragrafi 1. i këtij neni nuk përbën vepër penale nëse personi pasi që kupton për lidhjen apo rilidhjen e paautorizuar, menjëherë njofton furnizuesin e autorizuar për ekzistimin e lidhjes apo rilidhjes së tillë të paautorizuar.

Neni 323
Ndryshimi i njehsorit të shërbimeve

1. Kushdo që ndryshon çfarëdo njehsori që përdoret për matjen e sasisë së ndonjë shërbimi komunal me të cilin është furnizuar cilido objekt nga furnizuesi i autorizuar, ose pengon njehsorin e tillë apo matësin nga regjistrimi i saktë i sasisë së shërbimit komunal të shpenzuar, dënohet me gjobë dhe me burgim deri në tre (3) vjet.
2. Për ndjekjen e veprës nga ky nen, posedimi i mjeteve artificiale të cilat përdoren për të shkaktuar ndryshime në regjistrin e njehsorit ose ndërhyrje në njehsor për ta ndaluar regjistrimin e saktë, konsiderohet dëshmi e mjaftueshme se ndryshimi apo ndalimi është kryer me dashje nga personi i cili ka në përkujdesje apo në kontroll njehsorin.

Neni 324
Lejimi i njehsorëve të ndryshuar të shërbimeve

1. Kushdo që ndërhyn ose shmang njehsorin i cili gjendet në pronën e cila është në posedimin, pronësinë apo kontrollin e tij, për të ofruar shërbime komunale që nuk janë matur ose janë matur në mënyrë të pasaktë, dënohet me gjobë dhe me burgim deri në tre (3) vjet.
2. Sjellja nga paragrafi 1. i këtij neni nuk përbën vepër penale nëse personi pasi që kupton për ndërhyrjen apo shmangien e njehsorit, menjëherë njofton furnizuesin e autorizuar për ekzistimin e njehsorit në të cilin është ndërhyrë apo njehsorit të shmangur.

KAPITULLI XXVII
VEPRAT PENALE KUNDËR PASURISË

Neni 325
Vjedhja

1. Kushdo që personit tjetër ia merr pasurinë e cila vlerësohet në shumën prej pesëdhjetë (50) Euro apo më shumë, me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm për vete apo për personin tjetër, dënohet me gjobë dhe me burgim deri në tre (3) vjet.
2. Nëse vlera e pasurisë së vjedhur është më pak se pesëdhjetë (50) Euro, kryesi dënohet me gjobë ose me burgim deri në gjashtë (6) muaj.

Neni 326
Vjedhja e shërbimeve

1. Kushdo që me anë të lajthimit, largimit ose mënyrave tjera siguron shërbime për të cilat dihet se mundësohen vetëm në shkëmbim të kompensimit dhe shmang pagesën për shërbime të tilla, dënohet me gjobë dhe me burgim deri në një (1) vit.
2. Nëse vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni kryhet me forcë ose kanosje serioze, kryesi dënohet me gjobë dhe me burgim deri në tre (3) vjet.

3. Nëse vlera e shërbimeve të vjedhura është më pak se pesëdhjetë (50) Euro, kryesi dënohet me gjobë ose me burgim deri në gjashtë (6) muaj.
4. Për qëllime të këtij neni, "shërbime" përfshinë, por nuk kufizohet në transportimin; punën, shërbimet profesionale, teknike apo mekanike; shërbimet e skiliftit; objektet për biseda telefonikë; shërbimet e komunikimit ose telefonisë; ofrimi i ushqimit apo akomodimit; furnizimi me pajisje, vegla, vetura ose kamp-shtëpiza për përdorim të përkohshëm; furnizimi i pajisjeve për shfrytëzim; ose qasja në sistemin e internetit, kompjuterik apo kabllor. "Shërbim" po ashtu përfshinë çmimin e hyrjes në evenimente sportive, zbavitëse, shfaqje ose ngjarje tjera që kanë çmim të hyrjes ose tarifë tjetër për pjesëmarrje.
5. Largimi nga biznesi, hoteli apo restoranti pa ofruar për të paguar ose pa paguar për hotel, restorant apo shërbime tjera për të cilat kompensimi zakonisht paguhet pas pranimit të shërbimeve është dëshmi se shërbimet janë pranuar me qëllim të shmangies së pagesës.

Neni 327
Vjedhja e rëndë

1. Kushdo që kryen vjedhje nga paragrafi 1. i nenit 325 të këtij Kodi, dënohet me gjobë dhe me burgim prej tre (3) deri në shtatë (7) vjet, nëse:
   1.1. vepra është kryer duke thyer, kaluar apo depërtuar me forcë në veturat e mbyllura, ndërtesat, dhomat, arkat, sanduqet apo hapësirat tjera të mbyllura ose duke hequr pengesat tjera me qëllim të përvetësimit të pasurisë së luajtshme;
   1.2. kryesi ka vepruar në mënyrë posaçërisht të rrezikshme apo të vrazhdë;
   1.3. kryesi ka shfrytëzuar gjendjen e krijuar si rezultat i zjarrit, vërshimit, tërmetit apo fatkeqësive të tjera; ose
   1.4. kryesi ka shfrytëzuar paaftësinë ose gjendjen tjetër të rëndë të personit tjetër.
2. Kushdo që kryen vjedhje nga paragrafi 1. i nenit 325 të këtij Kodi ose paragrafi 1. i këtij neni dënohet me burgim prej tre (3) deri në dhjetë (10) vjet, nëse:
   2.1. pasuria apo shërbimi i vjedhur ka vlerë mbi pesëmijë (5.000) Euro;
   2.2. pasuria e vjedhur shërben për qëllime fetare ose është vjedhur nga ndërtesa fetare apo ndërtesa tjetër që shërben për mbajtjen e ceremonive fetare;
   2.3. pasuria e vjedhur ka vlerë kulturore, fetare apo historike; ka rëndësi të posaçme shkencore, teknike apo artistike; është pjesë e koleksionit publik, koleksionit privat të mbrojtur apo e ekspozitës publike; ose është monument natyral apo objekt i natyrës nën mbrojtje;
   2.4. pasuria është vjedhur nga varri;
   2.5. pasuria e vjedhur është armë;
   2.6. kryesi ka pasur me vete armë apo mjet tjetër të rrezikshme; ose
   2.7. kryesi ka vepruar si anëtar i grupit.

Neni 328
Vjedhja grabitqare

1. Kushdo që i zënë në befasi në kryerjen e aktit të vjedhjes dhe me qëllim që pasurinë e vjedhur ta mbajë, e përdor forcën apo kanosjen serioze për të sulmuar jetën apo

trupin e personit tjetër, dënohet me gjobë dhe me burgim prej tre (3) deri në dhjetë (10) vjet.
2. Kur vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni kryhet nga kryesi i cili vepron si anëtar i grupit ose i cili ka me vete armën apo mjetin e rrezikshëm, kryesi dënohet me gjobë dhe me burgim prej pesë (5) deri në dymbëdhjetë (12) vjet.
3. Kur vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni kryhet nga kryesi i cili vepron si anëtar i grupit të armatosur ose kur vepra penale rezulton me lëndim të rëndë trupor, kryesi dënohet me gjobë dhe me burgim prej shtatë (7) deri në dymbëdhjetë (12) vjet.
4. Kur vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni rezulton me vdekje, kryesi dënohet me gjobë dhe me burgim së paku dhjetë (10) vjet ose me burgim të përjetshëm.

Neni 329
Grabitja

1. Kushdo që me përdorim të forcës apo kanosjes serioze për të sulmuar jetën apo trupin e personit tjetër, e përvetëson pasurinë e luajtshme të personit të tillë me qëllim që t'i sjellë vetes apo personit tjetër dobi pasurore të kundërligjshme, dënohet me gjobë dhe me burgim prej tre (3) deri në dymbëdhjetë (12) vjet.
2. Nëse vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni ka të bëjë me sendin e vjedhur me vlerë që tejkalon pesëmijë (5.000) Euro, kryesi dënohet me gjobë dhe me burgim prej pesë (5) deri dymbëdhjetë (12) vjet.
3. Nëse vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni kryhet nga kryesi i cili vepron si anëtar i grupit ose i cili ka me vete armën apo mjetin e rrezikshëm, kryesi dënohet me gjobë dhe me burgim prej shtatë (7) deri në dymbëdhjetë (12) vjet.
4. Kur vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni kryhet nga kryesi i cili vepron si anëtar i grupit të armatosur ose kur vepra penale rezulton me lëndim të rëndë trupor, kryesi dënohet me gjobë dhe me burgim prej shtatë (7) deri në pesëmbëdhjetë (15) vjet.
5. Kur vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni rezulton me vdekje, kryesi dënohet me gjobë dhe me burgim prej së paku dhjetë (10) vjet ose me burgim të përjetshëm.

Neni 330
Shpërdorimi i pasurisë së huaj

1. Kushdo që me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për vete apo personit tjetër, e përvetëson pasurinë e cila i është besuar atij apo personit tjetër, dënohet me gjobë dhe me burgim deri në një (1) vit.
2. Nëse vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni kryhet nga kujdestari, avokati apo ndonjë person tjetër që ka detyrim ligjor ndaj pronarit të pasurisë, kryesi dënohet me gjobë dhe me burgim deri në tre (3) vjet.
3. Nëse vlera e pasurisë së përvetësuar e tejkalon shumën prej dhjetëmijë (10.000) Euro, kryesi dënohet me gjobë dhe me burgim prej një (1) deri në pesë (5) vjet.
4. Nëse pasuria e përvetësuar ka vlerë kulturore, fetare apo historike; ka rëndësi të posaçme shkencore, teknike apo artistike; është pjesë e koleksionit publik, koleksionit privat të mbrojtur apo e ekspozitës publike; ose është monument natyral

apo objekt i natyrës nën mbrojtje, kryesi dënohet me gjobë dhe me burgim prej një (1) deri në tetë (8) vjet.

5. Kushdo që në mënyrë të kundërligjshme përvetëson pasurinë e luajtshme të personit tjetër, të cilën ai e ka gjetur ose tek posedimi i së cilës ka arritur rastësisht, me qëllim që vetes ose personit tjetër t'i sjellë dobi pasurore të kundërligjshme, dënohet me gjobë dhe me burgim deri në një (1) vit.
6. Nëse vlera e pasurisë së përvetësuar është më pak se pesëdhjetë (50) Euro, kryesi dënohet me gjobë ose me burgim deri në gjashtë (6) muaj.
7. Ndjekja penale për veprën penale nga paragrafi 1. dhe 5. të këtij neni ndërmerret sipas propozimit.

Neni 331
Marrja në posedim e pasurisë së luajtshme

1. Kushdo që në mënyrë të kundërligjshme merr pasurinë e luajtshme të personit tjetër që ta mbajë në posedim të vetin pa qëllim të përvetësimit, dënohet me gjobë ose me burgim deri në (1) një vit.
2. Tentativa për të kryer veprën penale nga paragrafi 1. i këtij neni është e dënueshme nëse ka të bëjë me tentativën për marrjen e automjetit nga personi tjetër.
3. Procedura penale për veprën penale nga paragrafi 1. i këtij neni fillohet në bazë të propozimit, apo nëse pasuria është në pronësi ose nën administrimin e një organi publik sipas propozimit.

Neni 332
Uzurpimi i paligjshëm i pronës së paluajtshme

1. Kushdo që në mënyrë të kundërligjshme uzurpon pronën e paluajtshme të personit tjetër apo një pjesë të saj, dënohet me gjobë ose me burgim deri në dy (2) vjet.
2. Nëse vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni kryhet në një apo më shumë nga rrethanat në vijim, kryesi dënohet me burgim prej tre (3) muaj deri në tre (3) vjet:
   2.1. nëse prona e paluajtshme e uzurpuar është pjesë e pyllit të mbrojtur, parkut të mbrojtur apo pyllit tjetër me destinim të posaçëm, tokës ndërtimore ose rrugës;
   2.2. nëse kryesi ka uzurpuar pronën e paluajtshme duke e ditur se pronë e tillë i është nënshtruar dëbimit me urdhër të gjykatës apo me urdhër ose vendim të ndonjë organi apo institucioni tjetër publik të themeluar në bazë të ligjit të zbatueshëm në Republikën e Kosovës.
3. Kryesi dënohet me burgim prej një (1) deri në tre (3) vjet nëse është dënuar më parë për uzurpim të kundërligjshëm të pronës së paluajtshme ose nëse është dëbuar prej pronës së tillë të paluajtshme me vendim të gjykatës apo me urdhër apo vendim të ndonjë organi apo institucioni tjetër të themeluar në bazë të ligjit të zbatueshëm në Republikën e Kosovës.

Neni 333
Asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë

1. Kushdo që e asgjëson, dëmton apo e bën të papërdorshme pasurinë e personit tjetër në rrethana tjera nga ato të përcaktuara në nenin 334 të këtij Kodi, dënohet me burgim deri në një (1) vit.
2. Nëse vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni rezulton në dëm që tejkalon pesëmijë (5.000) Euro, kryesi dënohet me burgim prej një (1) vjet deri në tre (3) vjet.
3. Nëse vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni ka të bëjë me një send që ka vlerë kulturore, fetare apo historike; ka rëndësi të posaçme shkencore, teknike apo artistike; është pjesë e koleksionit publik, koleksionit privat të mbrojtur apo e ekspozitës publike; ose është monument natyral apo objekt i natyrës nën mbrojtje; ekspozohet në publik ose është send që shërben për përdorimin publik ose për dekorimin e sheshit, rrugës apo parkut, kryesi dënohet me gjobë dhe me burgim deri në tre (3) vjet, pavarësisht dëmit të shkaktuar.
4. Kur vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni është kryer për shkak të paragjykimeve ndaj kombësisë, gjuhës, besimit fetar ose mungesës së besimit fetar, ngjyrës së lëkurës, gjinisë, orientimit seksual, ose për shkak të afërsisë me persona me njërën nga këto karakteristika të mbrojtura, kryesi i veprës penale dënohet me burgim deri në tre (3) vjet.

Neni 334
Zjarrvënia

1. Kushdo që ndez zjarrin apo shkakton shpërthimin me qëllim të dëmtimit të pasurisë së personit tjetër, dënohet me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në tre (3) vjet.
2. Kushdo që ndez zjarrin apo shkakton shpërthimin me qëllim të dëmtimit apo asgjësimit të banesës së banuar ose veturës në shfrytëzim nga personi tjetër, dënohet me burgim prej një (1) deri në pesë (5) vjet.
3. Nëse vepra penale nga paragrafi 1. ose 2. i këtij neni shkakton dëm pasuror në shumë prej njëzetmijë (20.000) Euro apo më shumë ose nëse vepra penale i shkakton tjetrit lëndim të rëndë trupor, kryesi dënohet me burgim prej tre (3) deri në dhjetë (10) vjet.
4. Nëse vepra penale nga paragrafi 1. ose 2. i këtij neni rezulton me vdekje, kryesi dënohet me së paku me dhjetë (10) vjet burgim ose me burgim të përjetshëm.

Neni 335
Mashtrimi

1. Përveç siç parashihet në nenin 336 të këtij Kodi, kushdo që me anë të paraqitjes së rreme të fakteve apo duke fshehur faktet dhe me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për veten apo personin tjetër, ose për t'i shkaktuar dëm material personit tjetër, e mashtron apo vazhdon lajthimin e personit tjetër dhe me këtë e nxit një person që të kryej apo të mos kryej një veprim në dëm të pasurisë së tij apo të pasurisë së personit tjetër, dënohet me gjobë dhe me burgim prej tre (3) muaj deri në tre (3) vjet.

2. Nëse vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni rezulton me dobi pasurore të kundërligjshme ose shkakton dëme në vlerë prej dhjetëmijë (10.000) Euro apo më shumë, kryesi dënohet me gjobë dhe me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet.
3. Nëse qëllimi i mashtrimit është përfitimi i dobisë së kundërligjshme nga fondet publike, kryesi dënohet me gjobë dhe me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet.
4. Nëse qëllimi i mashtrimit është përfitimi i dobisë së kundërligjshme nga banka, unioni kreditor apo institucioni tjetër financiar, kryesi dënohet me gjobë dhe me burgim prej një (1) deri në pesë (5) vjet.
5. Nëse vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni rezulton në dobi pasurore të kundërligjshme ose shkakton dëm që tejkalon pesëdhjetëmijë (50.000) Euro, kryesi dënohet me gjobë dhe me burgim prej tre (3) deri në dhjetë (10) vjet.
6. Nëse vlera e dobisë së përfituar është më pak se pesëdhjetë (50) Euro, kryesi dënohet me gjobë ose me burgim deri në gjashtë (6) muaj.

Neni 336
Mashtrimi me subvencione

1. Kushdo që në lidhje me aplikimin për marrjen, vazhdimin ose modifikimin e kushteve për marrjen e një subvencioni, i paraqet organit kompetent të dhëna të pasakta apo jo të plota, e që është kusht për aprovimin, vazhdimin apo modifikimin e subvencionit, ose fsheh të dhënat e tilla në kundërshtim me detyrimin për të zbuluar të dhënat e tilla organit kompetent, dënohet me gjobë ose me burgim deri në pesë (5) vjet.
2. Kushdo që përdor subvencionin e tillë në shkelje të ligjit ose për tjera qëllime nga ato për të cilat është dhënë subvencioni nga dhënësi i subvencionit, dënohet me gjobe ose me burgim deri në pesë (5) vjet.
3. Nëse vepra penale nga paragrafi 1. ose 2. i këtij neni rezulton në dobi pasurore ose në dëm pasuror që tejkalon shumën prej njëzetepesëmijë (25.000) Euro, kryesi dënohet me burgim prej një (1) deri në tetë (8) vjet.
4. Për qëllim të këtij neni, shprehja "subvencion" do të thotë dobi nga fondet publike sipas ligjit të Republikës së Kosovës, që së paku pjesërisht jepet pa konsiderata që lidhen me tregun dhe që synon stimulimin e ekonomisë.

Neni 337
Mashtrimi lidhur me pranimin e fondeve nga Komuniteti Evropian

1. Kushdo që qëllimisht përdor ose paraqet deklarata apo dokumente të rrejshme, të pasakta apo jo të plota dhe si rezultat i këtij veprimi pranon ose merr fonde në mënyrë të kundërligjshme nga buxheti i përgjithshëm i komunitetit evropian ose buxhetet e menaxhuara nga apo në emër të Komunitetit Evropian, dënohet me burgim prej një (1) deri në pesë (5) vjet.
2. Kushdo që fsheh të dhëna në shkelje të detyrimit të posaçëm për zbulimin e të dhënave të tilla dhe si rezultat i kësaj pranon apo mban në mënyrë të kundërligjshme fonde nga buxheti i përgjithshëm i komunitetit evropian ose

buxhetet e menaxhuara nga apo në emër të komunitetit evropian, dënohet me gjobë ose me burgim prej një (1) deri në tre (3) vjet.

3. Kushdo që përdor fondet nga buxheti i përgjithshëm i komunitetit evropian apo buxhetet e menaxhuara nga apo në emër të komunitetit evropian për tjera qëllime nga ato për të cilat janë dhënë, dënohet me burgim prej dy (2) deri në tetë (8) vjet.

Neni 338
Keqpërdorimi i sigurimit

1. Kushdo që me qëllim të arkëtimit të parave apo benefiteve të sigurimit nga siguruesi, e asgjëson, dëmton apo fsheh pasurinë e siguruar nga asgjësimi, dëmtimi, humbja apo vjedhja e tillë dhe pastaj e lajmëron apo e lajmëron rrejshëm asgjësimin, dëmtimin, humbjen apo vjedhjen e tillë, dënohet me gjobë dhe me burgim deri në tre (3) vjet.
2. Kushdo që me qëllim të arkëtimit të parave apo benefiteve të sigurimit për lëndim trupor apo dëmtim të shëndetit, lajmëron rrejshëm lëndimin apo dëmtimin, dënohet me gjobë dhe me burgim deri në tre (3) vjet.
3. Kushdo që me qëllim të arkëtimit të parave të sigurimit për lëndim trupor apo dëmtim të shëndetit, i shkakton vetes lëndimin apo dëmtimin e tillë dhe pastaj lajmëron lëndimin apo dëmtimin, dënohet me gjobë dhe me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në tre (3) vjet.

Neni 339
Hyrja në sistemet kompjuterike

1. Kushdo që pa autorizim dhe me qëllim që të përfitojë në mënyrë të kundërligjshme dobi pasurore për vete apo personin tjetër apo që t'i shkaktojë dëm personit tjetër, ndryshon, publikon, shlyen, asgjëson apo shkatërron të dhënat apo programet kompjuterike ose në ndonjë mënyrë tjetër hyn në sistemin kompjuterik të tjetrit, dënohet me gjobë dhe me burgim deri në (3) tre vjet.
2. Nëse vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni rezulton me dobi pasurore që tejkalon shumën prej dhjetëmijë (10.000) Euro ose me dëm material që tejkalon shumën prej dhjetëmijë (10.000) Euro, kryesi dënohet me gjobë dhe me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet.

Neni 340
Detyrimi

1. Kushdo që me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për vete apo personin tjetër, përdor forcën apo kanosjen serioze për të detyruar personin tjetër të kryej apo të mos kryejë ndonjë veprim në dëm të pasurisë së tij apo të personit tjetër, dënohet me gjobë dhe me burgim prej tre (3) muaj deri në pesë (5) vjet.
2. Nëse vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni kryhet nga kryesi i cili vepron si anëtar i grupit; kryhet me përdorimin e armës apo mjetit të rrezikshëm; ose vepra penale rezulton me dobi pasurore në shumën që tejkalon dhjetëmijë (10.000) Euro, kryesi dënohet me gjobë dhe me burgim prej një (1) deri në dhjetë (10) vjet.

Neni 341
Shantazhi

1. Kushdo që me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për vete apo personin tjetër, kanos personin tjetër se do të zbulojë diç në lidhje me të apo personat e afërm të tij që do të dëmtojë nderin apo autoritetin e tyre dhe në këtë mënyrë e detyron personin e tillë të kryej apo të mos kryejë ndonjë veprim në dëm të pasurisë së tij apo të personit tjetër, dënohet me gjobë dhe me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet.
2. Nëse vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni kryhet nga kryesi i cili vepron si anëtar i grupit apo kryhet me përdorim të armës apo mjetit të rrezikshëm ose vepra penale rezulton me dobi pasurore të kundërligjshme në shumën që tejkalon dhjetëmijë (10.000) Euro, kryesi dënohet me gjobë dhe me burgim prej një (1) deri në dhjetë (10) vjet.

Neni 342
Keqpërdorimi i besimit

1. Kushdo që gjatë përfaqësimit apo kujdesit për interesat pasurore të personit tjetër nuk i përmbush detyrimet e tij ose i keqpërdor autorizimet e tij me qëllim që vetes apo personit tjetër t'i sjellë dobi pasurore të kundërligjshme apo t'i shkaktojë dëm personit interesat pasurore të të cilit ai i përfaqëson ose pasuria e të cilit është nën kujdesin e tij, dënohet me gjobë dhe me burgim prej tre (3) muaj deri në tre (3) vjet.
2. Nëse vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni kryhet nga kujdestari, avokati apo ndonjë person tjetër që ka detyrim ligjor ndaj pronarit të pasurisë, kryesi dënohet me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet.

Neni 343
Fajdeja

1. Kushdo që për vete apo për personin tjetër pranon ose kontrakton një shumë dukshëm joproporcionale të pasurisë në këmbim të shërbimit për personin tjetër, duke shfrytëzuar gjendjen e rëndë financiare të personit të tillë, gjendjen e rëndë të banimit, varfërinë, papërvojën ose paaftësinë për të gjykuar, dënohet me gjobë dhe me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet.
2. Nëse vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni rezulton me humbje financiare në shumë prej më tepër se dhjetëmijë (10.000) Euro ose nëse kryesi ka realizuar dobi pasurore në shumë që tejkalon dhjetëmijë (10.000) Euro, kryesi dënohet me gjobë dhe me burgim prej një (1) deri në tetë (8) vjet.
3. Nëse vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni rezulton me humbje financiare në shumë prej më tepër se njëzetepesëmijë (25.000) Euro ose nëse kryesi ka realizuar dobi pasurore në shumë që tejkalon njëzetepesëmijë (25.000) Euro, kryesi dënohet me gjobë dhe me burgim prej tre (3) deri në dymbëdhjetë (12) vjet.

Neni 344
Dëmtimi i të drejtave pronësore të personit tjetër

1. Kushdo që me qëllim të pengimit të realizimit të së drejtës pronësore, tjetërson, asgjëson ose merr sendin në pronën e tij, në të cilën personi tjetër ka të drejtën e pengut, hipotekës apo të drejtën e shfrytëzimit dhe me këtë i shkakton dëm personit të tillë, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet.
2. Kushdo që me qëllim që të pengojë pagesën e borxhit kreditorit, gjatë ekzekutimit të detyrueshëm tjetërson, asgjëson ose fsheh pjesë të pasurisë dhe me këtë dëmton kreditorët, dënohet sipas paragrafit 1. të këtij neni.
3. Kushdo që me qëllim që të pengojë pagesën e borxhit kreditorit, pranon kërkesa të rreme mbi pasurinë, lidh kontratë të rreme apo në ndonjë mënyrë tjetër e përkeqëson gjendjen e tij materiale dhe me këtë zvogëlon mundësinë që kreditorët e tij të realizojnë borxhin, dënohet me dënimin nga paragrafi 1. i këtij neni.

Neni 345
Blerja, pranimi ose fshehja e sendeve të përfituara me kryerjen e veprës penale

1. Kushdo që blen, pranon, fsheh apo në ndonjë mënyrë tjetër siguron ose fsheh sendin apo pasurinë për të cilën e di se është përfituar me kryerjen e veprës penale, dënohet me burgim prej tre (3) muaj deri në tre (3) vjet.
2. Kushdo që blen, pranon, fsheh apo në ndonjë mënyrë tjetër siguron ose fsheh sendin apo pasurinë për të cilën ka mundur ta dijë se është përfituar me kryerjen e veprës penale, dënohet me burgim deri në një (1) vit.
3. Nëse sendi apo pasuria ka vlerë më tepër se pesëmijë (5.000) Euro, kryesi dënohet me burgim prej një (1) deri në tre (3) vjet.

Neni 346
Plaçkitja e mjeteve motorike

1. Kushdo që në mënyrë të kundërligjshme, hyn apo qëndron në veturën e personit tjetër apo nuk largohet nga vetura pas kërkesës së tillë të personit të ligjshëm apo të autorizuar, dënohet me burgim deri në tre (3) vjet.
2. Nëse vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni kryhet në një apo më shumë nga rrethanat në vijim, kryesi dënohet me burgim prej një (1) deri në pesë (5) vjet, nëse:
   2.1. në atë kohë në veturë kanë qenë të pranishëm një apo më shumë persona;
   2.2. kryesi është i armatosur me armë, mjet të rrezikshëm apo ndonjë send tjetër që mund të shkaktojë lëndim të rëndë trupor apo dëmtim të rëndë të shëndetit; ose
   2.3. kryesi kanos ose lëndon personin tjetër gjatë kryerjes së veprës.
3. Nëse vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni kryhet nga personi zyrtar në keqpërdorim të pozitës apo autorizimeve të tij, kryesi dënohet me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet.

KAPITULLI XXVIII
VEPRAT PENALE KUNDËR MJEDISIT, KAFSHËVE, BIMËVE DHE OBJEKTEVE KULTURORE

Neni 347
Ndotja, degradimi ose shkatërrimi i mjedisit

1. Kushdo që duke shkelur ligjin, bën ndotjen ose degradimin e ajrit, ujit apo tokës ose shfrytëzon jashtë mase burimet natyrore, dënohet me gjobë ose burgim deri në dy (2) vjet.
2. Nëse vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni kryhet nga pakujdesia, kryesi dënohet me gjobë ose me burgim deri në një (1) vit.
3. Nëse vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni rezulton me dëmtimin e shëndetit të një numri të madh të njerëzve apo me asgjësimin e plotë ose të pjesërishëm të botës shtazore, bimore ose të rezervave të ujit të pijshëm apo me ndonjë dëmtim tjetër të mjedisit me pasoja të rënda, apo me shtimin e nivelit të ndotjes në shkallë kritike, kryesi dënohet me gjobë dhe me burgim deri në pesë (5) vjet.
4. Nëse vepra penale nga paragrafi 2. i këtij neni rezulton me dëmtimin e shëndetit të një numri të madh të njerëzve apo me asgjësimin e plotë ose të pjesërishëm të botës shtazore, bimore ose të rezervave të ujit të pijshëm apo me ndonjë dëmtim tjetër të mjedisit me pasoja të rënda, apo me shtimin e nivelit të ndotjes në shkallë kritike, kryesi dënohet me gjobë dhe me burgim deri në dy (2) vjet.
5. Nëse vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni rezulton me dëmtim apo me shkatërrim të papërmirësueshëm të mjedisit ose me rrezikimin e pasurive të mbrojtura natyrore, kryesi dënohet me gjobë dhe me burgim prej një (1) deri në tetë (8) vjet.
6. Nëse vepra penale nga paragrafi 2. i këtij neni rezulton me dëmtim apo me shkatërrim të papërmirësueshëm të mjedisit ose me rrezikimin e pasurive të mbrojtura natyrore, kryesi dënohet me gjobë dhe me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet.

Neni 348
Mbajtja e paligjshme e substancave dhe e mbeturinave të rrezikshme

1. Kushdo që duke shkelur ligjin, hedh, trajton, depoziton, transporton, eksporton ose importon substanca të rrezikshme apo mbeturina që mund të shkaktojnë vdekjen ose lëndimin e rëndë trupor të ndonjë personi ose dëm substancial material të cilësisë së ajrit, tokës, ujit, kafshëve, bimëve ose pasurisë, dënohet me gjobë dhe me burgim prej një (1) deri në tre (3) vjet.
2. Kushdo që duke shkelur ligjin hedh, trajton, depoziton, transporton, eksporton ose importon substanca apo mbeturina radioaktive që mund të shkaktojnë vdekjen ose lëndimin e rëndë trupor të ndonjë personi ose dëm substancial material të cilësisë së ajrit, tokës, ujit, kafshëve, bimëve ose pasurisë, dënohet me gjobë dhe me burgim prej një (1) deri në pesë (5) vjet.
3. Nëse vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni kryhet nga pakujdesia, kryesi dënohet me gjobë ose me burgim deri në një (1) vit.

4. Nëse vepra penale nga paragrafi 2. i këtij neni kryhet nga pakujdesia, kryesi dënohet me gjobë ose me burgim deri në dy (2) vjet.
5. Nëse vepra nga paragrafi 1. ose 2. i këtij neni rezulton me vdekje ose lëndim të rëndë trupor të ndonjë personi ose me dëm substancial material të pasurisë, kafshëve apo bimëve ose me keqësimin substancial material të cilësisë së ajrit, ujit ose tokës, kryesi dënohet me gjobë dhe me burgim prej tre (3) deri në dymbëdhjetë (12) vjet.
6. Nëse vepra penale nga paragrafi 3. i këtij neni rezulton me vdekje ose lëndim të rëndë trupor të ndonjë personi ose me dëm substancial material të pasurisë, kafshëve apo bimëve ose me keqësimin substancial material të cilësisë së ajrit, ujit ose tokës, kryesi dënohet me gjobë ose me burgim prej një (1) deri në tetë (8) vjet.

Neni 349
Lejimi i kundërligjshëm i ndërtimit apo drejtimit të fabrikave dhe instalimeve që ndotin mjedisin

1. Kushdo që duke shkelur ligjin mbi mbrojtjen e mjedisit, lejon ndërtimin apo instalimin e fabrikës ose drejton apo menaxhon fabrikën ose instalimin në të cilën kryhet veprimtari e rrezikshme dhe me këtë rrezikon të shkaktojë vdekjen apo lëndimin e rëndë trupor të ndonjë personi, ndotë mjedisin, ajrin, tokën apo ujin ose shkakton dëm në shumë prej pesëmijë (5.000) Euro apo më shumë të kafshëve, bimëve ose pasurisë, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet.
2. Nëse vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni kryhet nga pakujdesia, kryesi dënohet me gjobë ose me burgim deri në një (1) vit.
3. Kushdo që duke shkelur ligjin lejon ose aplikon teknologjinë që ndot mjedisin ose territorin në shkallë të madhe, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet.
4. Nëse vepra penale nga paragrafi 3. i këtij neni rezulton me asgjësimin e plotë ose të pjesërishëm të botës shtazore, bimore ose ndotjen në shkallë të madhe për të cilën nevojitet kohë e gjatë ose shpenzime të mëdha për ta sanuar, kryesi dënohet me gjobë dhe me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet.
5. Kur shqipton dënimin për vepër penale nga ky nen, gjykata mund ta detyrojë kryesin që të ndërmerr masa të caktuara për mbrojtjen, ruajtjen dhe përmirësimin e mjedisit jetësor.

Neni 350
Dëmtimi i objekteve dhe pajisjeve për mbrojtjen e mjedisit

1. Kushdo që dëmton, shkatërron, heq apo në mënyrë tjetër i bënë të papërdorshme objektet apo pajisjet për mbrojtjen e mjedisit, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet.
2. Nëse vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni kryhet nga pakujdesia, kryesi dënohet me gjobë ose me burgim deri në një (1) vit.
3. Nëse vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni rezulton me ndotjen e ajrit, ujit apo tokës në shkallë të madhe apo territorit të gjerë, kryesi dënohet me gjobë dhe me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet.
4. Nëse vepra penale nga paragrafi 2. i këtij neni rezulton me ndotjen e ajrit, ujit apo

tokës në shkallë të madhe apo territorit të gjerë, kryesi dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet.

5. Nëse vepra penale nga paragrafi 1. dhe 3. i këtij neni rezulton me asgjësimin e plotë ose të pjesërishëm të botës shtazore, bimore ose ndotjen në shkallë të madhe të cilën nevojitet kohë e gjatë ose shpenzime të mëdha për ta sanuar, kryesi dënohet me gjobë dhe me burgim prej një (1) deri në tetë (8) vjet.
6. Nëse vepra penale nga paragrafi 2. dhe 4. i këtij neni rezulton me asgjësimin e plotë ose të pjesërishëm të botës shtazore, bimore ose ndotjen në shkallë të madhe të cilën nevojitet kohë e gjatë ose shpenzime të mëdha për ta sanuar, kryesi dënohet me gjobë dhe me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet.
7. Kur shqipton dënimin për vepër penale nga ky nen, gjykata mund ta detyrojë kryesin që të ndërmerr masa të caktuara për mbrojtjen, ruajtjen dhe përmirësimin e mjedisit jetësor.

Neni 351
Prodhimi, shitja dhe vënia në qarkullim e materieve të dëmshme për mjekimin e shtazëve

1. Kushdo që prodhon me qëllim që t'i shesë apo t'i vë në qarkullim materiet për mjekimin apo për parandalimin e sëmundjeve të shtazëve apo shpendëve, kur materiet e tilla janë të dëmshme për jetën apo shëndetin e tyre, dënohet me gjobë ose me burgim deri në një (1) vit.
2. Nëse vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni rezulton me ngordhjen e një numri të madh të shtazëve apo të shpendëve, kryesi dënohet me gjobe dhe me burgim prej tre (3) muaj deri në (3) tre vjet.
3. Nëse vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni kryhet nga pakujdesia, kryesi dënohet me gjobë ose me burgim deri në gjashtë (6) muaj.
4. Nëse vepra penale nga paragrafi 2. i këtij neni kryhet nga pakujdesia, kryesi dënohet me gjobë ose me burgim deri në një (1) vit.

Neni 352
Dhënia e ndihmës veterinare në mënyrë të pandërgjegjshme

1. Veterinari apo ndihmësi i autorizuar i veterinarit i cili me rastin e dhënies së ndihmës veterinare haptazi përshkruan ose aplikon mjetin e papërshtatshëm apo mënyrën jo të rregullt të mjekimit ose nuk përdor masat përkatëse higjienike apo në përgjithësi shkel rregullat e profesionit të veterinarisë gjatë procesit të mjekimit dhe me këtë shkakton sëmundjen, keqësimin e sëmundjes apo ngordhjen e shtazës, dënohet me gjobë ose me burgim deri në një (1) vit.
2. Nëse vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni kryhet nga pakujdesia, kryesi dënohet me gjobë ose me burgim deri në gjashtë (6) muaj.
3. Nëse vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni rezulton me ngordhjen e një numri të madh të shtazëve apo të shpezëve, kryesi dënohet me burgim prej tre (3) muaj deri në tre (3) vjet.
4. Nëse vepra penale nga paragrafi 2. i këtij neni rezulton me ngordhjen e një numri të madh të shtazëve apo të shpezëve, kryesi dënohet me gjobë ose me burgim deri në një (1) vjet.

Neni 353
Ushtrimi i kundërligjshëm i shërbimeve veterinere

Kushdo që pa përgatitje adekuate profesionale merret me shërimin e shtazëve ose ofron shërbime tjera veterinare në kompensim të pagesës, dënohet me gjobë ose me burgim deri në (6) gjashtë muaj.

Neni 354
Moszbatimi i urdhrave për luftimin e sëmundjeve të shtazëve dhe të bimëve

1. Kushdo që gjatë kohës së ndonjë epidemie e cila mund të rrezikojë blegtorinë, nuk respekton urdhrin apo vendimin e lëshuar nga organi kompetent në pajtim me ligjin me të cilin parashihen masat për luftimin apo parandalimin e sëmundjes, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet.
2. Kushdo që gjatë periudhës së rrezikut ndaj botës bimore nga sëmundja ose murtaja, nuk respekton urdhrin apo vendimin e organit kompetent me të cilin parashihen masat për luftimin apo parandalimin e sëmundjes ose të murtajës, dënohet me dënimin nga paragrafi 1. i këtij neni.
3. Nëse vepra penale nga paragrafi 1. ose 2. i këtij neni rezulton me dëm të konsiderueshëm pasuror, kryesi dënohet me gjobë ose me burgim deri në pesë (5) vjet.
4. Nëse vepra penale nga ky paragrafi 1. ose 2. i këtij neni kryhet nga pakujdesia, kryesi dënohet me gjobë ose me burgim deri në një (1) vit.
5. Nëse vepra penale nga paragrafi 3. i këtij neni kryhet nga pakujdesia, kryesi dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet.
6. Për qëllime të këtij neni, shprehja "blegtori" do të thotë çdo gjedh, bricjap, kalë, zog, shpezë, shpendë, bletë mjalti, dele, derr apo peshk.

Neni 355
Ndotja e ushqimit dhe e ujit të shtazëve

1. Kushdo që me ndonjë materie helmuese apo të dëmshme e ndot ushqimin apo ujin e shtazëve, shpezëve, bletëve, shtazëve të egra apo peshqve, ose e ndot çfarëdo furnizimi ujorë natyrorë apo të bërë nga njeriu që siguron ujë për shtazë, shpezë, bletë, shtazë të egra apo peshq dhe me këtë rrezikon jetën apo shëndetin e shtazëve, shpezëve, bletëve, shtazëve të egra apo peshqve, dënohet me gjobë ose me burgim deri në dy (2) vjet.
2. Kushdo që me ndonjë materie helmuese apo të dëmshme e ndot çfarëdo uji dhe me këtë rrezikon ekzistencën e shtazëve, shpezëve, bletëve, shtazëve të egra apo peshqve në ujë, dënohet me dënimin nga paragrafi 1. i këtij neni.
3. Nëse vepra penale nga paragrafi 1. ose 2. i këtij neni rezulton me ngordhje të një numri të madh të shtazëve, shpezëve, bletëve, shtazëve të egra apo peshqve, në vlerë që tejkalon dhjetëmijë (10.000) Euro, kryesi dënohet me gjobë dhe me burgim prej tre (3) muaj deri në (3) tre vjet.
4. Nëse vepra penale nga paragrafi 1. ose 2. i këtij neni kryhet nga pakujdesia, kryesi dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre (3) muaj. Nëse vepra penale nga

paragrafi 3. i këtij neni kryhet nga pakujdesia, kryesi dënohet me gjobë ose me burgim deri në gjashtë (6) muaj.

Neni 356
Shkatërrimi i botës bimore me materie të dëmshme

1. Kushdo që në kundërshtim me ligjin dhe me përdorimin e materies së dëmshme, shkakton shkatërrimin e bimëve, pemëve ose vegjetacionit tjetër dhe me këtë shkakton dëm në vlerë prej dhjetëmijë (10.000) Euro apo më shumë, dënohet me gjobë ose me burgim deri në dy (2) vjet.
2. Nëse vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni kryhet ndaj llojit veçanërisht të mbrojtur të bimëve, pemëve ose vegjetacionit tjetër, kryesi dënohet me gjobë ose me burgim prej tre (3) muaj deri në tre (3) vjet.
3. Nëse vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni kryhet nga pakujdesia, kryesi dënohet me gjobë ose me burgim deri në gjashtë (6) muaj. Nëse vepra penale nga paragrafi 2. i këtij neni kryhet nga pakujdesia, kryesi dënohet me gjobë ose me burgim deri në një (1) vit.

Neni 357
Shkretërimi i pyjeve

1. Kushdo që në kundërshtim me ligjin ose urdhrin e organit kompetent, bën prerjen apo shkatërrimin e pyllit ose në ndonjë mënyrë tjetër shkretëron pyjet, dënohet me gjobë ose me burgim deri në dy (2) vjet.
2. Nëse vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni kryhet në pyllin e mbrojtur, në parkun e mbrojtur ose në pyje të tjera me destinim të posaçëm, kryesi dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet.

Neni 358
Vjedhja e pyllit

1. Kushdo që me qëllim të vjedhjes pret trungjet në pyll dhe sasia e drunjve të prerë tejkalon dy (2) metra kub, dënohet me gjobë ose me burgim deri në një (1) vit.
2. Nëse vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni kryhet me qëllim që drunjtë e prerë të shiten; nëse sasia e drunjve të prerë është mbi pesë (5) metra kub; ose nëse vepra penale është kryer në pyllin e mbrojtur, në parkun e mbrojtur apo në pyllin tjetër me destinim të posaçëm, kryesi dënohet me gjobë dhe me burgim prej tre (3) muaj deri në tre (3) vjet.
3. Tentativa për të kryer veprën penale nga paragrafi 1. i këtij neni është e dënueshme.

Neni 359
Gjuetia e kundërligjshme

1. Kushdo që gjuan kafshë të egra kur gjuetia është e ndaluar ose në territorin në të cilin gjuetia është e ndaluar, dënohet me gjobë ose me burgim deri në një (1) vjet.
2. Kushdo që pa leje ose autorizim, gjuan ose mbyt një kafshë të egër ose e zë të gjallë, dënohet me gjobë ose me burgim deri në gjashtë (6) muaj.

3. Nëse vepra penale nga paragrafi 1. ose 2. i këtij neni kryhet jashtë sezonës; në grup; ose ndaj gjahut në vlerë që tejkalon dymijë (2.000) Euro ose me rëndësi sipas rregulloreve të gjuetisë, kryesi dënohet me gjobë ose me burgim deri në dy (2) vjet.
4. Kushdo që gjuan lloje të rrezikuara ose të rralla të kafshëve, gjuetia e të cilave është e ndaluar, ose gjuan lloje të posaçme pa pasur lejen e veçantë për atë lloj gjahu, dënohet me gjobë dhe me burgim prej tre (3) muaj deri në tre (3) vjet.
5. Kushdo që gjuan duke përdorur metoda të asgjësimit masiv, duke përdorur automjetin ose duke përdorur dritën e fortë, dënohet me gjobë dhe me burgim prej tre (3) muaj deri në tre (3) vjet.
6. Kafshët e egra dhe pajisjet e gjuetisë konfiskohen.

Neni 360
Shitja ose nxjerrja e trofeve të kafshëve të egra jashtë Republikës së Kosovës

1. Kushdo që në mënyrë të kundërligjshme shet apo nxjerr jashtë Republikës së Kosovës trofenë nga kafshët e egra, dënohet me gjobë ose me burgim deri në dy (2) vjet.
2. Kushdo që në mënyrë të kundërligjshme shet apo nxjerr jashtë Republikës së Kosovës trofenë nga kafshët e egra të fituar me anë të veprës penale nga paragrafët 1. deri 3. të nenit 359 të këtij Kodi, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet.
3. Trofetë e kafshëve të egra konfiskohen.

Neni 361
Shitja ose nxjerrja e të mirave natyrore, bimëve ose kafshëve posaçërisht të mbrojtura jashtë Republikës së Kosovës

Kushdo që në mënyrë të kundërligjshme shet apo nxjerrë jashtë Republikës së Kosovës të mira, bimë apo kafshë posaçërisht të mbrojtura, dënohet me gjobë ose me burgim deri në dy (2) vjet.

Neni 362
Peshkimi i kundërligjshëm

1. Kushdo që peshkon gjatë kohës kur peshkimi është i ndaluar apo në ujërat ku peshkimi është i ndaluar, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre (3) muaj.
2. Kushdo që peshkon duke përdorur eksploziv, rrymë elektrike, helm ose mjete helmuese dhe me këtë shkakton ngordhjen e peshqve në mënyrë të tillë që të dëmtojë shumimin e peshqve, dënohet me gjobë ose me burgim deri në dy (2) vjet.

Neni 363
Dëmtimi, shkatërrimi dhe nxjerrja e paautorizuar e monumenteve ose objekteve të mbrojtura jashtë Republikës së Kosovës

1. Kushdo që dëmton ose shkatërron monumentin ose objektin e mbrojtur kulturor, historik, fetar, shkencor apo natyror, dënohet me gjobë ose me burgim deri në dy (2) vjet.

2. Nëse vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni kryhet ndaj monumentit ose objektit të mbrojtur kulturor, historik, fetar, shkencor apo natyror që kanë vlerë të posaçme ose nëse vepra penale rezulton me dëm të rëndë, kryesi dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet.
3. Kushdo që pa autorizimin përkatës të organit kompetent nxjerrë jashtë Republikës së Kosovës monumentin ose objektin e mbrojtur kulturor, historik, fetar, shkencor apo natyror, dënohet me gjobë ose me burgim deri në një (1) vit.
4. Nëse vepra penale nga paragrafi 3. i këtij neni ka të bëjë me monumentin ose objektin e mbrojtur kulturor, historik, fetar, shkencor apo natyror me vlerë të posaçme, kryesi dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet.
5. Për qëllime të këtij neni, shprehja "monument ose objekt i mbrojtur kulturor, historik, fetar, shkencor apo natyror" do të thotë objekt nderimi i një komuniteti fetar i cili ndodhet në pronën e caktuar për shërbime fetare, gur varri, varr apo vend tjetër i varrimit, monument publik, monument natyror, objekt artistik, shkencor apo artizanat i cili ruhet në koleksione publike ose në ekspozita publike, objekt i cili shërben për ndonjë nevojë publike ose zbukuron rrugën publike, sheshin apo parkun, atraksion natyror apo një lloj të rrezikuar i kafshëve ose bimëve.
6. Tentativa për të kryer vepër penale nga paragrafi 1. ose 3. i këtij neni është e dënueshme.

Neni 364
Punimet e paautorizuara dhe përvetësimi i monumenteve kulturore

1. Kushdo që pa autorizimin e organit kompetent kryen punë të konservimit, restaurimit apo punime hulumtuese në ndonjë monument kulturor, ose përkundër ndalimit ose joautorizimit, kryen gërmime apo hulumtime arkeologjike dhe me këtë e shkatërron ose e dëmton rëndë monumentin kulturor apo karakteristikat e tij, dënohet me gjobë ose me burgim deri në dy (2) vjet.
2. Nëse vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni kryhet ndaj monumentit kulturor me vlerë apo me rëndësi të posaçme ose rezulton me dëm të madh, kryesi dënohet me gjobë dhe me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në tri (3) vjet.
3. Kushdo që gjatë hulumtimeve arkeologjike apo të hulumtimeve të tjera përvetëson ose merr objektin e gërmuar apo objektin e gjetur në ndonjë mënyrë tjetër i cili paraqet monument kulturor, dënohet me dënimin nga paragrafi 2. i këtij neni.

KAPITULLI XXIX
VEPRAT PENALE KUNDËR SIGURISË SË PËRGJITHSHME TË NJERËZVE DHE PASURISË

Neni 365
Shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm

1. Kushdo që me anë të zjarrit, vërshimeve, armëve, eksplozivit, helmit ose gazit helmues, rrezatimit jonizues, forcës mekanike, me energji elektrike ose me ndonjë lloj energjie tjetër, ose me ndonjë veprim tjetër të rrezikshëm apo mjete të rrezikshme, shkakton rrezik të madh për jetën e njerëzve apo dëm të konsiderueshëm pasuror, dënohet me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet.

2. Kushdo që në kundërshtim me detyrimet e përcaktuara me ligj nuk i vendos pajisjet për mbrojtjen nga zjarri, vërshimi, eksplodimi, helmimi ose për mbrojtjen nga gazrat helmuese, rrezatimi jonizues, forcat mekanike, energjia elektrike ose nga ndonjë lloj energjie tjetër, ose me ndonjë veprim tjetër të rrezikshëm apo mjete të rrezikshme, apo këto pajisje nuk i mirëmban në gjendje të rregullt apo nuk i vë në përdorim ose në përgjithësi nuk vepron sipas rregullave ose rregulloreve teknike mbi masat mbrojtëse dhe me këtë shkakton rrezik të madh për jetën e njerëzve apo dëm të konsiderueshëm pasuror, dënohet me burgim prej një(1) deri në pesë (5) vjet.
3. Nëse vepra penale nga paragrafi 1. ose 2. i këtij neni kryhet në vendin ku janë të pranishëm një numër i madh i njerëzve, kryesi dënohet me burgim prej një (1) deri në tetë (8) vjet.
4. Nëse vepra penale nga paragrafi 1. ose 2. i këtij neni rezulton me lëndim të rëndë trupor apo me dëm substancial pasuror kryesi dënohet me burgim prej një (1) deri në dhjetë (10) vjet.
5. Nëse vepra penale nga paragrafi 1. ose 2. i këtij neni rezulton me vdekjen e një apo më shumë personave, kryesi dënohet me burgim prej tre (3) deri në dymbëdhjetë (12) vjet.
6. Nëse vepra penale nga paragrafi 1. ose 2. i këtij neni kryhet nga pakujdesia, kryesi dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet.
7. Nëse vepra penale nga paragrafi 6. i këtij neni kryhet në vendin ku janë të pranishëm një numër i madh i njerëzve, kryesi dënohet me burgim deri në pesë (5) vjet.
8. Nëse vepra penale nga paragrafi 6. i këtij neni rezulton me lëndim të rëndë trupor ose dëm substancial pasuror kryesi dënohet me burgim deri në pesë (5) vjet.
9. Nëse vepra penale nga paragrafi 6. i këtij neni rezulton me vdekjen e një apo më shumë personave, kryesi dënohet me burgim prej një (1) deri në tetë (8) vjet.

Neni 366
Asgjësimi, dëmtimi ose heqja e instalimeve publike

1. Kushdo që asgjëson, dëmton apo i heq pajisjet apo instalimet e përçuesve elektrik, të gazit, të ujit, të ngrohjes, të pajisjeve telekomunikuese, të pajisjeve të kanalizimit, të pajisjeve për mbrojtjen e mjedisit, naftësjellësve, kabllove nënujore, të pendave ose të pajisjeve të tjera të ngjashme dhe me këtë shkakton çrregullime në furnizimin e popullsisë apo të ekonomisë, dënohet me burgim deri në pesë (5) vjet.
2. Nëse vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni kryhet nga pakujdesia, kryesi dënohet me gjobë ose me burgim deri në një (1) vit.
3. Nëse vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni rezulton me lëndim të rëndë trupor apo me dëm substancial pasuror, kryesi dënohet me burgim prej një (1) deri në tetë (8) vjet.
4. Nëse vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni rezulton me vdekjen e një apo më shumë personave, kryesi dënohet me burgim prej tre (3) deri në dymbëdhjetë (12) vjet.
5. Nëse vepra penale nga paragrafi 2. i këtij neni rezulton me lëndim të rëndë trupor ose dëm substancial pasuror, kryesi dënohet me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet.

6. Nëse vepra penale nga paragrafi 2. i këtij neni rezulton me vdekjen e një apo më shumë personave, kryesi dënohet me burgim prej një (1) deri në tetë (8) vjet.

Neni 367
Asgjësimi, dëmtimi ose heqja e pajisjeve mbrojtëse dhe rrezikimi i sigurisë në vendin e punës

1. Kushdo që asgjëson, dëmton ose heq pajisjen mbrojtëse nga cilido vend i punës dhe me këtë rrezikon jetën e njerëzve ose shkakton dëm pasuror dënohet me burgim prej një (1) deri në tetë (8) vjet.
2. Kushdo që është përgjegjës për sigurinë dhe shëndetin në vendin e punës dhe i cili nuk i instalon pajisjet mbrojtëse, nuk i mirëmban ato në gjendje të rregullt për punë, nuk siguron përdorimin e tyre kur është e nevojshme apo nuk vepron në pajtim me dispozitat apo rregullat teknike mbi masat për sigurinë në vendin e punës dhe me këtë rrezikon jetën e njerëzve ose shkakton dëm të konsiderueshëm pasuror, dënohet me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet.
3. Nëse vepra penale nga paragrafi 1. ose 2. i këtij neni kryhet nga pakujdesia, kryesi dënohet me burgim deri në tre (3) vjet.
4. Nëse vepra penale nga paragrafi 1. ose 2. i këtij neni rezulton me lëndim të rëndë trupor të një apo më shumë personave ose me dëm substancial pasuror, kryesi dënohet me burgim prej një (1) deri në dhjetë (10) vjet.
5. Nëse vepra penale nga paragrafi 3. i këtij neni rezulton me lëndim të rëndë trupor të një apo më shumë personave ose me dëm substancial material, kryesi dënohet me burgim deri në pesë (5) vjet.
6. Nëse vepra penale nga paragrafi 1. ose 2. i këtij neni rezulton me vdekjen e një apo më shumë personave, kryesi dënohet me burgim prej një (1) deri në dymbëdhjetë (12) vjet.
7. Nëse vepra penale nga paragrafi 3. i këtij neni rezulton me vdekjen e një apo më shumë personave, kryesi dënohet me burgim prej një (1) deri në tetë (8) vjet.
8. Gjykata mund t'ia shqiptojë kryesit kushtin që të instalojë pajisjet e sigurisë brenda afatit kohor të caktuar.

Neni 368
Punimet ndërtimore të kundërligjshme

1. Personi përgjegjës i cili me rastin e projektimit, mbikëqyrjes apo kryerjes së ndonjë ndërtimi apo të punëve ndërtimore vepron në shkelje të ligjit apo në kundërshtim me standardet profesionale përgjithësisht të pranuara ose në kundërshtim me kushtet e lejes së ndërtimit dhe me këtë rrezikon jetën apo trupin e njerëzve ose të pasurisë me vlerë prej pesëmijë (5.000) Euro apo më shumë, dënohet me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet.
2. Nëse vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni kryhet nga pakujdesia, kryesi dënohet me burgim deri në tre (3) vjet.
3. Nëse vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni rezulton me lëndim të rëndë trupor apo me dëm të konsiderueshëm pasuror apo më shumë, kryesi dënohet me burgim prej një (1) deri në tetë (8) vjet.

4. Nëse vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni rezulton me vdekjen e një apo më shumë personave, kryesi dënohet me burgim prej tre (3) deri në dymbëdhjetë (12) vjet.
5. Nëse vepra penale nga paragrafi 2. i këtij neni rezulton me lëndim të rëndë trupor apo me dëm konsiderueshëm pasuror, kryesi dënohet me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet.
6. Nëse vepra penale nga paragrafi 2. i këtij neni rezulton me vdekjen e një apo më shumë personave, kryesi dënohet me burgim prej një (1) deri në tetë (8) vjet.

Neni 369
Dërgimi apo transportimi i kundërligjshëm i lëndëve eksplozive ose lëndëve ndezëse

1. Kushdo që në kundërshtim me ligjin transporton ose dërgon për transport lëndë eksplozive ose lëndë që mund të ndizen lehtë, dënohet me gjobë ose me burgim deri në një vit.
2. Nëse vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni kryhet nga personi i cili dërgon lëndët eksplozive ose lëndët që mund të ndizen lehtë për transportim me mjetet e transportit publik ose vetë transporton lëndë të tilla duke shfrytëzuar mjetet e transportit publik, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet.
3. Kushdo që në kundërshtim me ligjin dërgon lëndë eksplozive ose lëndë që mund të ndizen lehtë në lokalet ku mblidhen numër i madh i njerëzve, në lokalet ku grumbullohen numër i madh i njerëzve apo në lokalet ku priten një numër i madh i njerëzve, dënohet me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në tre (3) vjet.
4. Nëse vepra penale nga ky nen kryhet nga pakujdesia, kryesi dënohet me gjobë ose me burgim deri në një (1) vit.

Neni 370
Mos evitimi i rrezikut

1. Kushdo që nuk ndërmerr masa për evitimin e zjarrit, vërshimit, eksplodimit, fatkeqësisë në trafik apo të ndonjë rreziku tjetër për jetën ose sigurinë fizike të njerëzve apo të pasurisë në shkallë të madhe, ndonëse këtë ka mundur ta bëjë pa e rrezikuar veten apo ndonjë person tjetër, dënohet me gjobë ose me burgim deri në një (1) vit.
2. Kushdo që parandalon apo pengon personin tjetër nga ndërmarrja e masave për evitimin e zjarrit, vërshimit, eksplodimit, fatkeqësisë së trafikut apo të ndonjë rreziku tjetër për jetën apo sigurinë fizike të njerëzve apo të pasurisë në shkallë të madhe, dënohet me burgim prej tre (3) muaj deri në tre (3) vjet.

Neni 371
Keqpërdorimi i sinjalit të fatkeqësisë apo të rrezikut

Kushdo që keqpërdor ndonjë shenjë apo sinjal të fatkeqësisë apo rrezikut ose bën thirrje të pabazuar për ndihmë me qëllim që të bëjë personat zyrtar apo zjarrfikësit të ndërmarrin ndonjë veprim apo të mos ndërmarrin ndonjë veprim, dënohet me gjobë ose me burgim deri në gjashtë (6) muaj.

KAPITULLI XXX
VEPRAT PENALE TË ARMËVE

Neni 372
Importi, eksporti, furnizimi, transportimi, prodhimi, këmbimi, ndërmjetësimi ose shitja e paautorizuar e armëve apo materieve plasëse

1. Kushdo që në shkelje të ligjit të zbatueshëm në lidhje me armët apo materiet plasëse, importon, eksporton, blen, furnizon, transporton, prodhon, këmben, ndërmjetëson ose shet armë apo materie plasëse, dënohet me gjobë deri në shtatëmijepesëqind (7.500) Euro dhe me burgim prej një (1) deri në tetë (8) vjet.
2. Nëse vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni përfshin më shumë se katër armë, më shumë se katër (4) materie plasëse apo më shumë se katërqind (400) fishekë, kryesi dënohet me gjobë dhe me burgim prej një (1) deri në dhjetë (10) vjet.
3. Për qëllime të këtij neni, shprehja "prodhim" i armëve përfshin shndërrimin apo modifikimin e ndonjë sendi në armë ose të një arme në një lloj tjetër të armës, apo deaktivizimin ose riaktivizimin e ndonjë arme.
4. Armët, mjetet për transportimin e armëve dhe mjetet për prodhimin e armëve konfiskohen.

Neni 373
Fshirja, heqja apo ndryshimi i kundërligjshëm i shenjave në armë të zjarrit apo në municion

1. Kushdo që fshin, heq apo ndryshon shenjat në armë të zjarrit apo municion ose kushdo që e shënjon një armë të zjarrit apo municion me shenja të rrejshme, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet.
2. Kushdo që prodhon armën e zjarrit apo municionin dhe nuk e shënjon armën e zjarrit apo municionin në kohën e prodhimit sipas ligjit të zbatueshëm lidhur me shënjimin e armëve, dënohet me gjobë dhe me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet.
3. Nëse vepra penale nga paragrafi 1. ose 2. i këtij neni përfshin më shumë se katër (4) armë ose më shumë se katërqind (400) fishekë, kryesi dënohet me gjobë dhe me burgim prej një (1) deri në pesë (5) vjet.
4. Për qëllime të këtij neni, shprehja "shenjë" do të thotë një shenjë identifikuese e cila vendoset në armën e zjarrit apo në municion nga prodhuesi ose nga organi kompetent shtetëror.
5. Arma e zjarrit apo municioni konfiskohen. Mjeti i cili përdoret për fshirjen, heqjen apo ndryshimin e shenjës apo për shënjimin e rrejshëm konfiskohet.

Neni 374
Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve

1. Kushdo që mban në pronësi, kontrollon ose posedon armë në shkelje me ligjin e zbatueshëm lidhur me armë të tilla, dënohet me gjobë deri në shtatëmijë e pesëqind (7.500) Euro ose me burgim deri në pesë (5) vjet.

2. Nëse vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni përfshin më shumë se katër (4) armë ose më shumë se katërqind (400) fishekë, kryesi dënohet me burgim prej dy (2) deri në dhjetë (10) vjet.
3. Arma në pronësi, kontroll apo posedim në shkelje të këtij neni konfiskohet.

Neni 375
Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm

1. Kushdo që përdorë armë apo materie plasëse në shkelje me ligjin e zbatueshëm lidhur me armët apo materiet plasëse të tilla, dënohet me burgim prej një (1) deri në tetë (8) vjet.
2. Kushdo që përdor armën apo mjetin e rrezikshëm në mënyrë kërcënuese ose frikësuese, dënohet me gjobë deri në dhjetëmijë (10.000) Euro dhe me burgim prej një (1) deri në dhjetë (10) vjet.
3. Arma apo mjeti i rrezikshëm i përdorur në shkelje të këtij neni konfiskohet.

Neni 376
Lejet, pëlqimet dhe licencat e rreme të armëve dhe dhënia e informatave te rreme

1. Kushdo që jep informata të rreme, qoftë gojarisht apo me shkrim, në cilëndo fazë të procedurës së aplikimit për leje, pëlqim apo licencë të mbajtjes së armës apo mjetit plasës, dënohet me gjobë deri në pesëmijë (5.000) Euro ose me burgim deri në tre (3) vjet.
2. Kushdo që prodhon, posedon, shet ose blen leje, pëlqim apo licencë të rreme të mbajtjes së armës apo mjetit plasës, dënohet me gjobë deri në pesëmijë (5.000) Euro ose me burgim deri në tre (3) vjet.
3. Kushdo që mban lejen, licencën apo ndonjë autorizim tjetër për mbajtjen e armëve apo mjeteve plasëse dhe nuk ia tregon menjëherë lejen, licencën apo autorizimin tjetër policisë apo KFOR-it sipas kërkesës së tyre, dënohet me gjobë deri në dymijë e pesëqind (2.500) Euro ose me burgim deri në tre (3) muaj. Nëse kryesi nuk e ka lejen apo licencën në posedim në kohën e kërkesës dhe ai nuk njofton policinë apo KFOR-in për vendndodhjen e lejes, licencës apo autorizimit tjetër, kryesi dënohet me gjobë deri në dymijë e pesëqind (2.500) Euro ose me burgim deri në tre (3) muaj.
4. Leja, licenca apo autorizimi tjetër i rremë konfiskohet. Mjetet për prodhimin e lejes, licencës apo autorizimit tjetër të rremë konfiskohen.

Neni 377
Prodhimi dhe sigurimi i armëve dhe mjeteve për kryerjen e veprave penale

1. Kushdo që prodhon, siguron ose i mundëson personit tjetër që të sigurojë armë apo helme ose pajisje tjera të nevojshme për prodhimin e tyre, për të cilat e di se janë të destinuara për përdorimin ose kryerjen e veprës penale, dënohet me burgim prej tre (3) muaj deri në pesë (5) vjet.
2. Kushdo që prodhon, siguron ose i mundëson personit tjetër që të siguroj çelës të falsifikuar, kallauz ose pajisje tjera për përdorim në plaçkitje, për të cilat e di se janë

të destinuara për përdorimin ose kryerjen e veprës penale, dënohet me burgim deri në një (1) vit.

KAPITULLI XXXI
VEPRAT PENALE KUNDËR SIGURISË SË TRAFIKUT PUBLIK

Neni 378
Rrezikimi i trafikut publik

1. Kushdo që shkel ligjin mbi trafikun publik apo transportin rrugor dhe rrezikon jetën e njerëzve apo pasurinë dhe me këtë i shkakton dikujt lëndim të lehtë trupor ose dëm pasuror, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet.
2. Kushdo që shkel cilindo ligj mbi trafikun rrugor apo transportin rrugor dhe me këtë rrezikon trafikun hekurudhor, me tramvaj, me trolejbus, me autobus, me teleferik ose trafikun ujor dhe në këtë mënyrë rrezikon jetën e njerëzve, sigurinë fizike ose pasurinë, dënohet me burgim deri në pesë (5) vjet.
3. Nëse vepra penale nga paragrafi 2. i këtij neni rezulton me lëndim të lehtë trupor të ndonjë personi ose dëm pasuror në vlerë prej pesëmbëdhjetë mijë (15.000) Euro apo më shumë, kryesi dënohet me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet.
4. Nëse vepra penale nga paragrafi 1. ose 2. i këtij neni rezulton me lëndim të rëndë trupor të ndonjë personi ose dëm pasuror në vlerë prej njëzetmijë (20.000) Euro apo më shumë, kryesi dënohet me burgim prej një (1) deri në tetë (8) vjet.
5. Nëse vepra penale nga paragrafi 1. ose 2. i këtij neni rezulton me vdekjen e një apo më shumë personave, kryesi dënohet me burgim prej tre (3) deri në dymbëdhjetë (12) vjet.
6. Nëse vepra penale nga paragrafi 1. ose 2. i këtij neni kryhet nga pakujdesia, kryesi dënohet me gjobë ose me burgim deri në një (1) vit.
7. Nëse vepra penale nga paragrafi 6. i këtij neni rezulton me lëndim të lehtë trupor të ndonjë personi ose dëm pasuror në vlerë prej pesëmbëdhjetë mijë (15.000) Euro apo më shumë, kryesi dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet.
8. Nëse vepra penale nga paragrafi 6. i këtij neni rezulton me lëndim të rëndë trupor ose dëm pasuror në vlerë prej njëzetmijë (20.000) Euro apo më shumë, kryesi dënohet me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet.
9. Nëse vepra penale nga paragrafi 6. i këtij neni rezulton me vdekjen e një apo më shumë personave, kryesi dënohet me burgim prej një (1) deri në tetë (8) vjet.

Neni 379
Ngasja në gjendje të paaftë apo të dehur

1. Kushdo që drejton automjetin në gjendje të paaftë apo nën ndikim të alkoolit apo të substancave tjera dehëse, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet.
2. Nëse vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni rezulton me lëndim të lehtë trupor të ndonjë personi ose dëm pasuror në vlerë prej pesëmijë (5.000) Euro apo më shumë, kryesi dënohet me gjobë ose me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet.
3. Nëse vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni rezulton me lëndim të rëndë trupor të ndonjë personi ose dëm pasuror në vlerë prej njëzetmijë (20.000) Euro apo më shumë, kryesi dënohet me burgim prej një (1) deri në tetë (8) vjet.

4. Nëse vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni rezulton me vdekjen e një apo më shumë personave, kryesi dënohet me burgim prej tre (3) deri në dymbëdhjetë (12) vjet.

Neni 380
Rrezikimi i trafikut publik me veprime apo mjete të rrezikshme

1. Kushdo që asgjëson, heq ose dëmton rëndë instalimet, pajisjet, shenjat apo sinjalizimet që shërbejnë për sigurinë e trafikut, ose jep shenja ose sinjale të gabueshme ose vë pengesa në rrugët publike apo në ndonjë mënyrë tjetër e rrezikon jetën e njeriut apo sigurinë fizike, dënohet me burgim deri në tre (3) vjet.
2. Nëse vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni rezulton me lëndim të lehtë trupor të ndonjë personi ose dëm të konsiderueshëm pasuror, kryesi dënohet me gjobë ose me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet.
3. Nëse vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni rezulton me lëndim të rëndë trupor ose dëm substancial pasuror, kryesi dënohet me burgim prej një (1) deri në tetë (8) vjet.
4. Nëse vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni rezulton me vdekjen e një apo më shumë personave, kryesi dënohet me burgim prej tre (3) deri në dymbëdhjetë (12) vjet.
5. Nëse vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni kryhet nga pakujdesia, kryesi dënohet me gjobë ose me burgim deri në një (1) vit.
6. Nëse vepra penale nga paragrafi 5. i këtij neni rezulton me lëndim të lehtë trupor të ndonjë personi ose dëm të konsiderueshëm pasuror, kryesi dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet.
7. Nëse vepra penale nga paragrafi 5. i këtij neni rezulton me lëndim të rëndë trupor ose dëm substancial pasuror, kryesi dënohet me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet.
8. Nëse vepra penale nga paragrafi 5. i këtij neni rezulton me vdekjen e një apo më shumë personave, kryesi dënohet me burgim prej një (1) deri në tetë (8) vjet.

Neni 381
Mbikëqyrja e pandërgjegjshme e trafikut publik

1. Personi përgjegjës, të cilit i është besuar mbikëqyrja e gjendjes dhe e mirëmbajtjes së rrugëve dhe e objekteve në to, e mjeteve të transportit, plotësimi i kushteve të përcaktuara të punës për ngasës, ose personi përgjegjës të cilit i është besuar menaxhimi i ngasjes, i cili me ushtrimin e pandërgjegjshëm të detyrës së vet rrezikon jetën e njeriut, sigurinë fizike ose shkakton dëm pasuror, dënohet me gjobë ose me burgim deri në pesë (5) vjet.
2. Kushdo që është përgjegjës për dhënien e urdhrave për ngasje apo që lejon tjetrin të ngas edhe pse e di se ngasësi për shkak të lodhjes, sëmundjes, dehjes me alkool apo shkaqeve të tjera nuk është në gjendje që në mënyrë të sigurt të drejtojë automjetin, ose automjeti nuk është në gjendje të rregullt dhe me këtë rrezikon jetën e njeriut, sigurinë fizike ose shkakton dëm pasuror, dënohet me dënimin nga paragrafi 1. i këtij neni.

3. Nëse vepra penale nga paragrafi 1. ose 2. i këtij neni kryhet nga pakujdesia, kryesi dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet.
4. Nëse vepra penale nga paragrafi 1. ose 2. i këtij neni rezulton me lëndim të rëndë trupor ose dëm substancial pasuror, kryesi dënohet me burgim prej një (1) deri në tetë (8) vjet.
5. Nëse vepra penale nga paragrafi 1. ose 2. i këtij neni rezulton me vdekjen e një apo më shumë personave, kryesi dënohet me burgim prej tre (3) deri në dymbëdhjetë (12) vjet.
6. Nëse vepra penale nga paragrafi 3. i këtij neni rezulton me lëndim të rëndë trupor ose dëm substancial pasuror, kryesi dënohet me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet.
7. Nëse vepra penale nga paragrafi 3. i këtij neni rezulton me vdekjen e një apo më shumë personave, kryesi dënohet me burgim prej një (1) deri në tetë (8) vjet.

Neni 382
Mosdhënia e ndihmës personit të lënduar në fatkeqësinë e trafikut publik

1. Ngasësi i automjetit ose i mjetit tjetër të transportit, i cili nuk i ofron ndihmë personit të lënduar me atë mjet të transportit, dënohet me burgim deri në një (1) vit.
2. Nëse vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni rezulton me lëndim të rëndë trupor, kryesi dënohet me burgim prej tre (3) muaj deri në pesë (5) vjet.
3. Nëse vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni rezulton me vdekjen e personit të lënduar, kryesi dënohet me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet.

Neni 383
Keqpërdorimi i sinjaleve ndërkombëtare të komunikacionit

Kushdo që pa nevojë dërgon sinjalin e pranuar ndërkombëtarisht të komunikimit ose sinjalin e shfrytëzuar ndërkombëtarisht të fatkeqësisë apo sinjalin e rrezikut, ose mashtron se nuk ka rrezik ose keqpërdor sinjalin e pranuar ndërkombëtarisht të komunikimit, dënohet me burgim prej tre (3) muaj deri në tre (3) vjet.

KAPITULLI XXXII
VEPRAT PENALE KUNDËR ADMINISTRIMIT TË DREJTËSISË DHE ADMINISTRATËS PUBLIKE

Neni 384
Përkufizimet

Për qëllime të këtij Kapitulli, shprehja "procedurë zyrtare" nënkupton çfarëdo procedure penale siç përkufizohet në Kodin e Procedurës Penale të Kosovës; procedurat pranë cilësdo gjykatë dhe Gjykatës Kushtetuese; procedurën pranë Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe kuvendeve komunale; ose ndonjë procedurë e autorizuar me ligj pranë ndonjë ministrie, agjencie apo institucioni të pavarur të Republikës së Kosovës, përfshirë procedurat disiplinore dhe procedurat e noterisë.

Neni 385
Moslajmërimi i përgatitjes së veprave penale

1. Kushdo që duke qenë në dijeni për përgatitjen e kryerjes së ndonjë vepre penale, nuk e lajmëron këtë fakt në kohën kur kryerja e veprës penale ende ka mund të evitohet ndërsa vepra penale është kryer ose është tentuar, dënohet me gjobë ose me burgim deri në një (1) vit.
2. Kushdo që nuk lajmëron përgatitjen për kryerjen e një apo më shumë prej veprave penale në vijim, dënohet me burgim prej tre (3) muaj deri në tre (3) vjet.
   2.1. vrasja e rëndë;
   2.2. vrasja;
   2.3. sulmi me lëndim të rëndë trupor;
   2.4. ndonjë vepër penale nga Kapitulli XIV – Veprat penale kundër rendit kushtetues dhe sigurisë së Republikës së Kosovës;
   2.5. ndonjë vepër penale nga Kapitulli XV – Veprat penale kundër njerëzimit dhe vlerave të mbrojtura me të drejtën ndërkombëtare;
   2.6. ndonjë vepër penale nga Kapitulli XX – Veprat penale kundër integritetit seksual;
   2.7. ndonjë vepër penale nga Kapitulli XXXIV – Veprat penale kundër korrupsionit zyrtar dhe detyrës zyrtare;
   2.8. ndonjë vepër penale nga Kapitulli XXIII – Veprat penale të narkotikëve;
   2.9. ndonjë vepër penale nga Kapitulli XXX – Veprat penale të armëve;
3. Me përjashtim të veprave penale që përfshijnë abuzimin e fëmijëve dhe dhunën në familje, personi nuk është penalisht përgjegjës sipas paragrafit 1. të këtij neni nëse është në lidhje familjare me kryesin e veprës penale si prind, fëmijë, bashkëshort ose bashkëshorte, vëlla ose motër, prind adoptues apo fëmijë i adoptuar ose person me të cilin kryesi jeton në bashkësi jashtëmartesore.

Neni 386
Moslajmërimi i veprave penale apo kryesve të tyre

1. Kushdo që është në dijeni për identitetin e kryesit të një apo më shumë prej veprave penale në vijim dhe nuk e lajmëron faktin e tillë, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet.
   1.1. vrasja e rëndë;
   1.2. vrasja;
   1.3. sulmi me lëndim të rëndë trupor;
   1.4. ndonjë vepër penale nga Kapitulli XIV – Veprat penale kundër rendit kushtetues dhe sigurisë së Republikës së Kosovës;
   1.5. ndonjë vepër penale nga Kapitulli XV – Veprat penale kundër njerëzimit dhe vlerave të mbrojtura me të drejtën ndërkombëtare;
   1.6. ndonjë vepër penale nga Kapitulli XX – Veprat penale kundër integritetit seksual;
   1.7. ndonjë vepër penale nga Kapitulli XXXIV – Veprat penale kundër korrupsionit zyrtar dhe detyrës zyrtare;
   1.8. ndonjë vepër penale nga Kapitulli XXIII – Veprat penale të narkotikëve;
   1.9. ndonjë vepër penale nga Kapitulli XXX – Veprat penale të armëve;

2. Personi zyrtar apo personi përgjegjës i cili nuk e lajmëron veprën penale të cilën e ka zbuluar gjatë ushtrimit të detyrës së tij, dënohet me dënimin nga paragrafi 1. i këtij neni, nëse vepra e tillë është e dënueshme me së paku tre (3) vjet burgim.
3. Me përjashtim të veprave penale që përfshijnë abuzimin e fëmijëve dhe dhunën në familje, personi nuk është penalisht përgjegjës sipas këtij neni nëse është në lidhje familjare me kryesin e veprës penale si prind, fëmijë, bashkëshort ose bashkëshorte, vëlla ose motër, prind adoptues apo fëmijë i adoptuar ose person me të cilin kryesi jeton në bashkësi jashtëmartesore.

Neni 387
Moslajmërimi i personit të akuzuar nga tribunali ndërkombëtar penal

1. Kushdo që është në dijeni për aktakuzën dhe vendndodhjen e personit të akuzuar nga tribunali ndërkombëtar penal dhe nuk lajmëron për vendndodhjen e tillë edhe pse zbulimi në kohën e duhur i personit të kërkuar varet nga lajmërimi i tillë, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet.
2. Personi nuk është penalisht përgjegjës sipas këtij neni nëse është në lidhje familjare me kryesin e veprës penale si prind, fëmijë, bashkëshort ose bashkëshorte, vëlla ose motër, prind adoptues apo fëmijë i adoptuar ose person me të cilin kryesi jeton në bashkësi jashtëmartesore.

Neni 388
Dhënia e ndihmës kryesve pas kryerjes së veprave penale

1. Kushdo që strehon kryesin e ndonjë vepre penale, përveç veprave penale të parapara në paragrafin 2. të këtij neni, ose e ndihmon atë në shmangien e zbulimit ose arrestimit përmes fshehjes së mjeteve, provave apo në ndonjë mënyrë tjetër, ose kushdo që strehon personin e dënuar apo ndërmerr veprime për pengimin e arrestimit, ekzekutimit të dënimit apo urdhrit për trajtim të detyrueshëm, dënohet me gjobë ose me burgim deri në një (1) vit.
2. Nëse vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni ka të bëjë me një apo më shumë prej veprave penale në vijim, kryesi dënohet me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet:
   2.1. vrasja e rëndë;
   2.2. vrasja;
   2.3. sulmi me lëndim të rëndë trupor;
   2.4. ndonjë vepër penale nga Kapitulli XIV – Veprat penale kundër rendit kushtetues dhe sigurisë së Republikës së Kosovës;
   2.5. ndonjë vepër penale nga Kapitulli XIV – Veprat penale kundër njerëzimit dhe vlerave të mbrojtura me të drejtën ndërkombëtare;
   2.6. ndonjë vepër penale nga Kapitulli XX – Veprat penale kundër integritetit seksual;
   2.7. ndonjë vepër penale nga Kapitulli XXXIV – Veprat penale kundër korrupsionit zyrtar dhe detyrës zyrtare;
   2.8. ndonjë vepër penale nga Kapitulli XXIII – Veprat penale të narkotikëve;
   2.9. ndonjë vepër penale nga Kapitulli XXX – Veprat penale të armëve;

3. Nëse vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni ka të bëjë me vepër penale të dënueshme me burgim të përjetshëm, kryesi dënohet me burgim prej një (1) deri në dhjetë (10) vjet.
4. Dënimi i paraparë me paragrafin 1. të këtij neni nuk mund të jetë më i ashpër, as sipas llojit e as sipas lartësisë, se dënimi i përcaktuar për veprën penale të kryer nga personi të cilit i jepet ndihma.
5. Me përjashtim të veprave penale që përfshijnë abuzimin e fëmijëve dhe dhunën në familje, personi nuk është penalisht përgjegjës sipas këtij neni nëse është në lidhje familjare me kryesin e veprës penale si prind, fëmijë, bashkëshort ose bashkëshorte, vëlla ose motër, prind adoptues apo fëmijë i adoptuar ose person me të cilin kryesi jeton në bashkësi jashtëmartesore.

Neni 389
Dhënia e ndihmës personit të akuzuar nga tribunali ndërkombëtar penal

1. Kushdo që i jep ndihmë apo e fsheh personin e akuzuar nga tribunali ndërkombëtar penal ose e ndihmon personin e tillë për t'iu shmangur zbulimit, dënohet me burgim deri në tre (3) vjet.
2. Prindi, fëmija, bashkëshorti ose bashkëshortja, vëllai ose motra, prindi adoptues apo fëmija i adoptuar ose personi me të cilin kryesi jeton në bashkësi jashtëmartesore nuk dënohet për veprën penale nga paragrafi 1. i këtij neni.

Neni 390
Lajmërimi apo kallëzimi i rremë

1. Kushdo që bën lajmërim të rremë te personi zyrtar i ngarkuar me detyrën për të hetuar apo ndjekur, se personi i caktuar ka kryer vepër penale e cila ndiqet sipas detyrës zyrtare, duke e ditur se personi i tillë nuk është kryesi, dënohet me gjobë ose me burgim prej tre (3) muaj deri në tre (3) vjet.
2. Kushdo që ofron prova të rreme për veprën penale ose në ndonjë mënyre tjetër shkakton fillimin e procedurës penale për vepër penale e cila ndiqet sipas detyrës zyrtare kundër personit për të cilin ai e di se nuk e ka kryer veprën penale, dënohet me dënimin nga paragrafi 1. i këtij neni.
3. Kushdo që lajmëron veten se ka kryer vepër penale e cila ndiqet sipas detyrës zyrtare, edhe pse nuk e ka kryer veprën e tillë, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre (3) muaj.
4. Kushdo që lajmëron te personi zyrtar i ngarkuar me detyrën për të hetuar apo ndjekur, se është kryer vepër penale e cila ndiqet sipas detyrës zyrtare, edhe pse ai e di se vepra nuk është kryer, dënohet me dënimin nga paragrafi 3. i këtij neni.

Neni 391
Deklarimi i rremë nën betim

1. Kushdo që pasi të ketë dhënë betimin pranë organit kompetent për të administruar dëshmitë e dhëna nën betim ose betimet dhe pastaj nënshkruan dëshminë nën betim ose deklaron diç që nuk beson se është e vërtetë ose me dijeni fsheh ose shmang

nga deklarimi ndonjë çështje relevante për procedurën, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet.
2. Nëse deklarata nga paragrafi 1. i këtij neni është dhënë gjatë procedurës penale, kryesi dënohet me gjobë ose me burgim deri në pesë (5) vjet.
3. Nëse kryesi i veprës penale nga paragrafi 1. i këtij neni vullnetarisht e tërheq deklaratën e tij para fundit të dëshmisë së tij, gjykata mund ta zbusë dënimin.

Neni 392
Deklarimet e rreme

1. Pala, dëshmitari, eksperti në cilësi të dëshmitarit, përkthyesi apo interpreti i cili në procedurën gjyqësore, ne procedurën për kundërvajtje, ne procedurën administrative, ne procedurën para noterit publik ose ne procedurën disiplinore jep deklarate te rreme dënohet me gjobe dhe me burgim deri në një (1) vit.
2. Nëse deklarata e rreme merret si bazë për vendimin përfundimtar në procedurë, kryesi dënohet me burgim prej tre (3) muaj deri në tri (3) vjet.
3. Nëse vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni rezulton me pasoja të rënda, kryesi dënohet me burgim prej një (1) deri në pesë (5) vjet.
4. Nëse kryesi i veprës penale nga paragrafi 1. i këtij neni vullnetarisht e tërheq deklaratën e tij para marrjes së vendimit përfundimtar, gjykata mund ta zbusë dënimin.

Neni 393
Deklaratat e rreme të dëshmitarëve bashkëpunues

1. Dëshmitari bashkëpunues, i cili jep deklaratë apo dëshmi të rreme në cilëndo pjesë relevante ose i cili qëllimisht nuk ia tregon tërë të vërtetën prokurorit ose policisë, dënohet me gjobë ose me burgim prej tre (3) muaj deri në pesë (5) vjet.
2. Kushdo që kryen vepër penale nga paragrafi 1 i këtij neni dhe pastaj e tërheq deklaratën apo dëshminë dhe deklaron apo dëshmon të vërtetën para përfundimit të intervistës apo dëshmisë së tij, dënohet me gjobë deri në pesëqind (500) Euro ose me burgim deri në tre (3) muaj, por gjykata mund ta lirojë nga dënimi nëse ekzistojnë rrethana lehtësuese.

Neni 394
Pengimi i të provuarit apo procedurës zyrtare

1. Kushdo që me anë të detyrimit apo ryshfetit, me qëllim të:
   1.1. nxitjes së ndonjë personi që të jep deklaratë të rreme, të ofrojë dokument të rremë apo të fsheh ndonjë fakt material në procedurë zyrtare;
   1.2. parandalimit apo vonesës së pjesëmarrjes apo dëshmisë së ndonjë personi në procedurë zyrtare;
   1.3. parandalimit apo vonesës se ndonjë personi nga komunikimit i informatës zyrtarit policor ose hetuesit tjetër të autorizuar, prokurorit apo gjyqtarit lidhur me kryerjen e veprës penale;
   1.4. parandalimit apo vonesës së ndonjë personi nga paraqitja e çfarëdo dokumenti apo regjistri në procedurë zyrtare;

1.5. nxitjes së ndonjë personi që të ndryshojë, heq, fsheh, shkatërrojë, dëmtojë ose ta bëjë të pashfrytëzueshëm, tërësisht ose pjesërisht, ndonjë regjistër, pasuri, send ose dokument me qëllim të pamundësimit të shfrytëzimit të objektit në procedurë zyrtare;
1.6. nxitjes së personit të shmang thirrjen për të dhënë dëshmi ose për të paraqitur dëshmi në procedurë zyrtare; ose
1.7. nxitjes së dëshmitarit apo ekspertit për të refuzuar dhënien e dëshmisë ose për të dhënë dëshmi të rreme në procedure gjyqësore, procedurë për kundërvajtje, procedurë administrative ose në procedurë para noterit apo në procedurë disiplinore, dënohet me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet.

2. Kush me qëllim të parandalimit ose vështirësimit të mbledhjes së provave në procedurën gjyqësore, procedurën kundërvajtëse, procedurën administrative, në procedurën para noterit publik ose në procedurën disiplinore fsheh, dëmton, asgjëson, ose bënë të pa përdorueshme, në tërësi ose pjesërisht, sendin e personit tjetër ose dokumentet që mund të përdoren si prova, dënohet me gjobë ose burgim deri në tre (3) vjet.
3. Me dënimin nga paragrafi 1. i këtij neni dënohet edhe kushdo që me qëllim të parandalimit ose vështirësimit të mbledhjes së provave në procedurën gjyqësore ose administrative largon, zhvendos ose ndërron vendin e shenjave të kufijve kadastral, shenjën e matjes së tokës ose çfarëdo shenje tjetër që shënjon pronësinë a pasurinë e paluajtshme ose të drejtën për shfrytëzimin e ujit, ose për të njëjtin qëllim vendos shenja të tilla me qëllim të mashtrimit.
4. Kushdo që gjatë kryerjes së veprës penale nga paragrafët 1. deri 3. të këtij neni përdor dhunë ose kanos më përdorim të dhunës, dënohet me së paku dy (2) vjet burgim.
5. Nëse vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni kryhet ndaj dëshmitarit, kryesi dënohet me së paku tre (3) vjet burgim, e nëse vepra e tillë rezulton me lëndim trupor, kryesi dënohet me së paku pesë (5) vjet burgim.

Neni 395
Frikësimi gjatë procedurës penale

Kushdo që përdor forcën apo kanosjen serioze apo ndonjë mënyre tjetër të detyrimit, premton dhuratë apo ndonjë përfitim tjetër për të nxitur personin tjetër të përmbahet nga dhënia e deklaratës ose për të dhënë deklaratë të rreme, ose të mos dhënë informacione të vërteta pranë organeve policore, prokurorit apo gjyqtarit, kur informacionet e tilla ndërlidhen me pengimin e procedurës penale dënohet me gjobë deri në njëqind e njëzet e pesëmijë (125.000) Euro dhe me burgim prej dy (2) deri në dhjetë (10) vjet.

Neni 396
Hakmarrja

1. Kushdo që ndërmerr ndonjë veprim të dëmshëm për cilindo person, përfshirë ndërhyrjen në punësimin e ligjshëm apo sigurimin e mjeteve të jetesës së ndonjë

personi me qëllim të hakmarrjes për shkak të dhënies së informatave të vërteta policisë, hetuesit të autorizuar, prokurorit apo gjyqtarit lidhur me kryerjen ose kryerjen e mundshme të veprës penale, dënohet me gjobë dhe me burgim deri në tre (3) vjet.

2. Kushdo që vret personin tjetër me qëllim të hakmarrjes ndaj personit zyrtar për ndonjë vepër të kryer gjatë ushtrimit të detyrës së tij zyrtare, dënohet me jo më pak se pesëmbëdhjetë (15) vjet burgim ose me burgim të përjetshëm.
3. Kushdo që tenton të vrasë personin tjetër me qëllim të hakmarrjes ndaj personit zyrtar për ndonjë vepër të kryer gjatë ushtrimit të detyrës së tij zyrtare, dënohet me jo më pak se dhjetë (10) vjet burgim.
4. Kushdo që me qëllimin e paraparë në paragrafët 1. deri 3. të këtij neni, shkakton lëndim trupor ose dëm pasuror të ndonjë personi, dënohet me burgim së paku tre (3) vjet, por nëse vepra është kryer në lidhje me procedurën penale, kryesi dënohet së paku me dënimin e njëjtë sikur për veprën penale më të rëndë e cila ka qenë subjekt i procedurës penale.

Neni 397
Manipulimi me prova

1. Kushdo që ndryshon, heq, fsheh, shkatërron, dëmton ose e bën të pashfrytëzueshëm, tërësisht ose pjesërisht, ndonjë regjistër, pasuri, send ose dokument me qëllim të pamundësimit të shfrytëzimit të sendit në procedurë zyrtare, dënohet me gjobë ose me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet.
2. Kushdo që me qëllim të parandalimit ose vështirësimit të mbledhjes së provave në procedurën gjyqësore ose procedurën administrative, largon, zhvendos ose ndërron vendin e shenjave të kufijve administrativë, shenjën e tokës ose çfarëdo shenje tjetër që shënjon pronësinë apo pasurinë e paluajtshme ose të drejtën për shfrytëzimin e ujit, ose për të njëjtin qëllim vendos shenja të tilla me qëllim të lajthimit, dënohet me dënimin nga paragrafi 1. i këtij neni.

Neni 398
Falsifikimi i dokumenteve

1. Kushdo që përpilon dokument të falsifikuar, ndryshon dokumentin origjinal me qëllim të shfrytëzimit të atij dokumenti si origjinal ose me dije përdor dokumentin e falsifikuar apo të ndryshuar si origjinal, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet.
2. Nëse vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni kryhet në lidhje me dokumentin publik, testamentin, kambialin, regjistrin publik apo zyrtar ose ndonjë regjistër tjetër që ruhet në bazë të ligjit, kryesi dënohet me gjobë ose me burgim deri në pesë (5) vjet.

Neni 399
Rastet e posaçme të falsifikimit të dokumenteve

1. Personi do të konsiderohet se ka kryer vepër penale të falsifikimit të dokumenteve dhe do të dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet, nëse personi i tillë:

1.1. pa autorizim plotëson ndonjë letër, formular të zbrazët ose ndonjë formë tjetër në të cilën është vënë nënshkrimi i personit tjetër dhe plotëson deklaratën përmes së cilës krijon marrëdhënie juridike;
1.2. mashtron personin tjetër lidhur me përmbajtjen e ndonjë dokumenti dhe personi i tillë e nënshkruan këtë dokument duke menduar se nënshkruan ndonjë dokument tjetër ose dokument me ndonjë përmbajtje tjetër;
1.3. lëshon dokumentin në emër të ndonjë personi tjetër pa autorizimin e tij ose në emër të personit që nuk ekziston;
1.4. lëshon një dokument dhe pohon me nënshkrimin e vet se ka ndonjë pozitë, thirrje apo gradë edhe pse nuk ka pozitë, thirrje apo gradë të tillë, ndërsa veprimi i tillë ka ndikim substancial në vlerën e dokumentit; ose
1.5. lëshon një dokument duke përdorur vulën apo shenjën e vërtetë pa autorizim paraprak.

Neni 400
Shkelja e fshehtësisë së procedurës

1. Kushdo që pa autorizim zbulon informata për të cilat është njoftuar në procedurën zyrtare, që sipas ligjit nuk mund të zbulohen apo ato informata janë shpallur si fshehtësi me vendim të gjykatës apo të organit kompetent, dënohet me gjobë ose me burgim deri në një (1) vit.
2. Kushdo që pa autorizim zbulon të dhëna për identitetin apo të dhënat personale të personit të mbrojtur në procedurë penale apo në programin e veçantë të mbrojtjes, dënohet me burgim deri në tre (3) vjet.
3. Nëse vepra penale nga paragrafi 3. i këtij neni rezulton me pasoja të rënda për personin e mbrojtur ose procedura penale bëhet e pamundur ose vështirësohet në masë të madhe, kryesi dënohet me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet.
4. Nëse vepra penale nga paragrafi 3. i këtij neni rezulton me vdekjen e personit të mbrojtur, kryesi dënohet me burgim së paku dhjetë (10) vjet ose me burgim të përjetshëm.

Neni 401
Mospërfillja e gjykatës

1. Kushdo që nuk i bindet ndonjë urdhri, vendimi apo aktgjykimi të plotfuqishëm të ndonjë gjykate në Republikën e Kosovës ose refuzon apo pengon publikimin e vendimit apo aktgjykimit të plotfuqishëm të gjykatës së tillë, dënohet me gjobë ose me burgim deri në gjashtë (6) muaj.
2. Gjobat e shqiptuara sipas këtij neni mund të jenë ditore dhe mund të shqiptohen derisa kryesi të përfill urdhrin, vendimin apo aktgjykimin e plotfuqishëm që është subjekt i veprimit.
3. Nëse mospërfillja ka të bëjë me veprimin në mes të dy palëve private, gjykata mund të urdhërojë që gjoba t'i paguhet palës së dëmtuar.

Neni 402
Mosekzekutimi i vendimeve gjyqësore

1. Personi zyrtar apo personi përgjegjës i cili refuzon të ekzekutoj urdhrin, vendimin apo aktgjykimin e plotfuqishëm të ndonjë gjykate të Republikës së Kosovës apo i cili nuk e ekzekuton vendimin brenda afatit ligjor apo afatit të caktuar me vendim, dënohet me gjobë ose me burgim deri në dy (2) vjet.
2. Nëse me veprën penale nga paragrafi 1. i këtij neni është shkaktuar shkelje e rëndë e të drejtave njerëzore apo dëm substancial material, kryesi dënohet me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet.
3. Nëse kryesi i veprës penale nga paragrafi 1. i këtij neni e ekzekuton vendimin e plotfuqishëm të gjykatës, ndjekja nuk do të ndërmerret.

Neni 403
Legalizimi i përmbajtjes së rreme

1. Kushdo që vë në lajthim organin kompetent që në një dokument publik, regjistër apo libër të vërtetojë një çështje të pavërtetë, të paraparë për të shërbyer si provë në një çështje ligjore, dënohet me burgim prej tre (3) muaj deri në pesë (5) vjet.
2. Kushdo që përdorë dokumentin, regjistrin apo librin e tillë edhe pse e di së është i rremë, dënohet me dënimin nga paragrafi 1. i këtij neni.

Neni 404
Rebelimi i personave të privuar nga liria

1. Kushdo që nga institucioni ku gjendet në mbajtje në bazë të vendimit të ligjshëm mbi privimin nga liria, organizon rebelimin e personave të privuar nga liria, me qëllim që të lirohen me forcë ose së bashku të sulmojnë personat zyrtarë në atë institucion ose me forcë apo kanosje serioze t'i detyrojnë personat e tillë zyrtarë të veprojnë apo të mos veprojnë në kundërshtim me detyrën e tyre, dënohet me burgim prej një (1) deri në pesë (5) vjet.
2. Pjesëmarrësi në rebelim nga paragrafi 1. i këtij neni dënohet me burgim prej tre (3) muaj deri në një (1) vit.
3. Nëse vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni është kryer me përdorimin e forcës apo kanosjes serioze, kryesi dënohet me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet.
4. Nëse kryesi i veprës penale nga paragrafi 1. ose 2. i këtij neni heq dorë vullnetarisht nga rebelimi para se të ketë ushtruar forcën apo kanosjen serioze, gjykata mund ta lirojë nga dënimi.

Neni 405
Arratisja e personit të privuar nga liria

1. Kushdo që arratiset nga institucioni ku gjendet në mbajtje në bazë të vendimit të ligjshëm mbi privimin nga liria, dënohet me burgim deri në tre (3) vjet.
2. Kushdo që me anë të ryshfetit arratiset nga institucioni ku gjendet në mbajtje në

bazë të vendimit të ligjshëm mbi privimin nga liria, dënohet me burgim deri në pesë (5) vjet.
3. Kushdo që duke përdorur forcën apo kanosjen serioze, arratiset nga institucioni ku gjendet në mbajtje në bazë të vendimit të ligjshëm mbi privimin nga liria, dënohet me burgim prej një (1) deri në pesë (5) vjet.

Neni 406
Mundësimi i arratisjes së personave të privuar nga liria

1. Kushdo që mundëson arratisjen e personit i cili gjendet në mbajtje në bazë të vendimit të ligjshëm mbi privimin nga liria, dënohet me burgim prej tre (3) muaj deri në pesë (5) vjet.
2. Kushdo që me anë të ryshfetit mundëson arratisjen e personit i cili gjendet në mbajtje në bazë të vendimit të ligjshëm mbi privimin nga liria, dënohet me burgim prej tre (3) muaj deri në pesë (5) vjet.
3. Kushdo që duke përdorur forcën apo kanosjen serioze, mundëson arratisjen e personit i cili gjendet në mbajtje në bazë të vendimit të ligjshëm mbi privimin nga liria, dënohet me burgim prej tre (3) muaj deri në pesë (5) vjet.
4. Nëse vepra penale nga ky nen kryhet së bashku nga më shumë se një person, dënohen me burgim prej një (1) deri në tetë (8) vjet.

Neni 407
Lirimi i kundërligjshëm i personave të privuar nga liria

Personi zyrtar i cili në keqpërdorim të pozitës apo autorizimeve të tij, në mënyrë të kundërligjshme e liron personin e privuar nga liria dhe i cili i është besuar në ruajtje, ose e ndihmon arratisjen e tij apo i mundëson lidhje apo korrespondencë të kundërligjshme me qëllim të përgatitjes së arratisjes, dënohet me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet.

Neni 408
Mundësimi i kundërligjshëm i ushtrimit të profesionit, veprimtarisë ose detyrës

Kushdo që i mundëson personit tjetër ushtrimin e profesionit, veprimtarisë ose detyrës edhe pse e di se me aktgjykim të plotfuqishëm i është shqiptuar dënimi plotësues i ndalimit të ushtrimit të profesionit, veprimtarisë apo detyrës së tillë, dënohet me gjobë ose me burgim prej tre (3) muaj deri në tre (3) vjet.

KAPITULLI XXXIII
VEPRAT PENALE KUNDËR RENDIT PUBLIK

Neni 409
Pengimi i personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare

1. Kushdo që me forcë apo kanosje serioze, pengon ose tenton të pengojë personin zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare ose duke përdorur mjetet e njëjta e detyron atë të kryejë detyrën zyrtare, dënohet me burgim prej tre (3) muaj deri në tre (3) vjet.

2. Kushdo që merr pjesë në një grup të personave që me veprim të përbashkët pengon ose tenton të pengojë personin zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare ose duke përdorur mjetet e njëjta e detyron atë të kryejë detyrën zyrtare, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet.
3. Udhëheqësi apo organizatori i grupit që kryen vepër penale nga paragrafi 2. i këtij neni, dënohet me burgim prej një (1) deri në pesë (5) vjet.
4. Nëse vepra penale nga paragrafi 1. ose 2. i këtij neni përfshin kanosjen për përdorimin e armës apo mjetit të rrezikshëm ose rezulton me lëndim trupor, kryesi dënohet me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet.
5. Nëse vepra penale nga paragrafi 1. ose 2. i këtij neni kryhet ndaj gjyqtarit, prokurorit, zyrtarit të gjykatës, zyrtarit të prokurorisë apo personit të autorizuar nga gjykata dhe prokuroria zyrtarit policor, zyrtarit doganor**,** zyrtarit ushtarak apo zyrtarit të shërbimit korrektues gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre zyrtare, kryesi dënohet me burgim prej një (1) deri në pesë (5) vjet.
6. Nëse vepra penale nga paragrafi 1. ose 2. i këtij neni rezulton me lëndim të rëndë trupor, kryesi dënohet me jo më pak se pesë (5) vjet burgim.

Neni 410
Sulmi ndaj personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrës zyrtare

1. Kushdo që sulmon ose kanoset seriozisht se do ta sulmojë personin zyrtar, gjyqtarin, prokurorin apo personin i cili ndihmon në kryerjen e detyrave zyrtare lidhur me sigurinë e përgjithshme, sigurinë e Republikës së Kosovës apo ruajtjen e rendit publik, dënohet me burgim prej tre (3) muaj deri në tre (3) vjet.
2. Nëse vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni rezulton me lëndim të lehtë trupor të personit zyrtar apo ndihmësi të tij ose përfshin kanosje për përdorimin e armës apo mjetit të rrezikshëm, kryesi dënohet me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet.
3. Nëse vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni rezulton me lëndim të rëndë trupor të personit zyrtar apo ndihmësit të tij, kryesi dënohet me burgim prej një (1) deri në dhjetë (10) vjet.
4. Nëse kryesi i veprës penale nga paragrafi 1., 2. ose 3. i këtij neni është provokuar nga veprimi i kundërligjshëm apo i vrazhdë i personit zyrtar, gjykata mund ta zbusë dënimin.

Neni 411
Thirrja për rezistencë

1. Kushdo që thërret të tjerët për rezistencë apo mosbindje ndaj vendimeve apo masave të ligjshme të nxjerra nga organi apo zyrtari kompetent, dënohet me burgim deri në tre (3) vjet.
2. Nëse vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni rezulton me vështirësi të mëdha apo pamundësi të zbatimit të vendimit, masës apo veprimit zyrtar të ligjshëm, kryesi dënohet me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet.

Neni 412
Pjesëmarrja në turmë që kryen vepër penale dhe huliganizmi

1. Kushdo që merr pjesë në turmën e mbledhur prej më tepër se tetë personave, e cila me veprime të përbashkëta e privon personin tjetër nga jeta, i shkakton lëndime të rënda trupore personit tjetër, shkakton rrezik të përgjithshëm, shkakton dëm pasuror në vlerë prej njëzetmijë (20.000) Euro apo më shumë ose kryen vepra tjera të rënda të dënueshme me së paku pesë (5) vjet burgim apo tenton të kryejë vepra të tilla, dënohet me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet.
2. Organizatori i turmës nga paragrafi 1. i këtij neni dënohet me burgim prej dy (2) deri në dhjetë (10) vjet.
3. Secili person, që me veprimet e tij të dhunshme ose në ndihmë, ose me pjesëmarrje në veprimet huligane, duke hedhur gjësende në drejtim të personave ose të qytetarëve, të pjesëmarrësve në aktivitet sportiv, ose duke thyer, dëmtuar pajisjet, infrastrukturën publike, ose duke thyer, dëmtuar pajisjet dhe infrastrukturën dhe objektet sportive publike ose private, i vetëm ose në grup të organizuar dhe që ka për qëllim dëmtimin e personave zyrtarë, të pjesëmarrësve sportivë ose të personelit të sigurimit në detyrë zyrtare, në fushat sportive të hapura ose të mbyllura, kryen vepër penale të huliganizmit.
4. Për veprën penale, të përcaktuar në paragrafin 3. të këtij neni, parashihet dënimi me gjobë prej dyqind (200) deri dhjetë mijë (10.000) Euro për huliganizëm me pasoja të vogla ose me burgim deri në pesë (5) vjet burgim për huliganizëm me pasoja të rënda.

Neni 413
Mospjesëmarrja në mënjanimin e rrezikut të përgjithshëm

Kushdo që në kundërshtim me urdhrat e organit kompetent refuzon pa arsye të merr pjesë në mënjanimin e rrezikut për jetën e njerëzve apo të pasurisë gjatë zjarrit, vërshimit, tërmetit ose fatkeqësive tjera, dënohet me gjobë ose me burgim deri në një (1) vit.

Neni 414
Heqja apo dëmtimi i vulave zyrtare ose i shenjave

Kushdo që heq ose dëmton vulën zyrtare apo shenjën e ngjitur nga zyrtari i autorizuar me qëllim të sigurimit të objektit ose të lokaleve, apo kushdo që hap objektet e siguruara ose hyn në lokalet e tilla pa e hequr ose pa e dëmtuar vulën apo shenjën, ose hap sendin në të cilin ka qenë e vendosur vula apo shenja e tillë, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet.

Neni 415
Marrja apo asgjësimi i vulave zyrtare ose i shkresave zyrtare

Kushdo që në mënyrë të kundërligjshme merr, fsheh, asgjëson, dëmton apo në ndonjë mënyrë tjetër e bën të papërdorshme vulën, regjistrin, shkresat apo dokumentet zyrtare

që i përkasin ose janë në posedim të organit publik apo personit tjetër juridik i cili ushtron autorizime publike, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet.

Neni 416
Asgjësimi apo fshehja e materialit arkivor

Kushdo që në mënyrë të kundërligjshme asgjëson, fsheh ose bën të papërdorshme materialet arkivore apo nxjerr materialet e tilla jashtë vendit, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet.

Neni 417
Prezantimi i rremë si person zyrtar

1. Kushdo që prezantohet rrejshëm si person zyrtar apo ushtarak ose mban pa autorizim shenja të personit zyrtar apo ushtarak, dënohet me gjobë ose me burgim deri në një (1) vit.
2. Kushdo që me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore për vete apo për personin tjetër ose me qëllim që t'i shkaktojë dëm personit tjetër, prezantohet rrejshëm si person zyrtar apo ushtarak ose kushdo që me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore për vete apo për personin tjetër ose me qëllim që t'i shkaktojë dëm personit tjetër, mban pa autorizim shenja të personit zyrtar ose ushtarak ose ndërmerr ndonjë veprim të personit zyrtar apo ushtarak, dënohet me gjobë dhe me burgim deri në tre (3) vjet.

Neni 418
Vetëgjyqësia

1. Kushdo që ushtron në mënyrë arbitrare të drejtën që mendon se i takon në vend se t'i drejtohet organit kompetent, dënohet me gjobë ose me burgim deri në gjashtë (6) muaj.
2. Kushdo që me anë të përdorimit të forcës apo kanosjes serioze, ushtron një të drejtë që mendon se i takon në vend se t'i drejtohet organit kompetent, dënohet me burgim deri në dy (2) vjet.
3. Nëse vepra penale nga paragrafi 2. i këtij neni kryhet nga kryesi duke vepruar si anëtar i grupit, kryesi dënohet me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në tre (3) vjet.

Neni 419
Dhënia e kundërligjshme e ndihmës juridike

1. Kushdo që jep ndihmë juridike pa autorizim nga klienti i tij, dënohet me gjobë ose me burgim deri në dy (2) vjet.
2. Kushdo që jep ndihmë juridike pa kualifikim profesional, pa licencë apo në ndonjë mënyrë tjetër në kundërshtim me ligjin, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet.
3. Kushdo që kryen veprën penale nga paragrafi 1. ose 2. i këtij neni me pagesë, dënohet me gjobë dhe me burgim deri në pesë (5) vjet.

4. Për qëllime të këtij neni, shprehja "ndihmë juridike" ka kuptim të njëjtë siç përcaktohet me Ligjin për Avokatinë.

Neni 420
Pengimi i ceremonive fetare

1. Kushdo që në mënyrë të kundërligjshme pengon ose ndalon kryerjen e ceremonisë fetare, dënohet me gjobë ose me burgim deri në një (1) vit.
2. Nëse vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni kryhet me përdorimin e forcës apo kanosjes serioze, kryesi dënohet me burgim prej tre (3) muaj deri në tre (3) vjet.

Neni 421
Dëmtimi i varreve apo kufomave

1. Kushdo që pa autorizim gërmon, mih, rrënon, heq, dëmton, shkatërron ose përdhos varrin apo ndonjë vendvarrim tjetër, dënohet me gjobë ose me burgim deri në një (1) vit.
2. Kushdo që pa autorizim heq, dëmton, shkatërron ose fsheh kufomën, një pjesë të saj ose hirin e të vdekurit, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet.

KAPITULLI XXXIV
KORRUPSIONI ZYRTAR DHE VEPRAT PENALE KUNDËR DETYRËS ZYRTARE

Neni 422
Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar

1. Personi zyrtar, i cili duke shfrytëzuar detyrën apo autoritetin zyrtar i tejkalon kompetencat e tij ose nuk i përmbush detyrat zyrtare të tij me qëllim që të përfitoj çfarëdo dobie për vete ose për personin tjetër apo që t'i shkaktojë dëm personit tjetër ose që seriozisht t'i shkel të drejtat e personit tjetër, dënohet me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet.
2. Për qëllime të këtij neni, shpërdorimi i detyrës zyrtare përfshinë, por nuk kufizohet në:
   2.1. shkeljen me dashje apo me dijeni të ligjit lidhur me detyrat apo punësimin e zyrtarit;
   2.2. moskryerja me dashje e ndonjë detyre të domosdoshme të përcaktuar me ligj;
   2.3. pranimi i dhuratës, tarifës apo përparësisë së çfarëdo lloji si rezultat i kryerjes së detyrës zyrtare, përveç nëse pranimi i dhuratës, tarifës apo përparësisë lejohet me ligj;
   2.4. keqpërdorimi i pasurisë, shërbimeve apo personelit qeveritar apo i ndonjë sendit tjetër me vlerë që i përket qeverisë e që ka rënë në kujdesin apo posedimin e zyrtarit si rezultat i detyrës apo punës së tij;
   2.5. nënshtrimi me dashje i personit tjetër në keqtrajtim ose arrest, ndalim, kontroll, marrje, heqje, vlerësim ose barrë për të cilën e di se është e kundërligjshme; ose

2.6. ndalimi ose pengimi me dashje i tjetrit në ushtrimin apo gëzimin e ndonjë të drejte, privilegji, pushteti apo imuniteti ligjor.

Neni 423
Keqpërdorimi i informatës zyrtare

1. Personi zyrtar i cili keqpërdor informatën zyrtare me qëllim që për vete apo për personin tjetër të përfitojë ndonjë përparësi që nuk i takon, dënohet me gjobë dhe me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet.
2. Nëse informata zyrtare ka të bëjë me ndonjë veprim të prokurimit apo ankand publik, kryesi dënohet me gjobë dhe me burgim prej dy (2) deri në tetë (8) vjet.
3. Nëse vepra penale nga paragrafi 1 i këtij neni rezulton me dobi pasurore apo humbje në vlerën që tejkalon pesëmijë (5.000) Euro, kryesi dënohet me gjobë dhe me burgim prej një (1) deri në tetë (8) vjet.
4. Nëse vepra penale nga paragrafi 1 i këtij neni rezulton në dobi pasurore apo humbje në vlerën që tejkalon pesëdhjetë mijë (50.000) Euro, kryesi dënohet me gjobë dhe me burgim prej tre (3) deri në dymbëdhjetë (12) vjet.
5. Për qëllime të këtij neni, shprehja "informatë zyrtare" nënkupton informatën në të cilën personi ka qasje si rezultat i detyrës apo punës së tij dhe e cila nuk është bërë publike.

Neni 424
Konflikti i interesit

1. Personi zyrtar i cili merr pjesë personalisht në ndonjë çështje zyrtare në të cilën ai apo ndonjë anëtar i familjes ose ndonjë person juridik që ka të bëjë me të ka interes financiar, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet.
2. Nëse çështja zyrtare është veprim i prokurimit apo ankand publik, kryesi dënohet me burgim prej një (1) deri në pesë (5) vjet.
3. Për qëllime të këtij neni, shprehja "merr pjesë" nënkupton ushtrimin e autoritetit zyrtar përmes vendimit, miratimit, mosmiratimit, rekomandimit, këshillimit, hetimit ose në ndonjë mënyrë tjetër të ushtrimit të ndikimit për një çështje zyrtare.
4. Për qëllime të këtij neni, shprehja "çështje zyrtare" nënkupton procedurë gjyqësore ose procedurë tjetër zyrtare; aplikim, kërkesë për vendim ose përcaktim tjetër zyrtar; kontratë apo kërkesë; ankand publik ose veprim tjetër i prokurimit; ose ndonjë çështje tjetër e cila prek interesat financiare apo personale të zyrtarit apo personit tjetër.
5. Për qëllime të këtij neni, shprehja "person juridik që ka të bëjë më të" nënkupton personin juridik në të cilin zyrtari apo anëtari i familjes ka marrëdhënie financiare, përfshirë marrëdhënien apo marrëdhënien e ardhshme si person përgjegjës apo punonjës.

Neni 425
Përvetësimi në detyrë

1. Personi zyrtar, i cili me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për vete apo për personin tjetër, përvetëson pasurinë e cila i është besuar për shkak të

detyrës apo pozitës së tij, dënohet me gjobë dhe me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet.
2. Nëse vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni rezulton me dobi pasurore apo humbje në vlerë që tejkalon pesëmijë (5.000) Euro, kryesi dënohet me gjobë dhe me burgim prej një (1) deri në tetë (8) vjet.
3. Nëse vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni rezulton me dobi pasurore apo humbje në vlerë që tejkalon pesëdhjetë mijë (50.000) Euro, kryesi dënohet me gjobë dhe me burgim prej tre (3) deri në dymbëdhjetë (12) vjet.

Neni 426
Mashtrimi në detyrë

1. Personi zyrtar, i cili me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për vete apo për personin tjetër, bën prezantimin e rremë të raportit të llogarive apo në ndonjë mënyrë tjetër e vë në lajthim personin e autorizuar në kryerjen e pagesës së kundërligjshme, dënohet me gjobë dhe me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet.
2. Nëse vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni rezulton me dobi pasurore në vlerë që tejkalon pesëmijë (5.000) Euro, kryesi dënohet me gjobë dhe me burgim prej një (1) deri në tetë (8) vjet.
3. Nëse vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni rezulton me dobi pasurore në vlerë që tejkalon pesëdhjetë mijë (50.000) Euro, kryesi dënohet me gjobë dhe me burgim prej tre (3) deri në dymbëdhjetë (12) vjet.

Neni 427
Përdorimi i paautorizuar i pasurisë

Kushdo që pa autorizim përdor paratë, letrat me vlerë apo pasurinë tjetër të luajtshme e cila i është besuar atij në detyrë ose në përgjithësi në vendin e punës apo në të cilat ka qasje për shkak të shërbimit apo punës së tij, ose kushdo që i jep pasurinë e këtillë personit tjetër për shfrytëzim të paautorizuar, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet.

Neni 428
Marrja e ryshfetit

1. Personi zyrtar i cili në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, kërkon ose pranon ndonjë dhuratë apo përfitim tjetër për vete apo personin tjetër, ose që pranon ofertën apo premtimin për dhuratë apo përfitim të tillë, në mënyrë që personi zyrtar të veprojë ose të mos veprojë në pajtim me detyrën e tij zyrtare, dënohet me gjobë dhe me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet.
2. Personi zyrtar i cili në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, kërkon ose pranon ndonjë dhuratë apo përfitim tjetër për vete apo personin tjetër, ose që pranon ofertën apo premtimin për dhuratë apo përfitim të tillë, në mënyrë që personi zyrtar të veprojë ose të mos veprojë, në kundërshtim me detyrën e tij zyrtare, dënohet me gjobë dhe me burgim prej tre (3) deri në dymbëdhjetë (12) vjet.

3. Nëse vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni rezulton me përfitim në vlerë që tejkalon pesëmbëdhjetë mijë (15.000) Euro, kryesi dënohet me gjobë dhe me burgim prej një (1) deri në tetë (8) vjet.

Neni 429
Dhënia e ryshfetit

1. Kushdo që në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, i premton, ofron ose i jep ndonjë dhuratë apo përfitim tjetër personit zyrtar, në mënyrë që ai person të veprojë ose të mos veprojë në pajtim me detyrën e tij zyrtare, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet.
2. Kushdo që në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, i premton, ofron ose i jep ndonjë dhuratë apo përfitim tjetër personit zyrtar, në mënyrë që ai person të veprojë ose të mos veprojë në kundërshtim me detyrën e tij zyrtare, dënohet me gjobë dhe me burgim prej tre (3) muaj deri në tre (3) vjet.
3. Nëse vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni rezulton me përfitim në vlerë që tejkalon pesëmbëdhjetë mijë (15.000) Euro, kryesi dënohet me gjobë dhe me burgim prej një (1) deri në tetë (8) vjet.
4. Nëse kryesi i veprës penale nga paragrafi 1. ose 2. i këtij neni e ka dhënë ryshfetin me kërkesë të personit zyrtar apo personit përgjegjës dhe e lajmëron veprën para se ajo të jetë zbuluar ose para se të ketë kuptuar se vepra është zbuluar, gjykata mund ta lirojë nga dënimi.

Neni 430
Dhënia e ryshfetit zyrtarit publik të huaj

1. Kushdo që në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, i premton, ofron ose i jep ndonjë dhuratë apo përfitim tjetër zyrtarit publik të huaj, në mënyrë që ai zyrtar i huaj publik ose personi tjetër të veprojë ose të mos veprojë në pajtim me detyrën e tij zyrtare, dënohet me gjobë dhe me burgim deri në pesë (5) vjet.
2. Kushdo që në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, i premton, ofron ose i jep ndonjë dhuratë apo përfitim tjetër zyrtarit publik të huaj, në mënyrë që ai zyrtar i huaj publik ose personi tjetër të veprojë ose të mos veprojë në kundërshtim me detyrën e tij zyrtare, dënohet me gjobë dhe me burgim prej një (1) deri në pesë (5) vjet.
3. Nëse vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni rezulton me përfitim në vlerë që tejkalon pesëmbëdhjetë mijë (15.000) Euro, kryesi dënohet me gjobë dhe me burgim prej një (1) deri në tetë (8) vjet.
4. Dhurata apo përfitimi i pranuar apo i ofruar në shkelje të këtij neni konfiskohet.

Neni 431
Ushtrimi i ndikimit

1. Kushdo që në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, kërkon ose pranon ndonjë dhuratë apo përfitim tjetër për vete apo personin tjetër, ose pranon ofertën apo premtimin për dhuratë apo përfitim të tillë, në mënyrë që të ushtrojë ndikim të

padrejtë mbi vendimmarrjen e personit zyrtar apo zyrtarit publik të huaj, pavarësisht nëse ndikimi është ushtruar ose pavarësisht nëse ndikimi i supozuar shpie deri te rezultati i synuar, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tetë (8) vjet.
2. Kushdo që në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, i premton, ofron ose i jep ndonjë dhuratë apo përfitim tjetër personit tjetër, në mënyrë që ky person të ushtrojë ndikim të papërshtatshëm mbi vendimmarrjen e personit zyrtar apo zyrtarit publik të huaj, pavarësisht nëse ndikimi është ushtruar ose pavarësisht nëse ndikimi i supozuar shpie deri te rezultati i synuar, dënohet me gjobë ose me burgim deri në pesë (5) vjet.
3. Dhurata apo përfitimi i pranuar apo i ofruar në shkelje të këtij neni konfiskohet.

Neni 432
Nxjerrja e kundërligjshme e vendimeve gjyqësore

Gjyqtari i cili me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të çfarëdo dobie për vete ose për personin tjetër ose për t'i shkaktuar dëm personit tjetër, nxjerr vendim të kundërligjshëm, dënohet me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet.

Neni 433
Zbulimi i fshehtësisë zyrtare

1. Personi zyrtar i cili pa autorizim kumton, dërgon ose në ndonjë mënyrë tjetër i vë në dispozicion personit tjetër informatën që përbën fshehtësi zyrtare ose siguron informatën e tillë me qëllim që t'ia përcjellë ndonjë personi të paautorizuar, dënohet me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në tre (3) vjet.
2. Nëse vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni kryhet për përfitim personal ose me qëllim të publikimit apo shfrytëzimit të informacionit jashtë Republikës së Kosovës, kryesi dënohet me gjobë dhe me burgim prej një (1) deri në dhjetë (10) vjet.
3. Nëse vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni kryhet nga pakujdesia, kryesi dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet.
4. Dispozitat e këtij neni zbatohen ndaj personit i cili zbulon fshehtësinë zyrtare edhe pasi që të ketë pushuar statusi i tij zyrtar.
5. Për qëllime të këtij neni, shprehja "fshehtësi zyrtare" nënkupton informatat ose dokumentet të shpallura si fshehtësi zyrtare me ligj, dispozita të tjera ose me vendim të organit kompetent të nxjerrë në bazë të ligjit dhe zbulimi i të cilave ka shkaktuar ose mund të shkaktojë pasoja të dëmshme. Sidoqoftë, informatat në vijim nuk konsiderohen fshehtësi zyrtare:
   5.1. informatat apo dokumentet të cilat janë të drejtuara në cenimin e rëndë të të drejtave themelore të njeriut ose mos zbulimi i të cilave do të mund të rrezikonte rendin kushtetues apo sigurinë e Republikës së Kosovës; ose
   5.2. informatat dhe dokumentet të cilat kanë për qëllim fshehjen e kryesit të veprës penale të dënueshme me së paku pesë (5) vjet burgim.

Neni 434
Falsifikimi i dokumentit zyrtar

1. Personi zyrtar i cili në dokumentin zyrtar, në regjistër ose në shkresën zyrtare shënon të dhëna të rreme ose nuk shënon të dhënat e duhura apo me nënshkrimin e tij ose me vulën zyrtare vërteton dokumentin zyrtar, regjistrin apo shkresën zyrtare e cila përmban të dhëna të rreme ose mundëson përpilimin e dokumentit, regjistrit ose shkresës së tillë me përmbajtje të rreme, dënohet me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet.
2. Personi zyrtar i cili shfrytëzon dokumentin zyrtar, regjistrin ose shkresën zyrtare të rreme si të vërtetë në veprimtarinë e tij afariste ose i cili asgjëson, fsheh, dëmton apo në ndonjë mënyrë tjetër e bën të papërdorshëm dokumentin zyrtar, regjistrin ose shkresën zyrtare, dënohet me dënimin nga paragrafi 1. i këtij neni.

Neni 435
Arkëtimi dhe pagesa e kundërligjshme

1. Personi zyrtar i cili arkëton nga tjetri diçka që personi i tillë nuk është i detyruar të paguajë ose arkëton më shumë se që personi i tillë është i detyruar të paguajë apo që gjatë pagesës ose dërgesës, paguan ose dërgon më pak se që është dashur, dënohet me gjobë ose me burgim deri në një (1) vit.
2. Nëse vlera e pagesës apo dërgesës nga paragrafi 1. i këtij neni tejkalon shumën prej pesëmbëdhjetë mijë (15.000) Euro, kryesi dënohet me burgim deri në tre (3) vjet.
3. Tentativa për të kryer veprën penale nga paragrafi 1. i këtij neni është e dënueshme.

Neni 436
Përvetësimi i kundërligjshëm i pasurisë me rastin e bastisjes apo ekzekutimit të vendimit gjyqësor

Personi zyrtar i cili gjatë bastisjes së lokaleve, personit apo gjatë ekzekutimit të vendimit gjyqësor, merr pasurinë e luajtshme me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore për vete ose për personin tjetër, dënohet me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet.

Neni 437
Mos raportimi ose raportimi i rremë i pasurisë, i të ardhurave, i dhuratave, i dobisë tjetër materiale ose i detyrimeve financiare

1. Çdo person, i cili sipas ligjit është i detyruar të bëjë deklarimin e pasurisë, të të ardhurave, të dhuratave, të dobisë tjetër pasurore ose të detyrimeve financiare, dhe i cili nuk bën një gjë të tillë, dënohet me gjobë dhe me burgim deri në tre (3) vjet. Vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni konsiderohet se është kryer kur deklarata nuk paraqitet brenda afatit për paraqitjen e deklaratës.
2. Çdo person, i cili sipas ligjit është i detyruar të bëjë deklarimin e pasurisë, të të ardhurave, të dhuratave, të dobisë tjetër pasurore ose të detyrimeve financiare, i cili falsifikon ose nuk paraqet të dhënat e kërkuara në deklaratë, dënohet me gjobë dhe me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet.

3. Vlera e padeklaruar e pasurisë, të të ardhurave ose të dobisë tjetër pasurore, e cila është fituar në mënyrë joligjore konfiskohet.

KAPITULLI XXXV
DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 438
Vazhdimësia e sanksioneve penale

Të gjitha sanksionet penale për veprat të cilat edhe me këtë Kod janë të ndëshkueshme dhe të shqiptuara me aktgjykim të formës së prerë para hyrjes në fuqi të këtij Kodi vazhdojnë me kohëzgjatje dhe lartësi të njëjtë.

Neni 439
Shfuqizimi i akteve ligjore dhe nënligjore

Me hyrjen në fuqi të këtij Kodi, shfuqizohen Rregulloret e UNMIK-ut dhe Kodi Penal i Kosovës (UNMIK REG 2003/05) si dhe aktet tjera ligjore dhe nënligjore që mbulojnë çështjet e trajtuara në këtë Kod.

Neni 440
Referimi i ligjeve tjera, rregulloreve të UNMIK-ut dhe Kodit Penal të Republikës së Kosovës në nenet e Kodit Penal

1. Tabela e cila paraqet numrat e vjetër dhe numrat e ri të neneve i bashkëngjitet dhe miratohet së bashku me këtë Kod.
2. Kjo tabelë zbatohet për të gjitha ligjet dhe rregulloret e Republikës së Kosovës.
3. Të gjitha referencat e neneve të ligjeve tjera të Republikës së Kosovës, rregulloreve të UNMIK-ut apo Kodit Penal në fuqi, me hyrjen në fuqi të këtij Kodi duhet t'i referohen numrave të ri, siç përcaktohen në këtë tabelë.
4. Dispozitat e Kodit Penal të Republikës së Kosovës kanë përparësi ndaj të gjitha dispozitave tjera ligjore dhe nënligjore lidhur me veprat penale dhe ndëshkimet.

Neni 441
Dispozitat kalimtare lidhur me juridiksionin e prokurorisë speciale të Republikës së Kosovës

1. Me hyrjen në fuqi të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, përveç kompetencave ekskluzive sipas nenit 5.1 dhe nenit 5.2 të Ligjit për Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës, Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës po ashtu do të ketë kompetencë ekskluzive për të hetuar dhe ndjekur veprat penale në vijim dhe tentativën dhe bashkëpunimin për vepra të tilla:
   1.1. kryerja e veprës terroriste, rekrutimi për terrorizëm, trajnimi për terrorizëm, shtytja për kryerjen e veprave terroriste, fshehja ose moslajmërimi i terroristëve dhe grupeve terroriste, siç përcaktohet në nenet 136, 139, 140, 141 dhe 142 të këtij Kodi;

1.2. moslajmërimi i përgatitjes së veprave penale, moslajmërimi i veprave penale apo kryesve të tyre dhe dhënia e ndihmës kryerësve pas kryerjes së veprave penale, siç përcaktohet në nenet 385, 386 dhe 388 të këtij Kodi, kur këto vepra kryhen në lidhje me terrorizmin ose ndihmën në kryerjen e veprave terroriste sipas neneve 136 dhe 137 të këtij Kodi;
1.3. përgatitja e veprave terroriste ose veprave penale kundër rendit kushtetues dhe sigurisë së Republikës së Kosovës, siç përcaktohet në nenet 136-142 dhe 144 të këtij Kodi, kur këto vepra kryhen lidhur me vepra të terrorizmit;
1.4. lehtësimi në kryerjen e terrorizimit dhe organizimi dhe pjesëmarrja në grup terrorist, siç përcaktohet në nenet 138 dhe 143 të këtij Kodi,;
1.5. gjenocidi, siç përcaktohet në nenin 148 të këtij Kodi;
1.6. krimet kundër njerëzimit, siç përcaktohet në nenin 149 të këtij Kodi;
1.7. krimet e luftës në shkelje të rëndë me konventat e Gjenevës, Krimet e luftës në shkelje të rëndë të ligjeve dhe zakoneve që zbatohen në konfliktin e armatosur ndërkombëtar, Krimet e luftës në shkelje të rëndë të nenit 3 të përbashkët të konventave të Gjenevës, Krimet e luftës në shkelje të rëndë të ligjeve dhe zakoneve që zbatohen në konfliktet e armatosura që nuk janë të karakterit ndërkombëtar, siç përcaktohet në nenet 150-153 të këtij Kodi;
1.8. sulmet në konfliktet e armatosura që nuk kanë karakter ndërkombëtar kundër instalimeve që përmbajnë forca të rrezikshme, siç përcaktohet në nenin 154 të këtij Kodi;
1.9. rekrutimi ose regjistrimi i personave midis moshës pesëmbëdhjetë (15) dhe tetëmbëdhjetë (18) vjet në konfliktin e armatosur, siç përcaktohet në nenin 155 të këtij Kodi,;
1.10. përdorimi i mjeteve ose i metodave të ndaluara të luftimit, siç përcaktohet në nenin 156 të këtij Kodi;
1.11. organizimi i grupeve për kryerjen e gjenocidit, krimeve kundër njerëzimit dhe krimeve të luftës, siç përcaktohet në nenin 160 të këtij Kodi,;
1.12. rrezikimi i personave nën mbrojtje ndërkombëtare, siç përcaktohet në nenin 173 të këtij Kodi;
1.13. përvetësimi i paligjshëm, shfrytëzimi, transferi dhe vendosja e materialeve nukleare, siç përcaktohet në nenin 176 të këtij Kodi;
1.14. kanosja për përdorimin ose kryerjen e vjedhjes apo të grabitjes së materialit nuklear, siç përcaktohet në nenin 177 të këtij Kodi;
1.15. krimi i organizuar, siç përcaktohet në nenin 275 të këtij Kodi;
1.16. frikësimi gjatë procedurës penale për krimin e organizuar, siç përcaktohet në nenin 395 të këtij Kodi;
1.17. shpërlarja e parave, siç përcaktohet në nenin 308 të këtij Kodi dhe veprat tjera penale të përcaktuara në Kapitullin IV të Ligjit për parandalimin e shpërlarjes së parave dhe financimit të terrorizmit.

2. Me hyrjen në fuqi të Kodit Penal, përveç kompetencave plotësuese sipas nenit 9.1 dhe nenit 9.2 të Ligjit për Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës, Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës, sipas modaliteteve të përcaktuara në nenin 10 të Ligjit për Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës, po ashtu do të ketë kompetencë plotësuese për të hetuar dhe ndjekur veprat penale në vijim dhe tentativën dhe bashkëpunimin për vepra të tilla:

2.1. sulmi kundër rendit kushtetues të Republikës së Kosovës, siç përcaktohet në paragrafin 1. të nenit 121. të këtij Kodi;
2.2. nxitja e urrejtjes, përçarjes ose mos durimit kombëtar, racor, fetar apo etnik, siç përcaktohet në nenin 147 të këtij Kodi;
2.3. rrëmbimi i fluturakes, siç përcaktohet në nenin 164 të këtij Kodi;
2.4. rrezikimi i sigurisë së aviacionit civil (165), rrezikimi i sigurisë së lundrimit detar (166), rrezikimi i sigurisë së platformave fikse të vendosura në pragun kontinental (167), piratëria (168), siç përcaktohet në këto nene.
2.5. kontrabandimi me migrantë, siç përcaktohet në nenin 170 të këtij Kodi;
2.6. trafikimi me njerëz, siç përcaktohet në nenin 171 të këtij Kodi;
2.7. shërbimet seksuale të viktimës së trafikimit, siç përcaktohet në nenin 231 të këtij Kodi;
2.8. nxitja e akteve seksuale me premtim të rrejshëm të martesës, siç përcaktohet në nenin 240 të këtij Kodi;
2.9. ofrimi i lokaleve për prostitucion, siç përcaktohet në nenin 242 të këtij Kodi;
2.10. transplantimi i kundërligjshëm dhe trafikimi i organeve dhe qelizave njerëzore, siç përcaktohet në nenin 265 të këtij Kodi;
2.11. rrezikimi i personelit të Kombeve të Bashkuara dhe i personelit në marrëdhënie me to, siç përcaktohet në nenin 174 të këtij Kodi;
2.12. vrasja (178), dhe vrasja e rëndë, siç përcaktohet në nenin 179 të këtij Kodi;
2.13. marrja e pengjeve, siç përcaktohet në nenin 175 të këtij Kodi;
2.14. shkelja e statusit të barabartë të shtetasve dhe banorëve të Republikës së Kosovës, siç përcaktohet në nenin 193 të këtij Kodi;
2.15. rrëmbimi, siç përcaktohet në nenin 194 të këtij Kodi;
2.16. tortura, siç përcaktohet në nenin 199 të këtij Kodi;
2.17. veprat penale kundër integritetit seksual, siç përcaktohen në nenet 230-243 të këtij Kodi, kur veprat e tilla janë të dënueshme me së paku pesë (5) ose më shumë vjet burgim;
2.18. blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge (273) të këtij Kodi; Prodhimi dhe përpunimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope, analoge apo veglave, pajisjeve apo materialeve narkotike (274 të këtij Kodi); Organizimi, drejtimi apo financimi i trafikimit të narkotikëve apo substancave psikotrope, siç përcaktohet në nenin 279 të këtij Kodi;
2.19. shkaktimi i falimentimit (286); Mashtrimi ose dëmtimi i kreditorëve apo debitorëve (289); Keqpërdorimi i autorizimeve ekonomike (290); Lidhja e kontratës së dëmshme (291); Shkaktimi i falimentimit të rrejshëm (287), Mashtrimi në procedurën e falimentimit (neni 288 të këtij Kodi);
2.20. falsifikimi i parasë; Prodhimi, furnizimi, shitja, posedimi ose dhënia në shfrytëzim e mjeteve për falsifikim, siç përcaktohet në nenet 302 dhe 304 të këtij Kodi;
2.21. marrëveshjet për kufizimin e konkurrencës përmes ftesave për tender, siç përcaktohet në nenin 309 të këtij Kodi;
2.22. mashtrimi në shkëmbimin e letrave me vlerë, siç përcaktohet në nenin 310 të këtij Kodi;
2.23. keqpërdorimi i informatave të brendshme, siç përcaktohet në nenin 311 të këtij Kodi;

2.24. marrëveshja dhe mashtrimi me letrat me vlerë të Qeverisë, siç përcaktohet në nenin 312 të këtij Kodi;
2.25. dokumentet e rrejshme lidhur me tatimin, siç përcaktohet në nenin 314 të këtij Kodi;
2.26. organizimi i skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshëm; Shmangia nga tatimi, siç përcaktohet në nenet 300 dhe 313 të këtij Kodi;
2.27. pranimi i paarsyeshëm i dhuratave; Dhënia e paarsyeshme e dhuratave, siç përcaktohet në nenet 315 dhe 316 të këtij Kodi.
2.28. rastet e rënda të vjedhjes grabitqare ose grabitjes, siç përcaktohen në paragrafët 2. dhe 3. të nenit 328 të këtij Kodi;
2.29. mashtrimi, siç përcaktohet në nenin 335 të këtij Kodi;
2.30. detyrimi, siç përcaktohet në nenin 340 të këtij Kodi;
2.31. importi, eksporti, furnizimi, transportimi, prodhimi, këmbimi, ndërmjetësimi ose shitja e paautorizuar e armëve apo materieve plasëse, siç përcaktohet në nenin 372 të këtij Kodi;
2.32. pjesëmarrja në turmë që kryen vepër penale, siç përcaktohet në nenin 412 të këtij Kodi;
2.33. keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar; Marrja e ryshfetit; Dhënia e ryshfetit, siç përcaktohet në nenet 422, 428, 429 të këtij Kodi;
2.34. përvetësimi në detyrë; Mashtrimi në detyrë, siç përcaktohet në nenet 425 dhe 426 të këtij Kodi;
2.35. mashtrimi lidhur me pranimin e fondeve nga komuniteti evropian, siç përcaktohet në nenin 337 të këtij Kodi;
2.36. konflikti i interesit, siç përcaktohet në nenin 424 të këtij Kodi.

Neni 442
Dispozitat kalimtare lidhur me juridiksionin dhe kompetencat e gjyqtarëve dhe prokurorëve të EULEX-it në procedurë penale

1. Pas hyrjes në fuqi të këtij Kodi Penal, gjyqtarët dhe prokurorët e EULEX-it të caktuar në procedurë penale do të kenë juridiksion dhe kompetencë për çdo lëndë që mund të hetohet apo të ndiqet penalisht nga PSRK-ja.
2. Para fillimit të fazave përkatëse të procedurës dhe pas kërkesës së prokurorit të EULEX-it të caktuar në lëndë apo që punon në ekipin e përzier të identifikuar në nenet 9 dhe 10 të Ligjit Nr. 03/L-053 mbi Kompetencat, Përzgjedhjen e Lëndëve dhe Caktimin e Lëndëve të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve të EULEX-it në Kosovë, apo pas kërkesës së cilësdo palë në procedurë, apo pas kërkesës me shkrim të kryetarit të gjykatës kompetente apo të seancës së përgjithshme të Gjykatës Supreme të Kosovës kur nuk zbatohen dispozitat lidhur me përjashtmin e një gjyqtari apo një gjyqtari porotë të parapara sipas Kodit të Procedurës Penale, nuk janë të zbatueshme, Kryetari i Asamblesë së gjyqtarëve të EULEX-it do të ketë kompetencë, çdoherë kur konsiderohet e nevojshme që të sigurohet administrimi i duhur i drejtësisë, që t'i caktojë gjyqtarët e EULEX-it në fazën përkatëse të një procedure penale në përputhje me modalitetet për përzgjedhjen dhe caktimin e lëndëve të përcaktuara nga Asambleja e gjyqtarëve të EULEX-it dhe në pajtim me Ligjin nr. 03/L-053 mbi Kompetencat, Përzgjedhjen e Lëndëve dhe Caktimin e

Lëndëve të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve të EULEX-it në Kosovë, përveç veprave penale të parapara në nenin 3.3 të Ligjit Nr. 03/L-053 mbi Kompetencat, Përzgjedhjen e Lëndëve dhe Caktimin e Lëndëve të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve të EULEX-it në Kosovë, gjithashtu edhe për veprat penale në vijim atëherë kur hetimi a ndjekja penale nuk kryhet nga PSRK-ja:

2.1. sulmi kundër rendit kushtetues të Republikës së Kosovës (neni 121 (1);
2.2. nxitja e urrejtjes, përçarjes ose mosdurimit kombëtar, racor, fetar apo etnik (neni 147);
2.3. rrëmbimi i fluturakes, Rrezikimi i sigurisë së Aviacionit Civil, Rrezikimi i Sigurisë së Lundrimit Detar, Rrezikimi i Sigurisë së Platformave Fikse të vendosura në pragun kontinental dhe Pirateria (neni 164-168);
2.4. kontrabandimi me Migrantë (neni 170);
2.5. trafikimi me njerëz (neni 171);
2.6. shërbimet seksuale të viktimës së trafikimit (neni 231);
2.7. nxitja e akteve seksuale me premtim të rrejshëm të martesës (neni 240);
2.8. ofrimi i lokaleve për prostitucion (neni 242);
2.9. transplantimi i kundërligjshëm dhe trafikimi i organeve dhe qelizave njerëzore (neni 265);
2.10. rrezikimi i personelit të kombeve të bashkuara dhe i personelit në marrëdhënie me to (neni 174);
2.11. vrasja dhe vrasja e rëndë (neni 178-179);
2.12. marrja e pengjeve dhe Rrëmbimi siç parashihet në nenin 175 dhe 194;
2.13. shkelja e statusit të barabartë të shtetasve dhe banorëve të Republikës së Kosovës (neni 193);
2.14. tortura (neni 199);
2.15. veprat penale kundër integritetit seksual (neni 230- 243) në çfarëdo kohe janë të dënueshme me burgim prej pesë (5) apo më shumë vitesh duke e marrë parasysh maksimumin e dënimit të mundshëm të paraparë me ligj;
2.16. blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge, Prodhimi dhe përpunimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge, Organizimi, drejtimi apo financimi i trafikimit të narkotikëve apo substancave psikotrope siç parashihet në nenet 273, 274 dhe 279 të këtij Kodi;
2.17. shkaktimi i falimentimit, Mashtrimi apo Dëmtimi i Kreditorëve apo Debitorëve, Keqpërdorimi i autorizimeve ekonomike, Lidhja e kontratës së dëmshme, Shkaktimi i falimentimit të rrejshëm dhe Mashtrimi në procedurën e falimentimit siç parashihet në nenet 286-291 të këtij Kodi;
2.18. falsifikimi i parasë, Prodhimi, furnizimi, shitja, posedimi ose dhënia në shfrytëzim e mjeteve për falsifikim (neni 302-304);
2.19. marrëveshjet për kufizimin e konkurrencës përmes ftesave për tender (neni 309);
2.20. mashtrimi në shkëmbimin e letrave me vlerë (neni 310);
2.21. Keqpërdorimi i informatave të brendshme (neni 311);
2.22. marrëveshja dhe mashtrimi me letrat me vlerë të qeverisë (neni 312);
2.23. dokumentet e rrejshme në lidhje me tatimin (neni 314);
2.24. organizimi i Skemave Piramidale dhe Bixhozit të Paligjshëm (neni 300), Shmangia nga Tatimi (neni 313);

2.25. pranimi i paarsyeshëm i dhuratave (neni 315), Dhënia e paarsyeshme e dhuratave (neni 316);
2.26. rastet e rënda të vjedhjes grabitqare apo grabitjes (paragrafët 2. dhe 3. të nenit 328 të këtij Kodi);
2.27. mashtrimi dhe Detyrimi (neni 335 dhe 340);
2.28. importi, eksporti, furnizimi, raportimi, këmbimi, prodhimi, ndërmjetësimi ose shitja e paautorizuar e armëve apo materieve plasëse (neni 372);
2.29. pjesëmarrja në turmë që kryen vepër penale (neni 412);
2.30. shpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar, Marrja e ryshfetit, Dhënia e Ryshfetit (nenet 422, 428 dhe 429);
2.31. përvetësimi në detyrë, Mashtrimi në detyrë (neni 425 dhe 426);
2.32. mashtrimi lidhur me pranimin e fondeve nga komuniteti Evropian (neni 337);
2.33. konflikti i interesit (neni 424).

Neni 443
Dispozitat kalimtare lidhur me juridiksionin e Agjencisë Kosovare të Inteligjencës

1. Me hyrjen në fuqi të Kodit Penal, Agjencia Kosovare e Inteligjencës do të ketë juridiksion dhe kompetencë për të mbledhur informacione për çfarëdo rasti që ka të bëjë me veprat penale të përcaktuara në kapitujt e mëposhtëm:
   1.1. veprat penale kundër rendit kushtetues dhe sigurisë së Republikës së Kosovës, sipas Kapitullit XIV të këtij Kodi;
   1.2. veprat penale kundër njerëzimit dhe vlerave të mbrojtura me të drejtën ndërkombëtare, sipas Kapitullit XV të këtij Kodi.
   1.3. veprat penale kundër shëndetit publik, sipas Kapitullit XXII të këtij Kodi;
   1.4. veprat penale të narkotikëve, sipas Kapitullit XXIII të këtij Kodi;
   1.5. krimi i organizuar, sipas Kapitullit XXIV të këtij Kodi;
   1.6. veprat penale kundër sigurisë së përgjithshme të njerëzve dhe pasurisë, sipas Kapitullit XXIX të këtij Kodi;
   1.7. veprat penale të armëve, sipas Kapitullit XXX të këtij Kodi.

Neni 444
Hyrja në fuqi

Kodi Penal i Republikës së Kosovës hyn në fuqi me 1 janar 2013.

Kodi Nr. 04/L-82
20 prill 2012

Ligji shpallet ne Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës duke u bazuar në nenin 80 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës se Kosovës.

GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS / Nr.19 / 13 KORRIK 2012, PRISHTINË

LIGJI Nr. 04/L-129
PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E KODIT PENAL TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS Nr. 04/L-082

Kuvendi i Republikës së Kosovës;

Në bazë të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton

LIGJ PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E KODIT PENAL TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS NR. 04/L-082

Neni 1
Qëllimi

Ky ligj ka për qëllim heqjen e neneve 37, 38 dhe 39 nga Kodi Penal i Republikës së Kosovës.

Neni 2
Shfuqizimet në Kodin Penal të Republikës së Kosovës

Nenet 37, 38 dhe 39 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës hiqen.

Neni 3
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi me 1 janar 2013.

Ligji Nr. 04/L-129
19 tetor 2012

Shpallur me dekretin Nr.DL-048-2012, datë 02.11.2012 nga Presidentja e Republikës së Kosovës Atifete Jahjaga.

GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS / Nr. 30 09 NËNTOR 2012, PRISHTINË

KODI Nr. 03/L-193
I DREJTËSISË PËR TË MITUR

Përmbajtja

Pjesa e parë: Parimet udhëzuese dhe dispozitat hyrëse 182
Kreu I 182
Pjesa e dytë: 184
Kreu II: Masat dhe dënimet e zbatueshme 184
Kreu III: Ndërmjetësimi 187
Kreu IV: Masat e diversitetit 187
Kreu V: Masat edukative 188
Kreu VI: Gjoba dhe urdhëri për punë në dobi të përgjithshme 192
Kreu VII: Burgimi për të mitur 193
Kreu VIII: Masat e trajtimi të detyrueshëm dhe dënimet plotësuese 195
Pjesa e tretë: 195
Kreu IX: Procedura 195
Kreu X: Përbërja e trupit gjykues për të mitur 198
Kreu XI: Procedura përgatitore 199
Kreu XII: Arresti i përkohshëm, ndalimi policor dhe paraburgimi 202
Kreu XIII: Shqyrtimi gjyqësor 203
Kreu XIV: Mjetet juridike 205
Pjesa e katërt: Ndërmjetësimi dhe ekzekutimi i masave dhe i dënimeve 206
Kreu XV: Procedura për ndërmjetësim 206
Kreu XVI: Ekzekutimi i masave të diversitetit 207
Kreu XVII: Ekzekutimi i masve edukative 207
Kreu XVIII: Ekzekutimi i dënimeve 218
Kreu XIX: Ndihma pas ekzekutimit të masave për edukimin institucional ose burgimit të të miturit 220
Kreu XX: Ekzekutimi i masve për trajtimin e detyrueshëm rehabilitues ose trajtimin e detyrueshëm psikiatrik 221
Pjesa e pestë: Procedura gjyqësore që përfshijnë veprat penale të kryera ndaj fëmijëve 222
Kreu XXI: Gjykimi i madhorëve për vepra penale të kryera ndaj fëmijëve 222
Pjesa e gjashtë: Dispozitat kalimtare dhe përfundimtare 225
Kreu XXII: Dispozitat kalimtare dhe përfundimtare 225

Kuvendi i Republikës së Kosovës;

Në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton

KOD TË DREJTËSISË PËR TË MITUR

PJESA E PARË
PARIMET UDHËZUESE DHE DISPOZITAT HYRËSE

KREU I

Neni 1
Qëllimi i Kodit

1. Ky Kod rregullon procedurën e shqiptimit dhe ekzekutimit të masave dhe dënimeve ndaj të miturve, procedurën gjyqësore si dhe procedurën e ndërmjetësimit për të mitur.

Neni 2
Përkufizimet

1. Shprehjet e përdorura në këtë kod kanë këto kuptime:
   1.1. **Fëmijë** - personi i cili nuk e ka mbushur moshën tetëmbëdhjetë (18) vjet.
   1.2. **I mitur** - personi ndërmjet moshës katërmbëdhjetë (14) dhe tetëmbëdhjetë (18) vjet.
   1.3. **I mitur i ri** - personi ndërmjet moshës katërmbëdhjetë (14) dhe gjashtëmbëdhjetë (16) vjet.
   1.4. **I mitur i rritur** - personin ndërmjet moshës gjashtëmbëdhjetë (16) dhe tetëmbëdhjetë (18) vjet.
   1.5. **Madhor i ri** - personi ndërmjet moshës tetëmbëdhjetë (18) dhe njëzetenjë (21) vjet.
   1.6. **I ri** - fëmijë apo madhor i ri.
   1.7. **Madhor -** personi i cili ka mbushur moshën tetëmbëdhjetë (18) vjet.
   1.8. **Edukim i specializuar** - program edukativ i përpiluar sipas nevojave speciale të kryerësit të veprës penale, i cili synon të ndihmojë zhvillimin e gjithëmbarshëm adekuat të tij dhe të zvogëlojë mundësinë e recidivizmit.
   1.9. **Burgim për të mitur -** dënim me burgim i shqiptuar ndaj kryerësit të mitur ose ndaj madhorit, që është në pajtim me Kreun IV të këtij Kodi.
   1.10. **Objekt për kujdes të posaçëm -** institucion i cili siguron trajtim të personave me paaftësi mendore, psikologjike, sociale apo fizike.
   1.11. **Organ i kujdestarisë -** organi përgjegjës që vepron në kuadër të Qendrës për Punë Sociale i cili është përgjegjës për mbrojtjen e fëmijëve.
   1.12. **Gjyqtar për të mitur -** gjyqtar profesional i cili është ekspert në çështjet penale ku janë të përfshirë fëmijët dhe madhorët e rinj, dhe i cili është kompetent për ushtrimin e përgjegjësive të parapara në këtë Kod.

1.13. **Prokuror për të mitur -** prokuror profesional i cili është ekspert në çështjet penale ku janë të përfshirë fëmijët dhe madhorët e rinj, dhe i cili është kompetent për ushtrimin e përgjegjësive të parapara në këtë Kod
1.14. **Trup gjykues për të mitur -** trup gjykues - kolegj i themeluar në pajtim me Kreun X të këtij Kodi, i cili ka së paku një (1) gjyqtar për të mitur dhe është kompetent për ushtrimin e përgjegjësive të parapara në këtë Kod.
1.15. **Shërbim sprovues** - institucioni i cili e bën ekzekutimin e masave dhe të dënimeve alternative.

Neni 3
Parimet udhëzuese

1. Sistemi i drejtësisë për të mitur synon mirëqenien e të miturit dhe siguron që çdo reagim ndaj kryerësve të mitur të jetë gjithmonë në proporcion me rrethanat e kryerësit dhe veprës penale.
2. Kryerësve të mitur u shqiptohen masat e diversitetit dhe masat edukative, sipas nevojës.
3. Privimi nga liria shqiptohet vetëm si mjet i fundit dhe do të kufizohet në afatin më të shkurtër të mundshëm. Gjate kohës se privimit nga liria, i shqiptuar si dënim, kryesit të mitur i ofrohet edukim, ndihmë psikologjike, sipas nevojës, edhe ndihmë mjekësore, për ta lehtësuar rehabilitimin e tij.
4. Fëmijës që merr pjesë në procedurë penale i ofrohet mundësia që të shprehet lirisht.
5. Çdo i mitur i privuar lirie trajtohet me humanizëm për hir të dinjitetit të personalitetit të tij njerëzor, dhe me atë rast merren parasysh nevojat personale të moshës së tij. Në veçanti, çdo i mitur i privuar lirie ndahet nga madhorët, përpos nëse konsiderohet se është në interes të miturit të mos ndahet, dhe gëzojnë të drejtën e mbajtjes së kontakteve me familjen e tij përmes korrespondencave dhe vizitave, përveç rrethanave të jashtëzakonshme të përcaktuara me ligj.
6. Çdo i mitur i privuar lirie ka të drejtë në ndihmë të menjëhershme ligjore dhe ndihmë tjetër adekuate, si dhe të drejtën për të kundërshtuar ligjshmërinë e privimit të tij nga liria pranë një gjykate të pavarur dhe të paanshme, si dhe në procedurë të menjëhershme.
7. Për t'iu shmangur lëndimit për shkak të publicitetit të tepruar ose etiketimeve, e drejta e fëmijës për privatësi respektohet në të gjitha fazat. Në parim, nuk publikohet asnjë informacion që shpie në identifikimin e kryerësit të mitur.

Neni 4
Fusha e zbatimit

1. Dispozitat e këtij Kodi zbatohen ndaj secilit person të dyshuar për vepër penale të kryer si i mitur, pavarësisht nga mosha e tij në kohën e fillimit të procedurës.
2. Dispozitat e këtij Kodi zbatohen edhe ndaj çdo personi të dyshuar për vepër penale të kryer si madhor i ri.
3. Kur madhori akuzohet për vepër penale të kryer si i mitur, nenet 44 dhe 48 të këtij Kodi nuk zbatohen.

Neni 5

Dispozitat e Kodit Penal të Kosovës, Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, Ligjit mbi Ekzekutimin e Sanksioneve Penale dhe të çdo ligji tjetër relevant do të zbatohen për të miturit, përpos rasteve kur me këtë Kod është rregulluar ndryshe.

Neni 6

1. Në çdo kohë gjyqtari për të mitur mund të shqiptojë masa adekuate për të mbrojtur të drejtat dhe mirëqenien e fëmijës, duke përfshirë edhe vendosjen e fëmijës në strehimore ose në institucion edukativ apo të ngjashëm, vendosjen e fëmijës nën mbikëqyrjen e organit të kujdestarisë ose transferimin e fëmijës në familje tjetër, nëse është e nevojshme që fëmija të ndahet nga mjedisi në të cilin ai ka jetuar ose për t'i ofruar ndihmë, mbrojtje a strehim. Gjyqtari për të mitur e njofton organin e kujdestarisë për cilëndo masë të shqiptuar.
2. Organi i kujdestarisë apo përfaqësuesi i autorizuar i fëmijës nga gjyqtari për të mitur, mund të kërkojë shqiptimin e masës adekuate për mbrojtjen e të drejtave dhe mirëqenies së fëmijës.
3. Shpenzimet e strehimit për të miturin paguhen nga mjetet buxhetore dhe llogariten në shpenzimet e procedurës penale.

PJESA E DYTË

KREU II
MASAT DHE DËNIMET E ZBATUESHME

Neni 7
Masat dhe dënimet e zbatueshme ndaj të miturve

1. Masat që mund të shqiptohen ndaj të miturve janë: masat e diversitetit dhe masat edukative.
2. Dënimet që mund të shqiptohen ndaj të miturve janë: gjoba, urdhri për punë në dobi të përgjithshme dhe burgimi për të mitur.
3. Dënimi nuk mund t'i shqiptohet të miturit i cili ka qene nën moshën gjashtëmbëdhjetë (16) vjet në kohën e kryerjes se veprës penale.
4. Kohëzgjatja e çfarëdo mase apo dënimi të shqiptuar duhet të përcaktohet me vendim të gjykatës në pajtim me këtë Kod.
5. Kur gjykata cakton dënimin me burgim për të mitur deri në dy (2) vjet ose masën e dërgimit në institucionin edukativ apo edukativo-korrektues deri në dy (2) vjet, mund të shqiptojë dënimin me kusht në pajtim me Kodin Penal të Kosovës.
6. Përveç masës apo dënimit, të miturit mund t'i shqiptohet masa apo dënim nga Kreun VIII i këtij Kodi.

Neni 8
Zgjedhja e masave dhe e dënimeve të zbatueshme

1. Kur ndaj të miturit shqiptohet ndonjë masë apo dënim, gjykata në radhë të parë merr parasysh interesin më të mirë të të miturit. Gjykata gjithashtu merr parasysh edhe këto rrethana: llojin dhe peshën e veprës penale, moshën e të miturit, nivelin e zhvillimit psikologjik, karakterin e tij dhe prirjet, motivet që e nxitën atë të kryejë veprën penale, edukimin e tij në atë fazë, mjedisin dhe rrethanat e jetës së tij, nëse është shqiptuar masë apo dënim më herët dhe rrethanat tjera që mund të ndikojnë në shqiptimin e masës apo dënimit.
2. Shërbimi sprovues përgatit anketë të plotë sociale për të miturin me kërkesë të prokurorit publik, gjyqtarit për të mitur ose gjykatës ashtu siç është paraparë në këtë Kod. Anketa sociale përfshin të dhëna mbi moshën e të miturit dhe zhvillimin psikologjik, biografinë e familjes, biografinë dhe rrethanat nën të cilat jeton i mituri, nivelin shkollor, përvojën edukative dhe çfarëdo të dhëne tjetër relevante.
3. Para zgjedhjes së masës apo dënimit, gjykata mund të kërkojë nga shërbimi sprovues raportin para ndëshkues dhe mendimin lidhur me zgjedhjen e masës apo dënimit.

Neni 9
Shqiptimi i masave ndaj madhorit të ri për vepër penale të kryer si i mitur nën moshën gjashtëmbëdhjetë (16) vjet

1. Procedura gjyqësore nuk mund të zbatohet ndaj madhorit i cili ka mbushur moshën njëzetenjë (21) vjet për vepër penale të kryer si i mitur nën moshën gjashtëmbëdhjetë (16) vjet.
2. Procedura gjyqësore mund të zbatohet ndaj madhorit të ri për vepër penale të kryer si i mitur nën moshën gjashtëmbëdhjetë (16) vjet vetëm nëse vepra penale është e dënueshme me më shumë se pesë (5) vite burgim. Në procedurën e tillë gjyqësore, gjykata mund të shqiptojë vetëm masën edukative adekuate institucionale. Kriteret e përgjithshme të përcaktuara në nenin 8 të këtij Kodi do të merren parasysh së bashku me kohën që ka kaluar nga kryerja e veprës penale.

Neni 10
Shqiptimi i masave dhe i dënimeve ndaj madhorit për vepra penale të kryera si i mitur i cili ka mbushur moshën gjashtëmbëdhjetë (16) vjet

1. Në procedurën gjyqësore të zbatuar ndaj madhorit për vepër penale të kryer si i mitur, i cili ka mbushur moshën gjashtëmbëdhjetë (16) vjet, gjykata mund të shqiptojë ndonjë masë ose dënim në pajtim me nenin 7 të këtij Kodi. Kriteret e përgjithshme të përcaktuara në nenin 8 të këtij Kodi merren parasysh bashkë me kohën që ka kaluar nga kryerja e veprës penale.
2. Përjashtimisht nga paragrafi 1. i këtij neni, gjykata, në vend të burgimit për të mitur mund të shqiptojë burgim ose dënim me kusht ndaj madhorit i cili ka mbushur moshën njëzetenjë (21) vjet në kohën e procedurës gjyqësore.
3. Përjashtimisht nga paragrafi 1 i këtij neni, në vend të burgimit për të mitur, gjykata

shqipton burgim ose dënim me kusht ndaj madhorit i cili ka mbushur moshën njëzetetre (23) vjet në kohën e procedurës gjyqësore, nën kushtet e parapara në këtë Kod.

Neni 11
Shqiptimi i masave ose i dënimeve ndaj madhorit të ri për vepër penale të kryer si madhor i ri

1. Në procedurën gjyqësore të zbatuar ndaj madhorit të ri i cili nuk ka arritur moshën njëzetenjë (21) vjet për vepër penale të kryer si madhor i ri, gjykata mund të shqiptojë masë ose dënim në pajtim me nenin 7 të këtij Kodi, nëse çmon se qëllimi që do të arrihej me shqiptimin e burgimit gjithashtu do të arrihej edhe me shqiptimin e masës ose dënimit, duke marrë parasysh rrethanat nën të cilat është kryer vepra penale, mendimin e ekspertit lidhur me zhvillimin psikologjik të madhorit të ri dhe interesin e tij më të mirë.
2. Masa ose dënimi i shqiptuar mund të zgjasë derisa personi të arrij moshën njëzetetre (23) vjet.

Neni 12
Efekti i dënimit në masën edukative

1. Kur gjykata shqipton dënim me burgim për të mitur ndaj të miturit i cili ka arritur moshën gjashtëmbëdhjetë (16) vjet gjatë ekzekutimit të masës edukative, masa edukative pushon kur i mituri fillon mbajtjen e dënimit.
2. Kur gjykata shqipton ndonjë dënim me burgim për të mitur ose së paku një (1) vit burgim ndaj madhorit gjatë ekzekutimit të masës edukative, masa edukative pushon kur kryerësi fillon mbajtjen e dënimit.
3. Kur gjykata shqipton dënimin me burgim për të mitur ose burgimin me kohëzgjatje më pak se një (1) vit ndaj madhorit gjatë ekzekutimit të masës edukative, gjykata në aktgjykimin e vet vendos për vazhdimin apo revokimin e masës edukative pas mbajtjes së dënimit me burgim për të mitur apo burgimit.

Neni 13
Evidenca e masave dhe e dënimeve

1. Gjykata mban evidencë të masave dhe dënimeve të shqiptuara ndaj të miturit. Shërbimi sprovues duhet të ketë kopje të këtyre shënimeve.
2. Të dhënat mbi masat dhe dënimet e shqiptuara ndaj të miturit janë konfidenciale. Vetëm gjykata dhe prokuroria mund të marrin informatat e tilla kur kjo është e nevojshme për zbatimin e procedurës ndaj individit të njëjtë derisa ai është ende i mitur.
3. Shënimet nga paragrafi 1 i këtij neni do të fshihen kur personi të ketë arritur moshën njëzetenjë (21) vjet.
4. Kur ekzekutohet masa ose dënimi i shqiptuar ndaj madhorit për vepër penale të kryer si i mitur, shënimet mbi masën ose dënimin do të fshihen menjëherë pas përfundimit të masës ose dënimit.

KREU III
NDËRMJETËSIMI

Neni 14

1. Ndërmjetësimi është procedurë jashtëgjyqësore e cila zhvillohet nga personi i tretë, ndërmjetësuesi në pajtim me dispozitat e këtij Kodi dhe ligjit për ndërmjetësimin. Ndërmjetësimi vjen në shprehje vetëm atëherë kur ekziston vullneti i lirë dhe pjesëmarrja e të dy palëve, kryerësit të mitur dhe palës së dëmtuar.
2. Prokurori, gjyqtari për të mitur apo kolegji për të mitur mund të propozoj ndërmjetësimin nëse vlerëson se do të jetë më e përshtatshme duke pas parasysh natyrën e veprës penale, rrethanat në të cilat është kryer vepra penale, historia e të miturit, mundësia e kthimit të raporteve normale në mes të miturit dhe palës së dëmtuar, mundësia e zvogëlimit të dëmit të palës së dëmtuar, mundësia e rehabilitimit të të miturit dhe re-integrimi i tij në shoqëri.
3. Palëve në procedurë mund tu propozohet ndërmjetësimi në rast se ato kanë shprehur pëlqimin për ndërmjetësim.

Neni 15
Ndërmjetësuesi

1. Ndërmjetësuesi është person fizik, që i përmbush të gjitha kërkesat e përcaktuara me Ligjin për ndërmjetësimin dhe është i regjistruar në regjistrin e ndërmjetësuesve.
2. Ndërmjetësuesi ndihmon palët për të arritur marrëveshje.
3. Dispozitat për përjashtimin e gjyqtarit të përcaktuar ne Kodin e Procedurës Penale të Kosovës zbatohen përshtateshmerisht edhe për përjashtimin e ndërmjetësuesit. Kundër këtij aktvendimi nuk lejohet ankesa.
4. Përjashtimi i ndërmjetësuesit mund të kërkohet nga i mituri, prindi, prindi adoptues, kujdestari, avokati mbrojtës dhe pala e dëmtuar.
5. Kërkesa për përjashtim duhet të vendoset nga organi i cili e ka caktuar ndërmjetë-suesin.
6. Kundër Aktvendimit mbi refuzimin e kërkesës për përjashtimin e ndërmjetësuesit nuk lejohet ankesa.

KREU IV
MASAT E DIVERSITETIT

Neni 16
Qëllimi i masave të diversitetit

Qëllimi i masave të diversitetit është që të parandalojë, kur është e mundur, fillimin e procedurës ndaj kryerësit të mitur, të ndihmojë rehabilitimin pozitiv dhe riintegrimin e të miturit në bashkësinë e tij me qëllim të parandalimit të sjelljes recidiviste.

Neni 17
Kushtet për shqiptimin e masave të diversitetit

1. Masa e diversitetit mund të shqiptohet ndaj të miturit i cili ka kryer vepër penale për të cilën është paraparë dënim me gjobë apo me burgim deri në tri (3) vite ose për vepër penale të kryer nga pakujdesia për të cilën është paraparë dënimi deri në pesë (5) vite burgim, me përjashtim të atyre të cilat sjellin si pasojë vdekjen.
2. Kushtet për shqiptimin e masës së diversitetit janë:
   2.1. pranimi i përgjegjësisë për veprën penale nga i mituri;
   2.2. shprehja e gatishmërisë nga i mituri që të pajtohet me palën e dëmtuar dhe
   2.3. pëlqimi i të miturit ose i prindit, prindit adoptues ose kujdestarit në emër të të miturit për të zbatuar masën e shqiptuar të diversitetit.
3. Prokurori kompetent njoftohet menjëherë për moskryerjen e detyrimeve të masës së diversitetit nga i mituri i cili mund të vendosë për rifillimin e ndjekjes së rastit.

Neni 18
Llojet e masave të diversitetit

1. Masat e diversitetit që mund të shqiptohen ndaj kryerësit të mitur janë:
   1.1. pajtimi në mes të kryerësit të mitur dhe palës së dëmtuar, duke përfshirë edhe kërkim faljen nga i mituri ndaj palës së dëmtuar;
   1.2. pajtimi ndërmjet të miturit dhe familjes së tij;
   1.3. kompensimi i dëmit palës së dëmtuar në bazë të marrëveshjes së ndërsjellë ndërmjet të dëmtuarit, të miturit dhe përfaqësuesit të tij ligjor, në përputhje me situatën financiare të të miturit;
   1.4. vijimi i rregullt në shkollë;
   1.5. pranimi i punësimit apo aftësimit në një profesion adekuat me aftësitë dhe shkathtësitë e tij;
   1.6. kryerja e punës pa pagesë në dobi të përgjithshme në pajtim me aftësinë e kryerësit të mitur për kryerjen e punës së tillë. Kjo masë mund të shqiptohet me pëlqimin e të miturit në kohëzgjatje prej dhjetë (10) deri në gjashtëdhjetë (60) orë;
   1.7. edukimi në rregullat e trafikut; dhe
   1.8. këshillimi psikologjik.

KREU V
MASAT EDUKATIVE

Neni 19
Qëllimi i masave edukative

Qëllimi i masës edukative është që të kontribuojë në rehabilitimin dhe zhvillimin adekuat të kryerësit të mitur, duke ofruar mbrojtje, ndihmë dhe mbikëqyrje, duke siguruar edukim dhe aftësim profesional, duke zhvilluar përgjegjësinë e tij personale dhe kështu duke ndaluar sjelljen recidiviste.

Neni 20
Llojet dhe kohëzgjatja e masave edukative

1. Llojet e masave edukative që mund të shqiptohen ndaj kryerësit të mitur janë masat disiplinore, masat e mbikëqyrjes së shtuar dhe masat institucionale.
2. Masat disiplinore janë qortimi gjyqësor dhe dërgimi i të miturit në qendër disiplinore. Këto masa shqiptohen ndaj kryerësit të mitur interesat e të cilit më së miri përfillen me një masë afatshkurtër, veçanërisht nëse vepra penale është kryer nga pamaturia apo pakujdesia.
3. Masat e mbikëqyrjes së shtuar janë mbikëqyrja e shtuar nga ana e prindit, nga prindi adoptues ose kujdestarit të të miturit, mbikëqyrja e shtuar nga familja tjetër dhe mbikëqyrja e shtuar nga organi i kujdestarisë. Këto masa shqiptohen ndaj të miturit interesat e të cilit nuk kërkojnë izolimin nga mjedisi i tij i mëparshëm dhe mbahen me masë afatgjate që të miturit i ofron mundësinë e edukimit, rehabilitimit apo trajtimit. Kohëzgjatja e kësaj mase nuk mund të jetë më e shkurtër se tre (3) muaj apo më e gjatë se dy (2) vjet.
4. Masat institucionale edukative janë dërgimi i të miturit në institucion edukues, dërgimi i të miturit në institucion edukues korrektues dhe dërgimi i kryerësit të mitur në institucionin e kujdesit të posaçëm. Këto masa shqiptohen ndaj të miturit interesat e të cilit më së miri përfillen me veçimin e tij nga mjedisi i mëparshëm dhe me masë afatgjate, që të miturit i ofron mundësinë e edukimit, rehabilitimit apo trajtimit.
5. Kohëzgjatja e masës edukative nuk mund të kalojë afatin maksimal të burgimit të paraparë për veprën penale.

Neni 21
Qortimi gjyqësor

1. Gjykata e shqipton masën e qortimit gjyqësor kur masa e tillë konsiderohet e mjaftueshme dhe në interes të të miturit për të ndikuar pozitivisht në sjelljen e tij.
2. I mituri, të cilit i shqiptohet qortimi gjyqësor informohet se ai ka kryer vepër të dëmshme dhe të rrezikshme e cila përbën vepër penale dhe i bëhet me dije se nëse përsëri kryen vepër të tillë, gjykata do t'i shqiptojë një masë apo dënim më të rëndë.

Neni 22
Dërgimi në qendër disiplinore

1. Gjykata shqipton masën e dërgimit në qendër disiplinore kur masa e tillë konsiderohet e mjaftueshme dhe në interes më të mirë të të miturit për të ndikuar pozitivisht në sjelljen e tij.
2. Gjykata mund ta dërgojë të miturin në qendër disiplinore:
   2.1. më së shumti një (1) muaj, deri në katër (4) orë në ditë ose
   2.2. më së shumti katër (4) ditë gjatë festës shkollore apo shtetërore, deri në tetë (8) orë në ditë.
3. Kur shqiptohet kjo masë, gjykata kujdeset që ekzekutimi i saj të mos e pengojë shkollimin dhe punën e rregullt të të miturit.

4. Në qendrën disiplinore i mituri angazhohet në aktivitete të dobishme. Aktivitetet përshtaten me moshën e tij, shkathtësitë dhe interesat me qëllim të zhvillimit të ndjenjës së përgjegjësisë tek ai.

Neni 23
Mbikëqyrja e shtuar nga ana e prindit, prindit adoptues ose kujdestarit

1. Gjykata shqipton masën e mbikëqyrjes së shtuar nga ana e prindit, prindit adoptues ose kujdestarit pas dëgjimit të prindit, prindit adoptues ose kujdestarit, kur prindi, prindi adoptues apo kujdestari është i aftë për mbikëqyrjen e të miturit, por që është treguar i pakujdesshëm ndaj mbikëqyrjes së tillë dhe kur masa e tillë është në interesin më të mirë të të miturit.
2. Kur shqiptohet kjo masë, gjykata mund t'i jep prindit, prindit adoptues apo kujdestarit udhëzimet e nevojshme dhe ta urdhërojë atë në përmbushjen e detyrave të caktuara që janë pjesë e masës së shqiptuar me qëllim të përkujdesjes së të miturit dhe ndikimit pozitiv ndaj tij.
3. Kur shqiptohet kjo masë, gjykata mund të urdhërojë shërbimin sprovues të verifikojë ekzekutimin e masës dhe t'i ofrojë ndihmën e nevojshme prindit, prindit adoptues ose kujdestarit.

Neni 24
Mbikëqyrja e shtuar nga familja tjetër

1. Gjykata shqipton masën e mbikëqyrjes së shtuar nga ana e familjes tjetër pas dëgjimit të prindit, prindit adoptues ose kujdestarit kur prindi, prindi adoptues apo kujdestari është i paaftë për kryerjen e mbikëqyrjes së shtuar ndaj të miturit dhe kur masa e tillë është në interesin më të mirë të të miturit.
2. Ekzekutimi i kësaj mase përfundon kur prindi, prindi adoptues apo kujdestari i të miturit është në gjendje të ushtrojë mbikëqyrjen e shtuar ndaj tij apo kur sipas rezultateve të rehabilitimit nevoja për mbikëqyrje të shtuar pushon.
3. Kur shqiptohet kjo masë, gjykata gjithashtu mund të urdhërojë shërbimin sprovues të verifikojë ekzekutimin e masës dhe familjes që kryen mbikëqyrjen t'i ofrojë ndihmën e nevojshme

Neni 25
Mbikëqyrja e shtuar nga organi i kujdestarisë

1. Gjykata shqipton masën e mbikëqyrjes së shtuar nga organi i kujdestarisë pas dëgjimit të prindit, prindit adoptues apo kujdestarit kur prindi, prindi adoptues apo kujdestari nuk është në gjendje të ushtrojë mbikëqyrjen e shtuar ndaj të miturit dhe kur një masë e tillë është në interesin më të mirë të të miturit.
2. Gjatë ekzekutimit të kësaj mase, i mituri mbetet me prindin, prindin adoptues apo kujdestarin.
3. Me rastin e shqiptimit të kësaj mase, gjykata gjithashtu i cakton detyra organit të kujdestarisë, duke përfshirë:
   3.1. mbikëqyrjen e edukimit të të miturit;

3.2. lehtësimin e qasjes në aftësimin profesional dhe punësimin;
3.3. sigurimin e largimit të të miturit nga çfarëdo ndikimi negativ;
3.4. lehtësimin e qasjes në kujdes të nevojshëm mjekësor;
3.5. ofrimin e zgjidhjeve të mundshme për ndonjë problem që mund të shfaqet në jetën e të miturit dhe
3.6. detyra të tjera që gjykata i çmon se do të ishin në interesin më të mirë të të miturit.

4. Organi i kujdestarisë është i detyruar ti raportoj gjykatës, e cila e ka shqiptuar masën e mbikëqyrjes së shtuar nga ana e organit të kujdestarisë përkitazi me ekzekutimin e vendimit gjyqësor së paku çdo tre (3) muaj.

Neni 26
Detyrimet e veçanta lidhur me masat e mbikëqyrjes së shtuar

1. Gjatë shqiptimit të njërës nga masat sipas neneve 23, 24 dhe 25 të këtij Kodi, gjykata mund të shqiptojë po ashtu një ose më shumë detyrime të veçanta, nëse gjykata konstaton se është e domosdoshme për ekzekutimin e suksesshëm të masës, me kusht që detyrimet e veçanta të mos e tejkalojnë afatin e masës.
2. Gjykata ndaj të miturit mund të shqiptojë këto detyrime të veçanta:
   2.1. personalisht t'i kërkojë falje palës së dëmtuar;
   2.2. palës së dëmtuar t'ia kompensojë dëmin në pajtim me gjendjen financiare të të miturit;
   2.3. të vijojë rregullisht shkollimin;
   2.4. të pranojë punësimin ose të aftësohet për një profesion i cili i përshtatet shkathtësive dhe aftësive të tij;
   2.5. të përmbahet nga çfarëdo kontakti me individë të caktuar që mund të kenë ndikim negativ tek i mituri;
   2.6. të pranojë këshilla psikologjike;
   2.7. të mos vizitojë vende ose mjedise të caktuara që mund të kenë ndikim negativ tek i mituri dhe
   2.8. të përmbahet nga përdorimi i drogës dhe i alkoolit.
3. Gjykata në çdo kohë mund t'ia ndërpresë ose ndryshojë detyrimet e veçanta që i janë shqiptuar të miturit.
4. Nëse i mituri nuk vepron në pajtim me detyrimet e veçanta të parapara në paragrafin 2. të këtij neni, gjykata mund ta zëvendësojë masën e mbikëqyrjes së shtuar me një masë tjetër edukative.
5. Kur i urdhëron detyrimet e veçanta të parapara në paragrafin 2., gjykata e informon të miturin se mos përmbushja e tyre mund të rezultojë me shqiptimin e një mase më të rëndë edukative.

Neni 27
Dërgimi në institucionin edukativ

1. Gjykata e shqipton masën e dërgimit në institucionin edukativ kur të miturit i nevojitet mbikëqyrje e plotë nga edukatorët adekuat dhe kur masa e tillë është në interesin më të mirë të miturit.
2. Kohëzgjatja e kësaj mase nuk mund të jetë më e shkurtër se tre (3) muaj apo më e gjatë se dy (2) vjet.

Neni 28
Dërgimi në institucionin edukativo–korrektues

1. Gjykata e shqipton masën e dërgimit në një institucion edukativo-korrektues kur i mituri i cili ka kryer vepër penale të dënueshme me burgim prej më shumë se tre (3) vjet ka nevojë për edukim të specializuar dhe kur masa e tillë është në interesin më të mirë të të miturit.
2. Kur gjykata vendos për shqiptimin e kësaj mase, ajo merr parasysh peshën dhe natyrën e veprës penale dhe nëse të miturit më parë i është shqiptuar masë edukative ose dënimi me burgim për të mitur.
3. Kohëzgjatja e kësaj mase nuk mund të zgjasë më pak se një (1) vit ose më shumë se pesë (5) vjet.

Neni 29
Dërgimi në institucionin për kujdes të posaçëm

Gjykata mund të shqiptojë masën e dërgimit në një institucion për kujdes të posaçëm në vend të masës së dërgimit në institucion edukativ ose në institucion edukativo-korrektues me rekomandimin e ekspertit të mjekësisë kur të miturit i nevojitet përkujdesje e posaçme për shkak të çrregullimit mendor ose të metave fizike dhe kur kjo është në interesin më të mirë të të miturit. Gjykata e cila ka shqiptuar masën, çdo gjashtë (6) muaj e rishikon nevojën për qëndrim të mëtejshëm në institucionin e kujdesit të posaçëm si dhe kur i mituri arrin moshën tetëmbëdhjetë (18) vjet.

KREU VI
GJOBA DHE URDHËRI PËR PUNË NË DOBI TË PËRGJITHSHME

Neni 30
Gjoba

1. Gjykata mund të shqiptojë dënim me gjobë ndaj të miturit nëse i mituri ka mjete për ta paguar gjobën. Me rastin e shqiptimit të dënimit me gjobë, gjykata shqyrton gjendjen financiare të të miturit dhe në veçanti lartësinë e të ardhurave të tij personale, të ardhurat tjera, pasurinë dhe detyrimet. Gjykata nuk e cakton lartësinë e gjobës mbi lartësinë e mjeteve që posedon i mituri.
2. Dënimi me gjobë nuk mund të jetë më pak se njëzetepesë (25) Euro ose më shumë se pesëmijë (5.000) Euro.
3. Me aktgjykim përcaktohet afati për pagesën e gjobës i cili nuk mund të jetë më i shkurtër se pesëmbëdhjetë (15) ditë e as më i gjatë se tre (3) muaj, por në rrethana të arsyeshme gjykata mund të lejojë pagesën e gjobës me këste po jo më gjatë se dy (2) vjet.
4. Nëse i mituri nuk dëshiron apo nuk mund ta paguajë gjobën, gjykata mund të lejojë që gjoba të paguhet me këste, por jo më gjatë se dy (2) vjet. Pastaj, nëse i mituri përsëri nuk dëshiron apo nuk mund ta paguajë gjobën, gjykata, me pëlqimin e personit të dënuar, mund ta zëvendësojë gjobën me urdhër për punë në dobi të përgjithshme që nuk pengon vijimin e rregullt në shkollë dhe aktivitetet tjera të punës.

5. Gjykata mund ta zëvendësoj dënimin me gjobë me ndonjë masë edukative jo institucionale, nëse i mituri nuk e paguan dënimin me gjobë, e as nuk pajtohet me zëvendësimin e saj me urdhrin me punë në dobi të përgjithshme

Neni 31
Urdhri për punë në dobi të përgjithshme

1. Me pajtimin e të miturit, gjykata mund ta zëvendësojë masën e shqiptuar edukative institucionale deri në tre (3) vjet, burgimin e të miturit deri në dy (2) vjet ose gjobën me urdhër për punë në dobi të përgjithshme.
2. Kur e shqipton urdhrin për punë në dobi të përgjithshme, gjykata e urdhëron të miturin që të kryejë punë në dobi të përgjithshme pa pagesë për një afat të caktuar prej tridhjetë (30) deri në njëqindenjëzet (120) orëve. Shërbimi sprovues e përcakton llojin e punës në dobi të përgjithshme të cilën duhet ta kryejë personi i dënuar, cakton organizatën specifike për të cilën personi i dënuar do ta kryejë punën në dobi të përgjithshme, vendos për ditët e javës kur do të kryhet puna dhe mbikëqyrë kryerjen e punës në dobi të përgjithshme.
3. Puna në dobi të përgjithshme kryhet brenda periudhës së caktuar nga gjykata, e cila nuk mund të zgjat më shumë se një (1) vit.
4. Nëse pas kalimit të periudhës së caktuar i mituri nuk e kryen punën në dobi të përgjithshme ose punën e tillë në dobi të përgjithshme e kryen vetëm pjesërisht, gjykata urdhëron ekzekutimin e masës institucionale edukative ose burgimin për të mitur në kohëzgjatje proporcionale, duke marrë parasysh kohëzgjatjen e punës në dobi të përgjithshme që është kryer. Në rastin e gjobës, gjykata urdhëron pagesën e gjobës në përpjesëtim me kohëzgjatjen e punës në dobi të përgjithshme e cila nuk është kryer.

KREU VII
BURGIMI PËR TË MITUR

Neni 32
Qëllimi i burgimit për të mitur

Qëllimi i burgimit për të mitur është që të kontribuohet në rehabilitimin dhe në zhvillimin e kryerësit të mitur, veçanërisht në edukimin e të miturit, edukimin e specializuar, aftësitë profesionale dhe në zhvillimin e duhur personal. Përveç kësaj, burgimi për të mitur duhet të ndikojë pozitivisht në të miturin përmes mbrojtjes, ndihmës dhe mbikëqyrjes për ta parandaluar recidivizmin.

Nen 33
Shqiptimi i burgimit për të mitur

Gjykata mund të shqiptojë dënimin me burgim për të mitur ndaj kryerësit të mitur i cili e ka arritur moshën gjashtëmbëdhjetë (16) vjet dhe ka kryer vepër penale të dënueshme me mbi pesë (5) vite burgim, në rastet kur shqiptimi i masës edukative nuk do të ishte adekuate për shkak të peshës së veprës penale, pasojave të saj dhe shkallës së përgjegjësisë penale.

Neni 34
Kohëzgjatja e burgimit për të mitur

1. Kohëzgjatja e burgimit për të mitur nuk mund ta kalojë maksimumin e burgimit të paraparë për veprën penale por mund të jetë më i ulët se minimumi i burgimit të paraparë për veprën penale.
2. Burgimi për të mitur nuk mund të shqiptohet në kohëzgjatje më pak se gjashtë (6) muaj as më shume se pesë (5) vjet dhe shqiptohet në muaj dhe vite të plota. Maksimumi i burgimit për të mitur është dhjetë (10) vjet për vepra të rënda penale të dënueshme me burgim afatgjatë, ose kur i mituri ka kryer së paku dy (2) vepra penale në bashkim, ku secila është e dënueshme me burgim prej më shumë se dhjetë (10) vjet.
3. Kur gjykata vendos për kohëzgjatjen e burgimit për të mitur, merr parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese të parapara në nenin 8 të këtij Kodi dhe nenin 64, paragrafët 1. dhe 2. të Kodit Penal të Kosovës.

Neni 35
Lirimi me kusht nga burgimi për të mitur

1. Personi i dënuar me burgim për të mitur mund të lirohet me kusht nëse e ka mbajtur së paku një të tretën (1/3) e dënimit që i është shqiptuar.
2. Kur lejohet lirimi me kusht, gjykata mund të shqiptojë masën e mbikëqyrjes së shtuar nga ana e prindit, prindit adoptues ose kujdestarit apo organit të kujdestarisë i cili mund të zgjasë deri në përfundim të dënimit të shqiptuar.
3. Gjykata mund të revokojë lirimin me kusht nëse gjatë kohës së lirimit me kusht i mituri kryen vepër penale për të cilën shqiptohet burgimi ose burgimi për të mitur prej së paku gjashtë (6) muajve.

Neni 36
Parashkrimi i ekzekutimit të burgimit për të mitur

1. Dënimi me burgim për të mitur nuk mund të ekzekutohet pasi që të ketë kaluar periudha kohore si në vijim:
   1.1. pesë (5) vjet nga vendimi i formës së prerë me të cilin është shqiptuar burgim për të mitur për më shumë se pesë (5) vjet;
   1.2. tre (3) vjet nga vendimi i formës së prerë me të cilin është shqiptuar burgim për të mitur për më shumë se tre (3) vjet dhe
   1.3. dy (2) vjet nga vendimi i formës së prerë me të cilin është shqiptuar burgimi për të mitur deri në tre (3) vjet.

Neni 37
Shqiptimi i masës edukative dhe i burgimit për të mitur
për vepra penale në bashkim

1. Për vepra penale në bashkim gjykata shqipton vetëm një masë edukative ose vetëm dënim me burgim për të mitur kur kushtet ligjore për shqiptimin e dënimit të tillë janë përmbushur dhe gjykata konstaton se ai duhet të shqiptohet.

2. Paragrafi 1 i këtij neni po ashtu zbatohet në rastet kur i mituri ka kryer vepër tjetër penale para ose pas shqiptimit të masës edukative ose të burgimit për të mitur.

KREU VIII
MASAT E TRAJTIMI TË DETYRUESHËM DHE DËNIMET PLOTËSUESE

Neni 38
Qëllimi dhe shqiptimi i masave të trajtimit të detyrueshëm

1. Qëllimi i masës së trajtimit të detyrueshëm është që të kontribuojë në rehabilitimin e të miturit dhe të parandalojë rrezikun nga recidivizmi. Trajtimi i detyrueshëm shqiptohet në pajtim me dispozitat e Kodit penal të Kosovës.
2. Gjykata mund të shqiptojë masën e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik ndaj të miturit në pajtim me Ligjin për kryerësit me çrregullime mendore.
3. Gjykata mund të shqiptojë masën për trajtim të detyrueshëm të rehabilitimit ndaj të miturit në pajtim me kapitullin V të Kodit Penal të Kosovës.
4. Masa për trajtim të detyrueshëm shqiptohet vetëm pas konsultimit me shërbimin sprovues, organin e kujdestarisë dhe ekspertët përkatës.
5. Masa e trajtimit të detyrueshëm nuk mund të shqiptohet në të njëjtën kohë me masën disiplinore.

Neni 39
Shqiptimi i dënimeve plotësuese

Kur gjykata e konsideron të arsyeshme mund të shqiptojë dënimin plotësues në pajtim më nenet 54-62 të Kodit Penal të Kosovës.

PJESA E TRETË

KREU IX
PROCEDURA

Neni 40

1. Autoritetet ose institucionet që marrin pjesë në procedura gjyqësore që kanë të bëjnë me të miturit, si edhe personat dhe institucionet e tjera nga të cilët kërkohen njoftime, raporte dhe mendime janë të obliguar që të veprojnë shpejt dhe pa vonesa të panevojshme.
2. I mituri që është paraburgosur gjykohet sa më shpejt që të jetë e mundur.

Neni 41

1. Për fëmijën nën moshën katërmbëdhjetë (14) vjet nuk fillon procedura gjyqësore. Nëse fëmija është nën moshën katërmbëdhjetë (14) vjet në kohën e kryerjes së veprës penale, çdo procedurë gjyqësore që ka filluar pushohet menjëherë dhe organi i kujdestarisë njoftohet për rastin nga prokurori.

2. Organi i kujdestarisë ndërmerr veprimet e caktuara në pajtim me Ligjin për Shërbimet Sociale dhe Familjare për trajtimin e kryerësve të veprave penale nën moshën katërmbëdhjetë (14) vjet në bazë të programeve të tij. Kjo çështje më hollësisht mund të rregullohet me akt nënligjor të cilin e nxjerr ministria për Punë dhe Mirëqenie Sociale.

Neni 42

1. I mituri nuk mund të gjykohet në mungesë.
2. Kur ndërmarrin ndonjë veprim në të cilin është i pranishëm i mituri dhe sidomos gjatë marrjes së tij në pyetje, organet që marrin pjesë në procedurë janë të obliguara që të veprojnë me kujdes, duke marrë parasysh zhvillimin psikologjik, ndjeshmërinë dhe karakteristikat personale të të miturit në mënyrë që zbatimi i procedurës të mos ketë ndikim të kundërt në zhvillimin e tij.

Neni 43

1. I mituri duhet të ketë mbrojtës që nga fillimi e deri në përfundim të procedurës.
2. Në rastet kur i mituri, përfaqësuesi ligjor ose anëtari i familjes së tij nuk angazhojnë mbrojtës, gjyqtari për të mitur ose organi kompetent që e zbaton procedurën e emëron një (1) mbrojtës sipas detyrës zyrtare me shpenzime publike.
3. Nëse i mituri mbetet pa mbrojtës gjatë rrjedhës së procedurës dhe nëse ai nuk mund të sigurojë tjetër mbrojtës, gjyqtari për të mitur ose organi kompetent që e zbaton procedurën emëron një (1) mbrojtës të ri sipas detyrës zyrtare me shpenzime publike.
4. Me kërkesën e të miturit, të përfaqësuesit ligjor ose të anëtarit të familjes së tij emërohet mbrojtës me shpenzime publike, nëse ai nuk mund t'i paguajë shpenzimet për mbrojtjen e vet, por jo kundër dëshirës së të miturit.
5. I mituri udhëzohet për të drejtën në mbrojtës me shpenzime publike sipas paragrafit 4. të këtij neni, para marrjes së parë në pyetje.
6. Të miturin mund ta përfaqësojë vetëm mbrojtësi i regjistruar në Odën e Avokatëve të Kosovës.

Neni 44

1. Prindërit, prindërit adoptues ose kujdestari kanë të drejtë ta shoqërojnë të miturin në të gjitha procedurat dhe nga ata mund të kërkohet që të marrin pjesë nëse kjo është në interes të të miturit. Gjyqtari për të mitur mund ta përjashtojë prindin, prindin adoptues ose kujdestarin nga pjesëmarrja në procedurë nëse përjashtimi i tillë është në interesin më të mirë të të miturit.
2. Kur prindërit, prindërit adoptues ose kujdestari i të miturit nuk e kryejnë detyrën e tyre prindore, gjykata mund të caktojë një (1) kujdestar të përkohshëm për të miturin.
3. Gjykatat mbajnë evidencë të përgatitur nga Qendra për Punë Sociale, për punëtorët socialë, arsimtarët, pedagogët ose specialistët vullnetarë nga mesi i të cilëve caktohet kujdestari i përkohshëm në rastet nga paragrafi 2. i këtij neni.

Neni 45

I mituri i nënshtrohet kontrollit të përgjithshëm mjekësor para fillimit paraqitjes së propozimit për caktimin e masës së paraburgimit, për tu siguruar se shëndeti i tij lejon caktimin e paraburgimit.

Neni 46

Askush nuk mund të përjashtohet nga detyra për të dëshmuar lidhur me rrethanat e nevojshme për vlerësimin e zhvillimit psikologjik të të miturit ose për njohjen e personalitetit të tij dhe të kushteve në të cilat jeton ai.

Neni 47

1. Kur i mituri ka marrë pjesë në kryerjen e veprës penale me një të rritur, procedura gjyqësore kundër të miturit ndahet dhe zbatohet sipas dispozitave të këtij kodi.
2. Në mënyrë të veçantë, procedura kundër të miturit mund të bashkohet me procedurën kundër të rriturit dhe mund të zbatohet në pajtim me dispozitat e përgjithshme të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, vetëm nëse bashkimi i procedurës është i nevojshëm për sqarim gjithëpërfshirës të rastit. Trupi gjykues për të mitur i gjykatës kompetente merr vendim lidhur me këtë në bazë të propozimit të arsyeshëm të prokurorit ose mbrojtësit. Palët mund të ushtrojnë ankesë kundër aktvendimit të gjykatës së shkallës së dytë brenda tri (3) ditëve nga marrja e aktvendimit.
3. Kur procedura e bashkuar zbatohet kundër të miturit dhe kryerësit madhor, dispozitat e nenit 40, nenet 42 - 46, neni 48, neni 49, neni 50 paragrafët 1 dhe 3, neni 64 - 68 dhe neni 71 i këtij Kodi zbatohen gjithmonë lidhur me të miturin në rastet kur çështjet që kanë të bëjnë me të miturin sqarohen në shqyrtim gjyqësor dhe nenet 79 dhe 80 të këtij Kodi zbatohen gjithmonë lidhur me të miturin, ndërsa dispozitat tjera të këtij Kodi zbatohen nëse aplikimi i tyre nuk është në kundërshtim me zbatimin e procedurës së përbashkët.

Neni 48

1. Në procedurë ndaj të miturve, pavarësisht nga kompetencat e parashikuara qartë në dispozitat e këtij Kodi, organi i kujdestarisë njoftohet për rrjedhën e procedurës, të bëjë propozime dhe të paraqesë fakte e prova të rëndësishme për marrjen e vendimit të drejtë.
2. Prokurori e njofton organin kompetent të kujdestarisë kurdo që fillon procedura kundër të miturit.

Neni 49

1. I mituri ftohet në gjykatë personalisht dhe përmes prindit, prindit adoptues ose kujdestarit të tij.
2. Të miturit i dorëzohen vendimet dhe dokumentet e tjera të shkruara në pajtim me

dispozitat e Kodit të procedurës penale të Kosovës. Megjithatë dokumentet nuk i dorëzohen të miturit duke i ekspozuar në tabelën e shpalljeve të gjykatës dhe nuk zbatohen dispozitat e Kodit të procedurës penale.

Neni 50

1. Të gjitha procedurat në të cilat janë të përfshirë të miturit janë konfidenciale. Asnjë incizim i procedurës, duke përfshirë edhe audio dhe video incizimin, nuk mund të bëhet publik pa autorizimin e gjykatës.
2. Vetëm pjesa e vendimit të marrë gjatë procedurës që autorizohet për publikim bëhet publike.
3. Kur pjesa e autorizuar e incizimit të procedurës ose e vendimit bëhet publike nuk zbulohen të dhënat personale që mund të shfrytëzohen për identifikimin e të miturit.
4. Dispozitat e këtij neni zbatohen në procedurat ku përfshihen madhorët që gjykohen për vepra penale që i kanë kryer si të mitur.

KREU X
PËRBËRJA E TRUPIT GJYKUES PËR TË MITU

Neni 51

1. Trupi gjykues për të mitur në gjykatën e shkallës së parë dhe trupi gjykues për të mitur në gjykatën e shkallës së dytë, me përjashtim të kolegjeve në Gjykatën Supreme të Kosovës, përbëhet nga një (1) gjyqtar për të mitur dhe dy (2)gjyqtarë porotë. Gjyqtari për të mitur është kryetari i trupit gjykues.
2. Kolegji për të mitur në Gjykatën Supreme të Kosovës përbëhet nga tre (3) gjyqtarë duke përfshirë së paku një (1) gjyqtar për të mitur. Kur trupi gjykues për të mitur gjykon në shqyrtimin gjyqësor, do të përbëhet nga dy (2) gjyqtarë për të mitur dhe tre (3) gjyqtarë porotë.
3. Gjyqtarët porotë në trupin gjykues për të mitur emërohen nga mesi i profesorëve, arsimtarëve, edukatorëve, punëtorëve socialë, psikologëve dhe personave të tjerë që kanë përvojë në edukimin e të miturve.
4. Gjyqtarët porotë që marrin pjesë në trupin gjykues për të mitur janë të gjinive të ndryshme.

Neni 52

1. Prokurori mund të pezullojë ndjekjen e veprës penale dhe të shqiptojë masën e diversitetit nëse janë plotësuar kushtet nga neni 17 i këtij Kodi. Para vendosjes për masën e diversitetit, prokurori e thërret të miturin, prindin e tij, prindërit adoptues ose kujdestarin dhe mbrojtësin.
2. Gjyqtari për të mitur mund të shqiptojë masën e diversitetit nëse janë plotësuar kushtet nga neni i këtij Kodi. Para vendosjes për masën e diveristetit, gjyqtari për të mitur e thërret të miturin, prindin e tij, prindin adoptues ose kujdestarin dhe mbrojtësin. Nëse gjyqtari për të mitur vendos të shqiptojë masën e diversitetit, pushohet çdo procedurë që është duke vazhduar.

Neni 53

1. Gjykata e shkallës së dytë është kompetente:
   1.1. të vendosë për ankesën kundër vendimit të trupit gjykues për të mitur të shqiptuar në shkallë të parë;
   1.2. të vendosë për ankesën kundër vendimit të prokurorit publik;
   1.3. të vendosë për ankesën kundër vendimit të gjyqtarit për të mitur dhe
   1.4. në rastet e tjera të veprojë ashtu siç parashihet me ligj.

Neni 54

1. Gjykata në territorin e së cilës është adresa e përhershme e vendbanimit të të miturit, sipas rregullit ka kompetencë territoriale për procedurë kundër të miturit.
2. Nëse i mituri nuk ka adresë të përhershme apo nëse adresa e tij nuk dihet, gjykata në territorin e së cilës aktualisht ndodhet vendbanimi i të miturit ka kompetencë territoriale.
3. Procedura mund të zbatohet në gjykatën në territorin e së cilës aktualisht ndodhet vendbanimi i të miturit, edhe kur ai ka vendbanim të përhershëm, ose në gjykatën në territorin e së cilës është kryer vepra penale nëse është e qartë që procedura do të zbatohet më lehtë në atë gjykatë.

KREU XI
PROCEDURA PËRGATITORE

Neni 55

1. Prokurori fillon procedurën përgatitore ndaj të miturit të caktuar në bazë të kallëzimit penal të policisë, kallëzimit penal nga persona të tjerë ose nga burime të tjera nëse ekziston dyshim i bazuar se i mituri ka kryer vepër penale.
2. Procedura përgatitore për vepra penale që ndiqen në bazë të propozimit për ndjekje penale ose të padisë private fillohet vetëm nga prokurori nëse pala e dëmtuar ia ka dorëzuar propozimin për fillimin e procedurës prokurorit publik brenda afatit të parashikuar në dispozitën e Kodit të Procedurës Penale të Kosovës.

Neni 56

1. Për veprat penale të dënueshme me burgim prej më pak se tre (3) vjet ose me gjobë, prokurori mund të vendosë të mos fillojë procedurën përgatitore edhe pse ekziston dyshim i bazuar se i mituri ka kryer vepër penale, nëse prokurori mendon se nuk do të ishte e përshtatshme të zbatohet procedura kundër të miturit për shkak të natyrës së veprës penale, të rrethanave në të cilat është kryer ajo, mungesës së dëmit të rëndë ose të pasojave për të dëmtuarin, si edhe të të kaluarës së të miturit dhe të karakteristikave të tij personale.
2. Kur ndaj të miturit ekzekutohet dënimi ose masa, prokurori mund të vendosë të mos fillojë procedurën përgatitore për një vepër tjetër penale të kryer nga i mituri, nëse duke pasur parasysh peshën e asaj vepre penale, si dhe dënimin a masën e cila është duke u ekzekutuar, zbatimi i procedurës dhe shqiptimi i dënimit ose i masës për veprën penale nuk do t'i shërbente ndonjë qëllimi.

3. Nëse prokurori vendos të mos fillojë procedurën përgatitore, ai e njofton organin e kujdestarisë.
4. Për t'i vërtetuar rrethanat nga paragrafi 1. të këtij neni, prokurori mund të kërkojë që shërbimi sprovues ta bëjë një anketë sociale të parashikuar në nenin 8 të këtij Kodi. Nëse është e nevojshme, prokurori mund ta thirr prindin, prindin adoptues ose kujdestarin e të miturit, si edhe personat dhe institucionet e tjera dhe palën e dëmtuar.
5. Nëse për ndonjë arsye nuk është e mundur që anketa sociale sipas paragrafit 4 të këtij neni të përfundohet para se të merret vendimi për përshtatshmërinë e fillimit të procedurës përgatitore, prokurori i siguron informatat e nevojshme sipas nenit 8 të këtij Kodi dhe mund të konsultohet me shërbimin sprovues për vendimin e tij.

Neni 57

1. Procedura përgatitore fillohet me aktvendim të prokurorit. Në aktvendim përcaktohet i mituri ndaj të cilit zbatohet procedura përgatitore, koha e fillimit të procedurës përgatitore, përshkrimi i veprës që përcakton elementet e veprës penale, emërtimi ligjor i veprës penale, rrethanat dhe faktet që arsyetojnë dyshimin e bazuar për veprën penale, provat dhe informatat e mbledhura dhe raporti për ndonjë dënim ose masë të shqiptuar më parë ndaj të miturit. Një kopje e vulosur e aktvendimit mbi procedurën përgatitore i dërgohet pa vonesë gjyqtarit për të mitur.
2. Dispozitat e Kodit të procedurës penale të Kosovës zbatohen përshtatshmërisht në procedurën përgatitore.

Neni 58

1. Gjyqtari për të mitur cakton ekspert përkatës të shëndetit mendor kur është e nevojshme të vërtetohet gjendja e shëndetit mendor të të miturit qoftë në kohën e kryerjes së veprës penale ose të konstatojë aftësinë e të miturit për t'u gjykuar ose në të dyja rastet. Gjyqtari për të mitur caktimin e kësaj detyre e bën sipas detyrës zyrtare ose me kërkesën e prokurorit, të mbrojtësit, prindërve, prindërve adoptues a të kujdestarit. Kontrolli bëhet në ambient të përshtatshëm dhe konfidencial. Mendimi i ekspertit për shëndetin mendor është konfidencial dhe mund t'i zbulohet gjykatës dhe palëve.
2. Gjyqtari për të mitur mund të kërkojë nga shërbimi sprovues përgatitjen e raportit para ndëshkues.

Neni 59

1. Gjatë rrjedhës së procedurës përgatitore, gjyqtari për të mitur garanton të drejtat e të miturit.
2. Mbrojtësi dhe prindi, prindi adoptues, kujdestari i të miturit dhe organi i kujdestarisë mund të marrin pjesë në veprimet e marra gjatë procedurës përgatitore. Kur personat e tillë janë të pranishëm në veprimet e tilla, ata mund të bëjnë propozime dhe t'i shtrojnë pyetje personit që është duke u marrë në pyetje.
3. Marrja në pyetje e të miturit, në rastet kur është e nevojshme, ndërmerret me ndihmën e pedagogut, psikologut, defektologut, etj.

Neni 60

1. Prokuroi e pushon procedurën përgatitore kurdo që nga provat e mbledhura konstatohet se:
   1.1. nuk ka dyshim të bazuar se i mituri ka kryer veprën e caktuar penale;
   1.2. ka kaluar afati i parashkrimit për ndjekje penale;
   1.3. vepra penale është përfshirë me falje;
   1.4. janë prezente kushtet e parapara në nenin 56, në paragrafin 1 të këtij Kodi ose
   1.5. ekzistojnë rrethana të tjera që pengojnë ndjekjen.
2. Prokurori menjëherë e informon gjyqtarin për të mitur për pushimin e procedurës përgatitore. Prokurori publik menjëherë e njofton edhe të miturin për pushimin e procedurës përgatitore, përveç rasteve kur nuk janë ndërmarrë veprime në procedurën përgatitore.

Neni 61

Nëse procedurat përgatitore nuk përfundohen brenda periudhës gjashtë (6) mujore, prokurori i dorëzon gjyqtarit për të mitur kërkesë të arsyetuar me shkrim për vazhdimin e procedurës përgatitore. Procedura përgatitore mund të vazhdohet në pajtim me dispozitat e Kodit të procedurës penale të Kosovës.

Neni 62

Para përfundimit të procedurës përgatitore, prokurori e njofton mbrojtësin për qëllimin e tij që të përfundojë procedurën brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve. Gjatë kësaj periudhe mbrojtësi mund të parashtrojë kërkesë për marrjen parasysh të fakteve apo provave të reja në pajtim me nenin 59, paragrafi 2 të këtij Kodi. Nëse prokurori e miraton kërkesën, procedura përgatitore nuk përfundohet dhe nevojitet njoftim i ri për përfundimin e procedurës. Nëse nuk parashtrohet kërkesë, procedura përfundohet brenda afatit që i është komunikuar palëve. Prokurori nuk merr parasysh kërkesën për shqyrtimin e fakteve ose provave të reja pas përfundimit të procedurës përgatitore.

Neni 63

1. Pas përfundimit të procedurës përgatitore, prokurori mund të paraqesë propozim të arsyetuar pranë trupit gjykues për të mitur për shqiptimin e masës edukative ose dënimit.
2. Propozimi i prokurorit duhet të përfshijë: të dhënat personale të të miturit, përshkrimin e veprës penale, emërtimin ligjor të veprës penale me përcaktimin e dispozitave në Kodin Penal të Kosovës, provat që tregojnë se i mituri e ka kryer veprën penale, rezultatet e ndonjë ankete sociale të përpiluar nga shërbimi sprovues dhe propozimin për shqiptimin e masës edukative ose dënimin ndaj të miturit, duke përfshirë arsyerat pse nuk është shqiptuar masa e diversitetit.

KREU XII
ARRESTI I PËRKOHSHËM, NDALIMI POLICOR DHE PARABURGIMI

Neni 64

Arresti i përkohshëm, ndalimi policor dhe paraburgimi i të miturit urdhërohet vetëm si masë e fundit për një kohë sa më të shkurtër të mundshme.

Neni 65

1. Policia mund të arrestojë dhe të ndalojë të miturin në pajtim me kapitullin XXIV të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës.
2. Arresti i përkohshëm apo ndalimi i të miturit nuk mund të kalojë periudhën njëzetekatër (24) orësh. Pas kalimit të kësaj periudhe, policia e liron të miturin, përveç nëse gjyqtari për të mitur cakton paraburgim.

Neni 66

1. Gjyqtari për të mitur mund të caktoj paraburgimin ndaj të miturit nëse ekzistojnë arsyet e përcaktuara me dispozitat e Kodit të Procedurës Penale të Kosovës dhe nëse alternativat e paraburgimit nuk do të ishin të mjaftueshme për të siguruar praninë e të miturit, për të parandaluar kryerjen e serishme të veprës dhe për të siguruar zbatim të suksesshëm të procedurës. Gjyqtari për të mitur shqyrton nëse masat e parapara në nenin 6 të këtij Kodi ose në nenin 268 (1) të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës mund të urdhërohen si alternativë për paraburgimin. Aktvendimi mbi paraburgimin e të miturit përfshin një shpjegim të arsyetuar për pamjaftueshmërinë e alternativave kundruall paraburgimit.
2. I mituri mund të mbahet në paraburgim me aktvendim të gjyqtarit për të mitur për një periudhë maksimale prej tridhjetë (30) ditësh nga dita kur ai është arrestuar. Paraburgimi i të miturit mund të vazhdohet vetëm nga kolegji për të mitur i gjykatës kompetente për një periudhë shtesë deri në gjashtëdhjetë (60) ditë.
3. Kolegji për të mitur i gjykatës kompetente e rishqyrton aktvendimin për paraburgim brenda tridhjetë (30) ditëve nga marrja e aktvendimit. Rishqyrtimi i tillë bëhet në seancë dëgjimore në praninë e të miturit, mbrojtësit të tij dhe prokurorit.

Neni 67

1. Të miturit që mbahen në paraburgim në qendrën e paraburgimit ndahen nga të paraburgosurit madhor.
2. I mituri i cili mbahet në paraburgim mund të mbahet në institucionin edukativo korrektues nëse gjyqtari për të mitur konsideron se kjo është në interesin më të mirë të të miturit.
3. Derisa mbahet në paraburgim, të miturit, sipas nevojës dhe në përputhje me moshën, gjininë dhe personalitetin e tij, i ofrohet ndihmë sociale, edukative, psikologjike, mjekësore dhe fizike.

Neni 68

1. Dispozitat e Kodit të procedurës penale të Kosovës zbatohen përshtatshmërish për paraburgimin ndaj të miturit.
2. Përjashtimisht nga paragrafi 1. i këtij neni, i mituri nuk mund të mbahet në paraburgim më shume se dymbëdhjetë (12) muaj nga dita e arrestit
3. Gjyqtari për të mitur ka autorizime të njëjta lidhur me të miturin në paraburgim sikurse gjyqtari i procedurës paraprake sipas Kodit të Procedurës Penale të Kosovës lidhur me të rriturit në paraburgim.

KREU XIII
SHQYRTIMI GJYQËSOR

Neni 69

1. Kur gjyqtari për të mitur merr propozimin nga prokurori, ai mund të merr aktvendim për hedhjen e propozimit apo transferimin e çështjes në gjykatë tjetër, nëse ekzistojnë kushtet e parapara me dispozitat e Kodit të Procedurës Penale të Kosovës.
2. Nëse gjyqtari për të mitur nuk merr aktvendim për hedhjen e propozimit ose transferimin e çështjes në gjykatë tjetër, ai e cakton shqyrtimin gjyqësor brenda tetë (8) ditëve nga pranimi i propozimit.
3. Në çdo kohë, trupi gjykues për të mitur mund të pushojë procedurën në shqyrtimin gjyqësor dhe të shqiptojë masën e diversitetit nëse plotësohen kushtet nga neni 17 të këtij Kodi. Para vendosjes për masën e diversitetit, trupi gjykues për të mitur e thirr të miturin, prindin e tij, prindin adoptues ose kujdestarin dhe mbrojtësin.

Neni 70

1. I mituri, mbrojtësi dhe prokurori janë të pranishëm në shqyrtimin gjyqësor.
2. Përveç personave të paraparë me dispozitat e Kodit të procedurës penale të Kosovës, prindi, prindi adoptues ose kujdestari, përfaqësuesi i organit të kujdestarisë dhe përfaqësuesi i shërbimit sprovues thirren në shqyrtimin gjyqësor. Mosparaqitja e personave të tillë nuk e pengon gjykatën që ta mbajë shqyrtimin gjyqësor.
3. Dispozitat e Kodit të Procedurës Penale të Kosovës lidhur me ndryshimin dhe zgjerimin e akuzës po ashtu vlejnë në procedurën ndaj të miturit. Megjithatë, trupi gjykues për të mitur është i autorizuar të marrë vendim, madje edhe nëse prokurori nuk ka ndryshuar propozimin e tij ose nëse nuk ka përgatitur propozim të ri, në bazë të provave që janë prezantuar në shqyrtimin gjyqësor, duke treguar se gjendja faktike siç është shpjeguar në propozim ka ndryshuar.

Neni 71

1. Publiku gjithmonë përjashtohet kur gjykohet i mituri.
2. Trupi gjykues për të mitur në shqyrtim gjyqësor mund të lejojë pjesëmarrjen e ekspertëve dhe personave të cilët profesionalisht trajtojnë mirëqenien dhe edukimin e të miturve ose luftimin e sjelljes delikuente për të të miturit.

3. Gjatë seancës gjyqësore trupi gjykues për të mitur mund të urdhërojë që të gjithë personat ose personat e caktuar të largohen nga seanca me përjashtim të të miturit, prokurorit, mbrojtësit, përfaqësuesit të organit të kujdestarisë dhe përfaqësuesit të shërbimit sprovues. Trupi gjykues për të mitur mund të urdhërojë që prindi, prindi adoptues ose kujdestari të largohen nga shqyrtimi gjyqësor vetëm në rrethana të jashtëzakonshme, nëse ka arsye për të besuar se kjo është në interesin më të mirë të të miturit.
4. Dispozitat e këtij neni zbatohen në procedurë ku përfshihen madhorët që gjykohen për vepra penale që i kanë kryer si të mitur.

Neni 72

Seanca gjyqësore shtyhet ose ndërprehet vetëm përjashtimisht. Gjyqtari për të mitur e njofton kryetarin e gjykatës për çdo shtyrje ose ndërprerje të seancës gjyqësore duke paraqitur arsyet për këtë.

Neni 73

1. Trupi gjykues për të mitur nuk është i lidhur me propozimin e prokurorit me rastin e marrjes së vendimit të tij për llojin e masës ose dënimit që do të shqiptohet.
2. Trupi gjykues për të mitur e pushon procedurën në shqyrtim gjyqësor me aktvendim, kur ekzistojnë arsyet e parapara me dispozitat e Kodit të procedurës penale të Kosovës.
3. Trupi gjykues për të mitur me aktvendim shqipton masën edukative për të miturin. Në dispozitiv të aktvendimit ceket vetëm urdhri për masën edukative dhe çfarëdo mase tjetër ose dënimi në kreun VIII të këtij Kodi, por i mituri nuk shpallet fajtor për veprën penale të përshkruar në propozimin e prokurorit. Arsyetimi i aktvendimit përmban përshkrimin e veprës penale dhe rrethanat të cilat e arsyetojnë shqiptimin e masës edukative.
4. Trupi gjykues për të mitur me aktgjykim shqipton dënimin ndaj të miturit. Aktgjykimi merret sipas dispozitave të Kodit të procedurës penale të Kosovës. Aktgjykimi gjithashtu përfshin urdhrin për cilëndo masë ose dënim në kreun VIII të këtij Kodi.

Neni 74

Gjyqtari për të mitur e përpilon aktvendimin ose aktgjykimin me shkrim brenda tetë (8) ditëve nga dita e shpalljes së tij, përjashtimisht në raste të ndërlikuara afati i përcaktuar mund të zgjatet me lejen e kryetarit të gjykatës por jo më shumë se pesëmbëdhjetë (15) ditë.

Neni 75

1. Gjykata mund të urdhërojë të miturin t'i paguajë shpenzimet e procedurës dhe të plotësojë kërkesën pasuroro-juridike vetëm nëse të miturit i ka shqiptuar dënimin. Nëse të miturit i janë shqiptuar masat edukative, shpenzimet e procedurës gjyqësore paguhen nga buxheti i Kosovës kurse pala e dëmtuar për të realizuar kërkesën pasuroro juridike udhëzohet në kontest civil.

2. Nëse i mituri ka të ardhura të veta financiare ose pronë, gjykata mund ta urdhërojë të miturin t'i paguajë shpenzimet e procedurës dhe ta plotësojë kërkesën pasurorojuridike madje edhe kur është shqiptuar masa edukative.

Neni 76

Pjesa e katërt e Kodit të Procedurës Penale të Kosovës zbatohet përshtatshmërisht në shqyrtimin gjyqësor për të mitur dhe në aktvendimin dhe aktgjykimin e marrë lidhur me të miturin.

KREU XIV
MJETET JURIDIKE

Neni 77

1. Personat e paraparë me dispozitat e Kodit të procedurës penale të Kosovës mund të ankohen kundër vendimit për shqiptimin e masave të diversitetit, aktvendimit për pushimin e procedurës në shqyrtim gjyqësor, aktvendimit për shqiptimin e masës edukative, kundër aktgjykimit për shqiptimin e dënimit dhe aktgjykimit apo aktvendimit për shqiptimin e masës nga kreun VIII të këtij Kodi. Kjo ankesë mund të paraqitet brenda tetë (8) ditëve nga dita e pranimit të aktvendimit ose të aktgjykimit.
2. Mbrojtësi, prokurori, bashkëshorti, prindi, prindi adoptues ose kujdestari, i afërmi i gjakut në vijë të drejtë në cilëndo shkallë, vëllai ose motra mund të ushtrojnë ankesë në emër të të miturit madje edhe kundër dëshirës së tij.
3. I mituri nuk mund të heqë dorë nga e drejta e tij në ankesë.
4. Ankesa kundër aktvendimit me të cilin shqiptohet masa edukative që mbahet në institucion e pezullon ekzekutimin e masës. Gjykata mund të vendosë të ekzekutojë masën pavarësisht nga ankesa nëse konstaton se kjo është në interesin më të mirë të të miturit pasi ta dëgjojë të miturin, prindin e tij, prindin adoptues apo kujdestarin.

Neni 78

1. Gjykata e shkallës së dytë mund ta ndryshojë vendimin ndaj të cilit është ushtruar ankesa duke e shqiptuar një masë më të rëndë vetëm nëse është kërkuar kjo në ankesën prokurorit.
2. Nëse me aktvendim ose me aktgjykim në shkallë të parë nuk është shqiptuar burgim për të mitur, gjykata e shkallës së dytë mund ta shqiptojë burgimin për të mitur vetëm nëse mbahet shqyrtimi. Nëse me aktvendim ose me aktgjykim në shkallë të parë nuk është shqiptuar ndonjë masë edukative institucionale, gjykata e shkallës së dytë mund ta shqiptojë masën edukative institucionale vetëm nëse mbahet shqyrtimi.

Neni 79

Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë mund të paraqitet në pajtim me dispozitat e Kodit të procedurës penale, si dhe kur dënimi ose masa edukative i është shqiptuar të miturit me shkelje të dispozitave të këtij Kodi.

Neni 80

Dispozitat për rishikim të procedurës penale të pushuar me aktvendim të formës së prerë ose me aktgjykim të formës së prerë sipas dispozitave të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës zbatohen përshtatshmërisht për rishikimin e procedurës ndaj të miturit, e cila është pushuar me aktvendim të formës së prerë në shqyrtim gjyqësor, me aktvendim të formës së prerë me të cilin shqiptohet masa edukative dhe me aktgjykim të formës së prerë me të cilin shqiptohet dënimi.

PJESA E KATËRT
NDËRMJETËSIMI DHE EKZEKUTIMI I MASAVE DHE I DËNIMEVE

KREU XV
PROCEDURA PËR NDËRMJETËSIM

Neni 81

1. Para se palët të shkojnë në procedurën e ndërmjetësimit, prokurori ose gjyqtari për të mitur duhet që t'i njoftojë palët për parimet dhe rregullat e ndërmjetësimit, si dhe për procesin dhe efektet ligjore të çdo marrëveshjeje që arrihet përmes ndërmjetësimit, në pajtim me Ligjin për Ndërmjetësim.
2. Kur kryerësi i mitur dhe pala e dëmtuar shprehin pëlqimin e tyre për ndërmjetësim, ky pëlqim duhet të shënohet në procesverbal.
3. Prokurori ose gjyqtari për të mitur me aktvendim emëron një ndërmjetës të pavarur nga lista e ndërmjetësuesve në pajtim me Ligjin për Ndërmjetësimin.
4. Pas pranimit të aktvendimit që cakton ndërmjetësuesin, ndërmjetësuesi duhet që të vë kontakt me kryerësin e mitur dhe me palën e dëmtuar pastaj të fillojë procedurën e ndërmjetësimit.
5. Procedura e ndërmjetësimit nuk mund të zgjasë më tepër se nëntëdhjetë (90) ditë nga dita e nxjerrjes së aktvendimit. Për rezultatin e ndërmjetësimit njoftohet zyrtarisht Prokurori ose Gjyqtari për të mitur.
6. Nëse procedura e ndërmjetësimit nuk ka sukses, atëherë procedura gjyqësore duhet të vazhdojë nga aty ku është pezulluar.
7. Procedura e ndërmjetësimit për të mitur është pa pagesë për palët. Shpenzimet e procedurës së ndërmjetësimit, duke përfshirë pagesën për ndërmjetësuesin, paguhen nga buxheti i Këshillit Gjyqësor të Kosovës në rastet kur ndërmjetësuesi caktohet nga gjyqtari për të mitur ose nga kolegji për të mitur, ndërsa në rastet kur ndërmjetësuesi caktohet nga Prokurori, shpenzimet e procedurës paguhen nga buxheti i Këshillit Prokurorial të Kosovës.
8. Pagesa e shpenzimeve për procedurën e ndërmjetësimit dhe ndërmjetësuesit bëhet sipas ligjit për ndërmjetësimin dhe akteve nënligjore të nxjerra për zbatimin e tij.

Neni 82
Përfundimi i Procedurës së Ndërmjetësimit

1. Procedura e ndërmjetësimit përfundohet atëherë kur:

1.1. është kryer me sukses ndërmjetësimi;
1.2. ka kaluar afati prej nëntëdhjetë (90) ditësh
1.3. ndërmjetësuesi konsideron se vazhdimi i procedurës së ndërmjetësimit nuk është i mundur ose është i paarsyeshëm;
1.4. i mituri ose pala e dëmtuar deklarojnë se dëshirojnë ta ndërpresin procedurën;

2. Kur ndërmjetësimi nuk ka sukses, prokurori, gjyqtari, ose kolegji për të mitur i cili ka propozuar ndërmjetësimin, rifillon procedurën e pezulluar nga momenti i pezullimit të tyre;
3. Kur ndërmjetësimi ka sukses, me aktvendim ndërpritet procedura gjyqësore apo ajo te prokurori ndaj kryerësit të mitur të veprës penale. Pasi të ndërpritet procedura gjyqësore, prokurori ose gjyqtari për të mitur duhet që t'i njoftojë palët lidhur me vendimin e tyre.
4. Po që se palët arrijnë marrëveshjen mbi kompensimin e dëmit, atëherë ajo i dorëzohet prokurorit ose gjyqtari për të mitur, dhe nëse ata e miratojnë, marrëveshja përbën titull ekzekutiv dhe ekzekutohet në pajtim me ligjin në fuqi.

KREU XVI
EKZEKUTIMI I MASAVE TË DIVERSITETIT

Neni 83

1. Kur prokurori, gjyqtari për të mitur ose gjykata shqipton masën e diversitetit, aktvendimi dhe të gjitha informacionet dërgohen në shërbimin sprovues kompetent për ekzekutimin e kësaj mase.
2. Organi i cili e ka shqiptuar masën e diversitetit e mbikëqyrë ekzekutimin e masës së diversitetit.
3. Nëse i mituri nuk e përmbush detyrimin e urdhëruar si masë diversiteti, shërbimi sprovues verifikon faktet dhe arsyet e mos përmbushjes së detyrimit dhe e informon organin që e ka shqiptuar masën e diversitetit dhe prokurorin kompetent.

KREU XVII
EKZEKUTIMI I MASVE EDUKATIVE

Neni 84
Parimet e përgjithshme mbi ekzekutimin e masave edukative

1. Gjykata që ka shqiptuar masën edukative është kompetente për mbikëqyrjen e ekzekutimit të masës edukative dhe për lëshimin e urdhrave lidhur me ekzekutimin e masës edukative.
2. Shërbimi Sprovues që ndodhet në territorin ku i mituri ka banim të përhershëm apo të përkohshëm është përgjegjës lidhur me ekzekutimin e masës edukuese.

Neni 85

1. Masa edukative ekzekutohet duke respektuar personalitetin dhe dinjitetin e të miturve, duke inkurajuar zhvillimin e tyre fizik, moral dhe intelektual, si dhe duke mbrojtur shëndetin e tyre fizik dhe mendor.

2. Masa edukative ekzekutohet bazuar në programin individual të adaptuar sa më shumë që të jetë e mundur sipas personalitetit të të miturit dhe të përgatitur në pajtim me të arriturat bashkohore të dijes dhe përvojës.
3. Programi individual është i përgatitur në bazë të analizave gjithëpërfshirëse të karakteristikave të veçanta të të miturit, shkaqeve dhe llojit të veprës penale dhe formave të tjera të vështirësive në sjellje, si dhe shkallës së arsimimit, zhvillimit të të miturit dhe rrethanave të jetës së tij familjare.
4. Programi individual përfshin mjete motivuese të cilat u janë adaptuar karakteristikave personale të të miturit, regjistrimit në shkollë dhe aftësim profesional, aktiviteteve të kohës së lirë, aktivitetit me prindërit, prindërit adoptues, kujdestarit apo anëtarëve të tjerë të familjes së të miturit dhe mënyrave të tjera të ushtrimit të ndikimit ndaj të miturit.

Neni 86

1. Shpenzimet për ekzekutimin e masës edukative paguhen nga buxheti i Kosovës.
2. Prindërit ose personat të cilët janë të obliguar me ligj të kujdesen për të miturin mund të obligohen që të kontribuojnë në pagimin e shpenzimeve për ekzekutimin e masës edukative.
3. Niveli i kontributit të prindërve apo i personave të cilët me ligj detyrohen të kujdesen për të miturin caktohet nga gjykata kur merr aktvendim për shqiptimin e masës edukative. Nëse caktimi i nivelit të kontributit kërkon një studim të detajuar të gjendjes financiare të prindërve apo personave të cilët me ligj detyrohen të kujdesen për të miturin, gjykata së pari merr aktvendim për shqiptimin e masës edukative dhe pastaj vazhdon procedurën për caktimin e nivelit të kontributit.
4. Gjykata kompetente mund ta ndryshojë vendimin për nivelin e kontributit nëse më vonë ndryshojnë rrethanat.

Neni 87

1. Masa edukative ekzekutohet pas vendimit të formës së prerë të gjykatës dhe kur nuk ka më pengesa juridike për ekzekutimin e saj, përveç rasteve kur ky Kod parasheh ndryshe.
2. Vendimin e formës së prerë gjykata ia dërgon institucionit të autorizuar apo individit për ekzekutim brenda tri (3) ditëve nga dita kur vendimi merr formë të prerë, së bashku me certifikatën e lindjes, dëftesën e shkollës ose dokumentin për transferim, raportin e kontrollit mjekësor, të dhënat nga dosja penale për vepra penale të mëhershme, procedurën e zbatuar dhe raportin e lëshuar nga shërbimi sprovues.
3. Institucioni i autorizuar apo individi i cili e pranon vendimin për ekzekutim e fillon ekzekutimin e dënimit brenda tre (3) ditëve nga pranimi i vendimit.
4. Gjykata kompetente ruan të dhënat për çdo të mitur ndaj të cilit është shqiptuar masë edukative.

Neni 88

Gjatë ekzekutimit të masës edukative, gjykata kompetente mund të shqiptojë masa adekuate për mbrojtjen e të drejtave dhe të mirëqenies së të miturit, duke përfshirë edhe vendosjen e të miturit në strehimore ose në institucionin edukativ apo të ngjashëm, vendosjen e të miturit nën mbikëqyrjen e organit të kujdestarisë ose tranferimin e të miturit në ndonjë familje tjetër. Gjykata e njofton organin e kujdestarisë për cilëndo masë të shqiptuar.

Neni 89
Ekzekutimi i masës së dërgimit në qendrën disiplinore

Masa e dërgimit në qendër disiplinore për të mitur ekzekutohet në institucionin e posaçëm edukativ.

Neni 90

1. Prindi, prindi adoptues apo kujdestari duhet të sigurojë vizita të rregullta të të miturit në qendrën disiplinore.
2. Qendra disiplinore menjëherë e njofton gjykatën kompetente kur i mituri nuk paraqitet në kohën e caktuar në qendrën disiplinore apo kur ndërprenë vizitat e tij të rregullta.
3. Qendra disiplinore ruan shënimet mbi ekzekutimin e masës edukative e cila dorëzohet për inspektim në gjykatë dhe shërbimin sprovues.

Neni 91
Ekzekutimi i masës së mbikëqyrjes së shtuar nga prindi, prindi adoptues ose kujdestari

Ekzekutimi i masës edukative të mbikëqyrjes së shtuar nga prindi, prindi adoptues ose kujdestari fillon kur prindi, prindi adoptues ose kujdestari pranon aktvendimin e formës së prerë mbi shqiptimin e masës edukative.

Neni 92

1. Prindi, prindi adoptues ose kujdestari i respektojnë urdhrat dhe udhëzimet e gjykatës e cila ka shqiptuar masën edukative dhe lejojnë shërbimin sprovues të verifikojë ekzekutimin e masës edukative kur verifikimi i tillë urdhërohet nga gjykata.
2. Kontesti ndërmjet prindërve, prindërve adoptues ose kujdestarit të të miturit dhe shërbimit sprovues zgjidhet pranë gjykatës kompetente.

Neni 93

1. Prindi, prindi adoptues ose kujdestari i të miturit dhe shërbimi sprovues e informojnë gjykatën kompetente mbi përparimin në ekzekutimin e masës edukative sipas kushteve të urdhëruara nga gjykata.
2. Shërbimi sprovues pa vonesë e informon gjykatën kompetente për mos

përmbushjen e detyrimit të veçantë nga i mituri të shqiptuar në pajtim me nenin 26 të këtij Kodi dhe për çfarëdo pengese në ekzekutimin e masës edukative.

Neni 94
Ekzekutimi i masës për mbikëqyrje të shtuar në familjen tjetër

1. Gjykata kompetente me propozim të shërbimit sprovues cakton familjen në të cilën vendoset i mituri ndaj të cilit është shqiptuar masa e mbikëqyrjes së shtuar në familjen tjetër.
2. Para dorëzimit të propozimit, shërbimi sprovues analizon personalitetin e të miturit dhe strukturën sociale dhe psikologjike të familjes në të cilën ai do të vendoset.
3. Sipas kushteve të njëjta, përparësi i jepet familjes me të cilën i mituri është në lidhje farefisnore apo është i lidhur emocionalisht.

Neni 95

1. Shërbimi sprovues dhe familja në të cilën i mituri do të vendoset nënshkruajnë marrëveshje me shkrim që i rregullon të drejtat dhe detyrimet e përbashkëta.
2. Familja ku i mituri duhet të vendoset lejon shërbimin sprovues ta verifikojë ekzekutimin e masës edukative, kur një verifikim i tillë urdhërohet nga gjykata.

Neni 96

Gjatë ekzekutimit të masës edukative të mbikëqyrjes së shtuar në familjen tjetër, i mituri mbanë lidhje të përhershme me familjen e tij, përpos kur gjykata kompetente urdhëron ndryshe në bazë të propozimit të shërbimit sprovues.

Neni 97

Gjykata kompetente sipas detyrës zyrtare apo në bazë të propozimit të shërbimit sprovues mund të urdhërojë ndryshimin e vendit për të miturin, nëse rrethanat në familjen ku i mituri është i vendosur kanë ndryshuar në atë masë sa që ekzekutimi i masës edukative bëhet i vështirë.

Neni 98

Dispozitat e këtij Kodi mbi ekzekutimin e masës së mbikëqyrjes së shtuar nga prindi, prindi adoptues apo kujdestari zbatohen përshtatshmërisht në ekzekutimin e masës edukative të mbikëqyrjes së shtuar në familjen tjetër.

Neni 99
Ezekutimi i masës së mbikëqyrjes së shtuar nga organi i kujdestarisë

1. Organi kompetent i kujdestarisë është i autorizuar të ekzekutojë masën edukative të mbikëqyrjes së shtuar.
2. Organi i kujdestarisë menjëherë pas marrjes së aktvendimit për shqiptimin e masës

edukative e cakton zyrtarin përgjegjës nga organi i kujdestarisë për ekzekutimin e masës dhe për këtë menjëherë e informon gjykatën kompetente.

Neni 100

1. Gjykatat, prokuroria, shkollat dhe institucionet tjera ndihmojnë dhe bashkëpunojnë me organin e kujdestarisë në ekzekutimin e kësaj mase edukative.
2. Prindi, prindi adoptues apo prindi birësues i të miturit e informon organin e kujdestarisë për çfarëdo pengese në ekzekutimin e masës edukative.
3. Organi i kujdestarisë pa vonesë e informon gjykatën kompetente për mos përmbushjen e detyrimeve të posaçme të shqiptuara në pajtim me nenin 26 të këtij Kodi nga ana e të miturit, si dhe për çfarëdo pengese në ekzekutimin e masës edukative.
4. Dispozitat e këtij Kodi mbi ekzekutimin e masës edukative të mbikëqyrjes së shtuar nga ana e prindit, prindit adoptues apo kujdestarit zbatohen përshatshmërisht në rastet e ekzekutimit të masës edukative të mbikëqyrjes së shtuar nga organi i kujdestarisë.

Neni 101

Dispozitat e këtij Kodi mbi ekzekutimin e masës edukative të mbikëqyrjes së shtuar nga prindi, prindi adoptues ose kujdestari zbatohen përshtatshmërisht për ekzekutimin e masës edukative të kujdesit të shtuar nga organi i kujdestarisë.

Neni 102
Dispozitat e përgjithshme mbi masat edukative institucionale

I mituri ndaj të cilit ekzekutohet masa edukative institucionale, krahas të drejtave të parashikuara me këtë Kod, gëzon të njëjtat të drejta sikurse madhori i dënuar me burgim.

Neni 103

1. Me kërkesën e të miturit ose prindit të tij, prindit adoptues ose kujdestarit ose me propozimin e shërbimit sprovues, ekzekutimi i masës edukative institucionale mund të shtyhet për shkaqe të arsyeshme.
2. Për shtyrjen e ekzekutimit vendos gjykata kompetente.
3. Ankesa kundër aktvendimit në shkallë të parë për shtyrjen e ekzekutimit mund të parashtrohet në gjykatën e shkallës së dytë brenda tre (3) ditëve nga marrja e aktvendimit.

Neni 104

1. Kërkesa ose propozimi për shtyrjen e ekzekutimit e shtyn ekzekutimin e masës edukative institucionale deri në marrjen e aktvendimit të formës së prerë për kërkesën apo propozimin.

2. Nëse gjykata duke e refuzuar kërkesën e cila është dorëzuar për herë të dytë, konstaton se e drejta për kërkesë po keqpërdoret, gjykata vendos që ankesa të mos e shtyj ekzekutimin e masës edukative institucionale.

Neni 105

Dispozitat e Ligjit mbi Ekzekutimin e Sanksioneve Penale mbi shtyrjen e ekzekutimit të dënimit me burgim zbatohen përshtatshmërisht për shtyrjen e ekzekutimit të masës edukative institucionale.

Neni 106

1. Me kërkesën e të miturit apo të prindit të tij, prindit adoptues ose kujdestarit, ose me propozimin e drejtorit të institucionit ku ekzekutohet masa edukative institucionale, masa edukative institucionale mund të pezullohet për arsye të justifikueshme deri në tre (3) muaj. Përjashtimisht, për qëllime të trajtimit, pezullimi mund të vazhdojë deri në përfundim të trajtimit.
2. Gjykata kompetente vendos për pezullimin.
3. Ankesa kundër aktvendimit në shkallë të parë mund të parashtrohet në gjykatën e shkallës së dytë brenda tre (3) ditëve nga marrja e aktvendimit.

Neni 107

1. Gjykata pezullon ekzekutimin e masës edukative institucionale edhe kur i mituri i është nënshtruar ekzekutimit të masës para hyrjes në fuqi të aktvendimit mbi kërkesën ose propozimin për shtyrje të ekzekutimit të masës dhe më vonë konstatohet se kërkesa ose propozimi ka qenë i bazuar.
2. Në rastin e paraparë në paragrafin 1. të këtij neni, kohëzgjatja e ekzekutimit të masës edukative institucionale nuk llogaritet në kohëzgjatjen e pezullimit të ekzekutimit të masës edukative institucionale.

Neni 108

Masa edukative institucionale nuk konsiderohet se ekzekutohet gjatë periudhës së pezullimit të masës edukative institucionale.

Neni 109

Dispozitat e Ligjit mbi Ekzekutimin e Sanksioneve Penale mbi pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burgim zbatohen përshtatshmërisht për pezullimin e ekzekutimit të masës edukative institucionale.

Neni 110
Ekzekutimi i masës së dërgimit në institucionin edukativ

1. Masa edukative e dërgimit në institucionin edukativ ekzekutohet në institucionin për edukimin e të miturve.

2. I mituri i cili i nënshtrohet masës edukative gëzon të njëjtat të drejta dhe detyrime sikurse të miturit e tjerë në institucionin edukativ. Vetëm drejtori i institucionit edukativ dhe edukatori përgjegjës i të miturit njoftohen për shqiptimin e masës edukative ndaj të miturit.

Neni 111

Shërbimi sprovues është i autorizuar për të urdhëruar të miturin të paraqitet në institucionin edukativ.

Neni 112

1. Nëse ekzekutimi i masës edukative nuk mund të fillojë ose të vazhdojë për shkak se i mituri refuzon të zbatojë masën edukative apo arratiset, shërbimi sprovues menjëherë e informon gjykatën kompetente dhe stacionin kompetent policor të cilët të miturin e transportojnë në institucionin edukativ.
2. Mënyra e transportimit të të miturit në institucionin edukativ nuk e cenon dinjitetin e tij.

Neni 113
Ekzekutimi i masës së dorëzimit në institucionin edukativ korrektues

1. Masa edukative e dërgimit në institucionin edukativ korrektues ekzekutohet në institucionin edukativ korrektues të themeluar për këtë qëllim. Institucioni edukativo korrektues është institucion korrektues i tipit gjysmë të hapur dhe të hapur.
2. Femrat të cilat i nënshtrohen kësaj mase edukative vendosen në sektorin e femrave të institucionit edukativ korrektues.
3. Madhorët të cilët i nënshtrohen kësaj mase edukative, si dhe të miturit të cilët mbushin moshën tetëmbëdhjetë (18) vjeçare në institucionin edukativ korrektues, vendosen në sektorin e veçantë në institucionin edukativ korrektues.

Neni 114

1. Gjykata kompetente me shkrim urdhëron të miturin të paraqitet në institucionin edukativo-korrektues në një ditë të caktuar për ekzekutimin e masës edukative korrektuese.
2. Periudha kohore nga marrja e urdhrit dhe dita e paraqitjes nuk do të jetë më e shkurtër se tetë (8) ditë dhe as më e gjatë se pesëmbëdhjetë (15) ditë.
3. Gjykata kompetente e informon institucionin edukativ korrektues për datën kur i mituri duhet të paraqitet dhe i dorëzon vendimin e formës së prerë së bashku me të dhënat personale mbi të miturin të mbledhura gjatë procedurës.

Neni 115

1. Nëse i mituri i cili është thirrur sipas rregullit nuk paraqitet në institucionin edukativo-korrektues, gjykata urdhëron që ai të transportohet në institucionin

edukativo korrektues. Nëse personi i dënuar fshihet ose ndodhet në arrati, gjykata urdhëron lëshimin e letër rreshtimit.
2. Mënyra e transportimit të të miturit në institucionin edukativo- korrektues nuk e cenon dinjitetin e tij.

Neni 116

1. Kur i mituri pranohet në institucionin edukativo-korrektues, së pari konstatohet identiteti i tij, arsyeja e shqiptimit të masës dhe organi që ka shqiptuar masën edukative, e më pas ai i nënshtrohet kontrollit mjekësor brenda njëzetekatër (24) orëve nga arritja. Emri i të miturit, arsyet dhe organi që ka shqiptuar masën edukative, data dhe koha për pranimin e tij në institucionin korrektues shënohet në regjistër.
2. I mituri më pas dërgohet në sektorin për kontroll personal por jo më gjatë se gjashtëdhjetë (60) ditë, me qëllim të përpilimit të programit individual. Programi me të cilin do të trajtohet i mituri hartohet nga grupi i ekspertëve dhe nga institucioni edukativo korrektues.

Neni 117

1. Të miturit ndahen në grupe edukative në harmoni me moshën e tyre, zhvillimin mendor dhe karakteristikat tjera në pajtim me veçoritë e programit të individializuar.
2. Grupi edukativ ka më së shumti njëzet (20) të mitur dhe një (1) edukator të veçantë.

Neni 118

1. I mituri ka të drejtë që të ushtrojë në mënyrë të mjaftueshme për të ruajtur shëndetin dhe të kalojë së paku tri (3) orë jashtë lokaleve të mbyllura gjatë kohës së lirë.
2. Të miturit i garantohet një ambient i sigurt për t'u marrë me sport, për të ushtruar dhe për aktivitete të tjera fizike.

Neni 119

Nëse nuk ka orë mësimore për lëndë të caktuara ose nuk ka nivel arsimor në institucionin edukativ korrektues, i mituri lejohet të vijojë mësimin jashtë institucionit edukativo korrektues, nëse vijimi i tillë i mësimit nuk është i dëmshëm për ekzekutimin e masës edukative dhe vendimi arsyetohet me përparimet e mëparshme të të miturit në shkollim.

Neni 120

1. I mituri ka të drejtë të vizitohet së paku një (1) herë në javë minimum deri në një (1) orë nga prindi i tij, prindi adoptues, kujdestari, bashkëshorti, fëmija, fëmija i adoptuar dhe nga të afërmit e tjerë të gjakut në vijë të drejtpërdrejtë ose në vijë anësore deri në shkallën e katërt.
2. I mituri ka të drejtë të vizitohet së paku një (1) herë në muaj nga persona të tjerë të cilët nuk ndikojnë negativisht në ekzekutimin e masës.

3. Drejtori i institucionit edukativo-korrektues ka autorizimin për të ndaluar vizitat për shkaqe të justifikueshme në pajtim me një akt nënligjor të nxjerrë nga Ministria e Drejtësisë.

Neni 121

1. I mituri ka të drejtë në pushim ditor dhe javor në pajtim me dispozitat e përgjithshme të Ligjit mbi Ekzekutimin e Sanksioneve Penale.
2. I mituri ka të drejtë në pushim vjetor prej tridhjetë (30) ditësh të cilat me leje të institucionit korrektues mund të shfrytëzohen edhe jashtë lokaleve të institucionit edukativo-korrektues.
3. Drejtori i institucionit edukativo-korrektues të miturit mund t'i lejojë pushim shtesë nga institucioni edukativo-korrektues për arsye edukative, profesionale, familjare ose arsye të tjera sociale deri në pesëmbëdhjetë (15) ditë çdo vit.

Neni 122

1. Dispozitat mbi procedurat disiplinore dhe dënimet të zbatueshme për personat e dënuar me burgim të paraparë në Ligjin mbi Ekzekutimin e Sanksioneve Penale zbatohen përshtatshmërisht për të miturin i cili i nënshtrohet masës së dërgimit në institucionin edukativo korrektues.
2. Të miturit nuk i shqiptohet izolimi në qeli të veçantë si dënim disiplinor.
3. I mituri mund të vendoset në njësi të veçantë të institucionit edukativo-korrektues si dënim disiplinor nën kushtet vijuese:
   3.1. periudha e vendosjes në njësinë e veçantë nuk mund të kalojë pesëmbëdhjetë (15) ditë;
   3.2. i mituri nuk vendoset i vetëm në njësinë e veçantë;
   3.3. i mituri ka të drejtën të kalojë së paku tri (3) orë jashtë lokaleve të mbyllura gjatë kohës së lirë, në përputhje me nenin 118 të këtij Kodi dhe të pranoj vizita në përputhje me nenin 120 të këtij Kodi
   3.4. i mituri ka qasje në tekste mësimore dhe libra të tjerë dhe
   3.5. i mituri vizitohet nga zyrtari mjekësor dhe edukatori një (1) herë në ditë dhe dy (2) herë në javë nga drejtori i institucionit edukativo-korrektues.

Neni 123
Ekzekutimi i masës së dërgimit në institucionin për kujdes të posaçëm

I mituri të cilit i është shqiptuar masa edukative e dërgimit në institucionin e kujdesit të posaçëm për shkak të aftësive të kufizuara mendore apo fizike dërgohet në institucionin e posaçëm të mbrojtjes sociale, ku ai gëzon të njëjtat të drejta dhe detyrime sikurse të miturit e tjerë të vendosur në këtë institucion.

Neni 124

Me kërkesë të Shërbimit Sprovues, policia shoqëron të miturin në institucionin e kujdesit të posaçëm.

Neni 125

1. Nëse ekzekutimi i masës edukative e dërgimit në institucionin e kujdesit të posaçëm nuk mund të fillojë ose të vazhdojë për shkak se i mituri refuzon të zbatojë masën apo arratiset, shërbimi sprovues menjëherë e njofton gjykatën kompetente dhe stacionin policor kompetent, të cilët të miturin e transportojnë në institucion.
2. Mënyra e transportimit të të miturit në institucionin edukativ nuk e cenon dinjitetin e tij. Zyrtari mjekësor e shoqëron të miturin gjatë transportimit të tij në institucionin e kujdesit të posaçëm.

Neni 126

1. Institucioni i kujdesit të posaçëm e informon shërbimin sprovues kompetent dhe gjykatën kompetente mbi përparimin e ekzekutimit të masës edukative.
2. Institucioni veçanërisht e informon gjykatën kompetente për gjendjen shëndetësore të të miturit kur ai mbush moshën tetëmbëdhjetë (18) vjet.

Neni 127
Shqyrtimi, zëvendësimi dhe pushimi i masave edukative

1. Çdo gjashtë (6) muaj, drejtori i institucionit apo qendrës, ku ekzekutohet masa edukative gjykatës dhe shërbimit sprovues kompetent i dorëzon raport për sjelljen e të miturit dhe suksesin në ekzekutimin e masës. Varësisht nga suksesi i ekzekutimit të masës, drejtori paraqet propozim për ndryshimin apo pushimin e ekzekutimit të masës edukative.
2. Çdo gjashtë (6) muaj, gjyqtari për të mitur i viziton të miturit e vendosur në institucion apo qendër, dhe përmes kontaktit të drejtpërdrejtë me të miturit dhe zyrtarëve drejtpërdrejtë të përfshirë në ekzekutimin e masës edukative institucionale dhe pas shqyrtimit të shënimeve të institucionit apo qendrës, konstaton nëse të miturit trajtohen në mënyrë korrekte dhe në pajtim me ligjin, dhe nëse masat edukative institucionale kanë qenë të suksesshme.
3. Gjyqtari për të mitur menjëherë e informon shërbimin sprovues kompetent dhe institucionin ose qendrën që ekzekuton masën edukative institucionale për çfarëdo të mete apo vërejtje tjetër. Pas marrjes së informatave të tilla, shërbimi sprovues menjëherë bën kontrollet adekuate dhe ndërmerr masa për korrigjimin e pa ligjshmërive dhe parregullsive, dhe gjykatën kompetente e informon për veprimet e ndërmarra.

Neni 128

1. Gjykata kompetente që ka shqiptuar masën edukative shqyrton ekzekutimin e masës edukative çdo gjashtë (6) muaj.
2. I mituri, prindi i tij, prindi adoptues apo kujdestari, qendra, institucioni apo vendi ku ekzekutohet masa edukative ose shërbimi sprovues mund të kërkojnë rishqyrtimin e ekzekutimit të masës edukative.
3. Trupi gjykues për të mitur i gjykatës kompetente merr vendim për kërkesën të

paraparë në paragrafin 2. të këtij neni brenda tetë (8) ditësh nga pranimi i kërkesës. Ankesa kundër këtij vendimi mund të dorëzohet në gjykatën e shkallës së dytë brenda tri (3) ditësh nga pranimi i vendimit.

4. Gjatë shqyrtimit, gjykata kompetente i merr parasysh raportet e shërbimit sprovues dhe ato të drejtorit të institucionit apo qendrës ku një masë edukative institucionale ekzekutohet dhe dëgjon të miturin, prindin e tij, prindin adoptues a kujdestarin, avokatin mbrojtës, prokurorin dhe shërbimin sprovues.
5. Në bazë të rishqyrtimit, gjykata mund të vazhdojë apo të pushojë ekzekutimin e masës edukative apo atë ta zëvendësojë me një masë më të lehtë edukative.
6. Përjashtimisht nga paragrafi 5. i këtij neni, gjykata, masën edukative mund ta zëvendësojë me një masë më të rëndë edukative në rastin kur i mituri nuk i ka përmbushur detyrimet e posaçme të shqiptuara në pajtim me nenin 26 të këtij Kodi.

Neni 129

1. Nëse pas marrjes së vendimit mbi shqiptimin e masës edukative, zbulohen rrethana tjera, fakte të reja ose fakte që kanë ekzistuar por që nuk kanë qenë të njohura në kohën kur vendimi është marrë, e të cilat në mënyrë të qartë do të ndikonin në zgjedhjen e masës, gjykata shqyrton vendimin dhe mund të pushojë ekzekutimin e masës apo atë mund ta zëvendësojë me ndonjë masë tjetër edukative. Gjykata nuk mund tëshqiptojë masë më të rëndë në bazë të rishqyrtimit të provave të reja.
2. Nëse ekzekutimi i masës edukative nuk ka filluar brenda një (1) viti nga data prej së cilës vendimi mbi shqiptimin e masës bëhet i formës së prerë, gjykata rishqyrton vendimin dhe vendos për ekzekutimin apo pushimin e masës ose zëvendësimin e saj me ndonjë masë tjetër edukative. Gjykata nuk mund të shqiptojë masë më të rëndë.
3. Nëse pa fajin e të miturit ekzekutimi i masës të dërgimit në qendrën disiplinore nuk ka filluar brenda gjashtë (6) muajve nga data prej së cilës vendimi mbi shqiptimin e masës merr formën e prerë, masa nuk do të ekzekutohet.
4. Rishqyrtimi i masës edukative në pajtim me këtë nen bëhet në pajtim me nenin 128 të këtij Kodi.

Ankesat dhe lutjet

Neni 130

Dispozitat e Ligjit mbi Ekzekutimin e Sanksioneve Penale lidhur me dorëzimin e ankesave dhe lutjeve nga personat e dënuar me burgim vlejnë përshtatshmërisht për dorëzimin e ankesave dhe lutjeve nga të miturit që mbajnë masat edukative të dërgimit në qendrën disiplinore, dërgimit në institucionin korrektues, dërgimit në institucionin edukativo-korrektues apo dërgimit në institucionin për kujdes të posaçëm.

KREU XVIII
EKZEKUTIMI I DËNIMEVE

Neni 131
Ekzekutimi i gjobës

1. Dispozitat e Ligjit mbi ekzekutimin e sanksioneve penale lidhur me ekzekutimin e gjobës zbatohen përshtatshmërisht për ekzekutimin e gjobës të shqiptuara për të mitur.
2. Gjoba e shqiptuar ndaj të miturit e cila nuk është paguar nuk mund të zëvendësohet me burgim.

Neni 132
Ekzekutimi i urdhrit për punë në dobitë përgjithshme

1. Dispozitat e Ligjit mbi ekzekutimin e sanksioneve penale për ekzekutimin e dënimit me kusht me urdhrin për punë në dobi të përgjithshme zbatohen përshtatshmërisht për ekzekutimin e urdhrave për punë në dobi të përgjithshme të shqiptuara ndaj të miturve.
2. Nëse është në interes të të miturit, shërbimi sprovues mund të kërkojë ndihmë apo bashkëpunim me organin e kujdestarisë apo përfaqësuesin ligjor të të miturit.
3. Kujdes i veçantë duhet kushtuar që puna në dobi të përgjithshme të mos pengojë vijimin e rregullt në shkollë ose aktivitetet tjera të rëndësishme.

Neni 133

1. Gjykatës e cila e ka shqiptuar dënimin për punë në dobi të përgjithshme, zyrtarët e shërbimit sprovues i dorëzojnë raport me shkrim dhe e njoftojnë për çfarëdo pengese në ekzekutimin e kësaj mase.
2. Nëse i mituri nuk mund të kryejë punën në dobi të përgjithshme për shkak të ndryshimit të mëvonshëm të rrethanave për të cilat ai nuk është përgjegjës, shërbimi sprovues nga gjykata kërkon rishqyrtimin e urdhrit për punë në dobi të përgjithshme.
3. Varësisht nga rezultatet e arritura, gjykata mund ta ndryshojë urdhrin apo ta pushojë ekzekutimin e masës.
4. Shpenzimet lidhur me ekzekutimin masave të diversitetit, masave edukative dhe urdhrit për punë në dobi të përgjithshme bien në barrë të buxhetit të Kosovës.

Neni 134
Ekzekutimi i burgut për të mitur

1. Dispozitat e këtij Kodi që rregullojnë dërgimin, pranimin, qëndrimin dhe shtyrjen e ekzekutimit, caktimin e grupeve arsimore, të drejtat në vizitë dhe angazhimin në ushtrime fizike, përcaktimin e punës dhe edukimin, mundësinë e shkollimit të rregullt, dënimet disiplinore të të miturve në institucionet edukative dhe procedurat për ankesa dhe lutje, gjithashtu vlejnë edhe për ekzekutimin e dënimeve me burg për të miturit.
2. Dispozitat e Ligjit mbi Ekzekutimin e Sanksioneve Penale për ekzekutimin e

dënimit me burgim zbatohen përshtatshmërisht për ekzekutimin e dënimit me burgim për të mitur në rastet kur nuk janë në kundërshtim me këtë Kod.
3. I mituri i cili është dënuar me burgim për të mitur, krahas të drejtave të parapara me këtë Kod, gëzon të njëjtat të drejta si personi madhor i dënuar me burgim.

Neni 135

1. Gjatë kohës së vuajtjes së dënimit, të miturve u ofrohet aftësim i duhur profesional i bazuar në njohuritë e tyre, shkathtësitë, interesimet dhe punën që është duke e kryer, varësisht prej mundësive të institucionit korrektues. Bazat e trajtimit përfshijnë punën e dobishme edukative me shpërblim përkatës, lehtësimin dhe inkurajimin e kontakteve mes të miturve dhe botës së jashtme përmes letrave, telefonit, pranimin e vizitave, vizitave në shtëpi, aktiviteteve sportive dhe ofrimit të kushteve të nevojshme për kryerjen e ritualeve fetare.
2. Stafi profesional i shërbimit që trajton të miturin duhet të ketë njohuri të duhura nga lëmi i pedagogjisë dhe psikologjisë.

Neni 136

1. Burgimi për të miturit mbahet në institucion korrektues për të mitur dhe, në raste të jashtëzakonshme, në pavijone të ndara të institucionit korrektues për persona madhorë. Institucioni korrektues për të mitur është i llojit gjysmë të hapur dhe të hapur. Përjashtimisht të miturit mund të mbajnë dënimin me burgim për të mitur në institucionin korrektues të tipit të mbyllur.
2. Meshkujt dhe femrat e vuajnë dënimin e tyre të burgimit të të miturve në institucione të ndara korrektuese apo në pavijone të ndara të institucioneve të tilla.
3. Të miturit të cilët bëhen madhor gjatë ekzekutimit të dënimit me burgim të të miturit duhet të vendosen në pavijone të ndara të institucionit. Të miturit e mbajnë dënimin e tyre me burgim në institucionin korrektues për të mitur derisa të mbushin moshën njëzetetre (23) vjet. Nëse deri në këtë moshë ata nuk e kanë mbajtur dënimin e plotë, ata transferohen në institucionin korrektues për të rritur. Në raste të veçanta, personave të dënuar të cilët kanë mbushur njëzetetre (23) vjet mund t'u lejohet qëndrimi në institucionin korrektues për të mitur nëse kjo është e nevojshme për kryerjen e përgatitjes ose aftësimit profesional të tyre, apo nëse pjesa e mbetur e dënimit të tyre që duhet mbajtur nuk është më e gjatë se gjashtë (6) muaj. Ata në asnjë mënyrë nuk mund të qëndrojnë në institucionin korrektues për të mitur pasi të kenë mbushur njëzeteshtatë (27) vjet.
4. Madhorëve të cilëve u është shqiptuar dënimi për të mitur vendosen në një pavijon të ndarë të institucionit.
5. Çdo vit, drejtori i institucionit ku ekzekutohet dënimi për të mitur është i obliguar t'ia paraqesë raportin gjykatës e cila e ka shqiptuar dënimin për të mitur për sjelljen e të miturit dhe ekzekutimin e burgimit të të miturit.

Neni 137

1. Si rregull, të miturit i vuajnë dënimet e tyre së bashku.

2. Me kërkesë të të miturit, drejtori i qendrës korrektuese mund të lejoj që i mituri të ndahet nga personat tjerë të dënuar, nëse drejtori çmon se shqetësimet e cekura në kërkesën e të miturit janë të arsyeshme dhe se nuk ka mundësi tjera për trajtimin e shqetësimeve të të miturit.
3. Drejtori i qendrës korrektuese mund t'i urdhëroj të miturit që të ndahet nga personat tjerë të dënuar, pa kërkesën e të miturit për ndarje të tillë, vetëm nëse masa e tillë është e nevojshme:
   3.1. Për të parandaluar rrezikun për jetë apo shëndet të të miturit a personave të tjerë; ose
   3.2. Për të parandaluar kërcënimin ndaj sigurisë së institucionit korrektues të shkaktuar nga prania e vazhdueshme e të miturit brenda përbrenda gjithë njerëzve të burgut.
4. Dispozitat e Ligjit mbi Ekzekutimin e Sanksioneve Penale për ndarjen nga personat tjerë të dënuar aplikohen përshtatshmërisht për ndarjen e të miturit nga personat tjerë të dënuar.

Neni 138

1. Në përputhje me aktin nënligjor të nxjerrë nga Ministria e Drejtësisë, drejtori i ndonjë institucioni mund t'i lejojë të miturit që të marrë pushim nga dy (2) herë në çdo vit për t'i vizituar prindërit, prindërit birësues, bashkëshortin(en) kujdestar(e), fëmijët, fëmijët e birësuar, vëllezërit dhe motrat e tij.
2. Pushimi zgjat deri në tridhjetë (30) ditë dhe sipas rregullit ai lejohet atëherë kur nuk mbahen mësimet.

Neni 139

1. I mituri ka të drejtë të kalojë të paktën tri (3) orë gjatë ditës në ambient të hapur brenda institucionit.
2. I mituri nuk i nënshtrohet vetmisë si dënim disiplinor.

Neni 140

Trupi gjykues për të mitur i gjykatës së qarkut, e cila ka shqiptuar dënimin vendos lidhur me kërkesën për mbrojtje gjyqësore ndaj masave dhe vendimeve të drejtorit të institucionit korrektues në të cilin personi i dënuar është duke e mbajtur dënimin me burgim për të mitur.

KREU XIX
NDIHMA PAS EKZEKUTIMIT TË MASAVE PËR EDUKIMIN INSTITUCIONAL OSE BURGIMIT TË TË MITURIT

Neni 141

1. Gjatë tërë kohës derisa një masë e edukimit institucional ose burgimi për të mitur është duke u ekzekutuar, shërbimi sprovues mban kontakte të përhershme me të

miturin, familjen e tij dhe institucionin në të cilin është vendosur i mituri.
2. Jo më vonë se tre (3) muaj para lëshimit të të miturit, institucioni ose qendra korrektuese në të cilin është duke u zbatuar masa e edukimit institucional ose burgimi për të mitur i njofton prindërit e tij, prindërit birësues apo kujdestarë dhe shërbimin sprovues lidhur me këtë dhe ua propozon atyre masat për pranimin e të miturit.

Neni 142

1. Institucioni korrektues, prindi, prindi adoptues apo kujdestari i të miturit e njofton Gjykatën dhe Shërbimin sprovues për lirimin e të miturit.
2. Shërbimi sprovues i ofron ndihmë të miturit pas lirimit për aq kohë sa ai ka nevojë, por jo më gjatë se dymbëdhjetë (12) muaj. Nëse është në interesin e të miturit, Shërbimi sprovues mund të kërkojë ndihmë ose bashkëpunim prej Organit të Kujdestarisë ose përfaqësuesit ligjor të të miturit.

Neni 143

1. Pas lirimit të të miturit, Organi i Kujdestarisë ndërmerr një kujdes të veçantë për të miturin i cili nuk ka prindër apo për të miturin rrethanat familjare të të cilit nuk janë zgjidhur.
2. Kujdesi, në veçanti përfshinë vendosjen, ushqimin, sigurimin e veshmbathjes, trajtimin mjekësor, rregullimin e rrethanave familjare, kryerjen e aftësimit profesional dhe punësimin e të miturit.

KREU XX
EKZEKUTIMI I MASVE PËR TRAJTIMIN E DETYRUESHËM REHABILITUES OSE TRAJTIMIN E DETYRUESHËM PSIKIATRIK

Neni 144

1. Dispozitat e Ligjit mbi Ekzekutimin e Sanksioneve Penale për ekzekutimin e masës për trajtim të detyrueshëm rehabilitues dhe dispozitat e ligjit në fuqi mbi ekzekutimin e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik të shqiptuar madhorëve, zbatohen përshtatshmërishtpër ekzekutimin e këtyre masave të shqiptuara ndaj të miturve.
2. I mituri e mban masën e trajtimit të detyrueshëm në pavijon të veçantë të institucionit për kujdes të posaçëm ku këto masa ekzekutohen.

PJESA E PESTË
PROCEDURA GJYQËSORE QË PËRFSHIJNË VEPRAT PENALE TË KRYERA NDAJ FËMIJËVE

KREU XXI
GJYKIMI I MADHORËVE PËR VEPRA PENALE TË KRYERA NDAJ FËMIJËVE

Neni 145

1. Trupi gjykues për të mitur dhe gjyqtari për të mitur i gjykojnë personat madhor për veprat penale në vijim të kryera kundër fëmijës, të parapara në Kodin Penal të Kosovës:
   1.1. dhunimi;
   1.2. kryerja e akteve seksuale me kërcënim të nderit ose të autoritetit;
   1.3. sulmi seksual;
   1.4. degradimi i integritetit seksual;
   1.5. keqpërdorimi seksual i personave me aftësi të kufizuara mendore ose emocionale ose me paaftësi mendore;
   1.6. keqpërdorimi seksual i personave nën moshën gjashtëmbëdhjetë (16) vjet;
   1.7. nxitja e akteve seksuale ose prekja seksuale nga personat nën moshën gjashtëmbëdhjetë (16) vjet;
   1.8. shpërdorimi seksual duke keqpërdorur pozitën, autoritetin ose profesionin;
   1.9. mundësimi i prostitucionit;
   1.10. keqpërdorimi i fëmijëve në pornografi;
   1.11. tregimi i materialit pornografik personave nën moshën gjashtëmbëdhjetë (16) vjet;
   1.12. marrëdhëniet seksuale brenda familjeve;
   1.13. bashkëjetesa me persona nën moshën gjashtëmbëdhjetë (16) vjet në bashkësi jashtëmartesore;
   1.14. ndryshimi i statusit familjar të fëmijës;
   1.15. rrëmbimi i kundërligjshëm i fëmijës;
   1.16. keqtrajtimi ose braktisja e fëmijës;
   1.17. shkelja e detyrimeve familjare;
   1.18. shmangia nga ndihma për mjete jetese;
   1.19. pengimi dhe mosekzekutim i masave për mbrojtjen e fëmijëve;
   1.20. rekrutimi ose regjistrimi i personave ndërmjet moshës pesëmbëdhjetë (15) dhe tetëmbëdhjetë (18) vjet në konflikt të armatosur;
   1.21. vendosja e skllavërisë, kushteve të ngjashme me skllavërisë dhe e punës së detyruar;
   1.22. trafikimi me njerëz; dhe
   1.23. fshehja e dokumenteve të identifikimit të viktimave të skllavërisë ose trafikimit me njerëz.

Neni 146

1. Procedura kundër personit që kryen vepër penale kundër fëmijës sipas nenit 145 të këtij Kodi zbatohet në pajtim me dispozitat e Kodit Procedurës Penale të Kosovës, përveç dispozitave për dhënien e urdhrit ndëshkimor i përcaktuar me dispozitat e Kodit të procedurës penale të Kosovës.
2. Veprat penale të kryera ndaj fëmijëve i hetojnë oficerët e policisë që specializohen në këtë lëmi.

Neni 147

1. Kur zbatohet procedurë për vepër penale e kryer ndaj fëmijës, autoritetet ose institucionet veprojnë me kujdes të posaçëm ndaj fëmijës i cili ka pësuar dëmtime nga vepra penale, duke e pasur parasysh moshën e tij, karakteristikat personale, edukimin dhe ambientin në të cilin jeton ai, në mënyrë që t'iu shmangen pasojave të mundshme të dëmshme për edukimin dhe zhvillimin e tij. Kontrollimi i fëmijës bëhet me ndihmën e pedagogut, psikologut ose të ndonjë eksperti tjetër.
2. Nëse fëmija ndaj të cilit është kryer vepra penale nga neni 145 i këtij Kodi merret në pyetje si dëshmitar, marrja e tillë në pyetje zbatohet më së shumti dy (2) herë. Marrja në pyetje zbatohet me ndihmën e pedagogut, psikologut ose ndonjë eksperti tjetër. Gjykata mund të urdhërojë që dëshmitari të merret në pyetje jashtë gjykatores përmes televizionit me qark të mbyllur.
3. Fëmija ndaj të cilit është kryer vepër penale nga neni 145 i këtij Kodi, më mirë mund të merret në pyetje si dëshmitar në shtëpinë e tij ose në ndonjë lokacion tjetër ku ndodhet ai ose në qendrën për punë sociale se sa në gjykatë. Për marrjen e tillë në pyetje zbatohet paragrafi 2. i këtij neni.
4. Sipas paragrafit 2. të këtij neni, çdo incizim teknik i marrjes në pyetje përmes televizionit me qark të mbyllur asgjësohet brenda pesë (5) viteve nga hyrja në fuqi e aktgjykimit.
5. Neni 50 i këtij Kodi zbatohet përshtatshmërisht për procedurat ku përfshihen veprat penale të kryera ndaj fëmijës.

Neni 148

Gjyqtari për të mitur e informon organin kompetent të kujdestarisë për faktet dhe provat e vërtetuara në procedurë penale të cilat kanë kontribuuar ose kanë mundësuar kryerjen e veprës penale, në mënyrë që të ndërmerren masa për mbrojtjen e të drejtave dhe të mirëqenies së fëmijës.

Neni 149

Nëse gjatë procedurës penale vërtetohet se prindi po i keqpërdor ose së tepërmi po i lë pas dore detyrat prindore dhe të drejtat, ose po i shkel të drejtat e fëmijës, prokurori e fillon procedurën jashtëkontestimore për heqjen e të drejtave për përkujdesje prindore nga prindi.

Neni 150

Sipas rregullit, gjykata në territorin e së cilës e ka vendbanimin e përhershëm pala e dëmtuar ka kompetencë territoriale për procedurën për veprat penale të kryera ndaj fëmijës, ndërsa procedura mund të zbatohet në gjykatën në territorin e së cilës është kryer vepra penale kur procedura pranë asaj gjykate zbatohet më lehtë.

Neni 151

Neni 51 i këtij Kodi zbatohet përshtatshmërisht në gjykimin e personit për vepër penale të kryer ndaj fëmijës sipas nenit 145 të këtij Kodi.

Neni 152

1. Trupi gjykues për të mitur i gjykatës komunale dhe trupi gjykues për të mitur i gjykatës së qarkut në shkallën e parë përbëhet nga gjyqtari për të mitur dhe dy (2) gjyqtarë porotë. Kur trupi gjykues për të mitur e gjykon në shkallë të parë një vepër penale të dënueshme me burgim prej së paku pesëmbëdhjetë (15) vjet ose me burgim afatgjatë, ai përbëhet nga dy (2) gjyqtarë, prej të cilëve njëri është gjyqtarë për të mitur dhe tre (3) gjyqtarë porotë.
2. Trupi gjykues për të mitur i Gjykatës Supreme të Kosovës përbëhet nga tre (3) gjyqtarë në rastet kur gjykon në shkallë të dytë. Kur trupi gjykues për të mitur gjykon personin për vepër penale të dënueshme me burgim prej së paku pesëmbëdhjetë (15) vjet, ai përbëhet nga pesë (5) gjyqtarë, prej të cilëve tre (3) janë gjyqtarë për të mitur, ndërsa kur gjykon në shkallë të dytë me seancë shqyrtimi, trupi për të mitur përbëhet nga dy (2) gjyqtarë për të mitur dhe tre (3) gjyqtarë porotë. Kur gjykon në shkallë të tretë dhe vendos për mjete të jashtëzakonshme juridike, trupi gjykues përbëhet siç parashihet me Kodin e Procedurës Penale të Kosovës.
3. Në rastet kur nuk ka seancë shqyrtimi, trupi gjykues përbëhet sipas Kodit të Procedurës Penale të Kosovës. Megjithatë, së paku një (1) anëtar i trupit gjykues është gjyqtarë për të mitur.
4. Gjyqtar në procedurë të shkurtuar është gjyqtari për të mitur i gjykatës komunale.

Neni 153

Procedura lidhur me vepra penale të kryera ndaj fëmijës sipas nenit 145 të këtij Kodi zbatohet shpejtë dhe pa vonesa të paarsyeshme.

PJESA E GJASHTË
DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

KREU XXII
DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 154

Masa edukative institucionale e cila është shqiptuar me vendim të formës së prerë para datës së hyrjes në fuqi të këtij Kodi nuk mund të vazhdojë më gjatë se periudha kohore e paraparë me këtë Kod.

Neni 155

Burgimi për të mitur i cili është shqiptuar me vendim të formës së prerë para datës së hyrjes në fuqi të këtij Kodi për një periudhë më të gjatë se sa që ka mundur të shqiptohet në pajtim me nenin 34 paragrafi 2. i këtij Kodi, shkurtohet në pajtim me dispozitat e këtij Kodi.

Neni 156

Procedura përgatitore e filluar para 6 prillit 2004 por e cila nuk ka përfunduar deri në këtë datë, vazhdon dhe përfundon sipas dispozitave të ligjit të mëparshëm në fuqi.

Neni 157

1. Sipas pjesës së tretë të këtij Kodi, procedura penale në shkallë të parë për të cilën është bërë propozim i prokurorit para 6 prillit 2004 por e cila nuk është përfunduar deri në këtë datë, vazhdon sipas dispozitave të mëparshme të ligjit në fuqi derisa:
   1.1. procedura penale të pushohet me aktvendim të formës së prerë; ose
   1.2. aktgjykimi i shqiptuar në shqyrtim gjyqësor të merr formë të prerë.
2. Procedura penale në shkallë të parë sipas pjesës së pestë të këtij Kodi në të cilën aktakuza, propozim akuza ose padia private janë ngritur para datës së hyrjes në fuqi të këtij Kodi por të cilat nuk janë përfunduar deri në këtë datë, vazhdojnë në pajtim me dispozitat e ligjit të mëparshëm në fuqi derisa:
   2.1. procedura penale të pushohet me aktvendim të formës së prerë ose
   2.2. aktgjykimi i shqiptuar në shqyrtim gjyqësor të merr formë të prerë.

Neni 158

Nëse pas hyrjes në fuqi të këtij Kodi cilido afat i paraparë ecë, ai llogaritet në pajtim me dispozitat e këtij Kodi, përveç nëse afati i mëparshëm ka qenë më i gjatë ose dispozitat e këtij kreu e parashohin ndryshe.

Neni 159

Deri sa nuk themelohet Këshilli Prokurorial, kur ndërmjetësi caktohet nga prokurori,

shpenzimet e procedurës së ndërmjetësimit, duke përfshirë pagesën e ndërmjetësuesit paguhen nga buxheti i Ministrisë së Drejtësisë.

Neni 160

Organet kompetente nxjerrin akte nënligjore për zbatimin e këtij Kodi në afat prej gjashtë (6) muajve nga dita e hyrjes ne fuqi te këtij Kodi.

Neni 161

Ky kod shfuqizon Ligjin penal për të mitur UNMIK, Rregulloren nr. 2004/8 të datës 20. 04. 2004 dhe çdo dispozitë të ligjit në fuqi që është në kundërshtim me të.

Neni 162

Ky kod hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës.

Kodi Nr. 03/ L-193
8 korrik 2010

Shpallur me dekretin Nr. DL-039-2010, datë 28.07.2010 nga Presidenti i Republikës së Kosovës, Dr. Fatmir Sejdiu.

GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS / PRISHTINË: VITI V / Nr. 78 / 20 GUSHT 2010

LIGJI Nr. 2004/34
KUNDËR KORRUPSIONIT

Përmbajtja

Kreu 1: Dispozitat e përgjithshme 227
Kreu 2: Agjensioni kosovar i antikorrupsionit 229
Kreu 3: Konflikti i interesave 233
Kreu 4: Pranimi i dhuratave 235
Kreu 5: Mbikëqyrja e pasurive 236
Kreu 6: Mbrojta e të dhënave, ruajtja, mbajta e shënimeve, dhe fshehtësia e informacionit 238
Kreu 7: Sanksione administrative 239
Kreu 8: Dispozitat kalimtare dhe të fundit 239

Kuvendi i Kosovës,

Në mbështetje të autoritetit të dhënë Institucioneve të Vetëqeverisjes së Përkohshme nga Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2001/9 e datës 15 Maj 2001, "Për Kornizën Kushtetuese të Vetëqeverisjes", në veçanti Kreu 5.1 (m), 5.2 (b), 9.1.1., 9.1.26 dhe 11.2 dhe,

Në pajtim me Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2003/25 të 6 korrikut 2003 "Për dispozitat e Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës" që parasheh disa vepra penale të korrupsionit,

Për qëllime të mbrojtjes së rendit ligjor, demokracisë dhe të drejtave të njeriut, qeverisjes së mirë, ndershmërisë dhe drejtësisë sociale, konkurrencës, rritjes ekonomike, besimit të përgjithshëm tek institucionet publike dhe vlerat morale të shoqërisë.

Miraton:

LIGJIN KUNDËR KORRUPSIONIT

KREU 1
DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Ky ligj parasheh masat kundër korrupsionit brenda fushës së veprimit të strategjisë kundër korrupsionit, veçanërisht në fushën e hetimeve administrative të korrupsionit publik, eliminimin e shkaqeve të të korrupsionit, papajtueshmërinë mes mbajtjes së posteve publike dhe kryerjes së aktiviteteve fitimprurëse për personat zyrtar, kufizimet në lidhje me pranimin e dhuratave të lidhura me kryerjen e punëve në detyrë, mbikëqyrjen e pasurive të tyre si dhe të personave në lidhje të afërt me ta dhe kufizimet

në lidhje me subjektet kontraktuese që marrin pjesë në tenderët publikë duke kryer biznes me firmat ku personi zyrtari ose një person në marrëdhënie të afërt me të është i përfshirë.

Neni 2

Për qëllime të këtij ligji, shprehjet në tekst janë të definuara si më poshtë:
Korrupsion - nënkupton çdo shkelje të detyrës së personave zyrtarë ose përgjegjës në subjektet juridike dhe çdo veprimtari e iniciatorëve apo përfituesve të kësaj sjelljeje, e drejtuar si përgjigje ndaj një shpërblimi që drejtpërdrejt ose indirekt është premtuar, ofruar, dhënë, kërkuar, pranuar apo është pritur për t'u marrë për veten apo për një person tjetër.
Person zyrtar - nënkupton personin në kuptim të nenit 107 paragrafi 1 të Kodit të përkohshëm Penal të Kosovës.
Person përgjegjës në entitet juridik - nënkupton personin në kuptim të nenit 107 paragrafi 2 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës.
Personi zyrtar i lartë - nënkupton Presidentin e Kosovës, Kryeministrin, Kryetarin dhe deputetët e Kuvendit, ministrat, sekretarët e qeverisë, sekretarët permanentë, drejtorët e zyrave brenda ministrive gjyqtarët dhe prokurorët si dhe zyrtarët e lartë ndërkombëtarë në kuptim të këtij Ligji.
Marrëdhënie e afërt - nënkupton marrëdhënien mes dy personave: të cilët janë në vijë të gjakut në vijë të drejtë gjerë në pakufi, në vijë të tërthortë deri në shkallën e katërt dhe në gjini të krushqisë deri në shkallën e dytë.
Vepër serioze e korrupsionit - nënkupton një vepër korruptive ashtu siç përkufizohet nga Kodi Penal i Kosovës, e cila përfshin vlerat mbi 10.000 EURO ose pjesëmarrjen e një zyrtari të lartë publik.
Përparësi personale - nënkupton arritjen e ndonjë përftimi material ose jo material në formën e së drejtës apo përparësisë që nuk i takon këtij personi si dhe dhënia e kësaj përparësie një pale tjetër.

Neni 3

3.1. Askush nuk mund të shpërdorojë me postin apo detyrën e tij duke kryer apo duke mos kryer një veprim që sipas ligjit nuk duhet ose duhet ta kryejë, as të asistojë zbatimin e një veprimi juridik për interesin e tij personal apo interesin e një pale tjetër.
3.2. Personi zyrtari nga i cili eprori i tij kërkon që gjatë kryerjes së shërbimit të tij të veprojë në mënyrë të paligjshme, të pandershme dhe jo lojale ndaj autoritetit publik, apo që t'i japë një privilegj një personi fizik apo juridik, duhet të informojë eprorin e tij drejtpërdrejt me shkrim, nëse eprori drejtpërdrejt pas kundërshtimit me gojë përsëri këmbëngul në kërkesat e përmendura më lart.
3.3. Vetëm pas deklaratës me shkrim personi zyrtar lirohet nga detyrimi për të kryer në mënyrë të paligjshme këtë aktivitet zyrtar dhe nuk mund të konsiderohet përgjegjës për të, por është i detyruar të informojë autoritetet kompetente publike dhe Agjensionin Kosovar kundër-korrupsionit.

Neni 4

4.1. Çdokush ka të drejtën e qasjes së barabartë në kryerjen e aktiviteteve me interes publik dhe trajtim të barabartë nga ana e personave zyrtarë, pa u bërë viktimë e korrupsionit.
4.2. Personi zyrtarë është i detyruar të kryejë funksionin e tij me ndërgjegje, me profesionalizëm, pa diskriminim apo privilegje për vetën apo për ndonjë person tjetër, si dhe me respektin e duhur për liritë dhe të drejtat e njeriut dhe dinjitetin njerëzor.
4.3. Çdokush ka të drejtën e paraqitjes së lirë në treg dhe të konkurrencës së lirë, pa u frikësuar se mund të bëhet viktimë e sjelljeve monopoliste apo diskriminuese, të cilat rezultojnë nga korrupsioni.

Neni 5

5.1. Kur një person fizik apo juridik beson që vendimi i një personi zyrtar apo i personit përgjegjës të personit juridik është marrë për shkak të korrupsionit, ai duhet t'i drejtohet me shkrim Agjensionit Kosovar kundër korrupsionit.
5.2. Agjensioni Kosovar kundër korrupsionit është i detyruar të shqyrtojë kërkesën dhe brenda 60 ditëve nga marrja e saj të informojë personin fizik apo juridik për rezultatin lidhur me kërkesën.

Neni 6

6.1. Ushtrimi i funksioneve apo detyrave publike bëhet në mënyrë transparente dhe i përgjigjet kontrollit të publikut.
6.2. Askush nuk mund të përdorë një ligj apo një rregullore tjetër që kufizon ose përjashton transparencën ose publicitetin me qëllim mbulimin e keqpërdorimit të një funksioni apo detyre për përparësi personale.

Neni 7

7.1. Punët Juridike që rezultojnë nga korrupsioni janë të pavlefshme. Personi që ka një interes të ligjshëm mund të kërkojë revokimin e tyre.
7.2. Personi i dëmtuar nga një akt korruptiv ka të drejtë të kërkoj kompensim për dëmin e shkaktuar.

KREU 2
AGJENSIONI KOSOVAR I ANTIKORRUPSIONIT

Neni 8

8.1. Me qëllim të ushtrimit të përgjegjësive të përcaktuara me këtë Ligj do të themelohet Agjensioni Kosovar kundër korrupsionit si organ i pavarur (në tekstin e mëtejmë: Agjensioni).
8.2. Fondet për funksionimin e Agjensionit sigurohen nga Buxheti i Konsoliduar i

Kosovës në bazë të propozimit të Agjensionit. Agjensioni vendosë për mënyrën e përdorimit të fondeve.

Neni 9

9.1. Aktivitetet e Agjensionit do të udhëhiqen nga një drejtor, i cili ka vendbanim të përhershëm në Kosovës.
9.2. Drejtori duhet të jetë mbi moshën 35 vjeç, të kenë arsimin universitar dhe duhet të konsiderohet i përshtatshëm për kryerjen e funksioneve në Agjension.
9.3. Drejtori emërohet në detyrë për një mandat 5 vjeçar dhe mund të riemërohet vetëm një herë.
9.4. Funksioni i Drejtorit të Agjensionit është i papërputhshëm me ndonjë pozitë në Qeveri, Kuvend, organet lokale, partitë politike apo sindikatat e punëtorëve, apo kryerjen e ndonjë pune në ndonjë organizatë publike vendore, ndërkombëtare apo autoritet lokal.
9.5. Agjensioni angazhon numrin e nevojshëm të personelit tjetër.
9.6. Agjensioni mund të angazhojë ekspertë të jashtëm.

Neni 10

10.1. Këshilli do të iniciojë procedurën për zgjedhjen e drejtorit të ri të Agjensionit përmes një shpalljeje publike 6 muaj para mbarimit të mandatit të tij.
10.2. Këshilli e inicion procedurën e përmendur më lart nëpërmjet një shpallje publike me propozimin për zënien e vendit të drejtorit. Propozimet duhet të dorëzohen brenda 30 ditëve nga bërja e ftesës.
10.3. Këshilli i rekomandon Kuvendit të Kosovës dy kandidatë për postin e drejtorit. Kuvendi i Kosovës emëron njërin nga kandidatët e propozuar.
10.4. Nëse procedura për zgjedhjen e kandidatëve apo emërimin e tyre nuk ka sukses, procedura duhet të përsëritet derisa të emërohet drejtori.

Neni 11

Drejtori i Agjensionit mund të shkarkohet para kohe:

a. nëse e kërkon këtë,
b. nëse është burgosur për vepra kriminale,
c. nëse nuk pushon së ushtruari detyrën apo funksionet që janë në papajtueshmëri me pozitën e drejtorit,
d. me humbjen e përhershme apo të përkohshme të aftësisë për të kryer punët e tij,
e. nëse shkel ligjet pozitive gjatë ushtrimit të detyrave të tij.

Neni 12

Drejtori i Agjensionit përfaqëson, drejton dhe organizon punët e Agjensionit dhe në pajtim me ligjin ushtron të gjitha detyrat e tjera dhe përgjegjësitë e udhëheqësit të një organi.

Neni 13

Në bazë të propozimit të Agjensionit, Këshilli aprovon rregullat procedurale që definojnë në detaje të mëtejshme Agjensionin dhe metodën e saj të punës. Rregullat procedurale do të botohen në Gazetën Zyrtare.

Neni 14

Agjensioni mund të iniciojë hetime administrative të cilat kanë të bëjnë me masat disiplinore kundër shërbyesve civil.

Neni 15

Organet publike, autoritetet lokale dhe personat zyrtar janë të detyruar t'i ofrojnë Agjensionit me kërkesën e saj informacionin e duhur për kryerjen e punëve të tyre si dhe të lejojnë inspektimin e dokumentacionit relevant.

Neni 16

16.1. Personat zyrtar i raportojnë Agjensionit rastet e korrupsionit për të cilat vijnë në dijeni. Të gjitha këto raste Agjensioni ia përcjellë Prokurorisë publike të Kosovës (PPK) për shqyrtim.
16.2. Çdo person që ka zbuluar informacion që tregon në mirëbesim për ekzistencën e korrupsionit nuk do të ketë ndonjë pasojë të dëmshme.

Neni 17

Personat që parandalojnë, zbulojnë apo hetojnë korrupsionin gëzojnë pavarësi të plotë për qëllime të ushtrimit me efektivitet të kompetencave dhe përmbushjes së detyrimeve të tyre dhe nuk mund t'ju imponohet presion i padrejtë për shkak të punës së tyre apo kur ndërmarrin veprime të caktuara konkrete në pajtim me këtë ligj.

Neni 18

Agjensioni paraqet raportin njëvjeçar të aprovuar nga Këshilli, i cili duhet të miratohet nga Kuvendi i Kosovës.

Neni 19

19.1. 19.1.Këshilli i Agjensionit themelohet për ushtrimin e mbikëqyrjes së drejtpërdrejtë të Agjensionit.
19.2. Këshilli i Agjensionit përbëhet nga 9 (nëntë) anëtarë, 3 (tre) emërohen nga Kuvendi dhe nga 1 (një) përfaqësues të emëruar nga Zyra e Presidentit, Qeveria, Gjykata Supreme, Zyra e Prokurorit Publik, autoritetet lokale dhe shoqëria civile.
19.3. Anëtarët e Agjensionit kanë të drejtën e shpërblimit për shpenzimet që rezultojnë nga puna e tyre në Këshillin e Agjensionit.

19.4. Anëtarët e Këshillit të Agjensionit kanë një mandat prej dy vjetësh në detyrë dhe mund të riemërohen. Dy muaj para mbarimit të mandatit, institucionet e përmendura në paragrafin 2 të këtij neni kryejnë procedurat e nevojshme dhe do të emërojnë anëtarët e rinj të Këshillit.

Neni 20

Këshilli i Agjensionit ka një kryesues dhe zëvendëskryesuesin të zgjedhur nga anëtarët e Këshillit të Agjensionit midis tyre për një periudhë prej dy vjetësh si dhe rregullat procedurale që rregullojnë detajet e punës të Këshillit të Agjensionit.

Neni 21

21.1. Këshilli i Agjensionit kontrollon në mënyrë të rregullt dhe të plotë punën e Agjensionit dhe mbikëqyrë pasuritë e personave zyrtarë që punojnë në Agjension. Drejtori i Agjensionit raporton tek Këshilli i Agjensionit çdo gjashtë muaj në lidhje me përmbajtjen dhe shtrirjen e mbikëqyrjes së pasurive si dhe për gjetjet e Agjensionit në lidhje me papajtueshmërinë, konfliktin e interesave, dhuratat dhe hetimet e përfunduara.

21.2. Këshilli i Agjensionit ushtron funksionet e tij të parapara në këtë Ligj, kur të paktën gjysma e anëtarëve janë të pranishëm.

Neni 22

Këshillit të Agjensionit i caktohen detyrat profesionale dhe i sigurohen kushtet teknike për kryerjen e punëve nga Agjensioni.

Neni 23

Agjensioni:

a. përcjellë tek Prokuroria Publike e Kosovës çdo informatë që ka të bëjë me shkeljet e mundshme korruptuese, që e njëjta të iniciojë procedurë të mëtutjeshme dhe zhvillon hetime administrative lidhur me akuzat e supozuara për korrupsion në ato raste kur nuk iniciohet procedurë penale;
b. bashkëpunon me të gjitha autoritetet vendore dhe ndërkombëtare të ngarkuara për zbatimin e ligjit gjatë procedurave hetimore që kryhen nga këto autoritete;
c. përgatit strategjinë kundër korrupsionit për Qeverinë për aprovim nga Kuvendi dhe ka përgjegjësinë për bërjen e amendamenteve dhe implementimin e saj;
d. mbikëqyr dhe analizon të dhënat statistikore që kanë lidhje me gjendjen e korrupsionit në Kosovë;
e. merr pjesë me autoritetet publike kompetente në hartimin dhe harmonizimin e akteve për parandalimin e korrupsionit;
f. mbikëqyr realizimin e këtyre akteve dhe siguron iniciativa për ndryshimin dhe plotësimin e tyre;
g. merrë pjesë si organi kryesor në fushën e korrupsionit në organizimet e ngjashme nga vendet e tjera dhe në organizatat ndërkombëtare që trajtojnë korrupsionin;

h. paralajmëron autoritetet e Kosovës për realizimin e detyrimeve që dalin nga aktet ndërkombëtare dhe ofron rekomandime sesi të përmbushen këto detyrime;
i. merr pjesë së bashku me organizatat dhe shoqatat shkencore, profesionale, mediat dhe organizata dhe shoqata të tjera joqeveritare për parandalimin e korrupsionit;
j. merr pjesë dhe këshillon gjatë hartimit të platformës së kodit të etikës në sektorin publik dhe privat;
k. ofron opinione dhe sqarime në lidhje me papajtueshmërinë, konfliktin e interesave, dhuratat dhe çështje të tjera që kanë lidhje me përmbajtjen e këtij Ligji;
l. merr pjesë dhe jep këshilla për eleminimin e shkaqeve të korrupsionit në sektorët publik dhe privat me anë organizmit të konsultimeve, seminareve, mbledhje pune dhe formave të tjera të trajnimit;
m. nxjerr raport vjetor për thyerjet serioze dhe të zakonshme të ligjit, rregulloreve dhe parimeve të etikës.

KREU 3
KONFLIKTI I INTERESAVE

Neni 24

24.1. Në rast të një konflikti mes interesave personale dhe të përgjithshme, personi zyrtar duhet të veprojë në pajtim me interesin e përgjithshëm.
24.2. Ekziston një konflikt mes interesave personale dhe të përgjithshme kur gjatë kryerjes së detyrave të caktuara zyrtare ose të aktiviteteve të tjera preken interesat materiale dhe interesat e tjera të personit zyrtar ose të personit që është në marrëdhënie të afërt me të.

Neni 25

25.1. Personi zyrtar që kryen punën e tij në mënyrë profesionale (në tekstin e mëtejmë: profesionisti) nuk duhet të kryejë në mënyrë të pavarur apo brenda fushës pozicionit të tij apo veprimtari të tjera që kanë për qëllim gjenerimin e të ardhurave pa pëlqimin me shkrim të eprorit të tij.
25.2. Pëlqimi i eprorit mund të jepet nëse aktivitetet nga paragrafi 1 i këtij neni nuk prezantojnë ndonjë rrezik për konflikt mes interesave personale të personit zyrtar dhe interesave të përgjithshme të pozitës të tij.

Neni 26

26.1. Personi zyrtar profesionist nuk duhet të ushtrojë funksione administrative, mbikëqyrëse, apo përfaqësimi në shoqëritë tregtare, firma, institucione, kooperativa, fonde apo agjensione.
26.2. Si përjashtim nga paragrafi 1 i këtij neni, personi zyrtar profesionist mund si përfaqësues i organit të tij, të jetë anëtar bordi i një institucioni apo agjensioni

publik, apo anëtar i bordit mbikëqyrës së një ndërmarrjeje publike, fondi publik apo shoqërie komerciale ku autoriteti qendror apo lokal është mbajtësi i aksioneve apo i të drejtave të tjera në bazë të të cilave merr pjesë në menaxhim apo kapital.

Neni 27

Personi zyrtar joprofesionist nuk duhet të ushtroj funksione administrative ose përfaqësimi në një institucion publik, shoqëri, fond apo agjension tjetër kur posti i tij i jep një rol mbikëqyrës ndaj tyre.

Neni 28

Personit zyrtar, i cili ka pasur më parë një pozitë, që sipas këtij Ligji është në papajtueshmëri me funksionet publike i kërkohet heqja dorë nga pozita menjëherë pas zgjedhjes, emërimit, ose konfirmimit të mandatit të tij.

Neni 29

29.1. Nëse pas zgjedhjes, emërimit, ose konfirmimit të mandatit, personi zyrtar vazhdon të kryejë një aktivitet apo funksion që ky Ligj e përcakton si të papajtueshëm me funksionin e ri, Agjensioni nxjerr një paralajmërim për personin zyrtar dhe vendos një afat sipas të cilit atij do t'ju kërkohet të ndërpresin aktivitetin apo të heqin dorë nga posti. Afati i caktuar nga Agjensioni nuk mund të jetë më i shkurtër se 15 ditë apo më i gjatë se 3 muaj.

29.2. Në rast se personi zyrtar i referuar në paragrafin paraprak vazhdon kryerjen e aktiviteteve apo funksioneve të papajtueshme pavarësisht nga paralajmërimi i Agjensionit, Agjensioni propozon fillimin e procedurës për shkarkimin nga detyra nga organi kompetent.

29.3. Nëse organi kompetent konstaton që personi zyrtar vazhdon të kryejë një aktivitet apo funksion të papajtueshëm, ai fillon procedurën për shkarkimin nga funksioni. Organi kompetent duhet të informojë Agjensionin për vendimin e saj final.

Neni 30

Subjektet kontraktuese që marrin pjesë në tenderët publikë hyjnë në transaksione biznesi me ndërmarrje komerciale në pajtim me Ligjin Nr. 2003/17 për prokurimin publik në Kosovë (Rregullore e UNMIK-ut nr. 2004/03 për shpalljen e Ligjit të miratuar nga Kuvendi i Kosovës për Prokurimin Publik në Kosovë).

Neni 31

Agjensioni publikon rregullisht në Gazetën Zyrtare listën e ndërmarrjeve komerciale me të cilat në pajtim me dispozitat e këtij Ligji, entitetet kontraktuese që marrin pjesë në tenderët publikë të referuar në nenin 33, nuk mund të zhvillojnë transaksione biznesi.

Neni 32

32.1. Ndërmarrjet komerciale të referuara në paragrafin 3 të nenit 33 të këtij Ligji nuk kanë të drejtën të përfitojnë ndihma publike nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës.
32.2. Ndërmarrjet bujqësore në zotërim të personit zyrtar ose të personave në marrëdhënie të afërt me të gjithashtu nuk kanë të drejtë të përfitojnë ndihma publike nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës.
32.3. Dispozitat e dy paragrafëve paraprakë nuk aplikohen për ndihmat publike nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës në rast të emergjencave natyrore apo ngjarjeve të jashtëzakonshme në pajtim me ligjin.

KREU 4
PRANIMI I DHURATAVE

Neni 33

33.1. Personi zyrtar nuk ka të drejtë të pranon dhurata apo përfitime të tjera (në tekstin e mëtejmë: dhurata) në lidhje me ushtrimin e detyrës së tij përveç dhuratave formale dhe dhuratave të rastit në vlerë të vogël.
33.2. Dhurata formale konsiderohen dhuratat e sjella nga përfaqësuesit e vendeve të huaja dhe organizatave ndërkombëtare gjatë vizitave dhe rasteve të tjera si dhe dhuratat e sjella në kushte të ngjashme.
33.3. Dhurata të rastit në vlerë të vogël konsiderohen dhuratat e sjella në raste të ndryshme të jubileve të punës dhe personale, raste festash dhe raste të ngjashme dhe nuk e kalojnë vlerën 50 € ose vlera totale e tyre nuk kalon 100 € në një vit, nëse ato sillen nga i njëjti person.
33.4. Personi zyrtar nuk mund të pranojë më tepër se 10 dhurata të rastit brenda vitit.
33.5. Ndalimet dhe kufizimet që rrjedhin nga ky nen aplikohen edhe për personat që janë në marrëdhënie të afërta me personin zyrtar.

Neni 34

34.1. Të gjitha dhuratat e marra dhe vlera e tyre korresponduese do të regjistrohen nga personi zyrtar në katalogun e dhuratave që mbahet nga organi ku personi zyrtar ushtron funksionin e tij.
34.2. Nëse përcaktohet se vlera e dhuratave tejkalon vlerën e paraparë në nenin paraprak dhurata bëhet pasuri e autoritetit publik, nën ruajtjen e organit ku personi zyrtar ushtron aktivitetin e tij.
34.3. Dhuratat formale, pavarësisht nga vlera e tyre, bëhen pasuri e autoritetit publik, nën ruajtjen e organit ku personi zyrtar ushtron aktivitetin e tij.

Neni 35

35.1. Organet publike që janë të detyruara me ligj të mbajnë katalogjet e dhuratave i dërgojnë kopjet e katalogjeve për vitin paraprak në Agjension jo më vonë se dita e fundit e marsit të vitit vijues për vitin paraprak.

35.2. Për çdo shmangje nga kufizimet ligjore, Agjensioni i raporton organit publik që ka dhënë katalogun.

Neni 36

Nëse Agjensioni përcakton se në një rast specifik personi zyrtar ka shkelur dispozitat e neneve 34 dhe 35 të këtij Ligji, ajo informon organin ku personi zyrtar ushtron detyrën.

KREU 5
MBIKËQYRJA E PASURIVE

Neni 37

37.1. Agjensioni mbikëqyrë pasuritë e personave zyrtarë të lartë.
37.2. Nëse Agjensioni, gjatë mbikëqyrjes siç parashihet nga ky ligj konstaton se ka një mospërputhje të dukshme mes informacionit të dorëzuar mbi pasuritë e personit zyrtar të lartë ose personit që është në marrëdhënie të afërt me të, dhe gjendjes aktuale të pasurive, Agjensioni njofton organin ku personi zyrtar i lartë ushtron detyrën e tij dhe nëse është e nevojshme edhe organet e tjera kompetente.
37.3. Organet e referuara në paragrafin paraprak duhet të informojnë Agjensionin për masat dhe vendimet e tyre.

Neni 38

Organi ku personi zyrtar i lartë ushtron detyrën, njofton Agjensionin shtatë ditë pas fillimit apo përfundimit të detyrës së atij personi.

Neni 39

Agjensioni mbikëqyrë pasurinë e personit zyrtar të lartë në bazë të informacionit të dorëzuar nga personi zyrtar i lartë në një formular të posaçëm, i cili do të përcaktohet nga Agjensioni.

Neni 40

Brenda një muaji nga marrja e postit, personi zyrtar i lartë i vë në dispozicion Agjensionit informacionin e mëposhtëm:

a. funksioni i cili kryhet si profesionist apo si joprofesionist,
b. funksione ose aktivitete të tjera që kryhen nga personi zyrtar ,
c. funksionet e kryera nga personi zyrtar në periudhën më të afërt para marrjes së postit,
d. gjendjen e pasurive të tij ose të personave që janë në marrëdhënie të afërt me të.

Neni 41

41.1. Informacioni në lidhje me gjendjen e pasurive të personit zyrtar të lartë ose të personave që janë në marrëdhënie të afërt me personin zyrtar të lartë përmban informacione rreth pasurive dhe të ardhurave të tyre, si më poshtë:
   a. patundshmëri,
   b. pasuri e luajtshme në vlerë të madhe,
   c. zotërimi nga ana e tyre i aksioneve në shoqëri komerciale ,
   d. letra me vlerë,
   e. para të gatshme të mbajtura në bankë, banka kursimesh dhe institucione të tjera kursimi apo kreditore,
   f. borxhet, garancitë e ndërmarra dhe detyrimet e tjera, dhe
   g. të hyrat vjetore (që shërbejnë si bazë e tatueshme).

41.2. Pasuri e luajtshme në vlerë të madhe siç referohet në pikën (b) të paragrafit paraprak konsiderohen pasuritë e luajtshme me vlerë mbi 5.000 €.

41.3. Agjensioni mund të kërkojë dëshmi të përshtatshme nga personi zyrtar i lartë për informacionin e referuar në paragrafin 1 të këtij neni.

Neni 42

42.1. Çdo ndryshim në gjendjen e pasurive të referuara në pikat 1 deri në 6 të paragrafit paraprak raportohet nga personi zyrtar i lartë në Agjension, çdo vit deri në ditën e fundit të marsit.

42.2. Agjensioni mund të kërkojë në çdo kohë nga personi zyrtar i lartë që të dorëzojë informacionin e referuar në pikat 1 deri 6 të paragrafit 1 të nenit paraprak. Personi zyrtar i lartë duhet të përmbushë kërkesat e Agjensionit në afat prej 15 ditësh që nga marrja e kërkesës.

Neni 43

43.1. Nëse personi zyrtar i lartë nuk dorëzon informacionin e referuar në nenin 41 ose 42 të këtij Ligji brenda afateve të përcaktuara në këtë Ligj, Agjensioni nxjerr një paralajmërim dhe vendos një afat të ri i cili nuk mund të jetë më i shkurtër se 15 ditë nga dita e nxjerrjes së paralajmërimit.

43.2. Nëse personi zyrtar i lartë nuk dorëzon informacionin e kërkuar brenda afatit të përcaktuar në paragrafin paraprak, Agjensioni informon organin ku personi zyrtar i lartë ushtron detyrën e tij ose organin përgjegjës për përcaktimin e pagesës së pagës apo shpërblimin e pagës.

43.3. Në rastin e përshkruar në paragrafin paraprak, paga ose shpërblimi i pagës zvogëlohen me 1/5 për çdo muaj pas kalimit të afatit të referuar në paragrafin 1 të këtij neni dhe derisa të merret njoftimi i Agjensionit, që personi zyrtar i lartë ka dorëzuar informacionin e kërkuar.

43.4. Nëse personi zyrtar i lartë nuk dorëzon informacionin e kërkuar brenda tre muajve nga kalimi i afatit të referuar në paragrafin 1 të këtij neni, Agjensioni njofton organin përgjegjës për fillimin e procedurës për shkarkimin nga detyra. Pagesa e pagës ose shpërblimi i pagës ndërpriten.

43.5. Nëse organi kompetent përcakton se personi zyrtar i lartë nuk ka dorëzuar informacionin e kërkuar, ai fillon procedurën për shkarkimin nga detyra dhe informon Agjensionin për vendimin e tij final.

KREU 6
MBROJTA E TË DHËNAVE, RUAJTJA, MBAJTA E SHËNIMEVE, DHE FSHEHTËSIA E INFORMACIONIT

Neni 44

44.1. Anëtarët e Agjensionit, Këshillit të Agjensionit dhe çdo person i punësuar nga Agjensioni janë të detyruar të ruajnë si sekret zyrtar çdo informacion të marrë nga Agjensioni gjatë ushtrimit të detyrave të saj që konsiderohet si sekret zyrtar.
44.2. Të gjithë personat që vijne në dijeni të sekreteve zyrtare gjatë bashkëpunimit me Agjensionin do të informohen për detyrimin për të mbrojtur sekretet zyrtare dhe pasojat e nxjerrjes së tyre. Individët konfirmojnë me anë të nënshkrimit të tyre që janë në dijeni të paralajmërimit.
44.3. Edhe pas pushimit të marrëdhënies së punës, personat nga paragrafi 1 i këtij neni, kanë për detyrë ta ruajnë sekretin zyrtarë në afatin prej 15 vitesh, përveç nëse vendoset ndryshe nga drejtori i Agjensionit.

Neni 45

Të dhënat e marra në pajtim me këtë Ligj do të përdoren vetëm për qëllimet e përcaktuara nga ky ligj.

Neni 46

46.1. Agjensioni është i detyruar të mbajë të dhënat, informacionin dhe dokumentacionin e marrë në bazë të këtij Ligji për një periudhë prej 15 vitesh.
46.2. Agjensioni duhet të mbajë shënimet e mëposhtme:
   a. shënimet për hetimet për rastet e korrupsionit, si dhe personat e përfshirë në to,
   b. shënimet për personat zyrtarë dhe personat që janë të afërt me ta (emri personal, data e lindjes, vendqëndrimi dhe vendbanimi),
   c. shënimet për ndërmarrjet komerciale të referuara në nenin 33 i këtij Ligji (emri i ndërmarrjes komerciale, numri i regjistrimit dhe zyra qendrore) dhe ndërmarrjet bujqësore të referuara në paragrafin 2 të nenit 35 të këtij Ligji.
   d. Shënimet për katalogjet e dhuratave të referuara në paragrafin 1 të nenit 37 të këtij Ligji dhe shënimet për njoftimet e referuara në paragrafin 2 të nenit 38 dhe nenin 39 të këtij Ligji.
   e. Shënimet për informacionet sipas neneve 43 dhe 44 të këtij Ligji për personat e përmendur në pikën 2 të këtij paragrafi.
46.3. Të dhënat dhe informacionin në shënimet e mbajtura nga Agjensioni këtij Ligji duhet të ruhen për një periudhë prej 15 vite dhe të arkivohen apo mbahen në pajtim me Ligjin.

KREU 7
SANKSIONE ADMINISTRATIVE

Neni 47

47.1. Subjektet kontraktuese që marrin pjesë në tenderët publikë janë të detyruar të paguajnë një gjobë prej 50% të vlerës së kontratës nëse konfirmohet se ata ia kanë dhënë tenderin publik një ndërmarrjeje komerciale të referuar në paragrafin 3 të nenit 33 të këtij Ligji.

47.2. Personat përgjegjës të subjekteve kontraktuese që marrin pjesë në tenderët publike janë të detyruar të paguajnë një gjobë nga 5.000 deri në 50.000 €, nëse konfirmohet se ata kanë kryer shkeljet e referuara në paragrafin paraprak.

KREU 8
DISPOZITAT KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 48

Institucionet në të cilat punojnë personat zyrtarë të referuar në nenin 2 të këtij Ligji janë të detyruar të dorëzojnë listën e personave zyrtarë dhe personave të afërt në Agjension brenda 3 muajve pasi Agjensioni fillon funksionimin.

Neni 49

49.1. Personat zyrtarë janë të detyruar të dorëzojnë në Agjension informacionin e referuar në nenet 43 dhe 44 të këtij ligji brenda 6 muajve pasi Agjensioni fillon funksionimin.

49.2. Personat zyrtarë janë të detyruar të përfundojnë aktivitetet që janë të përcaktuara në këtë Ligj si të papajtueshëm me ushtrimin e detyrës apo të kërkojnë pëlqimin e eprorit sipas nenit 28 të këtij Ligji brenda 6 muajve pasi Agjensioni fillon funksionimin.

Neni 50

Brenda 15 ditëve pasi Agjensioni fillon funksionimin, drejtori duhet t'i fton institucionet e referuara në paragrafin 2 të nenit 19 të këtij Ligji për të emëruar anëtarët e Këshillit të Agjensionit. Mbledhja konstitutive (themeluese) do të thirret nga drejtori i Agjensionit brenda 15 ditëve nga marrja e informacionit për emërimin e anëtarit të fundit të Këshillit të Agjensionit.

Neni 51

51.1. Kuvendi i Kosovës emëron drejtorin vendor të Agjensionit brenda 60 ditësh pas shpalljes së këtij ligji.

51.2. Agjensioni do të fillojë funksionimin pas emërimit të drejtorit të Agjensionit.

Neni 52

52.1. Brenda 12 muajve nga fillimi i funksionimit, Agjensioni duhet të konfirmojë strategjinë e aplikueshme kundër korrupsionit ose të dorëzojë për aprovim nëpërmjet Qeverisë për Kuvendin e Kosovës amendamentet e duhura dhe relevante si dhe plotësimet tek strategjitë e aprovuara më parë apo një strategji të re.

52.2. Propozimi për rregullat procedurale të referuara në nenin 13 të këtij Ligji do t'i dorëzohet nga Agjensioni Këshillit të Agjensionit për aprovim brenda 3 muajve nga emërimi i drejtorit të Agjensionit.

52.3. Këshilli do të miraton rregullat procedurale brenda 30 ditëve nga dorëzimi i tyre, brenda 15 ditëve nga miratimi i rregullave procedurale, Agjensioni do të nxjerrë aktet që kanë të bëjnë me organizmin dhe sistematizimin e brendshëm.

Neni 53

Ky ligj hyn në fuqi pas miratimit në Kuvendin e Kosovës, nënshkrimit të Kryetarit të Kuvendit dhe shpalljes nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm.

12 maj 2005
UNMIK/REG/ 2005/26

GAZETA ZYRTARE E INSTITUCIONEVE TË PËRKOHSHME TË VETËQEVERISJES NË KOSOVË / PRISHTINË: VITI II / NR. 10 / 01 MARS 2007

LIGJI Nr. 04/L-030
PËR PËRGJEGJËSINË E PERSONAVE JURIDIK PËR VEPRA PENALE

Përmbajtja

Kreu I: Dispozitat themelore 241
Kreu II: Supozimet e fajësisë 242
Kreu III: Dënimet dhe sanksionet e tjera penalo juridike 243
Kreu IV: Procedura 249
Kreu V: Dispozitat kalimtare dhe përfundimtare 253

Kuvendi i Republikës së Kosovës

Në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton:

LIGJ PËR PËRGJEGJËSINË E PERSONAVE JURIDIK PËR VEPRA PENALE

KREU I
DISPOZITAT THEMELORE

Neni 1
Qëllimi

Me këtë ligj rregullohet përgjegjësia e personave juridik për vepra penale, sanksionet penale të cilat mund të zbatohen ndaj personave juridik dhe dispozitat e posaçme që e rregullojnë procedurën penale të zbatueshme ndaj personit juridik.

Neni 2
Përkufizimet

1. Shprehjet e përdorura në këtë ligj kanë këtë kuptim:
   1.1. **Person Përgjegjës -** personi fizik në kuadër të personit juridik, i cili ka besimin për kryerjen e detyrave të caktuara, ose autorizimin për të vepruar në emër të personit juridik si dhe ekziston bazueshmëria e lartë se është i autorizuar të veproj në emër të personit juridik.
   1.2. **Personi juridik -** subjekti juridik i vendit apo i huaj, i cili sipas legjislacionit Kosovar në fuqi konsiderohet si person juridik.
   1.3. **Sanksionet penale -** masat e dhunës të karakterit penalo-juridik që shqiptohen ndaj personit juridik.

Neni 3
Zbatimi i legjislacionit penal

1. Në qoftë se me këtë ligj nuk është paraparë ndryshe, ndaj personave juridik aplikohen dispozitat e Kodit Penal të Kosovës dhe të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës.
2. Personat juridik mund të përgjigjen për vepra penale nga pjesa e veçantë e Kodit Penal të Kosovës edhe për vepra tjera penale, nëse janë plotësuar kushtet për përgjegjësinë e personit juridik të paraparë me këtë ligj.

Neni 4
Vlefshmëria territoriale (hapësinore) e ligjit

1. Ky ligj aplikohet ndaj:
   1.1. personit juridik të vendit dhe të huaj i cili është përgjegjës për vepër penale të kryer në territorin e Republikës së Kosovës;
   1.2. personit juridik të huaj i cili është përgjegjës për vepër penale të kryer jashtë shtetit në dëm të Republikës së Kosovës, shtetasit të saj apo të personit juridik të vendit;
   1.3. personit juridik të vendit (vendor) i cili është përgjegjës për veprën e kryer penale jashtë vendit.
2. Në rastin nga paragrafi 1. nën-paragrafi 1.2. dhe 1.3. të këtij neni, ky ligj nuk aplikohet nëse janë plotësuar kushtet e veçanta për ndjekje penale nga dispozitat përkatëse të Kodit Penal të Kosovës.
3. Republika e Kosovës, organet e administratës shtetërore dhe të vetëqeverisjes lokale dhe organizatat e huaja qeveritare që veprojnë në Republikën e Kosovës nuk mund të jenë përgjegjëse për vepër penale, por personi përgjegjës mban përgjegjësi penale.
4. Personi juridik të cilit me ligj i është besuar kryerja e autorizimeve juridike nuk është përgjegjës për veprën penale e cila është kryer gjatë ushtrimit të atyre autorizimeve.

KREU II
SUPOZIMET E FAJËSISË

Neni 5
Baza dhe kufiri i përgjegjësisë së personave juridik

1. Personi juridik është përgjegjës për vepër penale të personit përgjegjës i cili duke vepruar në emër të personit juridik në kuadër të autorizimeve ka kryer vepër penale me qëllim që për atë personi juridik të realizoj ndonjë dobi ose ka shkaktuar dëme. Përgjegjësia e personit juridik ekziston edhe atëherë kur veprimi i atij personi juridik ka qenë në kundërshtim me politikën afariste apo urdhrat e personit juridik.
2. Nën kushtet e parapara në paragrafin 1. të këtij neni, personi juridik është përgjegjës për vepër penale edhe nëse personi përgjegjës i cili ka kryer veprën penale nuk është dënuar për atë vepër penale.

3. Përgjegjësia e personit juridik bazohet në fajësinë e personit përgjegjës.
4. Elementet subjektive të veprës penale të cilat ekzistojnë vetëm te personi përgjegjës do të çmohen në raport me personin juridik, nëse është realizuar baza e përgjegjësisë nga paragrafi 1. i këtij neni.

Neni 6
Përgjegjësia në rast ndryshimi të statusit dhe falimentimit të personit juridik

1. Nëse personi juridik pushon së ekzistuari para se procedura penale të përfundoj, dënimi në të holla, masat e sigurisë dhe të konfiskimit të dobisë pasurore mund t'i shqiptohen personit juridik, në qoftë se më parë është përcaktuar përgjegjësia e personit juridik i cili ka pushuar së ekzistuari.
2. Kur personi juridik pushon së ekzistuari pas përfundimit të plotfuqishëm të procedurës, dënimi në të holla, masat e sigurisë dhe të konfiskimit të dobisë pasurore përmbarohen në pajtim me paragrafin 1. të këtij neni.
3. Personi juridik në falimentim dënohet për vepra penale të kryera para ngritjes apo gjatë procedurës së falimentimit.

Neni 7
Tentativa e veprës penale

1. Personi juridik është përgjegjës edhe për vepër penale në tentativë sipas kushteve nga paragrafi 1. i nenit 5 të këtij ligji, në qoftë se me ligj është paraparë se tentativa është e dënueshme.
2. Personi juridik (personi përgjegjës) për tentativë do të dënohet me dënimin e paraparë me këtë ligj për vepër penale, ndërsa mund të dënohet edhe më butë.
3. Personi juridik i cili vullnetarisht e ka penguar përfundimin e veprës penale mund të lirohet nga dënimi.

KREU III
DËNIMET DHE SANKSIONET E TJERA PENALO JURIDIKE

Neni 8
Llojet e sanksioneve

1. Për vepra penale mund të shqiptohen këto sanksione: dënimet, dënimet me kusht dhe masat e sigurisë.
2. Llojet e dënimeve që mund të shqiptohen për vepra penale të personit juridik janë: dënimi me gjobë dhe pushimi i personit juridik**.**

Neni 9
Dënimi me gjobë

1. Për veprat penale të personave juridik dënimi i paraparë me gjobë nuk mund të jetë më i vogël se njëmijë (1.000) Euro dhe më i lartë se njëqindmijë (100.000) Euro.
2. Dënimi me gjobë shqiptohet në shumat si vijon:

2.1. për veprat penale për të cilat është paraparë dënimi me burgim nga pesëmbëdhjetë (15) ditë deri në tri (3) vite, Gjykata mund te shqiptoj dënim me gjobë, nga njëmijë (1.000) gjer në pesëmijë (5.000) Euro;
2.2. për veprat penale për të cilat është paraparë dënimi me burgim nga tri (3) deri në tetë (8) vite, Gjykata mund të shqiptoj dënim me gjobë, nga pesëmijë (5.000) gjer në pesëmbëdhjetëmijë (15.000) Euro;
2.3. Për veprat penale për të cilat është paraparë dënimi me burgim nga tetë (8) deri në njëzet (20) vite, gjykata mund të shqiptoj dënim me gjobë nga pesëmbëdhjetëmijë (15.000) gjer në tridhjetepesëmijë (35.000) Euro;
2.4. Për veprat penale për të cilat është paraparë dënimi me burgim afatgjatë, gjykata mund të shqiptoj dënim me gjobë, nga tridhjetepesëmijë (35.000) Euro deri në njëqindmijë (100.000) euro.

Neni 10
Matja e dënimit me gjobë

1. Gjykata do t'ia matë dënimin me gjobë personit juridik brenda kufijve të parashikuar me ligj për atë vepër, duke marrë parasysh të gjitha rrethanat që ndikojnë që dënimi të jetë më i madh ose më i vogël (rrethanat rënduese dhe lehtësuese), e sidomos:
   1.1. matjen e veprës penale, të kryer;
   1.2. pasojat që kanë lindur ose që kanë mundur të lindin;
   1.3. rrethanat në të cilat është kryer vepra penale;
   1.4. fuqinë ekonomike dhe madhësinë e personit juridik;
   1.5. pozitën dhe numrin e personave përgjegjës në personin juridik të cilët kanë kryer vepër penale;
   1.6. sjellja e personit juridik pas kryerjes së veprës penale;
   1.7. masat të cilat i ka ndërmarr personi juridik me qëllim të pengimit dhe zbulimit të veprës penale;
   1.8. raporti ndaj viktimës së veprës penale;
   1.9. sjellja e personit juridik ndaj veprës së kryer penale, duke përfshirë dhe pranimin e përgjegjësisë për veprën e kryer penale.
2. Gjatë caktimit të dënimit gjykata në veçanti do të merr parasysh se a është dënuar personi juridik për vepër penale, vepra penale e kryer më parë, a është e njëllojtë me veprën e re penale dhe sa kohë ka kaluar nga dënimi i mëparshëm.
3. Gjykata mund të japë dënimin edhe nën masën e parashikuar për vepër penale (zbutja e dënimit) kur këtë gjë e parashikon ky ligj ose dispozita me të cilën caktohet vepra penale, apo në qoftë se ekzistojnë rrethanat veçanërisht lehtësuese. Dënimi mund të zbutet deri në masën më të vogël të parashikuar në nenin 12 paragrafi 1. të këtij ligji.
4. Gjykata mund t'ia ashpërsojë dënimin personit juridik ose personit përgjegjës të parashikuar për vepër penale të kryer në dyfishin e shumës së masës më të lartë të dënimit, në qoftë se kryesi është recidivist i shumëfishtë.
5. Recidivi i shumëfishtë për personin juridik sipas paragrafit 4. të këtij neni ekziston në qoftë se:
   5.1. personi juridik ka qenë të paktën dy herë i dënuar për vepër penale të

ngjashme me mbi tridhjetepesëmijë (35.000) Euro dhe nëse prej dënimit të fundit që është dhënë në formë të prerë nuk kanë kaluar më tepër se pesë (5) vjet;

5.2. për veprat e ngjashme penale ka qenë të paktën dy herë i dënuar me burg ose me gjobë prej pesëmbëdhjetëmijë (15.000) Euro, nëse prej dënimit të fundit me burg, përkatësisht prej dënimit të fundit me gjobë të formës së prerë që i është caktuar nuk kanë kaluar më tepër se pesë (5) vjet dhe nëse kryesi tregon pririje për kryerjen e veprave të tilla penale.

Neni 11
Pushimi i personit juridik

1. Dënimi me pushim të veprimtarisë së personit juridik, mund të shqiptohet nëse personi juridik është themeluar me qëllim të kryerjes së veprave penale apo veprimtarinë e ka shfrytëzuar kryesisht për kryerjen e veprave penale.
2. Dënimi i pushimit të personit juridik nuk mund t'i shqiptohet njësive të vetëqeverisjes lokale dhe partive politike.
3. Pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit për pushimin e personit juridik zbatohet likuidimi i personit juridik në pajtim me ligjin.

Neni 12
Dënimi me kusht

1. Personit juridik për vepër penale gjykata mund t'ia caktojë dënimin me kusht.
2. Me dënimin me kusht gjykata mund t'i përcaktojë personit juridik dënimin deri në pesëdhjetëmijë (50.000) Euro, por që ajo të mos ekzekutohet në qoftë se personi juridik i dënuar për kohën në të cilën e cakton gjykata, e që nuk mund të jetë më e shkurtër se një dhe as më e gjatë se dy (2) vjet (koha e verifikimit), nuk kryen ndonjë vepër të re penale që ka elementet e veprës penale në kuptim të nenit 5 të këtij ligji.
3. Në dënimin me kusht gjykata mundet të caktoj se dënimi do të zbatohet edhe nëse personi juridik i dënuar në afatin e caktuar nuk e kthen dobinë pasurore të marr me kryerjen e veprës penale, nuk e kompenson dëmin të cilin e ka shkaktuar me veprën penale apo nuk i plotëson detyrimet e tjera të parapara në dispozitat penalo-juridike. Afati për plotësimin e këtyre detyrimeve e përcakton gjykata në suaza të afatit të caktuar të verifikimit.
4. Në pikëpamje të caktimit të dënimit me kusht, të kushteve për shqiptimin e dënimeve, të efektit të tij dhe revokimit të dënimit vihen përshtatshmërisht në zbatim dispozitat e neneve 42 deri 48 të Kodit Penal të Kosovës.

Neni 13
Masat e sigurisë

1. Për vepra penale për të cilat janë përgjegjës personat juridik mund të caktohen këto masa të sigurisë:
   1.1. ndalimi i kryerjes së veprimtarive dhe punëve të caktuara;

1.2. marrja e sendit;
1.3. konfiskimi e dobisë pasuror;
1.4. shpallja publikisht e aktgjykimit.

2. Ndalimi i kryerjes së veprimtarive dhe punëve të caktuara mund të caktohet:
   2.1. në lidhje me një apo të më shumë veprimtarive dhe punëve me kryerjen e së cilës është kryer vepra penale;
   2.2. personit juridik në kohëzgjatje deri në tre (3) vjet duke llogaritur që nga plotfuqishmëria e aktgjykimit nëse kryerja e mëtejme e veprimtarive dhe punëve të caktuara do të ishte e rrezikshme për jetën, shëndetin dhe sigurinë e njerëzve apo pasurinë, ose në qoftë se personi juridik tanimë ka qenë i dënuar për veprën e njëjtë apo të njëllojtë penale.
3. Masa e sigurisë e konfiskimin të sendit ka të bëjë me sendet që janë përdorur ose që janë destinuar për kryerjen e veprës penale, ose që janë krijuar nga kryerja e veprës penale, të cilat mund të merren nga personi juridik, në qoftë se janë në pronësi të personit juridik.
4. Sendet nga paragrafi 1. i këtij neni mund të merren edhe kur ato nuk disponohen nga personi juridik – kryesi i veprës penale, nëse këtë gjë e kërkojnë interesat e ruajtjes së jetës e të shëndetit të njerëzve, siguria e qarkullimit, interesat e tjera të ekonomike, ose arsyet e moralit, por me këtë gjë të mos preket në të drejtën e personave të tretë për shpërblimin e dëmit.
5. Me ligj mund të caktohet medoemos masa sigurisë e konfiskimit së sendit.
6. Masa sigurisë, konfiskimi i përfitimit pasuror realizohet si vijon:
   6.1. personi juridik nuk mund të mbajë për vete përfitimin pasuror të fituar me vepër penale;
   6.2. dobia pasurore merret me vendimin gjyqësor me të cilin është konstatuar kryerja e veprës penale;
   6.3. nëse personi juridik të cilit i është caktuar masa e konfiskimit së dobisë pasurore pas aktgjykimit të formës së prerë ka pushuar së ekzistuari, përfitimi pasuror do të merret nga personi juridik i cili ka marrë mbi vete pasurinë që ai e ka pasur në dispozicion – deri në shumën e kësaj pasurie;
   6.4. nëse konstatohet pamundësia e konfiskimit të përfitimit pasuror e cila përbëhet nga të holla, të drejta apo sende, gjykata do ta detyrojë personin juridik për të paguar kundërvlerën në euro, ndërsa me rastin e caktimit të shumës do të merret parasysh vlera e tregut e sendeve dhe të drejtave në kohën e marrjes së vendimit.
7. Masën e sigurisë të shpalljes publikisht të aktgjykimit gjykata do ta japë në qoftë se e vlerëson se do të ishte e dobishme që publiku të njihet me aktgjykimin, e sidomos nëse shpallja e aktgjykimit do të kontribuonte që të mënjanohet rreziku për jetën ose për shëndetin e njerëzve apo që të mbrohet siguria e qarkullimit ose interesi tjetër ekonomik.
8. Gjykata vendos sipas rëndësisë së veprës penale dhe nevojës së njoftimit të publikut, nëse aktgjykimi do të shpallet me anë të shtypit, televizionit apo të radios ose me anë të mjeteve të informimit si dhe nëse arsyetimi i aktgjykimit do të shpallet në tërësi ose në ekstrakte, duke pasur parasysh që mënyra e shpalljes të bëjë të mundur njoftimin e të gjithëve në interesin e të cilëve duhet të shpallet aktgjykimi.

Neni 14
Parashkrimi

1. Parashkrimi i ndjekjes penale të personit juridik llogaritet sipas dënimit të paraparë për personin juridik i cili ka kryer veprën penale.
2. Ndjekja penale nuk mund të ndërmerret kur kalon afati i parashkrimit i paraparë në nenin 90 të Kodit Penal të Kosovës.
3. Parashkrimi i ekzekutimit të dënimit për vepër penale fillon kur të kenë kaluar tre (3) vjet nga data kur aktgjykimi të ketë marrë formën e prerë.
4. Parashkrimi i ekzekutimit të masës mbrojtëse fillon:
   4.1. kur të kenë kaluar gjashtë (6) muaj nga dita kur vendimi mbi shqiptimin e masës së sigurisë është bërë i formës së prerë. Në rast se sendi gjendet jashtë vendit, afati parashkrimit është tetëmbëdhjetë (18) muaj nga dita kur vendimi është bërë i formës së prerë;
   4.2. kur të kenë kaluar tre (3) vjet nga dita kur të ketë marrë formën e prerë aktgjykimi me të cilën është caktuar kjo masë e sigurisë;
   4.3. kur të kenë kaluar tre(3) muaj nga data kur aktgjykimi të ketë marrë formën e prerë me të cilën është caktuar masa mbrojtëse shpallja publikisht e aktgjykimit.

Neni 15
Evidenca për dënimet e shqiptuara

1. Evidencën mbi dënimet e personave juridik për vepra penale e mbanë gjykata e shkallës së parë në territorin e së cilës gjendet selia e personit juridik vendor, përkatësisht selia e përfaqësisë apo degës së personit juridik të huaj.
2. Evidenca mbi dënimet e personave juridik për vepra penale përmban këto të dhëna:
   2.1. emërtimin, selinë dhe veprimtarinë e personit juridik;
   2.2. numrin e regjistrimit dhe numrin amë;
   2.3. të dhënat për veprën e kryer penale, mbi dënimin, dënimin me kusht, masën e sigurisë;
   2.4. të dhënat mbi personin përgjegjës i cili ka kryer veprën penale për të cilën është dënuar personi juridik;
   2.5. ndryshimet e mëvonshme të të dhënave të përmbajtura në evidencën mbi dënimet;
   2.6. të dhënat mbi dënimin e ekzekutuar dhe anulimin e evidencës për dënimin e gabuar.
3. Të dhënat nga evidenca për personat juridik të dënuar mund të ofrohen vetëm në qoftë se për këtë gjë ekzistojnë shkaqet e arsyeshme.
4. Të dhënat nga evidenca e dënimeve mund t'i epen vetëm gjykatës, prokurorit dhe policisë lidhur me procedurën penale që zhvillohet kundër personit juridik i cili më herët ka qenë i dënuar, organit për ekzekutimin e sanksioneve penale dhe organit i cili merr pjesë në procedurën e dhënies së faljes apo të vendosjes të pasojave juridike të dënimit, kur kjo është e nevojshme për kryerjen e punëve nga kompetenca e tyre.
5. Me kërkesë të arsyetuar të organit shtetëror apo të personit juridik mund të ofrohen

të dhënat nga evidenca e dënimeve në qoftë se zgjasin gjithnjë pasojat juridike të dënimit apo masat e sigurisë dhe në qoftë se për këtë gjë ekziston interesi i arsyeshëm i bazuar në ligj.

6. Personit juridik, me kërkesën e tyre, mund t'u ofrohen të dhënat mbi dënimin ose mos dënimin e tyre vetëm në qoftë se këto të dhëna u nevojiten për realizimin e të drejtave të tyre.

Neni 16
Pasojat juridike të dënimit dhe pushimi i tyre

1. Pasojat juridike të dënimit për personin juridik mund të fillojnë kur është caktuar dënimi me gjobë. Për personin juridik mund të fillojnë këto pasoja juridike të dënimit:
   1.1. ndalimi i kryerjes së veprimtarisë në bazë të lejes, autorizimit apo të koncesionit të lëshuar nga e organeve shtetërore;
   1.2. ndalimi i marrjes së lejes, autorizimit apo të koncesionit të cilat i lëshojnë organet shtetërore.
2. Pasojat juridike nga paragrafi 1, nën-paragrafi 1.2. i këtij neni mund të parashihen në kohëzgjatje më së shumti deri në pesë (5) vjet, duke llogaritur që nga dita kur aktgjykimi të ketë marrë formën e prerë.
3. Pasi të kenë kaluar tre (3) vjet nga dita e dënimit të ekzekutuar apo të parashkruar, gjykata në bazë të lutjes së personit juridik të dënuar mund të vendos që të pushojë pasoja juridike e të dënuarit që ka të bëjë me ndalimin e fitimit të drejtës së caktuar.
4. Me rastin e vendosjes për pushimin e pasojave juridike të dënimit gjykata merr parasysh sjelljen e personit juridik të dënuar, se a e ka bërë kompensimin e dëmit të shkaktuar me veprën penale dhe kthyer përfitimin pasuror të fituar me kryerjen e veprës penale, si dhe rrethana tjera të cilat bëjnë me dije për arsyeshmërinë e pushimit të pasojave juridike të dënimit.

Neni 17
Zbatimi subsidiar i dispozitave të pjesës së përgjithshme të Kodit Penal

1. Për personat juridik përshtatshmërisht do të zbatohen dispozitat e pjesës së përgjithshme të Kodit Penal të Kosovës për:
   1.1. veprën penale;
   1.2. veprës së rëndësisë së vogël;
   1.3. nevojës ekstreme;
   1.4. shtytjes;
   1.5. ndihmës;
   1.6. kufijtë e përgjegjësisë penale dhe ndëshkimi për bashkëpunim;
   1.7. mënyra e kryerjes së veprave penale;
   1.8. koha e kryerjes së veprave penale;
   1.9. vendi i kryerjes së veprave penale;
   1.10. qëllimi i dënimit me kusht;
   1.11. revokimi i dënimit me kusht për shkak të veprave penale të kryera më parë;
   1.12. revokimi i dënimit me kusht për shkak të mos përmbushjes së detyrimeve të caktuara;

1.13. afatet për revokimin e dënimit me kusht;
1.14. fillimi dhe ndërprerja e afateve të parashkrimit të ndjekjes penale;
1.15. fillimi dhe ndërprerja e afateve të parashkrimeve të ekzekutimit të dënimeve;
1.16. domethënia e shprehjeve.

KREU IV
PROCEDURA

Neni 18
Procedura unike

1. Për veprën penale të personit juridik dhe të personit përgjegjës ngritët dhe zbatohet procedura unike dhe nxirret një aktgjykim.
2. Në qoftë se për shkaqe ligjore dhe shkaqe tjera nuk mund të ngritët apo zbatohet procedura penale kundër personit përgjegjës, procedura do të filloj dhe zbatohet vetëm kundër personit juridik.

Neni 19
Kompetenca territoriale

1. E kompetencë territoriale, sipas rregullit, është gjykata në territorin e së cilës është kryer apo tentuar të kryhet vepra penale.
2. Në qoftë se nuk dihet vendi i kryerjes së veprës penale apo ai vend është jashtë territorit të Republikës së Kosovës, kompetent është gjykata në territorin e së cilës ndodhet selia e personit juridik të pandehur. Në rast dyshimi, selia konsiderohet vendi ku ndodhen organet e qeverisjes së personit juridik.
3. Në qoftë se për vepër penale gjykohet personi juridik i huaj me kompetencë territoriale është gjykata në zonën e së cilës në Republikën e Kosovës ndodhet përfaqësia apo dega e këtij personi juridik.

Neni 20
Përfaqësuesi i personit juridik të pandehur

1. Në procedurën penale personin juridik të pandehur e përfaqëson përfaqësuesi i personit juridik i cili është i autorizuar t'i ndërmarrë të gjitha veprimet që mund t'i ndërmarrë i pandehuri në procedurën penale.
2. Përfaqësues i personit juridik të pandehur është personi që është i autorizuar ta përfaqësojë këtë person juridik në bazë të ligjit, të aktit të organit shtetëror kompetent apo të statutit, përkatësisht të aktit tjetër të përgjithshëm të personit juridik.
3. Gjykata vërteton identitetin e përfaqësuesit të personit juridik të pandehur dhe autorizimin e tij për pjesëmarrje në procedurë.
4. Përfaqësuesi i personit të huaj të pandehur juridik është personi që drejton përfaqësinë, përkatësisht degën e këtij personi juridik në Republikën e Kosovës.
5. Përfaqësues i personit juridik të pandehur nuk mund të jetë personi i cili në të njëjtën çështje juridike është ftuar si dëshmitar.

6. Përfaqësues i personit juridik të pandehur nuk mund të jetë personi përgjegjës kundër të cilit zhvillohet procedura penale për vepër të njëjtë penale apo veprën tjetër, përpos në rastin në qoftë se ai person është i vetmi anëtar i atij personi juridik.
7. Organi i qeverisjes apo menaxhimit të personit juridik të pandehur për përfaqësues mund të caktoj personin tjetër nga radhët e anëtarëve të vet.

Neni 21
Caktimi i përfaqësuesit

1. Gjykata para së cilës zhvillohet procedura, në thirrjen e parë të saj e njoftojë personin juridik të pandehur se është i detyruar që të caktojë përfaqësuesin në afat prej tetë (8) ditësh nga data e pranimit të thirrjes. Nëse personi juridik nuk e cakton përfaqësuesin në afatin e caktuar, gjykata do ta caktojë njërin nga ata për përfaqësues.
2. Në qoftë se personi juridik i pandehur pushon të ekzistojë para përfundimit të procedurës penale me vendim të formës së prerë, pasardhësi i tij juridik cakton përfaqësuesin e tij në afat prej tetë (8) ditësh nga dita e pushimit të personit juridik, në të kundërtën përfaqësuesin do t'a caktojë gjykata para së cilës zhvillohet procedura.
3. Përfaqësuesin e personit juridik të pandehur e cakton kryetari i gjykatës me vendim e cila i dërgohet personit i cili është caktuar për përfaqësues të atij personi juridik. Personat e tillë kanë të drejtë ankese kundër vendimit, por ankesa nuk e ndalon ekzekutimin e tij.

Neni 22
Dërgimi i vendimeve dhe shkresave personit juridik

Të gjitha vendimet, thirrjet, komunikimet dhe letrat e tjera për personin juridik të pandehur dërgohen në adresën përfaqësuesit të tij apo në selinë e personit juridik, përkatësisht të degës së saj.

Neni 23
Sjellja e përfaqësuesit

Në qoftë se përfaqësuesi i thirr me rregull i personit juridik të pandehur nuk i përgjigjet thirrjes, gjykata që zhvillon procedurën mund të urdhërojë që ai të sillet me detyrim.

Neni 24
Shpenzimet e përfaqësuesit

1. Shpenzimet e përfaqësuesit të personit juridik të pandehur hyjnë në shpenzimet e procedurës penale.
2. Shpenzimet e nevojshme të përfaqësuesit të caktuar në procedurën për vepra penale për të cilat bëhet ndjekja sipas detyrës zyrtare paguhen që më parë nga mjetet e organit i cili zhvillon procedurën penale, ndërsa paguhen më vonë nga personat të

cilët janë të detyruar që t'i kompensojnë sipas dispozitave të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës.
3. Personi juridik i pandehur i heq vet shpenzimet e procedurës që i ka shkaktuar me fajin e vet përfaqësuesit të tij.

Neni 25
Mbrojtësi

1. Personi juridik i pandehur mund të ketë avokatin mbrojtës.
2. Personi juridik i pandehur dhe personi përgjegjës i pandehur për veprën e njëjtë penale nuk mund të kenë avokatin mbrojtës të përbashkët.
3. Për personin juridik të pandehur nuk zbatohen dispozitat e Kodit të Procedurën Penale të Kosovës për mbrojtjen e detyrueshme.

Neni 26
Refuzimi i kallëzimit penal

1. Prokurori, përveç bazës për refuzim të kallëzimit penal nga neni 208 paragrafi 1. i Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, refuzon kallëzimin penal edhe në rastin kur nuk ekziston baza e përgjegjësisë së personit juridik të paraparë nën nenin 5 të këtij ligji.
2. Në qoftë se prokurori gjen se nuk ka bazë për ndjekje për vepër penale, është i detyruar që, në afat prej tetë ditësh, për atë ta njoftojë të dëmtuarin dhe ta udhëzojë se vet mund të ndërmerr ndjekjen. Kështu do veproj edhe gjykata nëse ka nxjerrë vendim për ndërprerjen e procedurës për shkak të heqjes dorë të prokurorit nga ndjekja.

Neni 27
Përmbajtja e aktakuzës

Aktakuza kundër personit juridik të pandehur përveç pjesëve të parapara me Kodin e Procedurës Penale duhet të përmbajë edhe emërtimin e personit juridik të pandehur, selinë dhe veprimtarinë e personit juridik, numrin e regjistrimit të personit juridik, emrin dhe mbiemrin e përfaqësuesit të tij, datën e lindjes dhe adresën e banimit dhe shtetësinë, shteti i dhënies së dokumentit të udhëtimit dhe numri i dokumentit të udhëtimit nëse është i huaj.

Neni 28
Seanca kryesore

1. Në seancën kryesore së pari dëgjohet personi përgjegjës i pandehur, e pastaj dëgjohet përfaqësuesi i personit juridik të pandehur. Në dëgjimin e personit juridik të pandehur nuk mund të merr pjesë përfaqësuesi i personit juridik të pandehur i cili nuk është marrë në pyetje ende.
2. Gjykata mund të urdhërojë që përfaqësuesi i personit juridik të pandehur dhe personi përgjegjës i pandehur të ballafaqohen në qoftë se thëniet e tyre nuk pajtohen në faktet e rëndësishme.

3. Pas mbarimit të procedurës provuese, e pas fjalës së paditësit dhe të dëmtuarit, i epet fjala mbrojtësit të personit juridik të pandehur dhe përfaqësuesit të këtij personi, e pastaj mbrojtësit të personit përgjegjës të pandehur dhe personit përgjegjës të pandehur.

Neni 29
Përmbajtja e aktgjykimit

1. Aktgjykimi i hartuar me shkrim, përpos pjesëve të parapara me Kodin për Procedurën Penale përmban:
   1.1. në hyrjen e aktgjykimit emërtimin e personit juridik të pandehur, selinë dhe veprimtarinë e personit juridik të pandehur, numrin e regjistrimit, emrin dhe mbiemrin e përfaqësuesit të tij, datën e lindjes dhe adresën e banimit dhe të shtetësisë, shtetin e dhënies së dokumentit të udhëtimit dhe numrin e fletë udhëtimit në qoftë se është i huaj;
   1.2. në dispozitiv të aktgjykimit emërtimin, selinë dhe veprimtarinë e personit juridik të pandehur, numrin e regjistrimit të personit juridik të pandehur.

Neni 30
Anulimi i pjesshëm i aktgjykimit të gjykatës së shkallës së pare

Gjykata e shkallës së parë mund të anuloj aktgjykimin në pjesën që i përket vetëm personit juridik të pandehur apo vetëm personit përgjegjës të pandehur, në qoftë se ajo pjesë e aktgjykimit mund të ndahet pa dëm për gjykim të rregullt.

Neni 31
Masat e kujdesit ndaj personit juridik

1. Në qoftë se rrethanat e veçanta arsyetojnë frikën se personi juridik i pandehur do të përsëritë veprën penale apo do të përfundoj veprën penale të tentuar apo se do të kryej vepër penale me të cilën kërcënon, gjykata do t'i caktoj këto masa të kujdesit:
   1.1. ndalimi i kryerjes së veprimtarive dhe punëve të caktuara;
   1.2. ndalimi i afarizmit me llogaritë shtetërore dhe lokale;
   1.3. ndalimi i fitimit të lejeve, autorizimeve, koncesioneve dhe subvencioneve.
1. Gjykata mund të caktoj masën e kujdesit nga paragrafi 1. nën-paragrafi 1.1 i këtij neni edhe nëse kryerja e mëtejme e veprimtarive apo punëve të caktuara do të ishte e rrezikshme për jetën, shëndetin apo sigurinë e njerëzve apo pasurinë, ose për ekonominë. Kjo masë nuk mund t'iu shqiptohet njësive lokale të vetëqeverisjes, partive politike dhe sindikatave.
2. Nëse kundër personit juridik është ngritur procedura penale, gjykata mundet, sipas propozimit të prokurorit shtetëror apo sipas detyrës zyrtare, të ndaloj ndryshimet statusore të cilat kishin mund të sjellin deri te pushimi i personit juridik të pandehur. Ndalesa do të regjistrohet në regjistrin gjyqësor apo regjistrin tjetër të cilin e mban organi kompetent shtetëror.
3. Vendimi për caktimin e masës së kujdesit regjistrohet sipas detyrës zyrtare në regjistrin gjyqësor apo regjistrin tjetër të cilin e mbanë organi kompetent komunal.

Neni 32
Zbatimi i Kodit për Procedurën Penale dhe të Ligjit për ekzekutimin e sanksioneve penale

Në qoftë se me dispozitat e këtij ligji nuk është caktuar ndryshe, në procedurën për përgjegjësinë e personave juridik të pandehur dhe në zbatimin e sanksioneve penale, përshtatshmërisht do të zbatohen dispozitat e Kodit të Procedurës Penale dhe dispozitat e Ligjit për ekzekutimin e sanksioneve penale.

KREU V
DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 33
Përfundimi i lëndëve

1. Deliktet ekonomike të parapara me ligjet e veçanta me hyrjen në fuqi të këtij ligji bëhen kundërvajtje.
2. Procedurat për deliktet ekonomike të ngritura deri në hyrjen në fuqi të këtij ligji do të kryhen në gjykatën ku ka filluar procedura, ndërsa sipas dispozitave në bazë të cilave janë ngritur, më së voni deri më 31.12.2012.

Neni 34
Pushimi dhe hyrja në fuqi

1. Me hyrjen në fuqi të këtij ligji pushon të vlejë Ligji për deliktet ekonomike (Teksti i spastruar) ("Gazeta Zyrtare e RSFJ" nr. 10/86).
2. Ky ligj hyn në fuqi më 1 janar 2013.

Ligji Nr. 04/L-030
31 gusht 2011

Shpallur me dekretin Nr.DL-030-2011, datë 31.08.2011 nga Presidentja e Republikës së Kosovës Atifete Jahjaga.

GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS / Nr. 16 / 14 SHTATOR 2011, PRISHTINË

LIGJET PROCEDURALE

KODI Nr. 04/L-123 I PROCEDURËS PENALE

Përmbajtja

Pjesa e parë: Dispozitat e përgjithshme ... 258
Kapitulli I: Parimet themelore dhe përkufizimet ... 258
Kapitulli II: Kompetenca e gjykatave ... 266
Kapitulli III: Përjashtimi ... 275
Kapitulli IV: Prokurori i shtetit ... 278
Kapitulli V: Mbrojtësi ... 280
Kapitulli VI: I dëmtuari ... 283
Kapitulli VII: Mbikëqyrja e procedurës penale ... 284
Kapitulli VIII: Detyrimet e organeve publike ... 285
Pjesa e dytë: Procedura penale ... 285
Kapitulli IX: Fillimi i hetimeve dhe procedura penale ... 285
Kapitulli X: Heqja e lirisë para ngritjes së aktakuzës dhe masat për sigurimin e pranisë së të pandehurit ... 338
Kapitulli XI: Procesverbalet ... 360
Kapitulli XII: Provat gjatë hetimit ... 366
Kapitulli XIII: Mbrojtja e të dëmtuarve dhe dëshmitarëve ... 369
Kapitulli XIV: Procedurat alternative ... 373
Kapitulli XV: Faza e ngritjes së aktakuzës dhe deklarimit ... 380
Kapitulli XVI: Provat ... 388
Kapitulli XVII: Ngrirja e aseteve dhe urdhrat ndalues ... 391
Kapitulli XVIII: Konfiskimi ... 393
Kapitulli XIX: Shqyrtimi gjyqësor ... 404
Kapitulli XX: Aktgjykimi ... 428
Kapitulli XXI: Mjetet juridike ... 434
Pjesa e tretë: Administrimi i procedurës ... 458
Kapitulli XXII: Parashtresat ... 458
Kapitulli XXIII: Afatet ... 459
Kapitulli XXIV: Shpenzimet e procedurës penale ... 460
Kapitulli XXV: Kërkesat pasurore juridike ... 463
Kapitulli XXVI: Marrja dhe komunikimi i vendimeve ... 467
Kapitulli XXVII: Dërgimi i shkresave ... 468
Kapitulli XXVIII: Ekzekutimi i vendimeve ... 472
Kapitulli XXIX: Dispozitat tjera ... 473
Pjesa e katërt: Procedurat e veçanta ... 474
Kapitulli XXX: Procedurat për dhënien e urdhrit ndëshkimor ... 474
Kapitulli XXXI: Shqiptimi i vërejtjes gjyqësore ... 475
Kapitulli XXXII: Procedura ndaj personave të cilët kanë kryer vepër penale nën ndikimin e alkoolit ose drogës ... 477
Kapitulli XXXIII: Procedura penale ku përfshihen kryerës me çrregullime mendor ... 478
Kapitulli XXXIV: Procedura për revokimin e dënimeve alternative ... 483
Kapitulli XXXV: Procedura për marrjen e vendimit për shlyerjen e dënimit nga evidenca ... 484
Kapitulli XXXVI: Procedura për kompensim dëmi, rehabilitim dhe për ushtrimin e të drejtave të tjera të personave të dënuar ose të arrestuar pa arsye ... 485
Kapitulli XXXVII: Procedura për dhënien e letërreshtimit dhe shpalljeve publike ... 489
Pjesa e gjashtë: Dispozitat kalimtare dhe përfundimtare ... 491
Kapitulli XXXVIII: Dispozitat kalimtare dhe përfundimtare ... 491

Kuvendi i Republikës së Kosovës;

Në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton

KODIN E PROCEDURËS PENALE

PJESA E PARË
DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

KAPITULLI I
PARIMET THEMELORE DHE PËRKUFIZIMET

Neni 1
Fushëveprimi i këtij Kodi

1. Me këtë Kod përcaktohen rregullat e procedurës penale të cilat janë të detyrueshme për punën e gjykatave, prokurorisë së shtetit si dhe të pjesëmarrësve të tjerë në procedurën penale të paraparë me këtë Kod.
2. Me këtë Kod caktohen rregullat që garantojnë se asnjë person i pafajshëm nuk do të dënohet, ndërsa dënimi ose sanksioni tjetër penal mund t'i shqiptohet vetëm personit i cili ka kryer vepër penale sipas kushteve të parapara me Kodin Penal dhe me ligjet tjera të Kosovës në bazë të të cilave janë paraparë veprat penale sipas procedurës së zbatuar në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme para gjykatës kompetente.
3. Para marrjes së aktgjykimit të formës së prerë, liritë dhe të drejtat tjera të të pandehurit mund të kufizohen vetëm sipas kushteve të përcaktuara në këtë Kod.

Neni 2
Shqiptimi i sanksionit penal nga gjykata e pavarur dhe e paanshme

Vetëm gjykata kompetente, e pavarur dhe e paanshme mund t'i shqiptojë sanksion penal kryerësit të veprës penale në procedurë të filluar dhe të zbatuar sipas këtij Kodi.

Neni 3
Prezumimi i pafajësisë së të pandehurit dhe *in dubio pro reo*

1. Çdo person i dyshuar ose që akuzohet për vepër penale konsiderohet i pafajshëm derisa të vërtetohet fajësia e tij me aktgjykim të formës së prerë të gjykatës.
2. Mëdyshjet lidhur me ekzistimin e fakteve të rëndësishme për çështjen ose për zbatimin e ndonjë dispozite të ligjit penal interpretohen në favor të të pandehurit dhe të drejtave të tij sipas këtij Kodi dhe sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Neni 4
Ne Bis in Idem

1. Askush nuk mund të ndiqet dhe të dënohet për vepër penale nëse është liruar ose për të cilën është dënuar me vendim të formës së prerë, përkatësisht nëse procedura penale kundër tij është pushuar me vendim të formës së prerë të gjykatës ose aktakuza është refuzuar me vendim të formës së prerë të gjykatës.
2. Me përjashtim të rasteve kur me këtë Kod është paraparë ndryshe, vendimi gjyqësor i formës së prerë mund të ndryshohet me mjete të jashtëzakonshme juridike vetëm në favor të personit të dënuar.
3. Nenet 1 dhe 2 të Kodit Penal zbatohen përshtatshmërisht.

Neni 5
Gjykimi i drejtë, i paanshëm dhe në afat të arsyeshëm

1. Çdo person i dyshuar ose i akuzuar për vepër penale ka të drejtë të kërkojë procedurë të paanshme penale të zbatuar në kohë të arsyeshme.
2. Gjykata detyrohet të kujdeset që procedura të zbatohet pa zvarritje dhe të pengohet çdo keqpërdorim i të drejtave që u përkasin pjesëmarrësve në procedurë.
3. Çdo heqje lirie, e sidomos kohëzgjatja e paraburgimit në procedurë penale, duhet zvogëluar në kohën sa më të shkurtër të mundshme.
4. Kushdo që është privuar nga liria me arrest menjëherë njoftohet në gjuhën që e kupton për arsyet e heqjes së lirisë. Kushdo që privohet nga liria pa urdhër të gjykatës sillet para gjyqtarit të gjykatës themelore në juridiksionin e arrestimit brenda dyzet e tetë (48) orëve. Gjyqtari vendos për caktimin e paraburgimit, në pajtim me Kapitullin X të këtij Kodi.

Neni 6
Fillimi i procedurës penale

1. Hetimet policore mund të fillohen nga zyrtari i policisë në pajtim me nenet 69-83.
2. Procedura penale fillohet vetëm me vendim të prokurorit të shtetit kur ekziston dyshim i bazuar se është kryer vepër penale
3. Prokurori i shtetit mund te filloje procedurën penale në pajtim me paragrafin 2. të këtij neni pas marrjes së informacionit nga policia, institucioni tjetër publik, institucioni privat, qytetari, media, nga informacioni i marrë në një procedurë tjetër penale ose pas ankimit ose propozimit të të dëmtuarit.

Neni 7
Detyrimi i përgjithshëm për vërtetimin e plotë dhe të saktë të fakteve

1. Gjykata, prokurori i shtetit dhe policia të cilët marrin pjesë në procedurën penale detyrohen që saktësisht dhe tërësisht t'i vërtetojnë faktet të cilat janë të rëndësishme për marrjen e vendimit të ligjshëm.
2. Sipas dispozitave të parapara me këtë Kod, gjykata, prokurori i shtetit dhe policia që marrin pjesë në procedurë penale detyrohen që me vëmendje dhe me përkushtim maksimal profesional dhe me përkujdesje të njëjtë të vërtetojnë faktet kundër të

pandehurit si dhe ato në favor të tij, dhe para fillimit të procedurës dhe gjatë zhvillimit të saj t'i mundësojnë të pandehurit dhe mbrojtësit të tij shfrytëzimin e të gjitha fakteve dhe provave që janë në favor të të pandehurit.

Neni 8
Parimi i pavarësisë së gjykatës

1. Gjykata në punën e saj është e pavarur dhe vendos në bazë të ligjit.
2. Gjykata merr vendim në bazë të provave që shqyrtohen dhe verifikohen në shqyrtim gjyqësor.

Neni 9
Barazia e palëve

1. Nëse me këtë Kod nuk parashihet ndryshe, i pandehuri dhe prokurori i shtetit në procedurë penale kanë pozitë të barabartë.
2. I pandehuri ka të drejtë të deklarohet dhe atij duhet t'i lejohet deklarimi për të gjitha faktet dhe provat që e ngarkojnë dhe t'i paraqesë të gjitha faktet dhe provat që janë në favor të tij. Ai ka të drejtë që të kërkojë nga prokurori i shtetit të thërret dëshmitarë në emër të tij. Ai ka të drejtë t'i marrë në pyetje dëshmitarët kundër tij dhe të kërkojë praninë dhe marrjen në pyetje të dëshmitarëve në favor të tij, në kushte të njëjta që vlejnë për dëshmitarët kundër tij.
3. I dëmtuari ka të drejtë dhe i lejohet të bëjë deklaratë për të gjitha faktet dhe provat që ndikojnë në të drejtat e tij dhe ka të drejtë për të bërë deklaratë mbi të gjitha faktet dhe provat. Ai ka të drejtë të marrë në pyetje dëshmitarët, t'u parashtrojë pyetje të tërthorta dëshmitarëve të palës tjetër dhe të kërkojë nga prokurori i shtetit që të thirren dëshmitarët.
4. Nëse prokurori i shtetit vlerëson se gjatë hetuesisë janë mbledhur prova të mjaftueshme për të vazhduar në shqyrtim gjyqësor, prokurori i shtetit harton aktakuzën dhe paraqet faktet mbi të cilat ai e bazon aktakuzën dhe siguron provat për këto fakte.

Neni 10
Njoftimi për shkaqet e akuzës, mos detyrimi për vetëfajësim dhe ndalesa kundër imponimit për pranim të fajit

1. Gjatë arrestimit të tij dhe marrjes në pyetje për herë të parë, i pandehuri menjëherë njoftohet në hollësi për llojin dhe shkaqet e akuzës kundër tij në gjuhën që ai e kupton.
2. I pandehuri nuk ka detyrim të paraqesë mbrojtjen e vet ose të përgjigjet në ndonjë pyetje, dhe nëse mbrohet, nuk është i detyruar të akuzojë vetveten ose të afërmit e tij e as të pranojë fajësinë. Kjo e drejtë nuk përfshin rastin kur i pandehuri hyn vullnetarisht në marrëveshje për të bashkëpunuar me prokurorin e shtetit.
3. Nga i pandehuri ose personi tjetër që merr pjesë në procedurë ndalohet dhe dënohet që të imponohet pranimi i fajësisë ose ndonjë deklarim tjetër me anë të torturës, forcës, kanosjes apo nën ndikimin e drogës ose të masave të tjera të ngjashme.

Neni 11
Përshtatshmëria e mbrojtjes

1. I pandehuri ka të drejtë në kohë të mjaftueshme për përgatitjen e mbrojtjes së tij.
2. I pandehuri ka të drejtë të mbrohet personalisht ose me ndihmën e mbrojtësit i cili është anëtar i Odës së Avokatëve të Kosovës, sipas zgjedhjes së tij.
3. Në qoftë se i pandehuri nuk angazhon mbrojtës për të siguruar mbrojtjen, kurse mbrojtja është e detyrueshme, të pandehurit i caktohet mbrojtës i pavarur me përvojë dhe me kompetencë në përputhje me llojin e veprës penale dhe sipas kushteve të parapara me këtë Kod.
4. Sipas kushteve të parapara me këtë Kod, të pandehurit i cili nuk mund t'i paguajë shpenzimet e mbrojtjes dhe për këtë arsye nuk mund të angazhojë mbrojtës, me kërkesë të tij i caktohet një mbrojtës i pavarur me përvojë dhe me kompetencë konform me llojin e veprës penale, që paguhet nga mjetet e buxhetit kur interesat e drejtësisë këtë e kërkojnë.
5. Gjykata ose organi kompetent i cili e drejton procedurën penale detyrohet ta njoftojë të pandehurin për të drejtën e tij në mbrojtës që nga marrja në pyetje për herë të pare, ashtu siç parashihet me këtë Kod.
6. Në pajtim me dispozitat e këtij Kodi, çdo person i privuar nga liria ka të drejtë në shërbimet e mbrojtësit që nga arresti e tutje.

Neni 12
Ligjshmëria e privimit nga liria dhe vendosja në procedurë të përshpejtuar

1. Askujt nuk mund t'i hiqet liria, përpos rasteve dhe në pajtim me procedurën e përcaktuar me ligj.
2. Çdo person i privuar nga liria me arrest ose me ndalim, sipas procedurës së paraparë me këtë Kod ka të drejtë të ndërmarrë masa sipas të cilave për ligjshmërinë e arrestimit ose ndalimit të tij vendos gjykata në procedurë të përshpejtuar ose urdhëron lirimin e tij kur ndalimi është i paligjshëm.

Neni 13
Të drejtat e personit të privuar nga liria

1. Çdo person i privuar nga liria menjëherë njoftohet në gjuhën që ai e kupton për:
   1.1. arsyet e arrestit të tij;
   1.2. të drejtën në mbrojtës sipas zgjedhjes së tij; dhe
   1.3. të drejtën që lidhur me arrestin të njoftojë ose të njoftohet anëtari i familjes ose personi tjetër përkatës sipas zgjedhjes së tij.
2. Personi i privuar nga liria me dyshim se ka kryer vepër penale të sjellet menjëherë para gjyqtarit dhe jo më vonë se brenda dyzet e tetë (48) orëve nga arresti, ndërsa ai ka të drejtë në gjykim brenda një kohe të arsyeshme ose të lirohet në pritje të gjykimit.
3. Personi i privuar nga liria gëzon të drejtat e parapara me këtë nen gjatë gjithë kohës së heqjes së lirisë. Këto të drejta mund të hiqen vetëm nëse heqja dorë bëhet me shkrim në mënyrë vullnetare pasi të jetë informuar më parë për të drejtat e tij.

Ushtrimi i këtyre të drejtave nuk varet as nga vendimi i mëparshëm i mundshëm i personit lidhur me heqjen dorë nga të drejtat e caktuara dhe as nga koha e njoftimit për këto të drejta.

Neni 14
Gjuhët dhe shkrimi

1. Gjuha dhe shkrimet që mund të përdoren në procedurë penale janë gjuha shqipe dhe serbe, përveç nëse parashihet ndryshe me ligj.
2. Personi që merr pjesë në procedurë penale i cili nuk e flet gjuhën në të cilën zhvillohet procedura, ka të drejtë të flasë gjuhën e vet dhe të jetë i informuar nëpërmjet përkthimit pa pagesë me faktet, provat dhe procedurën. Përkthimi sigurohet përmes një përkthyesi të pavarur.
3. Personi nga paragrafi 2. i këtij neni njoftohet për të drejtën e tij në përkthim. Ai mund të heqë dorë nga kjo e drejtë nëse e di gjuhën në të cilën zhvillohet procedura gjyqësore. Njoftimi për këtë të drejtë dhe deklarata e pjesëmarrësit shënohet në procesverbal.
4. Deklaratat, ankesat dhe parashtresat tjera mund të dorëzohen në gjykatë në gjuhën shqipe ose serbe, përveç nëse parashihet ndryshe me ligj.
5. Personit të arrestuar, të pandehurit që mbahet në paraburgim dhe personit që mban dënimin duhet siguruar përkthimin e thirrjeve gjyqësore, vendimeve dhe parashtresave në gjuhën të cilën ai e përdor në procedurë.
6. Shtetasi i huaj që ndodhet në paraburgim mund t'i dorëzojë gjykatës parashtresat në gjuhën e tij para, gjatë dhe pas shqyrtimit gjyqësor vetëm sipas kushteve të reciprocitetit.

Neni 15
E drejta në rehabilitim dhe kompensim

Çdo person i cili është dënuar, arrestuar, ndaluar ose paraburgosur në mënyrë të paligjshme ka të drejtë në rehabilitim të plotë, kompensim të drejtë nga mjetet buxhetore dhe në të drejta të tjera të parapara me ligj.

Neni 16
Detyrimi i gjykatës për të njoftuar palët

Gjykata detyrohet të njoftojë të pandehurin ose pjesëmarrësin tjetër në procedurë për të drejtat që i përkasin sipas këtij Kodi, si dhe për pasojat e mosveprimit të tij nëse ai, për shkak të mosdijes, nuk ndërmerr veprimin e duhur në procedurë ose i nuk shfrytëzon të drejtat e tij.

Neni 17
Kohëzgjatja e pasojave që kufizojnë të drejtat

Kur dihet se fillimi i procedurës penale ka për pasojë kufizimin e disa të drejtave të caktuara dhe kur procedura penale zhvillohet për ndonjë vepër penale për të cilën është

paraparë dënimi me më shumë se tre vjet burgim, pasoja e tillë hyn në fuqi nga momenti i hyrjes në fuqi të aktakuzës, po qe se me ligj nuk është përcaktuar ndryshe. Nëse procedura penale zhvillohet për ndonjë vepër penale për të cilën është paraparë dënim me gjobë ose dënim me burgim deri në tre (3) vjet, pasoja e tillë hyn në fuqi nga dita kur aktgjykimi dënues merr formë të prerë, përveç nëse përcaktohet ndryshe me ligj.

Neni 18
Çështjet prejudikuese

1. Në qoftë se zbatimi i ligjit penal varet nga një vendim paraprak nga gjykata në ndonjë procedurë tjetër e cila është duke u zhvilluar apo nga organi tjetër publik, gjykata e cila ka kompetencë në çështjen penale vetë mund të marrë vendim për çështjen e tillë në pajtim me dispozitat e zbatueshme për provat në procedurë penale. Vendimi i tillë zbatohet vetëm për atë çështje penale që është duke u gjykuar nga kjo gjykatë.
2. Kur gjykata në ndonjë procedurë tjetër ose organi tjetër publik ka marrë një vendim mbi një çështje paraprake të këtij lloji, vendimi i tillë nuk është detyrues për gjykatën e cila gjykon çështjen penale për të vendosur nëse është kryer vepër penale.

Neni 19
Përkufizimet

1. Shprehjet e përdorura në këtë Kod të Procedurës Penale kanë këto kuptime:
   1.1. **Zyrtari i autorizuar i policisë –** zyrtari i policisë apo cilido pjestar i Policisë së Kosovës apo pjestari i ndonjë shërbimi tjetër të autorizuar për të zhvilluar hetime penale ose për të ekzekutuar vendimin e prokurorit të shtetit apo të gjykatës.
   1.2. **Çështje e ndërlikuar -** Çdo vepër penale që përfshin por nuk kufizohet në më shumë se dhjetë të pandehur, aktivitet të organizuar kriminal, korrupsion, ose hetimi i së cilës kërkon prova të shumta mjeko-ligjore, analiza kontabiliteti ose bashkëpunim ndërkombëtar. Një rast i ndërlikuar do të ishte një procedurë penale në të cilën hetohet apo gjykohet një rast i ndërlikuar.
   1.3. **I dyshuar -** personi për të cilin policia ose prokurori i shtetit dyshojnë se ka kryer vepër penale, por ndaj të cilit nuk është filluar hetim.
   1.4. **I pandehur -** personi kundër të cilit zbatohet procedura penale. Shprehja "i pandehur" po ashtu përdoret në këtë Kod edhe si shprehje e përgjithshme për të "pandehurin", "akuzuarin" dhe "personin e dënuar".
   1.5. **I akuzuar -** personi kundër të cilit është paraqitur aktakuza dhe është caktuar shqyrtimi gjyqësor.
   1.6. **Person i dënuar -** personi i cili me aktgjykim të formës së prerë të gjykatës është shpallur fajtor për kryerjen e veprës penale.
   1.7. **I dëmtuar ose viktima -** personi të cilit çfarëdo e drejte personale ose pasurore i është shkelur ose i është rrezikuar me veprën penale.
   1.8. **Dyshim i arsyeshëm -** njohuri për informacionin që do të bindte një

vëzhgues objektiv që një vepër penale ka ndodhur, po ndodh ose ka mundësi të konsiderueshme që do të ndodhë dhe se personi në fjalë mund të kryejë ose mund të ketë kryer veprën penale. Se çfarë mund të konsiderohet si "e arsyeshme" do të varet nga të gjitha rrethanat.

1.9. **Dyshim i bazuar -** njohuri për informacionin që do të bindte një vëzhgues objektiv që një vepër penale ka ndodhur, po ndodh ose ka mundësi të konsiderueshme që do të ndodhë dhe se personi në fjalë ka më shumë gjasa që të ketë kryer veprën penale se sa që të mos e ketë kryer atë. Dyshimi i bazuar duhet të mbështetet në prova të artikulueshme.

1.10. **Shkak i bazuar -** njohuri për informacionin që do të bind një vëzhgues objektiv që një vepër penale ka ndodhur, po ndodh ose ka mundësi të konsiderueshme që do të ndodhë dhe se personi në fjalë ka gjasë të konsiderueshme të ketë kryer veprën penale. Shkaku i bazuar duhet të mbështetet në prova të artikulueshme.

1.11. **Gjasa reale -** baza për urdhër për kontroll ose për të justifikuar ndërhyrjen e qeverisë në privatësinë e ndonjë personi. Posedimi i provave të pranueshme që do të bindte një vëzhgues objektiv që një vepër penale ka ndodhur, po ndodh ose ka mundësi të konsiderueshme që do të ndodhë dhe se personi në fjalë ka gjasë të konsiderueshme të ketë kryer veprën penale.

1.12. **Dyshimi i bazuar mirë -** nënkupton ngritjen e aktakuzës. Posedimi i provave të pranueshme që do të bindte një vëzhgues objektiv që një vepër penale ka ndodhur dhe që është kryer nga i pandehuri.

1.13. **Kompensimi -** kompensimi i dëmeve nga personi i dënuar. Në fund të një procedure penale gjykata urdhëron të pandehurin i cili është shpallur fajtor për një vepër penale që të kompensojë të dëmtuarin apo të dëmtuarit për dëmet që rezultojnë drejtpërdrejt apo në mënyrë të tërthortë nga vepra penale.

1.14. **Dëmi -** dëmi që drejtpërdrejt apo në mënyrë të tërthortë rezulton nga një veprim kriminal, duke përfshirë humbjen e pronës, humbjen e fitimit, heqjen e lirisë, dëmtimin fizik, dëmtimin psikik apo humbjen e jetës së bashkëshortit ose anëtarit të familjes së afërme. Shuma e dëmit do të vërtetohet nga përfaqësuesi i të dëmtuarit, mbrojtësi i viktimave apo prokurori i shtetit. Gjykata mund të urdhërojë pagesën e dëmit bazuar në një vlerësim të arsyeshëm të vlerës monetare të dëmit të drejtpërdrejtë ose të shkaktuar në mënyrë të tërthortë si pasojë e veprës penale.

1.15. **Palë në procedure -** prokurori i shtetit, i pandehuri dhe i dëmtuari. I pandehuri nuk konsiderohet palë sipas nenit 392, të Kodit Penal të Kosovës.

1.16. **Fëmijë –** person që është nën moshën tetëmbëdhjetë vjet (18) , në pajtim me Kodin e Drejtësisë për të Mitur.

1.17. **I mitur -** person që është i moshës mes katërmbëdhjetë (14) dhe tetëmbëdhjetë (18) vjet, në pajtim me Kodin e Drejtësisë për të Mitur,

1.18. **Organi publik -** një organ i Qeverisë së Republikës së Kosovës ose një organ njëjtë i autorizuar për të vepruar sipas Ligjit për Policinë apo Ligjit për Kompetencat, Përzgjedhjen e Rasteve dhe Caktimin e Lëndëve të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve të EULEX-it në Kosovë.

1.19. **Kontroll intim -** kontrolli i cili përbëhet nga kontrolli fizik i zgavrave të trupit të personit, pos gojës.

1.20. **Gjyqtari kompetent -** gjyqtari i cili sipas këtij kodi ka përgjegjësi për çështjen në fjalë. Në shumicën e rrethanave, ky do të jetë gjyqtari që mbikëqyrë fazën e procedurës penale.

1.21. **Kolegji shqyrtues –** kolegji i përbërë prej tre gjyqtarësh i cili formohet nga departamenti i njëjtë ose nga gjykata themelore për të shqyrtuar dhe gjykuar një kundërshtim kundër urdhrit të gjyqtarit të procedurës paraprake.

1.22. **Trupi gjykues -** trupi i përbërë prej kryetarit të trupit gjykues dhe dy gjyqtarëve profesional të cilën shqyrtojnë provat dhe gjykojnë gjatë shqyrtimit gjyqësor.

1.23. **Gjyqtari i procedurës paraprake -** gjyqtari i cili është caktuar në fazën e hetimit.

1.24. **Kryetari i trupit gjykues -** gjyqtari në departamentin e krimeve të rënda të gjykatës themelore i cili pranon aktakuzën, merr vendim për të gjitha propozimet paraprake dhe të provave në shqyrtimin fillestar dhe shqyrtimin e dytë, dhe kryeson trupin gjykues që gjykon në shqyrtimin gjyqësor.

1.25. **Gjyqtari i vetëm gjykues** - gjyqtari në departamentin e përgjithshëm të gjykatës themelore i cili pranon aktakuzën, merr vendim për të gjitha propozimet paraprake dhe të provave në shqyrtimin fillestar dhe shqyrtimin e dytë, dhe gjykon në shqyrtim gjyqësor.

1.26. **Fondi për kompensim të viktimave -** fond në të cilin depozitohen mjetet nga konfiskimi i dorëzanisë dhe pasurive tjera të autorizuara më ligj. Pagesat nga fondi për kompensim të viktimave përdoren për kompensimin e viktimave të krimit, siç caktohet me ligj.

1.27. **Përmbledhja, transkripti, regjistrimi -** tri lloje të procesverbaleve. Përmbledhja është një përshkrim i saktë i asaj se çfarë ka thënë një person. Transkripti është regjistrim fjalë për fjalë i asaj çfarë ka thënë një person. Regjistrimi mund të jetë regjistrim audio apo video me anë të mjeteve elektronike që mundëson përsëritjen e saktë të fjalëve që ka thënë një person.

1.28. **Mbrojtësi kryesor -** kur një palë përfaqësohet nga më shumë se një mbrojtës, një dhe vetëm një mbrojtës përfaqëson palën para gjykatës ose gjatë procedurave penale. Kur mbrojtësit kryesor i dorëzohen dokumentet, përfshirë aktakuzat, kërkesat, përgjigjet, ankesat dhe dokumentet tjera të cilat duhet t'i zbulohen të pandehurit, konsiderohet se dorëzimi u është bërë të gjithë mbrojtësve që përfaqësojnë palën.

1.29. **Thelbësisht të pambështetshme -** prova apo informata është thelbësisht e pambështetshme nëse origjina e provës apo informatës është e panjohur, bazohet në thashetheme apo në dukje të parë prova apo informata është e pamundshme ose e pabesueshme.

1.30. **Artikulueshëm -** kur informata apo prova duhet të jetë e artikulueshme, pala e cila paraqet informacionin apo provën duhet të specifikojë në detaje informatën apo provën në të cilën mbështetet.

1.31. **Mbështetje e pohimit -** dokument i paraqitur nga pala në mbështetje të dëshmisë apo provës që nuk është drejtpërdrejtë e arritshme në shqyrtim gjyqësor. Mbështetja e pohimit cakton prova tjera të pranishme që mbështesin dëshminë apo provën në fjalë. Mbështetja e pohimit ka për qëllim të tregojë se prova në fjalë nuk do të ishte prova e vetme apo vendimtare në mbështetje të aktgjykimit me të cilin i pandehuri shpallet fajtor.

1.32. **Policia apo zyrtari policor** – cilido pjesëtar i Policisë së Kosovës apo shërbimit tjetër të autorizuar për zbatimin e hetimit penal.

KAPITULLI II
KOMPETENCA E GJYKATAVE

1. KOMPETENCA LËNDORE DHE PËRBËRJA E GJYKATËS

Neni 20
Kompetenca e gjykatave

1. Kompetenca lëndore dhe kompetenca territoriale e gjykatës themelore për procedurë penale përcaktohet në nenin 11 të Ligjit për Gjykatat, Ligji nr. 03/L-199, ose me ligjin pasues.
2. Kompetenca lëndore e Gjykatës së Apelit për procedurë penale përcaktohet në nenin 18 të Ligjit për Gjykatat, Ligji nr. 03/L-199.
3. Kompetenca lëndore e Gjykatës Supreme për procedurë penale përcaktohet në nenin 22 të Ligjit për Gjykatat, Ligji nr. 03/L-199, ose me ligjin pasues.
4. Kompetenca lëndore dhe procedura e Gjykatës Kushtetuese për procedurë penale sipas nenit 113, paragrafi 7 i Kushtetutës përcaktohet në nenet 46-50 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Ligji Nr. 03/L-121, ose me ligjin pasues.

Neni 21
Caktimi i lëndëve brenda gjykatave

1. Procedura penale zhvillon dhe çështjen e gjykon në shkallë të parë në Departamentin e Përgjithshëm, Departamentin e Krimeve të Rënda apo ndonjë Divizion apo Departament të themeluar sipas nenit 8 të Ligjit për Gjykatat që ka juridiksion mbi veprat penale.
2. Kur një fëmijë është i pandehur në një rast penal, ai rast do të ndahet nga çdo rast tjetër dhe do të shqyrtohet vetëm nga Departamenti për të Miturit në kuadër të Gjykatës Themelore, sipas Kodit të Drejtësisë për të Mitur, nr. 03/L-193 apo ligjit pasues.
3. Departamenti i Përgjithshëm i Gjykatës Themelore zhvillon dhe çështjen e gjykon në të gjitha procedurat penale që nuk janë brenda juridiksionit të Departamentit për Krime të Rënda, Departamentit për të Miturit ose ndonjë Divizionit apo Departamentit të themeluar sipas nenit 8 të Ligjit për Gjykatat që ka juridiksion mbi veprat penale.
4. Departamenti i Krimeve të Rënda i Gjykatës Themelore zhvillon dhe çështjen e gjykon në çfarëdo procedure penale ku prokurori i shtetit pretendon apo ka ngritur akuzë për një ose më shumë vepra të mundshme penale sipas nenit 15 të Ligjit për Gjykatat në përgjithësi, dhe veçanërisht ato vepra penale të cekura në nenin 22.
5. Ndaj aktgjykimit të gjykatës themelore nuk mund të ushtrohet ankesë për arsye procedurale nëse ankuesi nuk e ka kundërshtuar në gjykatë themelore vendimin ligjor ose faktik mbi të cilin bazohet ankesa, përveç nëse ankuesi mund të demonstrojë rrethana të jashtëzakonshme që arsyetojnë një ankesë të tillë.

Neni 22
Veprat penale që konsiderohen krime të rënda për qëllime të këtij Kodi

1. Për qëllime të këtij Kodi, nenet në vijim të Kodit Penal konsiderohen krime të rënda në pajtim me nenin 15 të Ligjit për Gjykatat, Ligji nr. 03/L-199;
   1.1. Sulmi kundër rendit kushtetues të Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 121 të Kodit Penal;
   1.2. Kryengritja e armatosur, në pajtim me nenin 122 të Kodit Penal;
   1.3. Pranimi i kapitullimit dhe okupimit, në pajtim me nenin 123 të Kodit Penal;
   1.4. Tradhëtia ndaj vendit, në pajtim me nenin 124 të Kodit Penal;
   1.5. Rrezikimi i tërësisë territoriale të Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 125 të Kodit Penal;
   1.6. Vrasja e përfaqësuesve të lartë të Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 126 të Kodit Penal;
   1.7. Rrëmbimi i përfaqësuesve të lartë të Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 127 të Kodit Penal;
   1.8. Dhuna ndaj përfaqësuesve të lartë të Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 128 të Kodit Penal;
   1.9. Rrezikimi i rendit kushtetues me shkatërrimin apo dëmtimin e instalimeve dhe pajisjeve publike, në pajtim me nenin 129 të Kodit Penal;
   1.10. Sabotimi, në pajtim me nenin 130 të Kodit Penal;
   1.11. Spiunazhi, në pajtim me nenin 131 të Kodit Penal;
   1.12. Zbulimi i informacioneve të klasifikuara dhe mosruajtja e informacioneve të klasifikuara, në pajtim me nenin 132 të Kodit Penal;
   1.13. Veprat e rënda kundër rendit kushtetues dhe sigurisë së Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 133 të Kodit Penal;
   1.14. Bashkimi për veprimtari kundër kushtetuese, në pajtim me nenin 134 të Kodit Penal;
   1.15. Kryerja e veprës terroriste, në pajtim me nenin 136 të Kodit Penal;
   1.16. Ndihma në kryerjen e terrorizmit, në pajtim me nenin 137 të Kodit Penal;
   1.17. Lehtësimi në kryerjen e terrorizmit, në pajtim me nenin 138 të Kodit Penal;
   1.18. Rekrutimi për terrorizëm, në pajtim me nenin 139 të Kodit Penal;
   1.19. Trajnimi për terrorizëm, në pajtim me nenin 140 të Kodit Penal;
   1.20. Shtytja për kryerjen e veprave terroriste, në pajtim me nenin 141 të Kodit Penal;
   1.21. Fshehja ose moslajmërimi i terroristëve dhe grupeve terroriste, në pajtim me nenin 142 të Kodit Penal;
   1.22. Organizimi dhe pjesëmarrja në grup terrorist, në pajtim me nenin 143 të Kodit Penal;
   1.23. Përgatitja e veprave terroriste ose veprave penale kundër rendit kushtetues dhe sigurisë së Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 144 të Kodit Penal;
   1.24. Gjenocidi, në pajtim me nenin 148 të Kodit Penal;
   1.25. Krimet kundër njerëzimit, në pajtim me nenin 149 të Kodit Penal;
   1.26. Krimet e luftës në shkelje të rëndë të konventave të Gjenevës, në pajtim me nenin 150 të Kodit Penal;

1.27. Krimet e luftës në shkelje të rëndë të ligjeve dhe zakoneve që zbatohen në konfliktin e armatosur ndërkombëtar, në pajtim me nenin 151 të Kodit Penal;
1.28. Krimet e luftës në shkelje të rëndë të nenit 3 të përbashkët të konventave të Gjenevës, në pajtim me nenin 152 të Kodit Penal;
1.29. Krimet e luftës në shkelje të rëndë të ligjeve dhe zakoneve që zbatohen në konfliktet e armatosura që nuk janë të karakterit ndërkombëtar, në pajtim me nenin 153 të Kodit Penal;
1.30. Sulmet në konfliktet e armatosura që nuk kanë karakter ndërkombëtar kundër instalimeve që përmbajnë forca të rrezikshme, në pajtim me nenin 154 të Kodit Penal;
1.31. Rekrutimi ose regjistrimi i personave midis moshës pesëmbëdhjetë (15) dhe tetëmbëdhjetë vjet (18) në konfliktin e armatosur, në pajtim me nenin 155 të Kodit Penal;
1.32. Përdorimi i mjeteve ose i metodave të ndaluara të luftimit, në pajtim me nenin 156 të Kodit Penal;
1.33. Shtyrja e paarsyeshme e riatdhesimit të robërve të luftës ose e civilëve, në pajtim me nenin 157 të Kodit Penal;
1.34. Përvetësimi i kundërligjshëm i sendeve nga të vrarët ose të plagosurit në fushëbetejë, në pajtim me nenin 158 të Kodit Penal;
1.35. Rrezikimi i negociatorëve, në pajtim me nenin 159 të Kodit Penal;
1.36. Organizimi i grupeve për kryerjen e gjenocidit, krimeve kundër njerëzimit dhe krimeve të luftës, në pajtim me nenin 160 të Kodit Penal;
1.37. Shtytja për luftë agresive ose konflikt të armatosur, në pajtim me nenin 162 të Kodit Penal;
1.38. Keqpërdorimi i emblemave ndërkombëtare, në pajtim me nenin 163 të Kodit Penal;
1.39. Rrëmbimi i fluturakes, në pajtim me nenin 164 të Kodit Penal;
1.40. Rrezikimi i sigurisë së aviacionit civil, në pajtim me nenin 165 të Kodit Penal;
1.41. Rrezikimi i sigurisë së lundrimit detar, në pajtim me nenin 166 të Kodit Penal;
1.42. Rrezikimi i sigurisë së platformave fikse të vendosura në pragun kontinental, në pajtim me nenin 167 të Kodit Penal;
1.43. Piratëria, në pajtim me nenin 168 të Kodit Penal;
1.44. Skllavëria, kushtet e ngjashme me skllavërinë dhe puna e detyruar, në pajtim me nenin 169 të Kodit Penal;
1.45. Kontrabandimi me migrantë, në pajtim me nenin 170 të Kodit Penal;
1.46. Trafikimi me njerëz, në pajtim me nenin 171 të Kodit Penal;
1.47. Shërbimet seksuale të viktimës së trafikimit, në pajtim me nenin 231 të Kodit Penal;
1.48. Rrezikimi i personave nën mbrojtje ndërkombëtare, në pajtim me nenin 173 të Kodit Penal;
1.49. Rrezikimi i personelit të Kombeve të Bashkuara dhe i personelit në marrëdhënie me to, në pajtim me nenin 174 të Kodit Penal;
1.50. Marrja e pengjeve, në pajtim me nenin 175 të Kodit Penal;
1.51. Përvetësimi i paligjshëm, shfrytëzimi, transferi dhe vendosja e materialeve nukleare, në pajtim me nenin 176 të Kodit Penal;

1.52. Kanosja për përdorimin ose kryerjen e vjedhjes apo të grabitjes së materialit nuklear, në pajtim me nenin 177 të Kodit Penal;
1.53. Vrasja e rëndë, në pajtim me nenin 179 të Kodit Penal;
1.54. Rrëmbimi, në pajtim me nenin 194 të Kodit Penal;
1.55. Tortura, në pajtim me nenin 199 të Kodit Penal;
1.56. Cënimi i së drejtës për të kandiduar, në pajtim me nenin 210 të Kodit Penal;
1.57. Kanosja e kandidatit, në pajtim me nenin 211 të Kodit Penal;
1.58. Parandalimi i ushtrimit të së drejtës për të votuar, në pajtim me nenin 212 të Kodit Penal;
1.59. Cënimi i përcaktimit të lirë të votuesve, në pajtim me nenin 213 të Kodit Penal;
1.60. Keqpërdorimi i detyrës zyrtare gjatë zgjedhjeve, në pajtim me nenin 214 të Kodit Penal;
1.61. Dhënia ose marrja e ryshfetit në lidhje me votimin, në pajtim me nenn 215 të Kodit Penal;
1.62. Keqpërdorimi i të drejtës së votimit, në pajtim me nenin 216 të Kodit Penal;
1.63. Pengimi i procesit të votimit, në pajtim me nenin 217 të Kodit Penal;
1.64. Cënimi i fshehtësisë së votimit, në pajtim me nenin 218 të Kodit Penal;
1.65. Falsifikimi i rezultateve të votimit, në pajtim me nenin 219 të Kodit Penal;
1.66. Asgjësimi i dokumenteve të votimit, në pajtim me nenin 220 të Kodit Penal;
1.67. Dhunimi, në pajtim me nenin 230 të Kodit Penal;
1.68. Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge, në pajtim me nenin 273 të Kodit Penal;
1.69. Prodhimi dhe përpunimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope, analoge apo veglave, pajisjeve apo materialeve narkotike, në pajtim me nenin 274 të Kodit Penal;
1.70. Kultivimi i bimës së hashashit, shkurres së kokainës ose bimëve të kanabisit, në pajtim me nenin 278 të Kodit Penal;
1.71. Organizimi, drejtimi apo financimi i trafikimit të narkotikëve apo substancave psikotrope, në pajtim me nenin 279 të Kodit Penal;
1.72. Falsifikimi i parasë, në pajtim me nenin 302 të Kodit Penal;
1.73. Falsifikimi i letrave me vlerë dhe instrumenteve të pagesës, në pajtim me nenin 293 të Kodit Penal;
1.74. Pjesëmarrja ose organizimi i grupit kriminal të organizuar, në pajtim me nenin 283 të Kodit Penal;
1.75. Armëmbajtja pa leje në pajtim me nenin 374 të Kodit Penal;
1.76. Frikësimi gjatë procedurës penale për krimin e organizuar, në pajtim me nenin 395 të Kodit Penal;
1.77. Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar, në pajtim me nenin 422 të Kodit Penal;
1.78. Keqpërdorimi i informatës zyrtare, në pajtim me nenin 423 të Kodit Penal;
1.79. Konflikti i interesit, në pajtim me nenin 424 të Kodit Penal;
1.80. Përvetësimi në detyrë, në pajtim me nenin 425 të Kodit Penal;
1.81. Mashtrimi në detyrë, në pajtim me nenin 426 të Kodit Penal;
1.82. Përdorimi i paautorizuar i pasurisë, në pajtim me nenin 427 të Kodit Penal;
1.83. Marrja e ryshfetit, në pajtim me nenin 428 të Kodit Penal;

1.84. Dhënia e ryshfetit, në pajtim me nenin 429 të Kodit Penal;
1.85. Dhënia e ryshfetit zyrtarit publik të huaj, në pajtim me nenin 430 të Kodit Penal;
1.86. Ushtrimi i ndikimit, në pajtim me nenin 431 të Kodit Penal;
1.87. Nxjerrja e kundërligjshme e vendimeve gjyqësore, në pajtim me nenin 432 të Kodit Penal;
1.88. Zbulimi i fshehtësisë zyrtare, në pajtim me nenin 433 të Kodit Penal;
1.89. Falsifikimi i dokumentit zyrtar, në pajtim me nenin 434 të Kodit Penal;
1.90. Arkëtimi dhe pagesa e kundërligjshme, në pajtim me nenin 435 të Kodit Penal;
1.91. Përvetësimi i kundërligjshëm i pasurisë me rastin e bastisjes apo ekzekutimit të vendimit gjyqësor, në pajtim me nenin 436 të Kodit Penal;

Neni 23
Gjyqtari i procedurës paraprake

1. Gjykata themelore do të mbikëqyr hetimet penale duke caktuar, nëpërmjet një procesi transparent e të drejtë për caktimin e çështjeve, një gjyqtar profesional nga departamenti i duhur për të shërbyer si gjyqtar i procedurës paraprake.
2. Gjyqtari i procedurës paraprake mbikëqyr procedurën penale gjatë fazës së hetimit. Me paraqitjen e aktakuzës, gjyqtari i procedurës paraprake nuk ka më kompetencë mbi të pandehurit e përmendur në aktakuzë.
3. Gjyqtari i procedurës paraprake është kompetent për të pranuar kërkesat nga prokurori i shtetit, i pandehuri, mbrojtësi i viktimave dhe i dëmtuari dhe të nxjerr vendime dhe urdhra bazuar mbi këto kërkesa, në pajtim me këtë Kod.
4. Gjyqtari i procedurës paraprake është kompetent për të përcaktuar në mënyrë të pavarur nëse shqiptimi apo vazhdimi i privimit të lirisë së të pandehurit është proceduralisht apo kushtetutshmërisht i lejuar. Gjyqtari i procedurës paraprake ka për detyrë që të urdhërojë lirimin e të pandehurit, heqja e lirisë të së cilit nuk është proceduralisht apo kushtetutshmërisht e lejuar.

Neni 24
Urdhrat dhe vendimet e gjyqtarit të procedurës paraprake

1. Gjyqtari i procedurës paraprake në Departamentin e Përgjithshëm apo në Departamentin e Krimeve të Rënda është kompetent për të nxjerr vendime apo urdhra siç parashihet me këtë Kod.
2. Urdhrat e gjyqtarit të procedurës paraprake në Departamentin e Përgjithshëm apo në Departamentin e Krimeve të Rënda mund të shqyrtohen nga kolegji shqyrtues i të njëjtit departament të asaj gjykate pas paraqitjes së kundërshtimit nga palët. Nëse nuk ka numër të mjaftueshëm të gjyqtarëve, kryetari i gjykatës mund të caktojë gjyqtarët nga ndonjë departament tjetër për të shërbyer në kolegjin shqyrtues.
3. Vendimi i gjyqtarit të procedurës paraprake mund të shqyrtohet pas ankesës së paraqitur në Gjykatën e Apelit.
4. Çdo urdhër i gjyqtarit të procedurës paraprake që prek të drejtat e të dëmtuarit mund të shqyrtohet nga kolegji shqyrtues i gjykatës themelore sipas paragrafit 2. të

këtij neni brenda dyzet e tetë (48) orëve nga paraqitja e kundërshtimit. Prokurori i shtetit, mbrojtësi i viktimave mund të kërkojnë shqyrtimin e urdhrit të gjyqtarit të procedurës paraprake në emër të të dëmtuarit apo vetë i dëmtuari.

5. Afati për paraqitjen e kundërshtimeve kundër urdhrave të gjyqtarit të procedurës paraprake apo të kolegjit shqyrtues është dyzet e tetë (48) orë nga momenti kur pala pranon urdhrin, në pajtim me nenin 378.
6. Afati për paraqitje të ankesave kundër vendimeve të gjyqtarit të procedurës paraprake apo të kolegjit shqyrtues është pesë (5) ditë prej kur pala e pranon vendimin, në pajtim me nenin 378 të këtij Kodi.

Neni 25
Gjyqtari i vetëm gjykues, kryetari i trupit gjykues dhe trupi gjykues

1. Me dorëzimin e aktakuzës nga prokurori i shtetit në Gjykatën Themelore, një gjyqtar i vetëm ose një kolegj gjyqtarësh me kryetarin e tij nga departamenti përkatës caktohet, nëpërmjet një procesi transparent e të drejtë për caktimin e çështjeve, për të gjykuar çështjen.
2. Në procedurën penale në kuadër të Departamentit të Përgjithshëm të Gjykatës Themelore, rasti vendoset nga gjyqtari profesional i cili shërben si gjyqtar i vetëm gjykues.
3. Në procedurën penale në kuadër të Departamentit të Krimeve të Rënda të Gjykatës Themelore, aktgjykimi merret nga tre (3) gjyqtarë profesional, njëri nga të cilët kryeson trupin gjykues.

Neni 26
Vendimet para shqyrtimit gjyqësor

1. Pas ngritjes së aktakuzës nga prokurori i shtetit në gjykatën themelore, gjyqtari i vetëm gjykues apo kryetari i trupit gjykues mban shqyrtimin fillestar dhe shqyrtimin e dytë, merr vendim mbi kërkesat për hudhje të aktakuzës, merr vendim mbi kërkesat për të përjashtuar dëshmitë, dhe merr vendim mbi kërkesën për caktim të paraburgimit apo masat tjera për të siguruar praninë e të pandehurit.
2. Shqyrtimi gjyqësor mbahet nga gjyqtari i vetëm gjykues apo nga trupi gjykues, siç përcaktohet me këtë Kod.

Neni 27
Procedura për të mitur

Procedura kur të miturit janë kryes, ose fëmijët janë viktima dhe dëshmitarë rregullohet me Kodin e Drejtësisë për të Mitur ose Ligjin përkatës.

Neni 28
Kolegjet gjyqësore gjatë ankesave

1. Gjykata e Apelit gjykon mbi ankesat penale në kolegj prej tre (3) gjyqtarësh.
2. Gjykata Supreme gjykon mbi ankesat penale në kolegj prej tre (3) gjyqtarësh.

2. KOMPETENCA TERRITORIALE

Neni 29
Caktimi i kompetencës territoriale

1. Kompetenca territoriale në parim i jepet gjykatës themelore, brenda territorit të së cilës është kryer ose është tentuar vepra penale ose brenda territorit ku është shkaktuar pasoja.
2. Kur një vepër penale është kryer ose është tentuar të kryhet apo pasojat e saj janë shkaktuar në territorin e më shumë se një gjykate ose në kufijtë e atyre territoreve, kompetente është ajo gjykatë e cila e para e ka filluar procedurën gjyqësore si përgjigje në kërkesën e prokurorit të autorizuar, por nëse procedura nuk është filluar, atëherë kompetente është gjykata në të cilën së pari është dorëzuar kërkesa për fillimin e procedurës.
3. Në rast se me ligj themelohet ndonjë departament i gjykatës themelore që ka kompetencë për hetimin dhe gjykimin e veprave të caktuara penale, departamenti i tillë do të ketë kompetencë mbi të gjitha procedurat penale për veprat e tilla penale.

Neni 30
Kompetenca territoriale për veprat penale të kryera në aeroplan

Nëse vepra penale kryhet në aeroplan, kompetente do të jetë Gjykata Themelore në Prishtinë.

Neni 31
Kompetenca territoriale për veprat penale të kryera përmes mediave

1. Në qoftë se një vepër penale është kryer nëpërmjet gazetës, kompetente është gjykata në territorin e së cilës është shtypur gazeta. Po qe se ky vend nuk dihet ose gazeta është shtypur në botën e jashtme, kompetente është gjykata në territorin e së cilës shpërndahet informacioni i shtypur.
2. Në qoftë se sipas ligjit përgjigjet autori i materialit të publikuar, kompetente është gjykata e vendit në të cilin autori ka vendbanimin e përhershëm ose gjykata në territorin e së cilës është zhvilluar ngjarja që ndërlidhet me materialin e publikuar.
3. Paragrafët 1. dhe 2. të këtij neni zbatohen përshtatshmërisht në rastin kur materiali është shpallur nëpërmjet radios, televizionit ose ndonjë lloji tjetër të publikimit.

Neni 32
Kriteret dytësore të kompetencës

1. Në qoftë se nuk dihet territori i përshkruar në paragrafin .1 të nenit 29 të këtij Kodi ose kur ky vend nuk është në territorin e Kosovës, kompetente është gjykata në territorin e së cilës i pandehuri e ka vendbanimin ose vendqëndrimin.
2. Në qoftë se gjykata në territorin e së cilës i pandehuri e ka vendbanimin ose vendqëndrimin e ka filluar procedurën, gjykata mbetet kompetente edhe nëse është mësuar vendi i kryerjes së veprës penale.

3. Në qoftë se nuk dihet vendi i kryerjes së veprës penale, as vendbanimi apo vendqëndrimi i të pandehurit ose nëse të dyja janë jashtë territorit të Kosovës, kompetente është gjykata në territorin e së cilës arrestohet i pandehuri ose në territorin e së cilës i pandehuri vetë u dorëzohet organeve.

Neni 33
Kompetenca për veprat penale ndërkufitare

Në qoftë se një person kryen vepër penale në Kosovë dhe jashtë saj, kompetenca bie mbi gjykatën e cila është kompetente për veprën penale të kryer në Kosovë.

Neni 34
Kompetenca territoriale e urdhëruar nga Gjykata Supreme

Në qoftë se sipas dispozitave të këtij Kodi nuk mund të vërtetohet se cila gjykatë ka kompetencë territoriale, Gjykata Supreme e Kosovës cakton njërën nga gjykatat me kompetencë lëndore në të cilën do të zbatohet procedura.

3. BASHKIMI I PROCEDURËS

Neni 35
Kompetenca territoriale lidhur me bashkimin e procedurës

1. Kur personi i njëjtë fajësohet për më shumë vepra penale të peshës së njëjtë, kompetente është gjykata në të cilën së pari është ngritur aktakuza, ndërsa, kur nuk është paraqitur aktakuzë, kompetente është gjykata, të cilës së pari i është dorëzuar aktvendimi i vulosur i hetimeve.
2. Kur i dëmtuari njëkohësisht ka kryer vepër penale ndaj të pandehurit, gjithashtu zhvillohet procedurë e përbashkët.
3. Në parim të bashkëpandehurit i nënshtrohen kompetencës së gjykatës, e cila ka kompetencë për njërin pre tyre dhe në të cilën së pari është ngritur aktakuza.
4. Në parim gjykata e cila është kompetente për kryerësin e veprës penale është kompetente edhe për bashkëkryerësit dhe ndihmësit, pas kryerjes së veprës penale dhe për personat të cilët nuk kanë njoftuar për përgatitjen e veprës, kryerjen e saj ose kryerësin.
5. Të gjitha çështjet nga paragrafi 1. deri 4. të këtij neni, në parim shqyrtohen në procedurë të bashkuar dhe për to merret një aktgjykim.
6. Kur disa persona fajësohen për disa vepra penale, gjykata mund të vendos të zbatojë procedurë të bashkuar dhe të marrë një aktgjykim, me kusht që veprat të jenë të ndërlidhura dhe provat të jenë të përbashkëta.
7. Gjykata mund të vendosë të zbatojë procedurë të bashkuar dhe të marrë një aktgjykim, po që se, para të njëjtës gjykatë zbatohen procedura të ndara, kundër të njëjtit person, për disa vepra ose kundër disa personave, për vepër penale të njëjtë.
8. Për bashkim të procedurës, vendos gjykata, e cila është kompetente për zbatimin e procedurës së bashkuar, në bazë të propozimit të prokurorit të shtetit ose sipas detyrës zyrtare. Kundër aktvendimit me të cilin caktohet bashkimi i procedurës ose refuzimi i propozimit për bashkim, nuk lejohet ankesë**.**

Neni 36
Veçimi i procedurës

1. Gjykata e cila sipas këtij Kodi është kompetente, për shkaqe të rëndësishme ose për arsye të efikasitetit, deri në përfundim të shqyrtimit gjyqësor mund të vendos veçimin e procedurave të zbatuara për disa vepra penale ose kundër disa të pandehurve dhe procedon ndaras ose çështjet e ndara ia dërgon një gjykate tjetër kompetente.
2. Aktvendimin për veçimin e procedurës e merr gjykata kompetente pas dëgjimit të palëve dhe mbrojtësit.
3. Kundër aktvendimit me të cilin lejohet veçimi i procedurës ose refuzimi i propozimit për veçimin e procedurës nuk lejohet ankesë.

4. KALIMI I KOMPETENCËS TERRITORIALE

Neni 37
Kompetenca e deleguar dhe konflikti i kompetencës

1. Gjykata themelore është e detyruar që të shqyrtojë kompetencën territoriale të saj dhe nëse konstaton se i mungon kompetenca, shpall veten jokompetente, dhe pasi që aktvendimi të merr formën e prerë i dorëzon rastin gjykatës e cila ka kompetencë territoriale.
2. Në qoftë se gjykata themelore kompetente për shkaqe juridike ose faktike është penguar të zbatojë procedurën pas dëgjimit të palëve, kryetari i gjykatës themelore mund të kalojë procedurën te një degë tjetër brenda gjykatës themelore kompetente.
3. Nëse kalimi nga paragrafi 2. i këtij neni nuk është i mundshëm, kryetari i gjykatës themelore kompetente duhet të konsultohet me një tjetër gjykatë themelore që ka kompetencë lëndore dhe të pajtohen për transferimin e procedurës.
4. Në qoftë se dy gjykatat themelore nuk mund të përmbushin paragrafin 3. të këtij neni brenda dhjetë (10) ditëve, cilado prej tyre e njofton menjëherë për këtë Gjykatën e Apelit, e cila do të caktojë njërën nga gjykatat për të zbatuar procedurën.
5. Para marrjes së aktvendimit mbi konfliktin e kompetencës lëndore, gjykata kërkon mendimin e prokurorit të shtetit i cili është kompetent për të vepruar para asaj gjykate, të dëmtuarit apo mbrojtësit të viktimave dhe të pandehurit apo mbrojtësit të tij.
6. Kundër aktvendimit nga ky nen nuk lejohet ankesë.

5. PASOJAT E MUNGESËS SË KOMPETENCËS

Neni 38
Kompetenca e nënkuptuar e gjykatave

1. Gjykata jokompetente detyrohet të ndërmarrë ato veprime procedurale për të cilat ekziston rrezik nga vonesa.
2. Pasi aktakuza të merr formë të prerë, gjykata nuk mund të shpall veten jokompetente në pikëpamje territoriale dhe palët nuk mund të paraqesin kundërshtim për shkak të mungesës së kompetencës territoriale.

KAPITULLI III
PËRJASHTIMI

1. PËRJASHTIMI I GJYQTARËVE

Neni 39
Bazat për përjashtimin e gjyqtarëve

1. Gjyqtari përjashtohet nga ushtrimi i funksionit gjyqësor në rastin kur:
   1.1. është dëmtuar me vepër penale;
   1.2. është bashkëshort, bashkëshort jashtëmartesor, person në afri gjinie në vijë të drejtpërdrejtë të çfarëdo shkalle ose në vijë anësore deri në shkallën e katërt, person në afri krushqie deri në shkallën e dytë me të pandehurin, mbrojtësin e tij, prokurorin e shtetit, të dëmtuarin, përfaqësuesin e tij ligjor ose përfaqësuesin e autorizuar;
   1.3. është kujdestar ligjor, nën kujdestari ligjore, fëmijë i adoptuar ose prind adoptues, prind birësues ose fëmijë i birësuar i të pandehurit, mbrojtësit të tij, prokurorit të shtetit ose të dëmtuarit;
   1.4. në çështjen e njëjtë penale ka marrë pjesë në procedurë si prokuror, mbrojtës, përfaqësues ligjor apo përfaqësues i autorizuar i të dëmtuarit ose është pyetur si dëshmitar apo ekspert;
   1.5. ekziston konflikti i interesit siç përcaktohet në nenin 6 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.
2. Gjyqtari përjashtohet si gjyqtar i vetëm gjykues, kryetar i trupit gjykues, anëtar i trupit gjykues, anëtari i kolegjit të apelit apo kolegjit të Gjykatës Supreme nëse ka marrë pjesë në procedura të mëhershme në të njëjtin rast penal, përveç gjyqtarit që ka shërbyer në kolegjin e mundësisë hetuese të veçantë. Megjithatë, një gjyqtar nuk do të përjashtohet kur ai ose ajo ka qenë vetëm i përfshirë në procedurat e mëparshme në të njëjtën çështje penale, si një anëtar i një paneli shqyrtues.
3. Gjyqtari gjithashtu mund të përjashtohet nga ushtrimi i funksionit gjyqësor në rast konkret, nëse përpos rasteve nga paragrafi 1. dhe 2. i këtij neni, prezantohen dhe vërtetohen rrethana që e vënë në dyshim paanshmërinë e tij ose që duken të papërshtatshme.

Neni 40
Procedura për përjashtim

1. Gjyqtari posa të mësojë se ekziston ndonjë arsye për përjashtim nga neni 39, paragrafi 1. ose 2. i këtij Kodi ndërpret çdo aktivitet lidhur me çështjen dhe për këtë e njofton kryetarin e gjykatës, i cili sipas procedurave apo rregullave të brendshme të gjykatës cakton zëvendësimin e tij. Në rastin e përjashtimit të kryetarit të gjykatës, ai kërkon drejtpërdrejt nga Kryetari i Gjykatës së Apelit që të caktojë zëvendësimin.
2. Në qoftë se gjyqtari konstaton se ekzistojnë rrethana të cilat arsyetojnë përjashtimin e tij nga neni 39, paragrafi 3. i këtij Kodi, ai për këtë e njofton kryetarin e gjykatës. Derisa të merret vendim për përjashtim, gjyqtari mund të ndërmerr vetëm ato

veprime të cilat janë domosdo të nevojshme për të penguar shtyrjen ose vonesën e palejueshme të çështjes.

Neni 41
Kërkesa për përjashtim

1. Përjashtimin e gjyqtarit mund ta kërkojnë edhe palët.
2. Pala mund të kërkojë përjashtimin e gjyqtarit sapo të ketë mësuar për ekzistimin e arsyeve për përjashtim,dhe kete mund ta beje më së largu deri para përfundimit të shqyrtimit gjyqësor, ndërsa në rast të përjashtimit për arsyet e parapara në nenin 39, paragrafi 3. i këtij Kodi, përjashtimin e kërkon para fillimit të shqyrtimit gjyqësor.
3. Kërkesën për përjashtimin e gjyqtarit të Gjykatës së Apelit apo të Gjykatës Supreme pala mund ta bëjë në ankesë ose në përgjigje në ankesë.
4. Pala mund të kërkojë përjashtimin vetëm të gjyqtarit që e trajton çështjen.
5. Pala detyrohet që në kërkesë të shënojë rrethanat me të cilat e mbështet pretendimin për ekzistimin e bazës ligjore për përjashtim. Shkaqet e paraqitura në kërkesën e mëparshme për përjashtim e cila është refuzuar nuk mund të paraqiten përsëri në kërkesë.

Neni 42
Vendimet mbi kërkesat për përjashtim

1. Kërkesat për përjashtim sipas nenit 41 të këtij Kodi vendosen nga gjyqtarët në vijim:
   1.1. Kryetari i Gjykatës Themelore vendos mbi kërkesën për përjashtimin e gjyqtarëve të Gjykatës Themelore.
   1.2. Kryetari i Gjykatës së Apelit vendos mbi kërkesën për përjashtimin vetëm të Kryetarit të Gjykatës Themelore ose mbi kërkesën për përjashtimin e Kryetarit të Gjykatës Themelore dhe gjyqtarit tjetër të së njëjtës gjykatë.
   1.3. Kryetari i Gjykatës së Apelit vendos mbi kërkesën për përjashtimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit.
   1.4. Kryetari i Gjykatës Supreme të Kosovës vendos mbi kërkesën për përjashtimin e Kryetarit të Gjykatës së Apelit, kërkesën për përjashtimin e Kryetarit të Gjykatës së Apelit dhe gjyqtarit tjetër të së njëjtës gjykatë ose kërkesën për përjashtimin e gjyqtarit të Gjykatës Supreme të Kosovës. Kolegji i kryesuar nga Zëvendës kryetari i Gjykatës Supreme të Kosovës vendos mbi kërkesën për përjashtimin e kryetarit të Gjykatës Supreme të Kosovës ose mbi kërkesën për përjashtimin e kryetarit të Gjykatës Supreme të Kosovës dhe gjyqtarëve tjerë të së njëjtës gjykatë.
2. Para marrjes së aktvendimit për përjashtim dëgjohet gjyqtari apo kryetari i gjykatës, e sipas nevojës zhvillohen edhe hetime të tjera.
3. Kundër aktvendimit me të cilin pranohet kërkesa për përjashtim nuk lejohet ankesë. Aktvendimi me të cilin kërkesa për përjashtim refuzohet mund të kundërshtohet me ankesë të posaçme, e kur një aktvendim i tillë është marrë pas ngritjes së aktakuzës, atëherë mund të kundërshtohet vetëm me ankesë kundër aktgjykimit.
4. Në qoftë se kërkesa për përjashtim është në kundërshtim me dispozitat e nenit 41,

paragrafët 4. dhe 5. të këtij Kodi ose kërkesa për përjashtim nga neni 39, paragrafi 3. i këtij Kodi është parashtruar pas fillimit të shqyrtimit gjyqësor, kërkesa hudhet në tërësi ose pjesërisht. Kundër aktvendimit me të cilin hudhet kërkesa nuk lejohet ankesë. Aktvendimin me të cilin hudhet kërkesa e merr kryetari i gjykatës, kurse në shqyrtim gjyqësor atë e merr trupi gjykues. Gjyqtari, përjashtimi i të cilit kërkohet, mund të marrë pjesë në marrjen e aktvendimit nga trupi gjykues.

Neni 43
Ndërprerja e ushtrimit të veprimeve pas kërkesës për përjashtim të gjyqtarit

Kur gjyqtari mëson se është bërë kërkesë për përjashtimin e tij, ai detyrohet që menjëherë të ndërpresë çdo veprim në atë çështje, e kur kemi përjashtim nga neni 39, paragrafi 3. i këtij Kodi, ai deri në marrjen e aktvendimit mbi kërkesën mund të kryejë vetëm ato veprime për të cilat ekziston rrezik nga vonesa.

2. PËRJASHTIMI I PROKURORËVE TË SHTETIT

Neni 44
Bazat për përjashtimin e prokurorëve të shtetit

1. Prokurori i shtetit përjashtohet kur:
   1.1. është dëmtuar me vepër penale;
   1.2. Është bashkëshort, bashkëshort jashtëmartesor, person në afri gjinie në vijë të drejtpërdrejtë të çfarëdo shkalle ose në vijë anësore deri në shkallën e katërt, person në afri krushqie deri në shkallën e dytë me të pandehurin, mbrojtësin e tij, të dëmtuarin, përfaqësuesin e tij ligjor ose përfaqësuesin e autorizuar;
   1.3. është kujdestar ligjor, nën kujdestari ligjore, fëmijë i adoptuar ose prind adoptues, prind birësues ose fëmijë i birësuar i të pandehurit, mbrojtësit të tij ose të dëmtuarit;
   1.4. në çështjen e njëjtë penale ka marrë pjesë në procedurë si gjyqtar, mbrojtës, përfaqësues ligjor apo përfaqësues i autorizuar i të dëmtuarit ose është pyetur si dëshmitar apo ekspert; ose
   1.5. ekziston konflikti i interesit siç përcaktohet në nenin 6 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.
2. Prokurori i shtetit është përherë i detyruar që të përjashtojë veten me të mësuar se ekzistojnë arsye për përjashtimin e tij.
3. Nëse prokurori i shtetit kundërshton përjashtimin e tij, ai kërkon vendim nga prokurori i shtetit më i lartë sipas këtij paragrafi. Kryeprokurori i zyrës vendos mbi përjashtimin e prokurorit të shtetit të zyres së tij, ndërsa Kryeprokurori i Shtetit jep vendimin përfundimtar mbi përjashtimin e një prokurori të shtetit sipas këtij paragrafi. Çdo vendim nga ky paragraf duhet të jetë me shkrim dhe i dorëzohet prokurorit të shtetit në fjalë dhe Këshillit Prokurorial të Kosovës. Për përjashtimin e Kryeprokurorit të Shtetit vendos Këshilli Prokurorial i Kosovës në seancë plenare.

3. PËRJASHTIMI I PJESËMARRËSVE TJERË

Neni 45
Bazat për përjashtimin e pjesëmarrësve tjerë në procedurë penale

1. Kryetari i trupit gjykues, gjyqtari i vetëm gjykues, gjyqtari i procedurës paraprake ose kryetari i kolegjit shqyrtues apo kolegjit ankimor vendos për përjashtimin e procesmbajtësit, përkthyesit, specialistit dhe ekspertit dhe mbrojtësit të viktimave.
2. Në qoftë se zyrtari i autorizuar i policisë zbaton veprime hetimore në bazë të këtij Kodi, për përjashtimin e tij vendos prokurori i shtetit. Po qe se me rastin e ndërmarrjes së këtyre veprimeve merr pjesë procesmbajtësi, për përjashtimin e tij vendos personi zyrtar i cili ndërmerr veprimet.
3. Mbrojtësi i viktimave përjashtohet kur:
   3.1. është dëmtuar me veprën penale;
   3.2. është bashkëshort, bashkëshort jashtëmartesor, person në afri gjinie në vijë të drejtpërdrejtë të çfarëdo shkalle ose në vijë anësore deri në shkallën e katërt, person në afri krushqie deri në shkallën e dytë me të pandehurin, mbrojtësin e tij, prokurorin, të dëmtuarin, përfaqësuesin e tij ligjor ose përfaqësuesin e autorizuar;
   3.3. është kujdestar ligjor, nën kujdestari ligjore, fëmijë i adoptuar ose prind adoptues, prind birësues ose fëmijë i birësuar i të pandehurit, mbrojtësit të tij, prokurorit ose të dëmtuarit;
   3.4. në çështjen e njëjtë penale ka marrë pjesë në procedurë si gjyqtar, prokuror, mbrojtës, ose është pyetur si dëshmitar apo ekspert; ose
   3.5. ekzistojnë rrethana të cilat krijojnë paraqitjen e konfliktit të interesit.

KAPITULLI IV
PROKURORI I SHTETIT

Neni 46
Kompetenca dhe struktura e prokurorive të shtetit

Kompetencat dhe struktura e Prokurorive Themelore, Prokurorisë Speciale, Prokurorisë së Apelit dhe Zyrës së Prokurorit të Shtetit për të hetuar dhe ndjekur çështjet penale përcaktohen me Kapitullin IV të Ligjit për Prokurorin e Shtetit.

Neni 47
Pavarësia e prokurorit të shtetit

Organet publike nuk mund të ndikojnë në mënyrë formale apo joformale, e as të drejtojnë veprimet e prokurorit të shtetit në trajtimin e çështjeve individuale penale apo në hetime.

Neni 48
Detyrimi i prokurorit të shtetit ndaj të pandehurit

Gjatë hetimit të veprave penale, prokurori i shtetit detyrohet të analizojë provat dhe faktet fajësuese dhe shfajësuese dhe të sigurojë që hetimi të kryhet duke respektuar në tërësi të drejtat e të pandehurit dhe që mbledhja e provave të mos bëhet në kundërshtim me Kapitullin XVI të këtij Kodi.

Neni 49
Detyrat dhe kompetencat e prokurorëve të shtetit

1. Detyrat dhe kompetencat themelore të prokurorit të shtetit janë të përcaktuara në nenin 7 të Ligjit për Prokurorin e Shtetit. Përveç këtyre detyrave dhe kompetencave, prokurori i shtetit ka edhe detyrat dhe kompetencat e mëposhtme:
   1.1. prokurorët e shtetit janë të autorizuar për të përfaqësuar interesat publik para gjykatave të Republikës së Kosovës dhe të kërkojnë nga gjykata që të urdhërojë masa në pajtim me këtë Kod të Procedurës Penale.
   1.2. në lidhje me veprat penale të cilat ndiqen sipas detyrës zyrtare apo me propozimin e të dëmtuarit, prokurori i shtetit ka kompetencë që të negociojë dhe të pranojë marrëveshje vullnetare për bashkëpunim apo pranim të fajësisë me të pandehurin.

Neni 50
Kompetenca territoriale e prokurorëve të shtetit

Prokurori i shtetit ka kompetencë për të vepruar para gjykatës përkatëse në pajtim me Ligjin për Prokurorin e Shtetit.

Neni 51
Kompetenca e prokurorëve të shtetit në çështjet urgjente

Kur ekziston rrezik nga shtyrja, veprimet procedurale mund të ndërmerren edhe nga prokurori i shtetit që nuk është kompetent, me kusht që menjëherë të njoftohet prokurori i shtetit që është kompetent.

Neni 52
Tërheqja nga ndjekja penale

Prokurori i shtetit mund të tërhiqet nga ndjekja deri në përfundimin e shqyrtimit gjyqësor para gjykatës themelore, kurse në procedurat para gjykatës më të lartë, ai mund të tërhiqet nga ndjekja vetëm në rastet e parapara me këtë Kod.

KAPITULLI V
MBROJTËSI

Neni 53
E drejta e të pandehurit për të pasur mbrojtës

1. I dyshuari dhe i pandehuri kanë të drejtë të kenë mbrojtës gjatë gjithë fazave të procedurës penale.
2. Para çdo marrjeje në pyetje të të dyshuarit ose të pandehurit, policia ose organi tjeter kompetent, prokurori i shtetit, gjyqtari i procedurës paraprake, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues udhëzon të dyshuarin ose të pandehurin për të drejtën e tij në angazhimin e mbrojtësit dhe se mbrojtësi mund të marrë pjesë gjatë marrjes së tij në pyetje.
3. Nga e drejta për të pasur mbrojtës mund të hiqet dorë, përveç në rastin e mbrojtjes së detyruar, nëse heqja dorë bëhet qartë dhe vullnetarisht pas informimit të plotë për të drejtën e tij në mbrojtje. Heqja dorë duhet bërë me shkrim dhe duhet nënshkruar nga i dyshuari apo i pandehuri dhe nga organi kompetent që e zbaton procedurën, ose mund të bëhet gojarisht në audio apo videokasetë, autenticiteti i të cilës verifikohet nga gjykata.
4. Në rastet e mbrojtjes së detyruar, mund të hiqet dorë nga e drejta për të pasur mbrojtës në pajtim me paragrafin 3. të këtij neni, në qoftë se një avokat mbrojtës mbahet për të vepruar si "avokat në gatishmëri" me përgjegjësi për të këshilluar të pandehurin gjatë procedurës, dhe në qoftë se i pandehuri tërheq heqjen dorë, avokati në gatishmëri bëhet mbrojtës.
5. Personat nën moshën tetëmbëdhjetë (18) vjet mund të heqin dorë nga e drejta për të angazhuar mbrojtës me pëlqimin e prindit, kujdestarit ose përfaqësuesit nga qendra për punë sociale, përveç rasteve të dhunës në familje në të cilat është përfshirë prindi ose kujdestari, raste këto tek të cilët prindi ose kujdestari i tillë nuk mund të jep pëlqim për heqjen dorë nga kjo e drejtë.
6. Personat të cilët tregojnë shenja të çrregullimeve ose të paaftësisë mendore nuk mund të heqin dorë nga e drejta në angazhimin e mbrojtësit.
7. Kur i dyshuari ose i pandehuri i cili ka hequr dorë nga e drejta në angazhimin e mbrojtësit më vonë e kërkon sërish këtë të drejtë, ai këtë mund ta ushtrojë menjëherë.
8. Po qe se vetë i dyshuari apo i pandehuri nuk angazhon mbrojtës, përfaqësuesi i tij ligjor, bashkëshorti apo bashkëshorti jashtëmartesor, personi i gjinisë së gjakut në vijë të drejtë, prindi adoptues, fëmija i adoptuar, vëllai, motra dhe prindi birësues mund të angazhojnë mbrojtës për të, por jo kundër vullnetit të tij.

Neni 54
Kualifikimet e mbrojtësit

1. Për mbrojtës mund të angazhohet vetëm avokati i cili është anëtar i Odës së Avokatëve të Kosovës, por të cilin mund ta zëvendësojë praktikanti i avokatisë. Kur procedura zbatohet për vepër penale të dënueshme me së paku pesë vjet burgim, praktikanti i avokatisë mund ta zëvendësojë avokatin vetëm nëse e ka kaluar

provimin e judikaturës. Pranë Gjykates së Apelit dhe Gjykatës Supreme të Kosovës, të pandehurin mund ta përfaqësojë vetëm avokati i cili është anëtar i Odës së Avokatëve së Kosovës.

2. Mbrojtësi ia paraqet autorizimin e tij policisë, prokurorit të shtetit apo gjykatës pranë së cilës zbatohet procedura. I dyshuari ose i pandehuri gjithashtu mund t'i japin mbrojtësit autorizimin edhe gojarisht dhe kjo shënohet në procesverbalin e policisë, të prokurorit të shtetit apo gjykatës pranë së cilës zbatohet procedura.

Neni 55
Kufizimet në përfaqësim nga mbrojtësi

1. Në një procedurë penale, mbrojtësi nuk mund të mbrojë dy ose më tepër të pandehur në të njëjtën çështje. Një mbrojtës nuk mund të përfaqësojnë personin juridik dhe personin fizik në të njëjtin rast, përveç nëse personi fizik është i vetmi person që ka në pronësi, menaxhon dhe është i punësuar nga personi juridik.
2. I pandehuri mund të ketë deri në tre mbrojtës dhe e drejta për mbrojtje konsiderohet se është e mjaftueshme kur në procedurë merr pjesë njëri nga mbrojtësit.
3. Nëse i pandehuri ka më shumë se një mbrojtës, njëri nga ta caktohet si mbrojtës kryesor nga i pandehuri, e në rast se i pandehuri nuk bën një gjë të tillë, gjyqtari kompetent cakton mbrojtësin kryesor.

Neni 56
Përjashtimi i mbrojtësit

1. Mbrojtës nuk mund të jetë i dëmtuari, bashkëshorti apo bashkëshorti jashtëmartesor i të dëmtuarit, e as personi që është në gjini gjaku në vijë të drejtë në cilëndo shkallë, në vijë anësore deri në shkallën e katërt ose të krushqisë deri në shkallën e dytë me të dëmtuarin ose prokurorin.
2. Mbrojtës nuk mund të jetë as personi i cili është thirrur si dëshmitar në shqyrtimin gjyqësor, përveç nëse sipas këtij Kodi është liruar nga detyra e të dëshmuarit dhe ka deklaruar se nuk do të dëshmojë ose nëse mbrojtësi pyetet si dëshmitar në rastin nga neni 12, paragrafi 1. nën-paragrafi 1.2. i këtij Kodi.
3. Mbrojtës nuk mund të jetë as personi i cili në të njëjtën lëndë ka vepruar si gjyqtar ose prokuror i shtetit.

Neni 57
Mbrojtësi në rastet e mbrojtjes së detyruar

1. I pandehuri duhet të ketë mbrojtës në këto raste të mbrojtjes së detyruar:
   1.1. nga marrja në pyetje për herë të parë kur i pandehuri është memec, shurdh, i verbër ose shpreh shenja të çrregullimeve apo paaftësisë mendore dhe kështu është i paaftë që të mbrohet vetë me sukses;
   1.2. gjatë seancës për caktimin e paraburgimit dhe gjatë kohës derisa ai gjendet në paraburgim;
   1.3. nga ngritja e aktakuzës, kur aktakuza është ngritur kundër tij për vepër penale të dënueshme me të paktën dhjetë vjet burgim;

1.4. në procedurë sipas mjeteve të jashtëzakonshme juridike kur i pandehuri është memec, shurdh ose shpreh shenja të çrregullimit apo të paaftësisë mendore ose është shqiptuar dënimi me burgim të përjetshëm; dhe

1.5. në të gjitha rastet kur i pandehuri kërkon të hyjë në marrëveshje për pranimin e fajësisë për vepër penale për të cilën parashihet dënim me së paku një (1) vit burgim, i pandehuri duhet të përfaqësohet nga mbrojtësi.

2. Në qoftë se i pandehuri në rastin e mbrojtjes së detyruar nuk angazhon mbrojtës, e angazhimin nuk e bën askush nga personat ne nenin 53. paragrafi 8. i këtij Kodi, gjykata ose nje organ tjeter kompetent i cakton një mbrojtës sipas detyrës zyrtare me shpenzime publike. Kur mbrojtësi caktohet sipas detyrës zyrtare pasi të jetë ngritur aktakuza, i pandehuri njoftohet për këtë me rastin e dorëzimit të aktakuzës.
3. Në qoftë se i akuzuari në rastin e mbrojtjes së detyruar mbetet pa mbrojtës gjatë procedurës dhe nëse ai nuk angazhon mbrojtës tjetër, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues apo organi kompetent që e zbaton procedurën në fazën paraprake cakton një mbrojtës të ri sipas detyrës zyrtare në shpenzime publike.
4. Personi juridik nuk ka të drejtë në mbrojtës të caktuar me shpenzime publike.

Neni 58
Mbrojtësi me shpenzime publike, kur mbrojtja nuk është e detyruar

1. Kur nuk ekzistojnë kushtet për mbrojtjen e detyruar, të pandehurit i caktohet mbrojtës me shpenzime publike me kërkesën e tij, nëse:
   1.1. nuk ekzistojnë kushtet për mbrojtje të detyrueshme e procedura penale zhvillohet për vepër penale për të cilën është paraparë dënimi me burgim me tetë (8) ose më shumë vjet, ose
   1.2. këtë e kërkojnë interesat e drejtësisë pavarësisht nga dënimi parashikuar, të dyshuarit apo të pandehurit me kerkesën e tij i caktohet mbrojtësi, në qoftë se sipas gjendjes pasurore të tij nuk nuk mund t`i përballojë shpenzimet e mbrojtjes së tij.
2. I pandehuri njoftohet për të drejtën e tij në mbrojtës me shpenzime publike sipas paragrafit paraprak para se të merret në pyetje për herë të parë.
3. Kërkesa për caktimin e mbrojtësit me shpenzime publike sipas paragrafit 1. të këtij neni mund të bëhet gjatë gjithë procedurës penale. Kryetari i gjykatës ose organi kompetent i cili zbaton procedurën në fazën paraprake vendos për kërkesën dhe cakton mbrojtës. Nëse policia ose prokurori i shtetit refuzon kërkesën e të pandehurit për t'i caktuar mbrojtës me shpenzime publike, i pandehuri mund t'i ankohet gjyqtarit të procedurës paraprake.

4. Para caktimit të mbrojtësit me shpenzime publike sipas këtij neni, i pandehuri duhet të plotësojë një deklaratë duke cekur pasuritë e tij dhe të deklarohet se nuk mund të përballojë shpenzimet e mbrojtësit ligjor.

Neni 59
Shkarkimi i mbrojtësit

1. Në vend të mbrojtësit të caktuar, i pandehuri mund të angazhojë vetë mbrojtës tjetër. Në rastin e tillë, mbrojtësi i caktuar shkarkohet.

2. Mbrojtësi i caktuar mund të kërkojë që të shkarkohet vetëm për shkaqe të arsyeshme.
3. Aktvendimi për shkarkimin e mbrojtësit në rastet e parapara në paragrafët 1. dhe 2. të këtij neni para shqyrtimit gjyqësor merret nga gjyqtari i procedurës paraprake, gjatë shqyrtimit gjyqësor merret nga gjyqtari i vetëm gjykues apo kryetari i trupit gjykues, kurse në procedurën e apelit merret nga kryetari i kolegjit të apelit të Gjykatës së Apelit apo Gjykatës Supreme. Kundër këtij aktvendimi nuk lejohet ankesë.
4. Në bazë të kërkesës së të pandehurit ose me pëlqimin e tij, kryetari i gjykatës mund të shkarkojë mbrojtësin e caktuar i cili nuk e ushtron si duhet detyrën. Në vend të mbrojtësit të shkarkuar, kryetari i gjykatës cakton një mbrojtës të pavarur me përvojë dhe kompetencë në pajtim me natyrën e veprës penale. Oda e Avokatëve të Kosovës njoftohet për shkarkimin e mbrojtësit.

Neni 60
Tërheqja e mbrojtësit

1. Mbrojtësi i cili nuk pranon detyrën që i është besuar ose që tërhiqet prej saj duhet njoftuar menjëherë organin që zbaton procedurën dhe atë që e ka caktuar lidhur me mospranimin ose tërheqjen e tij.
2. Mospranimi ka efekt që nga çasti kur i komunikohet organit që zbaton procedurën.
3. Tërheqja nuk ka efekt derisa të pandehurit të mos i sigurohet një mbrojtës i ri sipas zgjedhjes së tij ose sipas detyrës zyrtare dhe deri në përfundim të afatit të caktuar që mund t'i jetë dhënë mbrojtësit zëvendësues për t'u njohur me shkresat dhe provat.
4. Paragrafi 3. i këtij neni zbatohet edhe në rastet nga neni 59, paragrafi 2. i këtij Kodi.

Neni 61
Të drejtat e mbrojtësit si përfaqësues i të pandehurit

1. Mbrojtësi gëzon të drejta të njëjta që ia njeh ligji edhe të pandehurit, përveç atyre që shprehimisht i rezervohen të pandehurit personalisht.
2. Mbrojtësi ka të drejtë të komunikojë lirisht me të pandehurin gojarisht ose me shkrim sipas kushteve që garantojnë fshehtësinë.
3. Mbrojtësi ka të drejtë të njoftohet me kohë për vendin dhe kohën e zbatimit të veprimeve hetimore, të marrë pjesë në to dhe të shikojë shkresat dhe provat e çështjes në pajtim me dispozitat e këtij Kodi.

KAPITULLI VI
I DËMTUARI

Neni 62
Të drejtat e të dëmtuarit

1. I dëmtuari ka këto të drejta:
   1.1. i dëmtuari nga vepra penale duhet te trajtohet me respekt nga policia, prokurorët, gjyqtarët ose organi tjeter që zbaton procedurën penale .

1.2. nëse i dëmtuari nga vepra penale mund të identifikohet, policia dhe prokurori ose organi tjeter që zbaton procedurën penale duhet të kontaktojnë të dëmtuarin në mënyrë të arsyeshme dhe të informojnë atë që është palë e dëmtuar.
1.3. i dëmtuari ka cilësinë e palës në procedurë penale.
1.4. i dëmtuari ka të drejtë në kompensimin e arsyeshëm të urdhëruar nga gjykata prej të pandehurit ose të pandehurve që kanë pranuar ose janë shpallur fajtor për dëmin material, fizik dhe emocional të shkaktuar nga kryerja e veprës penale për të cilën i pandehuri ose të pandehurit janë shpallur fajtorë.
1.5. nëse gjykata nuk mund të urdhërojë kompensimin nga i pandehuri apo të pandehurit për shkak të pamundësisë së tyre për të paguar, mungesës së kompetencës së gjykatës ose vdekjes, i dëmtuari ka të drejtë që të kërkojë nga gjykata që të dërgojë urdhrin për kompensim te koordinatori i fondit për kompensimin e viktimave.

Neni 63
Përfaqësuesi i të dëmtuarit

1. I dëmtuari mund të përfaqësohet nga përfaqësuesi i cili është anëtar i Odës së Avokatëve të Kosovës;
2. I dëmtuari mund të përfaqësohet nga mbrojtësi i viktimave;
3. I dëmtuari mund të përfaqësojë veten.

KAPITULLI VII
MBIKËQYRJA E PROCEDURËS PENALE

Neni 64
E drejta e gjykatës për të gjobitur palët që zvarrisin procedurën penale

1. Gjykata gjatë rrjedhës së procedurës mund t'i shqiptojë gjobë deri në dyqindepesëdhjetë (250) Euro mbrojtësit, përfaqësuesit të autorizuar ose përfaqësuesit ligjor, të dëmtuarit ose mbrojtësit të viktimave, kur veprimet e tij janë të drejtuara qartë në zvarritjen e procedurës penale. Gjoba mund te caktohet per cdo veprim qe ka per qellim zvarritjen e procedures sipas ketij paragrafi.
2. Oda e Avokatëve të Kosovës njoftohet për shqiptimin e gjobës ndaj anëtarit të saj ose praktikantit të avokaturës.
3. Në qoftë se prokurori i shtetit nuk i paraqet gjykatës propozimet me kohë ose veprimet tjera në procedurë i ndërmerr me vonesa të mëdha dhe kështu shkakton zvarritjen e procedurës, atëherë për këtë njoftohet kryeprokurori i asaj prokurorie.

Neni 65
Dërgimi i deklaratave të rreme prokurorit të shtetit

1. Nëse gjyqtari mëson se gjatë procedurës penale të cilën ai e kryeson ka pasur shkelje të neneve 391-401 të Kodit Penal, mund t'ia dërgojë rastin për hetim prokurorit përkatës të shtetit.

2. Gjyqtari i cili dërgon shkeljen nga nenet 391-401 të Kodit Penal sipas paragrafit 1. të këtij neni nuk merr pjesë në procedurën penale që rrjedh si rezultat i këtij dërgimi, por mund të vazhdojë të kryesojë procedurën penale e cila ka qenë duke u zbatuar.

KAPITULLI VIII
DETYRIMET E ORGANEVE PUBLIKE

Neni 66
Detyrimi i organeve publike që të ndihmojnë prokurorin e shtetit

Të gjitha organet publike detyrohen që prokurorit të shtetit, gjykatave dhe organeve të tjera kompetente që marrin pjesë në procedurë penale t'u japin ndihmën e nevojshme, sidomos për çështjet që kanë të bëjnë me hetimin e veprave penale ose vendndodhjen e kryerësve.

Neni 67
Nxjerrja e të dhënave konfidenciale

1. Me kërkesën e gjykatës, institucionet dhe personat përgjegjës për mbajtjen e bazave të të dhënave, qoftë edhe pa pëlqimin e personave përkatës, i sigurojnë gjykatës të dhëna nga baza e tyre e të dhënave që i mbajnë, kur të dhënat e tilla janë të domosdoshme për zhvillimin e procedurës penale.
2. Gjykata detyrohet të mbrojë fshehtësinë e të dhënave të siguruara në mënyrë të tillë.

PJESA E DYTË
PROCEDURA PENALE

KAPITULLI IX
FILLIMI I HETIMEVE DHE PROCEDURA PENALE

1. FAZAT E PROCEDURËS PENALE

Neni 68
Fazat e procedurës penale

Sipas këtij Kodi të Procedurës Penale, procedura penale ka katër faza të ndryshme: fazën e hetimit, fazën e ngritjes së aktakuzës dhe deklarimit, fazën e shqyrtimin gjyqësor dhe fazën e mjetit juridik. Procedurës penale mund t'i paraprijnë veprimet fillestare të policisë ose mbledhja e informatave sipas nenit 84 të këtij Kodi.

2. VEPRIMET FILLESTARE TË POLICISË

Neni 69
Hetimi nga policia

1. Policia heton veprat penale në pajtim me nenin 70 të këtij Kodi dhe ia raporton ato prokurorit te shtetit sa me shpejt qe te jete e mundur.

2. Prokurori i shtetit dhe policia punojnë bashkërisht gjatë veprimeve fillestare nga neni 70 të këtij Kodi.
3. Pas autorizimit për zbatimin e masës nga neni 84 apo pas fillimit të procedurës penale nga neni 102 këtij Kodi, prokurori i shtetit drejton dhe mbikëqyr punën e policisë apo organit tjetër që zbaton hetimin penal.
4. Prokurori i shtetit ka qasje në të gjitha informatat përkatëse të hetimit që policia ka në posedim gjatë veprimeve fillestare.

Neni 70
Veprimet hetimore të policisë

1. Pas pranimit të informatës për një vepër penale të dyshuar, policia heton nëse ka dyshim të arsyeshëm që një vepër penale e cila ndiqet sipas detyrës të jetë kryer.
2. Policia heton veprat penale dhe ndërmerr të gjitha masat e nevojshme që të zbulojë vendndodhjen e kryerësit, të ndalojë kryerësin ose ndihmësin e tij nga fshehja ose arratisja, të zbulojë dhe të ruajë gjurmët dhe provat tjera të veprës penale dhe sendet të cilat mund të shërbejnë si prova, dhe të mbledhë të gjitha informacionet të cilat mund të përdoren në procedurë penale.
3. Për të kryer detyrat nga ky nen, policia është e autorizuar që:
   3.1. të mbledhë informata nga personat;
   3.2. të kryejë kontroll të përkohshëm të automjeteve, udhëtarëve dhe valixheve të tyre;
   3.3. të kufizojë lëvizjen në zona të caktuara për kohën kur ky veprim është urgjentisht i nevojshëm;
   3.4. të ndërmarrë hapat e nevojshëm për të vërtetuar identitetin e personave dhe të sendeve;
   3.5. të organizojë kontrollimin për të zbuluar vendndodhjen e individit ose të sendit që kërkohet duke dërguar letërreshtimin;
   3.6. të kontrollojë nën praninë e personit përgjegjës objektet e caktuara dhe lokalet e organeve publike dhe të shqyrtojë dokumentet e caktuara që u përkasin atyre;
   3.7. te konfiskojë kontrabandën apo sendet të cilat mund të shërbejnë si prova në procedurë penale, përveç nëse për një gjë të tillë nevojitet urdhri nga neni 105 të këtij Kodi;
   3.8. të sigurojë ekzaminimin fizik të të dëmtuarit, në pajtim me nenin 144 të këtij Kodi;
   3.9. të zbulojë, mbledhë dhe ruajë gjurmët dhe provat nga vendi i ngjarjes për veprën penale të dyshuar dhe të urdhërojë testimin mjeko-ligjor të atyre provave nga laboratori i mjekësisë ligjore në pajtim me nenin 71 të këtij Kodi;
   3.10. të merr në pyetje dëshmitarët apo të dyshuarit e mundshëm në pajtim me nenin 73 të këtij Kodi;
   3.11. të ndërmerr hapat e nevojshëm për të parandaluar një rrezik të menjëhershëm për publikun;
   3.12. të ndërmerr të gjithë hapat e nevojshëm për të gjetur kryerësin dhe për të parandaluar kryerësin ose ndihmësin e tij nga fshehja ose arratisja; dhe

3.13. te ndërmerr hapa dhe veprime tjera të nevojshme siç përcaktohet me ligj.
4. Për veprimet të cilat i ndërmarrin dhe për faktet dhe rrethanat e konstatuara nga hetimet e tyre, policia përpilon procesverbal, fotografi ose shënim zyrtar.
5. Posa policia të ketë dyshim të arsyeshëm se është kryer një vepër penale e cila ndiqet sipas detyrës zyrtare, policia është e detyruar që brenda njëzet e katër (24) orëve t'i dorëzojë një raport policor prokurorit të shtetit që është kompetent, i cili pastaj vendos nëse duhet filluar procedurën penale.

Neni 71
Mbledhja e provave nga vendi i ngjarjes

1. Policia me kujdes mbledhë provat që gjenden në vendin e ngjarjes për veprën e dyshuar penale dhe i ruan ato në mënyrë të përshtatshme që lejon provat të testohen nga laboratori kompetent.
2. Me përjashtim të shenjave të gishtërinjve, për provat që merren nga trupi i një individi të cilat mund t'i nënshtrohen testimit mjeko-ligjor, policia duhet të ketë pëlqimin me shkrim të individit që provat e tilla të merren ose me urdhrin e gjykatës sipas nenit 143, 144 apo 145 të këtij Kodi që autorizon marrjen e provave.

Neni 72
E drejta e policisë për të ndaluar për kohë të shkurtë

Policia ka të drejtë t'i ndalojë dhe të mbledhë informacione nga personat që gjenden në vendin e kryerjes së veprës penale, të cilët mund të japin informacione të rëndësishëm për procedurën penale, nëse ka gjasa që mbledhja e informacionit nga këta persona më vonë do të ishte e pamundur ose do të zvarriste në mënyrë të konsiderueshme procedurën apo do të shkaktonte vështirësi të tjera. Ndalimi i personave të tillë nuk mund të zgjasë më shumë se sa është e nevojshme për të marrë emrat, adresat dhe informacionet e tjera që kanë lidhje me këtë dhe në asnjë rast nuk mund të zgjasë më shumë se gjashtë orë. Ndalimi i tillë mund të bëhet vetëm nëse nuk ka mjete të tjera për të arritur deri tek informacioni. Policia e trajton personin e ndaluar me dinjitet dhe nuk e ndalon personin në qendër të paraburgimit dhe nuk i vë pranga.

Neni 73
Marrja në pyetje nga policia

1. Policia ka të drejtë të merr pjesë në biseda me persona të cilët mund të jenë dëshmitarë ose të dyshuar të mundshëm për vepra penale vetëm gjatë hetimit të fshehtë të autorizuar. Gjatë këtyre bisedave, policia mund të bëjë pyetje në lidhje me veprën penale. Nëse është e mundur, këto biseda duhet të regjistrohen. Nëse këto biseda nuk mund të regjistrohen, zyrtari i policisë duhet sa më parë në një raport të përmbledhë saktë bisedat dhe të shpjegojë arsyen përse bisedat nuk janë regjistruar.
2. Policia ka të drejtë të marrë në pyetje personat të cilët mund të jenë dëshmitarë të një vepre penale dhe për këtë përpilon raportin policor të marrjes në pyetje. Raporti duhet të përmbajë saktë pyetjet dhe përgjigjet gjatë marrjes në pyetje, të identifikojë

zyrtarin e policisë që ka marrë në pyetje dëshmitarin, kohën, datën dhe vendin e mbajtjes së marrjes në pyetje dhe të identifikojë dëshmitarin.

3. Policia ka të drejtën e intervistimit të personave që mund të jenë të dyshimtë për kryerje të një vepre penale, por së pari duhet të informojë të dyshuarin për veprat penale, për të cilat dyshohet se ai i ka kryer dhe për të drejtat e tij, në bazë të nenit 125, paragrafi 3. Policia duhet të hartojë një raport policor nga intervista. Raporti duhet të përmbledhë në mënyrë të saktë pyetjet dhe përgjigjet gjatë intervistës, duhet të jep identitetin e zyrtarit policor që e interviston të dyshuarin, kohën, datën dhe vendin e mbajtjes së intervistimit**.**
4. Gjatë intervistës, sipas paragrafit 3. të këtij neni, i dyshuari duhet të ketë të drejtën për një përkthyes gojor ose përkthimin e dokumenteve relevante pa pagesë.

Neni 74
Ndalesat në marrjen në pyetje nga policia

Neni 257 i këtij Kodi zbatohet për mbledhjen e informacioneve prej personave nga nenet 72-73 të këtij Kodi.

Neni 75
Kontrolli i përkohshëm për siguri

1. Nëse ekziston rreziku se një person është i armatosur ose ka mjet të rrezikshëm i cili mund të përdoret për sulm apo për vetëlëndim, policia mund të kryejë një kontroll të përkohshëm sigurimi ndaj personit të tillë për të kontrolluar për armë ose për sende tjera të rrezikshme.
2. Kontrolli i përkohshëm për siguri nuk përbën kontrollin e personit dhe është i kufizuar në kontroll për armë në rrobat e jashtme të personit dhe përjashtimisht me anë të kontrollit të përkohshëm të valixheve ose automjetit nëse ato janë nën kontrollin direkt të personit të tillë.
3. Kontrolli i përkohshëm për siguri kryhet nga zyrtari policor i gjinisë së njëjtë me personin që kontrollohet, përveç rasteve kur për shkak të rrethanave të veçanta një gjë e tillë nuk është e mundur.
4. Kur gjatë zbatimit të kontrollit të përkohshëm për siguri zyrtari policor gjen sende që mund të përdoren si provë në procedurë penale, ai duhet të veprojë në pajtim me dispozitat që e rregullojnë kontrollin e personit sipas këtij Kodi.

Neni 76
Masat për identifikimin e të dyshuarit

1. Policia mund të fotografojë personin dhe të marrë shenjat e gishtave të tij, nëse ekziston dyshimi i arsyeshëm se ai ka kryer vepër penale.
2. Prokurori i shtetit mund të autorizojë policinë që ta publikojë fotografinë kur kjo është e nevojshme për përcaktimin e identitetit të të dyshuarit dhe në raste të tjera kur do t'i kontribuojë zbatimit efikas të procedurës.
3. Nëse është e nevojshme për të identifikuar se të kujt janë shenjat e gishtave të gjetur në objekte të caktuar, policia mund të marrë shenjat e gishtave të personave të cilët me gjasë mund të kenë pasur kontakt me objektet e tilla.

4. Policia, me ndihmën e një mjeku apo infermieri të kualifikuar, e në raste të jashtëzakonshme vetë, mund të mbledhë mostra nga neni 143, 144 ose 145 i këtij Kodi nga i dyshuari nëse kjo është e ngutshme. Prokurori i shtetit menjëherë informohet për mbledhjen e mostrave të tilla.
5. Policia mund të kërkojë nga i dyshuari t'i shtrohet alkotestit përmes mostrave të urinës ose të frymëmarrjes, ndërsa refuzimi i të dyshuarit për dhënien e këtyre mostrave përbën provë të pranueshme. I dyshuari duhet të njoftohet paraprakisht në lidhje me këtë. Asnjë mostër nuk duhet të merret me detyrim pa urdhrin e gjykatës.

Neni 77
Mbledhja e të dhënave nga policia prej të dëmtuarit

1. Me rastin e mbledhjes së të dhënave nga i dëmtuari, policia informon të dëmtuarin për të drejtat e tij nga neni 62 i këtij Kodi dhe me kërkesën e të dëmtuarit apo kur i dëmtuari i përket njërës prej kategorive nga neni 62, paragrafi 1. i këtij Kodi, njofton Njësinë për Mbrojtje të Viktimave.
2. Personi kundër të cilit është ndërmarrë ndonjë masë nga nenet 69-83 të këtij Kodi, ka të drejtë të parashtrojë ankim tek prokurori kompetent i shtetit brenda tre ditëve nga ndërmarrja e këtyre veprimeve.
3. Prokurori i shtetit pa vonesë verifikon bazueshmërinë e ankesës nga paragrafi 2. i këtij neni dhe nëse vërteton se veprimet ose masat e zbatuara e shkelin ligjin penal apo kodin e sjelljes për policinë ose detyrimet e punës, atëherë vepron në pajtim me ligjin dhe duhet të njoftojë personin që ka parashtruar ankim.

Neni 78
Kallëzimi penal nga organet publike

1. Të gjitha organet publike detyrohen t'i paraqesin veprat penale që ndiqen sipas detyrës zyrtare për të cilat janë informuar ose për të cilat kanë marrë dijeni në ndonjë mënyrë tjetër.
2. Me rastin e paraqitjes së kallëzimit penal, organet publike nga paragrafi 1. i këtij neni paraqesin provat që janë të njohura për ta dhe ndërmarrin masa për t'i ruajtur gjurmët e veprës penale, sendet mbi të cilat ose me ndihmën e të cilave është kryer vepra penale dhe provat tjera.

Neni 79
Kallëzimi penal nga personat

1. Çdo person ka të drejtë të kallëzojë veprën penale që ndiqet sipas detyrës zyrtare dhe detyrohet ta bëjë këtë në rastin kur moskallëzimi i veprës penale paraqet vepër penale.
2. Punëtori social, punëtori shëndetësor, mësuesi, edukatori ose personat tjerë që kryejnë punë në cilësi të ngjashme të cilët mësojnë ose zbulojnë se ekziston dyshim i arsyeshëm se fëmija është viktimë e veprës penale, e sidomos për vepra penale kundër integritetit seksual, këtë duhet ta kallëzojnë menjëherë.
3. Kur ndjekja për vepër të caktuar penale varet nga propozimi për ndjekje i të

dëmtuarit apo nga leja paraprake e organit kompetent, prokurori i shtetit nuk mund të zbatojë hetimin, të ngritë aktakuzën pa dorëzimin e provave që dëshmojnë se është dhënë propozimi apo leja. Në raste të ngutshme, prokurori i shtetit mund të veprojë në bazë të propozimit gojor për ndjekje i cili duhet konfirmuar me shkrim brenda dyzet e tetë (48) orëve. Kallëzimi penal i nënshkruar nga i dëmtuari mjafton sipas këtij paragrafi.

Neni 80
Kallëzimi penal i paraqitet prokurorit të shtetit

1. Kallëzimi penal i paraqitet prokurorit kompetent të shtetit me shkrim, me mjete teknike të komunikimit ose gojarisht.
2. Nëse vepra penale është kallëzuar gojarisht, personi i cili bën kallëzimin paralajmërohet për pasojat e kallëzimit të rremë. Për kallëzimet penale gojore përpilohet procesverbal dhe për kallëzimet e pranuara nëpërmjet telefonit ose me mjete të tjera komunikimi bëhet shënim zyrtar.
3. Kallëzimi penal që i është paraqitur gjykatës, policisë ose prokurorit të shtetit që nuk është kompetent duhet të pranohet dhe pa vonesë t'i dërgohet prokurorit kompetent të shtetit.

Neni 81
Kallëzimi penal i policisë

1. Duke u bazuar në të dhënat dhe provat e mbledhura, policia përpilon kallëzim penal të policisë në të cilin paraqiten provat e zbuluara në procesin e mbledhjes së të dhënave.
2. Kallëzimi penal i policisë i dorëzohet prokurorit të shtetit së bashku me sendet, skicat, fotografitë, raportet e marra, procesverbalet e masave dhe veprimeve të kryera, shënimet zyrtare, deklarimet e marra dhe materialet e tjera të cilat mund të kontribuojnë në zbatimin efektiv të procedurës.
3. Nëse pas dorëzimit të kallëzimit penal të policisë, policia mëson fakte të reja ose nxjerr prova apo gjurmë të veprës penale, ajo detyrohet që vazhdimisht të mbledhë informata të nevojshme dhe për këtë menjëherë duhet t'ia dorëzojë prokurorit të shtetit raportin plotësues të kallëzimit penal të policisë.
4. Nëse masat dhe veprimet e kryera nga policia, provat dhe të dhënat e mbledhura nuk sigurojnë bazë për kallëzim penal të policisë dhe nëse kjo nuk justifikon ekzistimin e dyshimit të arsyeshëm se është kryer vepër penale, policia megjithatë i dërgon për këtë raport të veçantë prokurorit të shtetit.

Neni 82
Hudhja e kallëzimit penal të policisë

1. Prokurori i shtetit me aktvendim e hudh kallëzimin penal të pranuar nga policia apo burime tjera brenda tridhjetë (30) ditëve, nëse nga raporti është e qartë se:
   1.1. nuk ekziston dyshim i arsyeshëm se është kryer vepër penale;
   1.2. ka kaluar afati i parashkrimit për ndjekje penale;

1.3. vepra penale është përfshirë me amnisti ose me falje;
1.4. i dyshuari gëzon imunitet dhe heqja e tij nuk është e mundur ose nuk është miratuar nga organi kompetent; ose
1.5. ekzistojnë rrethana të tjera të cilat e përjashtojnë ndjekjen.

2. Prokurori i shtetit menjëherë një kopje të aktvendimit sipas paragrafit 1. të këtij neni ia dërgon policisë.
3. Prokurori i shtetit brenda tetë (8) ditësh nga hudhja e kallëzimit njofton të dëmtuarin për hudhjen e kallëzimit dhe arsyet për këtë.

Neni 83
Të dhënat plotësuese të kallëzimit penal të policisë

1. Nëse prokurori i shtetit nga kallëzimi penal nuk mund të përcaktojë nëse pretendimet e përfshira në të janë të mundshme, ose të dhënat në kallëzim nuk sigurojnë bazë të mjaftueshme për fillimin e hetimit apo nëse prokurori vetëm ka dëgjuar se është kryer vepër penale, prokurori i shtetit, nëse nuk është në gjendje vetë të ndërmarrë këtë, kërkon nga policia që të mbledhë të dhënat e duhura. Policia detyrohet të veprojë sipas kërkesave të ligjshme të prokurorit.
2. Prokurori i shtetit gjithashtu mund të mbledhë vetë të dhëna të tilla ose nëpërmjet organeve të tjera publike, duke përfshirë bisedën me dëshmitarët, të dëmtuarit dhe përfaqësuesit e tyre ligjor. Prokurori i shtetit mund të marrë pjesë së bashku me policinë në çdo marrje në pyetje të të dyshuarit duke respektuar të drejtat e të dyshuarit sipas dispozitave të këtij Kodi.
3. Policia detyrohet t'i raportojë menjëherë prokurorit të shtetit mbi masat e ndërmarra nën udhëzimet e tij, e nëse ata nuk kanë mund t'i ndërmarrin ato, atëherë menjëherë i raportojnë prokurorit të shtetit për arsyet e pamundësisë së ndërmarrjes së masave të tilla.
4. Prokurori i shtetit mund të kërkojë të dhëna të nevojshme nga organet publike dhe për këtë qëllim mund ta thërret personin i cili e ka dorëzuar kallëzimin penal.
5. Prokurori i shtetit e hedh kallëzimin penal nga neni 79 i këtij Kodi brenda tridhjetë (30) ditësh nëse edhe pasi të jenë ndërmarr veprimet nga paragrafët 2., 3. dhe 4. të këtij neni vazhdojnë të ekzistojnë rrethanat nga paragrafi 1. i këtij neni.
6. Policia, prokurori i shtetit dhe organet tjera publike detyrohen të procedojnë me kujdes në mbledhjen ose në sigurimin e të dhënave, duke pasur kujdes që të mos cenohet dinjiteti dhe reputacioni i personit të cilit i referohen të dhënat e tilla.

3. MARRJA E INFORMATAVE

Neni 84
Masat e marra para fillimit të procedurës penale

1. Nëse prokurori i shtetit ka dyshim të bazuar se është kryer vepër penale nga neni 90 të këtij Kodi, po kryhet apo së shpejti do të kryhet, prokurori i shtetit mund të autorizojë apo të kërkojë nga gjyqtari i procedurës paraprake që të autorizojë masat e fshehta dhe teknike të vëzhgimit dhe hetimit në pajtim me nenet 86-100 të këtij Kodi.

2. Për autorizimin e masave të fshehta dhe teknike të hetimit dhe vëzhgimit nga paragrafi 1, prokurori i shtetit ose gjyqtari i procedurës paraprake nuk është e domosdoshme të ketë dyshim të arsyeshëm për identitetin e të dyshuarit apo të dyshuarve të cilët kanë kryer, janë duke kryer ose së shpejti do të kryejnë vepër penale.
3. Nëse autorizimi për masa të fshehta dhe teknike të hetimit dhe vëzhgimit bazohet, tërësisht apo pjesërisht, mbi dyshimin e bazuar të siguruar përmes informatave të dhëna nga informatory, dëshmitari apo dëshmitari bashkëpunues, prokurori i shtetit mund të marrë në pyetje atë informator, dëshmitar apo dëshmitar bashkëpunues.
4. Procedura penale nuk kërkohet që të jetë filluar për autorizimin nga prokurori i shtetit apo gjyqtari i procedurës paraprake të masave të fshehta dhe teknike të vëzhgimit dhe hetimit nga paragrafi 1; sidoqoftë, procedura penale fillohet posa prokurori i shtetit të ketë dyshim të arsyeshëm për identitetin e të dyshuarit apo dyshuarve që kanë kryer vepër penale.
5. Nëse masat e fshehta apo teknike të vëzhgimit apo hetimit janë autorizuar në pajtim me paragrafin 1. të këtij neni prokurori i shtetit ndërmerr masa të arsyeshme për ruajtjen e privatësisë së personave që nuk janë të përfshirë në vepër penale.
6. Nëse procedura penale autorizohet pasi ndërmarrjes së masave të fshehta apo teknike të vëzhgimit apo hetimit nga paragrafi 1. të këtij neni, prokurori i shtetit i bashkëngjet në procesverbal të procedurës penale urdhrat për masat e fshehta apo teknike të vëzhgimit apo hetimit dhe provat që rezultojnë nga to.
7. Nëse prokurori i shtetit nuk autorizon procedurë penale pas ndërmarrjes së masave të fshehta apo teknike të vëzhgimit apo hetimit nga paragrafi 1. të këtij neni, prokurori i shtetit raporton tek gjyqtari i procedurës paraprake mbi masat e ndërmarra.

Neni 85
Fshehtësia e mbledhjes së informatave

1. Nëse prokurori i shtetit autorizon masat e fshehta apo teknike të vëzhgimit apo hetimit në pajtim me nenin 84, paragrafi 1. të këtij Kodi dosja mbyllet dhe mbahet e fshehur nëse prokurori i shtetit kërkon që të mbyllet dhe tregon se ka gjasa të konsiderueshme që bërja publike e hetimit paraprak do të pengonte hetimin ose do të paraqiste rrezik për dëshmitarët dhe hetuesit.
2. Nëse prokurori i shtetit kërkon nga gjyqtari i procedurës paraprake që të urdhërojë masat e fshehta apo teknike të vëzhgimit apo hetimit, gjykata e mbyllë dosjen dhe e mban të fshehur nëse prokurori i shtetit kërkon një gjë të tillë dhe nëse tregon se ka gjasa të konsiderueshme që bërja publike e hetimit paraprak do të pengonte hetimin ose do të paraqiste rrezik për dëshmitarët dhe hetuesit.
3. Dosja mbahet e mbyllur jo më shumë se dymbëdhjetë (12) muaj ose deri në fillimin e hetimit, me ç'rast referenti i gjykatës e hap dosjen.
4. Gjyqtari i procedurës paraprak mund të urdhërojë që dosja të mbetet e mbyllur edhe për gjashtë (6) muaj tjerë vetëm nëse prokurori i shtetit arrin të dëshmojë se ka gjasa të konsiderueshme që bërja publike e hetimit paraprak do të pengonte hetimin ose do të paraqiste rrezik për dëshmitarët dhe hetuesit.
5. Masat e fshehta dhe teknike të vëzhgimit dhe hetimit

Neni 86
Kushtet për zbatimin e masave të fshehta dhe teknike të vëzhgimit dhe të hetimit

1. Masat e fshehta dhe teknike të vëzhgimit dhe hetimit mund të autorizohen në pajtim me nenin 84 të këtij Kodi.
2. Pas fillimit te procedurës penale, ose në të njëjtën kohë me aktvendimin e prokurorit të shtetit për të filluar procedurën paraprake, prokurori i shtetit mund të kërkojë nga gjyqtari i procedurës paraprake që të autorizojë masat e fshehta dhe teknikë të hetimit në pajtim me nenet 86-100 të këtij Kodi.

Neni 87
Përkufizimi i masave të fshehta dhe teknike të vëzhgimit dhe hetimit gjatë hetimit paraprak

Për qëllime të këtij Kapitulli:
1. Masa të fshehta ose teknike të vëzhgimit dhe hetimit ("masa sipas këtij kapitulli") do të thotë secila nga këto masa të mëposhtme:
   1.1. vëzhgim i fshehtë fotografik ose me video;
   1.2. monitorim i fshehtë i bisedave;
   1.3. kontrollim i dërgesave postare;
   1.4. përgjimi i telekomunikimeve dhe duhet të përdoret Lexuesi – IMSI – Identifikimi Ndërkombëtar i Shfrytëzuesit Mobil;
   1.5. përgjim i komunikimeve nëpërmjet rrjetit kompjuterik;
   1.6. dërgim i kontrolluar i dërgesave postare;
   1.7. shfrytëzim i mjeteve për përcjellje të vendndodhjes;
   1.8. blerje e simuluar e ndonjë sendi;
   1.9. stimulim i veprës së korrupsionit;
   1.10. hetim i fshehtë;
   1.11. regjistrim i thirrjeve telefonike; dhe
   1.12. zbulim i të dhënave financiare.
2. Shprehja "**vëzhgim i fshehtë fotografik ose me video"** do të thotë monitorim, vëzhgim ose incizim i personave, i lëvizjeve të tyre ose i aktiviteteve të tjera nga zyrtari i autorizuar i policisë me anë të fotografimit ose me video mjete, pa dijeninë apo pëlqimin e së paku njërit prej personave që i shtrohen kësaj mase.
3. Shprehja **"monitorim i fshehtë i bisedave"** do të thotë monitorimi, incizimi ose transkriptimi i bisedave nga zyrtari i autorizuar i policisë me anë të mjeteve teknike, pa dijeninë ose pëlqimin e së paku njërit prej personave që i shtrohen kësaj mase.
4. Shprehja "**kontrollim i dërgesave postare"** do të thotë kontrollim i letrave dhe i dërgesave të tjera postare nga zyrtari i autorizuar i policisë, që mund të përfshijë edhe përdorimin e pajimeve rëntgen.
5. Shprehja "**përgjim i telekomunikimeve"** do të thotë përgjim i komunikimeve zanore, komunikimeve tekstuale ose komunikimeve tjera përmes rrjeteve të telefonive fikse apo mobile. Kjo përfshinë çfarëdo mjeti apo sistemi tjetër të ngjashëm teknologjik që bartë të dhëna që kryesisht kanë për qëllim të jenë private.
6. Shprehja "**dërgim i kontrolluar i dërgesave postare"** do të thotë dërgim i letrave dhe i materialeve të tjera postare nga zyrtari i autorizuar i policisë.

7. Shprehja **"shfrytëzim i mjeteve për përcjellje të vendndodhjes"** do të thotë shfrytëzim nga zyrtari i autorizuar i policisë i mjeteve të cilat identifikojnë vendndodhjen e personit ose të objektit në të cilin është ngjitur.
8. Shprehja **"blerje e simuluar e ndonjë sendi"** do të thotë akt i blerjes së ndonjë sendi nga një person i dyshuar se ka kryer vepër penale që mund të shërbejë si provë në procedurën penale, ose nga personi për të cilin dyshohet të jetë viktimë e veprës penale të "Trafikimit me njerëz", siç përcaktohet në nenin 170 të Kodit Penal.
9. Shprehja **"simulim i veprës së korrupsionit"** do të thotë një veprim që është i njëjtë me veprën penale të ndërlidhur me korrupsion, por që ndryshon për shkak se kryhet me qëllim të mbledhjes së informacionit dhe provave gjatë hetimit penal.
10. Shprehja **"hetim i fshehtë"** do të thotë një ndërveprim i planifikuar i zyrtarit të autorizuar të policisë ose agjentit bashkëpunues të prokurorisë, i cili nuk është i identifikueshëm si zyrtar i autorizuar i policisë, ose i personit i cili vepron nën mbikëqyrjen e zyrtarit të autorizuar të policisë me personat e dyshuar se kanë kryer vepër penale.
11. Shprehja **"regjistrim i bisedave telefonike"** do të thotë sigurim i të dhënave të thirrjeve telefonike të bëra nga një numër i caktuar i telefonit.
12. Shprehja **"zbulim i të dhënave financiare"** do të thotë sigurim i informacionit nga banka apo ndonjë institucion tjetër financiar mbi depozitat, llogaritë ose transaksionet financiare.
13. Shprehja **"zyrtar i autorizuar gjyqësor"** do të thotë gjyqtar i procedurës paraprake ose prokuror i shtetit me autorizimin e të cilit është lëshuar urdhri sipas këtij kapitulli.
14. Shprehja **"person që i nënshtrohet urdhrit"** do të thotë person kundër të cilit është urdhëruar masa sipas këtij kapitulli.

Neni 88
Masat e fshehta dhe teknike të vëzhgimit dhe hetimit

1. Vëzhgimi i fshehtë fotografik ose me video, monitorimi i fshehtë i bisedave në vende publike, regjistrimi i thirrjeve telefonike ose zbulimi i të dhënave financiare mund të urdhërohet kundër një personi apo vendi të caktuar, nëse:
   1.1. ekziston dyshimi i bazuar se vendi është përdorur ose personi i tillë ka kryer vepër penale e cila ndiqet sipas detyrës zyrtare, ose në rastet kur tentativa është e ndëshkueshme, ka tentuar të kryejë vepër penale e cila ndiqet sipas detyrës zyrtare; dhe
   1.2. informacioni i cili mund të merret nga masat e urdhëruara ka gjasë të ndihmojë në hetimin e veprës penale dhe nuk do të kishte mundësi të merrej me masa të tjera hetimore pa shkaktuar vështirësi të paarsyeshme ose rrezik potencial për të tjerët.
2. Regjistrimi i bisedave telefonike ose zbulimi i të dhënave financiare po ashtu mund të urdhërohet kundër personave, përpos të dyshuarit, kur kushti në nën-paragrafin 1.1. të paragrafit 1. të këtij neni vlen për të dyshuarin dhe kur plotësohet parakushti nga paragrafi 1., nën-paragrafi 1.2. i këtij neni dhe ekziston dyshim i bazuar se:
   2.1. personi i tillë pranon ose transmeton komunikime që burojnë prej të

dyshuarit ose që i dedikohen të dyshuarit apo që merr pjesë në transaksionet financiare të të dyshuarit; ose

2.2. i dyshuari përdor telefonin e personit të tillë.

3. Monitorimi i fshehtë i bisedave në vende private, kontrollimi i dërgesave postare, përgjimi i telekomunikimeve, ndërhyrja e komunikimeve me anë të rrjetit kompjuterik, dërgimi i kontrolluar i dërgesave postare, shfrytëzimi i mjeteve për përcjellje të vendndodhjes, blerja e simuluar e ndonjë sendi, simulimi i një vepre të korrupsionit apo hetimi i fshehtë mund të urdhërohen kundër një personi, vendi apo sendi konkret, nëse:
   3.1. ekziston dyshim i bazuar se vendi apo sendi i tillë përdoret për kryerje të veprës penale ose personi i tillë ka kryer, apo në rastin kur tentimi ndëshkohet, ka tentuar të kryejë vepër penale nga neni 90 i këtij Kodi;
   3.2. informacioni i cili mund të merrej nga masat e urdhëruara me gjasë do të ndihmonte në hetimin e veprës penale dhe nuk do të kishte mundësi të merrej me veprime të tjera hetimore pa shkaktuar vështirësi të paarsyeshme ose rrezik potencial për të tjerët.
4. Kontrollimi i dërgesave postare, përgjimi i telekomunikimeve ose përgjimi i komunikimeve me anë të rrjetit kompjuterik po ashtu mund të urdhërohen kundër personit, përpos të dyshuarit, kur kushti nga paragrafi 3. nën-paragrafi 3.1. i këtij neni vlen për të dyshuarin dhe kur plotësohet parakushti nga paragrafi 3. nën-paragrafi 3.2. i këtij neni dhe ekziston dyshim i bazuar se:
   4.1. personi i tillë pranon ose transmeton komunikime që burojnë prej të dyshuarit ose që i dedikohen të dyshuarit; ose
   4.2. i dyshuari përdor telefonin e personit të tillë ose ka qasje në sistem kompjuterik.

Neni 89
Standardet për urdhra nga neni 88

1. Masat nga neni 88, paragrafi 2. ose paragrafi 4. të këtij Kodi mund të urdhërohen, nëse:
   1.1. ka dyshim të arsyeshëm se numri i telefonit, adresa elektronike apo llogaria financiare është përdorur për kryerjen e veprës penale, ose në rastet kur tentativa është e ndëshkueshme, është përdorur në tentativën për të kryer vepër penale nga neni 90 të këtij Kodi; dhe
   1.2. pronari apo shfrytëzuesi i numrit telefonik, adresës elektronike apo llogarisë financiare nuk është i njohur, është person juridik ose ka dyshim të arsyeshëm se numri telefonik, adresa elektronike apo llogaria financiare po përdoret nga dikush tjetër e jo nga pronari.

Neni 90
Veprat penale për të cilat mund të lëshohen urdhrat sipas nenit 88

1. Urdhri nga neni 88 i këtij Kodi mund të përdoret vetëm për hetimin e së paku një nga këto vepra të dyshuara penale:
   1.1. veprat penale të dënueshme me pesë (5) ose më shumë vjet burgim; ose

1.2. një apo më shumë nga veprat penale në vijim:
- 1.2.1. dhuna ndaj përfaqësuesve të lartë të Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 127 të Kodit Penal;
- 1.2.2. rrezikimi i rendit kushtetues me shkatërrimin apo dëmtimin e instalimeve dhe pajisjeve publike, në pajtim me nenin 128 të Kodit Penal;
- 1.2.3. sabotimi, në pajtim me nenin 129 të Kodit Penal;
- 1.2.4. spiunazhi, në pajtim me nenin 130 të Kodit Penal;
- 1.2.5. fshehja ose moslajmërimi i terroristëve dhe grupeve terroriste, në pajtim me nenin 141 të Kodit Penal;
- 1.2.6. përgatitja e veprave terroriste ose veprave penale kundër rendit kushtetues dhe sigurisë së Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 143 të Kodit Penal;
- 1.2.7. rrezikimi i negociatorëve, në pajtim me nenin 158 të Kodit Penal;
- 1.2.8. organizimi i grupeve për kryerjen e gjenocidit, krimeve kundër njerëzimit dhe krimeve të luftës, në pajtim me nenin 159 të Kodit Penal;
- 1.2.9. rrëmbimi i fluturakes, në pajtim me nenin 163 të Kodit Penal;
- 1.2.10. rrezikimi i sigurisë së aviacionit civil, në pajtim me nenin 164 të Kodit Penal;
- 1.2.11. skllavëria, kushtet e ngjashme me skllavërinë dhe puna e detyruar, në pajtim me nenin 168 të Kodit Penal;
- 1.2.12. kontrabandimi me migrantë, në pajtim me nenin 169 të Kodit Penal;
- 1.2.13. trafikimi me njerëz, në pajtim me nenin 170 të Kodit Penal;
- 1.2.14. fshehja e dokumenteve të identifikimit të viktimave të skllavërisë ose trafikimit me njerëz, në pajtim me nenin 171 të Kodit Penal;
- 1.2.15. rrezikimi i personave nën mbrojtje ndërkombëtare, në pajtim me nenin 172 të Kodit Penal;
- 1.2.16. rrezikimi i personelit të Kombeve të Bashkuara dhe i personelit në marrëdhënie me to, në pajtim me nenin 173 të Kodit Penal;
- 1.2.17. marrja e pengjeve, në pajtim me nenin 174 të Kodit Penal;
- 1.2.18. kanosja për përdorimin ose kryerjen e vjedhjes apo të grabitjes së materialit nuklear, në pajtim me nenin 176 të Kodit Penal;
- 1.2.19. rrëmbimi, në pajtim me nenin 193 të Kodit Penal;
- 1.2.20. tortura, në pajtim me nenin 198 të Kodit Penal;
- 1.2.21. cenimi i së drejtës për të kandiduar, në pajtim me nenin 209 të Kodit Penal;
- 1.2.22. kanosja e kandidatit, në pajtim me nenin 210 të Kodit Penal;
- 1.2.23. keqpërdorimi i detyrës zyrtare gjatë zgjedhjeve, në pajtim me nenin 213 të Kodit Penal;
- 1.2.24. dhënia ose marrja e ryshfetit në lidhje me votimin, në pajtim me nenin 214 të Kodit Penal;
- 1.2.25. falsifikimi i rezultateve të votimit, në pajtim me nenin 218 të Kodit Penal;
- 1.2.26. asgjësimi i dokumenteve të votimit, në pajtim me nenin 219 të Kodit Penal;

1.2.27. dhunimi, në pajtim me nenin 229 të Kodit Penal;
1.2.28. shërbimet seksuale të viktimës së trafikimit, në pajtim me nenin 230 të Kodit Penal;
1.2.29. mundësimi ose detyrimi në prostitucion, në pajtim me nenin 240 të Kodit Penal;
1.2.30. transplantimi i kundërligjshëm dhe trafikimi i organeve dhe qelizave njerëzore, në pajtim me nenin 264 të Kodit Penal;
1.2.31. ndotja e ujit të pijshëm, në pajtim me nenin 269 të Kodit Penal;
1.2.32. ndotja e artikujve ushqimorë që përdoren nga njerëzit apo kafshët, në pajtim me nenin 270 të Kodit Penal;
1.2.33. blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge, në pajtim me nenin 272 të Kodit Penal;
1.2.34. prodhimi dhe përpunimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope, analoge apo veglave, pajisjeve apo materialeve narkotike, në pajtim me nenin 273 të Kodit Penal;
1.2.35. organizimi, drejtimi apo financimi i trafikimit të narkotikëve apo substancave psikotrope, në pajtim me nenin 278 të Kodit Penal;
1.2.36. cenimi i barazisë në ushtrimin e veprimtarisë ekonomike, në pajtim me nenin 283 të Kodit Penal;
1.2.37. keqpërdorimi i autorizimeve ekonomike, në pajtim me nenin 289 të Kodit Penal;
1.2.38. falsifikimi i letrave me vlerë dhe instrumenteve të pagesës, në pajtim me nenin 292 të Kodit Penal;
1.2.39. organizimi i skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshëm, në pajtim me nenin 299 të Kodit Penal;
1.2.40. falsifikimi i parasë, në pajtim me nenin 301 të Kodit Penal;
1.2.41. Prodhimi, furnizimi, shitja, posedimi ose dhënia në shfrytëzim e mjeteve për falsifikim, në pajtim me nenin 303 të Kodit Penal;
1.2.42. shpërlarja e parave, në pajtim me nenin 307 të Kodit Penal;
1.2.43. marrëveshjet për kufizimin e konkurrencës përmes ftesave për tender, në pajtim me nenin 308 të Kodit Penal;
1.2.44. mashtrimi në shkëmbimin e letrave me vlerë, në pajtim me nenin 309 të Kodit Penal;
1.2.45. marrëveshja dhe mashtrimi me letrat me vlerë të Qeverisë, në pajtim me nenin 311 të Kodit Penal;
1.2.46. shmangia nga tatimi, në pajtim me nenin 312 të Kodit Penal;
1.2.47. pranimi i paarsyeshëm i dhuratave, në pajtim me nenin 314 të Kodit Penal;
1.2.48. dhënia e paarsyeshme e dhuratave, në pajtim me nenin 315 të Kodit Penal;
1.2.49. kontrabandimi i mallrave, në pajtim me nenin 316 të Kodit Penal;
1.2.50. shmangia nga pagesa e tarifave të detyrueshme doganore, në pajtim me nenin 317 të Kodit Penal;
1.2.51. zjarrvënia, në pajtim me nenin 333 të Kodit Penal;
1.2.52. mashtrimi, në pajtim me nenin 334 të Kodit Penal;

1.2.53. mashtrimi me subvencione, në pajtim me nenin 335 të Kodit Penal;
1.2.54. mashtrimi lidhur me pranimin e fondeve nga Komuniteti Evropian, në pajtim me nenin 336 të Kodit Penal;
1.2.55. keqpërdorimi i sigurimit, në pajtim me nenin 337 të Kodit Penal;
1.2.56. hyrja në sistemet kompjuterike, në pajtim me nenin 338 të Kodit Penal;
1.2.57. mbajtja e paligjshme e substancave dhe e mbeturinave të rrezikshme, në pajtim me nenin 347 të Kodit Penal;
1.2.58. importi, eksporti, furnizimi, transportimi, prodhimi, këmbimi, ndërmjetësimi ose shitja e paautorizuar e armëve apo materieve plasëse, në pajtim me nenin 371 të Kodit Penal;

1.3. një apo më shumë nga veprat e mëposhtme penale, nëse kryhen në lidhje me terrorizëm, korrupsion apo krim të organizuar:
1.3.1. kanosja, në pajtim me nenin 184 të Kodit Penal;
1.3.2. ngacmimi, në pajtim me nenin 185 të Kodit Penal;
1.3.3. sulmi, në pajtim me nenin 186 të Kodit Penal;
1.3.4. Lëndimi i rëndë trupor, në pajtim me nenin 188 të Kodit Penal;
1.3.5. shtrëngimi, në pajtim me nenin 194 të Kodit Penal;
1.3.6. detyrimi, në pajtim me nenin 339 të Kodit Penal;
1.3.7. shantazhi, në pajtim me nenin 340 të Kodit Penal;
1.3.8. shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm, në pajtim me nenin 364 të Kodit Penal;
1.3.9. asgjësimi, dëmtimi ose heqja e instalimeve publike, në pajtim me nenin 365 të Kodit Penal;
1.3.10. asgjësimi, dëmtimi ose heqja e pajisjeve mbrojtëse dhe rrezikimi i sigurisë në vendin e punës, në pajtim me nenin 366 të Kodit Penal;
1.3.11. dërgimi apo transportimi i kundërligjshëm i lëndëve eksplozive ose lëndëve ndezëse, në pajtim me nenin 368 të Kodit Penal;
1.3.12. përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm, në pajtim me nenin 374 të Kodit Penal;
1.3.13. pengimi i të provuarit apo procedurës zyrtare, në pajtim me nenin 393 të Kodit Penal;
1.3.14. frikësimi gjatë procedurës penale për krimin e organizuar, në pajtim me nenin 394 të Kodit Penal;
1.3.15. keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar, në pajtim me nenin 421 të Kodit Penal;
1.3.16. keqpërdorimi i informatës zyrtare, në pajtim me nenin 422 të Kodit Penal;
1.3.17. konflikti i interesit, në pajtim me nenin 423 të Kodit Penal;
1.3.18. përvetësimi në detyrë, në pajtim me nenin 424 të Kodit Penal;
1.3.19. mashtrimi në detyrë, në pajtim me nenin 425 të Kodit Penal;
1.3.20. marrja e ryshfetit, në pajtim me nenin 427 të Kodit Penal;
1.3.21. dhënia e ryshfetit, në pajtim me nenin 428 të Kodit Penal;
1.3.22. dhënia e ryshfetit zyrtarit publik të huaj, në pajtim me nenin 429 të Kodit Penal;
1.3.23. ushtrimi i ndikimit, në pajtim me nenin 430 të Kodit Penal;

1.3.24. zbulimi i fshehtësisë zyrtare, në pajtim me nenin 431 të Kodit Penal;

2. Provat e siguruara në pajtim me masën e urdhëruar ligjërisht sipas nenit 88 të këtij Kodi janë të pranueshme në shqyrtim kryesor, pa marrë parasysh nëse janë apo jo të përfshira në aktakuzë për veprat penale të cekura në këtë nen.

Neni 91
Personat kompetent për të urdhëruar dhe zbatuar masat e fshehta dhe teknike të vëzhgimit dhe hetimit

1. Prokurori i shtetit mund të urdhërojë përkohësisht njërën nga masat e përcaktuara në paragrafin 2. të këtij neni vetëm në procedura penale urgjente, ose në procedura penale, të cilat janë duke u hetuare nën kapitullin XXIV ose kapitullin XXXIV të Kodit Penal, ose rasteve të shpëlarjes së parasë në raste të nevojshme, nëse pritja do të rezultonte nga lëshimi i urdhrit prej gjyqtarit të procedurës paraprake sipas paragrafit 2. të këtij neni do të rrezikonte sigurinë e hetimeve ose jetën dhe sigurinë e palës së dëmtuar, dëshmitarit, informatorit ose anëtarëve të familjes së tyre. Urdhri i tillë i përkohshëm pushon të ketë efekt nëse nuk konfirmohet me shkrim nga gjyqtari i procedurës paraprake brenda tri (3) ditëve nga lëshimi i tij. Me rastin e vërtetimit të urdhrit të përkohshëm të prokurorit të shtetit, gjyqtari i procedurës paraprake, sipas detyrës zyrtare, do të bëjë vlerësim me shkrim të ligjshmërisë së tij.
2. Gjyqtari i procedurës paraprake, me kërkesë të prokurorit të shtetit mund të urdhërojë secilën nga masat e mëposhtme:
   2.1. fotografim të fshehtë ose vëzhgim me video në vende publike;
   2.2. monitorim të fshehtë të bisedave në vende publike;
   2.3. hetim të fshehtë;
   2.4. regjistrimi i bisedave telefonike.
   2.5. fotografim të fshehtë ose vëzhgim me video në vende private;
   2.6. monitorim të fshehtë të bisedave në vende private;
   2.7. kontrollim të dërgesave postare;
   2.8. përgjim të telekomunikimeve, përfshirë tekstet e mesazheve ose mesazhet e tjera elektronike;
   2.9. përgjim të komunikimeve me anë të rrjetit kompjuterik;
   2.10. dërgim i kontrolluar të dërgesave postare;
   2.11. shfrytëzim i mjeteve për përcjellje të vendndodhjes;
   2.12. blerje të simuluar të ndonjë sendi;
   2.13. simulim të një vepre të korrupsionit; ose
   2.14. zbulim i të dhënave financiare.
3. Kërkesa për marrjen e urdhrit për ndonjë nga masat e përcaktuara në paragrafët 1., 2. ose 3. të këtij neni bëhet me shkrim dhe përfshin të dhënat e mëposhtme:
   3.1. identitetin e zyrtarit të autorizuar policor, zyrtarit të organit të autorizuar për të zbatuar ligjin penal ose prokurorit të shtetit që bën kërkesën;
   3.2. arsyet dhe faktet që mbështesin kërkesën dhe përmbushin kushtet nga neni 88; dhe
   3.3. të dhënat lidhur me çfarëdo kërkese paraprake të njohur për paraqitësin e kërkesës që ka të bëjë me personin e njëjtë dhe veprimet e ndërmarra nga zyrtari i autorizuar gjyqësor lidhur me kërkesën e tillë.

Neni 92
Urdhrat për masat e fshehta dhe teknike të vëzhgimit dhe hetimit

1. Urdhri për ndonjë masë të caktuar nga ky kapitull i cili nuk duhet ta kalojë periudhën prej gjashtëdhjetë (60) ditëve nga data e lëshimit të këtij urdhri i cili bëhet me shkrim dhe përmban:
   1.1. emrin dhe adresën e personit ose të personave që i nënshtrohen urdhrit, nëse dihet numri i personave të prekur nga të dhënat dhe vendi i ngjarjes;
   1.2. emërtimi zyrtar i masës dhe baza ligjore e saktë e saj;
   1.3. në veçanti gjetjet e tanishme dhe gjasat reale sipas nenit 19 nën-paragrafi 1.11. të këtij Kodi;
   1.4. masa dhe koha e saktë e fillimit dhe përfundimit të saj nëse zbatohet, dhe
   1.5. personin e autorizuar për zbatimin e masës dhe zyrtarin përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të tillë.
2. Për urdhrin e lëshuar për ndonjërën masë nga ky kapitulli, nga zyrtari i autorizuar i policisë kërkohet t'i paraqesë raport zyrtarit të autorizuar gjyqësor mbi zbatimin e urdhrit brenda pesëmbëdhjetë ditëve nga dita e lëshimit të urdhrit.
3. Urdhri për vëzhgim të fshehtë fotografik ose me video në vende private, monitorim të bisedave në vende private, përgjim të telekomunikimeve, përgjim të komunikimeve nëpërmjet rrjetit kompjuterik ose shfrytëzim i mjeteve për përcjellje të vendndodhjes mund ta autorizojë zyrtarin e autorizuar të policisë të hyjë në lokale private, nëse gjyqtari i procedurës paraprake vlerëson se hyrja e tillë është e domosdoshme për të aktivizuar ose pamundësuar mjetet teknike për zbatimin e masave të tilla. Kur zyrtarët e autorizuar të policisë hyjnë në lokale private në pajtim me urdhrin nga ky paragraf, veprimet e tyre në lokalet private duhet të kufizohen në veprimet e nevojshme për të aktivizuar apo çaktivizuar pajisjet teknike.
4. Urdhri për regjistrimin e bisedave telefonike ose përgjimin e komunikimeve nëpërmjet rrjetit kompjuterik duhet të përfshijë të gjitha elementet për identifikimin e secilit telefon ose secilës pikë të qasjes në rrjetin kompjuterik që duhet të përgjohet. Përpos rasteve të parapara në paragrafin 5. të këtij neni, urdhri për përgjim të telekomunikimeve duhet të përmbajë të gjitha elementet për identifikimin e secilit telefon që duhet të përgjohet.
5. Me kërkesën e prokurorit të shtetit, urdhri për përgjimin e telekomunikimeve mund të përfshijë vetëm një përshkrim të përgjithshëm të telefonave që mund të përgjohen, kur gjyqtari i procedurës paraprake të gjykatës themelore kompetente çmon se ekziston dyshim i bazuar që:
   5.1. i dyshuari shfrytëzon telefona të ndryshëm me qëllim të shmangies nga vëzhgimi i zyrtarit të autorizuar të policisë; dhe
   5.2. një telefon apo telefonat e paraqitur në urdhër shfrytëzohen ose do të shfrytëzohen nga i dyshuari.
6. Kur urdhri për përgjimin e telekomunikimeve është lëshuar nga gjyqtari i procedurës paraprake të gjykatës themelore, në pajtim me paragrafin 5. të këtij neni:
   6.1. zyrtarët e autorizuar të policisë, pas zbatimit të urdhrit për një telefon të caktuar, menjëherë informojnë me shkrim gjyqtarin e procedurës paraprake mbi faktet e rëndësishme, duke përfshirë edhe numrin e telefonit;

6.2. urdhri nuk mund të shfrytëzohet për të përgjuar telekomunikimet e personit i cili nuk është i dyshuar; dhe

6.3. kohëzgjatja e urdhrit është e kufizuar deri në pesëmbëdhjetë (15) ditë dhe mund të ripërtërihet deri në nëntëdhjetë (90) ditë nga dita e lëshimit të urdhrit.

7. Urdhri për kontroll të dërgesave postare ose dërgim të kontrolluar të dërgesave postare duhet të përfshijë adresën në dërgesat postare që duhet të kontrollohen ose dërgohen. Adresa e tillë duhet të përputhet me atë të personit ose të personave të përfshirë në urdhër.
8. Urdhri për përgjimin e telekomunikimeve, përgjimin e komunikimeve nëpërmjet rrjetit kompjuterik, regjistrimin e thirrjeve telefonike, kontrollin e dërgesave postare, dërgimin e kontrolluar të dërgesave postare ose zbulimin e të dhënave financiare duhet të përfshijë si shtesë udhëzimin e veçantë me shkrim për personat, përveç zyrtarëve të autorizuar të policisë, ndihma e të cilëve mund të jetë e nevojshme për zbatimin e urdhrit. Udhëzimi i tillë me shkrim duhet t'i dërgohet drejtorit ose zyrtarit përgjegjës të sistemit të telekomunikimeve, rrjetit kompjuterik, shërbimit postar, bankës ose institucioneve të tjera financiare dhe duhet të përfshijë vetëm informacionin që kërkohet për ndihmë në zbatimin e urdhrit.

Neni 93
Zbatimi i urdhrit për masat e fshehta dhe teknike të vëzhgimit dhe hetimit

1. Zyrtari i autorizuar i policisë fillon zbatimin e urdhrit për zbatimin e ndonjë mase nga ky Kapitull jo më vonë se pesëmbëdhjetë ditë nga dita e lëshimit.
2. Zbatimi i urdhrit kryhet në atë mënyrë që të minimizojë përgjimin e komunikimeve të cilat në të kundërtën nuk i nënshtrohen përgjimit sipas këtij kapitulli.
3. Nëse ndonjë prej kushteve për urdhërimin e masave pushon të vlejë, zyrtari i autorizuar i policisë duhet të pezullojë zbatimin e urdhrit dhe të njoftojë me shkrim zyrtarin e autorizuar gjyqësor. Nëse urdhri është lëshuar nga gjyqtari i procedurës paraprake, zyrtari i autorizuar i policisë duhet po ashtu ta njoftojnë prokurorin e shtetit. Me pranimin e njoftimit me shkrim, prokurori i shtetit ose gjyqtari kompetent duhet të sjellë vendim me shkrim për ndërprerjen e urdhrit.
4. Zyrtari i autorizuar i policisë shënon kohën dhe datën e fillimit dhe të përfundimit të secilit veprim të ndërmarrë për zbatimin e urdhrit. Në procesverbal shënohen emrat e zyrtarëve të autorizuar të policisë të cilët kanë ndërmarrë cilindo veprim dhe funksion. Procesverbalit të tillë i bashkëngjiten raportet që i dorëzohen prokurorit të shtetit apo gjyqtarit kompetent sipas nenit 92, paragrafi 2. i këtij Kodi.
5. Me rastin e zbatimit të urdhrit për përgjimin e telekomunikimeve, përgjimin e komunikimeve nëpërmjet rrjetit kompjuterik, kontrollin e dërgesave postare, dërgimin e kontrolluar të dërgesave postare dhe regjistrimin e thirrjeve telefonike, personat përgjegjës për punën me telekomunikimet, rrjetat kompjuterike ose shërbimet postare duhet të lehtësojnë zbatimin e urdhrit nën mbikëqyrjen e drejtorit ose të zyrtarit përgjegjës për sistemin e telekomunikimeve, rrjetin kompjuterik ose shërbimin postar.
6. Me rastin e zbatimit të urdhrit për zbulimin e të dhënave financiare, punonjësit e institucionit financiar duhet të lehtësojnë zbatimin e urdhrit të tillë nën mbikëqyrjen e drejtorit ose të zyrtarit përgjegjës të institucionit financiar.

7. Zyrtari i autorizuar i policisë ose personi i cili vepron nën mbikëqyrjen e zyrtari të autorizuar të policisë mund të bëjë blerje të simuluar të sendit ose simulim të një vepre të korrupsionit.
8. Me rastin e zbatimit të urdhrit për hetime të fshehta, simulim të blerjes së një sendi ose simulim të një vepre të korrupsionit:
   8.1. personi i cili zbaton urdhrin nuk mund të nxisë personin tjetër të kryejë vepër penale të cilën personi nuk do ta kryente sikur të mos ishte intervenimi i personit i cili zbaton urdhrin; dhe
   8.2. personi, i cili në pajtim me dispozitat e këtij Kapitulli zbaton urdhrin e tillë, nuk kryen vepër penale.
9. Procedura penale nuk fillohet për vepër penale e cila është nxitur me shkeljen e paragrafit 8. të këtij neni.
10. Me rastin e zbatimit të urdhrit për përgjimin e telekomunikimeve, përgjimit të komunikimeve nëpërmjet rrjetit kompjuterik ose kontrollimit të dërgesave postare, urdhri i tillë nuk mund të zbatohet për komunikimet ndërmjet të dyshuarit dhe mbrojtësit të tij, përveç nëse ekziston dyshim i bazuar se i dyshuari dhe mbrojtësi i tij janë angazhuar së bashku në veprimtari kriminale që përbën bazën e urdhrit.

Neni 94
Zgjatja e urdhrit për masat e fshehta dhe teknike të vëzhgimit dhe hetimit

1. Prokurori i shtetit apo gjyqtari kompetent nuk mund të lëshojë urdhër tjetër me shkrim për zgjatjen e urdhrit sipas këtij Kapitulli, përveç nëse parakushtet për urdhërimin e masës sipas këtij Kapitulli, siç është paraparë në nenin 88 të këtij Kodi, vazhdojnë të vlejnë dhe ka shpjegim të arsyeshëm për dështimin në sigurimin e disa të dhënave apo të të gjitha të dhënave të kërkuara sipas urdhrit të mëparshëm.
2. Urdhri për vëzhgim të fshehte fotografik ose me video në vende publike, monitorim të fshehtë të bisedave, kontroll të dërgesave postare, përgjim të komunikimeve nëpërmjet rrjetit kompjuterik, dërgim i kontrolluar i dërgesave postare, shfrytëzim i mjeteve për përcjellje të vendndodhjes, hetim të fshehtë, regjistrim të thirrjeve telefonike ose zbulim të të dhënave financiare mund të zgjatet më së shumti deri në gjashtëdhjetë ditë, i cili urdhër mund të ripërtërihet brenda afatit prej treqindegjashtëdhjetë (360) ditësh nga dita e lëshimit të urdhrit.
3. Urdhri për vëzhgim të fshehte fotografik ose me video në vende private apo përgjimi i telekomunikimeve mund të zgjatet deri në gjashtëdhjetë (60) ditë, por mund të ripërtërihet edhe për gjashtëdhjetë (60) ditë të tjera.
4. Urdhri për blerje të simuluar të sendit ose për simulim të veprës së korrupsionit autorizohet vetëm për një blerje të sendit ose për një vepër të simuluar të korrupsionit. Zyrtari i autorizuar gjyqësor mund të lëshojë urdhër tjetër për personin e njëjtë kur parakushtet për urdhërimin e masës sipas këtij Kapitulli, siç parashihet në nenin 88 të këtij Kodi, vazhdojnë të zbatohen dhe ka shpjegim të arsyeshëm për dështimin në sigurimin e ndonjë ose të gjitha të dhënave të kërkuara me urdhrin e mëparshëm.
5. Zyrtari i autorizuar gjyqësor në çdo kohë mund të ndryshojë urdhrin kur ai çmon se ndryshimi i tillë është i nevojshëm për të siguruar se parakushtet për urdhërimin e masës sipas këtij Kapitulli, siç parashihet në nenin 88 të këtij Kodi, vlejnë edhe më tutje.

6. Zyrtari i autorizuar gjyqësor në çdo kohë mund të pushojë urdhrin kur çmon se parakushtet për urdhërimin e masës, siç është paraparë në nenin 88 të këtij Kodi, pushojnë të vlejnë.
7. Vazhdimi i urdhrit për masën e urdhëruar nga gjyqtari i procedurës paraprake mund të urdhërohet vetëm me propozim të prokurorit të shtetit.

Neni 95
Materialet e siguruara me masa të fshehta dhe teknike të vëzhgimit dhe hetimit

1. Pasi të përfundojë zbatimi i masës sipas këtij kapitulli, zyrtari i autorizuar i policisë duhet t'ia dërgojë prokurorit të shtetit të gjitha materialet e mbledhura, ku bëjnë pjesë të gjitha shkresat, shiritat dhe sendet tjera lidhur me urdhrin dhe zbatimin e tij.
2. Materialet mund të mbyllen dhe të mbahen në fshehtësi nëse prokurori i shtetit konsideron që bërja publike e tyre do të pengonte hetimin e mëvonshëm ose do të paraqiste rrezik për të dëmtuarit, dëshmitaret, hetuesit ose personat tjerë.
3. Dërgesat postare të cilat nuk përmbajnë të dhëna që do të ndihmonin hetimin e një vepre penale menjëherë duhet dërguar marrësit.

Neni 96
Të drejtat e personave ndaj të cilëve zbatohet urdhri sipas nenit 88

1. Përderisa nuk përcaktohet ndryshe, masat në bazë të nenit 86 deri 100 të këtij Kodi do t'i nënshtrohen këtyre kushteve:
2. Vendimet dhe dokumentacioni tjetër lidhur me masat, konform neneve 86 deri 100 të këtij Kodi do të depozitohen në zyrën e prokurorisë së Shtetit. Ato do t'i shtohen dosjeve vetëm nëse plotësohen kërkesat për njoftim në kuptim të paragrafit 5. të këtij neni
3. Të dhënat personale të cilat janë marrë me anë të masave në kuptim të neneve 86-100 të këtij Kodi duhet të etiketohen siç duhet. Pas bartjes së shënimeve tek Agjencia tjetër, etiketimi bëhet nga ajo agjenci.
4. Personat vijues do të njoftohen për masat në bazë të neneve 86 deri 100 të këtij Kodi:
   4.1. në rastin e nenit 87 nën-paragrafit 1.1. dhe 1.7. të këtij Kodi personi i synuar dhe personat e tjerë që janë prekur ndjeshëm me këtë;
   4.2. në rastin e nenit 87 nën-paragrafit 1.2. të këtij Kodi nëse ka pasur monitorim të fshehtë të bisedave në vende private, personi i synuar dhe personat e tjerë që janë prekur ndjeshëm në këtë mënyrë.
   4.3. në rastin e nenit 87 nën-paragrafit 1.2. të këtij Kodi nëse ka pasur monitorim të fshehtë të bisedave në vende private:
      4.3.1. personi i akuzuar, kundër të cilit është drejtuar masa;
      4.3.2. personave tjerë nën vëzhgim;
      4.3.3. personat që kanë poseduar ose jetuar në lokale private nën vëzhgim në kohën kur masa ka hyrë në fuqi;
   4.4. në rastin e nenit 87 nën-paragrafit 1.3. të këtij Kodi dërguesi dhe i adresuari i dërgesave postare;
   4.5. në rastin e nenit 87 nën-paragrafit 1.4. të këtij Kodi pjesëmarrësit në

telekomunikime nën vëzhgim, ose, nëse është përdorë ndonjë lexuesi IMSI, personi i synuar.

4.6. në rastin e nenit 87 nën-paragrafit 1.11. të këtij Kodi pjesëmarrësit në telekomunikacionin përkatës;

4.7. në rastin e nenit 87 nën-paragrafit 1. 10. të këtij Kodi:

4.7.1. personi i synuar;

4.7.2. personat të prekur ndjeshëm në këtë mënyrë;

4.7.3. personat, lokalet private të të cilëve përgjithësisht nuk kanë qasje të publikut regjistrohen nga hetuesi i fshehtë. Në njoftim, duhet përmendet opsioni i pastajmë i shkarkimit gjyqësor të gjykatës, në pajtim me paragrafin 7. të këtij neni dhe afatit të zbatueshëm kohor. Njoftimi përjashtohet kur interesat thelbësore të një personi të prekur, i cili e meriton mbrojtjen përbëjnë pengesë me këtë. Hetimet për përcaktimin e identitetit të ndonjë personi të radhitur në fjalinë e parë duhet të zbatohen vetëm nëse kjo paraqitet e nevojshme duke pasur parasysh shkallën pushtimit të masës lidhur me personin përkatës, orvatja e shoqëruar me vërtetimin e identitetit të tyre, si dhe dëmin rezultues ndaj personave të tillë ose personat e tjerë.

5. Njoftimi bëhet sa më shpejt që mund të fuqizohet pa e rrezikuar qëllimin e hetimit, jetën, integritetin fizik dhe lirinë personale të tjetrit, ose pasuritë e rëndësishme, në rastin e nenit 87 nën-paragrafët 1.1. dhe 1.10. të këtij Kodi përfshirë edhe mundësinë e shfrytëzimit të vazhdueshëm të hetuesit të fshehtë. Nëse njoftimi vonohet në kuptim të fjalisë së parë, arsyet duhet të dokumentohen në dosje.
6. Nëse njoftimin vonohet në kuptim të paragrafit 5. të këtij neni dhe se nuk është bërë brenda dymbëdhjetë (12) muajve pas përmbushjes së masës, çdo vonesë tjetër e njoftimit duhet t'i nënshtrohet miratimit të gjykatës. Gjykata vendos për kohëzgjatjen e vonesave të tjera. Gjykata mund ta aprovojë lejimin e përhershëm më njoftim nëse ka mundësi që kufizon sigurinë që kushtet për njoftim nuk do të përmbushën, madje edhe në të ardhmen. Nëse janë zbatuar disa masa brenda një periudhe të shkurtër kohore, afati kohor i përmendur në fjalinë e parë fillon pas përfundimit të masës së fundit. Në rastin e nenit 87 paragrafët 1. dhe 2. afati kohor i përmendur në fjalinë e parë do të jetë gjashtë (6) muaj.
7. Vendimet gjyqësore, në kuptim të paragrafit 6. të këtij neni, merren nga gjykata kompetente për ta urdhëruar masën. Në të gjitha rastet e tjera, Gjykata e cila shtrihet në vendin ku gjendet edhe zyra e prokurorisë së Shtetit do të jetë kompetente. Madje edhe pas përfundimit të masës dhe deri në dy (2) javë, pas njoftimit të tyre, personat e emëruar në paragrafin 4. të këtij neni, fjalia e parë, mund të paraqesin kërkesë në gjykatën kompetente, në pajtim me fjalinë e parë, për rishikimin e ligjshmërisë së masës, si dhe mënyrës dhe mjeteve të zbatimit të saj. Në ankesë e menjëhershme kundër vendimit është e pranueshme. Nëse akuzat publike janë parashtruar dhe se personi i akuzuar është njoftuar, gjykata që ka marrë rastin vendos për kërkesën në vendimin e saj përfundimtar.
8. Të dhënat personale të marra me anë të masës e cila nuk është më e nevojshme për qëllimin e ndjekjes penale ose të një rishqyrtimit nga gjykata e masës fshihet pa ndonjë vonesë. Fakti i shtyrjes duhet të dokumentohet. Përderisa fshirja e të dhënave është shlyer thjesht për qëllimet e rishikimit të masës nga ana e gjykatës,

shënimet nuk do të përdoren për qëllime të tjera pa pëlqimin e personit në fjalë; qasja në të dhëna duhet të kufizohet në mënyrën e duhur.

9. Prokurori shtetëror duhet ta njoftojë me përpikëri me shkrim me anë të postës me rekomande çdo person të ndonjë urdhri, në pajtim me paragrafin 4. të këtij neni se ai ose ajo ka qenë subjekt i atij urdhri dhe se ka të drejtë të parashtrojë padi në gjykatën kompetente brenda gjashtë (6) muajve nga data e njoftimit.

Neni 97
Pranueshmëria e provave të siguruara me anë të urdhrit për masat e fshehta dhe teknike të vëzhgimit dhe hetimit

1. Prova e marrë nëpërmjet masës nga ky kapitull është e papranueshme nëse urdhri për masën dhe zbatimin e saj është i kundërligjshëm.
2. Prova e cila është marrë nga monitorimi i fshehtë i bisedave në vende private, kontrollimi i dërgesave postare, përgjimi i telekomunikimeve, përgjimi i komunikimeve nëpërmjet rrjetit kompjuterik, dërgimi i kontrolluar i dërgesave postare, shfrytëzim i mjeteve për përcjellje të vendndodhjes, simulimi i blerjes së ndonjë sendi, simulimi i një vepre të korrupsionit ose hetimi i fshehtë lejohen vetëm në procedurë penale lidhur me veprën penale të përcaktuar në nenin 88, paragrafi 3. i këtij Kodi.
3. Pas ngritjes së aktakuzës, gjyqtari i vetëm gjykues apo kryetari i trupit gjykues vlerëson kundërshtimet e të pandehurit lidhur me pranueshmërinë e provave të mbledhura, nëse kundërshtimi paraqitet para shqyrtimit të dytë. Kundër vendimit mbi kundërshtimin nga ky paragraf mund të paraqitet ankesë.
4. Në çdo kohë para se aktgjykimi të merr formën e prerë, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues sipas detyrës zyrtare mund të shqyrtojë pranueshmërinë e materialeve të mbledhura nga neni 88 i këtij Kodi për shkelje të të drejtave kushtetuese të të pandehurit nëse ka indikacione se materialet janë mbledhur në mënyrë të kundërligjshme.
5. Kur aktvendimi për paligjshmërinë e urdhrit ose të zbatimit të tij merr formën e prerë, gjyqtari i vetëm gjykues apo kryetari i trupit gjykues i cili drejton procedurën heq tërë materialin e mbledhur nga procesverbali dhe materialet e tilla ia dërgon Panelit për Shqyrtimin e Vëzhgimit dhe Hetimit nëpërmjet kryetarit të gjykatës themelore për vendim mbi kompensim.

Neni 98
Paneli për Shqyrtimin e Vëzhgimit dhe Hetimit

1. Paneli për Shqyrtimin e Vëzhgimit dhe Hetimit duhet të:
   1.1. marrë vendim mbi ankesën e ushtruar sipas paragrafit 5 të këtij neni lidhur me masën ose urdhrin për masë sipas këtij kapitulli dhe të vendosë mbi kompensimin përkatës; ose
   1.2. vendos mbi kompensimin për personin ose personat që i nënshtrohen urdhrit sipas këtij kapitulli kur gjyqtari ka marrë aktvendim të formës së prerë sipas nenit 97, paragrafi 3 i këtij Kodi se urdhri ose zbatimi i tij është i kundërligjshëm.

2. Paneli për Shqyrtimin e Vëzhgimit dhe Hetimit përbëhet nga tre gjyqtarë të cilët emërohen nga kryetari i gjykatës themelore për të vendosur mbi ankimin konkret ose kompensimin ndaj aktvendimit konkret nga neni 97, paragrafi 3. i këtij Kodi. Asnjëri prej tre anëtarëve Panelit për Shqyrtimin e Vëzhgimit dhe Hetimit nuk duhet të jetë profesionalisht i lidhur me personin që i nënshtrohet ankesës ose me materialet e mbledhura që i nënshtrohen aktvendimit nga neni 97, paragrafi 3. i këtij Kodi.
3. Zyrtarët e autorizuar të policisë dhe prokurorët e shtetit i sigurojnë Panelit për Shqyrtimin e Vëzhgimit dhe Hetimit dokumentet të cilat ky panel i kërkon për kryerjen e funksioneve të tij dhe, sipas kërkesës së këtij paneli, i siguron edhe deklarime gojore.
4. Kur merr formën e prerë aktvendimi i gjyqtarit sipas të cilit urdhri për masën apo zbatimin e saj sipas këtij kapitulli është i kundërligjshëm, aktvendim i tillë është detyrues për Panelin për Shqyrtimin e Vëzhgimit dhe Hetimit.
5. Kur personi konsideron se i është nënshtruar një mase të kundërligjshme sipas këtij kapitulli apo një urdhri të kundërligjshëm për një masë nga ky kapitull, ai mund të paraqesë ankesë tek kryetari i gjykatës themelore, i cili, nëse pretendohet ndonjë shkelje e ligjit, emëron Panelin për Shqyrtimin e Vëzhgimit dhe Hetimit për të vendosur.
6. Kur me rastin e vendosjes mbi ankesën, Paneli për Shqyrtimin e Vëzhgimit dhe Hetimit konstaton se masa nga ky kapitull është e kundërligjshme ose urdhri për masën e tillë është i kundërligjshëm, mund të vendos që:
   6.1. të pushojë urdhrin nëse ende është në fuqi;
   6.2. të urdhërojë asgjësimin e materialeve të mbledhura; dhe
   6.3. të kompensojë personin ose personat që i janë nënshtruar urdhrit.

Neni 99
Ndihma nga organet tjera për zbatimin e masave

Policia, sipas nevojës, mund të kërkojë ndihmën e organeve të tjera përgjegjëse për zbatimin e ligjit, sigurimin e rendit dhe të një ambienti të sigurt në Kosovë lidhur me zbatimin e masave nga ky kapitull.

Neni 100
Vëzhgimi dhe hetimi për shërbime doganore dhe shërbime tjera të ngjashme

Dispozitat e këtij kapitulli, pa paragjykuar kompetencat e personave zyrtarë sipas ligjit në fuqi, vlejnë për zbatim të vëzhgimit dhe hetimit me rastin e ofrimit të shërbimeve doganore dhe shërbimeve të tjera të ngjashme.

4. FILLIMI I PROCEDURËS PENALE
A. Fillimi i fazës së hetimit formal

Neni 101
Fillimi i procedurës penale me fazën e hetimit formal apo ngritjen e aktakuzës

1. Kur policia apo ndonjë agjenci tjetër qeveritare bën kallëzim tek prokurori i shtetit për një dyshim të arsyeshëm për një vepër, prokurori i shtetit mund të fillojë fazën e hetimit të procedurës penale sipas nenit 102 të këtij Kodi.
2. Kur policia apo ndonjë person tjetër bën kallëzim tek prokurori i shtetit për një dyshim të arsyeshëm për një vepër penale ose për disa vepra penale, asnjëra nga të cilat nuk dënohet me më shumë se tre vjet burgim, dhe prokurori i shtetit vlerëson se ekziston dyshim i bazuar mirë për të mbështetur aktakuzën, prokurori i shtetit mund të ngrit aktakuzë sipas nenit 241 të këtij Kodi.
3. Në çdo kohë, i dyshuari nga ky nen mund të pranojë fajësinë për akuzën në pajtim me nenin 233 të këtij Kodi.

Neni 102
Fillimi i hetimit

1. Prokurori i shtetit mund të fillojë hetimin në bazë të kallëzimit të policisë apo burimeve tjera, nëse ka dyshim të arsyeshëm se po ndodh ose ka gjasë të ndodh në një të ardhme të afërt vepra penale e cila ndiqet sipas detyrës zyrtare.
2. Hetimi paraprak fillohet me vendim të prokurorit të shtetit nga neni 104 të këtij Kodi.

Neni 103
Parimet e përgjithshme të fazës së hetimit

1. Gjatë fazës së hetimit, prokurori i shtetit çmon jo vetëm rrethanat dhe provat fajësuese por edhe ato shfajësuese, dhe siguron marrjen e provave të cilat mund të mos jenë të mundshme në shqyrtim gjyqësor.
2. Qëllimi i hetimit është që të mblidhen provat dhe të dhënat e nevojshme për të vendosur nëse duhet të ngritet aktakuza apo të pushohet procedura dhe për të mbledhur prova të cilat mund të jetë e pamundshme apo e vështirë që të riprodhohen në shqyrtim gjyqësor.
3. Çdo person për të cilin prokurori i shtetit ka dyshim të arsyeshëm se ka kryer vepër penale duhet të ceket si i pandehur në aktvendimin për fillimin e hetimit. Çdo i pandehur i cekur në vendim gëzon të gjitha të drejtat që i takojnë të pandehurit me këtë Kod.
4. Nëse prokurori i shtetit mëson për kryerjen e një vepre tjetër penale ose për një të dyshuar tjetër gjatë hetimit, prokurori i shtetit mund të fillojë një hetim të ri për veprën e re penale apo të dyshuarit, ose mund të zgjerojë hetimin ekzistues. Prokurori i shtetit njofton gjyqtarin e procedurës paraprake për aktvendimet e reja apo të ndryshuara.

Neni 104
Aktvendimi për fillimin e fazës së hetimit

1. Hetimi fillohet me aktvendim të prokurorit të shtetit. Aktvendimi përcakton personin kundër të cilit do të kryhet hetimi, kohën e fillimit të hetimit, përshkrimin e veprës e cila tregon elementet e veprës penale, emërtimin ligjor të veprës penale, rrethanat dhe faktet që e justifikojnë dyshimin e arsyeshëm për veprën penale, nëse masat e fshehta dhe teknike të vëzhgimit apo hetimit janë autorizuar dhe provat me të dhënat e mbledhura deri në atë moment. Një kopje e aktvendimit të hetimit i dërgohet pa vonesë gjyqtarit të procedurës paraprake.
2. Rezultatet e veprimeve fillestare të policisë dhe mbledhjës së provave janë pjesë e lëndës hetimore.
3. Pas nxjerrjes së aktvendimit nga ky nen, hetimi zbatohet dhe mbikëqyret nga prokurori i shtetit.
4. Prokurori i shtetit mund të ndërmerr veprime hetimore ose të autorizojë policinë që të ndërmerr veprime hetimore lidhur me mbledhjen e provave.
5. Hetimi kryhet vetëm lidhur me veprën penale dhe me të pandehurin e përcaktuar në aktvendimin mbi fillimin e hetimit apo në aktvendimin e ndryshuar.
6. Aktvendimit nga ky nen mund ti bashkëngjitet kërkesa për urdhër të gjykatës sipas nenit 105 të këtij Kodi.
7. Aktvendimit nga ky nen mund ti bashkëngjitet kërkesa për urdhër të gjykatës sipas Kapitullit XVIII të këtij Kodi.
8. Aktvendimit nga ky nen mund ti bashkëngjitet urdhri për ngrirjen e përkohshme të pasurisë në pajtim me Kapitullin XVII të këtij Kodi.

B. Kontrolli dhe konfiskimi

Neni 105
Kontrolli dhe sekuestrimi i përkohshëm

1. I pandehuri në mënyrë vullnetare mund të jap pëlqimin e tij me shkrim për kontrollin e pronës nga ky kapitull. Sendet e gjetura gjatë kontrollit nga ky paragraf mund të sekuestrohen përkohësisht dhe janë provë e pranueshme në shqyrtim gjyqësor dhe në procedurë tjetër.
2. Sendet e gjetura gjatë kontrollit për të cilin i pandehuri nuk ka dhënë pëlqimin nuk mund të sekuestrohen përkohësisht dhe janë provë e papranueshme, përveç nëse përcaktohet ndryshe me këtë nen.
3. Me kërkesë të prokurorit të shtetit, në çdo kohë gjatë fazës së hetimit, gjyqtari i procedurës paraprake mund të urdhërojë kontrollin e një shtëpie, të lokaleve të tjera dhe të pronës së të pandehurit kur ekziston dyshim i bazuar se personi i tillë ka kryer vepër penale dhe kur ka shkak të bazuar që kontrolli do të rezultojë me arrestimin e personit të tillë ose me zbulimin dhe sekuestrimin e provave të rëndësishme për procedurën penale.
4. Gjyqtari i procedurës paraprake mund të urdhërojë kontrollin e një shtëpie apo të lokaleve të tjera dhe të pasurisë së një personi që nuk dyshohet për vepër penale vetëm në rastet kur:

4.1. ka gjasa reale se kontrolli do të rezultojë me arrestimin e të pandehurit; ose
4.2. është e nevojshme të ruhen provat e veprës penale apo të konfiskohen sendet përkatëse të cilat nuk mund të ruhen apo të sigurohen pa zbatimin e kontrollit dhe kur ka gjasa reale se provat ose sendet e tilla ndodhen në lokalet apo në pasurinë që i nënshtrohet kontrollit.

5. Gjyqtari i procedurës paraprake mund të urdhërojë kontrollin personal të një personi të caktuar kur ka gjasa reale se ky kontroll do të rezultojë në zbulimin e gjurmëve ose në konfiskimin e provave të një vepre penale.
6. Urdhërkontrolli lëshohet me shkrim në bazë të kërkesës me shkrim të prokurorit të shtetit, ndërsa në raste të ngutshme lëshohet në bazë të kërkesës me shkrim të zyrtarit të autorizuar të policisë
7. Urdhërkontrolli përfshin: identifikimin e vendit apo personit kundër të cilit lëshohet urdhri, përshkrimin e veprës penale për të cilën lëshohet urdhri, shpjegimin e arsyeve për shkak të bazuar në pajtim me këtë nen, përshkrimin e sendeve të kërkuara me kontroll, përshkrimin e veçantë të personit, të lokaleve apo të pasurisë ku zbatohet kontrolli dhe informacionin tjetër të nevojshëm për zbatimin e kontrollit.
8. Nëse ka shkak të bazuar për të kontrolluar pajisjet elektronike, përfshirë por pa u kufizuar në kompjutera, kamera, telefona celularë, pajisje elektronike mobile ose pajisje elektronike mobile për ruajtje, urdhërkontrolli duhet të autorizojë sekuestrimin e përkohshëm të pajisjes apo pajisjeve të tilla dhe duhet të përshkruajë llojin e të dhënave elektronike për të cilat zyrtari i autorizuar i policisë mund të kontrollojë dhe t'i kopjoj.
9. Dispozitat e këtij neni dhe të neneve të tjera që i referohen kontrollit të shtëpisë, lokaleve të tjera dhe pronës zbatohen përshtatshmërisht gjatë kontrollit të vendeve të fshehta në vetura ose në mjete të tjera të transportit.

Neni 106
Kufizimet në ekzekutimin e urdhërkontrollit

1. Urdhërkontrollin e ekzekutojnë zyrtarët e autorizuar të policisë me ndihmën e nevojshme të zyrtarëve të tjerë të policisë brenda dyzet e tetë (48) orëve nga lëshimi i urdhrit.
2. Në parim, zyrtarët e autorizuar të policisë e ekzekutojnë urdhrin e kontrollit brenda orës 06:00 dhe 22:00. Përjashtimisht, kontrolli mund të zbatohet jashtë kësaj kohe kur ka filluar brenda kësaj kohe e nuk është përfunduar në orën 22:00 ose kur ka arsye nga neni 110 i këtij Kodi, apo nëse gjyqtari i procedurës paraprake çmon që vonesa do të mund të çonte në arratisjen e personit të kërkuar ose në asgjësimin e gjurmëve ose provave të veprës penale dhe lejon kontroll jashtë orarit të paraparë nga ky paragraf.

Neni 107
Procedura para fillimit të kontrollit dhe të drejtat e të pandehurit

1. Para fillimit të kontrollit, zyrtari i autorizuar i policisë ia prezanton urdhrin personit të cilit i drejtohet ky urdhër dhe atë e njofton se ka të drejtë të kontaktojë me avokatin i cili ka të drejtë të jetë i pranishëm gjatë kontrollit.

2. Kur personi kërkon praninë e avokatit gjatë kontrollit, zyrtarët e autorizuar të policisë shtyjnë kontrollin derisa të arrijë avokati, por jo më shumë se dy (2) orë nga njoftimi i avokatit për kontroll. Ndërkohë, zyrtarët e autorizuar të policisë mund të kufizojë lëvizjen e personit përkatës dhe personave të tjerë në lokalet që do të kontrollohen. Në raste të ngutshme, zyrtarët e autorizuar të policisë mund të fillojnë kontrollin edhe para mbarimit të afatit kohor për ardhjen e avokatit.
3. Para fillimit të kontrollit, zyrtarët e autorizuar të policisë kërkojnë nga personi që vullnetarisht të dorëzojë personin ose sendet që kërkohen.
4. Përjashtimisht, kontrolli mund të fillojë pa prezantimin e urdhrit ose pa kërkesë të mëparshme për dorëzim të personit apo të sendeve të kërkuara, kur pritet rezistencë e armatosur ose kur ka mundësi të dështojë efekti i kontrollit nëse ai nuk zbatohet menjëherë dhe pa paralajmërim ose kur kontrolli zbatohet në lokale publike.

Neni 108
Kufizimet në kontroll

1. Gjatë kontrollit të shtëpisë ose të lokaleve të tjera personi, shtëpia, lokalet ose pasuria e të cilit kontrollohen ose përfaqësuesi i tij kanë të drejtë të jenë të pranishëm.
2. Gjatë kontrollit të personit, shtëpisë ose lokaleve të tjera kërkohet të jenë të pranishëm dy persona të rritur si dëshmitarë. Para fillimit të kontrollit, dëshmitarët paralajmërohen që me kujdes të vëzhgojnë zbatimin e kontrollit dhe njoftohen mbi të drejtën e tyre për të bërë vërejtje, nëse kanë, për përmbajtjen e procesverbalit të kontrollit para se të nënshkruhet.
3. Kontrolli i një femre zbatohet vetëm nga zyrtarja policore femër dhe dëshmitarët duhet të jenë femra.
4. Kontrolli i lokaleve të banimit zbatohet me kujdes për të mos prishur qetësinë. Lokalet e mbyllura, mobilet ose sendet tjera mund të hapen me forcë vetëm kur pronari nuk është i pranishëm ose refuzon hapjen e tyre në mënyrë vullnetare. Gjatë hapjes së këtyre objekteve me kujdes duhet shmangur dëmtimeve të panevojshme.
5. Kontrolli i personit mund të përfshijë kontrollin intim, i cili zbatohet nga mjeku ose infermieri i kualifikuar, në pajtim me rregullat e shkencës së mjekësisë dhe me respektim të plotë të dinjitetit të personit.
6. Kur kontrolli zbatohet në lokalet e organit publik, kryesuesi i tij thirret të jetë i pranishëm gjatë kontrollit.
7. Për çdo kontroll të personit, të shtëpisë ose të lokaleve përpilohet procesverbali. Procesverbali i tillë nënshkruhet nga personi i kontrolluar ose nga personi, lokalet apo pasuria e të cilit është kontrolluar, avokati i tij nëse është i pranishëm gjatë kontrollit dhe personat, prania e të cilëve është e detyruar. Gjatë zbatimit të kontrollit mund të konfiskohen vetëm sendet dhe shkresat lidhur me qëllimin e kontrollit të caktuar. Sendet dhe shkresat e konfiskuara përfshihen dhe përshkruhen qartë në procesverbal dhe shënohen në vërtetimin që menjëherë i jepet personit sendet dhe shkresat e të cilit janë konfiskuar.
8. Sendet dhe shkresat e konfiskuara gjatë kontrolli mbahen në kontejnerët përkatës ose në qese transparente të plastikës dhe zyrtari i autorizuar i policisë dhe prokurori i shtetit mbajnë procesverbal mbi mbikëqyrjen për secilin send apo grup të shkresave.

Neni 109
Kontrabanda ose provat që nuk kanë lidhje me bazën e kontrollit

Nëse gjatë kontrollit të personit, shtëpisë ose lokaleve gjenden sende të cilat nuk kanë të bëjnë me veprën penale për të cilën është zbatuar kontrolli, por që tregojnë një vepër tjetër penale që ndiqet sipas detyrës zyrtare, këto sende gjithashtu përshkruhen në procesverbal, konfiskohen dhe menjëherë lëshohet vërtetimi për konfiskim. Prokurorit të shtetit menjëherë i dërgohet njoftimi në mënyrë që të fillojë procedure penale apo të ndryshojë procedurën penale ekzistuese. Sendet e konfiskuara kthehen menjëherë kur prokurori i shtetit konstaton se nuk ka bazë për ndjekje penale, e as ndonjë bazë tjetër ligjore për konfiskimin e sendeve.

Neni 110
Arsyet për kontroll pa urdhër të gjykatës

1. Kur është e domosdoshme dhe në masë të nevojshme, zyrtarët policor mund të hyjnë në shtëpinë dhe lokalet tjera të personit dhe të zbatojnë kontrollin pa urdhrin e gjyqtarit të procedurës paraprake nëse:
   1.1. personi përkatës me dije dhe me vullnet jep pëlqimin për kontroll;
   1.2. Personi thërret për ndihmë;
   1.3. kryerësi i kapur në flagrancë gjatë kryerjes së veprës penale duhet arrestuar pas ndjekjes;
   1.4. arsyet për mbrojtjen e njerëzve dhe pasurisë e kërkojnë një veprim të tillë për mënjanimin e rrezikut të drejtpërdrejt dhe serioz për njerëzit dhe pronën;
   1.5. personi kundër të cilit është lëshuar urdhërarrest nga gjykata gjendet në shtëpi apo në lokale të tjera.
2. Në rastet nga paragrafi 1. i këtij neni nuk shkruhet procesverbal nëse nuk është zbatuar kontrolli, por personit i jepet një shënim zyrtar për arsyen e hyrjes në shtëpi dhe në lokale të tjera.
3. Përjashtimisht, në rrethana të ngutshme, kur urdhri me shkrim për kontroll nuk mund të merret me kohë dhe nëse ekziston rrezik real për vonesë, që mund të rezultojë me humbjen e provave, ose rrezik ndaj jetës ose shëndetit të njerëzve, zyrtari i autorizuar i policisë mund të fillojë kontrollin në bazë të lejes gojore nga gjyqtari kompetent.
4. Përjashtimisht, kontrolli mund të zbatohet pa praninë e dëshmitarëve nëse prania e tyre nuk mund të sigurohet menjëherë dhe vonesa e fillimit të kontrollit do të ishte e rrezikshme. Arsyet për zbatimin e kontrollit pa praninë e dëshmitarëve shënohen në procesverbal.
5. Policia mund të zbatojë kontrollin e personit pa urdhër ose pa praninë e dëshmitarëve kur ekzekuton aktvendimin për sjelljen forcërisht të personit ose kur bën arrestimin e tij, nëse ekziston dyshim i bazuar se personi mban armë apo ndonjë mjet për sulm ose kur mund të mënjanojë, fshehë apo asgjësojë sendet të cilat nga ai duhet të merren si provë në procedurë penale.
6. Kur policia ndërmerr kontroll pa urdhër të shkruar gjyqësor, brenda afatit prej dymbëdhjetë (12) orësh pas kontrollit i dërgon raport lidhur me këtë prokurorit të shtetit dhe gjyqtarit kompetent nëse për këtë çështje është caktuar ndonjë gjyqtar në

mënyrë që të merret aprovimi retroaktiv gjyqësor i kontrollit, në pajtim me dispozitat e Kushtetutës.

Neni 111
Pranueshmëria e provave të marra gjatë kontrollit

1. Provat e mbledhura nëpërmjet kontrollit janë të papranueshme nëse:
   1.1. provat e marra gjatë kontrollit, pa lejen e gjykatës, janë të pa pranueshme, nëse kontrollimi nuk merr aprovim retroaktiv gjyqësor, në pajtim me dispozitat e Kushtetutës;
   1.2. kontrolli është zbatuar pa urdhër të gjyqtarit kompetent në kundërshtim me dispozitat e këtij Kodi;
   1.3. urdhri i gjyqtarit kompetent është lëshuar në kundërshtim me procedurën e paraparë me këtë Kod;
   1.4. përmbajtja e urdhrit të gjyqtarit kompetent është në kundërshtim me kushtet e parapara me këtë Kod;
   1.5. kontrolli është zbatuar në kundërshtim me urdhrin e gjyqtarit kompetent;
   1.6. personat, prania e të cilëve është e detyrueshme, nuk kanë qenë të pranishëm gjatë kontrollit; ose
   1.7. kontrolli është zbatuar në kundërshtim me nenin 108 të këtij Kodi.

Neni 112
Sekuestrimi i përkohshëm

1. Sendet që përkohësisht mund të sekuestrohen janë sende që mund të jenë prova gjatë një procedure penale, sende ose pasuri që kanë mundësuar kryerjen e veprës penale, ose sende që konsiderohen dobi pasurore e fituar me kryerjen e veprës penale dhe për të cilat ligji parasheh sekuestrimin.
2. Sendet, pasuria, provat apo paratë mund t'i nënshtrohen kufizimit të përkohshëm sipas urdhrit të prokurorit të shtetit që zgjat jo më shumë se pesë ditë nëse zyrtarët e autorizuar të policisë mësojnë për sendin, pasurinë, provat apo paratë e tilla gjatë kontrollit apo arrestit të ligjshëm. Prokurori i shtetit kërkon urdhër të gjykatës nga gjyqtari i procedurës paraprake që është në pajtim me paragrafin 3. të këtij neni.
3. Prokurori i shtetit mund të kërkojë nga gjyqtari i procedurës paraprake që të lëshojë urdhër për sekuestrimin e përkohshëm të sendeve, pasurisë, provave apo parave. Kërkesa e tillë duhet të cek me saktësi sendet, pasurinë, provat apo paratë dhe duhet të përshkruajë si mund të jenë këto sende prova të veprës penale, si këto sende, pasuri apo para mund të mundësojnë kryerjen e veprës penale, ose si këto sende, pasuri apo para përbëjnë dobi pasurore të fituar me vepër penale. Sendet, pasuria, provat apo paratë mund të sekuestrohen përkohësisht vetëm me urdhër të gjykatës.
4. Sendet e sekuestruara përkohësisht fotografohen dhe mbahen në kontejnerët përkatës apo në qeset transparente të plastikës dhe zyrtari i autorizuar i policisë ose prokurori i shtetit mbajnë regjistër të fotografive dhe procesverbal mbi mbikëqyrjen për secilin send apo grup të shkresave.
5. Armët, automjetet, aeroplanët ose sendet tjera të mëdha të cilat janë sekuestruar përkohësisht, fotografohen dhe mbahen në zonat e sigurta përkatëse dhe zyrtari i

autorizuar i policisë ose prokurori i shtetit mbajnë regjistër të fotografive dhe procesverbal mbi mbikëqyrjen për secilin send apo grup të shkresave.

6. Ndërtesat apo prona e paluajtshme që sekuestrohet përkohësisht vendosen njoftimet e vëna në atë ndërtesë apo pronë të paluajtshme që njoftojnë qytetarët se prona i është nënshtruar sekuestrimit të përkohshëm, që hyrja në të nuk është e lejuar dhe që ata që hyjnë pa leje mund t'i nënshtrohen arrestit.
7. Paratë apo monedhat të cilat sekuestrohen përkohësisht fotografohen dhe mbahen në kasafortë dhe zyrtari i autorizuar i policisë ose prokurori i shtetit mbajnë regjistër të fotografive dhe procesverbal mbi mbikëqyrjen për secilin send apo grup të shkresave.
8. Paratë e mbajtura në llogarinë bankare e cila është e sekuestruar përkohësisht do të mbahen në një llogari bankare e cila është nën autoritetin e gjykatës.
9. Sendet dhe pasuria e sekuestruar përkohësisisht janë nën mbikëqyrjen dhe kontrollin e prokurorit të shtetit. Prokurori i shtetit mund t'ia delegojë mbikëqyrjen dhe kontrollin zyrtarit të autorizuar të policisë për sendet dhe pasurinë e sekuestruar përkohësisht nga paragrafët 5., 6. dhe 8. të këtij neni.
10. Kur sendet konfiskohen, duhet të tregohet se ku janë gjetur dhe ato sende duhet të përshkruhen. Nëse është e nevojshme, vërtetohet identiteti i tyre duhet të sigurohet në ndonjë mënyrë tjetër. Vërtetimi për sekuestrimin duhet të lëshohet për sendet e sekuestruara.
11. Nëse personi apo organi i cili ka nën mbikëqyrje sendin, pasurinë, provat apo paratë që i nënshtrohen urdhrit të gjyqtarit të procedurës paraprake nga ky nen refuzon t'ia dorëzojë sendin, pasurinë, provat apo paratë zyrtarit të autorizuar të policisë që është përgjegjës për ekzekutimin e urdhrit, personi apo organi i tillë mund të gjobitet nga gjyqtari i procedurës paraprake deri në pesëdhjetë përqind (50%) të vlerës së sendit, pasurisë, provave apo parave që janë objekt i kontestit. Personi apo organi ndaj të cilit shqiptohet gjoba e tillë mund të paraqesë ankesë kundër gjobës ose mund të shmangë gjobën duke iu bindur urdhrit të gjyqtarit të procedurës paraprake.

Neni 113
Sendet që nuk mund të sekuestrohen përkohësisht

1. Këto sende nuk mund të sekuestrohen përkohësisht:
   1.1. komunikimet me shkrim ndërmjet të pandehurit dhe personave të cilët sipas këtij Kodi nuk mund të dëshmojnë nga neni 126 i këtij Kodi, ose janë të liruar nga detyrimi për të dëshmuar dhe kanë refuzuar të bëjnë një gjë të tillë në pajtim me nenin 127 të këtij Kodi;
   1.2. shënimet nga personat e paraparë në nenin 126 të këtij Kodi lidhur me informacionin e fshehtë që u është besuar atyre nga i pandehuri; dhe
   1.3. sende të tjera, të mbrojtura me të drejtat e personave nga nenet 126 dhe 127 të këtij Kodi.
2. Këto kufizime zbatohen vetëm nëse sendet e tilla janë nën mbikëqyrjen e personit që nuk mund të dëshmojë sipas nenit 126 të këtij Kodi ose që lirohet nga detyrimi për të dëshmuar dhe ka refuzuar dhënien e dëshmisë sipas nenit 127 të këtij Kodi. Sendet e mbrojtura nga e drejta e personave të paraparë në nenin 127, paragrafi 1.,

nën-paragrafi 1.5. i këtij Kodi gjithashtu nuk i nënshtrohen sekuestrimit nëse ato janë nën mbikëqyrjen e ndonjë spitali ose ndonjë instituti tjetër mjekësor. Kufizimet nuk zbatohen kur personat që nuk mund të dëshmojnë sipas nenit 126 të këtij Kodi ose që janë liruar nga detyrimi i dëshmimit dhe kanë refuzuar dhënien e dëshmisë sipas nenit 127 të këtij Kodi, dyshohen për nxitje apo bashkëpunim, për pengim të drejtësisë, për pranimin e mallrave të vjedhura ose kur sendet përkatëse janë marrë me vepër penale, janë përdorur ose janë paraparë të përdoren për kryerjen e veprës penale apo janë rezultat i veprës penale.

Neni 114
Kufizimet në zbulimin e shkresave

1. Organet publike mund të kërkojnë nga gjyqtari i procedurës paraprake që të shtyjë apo të rishqyrtojë urdhrin për zbulimin e dosjeve apo shkresave nëse konsiderojnë se zbulimi i përmbajtjes së tyre do të dëmtonte interesin e përgjithshëm. Gjyqtari i procedurës paraprake duhet të baraspeshojë dëmtimin e interesit të përgjithshëm me interesin publik për gjykim me kohë të procedurës penale, të drejtat e njeriut të të pandehurit ose të drejtat e të dëmtuarit. Duhet të ketë prezumim në favor të zbulimit të dosjeve apo shkresave të organeve publike. Organi publik mund të kundërshtojë tek paneli shqyrtues refuzimin e gjyqtarit të procedurës paraprake që të shtyjë apo të rishqyrtojë urdhrin e tij. Paneli shqyrtues merr vendimin përfundimtar.
2. Organizatat afariste dhe personat juridik mund të kërkojnë që të dhënat lidhur me afarizmin e tyre të mos publikohen nëse një gjë e tillë është e ndjeshme apo përmban të dhëna personale të palës së tretë.

Neni 115
Konfiskimi i përhershëm i sendeve të konfiskuara përkohësisht

1. Sendet, pasuria, provat apo paratë e sekuestruara përkohësisht sipas nenit 112 të këtij Kodi në fund të procedurës penale i kthehen pronarit apo poseduesit sipas nenit 116 të këtij Kodi, përveç nëse veprimet janë marrë sipas paragrafit 2. të këtij neni apo nëse ndonjë veprim tjetër i lejuar me ligj do të ofronte bazën për të mos kthyer sendet, pasurinë, provat apo paratë.
2. Gjyqtari i vetëm gjykues ose trupi gjykues urdhëron sekuestrimin e përhershëm të sendeve në pajtim me ligjin, nëse prokurori i shtetit:
   2.1. përcakton në aktakuzë ato sende, pasuri, prova apo para të cilat i nënshtrohen sekuestrimit të përhershëm;
   2.2. nëse gjatë shqyrtimit gjyqësor vërtetohet se sendet, pasuria, provat apo paratë e sekuestruara përkohësisht kanë mundësuar kryerjen e veprës penale ose përbëjnë dobi pasurore të fituar me kryerjen e veprës penale; dhe
   2.3. ligji lejon konfiskimin e tyre.
3. Sendet, pasuria apo provat për të cilat është bërë sekuestrimi i përhershëm shiten dhe të ardhurat nga këto shitje përdoren për kompensimin e të dëmtuarve dhe pjesa e mbetur derdhet në buxhetin e shtetit.
4. Paratë për të cilat është bërë konfiskimi i përhershëm përdoren për kompensimin e të dëmtuarve dhe pjesa e mbetur derdhet në buxhetin e shtetit.

5. Armët dhe sendet e kontrabanduara shkatërrohen me përjashtim të sendeve që mund të përdoren nga shoqëria pasi të mos kenë më vlerë si prova në shqyrtim kryesor apo në procedurën e ankimimit, në pajtim me nenin 282, paragrafi 3. të këtij Kodi.
6. Me kërkesë të prokurorit të shtetit, automjetet apo aeroplanët për të cilët është bërë sekuestrimi i përhershëm mund t'i transferohen Qeverisë së Kosovës për shfrytëzim, nëse transferimi i tillë nuk e zbeh mundësinë e të dëmtuarit për të siguruar kompensimin.

Neni 116
Kthimi i sendeve të sekuestruara përkohësisht

1. Sendet e sekuestruara përkohësisht gjatë procedurës penale i kthehen pronarit ose poseduesit kur procedura pezullohet ose pushohet dhe kur nuk ka bazë për konfiskimin e tyre.
2. Kur pezullimi i procedurës penale bëhet për shkak të arratisjes së të pandehurit ose paaftësisë së tij mendore apo kur ka gjasa të arsyeshme që hetimi i pezulluar të rifillojë, prokurori i shtetit mund të kërkojë afat shtesë për sekuestrimin dhe gjyqtari i vetëm gjykues apo kryetari i trupit gjykues mund të lejojë për kthimin e sendit të sekuestruar kur ka arsye të forta

Neni 117
Sendet pronësia e të cilave nuk kërkohet

1. Kur sendi i gjetur tek i pandehuri i takon një personi tjetër i cili është i panjohur, organi i cili drejton procedurën penale e përshkruan sendin dhe e shpall përshkrimin në tabelën e njoftimeve të kuvendit të komunës në territorin e së cilës i pandehuri jeton dhe në territorin e së cilës është kryer vepra penale. Në njoftimin e tillë pronari thirret të paraqitet brenda një (1) viti nga dita e shpalljes së njoftimit ose në të kundërtën sendi shitet. Paratë e fituara nga shitja derdhen në buxhet.
2. Kur sendet kanë vlerë të konsiderueshme, njoftimi mund të shpallet edhe në shtypin e përditshëm.
3. Kur sendi mund të prishet ose mirëmbajtja e tij kërkon shpenzime të konsiderueshme, atëherë shitet sipas dispozitave që vlejnë për procedurën përmbaruese dhe paratë e fituara transferohen për ruajtje në një llogari bankare që është nën kontrollin e gjykatës.
4. Paragrafi 3. i këtij neni zbatohet edhe për sendet që i përkasin të pandehurit i cili është arratisur ose një kryerësi të panjohur.

Neni 118
Sendet që nuk kërkohen

1. Nëse brenda një (1) viti askush nuk ka pretendime mbi sendin ose për të ardhurat nga shitja, gjykata merr aktvendim që sendi t'i kalohet organit publik kompetent ose fitimi nga shitja të derdhet në buxhet.
2. Pronari ka të drejtë që në kontest civil të kërkojë kthimin e sendit ose të fitimit nga shitja. Afati i parashkrimit të kësaj të drejte fillon të ecë nga dita e shpalljes së njoftimit.

C. Marrja e provave para ngritjes së aktakuzës

Neni 119
Marrja e provave gjatë hetimit

1. Pas fillimit të hetimit, prokurori i shtetit merr në pyetje dhe merr deklaratat nga dëshmitarët, autorizon marrjen e deklaratave dhe raporteve nga eksperti dhe mbledh prova tjera të lejuara me ligj.
2. Nëse gjatë hetimit i dyshuari apo i pandehuri bashkëpunon me prokurorin e shtetit, bazuar në atë bashkëpunim prokurori i shtetit mund të fillojë hetim të ri.
3. Gjatë hetimit, prokurori i shtetit mund të urdhërojë apo të kërkojë masat nga neni 88 të këtij Kodi, të cilat zbatohen përshtatshmërisht.
4. Gjatë hetimit, i pandehuri apo mbrojtësi i tij mund të kërkojnë nga prokurori i shtetit që të merr apo të ruajë provat të cilat mund të jenë apo ka arsye të pritet që do të jenë shfajësuese.
5. Gjatë hetimit, i dëmtuari mund të kërkojë nga prokurori i shtetit që të merr ose të ruajë provat të cilat mund të tregonin apo ka arsye të pritet që provat e tilla do të tregonin dëmin e shkaktuar me vepër penale, dhembjen apo vuajtjen e pësuar nga viktima, apo shpenzimet tjera të ndërlidhura me vepër penale.

Neni 120
Identifikimi i personave apo sendeve

1. Kur është e nevojshme të vendoset se një dëshmitar a e njeh personin ose sendin, nga dëshmitari i tillë së pari kërkohet të përshkruajë dhe tregojë tiparet dalluese të personit ose të sendit të tillë.
2. Dëshmitarit pastaj i tregohet personi me persona të tjerë të panjohur për dëshmitarin ose fotografitë e tyre apo sendi me sende të tjera të llojit të njëjtë ose fotografitë e tyre.
3. Dëshmitarit i bëhet me dije se nuk detyrohet të zgjedhë personin ose sendin apo ndonjë fotografi dhe se është po aq e rëndësishme për të treguar se nuk e njeh personin, sendin ose fotografinë ashtu sikurse të thoshte se e njeh.
4. Procesverbali mbahet për përshkrimin e marrë sipas paragrafit 1 të këtij neni, përfshirë kohën dhe datën e këtij përshkrimi dhe personat e pranishëm me rastin e këtij përshkrimi. Procesverbali mbahet edhe për përshkrimin sipas paragrafit 2. të këtij neni, përfshirë kohën dhe datën e identifikimit dhe fotografitë e personave apo sendeve tjera.
5. Identifikimi i peronit apo sendit nga ky nen mund të mbikëqyret nga policia apo nga prokurori i shtetit. Procesverbali nga paragrafi 3. të këtij neni futet në shkresat e lëndës.

Neni 121
Marrja e provave para marrjes së deklaratës në procedurë paraprake

1. Kur është e mundur, prokurori i shtetit ne pajtim me ligjin merr të gjitha dokumentacionet që janë prova relevante para marrjes së deklaratës në procedurë paraprake. Dokumentacionet e tilla përfshijnë, por nuk kufizohen në;

1.1. pasaporta, letërnjoftime ose të dhënat kufitare të hyrjeve;
1.2. të dhënat financiare;
1.3. të dhënat ose fotografitë e vëzhgimit;
1.4. të dhënat e pronësisë së tokës;
1.5. të dhënat e pronësisë së automjeteve;
1.6. të dhënat e korporatave ose të subjekteve afariste;
1.7. dokumentet elektronike, siç janë emailat, mesazhet me tekst apo fotografitë;
1.8. të dhënat mjekësore;
1.9. shënime, ditarë ose kalendarë; ose
1.10. çdo dokument tjetër që është marrë në mënyrë të ligjshme sipas këtij Kodi të Procedurës Penale.

2. Nëse është e mundur, prokurori i shtetit ligjërisht merr të gjitha provat materiale para marrjes së deklaratave përkatës në procedurë paraprake. Provat e tilla material përfshijnë, por nuk kufizohen në:
2.1. prova materiale të siguruara në vendin e ngjarjes;
2.2. prova materiale të siguruara nga kontrolli i lokaleve të të pandehurit;
2.3. prova materiale të siguruara nga kontrolli i të pandehurit para apo gjatë arrestimin të tij;
2.4. fotografitë apo raportet mjeko-ligjore lidhur me provat materiale; ose
2.5. çdo provë tjetër materiale e siguruar në mënyrë të ligjshme, ekzistimi dhe forma e të cilave ofron prova të rëndësishme për hetimin sipas këtij Kodi të Procedurës Penale

Neni 122
Marrja dhe ruajtja e të dhënave apo provave nga dëshmitarët

1. Prokurori i shtetit mund të marrë në pyetje dëshmitarin nga neni 131 i këtij Kodi para marrjes së deklaratës në procedurë paraprake, ose mund të udhëzojë policinë që të zbatojë marrjen në pyetje.
2. Prokurori i shtetit mund të caktojë marrjen e deklaratës nga dëshmitari ose i pandehuri në procedurë paraprake sipas neneve 132-133 të këtij Kodi.
3. Nëse prokurori i shtetit dyshon se dëshmitari mund të mos jetë në dispozicion në të ardhmen, qoftë për shkak të sëmundjes, vdekjes së pashmangshme ose mundësisë së largimit nga Kosova, mund të kërkojë nga gjyqtari i procedurës paraprake që të zbatojë mundësinë hetuese të veçantë nga neni 149 të këtij Kodi.
4. Provat nga ekspertiza mund të paraqiten me raportin nga neni 138 i këtij Kodi ose mund të sqarohen me ekspertizën e procedurës paraprake.
5. Gjatë hetimit formal, i pandehuri ose mbrojtësi i tij mund të kërkojnë nga prokurori i shtetit që të merr apo të ruajë dëshmitë në procedurë paraprake që mund të jenë apo ka arsye të pritet që do të jenë shfajësuese.
6. Gjatë hetimit, viktima, përfaqësuesi i viktimës apo mbrojtësi i viktimave mund të kërkojnë nga prokurori i shtetit që të merr apo të ruajë provat të cilat mund të tregojnë apo ka arsye të pritet që provat e tilla do të tregonin dëmin e shkaktuar me vepër penale, dhembjen apo vuajtjen e pësuar nga viktima, apo shpenzimet tjera të ndërlidhura me vepër penale.

Neni 123
Marrja në pyetje në procedurë paraprake, deklarata në procedurë paraprake dhe mundësia hetuese e veçantë

1. Gjatë fazës së hetimit mund të merren prova nga dëshmitarët dhe ekspertët në njërën nga këto tri mënyra: marrja në pyetje në procedurë paraprake, deklarata në procedurë paraprake ose mundësia hetuese e veçantë.
2. Marrja në pyetje në procedurë paraprake zbatohet nga prokurori i shtetit. Procesverbali i kësaj marrje në pyetje vendoset në shkresat e lëndës. Provat e siguruara gjatë marrjes në pyetje në procedurë paraprake mund të përdoren si bazë për të forcuar urdhrat hetues në procedurë paraprake, vendimet për paraburgim dhe aktakuzën. Provat e siguruara gjatë marrjes në pyetje në procedurë paraprake nuk mund të përdoren si provë e drejtpërdrejtë gjatë shqyrtimit kryesor, por mund të përdoret gjatë marrjes së tërthortë në pyetje për vënien në dyshim të dëshmitarëve nëse dëshmitari ka dëshmuar ndryshe nga dëshmia e dhënë gjatë marrjes në pyetje në procedurë paraprake.
3. Deklarata në procedurë paraprake zbatohet nga prokurori i shtetit në pajtim me nenet 132-133 të këtij Kodi. Deklarata në procedurë paraprake audio incizohet, audio dhe video incizohet ose transkriptohet fjalë për fjalë. Provat e siguruara gjatë deklaratës në procedurë paraprake mund të përdoren si bazë për të forcuar urdhrat hetues në procedurë paraprake, urdhrat për paraburgim dhe aktakuzën. Deklarata në procedurë paraprake pranohet gjatë shqyrtimit kryesor për marrjen e tërthortë në pyetje të dëshmitarit të njëjtë dhe mund të përdoret si provë e drejtpërdrejtë gjatë shqyrtimit kryesor nëse dëshmitari nuk është në dispozicion për shkak të vdekjes, sëmundjes, privilegjeve apo mungesës së pranisë së tij në Kosovë, por nuk mund të përdoret si provë e vetme apo vendimtare fajësuese për dënimin e të pandehurit.
4. Mundësua hetuese e veçantë zbatohet pranë kolegjit prej tre gjyqtarësh që kryesohet nga gjyqtari i procedurës paraprake në pajtim me nenin 149 të këtij Kodi. Provat e siguruara nga mundësia hetuese e veçantë audio incizohen, audio dhe video incizohen ose transkriptohen fjalë për fjalë. Provat e siguruara gjatë mundësisë hetuese të veçantë mund të përdoren si bazë për të forcuar urdhrat hetues në procedurë paraprake, urdhrat për paraburgim dhe aktakuzën. Provat e siguruara nga mundësia hetuese e veçantë janë plotësisht të pranueshme gjatë shqyrtimit kryesor nëse së paku njëri nga gjyqtarët e kolegjit gjykues që ka dëgjuar dëshmitë është gjyqtar në trupin gjykues në shqyrtim kryesor dhe nëse dëshmitari nuk është në dispozicion për shkak të vdekjes, sëmundjes, privilegjeve apo mungesës së pranisë së tij në Kosovë. Nëse trupi gjykues në shqyrtim kryesor nuk përfshinë së paku një prej gjyqtarëve që ka shërbyer në Kolegjin për Mundësinë e Veçantë të Hetimit, provat trajtohen si prova të marra nga deklarata në procedurë paraprake nga paragrafi 3. të këtij neni.
5. Deklaratat e dhëna nga i pandehuri në çfarëdo konteksti, nëse janë dhënë në mënyrë vullnetare dhe pa shtrëngim, janë prova të pranueshme gjatë shqyrtimit kryesor kundër të pandehurit, por jo edhe kundër të bashkëpandehurve. Deklaratat e tilla nuk mund të shërbejnë si provë e vetme fajësuese apo vendimtare për dënimin e të pandehurit.
6. Pas ekspertizës, ekspertët mund të merren në pyetje, të japin deklarata në procedurë paraprake ose në mundësinë hetuese të veçantë.

Neni 124
Thirrja e dëshmitarëve

1. Si dëshmitar thirret personi për të cilin besohet se mund të jep informata për veprën penale, për kryerësin dhe për rrethanat e rëndësishme për procedurën penale.
2. I dëmtuari mund të merret në pyetje si dëshmitar.
3. Çdo person i thirrur si dëshmitar detyrohet t'i përgjigjet thirrjes, e kur me këtë Kod nuk është caktuar ndryshe, detyrohet edhe të dëshmojë.

Neni 125
Paralajmërimet të cilat duhet lexuar dëshmitarit, dëshmitarëve ekspert, te pandehurve dhe dëshmitarëve bashkëpunues

1. Në fillim të marrjes në pyetje në procedurë paraprake, seancës për deklaratë në procedurë paraprake ose mundësisë hetuese të veçantë, prokurori i shtetit i lexon dëshmitarit këtë paralajmërimin: "Ky është një hetim penal. Ju jeni i detyruar të dëshmoni. Ju jeni i detyruar të tregoni të vërtetën. Nëse ju nuk tregoni të vërtetën, mund të ndiqeni sipas nenit 390 ose 391 të Kodit Penal. Nëse besoni se ju mund të fajësoni veten si rezultat i përgjigjeve në pyetje, ju mund të refuzoni të përgjigjeni. Nëse besoni se keni nevojë për ndihmën e avokatit si rezultat i përgjigjes në një pyetje, ju mund të angazhoni dhe të këshilloheni me një avokat. Ky hetim penal kërkon të gjejë të vërtetën dhe kujtesën sa më të saktë të fakteve që ju mund të ofroni. Nëse ju nuk e kuptoni pyetjen që u është bërë, ju duhet të kërkoni që pyetja të ju bëhet ndryshe. Nëse besoni se ka një dokument ose prova të tjera që mund t'iu ndihmojnë për tu përgjigjur në pyetje sa më saktë apo t'iu kujtohen faktet më qartë, ju jeni të detyruar të na tregoni. Nëse keni nevojë për ndihmë, përkthim, apo pushim të shkurtër dhe të arsyeshëm nga kjo seancë, ju duhet të kërkoni atë. A i kuptoni këto të drejta?"
2. Në fillim të marrjes në pyetje në procedurë paraprake, seancës për deklaratë në procedurë paraprake ose mundësisë hetuese të veçantë, prokurori i shtetit i lexon ekspertit këtë paralajmërimin: "Ky është një hetim penal mbi veprimet për të cilat ju keni njohuri të specializuara. Ju jeni të detyruar të dëshmoni. Ju jeni të detyruar të tregoni të vërtetën. Nëse ju nuk tregoni të vërtetën, mund të ndiqeni sipas nenit 390 ose 391 të Kodit Penal. Ju jeni të detyruar të shpjegoni hapat që keni ndërmarrë për sigurimin e njohurive të specializuara që keni në këtë rast. Ky hetim penal kërkon të gjejë të vërtetën dhe kujtesën sa më të saktë të fakteve që ju mund të ofroni. Nëse ju nuk e kuptoni pyetjen që u është bërë, ju duhet të kërkoni që pyetja të ju bëhet ndryshe. Nëse besoni se ka një dokument ose prova të tjera që mund t'ju ndihmojë për tu përgjigjur në pyetje sa më saktë apo t'iu kujtohen faktet më qartë, ju jeni të detyruar të na tregoni. Nëse keni nevojë për ndihmë, përkthim, apo pushim të shkurtër dhe të arsyeshëm nga kjo seancë, ju duhet të kërkoni atë. A i kuptoni këto të drejta?".
3. Në fillim të marrjes në pyetje në procedurë paraprake, seancës për deklaratë në procedurë paraprake ose mundësisë hetuese të veçantë, prokurori i shtetit i lexon të pandehurit këtë paralajmërimin: "Ky është një hetim penal i veprave që ju mund të keni kryer. Ju keni të drejtë të jepni deklaratë, mirëpo poashtu keni të drejtë të

heshtni dhe të mos përgjigjeni në asnjë pyetje, përveç dhënies së informatave mbi identitetin tuaj. Ju keni të drejtë të mos e fajësoni veten tuaj. Nëse ju zgjedhni të jepni deklaratë apo të përgjigjeni në pyetje, ju do të jeni nën betim. Informatat e dhëna mund të përdorën si dëshmi në gjykatë. Nëse keni nevojë për përkthyes, do t'iu sigurohet falas. Nëse besoni se ju mund të fajësoni veten apo të afërmin tuaj si rezultat i përgjigjeve në pyetje, ju mund të refuzoni të përgjigjeni. Ju keni të drejtë të keni mbrojtës dhe të konsultoheni me të para dhe gjatë marrjes në pyetje. Nëse ju nuk e kuptoni pyetjen që u është bërë, ju duhet të kërkoni që pyetja të ju bëhet ndryshe. Nëse keni nevojë për ndihmë, përkthim, apo pushim të shkurtër dhe të arsyeshëm nga kjo seancë, ju duhet të kërkoni atë. Nëse nuk i kuptoni këto të drejta, konsultohuni me mbrojtësin tuaj".

4. Në fillim të marrjes në pyetje në procedurë paraprake, seancës për deklaratën në procedurë paraprake ose mundësisë hetuese të veçantë, prokurori i shtetit i lexon personit të shpallur dëshmitarit bashkëpunues këtë paralajmërimin: "Ky është një hetim penal i veprave për të cilat ju mund të keni njohuri të drejtpërdrejtë. Ju jeni pajtuar të bashkëpunoni në këtë hetim. Nëse shfrytëzoni të drejtën tuaj për të heshtur, ju nuk do të jeni më dëshmitarë bashkëpunues. Nëse ju nuk thoni të vërtetën, kjo mund të merret parasysh gjatë përcaktimit të dënimit tuaj dhe ju mund të ndiqeni sipas nenit 392 të Kodit Penal. Mbrojtësi juaj është i pranishëm. Nëse besoni se keni nevojë të këshilloheni me mbrojtësin tuaj, ju mund të bëni këtë. Ky hetim penal kërkon të gjejë të vërtetën dhe kujtesën sa më të saktë të fakteve që ju mund të ofroni. Nëse ju nuk e kuptoni pyetjen që u është bërë, ju duhet të kërkoni që pyetja të ju bëhet ndryshe. Nëse besoni se ka një dokument ose prova të tjera që mund t'iu ndihmojë për tu përgjigjur në pyetje sa më saktë apo të ju kujtohen faktet më shumë, ju duhet të na tregoni. Nëse keni nevojë për ndihmë, përkthim, apo pushim të shkurtër dhe të arsyeshëm nga kjo seancë, ju duhet të kërkoni atë. A i kuptoni këto të drejta?"
5. Paralajmërimet nga ky nen shënohen në procesverbalin e seancës për deklaratën në procedurë paraprake.
6. Paralajmërimet e bëra në bazë të këtij neni, duhet t'i dorëzohen edhe me shkrim të pandehurit në një gjuhë që ai e kupton, së bashku me thirrjen para marrjes në pyetje.
7. Paralajmërimet e bëra në bazë të këtij neni duhet të futen në regjistrin e seancës preliminare të dëshmisë.

Neni 126
Dëshmitarët e privilegjuar

1. Si dëshmitar nuk mund të merret në pyetje:
   1.1. personi i cili me deklarimin e vet do të shkelte detyrën e ruajtjes së fshehtësisë zyrtare ose ushtarake, derisa organi kompetent nuk e liron nga ky detyrim;
   1.2. mbrojtësi, për atë që i pandehuri ia ka besuar atij në cilësi të mbrojtësit të vet, përveç kur kërkon vetë i pandehuri; dhe
   1.3. i bashkëpandehuri derisa zbatohet procedurë e përbashkët.

Neni 127
Dëshmitarët e liruar nga detyrimi për të dëshmuar

1. Nga detyra e dëshmimit janë të liruar:
   1.1. bashkëshorti ose bashkëshorti jashtëmartesor i të pandehurit, përveç kur procedura zbatohet për vepër penale për të cilën mund të shqiptohet dënimi me të paktën pesë (5) vjet burgim dhe ai është i dëmtuar me atë vepër penale;
   1.2. personi i gjinisë së gjakut në vijë të drejtë me të pandehurin, bashkëshorti ose bashkëshorti jashtëmartesor: paraardhësit, pasardhësit, motrat, vëllezërit, axhët, dajët, tezet, hallat, fëmijët e motrave dhe vëllezërve; ose të afërmit: vjehrra, vjehrri, dhëndrri, nusja, motra e burrit/gruas, vëllai i burrit/gruas, kumbari, kumbarja, njerka, njerku; përveç kur procedura zbatohet për vepër penale për të cilën mund të shqiptohet dënimi me të paktën dhjetë (10) vjet burgim apo nëse është dëshmitar i veprës penale kundër fëmijës i cili bashkëjeton apo është i afërm me të apo me të pandehurin;
   1.3. prindi adoptues ose fëmija i adoptuar i të pandehurit, përveç kur procedura zbatohet për vepër penale për të cilën mund të shqiptohet dënimi me të paktën dhjetë (10) vjet burgim, ose ai është dëshmitar i veprës penale kundër fëmijës që bashkëjeton ose është i afërt me të apo me të pandehurin;
   1.4. personi fetar për atë çka i pandehuri apo një person tjetër i është rrëfyer;
   1.5. mbrojtësi, mbrojtësi i viktimave, mjeku, punëtori social, psikologu ose ndonjë person tjetër për faktet që i kanë mësuar gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre kur detyrohen ta ruajnë si fshehtësi atë që e kanë mësuar me rastin e ushtrimit të profesionit; dhe
   1.6. gazetari apo botuesi, i cili punon në media apo një ose më shumë nga bashkëpunëtorët e tij në pajtim me ligjin e zbatueshëm.
2. Personi i cekur në paragrafin 1., nën-paragrafët 1.4., 1.5. ose 1.6. të këtij neni nuk mund të refuzojë dëshmimin kur ekziston bazë ligjore për ta liruar nga detyrimi i mbajtjes së fshehtësisë.
3. Organi kompetent që zbaton procedurën detyrohet që personat e cekur në paragrafin 1. të këtij neni, para marrjes së tyre në pyetje ose sapo të mësojë për marrëdhënien e tyre me të pandehurin, t'i bëjë me dije për të drejtën e tyre për të mos dëshmuar. Paralajmërimi dhe përgjigjja shënohen në procesverbal.
4. Fëmija i cili, duke pasur parasysh moshën dhe zhvillimin intelektual, nuk është i aftë të kuptojë domethënien e të drejtës për të refuzuar dëshmimin nuk mund të pyetet si dëshmitar, përveç kur gjykata çmon se ata janë të aftë për të kuptuar se i nënshtrohen detyrimit për të treguar të vërtetën.
5. Personi i cili ka të drejtë të mohojë dëshmimin ndaj njërit nga të pandehurit, lirohet nga detyrimi i dëshmimit edhe ndaj të pandehurve të tjerë kur dëshmia e tij, duke marrë parasysh çështjen, nuk mund të kufizohet në të pandehurit tjerë.

Neni 128
Rrethanat kur deklarata është e papranueshme

1. Dëshmia e dëshmitarit është e papranueshme nëse:
   1.1. personi nuk mund të pyetet si dëshmitar;

1.2. personi është i liruar nga dëshmimi, por nuk është vënë në dijeni për këtë ose shprehimisht nuk ka hequr dorë nga kjo e drejtë, apo kur udhëzimi dhe heqja dorë nuk është shënuar në procesverbal;
1.3. personi është fëmijë, i cili nuk kupton të drejtën e tij për të refuzuar dëshmimin; ose
1.4. dëshmia e dëshmitarit është marrë me forcë, me kanosje ose me ndonjë mënyrë tjetër të ndaluar.

Neni 129
Dëshmitari nuk është i detyruara për të fajësuar veten apo të afërmin

Dëshmitari nuk ka detyrim të përgjigjet në pyetje konkrete kur ka gjasa se me këtë e vë veten ose ndonjë person të afërm të tij para turpit të rëndë, dëmit të konsiderueshëm material ose ndjekjes penale. Gjykata apo prokurori i shtetit për këtë të drejtë e njofton dëshmitarin.

Neni 130
Kushtet e përgjithshme për marrjen në pyetje në procedurë paraprake, marrjen e deklaratës në procedurë paraprake ose mundësinë hetuese të veçantë

1. Dëshmitari pyetet ndamas dhe pa praninë e dëshmitarëve të tjerë. Dëshmitari detyrohet t'i jep përgjigjet gojarisht.
2. Pas kësaj, dëshmitari pyetet për emrin dhe mbiemrin, emrin e babait dhe të nënës, numrin e letërnjoftimit, profesionin, vendbanimin, vendlindjen, moshën dhe marrëdhënien e tij me të pandehurin dhe me të dëmtuarin. Dëshmitarit i bëhet me dije detyrimi i tij për të lajmëruar gjykatën për çdo ndryshim të vendbanimit ose vendqëndrimit.
3. Dispozita e paragrafit 2. të këtij neni nuk zbatohet kur është në kundërshtim me masat për mbrojtjen e të dëmtuarve dhe dëshmitarëve siç parashihet me këtë Kod.
4. Zyrtarët e policisë janë të detyruar që të japin të dhënat nga paragrafi 3. i këtij neni por informohen për të drejtën e tyre, që në vend të adresës së banimit të japin adresën e stacionit të tyre policor.
5. Me rastin e marrjes në pyetje të personit i cili nuk ka mbushur moshën tetëmbëdhjetë (18) vjet, sidomos kur ai është dëmtuar me veprën penale veprohet me kujdes që pyetja të mos ndikojë dëmshëm në gjendjen e tij mendore. Kur është e nevojshme, ai pyetet me ndihmën e psikologut për fëmijë ose pedagogut për fëmijë apo ekspertit tjetër profesional.

Neni 131
Marrja në pyetje në procedurë paraprake

1. Gjatë fazës së hetimit, prokurori i shtetit mund të thërret dëshmitarët, viktimat, dëshmitarët bashkëpunues, dëshmitarët e mbrojtur dhe ekspertët që të japin informata në marrjen në pyetje në procedurën paraprake që është relevante për procedurën penale.
2. Prokurori i shtetit mund të lejojë mbrojtësin, viktimën apo mbrojtësin e viktimave që të merr pjesë në marrjen në pyetje në procedurë paraprake.

3. Gjatë marrjes në pyetje, prokurori i shtetit mund të pyesë personin i cili merret në pyetje lidhur me provat materiale. Provat materiale duhet të identifikohen qartë në procesverbalin, transkriptin ose raportin mbi marrjen në pyetje.
4. Marrja në pyetje në procedurë paraprake mund të incizohet audio, të incizohet audio dhe video, të transkriptohet fjalë për fjalë ose të përmblidhet në një raport. Incizimi, transkripti apo raporti janë në pajtim me Kapitullin XI dhe i bashkëngjiten shkresave të lëndës.
5. Personi i cili merret në pyetje nga ky nen mund të dëshmojë më vonë gjatë marrjes së deklaratës në procedurë paraprake ose në mundësinë hetuese të veçantë.

Neni 132
Marrja e deklaratës në procedurë paraprake

1. Gjatë fazës së hetimit, prokurori i shtetit thërret dëshmitarët, viktimat, ekspertët dhe të pandehurin apo të pandehurit për të dhënë deklaratë në procedurë paraprake lidhur me procedurën penale.
2. Gjatë fazës së hetimit, prokurori i shtetit merr në pyetje dëshmitarët e mbrojtur dhe dëshmitarët bashkëpunues duke siguruar sigurinë e përshtatshme për ta.
3. Dëshmitari thirret duke ia dërguar thirrjen me shkrim në të cilën shënohet emir, mbiemri dhe profesioni i dëshmitarit, koha dhe vendi ku duhet të paraqitet, lënda penale për të cilën thirret, shënimi se thirret si dëshmitar dhe paralajmërimi për pasojat e mungesës pa arsye.
4. Thirrja si dëshmitar e personit që nuk ka mbushur moshën gjashtëmbëdhjetë (16) vjet bëhet nëpërmjet prindërve të tij apo përfaqësuesit ligjor, përveç kur kjo nuk është e mundur për shkak të nevojës për veprim të ngutshëm ose për shkak të rrethanave të tjera.
5. Dëshmitari i cili për shkak të pleqërisë, sëmundjes ose të metave të rënda trupore nuk mund t'i përgjigjet thirrjes, mund të pyetet jashtë gjykatës.
6. Prokurori i shtetit e njofton me shkrim pesë (5) ditë më herët të pandehurin, mbrojtësin, të dëmtuarin dhe mbrojtësin e viktimave lidhur me datën, kohën dhe vendin ku do të merret deklarata në procedurë paraprake. Kopje e njoftimit i bashkëngjitet shkresave të lëndës.
7. Mospjesëmarrja e pajustifikuar e të pandehurit, mbrojtësit, të dëmtuarit apo mbrojtësit të viktimave në seancën për marrjen e deklaratës në procedurë paraprake, pasi të ketë pranuar njoftimin nga paragrafi 6, ia mohon atij të pandehuri, mbrojtësi, të dëmtuari apo mbrojtësi të viktimës që të kundërshtojë pranueshmërinë e dëshmisë në një fazë të mëvonshme të procedurës penale. Këto pasoja ceken në njoftimin nga paragrafi 6. të këtij neni.

Neni 133
Kushtet e seancës për marrjen e deklaratës në procedurë paraprake

1. Procesverbali i seancës për marrjen e deklaratës në procedurë paraprake mbahet në pajtim me Kapitullin XI të këtij Kodi. Nëse në procedurë penale hetohet vepra penale për të cilën parashihet dënimi maksimal me tre (3) apo më shumë vjet burgim, deklarata në procedurë paraprake audio incizohet, video incizohet ose

transkriptohet. Nëse në procedurë penale hetohet vepra penale për të cilën parashihet dënim maksimal me më pak se tre (3) vjet burgim, deklarata në procedure paraprake mund të audio incizohet, video incizohet, transkriptohet ose të përmblidhet në procesverbalin e hetimit paraprak.
2. Prokurori i shtetit së pari merr në pyetje dëshmitarët që i ka caktuar vetë.
3. Nëse mbrojtja ka kërkuar që të merret deklarata në procedurë paraprake nga dëshmitari, atëherë së pari mbrojtja merr në pyetje ata dëshmitarë.
4. Nëse viktima apo mbrojtësi i viktimave ka kërkuar që të merret deklarata në procedurë paraprake nga dëshmitari, atëherë së pari mbrojtësi i viktimave merr në pyetje ata dëshmitarë.
5. Secilës palë duhet t'i jepet mundësia që t'i shtrojë pyetje dëshmitarit të pyetur nga pala tjetër.
6. Gjatë marrjes në pyetje të dëshmitarit, neni 154 i këtij Kodi zbatohet përshtatshmërisht.
7. Dëshmitarët pyeten lidhur me provat materiale dhe dokumentuese të rëndësishme.
8. Dëshmitari mund të ballafaqohet në pajtim me nenin 334 të këtij Kodi.
9. I dëmtuari i cili merret në pyetje si dëshmitar pyetet nëse dëshiron të realizojë kërkesën pasurore juridike në procedurë penale.

Neni 134
Dëshmitarët me nevoja të veçanta

Në qoftë se marrja në pyetje e dëshmitarëve bëhet nëpërmjet përkthyesit, ose kur dëshmitari është shurdh ose memec, pyetja e tij bëhet në mënyrën e paraparë në nenin 153 të këtij Kodi.

Neni 135
Mosparaqitja e dëshmitarit

1. Kur dëshmitari i cili është thirrur me rregull nuk paraqitet, e mosparaqitjen nuk e arsyeton, ose pa leje dhe shkak të arsyeshëm largohet nga vendi ku duhet të pyetet, atëherë mund të detyrohet të paraqitet dhe mund të dënohet me gjobë deri dyqindepesëdhjetë (250) Euro për çdo herë qe nuk paraqitet.
2. Nëse dëshmitari paraqitet kur është thirrur, por pasi të jetë bërë me dije për pasojat refuzon të dëshmojë pa arsyetim ligjor, mund të dënohet me gjobë deri në dyqindepesëdhjetë (250) Euro. Kur edhe pas kësaj refuzon të dëshmojë, atëherë mund të burgoset. Burgimi zgjat derisa dëshmitari nuk pranon të dëshmojë apo derisa dëshmimi i tij bëhet i panevojshëm, ose derisa procedura të përfundojë, por jo më shumë se një (1) muaj.
3. Për ankesë kundër aktvendimit me të cilin shqiptohet dënimi me gjobë ose me burgim vendos kolegji shqyrtues. Ankesa nuk e pezullon ekzekutimin e aktvendimit. Dënimi nga paragrafët 1. dhe 2. të këtij neni shqiptohet nga gjyqtari.
4. Pjesëtarët e forcave ushtarake dhe pjesëtarët e policisë nuk mund të burgosen, por për refuzimin e dëshmimit të tyre njoftohet komanda e tyre përkatëse.

Neni 136
Ekspertimi

1. Për përdorimin e ekspertizës nga prokurori i shtetit:
   1.1. duhet të jetë në pyetje fajësia ose pafajësia e të pandehurit ose shkalla e dëmit të shkaktuar me vepër penale;
   1.2. përgjigja në pyetjen nga nën-paragrafi 1.1. të këtij paragrafi mund të jepet vetëm nga ekspertiza e specializuar ose teknike;
   1.3. eksperti duhet të ketë përvojë ose trajnim të specializuar që është relevant dhe aktual;
   1.4. eksperti duhet të ketë analizuar provat e siguruara në mënyrë të ligjshme;
   1.5. gjatë ekspertizës, eksperti duhet të ketë përdorur praktika përgjithësisht të pranuara në fushën e tij ose të ketë bazë shkencore apo teknike; dhe
   1.6. eksperti duhet të hartojë raport, në të cilin përmblidhen metodat e përdorura të analizës dhe përfundimet;
2. Eksperti nuk mund të shpreh mendimin e tij lidhur me fajësinë ose pafajësinë e të pandehurit.
3. I pandehuri ose mbrojtësi i tij mund t'i kërkojnë prokurorit të shtetit që të merr deklaratë nga eksperti.
4. Viktima ose mbrojtësi i viktimave mund të kërkojë nga prokurori i shtetit që të merr deklaratë nga eksperti.

Neni 137
Vendimi për angazhimin e ekspertit

1. Para angazhimit të ekspertit, prokurori i shtetit nxjerr vendim në të cilin:
   1.1. i paraqet ekspertit pyetje specifike në të shkruar apo një sërë pyetjesh që janë të rëndësishme për fajësinë ose pafajësinë e të pandehurit ose shkallën e dëmit të shkaktuar me vepër penale;
   1.2. e përcakton emrin e ekspertit dhe paraqet bazën për ekspertimin e specializuar të ekspertit, përfshirë shkollimin e tij, përvojën dhe shërbimin e mëparshëm si ekspert i gjykatës; dhe
   1.3. i siguron ekspertit qasje në provat e duhura për ekspertimin e specializuar apo teknike.
2. I pandehuri, mbrojtësi, viktima ose mbrojtësi i viktimave mund të kundërshtojë përzgjedhjen e ekspertit bazuar në kualifikimet e tij apo konfliktin potencial të interesit duke paraqitur kundërshtim tek gjyqtari i procedurës paraprake. Gjyqtari i procedurës paraprake merr aktvendim mbi përzgjedhjen e ekspertit brenda dhjetë (10) ditëve prej momentit të caktimit të ekspertit.
3. Nëse ndonjë lloj i caktuar i ekspertizës i përgjigjet fushës së ndonjë institucioni profesional apo ekspertimi mund të bëhet brenda një organi publik të caktuar, kjo detyrë, posaçërisht nëse është detyrë e ndërlikuar, si rregull i besohet institucionit të tillë profesional apo organit publik. Institucioni profesional apo organi publik cakton një apo disa ekspertë për të kryer ekspertimin.
4. Po qe se është e mundur dhe nëse nuk krijohet konflikt interesi, ekspertët caktohen nga institucionet profesionale ose organet publike të cilat ofrojnë ekspertët e tyre kur një gjë e tillë kërkohet nga to.

5. Nëse eksperti në fjalë është i punësuar nga Qeveria e Kosovës në cilësinë e ekspertit të mjekësisë ligjore ose ekzaminuesit mjeko-ligjor, ai zbaton ekspertimin e specializuar siç përcaktohet me ligj, me urdhër të gjykatës apo me urdhër të prokurorit të shtetit.
6. Nëse në institucionin profesional apo organet publike nuk ekziston ekspertiza përkatëse, eksperti me ekspertimin përkatës angazhohet dhe kompensohet nga fondet publike. Shpenzimet e ekspertit i shtohen shpenzimeve të procedurës.
7. Eksperti zbaton ekspertimin pa vonesë dhe i dërgon prokurorit të shtetit me shkrim raportin e ekspertizës në pajtim me nenin 138 të këtij Kodi.

Neni 138
Raporti i ekspertit

1. Raporti i ekspertit përmban:
   1.1. të dhënat mbi identitetin e ekspertit dhe të dhënat mbi hetimin;
   1.2. pyetjet e rëndësishme që kanë të bëjnë me fajësinë ose pafajësinë e të pandehurit apo shkallën e dëmit të shkaktuar me vepër penale;
   1.3. përvoja dhe trajnimet e specializuara të ekspertit, arsyet pse këto janë relevante dhe sa është aktuale ajo përvojë apo ato trajnime;
   1.4. përshkrimi i provave që janë analizuar;
   1.5. përshkrimi i ekspertizës, përfshirë fotografitë relevante, vizatimet, tabelat përmbledhëse, radioskopinë, imazhet, rezultatet laboratorike ose të dhënat tjera shkencore apo teknike që janë të rëndësishme.
   1.6. shpjegimin se praktikat analitike janë kryesisht të pranuara në fushën e ekspertit ose kanë bazë shkencore apo teknike; dhe
   1.7. përfundimin që paraqet mendimin e ekspertit lidhur me pyetjet në paragrafin 2. të këtij neni, ose që shpjegon përse nuk është arritur të jepen përgjigje në ato pyetje.
2. Eksperti nuk shpreh ne raport mendimin e tij lidhur me fajësinë apo pafajësinë e të pandehurit.
3. Raporti i ekspertit i cili nuk është në pajtim me këtë nen nuk është i pranueshëm.
4. Raporti i ekspertit i bashkëngjitet shkresave të lëndës.
5. Raporti i ekspertit i zbulohet të pandehurit apo mbrojtësit të tij dhe të dëmtuarit jo më pak se pesë (5) ditë para fillimit të seancës për deklaratë në procedurë paraprake nga eksperti, por jo më vonë se dhjetë (10) ditë pasi që prokurori i shtetit të ketë pranuar raportin e ekspertit.

Neni 139
Urdhrat e nevojshëm për shqyrtimin e provave nga eksperti

1. Autopsia bëhet nga ekzaminuesi i kualifikuar mjekësor në bazë të urdhrit të prokurorit të shtetit. Autopsia nuk mund t'i besohet mjekut i cili e ka mjekuar të vdekurin. Ministria e Drejtësisë nxjerr udhëzime dhe standarde lidhur me autopsinë.
2. Analizat toksikologjike laboratorike të mostrave të viktimës mund të urdhërohen nga prokurori i shtetit.
3. Nëse i pandehuri nuk jep pëlqimin me shkrim për të dhënë mostrën e gjakut, indin

trupor, ADN-në apo të ngjashme, ose nuk jep pëlqimin me shkrim për t'iu nënshtruar ekzaminimit fizik të lëndimeve siç kërkohet në hetim, prokurori i shtetit kërkon nga gjyqtari i procedurës paraprake që të lëshojë urdhër për marrjen e mostrës që nevojitet apo për ekzaminimin në pajtim me nenin 144 të këtij Kodi.

4. Mostrat e marra në pajtim me urdhrin nga paragrafi 3. të këtij neni mund t'i nënshtrohen ekzaminimit molekular dhe gjenetik, për aq sa masat e tilla janë të nevojshme për të përcaktuar origjinën ose për të vërtetuar nëse gjurmët e gjetura janë të të pandehurit ose të dëmtuarit. Ekzaminimi i tillë molekular apo gjenetik mund të zbatohet vetëm sipas urdhrit të gjyqtarit të procedurës paraprake.
5. Nëse të dhënat mjekësore ka gjasë të përmbajnë informata relevante për procedurën penale, prokurori i shtetit kërkon nga gjyqtari i procedurës paraprake që të lëshojë urdhër që të dhënat t'i jepen prokurorit të shtetit.

Neni 140
Deklarata e ekspertit në procedurë paraprake

1. Eksperti mund të thirret për të dëshmuar në seancës për marrjen e deklaratës në procedurë paraprake nëse:
   1.1. mendimi i dhënë në raportin e ekspertit mbështet përfundimin mbi fajësinë e të pandehurit;
   1.2. mendimi i dhënë në raportin e ekspertit mbështet përfundimin mbi pafajësinë e të pandehurit;
   1.3. mendimi i dhënë në raportin e ekspertit mbështet përfundimin që identifikon të pandehurin, viktimën ose personin tjetër që është i rëndësishëm për hetimin; ose
   1.4. mendimi i dhënë në raportin e ekspertit mbështet një përfundim që është i rëndësishëm për hetimin.
2. I pandehuri ose viktima mund të pranojë përfundimet e raportit të ekspertit. Nëse të gjitha palët pranojnë përfundimet e raportit të ekspertit, një gjë e tillë shënohet në procesverbal dhe nuk merret deklaratë.
3. Deklarata e ekspertit në procedurë paraprake merret në pajtim me rregullat e cilësdo deklarate të dhënë në procedurë paraprake nga dëshmitari.
4. Eksperti merret në pyetje nga prokurori i shtetit, mbrojtësi, viktima dhe mbrojtësi i viktimave.
5. Procesverbali, transkripti ose incizimi i deklaratës i bashkëngjitet shkresave të lëndës.

Neni 141
Angazhimi i ekspertit nga i pandehuri

1. I pandehuri mund të kërkojë nga prokurori i shtetit që të paraqes kërkesë për ekspertizë që është relevante për mbrojtjen e tij. Nëse prokurori i shtetit refuzon, i pandehuri mund të kundërshtojë këtë vendim tek gjyqtari i procedurës paraprake.
2. I pandehuri mund të merr dhe të paguajë vetë për ekspertizë. Eksperti duhet të veprojë në pajtim me nenin 138 të këtij Kodi dhe prokurori i shtetit duhet të pranojë kopjen e raportit të ekspertit të mbrojtjes brenda katërmbëdhjetë (14) ditëve nga përfundimi i saj.

Neni 142
Kundërthëniet në mes të ekspertëve

Në qoftë se të dhënat në konstatimin e ekspertëve ndryshojnë thelbësisht, ose kur konstatimet e tyre janë të paqarta, jo të plota apo në kontradiktë me vetveten ose me rrethanat e shqyrtuara, e në rast se këto të meta nuk mund të mënjanohen me marrjen e sërishme në pyetje të ekspertëve, mund të kërkohet mendimi i ekspertëve tjerë.

Neni 143
Analizat toksikologjike

1. Çdo ekzaminim apo analizë nga ky nen i nënshtrohet rregullave të ekspertizës dhe deklaratës së ekspertit nga nenet 136-142 të këtij Kodi.
2. Kur dyshohet për helmim, prokurori i shtetit urdhëron që materiet e dyshimta të gjetura në kufomë ose në ndonjë vend tjetër të dërgohen në institutin për hulumtime toksikologjike për ekspertim.
3. Me rastin e analizave të materieve të dyshimta, eksperti përqendrohet në veçanti në përcaktimin e llojit, sasisë dhe efektit të helmit të gjetur. Kur materiet e dyshimta janë gjetur në trup, atëherë sasia e helmit të përdorur duhet të përcaktohet kudo që të jetë e mundur.

Neni 144
Ekzaminimi i lëndimeve trupore dhe ekzaminimi fizik

1. Çdo ekzaminim ose analizë nga ky nen i nënshtrohet rregullave të ekspertizës dhe deklaratës së ekspertit nga nenet 136-142 të këtij Kodi.
2. Nëse lëndimet trupore relevante për procedurën penale kanë qenë të trajtuara nga një mjek, ai mjek mund të thirret për të dhënë deklaratë në procedurë paraprake bazuar në të dhënat e marra në rrjedhën normale të trajtimit mjekësor, të cilat do të merren me urdhër të gjykatës apo me pëlqim. Nëse policia ka marrë fotografi të lëndimeve, mjeku trajtues mund të merret në pyetje në bazë të atyre fotografive dhe të ofrojë mendime të bazuara në arsimimin dhe përvojën e tij. Mjeku ose mjekët mund të nxjerrin një raport ekspertimi me gjetjet e tyre në pajtim me nenin 138 të këtij Kodi, por nuk janë të detyruar për ta bërë këtë.
3. Nëse lëndimet trupore apo gjendja fizike e personit nuk janë trajtuar apo të dhënat mjekësore nuk janë të plota, prokurori i shtetit mund të kërkojë nga gjyqtari i procedurës paraprake të urdhërojë të bëhet një ekzaminim fizik. Gjyqtari i procedurës paraprake mund të urdhërojë ekzaminimin fizik nëse ka arsye të bazuara për të besuar se ekzaminimi fizik do të rezultojë me prova të rëndësishme për procedurën penale. Personi që do të ekzaminohet mund të jep pëlqimin për ekzaminimin fizik pa urdhër të gjykatës. Institucioni profesional, mjeku ose mjekët do të nxjerrin një raport ekspertimi me gjetjet e tyre në pajtim me nenin 138 të këtij Kodi.
4. Gjyqtari i procedurës paraprake mund të urdhërojë marrjen e mostrave të gjakut ose indeve apo mostra të tjera mjeko-ligjore ose mjekësore nga një i pandehur, vetëm nëse ka gjasa reale që i pandehuri ka kryer vepër penale dhe ka shkak të bazuar për

të besuar se mostrat do të sigurojnë prova të veprës penale ose identitetin e kryerësit, apo ekzistojnë prova të tjera mjeko-ligjore që mund të krahasohen me mostrat e urdhëruara që të merren. Integriteti personal i të pandehurit do të respektohet gjatë ekzekutimit të urdhrit nga ky paragraf. Institucioni profesional, mjeku ose mjekët do të nxjerrin një raport ekspertimi me gjetjet e tyre në pajtim me nenin 138 të këtij Kodi.

5. Kur është e nevojshme mostra e flokut dhe e folikulës, pështymës, urinës, sekretit të hundës, pjesës sipërfaqësore të lëkurës duke përfshirë edhe zonën e ijëve, thonjtë e mostra të pjesës së poshtme të thoit si dhe mostra të tjera të ngjashme, të cilat nuk përbëjnë ndërhyrje trupore, ato mund të merren gjatë ekzaminimit fizik pa urdhër të veçantë të gjykatës.
6. Ekzaminimi fizik që ndërlidhet me ndërhyrjet trupore, siç është marrja e mostrave të gjakut gjatë ekzaminimit fizik, mund të bëhet vetëm me urdhër të gjykatës ose me pëlqimin e vullnetshëm të personit në fjalë.
7. Ekzaminimi fizik nga ky nen zbatohet nga mjeku, infermieri ose nga tekniku i kualifikuar në pajtim me rregullat e shkencës së mjekësisë, duke pasur respekt të plotë për dinjitetin e personit dhe konsideratën ndaj ndikimeve fizike dhe psikologjike në lëndimin e tij.
8. Dispozita e nenit 139, paragrafi 2. i këtij Kodi zbatohet përshtatshmërisht në rastet kur personi, përpos të pandehurit, refuzon që t'i shtrohet kontrollit të urdhëruar nga gjykata. Detyrimi mund të përdoret vetëm me urdhër të posaçëm të gjykatës.
9. Ministria e Drejtësisë mban të gjitha mostrat e marra si rezultat i urdhrave të gjykatës dhe pëlqimit vullnetar për një periudhë prej një viti pas marrjes së aktvendimit përfundimtar në procedurë penale, në të cilën kohë mostrat do të asgjësohen. Mostrat do të jenë në dispozicion dhe do të përdorën vetëm për ritestim të urdhëruar nga gjykata.
10. Ministria e Drejtësisë mban regjistër të të gjitha rezultateve mjeko-ligjore të marra në bazë të urdhrave të gjykatave apo me pëlqim vullnetar, vetëm kur personi i cili i shtrohet testimit mjeko-ligjor shpallet fajtor.

Neni 145
Analizat molekulare e gjenetike dhe analizat e ADN-së

1. Çdo ekzaminim ose analizë nga ky nen i nënshtrohet rregullave të ekspertizës dhe deklaratës së ekspertit nga nenet 136-142 të këtij Kodi.
2. Gjykata mund të urdhërojë që materiali i siguruar me masat nga neni 144 i këtij Kodi t'i nënshtrohet ekzaminimeve molekulare dhe gjenetike për aq sa masat e tilla janë të nevojshme për të përcaktuar prejardhjen ose për të vërtetuar nëse gjurmët e gjetura i përkasin të pandehurit apo të dëmtuarit.
3. Me qëllim të përcaktimit të identitetit në procedurë penale, indet qelizore mund të merren nga personi i pandehur për identifikimin e ADN-së në pajtim me nenin 144 të këtij Kodi.
4. Indi i marrur qelizor mund të përdoret vetëm për identifikimin e ADN-së, siç është paraparë në paragrafin 1. ose 2. të këtij neni; ai shkatërrohet pa vonesë kur më nuk është i nevojshëm për atë qëllim. Informacionet tjera, përveç atyre që kërkohen për të përcaktuar kodin e ADN-së, nuk përcaktohen gjatë ekzaminimit dhe janë të papranueshme.

5. Provat e gjetura, të siguruara apo të kapura në vendin e kryerjes së veprës penale apo që kanë lidhje me procedurën penale mund të ekzaminohen dhe mostrat mund t'i nënshtrohen ekzaminimit molekular dhe gjenetik sipas urdhrit të prokurorit të shtetit.
6. Rezultatet nga ekzaminimi molekular dhe gjenetik i mostrave të siguruara sipas paragrafit 5. të këtij neni të cilat nuk përputhen me të dyshuarin apo të pandehurin mund të ruhen nga Ministria e Drejtësisë deri në një kohë të tillë kur ato të përputhen me të dyshuarin apo të pandehurin dhe derisa ai i dyshuar apo i pandehur të lirohet apo të shpallet fajtor. Ministria e Drejtësisë lëshon rregullore mbi ruajtjen e rezultateve të ekzaminimit molekular dhe gjenetik sipas këtij paragrafi.

Neni 146
Analizat psikologjike

1. Çdo ekzaminim ose analizë nga ky nen i nënshtrohet rregullave të ekspertizës dhe deklaratës së ekspertit nga nenet 136-142 të këtij Kodi.
2. Nëse gjendja psikologjike që lidhet me procedurë penale ka qenë e vlerësuar ose trajtuar nga një psikolog apo mjek, ai psikolog apo mjek do të thirret nga prokurori i shtetit për të dhënë deklaratë në procedurë paraprake bazuar në të dhënat e marra në rrjedhën normale të trajtimit, të cilat do të merren në bazë të urdhrit të gjykatës apo me pëlqim. Psikologu apo mjeku mund të japë mendime bazuar në arsimimin dhe përvojën e tij. Psikologu apo mjeku mund të nxjerrë një raport ekspertimi me gjetjet e tyre në pajtim me nenin 138 të këtij Kodi, por nuk është i detyruar për ta bërë këtë.
3. Personi i cili është vlerësuar mund të kundërshtojë thirrjen para gjyqtarit të procedurës paraprake nëse ka shqetësime të privatësisë që nuk tejkalojnë rëndësinë e procedurës penale.
4. Nëse gjendja relevante psikologjike e një personi nuk është trajtuar, prokurori i shtetit mund të kërkojë nga gjyqtari i procedurës paraprake të urdhërojë që të bëhet vlerësimi psikologjik. Gjyqtari i procedurës paraprake mund të urdhërojë vlerësimin psikologjik nëse ka shkak të bazuar për të besuar se vlerësimi psikologjik do të rezultojë me prova relevante për procedurën penale. Personi që do të vlerësohet mund të jep pëlqimin për vlerësimin psikologjik pa urdhër të gjykatës. Institucioni profesional, psikologu apo mjeku do të nxjerrin një raport ekspertimi me gjetjet e tyre në pajtim me nenin 138 të këtij Kodi.
5. Gjyqtari i procedurës paraprake mund të urdhërojë vlerësimin psikologjik të të pandehurit vetëm nëse ka gjasa reale që i pandehuri ka kryer vepër penale, ka shkak të bazuar për të besuar se gjendja psikologjike e të pandehurit është paaftësuar ose ka qenë e paaftësuar në kohën e kryerjes së veprës penale, dhe që paaftësimi i tillë psikik është i rëndësishëm për procedurën penale ose për të drejtën e të pandehurit për një gjykim të drejtë. Psikologu apo mjeku do të nxjerrin një raport ekspertimi me gjetjet e tyre në pajtim me nenin 138 të këtij Kodi.
6. Ekzaminimi psikologjik bëhet nga psikologët ose mjekët profesionistë të trajnuar në psikologji apo psikiatri. Ekzaminimet kryhen në një mënyrë që respekton të drejtën e privatësisë.

Neni 147
Analiza kompjuterike

1. Çdo ekzaminim ose analizë nga ky nen i nënshtrohet rregullave të ekspertizës dhe deklaratës së ekspertit nga nenet 136-142 të këtij Kodi.
2. Për pajisjet kompjuterike, pajisjet elektronike të ruajtjes apo pajisje të ngjashme që janë marrë në mënyrë të ligjshme nëpërmjet një urdhri të gjykatës ose me pëlqim, prokurori i shtetit mund të autorizojë zyrtarin e policisë apo ekspertin për të shqyrtuar, analizuar dhe kërkuar për informata ose të dhëna që gjenden brenda pajisjeve kompjuterike, pajisjeve elektronike për ruajtje ose pajisjeve të ngjashëm.
3. Zyrtari i autorizuar i policisë ose eksperti tjetër duhet të ketë arsimim, trajnim ose përvojë në analizat dhe kërkimin kompjuterik.
4. Zyrtari i autorizuar i policisë ose eksperti tjetër nxjerrë raport ekspertimi me gjetjet e tyre në pajtim me nenin 138 të këtij Kodi, që do të përfshijë të dhënat e mëposhtme:
   4.1. zyrtari i autorizuar i policisë ose eksperti tjetër përshkruan pajisjet kompjuterike, pajisjet për ruajtjen e të dhënave, ose dosjet e veçanta kompjuterike të ekzaminuara, përfshirë edhe ndonjë emër identifikimi, numra ose etiketa të provave.
   4.2. zyrtari i autorizuar i policisë ose eksperti tjetër përshkruan se ku dhe si janë marrë nga policia pajisjet kompjuterike, pajisjet për ruajtje të dhënave ose dosjet e veçanta kompjuterike.
   4.3. zyrtari i autorizuar i policisë ose eksperti tjetër përshkruan radhën e mbikëqyrjes së pajisjeve kompjuterike, pajisjeve për ruajtjen e të dhënave ose dosjeve të veçanta kompjuterike.
   4.4. zyrtari i autorizuar i policisë ose eksperti tjetër përshkruan informacionin specifik faktik për të cilin ka qenë i autorizuar për të kërkuar në pajisje kompjuterike, pajisje për ruajtje të të dhënave ose dosje të veçanta kompjuterike.
   4.5. zyrtari i autorizuar i policisë ose eksperti tjetër përshkruan hapat e ndërmarrë në përputhje me praktikat më aktuale në fushën e forenzikës kompjuterike për të realizuar kërkimin në mënyrë të saktë dhe të besueshme, përfshirë por pa u kufizuar në hapat e ndërmarrë për të mbrojtur kundër humbjes së dosjeve, deshifrimit të dosjeve, rikthimit të dosjeve të fshira apo marrjen e të dhënave nga dosjet kompjuterike ose emailat.
   4.6. zyrtari i autorizuar i policisë ose eksperti tjetër përshkruan rezultatet e kërkimit dhe i bashkëngjet kopjen elektronike të dosjeve kompjuterike që janë të rëndësishme për kërkimet.

Neni 148
Analiza financiare

1. Çdo ekzaminim ose analizë nga ky nen i nënshtrohet rregullave të ekspertizës dhe deklaratës së ekspertit nga nenet 136-142 të këtij Kodi.
2. Për të dhënat financiare që janë marrë në mënyrë të ligjshme nëpërmjet urdhrit të gjykatës ose me pëlqim, prokurori i shtetit mund të autorizojë zyrtarin e policisë ose

ekspertin për të shqyrtuar, analizuar dhe përmbledhur të dhënat financiare. Prokurori i shtetit specifikon nëse zyrtari i autorizuar i policisë ose eksperti tjetër do të përcaktojë:

2.1. nëse mjetet financiare janë dobi pasurore nga veprat e supozuara penale ose janë përdorur në kryerjen e veprave të supozuara penale;

2.2. lëvizja e mjeteve financiare që mund të jenë dobi pasurore nga veprat e supozuara penale ose mund të kenë qenë përdorur në kryerjen e veprave të supozuara penale;

2.3. nëse mjetet financiare mungojnë për shkak të veprave të supozuara penale dhe, nëse është e mundur, mjetet dhe metodat e përdorura;

2.4. dëmi material i shkaktuar nga veprat e supozuara penale;

2.5. përfitimi material nga veprat e supozuara penale;

2.6. shuma e tatimeve apo tarifave doganore që mund ti ketë detyrim i pandehuri; ose

2.7. çdo çështje tjetër relevante për procedurën penale.

3. Zyrtari i autorizuar i policisë ose eksperti tjetër duhet të ketë arsimim, trajnim ose përvojë në analiza financiare apo në kontabilitet.

4. Zyrtari i autorizuar i policisë ose eksperti tjetër nxjerrë raport ekspertimi me gjetjet e tyre në pajtim me nenin 138 të këtij Kodi.

5. Nëse kërkohet kontroll auditimi i të dhënave financiare për shkak të shkallës së madhe të veprave penale financiare, llojit të madh apo të ndërlikuar të të dhënave financiare ose nëse të dhënat financiare duhet të rindërtohen ose të rregullohen, prokurori i shtetit kërkon nga gjykata që të autorizojë auditivin me ç'rast:

5.1. urdhri i gjykatës udhëzon ekspertin për qëllimin dhe fushëveprimin e auditimit dhe faktet e rrethanat të cilat duhet të konstatohen. Shpenzimet për këtë mbulohen nga ndërmarrja afariste ose personi juridik.

5.2. aktvendimin për rregullimin e kontabilitetit e merr gjykata në bazë të raportit me shkrim nga eksperti i caktuar për të kontrolluar librat afariste. Në aktvendim po ashtu saktësohet shuma që ndërmarrja afariste apo personi tjetër juridik detyrohet t'ia deponojë gjykatës si paradhënie për shpenzimet rreth rregullimit të kontabilitetit të tij. Kundër këtij aktvendimi nuk lejohet ankesë.

5.3. pas rregullimit të kontabilitetit, gjykata, në bazë të raportit të ekspertëve, merr aktvendimin me të cilin cakton lartësinë e shpenzimeve të krijuara për shkak të rregullimit të kontabilitetit dhe urdhëron që këtë shumë ta paguajë ndërmarrja afariste ose personi tjetër juridik. Ndërmarrja afariste apo personi tjetër juridik mund të ankohen për bazueshmërinë e vendimit lidhur me kompenzimin dhe shumën e shpenzimeve. Për ankesë vendos kolegji prej tre gjyqtarësh.

5.4. arkëtimi i shpenzimeve, po qe se shuma e tyre nuk ka qenë paradhënë, bëhet në dobi të organit i cili që më parë ka paguar shpenzimet dhe ka bërë pagesën për ekspertët.

Neni 149
Mundësia hetuese e veçantë

1. Përjashtimisht, prokurori i shtetit, viktima, mbrojtësi i viktimave, i pandehuri ose mbrojtësi i tij mund të kërkojë nga gjyqtari i procedurës paraprake të merr dëshmi nga dëshmitari ose të kërkojë ekspertizë me qëllim të ruajtjes së provës kur ekziston një mundësi e veçantë për marrjen e provës së rëndësishme ose kur ka rrezik të konsiderueshëm se kjo provë nuk do të mund të merrej gjatë shqyrtimit gjyqësor.
2. Gjyqtari i procedurës paraprake miraton kërkesën nga paragrafi 1. i këtij neni vetëm kur procedura penale zbatohet për hetimin e veprave penale të përcaktuar në nenin 90 të këtij Kodi.
3. Gjyqtari i procedurës paraprake cakton dy (2) gjyqtarë tjerë në Panelin për Mundësinë Hetuese të Veçantë.
4. Nëse ngritet aktakuza në procedurë penale, së paku njëri prej dy gjyqtarëve nga paragrafi 3. të këtij neni caktohet si kryetar i trupit gjykues ose caktohet në trupin gjykues.
5. Kolegjit shqyrtues mund t'i paraqitet ankesë kundër mospranimit të gjyqtarit të procedurës paraprake për marrjen e dëshmisë së tillë.
6. Në rastet e Mundësisë Hetuese të Veçantë sipas këtij neni, gjyqtari i procedurës paraprake merr masat e nevojshme për të siguruar efikasitetin dhe tërësinë e procedurës, dhe në veçanti për të mbrojtur të drejtat e të pandehurit. I pandehuri, mbrojtësi i tij dhe prokurori i shtetit janë të pranishëm në seancën e dëgjimit për marrjen e dëshmisë. Viktima dhe mbrojtësi i viktimave njoftohen për seancën e dëgjimit dhe ata kanë të drejtë të jenë të pranishëm. Marrja e dëshmisë nga gjyqtari i procedurës paraprake zbatohet në pajtim me dispozitat që rregullojnë marrjen e dëshmive në shqyrtim gjyqësor.
7. Çdo deklaratë e marrë në Panelin e Mundësisë Hetuese të Veçantë audio incizohet ose audio dhe video incizohet, dhe ky incizim i bashkëngjitet shkresave të lëndës.
8. Dëshmia mund të merret me anë të teknologjisë që mundëson video-konferencat nëse dëshmitari nuk gjendet në Kosovë dhe ka gjasë që mos të kthehet në Kosovë, apo në pajtim me masën për mbrojtjen e dëshmitarëve.

Neni 150
Këqyrja dhe rikonstruksioni

1. Prokurori i shtetit mund të urdhërojë këqyrjen ose rikonstruksionin e vendit të ngjarjes për të shqyrtuar provat e mbledhura ose për të qartësuar faktet e rëndësishme për procedurën penale.
2. Këqyrjen ose rikonstruksionin e tillë të vendit të ngjarjes e kryen prokurori i shtetit ose policia. Prokurori i shtetit dhe policia mund të kryejnë këqyrjen ose rikonstruksionin e tillë për t'u njoftuar personalisht me gjendjen, e cila do t'u ndihmonte në përcaktimin e besueshmërisë ose gjetjen e fakteve, por në rastin e tillë, rezultatet për gjykatën janë të papranueshme, përveç nëse është në pajtim me paragrafin 3. ose 4. të këtij neni. Prokurori i shtetit mund ta përsërisë këqyrjen ose rikonstruksionin e tillë me njoftim, siç parashihet me këtë nen, me ç'rast rezultatet e tilla janë të pranueshme.

3. Nëse identiteti i tyre është i njohur, prokurori i shtetit njofton të dyshuarin, të pandehurin apo mbrojtësin e tij lidhur me këqyrjen dhe rikonstruksionin. Mbrojtësi i të pandehurit ka të drejtë të jetë i pranishëm në këqyrje ose në rikonstruksion të vendit të ngjarjes.
4. Nëse i dyshuari, i pandehuri apo mbrojtësi i tij janë të panjohur për prokurorin e shtetit, gjyqtari i procedurës paraprake merr pjesë dhe vëzhgon këqyrjen dhe rikonstruksionin.
5. Rikonstruksioni kryhet me rikrijimin e fakteve ose të situatave nën rrethanat e të cilave është zhvilluar ngjarja, bazuar në provat e mbledhura. Nëse faktet ose situatat paraqiten ndryshe në dëshmitë e dëshmitarëve konkretë, në parim, rikonstruksioni i ngjarjes zbatohet veçmas me secilin dëshmitar.
6. Gjatë rikonstruksionit të ngjarjes duhet pasur kujdes që të mos shkelet ligji dhe rendi, të mos fyhet morali publik apo të mos vihet në rrezik jeta ose shëndeti i njerëzve.
7. Këqyrja ose rikonstruksioni i vendit të ngjarjes mund të ndihmohet nga specialistët e mjekësisë ligjore, trafikut dhe lëmenjve të tjera që mund të angazhohen për të mbrojtur ose përshkruar provat, për të bërë matjet dhe incizimet e nevojshme, për të bërë skicat apo për të mbledhur informata të tjera. Dispozitat nga ky nen nuk prejudikojnë kompetencat e policisë për të ndërmarrë hapa fillestarë në mbledhjen e informatave, për të bërë matje, incizime, skica dhe për të mbledhur prova mjeko-ligjore nga nenet 70-77 të këtij Kodi.
8. Të dhënat e marra sipas neneve 70-77 të këtij Kodi në një raport që është përshtatshmërisht në pajtim më paragrafët 1. dhe 2. të nenit 138 të këtij Kodi mund të jenë të pranueshme bazuar në shqyrtimin e gjyqtarit të procedurës paraprake. Gjyqtari i procedurës paraprake mund të urdhërojë këqyrje dhe rikonstruksion minimal të vendit të ngjarjes për të vërtetuar gjetjet në raportin nga ky paragraf. Gjyqtari i procedurës paraprake urdhëron që raporti të jetë i pranueshëm.
9. Eksperti gjithashtu mund të thirret që të jetë i pranishëm në këqyrje apo në rikonstruksion të vendit të ngjarjes kur prania e tij konsiderohet e dobishme nga prokurori i shtetit ose nga gjykata.
10. Pas ngritjes së aktakuzës, kryetari i trupit gjykues mund të urdhërojë rikonstruksionin e vendit të ngjarjes nga ky nen vetëm nëse fajësia apo pafajësia e të pandehurit kërkon që trupi gjykues të ketë njohuri të drejtpërdrejtë nga rikonstruksioni i vendit të ngjarjes apo nga vizita në vendin e kryerjes së veprës penale.

D. Marrja në pyetje e të pandehurit në procedurë paraprake

Neni 151
Marrja në pyetje e të pandehurit në procedurë paraprake

1. Para ngritjes së aktakuzës, i pandehuri merret në pyetje në seancën e marrjes së deklaratës në procedurë paraprake. Nëse i pandehuri hetohet për vepër apo vepra penale për të cilat dënimi maksimal i paraparë është jo më shumë se tre (3) vjet burgim, mjafton që të pandehurit t'i jepet mundësia që të përgjigjet me shkrim.
2. Pas thirrjes, i pandehuri detyrohet të paraqitet para prokurorit të shtetit. Neni 174,

paragrafi 2. deri në 5. të këtij Kodi zbatohen përshtatshmërisht. I pandehuri mund të paraqesë ankesë te gjyqtari i procedurës paraprake për të vendosur mbi ligjshmërinë e detyrimit të tij për t'u paraqitur para prokurorit të shtetit.

Neni 152
Zbatimi i marrjes në pyetje të të pandehurit në procedurë paraprake

1. Të pandehurin e merr në pyetje prokurori i shtetit. Prokurori i shtetit marrjen në pyetje mund t'ia besojë policisë.
2. Para çdo marrjeje në pyetje, pavarësisht se a është i ndaluar ose në liri, të pandehurit i lexohet paralajmërimi nga neni 125, paragrafi 3. të këtij Kodi.
3. Para çdo marrjeje në pyetje, i pandehuri informohet për:
   3.1. veprën penale për të cilën akuzohet; dhe
   3.2. faktin se ai mund të kërkojë marrjen e provave për mbrojtjen e tij. Kur i pandehuri është në paraburgim, para çdo marrjeje në pyetje ai gjithashtu informohet për të drejtën e tij për të pasur mbrojtës, nëse nuk mund t'i paguajë shpenzimet për ndihmë juridike.
   3.3. e drejta për të heshtur dhe të mos përgjigjet në asnjë pyetje, përveç se të japë informacion në lidhje me identitetin e tij / të saj.
4. I pandehuri ka të drejtë të këshillohet me mbrojtësin e tij para dhe gjatë marrjes në pyetje.
5. Kur veprohet sipas këtij neni, çdo marrje në pyetje e të pandehurit nga policia ose prokurori i shtetit incizohet audio ose video në pajtim me nenin 208 ose 209 të këtij Kodi. Në rastet kur praktikisht kjo është e pamundur, procesverbali me shkrim i marrjes në pyetje bëhet në pajtim me Kapitullin XI të këtij Kodi dhe në procesverbal shënohen arsyet pse marrja në pyetje nuk ka mund të incizohet audio ose video.

Neni 153
E drejta e të pandehurit në përkthim

1. I pandehuri merret në pyetje me ndihmën e përkthyesit në rastet e parapara nga ky Kod.
2. Kur i pandehuri është shurdh ose memec, pyetjet i bëhen nëpërmjet një përkthyesi të kualifikuar për gjuhën e shenjave ose me shkrim. Nëse marrja në pyetje nuk mund të zbatohet në këtë mënyrë, personi i cili di të komunikojë me të pandehurin ftohet në rolin e përkthyesit, por jo në rastet kur ka konflikt interesi.
3. Nëse përkthyesi nuk është betuar më parë, ai betohet se besnikërisht do të përkthejë pyetjet që i parashtrohen të pandehurit dhe deklarimet e dhëna.
4. Përkthyesi vepron në pajtim me nenin 215 të këtij Kodi.

Neni 154
Marrja në pyetje e të pandehurit gjatë deklaratës në procedurë paraprake

1. Gjatë marrjes në pyetje për herë të pare, i pandehuri duhet të tregojë emrin dhe mbiemrin e tij dhe nofkën nëse ka; emrin dhe mbiemrin e prindërve të tij; mbiemrin

e vajzërisë së nënës; vendlindjen dhe vendbanimin e tij; ditën, muajin dhe vitin e lindjes; numrin e tij personal të identifikimit; kombësinë dhe shtetësinë; profesionin e tij dhe rrethanat familjare; a di shkrim e lexim; shkollimin e tij; a ka të ardhura personale edhe pozitën e tij materiale; a është ndonjë procedurë penale kundër tij për ndonjë vepër tjetër penale në zbatim e sipër; dhe nëse është i mitur, identitetin e përfaqësuesit të tij ligjor. Ai informohet për detyrimin e tij për të njoftuar për çdo ndryshim adrese ose për çdo qëllim ndryshimi të vendqëndrimit.

2. I pandehuri merret në pyetje gojarisht. Gjatë marrjes në pyetje atij mund t'i lejohet të mbajë shënime.
3. Marrja në pyetje zbatohet duke respektuar plotësisht dinjitetin e të pandehurit.
4. Të pandehurit pyetjet i parashtrohen në mënyrë të qartë, të kuptueshme dhe të përpiktë. Pyetjet të pandehurit nuk duhet parashtruar në bazë të supozimit që i pandehuri ka pranuar diçka që ai nuk e ka pranuar. Të pandehurit mund t'i kërkohet që të pohojë ose të mohojë fakte të caktuara.
5. Ndalesat nga paragrafi 4. i këtij neni zbatohen pavarësisht nga pëlqimi i të pandehurit.
6. Të pandehurit i parashtrohen pyetje bazuar në provat dhe shkresat që janë relevante për procedurën penale. Gjatë pyetjeve që kanë të bëjnë me prova apo dokumente, të pandehurit i paraqitet çdo provë ose shkresë relevante. Provat ose dokumentet identifikohen qartë në procesverbal.
7. Sendet të cilat janë të lidhura me veprën penale ose të cilat shërbejnë si provë, pas përshkrimit nga i pandehuri atij i prezantohen për njohje. Nëse këto sende nuk mund të sillen, i pandehuri dërgohet në vendin ku ato ndodhen.
8. Marrja në pyetje të pandehurit duhet t'i ofrojë mundësinë për t'i kundërshtuar arsyet e dyshimit kundër tij dhe për të nxjerrë në pah faktet që janë në favor të tij.

Neni 155
Pranueshmëria e deklaratave të të pandehurit

Nëse marrja në pyetje e të pandehurit është zbatuar në shkelje të dispozitave nga neni 257, paragrafi 4. ose neni 152 i këtij Kodi, deklarimet e të pandehurit janë të papranueshme.

E. Shqyrtimi, pezullimi, pushimi dhe afatet kohore të hetimit

Neni 156
Shqyrtimi i detyrueshëm i lëndës

Çdo tre (3) muaj, prokurori i shtetit dhe kryeprokurori i zyrës së tij shqyrtojnë lëndën dhe konstatojnë nëse hetimi duhet të mbetet i hapur, të pezullohet, të pushohet apo të ngritet aktakuza.

Neni 157
Pezullimi i hetimit

1. Prokurori i shtetit mund të pezullojë hetimin me aktvendim nëse i pandehuri pas kryerjes së veprës penale vuan nga një çrregullim ose paaftësi e përkohshme mendore

ose nga ndonjë sëmundje tjetër e rëndë, nëse është arratisur ose ekzistojnë rrethana të tjera të cilat përkohësisht e pengojnë ndjekjen me sukses të të pandehurit.
2. Para se të pezullohet hetimi, mblidhen të gjitha provat e mundshme lidhur me veprën penale dhe përgjegjësinë penale të të pandehurit.
3. Prokurori i shtetit rifillon hetimin pas eliminimit të pengesave të cilat e kanë shkaktuar pezullimin.
4. Prokurori i shtetit bën një shënim në procesverbalin e hetimit lidhur me kohën dhe arsyet e pezullimit të hetimit dhe kohën e rifillimit të hetimit. Prokurori i shtetit pa vonesë e njofton gjyqtarin e procedurës paraprake për pezullimin.
5. Koha derisa hetimi është pezulluar nuk llogaritet në kohën për zbatimin e hetimit, e as në kohën për parashkrimin e veprës penale.

Neni 158
Pushimi i hetimit

1. Prokurori i shtetit e pushon hetimin kurdo që është vërtetuar nga provat e mbledhura se:
   1.1. nuk ekziston dyshim i arsyeshëm që personi konkret e ka kryer veprën e tillë penale;
   1.2. vepra e kryer nuk është vepër penale që ndiqet sipas detyrës zyrtare;
   1.3. ka kaluar afati i parashkrimit;
   1.4. vepra penale është përfshirë në falje ose në amnistinë e lëshuar para miratimit të Kushtetutës së Republikës së Kosovës; ose
   1.5. vepra penale është përfshirë në amnistinë e lëshuar para miratimit të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.
   1.6. ekzistojnë rrethana të tjera të cilat përjashtojnë ndjekjen.
2. Prokurori i shtetit brenda tetë ditësh pas pushimit të hetimit e lajmëron të dëmtuarin për këtë fakt dhe arsyet për këtë. Prokurori i shtetit pa vonesë e njofton gjyqtarin e procedurës paraprake për pushimin e hetimit.
3. Hetimi pushon automatikisht me kalimin e afatit kohor nga neni 159 të këtij Kodi.

Neni 159
Afatet kohore të hetimit

1. Kur fillohet hetimi, hetimi përfundon brenda dy (2) viteve. Nëse brenda dy (2) viteve nga fillimi i hetimit paraprak nuk është ngritur aktakuzë, ose nuk është pezulluar hetimi sipas nenit 157 të këtij Kodi, hetimi menjëherë pushohet.
2. Gjyqtari i procedurës paraprake mund të autorizojë një vazhdim deri në gjashtë (6) muaj të hetimit nga paragrafi 1. të këtij neni, në rastet kur hetimi penal është i ndërlikuar, përfshirë por pa u kufizuar kur ka katër apo më shumë të pandehur, janë identifikuar disa të dëmtuar, është bërë kërkesa për ndihmë juridike ndërkombëtare, apo ekzistojnë rrethana tjera të jashtëzakonshme.
3. Nëse i pandehuri është arrestuar dhe mbahet në paraburgim, gjyqtari i procedurës paraprake nuk urdhëron vazhdimin nga paragrafi 2. të këtij neni apo vazhdimin e paraburgimit përveç nëse prokurori i shtetit tregon se hetimi po zbatohet në mënyrë aktive dhe vonesat janë jashtë kontrollit të tij.

Neni 160
Vdekja e të pandehurit

Kur gjatë rrjedhës së procedurës penale vërtetohet se i pandehuri ka vdekur, prokurori i shtetit merr aktvendim për pushimin e procedurës penale.

KAPITULLI X
HEQJA E LIRISË PARA NGRITJES SË AKTAKUZËS DHE MASAT PËR SIGURIMIN E PRANISË SË TË PANDEHURIT

1. PARIMET E PËRGJITHSHME

Neni 161
Parimi i interpretimit

1. Nenet nga ky kapitull interpretohen nga policia, prokurori i shtetit dhe gjykatat duke u mbështetur në këto parime:
   1.1. e drejta e të pandehurit për liri dhe siguri përcakton prezumimin në favor të qëndrimit në liri.
   1.2. privimi nga liria sipas këtij kapitulli urdhërohet nga gjykata vetëm nëse prokurori i shtetit paraqet prova nga ky kapitull që mbipeshojnë prezumimin nga nën-paragrafi 1.1. të këtij paragrafi;
   1.3. kur urdhërohet heqja e lirisë nga ky kapitull, policia, prokurori i shtetit ose gjykata përdor kufizimet më të vogla të mundshme ndaj lirisë.
   1.4. ky nen zbatohet për masat për heqjen e lirisë apo për sigurimin e pranisë së të pandehurit gjatë procedurës penale.

2. HEQJA E LIRISË PARA NGRITJES SË AKTAKUZËS

Neni 162
Arrestimi i përkohshëm dhe ndalimi policor

Kur një person kapet në flagrancë gjatë kryerjes së veprës penale e cila ndiqet sipas detyrës zyrtare ose është në ndjekje për veprën e kryer penale, policia ose çdo person tjetër është i autorizuar ta arrestojë atë përkohësisht edhe pa urdhër të gjykatës. Personi të cilit i është hequr liria nga persona të tjerë përpos policisë, menjëherë i dorëzohet policisë, e kur kjo është e pamundur menjëherë njoftohet policia ose prokurori i shtetit. Policia vepron në pajtim me nenin 163 dhe 164 të këtij Kodi.

Neni 163
Kufizimet në arrestimin e përkohshëm dhe ndalimin policor

1. Policia nuk mund të privojë personin nga liria, përveç nëse:
   1.1. arrestimi lejohet sipas nenit 162 të këtij Kodi;
   1.2. ka urdhër të gjykatës për të arrestuar personin;
   1.3. ka urdhërarrest që duket të jetë i vlefshëm, të pranuar përmes INTERPOL-it apo rrugëve tjera diplomatike;

1.4. rrestimi është i autorizuar nga neni 164 të këtij Kodi; ose
1.5. privimi nga liria është i shkurtë dhe në pajtim me nenin 72 të këtij Kodi.

2. Çdo person i privuar nga liria me arrest sipas këtij neni duhet që pa vonesë ta sillet te gjyqtari i procedurës paraprake për të vendosur mbi paraburgimin. Vonesa nuk tejkalon dyzet e tetë (48) orë.

Neni 164
Arrestimi gjatë fazës së hetimit

1. Kur prokurori i shtetit autorizon hetimin, policia arreston dhe ndalon personin vetëm nëse:
   1.1. ka dyshim të bazuar se ai ka kryer vepër penale që ndiqet sipas detyrës zyrtare; dhe
   1.2. ka baza të artikulueshme për të besuar se:
      1.2.1. ka rrezik të arratisjes;
      1.2.2. ai do të asgjësojë, fshehë, ndryshojë ose falsifikojë provat e veprës penale, ose kur rrethanat e posaçme tregojnë se ai do të pengojë rrjedhën e procedurës penale duke ndikuar në dëshmitarë, në të dëmtuarit apo në bashkëpjesëmarrësit; ose
      1.2.3. kur pesha e veprës penale, mënyra ose rrethanat në të cilat është kryer vepra penale, karakteristikat e tij personale, sjellja e mëparshme, ambienti dhe kushtet nën të cilat ai jeton ose ndonjë rrethanë tjetër personale tregojnë rrezikun se ai mund ta përsërisë veprën penale, mund ta përfundojë veprën e tentuar penale ose ta kryejë veprën penale për të cilën është kanosur ta kryej.
2. Arrestimi dhe ndalimi nga ky nen autorizohet nga prokurori i shtetit që ka filluar hetimin, ose kur për shkak të rrethanave të ngutshme autorizimi i tillë nuk mund të merret para arrestimit, nga policia e cila menjëherë pas arrestimit duhet të informojë prokurorin e shtetit.
3. Personi i arrestuar sipas këtij neni gëzon të drejtat e të pandehurit.
4. Me rastin e arrestimit, personi i arrestuar informohet:
   4.1. gojarisht për të drejtat e parapara në nenin 167 të këtij Kodi; dhe
   4.2. me shkrim për të drejtat tjera të cilat ai i gëzon sipas këtij Kodi.
5. Ndalimi nga ky nen nuk mund të kalojë dyzet e tetë (48) orë nga koha e arrestimit. Pas kalimit të këtij afati, policia e liron të ndaluarin, përveç rasteve kur gjyqtari i procedurës paraprake ka urdhëruar paraburgimin.
6. Sa më shpejtë që është e mundur pas arrestimit dhe jo më vonë se gjashtë (6) orë nga koha e arrestimit, prokurori i shtetit i lëshon personit të arrestuar vendimin me shkrim mbi ndalimin, që përfshin emrin dhe mbiemrin e personit të arrestuar, vendin, ditën dhe kohën e saktë të arrestimit, veprën penale për të cilën dyshohet dhe bazën juridike për arrestim.
7. Brenda njëzetekatër (24) orëve pas arrestimit, prokurori i shtetit i paraqet gjyqtarit të procedurës paraprake kërkesën për caktimin e paraburgimit.
8. Kërkesa për caktimin e paraburgimit duhet të jetë në pajtim me nenin 165 të këtij Kodi.
9. I pandehuri përfaqësohet nga mbrojtësi në seancën dëgjimore për shqyrtimin e

kërkesës për caktim të paraburgimit. Mbrojtësi ka qasje në shkresat e lëndës së të pandehurit për t'u përgatitur për seancën.

10. Sa më parë që të jetë e mundur, por jo më vonë se brenda dyzetetetë (48) orëve nga arresti, gjyqtari i procedurës paraprake mban seancën dëgjimore për të vendosur nëse i pandehuri duhet të mbahet në paraburgim.
11. Sa më parë që të jetë e mundur, por jo më vonë se brenda dyzet e tetë (48) orëve nga seanca dëgjimore sipas paragrafit 10. të këtij neni, gjyqtari i procedurës paraprake nxjerr aktvendim lidhur me caktimin apo jo të paraburgimit të të pandehurit.
12. Gjyqtari i procedurës paraprake duhet të shqyrtojë nëse mund të urdhërohen masa më të buta për sigurimin e pranisë së të pandehurit nga neni 173 të këtij Kodi.
13. Ndaj aktvendimit të gjyqtarit të procedurës paraprake për caktim të paraburgimit mund të paraqitet ankesë në përputhje me dispozitat e nenit 189, paragrafi 3. të këtij Kodi.

Neni 165
Kërkesa për caktimin e masës për sigurimin e pranisë së të pandehurit

1. Nëse prokurori i shtetit beson se duhet masë më e butë për sigurimin e pranisë së të pandehurit sipas nenit 173 të këtij Kodi, ai paraqet kërkesë për masën më të butë për sigurimin e pranisë së të pandehurit.
2. Nëse prokurori i shtetit beson se duhet caktuar masën e paraburgimit, ai i paraqet gjyqtarit të procedurës paraprake kërkesë për caktim të paraburgimit, e cila përfshinë:
   - 2.1. emrin dhe mbiemrin e personit të arrestuar;
   - 2.2. vendin, datën dhe kohën e saktë të arrestimit;
   - 2.3. veprën penale për të cilën dyshohet i pandehuri;
   - 2.4. përshkrimin e provave që mbështesin dyshimin e bazuar se personi i arrestuar ka kryer veprën e dyshuar penale;
   - 2.5. përshkrimin e provave që mbështesin bazat e artikulueshme për të besuar se:
     - 2.5.1. ka rrezik të arratisjes;
     - 2.5.2. personi i arrestuar do të asgjësojë, fshehë, ndryshojë ose falsifikojë provat e veprës penale, ose kur rrethanat e posaçme tregojnë se ai do të pengojë rrjedhën e procedurës penale duke ndikuar në dëshmitarë, në të dëmtuarit apo në bashkëpjesëmarrësit; ose
     - 2.5.3. kur pesha e veprës penale, mënyra ose rrethanat në të cilat është kryer vepra penale, karakteristikat e tij personale, sjellja e mëparshme, ambienti dhe kushtet nën të cilat ai jeton ose ndonjë rrethanë tjetër personale tregojnë rrezikun se ai mund ta përsërisë veprën penale, mund ta përfundojë veprën e tentuar penale ose ta kryejë veprën penale për të cilën është kanosur ta kryej; dhe
   - 2.6. përshkrimin e bazave të artikulueshme që bëjnë të besohet se masat më të buta për sigurimin e pranisë së të pandehurit janë të pamjaftueshme.
3. Nëse prokurori i shtetit në kërkesën për caktimin e paraburgimit nuk arrin të vërtetoj dyshimin e bazuar se personi i arrestuar ka kryer veprën e dyshuar penale, gjyqtari i procedurës paraprake e liron të pandehurin.

4. Nëse prokurori i shtetit në kërkesën për caktimin e paraburgimit nuk arrin të vërtetojë bazat e artikulueshme për të besuar cilindo nga tri elementet në paragrafin 2. nën-paragrafin 2.5. të këtij neni, gjyqtari i procedurës paraprake merr parasysh dhe urdhëron një masë më të butë nga neni 173 të këtij Kodi për të siguruar praninë e të pandehurit, e liron të pandehurin ose kërkon sqarime shtesë nga prokurori i shtetit.
5. Nëse prokurori i shtetit në kërkesën për caktimin e paraburgimit nuk arrin të vërtetoj bazat e artikulueshme që caktimi i masës më të butë për sigurimin e pranisë së të pandehurit është i pamjaftueshëm, gjyqtari i procedurës paraprake merr parasysh dhe urdhëron një masë më të butë nga neni 173 të këtij Kodi për të siguruar praninë e të pandehurit ose e liron të pandehurin.

Neni 166
Të drejtat e personit të arrestuar

1. Personi i arrestuar ka të drejtë në ndihmë të menjëhershme të mbrojtësit pas arrestimit sipas zgjedhjes së tij.
2. Kur personi i arrestuar nuk angazhon mbrojtës dhe askush nuk angazhon mbrojtës për të, atij i caktohet mbrojtësi me shpenzime publike.
3. Personi i arrestuar ka të drejtë të komunikojë në mënyrë konfidenciale me mbrojtësin e tij gojarisht dhe me shkrim. Komunikimi ndërmjet të arrestuarit dhe mbrojtësit të tij mund të vëzhgohet, por jo të dëgjohet nga zyrtari i policisë.
4. E drejta në ndihmën e mbrojtësit mund të hiqet në pajtim me nenin 53, paragrafët 3., 4. dhe 5. të këtij Kodi.
5. Kur personi i arrestuar dyshohet për terrorizëm ose krim të organizuar dhe ka arsye për të dyshuar se mbrojtësi i zgjedhur nga i arrestuari është i përfshirë në kryerjen e veprës penale ose se do të pengojë zbatimin e hetimeve, gjyqtari i procedurës paraprake me kërkesë të prokurorit të shtetit mund të urdhërojë caktimin e mbrojtësit tjetër që ta përfaqësojë të arrestuarin më së shumti shtatëdhjetë e dy (72) orë nga koha e arrestimit.

Neni 167
Njoftimi i personit të arrestuar për të drejtat e tij

1. Personi i arrestuar gëzon këto të drejta:
   1.1. të informohet në gjuhën që ai e kupton për arsyet e arrestimit;
   1.2. të heshtë dhe të mos përgjigjet në asnjë pyetje, përveç dhënies së informative mbi identitetin e tij;
   1.3. t'i sigurohet përkthim falas nëse nuk e kupton ose nuk e flet gjuhën e policit;
   1.4. të shfrytëzojë ndihmën e mbrojtësit dhe t'i caktohet mbrojtës nëse nuk ka mundësi të paguajë për ndihmë juridike;
   1.5. për arrestimin e tij të lajmërojë ose të kërkojë nga policia ta lajmërojë anëtarin e familjes ose ndonjë person tjetër sipas zgjedhjes së tij; dhe
   1.6. të ketë kontroll dhe trajtim mjekësor, duke përfshirë edhe trajtimin psikiatrik.
2. Kur personi i arrestuar është shtetas i huaj, ai ka të drejtë të njoftojë ose të kërkojë të njoftohet dhe të komunikojë gojarisht apo me shkrim me ambasadën, zyrën

ndërlidhëse apo me misionin diplomatik të shtetit, shtetas i të cilit është ai, ose me përfaqësuesin e organizatës kompetente ndërkombëtare kur ai është refugjat ose është nën mbrojtjen e ndonjë organizate ndërkombëtare.

Neni 168
Njoftimi për arrestimin

1. Personi i arrestuar ka të drejtë që menjëherë pas arrestimit të lajmërojë ose të kërkojë nga policia që të lajmërojnë anëtarin e familjes ose ndonjë person tjetër sipas zgjedhjes së tij për arrestimin dhe vendin e ndalimit dhe për çdo ndryshim të mëvonshëm të vendit të ndalimit menjëherë pas ndryshimit të tillë.
2. Kur personi i arrestuar nuk e ka mbushur moshën tetëmbëdhjetë (18) vjet, policia menjëherë pas arrestimit e lajmëron prindin ose përfaqësuesin ligjor të personit të arrestuar për arrestimin dhe vendin e ndalimi dhe për çdo ndryshim të mëvonshëm të vendit të ndalimit menjëherë pas ndryshimit të tillë. Kur lajmërimi i tillë është i pamundur ose do të ishte i dëmshëm për interesat e personit të arrestuar, apo shprehimisht refuzohet nga personi i arrestuar, policia e lajmëron qendrën për punë sociale.
3. Kur personi i arrestuar tregon shenja të çrregullimit mendor ose të paaftësisë mendore, policia menjëherë pas arrestimit njofton personin e caktuar nga personi i arrestuar dhe qendrën për punë sociale për arrestimin dhe vendin e ndalimit dhe për çdo ndryshim të mëvonshëm të vendit të ndalimit menjëherë pas ndryshimit të tillë.
4. Lajmërimi i anëtarëve të familjes dhe i personave të tjerë përkatës në pajtim me paragrafin 1. të këtij neni mund të vonohet më së shumti deri në njëzet e katër (24) orë kur prokurori i shtetit çmon se kjo kushtëzohet me nevoja të jashtëzakonshme për hetimin e rastit. Vonesë të tillë nuk ka kur personi i arrestuar është nën moshën tetëmbëdhjetë (18) vjet ose tregon shenja të çrregullimit apo të paaftësisë mendore.

Neni 169
E drejta e personit të arrestuar për kontrollim mjekësor

1. Personi i arrestuar ka të drejtë që sipas kërkesës së tij të kontrollohet nga mjeku ose dentisti sipas zgjedhjes së tij sa më shpejtë që të jetë e mundur pas arrestimit dhe në çdo kohë gjatë ndalimit. Kur mjeku ose dentisti i tillë nuk mund të sigurohet, atëherë policia cakton një mjek ose dentist.
2. Personi i arrestuar ka të drejtë në trajtim mjekësor, duke përfshirë edhe trajtimin psikiatrik kurdo që është e nevojshme me kërkesë të personit të arrestuar ose të anëtarëve të familjes.
3. Policia gjithashtu cakton një mjek për të kryer kontrollin mjekësor ose siguron trajtim mjekësor në çdo kohë në rast të lëndimit fizik ose nevojave të tjera mjekësore. Kur personi i arrestuar refuzon t'i nënshtrohet kontrollit mjekësor ose të pranojë trajtimin mjekësor, mjeku merr vendim përfundimtar lidhur me domosdoshmërinë e këtij kontrolli ose trajtimi duke pasur parasysh të drejtat e personit të arrestuar.
4. Kur personi i arrestuar tregon shenja të sëmundjes mendore, policia menjëherë mund të urdhërojë kontrollin nga një psikiatër.

5. Rezultati i kontrollit mjekësor ose çdo trajtim mjekësor i kryer në pajtim me këtë nen sipas rregullit regjistrohet dhe shënimet e tilla i vihen në dispozicion personit të arrestuar dhe mbrojtësit të tij.

Neni 170
Të drejtat e personit të arrestuar gjatë ndalimit

1. Personi i arrestuar veçohet nga personat e dënuar ose nga personat e paraburgosur.
2. Personat e ndaluar të gjinive të ndryshme nuk mbahen në të njëjtën dhomë.
3. Personit të ndaluar për më shumë se dymbëdhjetë (12) orë i sigurohen tri racione ushqimi në ditë.
4. Brenda njëzet e katër (24) orëve, personi i arrestuar ka të drejtë në së paku tetë (8) orë pushim pa ndërprerje dhe gjatë kësaj kohe nuk merret në pyetje e as nuk trazohet nga policia lidhur me hetimin.

Neni 171
Të drejtat e personit të arrestuar gjatë marrjes në pyetje nga policia

1. Gjatë çdo marrjeje në pyetje nga policia, personi i arrestuar ka të drejtë në praninë e mbrojtësit. Nëse mbrojtësi nuk paraqitet brenda dy (2) orëve pas informimit për arrestimin, policia i cakton mbrojtës tjetër. Më tutje, nëse mbrojtësi tjetër nuk paraqitet brenda një ore pas informimit nga policia, personi i arrestuar mund të merret në pyetje vetëm nëse prokurori i shtetit ose policia çmon se shtyrja e mëtejshme do të rrezikonte seriozisht zbatimin e hetimit.
2. Me rastin e marrjes në pyetje të personit të arrestuar përshtatshmërisht zbatohen nenet 152 deri 155 të këtij Kodi.
3. Gjatë marrjes në pyetje të personit të arrestuar bëhen pushime të shkurtra në intervale kohore përafërsisht dy (2) orëshe. Pushimi mund të shtyhet kur ka shkaqe të arsyeshme për të besuar se shtyrja do të:
   3.1. shkaktonte rrezik për lëndim të personave ose humbje apo dëmtim të rëndë të pasurisë;
   3.2. shtynte pa nevojë ndalimin e personit ose përfundimin e marrjes në pyetje; ose
   3.3. prejudikonte rezultatin e hetimeve.
4. Gjatë marrjes në pyetje nuk kërkohet nga personi i arrestuar të qëndrojë në këmbë dhe nuk i mohohet ushqimi, uji dhe kujdesi i nevojshëm mjekësor.

Neni 172
Procesverbali i arrestimit dhe veprimeve të policisë

1. Policia mban një procesverbal të vetëm për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me personin e arrestuar, duke përfshirë:
   1.1. të dhënat personale të të arrestuarit;
   1.2. arsyet e arrestimit;
   1.3. veprën penale për të cilën dyshohet;
   1.4. autorizimin ose njoftimin e prokurorit të shtetit;

1.5. vendin, datën dhe kohën e saktë të arrestimit;
1.6. rrethanat e arrestimit;
1.7. çfarëdo vendimi të prokurorit të shtetit lidhur me ndalimin;
1.8. vendin e ndalimit;
1.9. identitetet përkatëse të zyrtarëve të policisë dhe të prokurorit të shtetit;
1.10. njoftimin gojor dhe me shkrim të personit të arrestuar mbi të drejtat e tij të parapara në nenin 164, paragrafi 4. dhe nenin 167 të këtij Kodi;
1.11. informimin mbi ushtrimin e të drejtave të parapara në nën-paragrafin 1.10. të këtij paragrafi nga personi i arrestuar, veçanërisht e drejta në mbrojtës dhe e drejta për t'i lajmëruar anëtarët e familjes ose personat tjerë përkatës;
1.12. lëndimet e dukshme apo shenjat tjera që shtrojnë nevojën për ndihmë mjekësore;
1.13. ndërmarrjen e një ekzaminimi mjekësor ose sigurimin e trajtimit mjekësor; dhe
1.14. informacionin mbi kontrollin e përkohshëm të sigurisë së personit dhe përshkrimin e sendeve të marra nga personi në kohën e arrestimit ose gjatë ndalimit.
1.15. për daljen e personit të arrestuar nga objekti, përfshirë kohën dhe datën e saktë, nëse personi është liruar apo është dërguar para gjyqtarit, apo nëse është transferuar në qendrën e paraburgimit.

2. Policia mban procesverbal për çdo seancë të marrjes në pyetje të personit të arrestuar, duke përfshirë kohën e fillimit dhe të përfundimit të marrjes në pyetje, identitetin e zyrtarit të policisë i cili e ka marrë në pyetje dhe personat tjerë të pranishëm. Kur mbrojtësi nuk ka qenë i pranishëm, kjo shënohet në mënyrë të rregullt në procesverbal.
3. Procesverbalet nga paragrafi 1. i këtij neni nënshkruhen nga zyrtari përkatës i policisë dhe nga personi i arrestuar. Kur personi i arrestuar refuzon nënshkrimin e procesverbalit, organet policore shënojnë refuzimin e tillë dhe ia bashkëngjisin shpjegimin ose komentet eventuale me shkrim ose me gojë të personit të arrestuar.
4. Procesverbalet nga paragrafët 1. dhe 2. të këtij neni i vihen në dispozicion personit të arrestuar dhe mbrojtësit të tij me kërkesën e tyre, në gjuhë të kuptueshme për të arrestuarin.
5. Këto procesverbale ruhen në polici dhjetë (10) vjet nga koha e përfundimit zyrtar të procedurës penale ose nga lirimi i personit të ndaluar, nëse lirimi ka ndodhur më vonë se përfundimi i procedurës.

3. MASAT PËR SIGURIMIN E PRANISË SË TË PANDEHURIT

A. Kushtet e përgjithshme

Neni 173
Masat për sigurimin e pranisë së të pandehurit

1. Masat të cilat mund të përdoren për të siguruar praninë e të pandehurit, për pengimin e rikryerjes së veprës penale dhe për zbatimin e suksesshëm të procedurës penale janë:

1.1. thirrja;
1.2. urdhërarresti;
1.3. premtimi i të pandehurit se nuk do ta braktisë vendqëndrimin;
1.4. ndalimi për t'iu afruar vendit ose personit të caktuar;
1.5. paraqitja në stacionin policor;
1.6. dorëzania;
1.7. arresti shtëpiak
1.8. diversioni; dhe
1.9. paraburgimi.

2. Me rastin e vendosjes se cilën nga masat do ta zbatojë për të siguruar praninë e të pandehurit, gjykata detyrohet t'i merr parasysh kushtet e përcaktuara për masat konkrete dhe të sigurojë që të mos zbatojë masë më të rëndë kur mjafton masa më e butë.
3. Këto masa hiqen kur pushojnë shkaqet që i kanë shkaktuar, apo zëvendësohen me masa të tjera më të buta po qe se për këtë plotësohen kushtet.
4. Para ngritjes së aktakuzës vendimet lidhur me këto masa i merr gjyqtari i procedurës paraprake, kurse pas ngritjes së aktakuzës vendimet i merr kryetari i trupit gjykues, përveç nëse parashihet ndryshe me këtë Kod.
5. Shprehja "masë më e butë për të siguruar praninë e të pandehurit" apo "masa më të buta" për qëllim të këtij kodi nënkupton thirrjen, premtimin e të pandehurit se nuk do ta braktisë vendqëndrimin, ndalimi për t'iu afruar vendit ose personit të caktuar, paraqitjen në stacionin policor, dorëzaninë, arrestin shtëpiak dhe diversionin.

B. Thirrja

Neni 174
Thirrja

1. Prania e të pandehurit në procedurë penale sigurohet nëpërmjet thirrjes. Thirrjen të pandehurit ia dërgon gjykata në pajtim me Kapitullin XXVII.
2. Të pandehurit thirrja i dërgohet në letër të mbyllur e cila përfshin: emrin dhe adresën e gjykatës e cila e dërgon thirrjen; emrin dhe mbiemrin e të pandehurit; përcaktimin e veprës penale për të cilën akuzohet; vendin, ditën dhe orën kur duhet të paraqitet i pandehuri, njoftimin se thirret në cilësi të të pandehurit; paralajmërimin se në rast të mosparaqitjes do të lëshohet urdhërarrest dhe do të sillet në gjykatë forcërisht; vulën zyrtare dhe emrin e gjyqtarit i cili lëshon thirrjen.
3. Kur i pandehuri thirret për herë të parë, në thirrje udhëzohet për të drejtën e tij për të angazhuar mbrojtës dhe se mbrojtësi mund të jetë i pranishëm gjatë marrjes së tij në pyetje.
4. I pandehuri duhet menjëherë ta njoftojë gjykatën për çdo ndryshim të adresës së tij ose për qëllimin e ndryshimit të vendqëndrimit. I pandehuri njoftohet për këtë detyrim në rastin e marrjes në pyetje për herë të parë ose me rastin e dorëzimit të aktakuzës dhe njëkohësisht paralajmërohet për pasojat e mospërmbushjes së detyrimit siç është paraparë me këtë Kod.
5. Kur i pandehuri nuk është në gjendje t'i përgjigjet thirrjes për shkak të sëmundjes ose pengesës tjetër të paevitueshme, ai pyetet në vendin ku gjendet ose dërgohet në

ndërtesën e gjykatës apo në vendin tjetër ku është duke u zbatuar procedura ose shtyhet marrja e tij në pyetje.

C. Urdhërarresti

Neni 175
Urdhërarresti

1. Gjyqtari i procedurës paraprake, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues sipas detyrës zyrtare mund të lëshojë urdhërarrest me kërkesë të prokurorit të shtetit, ose në rrethana të ngutshme me kërkesë të policisë kur ekzistojnë kushtet nga paragrafi 1. i nenit 187 të këtij Kodi, ose kur i pandehuri i cili pasi është thirrur me rregull nuk paraqitet dhe nuk e arsyeton mungesën e tij ose kur thirrja nuk ka mundur t'i dërgohet sipas rregullit dhe kur sipas rrethanave është e qartë se i pandehuri i shmanget pranimit të thirrjes.
2. Urdhërarresti lëshohet me shkrim dhe përfshin: emrin dhe mbiemrin e të pandehurit dhe të dhëna të tjera personale të njohura për gjyqtarin, përcaktimin e veprës penale me të cilën ngarkohet duke iu referuar dispozitës përkatëse të Kodit Penal, bazën mbi të cilën lëshohet urdhri dhe vulën zyrtare dhe nënshkrimin e gjyqtarit që lëshon urdhërarrestin. Nëse nuk përcaktohet ndryshe në urdhërarrest, urdhërarresti skadon në mesnatën e ditës së treqind e gjashtëdhjetë e pestë (365) të nga dita e lëshimit.
3. Urdhërarrestin e ekzekuton policia.
4. Zyrtari i policisë i ngarkuar për ekzekutimin e urdhrit ia dorëzon urdhrin të pandehurit dhe kërkon që i pandehuri ta shoqërojë. Kur i pandehuri këtë e refuzon, atëherë dërgohet forcërisht.
5. Urdhri për paraqitje të detyrueshme të zyrtarëve të policisë ose të rojtarëve të institucionit ku personat mbahen në ndalim ekzekutohet nëpërmjet ndërmjetësimit të komandës ose eprorit të tyre.
6. Në kohën e arrestimit, personi informohet në gjuhën që e kupton për arsyet e arrestimit dhe për të drejtat nga neni 167 i këtij Kodi.
7. Menjëherë pas arrestimit, personi i arrestuar dërgohet para gjyqtarit i cili e ka lëshuar urdhrin.

D. Premtimi i të pandehurit se nuk do ta braktisë vendqëndrimin

Neni 176
Premtimi i të pandehurit se nuk do ta braktisë vendqëndrimin

1. Gjykata gjatë procedurës mund të kërkojë nga i pandehuri premtimin se nuk do të fshihet ose largohet nga vendqëndrimi pa lejen e gjykatës kur ekziston dyshim i bazuar se ai ka kryer vepër penale dhe ka arsye për dyshim se i pandehuri mund të fshihet, të shkojë në vend të panjohur ose të largohet nga Kosova. Premtimi i dhënë shënohet në procesverbal.
2. Dokumenti i udhëtimit të të pandehurit, i cili detyrohet me premtimin e dhënë nga paragrafi 1 i këtij neni, mund të konfiskohet përkohësisht. Ankesa kundër aktvendimit për konfiskimin e dokumentit të udhëtimit nuk e pezullon ekzekutimin e aktvendimit.

3. Me rastin e dhënies së premtimit, i pandehuri paralajmërohet se ndaj tij mund të caktohet paraburgim po qe se e shkel këtë premtim.

E. Ndalimi për t'iu afruar vendit apo personit të caktuar

Neni 177
Ndalimi për t'iu afruar vendit apo personit të caktuar

1. Gjykata mund t'ia ndalojë të pandehurit për t'iu afruar vendit ose personit të caktuar kur:
   1.1. ekziston dyshim i bazuar se i pandehuri ka kryer vepër penale;
   1.2. ekzistojnë rrethanat nga neni 187, paragrafi 1. nën-paragrafi 1.2.2. ose 1.2.3. të këtij Kodi; dhe
   1.3. ndalimi i tillë mund të zvogëlojë rrezikun që i pandehuri t'i asgjësojë provat e veprës penale, të ndikojë në dëshmitarë, në bashkëkryerës ose në bashkëpjesëmarrës pas kryerjes së veprës, në përsëritjen e veprës penale, në përfundimin e veprës penale të tentuar ose në kryerjen e veprës penale për të cilën është kanosur.
2. Gjykata vendos për një masë sipas këtij neni me aktvendim të arsyetuar. Aktvendimi duhet të përmbajë arsyetimin që përcakton se janë plotësuar kushtet nga paragrafi 1. i këtij neni dhe nevojën për masën e tillë.
3. Gjykata me aktvendim përcakton largësinë përkatëse nga vendi i caktuar ose nga personi të cilën i pandehuri duhet ta respektojë dhe nuk duhet ta kalojë me qëllim.
4. Aktvendimi i dërgohet të pandehurit dhe ku është e zbatueshme një kopje i dërgohet personit të mbrojtur nën masën e tillë.
5. Gjykata urdhëron paraburgim nëse i pandehuri shkel aktvendimin. I pandehuri gjithmonë njoftohet me kohë për pasojat e mosbindjes.
6. Nëse personi i mbrojtur me këtë masë qëllimisht cenon distancën të cilën i pandehuri detyrohet ta respektojë, gjykata mund ta dënojë personin e mbrojtur me gjobë siç parashihet në nenin 444 të këtij Kodi.
7. Përveç kur ky nen parasheh ndryshe, dispozitat e këtij Kodi lidhur me paraburgimin përshtatshmërisht zbatohen për caktimin, kohëzgjatjen, vazhdimin dhe pushimin e masës nga ky nen.
8. Për zgjatjen e masës nga ky nen para ngritjes së aktakuzës vendos gjyqtari i procedurës paraprake sipas detyrës zyrtare ose me kërkesë të prokurorit të shtetit.

F. Paraqitja në stacionin policor

Neni 178
Paraqitja në stacionin policor

1. Gjykata mund të urdhërojë që i pandehuri të paraqitet herë pas here në kohë të caktuar në stacionin policor, në rajonin ku i pandehuri e ka vendbanimin apo vendqëndrimin ose në vendin ku i pandehuri është ndodhur në momentin e urdhrit, nëse:
   1.1. ekziston dyshim i bazuar se i pandehuri ka kryer vepër penale; dhe

1.2. ka arsye për të dyshuar se i pandehuri do të fshihet, do të shkojë në vend të panjohur ose do të largohet nga Kosova.

2. Gjykata vendos për një masë sipas këtij neni me aktvendim të arsyetuar. Aktvendimi duhet të përmbajë arsyetimin që përcakton se janë plotësuar kushtet nga paragrafi 1. i këtij neni dhe nevojën për masën e tillë.
3. Aktvendimi i dorëzohet të pandehurit dhe kopja i dorëzohet stacionit policor përkatës në territorin e së cilës masa duhet të zbatohet.
4. Gjykata mund të urdhërojë paraburgim nëse i pandehuri shkel aktvendimin. I pandehuri gjithmonë njoftohet me kohë për pasojat e mosbindjes.
5. Përveç kur ky nen parasheh ndryshe, dispozitat e këtij Kodi lidhur me paraburgimin përshtatshmërisht zbatohen për caktimin, kohëzgjatjen, vazhdimin dhe pushimin e masës nga ky nen.
6. Për zgjatjen e masës nga ky nen para ngritjes së aktakuzës vendos gjyqtari i procedurës paraprake sipas detyrës zyrtare ose me kërkesë të prokurorit të shtetit.
7. Dokumenti i udhëtimit i personit i cili i nënshtrohet aktvendimit sipas këtij neni mund të konfiskohet përkohësisht. Ankesa kundër aktvendimit për konfiskimin e përkohshëm të dokumentit të udhëtimit nuk e pezullon ekzekutimin.

G. Dorëzania

Neni 179
Dorëzania

1. Gjykata mund të urdhërojë që i pandehuri të mbrohet në liri me dorëzani ose të lirohet nga paraburgimi me dorëzani kur:
   1.1. ekziston dyshim i bazuar se i pandehuri ka kryer vepër penale;
   1.2. baza e vetme për paraburgim është frika se i pandehuri mund të ikë; dhe
   1.3. i pandehuri premton se nuk do të fshihet ose pa leje nuk do të braktisë vendqëndrimin e tij.
2. Gjykata me aktvendim gjithashtu mund të urdhërojë që i pandehuri të mbrohet në liri me dorëzani ose të lirohet nga paraburgimi me dorëzani kur:
   2.1. ekziston dyshim i bazuar se i pandehuri ka kryer vepër penale;
   2.2. i pandehuri nuk dyshohet për vepër penale të dënueshme me të paktën pesë (5) vjet burgim sipas kapitujve XIV, XV, XVI, XVII, XX, XXI, XXIX, XXX dhe XXXIII të Kodit Penal;
   2.3. baza e vetme për paraburgim është rreziku se i pandehuri mund të përsërisë veprën penale, të përfundojë veprën e tentuar penale ose të kryejë veprën penale të cilën është kanosur ta kryejë; dhe
   2.4. i pandehuri ka premtuar se nuk do ta përsërisë veprën penale, nuk do ta përfundojë veprën e tentuar penale ose nuk do ta kryejë veprën penale të cilën është kanosur ta kryejë.
3. Dorëzania e urdhëruar nga gjykata jepet nga i pandehuri ose personi tjetër në emër të tij.

Neni 180
Aktvendimi mbi dorëzaninë

1. Gjykata me aktvendim të arsyetuar vendos mbi masën nga neni 179 i këtij Kodi. Aktvendimi duhet të përmbajë arsyetimin që përcakton se janë plotësuar kushtet nga neni 179 i këtij Kodi dhe nevojën për masën e tillë.
2. Para ngritjes së aktakuzës, aktvendimi mbi dorëzaninë merret nga gjyqtari i procedurës paraprake ndërsa pas ngritjes së aktakuzës nga gjyqtari i vetëm gjykues apo kryetari i trupit gjykues.
3. Aktvendimi me të cilin dorëzania pranohet dhe aktvendimi me të cilin ajo anulohet merren pas dëgjimit të mendimit të prokurorit të shtetit, nëse vepra penale ndiqet sipas detyrës zyrtare, dhe mendimit të të pandehurit ose mbrojtësit.
4. Aktvendimi i dorëzohet të pandehurit.
5. Personit që i nënshtrohet aktvendimit me dorëzani i konfiskohet përkohësisht dokumenti i udhëtimit, përveç nëse ka arsye bindëse për gjykatën që të mos konfiskojë dokumentin e udhëtimit. Ankesa ndaj aktvendimit për konfiskimin e përkohshëm të dokumentit të udhëtimit të personit nuk e pezullon ekzekutimin.

Neni 181
Përmbajtja e dorëzanisë

1. Dorëzania gjithmonë përkufizohet si shumë e parave e përcaktuar sipas peshës së veprës penale, rrethanave personale dhe familjare të të pandehurit dhe gjendjes materiale të personit që e jep dorëzaninë.
2. Dorëzania mund të jepet me para të gatshme, me letra me vlerë, sende të vlefshme dhe me pasuri të tjera të luajtshme me vlerë të konsiderueshme të cilat lehtë mund të shndërrohen në para dhe të ruhen, me vënien e hipotekës për shumën e dorëzanisë mbi vlerat e paluajtshme të personit që jep dorëzani ose me detyrim personal të një apo më shumë personave që në rast të ikjes së të pandehurit zotohen të paguajnë shumën e caktuar të dorëzanisë.
3. Nëse i pandehuri ik, me aktvendim të gjykatës caktohet që vlera e dhënë si dorëzani të derdhet në fondin për kompenzimin e viktimave.

Neni 182
Heqja e dorëzanisë

1. Kur urdhërohet dorëzani nga neni 179, paragrafi 1. i këtij Kodi, i pandehuri paraburgoset dhe dorëzania hiqet, nëse pas thirrjes me rregull ai nuk paraqitet dhe mungesën nuk e arsyeton, nëse përgatitet të ikë ose kur gjatë kohës sa është në liri paraqiten arsye të tjera ligjore për paraburgimin e tij.
2. Kur urdhërohet dorëzani nga neni 179, paragrafi 2. i këtij Kodi, i pandehuri paraburgoset dhe shuma e dhënë si dorëzani me aktvendim derdhet në buxhet, kur ai ka përsëritur veprën penale, ka përfunduar veprën e tentuar penale ose ka kryer veprën penale për të cilën ai është kanosur se do ta kryejë.
3. I pandehuri gjithmonë njoftohet me kohë për pasojat e mosbindjes.
4. Dorëzania hiqet kur procedura penale pushohet me aktvendim të formës së prerë

ose me aktgjykim të formës së prerë. Kur i pandehuri dënohet me burgim, dorëzania hiqet vetëm pasi ai të ketë filluar mbajtjen e dënimit.

5. Me heqjen e dorëzanisë, paratë e gatshme të depozituara, letrat me vlerë, sendet me vlerë dhe pasuri të tjera të luajtshme me vlerë të konsiderueshme kthehen dhe hipoteka hiqet.

H. Arresti shtëpiak

Neni 183
Arresti shtëpiak

1. Gjykata mund të caktojë arrestin shtëpiak për të pandehurin nëse:
   1.1. ekziston dyshim i bazuar se i pandehuri ka kryer vepër penale; dhe
   1.2. plotësohen kushtet nga neni 187, paragrafi .1, nën-paragrafi 1.2. i këtij Kodi.
2. Gjykata me aktvendim të arsyetuar vendos mbi masën nga ky nen. Aktvendimi duhet të përmbajë arsyetimin që përcakton se janë plotësuar kushtet nga paragrafi 1. i këtij neni dhe nevojën për masën e tillë.
3. Gjykata me aktvendim vendos se i pandehuri nuk guxon të largohet nga lokalet ku ai e ka vendbanimin ose vendqëndrimin apo nga institucioni publik për trajtim ose përkujdesje. Gjykata mund ta kufizojë ose ndalojë kontaktin ndërmjet të pandehurit dhe personave me të të cilët ai nuk jeton apo të cilët nuk janë të varur nga i pandehuri. Përjashtimisht, gjykata mund të lejojë të pandehurit që për kohë të caktuar të largohet nga lokalet ku mbahet arresti shtëpiak kur kjo është domosdo e nevojshme për përmbushjen e nevojave jetësore ose për kryerjen e ndonjë pune.
4. Aktvendimi i dorëzohet të pandehurit dhe një kopje i dorëzohet stacionit policor përkatës në territorin në të cilin duhet të zbatohet masa.
5. Gjykata mund të caktojë paraburgim nëse i pandehuri pa leje shkel aktvendimin. I pandehuri për këto pasoja gjithmonë duhet njoftuar me kohë.
6. Gjykata e mbikëqyrë zbatimin e masës së arrestit shtëpiak drejtpërdrejt ose nëpërmjet policisë. Policia ka të drejtë që në çdo kohë të verifikojë zbatimin e masës së arrestit shtëpiak dhe rastësisht verifikon praninë e të pandehurit në vendin e mbajtjes së arrestit shtëpiak. Policia e njofton gjykatën pa vonesë për çdo cenim të mundshëm të masës.
7. Përveç nëse ky nen parasheh ndryshe, dispozitat e këtij Kodi mbi paraburgimin përshtatshmërisht zbatohen lidhur me caktimin, kohëzgjatjen, vazhdimin dhe pushimin e masës nga ky nen. Dispozitat e Kodit Penal mbi përfshirjen e ndalimit në dënimin e shqiptuar gjithashtu zbatohen përshtatshmërisht për masën nga ky nen.
8. Pas ngritjes së aktakuzës, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues vendos në të gjitha rastet mbi vazhdimin e arrestit shtëpiak në bazë të propozimit të arsyetuar të prokurorit të shtetit. I pandehuri dhe mbrojtësi i tij, kur i pandehuri ka mbrojtës, duhet njoftuar për propozimin brenda tre ditëve nga kalimi i afatit të aktvendimit aktual mbi arrestin shtëpiak.
9. Personit në arrest shtëpiak përkohësisht mund t'i konfiskohet dokumenti i udhëtimit. Ankesa kundër aktvendimit mbi konfiskimin e përkohshëm të dokumentit të udhëtimit nuk e pezullon ekzekutimin.

I. Diversioni

Neni 184
Diversioni

1. I pandehuri i arrestuar për vepër penale për të cilën dënimi maksimal i paraparë është jo më shumë se një (1) vjet dhe i cili nuk ka dënime të mëparshme ose nuk ka marrë pjesë në diversion, mund t'i caktohet diversioni sipas urdhrit të gjyqtarit të procedurës paraprake. I pandehuri ose prokurori i shtetit gjithashtu mund të propozojnë diversionin. Nëse prokurori i shtetit pajtohet ose i propozon gjykatës masën e diversionit, gjyqtari i procedurës paraprake mund të pezullojë procedurën penale për një (1) vit dhe liron të pandehurin nën kushtet e mëposhtme:
   1.1. i pandehuri duhet të bëjë kompenzimin e arsyeshëm ndaj viktimës së veprës penale, nëse ka ndonjë, siç përcakton gjyqtari i procedurës paraprake;
   1.2. i pandehuri lajmërohet rregullisht në stacionin policor që është më së afërmi prej vendbanimit të tij, në intervalet e caktuara nga gjyqtari i procedurës paraprake;
   1.3. i pandehuri merr pjesë dhe përfundon këshillimin, trajtimin psikologjik, trajtimin nga abuzimi me substanca narkotike, arsimimin, ose veprimet tjera të cilat konsiderohen të përshtatshme nga gjyqtari i procedurës paraprake.
2. Kur i pandehuri vepron në pajtim me kushtet e përcaktuara nga gjyqtari i procedurës paraprake, procedura penale kundër të pandehurit pushohet nga gjyqtari i procedurës paraprake gjatë muajit të dymbëdhjetë të diversitetit.
3. Nëse i pandehuri shkel kushtet e përcaktuara nga gjyqtari i procedurës paraprake, procedura penale rifillohet. Gjyqtari i procedurës paraprake, nëse është e nevojshme, mund të lëshojë urdhërarrest sipas nenit 175 të këtij Kodi.

J. Paraburgimi

Neni 185
Paraburgimi

1. Paraburgimi mund të caktohet vetëm nën kushtet dhe në pajtim me procedurat e parapara me këtë Kod.
2. Paraburgimi duhet të reduktohet në kohën sa më të shkurtër të mundshme. Kur i pandehuri mbahet në paraburgim, të gjitha organet që marrin pjesë në procedurën penale dhe organet që ofrojnë ndihmën juridike detyrohen të veprojnë me nguti të posaçme.
3. Paraburgimi hiqet dhe i paraburgosuri lirohet në çdo fazë të procedurës posa të pushojnë shkaqet e caktimit të tij.
4. Neni 166, paragrafët 2. dhe 3., neni 167 paragrafi 2., neni 168, neni 169, neni 170, paragrafi 3. dhe neni 171, paragrafët 3. dhe 4. të këtij Kodi gjithashtu zbatohen gjatë kohës së paraburgimit.
5. Me rastin e arrestimit, personi që i nënshtrohet paraburgimit informohet:
   5.1. gojarisht dhe me shkrim për të drejtat nga neni 167 i këtij Kodi; dhe
   5.2. me shkrim për të drejtat tjera që i gëzon sipas këtij Kodi.

Neni 186
Njoftimi i organit kompetent për mirëqenie sociale për arrestin, kur kjo është e nevojshme

Kur është e nevojshme të ndërmerren masa për mbrojtjen e fëmijëve dhe të anëtarëve të tjerë të familjes së personit të arrestuar të cilët janë nën kujdesin e tij, për arrestim njoftohet organi kompetent për mirëqenie sociale.

Neni 187
Kushtet e nevojshme për caktimin e paraburgimit

1. Gjykata mund të caktojë paraburgim ndaj një personi vetëm nëse në mënyrë të qartë ka gjetur se:
   1.1. ekziston dyshim i bazuar se personi i tillë ka kryer vepër penale;
   1.2. përmbushet njëri nga kushtet e mëposhtme:
      1.2.1. kur ai fshihet, kur identiteti i tij nuk mund të vërtetohet ose kur ekzistojnë rrethana të tjera që tregojnë se ekziston rrezik i ikjes së tij;
      1.2.2. kur ka arsye për të besuar se ai do të asgjësojë, fshehë, ndryshojë ose falsifikojë provat e veprës penale, ose kur rrethanat e posaçme tregojnë se ai do të pengojë rrjedhën e procedurës penale duke ndikuar në dëshmitarë, në të dëmtuarit apo në bashkëpjesëmarrësit; ose
      1.2.3. kur pesha e veprës penale, mënyra ose rrethanat në të cilat është kryer vepra penale, karakteristikat e tij personale, sjellja e mëparshme, ambienti dhe kushtet nën të cilat ai jeton ose ndonjë rrethanë tjetër personale tregojnë rrezikun se ai mund ta përsërisë veprën penale, ta përfundojë veprën e tentuar penale ose ta kryejë veprën penale për të cilën është kanosur ta kryej.
   1.3. masat më të buta për sigurimin e pranisë së të pandehurit të parapara në nenin 173 të këtij Kodi do të ishin të pamjaftueshme për të siguruar praninë e personit të tillë, të parandalojë përsëritjen e veprës penale dhe të sigurojë zbatimin e suksesshëm të procedurës penale.
2. Në rastin nga paragrafi 1. nën-paragrafi 1.2. i këtij neni, paraburgimi i caktuar vetëm për shkak të mosvërtetimit të identitetit të personit hiqet posa të vërtetohet identiteti i tij. Në rastin nga paragrafi 1., nën-paragrafi 1.2. i këtij neni, paraburgimi hiqet posa të merren ose sigurohen provat për të cilat është caktuar paraburgimi.
3. Nëse i pandehuri ka shkelur njërën prej masave më të buta për sigurimin e pranisë së të pandehurit të parapara në nenin 173 të këtij Kodi, gjykata në mënyrë të posaçme këtë e merr parasysh gjatë vërtetimit të ekzistimit të rrethanave nga paragrafi 1., nën-paragrafët 1.2 dhe 1.3. të këtij neni.

Neni 188
Procedura për urdhrin për paraburgim

1. Paraburgimin e cakton gjyqtari i procedurës paraprake i gjykatës kompetente në bazë të kërkesës me shkrim të prokurorit të shtetit pas seancës dëgjimore.
2. Pasi që personi i arrestuar të jetë sjellë te gjyqtari i procedurës paraprake, ai

menjëherë e informon personin e tillë për të drejtat e tij nga neni 167 i këtij Kodi. Në procesverbal shënohet koha e saktë e arrestimit dhe koha kur është sjellur personi te gjyqtari i procedurës paraprake.
3. Pastaj, gjyqtari i procedurës paraprake zbaton seancën dëgjimore mbi paraburgimin. Prokurori i shtetit dhe mbrojtësi janë të pranishëm gjatë seancës dëgjimore.
4. Kur personi i arrestuar nuk angazhon mbrojtës brenda njëzet e katër (24) orëve nga koha e njoftimit për këtë të drejtë ose deklaron se nuk do të angazhojë mbrojtës, gjykata ia cakton mbrojtësin sipas detyrës zyrtare.
5. Në seancën dëgjimore për paraburgim, prokurori i shtetit paraqet arsyet për kërkim të paraburgimit. I pandehuri dhe mbrojtësi i tij mund të përgjigjen duke prezantuar argumentet e tyre.
6. Gjyqtari i procedurës paraprake vendos mbi propozimin e palëve pasi palët të jenë deklaruar për të gjitha çështjet të cilat mund të jenë të rëndësishme për zbatimin e masave nga ky kapitull.

Neni 189
Përmbajtja e aktvendimit për caktimin e paraburgimit dhe ankesa kundër tij

1. Paraburgimi caktohet me aktvendimin me shkrim i cili përfshin: emrin dhe mbiemrin e personit i cili paraburgoset dhe të dhënat e tij personale të njohura për gjyqtarin e procedurës paraprake; kohën e saktë të arrestimit; kohën e sjelljes te gjyqtari i procedurës paraprake; kohën e marrjes në pyetje për paraburgim; veprën penale për të cilën akuzohet; bazën ligjore për paraburgim; njoftimin për të drejtën në ankesë; dhe arsyetimin e të gjitha fakteve vendimtare që e kanë shkaktuar paraburgimin, duke përfshirë edhe arsyet për dyshim të bazuar se personi ka kryer vepër penale dhe faktet vendimtare nga neni 187, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.2. i këtij Kodi.
2. Aktvendimi mbi paraburgimin i dorëzohet personit përkatës, mbrojtësit të tij dhe prokurorit të shtetit. Koha e dorëzimit të aktvendimit personit përkatës shënohet në shkresat e lëndës.
3. Secila palë mund të paraqesë ankesë brenda njëzet e katër (24) orëve nga koha e dorëzimit të aktvendimit. Ankesa nuk e pezullon ekzekutimin e aktvendimit. Nëse ankohet vetëm njëra palë, gjykata ia dërgon ankesën palës tjetër e cila argumentet e veta mund t'ia paraqesë gjykatës brenda njëzet e katër (24) orëve nga dorëzimi i ankesës. Për ankesë vendoset brenda dyzet e tetë (48) orëve nga paraqitja e saj.
4. Kur gjyqtari i procedurës paraprake e refuzon kërkesën e prokurorit të shtetit për caktimin e paraburgimit, gjyqtari i procedurës paraprake mund të urdhërojë cilëndo masë tjetër nga ky kapitull.

Neni 190
Afatet kohore të paraburgimit

1. I paraburgosuri mund të mbahet në paraburgim më së shumti një (1) muaj nga dita e arrestimit në bazë të urdhrit nga neni 188 të këtij Kodi. Pas kësaj kohe, ai mund të mbahet në paraburgim vetëm me aktvendim të gjyqtarit të procedurës paraprake, gjyqtarit të vetëm gjykues ose kryetarit të trupit gjykues me të cilin urdhërohet vazhdimi i paraburgimit.

2. Para ngritjes së aktakuzës, paraburgimi nuk mund të zgjasë më shumë se:
   2.1. katër (4) muaj kur procedura zbatohet për vepër penale të dënueshme me më pak se pesë (5) vjet burgim;
   2.2. tetë (8) muaj kur procedura zbatohet për vepër penale të dënueshme me më shumë se pesë (5) vjet burgim.
3. Në raste të jashtëzakonshme kur procedura zbatohet për vepër penale të dënueshme me së paku pesë (5) vjet burgim dhe kur rasti është i ndërlikuar siç përkufizohet në nenin 19 të këtij Kodi, e zvarritja e procedurës nuk mund t'i atribuohet prokurorit të shtetit, përveç afateve të parapara në paragrafin 2. të këtij neni para ngritjes së aktakuzës paraburgimi mund të vazhdohet më së shumti deri në katër (4) muaj për një maksimum të përgjithshëm të paraburgimit prej dymbëdhjetë (12) muaj.
4. Kur ka shkak të bazuar dhe bindës për të besuar se ekziston rrezik i përgjithshëm apo rrezik i dhunës nëse lirohet i pandehuri në procedurë paraprake, vazhdimi i paraburgimit nga paragrafi 3. të këtij neni mund të vazhdohet edhe për gjashtë (6) muaj tjerë për një maksimum të përgjithshëm të paraburgimit prej tetëmbëdhjetë (18) muaj.
5. Nëse aktakuza nuk ngritet para kalimit të afateve të parapara në paragrafët 2., 3. dhe 4. të këtij neni, i paraburgosuri lirohet.

Neni 191
Vazhdimi i paraburgimit

1. Paraburgimi mund të vazhdohet vetëm nga gjyqtari i procedurës paraprake, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues në bazë të kërkesës së prokurorit të shtetit, i cili tregon se ka bazë për paraburgim nga neni 187 i këtij Kodi, se ka filluar hetimi dhe se janë ndërmarrë të gjitha veprimet e arsyeshme për të përshpejtuar zbatimin e hetimit. I dëmtuari apo mbrojtësi i viktimave mund të kërkojë formalisht apo joformalisht nga prokurori i shtetit që të kërkojë vazhdimin e paraburgimit.
2. I pandehuri dhe mbrojtësi i tij informohen me propozimin jo më vonë se tri (3) ditë para skadimit të paraburgimit të caktuar me aktvendimin e fundit.
3. Ndaj çdo aktvendimi mbi vazhdimin e paraburgimit mund të ushtrohet ankesë. Neni 189, paragrafët 3. dhe 4., zbatohen përshtatshmërisht.

Neni 192
Mbikëqyrja e paraburgimit nga gjykata

1. Në çdo kohë, derisa hetimi është duke u zbatuar, gjyqtari i procedurës paraprake mund të ndërprejë paraburgimin sipas detyrës zyrtare, pasi të ketë paralajmëruar prokurorin e shtetit tre ditë më parë. Prokurori i shtetit mund të paraqesë ankesë te kolegji shqyrtues kundër aktvendimit të gjyqtarit të procedurës paraprake për të ndërprerë paraburgimin. Kolegji shqyrtues nxjerr aktvendim brenda dyzet e tetë (48) orësh nga pranimi i ankesës së prokurorit të shtetit.
2. I paraburgosuri ose mbrojtësi i tij në çdo kohë mund t'i ankohen gjyqtarit të procedurës paraprake, gjyqtarit të vetëm gjykues, kryetarit të trupit gjykues ose kryetarit të gjykatës themelore që të vendosë mbi ligjshmërinë e paraburgimit ose mbi ligjshmërinë e kushteve të paraburgimit.

3. Nëse i pandehuri ankohet për ligjshmërinë e paraburgimit, gjyqtari i procedurës paraprake, gjyqtari i vetëm gjykues, kryetari i trupit gjykues ose kryetari i gjykatës themelore mund të zbatojë seancë dëgjimore në pajtim me neni 188, paragrafët 3., 4., 5. dhe 6. të këtij Kodi nëse në shikim të parë me ankesë vërtetohet se:
   3.1. arsyet për paraburgim nga neni 187 i këtij Kodi që nga vendimi i fundit gjyqësor për paraburgim pushojnë së ekzistuari për shkak të ndryshimit të rrethanave ose zbulimit të fakteve të reja; ose
   3.2. ndalimi për ndonjë arsye tjetër është i kundërligjshëm.
4. Nëse i pandehuri ankohet për ligjshmërinë e paraburgimit, gjyqtari i procedurës paraprake, gjyqtari i vetëm gjykues, kryetari i trupit gjykues ose kryetari i gjykatës themelore në seancë dëgjimore urdhëron lirimin e menjëhershëm të të paraburgosurit kur:
   4.1. pushojnë së ekzistuari arsyet e paraburgimit nga neni 187 i këtij Kodi;
   4.2. ka kaluar afati i paraburgimit i urdhëruar nga gjykata;
   4.3. afati i paraburgimit i caktuar nga gjykata kalon afatin e paraparë në nenin 190 të këtij Kodi; ose
   4.4. ndalimi për ndonjë arsye tjetër është i kundërligjshëm.
5. Nëse i pandehuri ankohet për ligjshmërinë e kushteve të paraburgimit, gjyqtari i procedurës paraprake, gjyqtari i vetëm gjykues, kryetari i trupit gjykues ose kryetari i gjykatës themelore mund të zbatojë një seancë dëgjimore ose vizitë në institucionin ku mbahet paraburgimi nëse ankesa në shikim të parë vërteton se kushtet e paraburgimit nuk plotësojnë kushtet e përcaktuara me këtë Kod ose nëse ekzistojnë kushte të cilat nuk janë në pajtim me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Liritë Themelore, siç interpretohet nga vendimet e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.
6. Nëse i pandehuri ankohet për ligjshmërinë e kushteve të paraburgimit, gjyqtari i procedurës paraprake, gjyqtari i vetëm gjykues, kryetari i trupit gjykues ose kryetari i gjykatës themelore në seancën dëgjimore apo gjatë vizitës në institucionin ku mbahet paraburgimi urdhëron ndryshimin e kushteve të paraburgimit nëse kushtet nuk janë në pajtim me interpretimin e arsyeshëm të kushteve të përcaktuara me këtë Kod ose nëse ekzistojnë kushte të cilat nuk janë në pajtim me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Liritë Themelore, siç interpretohet nga vendimet e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.
7. Seancat dëgjimore ose vizitat nga ky nen mbahen brenda shtatë (7) ditëve nga pranimi i ankesës.
8. Ankesa e cila është substancialisht e ngjashme me ankesën e mëparshme menjëherë hudhet sipas detyrës zyrtare.

Neni 193
Caktimi i paraburgimit pas ngritjes së aktakuzës

1. Pas ngritjes së aktakuzës dhe deri në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, paraburgimi mund të caktohet, vazhdohet ose të hiqet vetëm me aktvendim të gjyqtarit të vetëm gjykues, kryetarit të trupit gjykues ose trupit gjykues në seancë. Gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues së pari dëgjon mendimin e prokurorit të shtetit kur procedura është filluar me kërkesën e tij dhe mendimin e të pandehurit ose

mbrojtësit. Kundër aktvendimit palët kanë të drejtë ankese. Neni 189, paragrafët 3. dhe 4. të këtij Kodi zbatohen përshtatshmërisht.

2. Pasi të kalojnë dy (2) muaj nga aktvendimi i fundit për paraburgim, gjyqtari i vetëm gjykues apo kryetari i trupit gjykues edhe pa propozimin e palëve shqyrton nëse ende ekzistojnë arsyet për paraburgim dhe merr aktvendim për vazhdimin ose heqjen e paraburgimit. Kundër aktvendimit palët kanë të drejtë ankese. Neni 189, paragrafët 3. dhe 4. të këtij Kodi zbatohen përshtatshmërisht.

4. ZBATIMI I PARABURGIMIT

Neni 194
Trajtimi dhe kushtet për personat e paraburgosur

1. Personaliteti dhe dinjiteti i të paraburgosurit nuk guxon të fyhet gjatë mbajtjes në paraburgim. I paraburgosuri duhet të trajtohet në mënyrë humane dhe duhet mbrojtur shëndetin e tij fizik dhe psikik.
2. Ndaj të paraburgosurit mund zbatohen vetëm ato kufizime që janë të nevojshme për të penguar ikjen ose komunikimet që do të mund të ishin të dëmshme për zbatimin efektiv të procedurës.

Neni 195
Institucioni i paraburgimit

1. Pranimi në institucionin ku mbahet paraburgimi (në tekstin e mëtejmë: "institucioni i paraburgimit") bazohet në aktvendimin me shkrim të gjyqtarit.
2. Institucioni i paraburgimit detyrohet të mbajë evidencë për kohën e ardhjes së personit të paraburgosur në institucionin e paraburgimit dhe për kohën e skadimit të paraburgimit dhe të informojë të paraburgosurin dhe mbrojtësin e tij për datën e skadimit. Nëse institucioni i paraburgimit nuk e merr aktvendimin e gjykatës për vazhdimin e paraburgimit pasi të ketë skaduar afati nga aktvendimi, institucioni menjëherë duhet ta lirojë të paraburgosurin dhe për këtë të lajmërojë gjykatën kompetente.

Neni 196
Të dhënat lidhur me të paraburgosurit

1. Me qëllim të zbatimit të ligjshëm dhe të drejtë të paraburgimit, institucioni i paraburgimit mbledh, përpunon, ruan dhe mirëmban bazën e të dhënave për të paraburgosurit.
2. Baza e të dhënave nga paragrafi 1. i këtij neni përfshin të dhënat:
   2.1. mbi identitetin dhe gjendjen personale të të paraburgosurit;
   2.2. mbi aktvendimin e paraburgimit;
   2.3. mbi punën e kryer gjatë kohës së paraburgimit;
   2.4. mbi pranimin në institucionin e paraburgimit dhe kohëzgjatjen, vazhdimin apo heqjen e paraburgimit; dhe
   2.5. mbi sjelljen e të paraburgosurit dhe për masat disiplinore.

3. Informacionet nga baza e të dhënave ruhen dhe përdoren derisa zgjat paraburgimi. Pas heqjes së paraburgimit, të dhënat arkivohen dhe përgjithmonë ruhen.
4. Institucioni i paraburgimit ia dërgon të dhënat nga paragrafi 2. i këtij neni bazës qendrore të të paraburgosurve dhe të dhënat e tilla mund të përdoren vetëm nga persona të tjerë të autorizuar për përdorimin e bazës së të dhënave sipas ligjit apo lejes me shkrim ose kërkesës së personit të cilit i referohen të dhënat.
5. Ministria e Drejtësisë nxjerr urdhëresë administrative me të cilën më hollësisht do të definohen të dhënat nga paragrafi 2. i këtij neni dhe procedurat në pajtim me këtë nen.

Neni 197
Veçimi i të paraburgosurve

1. Paraburgimi mbahet në objekte të posaçme të paraburgimit ose në pjesë të ndarë të institucionit për mbajtjen e dënimeve me burgim.
2. Persona të gjinive të ndryshme nuk mund të mbahen në të njëjtën dhomë. Në parim, personat që kanë marrë pjesë në kryerjen e veprës së njëjtë penale nuk vendosen në dhomë të njëjtë dhe personat që mbajnë dënimin nuk vendosen në dhomë të njëjtë me të paraburgosurit. Po qe e mundur, personat që kanë përsëritur veprën penale nuk vendosen në dhomë të njëjtë me personat tjerë në paraburgim tek të cilët mund të ndikojnë negativisht.
3. Gjykata kompetente, me propozim të drejtorit të qendrës së paraburgimit në të cilën është vendosur i paraburgosuri, mund ta transferojë të paraburgosurin nga lokalet e një institucioni të paraburgimit në tjetrin për shkaqe sigurie, rendi dhe mbajtjeje të disiplinës ose për zbatim të suksesshëm dhe të arsyeshëm të procedurës penale.

Neni 198
Gjësendet të cilat të paraburgosurit kanë të drejtë të mbajnë dhe të shfrytëzojnë

Gjatë kohës së paraburgimit, i paraburgosuri mund të mbajë me vete dhe të shfrytëzojë sende për përdorim personal, për mbajtjen e higjienës, pajisje për dëgjimin e mediave publike, publikime, literaturë profesionale dhe literaturë tjetër, para dhe sende të tjera të cilat për nga masa dhe sasia mundësojnë jetë normale në hapësirën e qëndrimit dhe që nuk i pengojnë të paraburgosurit e tjerë. Gjatë kontrollit personal të të paraburgosurit sendet tjera konfiskohen dhe ruhen.

Neni 199
E drejta e të paraburgosurve në pushim, lëvizje dhe pagesë për punën e kryer

1. I paraburgosuri ka të drejtë në tetë (8) orë pushim pa ndërprerje brenda njëzet e katër (24) orëve. Përveç kësaj, atij i garantohet së paku dy (2) orë në ditë lëvizje në ambient të hapur.
2. I paraburgosuri mund të kryejë punë të nevojshme për mbajtjen e rendit dhe pastërtisë në ambientin e tyre. Të paraburgosurit mund t'i lejohet të punojë në aktivitete që i përgjigjen aftësive fizike dhe mendore brenda mundësive dhe kushteve me të cilat disponon institucioni dhe me kusht që të mos e dëmtojë

procedurën penale. Gjyqtari i procedurës paraprake, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues vendos për këtë në marrëveshje me drejtorinë e institucionit.

3. I paraburgosuri ka të drejtë pagese për punën e kryer. Ministria e Drejtësisë nxjerr urdhëresë administrative me të cilën përcakton mënyrën dhe shumën e pagesës.

Neni 200
Vizitat dhe e drejta për të komunikuar

1. Me leje të gjyqtarit të procedurës paraprake, gjyqtarit të vetëm gjykues apo kryetarit të trupit gjykues dhe nën mbikëqyrjen e tij ose nën mbikëqyrjen e ndonjë personi të caktuar nga gjyqtari i tillë, i paraburgosuri mund të vizitohet nga farefisi i afërm dhe me kërkesë të tij mund të vizitohet nga mjeku apo nga persona të tjerë, duke respektuar rregullat e institucionit të paraburgimit. Vizita të tilla mund të ndalohen nëse mund të dëmtojnë zbatimin e procedurës penale.
2. Me dijeninë e gjyqtarit të procedurës paraprake, gjyqtarit të vetëm gjykues apo kryetarit të trupit gjykues, përfaqësuesit e ambasadës, zyrës ndërlidhëse ose të misionit diplomatik kanë të drejtë të vizitojnë dhe të bisedojnë pa mbikëqyrje me të paraburgosurin që është shtetas i vendit të tyre. Përfaqësuesit e organizatave ndërkombëtare kompetente gëzojnë të drejta të njëjta të vizitojnë dhe të bisedojnë me të paraburgosurit të cilët janë refugjatë ose në ndonjë mënyrë tjetër janë nën mbrojtjen e organizatës së tillë ndërkombëtare.
3. Ombudspersoni i Kosovës ose zëvendësi i tij mund të vizitojë të paraburgosurit dhe të korrespondojë me ta pa paralajmërim paraprak dhe pa mbikëqyrjen e gjyqtarit të procedurës paraprake, gjyqtarit të vetëm gjykues apo kryetarit të trupit gjykues ose personave të tjerë të emëruar nga gjyqtari i tillë. Letrat e të paraburgosurit dërguar Zyrës së Ombudspersonit të Kosovës nuk mund të kontrollohen. Ombudspersoni i Kosovës dhe zëvendësi i tij mund të komunikojnë gojarisht ose me shkrim në mënyrë konfidenciale me të paraburgosurit. Komunikimi ndërmjet të paraburgosurit dhe Ombudspersonit ose zëvendësit të tij mund të shikohet nga zyrtari i policisë, por jo të dëgjohet.
4. Të paraburgosurit mund të korrespondojë ose të kenë kontakte të tjera me persona jashtë institucionit të paraburgimit me dijeninë dhe nën mbikëqyrjen e gjyqtarit të procedurës paraprake, gjyqtarit të vetëm gjykues ose kryetarit të trupit gjykues. Gjyqtari i procedurës paraprake, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues, pasi të ketë konsultuar prokurorin e shtetit mund të ndalojë dërgimin dhe pranimin e letrave dhe të dërgesave të tjera ose vënien e kontaktit që është i dëmshëm për procedurën, por nuk mund t'ia ndalojë të paraburgosurit dërgimin e kërkesave, ankesave ose komunikimin me mbrojtësin e tij.
5. Kur gjyqtari i procedurës paraprake, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues refuzon vizitën në pajtim me paragrafin 1. të këtij neni ose e ndalon komunikimin në pajtim me paragrafin 4. të këtij neni, i paraburgosuri mund të kërkojë nga kolegji shqyrtues t'i jepet leje e tillë.
6. Pas ngritjes së aktakuzës deri te forma e prerë e aktgjykimit, gjyqtari i vetëm gjykues apo kryetari i trupit gjykues, vendos për çështjet nga paragrafët 1. deri 4., të këtij neni, ndërsa paragrafi 5. i këtij neni zbatohet përshtatshmërisht.

Neni 201
Disiplina e të paraburgosurve

1. Gjyqtari i procedurës paraprake, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues mund të shqiptojë dënim disiplinor të ndalimit ose kufizimit të vizitave apo korrespondencave ndaj të paraburgosurit që ka bërë shkelje disiplinore.
2. Shkelja disiplinore përfshin:
   2.1. sulmin fizik ndaj të paraburgosurve të tjerë, ndaj punëtorëve të institucionit të paraburgimit ose personave të tjerë zyrtar;
   2.2. prodhimin, pranimin ose futjen e sendeve për sulm ose arratisje;
   2.3. prodhimin ose futjen e pijeve alkoolike dhe narkotikëve dhe shpërndarjen e tyre;
   2.4. shkeljen e rregullave për mbrojtjen në punë, mbrojtjen nga zjarri dhe parandalimin e pasojave nga fatkeqësitë natyrore;
   2.5. përsëritjen e shkeljes së rendit shtëpiak të institucionit të paraburgimit;
   2.6. shkaktimin e qëllimshëm të dëmit të madh material ose nga pakujdesia e rëndë; ose
   2.7. sjelljen fyese dhe të padenjë.
3. Kufizimi ose ndalimi i vizitës apo i korrespondencës nuk zbatohet ndaj vizitave ose korrespondencave me mbrojtësin, mjekët, Ombudspersonin e Kosovës, përfaqësuesit e ambasadës, zyrës ndërlidhëse ose të misionit diplomatik të shtetit, shtetas i të cilit është i paraburgosuri, ose të përfaqësuesve të organizatës kompetente në rastin e refugjatit ose të personit i cili në ndonjë mënyrë tjetër është nën mbrojtjen e asaj organizate ndërkombëtare.
4. Kundër aktvendimit mbi dënimin e shqiptuar nga paragrafi 1. i këtij neni mund t'i paraqitet ankesë kolegjit shqyrtues brenda afatit prej njëzet e katër (24) orëve nga pranimi i aktvendimit. Ankesa nuk e pezullon ekzekutimin e aktvendimit.
5. Kolegji në afat brenda dyzetetetë (48) orëve, të vendos për ankesën.

Neni 202
Zbatimi i Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale ndaj të paraburgosurve

Me përjashtim të rasteve kur ky Kod dhe ligjet tjera të nxjerra sipas këtij Kodi parashohin ndryshe, dispozitat ligjore të Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, zbatohen përshtatshmërisht për monitorimin, përcjelljen, mbikëqyrjen, mbajtjen e rendit dhe disiplinës, përdorimin e forcës, kontrollin personal dhe kontrollin e lokaleve në rastin e të paraburgosurve.

Neni 203
Mbikëqyrja e trajtimit të të paraburgosurve

1. Kryetari i gjykatës themelore kompetente ka përgjegjësinë përfundimtare për mbikëqyrjen e trajtimit të të paraburgosurve.
2. Kryetari i gjykatës themelore kompetente ose gjyqtari i cili ka urdhëruar paraburgimin, në çdo kohë mund të vizitojë të paraburgosurit, të bisedojë me ta dhe të pranojë ankesat e tyre.

3. Detyrimet nga ky nen nuk ndikojnë në detyrimin e gjyqtarit kompetent nga neni 192 i këtij Kodi për të vlerësuar ankesat e të pandehurve të cilët paraqesin ankesa të vlefshme lidhur me kushtet e paraburgimit dhe t'i korrigjoj ato kushte të kundërligjshme

KAPITULLI XI
PROCESVERBALET

A. Krijimi dhe mbajtja e procesverbaleve

Neni 204
Procesverbali i veprimeve në procedurë penale

1. Për çdo veprim të ndërmarrë gjatë procedurës penale shkruhet procesverbal në të njëjtën kohë kur ushtrohet veprimi, e kur kjo nuk është e mundur, atëherë shkruhet menjëherë pas kësaj.
2. Procesverbalin e shkruan procesmbajtësi i gjykatës, por kur veprimet ushtrohen nga prokurori i shtetit, procesverbalin e shkruan procesmbajtësi i zyrës së prokurorit të shtetit. Vetëm kur bëhet kontrolli i banesës apo i personave ose kur veprimi kryhet jashtë lokalit zyrtar të organit publik apo të autoritetit kompetent, e procesmbajtësi nuk mund të sigurohet, procesverbalin mund ta shkruajë personi i cili e kryen veprimin.
3. Kur procesverbalin e shkruan procesmbajtësi, atij i tregon gojarisht personi i cili kryen veprimin se çka duhet shënuar në procesverbal.
4. Personit që merret në pyetje i lejohet që personalisht t'i jep përgjigjet në procesverbal. Në rast të keqpërdorimit kjo e drejtë mund t'i mohohet.
5. Kur marrja në pyetje në procedurë paraprake, marrja e deklaratës në procedurë paraprake ose mundësia hetuese e veçantë duhet të regjistrohen audio ose të regjistrohen audio dhe video, kopja e regjistrimit i bashkëngjitet procesverbalit.

Neni 205
Shënimet në procesverbal

1. Në procesverbal shënohet emërtimi i organit kompetent para të cilit ushtrohet veprimi, vendi ku ushtrohet veprimi, data dhe ora kur ka filluar dhe përfunduar veprimi, emrat e mbiemrat e personave të pranishëm dhe në çfarë cilësie janë të pranishëm, si dhe numri i lëndës penale në të cilën ushtrohet veprimi.
2. Me rastin e ushtrimit të veprimit konkret procedural në pajtim me ligjin, pala duhet të informohet për të drejtën që i takon sipas ligjit. Fakti se njoftimi i tillë është bërë duhet të shënohet në procesverbal, ashtu siç duhet të shënohet edhe nëse pala e ka shfrytëzuar atë të drejtë.
3. Faktin se i është mundësuar përdorimi i të drejtës e cila i takon me ligj, pala e vërteton me nënshkrim.
4. Procesverbali duhet të përmbajë të dhënat thelbësore për zbatimin dhe përmbajtjen e veprimit të ushtruar. Kur me rastin e zbatimit të veprimit janë konfiskuar sendet ose shkresat, kjo shënohet në procesverbal, kurse sendet e marra i bashkëngjiten procesverbalit ose shënohet se ku gjenden për t'u ruajtur.

5. Me rastin e ndërmarrjes së veprimit procedural, siç është këqyrja e vendit ku është kryer vepra penale, kontrolli i banesës, automjetit apo i personit, ose identifikimi i personave apo i sendeve, dhe të dhëna me rëndësi për natyrën e veprimit ose vërtetimin e identitetit të sendit (përshkrimi, përmasat dhe madhësia e objekteve ose e gjurmëve, e etiketave në objekte etj.), gjithashtu shënohen në procesverbal; e kur bëhen skica, vizatime, plane, fotografi, incizime filmike ose incizime të tjera teknike, ato po ashtu shënohen në procesverbal dhe i bashkëngjiten procesverbalit.
6. Shkresat ose sendet të cilat ceken gjatë marrjes në pyetje në procedurë paraprake, marrjes së deklaratës në procedurë paraprake ose mundësisë hetuese të veçantë identifikohen me numra të provave. Shkresat ose sendet ceken sipas numrave të tyre gjatë marrjes në pyetje në procedurë paraprake, marrjes së deklaratës në procedurë paraprake ose mundësisë hetuese të veçantë, dhe në procesverbal shënohen sipas numrit të tyre.

Neni 206
Ruajtja i procesverbalit

1. Procesverbali duhet të mbahet me rregull; në të nuk bën të shlyhet, të shtohet ose të ndryshohet asgjë. Vendet e vijëzuara duhet të mbeten të lexueshme.
2. Të gjitha ndryshimet, korrigjimet dhe shtesat shënohen në fund të procesverbalit dhe ato duhet të vërtetohen nga personat që e nënshkruajnë procesverbalin.

Neni 207
Shqyrtimi i procesverbalit

1. Personi kundër të cilit zbatohet veprimi procedural, personat që duhet të jenë të pranishëm në veprimin hetimor, si dhe palët, mbrojtësi dhe i dëmtuari, po qe se janë të pranishëm, kanë të drejtë ta lexojnë procesverbalin ose të kërkojnë që t'u lexohet. Personi që ushtron veprimin hetimor detyrohet t'i paralajmërojë ata për këtë të drejtë, kurse në procesverbal shënohet se a është bërë paralajmërimi dhe a është lexuar procesverbali. Procesverbali lexohet gjithmonë kur nuk ka pasur procesmbajtës dhe kjo shënohet në procesverbal.
2. Procesverbalin e nënshkruan personi që merret në pyetje. Kur procesverbali përbëhet nga më shumë se një faqe, personi i pyetur nënshkruan secilën faqe.
3. Në fund, procesverbalin e nënshkruajnë përkthyesi, nëse ka pasur, dëshmitarët prania e të cilëve ka qenë e detyruar me rastin e kryerjes së veprimit hetimor, kurse me rastin e kontrollit atë e nënshkruan edhe personi që kontrollohet ose banesa e të cilit kontrollohet. Kur procesverbalin nuk e nënshkruan procesmbajtësi, procesverbalin e nënshkruajnë personat që marrin pjesë në procedurë. Kur nuk ka persona të tillë ose kur ata nuk janë në gjendje të kuptojnë përmbajtjen e procesverbalit, procesverbalin e nënshkruajnë dy (2) dëshmitarë, përveç kur nuk është e mundur të sigurohet prania e tyre.
4. Personi analfabet në vend të nënshkrimit vë shenjën e gishtit tregues të dorës së djathtë, kurse procesmbajtësi nën këtë shenjë shkruan emrin dhe mbiemrin e tij. Kur nuk ka mundësi që të vihet shenja e gishtit tregues të djathtë, vihet shenja e ndonjë gishti tjetër ose shenja e gishtit të dorës së majtë dhe në procesverbal shënohet se nga cili gisht dhe nga cila dorë është marrë shenja.

5. Në qoftë se personi i pyetur nuk i ka të dy duart, ai e lexon procesverbalin, e kur është analfabet, procesverbali i lexohet dhe kjo shënohet në procesverbal.
6. Kur veprimi hetimor nuk ka mund të kryhet pa ndërprerje, në procesverbal shënohet dita dhe ora kur është bërë ndërprerja si dhe dita dhe ora kur ka vazhduar veprimi hetimor.
7. Po qe se ka pasur vërejte rreth përmbajtjes së procesverbalit, në procesverbal shënohen edhe ato vërejtje.
8. Në fund, procesverbalin e nënshkruan personi që e ka ushtruar veprimin hetimor dhe procesmbajtësi.
9. Kur personi i cili sipas këtij Kodi duhet të nënshkruajë procesverbalin, kundërshton ta nënshkruajë atë ose të vendosë shenjën e gishtit, organi i procedurës shënon në procesverbal shkaqet e refuzimit.

Neni 208
Regjistrimi i seancave me incizim audio dhe me incizim audio dhe video

1. Seancat e zbatueshme të marrjes së deklaratës në procedurë paraprake ose të mundësisë hetuese të veçantë, apo marrja tjetër në pyetje sipas nevojës, regjistrohet me video ose audio në përputhje me procedurën vijuese:
   1.1. personi që merret në pyetje njoftohet në gjuhën që ai e kupton dhe e flet se marrja në pyetje do të regjistrohet me incizim audio ose video.
   1.2. incizimi duhet të përmbajë të dhënat nga neni 205, paragrafi 1. i këtij Kodi dhe njoftimin nga neni 125 i këtij Kodi, si dhe informatat e nevojshme për identifikimin e peronave deklarimet e të cilëve incizohen. Kur incizohen deklarimet e më shumë personave, duhet siguruar që nga incizimi të mund të identifikohet se kush e ka dhënë deklarimin.
   1.3. në rast ndërprerjeje gjatë marrjes në pyetje, ndërprerja dhe koha e ndërprerjes regjistrohet para se të përfundojë incizimi audio ose video, si dhe rifillimi i marrjes në pyetje;
   1.4. në fund të marrjes në pyetje, personit të pyetur duhet ofruar mundësinë që të sqarojë atë që e ka thënë ose të shtojë atë që dëshiron. Me kërkesën e personit të marrë në pyetje, incizimi menjëherë riprodukohet dhe incizohen korrigjimet apo shpjegimet e personit. Koha e përfundimit të marrjes në pyetje gjithmonë shënohet.
2. Në bazë të diskrecionit të prokurorit të shtetit apo sipas urdhrit të gjyqtarit të procedurës paraprake, gjyqtarit të vetëm gjykues ose kryetarit të trupi gjykues, përmbajtja e kasetës mund të transkriptohet. Në rast se transkriptohet përmbajtja, transkripti bëhet sa më parë që të jetë e mundur pas përfundimit të marrjes në pyetje dhe me kërkesën e personit të pyetur një kopje e transkriptit i dërgohet atij.
3. Se paku katër (4) kopje të incizimit audio apo të incizimit audio dhe video nga ky nen kopjohen në CD ose DVD disqe, apo në mjet të ngjashme me to, dhe së bashku me procesverbalin me shkrim të marrjes në pyetje vihen në shkresat e lëndës. Një kopje origjinale mbetet gjithmonë në shkresat e lëndës, një kopje i jepet secilit mbrojtës kur ngritet aktakuza, një kopje i sigurohet mbrojtësit të viktimës apo përfaqësuesit të viktimës dhe një kopje mbahet nga prokurori i shtetit.
4. Procesverbali i shkruar i marrjes në pyetje përmban:

4.1. faktin se marrja në pyetje është incizuar në mënyrë audio ose video;
4.2. emrin e personit i cili e ka bërë incizimin;
4.3. emrin e personave të pranishëm gjatë seancës së incizimit;
4.4. faktin se personi që merret në pyetje është njoftuar më parë për vendimin e incizimit të marrjes në pyetje;
4.5. nëse incizimi është riprodukuar;
4.6. përmbledhjen e deklaratës;
4.7. kopjet e provave të cilat i janë treguar personit i cili është marrë në pyetje; dhe

5. Pas shumëzimit të kopjeve, procesmbajtësi e mbyll kopjen origjinale të incizimit dhe e nënshkruan, si dhe ia bashkangjet deklaratën se incizimi nuk është ndryshuar dhe së është incizim i vërtetë i seancës.
6. Nëse ndodh ndonjë gabim teknik gjatë incizimit audio ose incizimit audio dhe video, personi marrja në pyetje e të cilit është duke u incizuar njoftohet për këtë gabim teknik gjatë incizimit dhe rimerret në pyetje prapë lidhur me çështjet apo përgjigjet incizimi i të cilave është ndikuar nga gabimi teknik, ose lejohet që të bëjë korrigjime lidhur me çështjet apo përgjigjet incizimi i të cilave është ndikuar nga gabimi teknik.
7. Incizimi audio apo incizimi audio dhe video i seancës nuk mund të ndryshohet apo të redaktohet. Në rast se në procedurën penale lidhur me të cilën është incizuar seanca është ngritur aktakuzë, kryetarit i trupit gjykues mund të vendos që incizimi audio ose incizimi audio dhe video i seancës të jetë i papranueshëm kur ka shkak të bazuar për të besuar se incizimi është ndryshuar apo redaktuar. Shkaku i bazuar nga ky paragraf nuk mund të mbështetet vetëm në dallimet në deklaratat e dëshmitarit.
8. Të dhënat personale të të pandehurit, të dëmtuari apo dëshmitarit janë konfidenciale dhe mund të përdoren vetëm gjatë procedurës penale. Shkelja nga ky paragraf konsiderohet si shkelje e detyrimeve etike të profesionistit të përfshirë dhe mund të sanksionohet nga gjykata.

Neni 209
Regjistrimi i veprimeve me incizim audio ose incizim audio dhe video

Prokurori i shtetit, gjyqtari i procedurës paraprake, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues mund të urdhërojë që, përpos marrjes në pyetje, të incizohen në mënyrë audio apo video edhe veprime të tjera hetimore. Neni 208 i këtij Kodi zbatohet përshtatshmërisht.

Neni 210
Stenografimi me dorë apo me makinë dhe transkriptimi

Prokurori i shtetit, gjyqtari i procedurës paraprake, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues mund të urdhërojë që veprimi hetimor në procedurë ose pjesë të tij të stenografohen me dorë apo me makinë stenografike. Procesverbali stenografik brenda dyzet e tetë (48) orësh transkriptohet, kontrollohet dhe i bashkëngjitet procesverbalit.

Neni 211
Incizimi nga të tjerët

1. Gjyqtari i procedurës paraprake mund t'u lejojë personave të tjerë që kanë interes legjitim të regjistrojnë në mënyrë audio ose video veprime të veçanta hetimore, nëse një gjë e tillë do të kishte ndikim të parëndësishëm mbi të drejtat, veçanërisht të jetës private të të pandehurit, të dëmtuarit, dëshmitarëve dhe pjesëmarrësve të tjerë në procedurë. Të dhënat personale për të pandehurin, të dëmtuarin ose dëshmitarin janë fshehtësi dhe mund të përdoren vetëm gjatë procedurës penale.
2. Me propozim të palës ose *ab initio*, kryetari i gjykatës përjashtimisht mund të lejojë incizime nga paragrafi 1. i këtij neni në ndonjë shqyrtim gjyqësor konkret.
3. Palët dhe mbrojtësit mund të bëjnë incizim audio të shqyrtimit gjyqësor të hapur. Të dhënat personale të regjistruara për të pandehurin, të dëmtuarin ose dëshmitarin janë fshehtësi dhe mund të përdoren vetëm gjatë procedurës penale. Dëgjimi i incizimit audio i bërë sipas këtij paragrafi nuk i lejohet dëshmitarit.
4. Kur lejohet incizimi i shqyrtimit gjyqësor, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues, për arsye të justifikueshme, mund të ndalojë incizimin e pjesëve të posaçme të seancës.

Neni 212
Shkresat e lëndës

1. Të gjitha procesverbalet, regjistrimet, transkriptet, provat, urdhrat, aktvendimet, kërkesat, ankesat, aktgjykimet apo shkresat tjera të rëndësishme për procedurën penale mbahen në shkresat e lëndës.
2. Shkresat e lëndës mbahen në mënyrë të rregullt nga procesmbajtësi përgjegjës.
3. Këshilli Prokurorial i Kosovës dhe Këshilli Gjyqësor i Kosovës janë kompetent për të përcaktuar rregulla mbi trajtimin e brendshëm të shkresave të lëndëve në kuadër të zyrave prokuroriale, respektivisht gjykatave.

B. Shikimi i procesverbalit dhe shkresave të lëndës

Neni 213
Qasja e të dyshuarit dhe të pandehurit në shkresat e lëndës

1. Gjatë hapave fillestarë të policisë, i dyshuari duhet të ketë qasje në dëshmitë që janë duke u mbledhur me kërkesë të tij, përveç rasteve ku paragrafi 6. ose 7. i këtij neni mund të aplikohet mutatis mutandis.
2. Me fillimin e hetimit, prokurori i shtetit është i detyruar që t'i sigurojë cilitdo të pandehur apo mbrojtësve të tyre qasje në shkresat e lëndës, përveç përjashtimeve të parapara me këtë nen.
3. Në asnjë fazë të hetimit mbrojtjes nuk mund t'i mohohet shikimi i shkresave lidhur me procesin e marrjes në pyetje të të pandehurit, shikimi i materialit të marrë nga i pandehuri apo materialit që i përket atij, shikimi i materialit lidhur me veprimet hetimore në të cilat është lejuar ose është dashur të lejohet pjesëmarrja e mbrojtësit ose shikimi i ekspertizave.

4. Pas përfundimit të hetimit, mbrojtja ka të drejtë të shikojë, të kopjojë ose t'i fotografojë të gjitha shkresat dhe provat materiale me të cilat disponon gjykata.
5. Pas ngritjes së aktakuzës, të pandehurit ose të pandehurve të cekur në aktakuzë mund t'u sigurohet kopja ose kopjet e shkresave të lëndëve.
6. Përveç të drejtave që i gëzon mbrojtja nga paragrafët 2., 3. dhe 4. të këtij neni, mbrojtjes i lejohet nga prokurori i shtetit që të shikojë, të kopjojë ose të fotografojë shkresa, libra, dokumente, fotografi dhe objekte të tjera materiale në posedim, ruajtje ose kontroll të prokurorit të shtetit, materiale të cilat shërbejnë për përgatitjen e mbrojtjes ose të cilat kanë për qëllim që të shfrytëzohen nga prokurori i shtetit si prova gjatë shqyrtimit gjyqësor, ose që janë marrë nga i pandehuri apo kanë qenë pronë e tij, varësisht nga rasti. Prokurori i shtetit mund t'i refuzojë mbrojtjes shikimin, kopjimin ose fotografimin e shkresave të caktuara, të librave, dokumenteve, fotografive dhe objekteve të tjera materiale në posedim, ruajtje ose nën kontroll të tij, nëse ka gjasa reale se shikimi, kopjimi ose fotografimi mund të rrezikojë qëllimin e hetimit, jetën ose shëndetin e njerëzve. Në rast të tillë, mbrojtja mund të kërkojë nga gjyqtari i procedurës paraprake, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues që të lejojë shikimin, kopjimin ose fotokopjimin. Vendimi i gjyqtarit është përfundimtar.
7. Informacionet mund të redaktohet ose të shënjohen nga prokurori i shtetit me vijë të trashë të zezë për të fshehur të dhëna të caktuara në kopjet e shkresave të cilat përmbajnë të dhëna të ndjeshme. I pandehuri mund të kundërshtojë redaktimin te gjyqtari i procedurës paraprake, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues brenda tre (3) ditëve nga pranimi i kopjes së redaktuar. Prokurorit të shtetit i jepet mundësia që të shpjegojë bazën ligjore të redaktimit pa zbuluar informacionin e ndjeshëm. Gjyqtari shqyrton informacionin e ndjeshëm dhe merr vendim brenda tre (3) ditëve nëse redaktimi është ligjërisht i arsyetuar.
8. Dispozitat e këtij neni varen nga masat për mbrojtjen e të dëmtuarve, dëshmitarëve dhe privatësisë së tyre si dhe për mbrojtjen e informacioneve konfidenciale, siç parashihet me ligj.

Neni 214
Qasja e të dëmtuarit dhe mbrojtësit të viktimës në shkresat e lëndës

1. I dëmtuari, përfaqësuesi i tij ligjorë apo përfaqësuesi i autorizuar, ose mbrojtësi i viktimës kanë të drejtë të shikojnë, kopjojnë ose fotografojnë shkresat dhe provat materiale që i disponon gjykata ose prokurori i shtetit nëse ka interes legjitim për të bërë një gjë të tillë.
2. Gjykata ose prokurori i shtetit mund të refuzojnë lejimin e shikimit, të kopjimit ose të fotokopjimit të shkresave ose provave materiale nëse interesi legjitim i të pandehurit dhe i personave të tjerë kalon interesin e të dëmtuarit, ose nëse ka gjasa reale që shikimi, kopjimi ose fotokopjimi mund të rrezikojë qëllimin e hetimit ose jetën dhe shëndetin e njerëzve apo do të zvarriste në mënyrë të konsiderueshme procedurën dhe nëse i dëmtuari ende nuk është pyetur si dëshmitar.
3. Nëse prokurori i shtetit refuzon shikimin e shkresave, i dëmtuari mund t'i paraqesë ankesë gjyqtarit të procedurës paraprake. Vendimi i gjyqtarit të procedurës paraprake është përfundimtar.

4. Nëse gjyqtari i procedurës paraprake refuzon shikimin e shkresave me të cilat disponon gjykata, atëherë mund të paraqitet ankesë në kolegjin shqyrtues.
5. Të dhënat mund të redaktohen apo të shënjohen nga prokurori i shtetit me vijë të trashë të zezë për të fshehur të dhëna të caktuara në kopjet e shkresave të cilat përmbajnë të dhëna të ndjeshme.
6. Dispozitat e këtij neni varen nga masat për mbrojtjen e të dëmtuarve, dëshmitarëve dhe privatësisë së tyre si dhe mbrojtjen e informacioneve konfidenciale siç parashihet me ligj, përfshirë Kapitullin XIII të këtij Kodi.

Neni 215
Kualifikimet e interpretëve ose përkthyesve

1. Personi i cili shërben si interpreto ose përkthyes nga ky Kod duhet të jetë i kualifikuar për të interpretuar ose përkthyer si në vijim:
   1.1. Nëse është në dispozicion, interpreti ose përkthyesi duhet të certifikohet si interpreto ose përkthyes në gjuhët përkatëse në pajtim me rregullat nga paragrafi 2. të këtij neni;
   1.2. Nëse interpreti ose përkthyesi nga paragrafi 1, nën-paragrafi 1.1. i këtij neni nuk është në dispozicion, interpreti ose përkthyesi duhet të jetë i diplomuar në gjuhën ose gjuhët përkatëse dhe të ketë së paku dy (2) vjet përvojë si interpret ose përkthyes;
   1.3. Nëse interpreti ose përkthyesi nga paragrafi 1. nën-paragrafët 1.1. dhe 1.2. të këtij neni nuk është në dispozicion, interpreti ose përkthyesi duhet të ketë së paku katër (4) vjet përvojë si interpret ose përkthyes në gjuhën ose gjuhët përkatëse;
   1.4. Nëse interpreti ose përkthyesi nga paragrafi 1. nën-paragrafët 1.1., 1.2. dhe 1.3. nuk është në dispozicion, interpreti ose përkthyesi duhet të ketë treguar aftësi të mjaftueshme për të interpretuar ose përkthyer saktë dhe pa anim në gjuhët përkatëse.
2. Ministria e Drejtësisë ka kompetencë për të nxjerr rregullore mbi çertifikimin e interpretove ose përkthyesve që janë kompetent për të interpretuar ose përkthyer profesionalisht në procedura penale në ato gjuhë që kryesisht përdoren në procedura penale.

KAPITULLI XII
PROVAT GJATË HETIMIT

A. Kërkesa e të pandehurit ose të dëmtuarit për marrjen apo ruajtjen e provave

Neni 216
Kërkesa e të pandehurit për marrjen apo ruajtjen e provave

1. Gjatë hetimit, i pandehuri mund të kërkojë nga prokurori i shtetit marrjen e ndonjë prove konkrete.
2. Prokurori i shtetit merr provën apo dëshminë e tillë nëse është e rëndësishme për procedurën dhe:

2.1. kur ekziston rrezik për humbjen e provës apo dëshmisë ose kur ka gjasa që të mos jetë e mundshme në shqyrtim gjyqësor;
2.2. kur prova e tillë arsyeton lirimin e të pandehurit nga paraburgimi;
2.3. kur ka gjasa të arsyeshme që prova apo dëshmia që kërkohet të merret të jetë shfajësuese; ose
2.4. kur ekzistojnë shkaqe të tjera të arsyeshme për marrjen e provës apo dëshmisë së tillë.

3. Nëse i pandehuri ose mbrojtësi i tij kërkon nga prokurori i shtetit që të merr prova të caktuara të cilat gjenden jashtë Kosovës, prokurori i shtetit mund të mbledh provat e tilla në pajtim me nenin 219 të këtij Kodi.
4. Nëse prokurori i shtetit refuzon kërkesën për marrjen e provës, ai merr aktvendim të arsyetuar dhe njofton të pandehurin. I pandehuri mund të ankohet te gjyqtari i procedurës paraprake ndaj aktvendimit të tillë.

Neni 217
Kërkesa e të dëmtuarit për marrjen apo ruajtjen e provave

1. Gjatë hetimit, i dëmtuari mund të kërkojë nga prokurori i shtetit marrjen e ndonjë prove konkrete.
2. Prokurori i shtetit merr provën apo dëshminë e tillë nëse është e rëndësishme për procedurën dhe:
   2.1. kur ekziston rrezik për humbjen e provës apo dëshmisë ose kur ka gjasa që të mos jetë e mundshme në shqyrtim gjyqësor;
   2.2. kur prova e tillë mund të jetë e efektshme për t'u marrë së bashku me prova tjera nga prokurori i shtetit; ose
   2.3. kur është drejtpërdrejt e rëndësishme për kërkesën e paraqitur nga i dëmtuari në procedurë penale.
3. Nëse i dëmtuari kërkon nga prokurori i shtetit që të merr prova të caktuara të cilat gjenden jashtë Kosovës, prokurori i shtetit mund të mbledh provat e tilla në pajtim me nenin 219 të këtij Kodi.
4. Nëse prokurori i shtetit refuzon kërkesën për marrjen e provës, ai merr aktvendim të arsyetuar dhe njofton të dëmtuarin, përfaqësuesin e autorizuar të palës së dëmtuar ose mbrojtësin e viktimës. I dëmtuari, përfaqësuesi i autorizuar i të dëmtuarit ose mbrojtësi i viktimës mund të ankohet te gjyqtari i procedurës paraprake ndaj aktvendimit të tillë.

Neni 218
Deklarimi i dëmit nga i dëmtuari

1. Gjatë fazës së hetimit ose brenda gjashtëdhjetë (60) ditëve prej ngritjes së aktakuzës, i dëmtuari mund të paraqesë një deklaratë të thjeshtë të dëmit të shkaktuar nga vepra penale. Mbrojtësi i viktimave mund të ndihmojë të dëmtuarin në paraqitjen e deklaratës së dëmit. Zyra e mbrojtësve të viktimave mund të nxjerr një formë standarde për deklarimin e dëmit që është në pajtim me këtë nen.
2. Deklarimi mund të paraqitet edhe në mënyrë anonime nëse lejohet nga gjykata dhe nëse identiteti i viktimës i zbulohet gjykatës.

3. Deklarimi i dëmit duhet të përmbajë:
   3.1. emrin e personit i cili ka shkaktuar dëmin;
   3.2. mënyrën se si ka ardhur deri te dëmi;
   3.3. si është shkaktuar dëmi nga vepra penale apo si ka qenë dëmi rezultat i parashikuar i veprës penale; dhe
   3.4. nëse ka pasur shpenzime të shkaktuara si rezultat i dëmit apo humbjeve të shkaktuar nga vepra penale, në deklaratë caktohet vlerësimi i arsyeshëm i shpenzimeve apo humbjeve.
4. Gjykata mund të mos urdhërojë kompensimin e të dëmtuarit i cili nuk paraqet deklaratën e dëmit në mënyrën e duhur.
5. I dëmtuari nuk konsiderohet nga gjykata si palë në procedurë penale nëse nuk ka paraqitur deklaratën e dëmit.
6. Nëse deklarata e dëmit përmban vlerësimin e shpenzimeve apo humbjeve, gjithashtu shërben si kërkesë pasurore.

Neni 219
Kërkesat ndërkombëtare

1. Prokurori i shtetit ose gjyqtari kompetent, sa më parë që është e mundur, fillon kërkesat për ndihmë juridike ndërkombëtare, kërkesat për ekstradime, kërkesat për transferimin e të burgosurve ose kërkesat për ekzekutimin e aktgjykimeve.
2. Të gjitha kërkesat ndërkombëtare bëhen në pajtim me Ligjin për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar në Çështje Penale, Ligji nr. 04/L-31 ose me ligjet pasuese.
3. Prokurori i shtetit ose gjyqtari kompetent paraqet të gjitha kërkesat ndërkombëtare në konsultim dhe pajtim me Departamentin për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar të Ministrisë së Drejtësisë, ose organin pasues.
4. Ministri i Drejtësisë ka të drejtën e miratimit përfundimtar të të gjitha kërkesave ndërkombëtare që i paraqiten qeverive të huaja.
5. Prokurori i shtetit ose gjyqtari kompetent nuk flasin për media lidhur me kërkesat ndërkombëtare që janë në procedurë e sipër por i drejtojnë mediat te Ministria e Drejtësisë.
6. Provat e siguruara përmes rrugëve joformale nga qeveritë e huaja, organet për zbatimin e ligjit, prokuroritë apo gjykatat janë të pranueshme nëse atyre provave u bashkëngjitet deklarata nga qeveritë e huaja, organet për zbatimin e ligjit, prokuroria apo gjykatat që tregon se provat janë të bazuara dhe janë marrë në pajtim me ligjin e atij shtetit të huaj. Provat e tilla nuk mund të jenë bazë e vetme apo vendimtare për gjetjen e fajësisë. Të dhënat e tilla në shqyrtim gjyqësor shoqërohen me mbështetje të pohimit nga neni 263 i këtij Kodi.
7. Nëse Departamenti për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar pranon apo miraton kërkesën e qeverisë së huaj për ndihmë juridike, Departamenti për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar i dërgon kërkesën prokurorit kompetent të shtetit, i cili fillon procedurën penale me qëllimin e kufizuar në sigurimin e informacioneve të kërkuara apo kryerjen e veprimit të kërkuar. Nëse kërkesa apo veprimi i kërkuar nuk lejohet me ligj ose nuk është e mundur të sigurohet apo të kryhet, prokurori i shtetit njofton Departamentin për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar dhe pushon procedurën penale.

KAPITULLI XIII
MBROJTJA E TË DËMTUARVE DHE DËSHMITARËVE

Neni 220
Përkufizimet

1. Për qëllime të këtij Kapitulli, shprehjet e mëposhtme kanë këtë kuptim:
   1.1. **"Rrezik serioz"** do të thotë frikë e justifikueshme për rrezikim të jetës, shëndetit fizik apo mendor, pronës së të dëmtuarit, dëshmitarit bashkëpunues, dëshmitarit ose anëtarit të familjes së të dëmtuarit apo të dëshmitarit, si pasojë që pritet për faktin se i dëmtuari, dëshmitari bashkëpunues ose dëshmitari ka dhënë prova gjatë marrjes në pyetje apo dëshmimit në gjykatë;
   1.2. **"Anëtar i familjes"** është bashkëshorti, bashkëshorti jashtëmartesor, personi në gjini të gjakut në vijë të drejtë, prindi adoptues, fëmija i adoptuar, vëllai, motra ose prindi birësues;
   1.3. **"Anonimitet"** do të thotë mungesa e informatave të dhëna për identitetin ose vendndodhjen e të dëmtuarit, dëshmitarit bashkëpunues apo të dëshmitarit, identitetin ose vendndodhjen e anëtarit të familjes së të dëmtuarit, dëshmitarit bashkëpunues apo dëshmitarit, ose identiteti i cilitdo personi që ka lidhje me të dëmtuarin, dëshmitarin bashkëpunues apo me dëshmitarin.

Neni 221
Kërkesa për masë mbrojtëse apo anonimitet

1. Prokurori i shtetit, i pandehuri, mbrojtësi, i dëmtuari, dëshmitari bashkëpunues apo dëshmitari, në cilëndo fazë të procedurës mund t'i paraqesin gjyqtarit kompetent kërkesë me shkrim për masën mbrojtëse ose urdhrin për anonimitet kur ka rrezik serioz për të dëmtuarin, dëshmitarin bashkëpunues, dëshmitarin apo anëtarët e familjeve të tyre.
2. Kërkesa përmban deklaratën e pretendimeve faktike. Gjyqtari kompetent evidencon kërkesën dhe deklaratën në një zarf të mbyllur dhe përmbajtjeve të tyre gjatë rrjedhës së procedurës kanë mundësi t'u qasen vetëm gjyqtari kompetent dhe prokurori i shtetit.
3. Pas marrjes së kërkesës, gjyqtari kompetent mund të urdhërojë masa të përshtatshme mbrojtëse për të dëmtuarin, dëshmitarin bashkëpunues ose dëshmitarin, e nëse ai e sheh të nevojshme para se të marrë vendim për kërkesën, thërret seancë dëgjimore të mbyllur për të dëgjuar informata shtesë nga prokurori i shtetit, i pandehuri, mbrojtësi, të dëmtuarit, dëshmitarët bashkëpunues ose dëshmitarët. Në rast të dorëzimit të kërkesës me të cilën kërkohet urdhër në pajtim me nenet 223 dhe 224 të këtij Kodi, gjyqtari kompetent thërret seancë të mbyllur dëgjimore.
4. Gjyqtari mund të urdhërojë masën mbrojtëse për të dëmtuarin, dëshmitarin bashkëpunues ose dëshmitarin kur ai konstaton se:
   4.1. ekziston rrezik serioz për të dëmtuarin, dëshmitarin bashkëpunues, dëshmitarin ose për anëtarin e familjes së tij; dhe

4.2. masa mbrojtëse është e domosdoshme për të parandaluar rrezikun serioz për të dëmtuarin, dëshmitarin bashkëpunues, dëshmitarin ose anëtarin e familjes së tij.

5. Prokurori i shtetit njoftohet menjëherë nga gjyqtari kompetent për çdo kërkesë të bërë nga i pandehuri, mbrojtësi, i dëmtuari, dëshmitari bashkëpunues ose dëshmitari dhe ai ka të drejtë të bëjë rekomandime e deklarata lidhur me faktet te gjyqtari kompetent në seancë dëgjimore, ose me shkrim nëse nuk është urdhëruar seancë dëgjimore nga gjyqtari kompetent.

Neni 222
Urdhri për masa mbrojtëse

1. Gjyqtari kompetent mund të jep urdhër për masa të tilla mbrojtëse kur e sheh të nevojshme, duke përfshirë por pa u kufizuar në:
   1.1. lënien bosh ose shlyerjen e emrave, adresave, vendit të punës, profesionit ose ndonjë të dhëne apo informate tjetër që mund të përdoret për të identifikuar të dëmtuarin, dëshmitarin bashkëpunues ose dëshmitarin;
   1.2. moszbulimin e ndonjë shkrese që identifikon të dëmtuarin, dëshmitarin bashkëpunues ose dëshmitarin;
   1.3. përpjekjen për të fshehur veçoritë ose përshkrimin fizik të të dëmtuarit, dëshmitarit bashkëpunues apo dëshmitarit që jep dëshminë, duke përfshirë dhënien e dëshmisë prapa një mburoje jo të tejdukshme apo përmes pajisjeve për ndryshimin e fotografisë ose të zërit, ose marrjen në pyetje të njëkohshme nga një vend tjetër që komunikon me gjykatoren me anën e qarkut të mbyllur televiziv, ose videoregjistrimin para seancës dëgjimore në praninë e mbrojtësit;
   1.4. caktimin e pseudonimit;
   1.5. seancën e mbyllur për publikun;
   1.6. urdhrat ndaj mbrojtësit për të mos zbuluar identitetin e të dëmtuarit, dëshmitarit bashkëpunues apo dëshmitarit, ose për të mos zbuluar ndonjë material apo informacion që mund të shpie në zbulimin e identitetit;
   1.7. largimin e përkohshëm të të pandehurit nga gjykatorja nëse dëshmitari bashkëpunues ose dëshmitari refuzon të dëshmojë në prani të të pandehurit apo nëse rrethanat ia bëjnë të ditur gjykatës se dëshmitari nuk do ta flasë të vërtetën në prani të të pandehurit; ose
   1.8. cilido kombinim i metodave të përmendura më lart për të parandaluar zbulimin e identitetit të të dëmtuarit, dëshmitarit bashkëpunues ose dëshmitarit.
2. Dispozitat tjera të këtij Kodi nuk vlejnë atëherë kur janë në kundërshtim me masat mbrojtëse nga paragrafi 1. i këtij neni.
3. Urdhri për masë mbrojtëse bëhet me shkrim dhe nuk përfshin informata të cilat mund të çojnë në zbulimin e identitetit të të dëmtuarit, dëshmitarit bashkëpunues, dëshmitarit ose të anëtarit të familjes së tij, ose të cilat mund ta zbulojnë ekzistimin ose seriozisht të rrezikojë sigurinë e veprimeve hetimore të policisë dhe fshehtësinë e tyre.
4. Kur urdhërohet masa mbrojtëse për të dëmtuarin, dëshmitarin bashkëpunues apo

dëshmitarin, pala që ka paraqitur kërkesën mund të kërkojë ndryshimin e masës mbrojtëse. Vetëm gjyqtari kompetent në këtë fazë të procedurës mund t'i ndryshojë apo anulojë urdhrat, ose të autorizojë dhënien e materialit të mbrojtur një gjyqtari tjetër për ta përdorur në procedura të tjera. Nëse në kohën kur bëhet kërkesa për ndryshim apo heqje gjykata fillestare nuk ka më kompetencë mbi rastin, gjyqtari kompetent i gjykatës që ka kompetencë mund të urdhërojë ndryshimin apo heqjen e tillë pasi të ketë njoftuar me shkrim dhe të ketë dëgjuar çfarëdo argumenti të prokurorit të shtetit.

Neni 223
Urdhri për anonimitet nga publiku

1. Kur masat mbrojtëse nga neni 222, paragrafi 1. i këtij Kodi janë të pamjaftueshme për të garantuar mbrojtjen e dëshmitarit i cili është propozuar nga mbrojtja, në rrethana të jashtëzakonshme gjyqtari kompetent mund të urdhërojë anonimitet, ku dëshmitari të cilin e ka propozuar mbrojtja mbetet anonim për publikun, të dëmtuarin dhe përfaqësuesit e tij ligjorë ose përfaqësuesit e autorizuar.
2. Para marrjes së urdhrit për anonimitet, gjyqtari kompetent mban seancë dëgjimore me dyer të mbyllura, në të cilën merren në pyetje dëshmitari përkatës dhe personat tjerë të nevojshëm, siç janë personeli policor dhe personeli ushtarak që kujdesen për sigurinë. Përveç këtyre personave, të pranishëm mund të jenë vetëm prokurori i shtetit, personeli i domosdoshëm i gjykatës e i prokurorisë dhe mbrojtësi.
3. Gjyqtari kompetent mund të nxjerrë urdhër për anonimitet vetëm kur ai çmon se:
   3.1. ekziston rrezik serioz për dëshmitarin ose anëtarin e familjes së tij dhe anonimiteti i plotë i dëshmitarit është i nevojshëm për të parandaluar rrezikun e tillë serioz;
   3.2. dëshmia e dëshmitarit është e rëndësishme për çështjen sa që e bën të padrejtë realizimin e mbrojtjes pa të;
   3.3. besueshmëria e dëshmitarit është hetuar dhe zbuluar plotësisht për gjyqtarin në seancë të mbyllur; dhe
   3.4. nevoja për anonimitetin e dëshmitarit është më e rëndësishme për vënien e drejtësisë se sa interesi i publikut apo të dëmtuarit për ta ditur identitetin e dëshmitarit në zbatimin e procedurës.

Neni 224
Urdhri për anonimitet prej të pandehurit

1. Kur masat mbrojtëse të parapara në neni 222, paragrafi 1. i këtij Kodi janë të pamjaftueshme për të garantuar mbrojtjen e të dëmtuarit, dëshmitarit bashkëpunues ose të dëshmitarit i cili nuk është propozuar nga mbrojtja, gjyqtari kompetent në rrethana të jashtëzakonshme mund të marrë urdhër për anonimitet me të cilin i dëmtuari, dëshmitari bashkëpunues ose dëshmitari mbetet anonim për të pandehurin dhe mbrojtësin.
2. Prokurori i shtetit kërkon urdhër për anonimitet prej të pandehurit vetëm me propozim me shkrim të mbyllur ku paraqiten fakte të cilat tregojnë se:
   2.1. ekziston rrezik serioz për të dëmtuarin, dëshmitarin bashkëpunues ose dëshmitarin për të cilin kërkohet urdhri për anonimitet; dhe

2.2. anonimiteti do të parandalonte rrezikun serioz për të dëmtuarin, dëshmitarin bashkëpunues ose dëshmitarin.

3. Gjykata nuk lëshon urdhër nga ky nen bazuar në kërkesën nga paragrafi 2. i këtij neni e cila bazohet në përshkrim të përgjithshëm të rreziqeve që i kanosen dëshmitarëve në raste të ngjashme.
4. Para se të merret urdhër për anonimitet, gjyqtari kompetent zbaton seancë dëgjimore me dyer të mbyllura, në të cilën merren në pyetje i dëmtuari, dëshmitari bashkëpunues ose dëshmitari në fjalë dhe personat tjerë të nevojshëm siç është personeli policor ose ushtarak që kujdesen për rendin. Përveç këtyre personave, të pranishëm mund të jenë vetëm prokurori i shtetit, personeli i domosdoshëm i gjykatës dhe i prokurorisë.
5. Gjyqtari kompetent mund të nxjerrë urdhër të tillë për anonimitet vetëm kur ai çmon se:
   5.1. ekziston rrezik serioz për të dëmtuarin, dëshmitarin bashkëpunues ose dëshmitarin apo anëtarin e familjes së tij dhe anonimiteti i plotë i të dëmtuarit, dëshmitarit bashkëpunues ose dëshmitarit është i nevojshëm për të parandaluar rrezikun e tillë serioz;
   5.2. dëshmia e të dëmtuarit, dëshmitari bashkëpunues ose dëshmitarit është e rëndësishme për çështjen sa që e bën të padrejtë realizimin e ndjekjes pa të;
   5.3. besueshmëria e të dëmtuarit, dëshmitarit bashkëpunues ose dëshmitarit është hetuar dhe zbuluar plotësisht për gjyqtarin kompetent në seancë të mbyllur; dhe
   5.4. nevoja për anonimitetin e të dëmtuarit, dëshmitarit bashkëpunues ose dëshmitarit është më e rëndësishme për vënien e drejtësisë se sa interesi i të pandehurit për ta ditur identitetin e të dëmtuarit, dëshmitarit bashkëpunues apo dëshmitarit në zbatimin e mbrojtjes.

Neni 225
Forma e urdhrit për anonimitet

1. Urdhri për anonimitet duhet bërë me shkrim dhe nuk përmban ndonjë informacion që mund të çojë në zbulimin e identitetit të të dëmtuarit, dëshmitarit bashkëpunues, dëshmitarit apo anëtarit të familjes së tij, ose që do të mund të zbulonte ekzistimin ose do të ekspozonte ndaj një rreziku serioz sigurinë operacionale të hetimit të fshehtë të policisë.
2. Të dhënat nga procesverbali i seancës së mbyllur hiqen nga procesverbali, mbyllen dhe ruhen si fshehtësi zyrtare menjëherë pas identifikimit dhe para marrjes në pyetje të të dëmtuarit, dëshmitarit bashkëpunues ose dëshmitarit.
3. Të dhënat e kufizuara mund të inspektohen dhe të përdoren nga prokurori i shtetit dhe gjyqtari kompetent vetëm në procedurën e ankimit kundër urdhrit të shqiptuar nga neni 223 ose 224 të këtij Kodi. Ankesa kundër urdhrit për anonimitet dhe përdorimi i metodave për të parandaluar zbulimin e identitetit ndaj publikut, të dëmtuarit, dëshmitarëve, mbrojtësit dhe të pandehurit mund t'i paraqitet kolegjit shqyrtues kur urdhri është dhënë nga gjyqtari i procedurës paraprake. Në të kundërtën, mund të ushtrohet ankesë vetëm kundër aktgjykimit.

Neni 226
Ndalimi i parashtrimit të pyetjeve që mund të zbulojnë identitetin

Gjykata ndalon të gjitha pyetjet, përgjigja e të cilave mund të zbulojë identitetin e të dëmtuarit, dëshmitarit bashkëpunues ose të dëshmitarit të mbrojtur me masa mbrojtëse apo të dhëna të kufizuara.

Neni 227
Mbrojtja e dëshmitarëve

Masat e veçanta dhe të jashtëzakonshme, mënyrat dhe procedurat për mbrojtje të dëshmitarëve dhe dëshmitarët bashkëpunues rregullohen me Ligjin për Mbrojtje të Dëshmitarëve, Ligji nr. 04/L-015.

Neni 228
Masat tjera mbrojtëse në rastet e dhunës në familje

Masat mbrojtëse në rastet e dhunës në familje para gjykatës themelore rregullohen me Ligjin për Mbrojtje nga Dhuna në Familje, Ligji nr. 03/L-182.

KAPITULLI XIV
PROCEDURAT ALTERNATIVE

Neni 229
Procedurat alternative

Prokurori i shtetit shqyrton dhe shfrytëzon procedurat alternative nga ky kapitull ose diversionin nga neni 184 i këtij Kodi kur procedura e tillë apo diversioni është në pajtim me detyrat dhe kompetencat e prokurorit të shtetit nga neni 49 i këtij Kodi.

Neni 230
Pezullimi i përkohshëm i procedurës

1. Prokurori i shtetit, me pëlqimin e të dëmtuarit mund të pezullojë ndjekjen për vepër penale të dënueshme me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet, duke pasur parasysh natyrën, rrethanat dhe karakterin e veprës penale dhe të kryerësit, nëse i pandehuri zotohet se do të sillet siç është udhëzuar nga prokurori i shtetit dhe se do t'i përmbushë detyrimet e caktuara që pakësojnë ose mënjanojnë pasojat e dëmshme të veprës penale, duke përfshirë:
   1.1. eliminimin ose kompensimin e dëmit;
   1.2. pagesën e një kontributi ndaj një institucioni publik ose humanitar apo të fondeve për kompensimin e dëmit të viktimave të veprave penale; ose
   1.3. kryerjen e punës në interes të përgjithshëm.
2. Nëse brenda një afati prej jo më shumë se gjashtë (6) muajsh i pandehuri i përmbush detyrimet, kallëzimi penal hudhet ose pushohet hetimi.
3. Kur i pandehuri nuk i ndërmerr veprimet në pajtim me paragrafin 1. të këtij neni, prokurori i shtetit mund të rifillojë ndjekjen e veprës penale.

4. Në rastet e dhunës në familje ose dhunës seksuale ky nen nuk zbatohet.

Neni 231
Kushtet kur ndjekja nuk është e detyrueshme

1. Prokurori i shtetit nuk detyrohet të fillojë ndjekjen penale ose mund të heqë dorë nga ndjekja:
   1.1. kur ligji penal parasheh që gjykata mund ta lirojë nga dënimi kryerësin e veprës penale dhe prokurori i shtetit çmon se nga aspekti i rrethanave aktuale të çështjes vetëm gjykimi pa sanksion nuk është i nevojshëm; ose
   1.2. kur kryerësi i veprës penale të dënueshme me gjobë ose burgim deri në një (1) vit sinqerisht pendohet për veprën penale dhe ndalon pasojat e dëmshme ose bën kompensimin e dëmit, kurse prokurori i shtetit çmon se nga aspekti i rrethanave të çështjes sanksioni penal nuk do të ishte i arsyeshëm.

Neni 232
Procedura e ndërmjetësimit

1. Prokurori i shtetit mund ta dërgojë kallëzimin penal për një vepër penale të dënueshme me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet për ndërmjetësim. Para se të veprojë kështu, prokurori i shtetit merr parasysh llojin dhe natyrën e veprës, rrethanat në të cilat ajo është kryer, personalitetin e kryerësit dhe dënimet e mëparshme të tij për të njëjtën vepër penale apo për vepra penale të ndryshme, si dhe nivelin e përgjegjësisë penale të tij.
2. Ndërmjetësimi bëhet nga ndërmjetësi i pavarur. Ndërmjetësi detyrohet ta pranojë çështjen e dërguar nga prokurori i shtetit dhe të ndërmarrë masa për të siguruar se përmbajtja e marrëveshjes është në proporcion me seriozitetin dhe pasojat e veprës.
3. Marrëveshja mund të arrihet përmes ndërmjetësimit vetëm me pëlqimin e të pandehurit dhe të dëmtuarit.
4. Me marrjen e njoftimit për arritjen e marrëveshjes, prokurori i shtetit e hudh kallëzimin penal. Ndërmjetësi detyrohet të informojë prokurorin e shtetit për dështim në arritjen marrëveshjes dhe për arsyet e dështimit të tillë. Kohëzgjatja për arritje të marrëveshjes nuk mund të kalojë tre (3) muaj.
5. Procedura mbi zbatimin e ndërmjetësimit zbatohet përshtatshmërisht sipas dispozitave të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve, dhe Ligjin për ndërmjetësim.

Neni 233
Negocimi i marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë

1. Në çdo kohë para ngritjes së aktakuzës, prokurori i shtetit dhe mbrojtësi mund të negociojnë kushtet e marrëveshjes së shkruar për pranimin e fajësisë, në bazë të së cilës i pandehuri dhe prokurori i shtetit pajtohen për akuzat e përfshira në aktakuzë dhe i pandehuri pajtohet të pranojë fajësinë në shkëmbim për:
   1.1. pajtimin e prokurorit të shtetit që t'i rekomandojë gjykatës dënim më të butë, por jo nën minimumin e paraparë me ligj ose minimumin e përcaktuar në paragrafin 7. të këtij neni; ose

1.2. konsiderime tjera në interes të drejtësisë, siç është lirimi nga dënimi sipas nenit 234 të këtij Kodi.

2. Në çdo kohë pas ngritjes së aktakuzës dhe para përfundimit të shqyrtimit gjyqësor, prokurori i shtetit dhe mbrojtësi mund të negociojnë kushtet e marrëveshjes së shkruar për pranimin e fajësisë, në bazë të së cilës i pandehuri pranon fajësinë në shkëmbim për:
   2.1. pajtimin e prokurorit të shtetit që t'i rekomandojë gjykatës dënim më të butë, por jo nën minimumin e parashikuar me ligj ose minimumin e përcaktuar në paragrafin 7. të këtij nenin; ose
   2.2. konsiderime tjera në interes të drejtësisë, siç është lirimi nga dënimi sipas nenit 234 të këtij Kodi.
3. Në rastet kur i pandehuri dëshiron të arrijë marrëveshje mbi pranimin e fajësisë, mbrojtësi i të pandehurit, ose i pandehuri nëse nuk përfaqësohet nga mbrojtësi, kërkon nga prokurori i shtetit një takim paraprak për të filluar negocimin për marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë. Në të gjitha negociatat e tilla, i pandehuri duhet të përfaqësohet nga mbrojtësi, në pajtim me paragrafin 1. të këtij neni.
4. Pas pranimit të kërkesës për takim paraprak, prokurori i shtetit informon kryeprokurorin e zyrës së tij përkatëse, i cili jep autorizim me shkrim për mbajtjen e takimit për diskutimet mbi pranimin e fajësisë, në të cilin deklaratave të të pandehurit do t'i jepet imunitet i kufizuar, siç parashihet me paragrafin 11. të këtij neni. Të gjitha marrëveshjet mbi pranimin e fajësisë duhet të jenë në formë të shkruar dhe të pranuara nga kryeprokurori i zyrës përkatëse të prokurorisë para se formalisht t'i ofrohen të pandehurit.
5. Në rastet kur prokurori i shtetit dëshiron të arrijë marrëveshje mbi pranimin e fajësisë, prokurori i shtetit merr miratimin e kryeprokurorit të zyrës së tij përkatëse për të filluar negociatat për marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë. Pas miratimit nga kryeprokurori i zyrës së tij përkatëse, prokurori i shtetit:
   5.1. i dërgon letër mbrojtësit të të pandehurit në të cilën përshkruhet marrëveshja e ofruar, përfshirë kushtet e përcaktuara në paragrafin 12. të këtij neni; ose
   5.2. takohet me mbrojtësin dhe të pandehurin për të negociuar mundësinë dhe kushtet e marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë. Paragrafi 4. i këtij neni zbatohet përshtatshmërisht.
6. Marrëveshja me shkrim mbi pranimin e fajësisë mund të përfshijë dispozitën që prokurori i shtetit, në pajtim me nenin 236 të këtij Kodi, do të kërkojë nga gjykata dhënien e urdhrit që të shpall të pandehurin si "dëshmitar bashkëpunues", siç përkufizohet në nenin 235 të këtij Kodi. Nëse i pandehuri i ndihmon si dëshmitar bashkëpunues, prokurori i shtetit do t'i rekomandojë gjykatës një dënim më të butë në pajtim me paragrafin 7. të këtij neni që reflekton nivelin e ndihmës dhe bashkëpunimit të dhënë nga i pandehuri, duke pasur parasysh shkallën e rrezikshmërisë së veprës penale.
7. Në pajtim me marrëveshjen me shkrim mbi pranimin e fajësisë, prokurori i shtetit mund të rekomandojë dënim më të butë nga paragrafi 1. nën-paragrafi 1.1., paragrafi 2. nën-paragrafi 2.1. dhe paragrafi 6. të këtij neni por vetëm deri në atë shkallë që lejohet sipas formulimit të mëposhtëm:
   7.1. për marrëveshjet mbi pranimin e fajësisë të arritura në shqyrtim gjyqësor, i pandehuri mund të dënohet së paku 90% të minimumit të dënimit të përcaktuar me dispozitat përkatëse të Kodit Penal.

7.2. për marrëveshjet mbi pranimin e fajësisë të arritura para shqyrtimit gjyqësor, i pandehuri mund të dënohet së paku 80% të minimumit të dënimit të përcaktuar me dispozitat përkatëse të Kodit Penal.

7.3. për marrëveshjet mbi pranimin e fajësisë të arritura para shqyrtimit gjyqësor, në rastet kur i pandehuri merr pjesë si dëshmitarë bashkëpunues dhe siguron prova në procedurë penale, i pandehuri mund të dënohet së paku 60% të minimumit të dënimit të përcaktuar me dispozitat përkatëse të Kodit Penal.

7.4. për marrëveshjet mbi pranimin e fajësisë të arritura para shqyrtimit gjyqësor, në rastet kur i pandehuri merr pjesë si dëshmitarë bashkëpunues në hetim të fshehtë dhe siguron prova në procedurë penale, i pandehuri mund të dënohet së paku 40% të minimumit të dënimit të përcaktuar me dispozitat përkatëse të Kodit Penal.

8. I pandehuri dhe mbrojtësi i tij duhet të jenë të pranishëm gjatë takimeve mbi negocimin e pranimit të fajësisë dhe duhet të pajtohen me kushtet e marrëveshjes me shkrim mbi pranimin e fajësisë para se ajo ti paraqitet gjykatës. Kur i pandehuri nuk merr pjesë si dëshmitarë bashkëpunues, zbatohen kushtet e mëposhtme. Prokurori i shtetit informon të dëmtuarin për marrëveshjen e arritur, pasi që marrëveshja të jetë në formën përfundimtare. Kur i dëmtuari ka paraqitur kërkesë pasurore juridike që rrjedh nga vepra penale e cekur ne aktakuzë, marrëveshja mbi pranimin e fajësisë duhet ta adresojë kërkesën e të dëmtuarit dhe prokurori i shtetit duhet të njoftojë të dëmtuarin se i pandehuri kërkon të arrijë marrëveshje mbi pranimin e fajësisë. Të dëmtuarit duhet t'i jepet rasti që t'i paraqesë deklaratë gjykatës mbi kërkesën e tillë pasurore juridike para se gjykata ta pranojë marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë.
9. Kur i pandehuri merr pjesë si dëshmitar bashkëpunues, prokurori i shtetit siguron që kërkesa pasurore juridike e të dëmtuarit të trajtohet me marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë. Kur i dëmtuari ka paraqitur kërkesë pasurore juridike që rrjedh nga vepra penale e cekur ne aktakuzë, marrëveshja mbi pranimin e fajësisë duhet ta trajtoj kërkesën e të dëmtuarit. Të dëmtuarit duhet t'i jepet rasti që t'i paraqesë deklaratë gjykatës mbi kërkesën e tillë pasurore juridike para se gjykata t'i shqiptojë dënimin të pandehurit sipas marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë.
10. Gjykata nuk merr pjesë në negocimin e pranimit të fajësisë, por mund të caktoj afat të arsyeshëm kohor, jo më të gjatë se tre (3) muaj, për përfundimin e negociatave në mënyrë që të pengohen zvarritja e procedurës.
11. Në çdo kohë para se gjykata të pranojë marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë, prokurori i shtetit ose i pandehuri mund të refuzojnë marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë dhe gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues do të caktoj shqyrtimin gjyqësor siç parashihet me Kapitullin XIX të këtij Kodi. Në qoftë se prokurori i shtetit dhe mbrojtësi apo i pandehuri nuk arrijnë marrëveshje mbi pranimin e fajësisë, ose nëse marrëveshja nuk pranohet nga gjykata, deklaratat e të pandehurit të dhëna gjatë negocimit të pranimit të fajësisë, siç parashihet në paragrafët 3., 4. dhe 5. të këtij neni janë provë e papranueshme në shqyrtim gjyqësor ose në procedurë tjetër të ndërlidhur.
12. Marrëveshja me shkrim mbi pranimin e fajësisë duhet të përmbajë të gjitha kushtet e marrëveshjes, e cila duhet të jetë e nënshkruar nga kryeprokurori i zyrës përkatëse, mbrojtësi dhe i pandehuri, dhe është detyruese për të gjitha palët nënshkruese. Marrëveshja mbi pranimin e fajësisë duhet së paku të përfshijë:

12.1. pikat e aktakuzës për të cilat i pandehuri pranon fajësinë;
12.2. nëse i pandehuri pranon të bashkëpunojë;
12.3. të drejtat nga të cilat hiqet dorë;
12.4. përgjegjësia e të pandehurit për kompensimin e të dëmtuarit dhe konfiskimi i të gjitha pasurive të cilat i nënshtrohen konfiskimit nga Kapitulli XVIII i këtij Kodi.

13. Marrëveshja po ashtu mund të përfshijë dispozitën ku palët pajtohen për kufijtë e dënimit që do të propozohet nga ana e prokurorit të shtetit nëse i pandehuri bashkëpunon substancialisht, ndërsa nëse gjykata shqipton dënim jashta këtyre kufijve në dëm të ndonjërës prej palëve, ajo palë ka të drejtë ankese kundër vendimit mbi dënimin.
14. Marrëveshja me shkrim mbi pranimin e fajësisë i paraqitet gjykatës në seance dëgjimore të hapur për publikun, përveç në rastet e përcaktuara në paragrafin 16. të këtij neni.
15. Nëse marrëveshja me shkrim mbi pranimin e fajësisë negociohet para ngritjes së aktakuzës, kundër të pandehurit i cili ka arritur marrëveshje paraqitet aktakuzë e veçantë në të njëjtën kohë me marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë. Të dy këto mund të paraqiten në zarf të mbyllur dhe të vulosur. Shqyrtimi fillestar para gjyqtarit të vetëm gjykues ose kryetarit të trupit gjykues mund të shërbejë gjithashtu si seancë dëgjimore nga ky nen.
16. Gjykata zyrtarisht mund ta pranoj apo refuzoj marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë në pajtim me kushtet që duhet të merren parasysh nga paragrafi 18. i këtij neni. Marrëveshja mbi pranimin e fajësisë hyn në fuqi vetëm pasi që të evidentohet në procesverbal se është pranuar zyrtarisht nga gjykata.
17. Nëse i pandehuri pajtohet të jetë dëshmitarë bashkëpunues dhe kur masat e parapara në Kapitullin XIII të këtij Kodi i janë siguruar atij, pas kërkesës së cilësdo palë, gjykata mund të urdhërojë që seanca dëgjimore për shqyrtimin e marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë të jetë e mbyllur për publik dhe mund të urdhërojë që marrëveshja me shkrim për pranim të fajësisë të jetë e mbyllur.
18. Gjatë shqyrtimit se a duhet pranuar marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë, gjykata duhet të dëgjoj të pandehurin, mbrojtësin e tij dhe prokurorin e shtetit dhe të përcaktojë nëse:
    i pandehuri ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë;
    18.1. pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga i pandehuri pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësin e tij, nëse ka mbrojtës, dhe se i pandehuri nuk ka qenë i detyruar ose i shtrënguar në asnjë mënyrë që të pranojë fajësinë;
    18.2. pranimi i fajësisë mbështetet në fakte dhe prova materiale të rastit konkret, të cilat paraqiten në aktakuzë, apo me provat materiale të paraqitura nga prokurori për plotësimin e aktakuzës dhe të pranuara nga i pandehuri, si dhe me dëshmi tjera, siç mund të jenë deklaratat e dëshmitarëve të paraqitura nga prokurori apo i pandehuri; dhe
    18.3. nuk ekzistojnë asnjë nga rrethanat e parapara në nenin 253, paragrafët 1. dhe 2. të këtij Kodi.
19. Me rastin e shqyrtimit të marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë, gjykata duhet të dëgjojë pikëpamjet e prokurorit të shtetit, mbrojtësit dhe të dëmtuarit. Nëse marrëveshja e të pandehurit për bashkëpunim dhe pranim të fajësisë është e mbyllur

në pajtim me paragrafin 17. të këtij neni, gjykata i lejon të dëmtuarit të jep deklaratë në përfundim të bashkëpunimit të të pandehurit, para shqiptimit të dënimit.

20. Nëse gjykata nuk bindet se janë përmbushur të gjitha kushtet e parapara në paragrafin 18. të këtij neni, gjykata refuzon marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë dhe rasti vazhdon në gjykim të rregullt ashtu siç parashihet me këtë Kod.
21. Nëse gjykata bindet se janë përmbushur të gjitha kushtet e parapara në paragrafin 18. të këtij neni, gjykata pranon marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë dhe urdhëron që marrëveshja të vendoset në shkresat e lëndës në gjykatë. Gjykata cakton datën kur palët do të japin deklaratat e tyre në lidhje me dënimin, pas së cilës gjykata shqipton dënimin. Megjithatë, kjo datë mund të shtyhet në mënyrë që i pandehuri të shërbejë si dëshmitar bashkëpunues.
22. Pas pranimit të marrëveshjes me shkrim mbi pranimin e fajësisë nga gjykata, por para shqiptimit të dënimit, gjykata mund të mos i lejojë të pandehurit tërheqjen e pranimit të fajësisë ose mund të mos i lejojë prokurorit që të tërheq marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë, përveç nëse gjykata çmon se ndonjë prej kushteve nga paragrafi 18. i këtij neni nuk është përmbushur. Pala e cila kërkon të tërhiqet nga marrëveshja ka barrën e të provuarit gjatë parashtrimit të kërkesës së tillë në gjykatë.

Neni 234
Lirimi nga dënimi

1. Me kërkesë të prokurorit të shtetit, gjykata mund të lirojë nga dënimi kryerësin i cili nuk është dëshmitarë bashkëpunues, ose këtë dënim ta ulë në pajtim me nenin 75 të Kodit Penal, kur kryerësi bashkëpunon vullnetarisht dhe kur bashkëpunimi i tij ka parandaluar vepra të tjera penale nga të tjerët ose ka rezultuar me ndjekje të suksesshme të kryerësve të tjerë të veprave penale.
2. Kur kryerësi shpallet fajtor për vepër penale për të cilën mund të shqiptohet dënim me të paktën dhjetë (10) vjet burgim, gjykata nuk e pezullon ose nuk e heq dënimin.

Neni 235
Dëshmitarët bashkëpunues

1. Sipas këtij kapitulli, shprehja “dëshmitar bashkëpunues” do të thotë i dyshuari ose i pandehuri për të cilin ende nuk është lexuar aktakuza në shqyrtimin gjyqësor dhe i cili pritet të dëshmojë në gjykatë kur:
   1.1. ka gjasa të parandalojë vepra të tjera penale nga personi tjetër;
   1.2. ka gjasa të shpie drejt zbardhjes së të vërtetës në procedurën penale;
   1.3. është bërë vullnetarisht dhe me marrëveshje të plotë për të dëshmuar të vërtetën në gjykatë;
   1.4. është vlerësuar nga gjykata si e vërtetë dhe e plotë; ose
   1.5. mund të shpie drejt ndjekjes së suksesshme të kryerësve të tjerë të veprës penale.

Neni 236
Kërkesa për shpalljen e personit dëshmitar bashkëpunues

1. Prokurori i shtetit mund të bëjë kërkesë me shkrim pranë gjykatës për të urdhëruar që personi të shpallet dëshmitar bashkëpunues. Kërkesa përfshin deklaratën e veçantë të pretendimeve faktike nga prokurori i shtetit.
2. Prokurori i shtetit mund të bëjë kërkesë të arsyetuar për urdhër që pretendimet faktike në deklarim të mbahen të fshehta nga palët tjera dhe mbrojtësit e tyre.
3. Gjykata në çdo kohë pas pranimit të kërkesës së prokurorit të shtetit për fshehtësi, mund të urdhërojë fshehtësinë lidhur me pretendimet faktike të përfshira në deklaratë.
4. Çdo shkelje e urdhrit për fshehtësi e bazuar në paragrafin 2. të këtij neni ndiqet nga prokurori i shtetit sipas nenit 202 të Kodit Penal dhe neni 202, paragrafi 2. i Kodit Penal nuk zbatohet.

Neni 237
Procedura për shpalljen e personit dëshmitar bashkëpunues

1. Pas marrjes së kërkesës, gjyqtari i procedurës paraprake, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues dëgjon kërkesën në seancë të mbyllur. Prokurori i shtetit dhe mbrojtësi i dëshmitarit bashkëpunues mund të jenë të pranishëm në seancën dëgjimore për të vlerësuar besueshmërinë e dëshmitarit bashkëpunues dhe për të siguruar plotësimin e kushteve nga neni 235 i këtij Kodi. Deklarimet e bëra te gjyqtari gjatë marrjes në pyetje nuk mund të përdoren në procedurë penale kundër dëshmitarit bashkëpunues ose kundër ndonjë personi tjetër si prova që mbështesin zbulimin e fajësisë.
2. Dispozitat e zbatueshme për marrjen në pyetje të dëshmitarëve zbatohen përshtatshmërisht gjatë marrjes në pyetje të dëshmitarit bashkëpunues dhe marrja në pyetje shënohet në procesverbal në pajtim me dispozitat e këtij Kodi.
3. Në mbyllje të seancës dëgjimore, gjyqtari i procedurës paraprake, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues mund të urdhërojë shpalljen e personit dëshmitar bashkëpunues kur ai çmon se janë plotësuar kriteret për dëshmitar bashkëpunues nga neni 235 i këtij Kodi.
4. Urdhri përcakton:
   4.1. veprat penale, me përshkrimin e veprimeve dhe të kualifikimit të tyre për të cilat urdhërohet ndalimi i fillimit ose i vazhdimit të procedurës penale apo shqiptimi i dënimit;
   4.2. ndalimin e fillimit ose të vazhdimit të procedurës penale kundër dëshmitarit bashkëpunues dhe shqiptimit të dënimit ndaj dëshmitarit bashkëpunues për vepër penale të përcaktuar në urdhër;
   4.3. natyrën dhe përmbajtjen e bashkëpunimit të dhënë nga dëshmitari bashkëpunues; dhe
   4.4. kushtet për revokimin e urdhrit.
5. Gjyqtari i procedurës paraprake, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues nuk lëshojnë urdhër të tillë kur dëshmitari bashkëpunues dyshohet nga prokurori i shtetit ose akuzohet me aktakuzë si organizator apo udhëheqës i grupit prej dy (2) apo më shumë personave të cilët kanë kryer vepër penale.

6. Urdhri nuk e ndalon fillimin apo vazhdimin e procedurës penale kundër dëshmitarit bashkëpunues për vepra penale të kryera pas lëshimit të urdhrit ose për vepra penale që dënohen me të paktën dhjetë (10) vjet burgim.

Neni 238
Revokimi i shpalljes si dëshmitar bashkëpunues

1. Me kërkesë të prokurorit të shtetit, urdhri i paraparë në nenin 237 të këtij Kodi mund të revokohet nga kolegji shqyrtues kur dëshmia e dëshmitarit bashkëpunues vërtetohet si e rreme në ndonjë pjesë të rëndësishme të saj, ose kur dëshmitari bashkëpunues nuk tregon të vërtetën e plotë.
2. Dëshmitari bashkëpunues paralajmërohet për pasojat e dhënies së dëshmisë së rreme në ndonjë pjesë të rëndësishme të saj ose kur qëllimisht nuk e tregon të vërtetën e plotë para se të merret në pyetje nga gjyqtari i procedurës paraprake sipas nenit 237, paragrafi 1. i këtij Kodi dhe para se të dëshmojë nën mbrojtjen e urdhrit. Çdo dëshmim i tillë duhet të jetë ose në formë të shkruar në gjuhën e dëshmitarit bashkëpunues dhe e nënshkruar nga ai për të vërtetuar saktësinë e saj, ose e incizuar në audio apo videotrakë e cila për gjykatën është autentike.

Neni 239
Njoftimi i të pandehurit për identitetin e dëshmitarit bashkëpunues

Të pandehurit kundër të cilit duhet të dëshmojë dëshmitari bashkëpunues i jepet një kopje e urdhrit me të cilin personi i tillë është shpallur dëshmitar bashkëpunues para shqyrtimit gjyqësor të të pandehurit.

KAPITULLI XV
FAZA E NGRITJES SË AKTAKUZËS DHE DEKLARIMIT

Neni 240
Gjykimi penal që zbatohet vetëm pas ngritjes së aktakuzës

1. Pas përfundimit të hetimit ose kur prokurori i shtetit konsideron se informacionet me të cilat ai disponon për veprën penale dhe kryerësin e saj paraqesin dyshim të bazuar mirë se i pandehuri ka kryer vepër penale apo vepra penale, procedura para gjyqit mund të zbatohet vetëm në bazë të aktakuzës së ngritur nga prokurori i shtetit.
2. Nëse hetimi ka përfunduar dhe nuk ka prova të mjaftueshme për të mbështetur dyshimin e bazuar mirë se i pandehuri ka kryer vepër penale ose vepra penale, prokurori i shtetit nxjerr aktvendim për pushimin e hetimit.

Neni 241
Aktakuza

1. Aktakuza përmban:
   1.1. përcaktimin e gjykatës ku do të mbahet shqyrtimi gjyqësor;

1.2. emrin dhe mbiemrin e të pandehurit dhe të dhënat e tij personale;
1.3. të dhënat nëse është shqiptuar paraburgimi dhe sa kohë ka zgjatur ose masat e urdhëruara kundër të pandehurit për sigurimin e pranisë së tij, nëse ai ndodhet në liri dhe nëse ai është liruar para ngritjes së aktakuzës, sa është mbajtur në paraburgim.
1.4. kohën dhe vendin e kryerjes së veprës penale, objektin në të cilin është kryer dhe mjetin me të cilin është kryer vepra penale, si dhe rrethanat tjera të nevojshme për të përcaktuar me saktësi veprën penale;
1.5. emërtimin ligjor të veprës penale duke i'u referuar dispozitave të Kodit Penal;
1.6. Rekomandimin për provat që duhet prezentuar në shqyrtimin gjyqësor së bashku me emrat e dëshmitarëve dhe ekspertëve, shkresat që duhet lexuar dhe sendet që duhet marrë si provë.
1.7. Shpjegimin e arsyeve për ngritjen e aktakuzës bazuar në rezultatet e hetimit dhe provat që vërtetojnë faktet kryesore;
1.8. Nëse është zbatuar mundësia hetuese e veçantë, në aktakuzë duhet të ceken emrat e gjyqtarëve të kolegjit që ka drejtuar mundësinë hetuese të veçantë.
1.9. Aktakuza përcakton me saktësi çdo ndërtesë, pasuri të paluajtshme, pasuri të luajtshme, fonde apo pasuri tjera që mund t'i nënshtrohen konfiskimit. Aktakuza po ashtu përshkruan provat e nevojshme që kërkohen për të arsyetuar konfiskimin nga Kapitulli XVIII i këtij Kodi.

2. Nëse i pandehuri gjendet në liri, prokurori i shtetit në aktakuzë mund të propozojë që të jepet urdhri për paraburgim, e kur i pandehuri gjendet në paraburgim, prokurori i shtetit mund të propozojë që ai të lirohet.
3. Një aktakuzë mund të ngritët për disa vepra të ndryshme penale ose ndaj disa të pandehurve vetëm kur në pajtim me nenin 35 të këtij Kodi mund të zbatohet procedura e përbashkët.

Neni 242
Procedura për ngritjen e aktakuzës

1. Aktakuza i paraqitet gjykatës kompetente në aq kopje sa ka të pandehur dhe mbrojtës të tyre dhe një kopje shtesë për gjykatën. Gjithashtu, gjykatës i dërgohet edhe lënda komplete e hetimit nga prokurori i shtetit.
2. Gjykata cakton gjyqtarin ose trupin gjykues me kryetarin e tijnëpërmjet një procesi transparent e të drejtë për caktimin e çështjeve, ashtu siç duhet. Nëse është zbatuar mundësia hetuese e veçantë, njëri nga gjyqtarët e kolegjit caktohet si gjyqtar i vetëm gjykues ose si kryetar i trupit gjykues ose si anëtar i trupit gjykues.
3. Gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues përcakton sipas detyrës zyrtare nëse ka kompetencë mbi çështjen që përbën aktakuzën.
4. Gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues cakton menjëherë shqyrtimin fillestar, i cili duhet të mbahet brenda tridhjetë (30) ditëve pas ngritjes së aktakuzës.
5. Nëse i pandehuri është në mbajtje në paraburgim, shqyrtimi fillestar mbahet në mundësinë e parë, jo më vonë se pesëmbëdhjetë (15) ditë pas ngritjes së aktakuzës.
6. Gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues njofton prokurorin e shtetit, të pandehurit dhe mbrojtësit e tyre për kohën dhe vendin e mbajtjes së shqyrtimit fillestar.

Neni 243
Shkresat që plotësojnë aktakuzën

1. Në të njëjtën kohë me paraqitjen e aktakuzës, prokurori i shtetit paraqet edhe dokumentet e mëposhtme kur është e nevojshme:
   1.1. prokurori i shtetit paraqet mbështetjen e pohimit nga neni 263 të këtij Kodi së bashku me deklaratat e marra nga neni 132 të këtij Kodi apo provat e siguruara nga neni 219, paragrafi 6. të këtij Kodi të cilat synon ti paraqesë si prova të drejtpërdrejta pa praninë e dëshmitarëve. Mbështetja e pohimit përshkruan provat e pavarura që vërtetojnë deklaratat të cilat prokurori i shtetit synon t'i paraqesë si prova të drejtpërdrejta. Kjo mbështetje e pohimit mund të plotësohet ose të paraqitet në një kohë më të vonshme nëse dëshmitari për të cilin zbatohet kjo dispozitë nuk është më në dispozicion për të dëshmuar në shqyrtim gjyqësor.
   1.2. prokurori i shtetit paraqet kërkesë për të vazhduar apo për të zbatuar ndonjë nga masat për sigurimin e pranisë së të pandehurit. Nenet 173 deri 193 të këtij Kodi zbatohen përshtatshmërisht për çfarëdo kërkese nga ky paragraf.
2. Prokurori i shtetit mund të paraqesë mbështetje të pohimit apo kërkesa nga ky nen edhe më pas nëse nuk ka mundur ta dijë bazën për paraqitjen e njoftimit apo kërkesës në kohën kur është ngritur aktakuza.

Neni 244
Materialet të cilat i jepen të pandehurit me ngritjen e aktakuzës

1. Jo më vonë se nga ngritja e aktakuzës, prokurori i shtetit i siguron mbrojtësit apo mbrojtësit kryesor materialet e mëposhtme ose kopjen e tyre të cilat janë në posedim, në kontroll ose në mbrojtje të tij, nëse këto materiale nuk i janë dhënë mbrojtësit gjatë hetimit:
   1.1. procesverbalet mbi deklarimet ose pohimet, të nënshkruara apo të panënshkruara nga i pandehuri;
   1.2. emrat e dëshmitarëve të cilët prokurori i shtetit ka ndërmend t'i thërret për dëshmim dhe çdo deklarim të mëhershëm të dhënë nga dëshmitarët e tillë;
   1.3. të dhënat mbi identifikimin e personave për të cilët prokurori i shtetit e di se posedojnë prova të pranueshme dhe shfajësuese ose informata lidhur me çështjen dhe çdo procesverbal të deklarimeve, të nënshkruar apo të panënshkruar nga personat e tillë për këtë çështje;
   1.4. rezultatet e ekzaminimit fizik dhe mendorë, testet shkencore ose eksperimentet e bëra lidhur me çështjen;
   1.5. kallëzimet penale dhe raportet e policisë; dhe
   1.6. përmbledhjet ose referencat për provat materiale të mbledhura gjatë hetimit.
2. Deklarimet e dëshmitarëve i vihen në disponim të pandehurit në gjuhën që ai e kupton dhe e flet.
3. Pas ngritjes së aktakuzës, prokurori i shtetit i siguron mbrojtësit çfarëdo materiali të ri të paraparë në paragrafin 1. të këtij neni brenda dhjetë (10) ditëve nga pranimi i tyre.
4. Për dispozitat e këtij neni vlejnë masat për mbrojtjen e të dëmtuarit, dëshmitarëve, të privatësisë së tyre dhe të dhënave konfidenciale, siç parashihet me ligj.

Neni 245
Shqyrtimi fillestar

1. Gjatë shqyrtimit fillestar duhet të jenë të pranishëm prokurori i shtetit, i pandehuri apo të pandehurit dhe mbrojtësit.
2. Gjatë shqyrtimit fillestar, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues i jep kopjen e aktakuzës të pandehuri apo të pandehurve, nëse ata nuk i kanë pranuar këto kopje të aktakuzës më parë.
3. Gjatë shqyrtimit fillestar, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupi gjykues vendos për të gjitha propozimet për të vazhduar apo zbatuar masat për sigurinë e pranisë së të pandehurit.
4. Gjatë shqyrtimit fillestar, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues siguron që prokurori i shtetit të ketë përmbushur detyrimet që kanë të bëjnë me zbulimin e provave nga neni 244 i këtij Kodi.
5. Gjatë shqyrtimit fillestar, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues cakton shqyrtimin e dytë jo më herët se tridhjetë (30) ditë pas shqyrtimit fillestar dhe jo më vonë se dyzet (40) ditë pas shqyrtimit fillestar. Në të kundërtën, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues mund të kërkojë vetëm paraqitjen e propozimeve deri në datën e caktuar e cila nuk mund të jetë më vonë se tridhjetë (30) ditë nga shqyrtimi fillestar.
6. Gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues njofton të pandehurin dhe mbrojtësin se para shqyrtimit të dytë, ata duhet që:
   6.1. të paraqesin kundërshtimet e tyre për provat e cekura në aktakuzë;
   6.2. të paraqesin kërkesat për hudhjen e aktakuzës nëse është e ndalur ligjërisht; dhe
   6.3. të paraqesin kërkesat për hudhjen e aktakuzës për shkak të mospërshkrimit të veprës penale sipas ligjit.
7. Asnjë dëshmitar apo ekspert nuk merret në pyetje dhe asnjë provë nuk paraqitet gjatë shqyrtimit fillestar, përveç nëse dëshmitari është i nevojshëm për marrjen e vendimit mbi vazhdimin ose zbatimin e masave për të siguruar praninë e të pandehurit nga paragrafi 3. të këtij neni.

Neni 246
Pranimi i fajësisë

1. Në fillim të shqyrtimit fillestar, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupi gjykues e udhëzon të pandehurin për të drejtën e tij për të mos u deklaruar në çështjen e tij ose të mos përgjigjet në pyetje dhe nëse ai deklaron për çështjen, se nuk ka për detyrë të inkriminojë vetveten ose të afërmin, as të pranojë fajësinë; të mbrohet vetë ose nëpërmjet ndihmës juridike nga mbrojtësi sipas zgjedhjes së tij; të kundërshtojë aktakuzën dhe pranueshmërinë e provave të paraqitura në aktakuzë.
2. Gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupi gjykues pastaj çmon nëse e drejta e të pandehurit në mbrojtës është respektuar dhe nëse prokurori i shtetit ka përmbushur detyrimet që kanë të bëjnë me zbulimin e provave nga neni 244 i këtij Kodi.
3. Pastaj prokurori i shtetit ia lexon aktakuzën të pandehurit.
4. Pasi që gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupi gjykues bindet se i pandehuri e

kupton aktakuzën, të pandehurit i ofron mundësinë të pranojë fajësinë ose të deklarohet i pafajshëm. Nëse i pandehuri nuk e ka kuptuar aktakuzën, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupi gjykues thërret prokurorin e shtetit që t'ia shpjegojë aktakuzën të pandehurit në mënyrë që ai ta kuptojë pa vështirësi. Nëse i pandehuri nuk dëshiron të bëjë ndonjë deklarim lidhur me fajësinë e tij, konsiderohet se ai nuk e pranon fajësinë.

Neni 247
Marrëveshjet mbi pranimin e fajësisë gjatë shqyrtimit fillestar

1. Nëse marrëveshja mbi pranimin e fajësisë nga neni 233 i këtij Kodi paraqitet së bashku me aktakuzën, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues çmon marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë dhe e pranon atë, e refuzon atë ose cakton shqyrtim të veçantë në pajtim me procedurat nga neni 248 dhe neni 233 të këtij Kodi.
2. Nëse i pandehuri deklarohet i pafajshëm, gjykata nuk mund ta dënojë të pandehurin, përveç nëse i pandehuri e ndryshon deklaratën e tij dhe pranon fajësinë, ose nëse gjykata e shpall fajtor të pandehurin pas shqyrtimit gjyqësor, pavarësisht nga marrëveshja mbi pranimin e fajësisë.
3. Shqyrtimet nga ky kapitull mund të mbahen nën masa të fshehta pas kërkesës së prokurorit të shtetit nga Kapitulli XIII të këtij Kodi.
4. Marrëveshja mbi pranimin e fajësisë nga neni 233 i këtij Kodi ose pranimi i fajësisë nga neni 248 i këtij Kodi mund të shqyrtohen nga gjykata në çdo kohë para përfundimit të shqyrtimit gjyqësor.

Neni 248
Pranimi i fajësisë gjatë shqyrtimit fillestar

1. Kur i pandehuri pranon fajësinë për të gjitha pikat e aktakuzës sipas nenit 246 ose 247 të këtij Kodi, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues përcakton nëse:
   1.1. i pandehuri kupton natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit;
   1.2. pranimi bëhet vullnetarisht nga i pandehuri pas këshillimeve të mjaftueshme me mbrojtësin, nëse i pandehuri ka mbrojtës;
   1.3. pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit për plotësimin e aktakuzës të pranuar nga i pandehuri dhe çdo provë tjetër, siç është dëshmia e dëshmitarëve e paraqitur nga prokurori i shtetit ose i pandehuri; dhe
   1.4. aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.
2. Në vlerësimin e pranimit të fajësisë së të pandehurit, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues mund të kërkojë mendimin e prokurorit të shtetit, mbrojtësit dhe të dëmtuarit.
3. Kur gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues nuk bindet se janë vërtetuar faktet nga paragrafi 1. i këtij neni, ai merr aktvendim me të cilin refuzon pranimin e fajësisë dhe procedon shqyrtimin fillestar sikur pranimi i fajësisë të mos ishte bërë.

4. Kur gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues bindet se janë vërtetuar faktet nga paragrafi 1. i këtij neni, ai merr aktvendim me të cilin pranon pranimin e fajësisë nga i pandehuri dhe vazhdon me shqiptimin e dënimit, caktimin e seancës për vërtetimin e ndonjë fakti relevant për dënimin ose pezullon dënimin deri në përfundimin e bashkëpunimit të të pandehurit me prokurorin e shtetit.
5. I pandehuri i cili nuk pranon fajësinë gjatë shqyrtimit fillestar mund të ndryshojë deklaratën e tij dhe të pranojë fajësinë në çdo kohë. Për cilindo të pandehur që dëshiron të pranojë fajësinë nga ky paragraf, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupi gjykues zbaton përshtatshmërisht shqyrtimin nga ky nen.

Neni 249
Kundërshtimi i provave

1. Para shqyrtimit të dytë, i pandehuri mund të paraqesë kundërshtim ndaj provave të caktuara në aktakuzë, bazuar në këto arsye:
   1.1. provat nuk janë marrë në mënyrë të ligjshme nga policia, prokurori i shtetit ose organi tjetër qeveritar;
   1.2. provat janë në kundërshtim me rregullat nga Kapitulli XVI i këtij Kodi; ose
   1.3. ka bazë të artikulueshme që gjykata të çmojë provën si thelbësisht të pambështetshme.
2. Prokurorit të shtetit i jepet mundësia që t'i përgjigjet kundërshtimit gojarisht ose me shkrim.
3. Për të gjitha provat për të cilat është paraqitur kundërshtim, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues merr aktvendim me shkrim të arsyetuar për lejimin ose përjashtimin e provës.
4. Provat e papranueshme ndahen nga shkresat dhe mbyllen. Provat e tilla mbahen nga gjykata të ndara nga shkresat dhe provat tjera. Provat e papranueshme nuk mund të shqyrtohen apo të shfrytëzohen në procedurë penale, përveç në rastin e ankesës kundër aktvendimit mbi pranueshmërinë.
5. Të gjitha provat kundër të cilave nuk është paraqitur kundërshtim janë të pranueshme në shqyrtim gjyqësor, përveç nëse gjykata sipas detyrës zyrtare përcakton se pranueshmëria e provës së caktuar do të cenonte të drejtat e të pandehurit të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.
6. Secila palë mund të paraqesë ankesë kundër aktvendimit nga paragrafi 3. të këtij neni. Ankesa duhet të bëhet brenda pesë (5) ditëve nga pranimi i aktvendimit me shkrim.

Neni 250
Kërkesa për hudhjen e aktakuzës

1. Para shqyrtimit të dytë, i pandehuri mund të paraqesë kërkesë për hudhjen e aktakuzës, bazuar në këto arsye:
   1.1. vepra për të cilën akuzohet nuk përbën vepër penale;
   1.2. ekzistojnë rrethana të cilat e përjashtojnë përgjegjësinë penale;
   1.3. ka kaluar afati i parashkrimit të veprës penale, vepra penale është e përfshirë në falje ose ekzistojnë rrethana të tjera të cilat e pengojnë ndjekjen; ose

1.4. nuk ka prova të mjaftueshme për të mbështetur një dyshim të bazuar mirë se i pandehuri ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet në aktakuzë.

2. Prokurorit të shtetit duhet t'i jepet mundësia që të përgjigjet ndaj kërkesës gojarisht apo me shkrim.
3. Gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues merr aktvendim me shkrim të arsyetuar me të cilin refuzon kërkesën ose hudh aktakuzën.
4. Secila palë mund të paraqesë ankesë kundër aktvendimit nga paragrafi 3. të këtij neni Ankesa duhet të bëhet brenda pesë (5) ditëve nga pranimi i aktvendimit me shkrim.

Neni 251
Përgjigjet

1. Prokurorit të shtetit i jepet mundësia që të përgjigjet në kundërshtimin nga neni 249 ose në kërkesën nga neni 250 të këtij Kodi.
2. Përgjigja nga paragrafi 1. i këtij neni mund të bëhet gojarisht gjatë shqyrtimit të dytë ose me shkrim.
3. Gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues i jep prokurorit të shtetit kohë prej një (1) javë për të paraqitur përgjigje me shkrim ndaj kundërshtimit nga neni 249 ose kërkesës nga neni 250 të këtij Kodi.
4. Në vend të përgjigjes ndaj kërkesës nga neni 250, prokurori i shtetit mund të paraqesë aktakuzë të ndryshuar nga neni 252 të këtij Kodi.

Neni 252
Aktakuza e ndryshuar

1. Nëse kërkesa e paraqitur nga i pandehuri për hudhjen e aktakuzës nga neni 250 të këtij Kodi mund të rregullohet me ndryshim të aktakuzës, prokurori i shtetit paraqet aktakuzë të ndryshuar në pajtim me nenin 241 të këtij Kodi brenda një (1) jave nga shqyrtimit i dytë.
2. Nëse aktakuza e ndryshuar paraqitet kundër një të pandehuri apo disa të pandehurve, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues cakton shqyrtim fillestar nga neni 245 i këtij Kodi sikurse aktakuza të ishte e re.
3. I pandehuri mund të paraqesë kundërshtime të reja nga neni 249 ose kërkesa nga neni 250 i këtij Kodi por vetëm për ato pjesë të aktakuzës të cilat janë ndryshuar.
4. I pandehuri mund të paraqesë sërish kundërshtimet e mëparshme nga neni 249 ose kërkesat nga neni 250 i këtij Kodi. Nëse i pandehuri nuk i paraqet sërish kundërshtimet apo kërkesat e mëparshme, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues vendosë që ato kundërshtime apo kërkesa nuk janë relevante për aktakuzën e ndryshuar dhe nuk i shqyrtojnë më tej.
5. Prokurori i shtetit mund të ndryshojë aktakuzën një herë, përveç në rastet kur siguron të dhëna të reja që bëjnë të nevojshme ndryshimin e aktakuzës.

Neni 253
Hudhja e aktakuzës

1. Për çdo kërkesë për hudhjen e aktakuzës nga neni 250 i këtij Kodi, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues merr aktvendim për hudhjen e aktakuzës dhe pushimin e procedurës penale kur çmon se:
   1.1. vepra me të cilën akuzohet nuk përbën vepër penale;
   1.2. ekzistojnë rrethana të cilat e përjashtojnë përgjegjësinë penale;
   1.3. ka kaluar afati i parashkrimit të veprës penale, vepra është përfshirë me amnesti apo falje, ose ekzistojnë rrethana të tjera të cilat e pengojnë ndjekjen; ose
   1.4. nuk ka prova të mjaftueshme për të mbështetur një dyshim të bazuar mirë se i pandehuri ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet në aktakuzë.
2. Me rastin e marrjes së aktvendimit nga ky nen, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues nuk detyrohet me cilësimin juridik të veprës penale siç është parashtruar nga prokurori i shtetit në aktakuzë.
3. Në përgjigjen ndaj kërkesës nga neni 250, prokurori i shtetit mund të hudhë aktakuzën nëse kërkesa nga neni 250 të këtij Kodi është e bazuar.

Neni 254
Shqyrtimi i dytë dhe caktimi i shqyrtimit gjyqësor

1. Në shqyrtimin e dytë marrin pjesë prokurori i shtetit, i pandehuri ose të pandehurit dhe mbrojtësit, përveç nëse gjyqtari i vetëm gjykues apo kryetari i trupit gjykues ka kërkuar vetëm paraqitjen e propozimeve deri në datën e shqyrtimit të dytë.
2. Gjatë shqyrtimit të dytë, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues sigurohet që mbrojtësi të ketë përmbushur të gjitha detyrimet lidhur me zbulimin e provave nga neni 256 i këtij Kodi.
3. Gjatë shqyrtimit të dytë, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues shqyrton kundërshtimet nga neni 249 ose kërkesat nga neni 250 të këtij Kodi. Ai mund të kërkojë nga prokurori i shtetit që të përgjigjet gojarisht gjatë shqyrtimit ose me shkrim, në pajtim me nenet 249-
4. të këtij Kodi.
5. Gjatë shqyrtimit të dytë, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues cakton seanca dëgjimore në pajtim me nenin 255 të këtij Kodi, nëse seancat e tilla janë të nevojshme.
6. Gjatë shqyrtimit të dytë, gjyqtari i procedurës paraprake ose kryetari i trupit gjykues cakton shqyrtimin gjyqësor, përveç nëse ende nuk ka marr aktvendim mbi kundërshtimet e paraqitura nga neni 249 apo kërkesat nga neni 250 të këtij Kodi.
7. Nëse gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues ende nuk ka vendosur për kundërshtimet nga neni 249 apo kërkesat nga neni 250 të këtij Kodi, ai merr aktvendim me shkrim të arsyetuar për të gjitha propozimet e pazgjidhura pas shqyrtimit të dytë. Ai cakton shqyrtimin gjyqësor me urdhër me shkrim, të cilin e nxjerr në të njëjtën kohë me aktvendimin apo aktvendimet me shkrim për propozimet e lartpërmendura.
8. Asnjë dëshmitar apo ekspert nuk merret në pyetje dhe nuk paraqiten prova gjatë shqyrtimit të dytë.

Neni 255
Shqyrtimet për përcaktimin e vlefshmërisë së propozimeve

1. Nëse gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues çmon se është e nevojshme mbajtja e shqyrtimit për të vlerësuar kundërshtimet e të pandehurit nga neni 249 apo kërkesat nga neni 250 të këtij Kodi, ai cakton dhe zbaton shqyrtimin e tillë sa më parë që të jetë e mundur dhe jo më vonë se tre (3) javë nga dita e shqyrtimit të dytë.
2. Gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues nxjerr aktvendim me shkrim të arsyetuar sa më parë që të jetë e mundur pas shqyrtimit të mbajtur sipas këtij neni dhe jo më vonë se tre (3) javë nga dita e mbajtjes së shqyrtimit nga ky nen.

Neni 256
Paraqitja e materialeve nga mbrojtja

1. Në shqyrtim të dytë, mbrojtja i paraqet prokurorit të shtetit:
   1.1. njoftimin për qëllimin e prezentimit të alibit, duke precizuar vendin ose vendet ku i pandehuri pohon të ketë qenë në kohën e kryerjes së veprës penale dhe emrat e dëshmitarëve dhe çdo provë tjetër që e mbështet alibinë;
   1.2. njoftimin për qëllimin e prezentimit të arsyeve për përjashtim të përgjegjësisë penale, duke precizuar emrat e dëshmitarëve dhe çdo prove tjetër që e mbështet arsyen e tillë; dhe
   1.3. njoftimin për emrat e dëshmitarëve të cilët mbrojtja synon t'i thërret për të dëshmuar.
2. Në çdo kohë para shqyrtimit gjyqësor, mbrojtësi mund të plotësojë me shkrim informatat e dhëna sipas paragrafit 1. të këtij neni prokurorit të shtetit.
3. Nëse mbrojtësi nuk kryen detyrimin nga paragrafët 1. dhe 2. të këtij neni ndërsa gjykata nuk gjen shkaqe të arsyeshme për një gjë të tillë, gjykata mund të shqiptojë gjobë deri në dyqindepesëdhjetë (250) Euro ndaj mbrojtësit dhe njofton Odën e Avokatëve për këtë.

KAPITULLI XVI
PROVAT

Neni 257
Rregullat e përgjithshme për prova

1. Rregullat e provës të parapara në këtë nen zbatohen në të gjitha procedurat penale para gjykatës dhe, në rastet kur e parasheh ky Kod, ato gjithashtu zbatohen në procedurat para prokurorit të shtetit dhe policisë.
2. Provat e marra me shkelje të dispozitave të procedurës penale janë të papranueshme kur ky Kod ose dispozita të tjera të ligjit shprehimisht parashikojnë kështu.
3. Gjykata nuk mund ta mbështesë vendimin e saj në prova të papranueshme.
4. Gjatë çdo intervistimi ose marrjeje në pyetje ndalohet që:
   4.1. liria e të pandehurit për të formuluar dhe shprehur mendimin e tij të ndikohet nëpërmjet keqtrajtimit, lodhjes së shkaktuar, ndërhyrjes fizike, përdorimit të drogës, torturës, shtrëngimit ose hipnotizimit;

4.2. i pandehuri të kanoset me masa të ndaluara me ligj;
4.3. të premtohet ndonjë përfitim që nuk parashihet me ligj; dhe
4.4. të dobësohet kujtesa e të pandehurit ose aftësia e tij për të kuptuar.

5. Ndalesa nga paragrafi 4. i këtij neni zbatohet pavarësisht nga pëlqimi i personit të intervistuar ose të marrë në pyetje.
6. Kur intervistimi ose marrja në pyetje është zbatuar në kundërshtim me paragrafin 4. të këtij neni, procesverbali i intervistimit ose marrjes së tillë në pyetje është i papranueshëm.

Neni 258
Provat dhe rendi në gjykatë

1. Gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues është përgjegjës për funksionimin e mirëfilltë të shqyrtimit gjyqësor, përfshirë marrjen e provave.
2. Gjykata mund të ndalojë marrjen e provave nëse:
   2.1. marrja e provave të tilla për të plotësuar provat tjera është e panevojshme dhe e tepërt sepse çështja në fjalë është e njohur në vija të përgjithshme;
   2.2. fakti që do të provohet është i parëndësishëm për vendimin apo është provuar;
   2.3. prova është tërësisht e papërshtatshme, e pamundshme ose e paarritshme; ose
   2.4. kërkesa bëhet për të zvarritur procedurën.
3. Gjykata mund të ndalojë marrjen e provës apo të përjashtojë provën.

Neni 259
Provat qartazi të parëndësishme apo thelbësisht të pambështetshme janë të papranueshme

1. Cilado provë që nuk ka të bëjë me të provuarit e ndonjë elementi të veprës penale, dëmit të shkaktuar me vepër penale, mbrojtjes nga ndjekja apo ndonjë çështjeje tjetër të rëndësishme mund të çmohet si provë qartazi e parëndësishme dhe është provë e papranueshme.
2. Cilado provë që është thelbësisht e pambështetshme, siç përkufizohet në nenin 19, paragrafi 1., nën-paragrafi 1.29 të këtij Kodi është provë e papranueshme.

Neni 260
Shqyrtimi i provave të pranueshme në shqyrtim kryesor

1. Pasi që gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues të ketë përjashtuar provat në pajtim me nenin 249 të këtij Kodi, ato prova mund të shqyrtohen nga gjykata vetëm gjatë rigjykimit nëse aktvendimi i gjyqtarit të vetëm gjykues ose kryetarit të trupit gjykues për të përjashtuar provat ndryshohet pas ankesës.
2. Prova mund të shqyrtohen nga gjyqtari i vetëm gjykues apo kryetari i trupit gjykues gjatë shqyrtimit kryesor nëse nuk është përjashtuar sipas nenit 249 apo nëse nuk është e papranueshme sipas nenit 259 të këtij Kodi.
3. Gjyqtari i vetëm gjykues, kryetari i trupit gjykues apo anëtari i trupit gjykues, çmon besueshmërinë, rëndësinë dhe vlerën provuese të provës së pranuar nga paragrafi 2. i këtij neni.

Neni 261
Përdorimi i deklaratave të mëparshme në shqyrtim gjyqësor

1. Deklarimi i të pandehurit dhënë policisë ose prokurorit të shtetit mund të jetë provë e pranueshme në gjykatë vetëm kur është marrë në pajtim me dispozitat e nenit 73, paragrafi 1. nenit 131 ose nenit 132 dhe në pajtim me nenet 151 deri 155 të këtij Kodi. Deklaratat e tilla mund të përdoren për ta kundërshtuar deklarimin e të pandehurit në gjyq ose si provë e drejtpërdrejtë në pajtim me nenin 262 paragrafi 2. të këtij Kodi.
2. Marrja në pyetje në procedurë paraprake mund të përdoret si provë në pajtim me nenin 123 paragrafi 2. të këtij Kodi.
3. Deklarata në procedurë paraprake mund të përdoret si provë në pajtim me nenin 123, paragrafi 3. të këtij Kodi.
4. Mundësia hetuese e veçantë mund të përdoret si provë në pajtim me nenin 123, paragrafi 4. të këtij Kodi.

Neni 262
Provat për përcaktimin e fajësisë

1. Gjykata nuk e shpall të akuzuarin fajtor duke u mbështetur vetëm në një dëshmi ose duke i dhënë rëndësi vendimtare një dëshmie apo një prove tjetër e cila nuk mund të kundërshtohet nga i pandehuri ose mbrojtësi përmes marrjes në pyetje gjatë ndonjë faze të procedurës penale.
2. Gjykata nuk e shpall të akuzuarin fajtor duke u mbështetur vetëm në një deklaratë ose duke i dhënë rëndësi vendimtare deklarimit të dhënë nga i pandehuri në polici ose para prokurorit të shtetit.
3. Gjykata nuk e shpall të akuzuarin fajtor vetëm në një deklaratë ose duke i dhënë rëndësi vendimtare dëshmisë së dhënë nga një dëshmitar, identiteti i të cilit është i panjohur për mbrojtësin dhe të akuzuarin.
4. Gjykata nuk e shpall personin fajtor vetëm mbi bazën e dëshmisë së dhënë nga dëshmitari bashkëpunues.

Neni 263
Mbështetja e pohimit

1. Prokurori i shtetit i cili synon të mbështetet në deklaratat e mëparshme nga neni 261 ose deklaratat e siguruara nga neni 219 paragrafi 6. i këtij Kodi duhet të paraqesë mbështetjen e pohimit.
2. Mbështetja e pohimit përmban:
   2.1. Përshkrimin e dëshmive, deklaratën apo provën tjetër në të cilën prokurori i shtetit synon të mbështetet e që do të ishte e kufizuar sipas nenit 262 të këtij Kodi;
   2.2. Përshkrimin e shkurtë të dëshmisë, shkresës apo provës që vërteton të dhënat fajësuese nga provat e cekura në nën-paragrafin 2.1. të këtij paragrafi.
3. Mbështetja e pohimit paraqitet së bashku me aktakuzë dhe jo më vonë se deri në fillim të shqyrtimit gjyqësor.

KAPITULLI XVII
NGRIRJA E ASETEVE DHE URDHRAT NDALUES

Neni 264
Ngrirja e përkohshme e aseteve

1. Nëse hetimi është autorizuar për vepër penale nga neni 90 i këtij Kodi, prokurori i shtetit mund të lëshojë urdhër për ndalimin e shitjes, shkëmbimit të pronësisë ose tërheqjen nga llogaria të cilitdo send të përshkruar në paragrafin 2 ose 3. të këtij neni.
2. Çdo ndërtesë, pasuri e paluajtshme, pasuri e luajtshme ose aset për të cilin prokurori i shtetit ka prova të artikulueshme që tregojnë dyshim të bazuar se:
   2.1. ndërtesa, pasuria e paluajtshme, pasuria e luajtshme ose aseti është përdorur në veprën penale nën hetim;
   2.2. ndërtesa, pasuria e paluajtshme, pasuria e luajtshme ose aseti është provë e veprës penale nën hetim; ose
   2.3. ndërtesa, pasuria e paluajtshme, pasuria e luajtshme ose aseti është fituar nga vepra penale nën hetim.
3. Çfarëdo llogarie financiare që i takon të pandehurit nën hetim, në të cilën mund të ketë mjete të cilat janë:
   3.1. të ardhura nga vepra penale nën hetim; ose
   3.2. përdorur në kryerjen e vazhdueshme të veprës penale nën hetim.
4. Urdhri i prokurorit të shtetit nga ky nen ka efektin e mëposhtëm:
   4.1. çdo bankë apo institucion financiar që pranon urdhrin nga ky nen menjëherë ndalon çfarëdo aktiviteti të mëtejmë të llogarisë bankare të përshkruar në urdhër. Banka nuk është përgjegjëse ndaj mbajtësit të llogarisë bankare për veprimet e saj në pajtim me urdhrin nga ky paragraf.
   4.2. cilado palë tjetër që pranon urdhrin nga ky nen duhet të ndërmerr hapat e arsyeshëm për t'iu bindur urdhrit.
5. Urdhri i prokurorit të shtetit nga ky nen mund të lëshohet vetëm një herë dhe është i vlefshëm vetëm për shtatëdhjetë e dy (72) orë nga koha e lëshimit të urdhrit.
6. Në urdhrin e prokurorit të shtetit përshkruhet ndërtesa, pasuria e paluajtshme, pasuria e luajtshme, llogaria financiare ose aseti dhe i urdhëron pranuesit të urdhrit që të ndalojë shitjen, shkëmbimin e pronësisë ose tërheqjen nga llogaria për shtatëdhjetë e dy (72) orë nga koha e lëshimit të urdhrit. Në urdhër ceket koha e lëshimit dhe koha e skadimit të urdhrit.
7. Urdhri nga ky paragraf mund të lëshohet nga prokurori i shtetit nëse ai i paraqet kërkesë gjyqtarit të procedurës paraprake për urdhër ndalues nga neni 265 i këtij Kodi për asetin e përcaktuar në urdhër.

Neni 265
Urdhri ndalues

1. Prokurori i shtetit i cili lëshon urdhrin për ngrirjen e përkohshme të aseteve nga neni 264 i këtij Kodi menjëherë i paraqet gjyqtarit të procedurës paraprake kërkesë për urdhër ndalues për asetin e përcaktuar në urdhrin për ngrirjen e përkohshme të asetit.

2. Kërkesa për urdhër ndalues përmban:
   2.1. kopjen e urdhrit për ngrirjen e përkohshme të aseteve;
   2.2. përshkrimin e provave të artikulueshme që arsyetojnë urdhrin;
   2.3. përshkrimin e arsyeve që urdhri ndalues të ndalojë shitjen, shkëmbimin apo tërheqjen nga llogaria e asetit të përshkruar; dhe
   2.4. identitetin e të gjithë personave që kanë interes pasuror në asetin e përshkruar, siç përcaktohet në regjistrat kadastral apo regjistrat tjerë qeveritar.
3. Gjyqtari i procedurës paraprake lëshon urdhër ndalues për secilin aset që kërkohet nëse prokurori i shtetit me anë të provave të artikulueshme tregon shkak të bazuar për të arsyetuar urdhrin.
4. Gjyqtari i procedurës paraprake refuzon ose lëshon urdhrin ndalues para skadimit të urdhrit për ngrirjen e përkohshme të aseteve.
5. Urdhri ndalues i lëshuar nga gjyqtari i procedurës paraprak në Kosovë vlen për të gjithë territorin e Kosovës.
6. Urdhri ndalues përcakton ndërtesën, pasurinë e paluajtshme, pasurinë e luajtshme, llogarinë financiare apo asetin dhe urdhëron pranuesin e urdhrit që të ndalojë shitjen, shkëmbimin e pronësisë ose tërheqjen nga llogaria për tridhjetë (30) ditë nga koha e lëshimit të urdhrit. Në urdhër ceket koha e lëshimit dhe koha e skadimit të urdhrit.
7. Urdhri i dërgohet institucionit financiar ose palës tjetër për të cilën është lëshuar urdhri për ngrirjen e përkohshme të aseteve.
8. Urdhri ndalues po ashtu i dërgohet të pandehurit dhe të gjithë personave që kanë interes në asetin e përcaktuar. Urdhri ndalues cakton shqyrtimin brenda tre (3) javësh dhe në të thuhet: "Pasuria e përcaktuar në urdhrin ndalues është ngrirë për tridhjetë (30) ditë. Shqyrtimi është caktuar. Nëse pretendoni të kundërshtoni ngrirjen e kësaj pasurie, ju duhet të merrni pjesë në shqyrtim dhe do të keni mundësinë të paraqitni argumentet tuaja për heqjen e kësaj ngrirjeje. Ndalimi afatgjatë i kësaj pasurie mund të urdhërohet në këtë shqyrtim dhe kjo prek të drejtën tuaj në këtë pasuri."
9. Urdhri ndalues nga ky nen ka efektin e mëposhtëm:
   9.1. çdo bankë apo institucion financiar që pranon urdhrin nga ky paragraf menjëherë ndalon çfarëdo aktiviteti të mëtejmë të llogarisë bankare të përshkruar në urdhër. Banka nuk është përgjegjëse ndaj mbajtësit të llogarisë bankarë për veprimet e saj në pajtim më urdhrin nga ky paragraf.
   9.2. cilado palë tjetër që pranon urdhrin nga ky paragraf duhet të ndërmerr hapat e arsyeshëm për t'iu bindur urdhrit.

Neni 266
Shqyrtimi për konfirmimin e ndalimit të pasurisë

1. Gjyqtari i procedurës paraprake mund të marrë parasysh provat apo dëshmitarët në mbështetje të urdhrit ndalues të lëshuar më parë gjatë çmuarjes nëse duhet lëshuar urdhër për ndalim afatgjatë në përfundim të shqyrtimit për ndalim. Ai poashtu mbështet urdhrin për ndalim afatgjatë në provat e paraqitura gjatë shqyrtimit për ndalim nga paragrafët 2., 3. dhe 4. të këtij neni.

2. Prokurori i shtetit paraqet prova ose dëshmitarë në mbështetje të urdhrit ndalues.
3. I pandehuri mund të paraqet prova ose dëshmitarë për të kundërshtuar provat në mbështetje të urdhrit ndalues, ose mund të paraqesë argumente kundër bazës ligjore për urdhrin ndalues.
4. Palët tjera që kanë të drejta në pasuri paraqesin prova ose dëshmitarë për të kundërshtuar provat në mbështetje të urdhrit ndalues, ose mund të paraqesin argumente kundër bazës ligjore për urdhrin ndalues.
5. Gjyqtari i procedurës paraprake lëshon urdhër për ndalim afatgjatë për secilin aset që kërkohet nëse ka prova të artikulueshme që tregojnë shkak të bazuar për të arsyetuar urdhrin.
6. Në përfundim të shqyrtimit, gjyqtari i procedurës paraprake lëshon urdhër, me të cilin:
   6.1. refuzon ndalimin e pasurisë dhe lëshon urdhër për lirimin e menjëhershëm të pasurisë; ose
   6.2. konfirmon ndalimin e pasurisë dhe menjëherë lëshon urdhër për ndalim afatgjatë.
7. Në përfundim të shqyrtimit, gjykata mund të urdhërojë që pasuria të administrohet nga Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar ose të Konfiskuar vetëm nëse gjykata është e bindur se me urdhër ndalues nuk do të arrihet të parandalohet që pasuria të mos largohet nga kompetenca territoriale e saj.
8. Përveç mjeteve të mbajtura në llogari financiare të ngrirë apo llogari financiare të ndaluar, i pandehuri ose shfrytëzuesi i pasurisë vazhdon shfrytëzimin e pasurisë por nuk mund ta shesë apo ta shkëmbejë në ndonjë mënyrë tjetër pronësinë mbi pasurinë.
9. Urdhri për ndalim afatgjatë i lëshuar nga gjyqtari i procedurës paraprak në Kosovë vlen për të gjithë territorin e Kosovës.
10. Urdhri për ndalim afatgjatë i lëshuar nga gjyqtari i procedurës paraprake nuk skadon deri në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, pushimit të hetimit ose sipas paragrafit 11. të këtij neni.
11. Nëse pasuria e përcaktuar në urdhrin për ndalim afatgjatë nuk ceket në aktakuzën nga neni 241 të këtij Kodi, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues mund të vendos për lirimin e pasurisë për të gjitha palët e përfshira në urdhrin për ndalim afatgjatë.
12. Urdhri për ndalim afatgjatë mund të ankimohet në Gjykatën e Apelit brenda dhjetë (10) ditëve nga lëshimi i urdhrit. Ankesa nuk e pezullon ekzekutimin e urdhrit për ndalim afatgjatë.

KAPITULLI XVIII
KONFISKIMI

1. PROCEDURAT PARA NGRITJES SË AKTAKUZËS

Neni 267
Konfiskimi i përkohshëm

1. Ndërtesat, pasuria e paluajtshme, pasuria e luajtshme dhe asetet e konfiskuara përkohësisht nga neni 112 i këtij Kodi duhet ose:

1.1. të i kthehen pronarit nga neni 116 i këtij Kodi;
1.2. të mbahen deri në shfrytëzimin e tyre si prova dhe/apo deri në konfiskimin e përhershëm nga neni 268 i këtij Kodi.

2. Sendet e ndaluara të cilat janë sekuestruar përkohësisht sipas nenit 105 të këtij Kodi nuk i kthehen pronarit dhe asgjësohen pasi të mos ketë më nevojë për shfrytëzim si provë.
3. Asetet e sekuestruara të cilat i nënshtrohen konfiskimit sipas ligjit konsiderohet se janë sekuestruar ose konfiskuar përkohësisht nga ky Kapitull.
4. Brenda gjashtëdhjetë (60) ditëve nga konfiskimi i ndërtesës, pasurisë së paluajtshme, pasurisë së luajtshëm apo asetit, prokurori i shtetit kërkon masë të përkohshme për sigurimin e pasurisë nga neni 268 i këtij Kodi.

Neni 268
Kërkesa për masat e përkohshme për sigurimin e pasurisë

1. Për ndërtesat, pasuritë e paluajtshme, pasuritë e luajtshme dhe asetet e konfiskuara përkohësisht dhe të cilat do të shfrytëzohen si provë ose të cilat mund t'i nënshtrohen konfiskimit të përhershëm, prokurori i shtetit i paraqet kërkesë me shkrim gjyqtarit të procedurës paraprake për masa të përkohshme për sigurimin e pasurisë.
2. Në kërkesë për masë të përkohshme përcaktohet:
   2.1. ndërtesa, pasuria e paluajtshme, pasuria e luajtshme ose aseti që është objekt i kërkesës,
   2.2. dyshimi i bazuar se ndërtesa, pasuria e paluajtshme, pasuria e luajtshme apo aseti është:
      2.2.1. rrjedhojë e veprës penale nën hetim; ose
      2.2.2. përdorur ose ka pasur për qëllim të përdoret në kryerjen e veprës penale;
   2.3. nëse ka gjasa të konsiderueshme se ndërtesa, pasuria e paluajtshme, pasuria e luajtshme apo aseti nuk do të jetë e mundur të konfiskohet në përfundim të procedurës penale ose që do të përdoret në kryerjen e veprës penale nëse nuk merren masa mbrojtëse;
   2.4. të gjithë personat që kanë ndonjë të drejtë ligjore në ndërtesë, pasuri të paluajtshme, pasuri të luajtshme apo aset; dhe
   2.5. masat e përkohshme që propozohen të merren nga neni 269 i këtij Kodi.
3. Prokurori i shtetit i dërgon kopjen e kërkesës për masën e përkohshme secilit person të cekur në nën-paragrafin 2.4. paragrafi 2. i këtij neni. Nëse kopja e kërkesës për masë të përkohshme nuk mund t'i dërgohet secilit person nga paragrafi 2. nën-paragrafi 2.4. i këtij neni prokurori i shtetit bën përpjekje të arsyeshme për të njoftuar secilin person nga nën-paragrafi 2.4. i këtij neni për ekzistimin dhe pasojat e kërkesës për masë të përkohshme.

Neni 269
Masat e përkohshme për sigurimin e pasurisë

1. Prokurori i shtetit mund të kërkojë, dhe Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar ose të Konfiskuar është përgjegjëse për ekzekutimin e këtyre masave të përkohshme për sigurimin e pasurisë:

1.1. mbajtja e pasurisë në kasafortë;
1.2. mbajtja e pasurisë në depo të sigurt;
1.3. mbajtja e pasurisë së paluajtshme nga administratori i pasurisë së paluajtshme;
1.4. mbajtja e mjeteve në llogarinë bankare të autorizuar nga gjykata;
1.5. tjetërsimin e pasurisë nga paragrafi 2. ose 3. të këtij neni;
1.6. masa të arsyeshme për mbajtjen e pasurisë si provë; ose
1.7. masa të arsyeshme për mbajtjen e pasurisë ose ekuivalentit të saj si aset.

2. Për pasurinë për të cilën kërkohen shpenzime të jashtëzakonshme për administrimin, mirëmbajtjen, ushqimin apo vendosja në depo, prokurori i shtetit mund të kërkojë masë të arsyeshme që do të minimizonte shpenzimet e jashtëzakonshme por do të ruante vlerë e pasurisë. Përpjekjet nga ky paragraf mund të përfshijnë shitjen e pasurisë për vlerën e saj aktuale në treg, shitjen apo prerjen e bagëtisë ose përpunimin e të lashtave në produkte për konsum.
3. Për pasurinë e cila shpejt humb vlerën ose që është plotësisht e zëvendësueshme, prokurori i shtetit mund të kërkojë masë të arsyeshme që do të parandalonte humbjen e vlerës apo shpenzimet e panevojshme të mirëmbajtjes. Përpjekjet nga ky paragraf mund të përfshijnë shitjen e pasurisë për vlerën e saj aktuale në treg, përzierjen e pasurisë ose përpunimin e të lashtave apo materialeve në produkte.
4. Shitja e pasurisë nga ky nen zbatohet në pajtim me nenin 8 të Ligjit për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar ose të Konfiskuar, Ligji nr. 03/L-141.
5. Mjetet nga shitja e pasurisë nga ky nen mbahen në pajtim me nenin 9 të Ligjit për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar ose të Konfiskuar, Ligji nr. 03/L-141.

Neni 270
Kundërshtimet nga palët e treta

1. Të gjithë personat që kanë ndonjë të drejtë në ndërtesën, pasurinë e paluajtshme, pasurinë e luajtshme ose asetet nga neni 268, paragrafi 4. i këtij Kodi duhet t'u jepet mundësia për të kundërshtuar masat e përkohshme të propozuara nga prokurori i shtetit.
2. Nëse pretendohet se ndërtesa, pasuria e paluajtshme, pasuria e luajtshme ose aseti janë përdorur në kryerjen e veprës penale, personi i cili kundërshton masën e përkohshme duhet të vërtetojë se:
   2.1. ai nuk ka ditur për përdorimin e pasurisë në kryerjen e veprës penale;
   2.2. ai nuk ka mundur ta dijë për përdorimin e pasurisë në kryerjen e veprës penale;
   2.3. pasuria nuk mund të përdoret prapë për vepër penale; dhe
   2.4. masa e përkohshme e propozuar do të dëmtonte në mënyrë të paarsyeshme të drejtat e personit që kundërshton atë.
3. Nëse pretendohet se ndërtesa, pasuria e paluajtshme, pasuria e luajtshme ose aseti janë, dobi pasurore e fituar me vepër penale personi i cili kundërshton masën e përkohshme duhet të vërtetojë se:
   3.1. ai ka pasur të drejtë pronësore në ndërtesën, pasurinë e paluajtshme, pasurinë e luajtshme ose asetin për më shumë se gjashtë muaj para konfiskimit të përkohshëm të pasurisë;

3.2. ai ka paguar çmimin e tregut për të drejtën pronësore në ndërtesë, pasuri të paluajtshme, pasuri të luajtshme apo aset;
3.3. ai nuk ka ditur për veprimet që kanë mbështetur veprën penale;
3.4. i dyshuari apo i pandehuri nuk do të mund të shfrytëzonte, shkëmbente ose në ndonjë formë tjetër të siguronte qasje në ndërtesën, pasurinë e paluajtshme, pasurinë e luajtshme ose asetin; dhe
3.5. masa e përkohshme e propozuar do të dëmtonte në mënyrë të paarsyeshme të drejtat e personit që kundërshton atë.

4. Në kundërshtim mund të propozohet që të urdhërohet një masë e përkohshme më pak kufizuese ose që të mos urdhërohet asnjë masë e përkohshme.
5. Në kundërshtim mund të kundërshtohet saktësia e përshkrimit të ndërtesës, pasurisë së paluajtshme, pasurisë së luajtshme ose asetit të përfshirë në kërkesë.

Neni 271
Kundërshtimet nga i pandehuri

1. I pandehuri mund të kundërshtojë kërkesën për masë të përkohshme nga neni 268 i këtij Kodi.
2. Në kundërshtim mund të kundërshtohet:
   2.1. saktësia e përshkrimit të ndërtesës, sendit të paluajtshëm, sendit të luajtshëm ose asetit të përfshirë në kërkesë.
   2.2. nëse ka dyshim të bazuar se ndërtesa, pasuria e paluajtshme, pasuria e luajtshme ose aseti është:
      2.2.1. rrjedhojë e veprës penale nën hetim; ose
      2.2.2. është përdorur ose ka pasur qëllim që të përdoret në kryerjen e veprës penale.
   2.3. nëse ka gjasa të konsiderueshme se ndërtesa, pasuria e paluajtshme, pasuria e luajtshme apo aseti nuk do të jetë e mundur të konfiskohet në përfundim të procedurës penale ose që do të përdoret në kryerjen e veprës penale nëse nuk merren masa të përkohshme;
   2.4. nëse masat e përkohshme të propozuara nga neni 269 i këtij Kodi janë të arsyeshme ose të nevojshme.

Neni 272
Mbajtja e shqyrtimit për urdhrin mbi masat e përkohshme

1. Gjyqtari i procedurës paraprake merr aktvendim mbi kërkesën për masë të përkohshme të paraqitur nga prokurori i shtetit sipas nenit 273 të këtij Kodi nëse gjykata nuk pranon kundërshtim brenda katërmbëdhjetë (14) ditëve nga paraqitja e kërkesës.
2. Nëse brenda katërmbëdhjetë (14) ditëve nga paraqitja e kërkesës gjyqtari i procedurës paraprake pranon kundërshtim nga i pandehuri ose nga pala e tretë, gjyqtari i procedurës paraprake mund të lëshojë urdhër me shkrim nga neni 273 i këtij Kodi pa mbajtur shqyrtim ose pas shqyrtimit.
3. Gjyqtari i procedurës paraprake mund të caktojë shqyrtim para se të urdhërojë masën e përkohshme nga neni 273 i këtij Kodi, nëse i pandehuri ose pala e tretë ka ngritur çështje faktike që kërkojnë marrjen e provave dhe sqarimin e fakteve.

Neni 273
Urdhri për masë të përkohshme

1. Gjyqtari i procedurës paraprake urdhëron, ndryshon ose refuzon kërkesën për masë të përkohshme të paraqitur nga prokurori i shtetit sipas nenit 268 të këtij Kodi.
2. Urdhri nga paragrafi 1. i këtij neni me të cilin urdhërohet ose ndryshohet masa e përkohshme e kërkuar nga prokurori i shtetit sipas nenit 268 të këtij Kodi, duhet të përcaktojë:
   2.1. ndërtesën, pasurinë e paluajtshme, pasurinë e luajtshme apo asetin që është objekt i kërkesës;
   2.2. dyshimin e bazuar se ndërtesa, pasuria e paluajtshme, pasuria e luajtshme ose aseti është:
      2.2.1. rrjedhojë e veprës penale nën hetim; ose
      2.2.2. është përdorur ose ka pasur qëllim që të përdoret në kryerjen e veprës penale.
   2.3. nëse ka gjasa të konsiderueshme që ndërtesa, pasuria e paluajtshme, pasuria e luajtshme apo aseti nuk do të jetë e mundur të konfiskohet në përfundim të procedurës penale ose që do të përdoret në kryerjen e veprës penale nëse nuk merren masa mbrojtëse;
   2.4. masën e përkohshme nga neni 269 i këtij Kodi që duhet zbatuar;
   2.5. urdhri po ashtu duhet të përmbajë arsyetimin për refuzimin e kundërshtimeve të pranuara nga neni 270 ose 271 i këtij Kodi, ose arsyetimin për ndryshimin e masës së përkohshme në bazë të atyre kundërshtimeve;
   2.6. urdhri mund të përcaktojë një afat kohor të arsyeshëm për masën e përkohshme;
   2.7. urdhri i dërgohet Agjencisë për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar ose të Konfiskuar brenda dhjetë (10) ditëve.
   2.8. agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar ose të Konfiskuar ekzekuton urdhrin brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga lëshimi i urdhrit, përveç nëse paraqitet ankesë nga paragrafi 4. i këtij neni.
3. Me urdhër nga paragrafi 1. i këtij neni me të cilin refuzohet masa e përkohshme e kërkuar nga prokurori i shtetit sipas nenit 268 të këtij Kodi urdhërohet që pasuria t'i lirohet pronarit apo poseduesit.
   3.1. urdhri i dërgohet Agjencisë për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar ose të Konfiskuar brenda dhjetë (10) ditëve.
   3.2. Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar ose të Konfiskuar ekzekuton urdhrin brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga lëshimi i urdhrit, përveç nëse paraqitet ankesë nga paragrafi 4. i këtij neni.
4. Kundërshtimi i urdhrit për masë të përkohshme nga ku nen mund të dëgjohet nga kolegji shqyrtues. Kundërshtimi e pezullon ekzekutimin e urdhrit nga ky nen deri në marrjen e aktvendimit nga kolegji shqyrtues.

2. PROCEDURAT PAS NGRITJES SË AKTAKUZËS

Neni 274
Përfshirja në aktakuzë, e pasurisë që është objekt i konfiskimit

1. Nëse ndërtesa, pasuria e paluajtshme, pasuria e luajtshme ose aseti që është objekt i urdhrit nga neni 273 ose i urdhrit për ndalim afatgjatë nga neni 266 të këtij Kodi nuk ceket në aktakuzë në pajtim me nenin 241, paragrafi 1. nën-paragrafi 1.9 të këtij Kodi, para shqyrtimit të dytë, pronari ose poseduesi mund të paraqesë kërkesë te gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues për t'i liruar pasurinë pronarit apo poseduesit.
2. Nëse ndërtesa, pasuria e paluajtshme, pasuria e luajtshme ose aseti që është objekt i urdhrit nga neni 273 ose i urdhrit për ndalim afatgjatë nga neni 266 i këtij Kodi është objekt i ndonjë procedure tjetër ligjore të konfiskimit, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues refuzon kërkesën nga paragrafi 1. i këtij neni.
3. Nëse ndërtesa, pasuria e paluajtshme, pasuria e luajtshme ose aseti që është objekt i urdhrit nga neni 273 ose i urdhrit për ndalim afatgjatë nga neni 266 i këtij Kodi nevojitet si provë në shqyrtim gjyqësor, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupi gjykues refuzon kërkesën nga paragrafi 1. i këtij neni.
4. Nëse ndërtesa, pasuria e paluajtshme, pasuria e luajtshme ose aseti që është objekt i urdhrit nga neni 273 ose i urdhrit për ndalim afatgjatë nga neni 266 i këtij Kodi mund të ceket në aktakuzën e cila ende nuk është ngritur, prokurori i shtetit njofton gjyqtarin e vetëm gjykues ose kryetarin e trupit gjykues. Gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues pezullon kërkesën nga paragrafi 1. i këtij neni, por i lejon paraqitësit të kërkesës që të ripërtërijë kërkesën pas gjashtë (6) muajve nëse nuk ngritet aktakuzë tjetër.
5. Nëse nuk ngritet aktakuzë tjetër dhe paraqitësi i kërkesës ripërtërinë kërkesën pas gjashtë (6) muajve, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues nxjerr urdhër nga paragrafi 6. të këtij neni. Prokurori i shtetit mund të kërkojë vazhdim prej tre (3) muajve vetëm në rrethana të jashtëzakonshme.
6. Gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues miraton kërkesën nga paragrafi 1. i këtij neni pasi të ketë vërtetuar se ndërtesa, pasuria e paluajtshme, pasuria e luajtshme ose aseti që është objekt i urdhrit nga neni 273 ose i urdhrit për ndalim afatgjatë nga neni 266 i këtij Kodi nuk është cekur në aktakuzën në pajtim me nenin 241, paragrafi 1. nën-paragrafi 1.9. të këtij Kodi
7. Urdhri nga ky nen mund të ankimohet. Ankesa nga ky paragraf nuk e zvarrit procedurën penale ose ekzekutimin e urdhrit nga ky nen.

Neni 275
Provat e nevojshme për konfiskimin e dobisë pasurore, të fituar me vepër penale

1. Para se gjykata të lëshojë urdhër përfundimtar për konfiskimin penal të ndërtesës, pasurisë së paluajtshme, pasurisë së luajtshme ose aseteve të përcaktuara në aktakuzë, në aktakuzë duhet të pretendohet dhe prokurori i shtetit duhet ta provojë në shqyrtim gjyqësor se ndërtesa, pasuria e paluajtshme, pasuria e luajtshme ose aseti ka qenë dobi pasurore e veprës penale nën hetim, në pajtim me nenet 276-280 të këtij Kodi.

2. Prokurori i shtetit, i dëmtuari ose i pandehuri mund të marrin në pyetje dëshmitarët dhe të paraqesin prova në shqyrtim gjyqësor për të mbështetur ose kundërshtuar provat nga paragrafi 1. i këtij neni.
3. Në raportin nga neni 148 i këtij Kodi dhe gjatë dëshmisë në shqyrtim gjyqësor, eksperti financiar i kualifikuar mund të shpreh mendimin e tij nëse ndërtesa, pasuria e paluajtshme, pasuria e luajtshme apo aseti i përcaktuar në aktakuzë është rrjedhojë e veprës penale që është nën hetim.
4. Nëse i dëmtuari ka paraqitur kërkesë pasurore juridike për rikthimin e sendit të humbur nga vepra penale ose për kompensimin monetar ekuivalent për vlerën e sendit, kjo kërkesë pasurore juridike mund të mbështet dëshminë që kërkohet në paragrafin 1. të këtij neni, por nuk mund të merret si provë e vetme apo vendimtare nga paragrafi 1. i këtij neni.

Neni 276
Përcaktimi i dobisë pasurore të fituar me vepër penale

1. Ndërtesa, pasuria e paluajtshme, pasuria e luajtshme ose aseti që është fituar drejtpërdrejt nëpërmjet veprimeve që përbëjnë vepër penale është dobi pasurore e fituar me atë vepër penale.
2. Mjetet e përfituara drejtpërdrejt si rezultat i veprimeve që përbëjnë vepër penale janë dobi pasurore e fituar me atë vepër penale.
3. Ndërtesa, pasuria e paluajtshme, pasuria e luajtshme ose aseti që është blerë me mjetet e përfituara drejtpërdrejt nga veprimet që përbëjnë vepër penale është dobi pasurore e fituar me atë vepër penale.
4. Mjetet e përfituara në mënyrë indirekte si rezultat i veprimeve që përbëjnë vepër penale, përfshirë interesin, fitimin bruto, ose rritjen nga kursi këmbimor i valutës, janë dobi pasurore e veprës penale nëse mjetet e përfituara në mënyrë indirekte nuk do të krijoheshin pa mjete nga paragrafi 2. i këtij neni.
5. Ndërtesa, pasuria e paluajtshme, pasuria e luajtshme ose aseti i blerë me mjetet e përfituara në mënyrë indirekte në pajtim me paragrafin 4. të këtij neni është dobi pasurore e fituar me atë vepër penale.

Neni 277
Llogaritja e dobisë pasurore të fituar me vepër penale

1. Për qëllim të këtij Kodi, nëse mjetet të cilat janë dobi pasurore e veprës penale përzihen me mjete që nuk janë dobi pasurore e veprës penale, çdo shumë që është e mundshme për konfiskim dhe e cila është e barabartë apo më e ultë se shuma e dobisë pasurore konsiderohet si dobi pasurore e veprës penale.
2. Gjyqtari i vetëm gjykues ose trupi gjykues mbështeten në rregullat e kontabilitetit dhe provat që kanë në dispozicion për të përcaktuar një vlerësim të arsyeshëm të shumës së dobisë pasurore të veprës penale.

Neni 278
Dobia pasurore nga vepra penale që gjendet në posedim të palës së tretë

1. Nëse të ardhurat nga vepra penale i kalohen personit tjetër, organizatës afariste apo personit juridik para se të bëhet konfiskimi, këto të ardhura konfiskohen nëse:
   1.1. të ardhurat nga vepra penale janë kaluar nga posedimi i të pandehurit;
   1.2. kalimi i të ardhurave nga vepra penale ka qenë për një shumë substancialisht më të ultë se sa çmimi real i tregut; dhe
   1.3. ka prova se i pandehuri ende kontrollon ose shfrytëzon të ardhurat nga vepra penale.
2. Nëse të ardhurat nga vepra penale janë në posedim të ndonjë personi tjetër, organizate afariste apo personi juridik, këto të ardhura konfiskohen nëse:
   2.1. personi, organizata afariste apo personi juridik ka siguruar posedimin e të ardhurave nga vepra penale si rezultat i drejtpërdrejtë i veprës penale;
   2.2. ka prova se i pandehuri kontrollon ose shfrytëzon të ardhurat nga vepra penale ose mban kontrollin mbi organizatën afariste apo personin juridik.

Neni 279
Të drejtat e palës së tretë që posedon dobinë pasurore nga vepra penale

1. Kur shqyrtohet konfiskimi i dobisë pasurore të fituar me vepër penale, personi të cilit i është kaluar dobia pasurore si dhe përfaqësuesi i organizatës afariste ose personi juridik thirren për t'u marrë në pyetje gjatë hetimit dhe në shqyrtim gjyqësor. Në thirrje paralajmërohet se procedura mund të zbatohet edhe pa praninë e tij.
2. Përfaqësuesi i organizatës afariste ose personi juridik në shqyrtim gjyqësor merret në pyetje pas të akuzuarit. Në mënyrë të njëjtë veprohet edhe me personin të cilit i është kaluar dobia pasurore e fituar me vepër penale, nëse ai nuk është thirrur si dëshmitar.
3. Personi të cilit i është kaluar dobia pasurore dhe përfaqësuesi i organizatës afariste ose personi tjetër juridik kanë të drejtë të propozojnë marrjen e provave për përcaktimin e dobisë pasurore, dhe me lejen e gjyqtarit të vetëm gjykues ose kryetarit të trupit gjykues t'u bëjnë pyetje të pandehurit, dëshmitarëve dhe ekspertëve.
4. Përjashtimi i publikut nga shqyrtimi gjyqësor nuk vlen për personin në të cilin ka kaluar dobia pasurore, përfshirë përfaqësuesin e ndërmarrjes afariste apo personin tjetër juridik.
5. Kur gjykata vetëm në shqyrtim gjyqësor mëson se është ngritur çështja e konfiskimit të dobisë pasurore të fituar me kryerjen e veprës penale, e ndërpret shqyrtimin gjyqësor dhe e thërret personin në të cilin ka kaluar dobia pasurore e fituar me vepër penale ose përfaqësuesin e organizatës afariste apo personin tjetër juridik.

Neni 280
Procedura për palën e tretë që posedon dobinë pasurore nga vepra penale

1. Gjykata mund të shqiptojë konfiskim të dobisë pasurore të fituar me kryerjen e veprës penale në aktgjykim me të cilin i akuzuari shpallet fajtor ose në aktgjykim mbi vërejtjen gjyqësore, si dhe në aktvendim me të cilin shqiptohet masa e trajtimit të detyrueshëm për rehabilitim të kryerësve të veprave penale të varur nga alkooli ose droga.
2. Në dispozitivin e aktgjykimit ose të aktvendimit, gjykata përcakton shumën e parave dhe sendin e konfiskuar. Kur ka shkaqe të arsyeshme, gjykata mund të lejojë pagesë me këste të dobisë pasurore të fituar nga veprat penale dhe cakton afatin e pagesës dhe shumën e saj.
3. Kur gjykata ka shqiptuar konfiskim të dobisë pasurore të fituar me vepër penale ndaj personit, organizatës afariste apo ndaj personit tjetër juridik, kopja e vërtetuar e aktgjykimit ose e aktvendimit i dërgohet edhe personit në të cilin ka kaluar dobia pasurore si dhe përfaqësuesit të organizatës afariste apo personit tjetër juridik.

Neni 281
Pasuria që rezulton nga veprimet korruptive

1. Në rastet kur procedura penale nuk përfundohet me aktgjykim me të cilin i akuzuari shpallet fajtor, sendet e fituara me vepër penale nga neni 344 i Kodit Penal dhe marrja ose dhënia e kundërligjshme e shpërblimit, dhuratës ose përfitimit nga nenet 214, 314, 315, 428, 429, 430 dhe 431 të Kodit Penal gjithashtu konfiskohen kur:
2. vërtetohen elementet ligjore të veprës penale nga neni 344 i Kodit Penal ose vërtetohet se sende të caktuara janë fituar me vepër penale nga neni 344 i Kodit Penal; ose
3. vërtetohen elemente ligjore të veprës penale nga nenet 214, 314, 315, 428, 429, 430 dhe 431 të Kodit Penal si dhe dhënia ose marrja e shpërblimit, dhuratës ose dobisë tjetër pasurore.
4. Me kërkesë të arsyetuar të prokurorit të shtetit, gjykata merr aktvendim të posaçëm për konfiskim nga paragrafi 1. i këtij neni. Prokurori i shtetit në kërkesë shënon të gjitha të dhënat dhe rrethanat e rëndësishme për përcaktimin e dobisë pasurore të fituar me vepër penale, të sendeve të fituara nga vepra penale ose dhënies të kundërligjshme të shpërblimit, dhuratës apo përfitimit.
5. Kopja e vërtetuar e aktvendimit me shkrim nga paragrafi 2. i këtij neni i dërgohet pronarit të parave ose pasurisë së konfiskuar nëse ai dihet. Kur pronari nuk dihet, aktvendimi shpallet në stendën e gjykatës dhe pas tetë ditëve konsiderohet se i është dorëzuar pronarit të panjohur.
6. Pronarët e parave ose të pasurisë së konfiskuar kanë të drejtë ankese kundër aktvendimit nga paragrafi 2. i këtij neni kur ata mendojnë se nuk ka bazë ligjore për konfiskim.

Neni 282
Pasuria që i nënshtrohet automatikisht konfiskimit

1. Pasuria që është qenësisht e rrezikshme ose e paligjshme i nënshtrohet automatikisht konfiskimit, pa marrë parasysh gjetjet e gjyqtarit të vetëm gjykues ose trupit gjykues lidhur me fajësinë apo pafajësinë e të pandehurit. Poseduesi, shfrytëzuesi ose i pandehuri nuk ka të drejtë ankese.
2. Pasuria nga paragrafi 1. të këtij neni përfshinë:
   2.1. armët të cilat janë krijuar apo përdorur në veprën penale nga nenet 371 deri 376 të Kodit Penal.
   2.2. kimikatet, sendet, substancat, pajisjet ose armët që janë krijuar apo përdorur në veprën penale nga nenet 121, 122, 124, 125, 127, 128, 129, 135, 136, 137, 138, 139, 140, 143, 144, 147, 148, 149, 150, 151, 152, 153, 158, 159, 161, 163, 172, 173, 174, 175, ose 176 të Kodit Penal.
   2.3. kimikatet ose substancat e krijuara apo të përdorura në veprën penale nga nenet 262, 263, 264, 265, 266, 269, 270, 346, 347, 348, 350, 353, 354 ose 355 të Kodit Penal, si dhe kafshët, të lashtat, ushqimi apo uji i kontaminuar me vepër penale.
   2.4. kimikatet, fabrikat, pajisjet laboratorike apo substancat e krijuara apo të përdorura në veprën penale nga nenet 272-280 të Kodit Penal.
   2.5. paratë apo sendet e falsifikuara të krijuara apo të përdorura në veprën penale nga neni 292, 293, 301 303 ose i Kodit Penal.
3. Për sendet e cekura në paragrafin 2. të këtij neni të cilat janë të nevojshme për shfrytëzim si prova në shqyrtim gjyqësor, sendi shkatërrohet ose në ndonjë mënyrë tjetër sigurohet, por fotografitë, testet laboratorike ose ekspertiza shërbejnë si prova të pranueshme për ekzistimin, identitetin dhe përbërjen e mjetet qenësisht të rrezikshëm. Për sendet nga paragrafi 2, nën-paragrafët 2.2., 2.3., 2.4. dhe 2.5., të këtij neni një mostër e vogël ruhet.
4. Policia njofton prokurorin e shtetit për veprimet e ndërmarra sipas paragrafit 3. të këtij neni brenda njëzet e katër (24) orëve.

Neni 283
Provat që kërkohen për konfiskimin e pasurisë së përdorur, në kryerjen e veprës penale

1. Para se gjykata të jep urdhrin përfundimtar për konfiskimin penal të ndërtesës, pasurisë së paluajtshme, pasurisë së luajtshme apo asetit të përcaktuar në aktakuzë, në aktakuzë duhet të pretendohet dhe prokurori i shtetit duhet të provojë në shqyrtim gjyqësor se ndërtesa, sendi i paluajtshëm, sendi i luajtshëm ose aseti është përdorur në kryerjen e veprës penale.
2. Për qëllim të këtij neni, ndërtesa, pasuria e paluajtshme, pasuria e luajtshme ose aseti është përdor në vepër penale nëse:
   2.1. ndërtesa, pasuria e paluajtshme, pasuria e luajtshme ose aseti është përdorur drejtpërdrejt për kryerjen e veprimit në mbështetje të veprës penale;
   2.2. ndërtesa, pasuria e paluajtshme, pasuria e luajtshme ose aseti ka ofruar strehimin e nevojshëm për kryerjen e veprimit në mbështetje të veprës penale;

2.3. ndërtesa, pasuria e paluajtshme, pasuria e luajtshme ose aseti është përdorur për financimin e veprimit apo veprimeve në mbështetje të veprës penale; ose
2.4. ndërtesa, pasuria e paluajtshme, pasuria e luajtshme ose aseti është i nevojshëm për të lehtësuar veprimin në mbështetje të veprës penale. Ndërtesa, sendi i paluajtshëm, sendi i luajtshëm ose aseti është i nevojshëm për lehtësimin e veprimit nëse vepra penale nuk do të kishte ndodhur po të mos ishte përdorur ndërtesa, sendi i paluajtshëm, sendi i luajtshëm apo aseti.

3. Prokurori i shtetit, i dëmtuari ose i pandehuri mund të merr në pyetje dëshmitarët dhe të paraqesë prova në shqyrtim gjyqësor për të mbështetur apo kundërshtuar dëshmitë nga paragrafi 1. të këtij neni.
4. Në raportin nga neni 148 i këtij Kodi dhe gjatë dëshmisë në shqyrtim gjyqësor, eksperti financiar i kualifikuar mund të shpreh mendimin e tij nëse ndërtesa, sendi i paluajtshëm, sendi i luajtshëm apo aseti i përcaktuar në aktakuzë është rrjedhojë e veprës penale që është nën hetim.
5. Nëse i dëmtuari ka paraqitur kërkesë pasurore juridike për rikthimin e sendit të humbur nga vepra penale ose për kompensimin monetar ekuivalent për vlerën e sendit, kjo kërkesë pasurore juridike mund të mbështet dëshminë që kërkohet në paragrafin 1., por nuk mund të merret si provë e vetme apo vendimtare nga paragrafi 1. i këtij neni.

Neni 284
Urdhri i arsyetuar për konfiskimin e pasurisë

1. Gjyqtari i vetëm gjykues ose trupi gjykues, së bashku me aktgjykimin lëshon edhe urdhrin e arsyetuar që përcakton nëse duhet të konfiskohen apo të lirohen ndërtesat, pasuritë e paluajtshme, pasuritë e luajtshme apo asetet e përcaktuara në aktakuzë, në pajtim me nenin 241, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.9. të këtij Kodi
2. Çdo ndërtesë, pasuri e paluajtshme, pasuri e luajtshme apo aset i përcaktuar në aktakuzë në pajtim me nenin 241, paragrafi 1. nën-paragrafi 1.9. të këtij Kodi duhet të shqyrtohet veçmas në urdhrin nga paragrafi 1. të këtij neni.
3. Prokurori i shtetit mund të kërkojë që ndërtesa, pasuria e paluajtshme, pasuria e luajtshme ose aseti të shitet apo të likuidohet. Mjetet e grumbulluara nga shitja apo likuidimi përdoren në pajtim me paragrafin 5. të këtij neni.
4. Prokurori i shtetit mund të kërkojë që ndërtesa, pasuria e paluajtshme, pasuria e luajtshme ose aseti të mbahen për shfrytëzim nga Qeveria e Kosovës.
5. Nëse mjetet konfiskohen drejtpërdrejt apo nëpërmjet paragrafit 3. të këtij neni, prokurori i shtetit, i dëmtuari ose mbrojtësi i viktimave mund të kërkojë që mjetet të përdoren për kompensimin e të dëmtuarit. Mjetet e mbetura i kalohen buxhetit të shtetit.
6. Urdhri nga paragrafi 1. i këtij neni udhëzon Agjencinë për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar ose të Konfiskuar që të shesë, likuidojë ose të mbajë ndërtesën, pasurinë e paluajtshme, pasurinë e luajtshme ose asetin. Nëse paraqitet kërkesë nga paragrafi 5. të këtij neni. I këtij neni, gjykata mund të urdhërojë kompensimin e të dëmtuarit. Gjyqtari i vetëm gjykues ose trupi gjykues mund të përcaktojë kushte shtesë lidhur më përdorimin e pasurisë, nëse pasuria mbahet nga Qeveria.
7. Urdhri i dërgohet cilitdo person që ka të drejtë pronësore në ndërtesën, pasurinë e paluajtshme, pasurinë e luajtshme ose asetin, i cili mund të ankimojë urdhrin.

8. Nëse nuk paraqitet ankesë kundër urdhrin brenda një (1) jave, urdhri i dërgohet për ekzekutim Agjencisë për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar ose të Konfiskuar.

KAPITULLI XIX
SHQYRTIMI GJYQËSOR

1. Përgatitja për shqyrtim gjyqësor

Neni 285
Caktimi i shqyrtimit gjyqësor

1. Gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues me urdhër cakton ditën, orën dhe vendin e shqyrtimit gjyqësor në pajtim me nenin 254 të këtij Kodi.
2. Gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues cakton fillimin e shqyrtimin gjyqësor brenda një (1) muaji nga shqyrtimi i dytë ose nga urdhri i fundit i lëshuar nga neni 254, paragrafi 5. i këtij Kodi.
3. Nëse gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues çmon se shqyrtimi gjyqësor nuk mund të mbahet brenda afati kohor të përcaktuar në paragrafin 2. të këtij neni, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues nxjerr aktvendim për shtyrjen e shqyrtimit gjyqësor deri në datën e parë të mundshme.
4. Nëse gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues çmon se shqyrtimi gjyqësor nuk mund të mbahet brenda afati kohor të përcaktuar në paragrafin 2. të këtij neni për shkak të mungesës së të pandehurit, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues lëshon urdhërarrest për të pandehurin. Nëse i pandehuri nuk ka qenë i pranishëm në shqyrtimin fillestar apo shqyrtimin e dytë, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues nxjerr aktvendim për pezullimin e shqyrtimit gjyqësor për shkak të mungesës së të pandehurit. Shqyrtimi gjyqësor rifillon kur arrestohet i pandehuri.

Neni 286
Vendi i mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor

1. Shqyrtimi gjyqësor mbahet në selinë e gjykatës dhe në ndërtesën e gjykatës.
2. Kur në raste të caktuara, lokalet në ndërtesën e gjykatës nuk janë të përshtatshme për mbajtjen e shqyrtimit gjyqësor për shkak të mungesës së hapësirës ose për shkaqe tjera të arsyeshme, kryetari i gjykatës mund të caktojë që shqyrtimi gjyqësor të mbahet në ndonjë ndërtesë tjetër.

Neni 287
Personat e thirrur në shqyrtim gjyqësor

1. Në shqyrtim gjyqësor thirret i akuzuari dhe mbrojtësi i tij, prokurori i shtetit, i dëmtuari dhe përfaqësuesit e tyre ligjor, përfaqësuesit e autorizuar si dhe përkthyesi. Dëshmitarët dhe ekspertët e propozuar nga prokurori i shtetit në aktakuzë dhe nga i akuzuari sipas nenit 256 të këtij Kodi thirren po ashtu në shqyrtimin gjyqësor.

2. Lidhur me përmbajtjen e thirrjes për të akuzuarin dhe dëshmitarët zbatohen nenet 174 dhe 132 të këtij Kodi. Në thirrje, të akuzuarit i bëhet me dije se do të konsiderohet se ka hequr dorë nga ankesa nëse nuk e paralajmëron ankesën brenda tetë (8) ditëve nga dita e shpalljes së aktgjykimit. Kur mbrojtja nuk është e detyrueshme, i akuzuari në thirrje udhëzohet për të drejtën e tij në mbrojtës, por shqyrtimi gjyqësor nuk mund të shtyhet nëse mbrojtësi nuk vjen në shqyrtimin gjyqësor ose për shkak se i akuzuari ka angazhuar mbrojtës në shqyrtimin gjyqësor.
3. Të akuzuarit i dërgohet thirrja jo më vonë se tetë (8) ditë para shqyrtimit gjyqësor që ai të ketë kohë të mjaftueshme ndërmjet dërgimit të thirrjes dhe ditës së shqyrtimit gjyqësor për përgatitjen e mbrojtjes. Me kërkesën e të akuzuarit ose të prokurorit të shtetit dhe me pëlqimin e të akuzuarit, ky afat mund të shkurtohet.
4. Gjykata në thirrje e njofton të dëmtuarin i cili nuk thirret si dëshmitar se shqyrtimi gjyqësor do të mbahet edhe pa praninë e tij dhe se deklarata e tij për kërkesën pasurore juridike do të lexohet.
5. I akuzuari, dëshmitari dhe eksperti njoftohen në thirrje për pasojat e mosparaqitjes në shqyrtimin gjyqësor.
6. Me kërkesë të Ombudspersonit të Kosovës, Ombudspersoni gjithashtu njoftohet për shqyrtimin gjyqësor me qëllim të monitorimit të procedurës penale në kufijtë e autorizimeve të tij.

Neni 288
Kërkesat pas caktimit të shqyrtimit gjyqësor

1. Palët, mbrojtësi dhe i dëmtuari edhe pas caktimit të shqyrtimit gjyqësor mund të kërkojnë që në shqyrtim gjyqësor të thirren dëshmitarë dhe ekspertë të rinj ose të mblidhen prova të reja. Kërkesa e palëve duhet të jetë e arsyetuar dhe të shënojë se cilat fakte duhet provuar dhe me cilat prova të propozuara.
2. Gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues aprovon kërkesën nga paragrafi 1. i këtij neni nëse dëshmitari i ri, eksperti i ri apo prova e re ka qenë e panjohur në kohën e shqyrtimit të dytë, ose nuk e përsërit në mënyrë të konsiderueshme dëshmitarin, ekspertin apo provën tjetër dhe e drejta e të pandehurit në gjykim të drejtë mund të dëmtohet duke refuzuar kërkesën.
3. Nëse gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues e refuzon kërkesën për mbledhjen e provave të reja, refuzimi i tillë mund të ankimohet brenda dyzet e tetë (48) orëve nga pranimi i urdhrit për refuzimin e kërkesës.
4. Palët dhe mbrojtësi njoftohen për vendimin me të cilin urdhërohet mbledhja e provave të reja para fillimit të shqyrtimit gjyqësor.

Neni 289
Gjyqtarët zëvendësues

Nëse parashihet se shqyrtimi gjyqësor do të zgjasë, kryetari i trupit gjykues mund të kërkojë nga kryetari i gjykatës të caktojë një gjyqtar për të marrë pjesë në shqyrtim gjyqësor në mënyrë që të zëvendësojë anëtarët e trupit gjykues në rast se nuk mund të marrin pjesë në shqyrtim gjyqësor. Ky gjyqtar quhet gjyqtar zëvendësues. Nëse mundësia hetuese e veçantë është zbatuar gjatë procedurës penale, një nga dy (2)

gjyqtarët që kanë shërbyer në atë kolegj, por që nuk kanë qenë gjyqtar në procedurë paraprake, shërben si anëtar i trupit gjykues ndërsa tjetri si gjyqtar zëvendësues.

Neni 290
Marrja në pyetje e dëshmitarëve ose ekspertëve jashtë gjykimit

1. Kur dëshmitari ose eksperti i thirrur në shqyrtim gjyqësor nuk mund të paraqitet për shkak të sëmundjes kronike ose për shkak të pengesave të tjera, dëshmitari i tillë ose eksperti mund të merret në pyetje në vendin ku ai banon, përveç nëse dëshmitari apo eksperti i tillë është marrë në pyetje gjatë mundësisë hetuese të veçantë.
2. Palët, mbrojtësi dhe i dëmtuari njoftohen për kohën dhe vendin e marrjes në pyetje nëse kjo është e mundshme duke pasur parasysh ngutin e procedurës. Nëse i akuzuari ndodhet në paraburgim, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues vendos nëse prania e tij gjatë marrjes në pyetje është e nevojshme, duke siguruar që në mungesë të të akuzuarit, mbrojtësi i tij të jetë i pranishëm. Kur palët, mbrojtësi dhe i dëmtuari janë të pranishëm, ata i gëzojnë të drejtat nga neni 149, paragrafi 6. i këtij Kodi.

Neni 291
Shtyrja e shqyrtimit gjyqësor

1. Gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues për shkaqe të rëndësishme mund ta shtyjë ditën e shqyrtimit gjyqësor me propozim të palëve, të mbrojtësit ose sipas detyrës zyrtare.
2. Nëse gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues shtyn ditën e shqyrtimit gjyqësor nga paragrafi 1. i këtij neni, ai mund të caktojë shqyrtime të herëpashershme për të diskutuar rreth statusit të lëndës, çështjeve të pazgjidhura dhe për të siguruar zgjedhjen në kohë të lëndës ose caktimin e shqyrtimit gjyqësor.

Neni 292
Tërheqja e aktakuzës para fillimit të shqyrtimit gjyqësor

1. Prokurori i shtetit mund të tërheqë aktakuzën para fillimit të shqyrtimit gjyqësor, nëse paraqet njoftimin për tërheqjen nga aktakuza. Në rast të tillë, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues, e hedhë aktakuzën.
2. Aktakuza e tërhequr nuk mund të paraqitet sërish nga prokurori i shtetit.

2. Karakteri publik i shqyrtimit gjyqësor

Neni 293
Publiciteti i shqyrtimit gjyqësor

1. Shqyrtimi gjyqësor është i hapur.
2. Në shqyrtim gjyqësor mund të marrin pjesë personat madhor.
3. Personat e pranishëm në shqyrtim gjyqësor nuk mund të mbajnë armë ose mjete të rrezikshme, me përjashtim të zyrtarëve të policisë që ruajnë të akuzuarin, të cilët mund të jenë të armatosur.

Neni 294
Përjashtimi i publikut

1. Nga fillimi deri në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, gjyqtari i vetëm gjykues ose trupi gjykues me propozimin e palëve ose sipas detyrës zyrtare, por gjithnjë pas dëgjimit të tyre, mund të përjashtojë publikun gjatë gjithë shqyrtimit gjyqësor ose nga një pjesë e tij, kur kjo është e nevojshme për:
   1.1. ruajtjen e fshehtësisë zyrtare;
   1.2. ruajtjen e informacionit të fshehtë i cili do të rrezikohej nga shqyrtimi i hapur;
   1.3. ruajtjen e rendit dhe respektimin e ligjit;
   1.4. mbrojtjen e jetës personale ose familjare të të akuzuarit, të dëmtuarit ose të pjesëmarrësve të tjerë në procedurë;
   1.5. mbrojtjen e interesave të fëmijëve; ose
   1.6. mbrojtjen e të dëmtuarve, dëshmitarëve bashkëpunues ose dëshmitarëve, siç parashihet në Kapitullin XIII të këtij Kodi.

Neni 295
Personat që nuk përjashtohen nga shqyrtimi gjyqësor dhe ruajtja e fshehtësisë

1. Përjashtimi i publikut nuk zbatohet për palët, të dëmtuarin, përfaqësuesit e tyre dhe mbrojtësin, përveç nën kushtet e dispozitave për mbrojtjen e të dëmtuarve, dëshmitarëve bashkëpunues ose të dëshmitarëve, siç parashihet në kapitullin XIII të këtij Kodi.
2. Gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues mund të lejojë që në shqyrtimin gjyqësor në të cilën është përjashtuar publiku të marrin pjesë zyrtarë të caktuar, akademikë, figura publike dhe, me kërkesën e të akuzuarit, mund të lejojë pjesëmarrjen e bashkëshortit ose bashkëshortit jashtëmartesor si dhe të afërmit e tij.
3. Gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues paralajmëron personat që marrin pjesë në shqyrtimin gjyqësor të mbyllur se detyrohen të ruajnë fshehtësinë e informatave të cilat i kanë mësuar në shqyrtimin gjyqësor dhe se zbulimi i informatës së tillë përbën vepër penale.

Neni 296
Aktvendimi për përjashtimin e publikut

1. Vendimin për mbajtjen e shqyrtimit gjyqësor të mbyllur e merr gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues me aktvendim, i cili duhet të arsyetohet dhe të shpallet publikisht.
2. Aktvendimi për mbajtjen e seancës së mbyllur mund të kundërshtohet vetëm me ankesë kundër aktgjykimit.

3. Zbatimi i shqyrtimit gjyqësor

Neni 297
Shqyrtimi gjyqësor para gjyqtarit të vetëm gjykues

1. Gjyqtari i vetëm gjykues, procesmbajtësi dhe gjyqtari zëvendësues i caktuar duhet të jenë vazhdimisht të pranishëm në shqyrtimin gjyqësor që mbahet para gjyqtarit të vetëm gjykues.
2. Gjyqtari i vetëm gjykues detyrohet të vërtetojë nëse gjykata është përbërë në pajtim me ligjin dhe nëse ka arsye për përjashtimin e procesmbajtësit.

Neni 298
Shqyrtimi gjyqësor para trupit gjykues

1. Kryetari i trupit gjykues, anëtarët e trupit gjykues, procesmbajtësi dhe gjyqtari zëvendësues i caktuar duhet të jenë vazhdimisht të pranishëm në shqyrtimin gjyqësor që mbahet para trupit gjykues.
2. Kryetari i trupit gjykues detyrohet të vërtetojë nëse trupi gjykues është përbërë në pajtim me ligjin dhe nëse ka arsye për përjashtimin e anëtarit të trupit gjykues ose procesmbajtësit.

Neni 299
Kryesimi i shqyrtimit gjyqësor nga gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues

1. Gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues drejton shqyrtimin gjyqësor dhe fton palët, të dëmtuarin, përfaqësuesit ligjorë, përfaqësuesit e autorizuar, mbrojtësin dhe ekspertët për t'i prezantuar dëshmitë e tyre ose për të parashtruar pyetje.
2. Anëtarët e trupit gjykues mund t'i parashtrojnë pyetje cilitdo dëshmitar apo ekspert.
3. Gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues detyrohet të kujdeset për shqyrtimin e gjithanshëm dhe të drejtë të çështjes në pajtim me administrimin e provave siç parashihet me këtë Kod.
4. Gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues siguron që provat të merren në pajtim me Kapitullin XVI të këtij Kodi.
5. Gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues vendos për propozimet e palëve.
6. Aktvendimet e gjyqtarit të vetëm gjykues ose kryetarit të trupit gjykues gjithmonë shpallen dhe shënohen në procesverbal të shqyrtimit gjyqësor me sqarim të shkurtër.

Neni 300
Radha e shqyrtimit të provave në shqyrtimin gjyqësor

Shqyrtimi gjyqësor zbatohet sipas rregullave të parapara me këtë Kod. Por, për shkaqe të arsyeshme, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues mund të ndryshojë

radhën e zakonshme të shqyrtimit të provave, sidomos për shkak të numrit të të akuzuarve, numrit të veprave penale ose të vëllimit të materialit provues.

Neni 301
Mbajtja e rendit dhe mediat në gjykatore

1. Gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues detyrohet të kujdeset për mbajtjen e rendit në gjykatore dhe dinjitetin e gjykatës. Ai menjëherë pas hapjes së seancës paralajmëron personat e pranishëm në shqyrtimin gjyqësor që të sillen si duhet dhe të mos e pengojnë punën e gjykatës. Gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues mund të urdhërojë kontrollin personal të personave të pranishëm në shqyrtimin gjyqësor.
2. Gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues mund të urdhërojë largimin e publikut nga shqyrtimi gjyqësor, kur me masat për mbajtjen e rendit të parapara me këtë Kod nuk është e mundur të sigurohet mbajtja pa pengesë e shqyrtimit gjyqësor.
3. Fotografimi, filmimi, regjistrimi televiziv dhe regjistrime të tjera përpos regjistrimit zyrtar të shqyrtimit gjyqësor lejohen, përveç nëse gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues kufizon fotografimin, filmimin, regjistrimin televiziv ose regjistrimet tjera me aktvendim të arsyetuar me shkrim.

Neni 302
Prishja e rendit dhe mosbindja ndaj urdhrave të gjykatës

1. Kur i akuzuari, mbrojtësi, i dëmtuari, përfaqësuesi ligjor ose përfaqësuesi i autorizuar, dëshmitari, eksperti, përkthyesi ose personi tjetër që merr pjesë në shqyrtim gjyqësor prish rendin ose nuk u bindet urdhrave të gjyqtarit të vetëm gjykues ose kryetarit të trupit gjykues për mbajtjen e rendit, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues ia tërheq vërejtjen. Kur vërejtja është e pasuksesshme, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues mund të urdhërojë që i akuzuari të nxirret jashtë gjykatores, kurse personat tjerë jo vetëm që mund t'i nxjerrë jashtë, por mund t'i dënojë me gjobë deri në njëmijë (1.000) Euro.
2. Me urdhër të gjyqtarit të vetëm gjykues ose kryetarit të trupit gjykues, i akuzuari mund të nxirret përkohësisht nga gjykatorja, por nëse ai është marrë në pyetje në shqyrtimin gjyqësor, atëherë mund të nxirret gjatë tërë kohës së shqyrtimit të provave. Para përfundimit të procedurës së provave, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues thërret të akuzuarin dhe e njofton për rrjedhën e shqyrtimit gjyqësor. Kur i akuzuari vazhdon të prishë rendin dhe të ofendojë dinjitetin e gjykatës, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues përsëri mund ta nxjerrë nga seanca. Në këtë rast, seanca përfundon pa praninë e të akuzuarit, kurse aktgjykimin ia komunikon gjyqtari i vetëm gjykues, kryetari i trupit gjykues ose gjyqtari anëtar i trupit gjykues në praninë e procesmbajtësit.
3. Mbrojtësit ose përfaqësuesit të autorizuar, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues mund t'ia mohojë të drejtën për të mbrojtur ose përfaqësuar klientët e tyre në shqyrtim gjyqësor kur pas dënimit ata vazhdojnë të prishin rendin dhe në këtë rast kërkon nga pala që të angazhojë një mbrojtës tjetër apo përfaqësues të autorizuar. Kur i akuzuari nuk mund të angazhojë mbrojtës tjetër menjëherë, apo

kur gjykata atë nuk mund ta caktojë më vonë pa e dëmtuar mbrojtjen, shqyrtimi gjyqësor ndërpritet ose shtyhet. Aktvendimi për këtë çështje së bashku me arsyetimin shënohet në procesverbalin e shqyrtimit gjyqësor. Kundër këtij aktvendimi nuk lejohet ankesë e veçantë.

4. Kur prokurori i shtetit e prish rendin, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues për këtë e njofton mbikëqyrësin e prokurorit të shtetit dhe gjithashtu mund të pezullojë shqyrtimin gjyqësor dhe të kërkojë nga mbikëqyrësi i prokurorit të shtetit që për këtë çështje të caktojë një prokuror tjetër të shtetit.
5. Kur gjykata e largon nga gjykatorja ose e gjobit anëtarin e Odës së Avokatëve apo avokatin praktikant për prishjen e rendit, për këtë e njofton Odën e Avokatëve.

Neni 303
Ankesat kundër aktvendimeve në shqyrtim gjyqësor

1. Kundër aktvendimit për dënimin lejohet ankesë dhe gjyqtari i vetëm gjykues ose trupi gjykues mund ta revokojë aktvendimin e tillë.
2. Kundër aktvendimeve lidhur me mbajtjen e rendit dhe drejtimin e shqyrtimit gjyqësor nuk lejohet ankesë.

Neni 304
Veprat penale të kryera në shqyrtim gjyqësor

1. Kur i akuzuari kryen vepër penale në shqyrtim gjyqësor, zbatohen dispozitat e nenit 351 të këtij Kodi.
2. Kur personi, përpos të akuzuarit, kryen vepër penale në seancë të shqyrtimit gjyqësor, gjyqtari i vetëm gjykues ose trupi gjykues në bazë të akuzës gojore të prokurorit të shtetit mund ta ndërpresë shqyrtimin gjyqësor dhe menjëherë të gjykojë veprën e kryer penale ose ta shqyrtojë këtë pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor.
3. Kur ka arsye për të dyshuar se dëshmitari ose eksperti ka dhënë dëshmi të rreme në shqyrtim gjyqësor, vepra e tillë penale nuk gjykohet menjëherë. Në rastin e tillë, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues mund të urdhërojë që për dëshminë e dëshmitarit apo të ekspertit të përpilohet procesverbal i veçantë, i cili i dërgohet prokurorit të shtetit.
4. Kur nuk është e mundur që kryerësi i veprës penale i cili ndiqet sipas detyrës zyrtare të gjykohet menjëherë, njoftohet prokurori i shtetit që është kompetent për ndërmarrjen e veprimeve të mëtejshme.

4. Parakushtet për mbajtjen e shqyrtimit gjyqësor

Neni 305
Hapja e seancës

Gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues hap seancën, shpall çështjen për gjykim në shqyrtim gjyqësor dhe përbërjen e trupit gjykues, nëse seanca mbahet nga trupi gjykues. Pastaj konstaton nëse kanë ardhur të gjithë personat e thirrur dhe kur nuk

kanë ardhur, verifikon se a u janë dorëzuar thirrjet dhe a i kanë arsyetuar mungesat e tyre.

Neni 306
Mosparaqitja e prokurorit të shtetit në shqyrtim gjyqësor

Kur prokurori i shtetit nuk paraqitet në shqyrtim gjyqësor të caktuar në bazë të aktakuzës së prokurorit të shtetit, shqyrtimi gjyqësor shtyhet dhe për këtë gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues e njofton kryeprokurorin e prokurorit të shtetit.

Neni 307
Mosparaqitja e të akuzuarit në shqyrtim gjyqësor

1. Kur i akuzuari i thirrur me rregull nuk paraqitet në shqyrtim gjyqësor dhe nuk e arsyeton mungesën, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues për të akuzuarin lëshon urdhërarrest në pajtim me nenin 175 të këtij Kodi. Kur i akuzuari nuk mund të sillet menjëherë, gjyqtari i vetëm gjykues ose trupi gjykues e shtyn shqyrtimin gjyqësor dhe urdhëron që i akuzuari në seancën e ardhshme të sillet me forcë. Kur i akuzuari e arsyeton mungesën para arrestimit të tij, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues e revokon urdhërarrestin.
2. Kur shihet qartazi se i akuzuari i thirrur me rregull i shmanget paraqitjes së tij në shqyrtim gjyqësor dhe nuk ekzistojnë shkaqe për paraburgimin e tij nga neni 187 i këtij Kodi, gjyqtari i vetëm gjykues ose trupi gjykues mund të caktojë paraburgim për sigurimin e pranisë së të akuzuarit në shqyrtimin gjyqësor. Ankesa nuk e pezullon ekzekutimin e aktvendimit. Për paraburgimin i cili është caktuar për këto shkaqe, përshtatshmërisht zbatohen dispozitat e neneve 185 deri 203 të këtij Kodi. Po qe se paraburgimi i tillë nuk hiqet më parë, ai zgjat derisa të shpallet aktgjykimi, por jo më shumë se një (1) muaj.

Neni 308
Mosparaqitja e mbrojtësit në shqyrtim gjyqësor

Kur në shqyrtim gjyqësor nuk paraqitet mbrojtësi i thirrur me rregull dhe për arsyet e mosardhjes nuk e njofton gjykatën posa të ketë mësuar për ato, ose nëse mbrojtësi lëshon shqyrtimin gjyqësor pa lejen e gjyqtarit të vetëm gjykues apo të trupit gjykues, gjykata kërkon menjëherë nga i akuzuari që të angazhojë mbrojtës tjetër. Nëse i akuzuari nuk e bën këtë, kurse caktimi i mbrojtësit nuk mund të bëhet pa e dëmtuar mbrojtjen, shqyrtimi gjyqësor shtyhet.

Neni 309
Mosparaqitja e dëshmitarit apo ekspertit në shqyrtim gjyqësor

1. Kur dëshmitari ose eksperti i thirrur me rregull nuk paraqitet në shqyrtim gjyqësor pa arsye, gjyqtari i vetëm gjykues ose trupi gjykues mund të urdhërojë sjelljen e tij të menjëhershme me forcë.

2. Shqyrtimi gjyqësor mund të fillojë edhe pa praninë e dëshmitarit ose ekspertit të thirrur. Në rast të tillë, gjyqtari i vetëm gjykues ose trupi gjykues gjatë shqyrtimit gjyqësor vendos nëse shqyrtimi gjyqësor duhet të vazhdojë ose të ndërpritet apo të shtyhet për shkak të mungesës së dëshmitarit ose të ekspertit.

5. Shtyrja dhe ndërprerja e shqyrtimit gjyqësor

Neni 310
Arsyet për shtyrjen e shqyrtimit gjyqësor

1. Përveç rasteve të përcaktuara me këtë Kod, shqyrtimi gjyqësor mund të shtyhet me aktvendim të gjyqtarit të vetëm gjykues apo të trupit gjykues, kur duhet mbledhur prova të reja ose kur gjatë shqyrtimit gjyqësor vërtetohet se tek i akuzuar, pas kryerjes së veprës penale është paraqitur çrregullim ose paaftësi mendore e përkohshme ose kur ekzistojnë pengesa të tjera për zbatim të suksesshëm të shqyrtimit gjyqësor.
2. Kur është e mundur, në aktvendim me të cilin shtyhet shqyrtimi gjyqësor caktohet dita dhe ora e vazhdimit të shqyrtimit gjyqësor. Me të njëjtin aktvendim, gjyqtari i vetëm gjykues ose trupi gjykues mund të urdhërojë mbledhjen provave të cilat me kalimin e kohës mund të humbin.
3. Kundër aktvendimit nga paragrafi 2. i këtij neni nuk lejohet ankesë.

Neni 311
Ndryshimi i përbërjes së trupit gjykues gjatë shtyrjes

1. Kur përbërja e trupit gjykues është ndryshuar, shqyrtimi gjyqësor i shtyrë fillon rishtas. Por, në rastin e tillë, trupi gjykues pas dëgjimit të palëve mund të vendosë që dëshmitarët dhe ekspertët të mos merren sërish në pyetje dhe të mos bëhet këqyrja e re e vendit, por të lexohen deklarimet e dëshmitarëve dhe ekspertëve të dhëna në shqyrtimin e mëparshëm gjyqësor apo të lexohet procesverbali i këqyrjes së vendit.
2. Kur përbërja e trupit gjykues nuk ka ndryshuar, shqyrtimi gjyqësor i shtyrë vazhdohet para të njëjtit trup gjykues dhe kryetari i trupit gjykues shkurtimisht paraqet rrjedhën e shqyrtimit gjyqësor të mëparshëm. Por, edhe në këtë rast, trupi gjykues mund të caktojë që shqyrtimi gjyqësor të fillojë rishtas.
3. Kur shtyrja ka zgjatur më shumë se tre (3) muaj ose kur shqyrtimi gjyqësor mbahet para një kryetari tjetër të trupit gjykues, shqyrtimi gjyqësor duhet të fillojë rishtas dhe përsëri të shqyrtohen të gjitha provat.

Neni 312
Ndërprerja e shqyrtimit gjyqësor

1. Përveç rasteve të përcaktuara me këtë Kod, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues mund të ndërpresë shqyrtimin gjyqësor për pushim për shkak të kalimit të orarit të punës, për të lejuar një kohë të shkurtër që të sigurohet provë konkrete ose për përgatitjen e akuzës apo mbrojtjes.

2. Shqyrtimi gjyqësor i ndërprerë gjithmonë vazhdon para të njëjtit gjyqtar të vetëm gjykues apo trup gjykues.
3. Kur shqyrtimi gjyqësor nuk mund të vazhdojë para të njëjtit trup gjykues, ose kur ndërprerja e tij zgjat më tepër se tetë (8) ditë, atëherë zbatohen dispozitat nga neni 311 i këtij Kodi.

Neni 313
Ndryshimi i përbërjes së trupit gjykues për shkak të mungesë së kompetencës

Kur gjatë shqyrtimit gjyqësor të drejtuar nga gjyqtari i vetëm gjykues, faktet në të cilat bazohet akuza tregojnë se për shqyrtimin e asaj vepre penale është kompetent trupi gjykues prej tre (3) gjyqtarëve, gjykimi i kalohet trupit përkatës në kuadër të gjykatës themelore dhe shqyrtimi gjyqësor fillon rishtas.

Neni 314
Koha për përfundimin e shqyrtimit gjyqësor

1. Përveç në rastet kur gjyqtari i vetëm gjykues ose trupi gjykues shtyn shqyrtimin gjyqësor nga neni 310 i këtij Kodi, shqyrtimi gjyqësor duhet të përfundojë brenda këtyre afateve kohore:
   1.1. nëse shqyrtimit gjyqësor mbahet para gjyqtarit të vetëm gjykues, shqyrtimi gjyqësor duhet të përfundohet brenda nëntëdhjetë (90) ditësh, përveç nëse gjyqtari i vetëm gjykues nxjerr aktvendim të arsyetuar për vazhdimin e kohës për shqyrtim gjyqësor për shkak të ndonjërës prej arsyeve nga paragrafi 2. i këtij neni;
   1.2. nëse shqyrtimit gjyqësor mbahet para trupit gjykues, shqyrtimi gjyqësor duhet të përfundohet brenda njëqindenjëzet (120) ditësh, përveç nëse trupi gjykues nxjerr aktvendim të arsyetuar për vazhdimin e kohës për shqyrtim gjyqësor për shkak të ndonjërës prej arsyeve nga paragrafi 2. i këtij neni.
2. Shqyrtimi gjyqësor mund të vazhdohet me aktvendimin të arsyetuar nga paragrafi 1. i këtij neni kur ekzistojnë rrethana të cilat kërkojnë më shumë kohë, përfshirë por pa u kufizuar në:
   2.1. numër të shumtë të dëshmitarëve;
   2.2. dëshmia e një apo më shumë dëshmitarëve është shumë e gjatë;
   2.3. numri i provave është jashtëzakonisht i madh;
   2.4. siguria e shqyrtimit gjyqësor bën të nevojshme vazhdimin.
3. Shqyrtimi gjyqësor mund të vazhdohet për tridhjetë (30) ditë për secilin aktvendim nga paragrafi 1. i këtij neni.

6. Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor

Neni 315
Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor

1. Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor duhet të përpilohet me shkrim. Në procesverbal duhet të shënohet thelbi i rrjedhës së shqyrtimit gjyqësor.

2. Përveç kësaj, shqyrtimi gjyqësor regjistrohet në mënyrë audio ose video ose në mënyrë stenografike, përveç nëse ka shkaqe të arsyeshme për të mos bërë një gjë të tillë.
3. Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor përfshin kopjen e transkriptit të regjistrimit audio të shqyrtimit gjyqësor dhe shënimin mbi rrjedhën e shqyrtimit gjyqësor, pjesët kryesore të tij dhe vendimet e marra, siç parashihet në nenet 317, 318 dhe 319 të këtij Kodi.
4. Kur i akuzuari është dënuar me burgim ose pas paralajmërimit të paraqitjes së ankesës në një shkallë më të lartë, regjistrimet audio ose video të shqyrtimit gjyqësor përshkruhen tërësisht brenda tri (3) ditëve të punës nga përfundimi i shqyrtimit gjyqësor. Ky afat mund të zgjatet nga gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues kur ekzistojnë rrethana të arsyeshme për një afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve. Gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues rishikon dhe konfirmon përshkrimin dhe atë e vendos në procesverbal si pjesë përbërëse të procesverbalit të shqyrtimit gjyqësor.
5. Për mënyrën e regjistrimit të shqyrtimi gjyqësor vendos gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues.

Neni 316
Procesverbali tekstual

1. Kur shqyrtimi gjyqësor regjistrohet vetëm me shkrim, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues, me propozim të palës ose sipas detyrës zyrtare, mund të urdhërojë që deklarimet që i konsideron të një rëndësie të veçantë të përfshihen tekstualisht në procesverbal.
2. Kur është e nevojshme, dhe veçanërisht kur deklarimi është shënuar tekstualisht në procesverbal, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues mund të urdhërojë që pjesë të caktuara të procesverbalit të lexohen menjëherë. Deklarimet e regjistruara tekstualisht lexohen menjëherë kur kërkon pala, mbrojtësi ose personi deklarimi i të cilit është përfshirë në procesverbal.

Neni 317
Kontrollimi, korrigjimi dhe nënshkrimi i procesverbalit të shqyrtimit gjyqësor, shqyrtimit fillestar dhe shqyrtimit të dytë

1. Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor, shqyrtimit fillestar dhe shqyrtimit të dytë përfundohet me mbarimin e seancës. Ai nënshkruhet nga procesmbajtësi, gjyqtari i vetëm gjykues, kryetari i trupit gjykues dhe palët e pranishme.
2. Palët kanë të drejtë të kontrollojnë procesverbalin e përfunduar dhe pjesët shtojcë, të bëjnë komente mbi përmbajtjen dhe të kërkojnë korrigjimin e tij.
3. Korrigjimet e emrave të shënuar gabimisht, të numrave jo të saktë dhe të gabimeve të qarta në shkrim mund të bëhen me urdhrin e gjyqtarit të vetëm gjykues ose kryetarit të trupit gjykues sipas detyrës zyrtare apo sipas propozimit të palës ose të personit që merret në pyetje. Korrigjime ose shtesa të tjera në procesverbal mund të urdhërohen vetëm nga gjyqtari i vetëm gjykues ose trupi gjykues.
4. Komentet dhe propozimet e palëve lidhur me procesverbalin, si dhe korrigjimet dhe

ndryshimet në procesverbal përfshihen si shtojcë në procesverbalin e përfunduar. Në shtojcë shënohen arsyet e mospranimit të sugjerimeve dhe komenteve të caktuara. Shtojcën e procesverbalit e nënshkruajnë procesmbajtësi dhe gjyqtari i vetëm gjykues apo kryetari i trupit gjykues.

Neni 318
Përmbajtja e procesverbalit të shqyrtimit gjyqësor

1. Pjesa hyrëse e procesverbalit të shqyrtimit gjyqësor duhet të përfshijë: gjykatën ku mbahet shqyrtimi gjyqësor, numrin e lëndës, vendin dhe kohën e seancës, emrin e gjyqtarit të vetëm gjykues ose kryetarit të trupit gjykues, të anëtarëve të trupit gjykues, të procesmbajtësit, prokurorit të shtetit, të akuzuarit dhe mbrojtësit të tij, të dëmtuarit dhe përfaqësuesit të tij ligjor ose përfaqësuesit të autorizuar, mbrojtësit të viktimës dhe emrin e përkthyesit, veprën penale që shqyrtohet dhe nëse dëgjimi zbatohet në shqyrtim gjyqësor të hapur apo të mbyllur.
2. Procesverbali veçanërisht përfshin të dhënat vijuese: identifikimin e aktakuzës, nëse prokurori i shtetit e ka ndryshuar apo e zgjeruar aktakuzën, cilat propozime janë bërë nga palët dhe çka është vendosur për to nga gjyqtari i vetëm gjykues apo kryetari i trupit gjykues ose trupi gjykues, cilat prova janë paraqitur, nëse provat ose shkrimet e tjera janë lexuar ose nëse regjistrimi audio dhe regjistrimet tjera janë riprodhuar, si dhe komentet e palëve për këtë. Nëse publiku përjashtohet nga shqyrtimi gjyqësor, në procesverbal shënohet se gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues ka paralajmëruar të pranishmit për pasojat e zbulimit të paautorizuar të informacionit të fshehtë që e kanë mësuar në shqyrtimin gjyqësor.
3. Në procesverbal përfshihet vetëm përmbajtja kryesore e deklarimit të prokurorit, akuzuarit, dëshmitarëve dhe ekspertëve. Me kërkesë të palës, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues urdhëron leximin e një deklarimi të mëparshëm ose ndonjë pjese të tij nga procesverbali.
4. Me kërkesë të palës, në procesverbal shënohet edhe pyetja ose përgjigjja e refuzuar si a palejueshme nga gjyqtari i vetëm gjykues ose trupi gjykues.

Neni 319
Përfshirja e dispozitivit të aktgjykimit në procesverbalin e shqyrtimit gjyqësor

1. Në procesverbal të shqyrtimit gjyqësor në tërësi shënohet dispozitivi i aktgjykimit dhe fakti se aktgjykimi është shpallur publikisht. Formulimi i dispozitivit të shkruar në procesverbal konsiderohet të jetë origjinal.
2. Kur urdhërohet vendim për paraburgim, ky vendim gjithashtu shënohet në procesverbalin e shqyrtimit gjyqësor.

Neni 320
Procesverbali për këshillim dhe votim i trupit gjykues

1. Kur shqyrtimi gjyqësor zbatohet para trupit gjykues:
   1.1. për këshillim dhe votim të trupit gjykues përpilohet procesverbali i veçantë.
   1.2. procesverbali për këshillim dhe votimin e trupit gjykues përfshin rrjedhën e votimit dhe vendimin e marrë.

1.3. procesverbalin e nënshkruajnë të gjithë anëtarët e trupit gjykues dhe procesmbajtësi. Mendimet e ndara i bashkëngjiten procesverbalit për këshillim dhe votim, nëse nuk janë shënuar në procesverbal.

1.4. procesverbali për këshillim dhe votim i trupit gjykues mbyllet në zarf të posaçëm. Qasje në këtë procesverbal ka vetëm gjykata më e lartë kur vendos lidhur me mjetin juridik dhe në këtë rast detyrohet që procesverbalin ta mbyllë përsëri në zarf të posaçëm në të cilin shënon se e ka shqyrtuar procesverbalin.

7. Fillimi i shqyrtimit gjyqësor dhe deklarimi i të akuzuarit

Neni 321
Prania e personave të thirrur në shqyrtim gjyqësor dhe vërtetimi i identitetit të të pandehurit

Kur gjyqtari i vetëm gjykues apo kryetari i trupit gjykues konstaton se në shqyrtim gjyqësor janë të pranishëm të gjithë personat e thirrur, ose kur gjyqtari i vetëm gjykues apo trupi gjykues vendos që shqyrtimi gjyqësor të mbahet në mungesë të ndonjë personi të thirrur apo vendimin për këto çështje e ka lënë për më vonë, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues e thërret të akuzuarin dhe prej tij merr të dhënat personale, përveç të dhënave mbi dënimet e mëparshme, për të vërtetuar identitetin e tij.

Neni 322
Udhëzimet fillestare të gjykatës lidhur me dëshmitarët dhe të dëmtuarit

1. Pasi të vërtetohet identiteti i të akuzuarit, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues i dërgon dëshmitarët dhe ekspertët në vendin e caktuar për ta dhe ata presin derisa të ftohen për të dëshmuar. Në rast nevoje, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues mund t'i ndalë ekspertët në gjykatore që të përcjellin zbatimin e shqyrtimit gjyqësor.
2. Kur i dëmtuari është i pranishëm dhe ende nuk ka paraqitur kërkesën pasurore juridike, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues e udhëzon se mund të paraqesë propozim për realizimin e kësaj kërkese në procedurën penale.
3. Gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues mund të ndërmarrë masat e nevojshme për të penguar marrëveshjen e fshehtë midis dëshmitarëve, ekspertëve dhe palëve.

Neni 323
Udhëzimet për të akuzuarin

1. Gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues e fton të akuzuarin të përcjellë me vëmendje zbatimin e shqyrtimit gjyqësor dhe e udhëzon se mund të paraqesë fakte, t'u shtrojë pyetje të bashkakuzuarve, dëshmitarëve dhe ekspertëve, të bëjë vërejtje dhe të jep shpjegime rreth deklarimeve të tyre.
2. Gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues pastaj e udhëzon të akuzuarin se:

2.1. ka të drejtë të mos deklarohet lidhur me çështjen e tij ose të mos përgjigjet në asnjë pyetje;
2.2. nëse deklarohet lidhur me çështjen, ai nuk detyrohet të inkriminojë vetveten ose të afërmin e tij, e as të pranojë fajësinë; dhe
2.3. ai mund të mbrohet personalisht ose nëpërmjet ndihmës juridike të mbrojtësit sipas zgjedhjes së tij.

Neni 324
Leximi i aktakuzës

Shqyrtimi gjyqësor fillon me leximin e aktakuzës nga prokurori i shtetit kundër të pandehurit. I pandehuri mund të heq dorë nga leximi i akuzave kundër tij.

Neni 325
Deklarimi i të pandehurit për aktakuzën

1. Gjyqtari i vetëm gjykues apo kryetari i trupit gjykues bindet se i akuzuari e kupton aktakuzën dhe të akuzuarit i jep mundësinë të pranojë ose të mos e pranoj fajësinë.
2. Kur i akuzuari nuk e kupton akuzën, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues kërkon nga prokurori që ta shpjegojë atë në mënyrë që i akuzuari të mund ta kuptojë pa vështirësi.
3. Kur i akuzuari nuk dëshiron të bëjë deklaratë lidhur me fajësinë e tij, konsiderohet se nuk e pranon fajësinë.

Neni 326
Pranimi i fajësisë nga i pandehuri në shqyrtim gjyqësor

1. Kur i akuzuari pranon fajësinë për të gjitha pikat e aktakuzës në shqyrtim gjyqësor, trupi gjykues vendos nëse janë përmbushur kërkesat nga neni 248, paragrafi 1. i këtij Kodi.
2. Në shqyrtimin e pranimit të fajësisë së të akuzuarit, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues mund të dëgjojë mendimin e prokurorit të shtetit, të mbrojtësit dhe të dëmtuarit.
3. Kur trupi gjykues vlerëson se kërkesat nga neni 248, paragrafi 1. i këtij Kodi nuk janë përmbushur, atëherë procedohet sikur pranimi i fajësisë të mos ishte bërë.
4. Kur trupi gjykues vlerëson se kërkesat nga neni 248, paragrafi 1. i këtij Kodi janë përmbushur, shqyrtimi gjyqësor vazhdon me fjalën përfundimtare të palëve.
5. Kur ka disa të pandehur dhe një apo më shumë prej tyre pranojnë fajësinë, shqyrtimi gjyqësor vazhdon vetëm për të pandehurit të cilët janë deklaruar të pafajshëm. Gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues shtyn shqiptimin e dënimit për të pandehurit të cilët pranojnë fajësinë në fillim të shqyrtimit gjyqësor deri në përfundim të shqyrtimit gjyqësor. Nëse provat te cilat janë paraqitur ne shqyrtimin gjyqësor e inkriminojnë te pandehurin i cili ka pranuar fajësinë, por nuk janë prova relevante kundër te pandehurve te tjerë te cilët nuk e kane pranuar fajësinë, provat e tilla nuk mund te merren parasysh kundër te pandehurve tjerë.
6. Kur i pandehuri pranon fajësinë sipas marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë, gjyqtari

i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues zbaton përshtatshmërisht nenin 233 dhe nenin 247 të këtij Kodi.

8. Radha e paraqitjes së provave

Neni 327
Rendi i paraqitjes së provave në shqyrtim gjyqësor

1. Provat në shqyrtim gjyqësor paraqiten sipas radhës së mëposhtme:
   1.1. fjala hyrëse;
   1.2. provat e paraqitura nga prokurori i shtetit;
   1.3. provat e paraqitura nga i dëmtuari, nëse ka të dëmtuar;
   1.4. provat e paraqitura nga mbrojtësi; dhe
   1.5. fjala përfundimtare.

9. Fjala hyrëse

Neni 328
Fjala hyrëse

1. Nëse i pandehuri nuk e pranon fajësinë në fillim të shqyrtimit gjyqësor, gjyqtari i vetëm gjykues apo kryetari i trupit gjykues thërret prokurorin e shtetit, të dëmtuarin dhe mbrojtësin për të përmbledhur provat që mbështesin rastin apo kërkesën e tyre. Prokurori i shtetit flet i pari, pastaj i dëmtuari dhe mbrojtësi.
2. Personat në fjalën hyrëse mund t'u referohen provave të pranueshme, ligjit në fuqi dhe mund të përdorin tabela, diagrame, transkripte të kasetave të lejuara nga gjykata, përmbledhje dhe krahasime të provave nëse ato bazohen në prova të pranueshme, si dhe zmadhim të ekzemplarëve të tyre për t'i demonstruar ose për t'i paraqitur si ilustrim në gjykatë.
3. Prezantimi i fjalëve hyrëse nga palët mund të kufizohet në kohë nga gjyqtari i vetëm gjykues apo kryetari i trupit gjykues.

10. Paraqitja e provave

Neni 329
Rregullat e përgjithshme të paraqitjes së provave

1. Prezentimi i provave përfshin të gjitha faktet që gjykata i konsideron të rëndësishme për një gjykim të saktë dhe të drejtë.
2. Gjatë shqyrtimit gjyqësor zbatohen rregullat e procedimit të provave të parapara në Kapitullin XIV të këtij Kodi.
3. Deri në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, palët dhe i dëmtuari mund të propozojnë shqyrtimin e fakteve të reja, mbledhjen e provave të reja dhe të përsërisin propozimet të cilat gjyqtari i vetëm gjykues, kryetari i trupit gjykues ose trupi gjykues më herët i ka refuzuar.
4. Përveç provave të propozuara nga palët dhe i dëmtuari, trupi gjykues ka të drejtë të

shqyrtojë provën që e konsideron të nevojshme për verifikimin e drejtë dhe të plotë të çështjes penale.

Neni 330
Marrja në pyetje e dëshmitarit apo ekspertit pa praninë e dëshmitarëve të tjerë

Në parim, dëshmitari i cili ende nuk është marrë në pyetje, nuk është i pranishëm gjatë shqyrtimit të provave dhe eksperti i cili ende nuk ka dhënë konstatimin dhe mendimin e tij, nuk mund të jetë i pranishëm në seancë derisa eksperti tjetër të jep deklarimin e tij mbi çështjen e njëjtë.

Neni 331
Dëshmitë e dhëna nga dëshmitarët në shqyrtim gjyqësor

1. Gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues cakton radhën e marrjes në pyetje të dëshmitarëve, duke filluar me dëshmitarët e propozuar nga prokurori i shtetit, dëshmitarët e propozuar nga i dëmtuari apo mbrojtësi i viktimave, dhe në fund me dëshmitarët e propozuar nga i pandehuri apo mbrojtësi i tij. Po qe se është e mundshme, dëshmitarët thirren duke respektuar radhën e propozuar nga prokurori i shtetit, i dëmtuari, mbrojtësi i viktimave, i pandehuri dhe mbrojtësi.
2. Prokurori i shtetit, i pandehuri apo i dëmtuari mund të kërkojnë nga gjykata që të dëgjojë dëshmitarët për të kundërshtuar dëshmitë apo provat e paraqitura nga pala e kundërt sipas paragrafit 1. të këtij neni.

Neni 332
Marrja e drejtpërdrejtë në pyetje, marrja e tërthortë në pyetje dhe rimarrja në pyetje e dëshmitarit

1. Pala e cila paraqet provën merr në pyetje dëshmitarin ose paraqet provën e para.
2. Palëve tjera pastaj u jepet mundësia për marrjen e tërthortë në pyetje të dëshmitarit ose kundërshtimin e besueshmërisë së dëshmitarit.
3. Palës e cila ka paraqitur provën i jepet mundësia në fund që të sqarojë përgjigjet me dëshmitarin ose të rehabilitojë besueshmërinë e dëshmitarit.
4. Nëse pala përfaqësohet nga më shumë se një mbrojtës, vetëm mbrojtësi kryesor mund të merr në pyetje dëshmitarët, t'u parashtrojë pyetje të tërthorta dhe të rehabilitojë besueshmërinë e dëshmitarëve.

Neni 333
Marrja e drejtpërdrejtë në pyetje e dëshmitarëve

1. Dëshmitari merret në pyetje së pari nga pala e cila e ka propozuar.
2. Pala e cila merr në pyetje dëshmitarin mund t'i parashtrojë pyetje në pajtim me rregullat për procedimin e provave.
3. Pala mund t'i paraqesë dëshmitarit provën materiale në pajtim me nenin 336 të këtij Kodi.
4. Nëse dëshmitari apo eksperti nuk mund të rikujtojë faktet të cilat i ka paraqitur në

dëshmimet e mëparshme, pala e cila ka propozuar dëshmitarin mund t'i paraqesë provën e pranueshme për t'ia rifreskuar kujtesën.

Neni 334
Marrja e tërthortë në pyetje e dëshmitarëve

1. Pala e cila bën marrjen e tërthortë në pyetje të dëshmitarit mund:
   1.1. t'i parashtrojë pyetje dëshmitarit në pajtim me rregullat për procedimin e provave; dhe
   1.2. të pyesë dëshmitarin të konfirmoj ose të mohoj një fakt. Nëse dëshmitari jep përgjigje që është në kundërshtim me provën e pranueshme, pala e cila bën marrjen e tërthortë në pyetje pastaj mund t'ia paraqet ose t'ia lexojë dëshmitarit provën që është në kundërshtim. Pala e cila zbaton marrjen e tërthortë në pyetje ose gjykata mund të kërkojë nga dëshmitari që të shpjegojë mospërputhjet.
   1.3. t'i parashtrojë dëshmitarit pyetje të cilat shqyrtojnë besueshmërinë e dëshmisë së dëshmitarit apo paragjykimet që dëshmitari mund të ketë.
2. Provat materiale të përdorura gjatë marrjes së tërthortë në pyetje duhet të identifikohen qartë për gjykatën dhe përdorimi i provës së tillë shënohet në procesverbal.

Neni 335
Rimarrja në pyetje

Pas marrjes së tërthortë në pyetje të dëshmitarit, pala e cila ka propozuar dëshmitarin ka mundësinë që t'i parashtrojë pyetje të cilat sqarojnë dëshminë e paqartë, shpjegojnë mospërputhjet në dëshmi, dyshimet lidhur me besueshmërinë e dëshmisë së dëshmitarit apo çfarëdo paragjykimi që i dëshmitari mund të ketë.

11. Rregullat për dëshmitarët

Neni 336
Provat materiale që mbështesin dëshminë e dëshmitarit

1. Pala mund t'i paraqesë dëshmitarit provën materiale dhe t'i parashtrojë pyetje dëshmitarit lidhur me atë provë materiale gjatë marrjes në pyetje, marrjes së tërthortë në pyetje ose rimarrjes në pyetje.
2. Provë materiale mund të jetë dokumenti, tabela, përmbledhja, videokaseta, audiokaseta apo prova tjetër materiale.
3. Çdo provë materiale që përmbledh ose tregon provë të pranueshme që është e shumtë, e madhe apo që është asgjësuar së pari i paraqitet dëshmitarit i cili mund të identifikojë këtë provën të pranueshme, të shpjegojë si është krijuar prova dhe të vërtetojë se prova është e vërtetë, e bazuar dhe paraqet saktësisht provën e pranueshme origjinale.
4. Cilado provë nga paragrafët 2. apo 3. të këtij neni është e pranueshme nëse është e vërtetë, e bazuar dhe paraqet saktësisht provën e pranueshme origjinale. Prova materiale shënohet në procesverbal nëse nuk është shënuar më parë.

Neni 337
Përdorimi i dëshmisë së mëparshme të dëshmitarit

1. Pala mund të propozojë marrjen e provës në shqyrtim gjyqësor nga dëshmia e mëparshme e dëshmitarit, nëse dëshmia e tillë është marrë gjatë mundësisë hetuese të veçantë nga neni 149 të këtij Kodi.
2. Pala mund të propozojë marrjen e provës në shqyrtim gjyqësor nga dëshmia e mëparshme e dëshmitarit nëse dëshmia e tillë është marrë gjatë seancës për marrjen e deklaratës në procedurë paraprake nga neni 132 i këtij Kodi, dëshmitari nuk është në dispozicion për të dëshmuar dhe është paraqitur mbështetje e pohimit në pajtim me nenin 263 të këtij Kodi.
3. Prokurori i shtetit mund të propozojë marrjen e provës në shqyrtim gjyqësor nga audiokasetat apo videokasetat e të akuzuarit të marra në pajtim me nenin 88 ose nenin 92 të këtij Kodi.
4. Nëse është bërë videokaseta ose audiokaseta e dëshmisë ose deklaratës nga paragrafi 1. deri 3. të këtij neni ajo reprodukohet në tërësi gjatë shqyrtimit gjyqësor, përveç nëse gjyqtari i vetëm gjykues ose trupi gjykues vendosin që dëgjimi i tërësishëm i videokasetës apo audiokasetës përmban tepër shumë informata të parëndësishme. Në rast të tillë, gjyqtari i vetëm gjykues ose trupi gjykues mund të urdhërojë që pjesë të veçanta dhe të rëndësishme të videokasetës apo audiokasetës të reprodukohen në shqyrtim gjyqësor.
5. Ky nen nuk ndalon përdorimin e deklaratave të mëparshme të dëshmitarit gjatë marrjes së tërthortë në pyetje të atij dëshmitari.

Neni 338
Leximi i deklaratave të tjera të dhëna më parë

1. Përveç rasteve të parapara me këtë Kod, procesverbalet mbi deklarimet e dëshmitarëve, të bashkakuzuarve ose pjesëmarrësve të dënuar për vepër penale, si dhe procesverbalet dhe shkresat tjera mbi konstatimin dhe mendimin e ekspertit, sipas vendimit të trupit gjykues mund të lexohen vetëm në këto raste:
   1.1. kur personat e marrë në pyetje kanë vdekur, kanë çrregullime ose paaftësi mendore, nuk mund të gjenden ose ardhja e tyre në gjykatë është e pamundur apo dukshëm e vështirësuar për shkak të pleqërisë, sëmundjes ose shkaqeve të tjera të rëndësishme;
   1.2. kur dëshmitarët ose ekspertët, pa arsye ligjore, nuk dëshirojnë të dëshmojnë në shqyrtim gjyqësor; ose
   1.3. kur palët pajtohen që, në vend të marrjes së drejtpërdrejtë në pyetje të dëshmitarit apo ekspertit i cili nuk është i pranishëm, pavarësisht se ka qenë i thirrur, të lexohet procesverbali mbi dëshminë e tij të mëparshme.
2. Procesverbalet mbi marrjen e mëparshme në pyetje të personave të cilët janë liruar nga detyra e dëshmimit nuk lexohen nëse këta persona nuk janë thirrur në shqyrtim gjyqësor ose nëse kanë deklaruar se nuk dëshirojnë të dëshmojnë në shqyrtimin gjyqësor. Kur personat e tillë, pasi të kenë dëshmuar më parë, e përdorin të drejtën e tyre për të mos dëshmuar në shqyrtim gjyqësor, ose nëse nuk kanë ardhur në shqyrtim kur janë thirrur, procesverbali mbi dëshminë e mëparshme është provë e papranueshme.

3. Arsyet e leximit të procesverbalit shënohen në procesverbalin e shqyrtimit gjyqësor, e me rastin e leximit tregohet nëse dëshmitari ose eksperti është betuar.

Neni 339
Dëshmitarët nën mbrojtje të veçantë

1. Në shqyrtimin gjyqësor nuk lejohet marrja në pyetje e personit nën moshën gjashtëmbëdhjetë (16) vjeç që është viktimë e veprës penale nga Kapitulli XX i Kodit Penal, nëse dëshmia e tij veç është marrë sipas nenit 132 ose nenit 149 të këtij Kodi dhe nëse trupi gjykues çmon se marrja e sërishme në pyetje nuk është e nevojshme. Nëse dëshmitari i tillë merret në pyetje, trupi gjykues mund të vendosë të përjashtojë publikun.
2. Kur fëmija është i pranishëm në seancë si dëshmitar ose si i dëmtuar, ai largohet nga gjykatorja posa prania e tij të mos jetë më e nevojshme
3. Masat për mbrojtjen e të dëmtuarve dhe dëshmitarëve, siç parasheh kapitulli XIII i këtij Kodi, zbatohen gjatë shqyrtimit gjyqësor.

Neni 340
Betimi

1. Para marrjes në pyetje të dëshmitarit, gjyqtari i vetëm gjykues, kryetari i trupit gjykues ose gjyqtari i procedurës paraprake kur vepron sipas nenit 149 të këtij Kodi, nga dëshmitari mund të kërkojë dhënien e betimit. Fëmija dhe personi për të cilin është vërtetuar të ketë kryer vepër penale ose me arsye dyshohet se ka kryer vepër penale ose ka marrë pjesë në kryerjen e veprës penale për të cilën merret në pyetje, nuk i nënshtrohet betimit. Nëse dëshmitari është betuar në procedurë paraprake, në shqyrtim gjyqësor i bëhet me dije se është nën betim.
2. Teksti i betimit të dëshmitarit është: "I ndërgjegjshëm për rëndësinë e dëshmisë sime dhe përgjegjësinë time ligjore, solemnisht betohem se do të them të vërtetën, gjithë të vërtetën dhe vetëm të vërtetën dhe se nuk do të fsheh asgjë për të cilën kam dijeni.
3. Para marrjes në pyetje të ekspertit, gjyqtari i vetëm gjykues apo kryetari i trupit gjykues mund të kërkojë nga ai dhënien e betimit. Para shqyrtimit gjyqësor, eksperti mund të betohet vetëm para gjykatës dhe vetëm kur ekziston rreziku se ai nuk do të jetë i pranishëm në shqyrtim gjyqësor. Arsyeja e dhënies së betimit shënohet në procesverbal. Ekspertit të përhershëm, i cili ka dhënë betim të përgjithshëm për ekzaminime përkatëse, në shqyrtimin gjyqësor vetëm i përkujtohet betimi i dhënë.
4. Teksti i betimit të ekspertit është: "I ndërgjegjshëm për rëndësinë e deklaratës sime dhe përgjegjësinë time ligjore, solemnisht betohem se do të kryejë ekspertizën me ndërgjegje dhe me aq sa kam njohuri dhe konstatimin e mendimin tim do ta paraqes saktësisht dhe plotësisht".
5. Dëshmitari dhe eksperti memec që dinë shkrim dhe lexim e bëjnë betimin me nënshkrim të tekstit të betimit, ndërsa dëshmitari dhe eksperti shurdh e lexojnë tekstin e betimit. Nëse dëshmitari dhe eksperti shurdh ose memec janë analfabetë, betimi bëhet përmes përkthyesit.

Neni 341
Deklarimi i ekspertit

1. Eksperti ia komunikon gjykatës konstatimin dhe mendimin e tij nëpërmjet raportit të përpiluar sipas nenit 138 të këtij Kodi.
2. Në shqyrtim gjyqësor, raporti futet në procesverbal. Eksperti përshkruan konstatimet dhe shpjegon analizat e tij. Eksperti mund të përdorë provat materiale në mbështetje të dëshmisë së tij.
3. Pala e cila nuk ka kërkuar ekspertizën mund të bëjë marrjen e tërthortë në pyetje të ekspertit lidhur me raportin, analizat, arsimimin, përvojën, ose bazën e ekspertizës së tij.

Neni 342
Prania e dëshmitarëve në gjykatore

1. Dëshmitarët dhe ekspertët e marrur në pyetje mbeten në gjykatore, përpos nëse gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues, pas marrjes në pyetje të palëve, i lejon të shkojnë ose përkohësisht të largohen nga gjykatorja.
2. Gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues, me propozim të palëve ose sipas detyrës zyrtare, mund të urdhërojë që dëshmitarët dhe ekspertët e marrur në pyetje të largohen nga gjykatorja dhe më vonë të thirren përsëri dhe të merren në pyetje edhe një herë në prani ose në mungesë të dëshmitarëve dhe ekspertëve të tjerë.

Neni 343
Provat e marra jashtë gjykatës

1. Kur në shqyrtim gjyqësor mësohet se dëshmitari ose eksperti i thirrur nuk mund të vijë në gjykatë ose kur paraqitja e tij do të shkaktonte vështirësi të konsiderueshme, gjyqtari i vetëm gjykues ose trupi gjykues, kur çmon se deklarimi i tij është i rëndësishëm, urdhëron që ta merr në pyetje gjyqtari i vetëm gjykues, kryetari i trupit gjykues ose gjyqtari anëtar i trupit gjykues jashtë shqyrtimit gjyqësor, ose marrja në pyetje të bëhet nga gjyqtari i procedurës paraprake brenda kompetencës territoriale ku banon dëshmitari apo eksperti.
2. Kur është e nevojshme të zbatohet këqyrja ose rikonstruksioni jashtë shqyrtimit gjyqësor, këtë e bën gjyqtari i vetëm gjykues, kryetari i trupit gjykues ose gjyqtari anëtarë i trupit gjykues.
3. Palët dhe i dëmtuari gjithmonë njoftohen kur dhe në cilin vend do të merret në pyetje dëshmitari apo do të zbatohet këqyrja ose rikonstruksioni dhe njoftohen se kanë të drejtë të jenë të pranishëm në këto veprime. Kur palët dhe i dëmtuari janë të pranishëm gjatë kryerjes së këtyre veprimeve, ata gëzojnë të drejtat e parapara në nenin 149, paragrafi 2. i këtij Kodi.

Neni 344
Leximi i procesverbaleve ose riprodhimi i regjistrimeve

1. Procesverbalet për këqyrjen e vendit jashtë shqyrtimit gjyqësor, për kontroll të lokaleve dhe të personit, marrjen e sendeve, dokumenteve, librave, dosjeve dhe shkresave të tjera si dhe incizime teknike me vlerë provuese lexohen ose riprodhohen në shqyrtim gjyqësor për vërtetimin e përmbajtjes së tyre. Trupi gjykues gëzon të drejtë diskrecioni të lejojë prezentim të përmbledhur gojor të këtyre të dhënave, si dhe riprodhim të regjistrimit audio ose video të rrjedhës së këtyre veprimeve hetimore. Dokumentet që kanë rëndësinë e provës, sipas mundësisë, dorëzohen në formë origjinale.
2. Sendet që gjatë shqyrtimit gjyqësor mund të shërbejnë për sqarimin e çështjes, mund t'i tregohen të akuzuarit, e në rast nevoje, edhe dëshmitarëve dhe ekspertëve.

Neni 345
Marrja në pyetje e të akuzuarit pas paraqitjes së provave

1. Pas marrjes në pyetje të dëshmitarëve e ekspertëve dhe pas prezentimit të provave materiale vazhdohet me marrjen në pyetje të të akuzuarit i cili nuk ka pranuar fajësinë.
2. Dispozitat e zbatueshme gjatë marrjes në pyetje të të pandehurit në procedurë paraprake zbatohen përshtatshmërisht edhe gjatë marrjes në pyetje të të akuzuarit në shqyrtim gjyqësor.
3. Të bashkakuzuarit të cilët ende nuk janë marrë në pyetje nuk do të jenë të pranishëm gjatë pyetjes së të akuzuarit.

Neni 346
Marrja në pyetje e të akuzuarit

1. I akuzuari ka të drejtë që të mos deklarojë. Nëse ai zgjedh që të deklarojë, marrja e tij në pyetje zbatohet në pajtim me paragrafin 2. deri 4. të këtij neni.
2. Mbrojtësi kryesor merr në pyetje të pandehurin në pajtim me nenin 333 të këtij Kodi.
3. Prokurori i shtetit merr në pyetje të pandehurin në pajtim me nenin 334 të këtij Kodi.
4. Nëse ka të bashkëpandehur, ata mund të marrin në pyetje të pandehurin në pajtim me nenin 334 të këtij Kodi.
5. I dëmtuari mund të merr në pyetje të pandehurin në pajtim me nenin 334 të këtij Kodi.
6. Mbrojtësi mund të rimerr në pyetje të pandehurin në pajtim me nenin 335 të këtij Kodi.
7. Pasi gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues sigurohet se palët nuk kanë pyetje të tjera, ai mund të vazhdojë t'i shtrojë pyetje të akuzuarit nëse në deklarimin ose në përgjigjet e tij ka zbraztësi, paqartësi apo kundërthënie. Pas kësaj, anëtarët e trupit gjykues mund t'i bëjnë pyetje të drejtpërdrejta të akuzuarit.
8. Pas përfundimit të marrjes në pyetje, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit

gjykues e pyet të akuzuarin nëse ka diçka për të shtuar për mbrojtjen e tij. Kur i akuzuari shtjellon më tej mbrojtjen e tij, mund të pyetet përsëri.

Neni 347
Marrja në pyetje e të bashkakuzuarit

1. Pas përfundimit të marrjes në pyetje të të akuzuarit të parë, secili prej të akuzuarve të tjerë, nëse ka, merren në pyetje me radhë në pajtim me nenin 346 të këtij Kodi. Çdo i akuzuar ka të drejtë t'u bëjë pyetje të bashkakuzuarve të tjerë të pyetur më parë.
2. Deklarimet e mëparshme të të bashkakuzuarve gjatë shqyrtimit gjyqësor mund të përdoren nga palët sipas nenit 334 të këtij Kodi. Kur deklarimet e të bashkakuzuarve për rrethana të njëjta ndryshojnë, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues mund të bëjë ballafaqimin e të bashkakuzuarve.

Neni 348
Propozimet për plotësimin e procedurës së provave

1. Pas përfundimit të procedurës së provave, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues i pyet palët dhe të dëmtuarin nëse kanë propozim për plotësimin e procedurës së provave.
2. Nëse askush nuk ka propozim për plotësim të procedurës së provave, ose propozimi refuzohet dhe gjykata çmon se çështja është sqaruar, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues shpall të përfunduar procedurën e provave.

Neni 349
Të dhënat penale të të akuzuarit

Të dhënat penale nga evidenca e të dënuarve, si dhe të dhënat tjera për dënimet për vepra penale mund të lexohen pas përfundimit të procedurës së provave. Kur i akuzuari pranon fajësinë, të gjitha informatat lidhur me dënimet e mëparshme të të akuzuarit lexohen para se palët të paraqesin fjalën përfundimtare.

12. Ndryshimi dhe zgjerimi i aktakuzës

Neni 350
Ndryshimi i aktakuzës në shqyrtim gjyqësor

1. Kur prokurori i shtetit gjatë shqyrtimit gjyqësor konstaton se provat e shqyrtuara tregojnë se gjendja faktike e paraqitur në aktakuzë është ndryshuar, ai në shqyrtim gjyqësor mund ta ndryshojë aktakuzën gojarisht dhe mund të propozojë që shqyrtimi gjyqësor të ndërpritet për përgatitjen e aktakuzës së re.
2. Nëse trupi gjykues lejon ndërprerjen e shqyrtimit gjyqësor për përgatitjen e aktakuzës së re, atëherë cakton afatin kur prokurori i shtetit detyrohet të paraqesë aktakuzën e re. Të akuzuarit i dërgohet kopja e aktakuzës së re. Nëse prokurori i shtetit në afatin e caktuar nuk paraqet aktakuzë të re, gjykata vazhdon shqyrtimin gjyqësor në bazë të aktakuzës së mëparshme.

3. Kur ndryshohet aktakuza, i akuzuari ose mbrojtësi mund të propozojnë ndërprerjen e shqyrtimit gjyqësor për përgatitjen e mbrojtjes. Trupi gjykues mund të ndërpresë shqyrtimin gjyqësor për përgatitjen e mbrojtjes kur thelbi i aktakuzës është ndryshuar ose është zgjeruar.

Neni 351
Zgjerimi i aktakuzës në shqyrtimin gjyqësor

1. Nëse i akuzuari gjatë shqyrtimit gjyqësor kryen vepër penale ose nëse vepra penale e mëparshme e të akuzuarit zbulohet gjatë shqyrtimit gjyqësor, trupi gjykues në shqyrtimin gjyqësor mund të përfshijë edhe këtë vepër në bazë të akuzës së prokurorit të shtetit, e cila mund të paraqitet edhe gojarisht.
2. Në rastin e tillë, gjykata mund të ndërpresë shqyrtimin gjyqësor për t'i dhënë kohë mbrojtjes për t'u përgatitur, e pas dëgjimit të palëve, mund të vendosë që për veprën nga paragrafi 1. i këtij neni të gjykojë veçmas të akuzuarin.
3. Nëse për gjykimin e çështjes nga paragrafi 1. i këtij neni është kompetent departamenti tjetër në kuadër të gjykatës themelore, trupi gjykues, pas dëgjimit të palëve, vendos se a do t'ia dërgojë çështjen për të cilën është duke e drejtuar shqyrtimin gjyqësor gjykatës drejtpërdrejt më të lartë kompetente për të marrë vendim.

13. Fjala përfundimtare

Neni 352
Fjala përfundimtare e palëve

1. Pas përfundimit të procedurës së provave, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues u jep fjalën palëve, të dëmtuarit dhe mbrojtësit për t'i përmbledhur argumentet e tyre. Së pari, fjalën e merr prokurori i shtetit, pastaj i dëmtuari, mbrojtësi dhe në fund i akuzuari.
2. Personat në fjalën përfundimtare mund t'u referohen provave të pranueshme, si dhe procedurës, ligjit në fuqi, karakterit dhe sjelljes së dëshmitarëve gjatë procedurës gjyqësore; ata mund të përdorin tabela, diagrame, përshkrime incizimesh të lejuara nga gjykata, përmbledhje dhe krahasime të provave nëse ato bazohen në prova të pranueshme, si dhe zmadhim të ekzemplarëve të tyre për t'i demonstruar ose për t'i paraqitur si ilustrim në gjykatë.

Neni 353
Fjala përfundimtare e prokurorit të shtetit

1. Prokurori i shtetit në fjalën e tij përfundimtare paraqet vlerësimin e tij për provat e shqyrtuara në shqyrtim gjyqësor, shpjegon konkluzionet e tij mbi faktet e rëndësishme për marrjen e vendimit, paraqet dhe arsyeton propozimin e tij për përgjegjësinë penale të të akuzuarit, për dispozitat e Kodit Penal të cilat duhet zbatuar si dhe për rrethanat lehtësuese dhe rënduese që duhet të merren parasysh me rastin e caktimit të dënimit. Prokurori i shtetit nuk mund të propozojë lartësinë e dënimit, por mund të propozojë shqiptimin e vërejtjes gjyqësore ose ndonjë dënim alternativ nga neni 49 i Kodit Penal.

2. Në rastet kur i akuzuari i cili është dëshmitar bashkëpunues pranon fajësinë në bazë të marrëveshjes mbi fajësinë, prokurori mund të rekomandojë gjykatës kufijtë e dënimit, qortimin gjyqësor ose njërën nga dënimet alternative të parashikuara me Kodin Penal të Kosovës.

Neni 354
Fjala përfundimtare në emër të të dëmtuarit

I dëmtuari ose përfaqësuesi i tij i autorizuar, në fjalën e tij përfundimtare mund të shpjegojë kërkesën e tij pasurore juridike dhe potencon provat që ndërlidhen me përgjegjësinë penale të të akuzuarit.

Neni 355
Fjala përfundimtare dhe komentet në emër të të akuzuarit

1. Mbrojtësi ose i akuzuari në fjalën përfundimtare paraqet personalisht argumente për mbrojtjen tij dhe mund të komentojë pretendimet e prokurorit dhe të dëmtuarit.
2. Pasi mbrojtësi të ketë prezentuar argumentet për mbrojtjen, i akuzuari ka të drejtë të deklarohet personalisht nëse pajtohet me mbrojtjen e prezentuar nga mbrojtësi i tij dhe mbrojtjen e tillë ta plotësojë.
3. Prokurori i shtetit dhe i dëmtuari kanë të drejtë të përgjigjen në mbrojtje, kurse mbrojtësi apo i akuzuari kanë të drejtë që këto përgjigje t'i komentojnë.
4. Fjalën e fundit gjithmonë e merr i akuzuari.

Neni 356
Paraqitja e fjalëve përfundimtare

1. Paraqitja e fjalës përfundimtare nga palët mund të kufizohet në kohë nga gjyqtari i vetëm gjykues apo kryetari i trupit gjykues.
2. Gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues, pasi të ketë bërë vërejtje paraprake, mund të ndërpresë personin i cili në fjalën e tij përfundimtare fyen rendin publik dhe moralin, fyen personin tjetër, përsërit ose jep shpjegime të gjata të cilat qartazi nuk ndërlidhen me çështjen. Në procesverbal të shqyrtimit gjyqësor shënohet koha dhe arsyeja e ndërprerjes së fjalës përfundimtare.
3. Kur akuzën e përfaqësojnë disa persona ose mbrojtjen e përfaqësojnë disa mbrojtës, vetëm prokurori apo mbrojtësi kryesor ose mbrojtësi i caktuar nga mbrojtësi kryesor mund të paraqet fjalën përfundimtare në emër të palës së tyre.
4. Pas paraqitjes së fjalës përfundimtare nga të gjithë, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues pyet nëse ndokush ka edhe ndonjë deklaratë tjetër.

Neni 357
Përfundimi i shqyrtimit gjyqësor, këshillimi dhe votimi

1. Nëse pas përfundimit të fjalës përfundimtare të palëve, gjyqtari i vetëm gjykues ose trupi gjykues nuk çmon se duhet marrë prova të tjera, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues shpall shqyrtimin gjyqësor të përfunduar.

2. Pas kësaj, gjyqtari i vetëm gjykues ose trupi gjykues tërhiqet për këshillim dhe votim për marrjen e aktgjykimit.

Neni 358
Hudhja e aktakuzës

1. Trupi gjykues me aktvendim e hudh aktakuzën kur:
   1.1. procedura është zbatuar pa kërkesën e prokurorit të shtetit;
   1.2. ka munguar propozimi i kërkuar i të dëmtuarit ose leja e organit publik kompetent, apo nëse organi publik kompetent e ka tërhequr lejen; ose
   1.3. ekzistojnë rrethana të tjera të cilat e pengojnë ndjekjen.
2. Aktvendimin mbi hudhjen e aktakuzës mund ta merr gjyqtari i vetëm gjykues ose trupi gjykues edhe pas caktimit të shqyrtimit gjyqësor.

KAPITULLI XX
AKTGJYKIMI

1. Marrja e aktgjykimit

Neni 359
Marrja dhe shpallja e aktgjykimit

1. Nëse gjykata gjatë këshillimit çmon se nuk nevojitet që përsëri të hapet shqyrtimi gjyqësor për plotësimin e procedurës ose për sqarimin e ndonjë çështjeje konkrete, atëherë e merr aktgjykimin.
2. Aktgjykimi merret dhe shpallet në emër të popullit.

Neni 360
Identiteti subjektiv dhe objekti i aktgjykimit me aktakuzën

1. Aktgjykimi mund t'i referohet vetëm personit të akuzuar dhe vetëm veprës që është objekt i akuzës të përfshirë në aktakuzën e paraqitur fillimisht, të ndryshuar ose të zgjeruar në shqyrtimin gjyqësor.
2. Gjykata nuk detyrohet me propozimet e prokurorit të shtetit lidhur me kualifikimin ligjor të veprës.
3. Gjykata nuk detyrohet me marrëveshje ndërmjet prokurorit të shtetit dhe mbrojtjes lidhur me ndryshimin e akuzës ose pranimin e fajit, përveç marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë të pranuar nga gjykata sipas nenit 233 të këtij Kodi.

Neni 361
Baza e aktgjykimit

1. Gjykata e bazon aktgjykimin vetëm në faktet dhe në provat e proceduara në shqyrtimin gjyqësor.
2. Gjykata detyrohet që me ndërgjegje të vlerësojë çdo provë një nga një dhe në lidhje me provat e tjera, dhe në bazë të vlerësimit të tillë të nxjerrë përfundim nëse fakti konkret është provuar.

2. Llojet e aktgjykimeve

Neni 362
Forma e aktgjykimit

1. Me aktgjykim ose refuzohet akuza, ose i akuzuari lirohet nga akuza, ose shpallet fajtor.
2. Kur akuza përfshin disa vepra penale, në aktgjykim shënohet nëse dhe për cilën vepër është refuzuar akuza, apo nëse dhe për cilën vepër i akuzuari lirohet ose shpallet fajtor.

Neni 363
Aktgjykimi refuzues

1. Gjykata merr aktgjykim me të cilin akuza refuzohet kur:
   1.1. prokurori i shtetit është tërhequr nga akuza nga hapja deri në përfundim të shqyrtimit gjyqësor;
   1.2. i akuzuari për të njëjtën vepër është gjykuar me aktgjykim të formës së prerë ose procedura kundër tij është pushuar me aktvendim të formës së prerë; ose
   1.3. ka kaluar afati i parashkrimit dhe vepra përfshihet në amnisti ose falje, ose kur ekzistojnë rrethana të tjera që përjashtojnë ndjekjen penale.

Neni 364
Aktgjykimi lirues

1. Gjykata merr aktgjykim me të cilin i akuzuari lirohet nga akuza nëse:
   1.1. vepra me të cilën i akuzuari akuzohet nuk përbën vepër penale;
   1.2. ka rrethana që përjashtojnë përgjegjësinë penale; ose
   1.3. nuk është provuar se i akuzuari ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet.

Neni 365
Aktgjykimi fajësues

1. Gjykata, në aktgjykimin me të cilin të akuzuarin e shpall fajtor shënon:
   1.1. veprën penale për të cilën shpallet fajtor, së bashku me faktet dhe rrethanat që përbëjnë figurën e veprës penale, si dhe faktet dhe rrethanat nga të cilat varet zbatimi i dispozitës përkatëse të Kodit Penal;
   1.2. emërtimin ligjor të veprës penale dhe dispozitat e ligjit penal të zbatuara gjatë marrjes së aktgjykimit;
   1.3. dënimin e shqiptuar të akuzuarit, duke përfshirë edhe dënimin alternativ nga Kodi Penal ose lirimin nga dënimi;
   1.4. urdhrin për shqiptimin e masës për trajtim të detyrueshëm rehabilitues të kryerësve të varur nga droga dhe alkooli, ose për konfiskimin e dobisë pasurore që i nënshtrohet konfiskimit;
   1.5. vendimin për llogaritjen e paraburgimit ose dënimit të mëparshëm në lartësinë e dënimit; dhe

1.6. vendimin për shpenzimet e procedurës penale, për kërkesën pasurore juridike, si dhe përcaktimin se a duhet shpallur aktgjykimin e formës së prerë në shtyp, në radio apo në televizion.

2. Kur i akuzuari dënohet me gjobë, në aktgjykim shënohet afati kur duhet paguar gjoba dhe mënyra e zëvendësimit të gjobës kur gjoba forcërisht nuk mund të arkëtohet.

3. Shpallja e aktgjykimit

Neni 366
Shpallja e aktgjykimit

1. Pasi gjykata merr aktgjykimin, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues e shpall menjëherë. Kur gjykata nuk ka mundësi që në të njëjtën ditë pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor të merr aktgjykimin, shpalljen e aktgjykimit e shtyn më së shumti tri (3) ditë dhe e cakton kohën dhe vendin e shpalljes së aktgjykimit.
2. Gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues në prani të palëve, të përfaqësuesve të tyre ligjorë, të përfaqësuesve të autorizuar dhe të mbrojtësve lexon në seancë të hapur dispozitivin dhe shkurtimisht prezenton arsyet e aktgjykimit.
3. Shpallja e aktgjykimit bëhet edhe kur pala, përfaqësuesi ligjor, përfaqësuesi i autorizuar ose mbrojtësi nuk janë të pranishëm. Gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupi gjykues mund të urdhërojë që të akuzuarit i cili nuk është i pranishëm t'ia komunikojë gojarisht aktgjykimin ose t'i dërgohet me shkrim aktgjykimi.
4. Kur publiku është përjashtuar nga shqyrtimi gjyqësor, dispozitivi i aktgjykimit gjithmonë lexohet në seancë të hapur. Trupi gjykues vendos se a do ta përjashtojë publikun me rastin e prezentimit të arsyeve të aktgjykimit dhe në ç'masë e përjashton.
5. Të gjithë të pranishmit e dëgjojnë leximin e dispozitivit të aktgjykimit duke qëndruar në këmbë.

Neni 367
Paraburgimi pas shpalljes së aktgjykimit

1. Me rastin e marrjes së aktgjykimit me të cilin i akuzuari dënohet me burgim, gjyqtari i vetëm gjykues ose trupi gjykues:
   1.1. cakton, vazhdon paraburgim kur ekzistojnë kushtet nga neni 187paragrafi 1. i këtij Kodi; ose
   1.2. ndërprenë paraburgimin nëse i akuzuari ndodhet në paraburgim kur pushojnë së ekzistuari shkaqet për të cilat është paraburgosur.
2. Nëse gjyqtari i vetëm gjykues ose trupi gjykues shqipton dënim prej pesë (5) ose më shumë vjet burg të akuzuarit ia cakton paraburgimin, nëse ai nuk gjendet në paraburgim, ose ia vazhdon atë kur i akuzuari gjendet në paraburgim.
3. Nëse dënimi i shqiptuar është më i ulët së pesë (5) vjet, atëherë paraburgimi caktohet ose vazhdohet nëse janë plotësuar kushtet e përcaktuara me nenin 187 par. 1. i këtij Kodi.

4. Trupi gjykues gjithmonë ndërpren paraburgimin dhe urdhëron lirimin e të akuzuarit nëse:
   4.1. është liruar nga akuza;
   4.2. është deklaruar fajtor, por është liruar nga dënimi;
   4.3. është dënuar vetëm më gjobë ose i është shqiptuar vërejtja gjyqësore;
   4.4. i është shqiptuar një nga dënimet alternative, përveç dënimit me gjysmëliri nga neni 61 i Kodit Penal;
   4.5. për shkak të llogaritjes së paraburgimit në lartësinë e dënimit, ai veç e ka mbajtur dënimin; ose
   4.6. akuza është refuzuar, përveç në rastin kur është refuzuar për shkak të moskompetencës së gjykatës.
5. Para caktimit ose heqjes së paraburgimit nga paragrafi 3. ose 4. i këtij neni, gjyqtari i vetëm gjykues ose trupi gjykues së pari dëgjon mendimin e prokurorit të shtetit, nëse procedura është filluar me kërkesën e tij, dhe pastaj dëgjon të akuzuarin apo mbrojtësin e tij.
6. Kur i akuzuari gjendet në paraburgim dhe gjyqtari i vetëm gjykues ose trupi gjykues çmon se ende ekzistojnë shkaqet për të cilat ishte caktuar paraburgimi, paraburgimin e vazhdon me aktvendim të posaçëm. Gjithashtu, me aktvendim të posaçëm e cakton ose e heq paraburgimin. Ankesa kundër aktvendimit nuk e pezullon ekzekutimin e aktvendimit.
7. Paraburgimi i caktuar ose i vazhduar sipas dispozitave të paragrafëve 3. deri 6. të këtij neni mund të zgjasë derisa aktgjykimi të merr formë të prerë, por jo më shumë se koha e dënimit të shqiptuar në aktgjykimin e gjykatës themelore.
8. I akuzuari i dënuar me burgim, i cili gjendet në paraburgim, me kërkesën e tij mund të transferohet me aktvendim të gjyqtarit të vetëm gjykues ose të kryetarit të trupit gjykues në institucionin për mbajtjen e dënimit para se aktgjykimi të merr formë të prerë.

Neni 368
Udhëzimet dhe paralajmërimet që shoqërojnë aktgjykimin

1. Pas shpalljes së aktgjykimit, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues i udhëzon palët për të drejtën në ankesë. Udhëzimi shënohet në procesverbal të shqyrtimit gjyqësor.
2. Kur shqiptohet dënim alternativ nga neni 49 i Kodit Penal, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues paralajmëron të akuzuarin për rëndësinë e dënimit dhe kushtet të cilat duhet respektuar.
3. Gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues përkujton palët për detyrimet e tyre që, deri në përfundim të procedurës, të njoftojnë gjykatën për çdo ndryshim të adresës.

4. Përpilimi dhe dorëzimi i aktgjykimit

Neni 369
Koha dhe dorëzimi i aktgjykimit me shkrim

1. Aktgjykimi i shpallur duhet të përpilohet me shkrim brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga shpallja e tij, kur i akuzuari gjendet në paraburgim ose i është caktuar paraburgimi, ndërsa në raste të tjera brenda tridhet (30) ditëve nga dita e shpalljes. Kur rasti është i ndërlikuar, gjyqtari i vetëm gjykues apo kryetari i trupit gjykues mund të kërkojë nga presidenti i gjykatës që të zgjasë afatin për përpilimin me shkrim të aktgjykimit deri në gjashtëdhjetë (60) ditë.
2. Aktgjykimin e nënshkruajnë gjyqtari i vetëm gjykues apo kryetari i trupit gjykues dhe procesmbajtësi.
3. Kopja e vërtetuar e aktgjykimit e cila përmban udhëzimin për të drejtën në ankesë i dërgohet palëve.
4. Kopja e vërtetuar e aktgjykimit, së bashku me udhëzimin për të drejtën në ankesë i dërgohet të dëmtuarit, personit të cilit i është konfiskuar sendi me aktgjykim, si dhe personit juridik të cilit i është konfiskuar dobia pasurore e fituar me vepër penale.
5. Kur gjykata gjatë zbatimit të dispozitave për caktimin e dënimit unik për vepra penale në bashkim shqipton aktgjykim duke i marrë parasysh edhe aktgjykimet që i kanë shqiptuar gjykatat tjera, atyre gjykatave u dërgon kopje të vërtetuara të aktgjykimit të formës së prerë.

Neni 370
Përmbajtja dhe forma e aktgjykimit me shkrim

1. Aktgjykimi i përpiluar me shkrim duhet të jetë në përputhje me aktgjykimin e shpallur. Aktgjykimi përfshinë hyrjen, dispozitivin dhe arsyetimin.
2. Hyrja e aktgjykimit përfshin: shënimin se aktgjykimi merret në emër të popullit, emrin e gjykatës, emrin dhe mbiemrin e gjyqtarit të vetëm gjykues ose kryetarit dhe të anëtarëve të trupit gjykues dhe të procesmbajtësit, emrin dhe mbiemrin e të akuzuarit, veprën penale për të cilën i akuzuari është dënuar dhe nëse ka qenë i pranishëm në shqyrtimin gjyqësor, ditën e shqyrtimit gjyqësor, nëse shqyrtimi gjyqësor ka qenë i hapur, emrin dhe mbiemrin e prokurorit të shtetit, mbrojtësit, përfaqësuesit ligjor dhe të përfaqësuesit të autorizuar të cilët kanë qenë të pranishëm në shqyrtim gjyqësor, datën e shpalljes së aktgjykimit të shqiptuar dhe datën e përpilimit të aktgjykimit.
3. Dispozitivi i aktgjykimit përfshin të dhënat personale të të akuzuarit dhe vendimin me të cilin i akuzuari shpallet fajtor për vepër penale për të cilën akuzohet, ose me të cilin lirohet nga akuza për atë vepër apo me të cilin refuzohet aktakuza.
4. Kur i akuzuari është dënuar, dispozitivi i aktgjykimit përfshin të gjitha të dhënat e nevojshme të parapara në nenin 365 të këtij Kodi, ndërsa kur ai është liruar nga akuza ose akuza është refuzuar, dispozitivi i aktgjykimit përfshin përshkrimin e veprës për të cilën është akuzuar dhe vendimin për shpenzimet e procedurës penale dhe kërkesën pasurore juridike, nëse një kërkesë e tillë është paraqitur.
5. Në rastin e gjykimit të veprave penale në bashkim, gjykata në dispozitivin e

aktgjykimit shënon dënimet e shqiptuara për secilën vepër penale, e pastaj dënimin për të gjitha veprat në bashkim.

6. Gjykata në arsyetimin e aktgjykimit paraqet arsyet për çdo pikë të aktgjykimit.
7. Gjykata paraqet qartë dhe në mënyrë të plotë se cilat fakte dhe për çfarë arsyesh i konsideron të vërtetuara apo të pavërtetuara. Gjykata gjithashtu, në mënyrë të veçantë vlerëson saktësinë e provave kundërthënëse, arsyet e mosmiratimit të propozimit konkret të palëve, si dhe arsyet në të cilat është bazuar me rastin e zgjidhjes së çështjeve juridike, veçanërisht me rastin e vërtetimit të ekzistimit të veprës penale dhe përgjegjësisë penale të të akuzuarit, si dhe me rastin e zbatimit të dispozitave të caktuara të ligjit penal ndaj të akuzuarit dhe veprës së tij.
8. Kur i akuzuari dënohet me burgim, arsyetimi përfshin rrethanat të cilat gjykata i ka marrë parasysh me rastin e caktimit të dënimit. Gjykata veçanërisht arsyeton se në cilat shkaqe është bazuar kur ka konstatuar se ka të bëjë veçanërisht me rast të rëndë dhe se duhet shqiptuar dënim më të rëndë se dënimi i paraparë, ose ka konstatuar se është e nevojshme të ulë apo të heqë dënimin, të shqiptojë dënim alternativ ose masën për trajtim të detyruar rehabilitimi ose të konfiskohet dobia pasurore e fituar me vepër penale.
9. Kur në aktakuzë përcaktohet pasuria që i nënshtrohet konfiskimit, aktgjykimi përcakton nëse pasuria konfiskohet apo jo. Aktgjykimi përmban arsyetimin për konfiskimin e secilës pasuri për të cilën urdhërohet konfiskimi dhe arsyetimin për secilën pasuri për të cilën nuk urdhërohet konfiskimi.
10. Kur i akuzuari lirohet nga akuza, në arsyetim veçanërisht shënohet arsyeja e paraparë në nenin 364 të këtij Kodi sipas së cilës ka vepruar.
11. Në arsyetimin e aktgjykimit me të cilin refuzohet akuza, gjykata nuk e vlerëson çështjen kryesore, por kufizohet vetëm në arsyet e refuzimit të akuzës.

Neni 371
Gabimet e imëta në aktgjykim

1. Gabimet në emra dhe numra, gabimet tjera në shkrim dhe llogaritje, parregullsitë në mënyrën e përpilimit të aktgjykimit me shkrim dhe mospërputhja e aktgjykimit me shkrim me origjinalin, me kërkesë të palëve, të mbrojtësit ose sipas detyrës zyrtare përmirësohen nga gjyqtari i vetëm gjykues apo kryetari i trupit gjykues me aktvendim të posaçëm.
2. Nëse gabimet e imëta apo të padëmshme në aktgjykim janë objekt i ankesës, Gjykata e Apelit mund ta përmirësojë aktgjykimin nga neni 403 i këtij Kodi.
3. Kur të dhënat nga neni 365, paragrafi 1. nën-paragrafët 1.1. deri në 1.4. dhe nën-paragrafi 1.6. i këtij Kodi në aktgjykimin e përpiluar me shkrim ndryshojnë nga origjinali, aktvendimi për përmirësim u dërgohet personave nga neni 369 i këtij Kodi. Në rastin e tillë, afati i ankesës kundër aktgjykimit llogaritet nga dita e dorëzimit të aktvendimit. Kundër këtij aktvendimi nuk lejohet ankesë e posaçme.

Neni 372
Ekzekutimi i sanksioneve penale

1. Kur gjykata vendos për vazhdimin ose caktimin e paraburgimit pas shpalljes së aktgjykimit dhe i akuzuari pajtohet me këtë, ose kur gjykata e cakton dënimin

konform dispozitës së nenit 369 paragrafit 5. të këtij kodi, konsiderohet së i akuzuari është në vuajtje të dënimit konform dispozitave të Ligjit për ekzekutimin e sanksioneve penale**.**

2. Kur me aktgjykim shqiptohet sanksioni penal nga neni 367 paragrafi 2. ose 3. ose kur me aktgjykim të formës së prerë me shkrim shqiptohet dënimi nga neni 369, paragrafi 5. i këtij Kodi ndërsa i akuzuari ka ikur jashtë Kosovës apo i shmanget mbajtjes së dënimit, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues lëshon urdhërarrest për të akuzuarin në pajtim me nenin 175 të këtij Kodi.

Neni 373
Aktgjykimi kundër personave juridik dhe ekzekutimi i aktgjykimit

Investitorët, aksionarët apo kreditorët e personit juridik nuk mund të kundërshtojnë aktgjykimet dhe ekzekutimin e tyre kundër personit juridik, përveç nëse personi i tillë është përfaqësues i personit juridik të pandehur nga neni 20 i Ligjit për Përgjegjësinë e Personave Juridik për Vepra Penale, Ligji nr. 04/L-030 ose ligji pasues.

KAPITULLI XXI
MJETET JURIDIKE

1. Mjetet juridike

Neni 374
Llojet e mjeteve juridike

1. Përveç rasteve kur parashihet ndryshe me këtë Kod, pala mund të paraqesë mjetin juridik në gjykatën e shkallës drejtpërdrejtë më të lartë përmes:
   1.1. ankesës kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjykatën e Apelit.
   1.2. ankesës kundër aktgjykimi të Gjykatës së Apelit në Gjykatën Supreme të Kosovës sipas paragrafit 1. të nenit 407 të këtij Kodi ose kur me aktgjykim shqiptohet dënimi me burgim të përjetshëm.
   1.3. ankesës kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Gjykatën e Apelit.
   1.4. kërkesës për mjetin e jashtëzakonshëm juridik nga Gjykata Themelore apo Gjykata e Apelit në Gjykatën Supreme të Kosovës.
2. Kur lejohet me këtë Kod, urdhri i gjyqtarit të procedurës paraprake mund të shqyrtohet nga kolegji i përbërë prej tre (3) gjyqtarëve të gjykatës themelore. Urdhri i shqyrtuar nga kolegji shqyrtues nga ky paragraf mund të shqyrtohet nga Gjykata e Apelit apo Gjykata Supreme vetëm me rastin e ankesës kundër aktgjykimit të gjykatës themelore.

2. Rregullat e përgjithshme të procedurës ankimore

Neni 375
Paanshmëria në shqyrtimin e mjetit juridik

1. Asnjëra palë nuk lejohet të ketë komunikim në prezencën e vetëm njërës palë me kolegjin shqyrtues, Gjykatën e Apelit apo Gjykatën Supreme lidhur me kundërshtimin

apo kërkesën për mjet juridik që pret zgjidhjen nga kolegji shqyrtues, Gjykata e Apelit ose Gjykata Supreme, apo të cilën pala pretendon ta paraqesë te kolegji shqyrtues, Gjykata e Apelit ose Gjykata Supreme.

2. Asnjë gjyqtari i kolegjit shqyrtues, Gjykatës së Apelit apo Gjykatës Supreme nuk komunikon lidhur me kundërshtimin apo kërkesën për mjet juridik me palën e cila ka interes në këtë mjet juridik që pret vendimin e Gjykatës së Apelit apo Gjykatës Supreme, apo të cilën pala pretendon ta paraqesë para kolegjit shqyrtues, Gjykatës së Apelit apo Gjykatës Supreme.
3. Gjyqtari me të cilin pala tenton të komunikojë pa praninë e palës tjetër, në kundërshtim me paragrafin 1. ose 2. të këtij neni, refuzon komunikimin menjëherë dhe informon palët tjera për tentimin e palës për të komunikuar pa praninë e tyre.

Neni 376
Forma e kundërshtimit apo kërkesa për mjet juridik

1. Si rregull e përgjithshme, kundërshtimi apo kërkesa për mjet juridik duhet të përmbajë:
   1.1. numrin e lëndës;
   1.2. emrin e të pandehurit;
   1.3. përshkrimin e statusit ligjor të lëndës, përfshirë shënimin nëse kundërshtimi apo kërkesa është paraqitur brenda afatit kohor të lejuar;
   1.4. përshkrimin e fakteve të rëndësishme që janë të përfshira në procesverbal;
   1.5. përshkrimin e bazës ligjore të kundërshtimit apo kërkesës;
   1.6. përshkrimin e mjetit juridik që kërkohet;
   1.7. përshkrimin e bazës ligjore të mjetit juridik;
   1.8. nëse kundërshtimi apo kërkesa paraqitet në emër të të pandehurit, duhet të bashkëngjitet deklarata e të pandehurit me të cilën jep pëlqimin për ankesën apo kërkesën.
2. Kundërshtimi apo kërkesa duhet të identifikojë qartë të dhënat në pajtim me paragrafin 1. të këtij neni.
3. Kundërshtimi apo kërkesa paraqitet në gjykatë themelore, e cila ia dërgon ankesën apo kërkesën palës së kundërt.
4. Asnjë kundërshtimi apo kërkesë që nuk është në pajtim me këtë nen nuk shqyrtohet.

Neni 377
Forma e përgjigjes në kundërshtim apo në kërkesën për mjet juridik

1. Përgjigja në kundërshtimin ose në kërkesën për mjet juridik duhet të përmbajë:
   1.1. numrin e lëndës;
   1.2. emrin e të pandehurit;
   1.3. përshkrimin e statusit ligjor të lëndës, përfshirë shënimin nëse përgjigja është paraqitur brenda afatit kohor të lejuar;
   1.4. përshkrimin e fakteve të rëndësishme që janë të përfshira në procesverbal;
   1.5. përshkrimin e bazës ligjore të kundërshtimit apo kërkesës së paraqitur nga ankuesi apo pala kërkuese;
   1.6. përshkrimin e mjetit juridik të kërkuar nga pala kërkuese;

1.7. përshkrimin e bazës ligjore të mjetit juridik të kërkuar nga pala kërkuese;
2. Përgjigja në kundërshtim apo në kërkesë duhet të identifikojë qartë të dhënat në pajtim me paragrafin 1. të këtij neni.
3. Përgjigja në kundërshtim apo në kërkesë paraqitet në gjykatë themelore, e cila ia dërgon përgjigjen palës kundërshtare.
4. Asnjë përgjigje në kundërshtim apo në kërkesë që nuk është në pajtim me këtë nen nuk shqyrtohet.

Neni 378
Afati për paraqitjen e kundërshtimit, kërkesës për mjet juridik dhe përgjigjes

1. Kundërshtimi i cili shqyrtohet nga kolegji shqyrtues duhet të paraqitet brenda dyzet e tetë (48) orëve, përveç nëse përcaktohet ndryshe me ligj.
2. Kërkesa e cila shqyrtohet nga Gjykata e Apelit duhet të paraqitet brenda pesë (5) ditëve nga aktgjykimi apo aktvendimi i formës së prerë, përveç nëse përcaktohet ndryshe me ligj.
3. Kërkesa e cila shqyrtohet nga Gjykata Supreme e Kosovës duhet të paraqitet brenda dhjetë (10) ditëve, përveç nëse përcaktohet ndryshe me ligj.
4. Përgjigja në kundërshtim duhet të paraqitet brenda njëzet e katër (24) orëve nga kundërshtimi i cili shqyrtohet nga kolegji shqyrtues.
5. Përgjigja në kërkesë duhet të paraqitet brenda pesë (5) ditëve nga kërkesa e cila shqyrtohet nga Gjykata e Apelit.
6. Përgjigja në kërkesë duhet të paraqitet brenda dhjetë (10) ditëve nga kërkesa e cila shqyrtohet nga Gjykata Supreme e Kosovës.

Neni 379
Të gjitha kundërshtimet, kërkesat për mjet juridik dhe përgjigjet duhet të jenë në pajtim

Asnjë mendim, kundërshtim, kërkesë për mjet juridik apo përgjigje që nuk është në pajtim me nenet 375 deri 378 të këtij Kodi, nuk shqyrtohet nga gjyqtari i gjykatës themelore, kolegji shqyrtues, Gjykata e Apelit apo Gjykata Supreme e Kosovës.

3. Ankesa kundër aktgjykimit

Neni 380
Ankesa kundër aktgjykimit

1. Kundër aktgjykimit të marrë në nga gjyqtari i vetëm gjykues ose trupi gjykues i gjykatës themelore, ankesë mund të paraqesin personat e autorizuar brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e dorëzimit të kopjes së aktgjykimit.
2. Ankesa e personit të autorizuar e paraqitur brenda afatit të caktuar e pezullon ekzekutimin e aktgjykimit.

Neni 381
Personat e autorizuar për të paraqitur ankesë kundër aktgjykimit

1. Ankesë mund të paraqesin prokurori i shtetit, i akuzuari, mbrojtësi, përfaqësuesi ligjor i të akuzuarit dhe i dëmtuari.
2. Prokurori i shtetit mund të paraqesë ankesë në dëm dhe në dobi të të akuzuarit.
3. I dëmtuari mund të ushtrojë ankesë ndaj aktgjykimit vetëm për vendimin e gjykatës lidhur me sanksionet penale për veprat penale kundër jetës dhe trupit, kundër integritetit seksual, kundër sigurisë së trafikut publik dhe për shpenzimet e procedurës penale.
4. Ankesë mund të paraqesë edhe personi, pasuria e të cilit është konfiskuar ose nga i cili është konfiskuar dobia pasurore e fituar me vepër penale, si dhe personi juridik, pasuria e të cilit është konfiskuar.

Neni 382
Përmbajtja e ankesës kundër aktgjykimit

1. Ankesa kundër aktgjykimit duhet të jetë në pajtim me nenin 376 të këtij Kodi por përfshinë edhe:
   1.1. të dhënat mbi aktgjykimin i cili ankimohet;
   1.2. arsyet për kundërshtimin e aktgjykimit nga neni 383 i këtij Kodi;
   1.3. propozimin për anulim të tërësishëm apo të pjesërishëm të aktgjykimit ose për ndryshim të tij; dhe
   1.4. nënshkrimin e ankuesit.
2. Kur ankesën e paraqet i akuzuari ose i dëmtuari i cili nuk përfaqësohet nga mbrojtësi, dhe ankesa nuk është përpiluar në pajtim me dispozitat e paragrafit 1. të këtij neni, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues kërkon nga ankuesi që në afat të caktuar të ndryshojë ankesën me parashtresën me shkrim. Nëse ankuesi nuk e përmbush kërkesën e tillë, ndërsa ankesa nuk përfshin informatat nga neni 376 të këtij Kodi ose paragrafi 1. i këtij neni, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues e hudh ankesën nëse të dhënat nuk mund të zbulohen lehtë.
3. Në ankesë mund të paraqiten fakte dhe prova të reja, por ankuesi detyrohet të arsyetojë përse ato nuk i ka paraqitur më parë. Kur ankuesi thirret në fakte të reja, ai detyrohet të paraqesë prova me të cilat këto fakte mund të provohen, e kur u referohet provave të reja, detyrohet të paraqesë faktet që ai synon t'i vërtetojë me to.
4. Kur ankuesi pretendon në ankesë arsye të cilat nuk i ka ngritur në gjykatën themelore gjatë shqyrtimit fillestar, shqyrtimit të dytë apo shqyrtimit gjyqësor, ankuesi nuk mund të ankohet mbi këto baza, përveç nëse vërteton se ka pasur shkaqe të jashtëzakonshme apo prova ose fakte të reja nga paragrafi 3. të këtij neni.

Neni 383
Arsyet për ushtrimin e ankesës ndaj aktgjykimit

1. Ndaj aktgjykimit mund të ushtrohet ankesë:
   1.1. për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale;

1.2. për shkak të shkeljes së ligjit penal;
1.3. për shkak të vërtetimit të gabueshëm ose jo të plotë të gjendjes faktike; ose
1.4. për shkak të vendimit lidhur me sanksionet penale, konfiskimit të dobisë pasurore të fituar me vepër penale, shpenzimeve të procedurës penale, kërkesave pasurore juridike, si dhe për shkak të vendimit mbi publikimin e aktgjykimit.

2. Ndaj aktgjykimit nuk mund të ushtrohet ankesë për shkak të vërtetimit të gabueshëm ose jo të plotë të gjendjes faktike kur ka marrëveshje mbi pranim të fajësisë apo kur i akuzuari ka pranuar fajësinë për të gjitha pikat e aktakuzës dhe trupi gjykues është pajtuar me pranimin e tillë.

Neni 384
Shkelja esenciale e dispozitave të procedurës penale

1. Shkelje esenciale e dispozitave të procedurës penale konsiderohet nëse:
1.1. përbërja e gjykatës nuk ka qenë në pajtim me ligjin ose kur në marrjen e aktgjykimit ka marrë pjesë gjyqtari i cili nuk ka qenë i pranishëm në shqyrtimin gjyqësor, ose kur me vendim të formës së prerë është përjashtuar nga gjykimi;
1.2. në shqyrtim gjyqësor ka marrë pjesë gjyqtari i cili është dashur të përjashtohet;
1.3. shqyrtimi gjyqësor është mbajtur pa personat, prania e të cilëve në shqyrtim gjyqësor kërkohet me ligj, ose kur të akuzuarit apo mbrojtësit, pavarësisht nga kërkesa e tij, i është mohuar përdorimi i gjuhës së vet në shqyrtim gjyqësor dhe përcjellja e zbatimit të shqyrtimit gjyqësor në gjuhën e tij;
1.4. publiku është përjashtuar nga shqyrtimi gjyqësor në kundërshtim me ligjin;
1.5. gjykata ka shkelur dispozitat e procedurës penale lidhur me çështjen nëse ekziston akuza e prokurorit të autorizuar, propozimi i të dëmtuarit ose leja e organit publik kompetent;
1.6. aktgjykimin e ka marrë gjykata e cila nuk ka pasur kompetencë lëndore për gjykimin e çështjes.
1.7. gjykata me aktgjykim nuk e ka gjykuar plotësisht lëndën e akuzës;
1.8. aktgjykimi bazohet në provë të papranueshme;
1.9. i akuzuari i thirrur të deklarohet mbi fajësinë nuk e ka pranuar fajësinë për të gjitha pikat e akuzës ose ndonjë pikë të saj dhe është marrë në pyetje para prezentimit të provave;
1.10. aktgjykimi ka tejkaluar akuzën;
1.11. me aktgjykim është shkelur dispozita e nenit 395 të këtij Kodi; ose
1.12. aktgjykimi nuk është përpiluar në pajtim me nenin 370 të këtij Kodi.

2. Shkelje esenciale e dispozitave të procedurës penale konsiderohet edhe kur gjatë procedurës penale, duke përfshirë edhe procedurën paraprake, gjykata, prokurori i shtetit dhe policia:
2.1. nuk kanë zbatuar ndonjë dispozitë të këtij kodi ose kanë zbatuar gabimisht; ose
2.2. kanë shkelur të drejtat e mbrojtjes, dhe kjo ka ndikuar ose ka mundur të ndikojë në marrjen e aktgjykimit të ligjshëm dhe të drejtë.

Neni 385
Shkelja e ligjit penal

1. Shkelje e ligjit penal ekziston kur:
   1.1. vepra për të cilën i akuzuari ndiqet nuk është vepër penale;
   1.2. ekzistojnë rrethana që përjashtojnë përgjegjësinë penale;
   1.3. ekzistojnë rrethana që përjashtojnë ndjekjen penale, e sidomos nëse ndjekja penale është parashkruar ose është përjashtuar për shkak të amnistisë apo faljes, ose më parë është gjykuar me aktgjykim të formës së prerë;
   1.4. lidhur me veprën e gjykuar penale është zbatuar ligji i cili nuk mund të zbatohet;
   1.5. në marrjen e vendimit për dënim, dënim alternativ, vërejtje gjyqësore ose në marrjen e vendimit për masën e trajtimit të detyrueshëm për rehabilitim apo për konfiskim të dobisë pasurore të fituar me vepër penale gjykata ka tejkaluar kompetencat ligjore; ose
   1.6. janë shkelur dispozitat mbi llogaritjen e paraburgimit dhe të dënimit të mbajtur.

Neni 386
Vërtetimi i gabueshëm ose jo i plotë i gjendjes faktike

1. Aktgjykimi mund të kundërshtohet për shkak të vërtetimit të gabueshëm ose jo të plotë të gjendjes faktike.
2. Vërtetimi i gabuar i gjendjes faktike ekziston kur gjykata ka vërtetuar gabimisht ndonjë fakt të rëndësishëm apo kur përmbajtja e dokumentit, procesverbalit mbi provat e shqyrtuara ose të incizimit teknik vënë në pikëpyetje saktësinë ose bazueshmërinë e vërtetimit të fakteve të rëndësishme.
3. Vërtetimi jo i plotë i gjendjes faktike ekziston kur gjykata nuk ka vërtetuar ndonjë fakt të rëndësishëm.

Neni 387
Ankesa kundër aktgjykimit lidhur me vendimin mbi sanksionin penal dhe vendimeve të tjera

1. Ndaj aktgjykimit mund të ushtrohet ankesë lidhur me vendimin mbi shqiptimin e dënimit ose vërejtjes gjyqësore kur gjykata, duke pasur parasysh të gjitha rrethanat përkatëse, përkundër mostejkalimit të kompetencave ligjore nuk e ka caktuar drejt dënimin ose vërejtjen gjyqësore.
2. Ndaj aktgjykimit gjithashtu mund të ushtrohet ankesë kur gjykata ka zbatuar ose nuk ka zbatuar dispozitat për zbutjen ose lirimin nga dënimi apo të vërejtjes gjyqësore.
3. Vendimi për masën e trajtimit të detyrueshëm rehabilitues të personave të varur nga droga ose alkooli ose për konfiskimin e dobisë pasurore të fituar me vepër penale mund të kundërshtohet kur gjykata, përkundër faktit se nuk ka bërë shkelje të nenit 385, nën-paragrafi 1.5. i këtij Kodi, ka marrë vendim jo të drejtë ose nuk e ka shqiptuar masën e trajtimit të detyrueshëm me rehabilitim për personat e varur nga

droga ose alkooli ose masën për konfiskimin e dobisë pasurore të fituar me vepër penale, përkundër ekzistimit të bazës ligjore për këtë.
4. Ndaj vendimit mbi shpenzimet e procedurës penale mund të ushtrohet ankesë kur gjykata për shpenzimet e tilla ka vendosur në mënyrë jo të drejtë ose në kundërshtim me dispozitat e këtij Kodi.
5. Ndaj vendimit mbi kërkesën pasurore juridike ose vendimit mbi publikimin e aktgjykimit mund të ushtrohet ankesë kur gjykata për çështjet e tilla ka marrë vendim në kundërshtim me dispozitat ligjore.

Neni 388
Procedura për paraqitjen e ankesës kundër aktgjykimit

1. Ankesa kundër aktgjykimit paraqitet në gjykatën e cila ka nxjerr aktgjykimin.
2. Kjo gjykatë i dërgon një kopje të ankesës palëve kundërshtare, të cilat mund të paraqesin përgjigje në ankesë brenda tetë (8) ditëve nga pranimi i kopjes së ankesës.
3. Kjo gjykatë i përcjell ankesën, përgjigjën dhe shkresat tjera përkatëse në gjykatën që është kompetente për shqyrtimin e ankesës.
4. Ankesa apo kërkesa nga ky nen paraqitet në numër të mjaftueshëm të kopjeve për gjykatën dhe palët kundërshtare.

Neni 389
Procedura lidhur me ankesën kundër aktgjykimit në gjykatën e apelit

1. Kur Gjykata e Apelit pranon lëndën me ankesë, ato ia dorëzon kryetarit të kolegjit të caktuar sipas orarit të gjykatës.
2. Kryetari i kolegjit të apelit cakton seancën e kolegjit.
3. Me rastin e kthimit të lëndës, prokurori i shtetit mund të paraqesë propozim ose të deklarojë se atë do ta paraqesë në seancën e kolegjit të apelit.
4. Gjyqtari raportues, sipas nevojës, mund të kërkojë nga gjykata themelore raport për shkeljen e dispozitave të procedurës penale, e nëpërmjet kësaj gjykate ose në ndonjë mënyrë tjetër të vërtetojë pretendimet e ankesës lidhur me provat dhe faktet e reja ose ai siguron raportet dhe dokumentet e nevojshme nga organet ose nga persona të tjerë juridikë.
5. Nëse i akuzuari është në paraburgim, gjyqtari raportues brenda pesë (5) ditësh pas pranimit të shkresave të lëndës shqyrton sipas detyrës zyrtare nëse ende ekzistojnë arsyet për mbajtje në paraburgim.

Neni 390
Seanca para kolegjit të apelit

1. Kur të akuzuarit i është shqiptuar dënimi me burgim, njoftimi për seancën e kolegjit të apelit i dërgohet prokurorit kompetent të shtetit, të dëmtuarit, të akuzuarit dhe mbrojtësit të tij.
2. Në qoftë se i akuzuari i cili gjendet në paraburgim ose në mbajtje të dënimit dëshiron të merr pjesë në seancë, pjesëmarrja i mundësohet atij.
3. Seanca e kolegjit fillon me raportim të gjyqtarit raportues mbi faktet. Kolegji mund

të kërkojë nga palët dhe mbrojtësi që prezantojnë në seancë sqarime të nevojshme lidhur me pretendimet e tyre në ankesë. Palët dhe mbrojtësi mund të propozojnë që për plotësim të raportit të lexohet ndonjë shkresë dhe mund të japin shpjegime të nevojshme për qëndrimet e tyre në ankesë apo përgjigje në ankesë, pa përsëritur përmbajtjen e raportit.
4. Mosardhja e palëve të njoftuara me rregull nuk pengon mbajtjen e seancës së kolegjit. Kur i akuzuari nuk e ka njoftuar gjykatën për ndërrimin e adresës ose të vendqëndrimit, seanca e kolegjit mund të mbahet edhe pa njoftimin e të akuzuarit.
5. Publiku mund të përjashtohet nga seanca e kolegjit që mbahet me prani të palëve vetëm nën kushtet e parapara me këtë kod.
6. Procesverbali i seancës i bashkëngjitet shkresave të gjykatës.
7. Aktvendimet nga nenet 399 dhe 400 të këtij Kodi mund të merren edhe pa njoftimin e palëve për seancën e kolegjit.

Neni 391
Vendimet e kolegjit të apelit të marra në seancë apo në shqyrtim

1. Gjykata e Apelit merr vendim në seancë të kolegjit ose në shqyrtim.
2. Gjykata e Apelit në seancë të kolegjit vendos nëse do ta mbajë shqyrtimin.

Neni 392
Arsyet për mbajtjen e shqyrtimit në gjykatën e apelit

1. Shqyrtimi para Gjykatës së Apelit mbahet vetëm kur është e nevojshme që, për shkak të vërtetimit të gabueshëm ose jo të plotë të gjendjes faktike, të merren prova të reja ose të përsëritën provat e marra më parë dhe kur ekzistojnë shkaqe të arsyeshme që lënda të mos i kthehet gjykatës themelore në rigjykim.
2. Në shqyrtim të Gjykatës së Apelit thirren i akuzuari dhe mbrojtësi i tij, prokurori i shtetit, i dëmtuari, përfaqësuesi ligjor dhe përfaqësuesi i autorizuar i të dëmtuarit, si dhe dëshmitarët dhe ekspertët të cilët gjykata me propozim të palëve apo sipas detyrës zyrtare vendos t'i pyesë.
3. Në qoftë se i akuzuari gjendet në paraburgim ose në mbajtje të dënimit, kryetari i trupit gjykues i Gjykatës së Apelit ndërmerr masa të nevojshme për të siguruar praninë e të akuzuarit në shqyrtim.

Neni 393
Shqyrtimi para kolegjit të apelit

1. Shqyrtimi para Gjykatës së Apelit fillon me raportim të gjyqtarit raportues, i cili paraqet gjendjen faktike pa dhënë mendimin e tij për bazueshmërinë e ankesës.
2. Aktgjykimi ose pjesa e tij për të cilën është ushtruar ankesë, dhe sipas nevojës, edhe procesverbali i shqyrtimit gjyqësor lexohet me propozim ose sipas detyrës zyrtare.
3. Pas kësaj thirret ankuesi ta arsyetojë ankesën dhe pastaj pala kundërshtare që t'i përgjigjet. I akuzuari dhe mbrojtësi i tij gjithmonë e kanë fjalën të fundit.
4. Palët gjatë shqyrtimit mund të paraqesin prova dhe fakte të reja.
5. Prokurori i shtetit, mbështetur në rezultatet e shqyrtimit, mund të tërhiqet tërësisht ose pjesërisht nga aktakuza ose ta ndryshojë atë në dobi të të akuzuarit.

Neni 394
Kufijtë e shqyrtimit të ankesës nga gjykata e apelit

1. Gjykata e Apelit shqyrton aktgjykimin në pjesën për të cilën është ushtruar ankesë, por çdo herë sipas detyrës zyrtare shqyrton:
   1.1. nëse ekziston shkelje e dispozitave të procedurës penale nga neni 384, paragrafi 1., nën-paragrafët 1.1., 1.2., 1.6. dhe 1.8. deri në 1.12. të këtij Kodi;
   1.2. nëse shqyrtimi gjyqësor është mbajtur në mungesë të të akuzuarit në kundërshtim me dispozitat e këtij Kodi;
   1.3. nëse në çështjen e mbrojtjes së detyrueshme është mbajtur shqyrtimi gjyqësor pa praninë e mbrojtësit; dhe
   1.4. nëse është shkelur ligji penal në dëm të të akuzuarit.
2. Nëse ankesa e paraqitur në dobi të të akuzuarit nuk përfshin të dhënat nga neni 382, paragrafi 1., nën-paragrafi 1.2. ose 1.3. i këtij Kodi, Gjykata e Apelit kufizohet vetëm në shqyrtimin e shkeljeve nga paragrafi 1. nën-paragrafët 1.1. deri në 1.4. të këtij neni dhe në shqyrtimin e vendimit për dënimin, caktimin e masës për trajtim të detyrueshëm për rehabilitim dhe konfiskimin e dobisë pasurore të fituar me vepër penale.

Neni 395
Reformatio in Peius

Në qoftë se është paraqitur ankesë vetëm në dobi të të akuzuarit, aktgjykimi përsa i përket cilësimit juridik të veprës dhe sanksionit penal nuk mund të ndryshohet në dëm të tij.

Neni 396
Efekti shtesë i ankesës së paraqitur për shkak të vërtetimit të gabueshëm ose jo të plotë të gjendjes faktike ose shkeljes së ligjit penal

Ankesa e paraqitur në dobi të të akuzuarit për shkak të vërtetimit të gabueshëm ose jo të plotë të gjendjes faktike, ose për shkak të shkeljes së ligjit penal përfshin edhe ankesën kundër vendimit lidhur me dënimin, trajtimin e detyrueshëm për rehabilitim dhe marrjen e dobisë pasurore të fituar me vepër penale.

Neni 397
Beneficium Cohaesionis

Kur me rastin e paraqitjes së ankesës së cilitdo të akuzuar, Gjykata e Apelit çmon se arsyet për të cilat ka marrë vendim në dobi të të akuzuarit, e që nuk janë të natyrës personale, shkojnë në dobi edhe të ndonjërit nga të bashkakuzuarit i cili nuk ka paraqitur ankesë ose nuk e ka paraqitur në atë drejtim, gjykata vepron sipas detyrës zyrtare sikurse ankesa e tillë të ishte paraqitur edhe nga i bashkakuzuari.

Neni 398
Vendimi i Gjykatës së Apelit lidhur me ankesën ndaj aktgjykimit të gjykatës themelore

1. Gjykata e Apelit në seancë të kolegjit ose në bazë të shqyrtimit:
   1.1. e hudh ankesën si të paafatshme ose të palejuar;
   1.2. e refuzon ankesën si të pabazë dhe e vërteton aktgjykimin e gjykatës themelore;
   1.3. e anulon aktgjykimin dhe çështjen ia kthen gjykatës themelore për rigjykim dhe vendim; ose
   1.4. e ndryshon aktgjykimin e gjykatës themelore.
2. Gjykata e Apelit mund të urdhërojë gjykatën themelore që të caktojë një tjetër gjyqtar të vetëm gjykues, kryetar të trupit gjykues ose trup gjykues sipas një sistemi të caktimit të lëndëve që të jetë objektiv dhe transparent, nëse Gjykata e Apelit vlerëson se gjyqtari i vetëm gjykues, kryetari i trupit gjykues ose trupi gjykues që e ka gjykuar rastin në mënyrë të vazhdueshme nuk e ka zbatuar ligjin siç duhet, ka vlerësuar shumë gabimisht provat ose moscaktimi i gjyqtarit apo trupit gjykues tjetër do të rezultonte në keqpërdorim të drejtësisë ose konflikt të interesit.
3. Gjykata e Apelit vendos për të gjitha ankesat kundër të njëjtit aktgjykim me një vendim.
4. Vendimi i Gjykatës së Apelit nënshkruhet nga të gjithë gjyqtarët e kolegjit, përveç vendimit të marrë sipas nenit 399 ose 400 të këtij Kodi. Një anëtar i kolegjit mund të jep mendim të ndarë, mospajtues ose pajtues për çështjet juridike ose faktike lidhur me ankesën, dhe mendimi i tillë i bashkëngjitet vendimit kryesor.

Neni 399
Hudhja e ankesave të paafatshme

Gjykata e Apelit me aktvendim e hudh ankesën si të paafatshme kur konstaton se është paraqitur pas kalimit të afatit ligjor.

Neni 400
Hudhja e ankesës së palejueshme

Gjykata e Apelit me aktvendim e hudh ankesën si të palejueshme kur konstaton se është paraqitur nga personi pa të drejtë ankese ose nga personi që ka hequr dorë nga ankesa, apo kur ankesa është tërhequr, ose kur ankesa e tërhequr paraqitet sërish apo ankesa nuk është e lejuar me ligj.

Neni 401
Refuzimi i ankesës së pabazë dhe vërtetimi i aktgjykimit të gjykatës themelore

Gjykata e Apelit me aktgjykim refuzon ankesën si të pabazë dhe vërteton aktgjykimin e gjykatës themelore kur vërteton se nuk ekzistojnë shkaqet për të cilat është ushtruar ankesë ndaj aktgjykimit dhe nuk ka shkelje të ligjit sipas nenit 394, paragrafi 1. i këtij Kodi.

Neni 402
Anulimi i aktgjykimit të gjykatës themelore

1. Gjykata e Apelit, në raste të caktuara, anulon aktgjykimin e gjykatës themelore dhe çështjen e kthen në rigjykim kur vërteton se:
   1.1. ekziston shkelje esenciale e dispozitave të procedurës penale, dhe Gjykata e Apelit nuk mund të procedojë sipas nenit 403 të këtij Kodi; ose
   1.2. për shkak të vërtetimit të gabueshëm ose jo të plotë të gjendjes faktike duhet urdhëruar shqyrtim të ri gjyqësor në gjykatë themelore dhe Gjykata e Apelit nuk mund të procedojë sipas nenit 403 të këtij Kodi.
2. Gjykata e Apelit me aktvendim e anulon aktgjykimin e gjykatës themelore edhe refuzon aktakuzën nëse konstaton rrethanat nga neni 358, paragrafi 1. i këtij Kodi. Gjykata e Apelit procedon në të njëjtën mënyrë kur gjen se gjykata themelore nuk ka pasur kompetencë lëndorë për gjykimin e rastit, përveç kur ankesa është paraqitur vetëm në favor të të akuzuarit.
3. Gjykata e Apelit mund të anulojë pjesërisht aktgjykimin e gjykatës themelore kur pjesë të posaçme të aktgjykimit mund të veçohen pa ndonjë pasojë për gjykim të drejtë.
4. Në qoftë se i akuzuari gjendet në paraburgim, Gjykata e Apelit shqyrton nëse ende ekzistojnë shkaqet për paraburgim dhe vendos me aktvendim për vazhdimin ose heqjen e paraburgimit. Kundër këtij aktvendimi nuk lejohet ankesë.

Neni 403
Ndryshimi i aktgjykimit të gjykatës themelore

1. Gjykata e Apelit e ndryshon aktgjykimin e gjykatës themelore me aktgjykim kur vërteton se gjykata themelore ka bërë vërtetim të gabuar apo jo të plotë të fakteve, dhe për këtë qëllim:
   1.1. në bazë të kërkesës së palëve ose sipas detyrës zyrtare, zbaton shqyrtim për të marrë prova të reja apo për të përsëritur shqyrtimin e provave në mënyrë që të vlerësojë drejtë dhe të çmojë provat materiale; ose
   1.2. mund të vërtetojë dhe të çmojë provat materiale pa mbajtur shqyrtim, nëse nuk ka nevojë për të marrë prova të reja apo për të përsëritur shqyrtimin e provave.
2. Kur Gjykata e Apelit çmon se ekzistojnë kushtet ligjore për shqiptimin e vërejtjes gjyqësore, e ndryshon aktgjykimin e gjykatës themelore me aktgjykim dhe shqipton vërejtjen gjyqësore.
3. Kur për shkak të ndryshimit të aktgjykimit të gjykatës themelore ka arsye për caktimin ose heqjen e paraburgimit, për këtë Gjykata e Apelit merr aktvendim të posaçëm. Kundër këtij aktvendimi nuk lejohet ankesë.

Neni 404
Arsyetimi i vendimeve të Gjykatës së Apelit

1. Në arsyetim të aktgjykimit apo të aktvendimit, Gjykata e Apelit vlerëson pretendimet e ankesës dhe tregon shkeljet e ligjit të cilat i ka shqyrtuar sipas detyrës zyrtare.

2. Kur aktgjykimi i gjykatës themelore anulohet për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, në arsyetim shënohen dispozitat e shkelura dhe në çka konsistojnë shkeljet, në pajtim me nenin 384 të këtij Kodi.
3. Kur aktgjykimi i gjykatës themelore anulohet për shkak të vërtetimit të gabueshëm ose jo të plotë të gjendjes faktike, në arsyetim shënohen të metat në vërtetimin e gjendjes faktike apo arsyet përse provat dhe faktet e reja janë të rëndësishme dhe me ndikim në marrjen e vendimit të drejtë.

Neni 405
Rikthimi i vendimeve në gjykatë themelore për t'ua dërguar palëve

1. Gjykata e Apelit ia kthen të gjitha shkresat gjykatës themelore bashkë me kopje të mjaftueshme të vërtetuara të vendimit të saj për t'ua dërguar palëve dhe personave të tjerë të interesuar.
2. Në qoftë se i akuzuari është në paraburgim, Gjykata e Apelit ia dërgon vendimin dhe shkresat gjykatës themelore jo më vonë se tre (3) muaj nga dita e marrjes së shkresave nga kjo gjykatë.

Neni 406
Procedura e rigjykimit në Gjykatë Themelore sipas aktvendimit të Gjykatës së Apelit

1. Gjykata themelore të cilës i është dërguar lënda për gjykim procedon në bazë të aktakuzës së mëparshme. Kur aktgjykimi i gjykatës themelore anulohet pjesërisht, gjykata merr për bazë atë pjesë të akuzës që ka të bëjë me pjesën e anuluar të aktgjykimit.
2. Në shqyrtim të ri gjyqësor palët kanë të drejtë të prezentojnë fakte dhe prova të reja.
3. Gjykata themelore ndërmerr të gjitha veprimet procedurale dhe shqyrton të gjitha çështjet kontestuese të theksuara në vendimin e Gjykatës së Apelit.
4. Me rastin e marrjes së aktgjykimit të ri, gjykata themelore detyrohet me ndalesën e paraparë në nenin 395 të këtij Kodi.
5. Në qoftë se i akuzuari është në paraburgim, kolegji i gjykatës themelore procedon sipas nenit 193, paragrafi 2. i këtij Kodi.

Neni 407
Ankesa në Gjykatën Supreme kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit

1. Ankesë kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit mund të paraqitet në Gjykatën Supreme të Kosovës në rastin kur Gjykata e Apelit e ndryshon aktgjykimin lirues të gjykatës themelore dhe e zëvendëson me aktgjykim dënues për të akuzuarin ose kur me aktgjykimin e Gjykatës Themelore, ose Gjykatës së Apelit i është shqiptuar dënimi me burg të përjetshëm.
2. Nenet 389 deri 406 të këtij Kodi zbatohen përshtatshmërisht për procedurën ankimore para Gjykatës Supreme.
3. Aktgjykimet e Gjykatës Supreme nënshkruhen nga të gjithë gjyqtarët e kolegjit. Një anëtar i kolegjit mund të paraqesë mendim të ndarë, mospajtues ose pajtues mbi çështje ligjore ose faktike lidhur me ankesën dhe mendimi i tillë i bashkëngjitet aktgjykimit.

4. Ankesa kundër aktvendimit

Neni 408
Llojet e aktvendimeve që mund të ankimohen

1. Kundër aktvendimeve të gjyqtarit të procedurës paraprake dhe kundër aktvendimeve tjera të gjykatës themelore, palët dhe personat të drejtat e të cilëve janë shkelur, në pajtim me nenin 411 të këtij Kodi mund të paraqesin ankesë, me përjashtim kur me dispozitat e këtij Kodi shprehimisht nuk lejohet ankesë e tillë.
2. Kundër aktvendimit të marrë në procedurë paraprake nga kolegji shqyrtues i përbërë nga tre (3) gjyqtarë nuk lejohet ankesë, me përjashtim të rasteve kur ky Kod parasheh ndryshe.
3. Aktvendimet që merren për përgatitjen e shqyrtimit gjyqësor dhe të aktgjykimit mund të kundërshtohen vetëm me ankesë kundër aktgjykimit, përveç kur ky Kod parasheh ndryshe.
4. Kundër aktvendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës nuk lejohet ankesë.

Neni 409
Afati për ankesë kundër aktvendimit

1. Ankesa i paraqitet gjykatës e cila ka marrë aktvendimin.
2. Me përjashtim të rasteve kur ky Kod parasheh ndryshe, ankesa kundër aktvendimit paraqitet brenda tri (3) ditëve nga dita e dorëzimit të aktvendimit.

Neni 410
Efekti suspenziv i ankesës kundër aktvendimit

Me përjashtim të rasteve kur ky Kod parasheh ndryshe, paraqitja e ankesës pezullon ekzekutimin e aktvendimit ndaj të cilit është ushtruar ankesë.

Neni 411
Procedura për paraqitjen e ankesës kundër aktvendimit

1. Pala e autorizuar paraqet ankesë në pajtim me këtë Kapitull.
2. Ankesa e cila nuk paraqitet në pajtim me këtë Kapitull mund të hudhet menjëherë nga Gjykata e Apelit pasi të jetë siguruar se në ankesë nuk ngritet ndonjë çështje e rëndësishme lidhur me të drejtat kushtetuese të garantuara.
3. Ankesa kundër vendimit të gjykatës themelore paraqitet nga ankuesi në gjykatë themelore.
4. Gjykata themelore i dërgon palës kundërshtare kopjen e ankesës.
5. Gjykata themelore i përcjellë ankesën, përgjigjen dhe shkresat e ndërlidhura Gjykatës së Apelit.
6. Ankesa mbi aktvendimin e Gjykatës së Apelit paraqitet nga pala e autorizuar në Gjykatën e Apelit.
7. Gjykata e Apelit i dërgon palës kundërshtare kopjen e ankesës.
8. Gjykata e Apelit i përcjellë ankesën, përgjigjen dhe shkresat e ndërlidhura Gjykatës Supreme.

9. Ankesa e paraqitur nga paragrafi 6. i këtij neni që nuk është në pajtim me këtë Kapitull mund të hudhet menjëherë nga Gjykata Supreme pasi të ketë siguruar se në ankesë nuk ngritet ndonjë çështje e rëndësishme lidhur me të drejtat kushtetuese të garantuara.
10. Në rastet nga paragrafi 2. ose paragrafi 9. i këtij neni kur ankesa ngrit çështje të rëndësishme për të drejtat e garantuara kushtetuese, por nuk është në pajtim me këtë Kapitull, ankuesit i jepet mundësia që të korrigjojë ankesën.
11. Ankesa apo kërkesa nga ky nen paraqitet në numër të mjaftueshëm të kopjeve për gjykatën dhe palët kundërshtare.

Neni 412
Procedura lidhur me ankesë kundër aktvendimit në Gjykatën e Apelit

1. Kur Gjykata e Apelit pranon lëndën me ankesë, ajo ia dërgon lëndën prokurorit kompetent të shtetit në kuadër të Prokurorisë së Apelit, i cili e shqyrton lëndën dhe pa vonesë ia kthen gjykatës.
2. Me rastin e kthimit të lëndës, prokurori i shtetit mund të paraqesë propozim ose të deklarojë se atë do ta paraqesë në seancën e kolegjit të apelit.
3. Pasi që prokurori i shtetit e kthen lëndën, kryetari i kolegjit të apelit cakton seancën e kolegjit.

Neni 413
Aktvendimet e kolegjit të apelit bazuar në shkresat e paraqitura apo të marra gjatë seancës

1. Gjykata e Apelit merr aktvendim bazuar në ankesën dhe propozimet e paraqitura ose gjatë seancës së kolegjit.
2. Gjykata e Apelit merr aktvendim bazuar në ankesën dhe propozimet e paraqitura vetëm kur:
   2.1. nuk ka ndonjë kundërshtim ligjor apo faktik; ose
   2.2. kolegji çmon se aktvendimi është aq i qartë sa që mbajtja e seancës do të ishte e panevojshme.
3. Aktvendimi i kolegjit të Gjykatës së Apelit në pajtim me paragrafin 2. të këtij neni duhet të përmbajë arsyetimin për aktvendimin nga paragrafi 2. i këtij neni.

Neni 414
Seanca para kolegjit të apelit

1. Kur Gjykata e Apelit pranon ankesë kundër aktvendimit kolegji mund të vendos për mbajtjen e seancës në të cilën njoftohen: prokurori kompetent i shtetit, të dëmtuarit, të akuzuarit dhe mbrojtësit e tij.
2. Në qoftë se i akuzuari i cili gjendet në paraburgim ose në mbajtje të dënimit dëshiron të merr pjesë në seancë, atij i mundësohet pjesëmarrja.
3. Kolegji mund të kërkojë nga palët dhe mbrojtësi që prezantojnë në seancë sqarime të nevojshme lidhur me pretendimet e tyre në ankesë. Palët dhe mbrojtësi mund të japin shpjegime të nevojshme për qëndrimet e tyre në ankesë apo përgjigjen në ankesë.

4. Mosardhja e palëve të thirrur me rregull nuk pengon mbajtjen e seancës së kolegjit. Kur i akuzuari nuk e ka njoftuar gjykatën për ndërrimin e adresës ose të vendqëndrimit, seanca e kolegjit mund të mbahet edhe pa njoftimin e të akuzuarit.
5. Publiku mund të përjashtohet nga seanca e kolegjit që mbahet me prani të palëve vetëm nën kushtet e parapara me këtë kod.
6. Procesverbali i seancës i bashkëngjitet shkresave të gjykatës.
7. Aktvendimet nga nenet 399 dhe 400 të këtij Kodi mund të merren edhe pa njoftimin e palëve për seancën e kolegjit.

Neni 415
Arsyet e ankesës kundër aktvendimit

1. Aktvendimi i gjyqtarit të procedurës paraprake, gjyqtarit të vetëm gjykues, kryetarit të trupit gjykues ose trupit gjykues mund të ankimohet kur ai aktvendim shkel:
   1.1. të drejtën e cila i njihet palës me Kushtetutën e Republikës së Kosovës;
   1.2. të drejtën thelbësore të palës të paraparë me këtë Kodi;
   1.3. të drejtën thelbësore të palës të paraparë me ndonjë ligj tjetër të Kosovës; dhe
   1.4. të drejtën procedurale që ka për qëllim garantimin e të drejtës nga nën-paragrafët 1.1. deri 1.3. të këtij neni;
2. Pala e cila kundërshton aktvendimin e gjykatës themelore duhet të demonstrojë se shkelja e së drejtës i shkakton asaj dëm të parevokueshëm.
3. Nëse arsyet e ankesës nuk janë në pajtim me paragrafët 1. dhe 2. të këtij neni, Gjykata e Apelit mund të hudhë ankesën. Ankesa e cila hudhet sipas këtij paragrafi mund të paraqitet sërish me ankesë kundër aktgjykimit nga neni 380 i këtij Kodi.

Neni 416
Vendimet mbi ankesën kundër aktvendimit

1. Me përjashtim të rasteve kur parashihet ndryshe me këtë Kod, ankesat kundër aktvendimit të gjykatës themelore vendosen në seancë të kolegjit të Gjykatës së Apelit.
2. Kur vendos për ankesë, gjykata me aktvendim mund ta hudhë ankesën si të paafatshme ose të papranueshme, ta refuzojë si të pabazë, ta aprovojë ankesën dhe ta ndryshojë aktvendimin ose ta anulojë dhe, sipas nevojës, çështjen ta kthejë për rivendosje.
3. Kur vendos mbi ankesën kundër aktvendimit me të cilin hudhet aktakuza, gjykata mund të refuzojë ankesën e tillë me aktgjykim nëse mëson se ka arsye për aktgjykim të tillë.
4. Kur e shqyrton ankesën, gjykata interesohet sipas detyrës zyrtare për të mësuar nëse gjykata themelore ka pasur kompetencë lëndore për marrjen e aktvendimit dhe nëse aktvendimi është marrë nga organi i autorizuar.

Neni 417
Shqyrtimi nga kolegji shqyrtues i gjykatës themelore

1. Kundërshtimi kundër urdhrit të gjyqtarit të procedurës paraprake vendoset nga kolegji shqyrtues i gjykatës së njëjtë nëse ashtu parashihet me këtë Kod.

2. Kryetari i gjykatës themelore cakton kolegjin shqyrtues prej tre (3) gjyqtarësh. Këta tre (3) gjyqtarë janë kompetent për të shqyrtuar kundërshtimin. Gjyqtari i procedurës paraprake apo cilido gjyqtar që ka marrë pjesë në mundësinë hetuese të veçantë nuk lejohet të marrin pjesë në kolegjin shqyrtues.
3. Përveç nëse përcaktohet ndryshe me këtë Kod, kolegji shqyrtues i shqyrton kundërshtimet e palëve brenda tre (3) ditë nga paraqitja e ankesës.
4. Përveç nëse përcaktohet ndryshe me këtë Kod, kolegji shqyrtues merr aktvendim mbi ankesën e palëve brenda një jave (1) nga paraqitja e kundërshtimit.
5. Përveç nëse përcaktohet ndryshe me këtë Kod, aktvendimi i kolegjit shqyrtues mbi kundërshtimin shqyrtohet nga Gjykata e Apelit vetëm në bazë të ankesës kundër aktgjykimit të gjykatës themelore.

5. Mjetet e jashtëzakonshme juridike

Neni 418
Mjetet e jashtëzakonshme juridike

1. Pala mund të kërkojë rishikimin e procedurës penale brenda dy vjetësh nga aktgjykimi i formës së prerë ose aktvendimi i formës së prerë për pushimin e procedurës penale. Pala i paraqet kërkesën gjykatës themelore e cila ka nxjerr aktgjykimin e formës së prerë, e cila ia përcjell të gjitha kërkesat e vlefshme Gjykatës Supreme.
2. Pala mund të kërkojë zbutjen e jashtëzakonshme të dënimit në çdo kohë gjatë periudhës së mbajtjes së dënimit, por jo kur kanë mbetur edhe gjashtë (6) muaj deri në përfundim të dënimit me burgim. Pala i paraqet kërkesën gjykatës themelore e cila ka nxjerr aktgjykimin e formës së prerë, e cila ia përcjell të gjitha kërkesat e vlefshme Gjykatës Supreme.
3. Pala mund të paraqesë kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë brenda tre (3) muajsh nga aktgjykimi i formës së prerë ose aktvendimi i formës së prerë kundër të cilit kërkohet mbrojtja e ligjshmërisë. Pala paraqet kërkesën në gjykatën themelore e cila ka nxjerr aktgjykimin e formës së prerë, e cila ia përcjell të gjitha kërkesat e vlefshme Gjykatës Supreme.
4. Nenet 375, 376, 377, 378 dhe 379 të këtij Kodi zbatohen për të gjitha kërkesat nga ky nen.

A. Rishikimi i procedurës penale

Neni 419
Dispozita e përgjithshme

Procedura penale e përfunduar me aktvendim të formës së prerë ose me aktgjykim të formës së prerë mund të rishikohet me kërkesën e personave të autorizuar vetëm në rastet dhe sipas kushteve të parapara me këtë Kod.

Neni 420
Ndryshimi i aktgjykimit të formës së prerë pa rishikim të procedurës penale

1. Aktgjykimi i formës së prerë mund të ndryshohet edhe pa rishikimin e procedurës penale kur:
   1.1. në dy ose më shumë aktgjykime të të njëjtit person të dënuar janë shqiptuar në formë të prerë disa dënime pa i zbatuar dispozitat për shqiptimin e dënimit unik për vepra penale në bashkim;
   1.2. me rastin e shqiptimit të dënimit unik sipas dispozitave për vepra penale në bashkim, dënimi i përfshirë në dënimin e shqiptuar sipas një aktgjykimi të mëparshëm për vepra penale në bashkim gjithashtu është marrë parasysh; ose
   1.3. aktgjykimi i formës së prerë me të cilin për disa vepra penale është shqiptuar dënim unik pjesërisht nuk mund të ekzekutohet për shkak të amnistisë, faljes ose për shkaqe të tjera.
2. Në rastin nga paragrafi 1. nën-paragrafi 1.1. i këtij neni, gjykata me aktgjykim të ri e ndryshon aktgjykimin e mëparshëm për dënimet e shqiptuara dhe shqipton dënim unik. Marrja e aktgjykimit të ri është kompetencë e gjykatës themelore që ka gjykuar çështjen ku është shqiptuar lloji më i rëndë i dënimit. Kur janë shqiptuar dënime të llojit të njëjtë, aktgjykimi i ri merret nga gjykata e cila ka shqiptuar dënim më të rëndë, ndërsa kur dënimet janë të njëjta, aktgjykimi merret nga gjykata e cila e fundit ka shqiptuar dënimin.
3. Në rastin nga paragrafi 1. nën-paragrafi 1.2. i këtij neni, aktgjykimin e ndryshon gjykata e cila me rastin e shqiptimit të dënimit unik ka përfshirë gabimisht dënimin i cili është përfshirë në ndonjë aktgjykim të mëparshëm.
4. Në rastin nga paragrafi 1. nën-paragrafi 1.3. i këtij neni, gjykata që gjykon në shkallë të parë ndryshon aktgjykimin e mëparshëm sa i përket dënimit dhe shqipton dënim të ri, ose vendos cila pjesë e dënimi të shqiptuar me aktgjykim të mëparshëm duhet ekzekutuar.
5. Aktgjykimin e ri e merr gjykata në seancë të kolegjit me propozim të prokurorit të shtetit kur procedura është filluar me kërkesën e tij ose të të akuzuarit, por pas dëgjimit të palës kundërshtare.
6. Kur në rastet nga paragrafi 1. nën-paragrafi 1.1. ose 1.2. i këtij neni me rastin e shqiptimit të dënimit janë marrë parasysh aktgjykimet e gjykatave të tjera, kopja e vërtetuar e aktgjykimit të ri të formës së prerë u dërgohet atyre gjykatave.

Neni 421
Vazhdimi i procedurës

Kur aktakuza hudhet sipas nenit 253, paragrafi 1. nën-paragrafi 1.2. ose nenit 358 të këtij Kodi, me kërkesën e prokurorit të shtetit vazhdohet procedura posa të pushojnë arsyet për marrjen e aktvendimit të tillë.

Neni 422
Rishikimi i procedurës penale të pushuar me aktvendim të formës së prerë

1. Procedura penale e pushuar në formë të prerë para fillimit të shqyrtimit gjyqësor mund të rishikohet kur prokurori i shtetit tërhiqet nga aktakuza dhe vërtetohet se

tërheqja është pasojë e veprës penale të keqpërdorimit të pozitës zyrtare të prokurorit të shtetit. Gjatë provimit të veprës penale zbatohen dispozitat nga neni 423, paragrafi 2. i këtij Kodi.

2. Kur aktakuza hidhet bazuar në mungesë provash të mjaftueshme për të mbështetur dyshimin e bazuar mirë se i pandehuri ka kryer veprën penale të përshkruar në aktakuzë dhe nëse zbulohen dhe mblidhen fakte dhe prova të reja, mund të ngritet aktakuzë e re kur kolegji shqyrtues vendos se provat dhe faktet e reja e arsyetojnë këtë.

Neni 423
Rishikimi i procedurës penale të përfunduar me aktgjykim të formës së prerë

1. Procedura penale e përfunduar me aktgjykim të formës së prerë mund të rishikohet vetëm nëse:
   1.1. provohet se aktgjykimi është mbështetur në dokument të falsifikuar ose në deklarim të rremë të dëshmitarit, ekspertit ose përkthyesit;
   1.2. provohet se aktgjykimi është pasojë e veprës penale të kryer nga gjyqtari ose personi që ka ndërmarrë veprimet hetimore;
   1.3. zbulohen fakte të reja ose paraqiten prova të reja, të cilat vetë ose së bashku me provat e mëparshme ka të ngjarë të arsyetojë pafajësinë e personit të dënuar ose dënimin e tij sipas një dispozite më të butë penale;
   1.4. personi për të njëjtën vepër është gjykuar disa herë ose kur disa persona janë dënuar për vepër të njëjtë të cilën ka mund ta kryejë vetëm një person ose disa prej tyre; ose
   1.5. në rastin e dënimit për vepër penale në vazhdim ose vepra tjera penale të cilat sipas ligjit përfshijnë disa veprime të njëjta ose të ndryshme, zbulohen fakte të reja ose paraqiten prova të reja që tregojnë se i dënuari nuk ka kryer veprimin që është përfshirë në veprën penale për të cilën ai është dënuar dhe ekzistimi i fakteve të tilla do të ishte me ndikim vendimtar në caktimin e dënimit.
2. Procedura penale e përfunduar me aktgjykim të formës së prerë mund të rishikohet vetëm në favor të të pandehurit, përveç nëse vërtetohet që rrethanat nga paragrafi 1. nën-paragrafët 1.1. dhe 1.2. të këtij neni janë pasojë e veprës penale të kryer nga i pandehuri ose personi që vepron në emër të tij kundër një dëshmitari, eksperti, përkthyesi, prokurori të shtetit ose gjyqtari apo të afërmve të tyre, me ç'rast procedura penale e përfunduar me aktgjykim të formës së prerë mund të rishikohet kundër të pandehurit. Rishikimi i procedurës penale kundër të pandehurit lejohet vetëm brenda pesë (5) vjetëve nga koha e shpalljes së aktgjykimit të formës së prerë.
3. Në rastet nga paragrafi 1. nën-paragrafi 1.1. dhe 1.2. ose paragrafi 2. i këtij neni, me aktgjykim të formës së prerë duhet vërtetuar se personat e tillë a janë shpallur fajtor për veprat penale përkatëse. Kur procedura kundër këtyre personave nuk mund të zbatohet për shkak se kanë vdekur ose ekzistojnë rrethana që përjashtojnë ndjekjen penale, faktet nga paragrafi 1. nën-paragrafi 1.1. dhe 1.2. ose paragrafi 2. i këtij neni mund të vërtetohen edhe me prova të tjera.

Neni 424
Personat e autorizuar për të kërkuar rishikimin e procedurës penale

1. Rishikimin e procedurës penale mund ta kërkojnë palët dhe mbrojtësi. Pas vdekjes së të dënuarit, rishikimin mund ta kërkojë prokurori i shtetit, bashkëshorti, bashkëshorti jashtëmartesor, personi në gjini gjaku në vijë direkte deri në shkallë të parë, prindi adoptues, fëmija i adoptuar, vëllai, motra ose prindi birësues i të dënuarit.
2. Rishikimi i procedurës penale mund të kërkohet edhe pasi i dënuari mban dënimin, pavarësisht nga afati i parashkrimit, amnistisë ose faljes.
3. Kur gjykata kompetente për të vendosur mbi rishikimin e procedurës penale mëson se ekzistojnë shkaqe për rishikimin e procedurës penale, për këtë e njofton të dënuarin apo personin e autorizuar për paraqitje të kërkesës.

Neni 425
Përmbajtja e kërkesës për rishikim të procedurës penale dhe gjykata që vendos për të

1. Kërkesa për rishikimin e procedurës penale vendoset nga kolegji shqyrtues i gjykatës themelore e cila ka gjykuar në procedurën e mëparshme.
2. Në kërkesë duhet shënuar bazën ligjore sipas së cilës kërkohet rishikimi, si dhe provat me të cilat argumentohen faktet në të cilat mbështetet kërkesa. Nëse kërkesa nuk i përmban këto të dhëna, gjykata e thërret parashtruesin që brenda afatit të caktuar të plotësojë kërkesën.
3. Me rastin e vendosjes së kërkesës për rishikim, në kolegj nuk merr pjesë gjyqtari i cili ka marrë pjesë në marrjen e aktgjykimit në procedurën e mëparshme.

Neni 426
Baza dhe procedura për hedhjen e kërkesës për rishikim të procedurës penale

1. Gjykata me aktvendim hudh kërkesën kur në bazë të saj dhe shkresave të procedurës së mëparshme vërteton se:
   1.1. kërkesën e ka parashtruar personi i paautorizuar;
   1.2. nuk ka bazë ligjore për rishikim të procedurës;
   1.3. faktet dhe provat në të cilat mbështetet kërkesa janë paraqitur në kërkesën e mëparshme për rishikim të procedurës e cila është refuzuar me aktvendim të formës së prerë;
   1.4. faktet dhe provat nuk ofrojnë aryse për lejim të rishikimit të procedurës; ose
   1.5. parashtruesi i kërkesës për rishikim të procedurës nuk ka vepruar sipas nenit 425, paragrafit 2. të këtij Kodi.
2. Kur gjykata nuk e hudh kërkesën, kopja e kërkesës i dërgohet prokurorit të shtetit ose palës kundërshtare, e cila ka të drejtë që brenda tetë (8) ditëve të përgjigjet në kërkesë. Pasi gjykata të merr përgjigje në kërkesë ose kur kalon afati për paraqitjen e përgjigjes, kryetari i kolegjit shqyrtues urdhëron gjurmimin dhe shqyrtimin e fakteve dhe provave të paraqitura në kërkesë dhe në përgjigje.

Neni 427
Vendimet e kolegjit lidhur me kërkesën për rishikim

1. Bazuar në rezultatet e hetimit, gjykata aprovon kërkesën dhe lejon rishikimin e procedurës penale ose e refuzon kërkesën.
2. Kur gjykata çmon se shkaqet për të cilat ka lejuar rishikimin e procedurës janë edhe në dobi të një të bashkakuzuari i cili nuk ka paraqitur kërkesë për rishikim të procedurës, vepron sipas detyrës zyrtare sikur kërkesa e tillë të ishte paraqitur.
3. Në aktvendim me të cilin lejohet rishikimi i procedurës penale, gjykata urdhëron caktimin e menjëhershëm të shqyrtimi të ri gjyqësor ose kthimin e çështjes në fazën e hetimit, apo fillimin e hetimit kur hetimi nuk është zbatuar më parë.
4. Gjykata urdhëron që ekzekutimi i aktgjykimit të shtyhet ose të ndërpritet nëse duke u bazuar në provat e paraqitura çmon se:
   4.1. i dënuari në procedurë të përsëritur mund të dënohet me dënim të tillë që pas llogaritjes së dënimit të mbajtur do të duhej të lirohet;
   4.2. ai mund të lirohet nga akuza; ose
   4.3. akuza e ngritur kundër tij mund të refuzohet.
5. Kur aktvendimi me të cilin lejohet rishikimi i procedurës penale merr formë të prerë, atëherë pushohet ekzekutimi i dënimit. Por, nëse ekzistojnë kushtet nga neni 187 paragrafi 1. i këtij Kodi, gjykata cakton paraburgimin.

Neni 428
Rregullat për procedurën e re të rishikimit

1. Për procedurën e re që zbatohet në bazë të aktvendimit me të cilin lejohet rishikimi i procedurës penale vlejnë dispozitat e njëjta si ato të procedurës së mëparshme. Në procedurën e re, gjykata nuk detyrohet me aktvendimet e marra në procedurën e mëparshme.
2. Në qoftë se procedura e re pushohet para fillimit të shqyrtimit gjyqësor, aktgjykimi i mëparshëm anulohet me aktvendimin mbi pushimin e procedurës.
3. Me rastin e marrjes së aktgjykimit të ri, gjykata anulon aktgjykimin e mëparshëm apo vetëm një pjesë të tij, ose e lë në fuqi aktgjykimin e mëparshëm. Në dënim të shqiptuar me aktgjykim të ri, gjykata i llogarit të akuzuarit dënimin e mbajtur, e kur lejohet rishikimi vetëm për ndonjë vepër për të cilën i akuzuari ka qenë i dënuar ose i liruar, gjykata shqipton dënim të ri unik sipas dispozitave të Kodit Penal.
4. Gjykata në procedurën e re detyrohet me ndalesën e paraparë në nenin 395 të këtij Kodi.

B. Zbutja e jashtëzakonshme e dënimit

Neni 429
Lejimi i zbutjes së jashtëzakonshme të dënimit

Zbutja e jashtëzakonshme e dënimit lejohet kur pas formës së prerë të aktgjykimit paraqiten rrethana të cilat nuk kanë ekzistuar në kohën e marrjes së aktgjykimit ose, megjithëse kanë ekzistuar në atë kohë, gjykata nuk ka qenë në dijeni për to, kurse ato dukshëm do të ndikonin në dënim më të ulët.

Neni 430
Personat e autorizuar për të kërkuar zbutjen e jashtëzakonshme të dënimit dhe efekti i saj

1. Kërkesë për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit mund të paraqesë prokurori i shtetit kur procedura është zbatuar me kërkesë të tij, i dënuari dhe mbrojtësi i tij.
2. Kërkesa për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit nuk e pezullon ekzekutimin e dënimit.

Neni 431
Procedura lidhur me kërkesën për zbutjen e jashtëzakonshme të dënimit dhe vendimet e Gjykatës Supreme

1. Për kërkesën mbi zbutjen e jashtëzakonshme të dënimit vendos Gjykata Supreme e Kosovës.
2. Kërkesa për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit në pajtim me nenin 376 të këtij Kodi i paraqitet gjykatës themelore e cila ka marrë aktgjykimin.
3. Gjykata themelore ia dërgon kërkesën prokurorit të shtetit, i cili përgjigjet në pajtim me nenin 377 të këtij Kodi.
4. Gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues të gjykatës themelore e hudh kërkesën që nuk është në pajtim me nenin 376 të këtij Kodi.
5. Gjykata themelore vërteton se a ekzistojnë shkaqe për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit, e pastaj shkresat me propozimin e arsyetuar ia dërgon Gjykatës Supreme të Kosovës.
6. Gjykata Supreme e Kosovës refuzon kërkesën kur çmon se nuk ka bazë ligjore për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit. Kur e aprovon kërkesën, gjykata me aktvendim e ndryshon aktgjykimin e formës së prerë lidhur me vendimin mbi dënimin.

C. Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë

Neni 432
Arsyet për paraqitje të kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë

1. Kundër vendimit gjyqësor të formës së prerë ose kundër procedurës gjyqësore e cila i ka paraprirë marrjes së vendimit të tillë, pas përfundimit të procedurës penale në formë të prerë mund të paraqitet kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë në rastet vijuese:
   1.1. në rast të shkeljes së ligjit penal;
   1.2. në rast të shkeljes esenciale të ligjit të procedurës penale nga neni 384, paragrafi 1. i këtij Kodi; ose
   1.3. në rast të shkeljeve të tjera të dispozitave të procedurës penale kur shkeljet e tilla kanë ndikuar në ligjshmërinë e vendimit gjyqësor.
2. Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë nuk mund të ushtrohet për shkak të konstatimit të gabueshëm ose jo të plotë të gjendjes faktike, as kundër vendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës me të cilën është vendosur mbi kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë.

3. Pavarësisht nga dispozitat e paragrafit 1. të këtij neni, Kryeprokurori i Shtetit mund të paraqesë kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë për cilëndo shkelje ligjore.
4. Pavarësisht nga dispozitat e paragrafit 1. të këtij neni, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë mund të paraqitet, gjatë procedurës penale e cila nuk ka përfunduar në formë të prerë, vetëm kundër vendimeve të formës së prerë lidhur me caktimin ose vazhdimin e paraburgimit.

Neni 433
Personat e autorizuar për të paraqitur kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë

1. Kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë mund të paraqesë Kryeprokurori i Shtetit, i pandehuri dhe mbrojtësi i tij. Pas vdekjes së të pandehurit, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë në emër të tij mund të paraqesin personat e paraparë në nenin 424, paragrafi 1. fjalia e fundit e këtij Kodi.
2. Kryeprokurori i shtetit, i pandehuri, mbrojtësi i tij dhe personat e paraparë në nenin 424, paragrafi 1. fjalia e fundit e këtij Kodi mund të paraqesin kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë brenda tre (3) muajve nga dita kur të pandehurit i është dorëzuar vendimi gjyqësor i formës së prerë. Nëse kundër vendimit të gjykatës themelore nuk paraqitet ankesë, afati rrjedh nga dita kur vendimi merr formë të prerë.
3. Kur me vendim të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut është vërtetuar se me vendim përfundimtar janë shkelur të drejtat e njeriut në dëm të të pandehurit, afati për paraqitjen e kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë rrjedh nga dita kur vendimi i Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut i dorëzohet të pandehurit.
4. Pavarësisht nga dispozitat e nenit 432, paragrafi 2. i këtij Kodi, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë nga paragrafi 3. i këtij neni mund të paraqitet edhe kundër vendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës.

Neni 434
Paraqitja e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë në gjykatë themelore

1. Kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë i paraqitet gjykatës themelore që ka marrë vendimin.
2. Gjyqtari i procedurës paraprake, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues i gjykatës themelore me aktvendim hudh kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë nëse:
   2.1. kërkesa është paraqitur kundër vendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës nga neni 432, paragrafi 2. i këtij Kodi, me përjashtim të rasteve të parapara në nenin 433, paragrafi 4. i këtij Kodi;
   2.2. kërkesa është paraqitur nga personi i paautorizuar nga neni 433, paragrafi 1. i këtij Kodi; ose
   2.3. kërkesa është paraqitur jashtë afatit nga neni 433, paragrafi 2. i këtij Kodi.
2. Kundër këtij aktvendimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit.
3. Varësisht nga përmbajtja e kërkesës, gjykata themelore mund të vendosë që ekzekutimi i vendimit gjyqësor i formës së prerë të shtyhet apo të ndërpritet.

Neni 435
Shqyrtimi i kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë nga kolegji i Gjykatës Supreme

1. Për kërkesën e mbrojtjes së ligjshmërisë vendos Gjykata Supreme e Kosovës në seancë të kolegjit.
2. Gjykata Supreme e Kosovës me aktvendim e hudh kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë nëse kërkesa është e papranueshme ose është paraqitur jashtë afatit nga neni 434, paragrafi 2. i këtij Kodi. Në të kundërtën, kopjen e kërkesës ia dërgon palës kundërshtare, e cila në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita e dorëzimit të kërkesës mund të paraqesë përgjigje në kërkesë.
3. Para marrjes së vendimit mbi kërkesën, gjyqtari raportues, sipas nevojës, mund të kërkojë raport për shkeljet e pretenduara ligjore.
4. Varësisht nga përmbajtja e kërkesës, Gjykata Supreme e Kosovës mund të caktojë shtyrjen ose ndërprerjen e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë.

Neni 436
Favoret e të pandehurit përkitazi me kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë

1. Me rastin e vendosjes mbi kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë, Gjykata Supreme e Kosovës kufizohet vetëm në verifikimin e shkeljeve ligjore në të cilat paraqitësi i kërkesës pretendon.
2. Kur Gjykata Supreme e Kosovës vërteton se shkaqet për të cilat ka marrë vendim në dobi të të pandehurit ekzistojnë edhe për ndonjërin nga të bashkakuzuarit që nuk ka paraqitur kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë, vepron sipas detyrës zyrtare sikurse kërkesa e tillë të ishte paraqitur nga personi i tillë.
3. Kur kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është paraqitur në dobi të të pandehurit, Gjykata Supreme e Kosovës me rastin e vendosjes detyrohet me ndalesën e paraparë në nenin 395 të këtij Kodi.

Neni 437
Refuzimi i kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë

Gjykata Supreme e Kosovës me aktgjykim refuzon si të pabazë kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë kur vërteton se nuk ekziston shkelje e ligjit për të cilën pretendon paraqitësi i kërkesës, ose kur kërkesa është paraqitur për shkak të vërtetimit të gabuar ose jo të plotë të gjendjes faktike nga nenet 386 dhe 432, paragrafi 2. i këtij Kodi.

Neni 438
Aktgjykimi mbi kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë

1. Kur Gjykata Supreme e Kosovës vërteton se kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është e bazuar, merr aktgjykim me të cilin, duke pasur parasysh llojin e shkeljes:
   1.1. ndryshon vendimin e formës së prerë;
   1.2. në tërësi ose pjesërisht anulon vendimin e gjykatës themelore dhe të gjykatës më të lartë ose vetëm vendimin e gjykatës më lartë dhe lëndën për vendim të ri ose për rigjykim ia kthen gjykatës themelore ose gjykatës më të lartë; ose

1.3. kufizohet vetëm në vërtetimin e shkeljes së ligjit.
2. Kur Gjykata Supreme e Kosovës çmon se kërkesa e paraqitur për mbrojtjen e ligjshmërisë në dëm të të pandehurit është e bazuar, vetëm konstaton shkeljen e ligjit pa ndikuar në vendimin e formës së prerë.
3. Kur Gjykata e Apelit sipas këtij Kodi nuk ka pasur të drejtë ta mënjanojë shkeljen e ligjit e cila është bërë me vendim të shkallës së parë ose në procedurë gjyqësore që i ka paraprirë atij vendimi dhe Gjykata Supreme e Kosovës vërteton se kërkesa e paraqitur në dobi të të akuzuarit është e bazuar dhe se për mënjanimin e asaj shkelje duhet anuluar ose ndryshuar vendimin e shkallës së parë, Gjykata Supreme e Kosovës e anulon ose e ndryshon edhe vendimin e Gjykatës së Apelit, edhe pse me të nuk është shkelur ligji.

Neni 439
Pasojat e dyshimit mbi saktësinë e fakteve në vendimin që kundërshtohet me kërkesë

Kur me rastin e vendosjes mbi kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë ka dyshim të konsiderueshëm lidhur me saktësinë e fakteve vendimtare të vërtetuara në vendimin kundër të cilit është paraqitur kërkesë, Gjykata Supreme e Kosovës me aktgjykim me të cilin vendos mbi kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë anulon vendimin dhe urdhëron mbajtjen e shqyrtimit të ri gjyqësor në gjykatën e njëjtë ose në gjykatën tjetër themelore.

Neni 440
Anulimi i aktgjykimit të formës së prerë të gjykatës themelore

1. Në qoftë se aktgjykimi i formës së prerë anulohet dhe lënda kthehet për gjykim të ri, procedura merr për bazë aktakuzën e mëparshme ose atë pjesë të saj që ka të bëjë me pjesën e anuluar të aktgjykimit.
2. Gjykata detyrohet t'i ndërmerr të gjitha veprimet procedurale dhe t'i shqyrtojë të gjitha çështjet për të cilat e ka paralajmëruar Gjykata Supreme e Kosovës.
3. Në gjykatë themelore apo në Gjykatë të Apelit palët kanë të drejtë të paraqesin fakte dhe prova të reja.
4. Me rastin e marrjes së vendimit të ri, gjykata detyrohet me ndalesën e paraparë në nenin 395 të këtij Kodi.
5. Kur krahas vendimit të Gjykatës së Apelit anulohet edhe vendimi i gjykatës themelore, lënda i dërgohet gjykatës themelore nëpërmjet Gjykatës së Apelit

Neni 441
Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut

Kërkesë për mjet të jashtëzakonshëm juridik sipas këtij kapitulli mund të paraqitet në bazë të të drejtave të siguruara me këtë Kod dhe të mbrojtura me Kushtetutën e Republikës së Kosovës ose Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe protokollet e saj, si dhe me vendimet e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

PJESA E TRETË
ADMINISTRIMI I PROCEDURËS

KAPITULLI XXII
PARASHTRESAT

Neni 442
Forma e paraqitjes së parashtresave

1. Aktakuzat, propozimet për ndjekje, aktvendimet e prokurorëve, mjetet juridike dhe deklaratat e njoftimet tjera paraqiten me shkrim ose gojarisht në procesverbal.
2. Parashtresa e paraqitur nga paragrafi 1. i këtij neni mund të dërgohet në formë elektronike nëse zyra e regjistrimit të gjykatës ka mundësi për administrimin e parashtresave elektronike. Këshilli Gjyqësor i Kosovës përcakton mundësitë e gjykatave për të administruar parashtresat elektronike dhe nxjerr urdhëresë për lejimin e parashtresave të tilla elektronike, si dhe përcakton rregulloret për parashtresat e tilla.
3. Parashtresat nga paragrafi 1. i këtij neni duhet të jenë të kuptueshme dhe të përmbajnë çdo gjë të nevojshme që të mund të veprohet sipas tyre.
4. Nëse me këtë Kod nuk është paraparë ndryshe, gjykata thërret paraqitësin e parashtresës së pakuptueshme ose që nuk përmban atë që është e nevojshme që të mund të veprohet në bazë të saj, që ta korrigjojë apo ta plotësojë parashtresën, e nëse ai nuk e bën këtë brenda afatit të caktuar, gjykata e hudh poshtë parashtesën.
5. Në thirrjen për korrigjim apo për plotësimin e parashtresës paraqitësit i tërhiqet vërejtja për pasojat e mosveprimit.

Neni 443
Dërgimi i parashtresave në kopje të mjaftueshme

1. Parashtresat të cilat në bazë të këtij Kodi i dërgohen palës kundërshtare, i dorëzohen gjykatës në numër të mjaftueshëm kopjesh për gjykatën dhe për palën tjetër.
2. Kur parashtresat e tilla nuk i janë dorëzuar gjykatës në numër të mjaftueshëm kopjesh, gjykata e urdhëron paraqitësin që në afat të caktuar të dorëzojë kopje të mjaftueshme. Në qoftë se paraqitësi nuk vepron sipas urdhrit të gjykatës, gjykata kopjon ekzemplarët e nevojshëm në shpenzime të paraqitësit.

Neni 444
Dënimet për parashtresat me shkrim ose për paraqitjet gojore me përmbajtje ofenduese

Gjykata e dënon me gjobë deri në dyqindepesëdhjetë (250) Euro mbrojtësin ose të dëmtuarin i cili në parashtresë ose gojarisht ofendon ose fyen gjykatën apo personin që merr pjesë në procedurë. Aktvendimin lidhur me dënimin e merr gjyqtari apo kolegji para të cilit është dhënë deklarata, e kur ajo është bërë në parashtresë e merr gjykata e cila duhet të vendosë për parashtresën. Kundër këtij aktvendimi lejohet ankesë. Kur prokurori i shtetit e ofendon tjetrin, për këtë njoftohet prokurori kompetent i shtetit që e mbikëqyr atë. Për dënimin e avokatit apo të praktikantit të avokatisë njoftohet Oda e Avokatëve.

KAPITULLI XXIII
AFATET

Neni 445
Afatet

1. Afatet e parapara me këtë Kod nuk mund të vazhdohen, përveç kur këtë shprehimisht e lejon ligji. Në qoftë se afati për realizimin e të drejtës së mbrojtjes dhe të drejtave të tjera procedurale të të pandehurit është paraparë me ligj, me kërkesën e tij me shkrim ose gojarisht në procesverbalin e gjykatës ky afat mund të shkurtohet.
2. Kur deklarata është e lidhur me afat, konsiderohet se është dhënë brenda afatit nëse i është dorëzuar marrësit të autorizuar para kalimit të afatit.
3. Kur deklarata dërgohet nëpërmjet postës, postës rekomande apo telegramit ose me ndonjë mjet tjetër si teleks, telefaks ose mjete të tjera të ngjashme, dita e postimit ose e dërgimit konsiderohet si ditë e dorëzimit për personin që i është dërguar. Dërguesi i deklaratës konsiderohet se nuk e ka lëshuar afatin kur personi të cilit tentohet t'i dërgohet deklarata nuk e ka marrë me kohë për shkak të gabimeve në mjetet e dërgimit për të cilat dërguesi nuk ka qenë në dijeni.
4. I pandehuri i cili gjendet në paraburgim, gjithashtu mund të jep deklaratë që është e lidhur me afat duke e përfshirë atë në procesverbalin e gjykatës që zbaton procedurën ose duke e dërguar në drejtorinë e burgut, kurse personi i cili gjendet në mbajtje të dënimit ose ndodhet në ndonjë institucion tjetër me urdhër për trajtim të detyrueshëm për rehabilitim, mund t'ia dërgojë deklaratën e tillë drejtorisë së institucionit ku është vendosur ai. Dita kur është përpiluar procesverbali i tillë apo kur deklarata i është dërguar drejtorisë së institucionit konsiderohet si ditë e dorëzimit të marrësit të autorizuar.
5. Kur parashtresa dorëzimi i së cilës është i lidhur me afat, për arsye të mosdijes ose të gabimit të qartë të dërguesit i është dërguar gjykatës jokompetente para kalimit të afatit, konsiderohet se është dorëzuar me kohë, përkundër faktit se te gjykata kompetente arrin pas kalimit të afatit të paraparë.

Neni 446
Llogaritja e afateve

1. Afatet llogariten me orë, me ditë, me muaj dhe me vite.
2. Ora ose dita kur është bërë dorëzimi, njoftimi apo kur ka ndodhur ngjarja që konsiderohet si fillim i afatit nuk llogaritet në afat, por për fillim të afatit merret ora apo dita e parë vijuese. Për një ditë llogariten njëzet e katër (24) orë, kurse muaji llogaritet sipas kalendarit.
3. Afatet e caktuara me muaj apo vite kalojnë në muajin ose vitin e fundit në fund të ditës së njëjtë të muajit kur ka filluar afati. Nëse një ditë e tillë nuk ekziston në muajin e fundit, afati kalon në ditën e fundit të atij muaji.
4. Kur dita e fundit e afatit bie në ditë feste zyrtare, të shtunën ose të dielën ose në ndonjë ditë tjetër kur organi kompetent nuk punon, afati kalon në fund të ditës pasuese të punës.

Neni 447
Kërkesa për kthim në gjendje të mëparshme

1. Nëse i pandehuri për shkaqe të arsyeshme nuk paraqet ankesë kundër aktgjykimit ose aktvendimit për konfiskimin e dobisë pasurore brenda afatit, gjykata i lejon kthim në gjendje të mëparshme për paraqitjen e ankesës nëse brenda tetë (8) ditësh nga pushimi i shkaqeve për mosrespektimin e afatit i pandehuri paraqet kërkesë për kthim në gjendje të mëparshme dhe paraqet paralajmërimin për ankesë ose ankesën së bashku me kërkesë.
2. Kërkesa për kthim në gjendje të mëparshme nuk mund të paraqitet nëse kanë kaluar tre (3) muaj nga dita e kalimit të afatit.

Neni 448
Aktvendimi për kthim në gjendje të mëparshme

1. Kryetari i trupit gjykues, i cili ka marrë aktgjykimin ose aktvendim kundër të cilit është ushtruar ankesë, merr aktvendim për kthim në gjendje të mëparshme.
2. Kundër aktvendimit me të cilin lejohet kthimi në gjendje të mëparshme nuk lejohet ankesë.
3. Kur i pandehuri paraqet ankesë kundër aktvendimit me të cilin refuzohet kthimi në gjendje të mëparshme, gjykata detyrohet që këtë ankesë ose ankesën kundër aktgjykimit apo aktvendimit për konfiskimin e dobisë pasurore, përgjigjen në ankesë dhe të gjitha procesverbalet t'ia dërgojë gjykatës më të lartë për marrjen e vendimit.

Neni 449
Efekti i kërkesës për kthim në gjendje të mëparshme

Në parim, kërkesa për kthim në gjendje të mëparshme nuk e pezullon ekzekutimin e aktgjykimit apo ekzekutimin e aktvendimit për konfiskimin e dobisë pasurore, por gjykata kompetente për marrjen e vendimit lidhur me kërkesën mund të vendosë ndërprerjen e ekzekutimit derisa të merret vendimi lidhur me kërkesën.

KAPITULLI XXIV
SHPENZIMET E PROCEDURËS PENALE

Neni 450
Lloji i shpenzimeve të procedurës penale

1. Shpenzimet e procedurës penale janë shpenzime të bëra gjatë procedurës penale dhe shpenzimet e shkaktuara lidhur me të.
2. Shpenzimet e procedurës penale përfshijnë:
   2.1. shpenzimet për dëshmitarë, ekspertë, përkthyes, specialistë, stenografim, regjistrime teknike dhe për këqyrjen e vendit;
   2.2. shpenzimet e transportit të të pandehurit;
   2.3. shpenzimet për shoqërimin e të pandehurit apo të personit të paraburgosur;

2.4. shpenzimet e transportit dhe të udhëtimit të personave zyrtarë;
2.5. shpenzimet e mjekimit të të pandehurit gjatë kohës sa gjendet në paraburgim ose në institucionin shëndetësor në bazë të vendimit të gjykatës, si dhe shpenzimet e lindjes së fëmijës;
2.6. shpenzimet paushalle;
2.7. shpërblimet dhe shpenzimet e nevojshme të mbrojtësit; dhe
2.8. shpenzimet e nevojshme për të dëmtuarin dhe përfaqësuesin e tij ligjor, si dhe kompenzimet dhe shpenzimet e nevojshme të përfaqësuesit të autorizuar.

3. Shuma paushalle caktohet nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës me urdhëresë administrative duke pasur parasysh zgjatjen dhe ndërlikueshmërinë e procedurës dhe gjendjen financiare të personit që ngarkohet me mbulimin e këtyre shpenzimeve.
4. Shpenzimet nga nën-paragrafët 2.1. deri në 2.5. të paragrafit 2. të këtij neni dhe shpërblimi apo shpenzimet e nevojshme të mbrojtësit të caktuar dhe të përfaqësuesit të autorizuar të të dëmtuarit parapaguhen nga fondet e policisë, të prokurorisë së shtetit ose të gjykatës që e zbaton procedurën penale, kurse arkëtohen më vonë nga personat që detyrohen t'i paguajnë sipas dispozitave të këtij Kodi. Organi që e zbaton procedurën penale detyrohet të shënojë të gjitha shpenzimet e parapaguara në listën e cila i bashkëngjitet shkresave.
5. Shpenzimet e përkthimit në gjuhën e të pandehurit, të dëshmitarit dhe të personit tjetër i cili merr pjesë ne procedurë penale që shkaktohen me zbatimin e dispozitave të këtij Kodi nuk arkëtohen nga personat që sipas dispozitave të këtij neni detyrohen t'i paguajnë shpenzimet e procedurës penale.
6. Shpenzimet e përkthimit nuk i ngarkohen të pandehurit i cili nuk e di ose nuk e flet gjuhën në të cilën zbatohet procedura penale.
7. Shpërblimi dhe shpenzimet e nevojshme të mbrojtësit të caktuar nga neni 57, paragrafi 2. apo 3. ose neni 58 i këtij Kodi paguhen nga mjetet buxhetore e jo nga i pandehuri.

Neni 451
Aktvendimi për shpenzimet e procedurës penale

1. Në çdo aktgjykim ose aktvendim me të cilin përfundohet procedura penale duhet përfshirë edhe vendimin për mbulimin e shpenzimeve të procedurës dhe shumën e tyre.
2. Kur mungojnë të dhënat për shumën e shpenzimeve, procesmbajtësi merr aktvendim të posaçëm për shumën e shpenzimeve, i cili aprovohet nga gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues kur sigurohen të dhënat. Kërkesa me shënimet për shumën e shpenzimeve mund të paraqitet brenda tre (3) muajsh nga dita e dorëzimit të aktgjykimit ose të aktvendimit të formës së prerë për personin që ka të drejtë të paraqesë kërkesë të tillë.
3. Kur për shpenzimet e procedurës penale është vendosur me aktvendim të posaçëm, për ankesë kundër atij aktvendimi vendos kolegji.

Neni 452
Pagimi i shpenzimeve sipas fajit të personit që i ka shkaktuar

1. I pandehuri, i dëmtuari, mbrojtësi, përfaqësuesi ligjor, përfaqësuesi i autorizuar, dëshmitari, eksperti, përkthyesi dhe specialisti, pavarësisht nga rezultati i procedurës penale, paguajnë shpenzimet e shoqërimit të tyre forcërisht, të shtyrjes së një veprimi hetimor, shpenzimet tjera të procedurës të shkaktuara me fajin e tyre, si dhe pjesën përkatëse të shumës paushalle.
2. Për shpenzimet nga paragrafi 1. i këtij neni merret aktvendim i posaçëm, përveç kur për shpenzimet që i paguan i pandehuri vendoset me vendim për çështjen kryesore.

Neni 453
Efekti i vendimit fajësues në kompenzimin e shpenzimeve

1. Kur gjykata e shpall të pandehurin fajtor, me aktgjykim vendos se detyrohet t'i kompenzojë shpenzimet e procedurës penale.
2. Personi i cili është fajësuar për disa vepra penale nuk ngarkohet me kompensim të shpenzimeve lidhur me veprat për të cilat është liruar nga akuza po qe se këto shpenzime mund të veçohen nga shpenzimet e përgjithshme.
3. Në aktgjykimin me të cilin disa të pandehur janë shpallur fajtor, gjykata cakton pjesën e shpenzimeve që duhet paguar secili prej tyre, e kur kjo nuk është e mundur, urdhëron që të gjithë të pandehurit të ngarkohen me shpenzime në mënyrë solidare. Pagesa e shumës paushalle caktohet veçmas për secilin të pandehur.
4. Në vendimin me të cilin vendoset për shpenzimet, gjykata mund ta lirojë të pandehurin nga detyrimi i kompenzimit, në tërësi ose pjesërisht, të shpenzimeve të procedurës penale nga neni 450, paragrafi 2., nën-paragrafët 2.1. deri në 2.6. të këtij Kodi, nëse pagesa e tyre do të rrezikonte gjendjen materiale të të pandehurit ose të personave që ai detyrohet t'i mbështesë materialisht. Kur këto rrethana konstatohen pas marrjes së vendimit lidhur me shpenzimet, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues me aktvendim të posaçëm mund të lirojë të pandehurin nga detyrimi i kompenzimit të shpenzimeve të procedurës penale ose t'i lejojë që ato t'i paguajë me këste.

Neni 454
Efekti i vendimeve të tjera lidhur me kompensimin e shpenzimeve

1. Kur pushohet procedura penale apo kur merret aktgjykimi me të cilin i pandehuri lirohet nga akuza ose me të cilin refuzohet akuza, gjykata në aktvendim apo në aktgjykim shënon se shpenzimet e procedurës penale nga neni 450, paragrafi 2. nën-paragrafi 2.1. deri në 2.5. të këtij Kodi, shpenzimet e nevojshme të të pandehurit dhe kompenzimi i shpenzimeve të nevojshme të mbrojtësit paguhen nga mjetet buxhetore, përveç në rastet e caktuara në paragrafët vijues të këtij neni.
2. Personi i cili me vetëdije ka paraqitur kallëzim të rremë i paguan shpenzimet e procedurës penale.
3. I dëmtuari i cili është tërhequr nga propozimi për ndjekje penale dhe si rrjedhojë e kësaj procedura pushon, detyrohet t'i paguajë shpenzimet e procedurës penale nëse i pandehuri nuk ka paralajmëruar se do t'i paguajë ato.

Neni 455
Shpërblimi dhe shpenzimet e nevojshme të mbrojtësit ose të përfaqësuesit të autorizuar

1. Shpërblimi dhe shpenzimet e nevojshme të mbrojtësit ose të dëmtuarit detyrohet t'i paguajë personi i përfaqësuar pavarësisht se kush detyrohet të paguajë shpenzimet e procedurës penale në bazë të urdhrit të gjykatës, përveç kur mbrojtësi caktohet sipas nenit 57 paragrafi 2. ose 3. apo nenit 58 të këtij Kodi.
2. Mbrojtësi ose përfaqësuesi i autorizuar, të cilët nuk janë anëtarë të Odës së Avokatëve, nuk kanë të drejtë në kompenzim. Ata kanë të drejtë në shpenzimet e nevojshme, kurse anëtarët e Odës së Avokatëve kanë të drejtë edhe në fitimin e humbur.

Neni 456
Vendimi përfundimtar mbi detyrimin për pagesën e shpenzimeve

1. Vendimin përfundimtar lidhur me detyrimin për pagesën e shpenzimeve që shkaktohen në gjykatën themelore e merr gjyqtari apo kolegji kompetent i gjykatës themelore në pajtim me këtë Kapitull.
2. Vendimin përfundimtar lidhur me detyrimin për pagesën e shpenzimeve që shkaktohen në Gjykatën e Apelit e merr kryetari i kolegjit të Gjykatës së Apelit në pajtim me këtë Kapitull.
3. Vendimin përfundimtar lidhur me detyrimin për pagesën e shpenzimeve që shkaktohen në Gjykatën Supreme e merr kryetari i kolegjit të Gjykatës Supreme në pajtim me këtë Kapitull.
4. Kushtet e këtij Kapitulli zbatohen përshtatshmërisht për shpenzimet e shkaktuara në procedurën e mjeteve të jashtëzakonshme juridike.

Neni 457
Rregulloret për shpenzimet

Këshilli Gjyqësor i Kosovës nxjerr urdhëresë administrative me të cilën rregullohen më detajisht çështjet e pagesës së shpenzimeve të shkaktuara në procedurën penale në gjykatë, e cila mund të ndryshohet për çdo vit.

KAPITULLI XXV
KËRKESAT PASURORE JURIDIKE

Neni 458
Kërkesat pasurore juridike

1. Kërkesa pasurore juridike si rrjedhojë e kryerjes së veprës penale vendoset me propozimin e personave të autorizuar në procedurën penale në qoftë se kjo nuk e zvarrit procedurën në mënyrë të konsiderueshme.
2. Kërkesa pasurore juridike mund të përfshijë kompensimin e dëmit, kthimin e sendit ose anulimin e një veprimi të caktuar juridik.

Neni 459
Personat e autorizuar për paraqitjen e propozimit për realizimin e kërkesës pasurore juridike

1. Propozimin për realizimin e kërkesës pasurore juridike në procedurë penale mund ta paraqesë personi i cili është i autorizuar për ta ushtruar këtë kërkesë në kontest civil.
2. Në qoftë se me vepër penale është dëmtuar pasuria në pronësi publike, shtetërore ose shoqërore, organi ose personi kompetent i cili është i autorizuar me ligj të kujdeset për mbrojtjen e kësaj pasurie, mund të merr pjesë në procedurë penale në pajtim me autorizimet që ka në bazë të ligjit të tillë.

Neni 460
Paraqitja e propozimit për realizimin e kërkesës pasurore juridike

1. Propozimi për realizimin e kërkesës pasurore juridike në procedurë penale i paraqitet organit kompetent të cilit i është parashtruar kallëzimi penal ose gjykatës para së cilës zbatohet procedura.
2. Propozimi mund të paraqitet jo më vonë se deri në përfundim të shqyrtimit gjyqësor në gjykatën themelore.
3. Personi i autorizuar për paraqitjen e propozimit detyrohet ta parashtrojë në mënyrë të qartë kërkesën e vet dhe të paraqesë prova.
4. Kur personi i autorizuar nuk e ka paraqitur propozimin për realizimin e kërkesës pasurore juridike në procedurë penale para ngritjes së aktakuzës, ai duhet njoftuar se propozimin mund ta paraqesë deri në përfundim të shqyrtimit gjyqësor. Kur me vepër penale është shkaktuar dëm në pasurinë në pronësi publike, shtetërore ose shoqërore dhe nuk është paraqitur propozim, gjykata për këtë e njofton organin ose personin kompetent sipas nenit 459, paragrafi 2. i këtij Kodi.

Neni 461
Tërheqja dhe heqja dorë nga propozimi për realizimin e kërkesës pasurore juridike

1. Personat e autorizuar mund të tërhiqen nga propozimi për realizimin e kërkesës pasurore juridike në procedurë penale deri në përfundim të shqyrtimit gjyqësor dhe atë ta realizojnë në kontest civil. Kur propozimi tërhiqet, i njëjti propozim nuk mund të paraqitet përsëri, përveç nëse me këtë Kod është paraparë ndryshe.
2. Në qoftë se pas paraqitjes së propozimit dhe para përfundimit të shqyrtimit gjyqësor e drejta në kërkesë pasurore juridike sipas rregullave të së drejtës pasurore i ka kaluar personit tjetër, ai person thirret të deklarohet se a mbetet pranë propozimit. Në qoftë se personi i thirrur me rregull nuk i përgjigjet thirrjes, konsiderohet se ka hequr dorë nga propozimi.

Neni 462
Shqyrtimi i propozimit për realizimin e kërkesës pasurore juridike

1. Gjykata që zbaton procedurën penale merr në pyetje të pandehurin për faktet e deklaruara në propozim dhe heton rrethanat që janë të rëndësishme për vërtetimin e

kërkesës pasurore juridike. Por gjykata edhe para paraqitjes së propozimit të tillë detyrohet të mbledhë prova dhe të kryejë hetimin e nevojshëm për marrjen e vendimit lidhur me kërkesën.

2. Në qoftë se hetimi i kërkesës pasurore juridike do të zvarriste procedurën penale në masë të konsiderueshme, gjykata kufizohet në mbledhjen e atyre të dhënave, vërtetimi i të cilave më vonë nuk do të ishte i mundur ose do të ishte dukshëm i vështirësuar.

Neni 463
Vendimi mbi propozimin për realizimin e kërkesës pasurore juridike

1. Për kërkesat pasurore juridike vendos gjykata.
2. Në aktgjykim me të cilin i akuzuari shpallet fajtor, gjykata mund të vendosë për kërkesën pasurore juridike të të dëmtuarit në tërësi ose pjesërisht dhe për pjesën e mbetur e udhëzon në kontest civil. Kur të dhënat e mbledhura në procedurë penale nuk paraqesin bazë të sigurt për gjykim të plotë e as të pjesërishëm, gjykata e udhëzon të dëmtuarin që kërkesën pasurore juridike mund ta realizojë në kontest civil.
3. Kur gjykata merr aktgjykim me të cilin i pandehuri lirohet nga akuza ose me të cilin akuza refuzohet apo kur me aktvendim pushohet procedura penale, e udhëzon të dëmtuarin që kërkesën pasurore juridike ta realizojë në kontest civil. Kur gjykata shpallet jokompetente për procedurën penale, e udhëzon të dëmtuarin që kërkesën pasurore juridike ta ushtrojë në procedurë penale të filluar ose të vazhduar nga gjykata kompetente.

Neni 464
Kthimi i sendit

Kur kërkesa pasurore juridike ka të bëjë me kthimin e sendit dhe gjykata konstaton se sendi i takon të dëmtuarit dhe se gjendet tek i pandehuri ose tek njëri nga pjesëmarrësit në veprën penale apo te personi të cilit ia kanë dhënë për ta ruajtur, me aktgjykim urdhëron që sendi t'i dorëzohet të dëmtuarit.

Neni 465
Anulimi i veprimit të caktuar juridik

Kur kërkesa pasurore juridike ka të bëjë me anulimin e veprimit të caktuar juridik, kurse gjykata çmon se kërkesa është e bazuar, me aktgjykim e urdhëron anulimin e plotë ose të pjesërishëm të atij veprimi juridik me pasojat që rrjedhin nga veprimi i tillë, pa cenuar të drejtat e personave të tretë.

Neni 466
Ndryshimi i aktgjykimit të formës së prerë lidhur me kërkesën pasurore juridike

1. Gjykata që zbaton procedurën penale, mund ta ndryshojë aktgjykimin e formës së prerë me të cilin është vendosur për kërkesën pasurore juridike vetëm në rastin e rishikimit të procedurës penale ose kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë.

2. Në të gjitha rastet tjera, i dënuari apo trashëgimtarët e tij mund të kërkojnë ndryshimin e aktgjykimit të formës së prerë të gjykatës penale me të cilin është vendosur për kërkesën pasurore juridike vetëm në kontest civil, me kusht të ekzistimit të arsyeve për rishikim sipas dispozitave të zbatueshme në procedurën kontestimore civile.

Neni 467
Masat e përkohshme për sigurimin e kërkesës pasurore juridike

1. Masat e përkohshme për sigurimin e kërkesës pasurore juridike si rrjedhojë e kryerjes së veprës penale mund të urdhërohen në procedurë penale sipas dispozitave të zbatueshme për procedurën e përmbarimit me propozimin e personave të autorizuar nga neni 459 i këtij Kodi.
2. Aktvendimi nga paragrafi 1. i këtij neni merret në procedurën paraprake nga gjyqtari i procedurës paraprake. Pas ngritjes së aktakuzës, aktvendimin e merr gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues për rastet jashtë shqyrtimit gjyqësor, kurse në shqyrtim gjyqësor aktvendimin e merr i tërë trupi gjykues.
3. Kundër aktvendimit të trupit gjykues për masat e përkohshme të sigurimit të kërkesës nuk lejohet ankesë. Në raste të tjera, për ankesë vendos kolegji prej tre (3) gjyqtarësh. Ankesa nuk e pezullon ekzekutimin e aktvendimit.

Neni 468
Kthimi i pasurisë të dëmtuarit

1. Në qoftë se kërkesa përfshin sendet të cilat padyshim i takojnë të dëmtuarit e nuk shërbejnë si provë në procedurë penale, sendet e tilla i dorëzohen të dëmtuarit edhe para përfundimit të procedurës.
2. Në qoftë se pronësia e sendeve kontestohet nga disa të dëmtuar, ata udhëzohen në kontest civil, ndërsa gjykata në procedurë penale urdhëron vetëm ruajtjen e sendeve si masë të përkohshme për sigurimin e kërkesës.
3. Sendet që shërbejnë si provë përkohësisht sekuestrohen dhe i kthehen pronarit pas përfundimit të procedurës. Kur sendi i tillë është shumë i nevojshëm për pronarin, ai mund t'i kthehet edhe para përfundimit të procedurës nëse ai zotohet se do ta kthejë kur t'i kërkohet.

Neni 469
Masat për sigurimin e përkohshëm të kërkesës pasurore juridike të drejtuar kundër personave të tretë

1. Në qoftë se i dëmtuari ka parashtruar kërkesë kundër personit të tretë për shkak se ai disponon me sendet që i ka fituar me vepër penale ose përmes veprës penale ka realizuar dobi pasurore, gjykata në procedurë penale, me propozimin e personave të autorizuar dhe sipas dispozitave që zbatohen në procedurën e përmbarimit, mund të urdhërojë masa të përkohshme për sigurimin e kërkesës kundër asaj pale të tretë. Në këtë rast zbatohen edhe dispozitat e nenit 467, paragrafët 2. dhe 3. të këtij Kodi.
2. Në aktgjykim me të cilin i akuzuari shpallet fajtor, gjykata revokon masat nga

paragrafi 1. i këtij neni nëse nuk janë revokuar më parë ose e udhëzon të dëmtuarin në kontest civil, në të cilin rast këto masa revokohen, përpos nëse kontesti civil nuk është filluar brenda afatit të caktuar nga gjykata.

KAPITULLI XXVI
MARRJA DHE KOMUNIKIMI I VENDIMEVE

Neni 470
Llojet dhe marrja e vendimeve

1. Në procedurën penale vendimet merren në formë të aktgjykimit, të aktvendimit dhe të urdhrit.
2. Aktgjykimin mund ta marrë vetëm gjykata, aktvendimin mund ta marrë edhe prokurori i shtetit, ndërsa urdhrin mund marrin edhe organet e tjera publike që marrin pjesë në procedurën penale.
3. Urdhri merret dhe shpallet në pajtim me dispozitat e këtij kodi.

Neni 471
Procedura për marrjen e vendimeve në seancë për këshillim dhe votim nga trupi gjykues

1. Vendimi i trupit gjykues merret pas këshillimit gojor dhe votimit. Vendimi miratohet kur për të voton shumica e anëtarëve të trupit gjykues.
2. Kryetari i trupit gjykues drejton këshillimin dhe votimin, kurse vetë voton i fundit. Ai detyrohet të kujdeset për shqyrtimin e tërësishëm të të gjitha çështjeve nga çdo këndvështrim.
3. Kur votat për ndonjë çështje individuale për të cilën duhet votuar ndahen në disa mendime të ndryshme, kështu që asnjëri prej tyre nuk e ka shumicën, çështjet ndahen dhe votimi përsëritet derisa të arrihet shumica e votave. Nëse në këtë mënyrë nuk arrihet shumica, atëherë merret vendim sipas të cilit votat të cilat janë më të pafavorshme për të pandehurin u shtohen votave të cilat janë më pak të pafavorshme se këto derisa të arrihet shumica e nevojshme.
4. Anëtarët e trupit gjykues nuk mund ta refuzojnë votimin për çështjet që i parashtron kryetari i trupit gjykues, por anëtari i trupit gjykues i cili ka votuar për lirimin e të akuzuarit ose për revokimin e vendimit dhe ka mbetur në pakicë nuk detyrohet të votojë për dënimin. Në qoftë se ai nuk voton, konsiderohet se pajtohet me votën që është më e favorshme për të pandehurin.

Neni 472
Radha e shqyrtimit të çështjeve për të cilat votohet

1. Me rastin e marrjes së vendimit, së pari votohet për kompetencën e gjykatës, pastaj për nevojën e plotësimit të procedurës dhe për çështje të tjera paraprake.
2. Me rastin e marrjes së vendimit për çështjen kryesore, së pari votohet se a e ka kryer i akuzuari veprën penale dhe a është ai penalisht përgjegjës, pastaj votohet për dënimin, për sanksionet tjera penale ose masat për trajtim të detyruar, për

shpenzimet e procedurës penale, për kërkesën pasurore juridike dhe për çështje të tjera për të cilat duhet marrë vendim.

3. Nëse një person akuzohet për disa vepra penale, së pari votohet për përgjegjësinë e tij penale dhe dënimet për secilën vepër penale, pastaj votohet për një dënim unik për të gjitha veprat penale.

Neni 473
Seanca e mbyllur për këshillim dhe votim

1. Këshillimi dhe votimi mbahen në seancë të mbyllur.
2. Në sallën ku gjykata mban këshillimin dhe votimin, të pranishëm mund të jenë vetëm anëtarët e trupit gjykues dhe procesmbajtësi.

Neni 474
Komunikimi i vendimeve

1. Në qoftë se ky Kod nuk parasheh ndryshe, vendimet u komunikohen palëve të interesuara gojarisht nëse janë të pranishëm, e kur mungojnë atyre u dërgohet kopja e vërtetuar.
2. Kur vendimi komunikohet gojarisht shënohet në procesverbal ose në shkresë, kurse personi të cilit i është dërguar vendimi, marrjen e vërteton me nënshkrimin e tij. Kur personi i interesuar deklaron se nuk do të ankohet, kopja e vërtetuar e vendimit të komunikuar gojarisht nuk i dërgohet po qe se me këtë Kod nuk është paraparë ndryshe.
3. Kopjet e vendimeve kundër të cilëve lejohet ankesë dërgohen së bashku me udhëzim për të drejtën në ankesë.

KAPITULLI XXVII
DËRGIMI I SHKRESAVE

Neni 475
Mënyra e dërgimit të shkresave

1. Në parim, shkresat dërgohen me postë. Dërgesa mund të bëhet edhe nëpërmjet organit kompetent komunal, zyrtarit të organit që ka marrë vendimin ose drejtpërdrejt përmes atij organi.
2. Thirrja për të marrë pjesë në shqyrtim gjyqësor ose thirrjet tjera gjykata mund t'ia komunikojë edhe gojarisht personit i cili gjendet në gjykatë së bashku me udhëzimin për pasojat e mosparaqitjes së tij. Thirrja e bërë në këtë mënyrë shënohet në procesverbal të cilin personi i thirrur e nënshkruan, përveç kur kjo thirrje është shënuar në procesverbalin e shqyrtimit gjyqësor. Kjo mënyrë konsiderohet si dërgesë e rregullt.
3. Gjykata apo prokurori i shtetit mund të urdhërojë Policinë e Kosovës që të bëjë dërgimin e shkresave, nëse pas përpjekjes së parë nga paragrafi 1. ose 2. të këtij neni dërgimi është i pasuksesshëm, është e paqartë nëse dërgimi ka qenë i suksesshëm ose personi i thirrur nuk paraqitet. Gjykata mund të urdhërojë Policinë

e Kosovës për të dërguar thirrjen pa shfrytëzuar mundësitë nga paragrafi 1. ose 2. të këtij neni nëse çmon se personi me gjasë nuk do të veprojë në pajtim me thirrjen nga paragrafi 1. dhe 2. të këtij neni.

Neni 476
Dorëzimi personal i shkresave

Shkresa, që sipas këtij Kodi duhet dorëzuar personalisht, i jepet direkt personit të cilit i është adresuar. Në qoftë se personi, të cilit shkresa duhet dorëzuar personalisht nuk gjendet në vendin ku duhet bërë dorëzimi, dërguesi mëson se kur dhe ku mund të gjendet ai person dhe le njoftimin me shkrim te ndonjëri nga personat e paraparë në nenin 477 të këtij Kodi, që marrësi i shkresës të gjendet në banesën e tij ose në vendin e punës në ditën dhe orën e caktuar për të pranuar shkresën. Kur edhe pas kësaj dërguesi nuk e gjen personin të cilit duhet dorëzuar shkresën, ai vepron sipas dispozitave të nenit 477, paragrafi 1. i këtij Kodi dhe dorëzimi i tillë konsiderohet se është kryer.

Neni 477
Alternativat e dorëzimit personal

1. Shkresa, për të cilën me këtë Kod nuk është paraparë dorëzim detyrues personal, dorëzohet gjithashtu personalisht, por kur marrësi nuk gjendet në banesë ose në vendin e punës, shkresa e tillë mund t'i dorëzohet ndonjërit nga anëtarët e rritur të familjes së tij i cili detyrohet ta pranojë shkresën. Në qoftë se ata nuk gjenden në shtëpi, shkresa i dorëzohet kujdestarit ose fqinjit, në qoftë se ai pajtohet ta pranojë atë. Kur dërgimi bëhet në vendin e punës së personit i cili duhet të pranojë shkresën, ndërsa ai nuk gjendet aty, mund t'i dorëzohet personit të autorizuar për marrjen e postës i cili detyrohet ta pranojë shkresën, ose personit të punësuar në të njëjtin vend pune në qoftë se ai pajtohet ta pranojë shkresën.
2. Kur shkresa nuk mund t'u dorëzohet personave nga paragrafi 1. i këtij neni, marrësit i lihet njoftimi për postën se ku mund të merret shkresa dhe afati deri kur mund të marrë atë shkresë. Shkresa e cila nuk merret brenda afatit të paraparë kthehet.
3. Kur vërtetohet se mungon personi të cilit duhet t'i dërgohet shkresa dhe se personat nga paragrafi 1. i këtij neni nuk mund t'ia dorëzojnë atij shkresën me kohë, shkresa kthehet me shënimin se ku gjendet personi që mungon.

Neni 478
Shkresat që duhet dorëzuar personalisht

1. Të pandehurit personalisht i dorëzohet thirrja për marrje në pyetje në procedure paraprake dhe për shqyrtim gjyqësor.
2. Të pandehurit i cili nuk ka mbrojtës i dërgohet personalisht aktakuza, aktgjykimi dhe vendimet tjera për të cilat afati i ankesës fillon nga dita e dorëzimit, duke përfshirë edhe ankesën e palës kundërshtare të dorëzuar për përgjigje. Me kërkesën e të pandehurit, aktgjykimi dhe vendimet tjera i dorëzohen personit të caktuar nga ai.

3. Në qoftë se të pandehurit i cili nuk ka mbrojtës duhet dorëzuar aktgjykimin me të cilin i është shqiptuar dënimi me burgim, kurse aktgjykimi nuk mund t'i dërgohet në adresën e tij të mëparshme, gjykata menjëherë i cakton mbrojtës të pandehurit, i cili e ushtron këtë detyrë derisa të gjindet adresa e re e të pandehurit. Mbrojtësit të caktuar i lihet afat i nevojshëm për t'u njoftuar me shkresat, e pastaj i dorëzohet aktgjykimi dhe vazhdon procedura. Në rast të ndonjë vendimi tjetër për të cilin data e dorëzimit konsiderohet si datë e fillimit të ecjes së afatit për parashtrimin e ankesës, ose në rastin e ankesës së palës kundërshtare e cila dorëzohet për përgjigje dhe dërguesi nuk ka mund ta gjej adresën e re të të pandehurit, vendimi apo ankesa vihet në stendën e gjykatës dhe pas tetë (8) ditëve nga dita e vënies në stendë dërgesa konsiderohet valide.
4. Në qoftë se i pandehuri ka mbrojtës, shkresa nga paragrafi 2. i këtij neni i dërgohet mbrojtësit dhe të pandehurit në pajtim me dispozitat e nenit 477 të këtij Kodi. Në rastin e tillë, afati për ushtrimin e mjetit juridik apo të përgjigjes në ankesë rrjedhë nga dita e dorëzimit të shkresës të pandehurit. Kur të pandehurit nuk mund t'i dorëzohet vendimi apo ankesa për shkak të mosdhënies së adresës, ato vihen në stendën e gjykatës dhe pas tetë (8) ditëve nga dita e vënies në stendë dërgesa konsiderohet valide.
5. Kur shkresa duhet dorëzuar mbrojtësit të të pandehurit dhe i pandehuri ka më shumë se një mbrojtës, mjafton t'i dorëzohet njërit prej tyre.

Neni 479
Procedura e dorëzimit

1. Marrësi dhe dërguesi e nënshkruajnë fletëdërgesën për të vërtetuar dorëzimin. Marrësi në flëtëdërgesë shënon personalisht datën e pranimit.
2. Në qoftë se marrësi nuk di shkrim ose nuk është në gjendje të nënshkruajë emrin e tij, për të nënshkruhet dërguesi duke e shënuar ditën e dorëzimit dhe arsyen përse është nënshkruar në vend të marrësit.
3. Kur marrësi refuzon të nënshkruajë fletëdërgesën, dërguesi këtë e shënon në fletëdërgesë si dhe ditën e dorëzimit të dërgesës, ndërsa dërgimi konsiderohet valid.

Neni 480
Refuzimi i marrjes së shkresës

Kur marrësi ose anëtari i rritur i familjes së tij refuzon marrjen e shkresës, dërguesi shënon në fletëdërgesë ditën, orën dhe shkakun e refuzimit të marrjes dhe shkresën e lë në banesën e marrësit ose në vendin e tij të punës. Dorëzimi i tillë konsiderohet valid.

Neni 481
Dërgimi i shkresave në rrethana të veçanta

1. Zyrtarëve të policisë, rojeve në institucionet ku mbahen personat e privuar lirie, të punësuarve në transportin tokësor, ujor dhe ajror u dërgohen thirrjet nëpërmjet komandës së tyre apo eprorit të drejtpërdrejtë dhe, sipas nevojës, në këtë mënyrë mund t'u dërgohen edhe shkresat tjera.

2. Personave të burgosur u dorëzohet thirrja nëpërmjet gjykatës ose nëpërmjet institucionit ku ata mbahen të burgosur.
3. Përveç rasteve kur me marrëveshje ndërkombëtare është caktuar ndryshe, personave që gëzojnë të drejtën e imunitetit në Kosovë u dërgohen thirrjet në pajtim me dispozitat e këtij kapitulli. Në lokalet e organizatës ndërkombëtare të mbrojtur me të drejtën apo marrëveshjen ndërkombëtare nuk mund të bëhet dorëzimi personal i thirrjes.

Neni 482
Dërgimi i shkresave prokurorit të shtetit

1. Prokurorit të shtetit vendimet dhe shkresat tjera i dërgohen përmes zyrës së regjistrimit të prokurorit të shtetit.
2. Në rastin e dërgimit të vendimeve ose shkresave të tjera për të cilat afati fillon të rrjedhë nga dita e dorëzimit, dita e dorëzimit të shkresës në zyrën e regjistrimit të prokurorit të shtetit konsiderohet ditë e dorëzimit.
3. Prokurorit të shtetit, me kërkesën e tij, i dërgohen për shqyrtim shkresat e çështjes penale. Kur afati për ushtrimin e mjetit të rregullt juridik rrjedh ose kur kjo është e nevojshme për arsye të tjera procedurale, gjykata mund të caktojë një afat kur prokurori i shtetit detyrohet t'i kthejë shkresat.

Neni 483
Dorëzimi sipas dispozitave të procedurës kontestimore

Për rastet që nuk janë paraparë në mënyrë të veçantë me këtë Kod, dërgimi bëhet sipas dispozitave që vlejnë për procedurën kontestimore.

Neni 484
Dorëzimi i shkresave nëpërmjet pjesëmarrësve të tjerë në procedurë

1. Thirrjet dhe vendimet e marra para përfundimit të shqyrtimit gjyqësor dhe të adresuara për personin që merr pjesë në procedurë, përpos të pandehurit, mund t'i dorëzohen një pjesëmarrësi në procedurë i cili pranon t'ia dorëzojë personit të adresuar, kur organi përkatës konsideron se në këtë mënyrë marrja e tyre është e sigurt.
2. Personat nga paragrafi 1. i këtij neni mund të njoftohen për thirrjen për shqyrtim gjyqësor ose për thirrjet tjera, si dhe për vendimin për shtyrje të shqyrtimit gjyqësor apo të veprimeve të tjera të planifikuara përmes telekomunikimit, nëse nga rrethanat mund të sigurohet se njoftimi i bërë në këtë mënyrë do të pranohet nga personi të cilit i është adresuar.
3. Në procesverbal bëhet shënim zyrtar se thirrja ose vendimi janë dërguar në mënyrën e paraparë në paragrafët 1. dhe 2. të këtij neni.
4. Personi i cili është njoftuar ose të cilit i është dërguar vendimi në pajtim me paragrafin 1. ose 2. të këtij neni mund të vuajë pasojat e dëmshme për shkak të mosndërmarrjes së veprimeve vetëm nëse vërtetohet se ai e ka marrë thirrjen apo vendimin me kohë dhe është njoftuar për pasojat e mosndërmarrjes së veprimit.

KAPITULLI XXVIII
EKZEKUTIMI I VENDIMEVE

Neni 485
Forma e prerë dhe ekzekutueshmëria e vendimit

1. Aktgjykimi merr formë të prerë kur më nuk mund të kundërshtohet me ankesë ose kur nuk lejohet ankesë.
2. Aktgjykimi i formës së prerë ekzekutohet kur është bërë dorëzimi dhe kur për ekzekutimin e tij nuk ka pengesa ligjore. Në qoftë se nuk është parashtruar ankesë ose palët kanë hequr dorë nga e drejta në ankesë apo janë tërhequr nga ankesa e parashtruar, aktgjykimi konsiderohet i ekzekutueshëm pas kalimit të afatit për ankesë apo nga dita e heqjes dorë ose e tërheqjes së ankesës.
3. Në qoftë se gjykata e cila ka marrë aktgjykimin në shkallë të parë nuk është kompetente për ekzekutimin e tij, kopjen e vërtetuar të aktgjykimit ia dërgon organit kompetent për ekzekutim së bashku me vërtetimin që lejon ekzekutimin.
4. Dispozitat që zbatohen për ekzekutimin e sanksioneve penale përcaktohen me ligj të posaçëm.

Neni 486
Ekzekutimi i dënimit me gjobë

Kur gjoba e shqiptuar me këtë Kod nuk mund të arkëtohet as detyrimisht, gjykata e ekzekuton duke zbatuar nenin 46 të Kodit Penal.

Neni 487
Ekzekutimi i aktgjykimit lidhur me shpenzimet e procedurës penale, konfiskimin i dobisë pasurore dhe kërkesën pasurore juridike

1. Në rastin e shpenzimeve të procedurës penale, konfiskimit të dobisë pasurore dhe kërkesës pasurore juridike, aktgjykimi ekzekutohet nga gjykata kompetente sipas dispozitave të zbatueshme në procedurën e përmbarimit.
2. Arkëtimi i detyrueshëm i shpenzimeve të procedurës penale që duhet derdhur në buxhet bëhet sipas detyrës zyrtare. Shpenzimet e arkëtimit të detyrueshëm fillimisht mbulohen nga mjetet buxhetore të gjykatës.
3. Në qoftë se me aktgjykim shqiptohet dënim plotësues i konfiskimit të sendit, sendet e tilla menjëherë kalojnë në pronësi të shtetit. Kopja e çertifikuar e aktgjykimit të formës së prerë menjëherë i dërgohet Agjencisë për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar ose të Konfiskuar, e cila mund të bëjë shitjen e sendeve ose dorëzimin e tyre për shfrytëzim nga Qeveria. Të ardhurat e fituara nga shitja e sendeve të tilla derdhen në buxhet.
4. Kur merret vendim për konfiskimin e sendeve në bazë të Kapitullit XVIII, pjesa 2 të këtij Kodi, paragrafi 3. i këtij neni zbatohet përshtatshmërisht.
5. Përveç rishikimit të procedurës penale ose kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë, urdhri i formës së prerë për konfiskimin e sendit mund të ndryshohet në kontest civil nëse paraqitet kontest lidhur me pronësinë e sendit të konfiskuar.

Neni 488
Ekzekutimi i aktvendimit dhe i urdhrit

1. Në qoftë se ky Kod nuk parasheh ndryshe, aktvendimi ekzekutohet kur merr formën e prerë. Urdhri ekzekutohet menjëherë, përpos rasteve kur organi që lëshon urdhrin vendos ndryshe.
2. Aktvendimi merr formën e prerë kur ndaj tij më nuk mund të ushtrohet ankesë ose kur nuk lejohet ankesë.
3. Nëse nuk është paraparë ndryshe, aktvendimet dhe urdhrat ekzekutohen nga organet që i kanë marrë ato vendime. Kur gjykata ka vendosur për shpenzimet e procedurës penale me aktvendim, arkëtimi i këtyre shpenzimeve bëhet sipas dispozitave të nenit 487, paragrafët 1. dhe 2. të këtij Kodi.

Neni 489
Mëdyshjet për ekzekutimin e vendimit dhe korrigjimet e tij

1. Kur ka mëdyshje lidhur me lejimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor apo për llogaritjen e dënimit, ose kur me aktgjykimin e formës së prerë nuk është vendosur për llogaritjen e paraburgimit apo të dënimit të mbajtur më parë apo llogaritja nuk është bërë në mënyrë të saktë, kryetari i trupit gjykues që ka gjykuar çështjen në shkallë të parë për këto çështje vendos me aktvendim të posaçëm. Ankesa nuk pezullon ekzekutimin e aktvendimit, përveç nëse gjykata vendos ndryshe.
2. Kur ka mëdyshje lidhur me interpretimin e vendimit gjyqësor, për këtë vendos gjykata që ka marrë vendimin e formës së prerë.

Neni 490
Lëshimi i kopjes së vërtetuar të vendimit lidhur me kërkesën pasurore juridike

Kur vendimi mbi kërkesën pasurore juridike merr formën e prerë, i dëmtuari mund të kërkojë nga gjykata e cila ka marrë vendimin në shkallë të parë që atij t'i lëshojë kopjen e vërtetuar të vendimit me shkrim që thotë se vendimi mund të ekzekutohet.

Neni 491
Mbajtja e evidencës për personat e dënuar

Evidencën mbi procedurat penale dhe evidencën e personave të dënuar e mban organi publik kompetent në lëmin e çështjeve gjyqësore. Mënyra e mbajtjes së evidencës caktohet me akt nënligjor.

KAPITULLI XXIX
DISPOZITAT TJERA

Neni 492
Imuniteti sipas të drejtës ndërkombëtare

1. Për përjashtimin e ndjekjes penale të personave të huaj, të cilët gëzojnë imunitet, zbatohen rregullat e së drejtës ndërkombëtare.

2. Në rast të dyshimi nëse një person gëzon imunitet, sipas paragrafit 1. të këtij neni, organi që e zhvillon procedurën i drejtohet për sqarim Ministrisë për Punë të Jashtme.

PJESA E KATËRT
PROCEDURAT E VEÇANTA

KAPITULLI XXX
PROCEDURAT PËR DHËNIEN E URDHRIT NDËSHKIMOR

Neni 493
Kërkesa për urdhër ndëshkimor

1. Për veprat penale për të cilat parashihet dënim me gjobë ose burgim deri në tri (3) vjet, për të cilat prokurori i shtetit është informuar në bazë të provave të besueshme nga kallëzimi penal, prokurori i shtetit mund të kërkojë në aktakuzë që gjykata të jep urdhër ndëshkimor, në të cilin të akuzuarit do t'i shqiptojë dënim përkatës pa e mbajtur shqyrtimin gjyqësor.
2. Prokurori i shtetit mund të kërkojë shqiptimin e një ose më shumë masave vijuese: dënim me gjobë, ndalim të drejtimit të automjetit, urdhër për publikim të aktgjykimit, konfiskim të sendit, vërejtje gjyqësore ose konfiskim të dobisë pasurore të fituar me vepër penale.

Neni 494
Hudhja e kërkesës për urdhër ndëshkimor

1. Një gjyqtar i vetëm hudh kërkesën për dhënien e urdhrit ndëshkimor për vepra penale për të cilat nuk mund të paraqitet kërkesë e tillë, ose kur prokurori i shtetit kërkon shqiptimin e dënimit i cili sipas ligjit nuk është i lejueshëm. Kolegji shqyrtues në afat prej dyzet e tetë (48) orëve vendos për ankesën e prokurorit të shtetit kundër aktvendimit mbi hudhjen e kërkesës.
2. Kur gjyqtari i vetëm çmon se të dhënat në aktakuzë nuk ofrojnë bazë të mjaftueshme për dhënien e urdhrit ndëshkimor ose nga të dhënat e tilla mund të pritet shqiptim i ndonjë dënimi tjetër nga ai që e ka propozuar prokurori i shtetit, ai pasi që ta pranojë aktakuzën cakton shqyrtim gjyqësor.

Neni 495
Aktgjykimi për urdhër ndëshkimor

1. Kur gjyqtari i vetëm pajtohet me kërkesën, ai jep urdhër ndëshkimor me aktgjykim.
2. Në urdhrin ndëshkimor shënohet se pranohet kërkesa e prokurorit të shtetit dhe se shqiptohet dënimi nga kërkesa ndaj të pandehurit, të dhënat personale të të cilit duhet shënuar qartë. Dispozitivi i aktgjykimit mbi urdhrin ndëshkimor përfshin të dhënat e nevojshme nga neni 365, paragrafi 1. i këtij Kodi, përfshirë vendimin për kërkesën pasurore juridike nëse është paraqitur propozimi për realizimin e saj. Në arsyetim shënohen provat që arsyetojnë dhënien e urdhrit ndëshkimor.

3. Urdhri ndëshkimor përmban udhëzimin për të pandehurin në pajtim me dispozitat e nenit 496 paragrafi 2. i këtij Kodi si dhe njoftimin se pas kalimit të afatit për kundërshtim, kur kundërshtim nuk paraqitet, urdhri ndëshkimor merr formë të prerë dhe ekzekutohet dënimi i shqiptuar kundër të pandehurit.

Neni 496
Dërgimi i aktgjykimit për urdhër ndëshkimor dhe kundërshtimi i tij

1. Urdhri ndëshkimor i dërgohet të pandehurit dhe mbrojtësit të tij, nëse ka mbrojtës, si dhe prokurorit të shtetit.
2. I pandehuri ose mbrojtësi i tij në afat prej tetë (8) ditëve pas pranimit mund të paraqesin kundërshtim me shkrim ose me gojë kundër urdhrit ndëshkimor në procesverbal të gjykatës. Kundërshtimi nuk duhet domosdo të arsyetohet. Në të mund të propozohen prova në dobi të mbrojtjes. I akuzuari mund të heqë dorë nga e drejta në kundërshtim, por nga kundërshtimi i paraqitur nuk mund të tërhiqet pas caktimit të shqyrtimit gjyqësor. Pagimi i gjobës para kalimit të afatit për kundërshtim nuk konsiderohet heqje dorë nga e drejta në kundërshtim.
3. Të pandehurit i cili për shkaqe të arsyeshme lëshon afatin për paraqitjen e kundërshtimit, gjyqtari i lejon kthim në gjendje të mëparshme. Me rastin e vendosjes mbi lutjen për kthim në gjendje të mëparshme zbatohen dispozitat e neneve 447 dhe 448 të këtij Kodi.
4. Kur një gjyqtar i vetëm nuk e hudh kundërshtimin si të paafatshëm ose të paraqitur nga personi i paautorizuar, cakton shqyrtim gjyqësor lidhur me aktakuzën e prokurorit të shtetit.
5. Kolegji prej tre (3) gjyqtarësh vendos për ankesë kundër aktvendimit mbi hudhjen e kundërshtimit kundër urdhrit ndëshkimor në afatin e përcaktuar në paragrafin 1. të nenit 494 të këtij Kodi.

Neni 497
Gjyqtari i vetëm gjykues nuk detyrohet nga kërkesa për urdhër ndëshkimor

Me rastin e marrjes së aktgjykimit lidhur me kundërshtimin, gjyqtar i vetëm gjykues nuk detyrohet me kërkesën e prokurorit të shtetit nga neni 493, paragrafi 2. i këtij Kodi dhe as me ndalesën nga neni 395 i këtij Kodi.

KAPITULLI XXXI
SHQIPTIMI I VËREJTJES GJYQËSORE

Neni 498
Vërejtja gjyqësore

1. Vërejtja gjyqësore shqiptohet me aktgjykim.
2. Nëse në këtë kapitull nuk është paraparë ndryshe, dispozitat e këtij Kodi lidhur me aktgjykimin me të cilin i pandehuri shpallet fajtor zbatohen përshtatshmërisht edhe ndaj aktgjykimit për vërejtje gjyqësore.

Neni 499
Shpallja dhe përmbajtja e dispozitivit të aktgjykimit për vërejtjen gjyqësore

1. Aktgjykimi për vërejtje gjyqësore shpallet menjëherë pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor, së bashku me arsyet esenciale.
2. Në dispozitiv të aktgjykimit për vërejtje gjyqësore shënohen të dhënat personale të të akuzuarit, shënohet se është shqiptuar vërejte gjyqësore për veprën që është objekt i aktakuzës dhe emërtimi ligjor i veprës penale. Dispozitivi i aktgjykimit për vërejtje gjyqësore përfshin edhe të dhënat e nevojshme nga neni 365, paragrafi 1. nën-paragrafët 1.4. dhe 1.6. të këtij Kodi.
3. Në arsyetim të aktgjykimit, gjykata paraqet shkaqet në të cilat është bazuar me rastin e shqiptimit të vërejtjes gjyqësore.

Neni 500
Arsyet për ankesë kundër aktgjykimit mbi vërejtjen gjyqësore

1. Kundër aktgjykimit për vërejtjen gjyqësore mund të paraqitet ankesë sipas arsyeve të parapara në nenin 383, paragrafi 1. nën-paragrafët 1.1., 1.2. dhe 1. 3. të këtij Kodi, si dhe për shkak të mosekzistimit të rrethanave që e arsyetojnë shqiptimin e vërejtjes gjyqësore.
2. Kur aktgjykimi për vërejtjen gjyqësore përmban vendimin mbi masën për trajtim të detyrueshëm për rehabilitim, konfiskimin e dobisë pasurore të fituar me vepër penale, shpenzimet e procedurës penale ose kërkesën pasurore juridike, ndaj aktgjykimit të tillë mund të ushtrohet ankesë për shkak se gjykata nuk e ka zbatuar drejt masën e trajtimit të detyrueshëm për rehabilitim ose të konfiskimit të dobisë pasurore të fituar me vepër penale apo për arsye se vendimin për shpenzimet e procedurës penale ose për kërkesën pasurore juridike e ka marrë në kundërshtim me dispozitat ligjore.

Neni 501
Ndalimi i tejkalimit të autorizimeve gjyqësore të parashikuara me ligj

Përveç shkeljeve të ligjit penal të përcaktuara në nenin 385 të këtij Kodi, me rastin e shqiptimit të vërejtjes gjyqësore po ashtu ekziston shkelje e ligjit penal kur gjykata tejkalon autorizimet që i ka me ligj përkitazi me vërejtjen gjyqësore, masën e trajtimit të detyrueshëm për rehabilitimin ose konfiskimin e dobisë pasurore të fituar me vepër penale.

Neni 502
Efekti i ankesës

1. Kur ankesën kundër aktgjykimit për vërejtje gjyqësore e paraqet prokurori në dëm të të akuzuarit, Gjykata e Apelit mund të merr aktgjykim me të cilin i akuzuari shpallet fajtor dhe gjykohet me dënim ose shqiptohet dënim alternativ kur çmon se gjykata themelore saktë ka vërtetuar provat materiale, por zbatimi i drejtë i ligjit kërkon shqiptimin e dënimit.

2. Gjykata e Apelit mund të vendosë për çdo ankesë kundër aktgjykimit mbi vërejtjen gjyqësore me aktgjykim me të cilin aktakuza hudhet, ose me aktgjykim me të cilin i akuzuari lirohet nga akuza kur çmon se gjykata themelore i ka vërtetuar saktë faktet vendimtare, por zbatimi i drejtë i ligjit kërkon marrjen e ndonjërit nga këto aktgjykime.
3. Kur ekzistojnë arsyet nga neni 401 i këtij Kodi, Gjykata e Apelit merr aktgjykim me të cilin refuzohet ankesa si e pabazë dhe vërteton aktgjykimin e gjykatës themelore mbi vërejtjen gjyqësore.

KAPITULLI XXXII
PROCEDURA NDAJ PERSONAVE TË CILËT KANË KRYER VEPËR PENALE NËN NDIKIMIN E ALKOOLIT OSE DROGËS

Neni 503
Shqiptimi i masës për trajtim të detyrueshëm rehabilitues

1. Me aktgjykim dënues, gjykata mund të shqiptojë masën e trajtimit të detyrueshëm për rehabilitimin e kryerësve të varur nga alkooli ose nga droga të cilët kanë kryer vepër penale nën ndikim të alkoolit ose drogës në pajtim me nenet 58 dhe 90 të Kodit Penal.
2. Masën nga paragrafi 1. i këtij neni gjykata mund ta shqiptojë pavarësisht nga sanksioni që i ka shqiptuar të akuzuarit dhe ekzekutimi i saj bëhet pavarësisht nëse i akuzuari gjendet në liri apo në mbajtje të dënimit me burgim.
3. Gjykata vendos për zbatimin e masës nga paragrafi 1. i këtij Kodi pas dëgjimit të mendimit të ekspertit dhe pas dëgjimit të prokurorit të shtetit dhe mbrojtjes. Mendimi i ekspertit duhet t'i analizojë mundësitë për trajtimin e të pandehurit.
4. Koha e qëndrimit në institucionin shëndetësor për masën e trajtimit të detyrueshëm rehabilitues llogaritet në kohëzgjatjen e dënimit me burgim.

Neni 504
Mbikëqyrja e trajtimit të detyrueshëm rehabilitues nga gjykata

1. Gjykata e cila ka shqiptuar masën e trajtimit të detyrueshëm për rehabilitim në institucionin e kujdesit shëndetësor, sipas detyrës zyrtare ose me propozimin e institucionit për kujdes shëndetësor dhe bazuar në mendimin e ekspertit të psikiatrisë, i merr të gjitha vendimet lidhur me kohëzgjatjen dhe ndryshimin e masës nga neni 90 i Kodit Penal.
2. Vendimet nga paragrafi i mëparshëm merren nga kolegji shqyrtues pas seancës së dëgjimit. Njoftimi për seancë dëgjimi i dërgohet prokurorit të shtetit dhe mbrojtësit. Para marrjes së vendimit, gjykata dëgjon mendimin e ekspertit dhe të kryerësit nëse gjendja e tij shëndetësore e lejon këtë.
3. Në procedurë për shqyrtim të vazhdimit ose ndryshimit të masës për trajtim të detyrueshëm për rehabilitim, kryerësi duhet të ketë mbrojtës.
4. Çdo dy (2) muaj, gjykata në pajtim me paragrafin 2. të këtij neni vendos sipas detyrës zyrtare nëse ende ekzistojnë kushtet për masën e trajtimit të detyrueshëm për rehabilitim në institucionin për kujdes shëndetësor. Eksperti i cili nuk punon në

institucionin e kujdesit shëndetësor ku kryerësi i është nënshtruar trajtimit të detyrueshëm për rehabilitim, kryen ekspertimin dhe paraqet konstatimin e tij me shkrim dhe kur është e nevojshme, bën deklarim në gjykatë.

5. Gjykata pushon zbatimin e masës nga paragrafi 1. i këtij neni kur trajtimi ose rehabilitimi më nuk janë të nevojshëm ose kur ka kaluar koha e përcaktuar në nenin 90 te Kodit Penal.

Neni 505
Zbatimi përshtatshmërisht i dispozitave të tjera të këtij kodi

Me përjashtim të rasteve kur në këtë Kapitull parashihet ndryshe, dispozitat tjera të këtij Kodi zbatohen përshtatshmërisht për personat të cilët kanë kryer vepra penale nën ndikimin e alkoolit dhe drogës.

KAPITULLI XXXIII
PROCEDURA PENALE KU PËRFSHIHEN KRYERËS ME ÇRREGULLIME MENDOR

Neni 506
Përkufizimet

Për qëllime të këtij Kapitulli:

1. **"Çrregullim mendor"** do të thotë çdo paaftësi apo çrregullim i mendjes apo trurit qoftë i përhershëm apo i përkohshëm që rezulton me dëmtim apo çrregullim të funksionimit mendor;
2. **"Paaftësi mendore"** ka kuptimin e paraparë në paragrafin 1. të nenit 18 të Kodit Penal;
3. **"Aftësi e zvogëluar mendore"** ka kuptimin e paraparë në paragrafin 2. të nenit 18 të Kodit Penal; dhe
4. **"Masë e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik"** do të thotë masë e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik dhe ndalim në institucionin e kujdesit shëndetësor ose masë a trajtimit të detyrueshëm psikiatrik në liri.

Neni 507
Masat e trajtimit të detyrueshëm sipas Kodit Penal

Kryerësi më çrregullim mendor apo personi i cili trajtohet si i tillë gëzon të drejtat dhe masat e trajtimit të detyrueshëm nga Kapitulli V i Kodit Penal.

Neni 508
Zbatimi i ekzaminimit psikiatrik

1. Në çdo kohë gjatë procedurës, duke përfshirë kohën gjatë shqyrtimin gjyqësor, nëse ekziston dyshimi se i pandehuri ka qenë në gjendje të paaftësisë mendore ose në gjendje të aftësisë së zvogëluar mendore në kohën e kryerjes së veprës penale apo nëse ka ndonjë çrregullim mendor, gjykata sipas detyrës zyrtare ose me propozimin e

prokurorit të shtetit apo të mbrojtësit, mund të caktojë ekspert sipas nenit 146 të këtij Kodi për të kryer ekzaminimin psikiatrik të të pandehurit për të konstatuar nëse:

1.1. në kohën e kryerjes së veprës penale i pandehuri ka qenë në gjendje të paaftësisë mendore ose aftësisë së zvogëluar mendore; ose

1.2. i pandehuri është i paaftë për të përballuar gjykimin.

2. Në urdhër shënohet koha kur duhet kryer ekzaminimin psikiatrik i cili duhet kryer brenda dy (2) javësh nga lëshimi i urdhërit. Nëse i pandehuri nuk ka angazhuar mbrojtës, gjykata nxjerr një urdhër për emërimin e mbrojtësit me shpenzime të shtetit .
3. Mbrojtësi mund të merr pjesë në ekzaminimin psikiatrik për të konstatuar aftësinë e të pandehurit për të përballuar gjykimin, përveç nëse eksperti konstaton se prania e tij do të pengonte vlerësimin e drejtë të të pandehurit
4. Nëse eksperti konstaton se për ekzaminimin psikiatrik të pandehurit nevojitet observim në një institucion të kujdesit shëndetësor, ose nëse i pandehuri refuzon ekzaminimin psikiatrik, eksperti i paraqet kërkesë të arsyetuar gjykatës për marrjen e aktvendimit mbi ndalimin në institucionin e kujdesit shëndetësor. Pas dëgjimit të prokurorit të shtetit dhe mbrojtësit, gjykata mund të marrë aktvendim për ndalimin e të pandehurit në institucionin e kujdesit shëndetësor deri në dy (2) javë. Ankesa kundër këtij aktvendimi nuk e ndalon ekzekutimin e tij
5. Nëse eksperti konstaton se për ekzaminimin psikiatrik të pandehurit në pajtim me paragrafin 1. të këtij neni ose për observimin e tij në një institucion të kujdesit shëndetësor në pajtim me paragrafin
6. të këtij neni nevojitet më tepër kohë, ai i paraqet kërkesë të arsyetuar gjykatës për zgjatjen e afatit. Gjykata mund të urdhërojë zgjatjen e afatit deri në dy (2) javë.
7. Nëse observimi në institucionin e kujdesit shëndetësor në pajtim me paragrafin 4. të këtij neni shqiptohet ndaj personit i cili është në paraburgim, koha e kaluar në institucionin e kujdesit shëndetësor llogaritet në periudhën e paraburgimit.
8. Në rastin e ekzaminimit psikiatrik të urdhëruar në pajtim me paragrafin 1. nën-paragrafin 1.1. të këtij neni, eksperti në konstatimin e tij shënon elementet vijuese: natyrën, llojin, shkallën dhe kohëzgjatjen e sëmundjes mendore të të pandehurit; llojin e ndikimit që kjo gjendje mendore ka pasur dhe ende ka në të kuptuarit dhe veprimet e të akuzuarit dhe nëse ky çrregullim mendor ka ekzistuar dhe deri në çfarë shkalle në kohën e kryerjes së veprës penale
9. Në rastin e ekzaminimit psikiatrik të urdhëruar në pajtim me paragrafin 1. nën-paragrafin 1.2. të këtij neni, eksperti në konstatimin e tij shënon elementet vijuese: natyrën, llojin, shkallën dhe kohëzgjatjen e sëmundjes mendore të të pandehurit dhe llojin e ndikimit që ky çrregullim mendor e ka në të kuptuarit dhe veprimet e të akuzuarit, veçmas në aftësinë e tij për ta mbrojtur veten, në aftësinë që të konsultohet me personat tjerë duke përfshirë mbrojtësin dhe në aftësinë për ta kuptuar akuzën.

Neni 509
Paraburgimi për personat me çrregullime mendor

1. Përveç rasteve nga neni 187 i këtij Kodi ku mund të urdhërohet paraburgimi, gjykata mund të urdhërojë paraburgim ndaj personit nëse:

1.1. ekziston dyshim i bazuar se personi i tillë ka kryer vepër penale;
1.2. në bazë të ekzaminimit psikiatrik të urdhëruar sipas nenit 508 të këtij Kodi, personi ka qenë në gjendje të paaftësisë mendore ose në gjendje të aftësisë së zvogëluar mendore në kohën e kryerjes së veprës penale; dhe
1.3. personi aktualisht vuan nga çrregullimi mendor, dhe si rezultat i kësaj, ka arsye për të besuar se ai do të rrezikojë jetën apo shëndetin e ndonjë personi tjetër.

2. Paraburgimi në pajtim me paragrafin 1. të këtij neni mund të urdhërohet vetëm nëse prokurori i shtetit ka paraqitur propozimin e paraparë në nenin 512 të këtij Kodi. Paraburgimi i tillë mbahet në institucionin e kujdesit shëndetësor dhe mund të zgjasë për aq kohë sa i pandehuri është i rrezikshëm, por që nuk kalon afatet e parapara për paraburgim në nenin 190 të këtij Kodi.
3. Nëse i pandehuri ndodhet në paraburgim dhe më pas konstatohet se ka qenë në gjendje të paaftësisë mendore në kohën e kryerjes së veprës penale, gjykata urdhëron që i pandehuri të mbajë paraburgimin në institucionin e kujdesit shëndetësor nëse ai aktualisht ndodhet në gjendje të çrregullimit mendor.
4. Gjykata merr aktvendim në pajtim me paragrafin 1. ose 3. të këtij neni vetëm pas dëgjimit të prokurorit të shtetit, mbrojtësit dhe të pandehurit, nëse gjendja e tij këtë e lejon, dhe pasi të ketë shqyrtuar mendimin e ekspertit. Aktvendimi i tillë i dërgohet prokurorit të shtetit, të pandehurit dhe mbrojtësit të tij, institucionit mjekësor dhe qendrës së paraburgimit. Ankesa nuk e pezullon ekzekutimin e urdhrit
5. Institucioni i kujdesit shëndetësor vendos për masat për të siguruar sigurinë publike dhe sigurinë e të pandehurit pas konsultimeve me organin kompetent të paraburgimit, duke marrë parasysh nevojat për siguri dhe nevojat terapeutike.
6. Dispozitat e këtij Kodi mbi paraburgimin zbatohen përshtatshmërisht për paraburgimin e mbajtur në institucionin e kujdesit shëndetësor

Neni 510
Aktvendimi mbi aftësinë për t'iu nënshtruar gjykimit

1. Gjykata, sipas detyrës zyrtare ose me kërkesë të mbrojtësit apo prokurorit të shtetit, merr aktvendim mbi aftësinë e të pandehurit për t'iu nënshtruar gjykimit pas shqyrtimit të raportit të ekspertit të marrë në pajtim me nenin 508 të këtij Kodi dhe pas dëgjimit të prokurorit të shtetit, mbrojtësit dhe të pandehurit.
2. Gjykata vendos se i pandehuri është i paaftë për t'iu nënshtruar gjykimit nëse ai aktualisht ka çrregullim mendor dhe për shkak të çrregullimit të tillë mendor ai nuk është i aftë që të mbrohet, të konsultohet me mbrojtësin apo të kuptojë procedurën.
3. Kundër aktvendimit mbi aftësinë e të pandehurit për t'iu nënshtruar gjykimit mund të ushtrohet ankesë.

Neni 511
Pushimi apo ndërprerja e procedurës për shkak të aktvendimit mbi paaftësinë për t'iu nënshtruar gjykimit

1. Nëse gjykata vendos se i pandehuri është i paaftë për t'iu nënshtruar gjykimit gjatë procedurës për shkak të sëmundjes së përhershme mendore, ajo merr vendim për pushimin e procedures

2. Nëse gjykata vendos se i pandehuri është i paaftë për t'iu nënshtruar gjykimit gjatë procedurës për shkak se ai ka pësuar ndonjë çrregullim të përkohshëm mendor pas kryerjes së veprës penale, ndërpriten hetimet ose ndërpritet shqyrtimi gjyqësor në pajtim me këtë Kod.
3. Nëse procedura pushohet në pajtim me paragrafin 1. të këtij neni, procedura rifillohet me kërkesën e prokurorit të shtetit, posa të pushojnë së ekzistuari arsyet për marrjen e aktvendimit të tillë
4. Nëse gjykata vendos se i pandehuri është i paaftë për t'iu nënshtruar gjykimit në pajtim me këtë nen, ajo mund të kërkojë fillimin e procedurave për pranimin e tij në ndonjë institucion të kujdesit shëndetësor në pajtim me ligjin në fuqi për Procedurën Jashtëkontestimore. Në këtë rast, gjykata mund të merr aktvendim që i pandehuri të ndalet në institucionin e kujdesit shëndetësor për një periudhë maksimale prej dyzet e tetë (48) orëve në pritje të fillimit të procedurave për pranim në ndonjë institucion të kujdesit shëndetësor në pajtim me ligjin në fuqi për Procedurën Jashtëkontestimore, nëse sirezultat i çrregullimit mendor të këtij personi ekzistojnë arsyet për të dyshuar se ai do të rrezikojë jetën apo shëndetin e ndonjë personi tjetër.

Neni 512
Propozimi i prokurorit për masën e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik

1. Para hapjes së shqyrtimit gjyqësor, prokurori I shtetit paraqet propozim që gjykata të shqiptojë masën e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik nëse i pandehuri ka kryer vepër penale në gjendje të paaftësisë mendore dhe nëse ekzistojnë aryset për shqiptimin e masës së tillë, siç parashihet në nenet 88 dhe 89 të Kodit Penal.
2. Nëse provat e paraqitura në shqyrtimin gjyqësor dëshmojnë se i pandehuri ka kryer vepër penale në gjendje të paaftësisë mendore, prokurori I shtetit gjatë shqyrtimit gjyqësor e ndryshon aktakuzën dhe paraqet propozim që gjykata të shqiptojë masën e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik nëse ekzistojnë aryset për shqiptimin e masës së tillë siç parashihet në nenet 88 dhe 89 të Kodit Penal.
3. I pandehuri duhet të ketë mbrojtës pas dorëzimit të propozimit nga paragrafi 1. ose 2. i këtij neni.

Neni 513
Zbatimi i procedures për shqiptimin e masës së trajtimit të detyrueshëm psikiatrik

1. Masa e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik shqiptohet pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor nga gjykata e cila është kompetente për gjykimin e çështjes në shkallë të parë.
2. Përveç personave të cilët duhet të thirren në shqyrtimin gjyqësor duhet të thirren edhe ekspertët dhe psikiatrat nga institucioni i kujdesit shëndetësor të cilëve iu është besuar kryerja e ekzaminimit psikiatrik mbi aftësinë mendore të të akuzuarit. Bashkëshorti/ja e të pandehurit dhe prindërit e tij ose prindërit adoptues njoftohen për shqyrtimin gjyqësor.
3. Vendimi mbi shqiptimin e masës së tillë bazohet në dëgjimin e personave të thirrur

dhe në rezultatet dhe mendimet e ekspertëve. Gjatë marrjes së vendimit mbi shqiptimin e masës, gjykata nuk detyrohet nga propozimi i prokurorit të shtetit.

Neni 514
Vendimet gjyqësore

1. Nëse gjykata konstaton se nuk ekzistojnë arsyet për shqiptimin e masës së trajtimit të detyrueshëm psikiatrik të parapara në nenet 88 dhe 89 të Kodit Penal, ajo e pushon procedurën e shqiptimit të masës së trajtimit të detyrueshëm psikiatrik.
2. Gjykata merr aktgjykim lirues për të pandehurin nëse i pandehuri ka qenë në gjendje të paaftësisë mendore kur e ka kryer veprën penale dhe nëse prokurori i shtetit nuk ka paraqitur propozimin për shqiptimin e masës së trajtimit të detyrueshëm psikiatrik në pajtim me nenin 512 të këtij Kodi.
3. Gjykata merr aktvendim për shqiptimin e masës së trajtimit të detyrueshëm psikiatrik nëse ekzistojnë arsyet për shqiptimin e masës së trajtimit të detyrueshëm psikiatrik siç parashihet në nenet 88 dhe 89 të Kodit Penal dhe nëse prokurori I shtetit ka paraqitur propozimin për shqiptimin e masës së trajtimit të detyrueshëm psikiatrik në pajtim me nenin 512 të këtij Kodi. Në aktvendim theksohet:
   3.1. vepra të cilën është vërtetuar se e ka kryer i pandehuri, kualifikimi juridik i veprës dhe dispozitat e zbatuara të ligjit penal;
   3.2. vendimin që i pandehuri e ka kryer veprën në gjendje të paaftësisë mendore; dhe
   3.3. masën e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik që i është shqiptuar të pandehurit.
4. Të gjithë personat të cilët kanë të drejtë të ushtrojnë ankesë kundër aktgjykimit, përveç të dëmtuarit, kanë të drejtë të paraqesin ankesë kundër aktvendimit të gjykatës brenda tetë (8) ditësh pas marrjes së aktvendimit.
5. Në rastin kur gjykata vendos të pushojë procedurën në pajtim me paragrafin 1. të këtij neni, pas konstatimit se në kohën e kryerjes së veprës penale i pandehuri nuk ka qenë në gjendje të paaftësisë mendore, prokurori I shtetit mund të heqë dorë nga e drejta e parashtrimit të ankesës kundër këtij vendimi, dhe menjëherë mund të paraqesë aktakuzë. Aktakuza paraqitet brenda tetë (8) ditësh nga heqja dorë e të drejtës për ankesë.
6. Në rastet nga paragrafi 5. i këtij neni, shqyrtimi gjyqësor rihapet pranë trupit të njëjtë gjykues dhe procedura vazhdon në bazë të aktakuzës së re duke iu nënshtruar këtyre kushteve:
   6.1. gjykata mund të ndërpresë shqyrtimin gjyqësor për përgatitjen e mbrojtjes; dhe
   6.2. provat e paraqitura më herët nuk prezantohen përsëri, përveç se në rastet e parapara në nenin 311 të këtij Kodi ose nëse trupi gjykues e çmon të nevojshme që ndonjë pjesë e provës të prezentohet sërish.

Neni 515
Shqiptimi dhe llogaritja e masës së trajtimit të detyrueshëm psikiatrik

1. Kur gjykata merr aktgjykim ndaj personit i cili ka kryer vepër penale në gjendje të aftësisë së zvogëluar mendore, në atë aktgjykim ajo gjithashtu shqipton masën e

trajtimit të detyrueshëm psikiatrik nëse ekzistojnë arsyet për shqiptimin e masës së tillë nga nenet 88 dhe 89 të Kodit Penal.
2. Masat nga paragrafi 1. i këtij neni mund të shqiptohen pavarësisht nëse i pandehuri ndodhet në liri apo ndaj tij është shqiptuar dënimi me burgim.
3. Koha e kaluar në institucionin e kujdesit shëndetësor në pajtim me nenin 508, me urdhërin për paraburgim në pajtim me nenin 509 të këtij Kodi ose me masën e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik me ndalim, llogaritet në dënimin e shqiptuar.

Neni 516
Njoftimi mbi vendimin me të cilin shqiptohet masë e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik

Pasi të merr formë të prerë, vendimi me të cilin shqiptohet masa e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik me ndalim apo masa e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik në liri i dorëzohet gjykatës e cila është kompetente që të marrë vendim mbi privimin nga zotësia për veprim. Qendra kompetente për mirëqenie sociale gjithashtu njoftohet për vendimin.

Neni 517
E drejta për mbrojtës

Kryerësi ka mbrojtës gjatë procedurës për të ndryshuar apo pushuar masën e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik.

Neni 518
Ekzekutimi i masës së trajtimit të detyrueshëm psikiatrik

Ekzekutimi i masës së trajtimit të detyrueshëm psikiatrik nga ky kapitull rregullohet me nenet 181 deri 187 të Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale.

KAPITULLI XXXIV
PROCEDURA PËR REVOKIMIN E DËNIMEVE ALTERNATIVE

Neni 519
Kushtet për revokimin e dënimeve alternative

1. Kur dënimi me kusht kushtëzohet me njërin nga detyrimet nga neni 51 i Kodit Penal dhe i akuzuari nuk e përmbush detyrimin brenda afatit të caktuar nga gjykata, gjykata themelore fillon procedurën për revokimin e dënimit me kusht sipas propozimit të prokurorit të shtetit ose të dëmtuarit ose sipas detyrës zyrtare.
2. Gjyqtari të cilit i caktohet çështja gjyqësore, merr në pyetje të dënuarin kur është i arritshëm dhe shtron pyetjet e nevojshme për vërtetimin e fakteve dhe mbledhjen e provave që kanë të bëjnë me gjykimin e çështjes, e pastaj shkresat ia dërgon kolegjit.
3. Kryetari i kolegjit cakton seancën e kolegjit për të cilën e lajmëron prokurorin e shtetit, të dënuarin dhe të dëmtuarin. Mosprania e palëve dhe e të dëmtuarit nëse janë thirrur me rregull nuk pengon mbajtjen e seancës së kolegjit.

4. Kur gjykata vërteton se i dënuari nuk e ka përmbushur detyrimin e caktuar me aktgjykim, atëherë merr aktgjykimin në pajtim me nenin 55 të Kodit Penal.

KAPITULLI XXXV
PROCEDURA PËR MARRJEN E VENDIMIT PËR SHLYERJEN E DËNIMIT NGA EVIDENCA

Neni 520
Shlyerja e dënimit

1. Kur ligji parasheh shlyerjen e dënimit pas kalimit të një afati të caktuar, me kusht që kryerësi të mos kryejë vepër të re penale brenda këtij afati nga neni 103 i Kodit Penal, organi publik kompetent për çështje gjyqësore sipas detyrës zyrtare merr aktvendimin për shlyerjen e dënimit.
2. Para marrjes së aktvendimit mbi shlyerjen e dënimit bëhen gjurmime të nevojshme, veçanërisht në mbledhjen e të dhënave të cilat tregojnë nëse kundër të dënuarit zbatohet procedurë penale për ndonjë vepër të re penale të kryer para kalimit të afatit të paraparë për shlyerjen e dënimit.

Neni 521
Procedura për shlyerjen e dënimit në rastet kur organi administrativ nuk vepron

1. Kur organi publik kompetent në lëmin e çështjeve gjyqësore nuk merr aktvendim mbi shlyerjen e dënimit, personi i dënuar mund të kërkojë të konstatohet se shlyerja e dënimit është bërë në bazë të ligjit.
2. Kur organi publik kompetent në lëmin e çështjeve gjyqësore nuk merr aktvendim sipas kërkesës së të dënuarit brenda tridhjetë (30) ditëve nga dita e marrjes së kërkesës, i dënuari mund të kërkojë që gjykata e cila në shkallë të parë ka marrë aktgjykimin të merr aktvendim për shlyerje të dënimit.
3. Për këtë kërkesë vendos gjykata pasi të dëgjojë mendimin e prokurorit të shtetit kur procedura është filluar me kërkesë të tij.

Neni 522
Shlyerja e dënimeve alternative

Kur dënimi alternativ nuk revokohet pas një (1) viti nga dita e pushimit të kohës së verifikimit, gjykata e cila ka gjykuar në shkallë të parë merr aktvendim me të cilin e shlyen dënimin. Ky aktvendim i dërgohet të dënuarit dhe prokurorit të shtetit kur procedura është filluar me kërkesë të tij, si dhe organit publik kompetent në lëmin e çështjeve gjyqësore.

Neni 523
Procedura për shlyerjen e dënimit në bazë të vendimit gjyqësor

1. Procedura për shlyerjen e dënimit në bazë të vendimit gjyqësor nga neni 104 i Kodit Penal fillohet me kërkesë të të dënuarit.

2. Kërkesa i paraqitet gjykatës e cila ka vendosur në shkallë të parë.
3. Gjyqtarit të cilit i caktohet çështja, së pari konstaton nëse ka kaluar afati i paraparë i nevojshëm ligjor, pastaj bën gjurmime të nevojshme, vërteton faktet të cilat i pohon kërkuesi dhe mbledh prova për të gjitha rrethanat e rëndësishme për vendim.
4. Gjykata për sjelljet e kërkuesit mund të kërkojë raport nga policia në territorin e të cilit ai ka banuar pas mbajtjes së dënimit, ndërsa raport të tillë mund ta kërkojë edhe nga administrata e institucionit ku i dënuari ka mbajtur dënimin.
5. Pas kryerjes së gjurmimeve dhe pas dëgjimit të prokurorit të shtetit, kur procedura zbatohet sipas kërkesës së tij, gjyqtari ia dërgon lëndën me propozim të arsyetuar kolegjit të gjykatës e cila e ka gjykuar çështjen në shkallë të parë.
6. Kërkuesi ose prokurori i shtetit mund të ushtrojë ankesë ndaj vendimit të gjykatës për shlyerjen e dënimit.
7. Kur gjykata refuzon kërkesën për shkak se i dënuari me sjelljen e tij nuk e ka arsyetuar shlyerjen e dënimit, i dënuari përsëri mund të paraqesë kërkesë pasi të kalojnë dy (2) vite nga dita kur aktvendimi mbi refuzimin e kërkesës ka marrë formën e prerë.

Neni 524
Efekti i shlyerjes nga evidenca e dënimeve

Dënimi i shlyer nuk shënohet në certifikatën e lëshuar të bazuar në evidencën e dënimeve për realizimin e të drejtave të individëve.

KAPITULLI XXXVI
PROCEDURA PËR KOMPENSIM DËMI, REHABILITIM DHE PËR USHTRIMIN E TË DREJTAVE TË TJERA TË PERSONAVE TË DËNUAR OSE TË ARRESTUAR PA ARSYE

1. Procedura për kompensimin e dëmit të personave të dënuar ose arrestuar pa arsye

Neni 525
Personat të cilët kanë të drejtë kompensimi për gjykim të paarsyeshëm

1. Të drejtë në kompensim dëmi për dënim të paarsyeshëm ka personi kundër të cilit është shqiptuar sanksioni penal në formë të prerë ose që është shpallur fajtor dhe është liruar nga dënimi por që më vonë, sipas mjetit të jashtëzakonshëm juridik, procedura e rishikuar është pushuar në formë të prerë ose me aktgjykim të formës së prerë është liruar nga akuza ose akuza është refuzuar, përveç në këto raste:
   1.1. kur pushimi i procedurës ose aktgjykimi me të cilin akuza është refuzuar ka ndodhur për arsye se në procedurën e re i dëmtuari është tërhequr nga propozimi si rezultat i marrëveshjes me të pandehurin; ose
   1.2. kur në procedurën e rishikimit me aktvendim është refuzuar akuza për shkak të moskomptencës së gjykatës, e paditësi i autorizuar e ka ndërmarrë ndjekjen në gjykatën kompetente.
2. I dënuari nuk ka të drejtë në kompensim dëmi në qoftë se me pohimin e tij të rremë

ose në mënyrë tjetër ka shkaktuar me qëllim dënimin e tij, përveç kur për këtë ka qenë i detyruar.
3. Në rast të dënimit për vepra penale në bashkim, e drejta në kompensim dëmi ekziston për veprën penale për të cilën plotësohen kushtet për njohjen e kompensimit.

Neni 526
Kërkesa për kompensim nga organi administrativ dhe parashkrimi i saj

1. E drejta për kompensim dëmi parashkruhet tri (3) vjet pas formës së prerë të aktgjykimit të shkallës së parë me të cilin i akuzuar është liruar nga akuza ose me të cilin është refuzuar akuza, apo nga forma e prerë e aktvendimit me të cilin hudhet aktakuza ose pushohet procedura. Kur për ankesë vendos gjykata më e lartë, e drejta për kompensim parashkruhet pas tri (3) vitesh nga dita e marrjes së vendimit nga gjykata e tillë.
2. Para se të paraqesë padinë në gjykatë për kompensim dëmi, i dëmtuari kërkesën e tij ia drejton organit publik kompetent në lëmin e çështjeve gjyqësore për arritjen e marrëveshjes për ekzistimin e dëmit, llojin dhe lartësinë e kompensimit.
3. Në rastin nga paragrafi 1. nën-paragrafi 1.2. neni 525 i këtij Kodi, kërkesa mund të vendoset vetëm kur paditësi i autorizuar nuk e ka ndërmarrë ndjekjen në gjykatën kompetente brenda tre (3) muajve nga dita e marrjes së aktvendimit të formës së prerë. Nëse pas kalimit të këtij afati paditësi i autorizuar ndërmerr ndjekjen në gjykatën kompetente, procedura për kompensim dëmi pezullohet derisa të përfundojë procedura penale.

Neni 527
Padia për kompensim

1. Kur kërkesa për kompensim dëmi nuk miratohet ose organi publik kompetent në lëmin e çështjeve gjyqësore dhe i dëmtuari nuk arrijnë marrëveshje brenda tre (3) muajsh nga dita e paraqitjes së kërkesës, i dëmtuari mund të paraqesë padinë për kompensim dëmi në gjykatën kompetente. Nëse arrihet marrëveshje vetëm për një pjese të kërkesës, i dëmtuari mund të paraqesë padi për pjesën tjetër të kërkesës.
2. Derisa zgjat procedura nga paragrafi 1. këtij neni nuk ec afati i parashkrimit nga neni 526, paragrafi 1. i këtij Kodi.
3. Padia për kompensim dëmi paraqitet kundër organit publik kompetent në lëmin e çështjeve gjyqësore.

Neni 528
Kompensimi pas vdekjes së të dëmtuarit

1. Trashëgimtarët trashëgojnë të drejtën e personit të dëmtuar vetëm për kompensim dëmi material. Nëse i dëmtuari ka paraqitur kërkesë, trashëgimtarët mund të vazhdojnë procedurën vetëm në kufijtë e kërkesës së paraqitur për kompensimin e dëmit material.
2. Pas vdekjes së të dëmtuarit, trashëgimtarët e tij mund ta vazhdojnë procedurën për

kompensim dëmi apo ta fillojnë procedurën nëse personi i dëmtuar ka vdekur para kalimit të afatit të parashkrimit dhe nëse nuk ka hequr dorë nga kërkesa për kompensim.

Neni 529
Personat që kanë të drejtë në kompensim për heqje lirie pa bazë

1. E drejta në kompensim dëmi i takon gjithashtu:
   1.1. personit i cili është mbajtur në paraburgim e kundër tij nuk është filluar procedurë penale ose procedura është pushuar me aktvendim të formës së prerë ose ai me aktgjykim të formës së prerë është liruar nga akuza apo akuza është refuzuar;
   1.2. personit i cili ka mbajtur dënimin me heqje të lirisë dhe me rastin e rishikimit të procedurës penale ose kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë i është shqiptuar dënim me burgim më të shkurtër nga dënimi të cilin e ka mbajtur, apo i është shqiptuar saksion penal pa heqje të lirisë ose është deklaruar fajtor dhe është liruar nga dënimi;
   1.3. personit i cili për shkak të gabimit ose veprimit të paligjshëm të një organi është arrestuar pa arsye ose është mbajtur një kohë në paraburgim apo në një institucion korrektues për mbajtjen e dënimit ose masës së shqiptuar; dhe
   1.4. personit i cili në paraburgim ka kaluar kohë më të gjatë se sa dënimi me burgim për të cilin është gjykuar.
2. Personi i cili sipas nenit 163 të këtij Kodi është arrestuar pa bazë ligjore, i takon e drejta në kompensim dëmi në qoftë se kundër tij nuk është caktuar paraburgimi ose nëse koha e arrestit nuk i është llogaritur në dënimin e shqiptuar për vepër penale ose kundërvajtje.
3. Kompensim dëmi nuk i takon personit i cili me veprimet e tij të palejueshme ka shkaktuar arrestimin. Në rastet nga paragrafi 1. nën-paragrafët 1.1 dhe 1.2. të këtij neni përjashtohet e drejta në kompensim dëmi kur ekzistojnë rrethanat nga neni 525, paragrafi 1, nën-paragrafët 1.1. dhe 1.2. të këtij Kodi.
4. Në procedurën për kompensimin e dëmit në rastet e parapara në paragrafët 1. dhe 2. të këtij neni, dispozitat e këtij kapitulli zbatohen përshtatshmërisht.

2. Rehabilitimi

Neni 530
Shpallja në media e komunikatës nga e cila shihet se gjykimi i mëparshëm ka qenë i pabazë

1. Kur rasti i dënimit të paarsyeshëm ose i arrestimit të pabazë të ndonjë personi është paraqitur në mjetet publike të informimit dhe me këtë është cenuar reputacioni i personit, gjykata, me kërkesën e tij, shpall njoftimin në gazetë ose në mjetin tjetër të informimit publik për vendimin nga i cili shihet qartë se dënimi ishte i paarsyeshëm ose arrestimi i pabazë. Kur rasti nuk është paraqitur në mjetet e informimit publik, me kërkesën e personit, njoftimi i tillë i dërgohet punëdhënësit të tij. Pas vdekjes së personit të dënuar, e drejta për paraqitjen e kësaj kërkese i takon bashkëshortit të tij apo bashkëshortit jashtëmartesor, fëmijëve, prindërve, vëllezërve dhe motrave të tij.

2. Kërkesa nga paragrafi 1. i këtij neni mund të paraqitet edhe kur nuk është bërë kërkesë për kompensim dëmi.
3. Pavarësisht nga kushtet e parapara në nenin 525 të këtij Kodi, kërkesa nga paragrafi 1. i këtij neni mund të paraqitet edhe kur me mjetin e jashtëzakonshëm juridik ndryshohet cilësimi juridik i veprës, kur për shkak të cilësimit juridik në aktgjykimin e mëparshëm është cenuar rëndë reputacioni i personit të dënuar.
4. Kërkesa nga paragrafët 1., 2. ose 3. të këtij neni i paraqitet brenda gjashtë (6) muajsh sipas nenit 526 paragrafi 1. i këtij Kodi, në gjykatën e cila në procedurën penale ka gjykuar në shkallë të parë. Për kërkesë vendos kolegji shqyrtues i Gjykatës së Apelit. Me rastin e vendosjes për kërkesë zbatohen përshtatshmërisht dispozitat e nenit 525, paragrafët 2. dhe 3. dhe neni 529, paragrafi 3. i këtij Kodi.

Neni 531
Aktvendimi për anulimin e dënimit të paarsyeshëm

Gjykata e cila ka gjykuar në procedurë penale në shkallë të parë, sipas detyrës zyrtare merr aktvendim me të cilin e anulon regjistrimin e dënimit të paarsyeshëm në evidencën e dënimeve. Aktvendimi i dërgohet organit publik kompetent në lëmin e çështjeve gjyqësore. Të dhënat nga vendimi i anuluar nuk i komunikohen askujt.

Neni 532
Kufizimet me rastin e shikimit dhe të kopjimit të shkresave

Personi i autorizuar për shikim dhe kopjim të shkresave lidhur me dënimin e paarsyeshëm ose arrestimin e pabazë të personit nuk mund t'i përdorë këto shënime në mënyrë të dëmshme për rehabilitimin e personit kundër të cilit është zbatuar procedura penale. Kryetari i gjykatës detyrohet që për këtë të paralajmërojë personin të cilit i lejohet shikimi dhe kjo shënohet në shkresë me nënshkrimin e atij personi.

3. Procedura për realizimin e të drejtave tjera

Neni 533
Realizimi i të drejtave tjera

1. Personit të cilit për shkak të dënimit të paarsyeshëm ose arrestimit të pabazë i ka pushuar marrëdhënia e punës ose sigurimi social sipas sistemit të mirëqenies sociale, ka të drejtë të përfitojë kohën e humbur të papunësisë dhe të sigurimit duke ia llogaritur kohën e humbur të papunësisë sikur të ishte i punësuar gjatë dënimit ose arrestimit të pabazë. Në stazh llogaritet edhe koha që ka qenë pa punë për shkak të dënimit të paarsyeshëm ose arrestimit të pabazë, nëse humbja e vendit të punës nuk është shkaktuar me fajin e atij personi.
2. Me rastin e çdo vendosjeje për të drejtën në të cilën ndikon gjatësia e stazhit të punës apo stazhit të sigurimit social, organi kompetent merr parasysh stazhin e njohur nga paragrafi 1. i këtij neni.
3. Kur organi kompetent nga paragrafi 2. i këtij neni nuk e merr parasysh stazhin e njohur nga paragrafi 1 i këtij neni, i dëmtuari mund të kërkojë që gjykata nga neni

527, paragrafi 1. i këtij Kodi të konfirmojë njohjen e asaj kohe sipas ligjit. Padia paraqitet kundër organit kompetent i cili refuzon të pranojë stazhin e pranuar dhe kundër organit publik kompetent në lëmin e çështjeve gjyqësore.
4. Me kërkesë të organit në të cilin realizohet e drejta nga paragrafi 2. i këtij neni, kontributi i caktuar për kohën e pranuar nga paragrafi 1. i këtij neni paguhet nga mjetet buxhetore.
5. Stazhi i sigurimit social i pranuar me paragrafin 1. të këtij neni në tërësi llogaritet në stazhin pensional.

KAPITULLI XXXVII
PROCEDURA PËR DHËNIEN E LETËRRESHTIMIT DHE SHPALLJEVE PUBLIKE

Neni 534
Kërkimi i adresës së të pandehurit

Kur nuk dihet vendbanimi i përhershëm apo i përkohshëm i të pandehurit, kurse me dispozitat e këtij Kodi kjo është e nevojshme, gjykata kërkon nga policia që i pandehuri të kërkohet dhe që gjykata të njoftohet për adresën e tij.

Neni 535
Kushtet për dhënien e letërrreshtimit

1. Letërreshtimi mund të urdhërohet kur i pandehuri gjendet në arrati, e kundër të cilit është filluar procedura penale për vepër penale e cila ndiqet sipas detyrës zyrtare dhe për të cilën vepër mund të shqiptohet sipas ligjit dënim me të paktën dy (2) vjet burgim dhe kur është lëshuar urdhërarrest ose aktvendim për caktimin e paraburgimit.
2. Letërreshtimi urdhërohet nga gjykata e cila e zbaton procedurën penale. Në procedurë paraprake lëshimi i letërreshtimit urdhërohet nga gjyqtari i procedurës paraprake me propozim të prokurorit të shtetit.
3. Letërreshtimi urdhërohet edhe në rastet kur i pandehuri është arratisur nga institucioni ku mban dënimin, pavarësisht nga lartësia e dënimit, ose kur është arratisur nga institucioni ku mban masën e trajtimit të detyrueshëm që konsiston me heqje lirie. Në këtë rast, urdhrin e lëshon drejtori i institucionit.
4. Letërrreshtimi ndërkombëtar mund të kërkohet në cilëndo nga situatat e parapara sipas këtij neni, nga ana e autoritetit përkatës kur personi i kërkuar nuk gjendet në Kosovë ose ka prova se personi banon jashtë Kosovës.
5. Kërkesa e gjykatës ose e drejtorit të institucionit për lëshimin e letërrreshtimit ndërkombëtar duhet të dërgohet tek autoritetet kompetente për lëshimin dhe shpërndarjen e tyre.
6. Urdhri i gjykatës ose i drejtorit të institucionit për lëshimin e letërreshtimin i dërgohet policisë për ekzekutim.
7. Policia mban evidencë mbi letërreshtimet e lëshuara. Të dhënat për personat ndaj të cilëve është lëshuar letërreshtim fshihen nga evidenca posa organi kompetent e revokon letërreshtimin.

Neni 536
Shpalljet Publike

1. Nëse janë të nevojshme informatat për sendet e caktuara lidhur me veprën penale ose këto sende duhet të gjenden, sidomos nëse janë të nevojshme për identifikimin e kufomës së paidentifikuar, organi kompetent i cili e zbaton procedurën, urdhëron shpalljen me të cilën kërkon që informatat dhe njoftimet t'i dërgohen organit kompetent që e zbaton procedurën.
2. Policia mund të publikojë fotografitë e kufomave dhe të personave të zhdukur kur ekzistojnë arsye për dyshim se vdekja apo zhdukja e këtyre personave është shkaktuar me vepër penale

Neni 537
Tërheqja e letërrreshtimit ose e shpalljes publike

1. Organi i cili ka urdhëruar letërreshtimin, letërrreshtimin ndërkombëtar ose shpalljen e tërheq atë posa të gjendet personi ose sendi i kërkuar, kur kalon afati i parashkrimit për ndjekje penale ose i ekzekutimit të dënimit, ose kur paraqiten shkaqe të tjera për të cilat letërreshtimi ose shpallja më nuk janë të nevojshme.
2. Urdhri për tërheqjen e letërrreshtimit, letërrreshtimit ndërkombëtar ose shpalljes duhet të i dërgohet autoritetit kompetent i cili duhet të siguroj anulimin e menjëhershëm të tyre.

Neni 538
Shpallja e letërrreshtimit ose kërkesës për informata nga publiku

1. Letërreshtimin dhe shpalljen publike e shpallë organi publik kompetent për punë të brendshme.
2. Për njoftimin e publikut me letërreshtim ose shpallje mund të shfrytëzohen edhe mjetet e informimit publik.
3. Organi kompetent mund të shpallë edhe letërreshtim ndërkombëtar përmes kanaleve ndërkombëtare.
4. Me lutjen e organit të jashtëm, organi kompetent për punë të brendshme mund të lëshojë letërreshtim për personin për të cilin dyshohet se gjendet në Kosovë, me kusht që në lutje të shënohet se në rast se gjendet ky person do të kërkohet ekstradimi i tij.
5. Dispozitat e këtij neni zbatohen përshtatshmërisht edhe në rastet kur policia shpall kërkimin e personave ose sendeve.

PJESA E GJASHTË
DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

KAPITULLI XXXVIII
DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 539
Kodi në fuqi për procedurat penale të filluara pas hyrjes në fuqi të këtij Kodi

Çdo procedurë penale e filluar pas hyrjes në fuqi të këtij Kodi duhet të jetë në pajtim me kushtet e përcaktuara në këtë Kod.

Neni 540
Zbatimi i këtij kodi për procedura penale të filluara para hyrjes së tij në fuqi

Dispozitat e këtij Kodi zbatohen përshtatshmërisht për çdo procedurë penale të filluar para hyrjes në fuqi të këtij Kodi në të cilën nuk është ngritur aktakuzë.

Neni 541
Aktakuzat apo propozimakuzat e paraqitura para hyrjes në fuqi të këtij Kodi

1. Procedurat penale në të cilat është ngritur aktakuza por nuk është konfirmuar para hyrjes në fuqi të këtij kodi, nuk do të konfirmohen sipas dispozitave të Kodit që ka qenë në fuqi në kohën e ngritjes së aktakuzës, por do të procedohen sipas dispozitave të këtij kodi.
2. Procedurat penale në të cilat aktakuza është konfirmuar me aktvendim të formës së prerë, para hyrjes në fuqi të këtij kodi, dhe procedurat në të cilat është ngritur propozim akuza, do të përfundohen në bazë të dispozitave të këtij kodi.

Neni 542
Zbatimi i afateve

Nëse me hyrjen në fuqi të këtij Kodi është duke ecur ndonjë afat, afati i tillë llogaritet në pajtim me dispozitat e këtij Kodi, përveç nëse afati i mëparshëm ka qenë më i gjatë ose dispozitat e këtij kapitulli parashohin ndryshe.

Neni 543
Vazhdimi i padisë private

1. Për veprat penale për të cilat kryerësi ndiqet me padi private ose padi subsidiare, procedura e tillë vazhdon në kuadër të departamentit të përgjithshëm të gjykatës themelore përkatëse.
2. Në procedurën penale nga paragrafi 1. të këtij neni ndjekja zbatohet përshtatshmërisht sipas dispozitave të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës

Neni 544
Ligji i zbatueshëm në rishqyrtim

Nëse pas hyrjes në fuqi të këtij Kodi paraqitet ankesë ose me mjet të jashtëzakonshëm juridik anulohet aktgjykimi, shqyrtimi gjyqësor zbatohet përshtatshmërisht sipas dispozitave të kodit të mëparshëm.

Neni 545
Zbatueshmëria e dispozitave kalimtare

1. Vendimi nëse duhet zbatuar këtë Kod të procedurës penale bazohet në datën e ngritjes së aktakuzës. Veprat të cilat janë kryer para hyrjes në fuqi të këtij Kodi i nënshtrohen këtij Kodi nëse procedura penale për hetimin apo ndjekjen e asaj vepre është filluar pas hyrjes në fuqi të këtij Kodi.
2. Me hyrjen në fuqi të këtij Kodi pushojnë të zbatohen dispozitat e Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, përpos rasteve të parapara në këtë Kapitull.

Neni 546
Zbatimi i këtij Kodi

Këshilli Gjyqësor i Kosovës, Këshilli Prokurorial i Kosovës dhe Ministria e Drejtësisë mund të nxjerrin rregullore administrative në fushat në kuadër të kompetencave të tyre për zbatimin e këtij Kodi

Neni 547
Hyrja në fuqi

Ky Kod hyn në fuqi me 1 Janar 2013.

Kodi Nr. 04/ L-123
13 dhjetor 2012

Shpallur me dekretin Nr.DL-057-2012, datë 21.12.2012 nga Presidentja e Republikës së Kosovës Atifete Jahjaga.

GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS / Nr. 37 / 28 DHJETOR 2012, PRISHTINË

LIGJI Nr. 03/L-196
PËR PARANDALIMIN E SHPËRLARJES SË PARAVE DHE FINANCIMIT TË TERRORIZMIT

Përmbajtja

Kreu I: Dispozitat e përgjithshme 493
Kreu II: Njësia për inteligjencë financiare 498
Kreu III: Subjektet raportuese 504
Kreu IV: Sanksionet dhe kundërvajtjet 522
Kreu V: Bashkëpunimi ndërkombëtar 525
Kreu VI: Sekreti profesional 526
Kreu VII: Dispozitat përfundimtare 526
Kreu VIII: Dispozitat kalimtare 526

Kuvendi i Republikës së Kosovës;

Në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton:

LIGJ PËR PARANDALIMIN E SHPËRLARJES SË PARAVE DHE FINANCIMIT TË TERRORIZMIT

KREU I
DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

1. Ky ligj përcakton masat, autoritetet kompetente dhe procedurat për zbulimin dhe parandalimin e shpërlarjes së parave dhe financimit të terrorizmit.
2. Për të luftuar shpërlarjen e parave dhe financimin e terrorizmit në Kosovë në mënyrë efektive, ky ligj themelon edhe NJIF-K-në.

Neni 2
Përkufizimet

1. Shprehjet e përdorura në këtë ligj kanë këtë kuptim:
   1.1. **Bankë** - një subjekt i përkufizuar si bankë sipas Ligjit për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës.
   1.2. **Mbajtës i të drejtës së pronësisë -** personi fizik i cili kryesisht zotëron ose kontrollon një klient ose llogari, personi në emër të të cilit kryhet një

transaksion ose personi i cili kryesisht ushtron kontroll efektiv mbi një person juridik ose marrëveshje ligjore.

1.3. **Organizatë afariste -** ka kuptimin e përkufizuar në nenin 2 të Ligjit për Shoqëritë Tregtare (Nr.02/L-123).

1.4. **Marrëdhënie afariste -** marrëdhënie profesionale ose komerciale e cila është e lidhur me aktivitetet profesionale të një subjekti raportues dhe nga e cila pritet të ketë një element kohëzgjatjeje që nga momenti kur lidhet kontrata.

1.5. **Rregullorja e BPK-së -** Rregullorja nr.1999/20 e UNMIK-ut me datë 15 nëntor 1999, me ndryshimet e bëra nga Autoriteti Bankar dhe i Pagesave i Kosovës.

1.6. **Kazino -** lokal i destinuar për organizim të lojërave të veçanta të fatit, të cilat organizohen në tavolinat për lojë me topëza, kubëza ose letra.

1.7. **BQK -** Banka Qendrore e Republikës së Kosovës.

1.8. **Kontabilist i certifikuar** - një kontabilist i certifikuar nga një shoqatë profesionale kontabiliteti sipas nenit 6 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/30 të datës 29 tetor 2001 për themelimin e Bordit Kosovar për Raportime Financiare dhe një Regjimi për Raportimin Financiar të Organizatave Buxhetore.

1.9. **Klient** - një person ose subjekt i cili kryen një transaksion me, ose shfrytëzon shërbimet e një banke, të një institucioni financiar, të një avokati, të një kontabilisti të certifikuar, të një auditori të licencuar, ose të një këshilltari tatimor. Termi klient përfshin çdo pronar, përfitues, person ose subjekt tjetër në emër të të cilit kryhet transaksioni apo pranohen shërbimet.

1.10. **Profesionist në fjalë** - avokatët, noterët, kontabilistët e certifikuar dhe auditorët e licencuar ose këshilltarët tatimor.

1.11. **Valuta -** mjet këmbimi në formë të monedhës ose kartëmonedhës, e cila qarkullon si mjet këmbimi.

1.12. **Subjekt -** një subjekt fizik ose juridik që ekziston në një formë që njihet ligjërisht, duke përfshirë, por pa u kufizuar në një: organizatë afariste, OJQ, parti politike, trust, ndërmarrje shoqërore dhe ndërmarrje publike.

1.13. **TFVF -** Task-Forca e Veprimit Financiar e cila nënkupton njësinë për parandalimin e pastrimit të parasë.

1.14. **NJIF-K** - Njësia për Inteligjencë Financiare e Republikës së Kosovës, e themeluar sipas nenit 4 të këtij ligji.

1.15. **Institucion financiar -** personi ose subjekti që drejton një ose më shumë aktivitete për ose në emër të një klienti duke përfshirë aktivitetet si më poshtë:

1.15.1. huadhënien, duke përfshirë por pa u kufizuar në kredinë për konsumatorë; kredinë për hipotekë; faktorizimin (biznesi i blerjes së çeqeve, obligacioneve etj.) me ose pa të drejtë tërheqjeje; dhe financimin e transaksioneve komerciale duke përfshirë edhe humbjen;

1.15.2. qiradhënien financiare, përveç marrëveshjeve për qiradhënie financiare që kanë lidhje me produktet për konsum;

1.15.3. dërgimin e parasë ose të instrumenteve monetare në çdo mënyrë, duke përfshirë edhe sistemin e dërgimit të parave në mënyrë

jozyrtare ose me anë të rrjetit të personave a subjekteve të cilët mundësojnë dërgimin e parave jashtë sistemit tradicional të institucioneve financiare;

1.15.4. këmbimin e parave dhe monedhave;

1.15.5. lëshimin dhe menaxhimin e mënyrave të pagesës, duke përfshirë, por jo të kufizuar në kartelat debitore dhe kreditore, çeqet, çeqet e udhëtarëve, urdhërpagesat, çeqet e bankierëve ose paratë elektronike;

1.15.6. dhënien e garancive financiare dhe zotimeve;

1.15.7. tregtimin në emër të personave ose subjekteve të tjera në një ose më shumë nga sa vijon:

1.15.7.1. instrumentet e tregut të parasë, çeqet, bankënotat, certifikatat e depozitave, produktet e prejardhura (që vijnë nga një veprimtari tjetër etj);

1.15.7.2. këmbimin a valutës së jashtme;

1.15.7.3. këmbimin, shkallën e interesit dhe instrumentet e indeksit;

1.15.7.4. letrat me vlerë të transferueshme, dhe

1.15.7.5. tregtimin e mallrave me transaksione të afatizuara.

1.15.8. menaxhimin e portofolit individual dhe kolektiv;

1.15.9. pjesëmarrjen në emetimin e letrave me vlerë dhe sigurimin e shërbimeve financiare lidhur me këto emetime;

1.15.10. ruajtjen dhe administrimin e parave të gatshme ose letrave me vlerë likuide në emër të personave të tjerë;

1.15.11. në të kundërt, investimin, administrimin ose menaxhimin e fondeve apo parave në emër të personave ose subjekteve të tjera;

1.15.12. të vepruarit si kompani e sigurimeve, sigurimeve të jetës ose si ndërmjetës i sigurimeve të jetës, siç është përkufizuar në nenin 1 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/25 të datës 5 tetor 2001, për licencimin, mbikëqyrjen dhe rregullimin e kompanive e ndërmjetësve të sigurimit;

1.15.13. të vepruarit si garantues siç është përkufizuar në nenin 1 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/35 të datës 22 dhjetor 2001, mbi pensionet në Kosovë.

1.16. **Ngrirja -** ndalimi i transferit, konvertimit, vendosjes ose lëvizjes së fondeve ose ndonjë prone tjetër mbi bazat e, dhe për kohëzgjatjen e vlefshmërisë së një vendimi të një gjyqi ose autoriteti tjetër kompetent. Fondet ose pronat e tjera të ngrira do të mbeten pronë e personave ose subjekteve që kishin interes në fondet ose pronat e tjera të veçanta në kohën kur u bë ngrirja dhe mund të vazhdojnë të administrohen nga institucioni financiar.

1.17. **Objekt i licencuar për lojërat e fatit -** çdo objekt ku organizohen lojërat e fatit, ku mund të përfshihen, por jo të kufizohen në të, çdo aneks hotelier dhe ambientet e tij shoqëruese, pikat e shitjes me pakicë, depo ose çdo formë tjetër shtesë e pronës afariste që menaxhohet ose është pronë e kompanisë së licencuar për lojërat e fatit dhe është pjesë e funksionimit të përgjithshëm. Ky term përfshin gjithashtu edhe subjektet ku bëhen bastet sportive.

1.18. **Pasuri e paluajtshme -** toka, ndërtesat dhe banesat.

1.19. **E drejta në pasuri të paluajtshme -** e drejta që lidhet me pasurinë e paluajtshme, duke përfshirë edhe pronësinë, hipotekën, servitutet dhe të drejtat për shfrytëzimin e pasurisë shoqërore, publike dhe shtetërore.

1.20. **Avokat -** çdo person që është i regjistruar në regjistrin e avokatëve në pajtim me Ligjin për Avokatinë (03/L-117).

1.21. **Auditor i licencuar -** një person i licencuar si auditor në pajtim me nenin 1 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/30 të datës 29 tetor 2001, për themelimin e Bordit Kosovar për Raportime Financiare dhe një Regjimi për Raportimin Financiar të Organizatave Buxhetore.

1.22. **Instrument monetar -** monedha, çeqet për udhëtim, çeqet personale, çeqet e bankave, urdhërpagesat, mandapostat, çeqet e bankave me firmën e arkëtarit të çdo lloji dhe letrat me vlerë për investime ose instrumentet e transferueshme në formë të bartësit ose në formë tjetër të atillë që titulli t'i kalohet me rastin e dërgimit.

1.23. **Shpërlarje e parasë** - çdo veprim me synim maskimin e origjinës së parave ose prone tjetër, të fituara nga ndonjë vepër penale, ku përfshihet:

1.23.1. konvertimi ose çdo transfer i parave që rrjedhin nga aktiviteti kriminal;

1.23.2. fshehja ose maskimi i natyrës, origjinës, vendit, lëvizjes, rregullimit, të drejtave, ose pronësisë në lidhje me paratë ose pronë tjetër të fituar nga aktivitet kriminale.

1.24. **Noter -** sipas nenit 2.2 të Ligjit nr. 03/L-10 për noterinë, do të thotë një avokat profesionist, zyrtar publik, i caktuar nga Ministria e Drejtësisë për të kryer aktivitet e përcaktuar me ligj.

1.25. **Organizatë jo qeveritare -** (ose "**OJQ**") sipas nenit 2 të Ligjit nr. 03/L-134 për lirinë e asociimit në organizatat ndërkombëtare, do të thotë çdo shoqatë ose fondacion vendor siç përkufizohet në nenin 5 të këtij ligji ose çdo organizatë ndërkombëtare ose e huaj siç përcaktohet në nenin 7 të këtij ligji.

1.26. **Person politikisht i ekspozuar -** çdo person i cili ka ose ka pasur funksion publik të spikatur në çdo vend si dhe anëtarët e familjes të këtij personi ose ata që kanë lidhje të ngushta me këtë person.

1.27. **Policia -** Policia e Kosovës sipas nenit 3 të Ligjit nr. 03/L-035 për policinë.

1.28. **Vepër e ndërlidhur penale -** çdo vepër penale e cila gjeneron të ardhura nga vepra penale.

1.29. **Të ardhurat nga vepra penale -** çdo pasuri e përfituar në mënyrë direkte apo indirekte nga vepra e ndërlidhur penale. Pasuria e fituar në mënyrë indirekte nga vepra e ndërlidhur penale përfshin pasurinë në të cilën më vonë është konvertuar, transformuar ose ngatërruar çdo pasuri e përfituar në mënyrë direkte nga vepra e ndërlidhur penale si dhe të ardhurat, kapitali apo përfitimet tjera ekonomike të realizuara nga pasuria e tillë në çfarëdo kohe të kryerjes së veprës penale.

1.30. **Pronë ose mjete financiare –** çfarëdo lloj pasurie, materiale ose jo materiale, të luajtshme ose të paluajtshme dhe dokumente ose instrumente ligjore të çdo lloji, duke përfshirë ato elektronike ose dixhitale, të cilat dëshmojnë të drejtën ose interesin në një pasuri të tillë, duke përfshirë, por jo

kufizuar në kreditë bankare, çeqet e udhëtarëve, mandapostat, aksionet, letrat me vlerë, çeqet dhe letrat akreditive si dhe çdo interes, dividendë ose të hyra të tjera ose vlera të cilat shtohen ose rrjedhin nga një pasuri e tillë.

1.31. **Institucione fetare -** të gjitha fetë dhe komunitetet e tyre në Kosovë në pajtim me nenin 5.4 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/48, për Shpalljen e Lirisë Fetare në Kosovë të miratuar nga Kuvendi i Kosovës.

1.32. **Subjekt raportues -** një person ose subjekt nga i cili kërkohet që t'i raportoj NJIF-K-së ashtu siç përcaktohet në nenin 16 të këtij ligji.

1.33. **Konfiskim -** ndalimi i transferit, konvertimit, vendosjes ose lëvizjes së fondeve ose ndonjë prone tjetër mbi bazat e, dhe për kohëzgjatjen e vlefshmërisë së një vendimi të një gjyqi ose autoriteti tjetër kompetent. Fondet ose pronat e tjera të konfiskuara do të mbeten pronë e personave ose subjekteve që kishin interes në fondet ose pronat e tjera të veçanta në kohën kur u bë konfiskimi, por do të vazhdojnë të administrohen nga autoriteti kompetent.

1.34. **Banka guaskë** - një bankë, ose një institucion i angazhuar me aktivitete ekuivalente i themeluar në një shtet ku nuk ka prezencë fizike, e cila bën të mundur menaxhimin dhe drejtimin pa u shoqëruar me ndonjë grup financiar të rregulluar.

1.35. **Veprim ose transaksion i dyshimtë -** veprim ose transaksion nga i cili buron dyshimi i arsyeshëm se pasuria e përfshirë në veprim ose transaksion është pasuri e fituar me vepër penale dhe do të interpretohet në pajtueshmëri me udhëzimin e lëshuar nga NJIF-K-ja për veprimet ose transaksionet e dyshimta.

1.36. **Financimi i terrorizmit -** sigurimi ose grumbullimi i mjeteve financiare në çfarëdo lloj mënyre, direkte ose indirekte, me synimin për tu përdorur ose me paramendimin që do të përdoren, plotësisht ose pjesërisht, për të kryer një nga krimet e dhëna sipas neneve 112 dhe 113 të Kodit Penal të Kosovës dhe përkufizimeve specifike të ofruara nga TFVF në Rekomandimet e Veçanta II.

1.37. **E pagueshme përmes** - llogaritë korresponduese të përdorura drejtpërdrejtë nga një palë e tretë për të zhvilluar biznes në emër të tyre.

1.38. **Transferi telegrafik** - transaksionin e kryer në emër të personit iniciues, atij fizik dhe juridik, përmes një institucioni financiar me anë të mjeteve elektronike me qëllim të vënies së një sasie të të hollave në dispozicion të një personi përfitues në një institucion tjetër financiar.

1.39. **Bordi menaxhues -** Bordi i përbërë nga anëtarë të institucioneve të ndryshme të cilët do të mbikëqyrin punën dhe do të sigurojnë pavarësinë e NJIF-K-së.

Neni 3
Prokuroria speciale

Veprat e renditura në nenet 26, 27 dhe 28 të këtij ligji hyjnë në kompetencën ekskluzive të Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës e themeluar me anë të Ligjit nr. 03/L-052 për Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës.

KREU II
NJËSIA PËR INTELIGJENCË FINANCIARE

Neni 4
Statusi i NJIF-K-së

Me qëllim që të luftohet në mënyrë efektive shpërlarja e parave dhe financimi i terrorizmit në Kosovë, ky ligj themelon NJIF-K-në, në kuadër të Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave (MEF), si institucionin qendror të pavarur kombëtar përgjegjës për kërkimin, marrjen, analizimin dhe shpërndarjen tek autoritet kompetente dhe bërjen publike të informacionit në lidhje me shpërlarjen potenciale të parave dhe financimin e terrorizmit.

Neni 5
Bordi Menaxhues

1. Bordi menaxhues "Bordi" i Njësisë për Inteligjencë Financiare themelohet pas shpalljes së këtij ligji nga Kuvendi i Kosovës. Ky bord do të mbikëqyrë dhe sigurojë pavarësinë e NJIF-K-së. Ai nuk ka fuqi ekzekutive ose zbatimi kundrejt NJIF-K-së.
2. Bordi përbëhet nga Ministri i Ekonomisë dhe Financave, i cili do të shërbejë në cilësinë e Kryetarit të Bordit. Anëtarë të tjerë të bordit do të jenë, ex officio, Ministri i Punëve të Brendshme, Kryeprokurori i Kosovës, Drejtori i Përgjithshëm i Policisë, Drejtori i Administratës Tatimore, Drejtori i Përgjithshëm i Doganave të Kosovës, Drejtori Menaxhues i Bankës qendrore të Republikës së Kosovës.
3. Bordi mban takime së paku dy (2) herë në vit.

Neni 6
Detyrat dhe kompetencat e Bordit

1. Bordi është i autorizuar të:
   1.1. rishikojë, miratojë dhe të refuzojë raportet e NJIF-K-së, të përgatitura sipas paragrafit 1. të nenit 10 të këtij ligji. Nëse Bordi e refuzon këtë raport, ai duhet t'i ofrojë Drejtorit të NJIF-K-së një letër me shkrim ku shpjegohen qartë dhe në detaje arsyet për një refuzim të tillë dhe mangësitë që duhet të korrigjohen;
   1.2. vëzhgojë dhe vlerësojë në mënyrë periodike performancën e Drejtorit të NJIF-K-së;
   1.3. emërojë dhe/ose shkarkojë Drejtorin e NJIF-K së;
   1.4. caktojë buxhetin e NJIF-K-së sipas propozimit të Drejtorit të NJIF-K-së;
   1.5. kontrollojë dhe vëzhgojë pasurinë e deklaruar nga Drejtori i NJIF-K-së dhe rastet e konfliktit të interesit në pajtueshmëri me rregullat dhe procedurat e parapara në Ligjin e parandalimit të konfliktit të interesave gjatë ushtrimit të funksioneve publike, Ligjin për deklarimin e pasurive dhe dhuratave të zyrtarëve të lartë publik dhe neneve të tjerë relevant të legjislacionit në Kosovë.

Neni 7
Mos ndërhyrja

Bordi nuk ka të drejtë që të ndërhyjë në asnjë mënyrë në çështjet në proces të NJIF-K-së.

Neni 8
Organizimi i Bordit dhe procedurat vendimmarrëse

1. Kryetari përfaqëson Bordin në publik dhe cakton një zyrtar të MEF-it që të shërbejë si Sekretar i Bordit.
2. Bordi merr vendim me anë të shumicës së votave. Bordi ka kuorumin për të marrë vendim nëse të paktën pesë (5) nga anëtarët e tij marrin pjesë në takimin e caktuar dhe lajmëruar në kohë, në kohën kur merret vendimi.
3. Nëse është e nevojshme që Bordi të takohet pa prezencën e Kryetarit, mbledhjen e kryeson Ministri i Punëve të Brendshme.
4. Bordi përgatit dhe miraton rregullat dhe procedurat e veta.

Neni 9
Kompetencat e Kryetarit

1. Kryetari është përgjegjës që:
   1.1. të kryejë të gjitha funksionet që atij/asaj i janë dhënë me ligj dhe që Bordi i delegon atij/asaj;
   1.2. të kryejë punët e zakonshme të Bordit në pajtueshmëri me vendimet dhe udhëzimet e miratuara në kohë nga Bordi.

Neni 10
Kompetencat dhe përgjegjësitë e Drejtorit të NJIF-K-së kundrejt Bordit

1. Një (1) herë në vit**,** Drejtori i NJIF-K-së i siguron çdo anëtari të Bordit një raport të azhurnuar pesëmbëdhjetë (15) ditë para çdo takimi të Bordit ku përmblidhen:
   1.1. vendimet dhe aktivitetet administrative, ekzekutive dhe rregullatore të NJIF-K-së;
   1.2. të gjitha aspektet e menaxhimit financiar, të hyrat dhe shpenzimet e NJIF-K-së. Nëse shumica e anëtarëve vendos se ka arsye që të besohet se NJIF-K-ja nuk po vepron ose nuk ka vepruar, në pajtueshmëri me këtë ligj ose akte të tjera nënligjore të aplikuara në Kosovë, Bordi i drejtohet Auditorit Gjeneral të Kosovës me lëndën përkatëse për mos-pajtueshmëri dhe i kërkon atij/asaj që të kryejë një auditim i cili do t'i paraqitet Kuvendit të Kosovës;
   1.3. Drejtori i NJIF-K-së nuk është i obliguar që të zbulojë ndonjë informacion i cili mund të rrezikojë anën operacionale të punës së NJIF-K-së.

Neni 11
Drejtori i NJIF-K-së

1. Njësia për Inteligjencë Financiare e Republikës së Kosovës-drejtohet nga një drejtor i cili është përgjegjës për drejtimin dhe menaxhimin e saj.
2. Drejtori i NJIF-K-së cakton një zyrtar të lartë nga kuadrot e NJIF-K-së për ta zëvendësuar atë në rastet kur ai/ajo mungon apo kur drejtori është i paaftë të kryejë detyrat e tij/saj.
3. Drejtori i NJIF-K-së caktohet nga Bordi me propozim të Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave, duke u bazuar në njohuritë, profesionalizmin dhe përvojën e dëshmuar, si dhe:
   3.1. të jetë një person me integritet të lartë morali dhe profesionalizëm;
   3.2. të ketë diplomë universitare në fushë të ngjashme të ekspertizës;
   3.3. të ketë të paktën pesë (5) vjet përvojë të konsiderueshme në profesionin përkatës;
   3.4. të mos:
      3.4.1. ketë pasur një pozitë politike në Qeverinë e Republikës së Kosovës, Kuvendit të Kosovës, autoritet vendore, parti politike, ose sindikatë;
      3.4.2. ketë interes direkt ose indirekt në një "subjekt raportues";
      3.4.3. ketë konflikt interesi në pajtim me Ligjin për konfliktin e interesit.
4. Ministri i Ekonomisë dhe Financave siguron një proces të hapur dhe transparent të zgjedhjes së drejtorit sipas procedurave të përcaktuara në nenin 12 të këtij ligji.
5. Asnjë person nuk mund të bëhet ose të mbetet drejtor nëse ai/ajo shpallet fajtor për një vepër penale e cila është e dënueshme me një vendim për burgim prej gjashtë (6) muajsh ose më shumë.
6. Për qëllime sqarimi, Drejtori i NJIF-K-së është një "Zyrtar" sipas Ligjit për Konfliktin e Interesit.
7. Mandati zgjat tri (3) vjet dhe mund të përsëritet.
8. Gjashtë (6) muaj para përfundimit të mandatit të ushtrimit të detyrës së Drejtorit, Ministria e Ekonomisë dhe Financave fillon procedurën e përzgjedhjes së drejtorit të ri përmes procesit të hapur, publik, të paanshëm dhe transparent të përzgjedhjes dhe intervistimit të kandidatëve duke përfshirë:
   8.1. publikimin e vendit të lirë të punës me detajet e postit, vendndodhjen e tij, përshkrimin e punëve, pagën mujore, kohëzgjatjen e kontratës, përshkrimin e shkurtër të kualifikimeve, aftësive, ekspertizës, dhe vetive personale që kërkohen, si dhe një shpjegim të qartë rreth procedurës së aplikimit dhe përzgjedhjes që duhet të ndiqet;
   8.2. të siguruarit se procedura e përzgjedhjes është e hapur, ofron konkurrencë jo-diskriminuese, e drejtë, objektive dhe transparente duke u bazuar në një grup kualifikimesh dhe aftësish të përcaktuara më parë.

Neni 12
Procedurat e zgjedhjes së Drejtorit të NJIF-K

1. MEF bën përzgjedhjen paraprake të kandidatëve më të përshtatshëm të cilët më së miri i plotësojnë kriteret e përcaktuara me ligj si dhe bën përzgjedhjen e të paktën dy (2) kandidatëve në listë të ngushtë.

2. MEF ia dorëzon Bordit emrat e kandidatëve që kanë hyrë në listën e ngushtë së bashku me një raport ku jepen në detaje kriteret mbi të cilat u bë edhe përzgjedhja paraprake.
3. Bordi cakton Drejtorin e NJIF-K-së në mesin e kandidatëve që kanë hyrë në listën e ngushtë nga MEF-i.

Neni 13
Shkarkimi ose pezullimi i Drejtorit të NJIF-K-së

1. Drejtori i NJIF-K-së mund të shkarkohet me anë të të njëjtit proces përmes së cilit ai ose ajo u caktua.
2. Drejtori i NJIF-K-së mund të shkarkohet:
   2.1. nëse ka kryer vepër penale;
   2.2. si rezultat i humbjes së vazhdueshme të aftësive për të kryer punën e tij/saj për një periudhë më shumë se tre (3) muaj;
   2.3. nëse zbulohet se ai/ajo e ka shfrytëzuar postin në kundërshtim me ligjin ose në një mënyrë të tillë që ka mundur të çojë NJIF-K-në në një diskreditim ligjor ose publik për shkak të shkeljeve serioze profesionale apo sjelljeve personale jo të duhura.
3. Drejtori i NJIF-K-në mund të pezullohet:
   3.1. nëse ai/ajo nuk kërkon miratim paraprak nga Bordi menaxhues para se ti bashkohet një organizate ose grupi; dështimi në raportim mund të jetë gjithashtu një shkak për pezullim të Drejtorit të NJIF-K-së;
   3.2. nëse ai/ajo ka një pozitë tjetër në kohën kur shërben në cilësinë e Drejtorit të NJIF-K-së;
   3.3. nëse ai/ajo është përfshirë në çfarëdo veprimi industrial apo në çfarëdo forme të ndalesës kolektive të punës;
   3.4. nëse ai/ajo, pa pëlqimin paraprak të Bordit Menaxhues, jep deklarata publike apo komenton rreth punës së NJIF-K-së, apo në ndonjë rast u ofron informacione personave të paautorizuar rreth të dhënave, dokumenteve, kontakteve, njohurive ose personelit të NJIF-K-së;
   3.5. nëse ai/ajo përpiqet që të fitojë apo pranojë çdo të ardhur si përfitime në para ose shërbime të jashtëligjshme për veten e tij ose për të tjerët, përveç atyre që ofrohen në këtë ligj;
   3.6. nëse ai/ajo shkel ndonjërën nga dispozitat e këtij neni apo të këtij ligji të cilat po ashtu do të konsiderohen shkak për pezullimin ose ndërprerjen e marrëdhënies së punës sipas këtij ligji.

Neni 14
Detyrat dhe kompetencat e NJIF-K-së

1. NJIF-K-ja është e autorizuar të pranojë dhe procedojë:
   1.1. të marrë dhe analizojë raportet dhe informacionet:
      1.1.1. të bëra dhe të ruajtura sipas neneve 16 deri në 28 të këtij ligji;
      1.1.2. që i janë ofruar NJIF-K-së nga NJIF-të e vendeve të huaja me funksione të ngjashme, nga gjykatat ose nga organet përgjegjëse për zbatimin e

ligjit, duke përfshirë organizatat ndërqeveritare e ndërkombëtare, organet publike ose qeveritare; dhe/ose

1.1.3. që i janë ofruar vullnetarisht NJIF-K-së në lidhje me dyshimet për shpërlarjen e parave ose financimit të aktiviteteve terroriste;

1.2. të grumbullojë informacione që kanë lidhje me shpërlarjen e parave ose financimin e aktiviteteve terroriste dhe që është në dispozicion publik (përfshirë bazën e të dhënave komerciale në dispozicion);

1.3. për qëllime të analizimit të aktiviteteve të dyshuara për shpërlarjen e parave ose financimin e terrorizmit, të kërkojë dhe të pranojë nga organet publike ose qeveritare, apo organe ose organizata ndërkombëtare ose ndërqeveritare (në Kosovë), të dhëna, informacione, dokumente në lidhje me një person, subjekt, pronë ose transaksion;

1.4. dhe kërkon të dhëna, dokumente dhe informata lidhur me kërkesat specifike të të dhënave ose analizave nga të detyruarit ligjërisht, të cilët duhet t'i ofrojnë ato me përpikëri për inspektim nga NJIF-K-ja dhe të lejojnë kopjimin dhe riprodhimin e tyre, vetëm për përdorim të Njësisë. Të detyruarit ligjërisht që i refuzojnë këto kërkesa duhet që brenda tri (3) ditëve pasi të jenë njoftuar rreth kërkesës së NJIF-K-së, të dërgojnë me shkrim arsyet e refuzimit të tyre. Pas kësaj, NJIF-K-ja merr një qëndrim dhe e njofton të detyruarin ligjërisht nëse ai/ajo është ose nuk është në pajtueshmëri me detyrimet e parapara në këtë dispozitë.

1.5. NJIF-K-ja së bashku me institucionet dhe organet tjera në Kosovë obligohen të bashkëpunojnë në mënyrë reciproke, të ndihmojnë njëra tjetrën gjatë kryerjes së detyrave të tyre si dhe t'i koordinojnë aktivitet në kuadër të kompetencave të tyre në pajtueshmëri me ligjet e aplikueshme;

1.6. të krijojë dhe mirëmbajë bazën e të dhënave për të gjitha informacionet e grumbulluar ose të pranuara në lidhje me aktivitetet e shpërlarjes së parave ose financimit të terrorizmit si dhe materiale të tjera të ngjashme që kanë lidhje me punën e NJIF-K-së;

1.7. spontanisht ose me anë të kërkesës, të ndajë informacionet me çdo agjenci homologe të huaj që kryen funksione të ngjashme dhe që i nënshtrohet obligimeve të ngjashme për ruajtjen e konfidencialitetit, pavarësisht nga natyra e agjencisë e cila i nënshtrohet reciprocitetit. Informacioni i ofruar përdoret vetëm me miratimin e agjencisë dhe vetëm për qëllime të luftimit të shpërlarjes së parave, të veprave të ndërlidhura penale dhe të financimit të terrorizmit;

1.8. të hartojë statistika dhe raporte dhe pas kësaj t'i bëj rekomandime Ministrit të Ekonomisë dhe Financave, Ministrit të Drejtësisë, Policisë, Doganat të Kosovës dhe/ose personave apo organeve të tjera, në lidhje me masat që duhet të merren dhe legjislacionin që duhet të miratohet për të luftuar shpërlarjen e parave dhe financimin e aktiviteteve terroriste;

1.9. t'i bëjë këto raporte publike si dhe të ndihmojë në kryerjen e detyrave të saj;

1.10. të organizojë dhe/ose kryej trajnime në lidhje me shpërlarjen e parave dhe financimin e aktiviteteve terroriste si dhe obligimet e subjekteve raportuese;

1.11. të shpërndajë raporte dhe çdo informacion të nevojshëm për autoritetet përkatëse në pajtueshmëri me dispozitat e këtij neni;

1.12. të lëshojë direktiva, udhëzime administrative mbi çështjet që kanë të bëjnë me sigurimin ose promovimin e pajtueshmërisë me këtë ligj, duke përfshirë por jo kufizuar në:
  1.12.1. përdorimin e formave të standardizuara raportuese;
  1.12.2. veprimet ose transaksionet e dyshimta, duke përfshirë natyrën e veprimeve ose transaksioneve të dyshimta për qëllime të këtij ligji, si dhe hartimin e listave të indikatorëve të këtyre veprimeve dhe transaksioneve;
  1.12.3. lirimin e personave ose subjekteve, apo grup personash ose subjektesh, nga obligimet e raportimit sipas këtij ligji, si dhe metodat për të raportuar lirime të tilla.
1.13. të kërkojë dokumente dhe informacione në pajtim me këtë ligj;
1.14. për qëllime të nën-paragrafit 1.7. të këtij paragrafi, NJIF-K-ja mund të nënshkruajë një kontratë ose marrëveshje me një agjenci homologe të huaj e cila kryen funksione të ngjashme dhe i nënshtrohet obligimeve të ngjashme për ruajtjen e fshehtësisë;
1.15. të lëshojë udhëzime për subjektet raportuese në pajtim me këtë ligj duke përfshirë udhëzimet për moskryerjen e një transaksion;
1.16. të kryejë funksione të tjera në pajtim me këtë ligj;
1.17. stafit të NJIF-K-së i kërkohet të ruajë si sekret çdo informacion të marrë në kuadër të fushëveprimit të detyrave të tyre, madje edhe pas ndërprerjes së atyre detyrave brenda NJIF-K-së. Informacione të tilla mund të përdoren vetëm për qëllimet e ofruara në pajtim me këtë ligj.

Neni 15
Publikimi dhe shpërndarja e informacionit dhe dokumenteve zyrtare nga NJIF-Ki

1. NJIF-K-i mund të bëjë publik vetëm informacionin ose dokumentet zyrtare që përmbajnë këtë informacion, në pajtueshmëri me paragrafin 2. të këtij neni si më poshtë:
   1.1. çdo të dhënë rreth personit ose subjektit i cili është lënda e një raporti të mbajtur nga NJIF-K-ja që mund ta identifikojë personin ose subjektin në mënyrë direkte ose indirekte, duke përfshirë por jo edhe duke kufizuar në një emër ose adresë;
   1.2. çdo të dhënë identifikuese në lidhje me një transaksion, duke përfshirë por jo edhe kufizuar datën, vendndodhjen, vlerën ose llojin e pronës, numrin e llogarisë ose numrin e transaksionit; dhe
   1.3. çdo të dhënë rreth një personi ose subjekti i cili i ka ofruar NJIF-K-së informacion ose dokument zyrtar që do ta identifikonte në mënyrë direkte ose indirekte personin ose subjektin.
2. Informacioni i referuar në paragrafin 1. të këtij neni mund të bëhet publik nga NJIF-K-ja në bazë të rrethanave të mëposhtme për:
   2.1. njësinë përkatëse të policisë, Njësinë për Hetime Financiare, Agjencinë Kosovare të Inteligjencës, Prokurorin kompetent, Doganat e Kosovës, Departamentin e Administratës Tatimore të Ministrisë së Ekonomisë dhe

Financave ose KFOR-in, nëse informacioni do të ishte relevant për hetimet në kuadër të kompetencës së saj ose për ndonjë organ jashtë Kosovës me funksione të ngjashme të NJIF-K-së;

2.2. një organ publik ose qeveritar të Republikës së Kosovës nëse ky publikim i informacionit do t'i shërbente NJIF-K-së;

2.3. organet përgjegjëse për zbatimin e ligjit ose ato organe që kryejnë funksion të ngjashëm me NJIF-K-në, jashtë Kosovës, nëse ky publikim i informacionit do t'i shërbente ose do t'i ndihmonte NJIF-K-së që të kryejë funksionet e saj;

3. Të gjitha të dhënat, informacionet dhe dokumentet zyrtare bëhen publike nga NJIF-K-ja vetëm për qëllime inteligjence, me qëllim të ofrimit të bazës për hetime. Ato nuk mund të përdoren si prova përpara një gjyqi, përveç nëse miratohen me shkrim nga Drejtori, i cili autorizon një publikim të tillë vetëm atëherë kur nuk ka mundësi të tjera për organet zbatuese të ligjit që të marrin fakte (prova) përkatëse diku tjetër dhe/ose në mënyrë tjetër.

KREU III
SUBJEKTET RAPORTUESE

Neni 16

1. Subjekte raportuese nënkupton:
   1.1. bankat,
   1.2. institucionet financiare,
   1.3. kazinotë, përfshirë ato në internet,
   1.4. agjentët e pasurive të patundshme dhe ndërmjetësit e pasurive të patundshme,
   1.5. personat fizik dhe ligjor që tregtojnë mallra kur pranojnë pagesa në para të gatshme në vlerë prej dhjetëmijë (10.000) Euro ose më shumë.
   1.6. avokatët dhe noterët (kontabilistët) kur përgatiten për, kryejnë ose përfshihen në transaksione për klientët e tyre rreth aktiviteteve të mëposhtme:
      1.6.1. blerjen dhe shitjen e pasurive të patundshme;
      1.6.2. menaxhimin e parave, letrave me vlerë ose pasurive të tjera të klientit;
      1.6.3. menaxhimin e llogarive bankare, kursimeve ose të letrave me vlerë,
      1.6.4. organizimin e kontributeve të nevojshme për krijimin, funksionimin ose menaxhimin e kompanive, ose
      1.6.5. krijimin, funksionimin ose menaxhimin e personave ose marrëveshjeve ligjore dhe blerjen e shitjen e subjekteve afariste.
   1.7. kontabilistët e certifikuar, auditorët e licencuar dhe këshilltarët tatimor;
   1.8. trustin dhe ofruesit e shërbimeve, që nuk përfshihen në këtë ligj, të cilët i ofrojnë shërbimet e mëposhtme palëve të treta në baza komerciale:
      1.8.1. duke vepruar si agjent formimi i personave ligjorë;
      1.8.2. duke vepruar ose cakton dikë tjetër të veprojë si një drejtor ose sekretar i një kompanie, një partner i një partneriteti, apo një pozitë të ngjashme në lidhje me persona të tjerë ligjorë;
      1.8.3. duke siguruar një zyrë të regjistruar, akomodim ose adresë për biznesin, adresë zyrtare ose me korrespondencë për një kompani, partneritet ose ndonjë person a marrëveshje tjetër ligjore;

1.8.4. duke vepruar ose caktuar dikë tjetër të veprojë si administrator i besuar i një trusti të caktuar;
1.8.5. duke vepruar ose caktuar dikë tjetër të veprojë si një aksionar i emëruar për një person tjetër.

Neni 17
Kujdesi i duhur ndaj klientit

1. Kujdesi i duhur ndaj klientit nënkupton:
   1.1. identifikimi i klientëve dhe verifikimi i identitetit të tyre duke u bazuar në dokumentacionin, të dhënat ose informacionet e marra nga burimet e besueshme dhe të pavarura.
   1.2. identifikimi, aty ku është e zbatueshme, i mbajtësit të së drejtës së pronësisë dhe marrja e masave adekuate të rrezikshmërisë me qëllim të vërtetimit të identitetit të tij/saj, kështu që institucioni ose personi i definuar në këtë ligj të jetë i kuptueshëm lidhur me mbajtjen e të drejtës së pronësisë, duke përfshirë për sa i përket personave ligjor, trusteve dhe marrëveshje të ngjashme ligjore, marrjen e masave adekuate dhe të bazuara në rrezik për të ditur pronën dhe strukturën e kontrollit të klientit;
   1.3. marrjen e informacionit rreth qëllimit dhe llojit të marrëdhënies afariste;
   1.4. monitorimin e vazhdueshëm të marrëdhënies afariste duke përfshirë hetimin e transaksioneve të ndërmarra gjatë gjithë rrjedhës së asaj marrëdhënie për të siguruar se transaksionet e kryera përputhen me informacionin që një institucion ose person ka rreth klientit, biznesit dhe profilit të rrezikut, duke përfshirë atëherë kur është e mundshme, burimin e fondeve dhe të siguruarit, që dokumentet, të dhënat dhe informacionet që zotërohen të jenë të azhurnuara. Autoriteti kompetent mbikëqyrëse mund të aprovojë rregullore që përcakton hollësisht këto kërkesa.
2. Të gjitha subjektet raportuese duhet të identifikojnë klientët e tyre dhe të verifikojnë identitetet e tyre me anë të burimeve të pavarura, dokumenteve, të dhënave ose informacioneve të besueshme në kohën kur:
   2.1. krijojnë marrëdhënie afariste;
   2.2. kryejnë transaksione të rastit kur klienti dëshiron të kryejë:
      2.2.1. një transaksion në vlerë prej dhjetëmijë (10.000) Euro ose më shumë, qoftë i kryer si një transaksion i vetëm ose në disa transaksione që kanë lidhje me njëra tjetrën. Nëse shuma e transaksionit nuk dihet në kohën kur kryhet veprimi, identifikimi i saj duhet të bëhet posa të bëhet e ditur shuma apo të arrihet pragu;
      2.2.2. transfer bankar vendor ose ndërkombëtar të fondeve;
      2.2.3. ekzistojnë dyshime rreth saktësisë dhe mjaftueshmërisë së të dhënave identifikuese të marra të klientit;
   2.3. ka dyshim për shpërlarje të parave ose financim të terrorizmit.
3. Një person fizik identifikohet duke paraqitur një dokument zyrtar origjinal që nuk i ka skaduar afati, dokument në të cilin gjendet edhe fotografia e këtij personi. Adresa e personit dhe data e lindjes do të verifikohen duke paraqitur një dokument, ose dokumente, të cilat ofrojnë dëshmi.

4. Identiteti i një subjekti do të verifikohet duke paraqitur:
   4.1. Certifikatën e regjistrimit të biznesit të lëshuar në pajtim me Ligjin nr. 02/L-123 për organizatat afariste;
   4.2. Certifikatën e regjistrimit të një OJQ-je të lëshuar në pajtim me Ligjin nr. 03/L-134 për lirinë e asociimit në organizatat ndërkombëtare;
   4.3. Dëshminë e të qenit i regjistruar në një parti politike në pajtim me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2004/11 të datës 5 Maj 2004 për regjistrimin dhe veprimtarinë e partive politike në Kosovë.
5. Nëse subjekti nuk është organizatë afariste, OJQ-ë apo parti politike, çdo dokument ose dokumente të tjera të cilat mundësojnë verifikimin e identitetit të subjektit, formës ligjore, adresës, drejtorëve si dhe direktivave që rregullojnë autoritetin e agjentëve, zyrtarëve, ose drejtorëve që do të angazhohen në subjekt.
6. Subjektet raportuese duhet të mbajnë të dhënat për informatat në vijim dhe të sigurojnë se dokumentacioni dhe informacionet përcjellëse të jenë të gatshme dhe në dispozicion të NJIF-K-së, si dhe autoriteteve të tjera kompetente:
   6.1. kopjet e dokumenteve që dëshmojnë identitetin e klientit, mbajtëseve të së drejtës së pronës, të marra në pajtim me nenin 17 të këtij ligji, llogaritë e dosjeve dhe korrespodencën biznesore, për së paku pesë (5) vjetët e fundit, pas përfundimit të marrëdhënies biznesore;dhe
   6.2. informacionet e marra në përputhje me dispozitat këtij ligji, për të mundësuar rindërtimin e transaksioneve, që janë ekzekutuar ose është tentuar të ekzekutohen, nga ana e klientëve dhe raportet me shkrim të krijuara në përputhje me nenin 20 të këtij ligji, për së paku pesë (5) vjet pas tentimit për ekzekutim ose ekzekutimit të transaksionit.

Neni 18
Identifikimi i klientëve

1. Bankave dhe institucioneve financiare nuk u lejohet të mbajnë llogari anonime.
2. Bankat dhe institucionet financiare duhet të verifikojnë emrin dhe adresën dhe në rastet kur kanë të bëjnë me persona duhet të verifikojnë edhe datën e lindjes, të të gjithë klientëve përpara se:
   2.1. të hapin një llogari bankare;
   2.2. të pranojnë aksione, bono thesari ose letra të tjera me vlerë për t'i ruajtur në kasafortë;
   2.3. të ofrojnë lehtësira për depozita të sigurta;
   2.4. të krijojnë një marrëdhënie afariste, ose
   2.5. të përfshihen në një transaksion të vetëm me para në vlerë prej më shumë se dhjetëmijë (10.000) Euro. Transaksionet e shumëfishta me para do të trajtohen si një transaksion i vetëm nëse banka ose institucioni financiar janë në dijeni se transaksionet kryhen nga ose në emër të një personi ose subjekti dhe kanë një vlerë totale më shumë se dhjetëmijë (10.000) Euro brenda një (1) dite.
3. Personi i përfshirë në një transaksion sipas paragrafit 3. të nenit 17 të këtij ligji duhet të sigurojë me shkrim bankën ose institucionin financiar, me anë të një formati të caktuar nga BQK-ja, se ai/ajo po vepron:

3.1. në emër të tij ose të saj si pronar dhe mbajtës i të drejtës së pronësisë mbi çdo pronë që i nënshtrohet transaksionit; ose

3.2. si një agjent i autorizuar i një ose më shumë personash ose subjektesh në pajtim me paragrafët 4. dhe 5. të nenit 17 të këtij ligji, pasi të ketë marrë masat e duhura për të verifikuar se secili person ose subjekt është pronari ose mbajtësi i të drejtës së pronësisë së çdo prone që i nënshtrohet transaksionit dhe ka mirëbesimin se çdo person ose subjekt i identifikuar është pronari dhe/ose mbajtësi i të drejtës së pronësisë së çdo prone që i nënshtrohet transaksionit.

4. Çdo person që vepron si agjent i autorizuar duhet të prezantojë dokumentet në pajtim me paragrafët 3. dhe 4. të nenit 17 të këtij ligji për veten e tij/saj dhe për personin ose subjektin që jep autorizimin si dhe duhet të sigurojë një dokument me anë të të cilit ai/ajo autorizohet për të kryer transaksione në emër të personit ose subjektit.
5. Pavarësisht nga të vepruarit në pajtueshmëri me paragrafët 3. dhe 4. të nenit 17 të këtij ligji, një bankë ose institucion bankar duhet të marrë masat e duhura shtesë për të identifikuar çdo person ose subjekt në emër të të cilit personi që përfshihet në një transaksion vepron në pajtim me paragrafit 4. të nenit 17 të këtij ligji duke përfshirë edhe pronarin ose mbajtësin e të drejtës së pronësisë.
6. Nëse një bankë ose institucion financiar nuk është i aftë të verifikojë identitetin e një klienti, marrëdhënia afariste duhet të përfundojë; çdo llogari të mbyllet dhe prona të kthehet tek burimi i saj. Veprime të tilla nuk do të kenë pasoja në obligimet e bankës ose institucionit financiar për të raportuar veprime ose transaksione të dyshimta në pajtim me paragrafin 1. të nenit 21 të këtij ligji dhe për të raportuar informacion shtesë të rëndësishëm në pajtim me paragrafin 2. të nenit 21 të këtij ligji.
7. Bankat dhe institucionet financiare duhet të bëjnë kopje të të gjithë dokumentacionit i cili do të paraqitet në pajtim me paragrafët 3. dhe 4. të nenit 17 të këtij ligji dhe duhet ti ruajë ato për të paktën pesë (5) vjet pas mbylljes së llogarisë apo pasi marrëdhënia me klientin të ketë përfunduar, për cilin do rast nga këto të fundit.

Neni 19
Transferet bankare

1. Bankat dhe institucionet financiare, aktiviteti i të cilave përfshin transferet bankare duhet të pajisen me emrin e plotë, numrin bankar, adresën ose në mungesë të adresës numrin kombëtar identifikues ose datën dhe vendin e lindjes, duke përfshirë, atëherë kur është e nevojshme, emrin e institucionit financiar ose autorin e këtyre transfereve. Informacioni duhet të përshihet në mesazh ose formularin e pagesës që shoqëron transferin. Në rast se nuk ka numër llogarie, transferi do të shoqërohet nga një numër unik referues.
2. Bankat dhe institucionet financiare duhet ta ruajnë këtë informacion dhe ta transmetojnë atë në momentin kur veprojnë si ndërmjetësues në zinxhirin e pagesave.
3. Autoriteti kompetent mund të lëshojë rregullore në lidhje me transferet përtej kufirit të ekzekutuara si transfere paketë dhe transfere brenda vendit.

4. Paragrafët 1. dhe 2. të këtij neni do të aplikohen tek transferet e ekzekutuar si rezultat i transaksioneve me kartelë krediti ose kartelë debiti me kusht që numri i kartelës së debitit ose i kartelës së kreditit të shoqërojë transferin që rrjedh nga ky transaksion. Ato nuk do të aplikohen në transferet mes bankave dhe/ose institucioneve financiare ku si autori ashtu edhe përfituesi janë bankat ose institucionet financiare të cilat veprojnë në emër të tyre.
5. Nëse bankat ose institucionet financiare pranojnë transfere bankare të cilat nuk e përmbajnë informacionin e plotë mbi autorin, ato duhet të marrin masa për të siguruar dhe verifikuar informacionin që mungon nga institucioni që bën porosinë ose përfituesi; në rast se ata nuk e marrin informacion që mungon ata duhet ta refuzojnë pranimin e transferit dhe ti raportojnë për këtë NJIF-K-së.

Neni 20
Monitorimi special i transaksioneve të veçanta

1. Subjektet raportuese duhet ti kushtojnë vëmendje të veçantë të gjitha transaksioneve të ndërlikuara dhe jashtëzakonisht të mëdha të cilat nuk kanë qëllime të qarta ekonomike ose ligjore.
2. Subjektet raportuese duhet ti kushtojnë vëmendje të veçantë marrëdhënieve afariste dhe transaksioneve me personat, duke përfshirë personat juridik dhe marrëveshjet ligjore nga ose në vende që nuk i aplikojnë ose i aplikojnë në mënyrë të pamjaftueshme, standardet ndërkombëtare përkatëse për të luftuar shpëlarjen e parave dhe financimin e terrorizmit.
3. Subjektet raportuese duhet të paraqesin me shkrim informacionin specifik në lidhje me transaksionet e referuara në paragrafët 1. dhe 2. të këtij neni si dhe të identifikojnë të gjitha palët e përfshira. Raporti duhet të ruhet siç përcaktohet në këtë ligj dhe duhet të vihet në dispozicion nëse kjo kërkohet nga NJIF-K-ja, autoriteti mbikëqyrës dhe autoritetet e tjera kompetente.

Neni 21
Kujdesi i duhur i shtuar

1. Subjektet raportuese duhet të shtojnë kujdesin e duhur ndaj klientëve në prezencë të ndonjë rreziku të madh të shpërlarjes së parave dhe financimit të terrorizmit dhe gjithsesi në rastet e përmendura në paragrafët 2., 4. dhe 5. të këtij neni.
2. Kur klienti nuk është "prezent fizikisht" institucionet dhe personat që i nënshtrohen këtij ligji duhet të marrin masa adekuate dhe specifike për të mënjanuar rreziqet e mëdha duke marrë një ose më shumë nga masat e mëposhtme:
   2.1. verifikimin e identitetit të klientit përmes dokumenteve, të dhënave, ose informacioneve;
   2.2. marrjes së masave shtesë për të verifikuar ose vërtetuar dokumentet e ofruara ose duke kërkuar certifikatë konfirmuese nga një institucion kreditor ose financiar të cilët përmenden në këtë ligj;
   2.3. sigurimin se pagesa e parë për operacione kryhet përmes një llogarie të hapur në emër të klientit në një institucion kreditor.
3. Kërkesat për identifikim dhe kujdes të duhur ndaj klientit konsiderohen të përmbushura edhe pa prezencën fizike të klientit, në rastet e mëposhtme:

3.1. nëse klienti tashmë është i identifikuar për sa i përket një marrëdhënie të vazhdueshme me bankën, me kusht që informacioni të jetë i azhurnuar;
3.2. kur veprimet kryhen me anë të sistemit të sigurimit ose ATM-së, përmes korrespondencës ose subjekteve të përfshira në transportin e gjërave me vlerë ose përmes kredit/debit kartelave; transaksione të tilla i ngarkohen pronarit të llogarisë të cilit i përkasin;
3.3. për klientë të dhënat identifikuese të të cilëve ose çdo informacion tjetër, do të kërkohen në mënyrë private ose publike ose do të vërtetohen nga certifikatat e kualifikuara që përdoren për të gjeneruar një nënshkrim digjital të shoqëruar me dokumente elektronike;

4. Në rastet e një marrëdhënie bankare me subjekte që kanë origjinën nga vende të tjera, bankat ose institucionet kreditore duhet:
4.1. të grumbullojnë informacione të mjaftueshme me qëllim që të kuptojnë plotësisht llojin e biznesit dhe të përcaktojnë, në bazë të regjistrave publik, listave, dokumenteve ose të dhënave të njohura nga çdokush, reputacionin e tij dhe cilësinë e kontrollit të cilit i nënshtrohet;
4.2. të vlerësojnë cilësinë e kontrolleve të cilave u nënshtrohet subjekti përkatës në lidhje me luftën kundër shpërlarjes së parave dhe financimit të terrorizmit;
4.3. të marrin miratimin nga drejtori gjeneral për personin ose punëtorin e tij të caktuar që kryen një funksion ekuivalent përpara se të krijojë një marrëdhënie të re bankare;
4.4. të përcaktojnë me shkrim kushtet e marrëveshjes me institucionin dhe obligimet e tyre përkatëse;
4.5. të sigurojnë se institucioni kreditor ka verifikuar identitetin e klientëve të cilët kanë qasje të drejtpërdrejtë në llogaritë e përkohshme, të cilat i kanë përmbushur me përputhshmëri kërkesat për verifikimin adekuat të klientëve kështu që, sipas kërkesës, ndërmjetësi mund të sigurojë të dhëna financiare plotësuese si rezultat i kryerjes së këtyre obligimeve.

5. Për sa i përket transaksioneve, marrëdhëniet ose shërbimet e ofruara nga personat politikisht të ekspozuar të cilët banojnë jashtë Republikës së Kosovës, subjektet raportuese duhet:
5.1. të kenë procedurat e duhura të bazuara në rrezik për të përcaktuar nëse klienti është një person politikisht i ekspozuar;
5.2. të marrë miratimin e drejtorit gjeneral për personin ose punëtorin e tij të caktuar, që kryen një funksion ekuivalent përpara se të fillojë një marrëdhënie me këta klientë;
5.3. të marrë masa adekuate për të vërtetuar origjinën e aseteve dhe fondeve të përdorura në marrëdhënie ose transaksion;
5.4. të sigurojë monitorim të fortë dhe të vazhdueshëm mbi marrëdhënien bankare ose veprimin e menjëhershëm.

6. Ndërmjetësuesit financiar nuk mund të hapin ose të mbajnë llogari koresponduese në një bankë guaskë ose një bankë e cila njihet se lejon një bankë të përdoret nga llogaritë e tyre guaskë.

7. Institucionet dhe personat që i nënshtrohen këtij ligji duhet ti kushtojnë vëmendjen e veçantë çdo rreziku për shpërlarjen e parave ose financimin e terrorizmit në lidhje me produktet ose transaksionet, të promovojnë anonimitetin dhe të marrin masat e

nevojshme për të parandaluar përdorimin e tij për qëllime të shpërlarjes së parave ose financimit të terrorizmit.

Neni 22
Bankat dhe institucionet financiare: raportimi tek NJIF-K-ja

1. Bankat dhe institucionet financiare do të raportojnë tek NJIF-K-ja, sipas mënyrës dhe formës së specifikuar nga NJIF-K-ja:
   1.1. të gjitha aktet ose transaksionet e dyshimta brenda njëzetekatër (24) orëve nga koha kur akti ose transaksioni është identifikuar si i dyshimtë;
   1.2. të gjitha transaksionet individuale në vlerë prej dhjetëmijë (10.000) Euro ose më shumë. Transaksionet e shumëfishta do të trajtohen si një transaksion individual nëse banka apo institucioni financiar është në dijeni se transaksionet janë nga apo në emër të një personi ose subjekti dhe kapin vlerën prej më shumë se dhjetëmijë (10.000) Euro në një (1) ditë të vetme.
2. Bankat dhe institucionet financiare do të vazhdojnë të raportojnë tek NJIF-K-ja çdo informacion shtesë të rëndësishëm në lidhje me transaksionin/net që është siguruar nga banka apo institucioni financiar pas raportimit të përcaktuar me paragrafin 1. të nenit 21 të këtij ligji.
3. NJIF-K-ja mund të përjashtojë transaksione të caktuara ose kategori të transaksioneve nga detyrimet e paragrafit 1. të nenit 21 të këtij ligji, ose me kërkesë të shkruar ose me iniciativë të vet, kur transaksionet apo kategoritë e transaksioneve bankare janë rutinore ose i shërbejnë një qëllimi legjitim apo nuk janë në interes të mandatit të NJIF-K-së.
4. Drejtorët, zyrtarët, punëtorët dhe agjentët e çfarëdo banke apo institucioni të cilët përgatisin apo përcjellin raporte në pajtim me këtë nen, nuk ua sigurojnë këtë raport, as nuk e komunikojnë ndonjë të dhënë të përfshirë në atë raport apo për atë raport, asnjë personi apo subjekti, duke përfshirë edhe personin apo subjektin e përfshirë në transaksionin i cili i nënshtrohet raportit, përpos NJIF-K-së apo BQK-së, pa pasur autorizim me shkrim të NJIF-K-ja, prokurorit publik ose gjykatës.
5. Banka ose institucioni financiar e njoftojnë NJIF-K-në në para ndërmarrjes së ndonjë veprimi lidhur me aktin ose transaksionin e dyshimtë, duke përfshirë edhe veprimin nga paragrafi 6. i nenit 18 të këtij ligji që mund të rezultojë me lëshimin apo transferimin e pasurisë që i nënshtrohet transaksionit nga kontrolli i bankës apo institucioni financiar. Njoftimi mund të bëhet gojarisht, por njoftimi i tillë nuk e anulon detyrimin e dorëzimit të raportit të shkruar në pajtim me paragrafët 1. dhe 3. të këtij neni.
6. Pas njoftimit, në pajtim me paragrafin 5. të nenit 21 të këtij ligji, NJIF-K-ja mund të udhëzojë bankën apo institucionin financiar që të pezullojë ndërmarrjen e veprimit nga paragrafi 6. të nenit 17 të këtij ligji lidhur me aktin ose transaksionin e dyshimtë për një kohë maksimale prej dyzetetetë (48) orëve ose dy (2) ditë pune, varësisht se cila periudhë është më e gjatë. Pezullimi i tillë i veprimit në pajtim me këtë nen nuk i komunikohet asnjë personi apo subjekti, duke përfshirë edhe klientin, pa pëlqimin e NJIF-K-së.

Neni 23
Bankat dhe institucionet financiare: Programet e brendshme

1. Bankat dhe institucionet financiare do të caktojnë një person kontaktues i cili do të jetë përgjegjës për ndërveprim dhe këmbim informacionesh me NJIF-K-në, i cili u nënshtrohet detyrimeve të raportimit dhe mbajtjes së shënimeve sipas këtij ligji. Bankat dhe institucionet financiare e informojnë agjencionin mbikëqyrës dhe NJIF-K-në për identitetin e personit kontaktues brenda tridhjetë (30) ditëve nga shpallja e këtij ligji dhe pas kësaj informimin për çfarëdo ndryshimi të personit kontaktues të caktuar e bënë brenda tridhjetë (30) ditëve.
2. Bankat dhe institucionet financiare do të nxjerrin procedura të brendshme të shkruara dhe do të vendosin kontroll për parandalimin dhe zbulimin e shpërlarjes së parave dhe do t'i zbatojnë ato. Këto procedura mes tjerash përfshijnë, por nuk kufizohen në:
   2.1. procedurën për identifikimin e klientit;
   2.2. procedurën për grumbullimin e të dhënave, ruajtjen e shënimeve në pajtim me këtë ligj dhe për parandalimin e qasjes së paautorizuar;
   2.3. procedurën e raportimit tek NJIF-K-ja, në pajtim me paragrafët 1. deri 6. të nenit 22 të këtij ligji;
   2.4. masat që duhet të ndërmerren nga banka apo institucioni financiar nga çasti i zbulimit të aktit ose transaksionit të dyshimtë deri në dorëzimin e raportit te NJIF-K-ja në pajtim me paragrafët 1. deri 6. të nenit 22 të këtij ligji;
   2.5. rregullat për përpunimin ose marrjen e veprimeve të mëtejme lidhur me aktin apo transaksionin e dyshuar, duke përfshirë masat për ndalimin e veprimeve të mëtejme lidhur me aktin ose transaksionin e dyshuar pa e njoftuar Qendrën në pajtim me paragrafin 5. të nenit 22 të këtij ligji;
   2.6. procedurat për sigurimin e organizimit dhe financimit të programit për trajnimin e punëtorëve mbi përgjegjësitë e parapara në këtë nen dhe parandalimin e shpërlarjes së parave dhe funksionin e auditorit për të testuar sistemin e raportimit dhe identifikimit.
3. Bankat dhe institucionet financiare do t'i dorëzojnë NJIF-K-së procedurat e parapara në paragrafin 2. të këtij neni jo më vonë se gjashtëdhjetë (60) ditë nga dita e hyrjes në fuqi të këtij neni ose tridhjetë (30) ditë pas themelimit të bankës ose institucionit financiar.

Neni 24
Detyrimet shtesë të OJQ-ve

1. Përpos asaj që është paraparë në paragrafin 3. të këtij neni një OJQ-ë nuk pranon kontribute në para që tejkalojnë njëmijë (1.000) Euro nga një burim i vetëm brenda një (1) dite të vetme.
2. Përpos asaj që është paraparë në paragrafin 3. të këtij neni një OJQ-ë nuk do të paguajë para që tejkalojnë pesëmijë (5.000) Euro brenda një (1) dite të vetme cilitdo marrësi të vetëm.
3. OJQ-të që kërkojnë lirim të njëhershëm ose të vazhdueshëm nga detyrimet e paragrafit 1. dhe 2. të këtij neni, mund të dorëzojnë një kërkesë me shkrim tek

NJIF-K-ja për t'u liruar, duke potencuar llojin e kërkuar të lirimit dhe arsyet për të. NJIF-K-ja i përgjigjet po me shkrim kërkesës me shkrim brenda tridhjetë (30) ditëve dhe mund të vendosë që ta lejojë, ta lejojë me kusht ose ta refuzojë lirimin. Nëse NJIF-K-ja vendos ta lejojë ose ta lejojë me kusht një lirim, një (1) kopje të vendimit të vet ia dorëzon organit kompetent sipas Ligjit për Lirinë e Asociimit në Organizatat Joqeveritare (Nr. 03/L-134).

4. OJQ-të do të ruajnë llogaritë të cilat dëshmojnë të gjitha të ardhurat dhe shpenzimet. Llogaritë do të identifikojnë të ardhurat sipas burimit, sasisë dhe mënyrës së pagesës, me para ose me urdhërpagesë, do të identifikojnë shumat e paguara sipas marrësit, destinimit të shfrytëzimit të fondeve dhe mënyrës së pagesës. Dokumentet e llogarive do të ruhen pesë (5) vite dhe do të jenë në dispozicion për inspektim me kërkesë të NJIF-K-së dhe organit kompetent sipas Ligjit për Lirinë e Asociimit në Organizatat Joqeveritare (Nr. 03/L-134).
5. OJQ-të i raportojnë NJIF-K-së të gjitha aktet apo transaksionet e dyshimta brenda tri (3) ditëve të punës dhe para ndërmarrjes së veprimeve të mëtejme lidhur me aktin apo transaksionin e tillë.
6. Me rastin e dorëzimit të raportit vjetor në pajtim me nenin 18 të Ligjit për Lirinë e Asociimit në Organizatat Joqeveritare (Nr. 03/L-134), një OJQ në raport do të shpalosë:
   6.1. çdo kontribut në para gjatë vitit nga një burim i caktuar, nëse vlera e përgjithshme në para e kontributeve nga ai burim gjatë vitit tejkalon pesëmijë (5.000) Euro, duke identifikuar burimin, shumën dhe datën e çdo kontributi; dhe
   6.2. çdo pagesë në para gjatë vitit që i dedikohet marrësit të caktuar, nëse vlera e përgjithshme në para e pagesave dedikuar atij marrësi tejkalon dhjetëmijë (10.000) Euro, duke identifikuar marrësin, shumën, datën e çdo pagese dhe destinimin e shfrytëzimit të parave.
7. Me rastin e dorëzimit të raportit vjetor në pajtim me nenin 18 të Ligjit për Lirinë e Asociimit në Organizatat Joqeveritare (Nr. 03/L-134), një OJQ do të vërtetojë se i përmbush të gjitha detyrimet e këtij neni.
8. Organi kompetent sipas Ligjit për Lirinë e Asociimit në Organizatat Joqeveritare (Nr. 03/L-134) mund të pezullojë ose revokojë regjistrimin e një OJQ-je për shkelje të ndonjë dispozite të këtij neni në pajtim me nenin 21 të Ligjit për Lirinë e Asociimit në Organizatat Joqeveritare (Nr. 03/L-134). Imponimi i sanksionit të tillë nuk cënon çfarëdo procedure penale.
9. Pavarësisht nga cilado dispozitë tjetër ligjore, raportet e dorëzuara nga OJQ-të në pajtim me Ligjin për Lirinë e Asociimit në Organizata Joqeveritare (Nr. 03/L-134), do t'i vihen në dispozicion NJIF-K-së me rastin e paraqitjes së kërkesës.

Neni 25
Detyrimet shtesë të partive politike dhe kandidatëve të regjistruar

1. Partitë politike dhe kandidatët e regjistruar nuk pranojnë kontribute në para që tejkalojnë njëmijë (1.000) Euro nga një burim i vetëm brenda një (1) dite të vetme.
2. Partitë politike dhe kandidatët e regjistruar nuk i paguajnë një marrësi të vetëm para që tejkalojnë pesëmijë (5.000) Euro brenda një (1) dite të vetme.

3. Partitë politike do të ruajnë librat e kontabilitetit të cilat identifikojnë të ardhurat sipas burimit, shumës, mënyrës së pagesës, siç është pagesa me para apo me urdhërpagesë dhe pagesat nga palët për çdo person, destinimin e pagesës si dhe mënyrën e kryerjes së pagesës. Librat e kontabilitetit ruhen shtatë (7) vjet dhe do të jenë në dispozicion të NJIF-K-së dhe Zyrës së Regjistrimit të partive politike për inspektim me rastin e paraqitjes së kërkesës.
4. Partitë politike i raportojnë NJIF-K-së për akte ose veprime bankare të dyshimta brenda tri (3) ditëve të punës dhe para ndërmarrjes së veprimeve të mëtejme lidhur me aktin apo transaksionin e tillë.
5. Raportet financiare gjashtë (6) mujore të dorëzuara në pajtim me nenin 19 të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2004/11, do të përfshijnë:
   5.1. regjistrin e çdo kontributi për partinë politike të regjistruar nga një burim i vetëm, nëse vlera e përgjithshme në para e kontributeve nga ai burim ka tejkaluar njëqind (100) Euro gjatë periudhës së raportuar i cili duhet të tregoj:
      5.1.1. vlerën e çdo kontributi dhënë partisë politike;
      5.1.2. datën në të cilën është dhënë kontributi;
      5.1.3. emrin e plotë, adresën dhe regjistrimin civil, numrin e pasaportës apo lejes së vozitjes së kontribuesit; dhe
   5.2. një deklaratë që identifikon çdo pagesë të bërë ndaj ndonjë personi tjetër gjatë periudhës së raportuar, nëse vlera e përgjithshme e të gjitha pagesave për atë person gjatë asaj periudhe tejkalon shumën prej pesëmijë (5.000) Euro dhe ndikimin e qëllimit të pagesës.
6. Partia politike do të vërtetojë në raportin e saj financiar gjashtë (6) mujor se i ka përmbushur të gjitha detyrimet nga ky nen. Kandidati do të vërtetojë se i përmbushin detyrimet nga paragrafi 1. dhe 2. i këtij neni, në formularin e tij/saj të regjistrimit të kandidatëve dorëzuar Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
7. Zyra për regjistrimin e partive politike mund të hetojë përputhshmërinë e partisë politike me këtë nen dhe mund të pezullojë ose revokojë regjistrimin për shkelje të cilësdo dispozite të këtij neni në pajtim me nenin 5 të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2004/11. Sanksioni nga ky paragraf nuk cenon çfarëdo procedurë penale.
8. Pavarësisht nga dispozitat tjera ligjore, raportet e dorëzuara nga partitë politike në pajtim me Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2004/11, do të vihen në dispozicion të NJIF-së me rastin e paraqitjes së kërkesës.

Neni 26
Detyrimet shtesë të avokatëve, noterëve, kontabilistëve të certifikuar, auditorëve të licencuar dhe këshilltarëve tatimor

Identifikimi i klientëve

1. Avokatët, noterët, kontabilistët dhe auditorët e licencuar dhe këshilltarët tatimor (më tutje "profesionistët në fjalë") do ta verifikojnë emrin dhe adresën dhe në rastin e personave, datën e lindjes të çdo klienti para kryerjes së shërbimeve profesionale për klientin. Neni 17 dhe paragrafët 4.,5. dhe 6. të neni 18 të këtij ligji do të zbatohen për verifikim dhe identifikim. Nëse profesionisti në fjalë nuk mund ta identifikojë klientin ose ta verifikojë identitetin e tij/saj, ai/ajo nuk do të pranojë pasuri nga klienti ose në emër të tij për asnjë qëllim.

Trajtimi i pasurisë së klientit

2. Kur profesionisti në fjalë në cilëndo kohë posedon me pasuri në emër të klientit apo palës së tretë, profesionisti përkatës do të:
   2.1. mbajë pasurinë në xhirollogarinë, ose në kasafortën, e bankës e cila i nënshtrohet mbikëqyrjes së BQK-së, përveç nëse klienti në mënyrë qartë pajtohet që pasuria të trajtohet ndryshe, ose kur lloji i pasurisë këtë nuk e lejon;
   2.2. shënojë në titullin ose destinimin e xhirollogarisë se pasuria mbahet në emër të klientit ose klientëve të profesionistit në fjalë;
   2.3. në rastin e parave të gatshme ose letrave me vlerë likuide, do të ruajë një shumë në xhirollogari e cila në çdo kohë është baras ose tejkalon shumën e pasurisë së klientit që mbahet nga profesionisti në fjalë; dhe
   2.4. mbajë shënime të plota dhe të sakta, të cilat me rastin e kërkesës janë në dispozicion të klientit, duke treguar të gjitha qëndrimet me pasurinë e klientit dhe duke e veçuar pasurinë e klientit nga pasuritë tjera të cilat mbahen nga profesionisti në fjalë.

Raportimi

3. Çdo profesionist në fjalë i cili, gjatë kryerjes së shërbimeve për klientin, pranon para nga klienti në shumë prej dhjetëmijë (10.000) Euro apo më shumë, për një transaksion ose transaksione të lidhura me të, do të dorëzojë raport tek NJIF-K-ja brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga transaksioni i raportueshëm. Transaksioni gjithashtu do të raportohet nëse profesionisti në fjalë i pranon paratë si ndërmjetësues, që do të thotë se ai ose ajo tenton të transferojë paratë tek pala e tretë në emër të klientit. Transaksioni nuk do të ndahet në transaksione të shumta për t'iu shmangur raportimit sipas këtij neni.
4. Për qëllime të paragrafit 3. të këtij neni, "transaksioni" përfshin mes tjerash, por nuk është i kufizuar me:
   4.1. shitjen e mallrave dhe shërbimeve;
   4.2. shitjen e pasurisë së patundshme;
   4.3. shitjen e pasurisë së paprekshme;
   4.4. qiradhënien e pasurisë së patundshme ose personale;
   4.5. këmbimin e parave për mjete të tjera monetare, duke përfshirë edhe para të tjera;
   4.6. pagesën e një borxhi të mëparshëm;
   4.7. pagesën e shpenzimeve të paguara;
   4.8. vazhdimin ose ri pagesën e huas; apo
   4.9. pagesën e taksave në para profesionistit në fjalë për shërbimet e tij ose saj.
5. Për qëllime të paragrafit 3. të këtij neni, shprehja "transaksione të ndërlidhura" do të thotë të gjitha transaksionet e kryera në mes të klientit dhe profesionistit në fjalë brenda një periudhe prej njëzetekatër (24) orëve ose të gjitha transaksionet e kryera në mes të klientit dhe profesionistit në fjalë brenda një periudhe prej më shumë se njëzetekatër (24) orëve, nëse marrësi është në dijeni ose ka arsye të jetë në dijeni se secili transaksion është njëri prej një sërë transaksionesh të ndërlidhura. Pagesat e

shumta që i bëhen avokatit për përfaqësim në një rast të vetëm janë transaksione të ndërlidhura.

6. Forma dhe mënyra e raportimit do të rekomandohet nga NJIF-K-ja dhe përfshin:
   6.1. emrin, adresën dhe të dhëna të tjera identifikuese të rekomanduara nga NJIF-K-ja të personit apo subjektit nga i cili janë marrë paratë dhe çdo përfaqësuesi në emër të të cilit vepron personi apo subjekti;
   6.2. shuma e parave të marra;
   6.3. data dhe lloji i transaksionit; dhe
   6.4. informacione të tjera, duke përfshirë edhe identifikimin e personit a të subjektit që e ka dorëzuar raportin e rekomanduar nga NJIF-K-ja.
7. Kontabilistët e certifikuar dhe auditorët e licencuar do t'i raportojnë NJIF-K-së për çdo lloj akti apo transaksioni të dyshimtë brenda tri (3) ditëve të punës dhe para ndërmarrjes së veprimeve të mëtejme lidhur me aktin apo transaksionin e tillë. Raportet do të përgatiten në formën dhe mënyrën e rekomanduar nga NJIF-K-ja.
8. Përveç rasteve të parapara në paragrafin 9. të këtij neni, avokatët e angazhuar në aktivitete specifike do t'i raportojnë NJIF-K-së për akte apo transaksione të dyshimta brenda tri (3) ditëve të punës dhe para ndërmarrjes së veprimeve të mëtejshme lidhur me aktin ose transaksionin e tillë. Në aktivitete specifike përfshihen:
   8.1. ndihma ose përfaqësimi i klientit apo klientëve në:
      8.1.1. blerjen apo shitjen e pasurisë së paluajtshme ose të organizatave të biznesit;
      8.1.2. trajtimin e parave të klientit, letrave me vlerë ose pasurisë tjetër;
      8.1.3. hapjen ose menaxhimin e llogarive bankare, librezave të kursimit ose llogarive të letrave me vlerë;
      8.1.4. organizimin e kontributeve të nevojshme për krijimin, funksionimin ose menaxhimin e kompanive;
      8.1.5. krijimin, funksionimin ose menaxhimin e kompanive, trusteve ose strukturave të ngjashme; ose
   8.2. të vepruarit në emër të klientit ose për klientin në çfarëdo transaksioni financiar apo transaksion mbi të drejtat në pasurinë e paluajtshme.

Raportet do të përgatiten në formën dhe mënyrën e rekomanduar nga NJIF-K-ja.

9. Avokati nuk jep informacione të cilat ai/ajo i ka marrë nga klienti ose i ka mësuar për klientin, për ta përfaqësuar klientin në procedurë penale a gjyqësore pa autorizim nga klienti ose me urdhër të gjykatës, përveç nëse avokati me arsye beson se klienti kërkon këshillë ose ndihmë nga avokati për të kryer një vepër penale.
10. Shënimet e grumbulluara në pajtim me këtë nen do të ruhen për një periudhë pesë (5) vjeçare nga dita e përfundimit të marrëdhënies afariste apo përfaqësimit. Shënimet relevante për aktin apo transaksionin e dyshimtë do të ruhen për një periudhë pesë (5) vjeçare nga dita kur në NJIF-K-ja është raportuar akti ose transaksioni i dyshimtë. Sa të jetë e mundur, shënimet e ruajtura në pajtim me këtë nen do të ruhen ndaras nga dosjet që përfshijnë të dhëna që i nënshtrohen të drejtës së posaçme avokat-klient.
11. Profesionistët në fjalë do të sigurojnë aftësimin e të gjithë anëtarëve të personelit, të punëtorëve dhe të përfaqësuesve në lidhje me detyrimet që dalin nga ky ligj.

12. NJIF-K-ja, në konsultim me Shoqatën e Avokatëve të Kosovës dhe Bordin Kosovar për Standardet e Raportimit Financiar, dhe çdo shoqatë tjetër relevante profesionale e profesionistëve në fjalë , do të caktojë standardet minimale, procedurat e shkruara dhe kontrollet për parandalimin dhe zbulimin e shpëlarjes së parave nga profesionistët në fjalë dhe do t'i mbikëqyr ata. Këto procedura mes tjerash do të përfshijnë, por nuk kufizohen në:
    12.1. procedurën për identifikimin e klientit;
    12.2. procedurën për grumbullimin e të dhënave dhe ruajtjen e shënimeve në pajtim me këtë ligj dhe për parandalimin e qasjes së paautorizuar;
    12.3. procedurën e raportimit tek NJIF-K-ja në pajtim me paragrafin 3. deri 9. të nenit 24 të këtij
    12.4. ligji;
    12.5. një listë të detajuar për treguesit e aktit ose transaksionit të dyshimtë, duke marrë parasysh problemet specifike të krimit në Kosovë dhe sistemet ligjore dhe afariste të Kosovës;
    12.6. masat që duhet ndërmarrë nga profesionistët në fjalë nga momenti i zbulimit të aktit të dyshimtë ose të transaksionit deri te dorëzimi i raportit tek NJIF-K-ja;
    12.7. procedurat për sigurimin e institucionit dhe sigurimin e një programi për aftësimin e punonjësve lidhur me detyrimet sipas këtij neni si dhe parandalimin e shpërlarjes së parave;
    12.8. një funksion auditimi për të testuar raportimin dhe sistemin e identifikimit.
13. Shoqata e Avokatëve të Kosovës dhe Bordi Kosovar për Standardet e Raportimit Financiar dhe çdo shoqatë tjetër relevante profesionale e profesionistëve në fjalë duhet të informojë anëtarët e saj mbi procedurat e miratuara dhe detyrimet e tyre si dhe për sanksionet e këtij ligji në lidhje me profesionistët përkatës.

Sanksionet

14. Sanksioni i shqiptuar nga Shoqata kompetente e Avokatëve, Bordi Kosovar për Standardet e Raportimit Financiar apo ndonjë shoqatë tjetër relevante profesionale e profesionalistëve në fjalë për shkelje të këtij ligji nuk cenon asnjë nga procedurat penale.

Neni 27
Detyrimet shtesë të transaksioneve për pasuritë e paluajtshme

1. Kur bartja e të drejtave mbi pasurinë e paluajtshme përfshin një transaksion ose transaksione në një shumë të hollash prej dhjetëmijë (10.000) Euro apo më shumë, secili transaksion duhet të bëhet me anë të urdhërpagesës ose transferit telegrafik.
2. Zyra Kadastrale Komunale (ZKK) nuk do ta regjistrojë transferin e të drejtave mbi pasurinë e paluajtshme derisa nuk pranon, krahas dokumenteve të tjera që paraqiten në pajtim me ligjin për regjistrimin e transferit, një deklaratë, në mënyrën dhe formën e saktësuar nga NJIF-K-ja, të nënshkruar nga transferuesi dhe pranuesi, e cila vërteton:
    2.1. regjistrimin e transferuesit dhe të pranuesit;

2.2. identitetin e secilit prej personave ose subjektit që ka interes financiar dhe i cili është shfrytëzues i pronës që transferohet dhe natyrën e interesit a statusin e përfituesit;
2.3. çmimin e blerjes dhe mënyrën e pagesës, nëse pagesa bëhet pjesërisht ose tërësisht, duke përfshirë përmes transferit të pronës pos në të holla të gatshme një përshkrim dhe një vlerësim të vlerës së pronës;
2.4. nëse transferi i nënshtrohet paragrafit 1. të këtij neni, numri i llogarisë financiare ose numrat prej të cilëve pagesa ka qenë ose do të debitohet dhe te e cila ka qenë ose do të transferohet dhe emrat nën të cilët mbahen llogaritë.

3. ZKK-ja mban deklaratën së bashku me dokumentet e tjerë që janë të dorëzuara në pajtim me ligjin mbi regjistrimin e transferit. Pos kësaj, ZKK-ja i dërgon në NJIF-K-së kopjet e të gjitha deklaratave të pranuara në baza mujore.
4. Vendimi i ZKK-së për të refuzuar regjistrimin me arsyetimin e bazuar mbi mosrespektimin e këtij neni, do të bëhet si dhe mund të rishqyrtohet në pajtim me Ligjin Nr. 2002/5 mbi themelimin e regjistrit mbi të drejtat në pronën e paluajtshme, siç është shpallur me anë të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2002/22 të datës 20 dhjetor 2002.

Neni 28
Detyrimet shtesë të kazinove dhe shtëpive tjera të lojërave të fatit

1. Kazinotë dhe shtëpitë tjera të lojërave të fatit (në tekstin e mëtejmë shtëpi të lojërave) i nënshtrohen dispozitave kundër shpërlarjes së parave dhe kundër financimit të terrorizmit të këtij ligji dhe janë të detyruara të marrin masa specifike për të adresuar rrezikun e shpërlarjes së parave dhe financimit të terrorizmit në ofrimin e shërbimeve të bixhozit.
2. Shtëpitë e lojërave do ta verifikojnë identitetin e klientit para se të hyjnë në një transaksion ose transaksione të lidhura me shitjen, blerjen, transferimin ose këmbimin e monedhave të bixhozit, taloneve apo dëshmive të tjera me vlerë të lojërave në një shumë prej dymijë (2.000) Euro ose më shumë ose barasvlershëm në monedhë të huaj. Kërkesa për verifikimin e identitetit përfshinë po ashtu edhe transaksionet financiare siç janë hapja e një llogarie, transferimi telegrafik ose këmbimi valutor në shumën prej dymijë (2.000) Euro ose më shumë ose barasvlershëm në monedhë të huaj. Nëse shtëpia e lojërave nuk është në gjendje ta verifikojë identitetin e klientit, ajo nuk do të hyjë në transaksion.
3. Shtëpitë e lojërave nuk do të angazhohen në ndonjë nga transaksionet në vijim:
   3.1. këmbimin e parasë së gatshme me para të gatshme me një klient ose me një marrës tjetër në emër të klientit, në çdo transaksion në të cilin shuma e shkëmbimit është dymijë (2.000) Euro ose më shumë;
   3.2. lëshimin e një çeku ose instrumenti tjetër të negociueshëm një klienti, ose një marrësi tjetër në emër të klientit, në këmbim të parasë së gatshme në çdo transaksion në të cilin shuma e këmbimit është dymijë (2.000) Euro ose më shumë;
   3.3. transferin e fondeve me anë të transfereve elektronike, telegrafike ose metodave të tjera një klienti, ose në një marrësi tjetër në emër të klientit, në këmbim të parasë së gatshme në çdo transaksion në të cilin shuma e këmbimit është dymijë (2.000) Euro ose më shumë.

4. Këto ndalesa nuk e kufizojnë një shtëpi të lojërave që ta kryej pagesën e fitimit ndaj një klienti me anë të çekut ose instrumentit tjetër të negociueshëm apo me transfer elektronik ose telegrafik nëse çeku, instrumenti i negociueshëm, transferi elektronik apo ai bankar është i pagueshëm sipas urdhrit të klientit.

Neni 29
Qarkullimi i mjeteve monetare brenda dhe jashtë Kosovës –
Detyrimi për të deklaruar

1. Secili person i cili hyn ose del nga Kosova dhe i cili bart mjete monetare në një vlerë që tejkalon shumën prej dhjetëmijë (10.000) Euro apo më shumë duhet të paraqesë me shkrim shumën e mjeteve monetare dhe burimin e tyre në një formë e cila duhet të përcaktohet nga Doganat e Kosovës, para nëpunësit të autorizuar të doganës dhe nëse kjo kërkohet nga nëpunësi, ai duhet ti paraqesë këto mjete monetare. Sipas këtij neni, konsiderohet se personi bart mjete financiare nëse, midis të tjerash, ato janë në posedim fizik të këtij person apo në automjetin privat ose në ndonjë mjet transporti tjetër që shfrytëzohet nga ky person. Detyrimi për të deklaruar nuk konsiderohet i përmbushur nëse informatat e ofruara janë të pasakta apo jo të plota.
2. Secili person i cili nga Kosova dërgon në një vend jashtë Kosovës ose i cili i pranon në Kosovë nga një vend tjetër jashtë Kosovës, përmes postës apo kuririt komercial, mjete monetare në një vlerë e cila tejkalon shumën prej dhjetëmijë (10.000) Euro apo më shumë duhet të deklarojë me shkrim shumën e mjeteve monetare dhe burimin e tyre në një formë e cila duhet të përcaktohet nga Doganat e Kosovës, para nëpunësit të autorizuar të doganës dhe t'i paraqesë mjetet monetare nëse këtë e kërkon nëpunësi. Personi mund të plotësojë detyrën e tij lidhur me raportimin sipas këtij paragrafi me anë të njoftimit të përmbajtjes së pakos në deklaratën doganore ose në dokumentacionin ndërkombëtar të bagazhit. Detyrimi për të deklaruar nuk konsiderohet i përmbushur nëse informatat e ofruara janë të pasakta apo jo të plota.
3. Doganat e Kosovës i dërgojnë NJIF-K-së kopjet e të gjitha deklaratave të regjistruara në pajtim me paragrafët 1. dhe 2. të këtij neni.
4. Personi, i cili nuk respekton dispozitat e paragrafëve 1. dhe 2. të këtij neni kryen vepër të kundërvajtjes që dënohet me gjobë prej 25 % të shumës së mjeteve monetare të padeklaruara në posedim të tij/saj.
5. Nëpunësi i autorizuar i doganës i lëshon personit që ka kryer kundërvajtje të tillë një njoftim me shkrim në një formular standard, ku deklarohet natyra e veprës kundërvajtëse dhe gjoba e shqiptuar i cila duhet t'i paguhet Doganave të Kosovës menjëherë.
6. Nëse gjoba e shqiptuar nuk paguhet menjëherë, nëpunësi i autorizuar i doganës do t'i konfiskoj dhe mbaj 25% të shumës së mjeteve monetare. Nëse mjetet monetare nuk janë të ndashme në mënyrën që lejon konfiskimin dhe mbajtjen e shumës së saktë të mjeteve monetare të cilat duhet të konfiskohen dhe të mbahen, nëpunësi i autorizuar i doganës do të konfiskojë shumë më të madhe nga vlera, por sa të jetë e mundur ajo duhet të jetë sa më e përafërt me shumën e tillë.
7. Pas konfiskimit sipas paragrafit 6. të këtij neni, nëpunësi i autorizuar i doganës i lëshon personit në fjalë vërtetimin me shkrim ku deklarohen faktet përkatëse, shuma e mjeteve monetare të konfiskuara dhe të mbajtura.

8. Mjetet monetare të konfiskuara dhe të ruajtura në pajtim me këtë nen, nëse është e mundur, do të ruhen në një llogari të posaçme pa kamatë në emër të BQK-së ose lihen në ruajtje të sigurt në BQK për aq kohë derisa të paguhet gjoba e plotë apo siç është urdhëruar nga gjykata kompetente, përkatësisht në mënyrën e paraparë me këtë nen.
9. Gjoba e shqiptuar në përputhje me këtë nen nuk cenon cilëndo procedurë penale ndaj personit.

Lëvizja e mjeteve monetare në dhe jashtë Kosovës –
Parandalimi i shpëlarjes së parave dhe financimit të terrorizmit

10. Doganat e Kosovës do të marrin të gjitha masat e duhura për parandalimin e shpërlarjes së parave dhe financimit të terrorizmit dhe do ta raportojnë tek Njësia e Inteligjencës Financiare e Republikës së Kosovës çdo transaksion të dyshimtë ose financimin e dyshuar të terrorizmit që zbulon gjatë kryerjes së detyrave të saj. Doganat e Kosovës do të mbajnë lidhje me NJIF-K-në, prokurorët, policinë dhe organet tjera përkatëse për qëllimin e kryerjes së këtyre detyrave.
11. Gjatë kryerjes së detyrave të tyre, zyrtarët doganor mund të marrin në pyetje dhe të kontrollojnë persona fizikë, bagazhin e tyre dhe mjetet e transportit dhe mund të konfiskojnë dhe mbajnë mjete monetare në përputhje me këtë nen. Doganat e Kosovës dhe Kodi i Akcizës do të zbatohen në mënyrë të barabartë kur kemi të bëjmë me mjetet monetare sikurse me mallrat.
12. Doganat e Kosovës do të konfiskojnë dhe mbajnë:
    12.1. një person që është duke hyrë apo dalë nga Kosova dhe bartë çfarëdo instrumenti monetare në vlerë dhjetëmijë (10.000) Euro apo që ka tejkaluar shumën dhjetëmijë (10.000) Euro dhe nuk janë deklaruar në pajtim me paragrafët 1. dhe 2. të këtij neni;
    12.2. çdo instrument monetar që bartet nga një person që është duke hyrë apo duke dalë nga Kosova, në qoftë se ekziston dyshimi i arsyeshëm se mjetet e tilla monetare janë fryt i krimit, ose janë përdorur ose kanë pas për qëllim të përdoren për të kryer ose për të lehtësuar shpërlarjen e parave ose janë presupozuar për vepër penale nga e cila kanë buruar frytet e krimit ose janë të lidhura me financimin e terrorizmit.
13. Pas konfiskimit të paraparë me paragrafin 12. të këtij neni, Doganat e Kosovës do t'i lëshojnë personit në fjalë vërtetimin me shkrim ku deklarohet shuma e mjeteve monetare të konfiskuara dhe të mbajtura, faktet përkatëse, duke specifikuar po ashtu nëse gjoba është zbritur nga shuma e konfiskuar në pajtim me paragrafin 4. të këtij neni.
14. Me konfiskimin e mjeteve monetare në bazë të paragrafit 3. të këtij neni, Doganat e Kosovës, pa vonesë, do të:
    14.1. raportojnë për këtë çështje tek NJIF-K-ja;
    14.2. lajmërojnë prokurorin kompetent për të mundësuar hetime/veprime të mëtutjeshme dhe do t'i ofrojnë prokurorit kompetent një kopje të vërtetimit me shkrim cili i është dorëzuar personit në fjalë si dhe të gjitha informatat tjera të kërkuara.
15. Mjetet monetare të konfiskuara dhe të mbajtura nga Doganat e Kosovës në

përputhje me këtë nen duhet, ku ajo mund të jetë e mundur, të ruhen në një llogari të veçantë pa kamatë në emër të BQK-së ose përndryshe të mbahen në kujdestari të sigurt në BQK derisa gjoba nuk paguhet plotësisht ose siç mund të urdhërohet ndryshe nga një gjykatë kompetente ose siç parashihet ndryshe me këtë ligj.

16. Kur mjetet monetare janë konfiskuar në pajtim me paragrafin 12. të këtij neni, brenda dhjetë (10) ditëve nga njoftimi sipas paragrafit 14. të këtij neni, prokurori do të:
    16.1. paraqes një kërkesë për konfiskimin e mjeteve monetare;
    16.2. paraqes një kërkesë për masa të përkohshme të sigurimit të mjeteve monetare; apo
    16.3. njoftojë me shkrim personin në fjalë, Doganat e Kosovës dhe NJIF-K-në se asnjë veprim nuk do të ndërmerret në lidhje me pasurinë e konfiskuar dhe se personi në fjalë mund të aplikoj për kthim të mjeteve monetare në përputhje me paragrafin 17. të këtij neni.
17. Nëse prokurori i jep një njoftim sipas nën-paragrafit 16.3, paragrafi 16. i këtij neni se asnjë veprim nuk do të ndërmerret në lidhje me mjetet e konfiskuara monetare, Dogana e Kosovës, do t'ia kthejë mjetet monetare personit në fjalë pas aplikimin nga ana e tyre.
18. Në qoftë se personi në fjalë nuk është në gjendje të merr personalisht mjetet monetare, atëherë ai/ajo mund të:
    18.1. ti japë autorizim një personi tjetër me anë të të cilit ky person autorizohet që të marrë mjetet e konfiskuara monetare në emër të tij ose të saj dhe/apo t'i ofroj organit kompetent një dokument me shkrim, të nënshkruar dhe të noterizuar duke udhëzuar autoritetin e tillë t'i kthej mjetet monetare një individi tjetër të cekur; ose
    18.2. dorëzojë një kërkesë me shkrim, drejtuar BQK-së, për të depozituar mjetet monetare në një llogari të veçantë të Doganat të Kosovës në emër të personit të tillë deri në kohën kur mjetet monetare të jenë marrë personalisht nga personi në fjalë ose nga një person i autorizuar për ta bërë këtë në përputhje me nën- paragrafin 18.1. të këtij paragrafi.
19. Në qoftë se nuk është bërë kërkesë për kthim të mjeteve monetare në përputhje me paragrafin 18. të këtij neni ose mjetet monetare nuk janë marrë brenda dymbëdhjetë (12) muajsh nga data e mbylljes së procedurës së përcaktuar në këtë nen, mjetet monetare do të konfiskohen në Shërbimin Doganor të Kosovës dhe depozitohen në Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës.
20. Gjatë kryerjes së detyrave të tyre dhe veçanërisht kur veprojnë në pajtueshmëri me nën-paragrafin 12.2., paragrafi 12. i këtij neni të këtij neni, zyrtarët doganor mund të arrestojnë dhe të mbajnë në paraburgim një person duke u bazuar në kushtet e caktuara në Kapitullin XXIV të Kodit të Përkohshëm të Procedurës Penale dhe për qëllime të këtij kodi, zyrtarët doganor gjatë arrestimit dhe mbajtjes në paraburgim të një personi do të njihen si zyrtarë policor.

Neni 30
Inspektimet e pajtueshmërisë nga zyrtarët e NJIF-së

1. Për subjektet raportuese sipas përcaktimin të nën-paragrafëve 1.4 deri 1.8., paragrafi 1. i nenit 16 të këtij ligji, një zyrtar apo zyrtarë të NJIF-K-së të cilët janë

autorizuar nga Drejtori i NJIF-K-së për këtë qëllim (në tekstin e mëtejmë "një zyrtar ose zyrtarë i autorizuar"), mund, në çdo kohë gjatë orarit të zakonshëm të punës, të hyjë në çdo objekt përveç banesës, nëse ekziston dyshimi i arsyeshëm se aty gjenden shënime që mirëmbahen sipas neneve 16 deri 28 të këtij ligji ose dokumente relevante për përcaktimin nëse detyrimet sipas neneve 16 deri 28 të këtij ligji kanë qenë në përputhje me të. Zyrtari ose zyrtarët e autorizuar mund të kërkojnë dhe të inspektojnë shënimet ose dokumentet; kopjojnë ose ndryshe riprodhojnë çdo shënim ose dokument të tillë; dhe të shtrojnë pyetje në mënyrë që të gjejnë dhe të kuptojnë shënimet ose dokumentet e tilla. Zyrtari ose zyrtarët e autorizuar do të kufizojnë inspektimin në atë pjesë të objekteve në të cilat ka të ngjarë të gjinden shënimet ose dokumentet relevante dhe ata do të kryejnë vetëm veprime që janë të nevojshme për, dhe proporcionale me, qëllimin e inspektimit të shënimeve të tilla .

2. Pronari ose personi përgjegjës i objekteve që inspektohen dhe çdo person i pranishëm në këto ambiente do t'iu japin zyrtarëve të autorizuar të gjithë ndihmën e arsyeshme për t'iu mundësuar atyre të kryejnë përgjegjësitë e tyre, duke përfshirë identifikimin e shënimeve apo dokumenteve relevante dhe t'i furnizojnë ata me çdo informacion të kërkuar për t'i mundësuar zyrtarët e autorizuar të gjejnë dhe kuptojnë shënimet apo dokumentet e tilla. Personat e tillë gjithashtu do të ndihmojnë zyrtarët e autorizuar të kenë qasje dhe t'i kopjojnë apo riprodhojnë shënimet dhe dokumentet që mirëmbahen në mënyrë elektronike dhe do të lejojnë përdorimin e çdo pajisjeje për kopjim të vendosur në objekt.
3. Personi në ndërtesat që janë subjekt i një inspektimi sipas paragrafit 1. dhe 2. të këtij neni mund të refuzojë të lejojë inspektimin ose kopjimin e një shënimi ose dokumenti nëse ai/ajo vlerëson se:
   3.1. nuk është mirëmbajtur në përputhje me nenet 16 deri 28 të këtij ligji dhe nuk është relevante për të përcaktuar nëse detyrimet sipas neneve 16 deri 28 të këtij ligji kanë qenë në përputhje; ose
   3.2. përmban informacion që është subjekt i privilegjit avokat-klient.
4. Në rast të një refuzimi të tillë, një zyrtar i autorizuar që kryen inspektimin do ta vendos shënimin apo dokumentin e kontestuar në një zarf ose kuti tjetër të përshtatshme, e cila do të mbyllet në prani të personit apo përfaqësuesit të tij/saj dhe do të firmoset nga zyrtari dhe personi ose përfaqësuesi. Shënimi apo dokumenti i mbyllur do të paraqitet brenda dhjetë (10) ditëve para një gjykatësi të procedurës paraprake të Gjykatës kompetente të qarkut, i cili do të inspektojë atë, dhe të përcaktojë nëse ai, apo ndonjë pjesë e tij, i nënshtrohet inspektimit dhe kopjimit sipas këtij neni.
5. Në qoftë se një person mendon se ai/ajo kanë qenë subjekt i veprimeve në paragrafin 1. dhe 2. të këtij neni të cilat janë të paligjshme, ai/ajo mund të paraqesë një ankesë brenda 30 ditëve që nga dita e inspektimit të një gjykatësi të procedurës paraprake të Gjykatës kompetente të qarkut i cili do të gjykoj ligjshmërinë e veprimeve të përmendura në ankesë dhe të vendosë për kompensim kur është e përshtatshme. Zyrtarët e autorizuar të NJIF-K-së do të sigurojnë gjykatësit hetues dokumente të tilla që ai ose ajo do të kërkojnë dhe sipas kërkesës, do të ofrojnë dëshmi gojore.

KREU IV
SANKSIONET DHE KUNDËRVAJTJET

Neni 31
Sanksionet administrative

1. Një vendim i marrë nga NJIF-K-ja, përmes së cilit njoftohet obliguesi i dështimit për të përmbushur kërkesat e nën-paragrafit 1.3, paragrafi 1. i nenit 14 të këtij ligji do të përbëjë një shkelje të detyrimeve të përcaktuara sipas këtij ligji, i cili do t'i nënshtrohet një sanksioni administrativ në formën e një gjobe prej pesëqind (500) Euro për çdo ditë të mos përmbushjes duke filluar nga data e njoftimit.
2. Shqiptimi i sanksionit mund të kontestohet para ndonjë gjykate kompetente.

Neni 32
Veprat penale

1. Gjykatat e qarkut kanë juridiksion të plotë për të gjitha veprat penale sipas këtij neni.

Shpërlarja e parave

2. Kushdo që, duke e ditur ose që ka arsye për të ditur se pasuria e caktuar buron nga ndonjë formë e aktivitetit kriminal, pasuri kjo e cila në të vërtetë fitohet me vepër penale apo kushdo që, duke besuar se pasuria e caktuar fitohet nga ndonjë formë e aktivitetit kriminal bazuar në përfaqësimet e bëra si pjesë e një hetimi zbulues të zhvilluar në pajtim me Kapitullin XXIX të Kodit të procedurës penale të Kosovës:
   2.1. konverton, transferon ose përpiqet të konvertojë apo transferojë pasurinë me qëllim të fshehjes apo të maskimit të natyrës, burimit, vendit, dispozicionit, lëvizjes ose pronësisë së pasurisë;
   2.2. konverton, transferon ose përpiqet të konvertojë apo transferojë pasurinë me qëllim të ndihmës së personit i cili është i përfshirë në të ose që, siç pandehet, është i përfshirë në kryerjen e veprës penale që ka shkaktuar shmangien e pasojave ligjore apo të pasojave të qarta ligjore të veprimeve të tij/saj;
   2.3. konverton, transferon ose përpiqet të konvertojë apo transferojë pasurinë me qëllim të shmangies së detyrimit të raportimit sipas këtij ligji;
   2.4. konverton, transferon ose përpiqet të konvertojë apo transferojë pasurinë me qëllim të nxitjes së aktivitetit të ndërlidhur kriminal; apo
   2.5. merr, posedon ose shfrytëzon apo përpiqet të marrë, të posedojë ose të shfrytëzojë pasurinë;
   2.6. fsheh ose maskon natyrën e vërtetë, burimin, vendndodhjen, sistemimin, lëvizjen, të drejtat në lidhje me, apo pronësinë e pasurisë, ose nga një akt i pjesëmarrjes në veprimtari të tilla;
   2.7. merr pjesë në, bashkëpunon dhe ndihmon për të kryer, nxit, lehtëson dhe këshillon në kryerjen e ndonjë prej veprimeve të përmendura në nën-paragrafët 2.1. deri në 2.6. të këtij paragrafi;

2.8. kryen vepër penale të dënueshme me një afat burgosjeje deri në dhjetë (10) vjet dhe me gjobë deri në tri (3) herë më të madhe në vlerë të pasurisë e cila është subjekt i veprës penale.

3. Për qëllime të paragrafit 2. të këtij neni përfaqësimet mund të jenë bazë për të besuar se pasuria e caktuar përbën pasuri të fituar me anë të veprës penale, madje edhe nëse ato përfaqësime vetëm tërthorazi mbështesin besimin se ajo përbën pasuri të fituar me anë të veprës penale.
4. Pa cenuar ligjin penal në fuqi lidhur me personin i cili ka kryer veprat e ndërlidhura penale jashtë fushëveprimit të këtij paragrafi:
   4.1. personi mund të dënohet për vepër penale të shpërlarjes së parave madje edhe nëse nuk ka qenë i dënuar asnjëherë për vepër të ndërlidhur penale prej të cilës është nxjerrë pasuria e fituar me anë të veprës penale;
   4.2. i njëjti person mund të ndiqet dhe të dënohet në procedura të veçanta për vepra penale të shpërlarjes së parave dhe të veprës së ndërlidhur penale prej të cilës është nxjerrë pasuria e fituar me anë të veprës penale; dhe
   4.3. gjykatat e Kosovës mund të kenë juridiksion mbi veprën penale të shpërlarjes së parave, madje edhe nëse ato nuk kanë juridiksion territorial mbi veprat e ndërlidhura penale prej të cilave është nxjerrë pasuria e fituar me anë të veprës penale të shpërlarjes së parave, ngaqë ka qenë kryer jashtë Kosovës.

Neni 33
Veprat e tjera penale

1. Gjykatat e qarkut kanë juridiksion të plotë për të gjitha veprat penale sipas këtij neni.
2. Kushdo, që duke siguruar ndonjë informacion ose duke raportuar dhe duke bërë certifikata ose deklarime në pajtim me nenin 17, paragrafët 2. dhe 3. të nenit 18, paragrafët 1. dhe 2. të nenit 19, paragrafin 3. të nenit 20, paragrafin 2. të nenit 21, paragrafët 1. 2. dhe 3. të nenit 22., paragrafëve 4. deri 7. të nenit 24, paragrafëve 3. deri 6. të nenit 25, paragrafëve 3. deri 8. të nenit 26, paragrafit 2. të nenit 27, paragrafëve 2. dhe 3. të nenit 28 të këtij ligji, me dije:
   2.1. bën çfarëdo deklarate të rëndësishme të rrejshme ose me qëllim nuk i zbulon informacionet e rëndësishme;
   2.2. bën apo shfrytëzon çfarëdo dokumenti duke e ditur se dokumenti përmban deklaratë ose shënime të rëndësishme të rrejshme, mos tregim material ose gabim material,
   2.3. kryen vepër penale të dënueshme me burgim deri në pesë (5) vjet dhe me gjobë deri në njëqindmijë (100.000) Euro.
3. Kushdo që me dashje:
   3.1. shkatërron ose largon çfarëdo shënimesh që duhet të mbahen në pajtim me paragrafin 7. të nenit 18, paragrafin 3. të nenit 20, paragrafin 4. të nenit 24 ose paragrafin 3. të nenit 25 të këtij ligji;
   3.2. nuk raporton në pajtim me paragrafët 1. dhe 2. të nenit 22, paragrafit 5. të nenit 24, paragrafit 4. të nenit 25, paragrafit 3. të nenit 26 apo paragrafit 3. të nenit 28 të këtij ligji;
   3.3. Kryen vepër penale të dënueshme me burgim deri në dy (2) vjet dhe me

gjobë deri në njëqindmijë (100.000) Euro. Nëse çfarëdo vepre penale e paraparë me këtë paragraf kryhet me qëllim të pengimit të rolit rregullues ose funksionit të zbatimit të ligjit, kryerësi do të dënohet me burgim deri në pesë (5) vjet dhe me gjobë deri në njëqindmijë (100.000) Euro.

4. Personi që vepron në cilësi të bankës, institucionit financiar apo nëpunësit, drejtorit, agjentit ose punonjësit të bankës apo institucionit financiar, i cili me dashje shkel paragrafin 4. të nenit 22 të këtij ligji, kryen vepër penale të dënueshme me burgim deri në dy (2) vjet dhe/ose me gjobë deri në njëqindmijë (100.000) Euro. Nëse ndonjëra prej veprave penale të specifikuara në këtë paragraf kryhet me qëllim të pengimit të ndonjë roli rregullues ose funksioni të zbatimit të ligjit, kryerësi do të dënohet me burgim deri në pesë (5) vjet dhe/ose me gjobë deri në njëqindmijë (100.000) Euro.
5. Kushdo që me dashje pranon ose paguan valutën në kundërshtim me nenet 24 apo 25 të këtij ligji, kryen vepër penale të dënueshme me burgim deri në dy (2) vjet dhe me gjobë deri në pesëmijë (5.000) Euro ose me dyfishin e shumës së valutës së pranuar apo të paguar, cilado prej tyre që është më e lartë.
6. Një zyrtar i NJIF-K-së, i cili me dashje:
   6.1. raporton informacionin ose zbulon informacionin në pajtim me paragrafët 1. dhe 2. të nenit 15 të këtij ligji apo ia zbulon informacionin prokurorit publik apo një gjykate, duke e ditur se informacioni i tillë përmban falsitete, pasaktësi, ose gabime të rëndësishme
   6.2. shkatërron ose largon çfarëdo të dhëna të cilat duhet të mblidhen nga NJIF-K-ja në pajtim me këtë ligj, ndryshe nga ç'është paraparë me politikën e mbajtjes dhe të shkatërrimit të dokumenteve të krijuar nga NJIF-K-ja; apo
   6.3. zbulon çfarëdo informacioni të përshkruar në paragrafin 1. të neni 15 ndryshe nga ç'është paraparë me paragrafin 2. të neni 15, përveç nëse është i autorizuar me shkrim nga Drejtori i NJIF-K-së,
   6.4. kryen vepër penale të dënueshme me burgim deri në dy (2) vite dhe me gjobë deri në njëqindmijë (100.000) Euro. Nëse vepra penale e përcaktuar në këtë paragraf kryhet me qëllim të pengimit të rolit rregullues apo funksionit të zbatimit të ligjit, kryerësi do të dënohet me burgim deri në dhjetë (10) vjet dhe me gjobë deri në njëqindmijë (100.000) Euro.
7. Informacioni ose dështimi i sigurimit të informacionit mund të jetë i rëndësishëm edhe nëse pranuesi nuk është ndikuar apo çorientuar nga ato.
8. Kushdo që vepron në cilësinë e bankës apo institucionit financiar sipas përkufizimit në këtë ligj pa regjistrim në pajtim me nenin 3.1 të Rregullores mbi Bankat kryen vepër penale të dënueshme me burgim deri në një (1) vit ose me gjobë deri në njëqindmijë (100.000) Euro.
9. Kushdo që kundërligjshëm refuzon apo pengon inspektimin e ligjshëm të ndërmarrë në pajtim me paragrafin 1. dhe 2. të neni 30 të këtij ligji ose me dashje fsheh shënimet që duhet të mbahen dhe të paraqiten në pajtim me këtë ligj, kryen vepër penale të dënueshme me burgim deri në një vit dhe me gjobë deri në njëqindmijë (100.000) Euro.
10. Kushdo që me dashje shkel rregullën me të cilën urdhërohet masa e përkohshme për sigurimin e pasurisë sipas nenit 34 të këtij ligji, kryen vepër penale të dënueshme me burgim deri në pesë (5) vjet dhe me gjobë deri në njëqindmijë (100.000) Euro.

11. Për qëllime të paragrafëve 2., 6., 9. dhe 10 të nenit 32 të këtij ligji akt "me dashje" konsiderohet akti i cili kryhet jo vetëm qëllimisht, por edhe me dashje dhe që nuk kryhet paqëllimshëm nga pakujdesia ose rastësisht.

Neni 34
Përgjegjësia penale e personave juridik

1. Nëse një person juridik kryen një vepër penale sipas këtij ligji, çdo drejtor dhe person tjetër në lidhje me menaxhimin e personit juridik (dhe çdo person që pretendon të veproj në kapacitet të tillë) kryen vepër penale përveç nëse ai person dëshmon se:
   1.1. vepra penale është kryer pa pëlqimin apo dijeninë e tij/saj; dhe
   1.2. personi ka ndërmarr hapa të arsyeshëm për të parandaluar kryerjen e veprës që do të ishte ushtruar nga ai person duke pas parasysh natyrën e funksioneve të tij/saj në atë kapacitet.

Neni 35
Lirimi nga përgjegjësia

Pavarësisht nga dispozitat kundërthënëse të ligjit në fuqi, asnjë veprim për përgjegjësinë civile a penale dhe asnjë sanksion profesional nuk mund të ndërmerret ndaj ndonjë personi apo Subjekti bazuar vetëm në transmetimin e informatave në mirëbesim, dorëzimin e raporteve apo veprimeve të tjera në pajtim me këtë ligj, apo transmetimin vullnetar të informatave në mirëbesim lidhur me aktin apo transaksionin e dyshimtë, shpëlarjen e dyshimtë të parave apo financimin e dyshimtë të aktiviteteve terroriste tek NJIF-K-ja.

KREU V
BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR

Neni 36
Qëllimi dhe fushëveprimi

1. Autoritetet kompetente të Kosovës ndërmarrin sigurimin e masave më të gjera të mundshme të bashkëpunimit me autoritetet e shteteve të huaja me qëllim të këmbimit të informacioneve, hetimeve dhe procedurave gjyqësore në lidhje me masat e përkohshme për sigurimin e pasurisë dhe urdhrave për konfiskim lidhur me mjetet e shpëlarjes së parave dhe pasurinë e fituar me anë të veprës penale dhe me qëllim të ndjekjes së kryerësve të shpëlarjes së parave dhe aktivitetit terrorist.
2. Procedurat për sigurimin e bashkëpunimit sipas paragrafit 1. të këtij neni janë përcaktuar në këtë Kapitull dhe në dispozitat e tjera të tilla përkatëse të ligjit në fuqi të cilat nuk janë në kundërshtim me të.
3. Një kërkesë e bërë sipas këtij neni duhet të dërgohet përmes kanaleve diplomatike në pajtueshmëri me ligjet dhe marrëveshjet në fuqi, i cili e dërgon atë te drejtori i Departamentit Ligjor në Ministrinë e Drejtësisë.

KREU VI
SEKRETI PROFESIONAL

Neni 37
Sekreti profesional

1. Pavarësisht nga dispozitat kundërthënëse të ligjit në fuqi, sekreti profesional nuk mund të përdoret si arsye për refuzimin e sigurimit të informatave që:
   1.1. duhet zbuluar në pajtim me këtë ligj; ose
   1.2. janë mbledhur dhe ruajtur në pajtim me këtë ligj dhe kërkohen qoftë nga NJIF-K-ja, qoftë nga policia lidhur me një hetim për larjen e parave të urdhëruar apo të kryer nën mbikëqyrjen e prokurorit apo gjyqtarit hetues.
2. Ky nen nuk do të ketë pasoja për nën-paragrafin 3.2., paragrafi 3. i nenit 30 të këtij ligji.

KREU VII
DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 38
Zbatimi

Ministria e Ekonomisë dhe Financave mund të nxjerrë udhëzime administrative për zbatimin e këtij ligji.

Neni 39
Dispozitat shfuqizuese

Ky ligj shfuqizon dhe zëvendëson Rregulloren e UNMIK-ut 2004/2 mbi Pengimin e shpëlarjes së parave dhe veprave të ngjashme penale.

KREU VIII
DISPOZITAT KALIMTARE

Neni 40
Dispozitat kalimtare nga EULEX-i tek Kosova

Të gjitha të dhënat e mbledhura nga QIF, sipas Rregullores së UNMIK- ut 2004/02, do të barten te NJIF-K-ja. Pas transferit të përgjegjësive nga QIF-ja tek NJIF-K-ja dhe për aq kohë sa do zgjasë mandati i tij, misioni i EULEX-it në Kosovë do ta ketë autoritetin e nevojshëm për të ushtruar në mënyrë efektive mandatin e tij në fushën e sundimit të ligjit siç përcaktohet në instrumentet përkatëse ligjore. Aspektet përkatëse të kalimit të përgjegjësive nga QIF-ja tek NJIF-K-ja aktivitetet e misionit të EULEX-it në Kosovë, bashkëpunimi dhe qasja në informacione do të dakordohet me një marrëveshje të ndarë në mes të misionit të EULEX-it në Kosovë dhe Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave.

Neni 41

Pavarësisht ndonjë dispozitë të këtij ligji apo ndonjë ligji tjetër, Ministri i Ekonomisë dhe Financave mund t'ia delegoj një pale të tretë autoritetin për të ushtruar funksionet që i janë përcaktuar atij me këtë ligj apo ndonjë ligj tjetër, që janë subjekt i marrëveshjes në mes të MEF-it dhe palës së tretë.

Neni 42
Hyrja në fuqi

Pos aty ku është thënë shprehimisht një datë e mëvonshme e hyrjes në fuqi në nene të caktuara, ky ligj do të hyjë në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ligji Nr. 03/ L-196
30 shtator 2010

Shpallur me dekretin Nr. DL-055-2010, datë 18.10.2010 nga u.d. Presidenti i Republikës së Kosovës, Dr. Jakup Krasniqi.

GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS / PRISHTINË: VITI V / Nr. 85 / 09 NËNTOR 2010

LIGJI Nr. 04/L-178
PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT Nr. 03/L-196 PËR PARANDALIMIN E PASTRIMIT TË PARAVE DHE PARANDALIMIN E FINANCIMIT TË TERRORIZMIT

Kuvendi i Republikës së Kosovës;

Në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton

LIGJ PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT Nr. 03/L-196 PËR PARANDALIMIN E PASTRIMIT TË PARAVE DHE PARANDALIMIN E FINANCIMIT TË TERRORIZMIT

Neni 1

1. Neni 2 i ligjit bazik, nënparagrafi 1.9. riformulohet me tekstin si në vijim:
   1.9. **Klienti** - çdo person që kryen, apo bën përpjekje për të kryer, një transaksion me ose përdor shërbimet e një subjekti raportues siç përcaktohet në nenin 16, dhe do të përfshijë çdo pronar ose shfrytëzues ose person ose entitet tjetër në emër të cilit është kryer transaksioni apo janë pranuar shërbimet;
2. Neni 2 i ligjit bazik, nënparagrafi 1.13. riformulohet me tekstin si në vijim:
   1.13. **FATF** - do të thotë "Task Forca e Veprimit Financiar" që është trup i pavarur ndër-qeveritar që zhvillon dhe promovon politika për të mbrojtur sistemin financiar global kundër pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe financimit të përhapjes së armëve të shkatërrimit në masë;
3. Neni 2 i ligjit bazik, nënparagrafi 1.26. fshihet nga teksti i ligjit.
4. Neni 2 i ligjit bazik, nënparagrafi 1.35. riformulohet me tekstin si në vijim:
   1.35. **Akti ose Transaksioni i Dyshimtë** - një akt ose transaksion, ose një akt ose transaksion i tentuar, që gjeneron një dyshim të arsyeshëm se pasuria e përfshirë në aktin apo transaksionin, ose në aktin ose transaksionin e tentuar, është produkt i krimit dhe do të interpretohet në përputhje me çdo udhëzim të lëshuar nga NjIF-ja për aktet apo transaksionet e dyshimta;
5. Neni 2 i ligjit bazik, pas nën paragrafit 1.39. shtohen nënparagrafët e rinj 1.40., 1.41. 1.42. me tekstin si në vijim:
   1.40. **Aktiviteti kriminal -** nënkupton çdo lloj përfshirje kriminale në kryerjen e një vepre penale, siç përcaktohet në bazë të ligjeve të Kosovës
   1.41. **Personat e ekspozuar politikisht** - nënkupton personat fizik të cilët janë ose kanë qenë të besuar me funksione të shquara publike dhe anëtarët e ngushtë të familjes së tyre, apo persona të njohur të jenë bashkëpunëtorë të ngushtë,

të personave të tillë. NjIF-ja në konsultim me Ministrinë e Financave mund të lëshojë një akt nënligjor për të përcaktuar funksionet publike të shquara dhe anëtarët e familjes së ngushtë të këtyre personave.

1.42. **Akt Terrorist** - nënkupton definicionin e përcaktuar me Kodin Penal të Kosovës.

Neni 2

Në tërë tekstin e ligjit bazik referencat "**Rregulloreve të UNMIK-ut**" zëvendësohet me fjalën "**sipas ligjit në fuqi në Republikën e Kosovës**".

Neni 3

Neni 3 i ligjit bazik riformulohet me tekstin si në vijim:

Neni 3
Prokuroria speciale

Veprat penale sipas këtij ligji dhe ligjit bazik hyjnë në kompetencën ekskluzive të Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës e themeluar me anë të Ligjit nr. 03/L-052 për Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës.

Neni 4

Neni 11 i ligjit bazik, paragrafi 2. riformulohet me tekstin si në vijim:

2. Drejtori i NJIF-K-së emëron Zëvendës Drejtorin e NJIF-K-së dhe në formë të shkruar i delegon detyra.

Neni 5

1. Neni 15 i ligjit bazik, pas paragrafit 1. shtohet paragrafi i ri 1.a me tekstin si në vijim:
   1.a. NJIF-ja është në gjendje për të shkëmbyer ndërkombëtarisht të gjitha informatat që mund të jenë të arritshme apo të mundura direkt ose indirekt nga NjIF-ja.
2. Neni 15 i ligjit bazik, paragrafi 2., pas tekstit "**mund të bëhen publike"** shtohet teksti "**me iniciativën e vet ose me kërkesë**", pjesa tjetër e fjalisë mbetet e njëjtë.

Neni 6

Neni 16 i ligjit bazik, paragrafi 1., pas nën-paragrafit 1.8. shtohen nën-paragrafët e rinj 1.9. 1.10. 1.11., 1.12. me tekstin si në vijim:

1.9. Organizatat Jo-Qeveritare;
1.10. Subjektet Politike;
1.11. Shitësit e metaleve të çmuara dhe tregtarët me gurë të çmuar;
1.12. Kompanitë e ndërtimit.

Neni 7

1. Neni 17 i ligjit bazik, paragrafi 1. nën-paragrafët 1.1., 1.2. dhe 1.3. riformulohen me tekstin si në vijim:
   1.1. të gjitha subjektet raportuese do të përcaktojnë, në mënyrë të vazhdueshme, rrezikun e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit të paraqitur nga klientët e tyre dhe të personave tjerë të cilëve ato u ofrojnë shërbime financiare. Kur subjektet raportuese përcaktojnë qe rreziku i pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit është ngritur, ata do të marrin masat e përcaktuara në paragrafin 1. të nenit 21, shtesë masave të përcaktuara në këtë nen.
   1.2. të gjitha subjektet raportuese duhet të identifikojnë pronarin përfitues dhe/ose një person ose personat fizik të cilët kontrollojnë drejtpërdrejt ose tërthorazi njëzet përqind (20%) ose më shumë të një personi juridik. Ku subjektet raportuese konsiderojnë se rreziku i pastrimit të parave apo financimin e terrorizmit është i lartë, ata do të marrin masa të arsyeshme për të verifikuar identitetin e tij ose të saj në mënyrë që institucioni apo personi që mbulohet nga ky ligj është i bindur se ai e di se kush është pronari përfitues, duke përfshirë, sa i përket personave juridike, trustet dhe aranzhimet e ngjashme ligjore, duke marrë masa bazuar në rrezik dhe adekuate për të kuptuar strukturën e pronësisë dhe kontrollit të klientit.
   1.3. të gjitha subjektet raportuese duhet të marrin informacion mbi qëllimin dhe natyrën e synuar të marrëdhënies së biznesit, si dhe monitorimin e marrëdhënieve të biznesit, duke përfshirë shqyrtimin e transaksioneve të bëra gjatë kohës së marrëdhënieve për tu siguruar që transaksionet e kryera janë në përputhje me njohuritë e personit të njësive raportuese apo personave të konsumatorit. Rregullatori kompetent mund të lëshojë instruksionet e detyrueshme në lidhje me këtë.
2. Neni 17 i ligjit bazik, paragrafi 1., nën-paragrafi 1.4. fshihet nga teksti i ligjit.
3. Neni 17 i ligjit bazik, paragrafi 2. nën-paragrafi 2.2.1. riformulohet me tekstin si në vijim:
   2.2.1. një transaksion në monedhë në shumën e barabartë me ose më lart se dhjetëmijë (10,000) Euro, nëse i kryer si një transaksion i vetëm ose disa transaksione që duket të jenë të ndërlidhura. Nëse shuma e transaksioneve nuk dihet në kohën e veprimit, identifikimi duhet të bëhet në momentin kur shuma monetare bëhet e njohur apo pragu është arritur; ose

Neni 8

1. Neni 18 i ligjit bazik, paragrafi 1. riformulohet me tekstin si në vijim:
   1. Bankat, institucionet financiare dhe kreditore janë të ndaluara nga mbajtja e llogarive anonime ose librezave bankare anonime. Bankat dhe institucionet financiare duhet të zbatojnë masat e përcaktuara në këtë ligj të klientëve dhe të llogarive të tyre të cilët janë anonime, dhe llogaritë e tilla nuk mund të përdoren për procesin e transaksioneve derisa pronarët dhe përfituesit e llogarive anonime ose të librezave bankare ekzistuese anonime të janë bërë objekt i masave të tilla sa më shpejt që të jetë e mundur.

2. Neni 18 i ligjit bazik, paragrafi 2. nënparagrafi 2.5. riformulohet me tekstin si në vijim:
   2.5. Angazhimi në çdo transaksion të vetëm në vlerën prej dhjetë mijë (10,000) euro ose më shumë. Transaksionet në monedha të shumëfishta do të trajtohen si një transaksion i vetëm nëse banka ose institucioni financiar është në dijeni se transaksionet janë kryer nga ose në emër të një personi ose subjekti dhe shuma e përgjithshme prej dhjetë mijë (10,000) euro ose më shumë është bërë në një ditë vetme.
3. Neni 18 i ligjit bazik, paragrafi 6. referenca "**paragrafi 1. i nenit 21 të këtij ligji**" fshihet dhe zëvendësohet me referencën "**paragrafi 2. i nenit 22 i këtij ligji**."
4. Neni 18 i ligjit bazik, paragrafi 7. fshihet nga teksti i ligjit.

Neni 9

1. Neni 19 i ligjit bazik, paragrafi 1. riformulohet me tekstin si në vijim:
   1. Bankat dhe institucionet financiare aktivitetet e të cilave përfshijnë transfere elektronike do të marrin dhe verifikojnë emrin e plotë, numrin e llogarisë, adresën, ose në mungesë të adresës numrin e dokumentit të identifikimit, ose datën dhe vendin e lindjes, duke përfshirë kur është e nevojshme emrin e institucionit financiar, të autorit të transfereve të tilla. Informacioni do të përfshihet në mesazhin ose formularin e pagesës që shoqëron transferin. Nëse nuk ka numër llogarie, një numër unik referencë do të shoqërojë transferin.
2. Neni 19 i ligjit bazik, paragrafi 4. riformulohet me tekstin si në vijim:
   4. Paragrafët 1. dhe 2. të këtij neni nuk zbatohen për transfere të ekzekutuara si rezultat i transaksioneve me kartë krediti ose kartë debiti, me kusht që numri i kartës së kreditit ose kartës së debitit të shoqëron transferin e rezultuar nga transaksioni, dhe nuk do të zbatohet për transfere midis bankave dhe/ose institucioneve financiare ku të dy iniciatori dhe përfituesi janë banka apo institucione financiare që veprojnë në emër të tyre.

Neni 10

1. Neni 21 i ligjit bazik, paragrafi 1. riformulohet me tekstin si në vijim:
   1. Kur subjektet e raportimit përcaktojnë, në përputhje me paragrafin 1. të nenit 17, se rreziku i pastrimit të parave apo financimi të terrorizmit është ngritur, ata do të marrin masa të arsyeshme për të mbajtur të azhurnuara informacionet e mbledhura në pajtim me nenin 17, dhe të zbatojnë masat e arsyeshme të shtuara për të monitoruar profilin e biznesit dhe të rrezikut, duke përfshirë burimin e fondeve, dhe të sigurojnë që të dhënat dhe informacionet e tjera janë mbajtur të azhurnuara. Rregullatori kompetent mund të nxjerrë udhëzime të detyrueshme në lidhje me to.
2. Neni 21 i ligjit bazik, paragrafi 5. riformulohet me tekstin si në vijim:
   5. Subjektet raportuese duhet të marrin masa të arsyeshme për të përcaktuar nëse klientët e tyre janë persona të ekspozuar politikisht vendas, dhe nëse përcaktimi i tillë rezulton që një klienti të jetë një person i ekspozuar

politikisht vendas, atëherë subjektet raportuese duhet të marrin masat e përcaktuara në nenin 19 paragrafi 1., në lidhje me e klientët e tillë.

5.1. Subjektet raportuese duhet të sigurojnë që ata të përcaktojnë nëse klientët e tyre janë persona të ekspozuar politikisht të huaj, dhe përcaktimi i tillë rezulton që një klient të jetë një person i ekspozuar politikisht i huaj, atëherë subjektet raportuese duhet të marrin masat e mëposhtme:

5.1.1. të marrin miratimin e një oficeri të subjektit raportues;

5.1.2. të marrin masa të përshtatshme për të krijuar origjinën e mjeteve të përdorura në marrëdhënie ose transaksion; dhe

5.1.3. të sigurohet monitorimi i vazhdueshëm dhe i forcuar i llogarisë dhe marrëdhënies.

3. Neni 21 i ligjit bazik, paragrafët 6. dhe 7. riformulohen me tekstin si në vijim:

6. Ndërmjetësuesit financiar nuk mund të hapin ose të mirëmbajnë llogaritë korresponduese me një bankë fiktive ose një bankë e cila është e njohur që lejon përdorimin e llogarive fiktive.

7. Institucionet dhe personat që i nënshtrohen këtij ligji, do ti kushtojnë vëmendje të veçantë ndonjë rreziku të pastrimit të parave apo financimit të terrorizmit në lidhje me produktet apo transaksionet që promovojnë anonimitetin dhe të marrin të gjitha masat e nevojshme për të parandaluar përdorimin e tij për qëllime të pastrimit të parave apo financimit të terrorizmit.

4. Neni 21 i ligjit bazik**,** pas paragrafit 7. shtohen paragrafët të rinj 8. dhe 9. me tekstin si në vijim:

8. Shitësit në metale të çmuara dhe tregtarët në gurë të çmuar do të raportojnë çdo akt apo transaksion të dyshimtë tek NjIF-ja brenda tri (3) ditëve të punës dhe para ndërmarrjes së veprimeve të mëtejshme në lidhje me ndonjë transaksion të tillë apo akter. Raportet do të përgatiten në formën dhe mënyrën e rekomanduar nga NJIF-ja.

9. Kompanitë e ndërtimit do të raportojnë çdo akt apo transaksion të dyshimtë tek NjIF-ja brenda tri (3) ditëve të punës dhe para ndërmarrjes së veprimeve të mëtejshme në lidhje me ndonjë transaksion të tillë apo akter. Raportet do të përgatiten në formën dhe mënyrën e rekomanduar nga NJIF-ja.

Neni 11

1. Neni 22 i ligjit bazik, paragrafi 2. referenca "**paragrafin 1. të nenit 21 të këtij ligji**" zëvendësohet me referencën "**paragrafi 1. neni 22 i këtij ligji"**.
2. Neni 22 i ligjit bazik**,** paragrafi 3. referenca "**paragrafi 1. i nenit 21 të këtij ligji**" zëvendësohet me referencën"**paragrafi 1. neni 22 i këtij ligji".**
3. Neni 22 i ligjit bazik, paragrafi 6. referenca "**paragrafin 5. të nenit 21 të këtij ligji**" zëvendësohet me referencën "**paragrafi 5. neni 22 i këtij ligji".**

Neni 12

1. Neni 23 i ligjit bazik, paragrafi 1., togfjalëshi **"personi kontaktues"** fshihet dhe zëvendësohet me togfjalëshin **"zyrtari i pajtueshmërisë",** pjesa tjetër e fjalisë mbetet e njëjtë.

2. Neni 23 i ligjit bazik, në paragrafët 1. dhe 3. pas shkurtesës "**NjIF**" shtohet lidhëza dhe shkurtesa "**dhe BQK**", pjesa tjetër e fjalisë mbetet e njëjtë.

Neni 13

1. Neni 24 i ligjit bazik, pas paragrafit 9. shtohet paragrafi i ri 10. me tekstin si në vijim:
   10. Drejtorët, zyrtarët, punonjësit dhe agjentët e OJQ-ve që bëjnë ose transmetojnë raporte në pajtim me këtë nen nuk do të japin raport, apo të komunikojnë ndonjë informacion që gjendet në raport apo në lidhje me raportin, tek ndonjë person apo subjekt, duke përfshirë çfarëdo personi ose subjekti, duke përfshirë ndonjë person apo subjekt të përfshirë në transaksion i cili është subjekt i raportit, përveç NjIF-së, përveç nëse autorizohet me shkrim nga NjIF-ja, një Prokuror, ose një Gjykatë.

Neni 14

Neni 25 i ligjit bazik, pas paragrafit 8. shtohet paragrafi i ri 9. me tekstin si në vijim:
   9. Drejtorët, zyrtarët, punonjësit dhe agjentët e partive politike dhe kandidatëve të regjistruar që bëjnë ose transmetojnë raporte në pajtim me këtë nen nuk do të japin raport, apo të komunikojnë ndonjë informacion që gjendet në raport apo në lidhje me raportin, për çdo person apo subjekt, duke përfshirë çdo person ose subjekt të përfshirë në transaksion i cili është subjekt i raportit, përveç NjIF-së.

Neni 15

1. Neni 26 i ligjit bazik, paragrafi 12. nënparagrafi 12.3. referenca "**paragrafit 3 deri 9 i nenit 24 të këtij ligji**" fshihet dhe zëvendësohet me referencën "**paragrafët 3 deri 9 i nenit 26 të këtij ligji.**
2. Neni 26 i ligjit bazik, pas paragrafit 13. shtohet paragrafi i ri 13.a. me tekstin si në vijim:
   13.a. Drejtorët, zyrtarët, punonjësit dhe agjentët "profesionistëve të mbuluar" që bëjnë ose transmetojnë raporte në pajtim me këtë nen nuk do të japin raport, apo të komunikojnë ndonjë informacion që gjendet në raport apo në lidhje me raportin, për ndonjë person apo subjekt, duke përfshirë ndonjë person ose subjekt të përfshirë në transaksion i cili është subjekt i raportit, përveç NjIF-së përveç nëse autorizohet me shkrim nga NjIF-ja, një Prokuror, ose një Gjykatë.

Neni 16

1. Neni 27 i ligjit bazik, paragrafi 1. riformulohet me tekstin si në vijim:
   1. Kur bartja e të drejtave mbi pronën e paluajtshme përfshin një transaksion ose transaksione të një sasie monetare prej dhjetëmijë (10,000) euro ose më shumë, secili transaksion duhet të bëhet me anë të urdhërpagesës ose transferit bankar.

Neni 17

Neni 28 i ligjit bazik riformulohet me tekstin si në vijim:

Neni 28
Detyrimet shtesë të kazinove dhe shtëpive tjera të lojërave të fatit

1. Kazinotë dhe Objektet e Licencuara të Lojërave të Fatit, të përcaktuara në nenin 2 janë subjekt i dispozitave të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit të këtij ligji dhe janë të detyruar të marrin masa specifike për të adresuar rrezikun e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit në ofrimin e shërbimeve të lojërave të fatit.
2. Kazinotë dhe Objektet e Licencuara të Lojërave të Fatit do të verifikojnë dhe të regjistrojnë në mënyrë të përhershme identitetin e klientit para se të hyjë në një transaksion ose transaksione të shumta ose të ndërlidhura për të shitur, blerë, transferuar, ose shkëmbyer zhetonët, çipat, ose ndonjë dëshmi tjetër të vlerës në shumën prej dymijë (2,000) euro ose më shumë apo vlerës ekuivalente në monedhë të huaj. Verifikimi dhe regjistrimi i identitetit shtrihet edhe për transaksionet financiare si hapja e një llogarie (duke përfshirë llogarinë e kursimeve), një transfer elektronik ose një shkëmbim i monedhës në shumën prej dymijë (2,000) euro ose më shumë apo ekuivalente në monedhë të huaj. Nëse Kazinoja, Objekti i Lojërave të Fatit ose Objekti i licencuar i lojërave të fatit, nuk është në gjendje për të verifikuar identitetin e një klienti, ai nuk do të hyjë në transaksion.
3. Kazinotë dhe Objektet e licencuara të lojërave të fatit duhet të raportojnë tek NjIF-ja, në mënyrën dhe në formatin e specifikuar nga NjIF-ja:
   3.1. të gjitha aktet e dyshimta, transaksionet apo transaksionet e tentuara brenda njëzet e katër (24) orëve nga koha kur akti, transaksioni apo transaksioni tentativë i identifikuar si i dyshimtë;
   3.2. të gjitha transaksionet e vetme në monedhë prej dhjetëmijë (10,000) euro ose më shumë. Transaksione të shumta të ndërlidhura do të trajtohen si një transaksion i vetëm, nëse Kazinoja, Objekti i lojërave të fatit apo Objekti i licencuar i lojërave të fatit di, apo është dashur të dijë, se transaksionet nga ose në emër të një personi ose subjekti dhe të totalit më shumë se dhjetë mijë (10,000) euro në një ditë të vetme të lojërave të fatit.
4. Shtëpitë e lojërave nuk do të angazhohen në ndonjë nga transaksionet në vijim:
   4.1. Shkëmbimin e të hollave me të holla me një klient, ose me një pranues tjetër në emër të klientit, në çdo transaksion në të cilën vlera e shkëmbimit është prej dy mijë (2,000) euro ose më shumë;
   4.2. Lëshimin e një çeku ose instrumenti tjetër të negociueshëm ndaj një klienti, ose tek një pranues tjetër në emër të klientit, në shkëmbim për të holla në çdo transaksion në të cilën vlera e shkëmbimit është prej dy mijë (2,000) euro ose më shumë;
   4.3. Transferimin e fondeve në mënyrë elektronike ose me ndonjë metodë tjetër për një klient, ose tek një pranues tjetër në emër të klientit, në këmbim me të holla në çdo transaksion në të cilën vlera e shkëmbimit është prej dy mijë (2,000) euro ose më shumë.

5. Këto ndalesa nuk e kufizojnë një shtëpi të lojërave të fatit nga pagesa e fitimeve të klientit me çek apo instrument tjetër të negociueshëm apo me transferim elektronik nëse çeku, instrumenti i negociueshëm, ose transferi elektronik që është bërë paguhet me urdhër të klientit.
6. Kazinotë, Shtëpitë e lojërave të fatit dhe Objektet e licencuara të lojërave të fatit duhet të:
   6.1. zhvillojnë dhe zbatojnë politika, procedura dhe kontrolle të duhura të brendshme, duke përfshirë regjimet e pajtueshmërisë dhe procedurat adekuate të shqyrtimit për të siguruar standarde të larta kur punësojnë punonjës;
   6.2. kryejnë programe të trajnimit të vazhdueshëm të punonjësve; dhe
   6.3. zbatojnë procedura për të provuar pajtueshmërinë me ligjin dhe aktet nënligjore.
7. Çdo Kazino, Shtëpi e lojërave të fatit ose Objekt i licencuar i lojërave të fatit do të, në një mënyrë të kërkuar nga NjIF-ja, të krijojë dhe të mbajë të dhëna origjinale dhe të përhershme të sakta, të plota, të lexueshme për të siguruar pajtueshmërinë me këtë ligj dhe aktet nënligjore brenda Kosovës për një periudhë minimale prej pesë (5) vitesh.
8. NjIF-ja do të, kohë pas kohe, miratojë, ndryshojë, shfuqizojë aktet nënligjore në përputhje me politikën, objektet dhe qëllimet e këtij neni të ligjit si ajo i konsideron të nevojshme ose të dëshirueshme në interes të publikut në kryerjen e politikës dhe dispozitave të këtij ligji.

Neni 18

1. Neni 29 i ligjit bazik, paragrafi 3., në fund të paragrafit shtohet teksti **"NjIF-ja duhet të njoftohet për deklarimet apo shpalosjet e rreme."**
2. Neni 29 i ligjit bazik, paragrafi 4., në fund të paragrafit shtohet teksti **"për të cilat ka detyrim për të deklaruar."**
3. Neni 29 i ligjit bazik, paragrafi 14. referenca**"paragrafin 3 të këtij neni"** fshihet dhe zëvendësohet me referencën**"paragrafi 12 i këtij neni"**
4. Neni 29 i ligjit bazik, pas paragrafit 20., shtohet paragrafi i ri 21. me tekstin si në vijim:
   21. kundër vendimit të sjellë sipas nenit 29 të këtij ligji, pala ka të drejtë të paraqesë një kërkesë për rishikim të vendimit në Doganë brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të vendimit, ose kur deklarata doganore është marrë.

Neni 19

Neni 30 i ligjit bazik, paragrafi 1. riformulohet me tekstin si në vijim:

1. Për subjektet raportuese të përcaktuara në nënparagrafët 1.1 deri 1.11, paragrafi 1 i nenit 16 i këtij ligji, një zyrtar ose zyrtarët e NjIF-së të cilët janë të autorizuar nga Drejtori i NJIF-së për këtë qëllim (në tekstin e mëtejmë "një zyrtar i autorizuar ose zyrtarët"), mund, në çdo kohë gjatë orarit të zakonshëm, të hyjë në çfarëdo ndërtese tjetër përveç se në një shtëpi banimi

ose banesë, nëse ekziston dyshimi i arsyeshëm se ai përmban shënime të cilat ruhen në pajtim me nenet 16-28 të këtij ligji ose dokumentet relevante për të përcaktuar nëse detyrimet sipas neneve 16-28 të këtij ligji janë përmbushur. Zyrtari ose zyrtarët e autorizuar mund të kërkojnë dhe të inspektojnë shënimet ose dokumentet, kopjojnë ose të riprodhojnë çdo regjistrim të tillë ose dokument dhe të bëjnë pyetje për të gjetur dhe për të kuptuar shënimet ose dokumentet e tilla. Zyrtari ose zyrtarët e autorizuar do të kufizojnë inspektimin në atë pjesë të ambienteve në të cilat të dhënat përkatëse ose dokumentet janë të arsyeshme, gjasa për tu gjetur dhe ata do të kryejnë vetëm veprime të cilat janë të nevojshme për , dhe në proporcion me, qëllimet e inspektimit të shënimeve të tilla.

Neni 20

Neni 31 i ligjit bazik riformulohet si në vijim:

Neni 31
Sanksionet administrative

1. Një vendim i marrë nga NJIF-ja që njofton të detyruarin për një dështim për të qenë në përputhje me këtë ligj do të përbëjë një shkelje të detyrimeve të përcaktuara në bazë të këtij Ligji i cili do t'i nënshtrohet një sanksioni administrativ në formë të një gjobe prej pesë qind (500) euro për çdo ditë të mosrespektimit pas datës së njoftimit.
2. NJIF-ja në konsultim me Ministrin e Financave, nxjerr akt nënligjor për të përcaktuar procedurën për shkelje administrative.
3. Shqiptimi i sanksionit mund të kontestohet para ndonjë Gjykate kompetente.

Neni 21

Pas nenit 31 të ligjit bazik, shtohen dy nene të reja 31.A. dhe 31.B. me tekstin si në vijim:

Neni 31.A

1. Me gjobë në të holla në shumë prej pesëqind (500) deri shtatë mijë (7,000) euro do të dënohet për kundërvajtje personi juridik:
   1.1. nëse nuk kryen analizën e rrezikut, përkatësisht nuk bën vlerësimin e rrezikut të grupeve të caktuara dhe llojit të palës, marrëdhënieve afariste, produkteve apo transaksioneve ose, nëse analizën dhe vlerësimin e rrezikut nuk e kryen në përputhje me udhëzimet e nxjerra nga autoriteti mbikëqyrës.
   1.2. nëse nuk zbaton masat e analizës së thellë të palës në rastet e përcaktuara me këtë ligj apo Udhëzim Administrativ.
   1.3. nëse me palën krijon një marrëdhënie afariste dhe para kësaj nuk zbaton masat e analizës së thellë të palës.
   1.4. në qoftë se kryen një transaksion me vlerë prej dhjetë mijë (10,000) euro ose

më shumë, përkatësisht nëse kryen transaksione të ndërlidhura dhe para kësaj nuk zbaton masat e përcaktuara me këtë ligj.

1.5. nëse nuk e vërteton ose nuk e verifikon identitetin e palës, me rastin e hyrjes në kazino apo në kohën e kryerjes së transaksionit në arkë ose kur pala paraqitet për të marrë pjesë në organizimin e lojërave të fatit tek organizatori, i cili lojërat e fatit i organizon në internet ose mjete të tjera të telekomunikacionit, përkatësisht komunikimeve elektronike, apo nëse nuk merr të dhënat e caktuara për palën, ose nuk i merr në mënyrën e përcaktuar.

1.6. nëse gjatë transferimit ose shënjimit të parave në mënyrën e përcaktuar nuk mbledh apo nuk i përfshin në formular ose mesazh, i cili e shoqëron transferimin elektronik, informacionin e saktë dhe kuptimplotë mbi dërguesin, apo urdhërdhënësin ose, nëse të dhënat për ta nuk shoqërojnë transferin në çdo kohë gjatë kalimit të transferit përmes zinxhirit të pagesave.

1.7. nëse ofruesi i shërbimeve të pagesave, si një ndërmjetësues ose pranues i mjeteve monetare, me rastin e transferimit të mjeteve të cilat nuk përmbajnë informacion të plotë për paguesin nuk e refuzon transferin e tillë ose nuk kërkon që brenda afatit të caktuar kohor të plotësohen të dhënat shtesë për paguesin.

1.8. nëse nuk e vërteton ose nuk e verifikon identitetin e palës, ose identitetin e përfaqësuesit ligjor, avokatit ose pronarit të vërtetë të palës dhe nëse dështon të sigurojë dokumentacionin e nevojshëm për të identifikuar dhe verifikuar identitetin ose autorizimin në rastin, kur pala kryen transaksione nëpërmjet të autorizuarit.

1.9. nëse gjatë analizës nuk pranon informacione mbi qëllimin dhe natyrën e synuar të marrëdhënies afariste ose transaksionit dhe informacione të tjera në bazë të këtij ligji, që duhet t'i mbledh.

1.10. nëse krijon marrëdhënie afariste me palën në rastin kur analiza e thellë është kryer nga një palë e tretë në kundërshtim me këtë ligj dhe rregulloret që i sjellë Ministria e Financave.

1.11. nëse gjatë krijimit të një marrëdhënie korrespondente me një bankë ose institucion tjetër të kredisë, që ka zyrën e saj qendrore në një vend të tretë nuk zbaton masat e kërkuara dhe nuk mbledh të dhënat shtesë, informatat dhe dokumentacionin ose nuk i merr në mënyrën e përcaktuar.

1.12. në qoftë se lidhet ose zgjatët një marrëdhënie me bankën ose institucionin tjetër të kredisë që ka zyrën e saj qendrore në një vend të tretë, në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji.

1.13. nëse në përfundim të një marrëdhënie afariste apo kryerje të transaksioneve për një palë që është një person i ekspozuar politikisht, nuk merr informacion mbi burimin e mjeteve dhe të pasurive që janë apo do të jenë subjekt i një marrëdhënie afariste apo transaksioni, ose nuk i merr në mënyrën e përcaktuar me këtë ligj.

1.14. nëse gjatë një analize të thellë të thjeshtëzuar të palës nuk merr informacionin e nevojshëm të palës ose nuk i merr në mënyrën e përcaktuar me këtë ligj.

1.15. nëse palëve ia hap, lëshon ose për të njëjtit udhëheq llogari anonime, librezë të kursimeve në kod ose llogari apo librezë të kursimeve në emër por pa

asnjë informacion tjetër personal apo llogari në emër të rremë apo produkteve tjera anonime.

1.16. në qoftë se hyn ose zgjatë një marrëdhënie korrespondente me një bankë që vepron ose mund të veprojë si një bankë fiktive apo me një institucion kreditues, për të cilin dihet se me një bankë fiktive do të hyjë në marrëveshje për hapjen dhe mbajtjen e llogarive.

1.17. nëse nga pala ose një person i tretë pranon një pagesë në të gatshme në shumën e cila tejkalon dhjetë mijë (10,000) euro ose në transaksione me personat jo rezidentë me një vlerë që tejkalon dhjetë mijë (10,000) euro, përkatësisht nëse pranon pagesa në të gatshme me shumë transaksione të ndërlidhura ndërmjet tyre, të cilat në total tejkalojnë shumën prej dhjetë mijë (10,000) euro.

1.18. nëse nuk abstenon nga transaksioni për të cilin e din ose dyshon të jetë i lidhur me shpëlarje parash apo financimit të terrorizmit, nëse për një transaksion të këtillë dështon të njoftojë Zyrën para përfundimit të transaksionit dhe në qoftë se në njoftim nuk specifikon arsyet për të dyshuar për shpëlarje parash ose financim të terrorizmit, periudhë në të cilën transaksioni duhet të ekzekutohet dhe informacione të tjera të nevojshme, ose nuk arrin të njoftojë Zyrën lidhur me palën me të cilin ka ndërprerë marrëdhënien afariste ose ka refuzuar për të kryer një transaksion, të cilin ka refuzuar ta kryejë sepse nuk ka mund të zbatojë dispozitat e përcaktuara.

1.19. nëse Zyrës në afatin e caktuar nuk i dorëzon të dhënat e kërkuara, informacionin dhe dokumentacionin në lidhje me transaksionin apo personi për të cilin ekziston baza për dyshim të shpëlarjes së parave apo financimit të terrorizmit, ose nëse personit të autorizuar të Zyrës, me kërkesën e tij nuk i lejon inspektimin e drejtpërdrejtë të dokumenteve në ambientet e biznesit të tij.

1.20. nëse nuk zbaton urdhrin e NJIF-së për të ndaluar përkohësisht transaksionin ose nuk zbaton udhëzimet për mënyrën e veprimit me palët të cilave i referohet masa e përkohshme e ndalimit të transaksionit.

1.21. nëse nuk zbaton urdhrin e NJIF-së për monitorim të vazhdueshëm të qëndrueshmërisë financiare të palës së caktuar.

1.22. nëse llogaritë anonime, librezat e kursimeve, si dhe të gjitha produktet e tjera anonime të cilat mundësojnë fshehjen e identitetit të palëve të hapura përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, nuk do t'i mbyllë brenda afatit të caktuar nga NJIF ose nuk arrin të kryejë analizën e thellë të palës.

Neni 31.B.

1. Me gjobë në shumë prej pesëqind (500) deri dhjetë mijë (10,000) euro do të dënohet për kundërvajtje personi juridik:

1.1. nëse nuk siguron zbatimin e masave për të zbuluar dhe për të parandaluar shpëlarjen e parave dhe financimit të terrorizmit, siç përcaktohet me këtë ligj, në njësitë e tij afariste dhe kompanitë në të cilin ai mban shumicën e aksioneve, si dhe shumica e të drejtave për vendosje, të cilët kanë selinë në një vend të tretë.

1.2. nëse nuk zbaton të gjitha masat e nevojshme për një analizë të thellë të palës ose nuk i zbaton në përputhje me procedurën e përcaktuar përmes aktit nënligjor.
1.3. nëse para vendosjes së një marrëdhënie afariste apo ekzekutimi të transaksionit, kur ekziston dyshimi në vërtetësinë e të dhënave që do të përdoren për të krijuar identitetin e palëve, përfaqësuesit ligjor ose të autorizuarit nuk i është marrë një deklaratë me shkrim e palës, përfaqësuesit ligjor të palës apo të autorizuarit.
1.4. nëse gjatë ndjekjes së aktiviteteve të palës nuk zbatohen masat e parashikuara.
1.5. nëse nuk kryen një analizë të thellë të përsëritur vjetore të personit juridik ose në qoftë se dështon të jap informacionin e kërkuar dhe dokumentet, apo nuk i merr në mënyrën e përcaktuar.
1.6. nëse kryen transaksion për një person juridik të huaj, për të cilin nuk ka verifikuar plotësimin e të gjitha kushteve të përcaktuara me këtë ligj.
1.7. nëse analizën e thellë të palës ja beson një pale të tretë për të cilën nuk ka verifikuar se a i plotëson të gjitha kushtet e kërkuara me këtë ligj.
1.8. nëse si adekuate e pranon një analizë të thellë të kryer nëpërmjet një pale të tretë e cila përcaktimin dhe verifikimin e identitetit të palës e ka kryer pa dijeninë e palës.
1.9. nëse analizën e thellë të palës ia beson një personi të tretë i cili nuk i plotëson kushtet e parapara me këtë ligj.
1.10. nëse pas arritjes së një marrëdhënie afariste me një person të huaj të ekspozuar politikisht nuk ndjekë me vëmendje të veçantë transaksionet dhe aktivitetet e tjera të biznesit që kryen ai person tek ai.
1.11. nëse krijon një marrëdhënie biznesi me palën që me rastin e verifikimit të identitetit nuk është personalisht i pranishëm dhe të mos miratojë një masë që siguron se para ekzekutimit të mëtejshëm të transaksioneve të palës, pagesa e parë të bëhet përmes një llogarie që ka pala të hapur në një institucion kreditues.
1.12. nëse nuk krijojnë politikat dhe procedurat për monitorimin e rrezikut të shpëlarjes së parave apo financimit të terrorizmit, të cilat mund të rrjedhin nga teknologjitë e reja që lejojnë anonimitet, ose në qoftë se nuk merr masa për të parandaluar përdorimin e teknologjive të reja për qëllimin e shpëlarjes së parave apo financimit të terrorizmit.
1.13. nëse nuk ka politika dhe procedura për rrezikun që përcjell një marrëdhënie afariste apo transaksion me palët që nuk janë fizikisht të pranishme, ose nuk i aplikon kur vendos një marrëdhënie afariste me palën dhe gjatë zbatimit të masave të një analize të thellë të palës.
1.14. nëse NJIF në afatin ligjor të përcaktuar dështon t'i ofrojë informacion në lidhje me transaksionin, që do të ekzekutohet në të holla në vlerë prej dhjetë mijë (10,000) euro ose më shumë.
1.15. nëse nuk emëron një person të autorizuar ose një ose më shumë zëvendës të personit të autorizuar sipas kërkesës së NJIF-së, për të kryer punë në zbulimin dhe parandalimin e shpëlarjes së parave dhe financimit të terrorizmit, të përcaktuar sipas këtij ligji dhe akteve të miratuara për zbatim të këtij ligji.

1.16. nëse personit të autorizuar nuk i siguron autoritetin e duhur dhe kushtet për kryerjen e punëve dhe detyrave të tij.
1.17. nëse nuk krijon një listë të treguesve për të identifikuar palët dhe transaksionet për të cilat ekziston baza për dyshim të shpëlarjes së parave apo financimit të terrorizmit, përkatësisht nëse nuk i krijon ato në mënyrën e përshkruar dhe brenda afatit kohor të përcaktuar; dhe
1.18. nëse të dhënat dhe dokumentacionin nuk e ruan pesë (5) vite pas kryerjes së transaksionit, apo pas ndërprerjes së aktivitetit afarist, hyrjes së palës në kazino apo kasafortë.

Neni 22

1. Neni 32 i ligjit bazik, paragrafi 1. fshihet nga teksti i ligjit.
2. Neni 32 i ligjit bazik, paragrafi 2, në rreshtin e katërt referenca "**Kapitullin XXIX**" zëvendësohet me referencën "**Kapitullin IX**".

Neni 23

1. Neni 33 i ligjit bazik, paragrafi 1. fshihet nga teksti i ligjit.
2. Neni 33 i ligjit bazik, paragrafi 2. riformulohet me tekstin si në vijim:
   2. cili do person, duke siguruar ndonjë informacion ose duke raportuar dhe duke bërë certifikata ose deklarime sipas këtij ligji, me dijeni të plotë.
      2.1. bën, çfarëdo deklarate të rëndësishme të rrejshme ose me qëllim nuk i zbulon informacionet e rëndësishme;
      2.2. bën apo shfrytëzon çfarëdo dokumenti duke e ditur se dokumenti përmban deklaratën ose shënime të rëndësishme të rrejshme.
      2.3. kryen vepër penale të dënueshme deri në pesë (5) vite burgim dhe me gjobe deri në njëqind mijë (100,000) Euro.
3. Neni 33 i ligjit bazik paragrafët 3.1. dhe 3.2. riformulohen me tekstin në vijim:
   3.1. shkatërron ose largon çfarëdo të dhënash të cilat duhet të mbahen në pajtim me paragrafin 3. të nenit 20, paragrafin 4. të nenit 24, paragrafin 3. të nenit 25, paragrafin 10. të nenit 26 ose paragrafin 3. të nenit 27 të këtij ligji;
   3.2. dështon për të bërë një raport në përputhje me paragrafin 1. dhe 2. të nenit 22, paragrafit 5. të nenit 24, paragrafit 4. të nenit 25, paragrafit 3., 7. dhe 8. të nenit 26 ose paragrafit 3. të nenit 28 të këtij ligji.
4. Neni 33 i ligjit bazik, paragrafi 10., pas tekstit për **"sigurimin e pasurisë"** referenca **"nenin 34"** fshihet dhe zëvendësohet me referencën **"sipas këtij neni",** kurse pjesa tjetër e fjalisë mbetet e njëjtë.
5. Neni 33 i ligjit bazik, paragrafi 11. referenca **"neni 32 i këtij ligji"** fshihet dhe zëvendësohet me referencën **" neni 33 i këtij ligji",** pjesa tjetër e fjalisë mbetet e njëjtë.

Neni 24

Neni 36 i ligjit bazik, paragrafi 3. riformulohet me tekstin si në vijim:
3. Një kërkesë sipas këtij neni do të dërgohet nëpërmjet kanaleve diplomatike

në pajtim me ligjet dhe marrëveshjet në fuqi, i cili do të përcjellët tek Zyra e Bashkëpunimit Juridik Ndërkombëtar ose autoriteti tjetër kompetent.

Neni 25

Pas Nenit 36 të ligjit bazik, shtohen nenet të reja 36.A., 36.B., 36.C., 36.D. me tekstin si në vijim:

Neni 36.A.
Inspektimi i pajtueshmërisë nga BQK-ja

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës dhe mbikëqyrësit e tjerë sektorial në përputhje me kompetencat e tyre të përcaktuara në këtë dokument dhe në ligjet e tjera përkatëse, mbeten përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të dispozitave të këtij ligji nga personi nën mbikëqyrjen e tyre vetëm nëse NjIF-ja delegon këtë të drejtë për bazën e mbikëqyrësit në marrëveshje me shkrim.

Neni 36. B.
Vepra Penale Financimi i Terrorizmit

1. Kushdo, që me qëllim kryen, merr pjesë si bashkëpunëtor, siguron ose mbledhë fonde apo organizon ose drejton të tjerët drejtpërdrejt të ofrojnë ose të mbledhin fonde, apo përpjekja për ta bërë këtë, përmes çfarëdo mjeti, drejtpërdrejt ose tërthorazi, me qëllim që ato të përdoren ose në njohuri se ato do të përdoren në mënyrë të plotë ose pjesërisht për:
   1.1. për të kryer një akt terrorist;
   1.2. nga një terrorist; ose
   1.3. nga një organizatë terroriste do të konsiderohet të ketë kryer aktin e financimit të terrorizmit.
2. Vepra penale është kryer pavarësisht se a ka ndodh një akt terrorist i përmendur në paragrafin 1., ose nëse fondet janë përdorur në fakt për të kryer akt të tillë.
3. Financimi i terrorizmit do të jetë i dënueshëm me një gjobë deri pesëqind mijë (500,000) euro ose me burgim shtatë (7) deri njëzetë (20) vite apo ndonjëra nga këto dënime.
4. Tentativa për të kryer veprën penale të financimit të terrorizmit apo ndihmesa, mbështetja, lehtësimi ose këshillimi në kryerjen e ndonjë vepre të tillë, do të dënohet sikur vepra të kishte përfunduar.

Neni 36.C.
Kërcënimi lidhur me veprimtarinë e raportimit të transaksioneve të dyshimta

Kushdo që përdor forcën apo kërcënimin e rëndë, ose çdo mjet tjetër të detyrimit, ose një premtim të një dhurate ose ndonjë forme tjetër të përfitimit për të nxitur personin tjetër të përmbahet nga përgatitja e një raporti të kërkuar sipas nenit 13 të këtij ligji, ose për të bërë një deklaratë të rrejshme ose dështimi për të deklaruar informacionin e vërtetë tek NjIF-ja, BQK-ja, tek agjencitë hetimore, tek prokurori apo gjyqtari, kur një

informacion i tillë ka të bëjë me detyrimet e raportimit të nenit 13 të këtij ligji, dënohet me gjobë deri në njëqind e njëzetepesë mijë (125,000) euro dhe me burgim prej dy (2) deri në dhjetë (10) vjet.

Neni 36.D.

1. Zyrtarët doganor dhe zyrtarët e Administratës Tatimore të Kosovës të njohur si "Polici Gjyqësore" në bazë të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës kanë kompetenca, përgjegjësi dhe detyra për hetimin dhe zbulimin e veprave penale për shpëlarje të parave dhe financimit të terrorizmit dhe janë të autorizuar për hetimin e këtyre veprave penale nën mbikëqyrjen e prokurorit.
2. ATK dhe Dogana do të caktojnë zyrtar ndërlidhës me Prokurorin Speciale dhe Prokurorit tjera për bashkëpunim profesional.

Neni 26

Neni 37 i ligjit bazik, paragrafi 2. riformulohet me tekstin si në vijim:

2. Ky nen do të jetë pa paragjykim ndaj paragrafit 9. të nenit 26 dhe nënparagrafit 3.2., paragrafi 3. i nenit 30 të këtij ligji.

Neni 27

Ministria e Financave do të nxjerrë Udhëzime Administrative për Vlerësimin e Rrezikut Kombëtar të Shpëlarjes së Parave dhe Financimit të Terrorizmit, për të sjellë në fuqi në të ardhmen Direktivën e re të BE-së për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit dhe dispozitat tjera për zbatimin e këtij ligji.

Neni 28
Hyrja në Fuqi

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ligji Nr. 04/L-178
11 shkurt 2013

Shpallur me dekretin Nr.DL-003-2013, datë 26.02.2013 nga Presidentja e Republikës së Kosovës Atifete Jahjaga.

GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS / Nr. 5 / 8 MARS 2013, PRISHTINË

LIGJI Nr. 03/L-182
PËR MBROJTJE NGA DHUNA NË FAMILJE

Përmbajtja

Kreu I: Dispozitat e përgjithshme 543
Kreu II: Dispozitat kalimtare dhe përfundimtare 555

Kuvendi i Republikës së Kosovës;

Në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton

LIGJ PËR MBROJTJE NGA DHUNA NË FAMILJE

KREU I
DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi i ligjit

1. Ky ligj ka për qëllim parandalimin e dhunës në familje, në të gjitha format e saj, me masa të përshtatshme ligjore, të pjesëtarëve të familjes, që janë viktima të dhunës në familje, duke u kushtuar vëmendje të veçantë fëmijëve, të moshuarve dhe personave me aftësi të kufizuara.
2. Ky ligj, po ashtu, ka për qëllim edhe trajtimin e kryerësve të dhunës në familje dhe lehtësimin e pasojave.

Neni 2
Përkufizimet

1. Shprehjet e përdorura në këtë ligj kanë këto kuptime:
   1.1. **Marrëdhënie Familjare** konsiderohen personat nëse:
      1.1.1. janë të fejuar apo ishin të fejuar;
      1.1.2. janë të martuar apo ishin të martuar;
      1.1.3. janë në bashkësi jashtëmartesore apo ishin në bashkësi jashtëmartesore;
      1.1.4. bashkëjetojnë në ekonomi të përbashkët ose që bashkëjetuan në një ekonomi të tillë;
      1.1.5. përdorin një shtëpi të përbashkët dhe janë në lidhje gjaku, martese, adoptimi, krushqie apo janë në lidhje kujdestarie duke përfshirë

prindërit, gjyshërit, fëmijët, nipat, vëllezërit dhe motrat, hallat e tezet, xhaxhallarët e dajallarët ose kushërinjtë;

1.1.6. janë prindër të një fëmije të përbashkët;

1.1.7. janë palë procedurale në një kontest nga marrëdhëniet familjare;

1.2. **Dhunë ne familje** - një ose më shumë vepra apo lëshime të qëllimshme që i bën një person personit tjetër me të cilin është ose ka qenë në marrëdhënie familjare si këto, por nuk kufizohet në:

1.2.1. përdorimin e forcës fizike ose presionin psikik të ushtruar ndaj anëtarit tjetër të familjes;

1.2.2. çdo veprim tjetër i një anëtari të familjes që mund të shkaktojë apo kanos, se do të shkaktojë dhembje fizike dhe vuajtje psikike;

1.2.3. shkaktimi i ndjenjës së frikës, rrezikshmërisë personale apo cenimin e dinjitetit;

1.2.4. sulmi fizik pa marrë parasysh pasojat;

1.2.5. ofendimi, sharja, thirrja me emra ofendues dhe mënyra të tjera të shqetësimit të vrazhdë;

1.2.6. përsëritja e vazhdueshme e sjelljeve me qellim te përuljes se personit tjetër;

1.2.7. marrëdhënia seksuale pa pëlqim dhe keqtrajtimi seksual;

1.2.8. kufizimi i kundërligjshëm i lirisë së lëvizjes ndaj personit tjetër;

1.2.9. dëmtimi apo shkatërrimi i pasurisë dhe kanosja që ta bëjë këtë;

1.2.10. vënia e personit tjetër në pozitën qe ai të frikësohet për gjendjen fizike, emocionale dhe ekonomike;

1.2.11. hyrja apo largimi me dhunë nga banesa e përbashkët apo banesën e personit tjetër;

1.2.12. rrëmbimi.

1.3. **Pala e mbrojtur** - personi ndaj të cilit është ushtruar dhuna në familje dhe vartësit në dobi të të cilit është kërkuar urdhri për mbrojtje, urdhri për mbrojtje emergjente ose urdhri për mbrojtjen e përkohshme emergjente.

1.4. **Kërkesë** - akti me të cilin kërkohet mbrojtja nga dhuna në familje.

1.5. **Kryerësi i dhunës në familje** - personi, i cili ka kryer një apo me tepër vepra të dhunës në familje, kundër të cilit kërkohet urdhri për mbrojtje, urdhri për mbrojtje emergjente. ose urdhri për mbrojtjen e përkohshme emergjente.

1.6. **Viktimë** - personi i cili i është nënshtruar dhunës në familje.

1.7. **Përfaqësuesi i autorizuar** - personi, i cili është i autorizuar për të mbrojtur interesat e palës së mbrojtur, dhe për t'iu siguruar përkrahje e ndihmë viktimave.

1.8. **Mbrojtësi i viktimave** - personi i autorizuar zyrtar i cili ndihmon drejtpërdrejtë palën e dëmtuar që nga kontaktet e para me organet kompetente të mbrojtjes, këshillon, inicion procedurat për caktimin e masave të mbrojtjes, është i obliguar të marr pjesë në të gjitha seancat gjyqësore, të monitoroj mbarëvajtjen e procesit gjyqësor.

1.9. **Urdhër mbrojtje** - urdhri i lëshuar me vendim gjykate, ku parashikohen masat mbrojtëse për viktimën.

1.10. **Urdhër mbrojtje emergjente** - urdhri i lëshuar përkohësisht me vendim gjykate.

1.11. **Urdhër mbrojtje e përkohshme emergjente** urdhri i lëshuar jashtë orarit të punës së gjykatave.

Neni 3
Juridiksioni i Gjykatës, organet kompetente dhe masat mbrojtëse

1. Gjykata Komunale e cila e ka juridiksionin në komunën ku parashtruesi i kërkesës ka vendbanimin apo vendqëndrimin, është kompetente për shqiptimin e masave mbrojtëse.
2. Çdo gjykatë komunale është kompetente për të shqyrtuar kërkesën për urdhër mbrojtje ose urdhër mbrojtje emergjente dhe për të shqiptuar urdhrin, nëse gjykata kompetente sipas paragrafit 1 të këtij neni e ka paraqitur kërkesën për urdhër mbrojtje ose urdhër mbrojtje emergjente në atë gjykatë dhe nëse ajo gjykatë ka juridiksion në komunën në të cilën pala e mbrojtur e ka ndërruar vendbanimin apo vendqëndrimin, apo nëse kjo bartje i shërben interesit më të mirë të palës së mbrojtur.
3. Nëse në gjykatën kompetente është parashtruar kërkesa, e njëjta gjykatë është kompetente për të shqyrtuar kërkesën për urdhër mbrojtje ose urdhër mbrojtje emergjente dhe për të shqiptuar urdhrin.
4. Masat mbrojtëse shqiptohen me qëllim të parandalimit të dhunës në familje, për mbrojtjen e personit që i është ekspozuar dhunës, duke mënjanuar rrethanat që ndikojnë apo mund të ndikojnë në kryerjen e veprave tjera.
5. Gjykata komunale kompetente, me urdhër mbrojtje apo me urdhër mbrojtje emergjente mund të shqiptojë një apo më tepër masa mbrojtëse.
6. Organ kompetent për ekzekutimin e masave mbrojtëse është Policia e Kosovës.

Neni 4
Masa mbrojtëse e trajtimit psikosocial

1. Masa mbrojtëse e trajtimit psikosocial, mund ti shqiptohet kryesit të dhunës në familje në kombinim me ndonjë masë tjetër parandaluese, me qëllim të evitimit të sjelljeve të dhunshme të kryerësit apo nëse ekziston rrezik i përsëritjes së dhunës në familje.
2. Masa nga paragrafi 1 i këtij neni, zgjatë derisa të përfundojnë shkaqet mbi bazën e të cilave është shqiptuar, por nuk mund të zgjasë më shumë se gjashtë muaj.
3. Ministria përgjegjëse për mirëqenie sociale në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për Shëndetësi dhe institucionet përkatëse përgatisin dhe propozojnë për aprovim në Qeveri aktin nënligjor me të cilin përcaktohet mënyra dhe vendi i zbatimit të trajtimit psikosocial.

Neni 5
Masa mbrojtëse e ndalimit të afrimit viktimës së dhunës në familje

1. Masa mbrojtëse e ndalimit të afrimit viktimës së dhunës në familje si dhe vartësit të tij/saj dhe personave tjerë nëse është e nevojshme, mund t'i shqiptohet personit i cili ka kryer dhunë në familje, nëse ekziston rreziku i përsëritjes së dhunës në familje.

2. Në urdhrin me të cilin shqiptohet masa e ndalimit të afrimit viktimës së dhunës në familje, gjykata cakton vendin, regjionin dhe largësinë, brenda së cilës kryerësi nuk guxon t'i afrohet viktimës së dhunës në familje.

Neni 6
Masa mbrojtëse e ndalimit të shqetësimit personave të ekspozuar dhunës

1. Masa mbrojtëse e ndalimit të shqetësimit në përputhshmëri me përkufizimin e dhënë në nenin 2 nën-paragrafi 1.2, të këtij ligji, mund t'i shqiptohet kryerësit të dhunës në familje, nëse ekziston rreziku i përsëritjes së dhunës në familje.
2. Kujdestaria e fëmijës përkohësisht i besohet viktimës së dhunës në familje, ndërsa e drejta prindërore përkohësisht i hiqet kryerësit të dhunës në familje.

Neni 7
Masa mbrojtëse e largimit nga banesa, shtëpia apo hapësira tjetër e banimit

1. Masa mbrojtëse e largimit nga banesa, shtëpia apo hapësira tjetër e banimit, i shqiptohet personit që ka kryer dhunë ndaj anëtarit të familjes me të cilin jeton në banesë, shtëpi apo ndonjë hapësirë tjetër banimi, nëse ekziston rreziku i përsëritjes së dhunës në familje.
2. Personi të cilit i është shqiptuar masa nga paragrafi 1. i këtij neni, obligohet menjëherë t'a lëshoj banesën, shtëpinë apo hapësirën tjetër të banimit, në prezencë të zyrtarit policor.

Neni 8
Masa mbrojtëse e shoqërimit viktimës së dhunës

1. Masa mbrojtëse e shoqërimit të viktimës, mund të shqiptohet me qëllim të mbrojtjes gjatë marrjes së gjësendeve personale.
2. Masa nga paragrafi 1. i këtij neni zbatohet nën shoqërimin e zyrtarit policor.

Neni 9
Masa mbrojtëse e trajtimit mjekësor nga varësia prej alkoolit dhe substancave psikotrope

1. Masa mbrojtëse e trajtimit të obligueshëm mjekësor nga varësia e alkoolit dhe substancave psikotrope i shqiptohet personit, i cili ka kryer dhunë në familje nën ndikimin e tyre, kur ekziston rreziku i përsëritjes së dhunës në familje.
2. Ministria përgjegjëse për Shëndetësi nxjerr akt nënligjor, për mënyrën e trajtimit të personave ndaj të cilëve është shqiptuar masa mbrojtëse e trajtimit të obligueshëm mjekësor nga varësia e alkoolit dhe substancave psikotrope.

Neni 10
Masa mbrojtëse e marrjes së sendit

1. Masa mbrojtëse e marrjes së sendit me të cilin është kryer vepra, apo sendeve me të cilat dyshohet se mund të përsëritet dhuna në familje, shqiptohet me qëllim të

mbrojtjes së personit ndaj të cilit është ushtruar dhuna në familje apo e personave tjerë.

2. Masa mbrojtëse nga paragrafi 1 i këtij neni zbatohet në pajtim me Kodin Penal të Kosovës.

Neni 11
Masat mbrojtëse pasurore

1. Gjykata, krahas masave të parapara në nenet 4 deri 10 të këtij ligji, mund të shqiptoj edhe masat si në vijim:
   1.1. urdhërimi i kryerësit të dhunës në familje që të lejojë palën e mbrojtur të shfrytëzojë banesën të cilën e përdorin së bashku ose ndonjë pjesë të saj;
   1.2. urdhërimi i kryerësit të dhunës në familje që të paguajë qiranë e banesës së përkohshme të palës së mbrojtur ose të paguajë alimentacionin për palën e mbrojtur dhe për fëmijë, për të cilin kryerësi i dhunës në familje ka obligim për ta mbajtur;
   1.3. ndalimi i kryerësit të dhunës në familje ose palës së mbrojtur, bartjen si dhe çdo lloj transaksioni të çfarëdo pasurie brenda një periudhe të caktuar kohore;
   1.4. ofrimi i mundësisë palës së mbrojtur, që vetëm ajo të posedojë dhe të shfrytëzojë pasurinë e caktuar personale të saj;
   1.5. caktimi i ndonjë mase tjetër që është e domosdoshme për të mbrojtur sigurinë, shëndetin ose mirëqenien e palës së mbrojtur apo personit me të cilin pala e mbrojtur ka lidhje familjare;
   1.6. t'i urdhërohet kryerësit të dhunës në familje që palës së mbrojtur t'i lejohet kthimi ne shtëpi.
2. Kryerësi i dhunës në familje, ka të drejtë që me shoqërimin e policisë t'i merr gjërat e tij personale.
3. Masat mbrojtëse të parapara në nenet 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11 shqiptohen në pajtim me kohëzgjatjen e urdhrit mbrojtës.

Neni 12
Ndërlidhja me urdhrat e tjerë

1. Pavarësisht prej ndonjë urdhri tjetër të shqiptuar nga gjykata apo vendimi tjetër të nxjerrë nga gjykata apo organ tjetër kompetent, urdhri për mbrojtje, urdhri për mbrojtje emergjente ose urdhri për mbrojtje emergjente të përkohshme mund të shqiptohet në përputhje me këtë ligj.
2. Shqiptimi i urdhrit për mbrojtje, urdhrit për mbrojtje emergjente ose urdhrit për mbrojtje emergjente të përkohshme nuk i cenon të drejtat pasurore ose të kujdestarisë së asnjë personi pas skadimit të urdhrit.

Neni 13
Kërkesat për urdhër mbrojtje ose urdhër mbrojtje emergjente

1. Kërkesën për urdhër mbrojtje mund ta paraqesë:
   1.1. pala e mbrojtur;

1.2. përfaqësuesi i autorizuar i palës së mbrojtur;
1.3. mbrojtësi i viktimave me pëlqimin e palës së mbrojtur;
1.4. përfaqësuesi i qendrës për punë sociale në komunën ku pala e mbrojtur ka vendbanimin apo vendqëndrimin në rastet kur viktimë është i mituri.

2. Kërkesën për urdhër mbrojtje emergjente mund ta paraqesë:
2.1. pala e mbrojtur;
2.2. përfaqësuesi i autorizuar i palës së mbrojtur;
2.3. mbrojtësi i viktimave me pëlqimin e palës së mbrojtur;
2.4. personi me të cilën pala e mbrojtur ka lidhje familjare;
2.5. përfaqësuesi i qendrës për punë sociale në komunën ku pala e mbrojtur e ka vendbanimin apo vendqëndrimin në rastet kur viktimë është i mituri;
2.6. personi i cili është në dijeni të drejtpërdrejtë për një apo më tepër vepra të dhunës në familje ndaj palës së mbrojtur.

3. Kërkesë për urdhër mbrojte ose për urdhër mbrojtje emergjente mund të paraqesin edhe OJQ-të, që janë familjarizuar me problemin e viktimës, që janë njoftuar mirë për trajtimin e tyre.

Neni 14
Formulari i kërkesës për urdhër mbrojtje ose urdhër mbrojtje emergjente

1. Kërkesa për urdhër mbrojtje ose urdhër mbrojtje emergjente paraqitet me shkrim ose gojarisht dhe përfshinë:
1.1. emërtimin e gjykatës;
1.2. emrin, adresën dhe profesionin e kërkuesit dhe të kryerësit të dhunës në familje;
1.3. emrin dhe adresën e palës së mbrojtur dhe të personit i cili ka kërkuar mbrojtjen për palën ndaj së cilës është ushtruar dhuna, si dhe lidhja familjare e palës me personin i cili ka shkaktuar dhunë në familje;
1.4. përshkrimi në hollësi i gjendjes faktike dhe kur është e mundur duhet të bashkangjes edhe provat, si dhe arsyen e kërkesës për shqiptimin e urdhrit mbrojtës ose urdhrit për mbrojtje emergjente;
1.5. propozimin e masës mbrojtëse.

2. Nëse zbulimi i vendbanimit apo vendqëndrimit të kërkuesit, të palës së mbrojtur ose të personit me të cilin pala e mbrojtur ka lidhje familjare, e i cili duhet të mbrohet me anë të urdhrit për mbrojtje ose urdhrit për mbrojtje emergjente, do ta rrezikonte atë person, atëherë mund të merren një apo me tepër veprime, si më poshtë:
2.1. kërkesa duhet të sigurojë një adresë alternative;
2.2. adresa tjetër e siguruar në kërkesë duhet të jetë adresa e vetme që paraqitet në dokumentet dhe dosjet publike të gjykatës; ose
2.3. nëse gjykata vendos se zbulimi i adresës në dosjet e gjykatës është i domosdoshëm, ato dosje në të cilat shkruhet adresa duhet të jenë të mbyllura.

Neni 15
Shqyrtimi i kërkesave për urdhër mbrojtje

1. Gjykata kompetente vendosë përkitazi me kërkesën për urdhër mbrojtje brenda pesëmbëdhjetë ditëve pas pranimit të saj.

2. Gjatë shqyrtimit të kërkesës për urdhër mbrojtje, gjykata e mban seancën e dëgjimit në mënyrë që t'i dëgjojë personat në vijim:
   2.1. pala e mbrojtur, përfaqësuesi i autorizuar ose mbrojtësi i viktimave;
   2.2. kryerësi i dhunës ose përfaqësuesi i autorizuar;
   2.3. parashtruesi i kërkesës;
   2.4. përfaqësuesi nga qendra për punë sociale i komunës në të cilin jeton përherë ose përkohësisht personi i përmendur më poshtë në rastin kur:
      2.4.1. parashtruesi i kërkesës është i moshës nën tetëmbëdhjetë (18) vjet ose i mungon zotësia e veprimit; ose
      2.4.2. veprat e supozuara të dhunës në familje kanë ndikim në personin i cili është i moshës nën tetëmbëdhjetë (18) vjet ose nuk ka zotësi të veprimit;
   2.5. dëshmitarë të cilët gjykata i konsideron të domosdoshëm.
3. Dëgjimi dhe shqiptimi bëhet në mungesë të kryerësit të dhunës në familje nëse kryerësi i dhunës në familje është thirrur në mënyrë të rregullt dhe nëse kërkesa është mbështetur në dëshmi të mjaftueshme.
4. Gjykata i thërret menjëherë personat e përmendur sipas paragrafit. 2 të këtij neni, në bazë të ligjit për procedurën kontestimore.
5. Kërkesa konsiderohet si e tërhequr nëse në seancën e dëgjimit nuk paraqiten as pala e mbrojtur e as përfaqësuesi i autorizuar i palës së mbrojtur dhe nëse këta individë janë thirr në mënyrën e rregullt, ndërsa nuk e kanë njoftuar gjykatën për arsyet e mungesës së tyre.
6. Tërheqja e kërkesës nuk parandalon paraqitjen e kërkesës tjetër.

Neni 16
Shqyrtimi i kërkesës për urdhër mbrojtje emergjente

1. Gjykata vendos përkitazi me kërkesën për urdhër mbrojtje emergjente brenda njëzet e katër (24) orëve pas parashtrimit të kërkesës.
2. Me rastin e shqyrtimit të kërkesës për urdhër mbrojtje emergjente, gjykata duhet të mbajë seancë në të cilën dëgjohen personat në vijim:
   2.1. pala e mbrojtur, përfaqësuesi i autorizuar, ose mbrojtësi i viktimave;
   2.2. kryerësi i dhunës ose përfaqësuesi i autorizuar;
   2.3. parashtruesi i kërkesës; dhe
   2.4. çdo dëshmitar, i cili ka njohuri për dhunën në familje.
3. Sipas nevojës, gjykata mund të bëjë dëgjimin dhe shqiptimin e urdhrit mbrojtës në mungesë të kryerësit të dhunës ne familje, duke shfrytëzuar dhe mjetet tjera alternative përfshirë ato elektronike.

Neni 17
Shqiptimi i urdhër mbrojtjes dhe urdhër mbrojtjes emergjente

1. Gjykata kompetente e shqipton urdhër mbrojtjen apo urdhër mbrojtjen emergjente, në rastet kur dyshon se kryerësi i dhunës pashmangshëm rrezikon sigurinë, shëndetin ose mirëqenien e palës së mbrojtur dhe personit me të cilin pala e mbrojtur ka lidhje familjare dhe i cili duhet të mbrohet me anë të urdhër mbrojtjes apo urdhër mbrojtjes emergjente.

2. Vendimi për urdhër mbrojtje ose urdhër mbrojtje emergjente ekzekutohet menjëherë me vendim përkatës, i shqiptuar nga Gjykata kompetente dhe i`u dërgohet menjëherë kryerësit të dhunës në familje Policisë së Kosovës, qendrave për punë sociale, si dhe palëve të tjera në procedurë.
3. Pas skadimit të urdhër mbrojtjes ose urdhër mbrojtjes emergjente, pushojnë të gjitha kufizimet e shqiptuara.

Neni 18
Përmbajtja e urdhrit mbrojtës dhe urdhrit për mbrojtje emergjente

1. Në urdhrin për mbrojtje duhet të ceket:
   1.1. masa mbrojtëse e caktuar nga gjykata;
   1.2. moszbatimi i urdhrit mbrojtës është vepër penale;
   1.3. njoftimi për të drejtën e ankesës;
   1.4. njoftimi se kryerësit të dhunës mund t'i ofroj ndihmë përfaqësuesi i autorizuar.
2. Kohëzgjatja e urdhrit për mbrojtje nuk mund të jetë më e gjatë se dymbëdhjetë (12) muaj por me mundësi vazhdimi jo më shumë se njëzetekatër (24) muaj.
3. Në vendimin për urdhrin për mbrojtje emergjente duhet të ceket:
   3.1. masa mbrojtëse e caktuar nga gjykata;
   3.2. moszbatimi i urdhrit për mbrojtje emergjente është vepër penale;
   3.3. njoftimi për të drejtën e ankesës;
   3.4. data e dëgjimit për vërtetimin e urdhrit për mbrojtje emergjente, e cila duhet të jetë brenda tetë (8) ditëve prej shqiptimit të urdhrit për mbrojtje emergjente;
   3.5. njoftimi se kryerësit mund t'i ofrojë ndihmë përfaqësuesi i autorizuar.
4. Kohëzgjatja e urdhrit për mbrojtje emergjente skadon në fund të dëgjimit për vërtetimin e urdhrit për mbrojtje emergjente.
5. Gjatë dëgjimit për vërtetimin e urdhrit për mbrojtje emergjente, gjykata mund:
   5.1. të jep urdhrin për përfundimin e urdhrit për mbrojtje emergjente; ose
   5.2. të shqiptoj urdhrin për mbrojtje

Neni 19
Ankesat

1. Kundër vendimit të urdhrit për mbrojtje, mund të ushtrohet ankesë, brenda afatit tetë (8) ditor nga dita e dorëzimit të vendimit.
2. Kundër vendimit të urdhrit për mbrojtje emergjente, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afatin prej tri (3) ditësh nga dita e dorëzimit të vendimit.
3. Parashtrimi i ankesës nuk e ndalon ekzekutimin e urdhrit mbrojtës apo urdhrit për mbrojtje emergjente.

Neni 20
Ndryshimi, ndërprerja dhe vazhdimi i urdhër mbrojtjes

1. Kur rrethanat kanë ndryshuar, pala e mbrojtur ose kryesi i dhunës mund t'i parashtrojë kërkesë gjykatës, për ndryshimin ose ndërprerjen e urdhrit për mbrojtje, me ç'rast gjykata mund të vendosë që urdhri për mbrojtje:

1.1. të mbetet në fuqi;
1.2. të ndryshohet;
1.3. të ndërpritet, nëse gjykata vlerëson se kanë pushuar të gjitha shkaqet mbi bazën e të cilave është shqiptuar urdhri mbrojtës.

2. Parashtrimi i kërkesës për ndryshimin ose ndërprerjen e urdhrit për mbrojtje, nuk e ndalon ekzekutimin e urdhrit për mbrojtje.
3. Pesëmbëdhjetë ditë para skadimit të urdhrit për mbrojtje, pala e mbrojtur ose përfaqësuesi i autorizuar, mund të parashtrojë kërkesën për vazhdimin e urdhrit për mbrojtje. Nëse nuk parashtrohet kërkesa për vazhdimin e urdhrit për mbrojtje, ai ndërpritet menjëherë në ditën e skadimit.
4. Pas marrjes së kërkesës për vazhdimin e urdhrit për mbrojtje, gjykata mund:
   4.1. të ndërpres urdhrin për mbrojtje në datën e skadimit të tij; ose
   4.2. të vendosë që të vazhdohet urdhri për mbrojtje, nëse nuk kanë pushuar shkaqet mbi bazën e të cilave është shqiptuar masa mbrojtëse.

Neni 21
Ndryshimi, ndërprerja dhe vazhdimi i urdhër mbrojtjes emergjente

1. Gjykata mund të vendos për vërtetimin e urdhrit për mbrojtje emergjente, ndryshimin ose ndërprerjen e tij, pas shqyrtimit të ankesës së parashtruar nga kryerësi i dhunës në familje apo personi i autorizuar.
2. Dy (2) ditë para skadimit të urdhrit për mbrojtje emergjente, pala e mbrojtur, përfaqësuesi i autorizuar ose mbrojtësi i viktimave mund të parashtrojë kërkesën për vazhdimin e urdhrit për mbrojtje emergjente.
3. Nëse nuk parashtrohet kërkesa për vazhdimin e urdhrit për mbrojtje emergjente, ai ndërpritet menjëherë në ditën e skadimit.
4. Pas marrjes së kërkesës për vazhdimin e urdhrit për mbrojtje emergjente, gjykata mund:
   4.1. të vendosë që të vazhdohet urdhri për mbrojtje, nëse nuk kanë pushuar shkaqet, mbi bazën e të cilave është shqiptuar urdhri për mbrojtje emergjente.
   4.2. të ndërpres urdhrin për mbrojtje emergjente në datën e skadimit të tij.

Neni 22
Urdhri për mbrojtjen e përkohshme emergjente

1. Jashtë orarit të punës së gjykatave, kërkesa për urdhër të mbrojtjes së përkohshme emergjente mund t'i paraqitet Policisë së Kosovës nga:

1.1 pala e mbrojtur;
   1.1. përfaqësuesi i autorizuar, ose mbrojtësi i viktimave;
   1.2. personi me të cilin pala e mbrojtur ka lidhje familjare;
   1.3. përfaqësuesi i qendrës për punë sociale ku ka vendbanimin ose vendqëndrimin pala e mbrojtur;
   1.4. personi i cili është në dijeni të drejtë për drejtë për një vepër ose më shumë vepra të dhunës në familje ndaj kërkuesit.

2. Kohëzgjatja e urdhrit të përkohshëm emergjent skadon në fund të ditës së ardhshme gjatë të cilës gjykata punon.

3. Shefi i njësitit rajonal të Policisë së Kosovës kundër dhunës në familje, mund të shqiptojë urdhrin për mbrojtje të përkohshme emergjente dhe të caktojë një ose disa prej masave të përmendura në nenet 5,6,7 dhe 10 të këtij ligji, nëse ai ose ajo vërteton se:
   3.1. ekzistojnë baza për të besuar se kryesi ka kryer ose është kërcënuar se do të kryejë ndonjë vepër të dhunës në familje;
   3.2. kryesi i dhunës paraqet kërcënim të drejtpërdrejtë dhe të atypëratyshëm për sigurinë, shëndetin dhe mirëqenien e palës së mbrojtur ose të personit me të cilin pala e mbrojtur ka lidhje familjare, të cilët duhet të mbrohen me anë të urdhrit për mbrojtje dhe
   3.3. shqiptimi i urdhrit për mbrojtje të përkohshme emergjente është i domosdoshëm për të siguruar shëndetin ose mirëqenien e palës së mbrojtur ose të personit me të cilin pala e mbrojtur ka lidhje familjare, e që duhet të mbrohen me anë të urdhërit për mbrojtje.
4. Kërkesa për urdhër mbrojtje të përkohshme emergjente mund t'i paraqitet Policisë së Kosovës edhe nga OJQ-të, që kanë njoftime të sigurta për dhunën në familje dhe që janë familjarizuar me viktimën.

Neni 23
Përmbajtja e urdhrit të përkohshëm emergjent

1. Në urdhrin për mbrojtje të përkohshme emergjente duhet të ceket:
   1.1. masa e caktuar nga Shefi i njësitit rajonal të Policisë së Kosovës kundër dhunës në familje;
   1.2. kohëzgjatja e urdhrit për mbrojtje të përkohshme emergjente, e cila skadon në fund të ditës së ardhshme gjatë të cilës gjykata punon;
   1.3. vërejtja se shkelja e urdhrit për mbrojtje emergjente të përkohshme është vepër penale;
   1.4. njoftimi se kryesit të dhunës mund t'i ofrojë ndihmë përfaqësuesi ligjor në procedurën ligjore; dhe
   1.5. shpjegimi se pas kalimit të afatit për mbrojtje të përkohshme emergjente, pala e mbrojtur mund të paraqesë kërkesë për urdhër mbrojtje emergjente, e cila nëse lejohet, do t'i nënshtrohej mbajtjes së një seance apo paraqitjes së kërkesës për urdhër mbrojtje kundër së cilës ushtrohet ankesë.
2. Urdhri për mbrojtje të përkohshme emergjente i shqiptuar nga Shefi i njësitit rajonal të Policisë së Kosovës kundër dhunës në familje, duhet t'i dërgohet menjëherë të kryerësit të dhunës në familje në pajtim me ligjin.
3. Organet e zbatimit të ligjit u dërgojnë personave në vijim nga një kopje të urdhrit për mbrojtje të përkohshme emergjente:
   3.1. palës së mbrojtur dhe personave të tjerë, emrat e të cilëve janë shënuar në urdhrin për mbrojtje emergjente;
   3.2. kërkuesit;
   3.3. stacionit lokal të policisë në vendbanimin ose vendqëndrimin e palës së mbrojtur dhe personat tjerë të përmendur në urdhër për mbrojtje të përkohshme emergjente;
   3.4. qendrës për punë sociale në komunën ku ka vendbanimin ose vendqëndrimin

pala e mbrojtur dhe personat e tjerë të përmendur në urdhrin për mbrojtje të përkohshme emergjente;
3.5. gjykatës kompetente komunale; dhe
3.6. mbrojtësit të viktimave.

4. Urdhri për mbrojtje të përkohshme emergjente menjëherë pas shqiptimit nga ana e Shefit të njësisë rajonale të Policisë së Kosovës kundër dhunës në familje hyn në fuqi dhe fillon të zbatohet ndaj kryerësit të dhunës në familje pasi t'i jetë dorëzuar personalisht atij.

Neni 24
Përgjegjësitë e Policisë së Kosovës

1. Policia e Kosovës duhet t'i përgjigjet secilit njoftim për veprat ose kërcënimet e dhunës në familje ose shkeljes së urdhrit për mbrojtje apo të urdhrit për mbrojtje emergjente pa marrë parasysh se kush e bën njoftimin.
2. Nëse ekziston dyshimi i arsyeshëm se është kryer vepra që ka të bëjë me dhunën në familje, Policia e Kosovës e ndalon kryerësin e supozuar në pajtim me ligjin.
3. Policia e Kosovës përdor mjete të arsyeshme për të mbrojtur viktimën dhe për të parandaluar dhunën, përfshirë, por duke mos u kufizuar vetëm në:
   3.1. sigurimin e linjës së posaçme telefonike për raportim të dhunës në familje;
   3.2. informimin e viktimës, përfaqësuesin ligjor ose mbrojtësin e viktimës për të drejtat e tij në përputhje me këtë ligj, por edhe me të drejtën për të kërkuar urdhrin për mbrojtje të përkohshme sipas nenit 22 të këtij ligji;
   3.3. informimin e viktimës lidhur me shërbimet e ndihmës ligjore, psikologjike dhe ndihmave të tjera në dispozicion nga institucionet qeveritare si dhe prej rrjetit të autorizuar të organizatave joqeveritare të cilat ofrojnë shërbime për viktimat;
   3.4. informimin e ofruesve përkatës të shërbimeve të përmendura sipas paragrafit 3.2 të këtij neni lidhur me ndonjë rast të dhunës në familje dhe mundësimin e kontaktit mes ofruesit të shërbimit dhe viktimës me kërkesën e viktimës;
   3.5. sigurimin e transportimit të viktimës dhe vartësve të saj deri në objektin e duhur mjekësor për trajtim ose kontrollim mjekësor;
   3.6. sigurimin e transportimit të viktimës, e sipas nevojës edhe vartësve të saj deri në një vendstrehim apo vendqëndrim tjetër të përshtatshëm dhe të sigurt, me kërkesën e viktimës;
   3.7. nëse paraqitet nevoja, sigurimin e mbrojtjes për atë që ka lajmëruar dhunën në përputhje me obligimet përkatëse ligjore lidhur me mbrojtjen e dëshmitarëve;
   3.8. largimin e të pandehurit nga banesa ku e ka vendbanimin ose vendqëndrimin e palës së mbrojtur apo ndonjë pjese të saj në rastin kur me anë të urdhrit për mbrojtje ose urdhrit për mbrojtje emergjente caktohet masa e paraparë në nenin 7 të këtij ligji;
   3.9. sigurimin e kontaktit zyrtar për viktimën ose përfaqësuesin e saj ligjor me nëpunësin hetues në kuadër të Policisë së Kosovës nëse kërkohet ndihma e mëtejshme. Nëse mungon nëpunësi hetues, atëherë ndonjë nëpunës tjetër i Policisë së Kosovës duhet t'i ndihmojë viktimës.

4. Policia e Kosovës e përpilon raportin lidhur me rastin pavarësisht se a është kryer vepra apo jo, a është ndaluar dikush apo jo dhe një kopje të këtij raporti ia japin viktimës, përfaqësuesit të saj ligjor dhe mbrojtësit të viktimës.
5. Nëse viktima është e moshës nën tetëmbëdhjetë (18) vjet ose nuk ka zotësi të veprimit, apo kur veprat e dhunës në familje janë aq të rënda sa ndikojnë në qetësinë a sigurinë e personit të moshës nën tetëmbëdhjetë (18) vjet, ose që nuk ka aftësi të plotë të veprimit dhe jeton në banesën e njëjtë, Policia e Kosovës duhet të raportoj për rastin menjëherë në qendrën për punë sociale të komunës ku ai person ka vendbanimin ose vendqëndrimin.
6. Nëse ekziston dyshimi i bazuar se është kryer një vepër që ka të bëjë me dhunën në familje pavarësisht se a është arrestuar kryerësi ose është gjetur vendndodhja e tij, Policia e Kosovës duhet ta njoftoj rregullisht viktimën apo përfaqësuesin ligjor dhe mbrojtësin e viktimës për gjendjen e hetimeve, duke përfshirë informatat lidhur me vendndodhjen e kryerësit të supozuar ose lirimin e tij a të saj nga burgimi.

Neni 25
Shkelja e urdhrave mbrojtës

1. Kush e shkel në tërësi ose pjesërisht urdhrin për mbrojtje, urdhrin për mbrojtje emergjente ose urdhrin për mbrojtje të përkohshme emergjente kryen vepër penale që dënohet me gjobë prej dyqind (200) euro deri më dymijë (2000) Euro ose me burgim deri në gjashtë muaj.
2. Përsëritja vazhdueshme e shkeljes në tërësi ose pjesërisht e urdhrit për mbrojtje, urdhrit për mbrojtje emergjente ose urdhrit për mbrojtje të përkohshme emergjente konsiderohet rrethanë rënduese për kryerësin e veprës.

Neni 26
Ndjekja e veprave penale që kanë të bëjnë me dhunën në familje

1. Shkelja e urdhrit për mbrojtje, e urdhrit për mbrojtje emergjente ose urdhrit për mbrojtje të përkohshme emergjente do të ndiqet *ex officio*.
2. Shqiptimi i urdhrit për mbrojtje dhe urdhrit për mbrojtje emergjente me vendim gjykate nuk i ndalon palët e interesuara të nisin procedurë penale, për sa i përket veprimeve dhe mosveprimeve që përbëjnë veprat penale.

Neni 27
Programi i Kosovës Kundër Dhunës në Familje

Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale, në bashkëpunim me: Ministrinë e Shëndetësisë, Ministrinë e Drejtësisë, Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, Ministrinë e Punëve të Brendshme, Ministrinë e Kulturës, të Rinisë dhe të Sportit dhe me atë të Arsimit, është përgjegjëse për mbështetjen dhe për ngritjen e strukturave ndihmëse dhe të infrastrukturës së nevojshme, që shërben për mbështetjen dhe për plotësimin e nevojave të personave ndaj të cilëve është ushtruar dhuna në familje, përfshirë këtu asistencën sociale dhe shërbimet mjekësore, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

KREU II
DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 28
Zbatimi

1. Qeveria e Kosovës, gjashtë muaj pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, nxjerr akte nënligjore që burojnë nga ky ligj.
2. Lëndët në të cilat ka filluar procedura gjyqësore deri në momentin e hyrjes ne fuqi të këtij ligji, do të zbatohen dispozitat e aplikueshme.

Neni 29
Shfuqizimi

Ky ligj shfuqizon Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2003/12 për mbrojtjen nga dhuna në familje.

Neni 30
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ligji Nr. 03/L-182
1 korrik 2010

Shpallur me dekretin Nr. DL-036-2010, datë 15.07.2010 nga Presidenti i Republikës së Kosovës, Dr. Fatmir Sejdiu.

GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS / PRISHTINË: VITI V / Nr. 76 / 10 GUSHT 2010

LIGJI Nr. 04/L-149
PËR EKZEKUTIMIN E SANKSIONEVE PENALE

Përmbajtja

Pjesa e parë: Pjesa e përgjithshme ... 557
Kreu I: Dispozitat themelore ... 557
Pjesa e dytë: Ekzekutimi i dënimeve kryesore ... 559
Kreu II: Ekzekutimi i dënimit me burgim dhe i dënimit me burgim të përjetshëm ... 559
Kreu III: Ekzekutimi i dënimit me gjobë ... 597
Pjesa e tretë: Ekzekutimi i dënimeve alternative ... 598
Kreu IV: Dispozitat e përgjithshme mbi ekzekutimin e dënimeve alternative ... 598
Kreu V: Ekzekutimi i dënimit me kusht ... 599
Kreu VI: Ekzekutimi i dënimit me kusht me urdhër për trajtim të detyrueshëm rehabilitues ... 600
Kreu VII: Ekzekutimi i dënimit me kusht me urdhër për mbikëqyrje nga shërbimi sprovues ... 601
Kreu VIII: Ekzekutimi i dënimit me urdhër për punë në dobi të përgjithshme ... 602
Kreu IX: Ekzekutimi i burgimit në gjysmëliri ... 604
Pjesa e katërt: Ekzekutimi i dënimeve plotësuese ... 604
Kreu X: Heqja e të drejtës për t'u zgjedhur ... 604
Kreu XI: Ndalimi i ushtrimit të funksioneve në administratën publike ose në shërbimin publik ... 605
Kreu XII: Ndalimi i ushtrimit të profesionit, veprimtarisë, ose detyrës ... 605
Kreu XIII: Ndalimi i drejtimit të automjetit ... 606
Kreu XIV: Marrja e lejes së vozitjes ... 607
Kreu XV: Marrja e sendit ... 607
Kreu XVI: Urdhri për publikimin e aktgjykimit ... 608
Kreu XVII: Dëbimi i të huajit nga territori i Kosovës ... 608
Kreu XVIII: Ekzekutimi i masave të trajtimit të detyrueshëm ... 608
Kreu XIX: Ekzekutimi i dënimit me burgim për kundërvajtje ... 612
Kreu XX: Ekzekutimi i dënimit me gjobë dhe i masave mbrojtëse të shqiptuara për kundërvajtje ... 615
Kreu XXI: Ekzekutimi i masave te paraburgimit ... 616
Pjesa e pestë: Organet ekzekutive për ekzekutimin e sanksioneve penale ... 618
Kreu XXII: Shërbimi korrektues i Kosovës ... 618
Kreu XXIII: Shërbimi sprovues ... 628
Kreu XXIV: Mbikëqyrja e punës së institucioneve korrektuese ... 630
Pjesa e gjashtë: Dispozitat kalimtare dhe përfundimtare ... 634
Kreu XXV: Dispozitat kalimtare dhe përfundimtare ... 634

Kuvendi i Republikës së Kosovës;

Në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton

LIGJ PËR EKZEKUTIMIN E SANKSIONEVE PENALE

PJESA E PARË
PJESA E PËRGJITHSHME

KREU I
DISPOZITAT THEMELORE

Neni 1
Qëllimi i ligjit

Qëllimi i këtij ligji është ekzekutimi i sanksioneve penale, sanksioneve kundërvajtëse dhe masave të trajtimit të detyrueshëm, dhe aplikimi i masës së paraburgimit.

Neni 2
Fushëveprimi i ligjit

1. Sanksionet penale ekzekutohen në pajtim me këtë ligj.
2. Sipas këtij ligji sanksionet penale janë dënimet kryesore, dënimet alternative, dënimet plotësuese dhe vërejtja gjyqësore.
3. Ekzekutimi i masave të trajtimit të rehabilitimit të detyrueshëm kryhet në institucion të veçantë në pajtim me këtë ligj.

Neni 3
Ekzekutimi i sanksioneve penale të shqiptuara nga gjykatat vendore dhe të huaja

Dispozitat e këtij ligji zbatohen për ekzekutimin e sanksioneve penale të shqiptuara nga gjykatat vendore dhe të huaja, në pajtim me Kodin e Procedurës Penale, Kodin e Drejtësisë për të mitur, Ligjin për kundërvajtje dhe me marrëveshjet ndërkombëtare.

Neni 4
Qëllimi i ekzekutimit të sanksioneve penale

Ekzekutimi i sanksioneve penale ka për qëllim risocializimin dhe riintegrimin e të dënuarit në shoqëri dhe përgatitjen e tij për jetë, si dhe për sjellje të përgjegjshme. Ekzekutimi i sanksioneve penale, po ashtu shërben për mbrojtjen e shoqërisë duke parandaluar kryerjen e veprave të tjera penale dhe duke përmbajtur të tjerët nga kryerja e veprave penale.

Neni 5
Parimet drejtuese

1. Sanksionet penale ekzekutohen në mënyrën e cila siguron trajtimin human dhe respektimin e dinjitetit të secilit individ. Personi i dënuar nuk i nënshtrohet torturës ose trajtimit, apo ndëshkimit çnjerëzor apo degradues.
2. Sanksionet penale ekzekutohen në mënyrë plotësisht të paanshme. Askush nuk mund të diskriminohet në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike, prejardhjes kombëtare a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike, sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal në Republikën e Kosovës.
3. Me qëllim të eliminimit të shkaqeve të korrupcionit në Shërbimin Korrektues, institucionet korrektuese dhe në Shërbimin Sprovues, në pajtim me këtë Ligj, aktet nënligjore përkatëse, të cilat do të nxjerren për zbatimin e këtij ligji, duhet të vendosin dispozitat antikorruptive, në veçanti për promovimin dhe ekzistimin e sistemit të qartë për shpërblime dhe sanksione në pjesën e zbatimit të programit të veprimit, zhvillimin e standardeve të etikës etj, si mekanizma për luftën kundër korupcionit.
4. Gjatë ekzekutimit të sanksionit penal gjithmonë respektohen të drejtat e personit të dënuar. Këto të drejta mund të kufizohen vetëm në atë masë që është e domosdoshme për ekzekutimin e sanksionit penal në pajtim me ligjin dhe standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.
5. Ekzekutimi i sanksioneve penale duhet të nxisë sa më shumë që të jetë e mundur pjesëmarrjen e personit të dënuar në risocializimin dhe riintegrimin e tij shoqëror, përmes planifikimit të dënimit dhe planit individual, si dhe bashkëpunimit të shoqërisë në arritjen e qëllimeve të tilla.
6. Qëllimi i risocializimit dhe riintegrimit të personit të dënuar në bashkësi, po ashtu duhet të plotësohet përmes nxitjes dhe organizimit të pjesëmarrjes së institucioneve ose të organeve publike dhe private, si dhe të individëve në procesin e riintegrimit.

Neni 6
Fillimi i ekzekutimit të sanksioneve penale

1. Ekzekutimi i sanksionit penal fillon kur vendimi me të cilin është shqiptuar sanksioni penal e merr formën e prerë dhe nëse për ekzekutimin e tij nuk ka pengesa ligjore.
2. Ekzekutimi i sanksionit penal mund të fillojë edhe para se të marrë formën e prerë vendimi me të cilin shqiptohet sanksioni penal, por vetëm në rastet kur kjo është paraparë shprehimisht me ligj.

Neni 7
Shtyrja dhe pezullimi i sanksionit penal

Ekzekutimi i sanksionit penal mund të shtyhet dhe të pezullohet sipas kushteve të parapara me ligj.

Neni 8
Taksat administrative për parashtresa

Për parashtresa, veprime zyrtare dhe vendime lidhur me zbatimin e dispozitave të këtij ligji nuk paguhen taksa administrative, përveç nëse me ligj parashihet ndryshe.

Neni 9
Mbajtja e evidencës

1. Për personat ndaj të cilëve ekzekutohen sanksionet penale dhe paraburgimi, mbahen evidenca përkatëse.
2. Me akt nënligjor të nxjerrë nga Ministri i Drejtësisë (më tej: Ministri), rregullohet mbajtja dhe grumbullimi i evidencave.

Neni 10
Mjetet financiare për ekzekutimin e sanksioneve penale

1. Mjetet financiare për ekzekutimin e sanksioneve penale sigurohen nga buxheti i Republikës së Kosovës**.**
2. Personi i dënuar nuk i paguan shpenzimet për ekzekutimin e sanksioneve penale, përveç nëse me ligj parashihet ndryshe.

PJESA E DYTË
EKZEKUTIMI I DËNIMEVE KRYESORE

KREU II
EKZEKUTIMI I DËNIMIT ME BURGIM DHE I DËNIMIT ME BURGIM TË PËRJETSHËM

Neni 11
Dërgimi i personave të dënuar në institucionet korrektuese

1. Personat e dënuar me burgim dhe me burgim të përjetshëm dërgohen në institucione korrektuese për ekzekutimin e dënimit me burgim dhe me burgim të përjetshëm, në pajtim me aktin e vendosjes të Ministrit.
2. Përjashtimisht, me lutje të personit të dënuar, Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Korrektues, për arsye të justifikueshme mund të heq dorë nga akti i vendosjes dhe të ndërroj vendin e ekzekutimit të dënimit. Lidhur me këtë dhe arsyet e ndërrimit duhet të njoftohet me shkrim sa më parë që të jetë e mundur ministri.
3. Kundër vendimit të Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues nga paragrafi 2. i këtij neni, lejohet ankesa tek Ministri, në afat prej tre ditësh nga dita e marrjes së vendimit. Ankesa nuk e ndalon ekzekutimin e vendimit**.**

Neni 12
Vendosja e personave të dënuar në institucionet korrektuese

1. Personi i dënuar me burgim, mund të vendoset në qendrën e paraburgimit, nëse kohëzgjatja e burgimit pas llogaritjes së paraburgimit, ose të privimit tjetër nga liria lidhur me veprën penale nuk i kalon tre (3) muaj.
2. Personi i dënuar me burgim vendoset në institucionin korrektues, nëse kohëzgjatja e burgimit pas llogaritjes së paraburgimit, ose të privimit tjetër nga liria lidhur me veprën penale i kalon tre (3) muaj.
3. Personi i dënuar me burgim të përjetshëm vendoset në institucionin korrektues.

Neni 13
Veprimet që i paraprijnë dërgimit të personave të dënuar në institucionet korrektuese

1. Nëse gjykata që ka marrë vendim në shkallë të parë nuk ka kompetencë për dërgimin e personit të dënuar për mbajtjen e dënimit me burgim, ose me burgim të përjetshëm, ajo vendimin e formës së prerë së bashku me të dhënat personale të personit të dënuar të mbledhura gjatë procedurës penale ia dërgon gjykatës kompetente brenda tri (3) ditëve prej ditës kur vendimi merr formën e prerë.
2. Gjykata kompetente duhet ta fillojë procesin e dërgimit të personit të dënuar në mbajtje të dënimit me burgim, ose burgim të përjetshëm brenda tri (3) ditëve nga pranimi i vendimit.

Neni 14
Kompetenca për dërgimin e personave të dënuar për mbajtje të dënimit me burgim ose me burgim të përjetshëm

1. Gjykata themelore që e ka shqiptuar dënimin është kompetente për dërgimin e personit të dënuar për mbajtjen e dënimit me burgim, ose me burgim të përjetshëm.
2. Gjykata e njëjtë e ka këtë kompetencë edhe kur vendqëndrimi apo vendbanimi i personit të dënuar ndryshon më vonë.

Neni 15
Gjykata kompetente për dërgimin e personit në mbajtje dënimi kur nuk dihet vendqëndrimi i personit të dënuar

Kur vendqëndrimi dhe vendbanimi i personit të dënuar nuk dihen, kompetente për dërgimin e personit të dënuar për mbajtjen e dënimit me burgim, ose me burgim të përjetshëm është gjykata themelore që ka marrë vendim në shkallë të parë dhe nëse këtë vendim e ka marrë Gjykata e Apelit, atëherë kompetente është gjykata themelore e cila gjendet në selinë e Gjykatës së Apelit.

Neni 16
Urdhëri i gjykatës për paraqitje në institucion për mbajtje dënimi

1. Gjykata kompetente e urdhëron me shkrim personin e dënuar që në ditën e caktuar të paraqitet në institucionin korrektues për mbajtjen e dënimit me burgim, ose me burgim të përjetshëm.
2. Periudha kohore ndërmjet pranimit të urdhrit dhe ditës së paraqitjes nuk duhet të jetë më e shkurtër se tetë (8) ditë dhe më e gjatë se pesëmbëdhjetë (15) ditë.
3. Gjykata kompetente e informon institucionin korrektues për datën kur personi i dënuar duhet të paraqitet në institucion dhe ia dorëzon vendimin e formës së prerë së bashku me të dhënat personale për personin e dënuar të cilat janë mbledhur gjatë procedurës penale.

Neni 17
Fillimi i ekzekutimit të dënimit me burgim ose me burgim të përjetshëm

1. Institucioni korrektues e informon gjykatën kompetente se a është paraqitur personi i dënuar për mbajtjen e dënimit.
2. Mbajtja e dënimit me burgim ose me burgim të përjetshëm llogaritet prej ditës kur personi i dënuar është paraqitur në institucionin korrektues.

Neni 18
Sjellja me forcë e personit të dënuar për mbajtjen e dënimit

1. Kur personi i dënuar i cili është thirrur me rregull për mbajtje të dënimit nuk paraqitet në institucionin korrektues, gjykata urdhëron që ai të sjellet me forcë. Nëse personi i dënuar fshehet, ose është në arrati, gjykata urdhëron shpalljen e letër rreshtimit.
2. Ekzekutimi i dënimit me burgim ose me burgim të përjetshëm llogaritet prej ditës kur personi i dënuar është privuar nga liria.

Neni 19
Shpenzimet e transportimit

1. Institucioni korrektues, personit të dënuar ia kompenson shpenzimet e transportimit publik nga vendbanimi, ose vendqëndrimi deri në institucionin korrektues.
2. Personi i dënuar i cili në institucionin korrektues sillet me forcë i paguan shpenzimet.

Neni 20
Shtyrja e ekzekutimit të dënimit me burgim

1. Ekzekutimi i dënimit me burgim mund të shtyhet me lutje të personit të dënuar:
   1.1. deri në shërimin e sëmundjes, nëse personi i dënuar vuan nga një sëmundje e rëndë akute;

1.2. më së largu deri në fund të vitit të tretë të jetës së fëmijës, nëse personi i dënuar femër e ka përfunduar muajin e gjashtë të shtatzënësisë, ose e ka fëmijën më të ri se një (1) vit;
1.3. më së largu deri në tre (3) muaj nga dita e fillimit të shtyrjes së ekzekutimit, nëse bashkëshorti, fëmija, fëmija i adoptuar, prindi, ose prindi adoptues i personit të dënuar ka vdekur, ose vuan nga ndonjë sëmundje e rëndë;
1.4. më së largu deri në gjashtë (6) muaj nga dita e fillimit të shtyrjes së ekzekutimit, nëse bashkëshortja e personit të dënuar ka për të lindur edhe tre (3) muaj, ose nëse kanë kaluar më pak se gjashtë (6) muaj prej ditës kur ajo ka lindur dhe nuk ka anëtar tjetër të familjes për t'i ndihmuar asaj;
1.5. më së largu deri në gjashtë (6) muaj nga dita e fillimit të shtyrjes së ekzekutimit, nëse bashkëshorti, ose ndonjë anëtar tjetër i bashkësisë familjare të personit të dënuar ftohet me personin e dënuar që ta mbajë dënimin me burgim, ose, nëse ndonjëri prej tyre tashmë është në burg;
1.6. më së largu deri në tre (3) muaj nga dita e fillimit të shtyrjes së ekzekutimit, nëse shtyrjen e kërkon personi i dënuar për kryerjen e punëve bujqësore, ose sezonale që nuk mund të shtyhen, ose për punë si pasojë e ndonjë fatkeqësie dhe familja e personit të dënuar nuk ka fuqi të duhur punëtore;
1.7. më së largu deri në tre (3) muaj nga dita e fillimit të shtyrjes së ekzekutimit, nëse personi i dënuar është i detyruar të kryejë punën tashmë të filluar dhe moskryerja e saj do të shkaktonte dëm të konsiderueshëm;
1.8. më së largu deri në gjashtë (6) muaj nga dita e fillimit të shtyrjes së ekzekutimit, nëse personi i dënuar kërkon shtyrjen për përfundimin e shkollimit, ose për t'iu nënshtruar provimit të cilin e ka përgatitur.

2. Dita kur merret vendimi për shtyrjen e ekzekutimit konsiderohet dita e fillimit të shtyrjes së ekzekutimit.
3. I dënuari mund të kërkojë shtyrjen e dënimit më së shumti dy herë për cilën do nga arsyet e parashikuara me këtë nen.
4. Ekzekutimi i dënimit nuk mund të shtyhet, nëse ekzekutimi i dënimit, ose të një pjese të dënimit do të bëhet i pamundur për shkak të parashkrimit

Neni 21
Procedura për shtyrjen e ekzekutimit të dënimit me burgim

1. Personi i dënuar mund të parashtroj lutjen për shtyrjen e ekzekutimit të dënimit brenda shtatë (7) ditëve nga pranimi i urdhrit për mbajtjen e dënimit me burgim.
2. Nëse urdhri nuk mund t'i dorëzohet të pandehurit ai i dorëzohet ndonjërit nga anëtarët madhorë të familjes, ose i lehet njoftimi për ditën dhe orën e dorëzimit. Nëse i dënuari nuk gjendet në adresën e tij në ditën dhe kohën e caktuar atij i ngjitet urdhri në derë. Dorëzimi i këtillë konsiderohet i rregullt.
3. Nëse sëmundja e rëndë akute e personit të dënuar, ose vdekja e bashkëshortit të tij, fëmijës, fëmijës së adoptuar, prindit, ose prindit adoptues paraqitet pas kalimit të periudhës prej shtatë (7) ditëve, lutja mund të parashtrohet deri në ditën kur personi i dënuar duhet të paraqitet për mbajtjen e dënimit.
4. Lutja për shtyrjen e ekzekutimit duhet të përmbajë arsyet e shtyrjes, provat që mbështesin shtyrjen dhe periudhën kohore për të cilën kërkohet shtyrja.

Neni 22
Lutja për shtyerjen e ekzekutimit të dënimit

1. Lutja për shtyrjen e ekzekutimit i parashtrohet kryetarit të gjykatës kompetente themelore.
2. Nëse provat nuk i bashkëngjiten lutjes, kryetari i gjykatës themelore e urdhëron personin e dënuar që provat t'i parashtrojë brenda tetë (8) ditëve me paralajmerim se në të kundërtën lutja e tij do të hudhet.

Neni 23
Vendosja lidhur me lutjen për shtyrjen e ekzekutimit të dënimit

1. Kryetari i gjykatës kompetente themelore vendosë lidhur me lutjen për shtyrjen e ekzekutimit të dënimit brenda tri (3) ditëve nga pranimi i lutjes. Para marrjes së vendimit gjykata mund të zbatojë hetime të nevojshme për vërtetimin e fakteve të parashtruara në lutje.
2. Kryetari i gjykatës kompetente themelore e hedh lutjen për shtyrjen e ekzekutimit të dënimit nëse lutja:
   2.1. është paraqitur jo me kohë;
   2.2. është paraqitur nga personi i paautorizuar;
   2.3. nuk iu janë bashkangjitur me kohë provat.

Neni 24
Ankesa

1. Kundër aktvendimit të shkallës së parë, personi i dënuar mund t'i parashtrojë ankesë kryetarit të Gjykatës së Apelit brenda tri (3) ditëve nga pranimi i aktvendimit.
2. Kryetari i Gjykatës së Apelit vendosë për ankesën brenda tri (3) ditëve nga pranimi i saj.

Neni 25
Pezullimi i ekzekutimit të dënimit për shkak të lutjes për shtyrjen e ekzekutimit

1. Lutja për shtyrjen e ekzekutimit e pezullon ekzekutimin e dënimit me burgim, derisa të merret vendim i formës së prerë lidhur me lutjen.
2. Kryetari i gjykatës kompetente themelore, i cili pas refuzimit të dytë të lutjes konstaton se e drejta në ankesë është keqpërdorur, vendosë që ankesa të mos e shtyj ekzekutimin e vendimit.

Neni 26
Raporti për gjendjen shëndetësore për shkak të sëmundjes së rëndë

Personi i dënuar, të cilit i është shtyrë ekzekutimi i dënimit për shkak të sëmundjes së rëndë akute, duhet të dorëzojë raport mbi gjendjen e tij shëndetësore të lëshuar nga institucioni mjekësor ku është duke u trajtuar një herë në tre (3) muaj, ose me kërkesë të gjykatës kompetente, edhe më shpesh.

Neni 27
Revokimi dhe ndërprerja e shtyrjes së ekzekutimit të dënimit me burgim

1. Kryetari i gjykatës kompetente themelore e revokon shtyrjen e ekzekutimit të dënimit me burgim, nëse ndërkohë konstatohet se arsyet për lejimin e shtyrjes nuk kanë ekzistuar, ose kanë pushuar së ekzistuari, ose personi i dënuar e ka shfrytëzuar periudhën e shtyrjes për qëllime të tjera e jo për ato për të cilat është lejuar.
2. Nëse shtyrja i është lejuar gruas shtatzënë, fëmija i së cilës nuk ka lindur i gjallë, shtyrja ndërpritet gjashtë (6) muaj pas lindjes, dhe nëse fëmija vdes pas lindjes, shtyrja ndërpritet gjashtë (6) muaj pas vdekjes së fëmijës.
3. Nëse shtyrja i është lejuar nënës së fëmijës më të ri se një (1) vit i cili vdes, shtyrja ndërpritet gjashtë (6) muaj pas vdekjes së fëmijës.

Neni 28
Ankesa kundër aktvendimit për revokimin, ose ndërprerjen e shtyrjes së ekzekutimit të dënimit me burgim

1. Personi i dënuar me burgim ka të drejtë ankese kundër aktvendimit për revokimin, ose ndërprerjen e shtyrjes së ekzekutimit të dënimit me burgim nën kushte të njëjta, si edhe kundër aktvendimit në bazë të cilit është vendosur lidhur me kërkesën për shtyrje.
2. Ankesa e shtynë ekzekutimin e aktvendimit.

Neni 29
Shtyrja e ekzekutimit lidhur me mjetet e jashtëzakonshme juridike

1. Gjykata që vendos lidhur me kërkesën për përsëritjen e procedurës penale të parashtruar në favor të personit të dënuar, mund ta shtyjë ekzekutimin e dënimit me burgim, edhe para hyrjes në fuqi të aktvendimit me të cilin lejohet përseritja e procedurës penale.
2. Gjykata që vendos lidhur me lutjen për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit mund ta shtyjë ekzekutimin e dënimit, varësisht nga përmbajtja e lutjes.

Neni 30
Lejimi i shtyrjes së ekzekutimit të dënimit me burgim me kërkesë të Prokurorit të Shtetit

1. Me kërkesë të Prokurorit të Shtetit kompetent gjithmonë lejohet shtyrja e ekzekutimit të dënimit me burgim, derisa të merret vendimi për shfrytëzimin e mjetit juridik.
2. Vendimi për shtyrjen e ekzekutimit të dënimit me burgim pushon të vlej, nëse prokurori i shtetit nuk e shfrytëzon mjetin juridik brenda tridhjetë (30) ditëve nga pranimi i vendimit për shtyrjen e ekzekutimit.

Neni 31
Pranimi i personit të dënuar në institucionin korrektues

1. Kur personi i dënuar pranohet në institucionin korrektues, së pari vërtetohet identiteti i tij, baza dhe autorizimi për burgimin, ose burgimin e tij të përjetshëm dhe më pas i nënshtrohet kontrollit mjekësor brenda njëzetekatër (24) orëve nga pranimi i tij, apo në ditën e parë të punës pas pranimit. Emri i personit të dënuar, bazat dhe autorizimi për burgimin, ose burgimin e tij të përjetshëm, data dhe koha e ardhjes së tij në institucionin korrektues, kontrolli dhe raporti mjekësor shënohet në regjistër dhe dosjen personale të dënuarit.
2. Me rastin e pranimit në institucionin korrektues, personi i dënuar njoftohet me shkrim për të drejtat dhe detyrimet qe i ka gjatë mbajtjes së denimit. Personi i denuar i cili nuk dinë shkrim dhe lexim njoftohet gojarisht.
3. Teksti i këtij ligji dhe akti nënligjor për rendin shtëpiak në institucionet korrektuese janë në dispozicion në gjuhë të personave të dënuar gjatë tërë kohës së mbajtjes se denimit, në pajtim me ligjin për përdorimin e gjuhëve zyrtare.
4. Procedurat në paragrafin 1., 2. dhe 3. të këtij neni nuk zbatohen në prani të personave të tjerë të dënuar. Personi i dënuar fotografohet.

Neni 32
Rendi shtëpiak

1. Me aktin nënligjor për rendin shtëpiak në institucionet korrektuese (më tej: akti për rendin shtëpiak), të cilin e nxjerrë Ministri, rregullohet organizimi dhe mënyra e jetës së personave të dënuar dhe të personave të paraburgosur, e në veçanti:
   1.1. pranimi dhe vendosja;
   1.2. njohja me rendin shtëpiak dhe me dispozitat e tjera;
   1.3. ushqimi, mbrojtja shëndetësore dhe zbatimi i masave higjienike;
   1.4. mënyra e plotësimit të nevojave fetare;
   1.5. korrespodenca, pranimi i vizitave dhe i paketave;
   1.6. llojet dhe sasitë e prodhimeve ushqimore të cilat mund të pranohen;
   1.7. kushtet dhe mënyra e disponimit me të hollat e fituara si kompenzim për punë dhe shpërblimet;
   1.8. mënyra e shfrytëzimit të pushimit vjetor;
   1.9. mbajtja e rendit dhe disiplinës;
   1.10. sistemi i shkeljeve disiplinore dhe të sanksioneve;
   1.11. kushtet dhe mënyra e aplikimit të masave disiplinore, masave të vetmisë;
   1.12. llojet e beneficioneve, të kushteve dhe mënyrës së shfrytëzimit të të gjitha beneficioneve;
   1.13. organizimi i aktiviteteve kulturore, arsimore, sportive dhe argëtuese;
   1.14. qëndrimi në hapësirë të hapur;
   1.15. lirimi dhe ndihma me rastin e lirimit nga mbajtja e dënimit me burg apo nga paraburgimi;
   1.16. çështjet e tjera të cilat janë me rëndësi për kushtet dhe mënyrën e mbajtjes së masës së dënimit me burgim dhe paraburgim.

Neni 33
Vendosja e personave të dënuar në institucionin korrektues

1. Institucioni korrektues i mundëson personit të dënuar kontakt të menjëhershëm me anëtarët e familjes pas pranimit të tij. Shtetasit të huaj i ofrohet mundësia që me shkrim, ose me telefon ta kontaktojë përfaqësuesin diplomatik, apo zyrën përkatëse të shtetit, shtetësinë e të cilit e ka ai.
2. Nëse personi i dënuar ka fëmijë të mitur, ose persona për të cilët ka përgjegjësi të veçantë për përkujdesje, institucioni korrektues lidhur me këtë e informon organin e kujdestarisë.
3. Gjatë vendosjes së personit të dënuar në institucionin e veçantë korrektues, ose në njësi të veçantë të institucionit korrektues, duhet të merret parasysh mosha e tij, llojet dhe pesha e dënimit, fakti se a ka qenë me parë i dënuar, shëndeti i tij fizik dhe mendor, kërkesat për trajtim të veçantë, lokacioni i vendbanimit, ose i vendqëndrimit të familjes së tij, siguria e tij, si dhe arsyet lidhur me arsimimin, ose punët që mund të jenë të rëndësishme për riintegrimin e tij shoqëror dhe të kritereve tjera të përcaktuara me akt nënligjor të cilin e nxjerr Ministri.
4. Me rastin e vendosjes së personit të dënuar, po ashtu duhet të merret parasysh mundësia për zbatimin e programeve të përbashkëta risocializuese, si dhe nevoja për shmangien e ndikimeve negative.
5. Personat e dënuar meshkuj dhe femra vendosen ndarazi. Gratë shtatzëna, gratë që lindin fëmijë dhe nënat që përkujdesen për fëmijët e tyre vendosen ndarazi nga gratë e tjera të dënuara.
6. Personat madhorë nuk vendosen në institucionin korrektues, ose në një pjesë të institucionit korrektues me të miturit.
7. Personat e dënuar nuk vendosen në të njëjtën pjesë të institucionit me personat e paraburgosur.
8. Duhet bërë përpjekje të mëdha që personat e dënuar për herë të parë të ndahen nga personat të cilët më parë kanë mbajtur dënimin me burgim.

Neni 34
Ndarja nga personat e dënuar

1. Me lutje të personit të dënuar, drejtori i institucionit korrektues mund të lejojë që personi i dënuar të ndahet nga personat e tjerë të dënuar në një njësi të veçantë të institucionit korrektues, nëse drejtori konstaton se arsyet e paraqitura në kërkesën e personit të dënuar janë të arsyeshme dhe nuk ka mundësi të tjera për zgjidhjen e tyre.
2. Drejtori i institucionit korrektues mund të urdhërojë që personi i dënuar të ndahet nga personat e tjerë të dënuar edhe pa lutjen e personit të dënuar vetëm kur kjo masë është e nevojshme:
   2.1. për t'iu shmangur rrezikut për jetën, ose shëndetin e personit të dënuar, ose të personave të tjerë;
   2.2. për t'iu shmangur rrezikut të sigurisë në institucionin korrektues të shkaktuar nga prania e vazhdueshme e personit të dënuar në mesin e të burgosurve dhe personave të tjerë të burgut, ose

2.3. për të siguruar integritetin e hetimit të ndonjë çështjeje disiplinore.

3. Vendimi nga paragrafët 1. dhe 2. të këtij neni merret pas hetimit të të gjitha rrethanave relevante. Ndarja nuk mund të urdhërohet për një periudhë që i kalon tridhjetë (30) ditë. Vendimi i tillë rishikohet për aq sa ka nevojë, por të paktën një herë në dhjetë (10) ditë.
4. Kur ndarja është urdhëruar për parandalimin e personit të dënuar për të mos ndikuar në personin tjetër të dënuar në shkeljen e rëndë të rendit brenda institucionit korrektues, ose për parandalimin e tij në kryerjen e aktivitetit të vazhdueshëm kriminal në institucionin korrektues, personi i dënuar mund të vendoset në njësi të veçantë të institucionit korrektues kur pritet që ndarja të zgjasë shumë.
5. Drejtori i institucionit korrektues mund të urdhërojë ndarjen e personit të dënuar i cili sillet në mënyrë të dhunshme nga personat tjerë të dënuar pa kërkesën e tij, për aq sa është e nevojshme të pengojë sjelljen e tij të dhunshme.
6. Personit të dënuar, të ndarë prej personave të tjerë të dënuar i njihen të njëjtat të drejta, benificione dhe kushte sikurse ato të cilat i gëzojnë të gjithë të burgosurit, përveç atyre benificioneve të cilat mund të gëzohen vetëm bashkërisht me të burgosurit tjerë, apo të cilat nuk mund të sigurohen për shkak të kufizimeve që i kanë njësitë e institucionit korrektues në të cilin është vendosur personi i dënuar i ndarë.
7. Personeli i kualifikuar shëndetësor e kontrollon personin e dënuar të ndarë, së paku një herë në ditë dhe sipas nevojës.
8. Vendimi për ndarjen e personit të dënuar nga personat e tjerë të dënuar ndërpritet posa të pushojnë së ekzistuari arsyet për urdhërimin e ndarjes, ose në rastet kur personeli i kualifikuar shëndetësor konstaton se vazhdimi i ndarjes do të jetë i dëmshëm për shëndetin e personit të dënuar.

Neni 35
Kontrollimet

1. Personi i dënuar nuk duhet të kontrollohet në mënyrën e cila e cenon dinjitetin e tij. Shkalla e bezdisjes së personit të dënuar gjatë kontrollimit duhet të jetë proporcionale me qëllimin e tij, ashtu siç është paraparë me këtë nen.
2. Nëse tek anëtari i personelit korrektues ekziston dyshim i bazuar se personi i dënuar ka në posedim ndonjë mjet, i cili atij nuk i lejohet ta ketë në posedim në pajtim me rregullat për rendin e brendshëm mjet i palejuar, personi i dënuar mund të kontrollohet me dorë, ose me mjete teknike derisa është i veshur. Kontrollimi me dorë duhet të bëhet nga anëtari i personelit korrektues të së njëjtës gjini me atë të personit të dënuar.
3. Anëtari i personelit korrektues mund të kontrollojë trupin e zhveshur të personit të dënuar përmes inspektimit vizuel kur nuk ekziston ndonjë dyshim i veçantë në pajtim me kushtet e parapara në paragrafin 6. të këtij neni:
   3.1. në rrethanat e përcaktuara, të parapara në urdhëresë të kufizuara në situata ku personi i dënuar ka qenë në vend ku ka pasur gjasa të ketë qasje në mjetin e palejuar që ka mundësi të fshehët në, apo brenda trupit;
   3.2. kur personi i dënuar hyn, apo del nga lokalet e personave të dënuar të ndarë.

4. Nëse tek anëtari i personelit korrektues ekziston dyshim i bazuar se personi i dënuar është në posedim të ndonjë mjeti të palejuar dhe e ka bindur drejtorin e institucionit korrektuese se kontrolli i trupit të zhveshur të personit të dënuar me inspektim vizuel është i nevojshëm për gjetjen e mjetit të palejuar, kontrolli i tillë mund të bëhet në pajtim me kushtet e parapara në paragrafin 6. të këtij neni.
5. Nëse tek anëtari i personelit korrektues ekziston dyshim i bazuar se personi i dënuar posedon ndonjë mjet të palejuar dhe se kontrolli i trupit të zhveshur të personit të dënuar me inspektim vizuel është i nevojshëm për gjetjen e mjetit të palejuar, ai mund të kryejë kontrollin e tillë në pajtim me kushtet e parapara në paragrafin 6. të këtij neni pa miratim paraprak të drejtorit të institucionit korrektuese nëse vonesa për kërkimin e miratimit të tillë do të rezultonte me rrezik për jetën, apo sigurinë e njeriut.
6. Kontrolli i trupit të zhveshur të personit të dënuar me kontrollim vizuel:
   6.1. bëhet nga ana e dy (2) punonjësve korrektues të së njëjtës gjini me atë të personit të dënuar dhe në një vend të veçuar, pa praninë e personave të tjerë;
   6.2. asnjëherë nuk bëhet në praninë e personave të gjinisë tjetër nga ajo e personit të dënuar; dhe
   6.3. nuk përfshin zhveshjen e pjesëve të sipërme dhe të poshtme të trupit të personit të dënuar në të njëjtën kohë.
7. Nëse tek anëtari i personelit korrektues ekziston dyshim i bazuar se personi i dënuar posedon ndonjë mjet të palejuar të fshehur në zgavrat e trupit të tij, ai e informon drejtorin e institucionit korrektues. Nëse drejtori i institucionit korrektues është i bindur se ekziston dyshim i bazuar se personi i dënuar është në posedim të ndonjë mjeti të palejuar të fshehur në zgavrat e trupit të tij dhe se kontrollimi fizik i zgavrave të trupit të tij është i nevojshëm për gjetjen e mjetit të palejuar, drejtori mund të lëshojë autorizim me shkrim për kontrollimin e tillë fizik, me pëlqimin e personit të dënuar. Kontrollimi i tillë fizik kryhet vetëm nga ana e personelit të kualifikuar shëndetësor i së njëjtës gjini me atë të personit të dënuar në një vend të veçuar.
8. Çfarëdo mjeti i palejuar i cili zbulohet si rezultat i kontrollimit, ose kontrollimit fizik të zgavrave të trupi mund të konfiskohet.
9. Kontrollimi i qelisë së burgut të personit të dënuar duhet të kryhet me respektimin e pasurisë së tij personale.

Neni 36
Strehimi i personave të dënuar

1. Personi i dënuar ka të drejtë në strehim që i përgjigjet kushteve bashkëkohore higjienike dhe rrethanave vendore klimatike.
2. Lokalet në të cilat jeton dhe punon personi i dënuar duhet të kenë hapësirë të mjaftueshme ashtu që secili person i dënuar të ketë së paku tetë (8) metra kub hapësirë dhe kur është e mundshme nëntë (9) metra katrorë për të dënuarit në qeli të përbashkëta dhe katër (4) metra katrorë për të dënuarit në qeli të vetme, dhe sasi të mjaftueshme të dritës natyrore dhe artificiale për punë dhe lexim, ngrohje dhe ajrosje.

3. Lokalet nuk duhet të kenë lagështi dhe duhet të kenë pajisje sanitare adekuate dhe mjete të tjera të nevojshme për higjienë personale.
4. Në lokale të përbashkëta vendosen personat e dënuar të cilët janë të përshtatshëm për t'u shoqëruar me të tjerët në kushtet e tilla.

Neni 37
Marrja me ushtrime fizike

Personi i dënuar ka të drejtë që të merret me ushtrime fizike aq sa është e nevojshme për ruajtjen e shëndetit të tij dhe të kalojë së paku dy (2) orë në ditë jashtë lokaleve të mbyllura gjatë kohës së lirë. Nëse moti është i mirë, personi i dënuar mund të merret me ushtrime fizike në ambient të hapur.

Neni 38
Higjiena

1. Higjiena e personave të dënuar dhe higjiena e lokaleve mbikëqyret rregullisht në institucionet korrektuese.
2. Me qëllim të sigurimit të higjienës së personave të dënuar dhe higjienës së lokaleve, personave të dënuar iu sigurohet sasi e mjaftueshme e ujit të ftohtë dhe të nxehtë si dhe, artikuj adekuat për pastrim dhe tualet. Pajisjet dhe mjetet për higjienë personale sigurojnë privatësinë e mjaftueshme dhe ata mirëmbahen dhe pastrohen me rregull.
3. Personit të dënuar i sigurohet shtrat i veçantë dhe shtresa e mbulesa të mjaftueshme të cilat duhet të jenë të pastra kur i jepen, duhet të mirëmbahen si duhet dhe të ndërrohen rregullisht.
4. Standardet për kushte higjieno-sanitare rregullohen me akt nënligjor.

Neni 39
Ushqimi i personave të dënuar

1. Personi i dënuar ka të drejtë në ushqim të përshtatshëm për ruajtjen e mirë të shëndetit dhe fuqisë së tij në tri shujta për çdo ditë të cilat duhet të jenë të llojllojshme dhe ushqyese. Ushqimi që i jepet personit të dënuar duhet t'i përshtatet moshës dhe gjendjes së tij shëndetësore, natyrës së punës, stinës e kushteve klimatike dhe aq sa është e mundur, kërkesave të tij fetare dhe kulturore.
2. Personi i dënuar i cili kryen punë të rënda, personi i sëmurë, gruaja shtatzënë, ose ajo e cila ka lindur fëmijë kanë të drejtë në ushqim të caktuar nga mjeku.
3. Mjeku, ose eksperti tjetër për ushqim e kontrollon ushqimin dhe e njofton drejtorin e institucionit korrektues para servimit të çdo shujte për cilësinë e tij dhe konstatimet e tij shënohen në librin përkatës.
4. Ministri nxjerr udhëzim administrativ për rregullim më të përafërt për ushqimin e personave të dënuar.
5. Shërbimi Korrektues, sipas rregullit, drejtpërdrejt e udhëheq shërbimin që u siguron shujtat personave të dënuar në institucionin korrektues.

Neni 40
Disponimi i vazhdueshëm me ujë të pishëm

1. Personi i dënuar vazhdimisht duhet të ketë në dispozicion ujë të pijshëm.
2. Ushqimi dhe uji i përshtatshëm nga aspekti mjekësor, zbatimi i tabelave dietale dhe përgatitja e shujtave mbikëqyret rregullisht nga shërbimi mjekësor në secilin institucion korrektues.

Neni 41
Veshmbathja e personave të dënuar

1. Personi i dënuar ka të drejtë në ndërresa, rroba dhe këpuca pa pagesë, të përshtatshme për kushtet vendore klimatike dhe stinën e vitit.
2. Personi i dënuar ka të drejtë në rroba, këpucë dhe pajisje të posaçme që janë të nevojshme për punën që ai e kryen.

Neni 42
Mbajtja e uniformës së institucionit korrektues

1. Personi i dënuar e vesh uniformën e institucionit korrektues.
2. Veshmbathja e personit të dënuar nuk guxon të ketë ndikim poshtërues, ose degradues.
3. Drejtori i institucionit korrektues përkatës mund t'u lejojë personave në qendrën e paraburgimit, në institucionin e hapur korrektues, ose në njësinë e hapur të institucionit korrektues që t'i veshin rrobat e tyre personale.
4. Drejtori i institucionit korrektues u lejon të paraburgosurve dhe personave të dënuar që t'i veshin rrobat e tyre personale kur paraqiten në gjyq, ose kur dalin jashtë burgut, përveç nëse kjo e shton rrezikun e arratisjes.

Neni 43
Përkujdesja shëndetësore

1. Personi i dënuar ka të drejtë në përkujdesje shëndetësore pa pagesë.
2. Personi i dënuar të cilit nuk mund t'i ofrohet trajtim i duhur mjekësor në institucionin korrektues dërgohet në spitalin e burgut, në institucionin psikiatrik adekuat, ose në ndonjë institucion tjetër për përkujdesje shëndetësore.
3. Koha e kaluar për trajtim mjekësor jashtë institucionit korrektues llogaritet në dënimin me burgim, ose me burgim të përjetshëm.

Neni 44
Kontrolli mjekësor specialistik

1. Me kërkesë të personit të dënuar, drejtori i institucionit korrektues mund të lejojë kontroll mjekësor specialistik edhe nëse mjeku i institucionit nuk ka urdhëruar kontroll të tillë.
2. Shpenzimet për kontrollin e tillë paguhen nga personi i dënuar, përveç nëse drejtori i institucionit korrektues vendos ndryshe.

Neni 45
Njoftimi i familjes kur personi i dënuar është i sëmurë rëndë

1. Kur personi i dënuar është i sëmurë rëndë, institucioni korrektues e informon bashkëshortin-en e tij, fëmijët dhe fëmijët e adoptuar, dhe nëse personi i dënuar nuk ka të afërm të tillë, institucioni korrektues i njofton prindërit e tij, prindërit adoptues, vëllain, motrën, ose të afërmit më të largët.
2. Me kërkesë të personit të dënuar, drejtori i institucionit korrektues mund të lejojë që personat tjerë të njoftohen për sëmundjen.

Neni 46
Përkujdesja shëndetësore

1. Përkujdesja shëndetësore në institucion korrektues zbatohet në pajtim me rregullat e përgjithshme për përkujdesje shëndetësore, për sigurim shëndetësor dhe për shërbime mjekësore dhe farmaceutike, përveç nëse me këtë ligj parashihet ndryshe.
2. Institucioni përkatës shëndetësor pranë Ministrisë së Shëndetësisë (me tej: institucioni shëndetësor), siguron kushte për shërbime elementare mjekësore.
3. Institucioni shëndetësor, siguron shërbimin mjekësor, shërbimin e përkujdesjes dhe atë të farmacisë për plotësimin e nevojave të kujdesit shëndetësor për personat e dënuar.

Neni 47
Vizitat dhe kontrollimet mjeksore

1. Mjeku e viziton dhe e kontrollon secilin person të dënuar pas pranimit, e sipas nevojës edhe më vonë, me qëllim të identifikimit të sëmundjeve të mundshme fizike, ose mendore dhe për ndërmarrjen e të gjitha masave të nevojshme për trajtim mjekësor.
2. Personit të dënuar, gjatë mbajtjes së dënimit me burgim, ose burgim të përjetshëm i sigurohet përkujdesje shëndetësore përmes kontrollimeve të rregullta dhe të herëpashershme, pavarësisht a është bërë kërkesë për këtë.
3. Mjeku çdo ditë i viziton të gjithë personat e sëmurë, personat që ankohen për ndonjë sëmundje, ose lëndim dhe personat të cilët janë nën përkujdesje të posaçme. Mjeku menjëherë e paraqet sëmundjen për të cilën nevojitet ekzaminim i veçantë, ose përkujdesje specialistike.
4. Kur personi i dënuar manifeston sjellje që tregojnë se ai mund të bëjë përpjekje që ta lëndojë veten, ose të bëjë vetëvrasje, personeli ndërmerr të gjitha masat e nevojshme për pengimin e vetëlëndimit, ose vetëvrasjes. Nëse personi i dënuar bën përpjekje për ta lënduar veten, ose të bëjë vetëvrasje, një ekip profesional shumë disiplinor ndërmerr veprime të nevojshme për t'i dalë në ndihmë atij në evitimin e shkaqeve që atë e shtyjnë të tentojë të ndërmerr një veprim të tillë.
5. Personi i dënuar për të cilin dyshohet ose të cilit i është përcaktuar diagnoza se vuan nga ndonjë sëmundje infektive, ose ngjitëse trajtohet menjëherë. Kur dyshohet se ka çrregullim mendor, ose shqetësim emocional pa vonesë merren masat e duhura në pajtim me ligjin në fuqi dhe rregullat lidhur me ndihmën psikiatrike dhe shëndetin mendor.

Neni 48
Përkujdesja mjekësore

1. Përkujdesja mjekësore, vlerësimi, ose trajtimi psikiatrik apo psikologjik mund të zbatohet ndaj personit të dënuar vetëm me pëlqimin e tij.
2. Personi i dënuar mund të refuzojë dhënien e pëlqimit sipas paragrafit 1. të këtij neni. Kur personi i dënuar nuk jep pëlqim, nga ai kërkohet që të nënshkruajë deklaratën për mospajtimin.
3. Për parandalimin e vetëlëndimit, lëndimin e të tjerëve, ose dëmtimin e pronës, institucioni korrektues mund të përdor mjete shtrënguese pa pëlqimin e personit të dënuar.

Neni 49
Konstatimet mjekësore

Konstatimet mjekësore të personit të dënuar trajtohen si konfidenciale në pajtim me praktikën mjekësore profesionale dhe me kodet e etikës mjekësore.

Neni 50
Njoftimi për shëndetin fizik apo mendor të keqësuar të personit të dënuar

1. Mjeku e njofton drejtorin e institucionit korrektues kurdo që ai konstaton se shëndeti fizik, ose mendor i personit të dënuar është keqësuar, apo do të keqësohet nga qëndrimi i vazhdueshëm në burgim, apo në burgim të përjetshëm, ose nga ndikimi i ndonjërit prej kushteve të burgimit, apo burgimit të përjetshëm
2. Mjeku në bashkëpunim me organin kompetent të shëndetësisë bën kontrollime të rregullta të institucionit korrektues dhe drejtorin e institucionit korrektues e njofton me shkrim për:
   2.1. sasinë, cilësinë, përgatitjen dhe servimin e ushqimit dhe të ujit;
   2.2. higjienën dhe pastërtinë e institucionit korrektues dhe të personave të dënuar;
   2.3. instalimet hidrosanitare, ngrohjen, ndriçimin dhe ajrosjen e institucionit korrektues dhe
   2.4. përshtatshmërinë dhe pastërtinë e veshmbathjes dhe të shtresave e mbulesave të personave të dënuar.
3. Nëse personi i dënuar vuan nga ndonjë sëmundje e rëndë shëndetësore merren masa që atij t'i ofrohet trajtimi më i mirë i mundshëm.

Neni 51
Ndalimi i marrjes së detyrueshme të ushqimit nga personi i dënuar

1. Ndalohet marrja e detyrueshme e ushqimit nga personi i dënuar.
2. Nëse personi i dënuar me refuzimin e marrjes së ushqimit ose të mjekimit sjell jetën dhe shëndetin e vet në rrezik, mund të ndërmerren masat e domosdoshme medicionale edhe pa pëlqimin e tij.

Neni 52
Sigurimi i shërbimeve shëndetësore të kujdesit shëndetësor të femrave shtatëzana

1. Në institucionin korrektues për femra, shërbimet shëndetësore të kujdesit shëndetësor të femrave shtatzëna i siguron isntitucioni shëndetësor.
2. Kudo që është e mundur bëhen përgatitje që fëmijët të lindin në spital jashtë institucionit. Nëse fëmija lind në institucionin korrektues, fakti i tillë nuk shënohet në certifikatën e lindjes.

Neni 53
Mbjatja e fëmijës nga ana e femrës së denuar

1. Femra e dënuar që ka fëmijë mund ta mbajë atë derisa i mbush tetëmbëdhjetë (18) muaj dhe pastaj prindërit e fëmijës vendosin, nëse kujdestaria e fëmijës i besohet babait, të afërmve, ose personave të tjerë.
2. Nëse prindërit nuk pajtohen për kujdestarinë e fëmijës, ose nëse marrëveshja e tyre është e dëmshme për fëmijën, gjykata e cila është kompetente sipas vendbanimit, ose vendqëndrimit të nënës në kohën kur është dënuar ajo vendos se kujt i besohet fëmija.
3. Kur sipas paragrafit 2. të këtij neni merret vendim, gjykata para së gjithash merr parasysh interesin më të mirë të fëmijës, duke përfshirë mbrojtjen dhe sigurinë e fëmijës, si dhe mirëqenien e tij fizike dhe shpirtërore.
4. Kur fëmija mbahet në institucionin korrektues me nënën e tij merren masa të posaçme për sigurimin e një dhome fëmijësh me persona të kualifikuar në të cilën vendoset fëmija kur nuk është nën kujdesin e nënës së tij.

Neni 54
Rrethanat dhe nevojat e posacme për risocializimin në ambinetet korrektuese

1. Risocializimi në ambientet korrektuese merr parasysh rrethanat dhe nevojat e posaçme të secilit person që kanë të bëjnë me risocializimin e tij. Për caktimin e të gjitha rrethanave dhe faktorëve të rëndësishëm për planifikimin e riedukimit të personit në institucionin korrektues dhe riintegrimin e tij shoqëror pas lirimit, vrojtimi i personalitetit bëhet në fillim të ekzekutimit të dënimit dhe vazhdon gjatë tërë kohës së dënimit.
2. Gjatë ekzekutimit të dënimit, programi riedukues përfshihet, ose ndryshohet për t'iu përshtatur përparimit të arritur dhe rrethanave të tjera përkatëse. Për përmbushjen e këtij qëllimi hartohet plan i përshtatshëm kohor për realizimin e këtij programi.
3. Personi i dënuar inkurajohet që të bashkëpunojë në realizimin e programeve dhe aktiviteteve risocializuese në institucion.

Neni 55
Programi individual për korrektim dhe risocializim

1. Drejtori i institucionit korrektues e nxjerr program individual për korrektim dhe risocializim të çdo të denuari në bazë të rekomandimeve të personelit profesional të institucionit korrektues.

2. Programi risocializues përfshin së paku:
   2.1. vendosjen në institucionin, ose në sektorin brenda institucionit;
   2.2. pjesëmarrjen në aktivitete arsimore;
   2.3. pjesëmarrjen në aktivitete të aftësimit profesional;
   2.4. pjesëmarrjen në aktivitete kulturore, edukuese dhe sportive;
   2.5. punën dhe përmirësimin e aftësive profesionale;
   2.6. lidhjet familjare dhe kontaktet me botën e jashtme;
   2.7. kushtet për fitimin e të drejtës për pushim në shtëpi, për lirim me kusht, ose lirim të parakohshëm dhe
   2.8. masat që synojnë përgatitjen për lirimin përfundimtar.

Neni 56
Qëllimi i riintegrimit të personave të dënuar

1. Qëllimi i riintegrimit të personave të dënuar në shoqëri, po ashtu realizohet përmes nxitjes dhe organizimit të pjesëmarrjes së institucioneve, ose të organeve publike dhe private, si dhe të individëve në aktivitetet korrektuese dhe risocializuese.
2. Personat që janë të interesuar dhe manifestojnë aftësi për përkrahjen e kontakteve ndërmjet personave të dënuar në institucione korrektuese dhe bashkësisë së jashtme, lejohen që t'i vizitojnë institucionet korrektuese nën mbikëqyrjen e drejtorit me autorizimin e Ministrit të Drejtësisë.

Neni 57
Parashtresat

1. Personi i dënuar ka të drejtë t'i dërgojë parashtresa organeve kompetente.
2. Shtetasi i huaj ka të drejtë t'i dërgojë parashtresa Ambasadës, Misionit Diplomatik dhe zyrës ndërlidhëse, ose misionit diplomatik të shtetit shtetas i të cili është ai, ose shtetit i cili i mbron interesat e tij. Shtetasi i huaj i cili nuk është nën mbrojtjen e ndonjë shteti ka të drejtë t'i dërgojë parashtresa organeve dhe organizatave kompetente në Republikën e Kosovës dhe organizatave kompetente ndërkombëtare.
3. Personi i dënuar pranon dhe dërgon parashtresa përmes institucionit korrektues.

Neni 58
Korrespondenca

1. Personi i dënuar gëzon të drejtë të pakufizuar për korrespondencë.
2. Personi i dënuar gëzon të drejtën e privatësisë së letrave dhe mjeteve të tjera të komunikimit.
3. Letra, ose dërgesa tjetër postare mund të hapet nëse ekziston dyshim i bazuar se në të gjendet ndonjë send i palejuar.
4. Personit të dënuar i mundësohet të jetë i pranishëm gjatë hapjes së letrës, ose dërgesës tjetër postare dërguar atij, ose nga ai në pajtim me paragrafin 3. të këtij neni. Në rastin kur ai nuk është i pranishëm informohet menjëherë. Kur hapja e letrës, ose e dërgesës tjetër postare bëhet në pajtim me paragrafin 3. të këtij neni,

përmbajtja e tyre kontrollohet vetëm në masën e nevojshme për nxjerrjen e konstatimit, nëse letra, ose dërgesa tjetër postare përmban ndonjë send të palejuar.

5. Drejtori i institucionit korrektues mund të nxjerrë vendim me shkrim për autorizimin e hapjes, a leximit të letrës, ose dërgesës tjetër postare si masë më së paku shqetësuese e mundshme nëse ekziston dyshim i bazuar se në të ka prova për:
   5.1. veprim që do të rrezikonte sigurinë e institucionit korrektues, ose të ndonjë personi;
   5.2. vepër penale, apo plan për kryerjen e veprës penale; dhe
   5.3. hapja e leximi i letrës, ose i dërgesës postare është masa më së paku e bezdisshme e mundshme në ato rrethana.
6. Kur letra, ose dërgesa tjetër postare hapet dhe lexohet në pajtim me paragrafin 5. të këtij neni, drejtori i institucionit korrektues menjëherë e informon me shkrim personin e dënuar lidhur me arsyet e veprimit të tillë dhe atij i mundëson dhënien e sqarimeve lidhur me këtë, përveç nëse informata pafavorshëm do të ndikonte në hetimet e papërfunduara, me ç'rast personi i dënuar informohet për arsyet dhe atij i mundësohet dhënia e sqarimeve lidhur me këtë me përfundimin e hetimeve.
7. Letra, ose dërgesa postare që është hapur dhe lexuar në pajtim me paragrafin 5. të këtij neni mund të ndalohet, nëse do të rrezikohej siguria e institucionit korrektues, ose e ndonjë personi. Në rastin e tillë personi i dënuar informohet menjëherë dhe, në rastin e ndalimit të letrës, ose të dërgesës postare pasuese, ai informohet për përmbajtjen e saj deri në masën e nevojshme. Letra që është ndaluar i dorëzohet personit të dënuar sapo të pushojë së ekzistuari baza për ndalimin e saj dhe më së voni deri në fund të mbajtjes se dënimit të tij, përveç nëse gjykata kompetente vendos ndryshe. Kundër vendimit të gjykatës lejohet ankesa gjykates më të lartë kompetente. Ankesa nuk e shtyen ekzekutimin e vendimit.
8. Letrat dhe dërgesat tjera postare nga personi i dënuar që i adresohen Avokatit të Popullit nuk kontrollohen.

Neni 59
Korrespondenca me avokatin nga ana personit të dënuar

1. Personi i dënuar mund të kontaktojë me avokatin e tij pa kufizim dhe pa mbikëqyrjen e përmbajtjes së korrespondencës.
2. Përjashtimisht, kolegji i përbërë nga tre (3) gjyqtarë të gjykatës themelore kompetente mund të nxjerrë aktvendim me kërkesë të drejtorit të institucionit korrektuese që:
   2.1. korrespondenca e personit të dënuar me avokatin e tij të mund të hapet, nëse plotësohen kushtet nga paragrafi 3 i nenit 58 i këtij ligji. Në rastin e tillë zbatohet paragrafi 4 i nenit 58 të këtij ligji;
   2.2. drejtori i institucionit korrektues mund të hapë dhe të lexojë korrespondencën e personit të dënuar me avokatin e tij, nëse plotësohen kushtet e paraqitura në paragrafin 5 të nenit 58 të këtij ligji. Në rastin e tillë zbatohet paragrafi 6.i nenit 58 të këtij ligji.
3. Aktvendimi i kolegjit prej tre (3) gjyqtarësh merret brenda dyzetetetë (48) orësh nga pranimi i kërkesës së drejtorit të institucionit korrektues.

Neni 60
E drejta në thirrje telefonike

1. Personi i dënuar ka të drejtë të bëjë thirrje telefonike.
2. Dispozitat e nenit 58 të këtij ligji përshtatëshmërisht aplikohen edhe për mbikqyrje të thirrjeve telefonike.

Neni 61
Ndihma juridike

Institucioni korrektues lehtëson qasjen e personit të dënuar për ndihmë juridike lidhur me ekzekutimin e dënimit me burgim, ose me burgim të përjetëshëm dhe ndërmerr veprime të nevojshme për mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të garantuara me ligj.

Neni 62
Vizitat

1. Personi i dënuar ka të drejtë në pranimin e vizitave së paku një herë në muaj në kohëzgjatje prej së paku një (1) orë nga bashkëshorti/ja, fëmija, fëmija i adoptuar, prindi, prindi adoptues dhe të afërmit e tjerë të gjakut në vijë të drejtpërdrejtë, ose në vijë të tërthortë deri në shkallën e katërt.
2. Vizitat e tilla bëhen në lokale të veçanta nën mbikëqyrjen e personelit të institucionit korrektues.
3. Drejtori i institucionit korrektues mund t'i lejojë personit të dënuar të pranojë vizita edhe nga persona të tjerë.
4. Për vizitat që u bëhen nënave të dënuara nga fëmijët e tyre zbatohen rregulla të posaçme që atyre u mundësojnë vizita edhe më të rregullta.
5. Kryetari i gjykatës themelore kompetente ku gjendet institucioni korrektues, ose i deleguari i tij mund t'i vizitojë dhe të flasë me personat e dënuar në çdo kohë, ose me kërkesën e tij.
6. Çështjet lidhur me kontrollin e detajuar të vizitorëve të personave të dënuar, për sigurinë gjatë vizitave, për procedurat e kategorive specifike të vizitorëve dhe për kushtet sipas të cilave vizitat mund të refuzohen, ose të pezullohen nga drejtori i institucionit korrektues për shkaqe të mbrojtjes dhe sigurisë rregullohen me aktin për rendin shtëpiak.

Neni 63
Vizita nga ana e përfaqësuesit te autorizuar

1. Personi i dënuar mund të vizitohet nga përfaqësuesi i tij i autorizuar i cili e përfaqëson atë në procedurë ligjore.
2. Personi i dënuar ka të drejtë për komunikim konfidencial gojor me përfaqësuesin e tij të autorizuar nën mbikëqyrje, por jo edhe me dëgjimin dhe përgjim nga ana e personelit të institucionit korrektues.

Neni 64
Vizita e shtetasit të huaj nga përfaqësuesi diplomatik ose konsullar

1. Shtetasi i huaj ka të drejtë të vizitohet nga përfaqësuesi diplomatik, ose konsullar i shtetit, shtetas i të cilit është ai, ose të shtetit i cili i mbron interesat e tij. Shtetasi i huaj i cili nuk është nën mbrojtjen e asnjë shteti ka të drejtë të vizitohet nga organet dhe organizatat kompetente të Kosovës dhe nga organizatat kompetente ndërkombëtare.
2. Përfaqësuesi konsullor, ose diplomatik i shtetit të huaj dhe përfaqësuesi i organizatës kompetente ndërkombëtare është i detyruar ta njoftojë drejtorin e institucionit korrektues për vizitën që do t'i bëjë të burgosurit në pajtim me aktet juridike ndërkombëtare të zbatueshme në Kosovë.

Neni 65
Kalimi i kohës në lokale të veçanta

1. Personi i dënuar ka të drejtë të qëndrojë me bashkëshortin/en dhe fëmijët së paku një (1) herë në tre (3) muaj të paktën tri (3) orë.
2. Koha, kohëzgjatja, mënyra e vizitës, natyra e vizitave dhe kalimi i kohës në lokale të veçanta rregullohet me aktin për rendin shtëpiak.

Neni 66
Pranimi i pakove

1. Personi i dënuar ka të drejtë të pranojë pako të cilat përmbajnë artikuj për përdorimin personal, artikuj ushqimor, pije dhe artikuj higjieno – sanitar së paku një herë në muaj.
2. Pakot kontrollohen në prani të personit të dënuar para se t'i jepen atij.
3. Pesha dhe përmbajtja e lejueshme e pakove rregullohet me aktin për rendin shtëpiak.

Neni 67
Mbajtja e sendeve

1. Personat e dënuar nuk mund të mbajnë sende të tjera përveç atyre të lejuara me aktin për rendin shtëpiak.
2. Prona personale e personave të dënuar që vendoset nën mbikëqyrje të sigurt nga ana e drejtorit të institucionit korrektues mbahet në gjendje të mirë. Kur asgjësimi i ndonjë sendi është i domosdoshëm, ky veprim regjistrohet dhe lidhur me këtë njoftohet personi i dënuar.
3. Çdo pronë që i takon personit të dënuar, e cila nuk kërkohet për një periudhë më të gjatë se tri (3) vjet pas lirimit apo vdekjes së tij, mund të shitet, ose të hidhet. Të ardhurat nga shitja derdhen në Buxhetin e Kosovës.

Neni 68
Paratë e të burgosurit

1. Personi i dënuar me burgim ose me burgim të përjetshëm nuk mund të mbajë para gjatë mbajtjes së dënimit, përveç nëse kjo lejohet me aktin për rendin shtëpiak.
2. Nëse me rastin e pranimit në institucionin korrektues i burgosuri posedon para, ato duhet të depozitohen në xhirollogari kursimi në emër të tij, përveç nëse ai vendos ndryshe.
3. Me aktin për rendin shtëpiak caktohet shuma e mjeteve me të cilat personi i dënuar mundet lirisht të disponoj si dhe shuma të cilën ai e depoziton në kursim.

Neni 69
Puna

1. Personi i dënuar i aftë për punë ka të drejtë dhe obligim të punojë.
2. Qëllimi i punës së tillë është që personi i dënuar të fitojë, të ruajë dhe zhvillojë aftësitë punuese, shprehitë e punës dhe njohuritë profesionale për fillimin e sërishëm të jetës normale sa më parë që të jetë e mundur pas mbajtjes së dënimit.

Neni 70

1. Puna e personave të dënuar duhet të jetë e dobishme dhe nuk guxon të jetë degraduese.
2. Puna nuk mund të imponohet si formë e dënimit disiplinor.
3. Realizimi i përfitimit ekonomik nuk guxon të shkojë në dëm të qëllimit të punës, ose të interesave të personave të dënuar.

Neni 71
Zgjedhja e punës

1. Personi i dënuar mund ta zgjedhë llojin e punës që i pëlqen nëse zgjedhja e tillë është e zbatueshme dhe në pajtim me programin përkatës profesional.
2. Ekipi profesional në institucionin korrektues i vlerëson aftësitë e personit të dënuar.

Neni 72
Punësimi i personit të dënuar brenda ose jashtë institucionit korrektues

1. Personi i dënuar mund të punësohet brenda, ose jashtë institucionit korrektues.
2. Organizimi dhe metoda e punës brenda institucionit korrektues duhet të jenë sa më afër punës së ngjashme që kryhet jashtë institucionit korrektues.

Neni 73
Orari i punës

1. Personi i dënuar punon dyzet (40) orë në javë, por orari i punës mund të jetë më i gjatë sipas kushteve të përcaktuara me ligj.

2. Personi i dënuar që vijon shkollimin e përgjithshëm, ose atë profesional punon proporcionalisht më pak orë.
3. Personi i dënuar mund të urdhërohet të punojë jashtë orarit të punës deri në dy (2) orë në ditë për mirëmbajtjen e pastërtisë dhe kryerjen e obligimeve të tjera të zakonshme në institucionin korrektues.
4. Kur në pajtim me dispozitat e përgjithshme koha e kaluar në punë pranohet me qëllim të fitimit të kualifikimit profesional, koha e kaluar në llojin e njëjtë të punës gjatë kohëzgjatjes së dënimit me burgim, ose me burgim të përjetëshëm pranohet po ashtu për atë kualifikim.

Neni 74
Shpërblimi mujor

Personi i dënuar ka të drejtë në shpërblim mujor për punën e tij. Shpërblimi për secilën kategori caktohet në vlerë të drejtë në proporcion me sasinë dhe cilësinë e punës së krye dhe organizimin e punës që rregullohet me akt nënligjor të cilin e nxjerr Ministri i Drejtësisë.

Neni 75
Disponimi me shpërblimin

1. Personi i dënuar lirshëm mund të disponojë shtatëdhjetë përqind (70%) të shpërblimit për punën e kryer, kurse pjesa e mbetur deponohet në xhirollogari të ruajtjes së parave.
2. Drejtori i institucionit korrektues mund të lejojë shpenzimin e mjeteve nga xhirollogaria e ruajtjes së parave të kursimit, nëse ato janë të domosdoshme për personin e dënuar, ose për familjen e tij.

Neni 76
E drejta në benificione

1. Personi i dënuar ka të drejtë në beneficione, në masa mbrojtëse dhe përkujdesje shëndetësore në punën e tij në pajtim me dispozitat e përgjithshme. Për zhdëmtimin e të burgosurve kundër lëndimeve në punë, duke përfshirë edhe sëmundjen profesionale merren masa nën kushte jo më pak të favorshme nga ato që i parasheh ligji për punëtorë jashtë institucioneve korrektuese.
2. Institucioni korrektues i mbulon nevojat më urgjente të personit të dënuar i cili pa fajin e tij nuk mund të punojë dhe nuk ka mjete të veta.
3. Ministri i Drejtësisë nxjerr akt nënligjor për kushtet e punës, duke përfshirë edhe kompensimin në rast të paaftësisë për punë.

Neni 77
Orari maksimal i punës ditore ose javore për personat e dënuar

1. Orari maksimal i punës ditore, ose javore për personat e dënuar caktohet në pajtim me dispozitat e përgjithshme të punës. Ky orar parasheh një (1) ditë

pushim në javë dhe kohë të mjaftueshme për arsimim dhe aktivitete të tjera të domosdoshme për korrektimin dhe risocializimin e personave të dënuar.
2. Personi i dënuar që ka punuar më tepër se gjashtë (6) muaj gjatë qëndrimit në institucionin korrektues ka të drejtë në pushim vjetor në pajtim me dispozitat e përgjithshme të punës.
3. Personi i dënuar shpërblehet gjatë periudhës së pushimit vjetor sikurse të punonte.

Neni 78
Të drejtat e punës së femrës së dënuar për shkak të shtatzënësisë, lindjes dhe amësisë

Femra e dënuar ka të drejtë të mos punojë për shkak të shtatzënësisë, lindjes dhe amësisë, në pajtim me dispozitat e përgjithshme të punës.

Neni 79
Të drejtat lidhur me shpikjet dhe inovacionet teknike

1. Personi i dënuar i gëzon të gjitha të drejtat në pajtim me dispozitat e përgjithshme lidhur me shpikjet dhe inovacionet teknike të arritura gjatë mbajtjes së dënimit.
2. Veprat artistike dhe veprat tjera krijuese të realizuara nga personi i dënuar gjatë kohës së lirë janë pronë e tij intelektuale.

Neni 80
Aftësimi profesional

Personave të dënuar, institucioni korrektues u ofron mundësi për vijimin e aftësimit profesional në përmirësimin e shkathtësive të tyre, ose përvetësimin e shkathtësive të reja.

Neni 81
Organizimi i kurseve për aftësim profesional

Organet publike kompetente përgjegjëse për arsimin publik dhe punën bashkëpunojnë në organizimin e kurseve për aftësimin profesional.

Neni 82
Mbajtja e kurseve për aftësimin profesional

Kurset për aftësimin profesional mbahen gjatë orarit të punës. Personi i dënuar i cili nuk punon si pasojë e pjesëmarrjes në kurse për aftësimin profesional ka të drejtë në ndihmë financiare.

Neni 83
Arsimimi

1. Personi i dënuar ka të drejtë në shkollim fillor dhe të mesëm në pajtim me ligjin për arsimin fillor dhe të mesëm.

2. Shërbimi Korrektues është përgjegjës për caktimin e lokacionit dhe infrastrukturës ku do të zhvillohet mësimi.
3. Përgjegjës për arsimimin fillor dhe të mesëm në institucionin korrektues është Ministria kompetente për arsim.
4. Për personat e dënuar që nuk din shkrim lexim organizohen kurse të posaçme.
5. Personat e dënuar sa të jetë e mundur ndihmohen në vijimin e kurseve arsimore që ofrohen përmes postës, radios, ose televizionit.
6. Institucioni korrektues organizon edhe forma të tjera të arsimimit për personat e dënuar.
7. Me akt nënligjor, të cilin e nxjerrë Ministri për Arsim me pëlqimin e Ministrit të Drejtësisë rregullohet arsimimi i përsonave të dënuar.

Neni 84
Programet e veçanta për vijimin e shkollimit

1. Përmes programeve të veçanta, drejtori i institucionit korrektues i mundëson personit të dënuar vijimin e shkollimit fillor, të mesëm, universitar, apo ndonjë shkollim tjetër. Shpenzimet e shkollimit të tillë mbulohen nga personi i dënuar.
2. Vullnetarët që dëshirojnë t'u ndihmojnë personave të dënuar për të vijuar shkollimin e mesëm dhe universitar në institucion korrektues mund të autorizohen nga drejtori i institucionit korrektues.

Neni 85
Vijimi i kurseve arsimore gjatë orarit të punës

Vijimi i kurseve arsimore bëhet gjatë orarit të punës. Personi i dënuar që nuk punon për shkak të vijimit të kurseve arsimore ka të drejtë në kompenzim.

Neni 86
Dokumenti pas përfundimit të aftësimit profesional, ose kurseve arsimore

Dokumentin e lëshuar pas përfundimit të aftësimit profesional, ose kurseve arsimore nuk shënohet se kurset janë kryer gjatë qëndrimit të personit të dënuar në institucionin korrektues.

Neni 87
Informimi

1. Personi i dënuar ka të drejtë të ketë qasje në shtypin ditor dhe atë periodik në gjuhën e tij amtare dhe në burime të tjera të informimit publik.
2. Personi i dënuar ka të drejtë të ketë qasje në programet e radios dhe të televizionit. Gjatë zgjedhjes së programeve merret parasysh parapëlqimi i personave të dënuar, si dhe nevojat e tyre arsimore dhe rekreative.
3. Të gjitha institucionet korrektuese pajisen me bibliotekë për t'u shfrytëzuar nga personat e dënuar. Biblioteka përmban libra (duke përfshirë tekste bazike mbi të drejtat e njeriut dhe ligjet penale), revista dhe gazeta në gjuhën amtare që personave të dënuar u mundësojnë alternativa të shumta.

4. Librat, revistat dhe gazetat në bibliotekë zgjidhen në atë mënyrë për të përmirësuar nivelin e njohurive të personave të dënuar, për të zhvilluar aftësitë e tyre për qëndrim kritik ndaj ngjarjeve ditore, si dhe për t'u ofruar rekreacion.
5. Personi i dënuar ka të drejtë të lexojë libra nga biblioteka e institucionit korrektues dhe libra të siguruara nga ai. Shërbimi Korrektues mund të kufizoj qasjen në literaturë e cila është e rrezikshme për sigurinë e ambienteve të institucionit korrektues, apo për sigurinë e ndonjë personi, e cila inkurajon urrejtjen, apo dhunën përmban materiale pornografike, apo të cilat në çfarëdo mënyre ndikojnë në paraqitjen e çrregullimeve apo formave të ndryshme të kriminalitetit.

Neni 88
Aktivitetet kulturore, rekreative dhe sportive

1. Aktivitetet kulturore, rekreative dhe sportive, si dhe aktivitetet tjera që synojnë zhvillimin e personalitetit të personit të dënuar organizohen brenda institucioneve korrektuese me ndihmën e subjekteve publike dhe private të interesuara për riintegrimin e personave të dënuar në shoqëri.
2. Pjesëmarrja aktive e personave të dënuar në organizimin e aktiviteteve kulturore, rekreative dhe sportive inkurajohet pa prishur rendin dhe sigurinë.

Neni 89
E drejta për ushtrimin e fesë

1. Personi i dënuar ka të drejtë të marrë pjesë në ceremoni fetare dhe të lexojë literaturë fetare.
2. E drejta për t'u vizituar nga përfaqësuesi kompetent i fesë përkatëse nuk mund të kufizohet. Koha e vizitave përcaktohet me aktin për rendin shtëpiak.
3. Me kërkesë të personave të dënuar, drejtori i institucionit korrektues mund të caktojë vizita të rregullta të përfaqësuesit kompetent të fesë përkatëse në institucionin korrektues, nëse numri i personave të dënuar të të njëjtit besim fetar e arsyeton këtë.
4. Drejtori i institucionit korrektues përkohësisht mund t'i përjashtojë personat e dënuar nga ceremonitë fetare, nëse përjashtimi i tillë është i nevojshëm për ruajtjen e rendit dhe të sigurisë dhe lidhur me këtë njoftohet përfaqësuesi kompetent i fesë.
5. Ceremonitë fetare mbahen në lokale të veçanta të përshtatshme të institucionit korrektues

Neni 90
Pushimi për raste të jashtëzakonshme

1. Në rast të sëmundjes së rëndë, ose të rrezikut të drejtpërdrejtë të vdekjes, a të vdekjes së një anëtari të familjes, drejtori i institucionit korrektues mund t'i jep pushim personit të dënuar në pajtim me aktin për rendin shtëpiak.
2. Përjashtimisht mund të jepet pushim, për ndodhi të rënda personale, ose familjare.
3. Drejtori i institucionit korrektues mund të caktojë kushte të cilat ai i konsideron të arsyeshme dhe të nevojshme për mbrojtjen e rrethit shoqëror me rastin e lejimit të

pushimit në pajtim me këtë nen, duke përfshirë edhe urdhrin që personi i dënuar të shoqërohet gjatë pushimit nga një anëtar i personelit korrektues, ose i personave të tjerë të autorizuar nga drejtori.

Neni 91
Ankimet dhe lutjet

1. Personi i dënuar njoftohet mbi të drejtat dhe detyrimet e të burgosurve dhe lidhur me procedurat e paraqitjes së ankimeve dhe lutjeve.
2. Personi i dënuar ka të drejtë ankimi në procedurën dhe vendimin të punësuarve në institucionet korrektuese. Ankimi paraqitet gojarisht, apo me shkrim nëpërmes drejtorit të institucionit korrektues, Zyrës Qendrore të Shërbimit Korrektues. Ankimi me shkrim, Zyrës Qendrore i dërgohet në mbështjellës të cilën drejtoria e institucionit korrektues nuk guxon ta hap.
3. Personit të dënuar duhet t'i mundësohet që ankimin gojor ta paraqes pa pranin e të punësuarit të institucionit korrektues, apo pa pranin e personit kundër procedurave dhe vendimeve të të cilit është paraqitur ankimi.
4. Në ankimin e paraqitur drejtori i insitutcionit korrektues do të përgjigjet në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, ndërsa Zyra Qendrore e Shërbimit Korrektues në afat prej tridhjetë (30) ditësh. Në ankimin me shkrim do të jipet përgjigja në formën me shkrim.
5. Personi i dënuar ka të drejtë të parashtrojë ankim te drejtori i institucionit korrektues lidhur me shkeljen e të drejtave të tij, ose me parregullsitë e tjera që i janë bërë atij në institucionin korrektues.
6. Drejtori i institucionit korrektues, ose personi i autorizuar nga ai është i obliguar që t'i përgjigjet me shkrim.
7. Drejtori i institucionit korrektues, ose personi i autorizuar nga ai është i obliguar që:
   7.1. t'i regjistrojë të gjitha ankimet dhe masat që janë ndërmarrë për trajtimin e tyre;
   7.2. ankimet t'i shqyrtojë menjëherë dhe personit të dënuar t'ia dorëzojë vendimin lidhur me ankimin;
   7.3. nëse ankimi ka të bëjë me sulmin e pohuar, të sigurojë që personi i dënuar t'i nënshtrohet kontrollit të menjëhershëm mjekësor dhe trajtimit të rekomanduar dhe
   7.4. t'ia paraqesë veprat penale prokurorit të shtetit në pajtim me dispozitat kreut përkates për kallëzimin penal të Kodit të Procedurës Penale.
8. Nëse personi i dënuar nuk merr përgjigje lidhur me ankimin, ose nuk është i kënaqur me përgjigjen e marrë, ai ka të drejtë që Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues t'i dorëzojë ankesë me shkrim, i cili organ e shqyrton ankesën dhe përgjigjen lidhur me këtë ia dërgon personit të dënuar.
9. Personi i dënuar, i paknaqur me përgjigjen e pranuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Korrektues ka të drejtë t'i parashtrojë ankim Ministrit.
10. Përmbajtja e ankimit dhe e lutjes është konfidenciale.

Neni 92
Beneficionet e personave të dënuar

1. Për sjellje të mirë dhe angazhim në punë, drejtori i institucionit korrektues pas marrjes së rekomandimit të ekipit për planifikimin e mbajtjes së dënimit mund t'i japë benificione vijuese personit të dënuar:
   1.1. të drejtën e zgjeruar në pranimin e vizitave duke përfshirë vizitat nga rrethi i gjerë i personave;
   1.2. pranimin e vizitave në institucionin korrektues në prani të mbikëqyrësve, por pa u dëgjuar nga ata;
   1.3. të drejtën e zgjeruar në kalimin e kohës së caktuar në lokale të veçanta me bashkëshortin/en.
   1.4. pranimin e vizitave jashtë institucionit korrektues;
   1.5. pushimin jashtë institucionit korrektues;
   1.6. vizitat në familje dhe të të afërmit gjatë fundjavave dhe festave;
   1.7. pushimin jashtë institucionit korrektues deri në shtatë (7) ditë për çdo vit;
   1.8. pushimin e jashtëzakonshëm prej shtatë (7) ditëve;
   1.9. të drejtën e shfrytëzimit të pushimit vjetor jashtë institucionit korrektues.
2. Kushtet dhe mënyra e shfrytëzimit të benificioneve nga neni 90, 91 dhe 92 i këtij ligji përcaktohen me aktin për rendin shtëpiak.

Neni 93
Transferimi i personave të dënuar

1. Personi i dënuar mund të transferohet nga një institucion korrektues në tjetrin, ose nga një njësi e institucionit korrektues në tjetrën, nëse kjo është e nevojshme:
   1.1. për zbatimin e programit të tij korrektues dhe risocializues, ose programin e punës;
   1.2. për inkurajimin e kontakteve ndërmjet personit të dënuar dhe familjes së tij dhe rrethit shoqëror, me qëllim të lehtësimit të riintegrimit të tij përfundimtar në shoqëri;
   1.3. për shkaqet e mbrojtjes dhe sigurisë të personit të dënuar;
   1.4. në interes të ruajtjes së rendit dhe disiplinës brenda institucionit korrektues;
   1.5. për shkak të trajtimit shëndetësor.
2. Vendimin për transferimin e personit të dënuar e merr Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Korrektues me propozim të drejtorit të institucionit korrektues, ose në bazë të kërkesës së personit të dënuar, apo të ndonjë anëtari të ngushtë të familjes**.**
3. Në rast të transferimit të cilin nuk e ka kërkuar personi i dënuar, drejtori i institucionit korrektues siguron që personi i dënuar të njoftohet lidhur me arsyet për transferim brenda njëzetekatër (24) orëve nga marrja e vendimit.
4. Bashkëshortja e personit të dënuar, anëtari i familjes, ose ndonjë person tjetër i caktuar nga personi i dënuar duhet të njoftohen lidhur me transferimin brenda njëzetekatër (24) orëve nga marrja e vendimit.
5. I burgosuri nuk mund të parashtrojë lutje të sërishme për transferimin, derisa të kalojnë gjashtë (6) muaj nga paraqitja e kërkesës së tij të fundit për transferim.

Neni 94
Pezullimi i ekzekutimit të dënimit me vendim të Ministrit

1. Me lutjen të personit të dënuar, ose të anëtarit të ngushtë të familjes së tij, apo me propozim të drejtorit të institucionit korrektues dhe me rekomandimin e Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues, Ministri mund të lejojë pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burgim, nëse për këtë ekzistojnë arsyet, i cili pezullim nuk mund të zgjasë më shumë se tre (3) muaj. Përjashtimisht, me qëllim të trajtimit mjekësor, pezullimi mund të zgjasë deri në përfundim të trajtimit.
2. I dënuari është i detyruar që çdo muaj nëpërmjet raportit të nënshkruar nga komisioni përkatës prej tre (3) mjekëve ta informoj shërbimin korrektues mbi gjendjen e tij shëndetësore.
3. Vendimin mbi vazhdimin e pezullimit e nxjerr Ministri në bazë të propozimit të komisionit të përbërë nga tre (3) mjek të emëruar nga Ministri.
4. Në rastet e parapara të pezullimit të ekzekutimit të dënimit sipas këtij neni kohëzgjatja e pezullimit nuk llogaritet në kohëzgjatjen dënimit.

Neni 95
Pezullimi i ekzekutimit të dënimit për shkak të mjeteve të jashtëzakonshme juridike

Gjykata kompetente e cila vendos lidhur me kërkesën për rishikimin e procedurës penale, e paraqitur në favor të personit të dënuar mund të pezullojë ekzekutimin e dënimit edhe para se aktvendimi të merr formë të prerë me të cilin lejohet rishikimi i procedurës penale.

Neni 96
Pezullimi i ekzekutimit të dënimit për shkak të kërkesës së prokurorit të shtetit kompetent

1. Me kërkesë të prokurorit të shtetit kompetent çdo herë lejohet pezullimi i ekzekutimit të dënimit derisa të merret vendimi për ushtrimin e mjetit juridik.
2. Vendimi për pezullimin e ekzekutimit të dënimit e humb vlefshmërinë, nëse prokurori i shtetit nuk e shfrytëzon mjetin juridik brenda tridhjetë (30) ditëve nga marrja e vendimit mbi pezullimin.

Neni 97
Revokimi i pezullimit të ekzekutimit të dënimeve

1. Ministri i Drejtësisë e revokon pezullimin e ekzekutimit të dënimit, nëse më vonë vërtetohet se arsyet për lejimin e pezullimit nuk kanë ekzistuar, ose kanë pushuar së ekzistuari, apo personi i dënuar e ka përdorur pezullimin në kundërshtim me qëllimin për të cilin është lejuar.
2. Nëse personi i dënuar nuk lajmërohet në shërbimin korrektues pas skadimit të pezullimit të ekzekutimit të dënimit, apo të revokimit të tij, shërbimi korrektues e njofton menjëherë policinë e cila personin e dënuar e sjell për mbajtjen e mëtejshme të dënimit.

Neni 98
Efektet e pezullimit të ekzekutimit të dënimeve

1. Periudha e pezullimit të ekzekutimit të dënimit nuk llogaritet në dënimin i cili duhet mbajtur.
2. Gjatë periudhës së pezullimit të ekzekutimit të dënimit personi i dënuar nuk i gëzon të drejtat e parapara me këtë ligj.
3. Dispozitat e këtij ligji që rregullojnë shtyrjen e ekzekutimit të dënimit zbatohen përshtatshmërisht edhe për çështje të tjera që kanë të bëjnë me pezullimin e ekzekutimit të dënimit.

Neni 99
Vdekja e personave të dënuar

1. Në rast të vdekjes së personit të dënuar, shërbimi korrektues menjëherë e njofton bashkëshortin/en, fëmijët dhe fëmijët e adoptuar, e nëse nuk ka të tillë, i njofton prindërit e tij, prindin adoptues, vëllain, apo motrën, ose të afërmit më të largët.
2. Gjykata që ka shqiptuar dënimin, Ministri dhe Zyra Qendrore e Regjistrimit Civil njoftohen për vdekjen e personit të dënuar.

Neni 100
Dorëzimi i kufomës dhe gjësendeve personale familjes

1. Kufoma e personit të dënuar dhe gjësendet e tij personale i dorëzohen familjes së tij.
2. Nëse personi i dënuar nuk ka familje, apo familja e tij nuk e pranon kufomën, kufoma e personit të dënuar varroset me shpenzimet e shërbimit korrektues.

Neni 101
Shkeljet dhe dënimet disiplinore

1. Qëllimi i procedurave disiplinore, i përcaktuar është inkurajimi i personave të dënuar që të sillen në mënyrën e cila e avancon mirëmbajtjen e rendit në institucionin korrektues përmes procesit të korrektimit dhe risocializimit të personit të dënuar dhe riintegrimit të tij të suksesshëm në shoqëri.
2. Dënimet disiplinore u shqiptohen personave të dënuar vetëm në pajtim me dispozitat e mëposhtme të këtij ligji.
3. Personi i dënuar kryen shkelje të lehtë disiplinore kur:
   3.1. nuk respekton urdhrin e arsyeshëm të anëtarit të personelit;
   3.2. qëndron në zonë të ndaluar për personat e dënuar pa leje;
   3.3. manifeston sjellje të pahijshme dhe fyen anëtarin e personelit;
   3.4. manifeston sjellje të pahijshme dhe fyen cilindo person në mënyrën e cila mund të provokojë personin tjetër të jetë i dhunshëm;
   3.5. refuzon, apo i shmanget punës, ose nuk paraqitet në punë pa ndonjë shkak të arsyeshëm;

3.6. merret me bixhoz;
3.7. me vetëdije nuk i respekton rregullat e shkruara me të cilat rregullohet sjellja e personave të dënuar; ose
3.8. tenton të kryejë apo t'i ndihmojë personit tjetër në kryerjen e ndonjërit prej veprimeve nga nënparagrafët 3.1 deri 3.7. të këtij paragrafi.

4. Personi i dënuar kryen shkelje të rëndë disiplinore nëse:
4.1. rrahet, sulmon, ose kërcënohet se do të sulmojë personin tjetër;
4.2. me vetëdije, apo nga pakujdesia e dëmton, ose e shkatërron pasurinë që nuk është e tij;
4.3. kryen vjedhje;
4.4. nëse posedon pasuri të vjedhur;
4.5. ofron, jep, ose merr ryshfet, apo shpërblim;
4.6. është në posedim, ose merret me sendin e palejuar;
4.7. pa leje konsumon narkotikë të rrezikshëm, substancë psikotrope, apo alkool;
4.8. krijon, apo merr pjesë në ndonjë trazirë, ose në ndonjë aktivitet tjetër i cili mund të rrezikojë mbrojtjen dhe sigurinë në institucionit korrektues;
4.9. kryen veprime përgatitore me qëllim të arratisjes dhe
4.10. ikë, ose largohet nga institucioni korrektues, ose pa leje nuk kthehet në të.

Neni 102
Dënimet disiplinore

1. Shkeljet disiplinore ndëshkohen me dënime disiplinore.
2. Dënimet disiplinore janë:
2.1. qortimi;
2.2. heqja e beneficionit të caktuar;
2.3. urdhri për kompensim dhe
2.4. vetmia.

Neni 103
Shqiptimi i dënimeve diciplinore

1. Dënimi disiplinor duhet të jetë në proporcion me shkeljen disiplinore të kryer nga personi i dënuar. Personi i dënuar nuk mund të dënohet dy herë për të njëjtën vepër.
2. Qortimi mund të shqiptohet kur personi i dënuar kryen shkelje të lehtë disiplinore.
3. Heqja e beneficionit të caktuar, ose urdhri për kompensim mund të shqiptohen kur personi i dënuar kryen shkelje të lehtë, apo të rëndë disiplinore.
4. Vetmia për periudhën jo më të gjatë se pesëmbëdhjetë (15) ditë mund të shqiptohet vetëm për shkelje të rënda disiplinore, nëse dënimet tjera disiplinore nuk do të ishin të mjaftueshme për arritjen e qëllimit të dënimit disiplinor. Në rastin e tillë vetmia shqiptohet për periudhën më të shkurtër të nevojshme për arritjen e qëllimit të dënimit disiplinor.

Neni 104
Shqiptimi i dënimit unik diciplinor

1. Kur personi i dënuar me ndërmarrjen e një, apo disa veprimeve kryen disa shkelje disiplinore për të cilat zbatohen procedura disiplinore unike (shkelje disiplinore në bashkim), së pari caktohet dënim disiplinor për secilën shkelje disiplinore, e më pas shqiptohet dënimi disiplinor unik për të gjitha shkeljet disiplinore.
2. Në rastin e shqiptimit të dënimit disiplinor të vetëm për shkelje disiplinore në bashkim, vetmia nuk është më e gjatë se tridhjetë (30) ditë.
3. Periudha e përgjithshme e vetmisë së personit të dënuar nuk mund të jetë më e gjatë se dy (2) muaj gjatë një viti kalendarik.

Neni 105
Shtyrja me kusht e ekzekutimit të dënimeve disiplinore

Nëse qëllimi i dënimit disiplinor përveç qortimit mund të arrihet edhe pa ekzekutimin e dënimit disiplinor, ekzekutimi i dënimit disiplinor mund të shtyhet me kusht për gjashtë (6) muaj.

Neni 106
Shkaqet e shtyrjes së ekzekutimit të masave disiplinore

1. Shtyrja me kusht e ekzekutimit të dënimit disiplinor revokohet, nëse gjatë periudhës së shtyrjes së ekzekutimit ndaj personit të dënuar shqiptohet dënim i ri disiplinor përveç qortimit.
2. Kur revokohet shtyrja me kusht e ekzekutimit të dënimit disiplinor, shqiptohet dënim unik për shkeljen e mëparshme disiplinore dhe për shkeljen e re. Dënimi i mëparshëm disiplinor merret si i caktuar dhe dënimi disiplinor unik shqiptohet me anë të zbatimit të rregullave për matjen e dënimit disiplinor për shkelje disiplinore në bashkim.
3. Kur revokohet shtyrja me kusht e ekzekutimit të dënimit disiplinor të vetmisë, vetmia e shqiptuar nuk është më e gjatë se njëzet (20) ditë nëse heqja e benificioneve të caktuara është shqiptuar për shkeljen e fundit, por nëse vetmia është shqiptuar për shkeljen e fundit, vetmia mund të shqiptohet më së shumti deri në tridhjetë (30) ditë.

Neni 107
Procedura disiplinore

1. Në rastet e shkeljeve të rënda disiplinore, drejtori i institucionit korrektues zbaton procedura disiplinore dhe merr vendime lidhur me to. Në rastet e shkeljeve të lehta disiplinore, mbikëqyrësi i lartë në institucionin korrektues zbaton procedurat disiplinore dhe merr vendime lidhur me to.
2. Procedurat disiplinore mbahen në seancë dëgjimi në të cilën dëgjohet personi i dënuar dhe verifikohet deklarata e tij. Personit të dënuar i cili nuk ka njohuri të mjaftueshme të gjuhës së përdorur në procedurë disiplinore i sigurohet përkthyesi.

Atij i mundësohet që me arsye të thërret dëshmitarë, t'u parashtrojë pyetje dëshmitarëve, të paraqesë prova, të shqyrtojë provat materiale dhe dokumentet, si dhe të paraqesë parashtresa duke përfshirë edhe parashtresat lidhur me dënimin disiplinor.

3. Para shqiptimit të dënimit disiplinor merret parasysh sjellja dhe puna e kryer nga personi i dënuar.
4. Dënimi disiplinor i vetmisë nuk mund të fillojë të ekzekutohet para sigurimit të konstatimit mjekësor me shkrim me të cilin vërtetohet se personi i dënuar është në gjendje të aftë fizike dhe psikike për qëndrim në dhomën e vetmisë gjatë periudhës së caktuar kohore.
5. Vendimi i arsyetuar mbi dënimin disiplinor përpilohet me shkrim dhe i dërgohet personit të dënuar.

Neni 108
Ankesa kundër shqiptimit të vetmisë

1. Personi i dënuar ka të drejtë ankimi kundër vendimit me cilin shqiptohet dënimi disiplinor i vetmisë brenda tri (3) ditëve nga pranimi i vendimit.
2. Ankesa nuk e shtyn ekzekutimin e vendimit.

Neni 109
Vendosja lidhur me ankesën

1. Drejtori i institucionit korrektues mund ta ndryshojë, ose ta anulojë vendimin mbi dënimin disiplinor brenda shtatëdhjetedy (72) orëve nga pranimi i ankesës.
2. Nëse brenda shtatëdhjetedy (72) orëve nga marrja e ankesës, drejtori i institucionit korrektues nuk e ndryshon, apo nuk e anulon aktvendimin, ose atë e ndryshon jo siç është propozuar në ankesë, ai mund t'ia dorëzoj ankesën Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues brenda një periudhe të mëtejme prej njëzetekatër (24) orëve.
3. Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Korrektues vendos për ankesën brenda tri (3) ditëve nga pranimi i saj.

Neni 110
Nderprerja e ekzekutimit të dënimeve disiplinore

1. Kur qëllimi i dënimit disiplinor të jetë arritur, drejtori i institucionit korrektues mund ta ndërpresë ekzekutimin e dënimit disiplinor para përfundimit të periudhës për të cilën është shqiptuar.
2. Drejtori i institucionit korrektues e ndërpret ekzekutimin e dënimit disiplinor të vetmisë, nëse bazohet në konstatimin me shkrim të personelit mjekësor se vazhdimi i vetmisë do të rrezikonte shëndetin e personit të dënuar.

Neni 111
Ekzekutimi i dënimit disiplinor të vetmisë

1. Dënimi disiplinor i vetmisë konsiston në mbajtjen e vazhdueshme në izolim të personit të dënuar në dhomë të veçantë.

2. Dhoma për ekzekutimin e vetmisë ka një hapësirë prej së paku dhjetë (10) metra kub, pajisje sanitare, dritë natyrore, ujë të pijshëm, shtrat me çarçaf, tavolinë, karrigë dhe ngrohje.

Neni 112
Të drejtat e personit të dënuar në vetmi

1. Gjatë ekzekutimit të dënimit disiplinor të vetmisë, personi i dënuar i gëzon të njëjtat kushte higjienike dhe shëndetësore sikurse personat tjerë të dënuar në institucionin korrektues dhe atij i lejohet qëndrim jashtë ambientit të mbyllur së paku një (1) orë në ditë për ajër të pastër dhe për ushtrime. Personi i dënuar, po ashtu ka të drejtë të vizitohet një herë nga bashkëshorti/ja, ose anëtari tjetër i familjes brenda periudhës pesëmbëdhjetë (15) ditore.
2. Gjatë kohës së vetmisë personi i dënuar ka qasje në tekste mësimore, libra dhe shtypin ditor.
3. Personi i dënuar në vetmi vizitohet nga mjeku çdo ditë kurse nga drejtori i institucionit korrektues dhe punëtori social një herë në shtatë (7) ditë, apo kur e kërkon nevoja edhe më shpesh.

Neni 113
Akti nënligjor për dënimet dhe procedurën disiplinore

Ministri nxjerr akt nënligjor për rregullimin më të përafërt për dënimet dhe procedurën disiplinore.

Neni 114
Përgjegjësia materiale e personave të dënuar

1. Personi i dënuar është i obliguar ta kompensojë dëmin në institucionin korrektues të shkaktuar me dashje, ose nga pakujdesia e rënd.
2. Drejtori i institucionit korrektues vendosë lidhur me dëmin, vlerën e dëmit dhe periudhën brenda së cilës duhet paguar kompensimi.
3. Kundër vendimit për kompensimin e dëmit personi i dënuar mund t'i ankohet Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues brenda tetë (8) ditëve nga pranimi i vendimit.

Neni 115
Kompensimi i dëmit

1. Nëse pas vendimit të Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues, personi i dënuar nuk e paguan dëmin prej më pak se njëqind (100) Euro, institucioni korrektues kompensohet nga llogaria e mjeteve të personit të dënuar.
2. Personi i dënuar në procedurë civile mund të kërkojë kthimin e parave që i janë marrë për kompensimin e dëmit.
3. Kundër vendimit përfundimtar në të cilën përsonit të dënuar gjatë ekzekutimit të dënimit i është kufizuar, apo shkelur ndonjë e drejtë e përcaktuar me këtë ligj, përsoni i dënuar ka të drejtë në mbrojtje gjyqësore**.**

Neni 116
Kushtet për përdorimin e forcës kundër personave të dënuar

1. Kundër personit të dënuar mund të përdoret forca vetëm nëse është e domosdoshme për parandalimin e:
   1.1. arratisjes;
   1.2. sulmit fizik ndaj ndonjë personit tjetër;
   1.3. vetëlëndimit;
   1.4. shkaktimit të dëmeve materiale;
   1.5. rezistencës aktive, apo pasive gjatë ekzekutimit të urdhrave ligjorë nga zyrtari korrektues.
2. Forca e përdorur duhet të jetë në masë sa më të vogël dhe në proporcion me sulmin.
3. Forca mund të përdoret vetëm kur ajo lejohet nga drejtori i institucionit korrektues, përveç nëse zyrtari korrektues me arsye beson se drejtori do ta lejonte përdorimin e forcës dhe se vonesa e marrjes së lejes do të rezultonte në mosarritjen e qëllimit.
4. Nëse forca është përdorur pa leje në pajtim me paragrafin 3. të këtij neni, zyrtari korrektues e njofton drejtorin e institucionit korrektues për veprimin e ndërmarrë sa më parë që të jetë e mundur.
5. Kur përdoret forca, personi i dënuar në fjalë menjëherë i nënshtrohet kontrollit mjekësor dhe trajtimit të rekomanduar përkatës.
6. Pas përdorimit të çfarëdo force, pa vonesë përpilohet raporti për arsyen e përdorimit të forcës.

Neni 117
Mjetet shtrënguese

1. Mjetet shtrënguese mund të përdoren nga zyrtari korrektues pas lejimit nga drejtori i institucionit korrektues nëse zyrtari korrektues është i aftësuar për përdorimin e mjeteve të tilla.
2. Mjetet shtrënguese përfshijnë pajisjet që përdoren për kufizim të përkohshëm të lirisë së lëvizjes të personit të dënuar. Ndalohet përdorimi i zinxhirëve dhe prangave.
3. Mjetet shtrënguese nuk zbatohen si dënim dhe mund të përdoren vetëm:
   3.1. për të mundësuar transferimin, apo shoqërimin;
   3.2. për shkaqe mjekësore nën udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e personelit mjekësor;
   3.3. kur personi i dënuar nuk e lëshon armën, ose sendin tjetër të rrezikshëm pasi të jetë urdhëruar që ta bëjë këtë;
   3.4. me urdhër të drejtorit të institucionit korrektues, si mjet i fundit për mbrojtjen e personit të dënuar për të parandaluar lëndimin e të tjerëve, ose për parandalimin e dëmtimit të rëndë të pasurisë;
   3.5. për parandalimin e arratisjes.
4. Përdorimi i mjeteve shtrënguese raportohet me shkrim.

Neni 118
Mbajtja dhe përdorimi i armëve të zjarrit

1. Me miratimin e Ministrisë së Drejtësisë, Ministria e Punëve të Brendshme mund t'i lejoj armën e zjarrit vetëm zyrtarit korrektues i cili është i aftësuar për përdorimin e saj.
2. Arma mund të përdoret si mjet i fundit dhe atë vetëm gjatë kryerjes së detyrës zyrtare. Arma e zjarrit mund të përdoret vetëm kur siguria e institucionit korrektues, apo siguria e personave kërcënohet nga brenda dhe jashtë institucionit korrektues.
3. Përdorimi i armës së zjarrit duhet të jetë në proporcion me shkallën e rrezikshmërisë.
4. Para përdorimit të armës së zjarrit, zyrtari korrektuesi apo zyrtari tjetër korrektues që mbanë armë do të urdhëroj personin që të ndalet duke e paralajmëruar në mënyrë verbale se do të shtijë me armë, nëse personi nuk ndalet.
5. Përjashtimisht nga paragrafi 4 i këtij neni, urdhri dhe parandalimi mund të mos bëhen nëse një gjë e tillë do të rrezikonte jetën e zyrtarit korrektues, apo të personave të tjerë.
6. Zyrtari korrektues dhe stafi tjetër të cilët janë në kontakt me të burgosurit nuk do t'i mbajnë armët brenda perimetrit të burgut, përveç nëse nuk kërkohet ndryshe për sigurinë e institucionit korrektues dhe personave.
7. Shërbimi Korrektues duhet të krijojë një vend të përshtatshëm për ruajtjen e sigurt të armëve të zjarrit dhe municionit.
8. Përdorimi i armëve të zjarrit raportohet me shkrim te Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Korrektues.

Neni 119
Detyrimi për njoftimin e përdorimit të forcës

Drejtori i institucionit korrektues menjëherë e njofton Drejtorin e Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues për përdorimin e forcës ndaj personit të dënuar.

Neni 120

Ministri nxjerr akt nënligjor për përdorimin e forcës, lejimin dhe përdorimin e mjeteve shtrënguese dhe lejimin, përdorimin dhe ruajtjen e armëve të zjarrit.

Neni 121
Lirimi me kusht

1. Personit të dënuar mund t'i lejohet lirimi me kusht në pajtim me dispozitat e Kodit Penal të Kosovës.
2. Personi i dënuar ka të drejtë t'i paraqesë lutje për lirim me kusht panelit të themeluar në pajtim me dispozitat e Kodit Penal të Kosovës nëpërmjet institucionit korrektues në të cilin ai është duke e mbajtur dënimin.
3. Drejtori i institucionit korrektues mund të paraqesë propozim për lirimin me kusht.

4. Pas paraqitjes së lutjes për lirim me kusht, Drejtori i institucionit korrektues kërkon nga Shërbimi Sprovues që të vizitoj të dënuarin dhe të nënshkruaj marrëveshjen për mbikëqyrjen e tij pas lirimit me kusht.
5. Pas paraqitjes së lutjes, apo propozimit për lirimin me kusht, drejtori i institucionit korrektues, panelit për lirim me kusht menjëherë i dorëzon kopjen e dosjes personale të personit të dënuar dhe raportin mbi personin e dënuar të hartuar nga ekipi profesionist në institucionin korrektues me anë të shkresës përcjellëse të cilën e nënshkruan Drejtori i Institucionit Korrektues.
6. Nëse paneli për lirim me kusht nuk ka të dhëna të mjaftueshme, mund të kërkoj nga institucioni korrektues të dhëna shtesë.
7. Raporti nga paragrafi 5. i këtij neni përfshin:
   7.1. llojin e veprës penale të kryer nga personi i dënuar;
   7.2. qëndrimin e personit të dënuar ndaj veprës penale, viktimës dhe familjes së viktimës;
   7.3. ndonjë vepër penale të kryer më parë nga ai;
   7.4. rrethanat e tij familjare dhe të kaluarën shoqërore;
   7.5. gjendjen e tij fizike dhe psikologjike, duke përfshirë vlerësimin e rrezikshmërisë kurdo që konsiderohet e nevojshme nga një psikiatër, apo psikolog;
   7.6. sjelljen e tij në institucionin korrektues dhe suksesin e arritur në shmangien e faktorëve të veprës penale;
   7.7. planet e tij pas lirimit;
   7.8. përkrahja që mund t'i ofrohet pas lirimit dhe
   7.9. ndonjë rrethanë që tregon se ai nuk do të kryejë vepër të re penale.

Neni 122
Paneli për lirim me kusht

1. Për lirimin me kusht, vendos Paneli për lirim me kusht.
2. Paneli për lirim me kusht përbëhet prej tre (3) anëtarëve: një (1) gjyqtar i Gjykatës Supreme, i deleguar nga Kryetari i Gjykatës Supreme; një (1) prokuror i shtetit i deleguar nga Kryeprokurori i Shtetit; një (1) përfaqësues nga MPB/Policia e Kosovës, me njohuri dhe përvojë në fushat relevante profesionale (Juridik, pedagogji, sociologji, psikologji) i deleguar nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës. Këshilli Gjyqësor i Kosovës gjithashtu emëron edhe një (1) përfaqësues të deleguar nga Rektorati/Fakulteti Juridik, si anëtar të katërt, me njohuri dhe përvojë nga fusha përkatëse profesionale, i cili përzgjidhet për të qenë në gatishmëri për të vendosur në rastet kur me ligj parashihet përjashtimi i anëtarit të panelit në një çështje të caktuar apo zëvendësimi në mungesë të ndonjë anëtari tjetër.
3. Paneli për lirim me kusht vendos për të gjitha lutjet dhe propozimet për lirimin me kusht.
4. Këshilli Gjyqësor i Kosovës nxjerr rregulloren për punën e panelit për lirim me kusht.
5. Kundër aktvendimit të panelit për lirim me kusht nuk lejohet ankesa dhe nuk mund të ngritet konflikt administrativ**.**

Neni 123
Ekzekutimi i vendimit të panelit për lirim me kusht

1. Aktvendimi për lirimin me kusht i dorëzohet personit të dënuar brenda tri (3) ditëve nga dita e marrjes së tij dhe, po ashtu evidencohet në gjykatën e cila e ka shqiptuar dënimin.
2. Aktvendimi i Panelit për Lirim me Kusht së bashku me dosjen e të liruarit me kusht, duhet t'i dorëzohet shërbimit sprovues brenda afatit tre (3) ditor pas marrjes së vendimit për lirim me kusht.
3. Aktvendimi me të cilin lejohet lirim me kusht mes tjerash përfshin datën kur personi i dënuar do të lirohet nga mbajtja e dënimit.
4. Nëse lirimi me kusht nuk lejohet aktvendimi mes tjerash përfshin datën kur paneli për lirim me kusht mund të rishqyrtojë kërkesën e personit të dënuar për lirim me kusht. Data për rishqyrtim nuk mund të jetë më e shkurtë se tre (3) muaj dhe jo më e gjatë se dymbëdhjetë (12) muaj.
5. Nëse personit të dënuar i shqiptohet dënimi disiplinor i vetmisë ndërmjet datës së marrjes së aktvendimit për lirim me kusht dhe datës së lirimit me kusht nga mbajtja e dënimit, paneli për lirimin me kusht e rishqyrton aktvendimin.

Neni 124
Obligimet e personit të liruar me kusht

1. Brenda pesë (5) ditëve nga data e lirimit, personi i liruar me kusht obligohet ta njoftojë policinë dhe shërbimin sprovues për vendqëndrimin e tij gjatë periudhës së lirimit me kusht.
2. Personi i liruar me kusht obligohet që gjatë periudhës së lirimit të tij me kusht t'i raportojë shërbimit sprovues.
3. Nëse personi i liruar me kusht e ndërron vendqëndrimin, ai obligohet ta informojë policinë dhe shërbimin sprovues.
4. Nëse personi i liruar me kusht nuk i përmbush obligimet e parapara në paragrafët 1.,2. dhe 3. të këtij neni, Paneli për Lirim me Kusht mund ta revokoj vendimin për lirim me kusht me propozim të shërbimit sprovues.
5. Nëse lirimi me kusht i paraparë në paragrafin 4. të këtij neni revokohet, personi i dënuar mban pjesën e mbetur të dënimit.
6. Në rast se brenda njëzetekatër (24) orëve, pas dorëzimit të vendimit me shkrim për revokimin e vendimit për lirim me kusht, personi i liruar nuk kthehet vullnetarisht në mbajtje të dënimit, Policia e Kosovës me forcë e sjell në Institucionin Korrektues për mbajtjen e pjesës së mbetur të dënimit.
7. Shërbimi sprovues përpilon raporte me shkrim për Panelin për Lirim me Kusht lidhur me ecurinë e mbikëqyrës së personave të liruar me kusht.
8. Kriteret dhe afatet kohore të përpilimit të raporteve dhe mbikëqyrjes së personave të liruar me kusht rregullohen me akt të veçantë nënligjor të nxjerr nga Ministri.

Neni 125
Efekti i lirimit me kusht në të drejtat e parapara me këtë ligj

Gjatë periudhës së lirimit me kusht personi i dënuar nuk i gëzon të drejtat e parapara me këtë ligj.

Neni 126
Lirimi për shkak të përfundimit të mbajtjes së dënimit

1. Personi i dënuar lirohet nga institucionit korrektues në ditën e përfundimit të mbajtjes së dënimit të tij me burgim.
2. Nëse dita e fundit e dënimit është e shtunë, e diel, apo ditë feste zyrtare, personi i dënuar lirohet ditën e fundit të punës para asaj dite.
3. Lirimi i paraparë në paragrafin 2. të këtij neni nuk zbatohet për dënimin me burgim për kundërvajtje më të shkurtër se shtatë (7) ditë.
4. Personi i dënuar lirohet prej ndonjë pune, apo detyre së paku tri (3) ditë para ditës së lirimit.

Neni 127
Lirimi i parakohshëm

1. Drejtori i institucionit korrektues mund ta lirojë personin e dënuar para përfundimit të mbajtjes së dënimit të tij me burgim nëse ai ka pasur sjellje të mirë, suksese në punë dhe në aktivitete të tjera.
2. Drejtori i institucionit korrektues mund të lejojë lirim të parakohshëm në bazë të paragrafit 1. të këtij neni, nëse personi i dënuar ka mbajtur të paktën tri të katërtat (3/4) e dënimit me burgim dhe nëse të njëjtit i kanë mbetur jo më shumë se tre (3) muaj të dënimit.
3. Nëse personit të dënuar i shqiptohet dënimi disiplinor i vetmisë ndërmjet datës së lëshimit të aktvendimit për lirim të parakohshëm dhe datës për lirim të parakohshëm nga mbajtja e dënimit, drejtori i institucionit korrektues e rishqyrton aktvendimin.
4. Aktvendimi për lirim të parakohshëm sipas këtij neni i dorëzohet personit të dënuar brenda tri (3) ditëve nga dita e marrjes së tij dhe evidentohet në gjykatën e cila e ka shqiptuar dënimin.

Neni 128
Lirimi nga mbajtja e dënimit për shkak të faljes

Personi i dënuar i cili është falur lirohet në të njëjtën ditë kur institucioni korrektues e pranon vendimin për falje dhe jo më vonë se njëzetekatër (24) orë nga pranimi i vendimit.

Neni 129
Dispozitat tjera për lirimin e personit të dënuar nga mbajtja e dënimit

1. Para lirimit, personi i dënuar kontrollohet nga mjeku jo më shumë se tri (3) ditë pune para datës së lirimit dhe raporti mjekësor i bashkëngjitet dosjes mjekësore të personit të dënuar.
2. Kur trajtimi mjekësor është i nevojshëm pas lirimit, mjeku, në konsultim me drejtorin e institucionit korrektues mundëson trajtimin e tillë para lirimit. Personit të dënuar i jepet sasi e nevojshme barnash vetëm për tri (3) ditë pas lirimit.
3. Personi i dënuar i cili është i sëmurë rëndë, apo i cili nuk është në gjendje të udhëtojë për shkak të sëmundjes, nga institucioni korrektues dërgohet në institucionin më të afërt të kujdesit shëndetësor.

Neni 130
Pajisja me fletë lëshim

1. Pas lirimit nga institucionit korrektues, personi i dënuar pajiset me fletë lëshim i cili mes tjerash përmban të dhënat personale të personit të dënuar, datën e pranimit në institucionin korrektues, datën e lëshimit dhe sipas nevojës, datën kur personi i dënuar duhet të paraqitet në stacionin policor. Personi i dënuar i cili është liruar me kusht pajiset me fletë lëshim që përmban obligimin për moskryerjen e ndonjë vepre të re penale dhe afatin e caktuar kohor të lirimit të tij me kusht.
2. Fletë lëshimi shërben si dëshmi mbi identitetin e personit të dënuar derisa ai të arrijë në vendbanimin, ose vendqëndrimin e tij.

Neni 131
Gjërat personale

1. Pas lirimit, personit të dënuar i jepen të gjitha gjërat dhe sendet personale të cilat atij i janë ruajtur nga institucioni korrektues, kursimet e tij dhe paratë që i ka pranuar gjatë kohës së mbajtjes së dënimit.
2. Personit të dënuar i sigurohen ndërresa të brendshme, tesha dhe këpucë nga institucioni korrektues nëse ai këto nuk i ka dhe nuk ka mjete financiare për sigurimin e tyre.

Neni 132
Shpenzimet e transportit

1. Me rastin e lirimit, personit të dënuar i paguhen shpenzimet e transportit deri në vendbanimin, ose vendqëndrimin e tij.
2. Me rastin e lirimit, të dënuarit të huaj i paguhen shpenzimet e transportit deri në vendkalimin kufitar, nëse me dispozita të veçanta nuk parashihet ndryshe.
3. Shpenzimet e transportit mbulohen prej institucionit korrektues nga i cili lirohet personi i dënuar.

Neni 133
Njoftimi para lirimit me kusht

1. Para lirimit, institucioni korrektues e njofton gjykatën që e ka shqiptuar dënimin dhe stacionin më të afërt policor me vendbanimin, ose vendqëndrimin e personit të dënuar për lirimin e tij.
2. Në rastin kur personi i dënuar është i mitur, institucioni korrektues e njofton familjen e tij shërbimin sprovues dhe Qendrën për Punë Sociale lidhur me lirimin e personit të dënuar.
3. Përgatitja për lirimin e personit me çrregullime mendore bëhet në konsultim me drejtorin e institucionit korrektues, me psikiatrin i cili e ka trajtuar personin e dënuar në institucionin korrektues, si dhe me autoritetet përkatëse të shëndetit mental në shoqëri.

Neni 134
Ndihma pas lirimit nga dënimi

1. Nëse pas lirimit personi i dënuar ka nevojë për ndihmë, institucioni korrektues e njofton qendrën për punë sociale, e cila është kompetente sipas vendbanimit, apo vendqëndrimit të personit të dënuar, së paku tre (3) muaj para lirimit.
2. Institucioni korrektues e njofton qendrën për punë sociale lidhur me llojin e ndihmës së kërkuar nga personi i dënuar.

KREU III
EKZEKUTIMI I DËNIMIT ME GJOBË

Neni 135
Kompetenca dhe procedura për ekzekutimin e dënimit me gjobë

1. Gjykata e cila shqipton dënimin me gjobë e urdhëron ekzekutimin e saj.
2. Dispozitat e Ligjit të procedurës përmbaruese në fuqi zbatohen për kompetencën dhe procedurën e ekzekutimit të dënimit me gjobë, përveç nëse me këtë ligj parashihet ndryshe.

Neni 136
Efekti i zëvendësimit të dënimit me gjobë me dënim me burgim

Personi i dënuar, dënimi me gjobë i të cilit është zëvendësuar me dënimin me burgim, sipas dispozitave të Kodit Penal të Kosovës, trajtohet si person i cili mban dënimin me burgim për kundërvajtje.

Neni 137
Raporti në mes të ekzekutimit të dënimit me gjobë, shpenzimeve të procedurës penale dhe kërkesave pasurore-juridike të palëve të dëmtuara

1. Kur shpenzimet e procedurës penale dhe dënimi me gjobë duhet të ekzekutohen njëkohësisht, së pari ekzekutohen shpenzimet e procedurës penale.

2. Nëse pasuria e personit të dënuar është zvogëluar për shkak të pagesës së dënimit me gjobë deri në atë masë sa që kërkesa pasurore-juridike e të dëmtuarit nuk mund të realizohet, kërkesa pasurore-juridike realizohet nga gjoba e paguar, por vetëm deri në masën e vlerës së gjobës**.**

Neni 138
Shpenzimet e ekzekutimit të dënimit me gjobë

1. Personi i dënuar, i paguan shpenzimet e ekzekutimit të dhunshëm të dënimit me gjobë.
2. Mjetet e paguara nga dënimi me gjobë derdhen në Buxhetin e Kosovës.

PJESA E TRETË
EKZEKUTIMI I DËNIMEVE ALTERNATIVE

KREU IV
DISPOZITAT E PËRGJITHSHME MBI EKZEKUTIMIN E DËNIMEVE ALTERNATIVE

Neni 139
Fillimi i ekzekutimit të dënimit alternativ me kusht

1. Ekzekutimi i dënimit alternativ fillon pasi vendimi merr formë të prerë.
2. Ndaj personit të dënuar dënimi alternativ ekzekutohet në vendbanimin, apo vendqëndrimin e tij.
3. Ekzekutimin e dënimeve alternative e përgatit, udhëheq dhe mbikqyrë Shërbimi Sprovues.

Neni 140
Mënyra e ekzekutimit të dënimeve alternative

1. Dënimi alternativ ekzekutohet në mënyrën e cila siguron respektimin e dinjitetit dhe të drejtat, liritë themelore të personit të dënuar dhe të familjes së tij.
2. Personi i dënuar, dinjiteti, apo të drejtat dhe liritë themelore të të cilit janë shkelur gjatë ekzekutimit të dënimit alternativ, ka të drejtë në ankesë.
3. Kundër vendimit përfundimtar me të cilët personit të dënuar gjatë ekzekutimit të dënimit alternativ i është kufizuar, apo i është shkelur ndonjë e drejtë e përcaktuar më këtë ligj, i dënuari ka të drejtë në mbrojtje gjyqësore.

Neni 141
Raporti para shqiptimit të dënimit alternativ

1. Para shqiptimit të dënimit alternativ, gjykata mund të kërkojë raport nga shërbimi sprovues. Shërbimi sprovues ia dorëzon raportin gjykatës para shqiptimit të dënimit, brenda tri (3) javësh nga paraqitja e kërkesës së tillë.
2. Raporti i dhënë para shqiptimit të dënimit përcakton dënimin, apo dënimet

alternative adekuate për personin e dënuar duke pasur parasysh objektivat e risocializimit dhe parandalimin e kryerjes së veprave penale në të ardhmen.

Neni 142
Raporti për revokimin e denimit alternativ

1. Kur gjykata e pranon raportin e Shërbimit Sprovues, i cili përmban të dhënat mbi shkeljen e kushteve të dënimit alternativ, apo mos përmbushjen e ndonjë obligimi, gjykata shqyrton mundësinë e revokimit të dënimit alternativ dhe personin e dënuar e njofton për përmbajtjen e raportit duke i dhënë atij të drejtën që t'i përgjigjet raportit. Personit të dënuar i bëhet me dije se me shpenzime të veta ka të drejtë të angazhojë mbrojtës.
2. Gjatë periudhës së shqyrtimit të revokimit të dënimit alternativ, ekzekutimi i tij pezullohet.
3. Pasi që gjykata shqyrton raportin e shërbimit sprovues dhe përgjigjet e pranuara nga personi i dënuar, apo mbrojtësi i tij, ajo vendos se a do ta revokojë dënimin alternativ, apo do të ndërmarrë veprime të tjera në pajtim me Kodin Penal të Kosovës.
4. Gjykata merr vendim të arsyetuar me shkrim brenda tridhjetë (30) ditëve pas pranimit të raportit nga shërbimi sprovues. Ky vendimi i dërgohet personit të dënuar, mbrojtësit të tij, shërbimit sprovues dhe prokurorit të shtetit.
5. Ndaj vendimit personi i dënuar mund të ankohet brenda tetë (8) ditëve nga pranimi i tij.

KREU V
EKZEKUTIMI I DËNIMIT ME KUSHT

Neni 143
Mënyra e ekzekutimit të dënimit me kusht

1. Kur gjykata shqipton dënimin me kusht, ajo ia dërgon aktgjykimin me të gjitha të dhënat që i posedon shërbimit sprovues për ekzekutimin e këtij dënimi alternativ.
2. Nëse personi i dënuar mbahet në paraburgim, gjykata po ashtu ia dërgon vendimin institucionit të paraburgimit ku mbahet ai. Drejtori i institucionit të paraburgimit e liron personin e dënuar në mënyrë që të ekzekutohet ky dënim alternativ.

Neni 144
Mbikqyrja e përmbushjes së obligimeve

1. Kur gjykata shqipton dënimin me kusht dhe urdhëron përmbushjen e ndonjë obligimi sipas dispozitave të Kodit Penal të Kosovës, shërbimi sprovues mbikëqyr përmbushjen e obligimit.
2. Nëse personi i dënuar nuk e përmbush obligimin e urdhëruar nga gjykata, sipas paragrafit 1. të këtij neni Shërbimi sprovues e njofton gjykatën pas verifikimit të fakteve dhe arsyeve për mos përmbushjen e obligimit.

KREU VI
EKZEKUTIMI I DËNIMIT ME KUSHT ME URDHËR PËR TRAJTIM TË DETYRUESHËM REHABILITUES

Neni 145
Mënyra e ekzekutimit të dënimit me kusht me urdhër për trajtim të detyrueshëm rehabilitues

1. Dënimi me kusht me urdhër për trajtim të detyrueshëm rehabilitues ekzekutohet në institucionin e kujdesit shëndetësor apo në ndonjë institucion tjetër përkatës.
2. Kur gjykata shqipton dënimin me kusht me urdhër për trajtim të detyrueshëm rehabilitues, ajo aktgjykimin dhe të gjitha të dhënat që i posedon ia dërgon menjëherë shërbimit sprovues kompetent dhe institucionit kompetent të kujdesit shëndetësor, apo institucionit përkatës për ekzekutimin e këtij dënimi.
3. Nëse personi i dënuar mbahet në paraburgim, gjykata po ashtu ia dërgon vendimin institucionit të paraburgimit ku mbahet ai. Drejtori i institucionit të paraburgimit e liron personin e dënuar në mënyrë që të ekzekutohet ky dënim alternativ.

Neni 146
Programi për trajtimin rehabilitues

1. Institucioni kompetent i kujdesit shëndetësor, apo institucioni përkatës, në bashkëpunim me shërbimin sprovues, përcaktojnë programin për trajtim rehabilitues për personin i cili i nënshtrohet dënimit me kusht me urdhër për trajtim të detyrueshëm rehabilitues. Shërbimi sprovues në bashkëpunim me institucionin kompetent të kujdesit shëndetësor, apo me institucionin përkatës e mbikëqyrë nëse personi i tillë i përmbahet programit të trajtimit rehabilitues.
2. Çdo katër (4) muaj shërbimi sprovues ia dërgon gjykatës raportet mbi përparimin e arritur në programin e trajtimit rehabilitues, bazuar në të dhënat e siguruara nga institucioni kompetent i kujdesit shëndetësor, apo nga institucioni tjetër përkatës.
3. Institucioni kompetent i kujdesit shëndetësor, apo institucioni tjetër përkatës e njofton menjëherë shërbimin sprovues për mos përmbushjen e programit të trajtimit rehabilitues nga personi i dënuar. Mos përmbushja e programit të trajtimit rehabilitues nga ana e personit të dënuar vlerësohet nga shërbimi sprovues dhe i raportohet gjykatës.
4. Pas njoftimit nga institucioni kompetent shndetësor për përfundimin e suksesshëm të programit të trajtimit rehabilitues, raporti i tillë i dërgohet gjykatës nga shërbimi sprovues.

KREU VII
EKZEKUTIMI I DËNIMIT ME KUSHT ME URDHËR PËR MBIKËQYRJE NGA SHËRBIMI SPROVUES

Neni 147
Mënyra e ekzekutimit të dënimit me kusht me urdhër për mbikëqyrje nga Shërbimi Sprovues

1. Kur gjykata shqipton dënimin me kusht, me urdhër për mbikëqyrje nga shërbimi sprovues, sipas dispozitave të Kodit Penal të Kosovës aktgjykimin dhe të gjitha të dhënat që i posedon ia dërgon menjëherë shërbimit sprovues kompetent për ekzekutimin e këtij dënimi alternativ.
2. Nëse personi i dënuar mbahet në paraburgim, gjykata po ashtu ia dërgon aktgjykimin institucionit korrektues përkatës ku ai mbahet. Drejtori i institucionit korrektues përkatës e liron personin e dënuar me vendim në mënyrë që të ekzekutohet ky dënim alternativ.

Neni 148
Mbikëqyrja nga shërbimi sprovues

1. Shërbimi sprovues e mbikëqyrë ekzekutimin e dënimit me kusht me urdhër për mbikëqyrje nga shërbimi sprovues.
2. Nëse personi i dënuar nuk kontakton me shërbimin sprovues, shërbimi sprovues e njofton gjykatën pas verifikimit të fakteve dhe arsyeve për mosmbajtjen e kontaktit të tillë.

Neni 149
Mbikëqyrja e përmbushjes së obligimeve

1. Kur gjykata e shqipton dënimin me kusht me urdhër për mbikëqyrje nga shërbimi sprovues dhe urdhëron përmbushjen e ndonjë obligimi, sipas dispozitave të Kodit Penal të Kosovës, shërbimi sprovues e mbikëqyrë përmbushjen e këtij obligimi.
2. Nëse personi i dënuar nuk e përmbush obligimin e urdhëruar nga gjykata, shërbimi sprovues e njofton gjykatën pas verifikimit të fakteve dhe arsyeve për mos përmbushjen e obligimit të tillë.

Neni 150
Raportimi i Shërbimit Sprovues

Përfundimi i suksesshëm i periudhës së verifikimit të ekzekutimit të këtij dënimit alternativ të personave të dënuar i raportohet gjykatës nga shërbimi sprovues. Pas pranimit të raportit të tillë, gjykata merr vendim me të cilin vërtetohet mbajtja e dënimi alternativ

KREU VIII
EKZEKUTIMI I DËNIMIT ME URDHËR PËR PUNË NË DOBI TË PËRGJITHSHME

Neni 151
Mënyra e ekzekutimit të dënimit me urdhër për punë në dobi të përgjithshme

1. Kur gjykata shqipton dënimin me urdhrin për punë në dobi të përgjithshme, sipas dispozitave të Kodit Penal të Kosovës, ajo ia dërgon menjëherë aktgjykimin me të gjitha të dhënat që i posedon shërbimit sprovues kompetent për ekzekutimin e këtij dënim alternativ.
2. Nëse personi i dënuar mbahet në paraburgim, gjykata po ashtu ia dërgon vendimin institucionit të paraburgimit ku mbahet ai. Drejtori i institucionit korrektues përkatës e liron personin e dënuar në mënyrë që të ekzekutohet ky dënim alternativ.

Neni 152
Programi i punës në dobi të përgjithshme

1. Shërbimi sprovues e zhvillon programin për punë në dobi të përgjithshme për personin e dënuar në pajtim me dispozitat e Kodit Penal të Kosovës dhe bazuar në aftësitë, shkathtësitë dhe të kaluarën e tij.
2. Shërbimi sprovues e mbikëqyrë ekzekutimin e dënimit me urdhër për punë në dobi të përgjithshme.
3. Shërbimi sprovues, në bashkërendim me organizatën ku duhet kryer puna në dobi të përgjithshme, vendosë rregullat e sigurimit për rastet e lëndimeve në vendin e punës, ose sëmundjes, sjelljen e përgjithshme në vendin e punës dhe çështjet tjera përkatëse para fillimi të punës në dobi të përgjithshme. Akti nënligjor për orarin e punës, pushimet, pushimet javore dhe mbrojtjen në vendin e punës zbatohen gjatë punës në dobi të përgjithshme**.**

Neni 153
Mbikqyrja e kryerjes së punës në dobi të përgjithshme

1. Kur gjykata shqipton dënimin me urdhër për punë në dobi të përgjithshme dhe personin e dënuar e urdhëron që të kontaktojë me shërbimin sprovues, apo të përmbushë një, ose më shumë obligime sipas dispozitave të Kodit Penal të Kosovës, shërbimi sprovues e mbikëqyrë mbajtjen e kontaktit, apo përmbushjen e obligimit.
2. Nëse personi i dënuar nuk mban kontakt me shërbimin sprovues, ose nuk e përmbush obligimin e urdhëruar nga gjykata, shërbimi sprovues e njofton gjykatën pas verifikimit të fakteve dhe arsyeve për mos mbajtjen e kontaktit, apo mos përmbushjen e obligimit.
3. Organet e administratës të nivelit qendror dhe lokal, institucionet dhe personat e tjerë juridik, si dhe personat fizik janë të obliguar të bashkëpunojnë me shërbimin sprovues dhe zyret regjionale sprovuese në ekzekutimin e dënimit me urdhër për punë në dobi të përgjithëshme.

4. Ministri lidhë marveshje të bashkpunimit për ekzekutimin e dënimit për punë në dobi të përgjithëshme nga paragrafi 3. i këtij neni. Me marrëveshje të bashkëpunimit përcaktohen të drejtat dhe detyrimet reciproke.

Neni 154
Njoftimi

1. Organizata në të cilën duhet kryer puna në dobi të përgjithshme menjëherë e njofton shërbimin sprovues nëse personi i dënuar nuk e kryen punën në dobi të përgjithshme në nivel të kënaqshëm. Moskryerja në nivel të kënaqshëm e punës në dobi të përgjithshme vlerësohet nga shërbimi sprovues dhe i raportohet gjykatës.
2. Moskryerja në nivel të kënaqshëm e punës në dobi të përgjithshme nënkupton ardhjen e vonuar në punë, mungesat e palejuara nga puna, mosrespektimin e rregullave të punës.

Neni 155
Korrigjimi i programit të punës në dobi të përgjithshme

1. Nëse personi i dënuar është i paaftë për kryerjen e punës në dobi të përgjithshme për shkak të rrethanave të ndryshuara, shërbimi sprovues mund të korrigjojë programin për punën në dobi të përgjithshme.
2. Ekzekutimi i urdhrit për punë në dobi të përgjithshme me dënim mund të shtyhet, apo pezullohet për shkak të:
   2.1. sëmundjes së papritur të personit të dënuar, e cila kërkon trajtim mjekësor dhe atij ia pamundëson kryerjen e punës në dobi të përgjithshme;
   2.2. vdekjes së ndonjë anëtari të familjes, që atë e obligon të merr rolin e kujdestarit kryesor ndaj anëtarëve të tjerë të familjes dhe ia pamundëson kryerjen e punës në dobi të përgjithshme;
   2.3. rrethanave të tjera të jashtëzakonshme, të cilat kërkojnë praninë e përhershme të personit të dënuar për arsye humanitare dhe atij ia pamundësojnë kryerjen e punës në dobi të përgjithshme.
3. Kërkesa për shtyrjen, apo pezullimin e ekzekutimit të urdhrit për punë në dobi të përgjithshme mund t'i paraqitet gjykatës nga personi i dënuar, mbrojtësi, ose përfaqësuesi i shërbimit sprovues. Parashtrimi i kërkesës pezullon obligimin për kryerjen e punës në dobi të përgjithshme derisa gjykata të vendos lidhur me kërkesën.
4. Gjykata vendos për shtyrjen, apo pezullimin e ekzekutimit të urdhrit për punë në dobi të përgjithshme të urdhëruar me dënim brenda tri (3) ditëve nga pranimi i kërkesës. Nëse gjykata e miraton shtyrjen, apo pezullimin e ekzekutimit të urdhrit për punë në dobi të përgjithshme, ajo me aktin e përcakton periudhën e shtyrjes, apo pezullimit.
5. Shtyrja, apo pezullimi i ekzekutimit të urdhrit për punë në dobi të përgjithshme të urdhëruar mund të zgjasë:
   5.1. deri në shërimin e sëmundjes, në rastet nga nën-paragrafi 2.1 i paragrafit 2 të këtij neni.
   5.2. deri në njëzet (20) ditë, në rastet nga nënparagrafi 2.2. dhe 2.3. të paragrafit 2.të këtij neni.

Neni 156
Raportimi

Përfundimi i suksesshëm i punës në dobi të përgjithshme i raportohet gjykatës nga shërbimi sprovues. Pas pranimit të raportit të tillë, gjykata merr vendim me të cilin vërtetohet mbajtja e dënimit alternativ.

KREU IX
EKZEKUTIMI I BURGIMIT NË GJYSMËLIRI

Neni 157
Mënyra e ekzekutimit të burgimit në gjysmëliri

1. Kur gjykata shqipton dënimin me burgim dhe urdhëron ekzekutimin e dënimit në gjysmëliri, ajo aktgjykimin dhe të gjitha të dhënat që i posedon ia dërgon menjëherë shërbimit sprovues kompetent dhe institucionit korrektues për ekzekutimin e këtij dënimi alternativ.
2. Drejtori i përgjithshëm i Shërbimit Korrektues përcakton institucionin korrektues ku do të ekzekutohet urdhri për gjysmëliri, duke marrë parasysh vendin e punës, apo obligimet dhe përgjegjësitë tjera të personit të dënuar dhe faktorët tjerë veprues.

Neni 158
Mbikëqyrja e personit të dënuar në gjysmëliri

1. Drejtori i institucionit korrektues e mbikëqyrë personin e dënuar derisa ai është i burgosur, kurse shërbimi sprovues kompetent e mbikëqyrë atë derisa ai është në gjysëmliri.
2. Nëse personi i dënuar nuk kthehet në institucionin korrektues pas kryerjes së obligimeve të tij, drejtori i institucionit korrektues e njofton gjykatën pas verifikimit të fakteve dhe arsyeve për moskthim në institucionin korrektues.
3. Nëse personi i dënuar nuk i përmbush obligimet e tij lidhur me punën, arsimimin, kualifikimin, ose aftësimin profesional, përgjegjësitë familjare, apo nevojën për trajtim, ose rehabilitim mjekësor, shërbimit sprovues e njofton gjykatën pas verifikimit të fakteve dhe arsyeve për mos përmbushjen e obligimeve të tilla.

PJESA E KATËRT
EKZEKUTIMI I DËNIMEVE PLOTËSUESE

KREU X
HEQJA E TË DREJTËS PËR T'U ZGJEDHUR

Neni 159
Mënyra e ekzekutimit të heqjes së të drejtës për t'u zgjedhur

1. Kur gjykata vendos që kryerësit t'ia heqë të drejtën për t'u zgjedhur sipas dispozitave të Kodit Penal të Kosovës, menjëherë ia dërgon aktgjykimin dhe të

gjitha të dhënat që i posedon stacionit të policisë në territorin e së cilës personi i dënuar ka vendbanimin për ekzekutimin e këtij dënimi plotësues.

2. Njësia administrative e stacionit të policisë e njofton Komisionin Qendror të Zgjedhjeve të Kosovës dhe Komisionin Lokal të Zgjedhjeve ku personi i dënuar e ka vendbanimin, se personit të dënuar i është hequr e drejta për t'u zgjedhur me akt të formës së prerë të gjykatës.
3. Nëse personi i dënuar e ndërron vendbanimin, ai e njofton gjykatën dhe policinë për vendbanimin e tij të ri. Stacioni i policisë në territorin e të cilit personi i dënuar ka pasur vendbanimin e mëhershëm e njofton stacionin e policisë për vendbanimin e ri të personit të dënuar.

KREU XI
NDALIMI I USHTRIMIT TË FUNKSIONEVE NË ADMINISTRATËN PUBLIKE OSE NË SHËRBIMIN PUBLIK

Neni 160
Mënyra e ekzekutimit të ndalimit të ushtrimit të funksioneve në administratën publike, ose në shërbimin publik

1. Kur gjykata vendos që kryerësit t'ia ndalojë ushtrimin e funksioneve në administratën publike, ose në shërbimin publik, sipas dispozitave të Kodit Penal të Kosovës, menjëherë ia dërgon aktgjykimin dhe të gjitha të dhënat që i posedon Ministrisë së Administratës Publike për ekzekutim të këtij dënimi plotësues.
2. Nëse personi i dënuar nuk i përmbahet ndalesës së ushtrimit të funksioneve në administratën publike, ose në shërbimin publik, Ministria e Administratës Publike e njofton gjykatën për mosrespektimin e ndalesës.

KREU XII
NDALIMI I USHTRIMIT TË PROFESIONIT, VEPRIMTARISË, OSE DETYRËS

Neni 161
Ekzekutimi i ndalimit të ushtrimit të profesionit, veprimtarisë, ose detyrës

Kur gjykata vendos që kryerësit t'ia ndalojë ushtrimin e profesionit, veprimtarisë së pavarur, detyrës udhëheqëse, ose administrative, sipas dispozitave të Kodit Penal të Kosovës, menjëherë ia dërgon aktgjykimin dhe të gjitha të dhënat që i posedon ndërmarrjes publike, apo private ku personi i dënuar ka qenë i punësuar, organit të autorizuar për dhënien e lejes për ushtrimin e profesionit, apo veprimtarisë dhe Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale për ekzekutim të këtij dënimi plotësues.

Neni 162
Revokimi i lejes

1. Kur parakusht për ushtrimin e profesionit, veprimtarisë ose detyrës është leja e dhënë nga organi i autorizuar, ky dënim plotësues ekzekutohet me revokim të

lejes, ose me ndalimin e dhënies së lejes gjatë kohës derisa dënimi plotësues është në fuqi.

2. Në rastet tjera Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale ndërmerr veprime përkatëse që personi i dënuar të parandalohet nga ushtrimi i profesionit, veprimtarisë apo detyrës.
3. Ndërmarrja publike, apo private, organi përgjegjës, ose Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale e njofton gjykatën, e cila e ka shqiptuar dënimin plotësues kur është ekzekutuar dënimi i tillë.

Neni 163
Njoftimi i gjykatës

Nëse personi i dënuar nuk i përmbahet ndalesës së ushtrimit të profesionit, veprimtarisë, ose detyrës, ndërmarrja publike, apo private, organi përgjegjës, ose Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale e njofton gjykatën për mosrespektim të ndalesës.

KREU XIII
NDALIMI I DREJTIMIT TË AUTOMJETIT

Neni 164
Ekzekutimi i ndalimit të drejtimit të automjetit

1. Kur gjykata vendos që kryerësit t'ia ndalojë drejtimin e automjetit, sipas dispozitave të Kodit Penal të Kosovës, menjëherë ia dërgon aktgjykimin dhe të gjitha të dhënat që i posedon organit kompetent për dhënien e lejeve të vozitjes në territorin ku personi i dënuar ka vendbanimin, për ekzekutim të këtij dënimi plotësues.
2. Nëse vendbanimi i personit të dënuar nuk dihet, organi kompetent i autorizuar për dhënien e lejeve të vozitjes në territorin ku personi i dënuar ka vendqëndrimin e ekzekuton këtë dënim plotësues.
3. Nëse personi i dënuar nuk ka vendbanim në Kosovë, aktgjykimi i dërgohet organit kompetent të autorizuar për dhënien e lejeve të vozitjes në territorin ku është kryer vepra penale.

Neni 165
Pavlefshmëria e lejes së vozitjes

1. Organi kompetent i autorizuar për dhënien e lejeve të vozitjes këtë dënim e ekzekuton me thirrjen e personit të dënuar dhe shënimin në lejen e vozitjes së tij si të pavlefshme gjatë kohës së ekzekutimit të këtij dënimi plotësues për llojin dhe kategorinë e caktuar të automjetit.
2. Nëse personi i dënuar nuk ka leje të vozitjes, ose ka leje të dhënë nga organi kompetent i shtetit të huaj, ky dënim plotësues ekzekutohet me regjistrimin e dënimit në regjistrin e organit kompetent për dhënien e lejeve të vozitjes. Organi publik kompetent regjistron të dhënat e personit të dënuar, dënimin e shqiptuar plotësues dhe kohëzgjatjen e tij.

3. Pas përfundimit të dënimit plotësues, personi i dënuar mund të kërkojë dhënien e lejes së re të vozitjes nga organi kompetent.

Neni 166

Nëse personi i dënuar nuk i përmbahet ndalimit të drejtimit të automjetit, organi kompetent i autorizuar për dhënien e lejes së vozitjes e njofton gjykatën për mosrespektimin e ndalimit të tillë.

KREU XIV
MARRJA E LEJES SË VOZITJES

Neni 167
Ekzekutimi i marrjes së lejes së vozitjes

1. Kur gjykata vendosë që kryerësit t'ia marrë lejen e vozitjes, sipas dispozitave të Kodit Penal të Kosovës, menjëherë ia dërgon aktgjykimin dhe të gjitha të dhënat që i posedon stacionit të policisë në territorin ku personi i dënuar e ka vendbanimin për ekzekutimin e këtij dënimi plotësues.
2. Nëse vendbanimi i personit të dënuar nuk dihet, stacioni i policisë në territorin ku personi i dënuar ka vendqëndrimin e ekzekuton këtë dënim plotësues.

Neni 168

1. Nëse personi i dënuar posedon leje të vozitjes, policia e ekzekuton këtë dënim plotësues me thirrjen e personit të dënuar dhe marrjen e lejes së vozitjes gjatë kohëzgjatjes së dënimit.
2. Nëse personi i dënuar nuk posedon leje të vozitjes, ky dënim plotësues ekzekutohet me regjistrimin e dënimit në regjistrin e organit administrativ kompetent për dhënien e lejes së vozitjes. Organi kompetent e regjistron të dhënat e personit të dënuar, dënimin plotësues të shqiptuar dhe kohëzgjatjen e tij.
3. Ekzekutimi i këtij dënimi plotësues fillon në ditën e marrjes së lejes së vozitjes, ose të regjistrimit të dënimit në regjistrin e organit kompetent për dhënien e lejes së vozitjes.

KREU XV
MARRJA E SENDIT

Neni 169
Ekzekutimi i marrjes së sendit

1. Dënimi plotësues i marrjes së sendit, sipas dispozitave të Kodit të Penal të Kosovës, ekzekutohet nga gjykata e cila e ka shqiptuar dënimin në shkallë të parë.
2. Gjykata vendos nëse sendi do të shitet sipas dispozitave të ligjit për procedurë përmbarimore, do t'i dorëzohet organit kompetent, muzeut të kriminalistikës, ose institucionit përkatës, apo nëse do të asgjësohet.
3. Të ardhurat nga shitja e sendit depozitohen në Buxhetin e Kosovës.

KREU XVI
URDHRI PËR PUBLIKIMIN E AKTGJYKIMIT

Neni 170
Publikimi i aktgjykimit

Kur gjykata urdhron publikimin e aktgjykimit, sipas dispozitave të Kodit Penal të Kosovës, menjëherë e dërgon aktgjykimin e përmbarueshëm për publikim në një, ose në më shumë gazeta, ose për transmetim në ndonjë kanal të radios a televizionit.

KREU XVII
DËBIMI I TË HUAJIT NGA TERRITORI I KOSOVËS

Neni 171

Kur gjykata vendos për dëbimin e shtetasit të huaj nga territori i Kosovës, sipas dispozitave të Kodit Penal të Kosovës, ajo aktgjykimin dhe të gjitha të dhënat që i posedon ia dërgon menjëherë stacionit të policisë në territorin ku personi i dënuar ka vendqëndrimin për ekzekutimin e këtij dënimi plotësuese.

KREU XVIII
EKZEKUTIMI I MASAVE TË TRAJTIMIT TË DETYRUESHËM

Neni 172
Mënyra e ekzekutimit të trajtimit të rehabilitimit të detyrueshëm për kryerësit e varur nga droga apo alkooli

1. Masa e trajtimit të rehabilitimit të detyrueshëm për kryerësit e varur nga droga, apo alkooli ekzekutohet në institucionin e kujdesit shëndetësor, apo në institucionin tjetër përkatës. Nëse kjo masë shqiptohet së bashku me dënimin me burgim ajo mbahet në institucionin shëndetësor.
2. Gjykata vendos për institucionin e kujdesit shëndetësor, për institucionin korrektues, apo institucionin tjetër përkatës ku duhet të ekzekutohet masa e trajtimit të detyrueshëm.
3. Kur gjykata shqipton masën e trajtimit të rehabilitimit të detyrueshëm, ajo menjëherë ia dërgon vendimin dhe të gjitha të dhënat tjera që i posedon për shërbimit sprovues kompetent dhe institucionit të kujdesit shëndetësor, institucionit korrektues, ose institucionit përkatës për ekzekutimin e kësaj mase.
4. Nëse personi i dënuar mbahet në paraburgim, gjykata gjithashtu ia dergon vendimin qendrës së paraburgimit ku mbahet ai. Drejtori i qendrës së paraburgimit e liron personin e dënuar për ekzekutimin e kësaj mase.

Neni 173
Programi i trajtimit të rehabilitimit

1. Institucioni shëndetësor, institucioni korrektues, apo institucioni përkatës, në bashkëpunim me shërbimin sprovues cakton programin e trajtimit të rehabilitimit

për personin që i nënshtrohet masës së trajtimit të rehabilitimit të detyrueshëm. Shërbimi sprovues mbikëqyrë nëse personi vepron në përputhje me programin e trajtimit rehabilitues, në bashkëpunim me institucionin shëndetësor, institucionin korrektues, apo institucionin përkatës.

2. Shërbimi sprovues i dërgon çdo dy (2) muaj raport gjykatës për përparimin e arritur në programin e trajtimit rehabilitues bazuar në informatat e siguruara nga institucioni shëndetësor, i institucionit korrektues, apo i institucionit tjetër përkatës.
3. Institucioni shëndetësor, institucioni korrektues, apo institucioni përkatës menjëherë e informojnë shërbimin sprovues nëse personi i dënuar nuk i përmbahet programit të trajtimit rehabilitues. Mos përmbushja e programit të trajtimit rehabilitues nga personi i dënuar vlerësohet nga shërbimi sprovues dhe i raportohet gjykatës.
4. Përfundimi i suksesshëm i programit të trajtimit rehabilitues i raportohet gjykatës nga shërbimi sprovues. Pas marrjes së raportit të tillë gjykata merr vendim me të cilin vërtetohet mbajtja e masës së tillë.

Neni 174
Mënyra e ekzekutimit të masës së trajtimit të detyrueshëm psikiatrik me ndalim në institucionin e kujdesit shëndetësor

1. Masat e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik me ndalim ekzekutohet në institucionin shëndetësor, ose në institucionin tjetër të posaçëm që ndodhet në vendbanimin e përhershëm, ose vendqëndrimin e të pandehurit, ose nëse institucioni i tillë nuk ndodhet në atë vend, në institucionin më të përafërt me vendin ku i pandehuri ka vendbanimin e përhershëm, ose vendqëndrimin, ose në vendin ku është zbatuar procedura penale.
2. Gjykata vendos për institucionin shëndetësor, ose institucionin tjetër përkatës ku duhet të ekzekutohet masa e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik me ndalim. Me rastin e vendosjes për institucionin e kujdesit shëndetësor gjykata merr parasysh rrezikun që i pandehuri paraqet për mjedisin e tij, për vendbanimin e përhershëm, ose vendqëndrimin e tij dhe nevojat e tij për trajtim.
3. Kur gjykata cakton masën e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik me ndalim, ajo menjëherë ia dërgon vendimin dhe të gjitha të dhënat që i posedon shërbimit sprovues kompetent dhe institucionit shëndetësor, institucionit korrektues, ose institucionit përkatës për ekzekutimin e kësaj mase.
4. Nëse masa është caktuar së bashku me dënimin me burgim, kryerësi i veprës penale së pari dërgohet në institucionin e kujdesit shëndetësor për trajtim.

Neni 175
Transferimi i personit të cilit i është shqiptuar masa e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik në liri me ndalim në institucionin e kujdesit shëndetësor

1. Nëse personi ndaj të cilit është caktuar masa e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik, me ndalim ndodhet në liri, gjykata urdhëron transferimin e tij në institucionin e kujdesit shëndetësor, ose urdhëron lëshimin e letër rreshtimit, por

nëse personi ndodhet në paraburgim, personeli i Shërbimit Korrektues të Kosovës e përcjell në institucionin e kujdesit shëndetësor.

2. Personi ndaj të cilit është caktuar kjo masë, transferohet në institucionin e kujdesit shëndetësor i shoqëruar nga punëtorët e kujdesit shëndetësor.
3. Personi ndaj të cilit ekzekutohet kjo masë ka të drejta dhe detyrime të njëjta sikurse person i cili mban dënimin me burgim, nëse nevojat e trajtimit nuk kërkojnë ndryshe.
4. Me propozimin e institucionit të kujdesit shëndetësor ku ekzekutohet kjo masë, gjykata gjatë kohëzgjatjes së masës, mund të vendosë për transferimin e personit nga një institucion i kujdesit shëndetësor në tjetrin.
5. Gjykata e cila ka caktuar masën në shkallë të parë monitoron ligjshmërinë e ekzekutimit të saj. Organi publik kompetent për shëndetësi monitoron aftësinë profesionale të trajtimit, i cili ofrohet gjatë ekzekutimit të masës.

Neni 176
Raportimi i institucioni të kujdesit shëndetësor

1. Institucioni i kujdesit shëndetësor i dërgon gjykatës që ka caktuar masën në shkallë të parë raport mbi gjendjen shëndetësore dhe suksesin e trajtimit të personit ndaj të cilit ekzekutohet masa, së paku një herë në gjashtë (6) muaj dhe më shpesh me kërkesë të gjykatës.
2. Kur institucioni i kujdesit shëndetësor, ose mjeku përgjegjës për shërimin mendor konstaton se, më nuk është e nevojshme ta trajtojë, ose ta ndalojë kryerësin e veprës penale në institucionin e kujdesit shëndetësor, ai menjëherë e informon gjykatën që e ka caktuar masën në shkallë të parë.
3. Çdo gjashtë (6) muaj, gjykata që ka caktuar masën në shkallë të parë, e shqyrton nevojën e vazhdimit të masës pas shqyrtimit të institucionit shëndetësor dhe të mendimit të ekspertit të pavarur, i cili nuk është i punësuar në institucionin e kujdesit shëndetësor ku është duke u ekzekutuar masa.
4. Sipas detyrës zyrtare, ose me propozimin e të pandehurit, mbrojtësit të institucionit të kujdesit shëndetësor, ose të organit të kujdestarisë që është kompetent në bazë të vendbanimit të përkohshëm, ose të përhershëm të personit në kohën kur ka hyrë në fuqi urdhri me anë të cilit është caktuar masa, gjykata e cila ka caktuar masën në shkallë të parë e pushon masën nëse konstaton se më nuk është e nevojshme që kryerësi të trajtohet, ose ndalohet në atë institucion. Kur pushon masën, gjykata mund ta caktojë masën e trajtimit të detyrueshëm në liri nëse ekzistojnë arsyet për caktimin e masës së tillë.
5. Vendimi sipas paragrafit 4. të këtij neni merret pas dëgjimit të prokurorit të shtetit, mbrojtësit dhe kryerësit të veprës penale nëse gjendja e tij këtë e lejon edhe pas shqyrtimit të mendimit të ekspertit.
6. Kur gjykata pushon masën, e informon institucionin e kujdesit shëndetësor, e liron personin ndaj të cilit është caktuar masa menjëherë pas marrjes së vendimit.

Neni 177
Dhënja e ndihmës pas lirimit nga përkujdesja shëndetësore

1. Pasi që personi të lirohet nga institucioni shëndetësor, organi kompetent i kujdestarisë është përgjegjës për personin ndaj të cilit është ekzekutuar masa në dhënien e ndihmës pas lirimit nga institucioni shëndetësor.
2. Nëse kryerësi i cili ka kryer vepër penale në gjendje të aftësisë së zvogëluar mendore lirohet nga institucioni shëndetësor, dhe nëse ai në institucionin shëndetësor ka kaluar kohë më të shkurtër sesa kohëzgjatja e burgimit të caktuar, gjykata e shqyrton lirimin me kusht për atë person.
3. Me rastin e vendosjes për lirim me kusht, gjykata veçanërisht merr parasysh suksesin e trajtimit të personit të dënuar, gjendjen e tij shëndetësore, kohën e kaluar në institucionin shëndetësor dhe kohën e mbetur të dënimit.
4. Nëse gjykata vendosë për lirimin me kusht, mundet gjithashtu ta caktojë masën e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik në liri, nëse ekzistojnë arsyet për caktimin e masës së tillë.
5. Nëse gjykata vendosë që personi i dënuar të mbajë pjesën e mbetur të dënimit me burgim, personeli i Shërbimit Korrektues të Kosovës e përcjellë atë në institucionin korrektues të dënimit.

Neni 178
Ekzekutimi i masës së trajtimit të detyrueshëm psikiatrik në liri

1. Masa e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik në liri ekzekutohet në institucionin shëndetësor të caktuar nga gjykata që ka caktuar masën në shkallë të parë.
2. Gjykata e informon institucionin shëndetësor për datën kur personi ndaj të cilit është caktuar masa duhet të paraqitet për trajtim.
3. Personi ndaj të cilit është caktuar masa detyrohet të paraqitet në institucionin shëndetësor për trajtim brenda kohës së caktuar nga gjykata.

Neni 179
Raportimi i institucionit të kujdesit shëndetësor

1. Institucioni shëndetësor i dërgon gjykatës që ka caktuar masën në shkallë të parë raport mbi gjendjen shëndetësore dhe suksesin e trajtimit të personit ndaj të cilit është ekzekutuar masa, së paku një (1) herë në gjashtë (6) muaj, dhe më shpesh me kërkesë të gjykatës.
2. Kur institucioni shëndetësor çmon se më nuk është e nevojshme ta trajtojë personin ndaj të cilit është shqiptuar masa, menjëherë e informon gjykatën e cila ka caktuar masën në shkallë të parë.
3. Gjykata e cila ka caktuar masën në shkallë të parë, sipas detyrës zyrtare, ose me propozimin e të pandehurit, mbrojtësit, institucionit shëndetësor, ose organit kompetent të kujdestarisë, e pushon masën nëse konstaton se më nuk është e nevojshme ta trajtojë personin ndaj të cilit është shqiptuar masa.
4. Vendimi për pushimin e masës merret pas dëgjimit të prokurorit të shtetit, mbrojtësit dhe personit ndaj të cilit është shqiptuar masa, nëse këtë e lejon gjendja e tij dhe pas shqyrtimit të mendimit të ekspertit.

Neni 180

1. Institucioni shëndetësor menjëherë e njofton gjykatën që e ka caktuar masën në shkallë të parë, kur personit ndaj të cilit është shqiptuar masa nuk i është nënshtruar trajtimit në liri nëse ai arbitrarisht e ka ndërprerë trajtimin, ose nëse mendon se trajtimi ka qenë i pasuksesshëm.
2. Gjykata sipas detyrës zyrtare, ose me propozimin e institucionit shëndetësor, në të cilin personi trajtohet, ose duhet të trajtohet, mund të caktojë masën e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik me ndalim nëse:
   2.1. kryerësi i veprës penale nuk i është nënshtruar trajtimit në liri, ka ndërprerë trajtimin arbitrarisht, ose kur trajtimi është konsideruar i pasuksesshëm nga institucioni i kujdesit shëndetësor;
   2.2. ekzistojnë arsyet për caktimin e masës së tillë.
3. Vendimi për caktimin e masës së trajtimit të detyrueshëm psikiatrik me ndalim merret pas dëgjimit të prokurorit te shtetit, mbrojtësit dhe personit ndaj të cilit është shqiptuar masa, nëse këtë e lejon gjendja e tij dhe pas shqyrtimit të mendimit të ekspertit të pavarur, i cili nuk është i punësuar në institucionin e kujdesit shëndetësor ku ekzekutohet masa.
4. Pasi personi nuk ka më nevojë për trajtim në institucionin shëndetësor, organi kompetent i kujdestarisë është përgjegjës për personin ndaj të cilit është ekzekutuar masa në dhënien e ndihmës pas pushimit të trajtimit të detyrueshëm në liri.

KREU XIX
EKZEKUTIMI I DËNIMIT ME BURGIM PËR KUNDËRVAJTJE

Neni 181
Aplikimi i dispozitave të këtij ligji

Dënimi me burgim i shqiptuar për kundërvajtje, ose me të cilin është zëvendësuar dënimi i shqiptuar me gjobë ekzekutohet sipas dispozitave të këtij ligji, nëse me ligj të veçantë nuk është paraparë ndryshe.

Neni 182
Vendosja e personave të dënuar në institucionet korrektuese

1. Personat e dënuar me burgim për kundërvajtje, e mbajnë dënimin në institucionin korrektues, të ndarë nga personat e paraburgosur.
2. Femrat e dënuara me burgim për kundërvajtje, e mbajnë dënimin në institucionin korrektues për femra, të ndara nga femrat e paraburgosura.
3. Të dënuarit e mitur me burgim për kundërvajtje, e mbajnë dënimin të ndarë nga madhorët.

Neni 183
Kompetenca për dërgimin e personave të dënuar për mbajtjen e dënimit me burgim për kundërvajtje

1. Gjykata themelore në vendin e së cilës personi i dënuar ka vendbanimin, ose vendqëndrimin, në kohën kur vendimi për shqiptimin e dënimit merr formën e prerë është kompetente për dërgimin e personit të dënuar për mbajtjen e dënimit me burgim për kundërvajtje.
2. Kur vendbanimi, ose vendqëndrimi i personit të dënuar nuk dihen, kompetente për dërgimin e personit të dënuar për mbajtjen e dënimit me burgim për kundërvajtje është gjykata themelore që ka marrë vendim në shkallë të parë.
3. Nëse në procedurën kundërvajtëse është vendosur që dënimi me burgim të ekzekutohet menjëherë pa marrë parasysh ankesën, dërgimin e personit të dënuar për ta mbajtur dënimin e bën gjykata themelore e cila ka marrë vendim në shkallë të parë.

Neni 184

Nëse gjykata themelore e cila ka shqiptuar dënimin me burg, ose e ka zëvendësuar dënimin e shqiptuar me gjobë, me dënimin, me burg, nuk është kompetente për ekzekutim, ajo ka për detyrë që vendimin e ekzekutueshëm t'ia dërgojë gjykatës themelore, jo më vonë se brenda afatit prej tri (3) ditësh, pasi vendimi të ketë marrë formën ekzekutuese.

Neni 185

1. Gjykata themelore e urdhëron me shkrim personin e dënuar të paraqitet ditën e caktuar në institucionin korrektues për mbajtjen e dënimit me burgim për kundërvajtje.
2. Afati ndërmjet pranimit të urdhrit dhe ditës së paraqitjes nuk duhet të jetë më i shkurtër se tetë (8) ditë dhe më i gjatë se pesëmbëdhjetë (15) ditë.
3. Gjykata themelore e informon institucionin korrektues lidhur me datën kur personi i dënuar duhet të paraqitet në institucion, ia dorëzon vendimin e formës së prerë, dhe të dhënat personale për personin e dënuar të cilat janë mbledhur gjatë procedurës kundërvajtëse.

Neni 186
Fillimi i mbajtjes së dënimit me burgim për kundërvajtje

1. Institucioni korrektues e informon gjykatën themelore se a është paraqitur personi i dënuar për mbajtjen e dënimit me burgim për kundërvajtje.
2. Fillimi i mbajtjes së dënimit me burgim për kundërvajtje llogaritet nga dita kur personi i dënuar është paraqitur për mbajtjen e dënimit në institucionin korrektues.

Neni 187

1. Nëse i dënuari me burgim për kundërvajtje i cili është thirrur me rregull nuk paraqitet në institucionin korrektues, gjykata kompetente për kundërvajtje urdhëron shoqërimin e tij, e nëse ai fshihet, ose është në arrati, gjykata urdhëron shpalljen urdhër arresti
2. Në rastet nga paragrafi 1. i këtij neni fillimi i ekzekutimit të dënimit me burgim për kundërvajtje llogaritet nga dita kur i dënuari është privuar nga liria, ndërsa shpenzimet e transportit i paguan i dënuari.

Neni 188
Shtyrja e ekzekutimit të dënimit me burgim për kundërvajtje

1. Ekzekutimi i dënimit me burgim për kundërvajtje mund të shtyhet nga arsyet e njëjta për të cilat mund të shtyhet edhe ekzekutimi i dënimit me burgim të shqiptuar për vepër penale.
2. Shtyrja e fillimit të mbajtjes së dënimit me burgim për kundërvajtje nga paragrafi 1. i këtij neni nuk mund të zgjatë më shumë se gjashtëdhjetë (60) ditë.

Neni 189
Procedura e shtyrjes së ekzekutimit të dënimit me burgim për kundërvajtje

1. Personi i dënuar e parashtron lutjen për shtyrjen e ekzekutimit të dënimit me burgim për kundërvajtje brenda tri (3) ditëve nga pranimi i urdhrit për mbajtjen e dënimit.
2. Lutja për shtyrjen e ekzekutimit të dënimit me burgim për kundërvajtje i parashtrohet kryetarit të gjykatës themelore.
3. Kryetari i gjykatës themelore vendos lidhur me lutjen për shtyrjen e ekzekutimit të dënimit brenda tri (3) ditëve nga pranimi i kërkesës.
4. Kryetari i gjykatës themelore e hedh poshtë lutjen për shtyrjen e ekzekutimit të dënimit, nëse ajo nuk është parashtruar brenda periudhës së paraparë kohore dhe nëse është paraqitur nga personi i paautorizuar, ose nëse në të nuk janë bashkëngjitur provat që e mbështesin atë brenda periudhës së paraparë kohore.

Neni 190

1. Kundër aktvendimit të shkallës së parë me të cilin refuzohet lutja për shtyrjen e fillimit të mbajtjes së dënimit, i dënuari mund t'i parashtrojë ankesë kryetarit të Gjykatës së Apelit brenda afatit prej tri (3) ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit.
2. Kryetari i Gjykatës së Apelit vendosë lidhur me ankesën brenda tri (3) ditëve nga pranimi i saj.

Neni 191
Pezullimi i ekzekutimit të dënimit

1. Lutja për shtyrjen e ekzekutimit e pezullon ekzekutimin e dënimit derisa të merret vendimi i formës prerë lidhur me kërkesën.
2. Kryetari i gjykatës themelore, i cili pas parashtrimit të lutjes së dytë konstaton se e drejta në ankesë është keqpërdorur vendosë që ankesa të mos e shtyjë ekzekutimin e dënimit.

Neni 192
Revokimi i ekzekutimit të dënimit

1. Kryetari i gjykatës themelore e revokon shtyrjen e ekzekutimit të dënimit, nëse më vonë konstatohet se arsyet për lejimin e shtyrjes nuk kanë ekzistuar, ose kanë pushuar së ekzistuari, ose nëse personi i dënuar e ka shfrytëzuar shtyrjen për qëllime të tjera, e jo për ato për të cilat është lejuar.
2. I dënuari ka të drejtën e ankesës kundër aktvendimit mbi revokimin, ose ndërprerjen e shtyrjes së ekzekutimit të dënimit në kushte të njëjta si edhe kundër aktvendimit në bazë të cilit është vendosur lidhur me kërkesën për shtyrje.
3. Ankesa e shtyn ekzekutimin e aktvendimit.

Neni 193
Ndërprerja e mbajtjes së dënimit me burgim për kundërvajtje

1. Me kërkesën e personit të dënuar për kundërvajtje, përjashtimisht në raste të arsyeshme, mund të lejohet ndërprerja e mbajtjes së dënimit me burgim për kundërvajtje, por jo më shumë se dhjetë (10) ditë. Në raste të jashtëzakonshme me qëllim të mjekimit, ndërprerja mund të vazhdojë derisa të zgjasë mjekimi.
2. Koha e ndërprerjes së lejuar nuk llogaritet në mbajtjen e dënimit.

Neni 194
Zbatimi i dispozitave për lirimin me kusht dhe lirimin e të dënuarve

Dispozitat e këtij Ligji që i referohen lirimit me kusht dhe lirimit të personave të dënuar zbatohen përshtatshmërisht edhe ndaj personave të dënuar me burgim për kundërvajtje.

KREU XX
EKZEKUTIMI I DËNIMIT ME GJOBË DHE I MASAVE MBROJTËSE TË SHQIPTUARA PËR KUNDËRVAJTJE

Neni 195

Dispozitat e këtij ligji që u referohen ekzekutimit të dënimit me gjobë, dhe të dënimeve plotësuese të shqiptuara për vepër penale zbatohen përshtatshmërisht edhe për ekzekutimin e dënimit me gjobë dhe të masave mbrojtëse të shqiptuara për kundërvajtje, nëse me ligj të posaçëm nuk është paraparë ndryshe.

KREU XXI
EKZEKUTIMI I MASAVE TE PARABURGIMIT

Neni 196
Mënyra e ekzekutimit të masës së paraburgimit

1. Masa e paraburgimit sipas aktvendimeve të gjykatave kompetente ekzekutohet në institucionet përkatëse korrektuese.
2. Në veprimin me personat në paraburgim aplikohen dispozitat përkatëse të Kodit për procedurën penale dhe dispozitat e këtij ligji.
3. Me kërkesën e prokurorit dhe nëse ajo është në interesin e drejtësisë, gjykata mund të urdhërojë që të kufizohen të drejtat e caktuar të përsonit në paraburgim.

Neni 197
Vendosja e personit të paraburgosur

1. Në institucionin përkatës korrektues mund të vendoset personi për të cilin gjykata kompetente ka nxjerr aktvendim për caktimin e paraburgimit. Bashkë me aktvendimin për caktimin e paraburgimit, institucionit korrektues përkatës i dërgohet edhe urdhëri me shkrim për pranim të personit të paraburgosur.
2. Institucioni korrektues përkatës lëshon vërtetim me shkrim për pranimin e të paraburgosurit, në të cilin përveç tjerash shënohet, dita dhe ora e pranimit, emri dhe mbiemri i personit i cili e ka sjellë të paraburgosurin.

Neni 198
Kontrollimi mjekësor dhe njoftimi me të drejtat e tij

1. Menjëherë pas pranimit në institucioni korrektues përkatës, kryhet kontrolli mjeksor i të paraburgosurit, ndërsa konstatimi dhe mendimi i mjekut shënohet në kartonin shëndetësor të paraburgosurit.
2. Pas pranimit në institucion korrektues përkatës, i paraburgosuri njoftohet me aktin nënligjor për rendin e brendshëm shtëpiak, për ekzekutimin e masës së paraburgut, të drejtat dhe detyrimet e tjera gjatë kohës së zbatimit të masës së paraburgut.
3. Të paraburgosuri të cilët së bashku kanë marrë pjesë në kryerjen e veprës penale sistemohen në lokale të veçanta.

Neni 199
Kushtet për personat në paraburgim

1. Të paraburgosurit në institucionin korrektues përkatës qëndrojnë nën kushtet e njëjta sikurse edhe personat e dënuar lidhur me vendosjen, ushqimit, mbrojtjes shëndetësore, përdorimit të masave të dhunës, të masave të veçanta për mbajtjen e rendit dhe sigurisë, dhe kompensimit për dëmin e shkaktuar gjatë kohës së zbatimit të masës së paraburgut.
2. Në rast nevoje të ruajtjes të paraburgosurit gjatë kohës së qëndrimit jashta institucionit korrektues sipas cilësdo bazë, sigurinë e kryen policija.

Neni 200

1. I paraburgosuri mund të angazhohet me punë në punëtori, punëtoritë e njësive ekonomike të cilat gjenden në rrethin e institucionit korrektues përkatës pas marrjes së pëlqimit të gjykatës kompetente.
2. I paraburgosuri i cili punon, ka të drejtë në kompenzim dhe të drejta tjera në bazë të punës në pajtim me këtë Ligj që u takojnë personave të dënuar.

Neni 201

1. Nëse gjatë kohës së ekzekutimit të masës së paraburgimit, i paraburgosuri kryen shkelje disiplinore, apo cilin do kundërvajtje, institucioni korrektues për atë e informon gjykatën e cila udhëheqë procedurën.
2. Gjykata kompetente lajmërohet edhe në rastin e arratisjes të personit të paraburgosur. Gjykata lëshon urdhërin për shpalljen e urdhërarrestimit për gjetjen dhe sjelljen të paraburgosurit.
3. Mbikëqyrjen ndaj ekzekutimit të masës së paraburgimit e kryen kryetari i gjykatës kompetente në pajtim me Kodin për Procedurën Penale.

Neni 202

Lëshimi i të paraburgosurit nga institucioni korrektues kryhet në bazë të aktvendimit për abrogimin e paraburgimit të gjykatës kompetente, apo pas skadimit të afatit për të cilin është caktuar paraburgimi**.**

Neni 203

I paraburgosuri i cili në bazë të dispozitave të Kodit të Procedurës Penale, me kërkesën e tij, para formës së prerë dërgohet në mbajtjen e dënimit me burg është i barazuar në të drejtat dhe detyrimet me personat e tjerë të dënuar.

Neni 204

1. Me aktin për rendin shtëpiak në institucionet korrektuese përcaktohet në veçanti:
   1.1. pranimi dhe sistemimi i të paraburgosurve;
   1.2. masat higjieniko-shëndetësore dhe ushqimi;
   1.3. pranimi i vizitave;
   1.4. pranimi i dërgesave dhe shtypit;
   1.5. puna dhe sjellja e të paraburgosurve, mbajtja e rendit dhe disiplinës;
   1.6. procedura në rastin e arratisjes, apo vedekjes së të paraburgosurit;
   1.7. sjellja e të paraburgosurit, lirimi dhe
   1.8. çështje tjera me rëndësi për ekzekutimin e masës së paraburgimit.

PJESA E PESTË
ORGANET EKZEKUTIVE PËR EKZEKUTIMIN E SANKSIONEVE PENALE

KREU XXII
SHËRBIMI KORREKTUES I KOSOVËS

Neni 205
Veprimtaria e Shërbimit Korrektues të Kosovës

1. Shërbimi Korrektues i Kosovës (më tej: Shërbimi Korrektues) është organ qendror i administratës shtetërore, profesional i pavarur, i uniformuar me grada dhe pjesërisht i armatosur në vartësi të Ministrisë së Drejtësisë (më tej: Ministria).
2. Shërbimi Korrektues është përgjegjës për kryerjen e këtyre punëve:
   2.1. organizimin, zbatimin dhe mbikëqyrjen e ekzekutimit të dënimit me burgim dhe me burgim të përjetëshëm;
   2.2. organizimin, zbatimin dhe mbikëqyrjen e burgimit të të miturve dhe masave edukuese, përveç nëse Kodi i Drejtësisë për të Mitur e parasheh ndryshe;
   2.3. organizimin e programeve që i kontribuojnë korrektimit, përgatitjes për lirim dhe mbikëqyrjes afatgjatë të personave të dënuar me burgim dhe me burgimtë përjetëshëm;
   2.4. Vleresimin e rrezikut kriminogjen dhe per caktimin e nevojave per trajtim të kryerësve të veprave penale;
   2.5. udhëzimin dhe mbështetjen ndaj personave të dënuar në përfundim të dënimit të tyre;
   2.6. ndërmarrjen e masave me qëllim të arsimimit dhe aftësimit profesional të personelit civil dhe të zyrtarëve korrektues të punësuar;
   2.7. për realizimin e bashkëpunimit me institucionet përkatëse, shoqatat dhe organizatat të cilat merren me problemet e ekzekutimit të sanksioneve penale.
3. Shërbimi korrektues ka statusin e personit juridik.
4. Shërbimi Korrektues ka shenjën e vet identifikuese dhe ka selinë në Prishtinë.

Neni 206
Struktura organizative e Shërbimit Korrektues

1. Për kryerjen e punëve dhe detyrave nga kompetenca e Shërbimit Korrektues themelohen këto njësi themelore organizative:
   1.1. Zyra Qëndrore e Shërbimit Korrektues me seli në Prishtinë; dhe
   1.2. institucionet korrektuese.
2. Organizimi i brendshëm dhe sistematizimi i Shërbimit Korrektues, dhe i institucioneve korrektuese rregullohet me akt të veçantë, të cilin e miraton Ministri, dhe që përfshihet si kre i veçantë në Rregulloren për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës të Ministrisë.

Neni 207
Përgjegjësitë e Zyrës Qendrore të Shërbimit Korrektues

1. Zyra Qendrore e Shërbimit Korrektues, e përcjell, e mbikëqyr ligjshmërinë e punës dhe të veprimit të njësive organizative të Shërbimit Korrektues dhe të institucioneve korrektuese.
2. Në Zyrën Qendrore të Shërbimit Korrektues, themelohen drejtoritë dhe sektoret. Me drejtorinë udhëheqin, udhëheqësit të cilët emrohen nga Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Korrektues.
3. Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Korrektues njëherit është edhe udhëheqës i Zyrës Qendrore të Shërbimit Korrektues**.**

Neni 208
Llojet e institucioneve korrektuese

1. Në Shërbimin Korrektues ekzistojnë këto lloje të institucioneve korrektuese:
   1.1. burgjet, për ekzekutimin e dënimit me burgim dhe me burgim të përjetshëm;
   1.2. qendrat e paraburgimit, për ekzekutimin e paraburgimit dhe dënimeve me burgim deri në tre (3) muaj;
   1.3. burgjet për femra, për ekzekutimin e dënimit me burgim, burgimit për të mitur të shqiptuar ndaj femrave;
   1.4. burgjet për të mitur, për ekzekutimin e burgimit të të miturve;
   1.5. institucionet edukative-korrektuese, për ekzekutimin e masave edukative të dërgimit të kryerësit të mitur në institucionin edukativo-korrektues;
   1.6. spitali dhe ambulancat e burgjeve, për trajtimin e personave të paraburgosur dhe personave të dënuar.

Neni 209
Tipet e Institucioneve Korrektuese

1. Në bazë të shkallës së sigurisë dhe mënyrës së trajtimit të personave të dënuar, institucionet korrektuese mund të jenë të tipit të mbyllur, gjysmë të hapur dhe të hapur.
2. Institucionet korrektuese të tipit të mbyllur kanë elemente të sigurisë fizike dhe materiale, siç janë zyrtaret korrektues te armatosur, muret rrethuese apo rrethoja, pajimet teknike dhe masat tjera të sigurisë që pengojnë arratisjen e personave të dënuar. Në kuadër të tipit të mbyllur bënë pjesë edhe burgu i sigurisë së lartë, për ekzekutimin e dënimit me burgim ndaj personave të klasifikuar me rrezikshmëri shumë të lartë, personave të paraburgosur të klasifikuar me rrezikshmëri shumë të lartë dhe atyre të dënuar me burgim të përjetëshëm
3. Institucionet korrektuese të tipit gjysmë të hapur nuk kanë elemente të sigurisë fizike në formë të mbikëqyrjes së lëvizjeve dhe punës së personit të dënuar, por kanë elemente të sigurisë materiale që e pengojnë arratisjen e personave të dënuar.
4. Institucionet korrektuese të tipit të hapur nuk kanë elemente të sigurisë fizike as materiale që e pengojnë arratisjen e personave të dënuar. Sjellja ndaj

personave të denuar bazohet në vetë disiplinën e tyre dhe përgjegjësinë personale, kurse personeli korrektues mbikëqyrë lëvizjen dhe punën e personave të dënuar.

5. Në institucionet korrektuese të tipit të mbyllur mbahet së paku një e treta (1/3) e dënimit me burgim të përjetshëm.

Neni 210

Në kuadër të institucionit korrektues mund të ketë njësi të hapur, gjysmë të hapur dhe të mbyllur.

Neni 211
Themelimi i Institucioneve Korrektuese

Me propozimin e Ministrit institucionet korrektuese themelohen me akt nënligjor të Qeverisë së Republikës së Kosovës. Me këtë akt nënligjor percaktohet lloji, tipi dhe selia e institucionit korrektues.

Neni 212
Njësitë Ekonomike

1. Në institucionet korrektuese themelohen një apo më shumë njësi ekonomike për punë të personave të dënuar.
2. Njësia ekonomike themelohet me vendim të Ministrisë së Drejtësisë
3. Mjetet fillestare të nevojshme për themelimin e njësisë ekonomike sigurohen në Buxhetin e Republikës së Kosovës.
4. Me punën e njësisë ekonomike udhëheqë drejtori i institucionit, apo personi i autorizuar nga ai.

Neni 213
Statusi i njësisë ekonomike

1. Njësia ekonomike ka statusin e personit juridik dhe në qarkullim paraqitet në emrin e vetë dhe për llogari të tijë.
2. Njësia ekonomike krijon të hyra të dedikuara për nevoja të Shërbimit Korrektues.

Neni 214
Të hyrat e dedikuara

Ministria e Drejtësisë nxjerr akt nënligjor për shfrytëzimin dhe ndarjen e të hyrave të dedikuara

Neni 215
Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Korrektues

1. Me Shërbimin Korrektues udhëheq Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Korrektues (më tej: Drejtori i Përgjithshëm).

2. Drejtori i Përgjithshëm emërohet në bazë të konkursit të hapur nga Ministria e Drejtësisë në pajtim me dipozitat për Shërbimin Civil për emërimin, për pozitat e larta drejtuese në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës. Komisioni profesional vlerësues duhet të përbëhet nga profesionist përfaqësues të Ministrisë së Drejtësisë, Shërbimi Korrektues, gjyqëtar i Gjykatës së Apelit, prokuror i shtetit dhe profesor i fakultetit të drejtësisë i drejtimit penalo juridik.
3. Drejtori i Përgjithshëm udhëheqë, drejton dhe kontrollon Shërbimin Korrektues dhe të gjitha çështjet lidhur me Shërbimin Korrektues.
4. Drejtori i Përgjithshëm zgjidhet për periudhë kohore pesë (5) vjeçare, e me mundësi rizgjedhje.
5. Për punën e tij Drejtori i Përgjithshëm i përgjigjet drejtpërdrejtë Ministrit.

Neni 216
Kushtet për emrimin e Drejtorit të Përgjithshëm

1. Detyrën e Drejtorit të Përgjithshëm duhet ta ushtroj personi (kandidati) i cili i plotëson kushtet në vijim:
   1.1. të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
   1.2. të ketë përgatitje universitare;
   1.3. të ketë tetë (8) vite përvojë pune profesionale, prej të cilave së paku pesë (5) vite përvoj pune në vende udhëheqëse;
   1.4. të mos jetë anëtarë i ndonjë partie politike;
   1.5. të ketë reputacion moral dhe profesional, dhe të mos jetë i dënuar për vepër penale.
2. Shërbimi Korrektues mund të ketë edhe zëvendësdrejtorët e Përgjithshëm të cilët emrohen sipas procedures, kushteve dhe kohëzgjatjes të parapara për Drejtorin e Përgjithshëm.

Neni 217
Drejtorët e Institucioneve Korrektuese

1. Drejtorët e institucioneve korrektuese emërohen me konkurs të hapur nga Ministria e Drejtësisë në pajtim me dipozitat për Shërbimin Civil, për emërimin, për pozitat e larta drejtuese në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.
2. Drejtorët e institucioneve korrektuese emërohen përshtatshmërisht me dispozitat për emërimin e Drejtorit të Përgjithshëm.
3. Drejtorët e institucioneve korrektuese emërohen për periudhë kohore pesë (5) vjeçare me mundësi vazhdimi.
4. Detyrën e drejtorit të institucionit korrektues mund ta ushtroj personi (kandidati) i cili i plotëson kushtet në vijim:
   4.1. të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
   4.2. të ketë përgatitje universitare;
   4.3. të ketë gjashtë (6) vite përvojë pune profesionale, prej të cilave së paku tri (3) vite përvoj pune në pozita udhëheqëse;
   4.4. të mos jetë anëtarë i ndonjë partie politike;
   4.5. të ketë reputacion moral dhe profesional, dhe të mos jetë i dënuar për vepër penale.

5. Ministri vet, apo me propozimin e Drejtorit të Përgjithshëm mund t'i suspendoj, ose shkarkoj drejtorët e institucioneve korrektuese për shkelje ligjore, apo për shkak të mos efikasitetit në punë.
6. Vendimi i Ministrit për suspendim, apo shkarkim të drejtorëve të institucioneve korrektuese është përfundimtar.
7. Institucionet korrektuese mund të kenë edhe zavendës drejtorët të cilët emrohen sipas procedurës, kushteve dhe kohëzgjatjes të parapara për drejtorët e institucioneve korrektuese.

Neni 218
Organizimi i Brendshëm i Institucioneve Korrektuese

Në institucionet korrektuese, varësisht nga madhësia dhe nga përmbajtja e punëve të institucionit korrektues mund të themelohen drejtorate dhe sektore. Drejtoritë munden me qenë: për sigurim, trajtim dhe administrative. Në kuadër të shërbimeve mund të organizohen edhe sektore, pavijone apo struktura tjera të veçanta. Me aktin nënligjor për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës të Shërbimit Korrektues përcaktohet organizimi i brendshëm, pozitat dhe vendet e punës në institucionet korrektuese.

Neni 219
Personeli i Shërbimit Korrektues

1. Personelin e Shërbimit Korrektues dhe të institucioneve korrektuese e përbëjnë nëpunësit civil në pajtim me dispozitat për shërbimin civil të Republikës së Kosovës dhe zyrtarët korrektues të shërbimit Korrektues dhe të institucioneve korrektuese në pajtim me këtë ligj.
2. Marrëdhënia e punës për zyrtarët korrektues rregullohet me akt nënligjor të cilin e nxjerr Ministri.
3. Shërbimi Korrektues e harton ndërsa Ministri miraton Kodin e Etikës Profesionale për zyrtarët korrektues të Shërbimit Korrektues.

Neni 220
Zyrtarët korrektues

1. Zyrtarët korrektues i emëron dhe shkarkon Drejtori i Përgjithshëm në bazë të konkursit publik dhe në pajtim me këtë ligj.
2. Në Shërbimin Korrektues si zyrtar korrektues mund të pranohet personi i cili i plotëson:
   2.1. kushtet e përgjithshme të parapara për personelin civil sipas Ligjit për shërbimin civil;
   2.2. kushtet e veçanta në pikëpamje të kualifikimit përkatës shkollor dhe profesional, të përvojës së punës, dhe të kushteve tjera të përcaktuara me Rregulloren për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës të Ministrisë së Drejtësisë.
3. Personat të cilët themelojnë marrëdhënie pune si zyrtar korrektues në Shërbimin

Korrektues në punët e drejtorateve të sigurimit, në punët e trajtimit si edukues dhe në punët e instruktorit, përpos kushteve të parapara në paragrafin 1. të këtij neni, duhet t'i plotësojnë edhe aftësitë shëndetësore dhe psikofizike të nevojshme për kryerjen e atyre punëve.

Neni 221

1. Zyrtarët korrektues, për shkak të rrezikshmërisë, rëndësisë, si dhe kushteve të veçanta të punës, për çdo dymbëdhjetë (12) muaj pune i llogaritet si gjashtëmbëdhjetë (16) muaj stazh i siguruar, kurse në llogaritjen e pagave sigurohet një shtesë e të ardhurave.
2. Kategorizimi i zyrtarëve korrektues, të cilët do të realizojnë beneficionet e parapara në paragrafin 1. të këtij neni rregullohen me akt të veçantë nënligjor të cilin e nxjerr Ministri.

Neni 222

Me vendimin e Drejtorit të institucionit korrektues, në interes të shërbimit, sipas nevojës së krijuar, personi i punësuar është i detyruar të punojë edhe më gjatë se koha e punës së plotë, dhe mund t'i ndërpritet apo t'i shtyhet shfrytëzimi i pushimit vjetor.

Neni 223

1. Për të punësuarit si zyrtar korrektues në institucionet korrektuese të cilët punojnë në punët e ekzekutimit të sanksioneve penale, është i detyrueshëm arsimimi dhe aftësimi profesional permanent në pajtim me planin dhe programin e trajnimit të arsimimit dhe aftësimit profesional.
2. Për arsimimin dhe aftësimin profesional të punësuarve nga paragrafi 1. i këtij neni, shërbimi korrektues mundet në mënyrë të pavarur, apo nëpërmjet të organizatës profesionale vendore, apo të jashtme, me projekte të organizojë seminare, këshillime dhe forma tjera të aftësimit profesional.
3. Planin dhe programin mësimor të arsimimit profesional e nxjerrë Drejtori i Përgjithshëm, pas marrjes së pëlqimit nga Ministri.

Neni 224

1. Vërtetimi i aftësive shëndetësore dhe psikofizike të punësuarve si zyrtar korrektues të cilët punojnë në punët e sigurimit kryhet njëherë gjatë dy (2) viteve, ndërsa sipas nevojës së paparë mund të dërgohen edhe në periudhat më të shkurta kohore, për çka vendosë drejtori i përgjithshëm.
2. Vërtetimi i aftësive shëndetësore të punësuarve të cilët punojnë në punët e tjera për të cilat stazhi i punës llogaritet në kohëzgajtje të rritur, kryhet një herë në tre vjet, ndërsa sipas nevojës së paraqitur mund të dërgohen edhe në periudhat kohore më të shkurta, për çka vendosë drejtori i institucionit korrektues.
3. Nëse te i punësuari nga paragrafi 1. dhe 2. i këtij neni paraqiten ndryshime psikike, apo në gjendjen e përgjithshme shëndetësore e cila e bënë të paaftë për kryerjen e

atyre punëve udhëzohet në organin kompetent për vlerësimin e aftësisë punuese në pajtim me ligjin me të cilin përcaktohen të drejtat nga sigurimi pensional dhe invalidor.

4. Në qoftë se organi kompetent përcakton ekzistimin e aftësisë profesionale të mbetur, i punësuari sistemohet në punë të tjera në pajtim me mundësitë e Shërbimit Korrektues, apo i mundësohet rikualifikimi. Nëse nuk ekziston mundësia e sistemimit në punë tjera të punësuarit i pushon marrëdhënia e punës.
5. Vendimin për pushimin e marrëdhënies së punës e nxjerrë Drejtori i Përgjithshëm.

Neni 225
Transferimi

1. Personi i punësuar në Institucionin korrektues nga neni 221 paragrafi 1. i këtij ligji, për shkak të nevojave të punës, apo për shkak të rritjes së vëllimit të punëve, mundet të transferohet përkohësisht pa pëlqimin e tij në Institucionin tjetër korrektues më së gjati gjashtë (6) muaj gjatë dy (2) viteve, ndërsa me pajtimin e tij më së gjati dymbedhjete (12) muaj.
2. Vendimin për dërgimin e nxjerrë Drejtori i Përgjithshëm, kundër të cilit nuk lejohet ankesa.

Neni 226

1. Zyrtari korrektues i punësuar në institucionin korrektues, përveç drejtorit dhe zëvendës drejtorit të institucionit korrektues dhe të udhëheqësve të njësive organizative të institucionit, mundet me pëlqimin e Drejtorit të Përgjithshëm të sistemohet në insitucionin korrektues në punët të tjera, për të cilat i plotëson kushtet e parapara me Rregulloren për organizimin dhe sistematizimin e vendeve të punës, nëse atë e urdhëron organizimi i ri, apo racionalizimi i punëve apo nevoja e punëve.
2. Kundër vendimit nga paragrafi paraprak mund të ushtrohet ankesë Ministrit në afat prej tetë (8) ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Neni 227
Pushimi i marrëdhënies së punës të zyrtarit korrektues

1. Zyrtarit korrektues në Shërbimin Korrektues i pushon marrëdhënia e punës:
   1.1. në rast vdekje;
   1.2. me skadimin e afati, nëse marrëdhënia e punës është themeluar në kohë të caktuar;
   1.3. me kërkesë marrëveshje;
   1.4. me plotësimin e kushteve, të parapara me ligj, lidhur me moshën për pensionim;
   1.5. në rast suprimimi, apo rirganizimit të institucionit korrektues, apo të shkëputjes të vendit të punës, nëse nuk sistemohet në vend tjetër të punës në afat prej tre muajsh prej momentit kur ka ardh deri te riorganizimi, apo shkëputja;

1.6. nëse me aktgjykimin e formës së prerë dënohet me denim me burg më së paku gjashtë (6) muaj;
1.7. nëse refuzon sistemimin, apo kur për shkaqe të paarsyeshme nuk ia fillon punës në të cilën është sistemuar;
1.8. në qoftë se me rastin e themelimit të marrëdhënies së punës ka heshtë, apo ka dhënë shënime jo të sakta të cilat kanë qenë me rëndësi për themelimin e marrëdhënies së punës, dhe
1.9. nëse nuk ekziston mundësia që në afat prej tre (3) muajsh pas shkarkimit të sistemohet në punë dhe detyra të cilat i përgjigjen kualifikimit profesional të tij.

2. Për pushimin e marrëdhënies së punës nxirret vendim kundër të cilit mund të ushtrohet ankesë Drejtorit të Përgjithshëm në afat prej tetë (8) ditësh nga data e pranimit të vendimit. Vendimi i Drejtorit të Përgjithshëm është përfundimtar dhe kundër tij mund të ngritet konflikti administrativ në gjykatën kompetente.
3. Në qoftë se vijë deri te riorganizimi, apo shkëputja e Institucionit korrektues, Ministri përcakton kriteret për përcaktimin e tepricës së personelit korrektues, si dhe vëllimin e drejtave që iu takojnë sipas kësaj baze.

Neni 228
Kompensimi për vdekje në detyrë, apo në kryerje të detyrës

1. Shërbimi Korrektues paguan shpenzimet e ceremonisë së varrimit për zyrtarin korrektues që vdes në detyrë, apo në kryerje të detyrës. Vendvarrimi do të caktohet nga anëtarët e familjes së zyrtarit korrektues. Shërbimi Korrektues do t'i paguajë shpenzimet në vijim:
1.1. transportin për bartjen e kufomës;
1.2. shpenzimet e udhëtimit për dy (2) persona shoqërues;
1.3. shpenzimet e funeralit që nuk janë paguar në forma të tjera;
1.4. shpenzimet e tjera me aprovimin e ministrit.
2. Shërbimi Korrektues do të paguaj bashkëshortin, apo fëmijët nën moshën tetëmbëdhjetë (18) vjeçare të zyrtarit korrektues i cili vdes në detyrë, apo në kryerje të detyrës me një ndihmë financiare të menjëhershme në një shumë që është e barabartë me pagën mujore bruto të shumëzuar me gjashtë (6). Një pagesë e tillë do të bëhet vetëm pasi të përcaktohet se bashkëshorti, apo fëmijët kanë qenë të përkrahur nga zyrtari korrektues para vdekjes së tij, ose saj. Në raste të caktuara sipas vlerësimit, Qeveria mund të ndaj shumë më të lartë financiare të menjëhershme për zyrtarin korrektues i cili ka vdekur në kryerje të detyrës.
3. Bashkëshorti i/e cili/a përcaktohet që ka qenë e përkrahur nga zyrtari korrektues dhe fëmijët nën moshën tetëmbëdhjetë (18) vjeçare të zyrtarit korrektues i cili vdes në kryerje të detyrës kanë të drejtë në pension familjar, por vetëm deri në vlerën gjashtëdhjetë përqind (60%) të pagës bruto.
4. Me propozimin e Ministrisë së Drejtësisë, Qeveria nxjerr akt nënligjor për përcaktimin e kompenzimeve për rastet e zyrtarëve korrektues të cilët vdesin në detyrë, apo në kryerje të detyrës.

Neni 229
Procedurat disiplinore për zyrtarët korrektues

1. Të gjitha shkeljet disiplinore, ku përfshihet zyrtari korrektues hetohen dhe vendosen nga Zyra Qendrore e Shërbimit Korrektues.
2. Shkeljet, masat dhe procedura disiplinore e zyrtarëve korrektues rregullohen me akt nënligjor të cilin e nxjerr Ministri.

Neni 230
Procedura disiplinore

1. Procedurën disiplinore të punësuarve (personeli civil dhe zyrtarët korrektues) brenda institucionit korrektues e udhëheq komisioni displinor të cilin e emëron drejtori i institucionit korrektues. Për përgjegjësinë disiplinore vendosë drejtori i institucionit korrektues, me propozimin e komisionit disiplinor.
2. Procedurën disiplinore kundër drejtorit të institucionit korrektues dhe të punësuarve në Zyrën Qëndrore të Shërbimit Korrektues e udhëheqë Komisioni disiplinor të cilin e emëron Drejtori i Përgjithshëm. Për përgjegjësinë disiplinore vendosë Drejtori i Përgjithshëm me propozimin e Komisionit disiplinor.
3. Kundër vendimit të shkallës së parë të nxjerrë në procedurën disiplinore mund ti parashtrohet ankesa Drejtorit të Përgjithshëm, në afat prej tete (8) ditësh nga data e pranimit të vendimit.
4. Për shqyrtimin e ankesësave dhe dhënien e propozimeve lidhur me theksimet në to, dhe për ligjshmërinë e vendimeve në procedurën disiplinore Drejtori i Përgjithshëm formon Komisionin për ankesa.
5. Vendimi i Drejtorit të Përgjithshëm lidhur me ankesën është përfundimtar.

Neni 231
Masat disiplinore

1. Komisioni mund të shqiptoj masat disiplinore si në vijim:
   1.1. qortimin;
   1.2. qortim me vërejtje, me shkrim;
   1.3. zvogëlimi i së ardhurave personale deri në tridhjetë përqind (30%), duke pasur parasysh natyrën e shkeljes;
   1.4. transferin në institucion tjetër korrektues deri në gjashtë (6) muaj;
   1.5. ulja në pozitë;
   1.6. ndërprerjen e marrëdhënies së punës.
2. Komisioni propozon sanksionin në harmoni me shkallën e përgjegjësisë disiplinore dhe pasojat e shkeljes.

Neni 232
Publiciteti i punës së Shërbimit Korrektues dhe Shërbimit Sprovues

1. Puna e Shërbimit Korrektues dhe e Shërbimit Sprovues është publike.
2. Ministri dhe Drejtori i Përgjithshëmi i Shërbimit Korrektues, apo Drejtori i

Përgjithshëm i Shërbimit Sprovues, drejtpërdrejt apo nëpërmjet personave të cilët i autorizojnë, e informojnë opinionin për ekzekutimin e sanksioneve, apo të punëve sprovuese me kusht që me atë të mos shkelet sekreti zyrtar, seriozisht të mos rrezikohet siguria, apo mbajtja e rendit në institucionin korrektues në të cilën ekzekutohet sanksioni, apo kryhen punët sprovuese.

3. Drejtorët e Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues dhe Shërbimit Sprovues, me pëlqimin e ministrit, caktojnë zëdhënësit.
4. Të gjitha informacionet lidhur me personat e dënuar dhe të paraburgosurit janë konfidenciale, nuk zbulohen dhe nuk bëhen të njohura për opinionin apo për mediat.
5. Përjashtimisht nga paragrafi 3. i këtij neni, Ministria e Drejtësisë mund t'i bëjë të njohura informacionet konfidenciale për mediat, ose grupet tjera të informimit publik nëse dhënia e këtyre informacioneve është në pajtim me interesin e përgjithshëm shoqëror. Informacionet e tilla konfidenciale nuk zbulohen nëse zbulimi i tyre paraqet rrezik për rendin dhe sigurinë e përgjithshme të institucioneve korrektuese, apo nëse dhënia e këtyre informacioneve mund të dëmtojë qëllimin e dënimit.
6. Personat e dënuar nuk intervistohen nga mediat, grupet publike lokale, apo personat tjerë pa pëlqim paraprak të tij.
7. Ministri nxjerr akt nënligjorë mbi fshehtësinë e informacioneve, dhënien dhe zbulimin e tyre, si dhe udhëzime për mediat.
8. Dispozitat e këtij neni nuk e cenojnë autorizimin që e kanë Avokati i Popullit, gjykatësit dhe zyrtarët tjerë të drejtësisë në bazë të ligjit në fuqi për qasje në dokumentet zyrtare dhe Ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale Kodit penal të Kosovës.
9. Ministri mund t'i lejoj qasje në dokumente organizatave të cilat merren me mbrojtjen e të drejtave të njeriut në pajtim me aktin për rendin shtëpiak të institucioneve korrektuese.

Neni 233
Vizitat e personave apo grupeve në institucionet korrektuese

1. Drejtori i Përgjithshëm është i autorizuar për miratimin e vizitave nga ana e personave, apo grupeve në institucionet korrektuese.
2. Dispozitat e paragrafit 1. të këtij neni nuk vlejnë për përfaqësuesit e organeve shtetërore, kur kryejnë punët nga kompetenca e tyre.
3. Në veçanti duhet patur kujdes që të mundësohet vizita e përfaqësuesve të institucioneve vendore dhe të huaj, si dhe të shoqatave të cilat merren me mbrojtjen e drejtave njerëzore, të punëtorëve shkencor të cilët me hulumtimin e kriminalitetit, përfaqësuesve të mjeteve të informimit, si dhe të studentëve të fakulteteve përkatëse.
4. Personave të cilët vizitojnë Institucionin korrektues, Drejtori i Përgjithshëm mund të lejoj bisedë me personat e denuar, apo me personat e caktuar të dënuar, me prezencën, apo pa prezencën e personit zyrtar.

Neni 234
Medaljet, lëvdatat, shpërblimet dhe mirënjohjet

1. Kryeministri, Ministri dhe Drejtori i Përgjithshëm janë të autorizuar t'u japin medalje, lëvdata, shpërblime dhe mirënjohje, zyrtarëve korrektues, punëtorëve të tjerë të Shërbimit Korrektues, personave fizik dhe juridik të vendit dhe të huaj që e kanë dalluar vetën me meritat e tyre.
2. Kryeministri jep medaljen në vijim:
   2.1. medaljen e nderit.
3. Ministri jep medaljet në vijim:
   3.1. medaljen për merita;
   3.2. medaljen për trimëri; dhe
   3.3. medaljen e shpëtimit të jetës.
4. Drejtori i Përgjithshëm jep medaljet në vijim:
   4.1. medaljen për shërbim të dalluar;
   4.2. medaljen korrektuese për lëvdim; dhe
   4.3. medaljen për shërbim të besnikërisë**.**

KREU XXIII
SHËRBIMI SPROVUES

Neni 235
Veprimtaria e Shërbimit Sprovues

1. Shërbimi Sprovues është organ qendror i administratës shtetërore në vartësi të Ministrisë.
2. Shërbimi Sprovues është përgjegjës për kryerjen e punëve lidhur me:
   2.1. organizimin, zbatimin dhe mbikëqyrjen e ekzekutimit të dënimeve alternative dhe të riintegrimit shqëror të personave të dënuar (punët sprovuese);
   2.2. përgatitjen e anketës sociale dhe raportet parandëshkuese për kryerësit e veprave penale;
   2.3. vlerësimin e rrezikut kriminogjen dhe per caktimin e nevojave per trajtim të kryesve të veprave penale;
   2.4. Ekzekutimin e masave te diversitetit dhe masave edukative per te mitur;
   2.5. mbikëqyrjen dhe ndihmën ndaj personave të dënuar gjatë mbajtjes së dënimeve alternative;
   2.6. mbikëqyrjen dhe ndihmën ndaj kryerësve të varur nga droga, ose alkooli të cilët i nënshtrohen trajtimit të detyrueshëm rehabilitues i cili mbahet në liri;
   2.7. mbikëqyrjen dhe ndihmën ndaj personave të dënuar të liruar me kusht;
   2.8. Zhvillimi i programeve individuale të mbikëqyrjes;
   2.9. Hartimin e raporteve per ekzekutimin e denimeve alternative dhe personave te liruar me kusht nga burgu për Prokurorit, Gjykatat dhe Panelin për Lirim me Kusht;
   2.10. udhëzimin dhe mbështetjen ndaj personave të dënuar në përfundim të dënimit të tyre;

2.11. mbajtjen e evidencave dhe regjistrave per ekzekutimin e masave dhe denimeve alternative ne sistemin elektronik per menaxhimin e te dhenave;
2.12. ndonjë detyrë tjetër të përcaktuar nga Ministri.

3. Ministria e Drejtësisë dhe Shërbimi Sprovues në zbatimin e punëve sprovuese bashkëpunon me organet e pushtetit shtetëror, me institucionet shkencore dhe institucionet e tjera, me organet e pushtetit lokal dhe institucionet e tjera, personat juridik dhe shkëmben informata relevante.
4. Shërbimi Sprovues ka statusin e personit juridik.
5. Shërbimi Sprovues ka shenjën e vet identifikuese dhe ka selinë në Prishtinë.
6. Organizimi i brendshëm dhe sistematizimi i Shërbimit Sprovues dhe i zyret rajonale sprovuese rregullohet me akt të veçantë të cilin e miraton Ministri. Ky akt përfshihet si kre i veçantë në Rregulloren për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës të Ministrisë.

Neni 236
Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Sprovues

1. Shërbimin Sprovues e udhëheq Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit sprovues.
2. Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Sprovues emërohet me konkurs të hapur nga Ministria e Drejtësisë në pajtim me dipozitat për Shërbimin Civil për emërimin për pozitat e larta drejtuese në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës. Komisioni profesional vlerësues duhet të përbëhet nga profesionist përfaqësues të Ministrisë së Drejtësisë, Shërbimit Sprovues, Gjykatës së Apelit, Prokurorit të Shtetit dhe Fakultetit të Drejtësisë, drejtimi penalo juridik.
3. Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Sprovues emërohet për periudhë kohore pesë (5) vjeçare e me mundësi rizgjedhje.
4. Për punën e tij Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Sprovues i përgjigjet drejtpërdrejtë Ministrit.
5. Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Sprovues udhëheqë, drejton dhe kontrollon Shërbimin Sprovues dhe të gjitha çështjet lidhur me Shërbimin Sprovues.

Neni 237
Kushtet për emrimin e Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Sprovues

1. Detyrën e Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Sprovues mund ta ushtroj personi (kandidati), i cili i plotëson kushtet në vijim:
   1.1. të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
   1.2. të ketë përgatitje universitare;
   1.3. të ketë tetë (8) vite përvojë pune profesionale, prej të cilave së paku pesë (5) vite përvoj pune në vende udhëheqëse;
   1.4. të mos jetë anëtarë i ndonjë partie politike;
   1.5. të ketë reputacion moral dhe profesional, dhe të mos jetë i dënuar për vepër penale.

Neni 238
Struktura organizative e Shërbimit Sprovues

1. Për kryerjen e punëve dhe detyrave nga kompetenca e Shërbimit Sprovues themelohen këto njësi themelore organizative:
   1.1. Zyra Qëndrore e Shërbimit Sprovues me seli në Prishtinë; dhe
   1.2. Zyret rajonale sprovuese.
2. Organizimi i brendshëm dhe sistematizimi i Shërbimit Sprovues dhe të zyreve rajonale sprovues rregullohet me Rregulloren për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës të Shërbimit Sprovues të cilën e miraton Ministri dhe përfshihet në kre të veçantë të Rregullores së Ministrisë për organizimimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës të Ministrisë.
3. Zyra Qendrore e Shërbimit Sprovues e përcjell dhe mbikqyrë ligjshmërinë e punës dhe të veprimit të njësive organizative të Shërbimit Sprovues dhe të zyreve rajonale sprovuese.
4. Në Zyrën Qendrore të Shërbimit Sprovues, themelohen drejtoritë dhe sektoret. Me drejtorinë udhëheqin udhëheqësit, të cilët emrohen nga Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Sprovues.
5. Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Sprovues njëherit është edhe udhëheqës i Zyrës Qendrore të Shërbimit Sprovues.
6. Zyret regjionale sprovuese, të cilët kryejnë punët sprovuese në kuadër të përgjegjësive të Shërbimit Sprovues, themelohen me vendim të ministrit për territorin e gjykatave themelore. Zyrën rajonale sprovuese e udhëheqë udhëheqësi i zyrës i cili emërohet nga Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Sprovues me konkurs të hapur në pajtim me Ligjin për Shërbimin Civil.

Neni 239

1. Personeli i shërbimit Sprovues, për shkak të rrezikshmërisë, rëndësisë, si dhe kushteve të veçanta të punës, për çdo dymbëdhjetë (12) muaj pune i llogaritet si gjashtëmbëdhjetë (16) muaj stazh i siguruar, kurse në llogaritjen e pagave sigurohet një shtesë e të ardhurave.
2. Kategorizimi i personelit, të cilët do të realizojnë beneficionet e parapara në paragrafin 1. të këtij neni rregullohen me akt të veçantë nënligjor, të cilin e nxjerr Ministri i Drejtësisë**.**

KREU XXIV
MBIKËQYRJA E PUNËS SË INSTITUCIONEVE KORREKTUESE

Neni 240
Mbikëqyrja administrative

1. Mbikëqyrjen administrative të punës së institucioneve korrektuese e kryen Zyra Qendrore e Shërbimit Korrektues në pajtim me dispozitat ligjore.
2. Në zbatimin e mbikëqyrjes administrative, mbikëqyret në veçanti ligjshmëria e punës dhe e veprimit, ligjshmëria e akteve nga kompetenca e drejtorit të

institucionit korrektues, efikasiteti dhe përshtatshmëria e punës në kryerjen e punëve nga fushëveprimi i institucioneve korrektuese.

3. Mbikëqyrjen lidhur me ofrimin e mbrojtjes shëndetësore të personave të burgosur e kryen ministria e kompetente për punët e shëndetësisë, ndërsa ndaj programeve të arsimimit të personave të dënuar dhe për zbatimin e tyre ministria kompetente për punët e arsimit.

Neni 241
Këshilli profesional

Me qëllim të përcjelljes, hulumtimit dhe përparimit të sistemit të ekzekutimit të sanksioneve penale do të themelojë këshillin profesional nga radhët e institucioneve shkencore, gjykatave, organeve të administratës, shoqatave profesionale, shoqërisë civile dhe të institucioneve tjera të cilat merren me çështjet e kriminalitetit dhe të edukimit të personave të dënuar.

Neni 242
Inspektimi i brendshëm i institucioneve korrektuese

1. Ministri themelon Inspektoratin për mbikëqyrjen e punës së institucioneve korrektuese (më tej: Inspektorati).
2. Inspektorati është strukturë e veçantë organizative dhe vepron në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë. Inspektoratin e udhëheqë Kryeinspektori.
3. Emërimi dhe shkarkimi i Kryeinspektorit dhe inspektorëve bëhet në pajtim me rregullat e Ligjit për Shërbimin Civil për pozitat e nivelit drejtues.
4. Aktivitetet e inspektimit sipas këtij ligji dhe akteve nënligjore të nxjerra për zbatimin e tij, e bënë Ministria përmes inspektorëve.
5. Kryeinspektor mund të zgjidhet personi i cili ka përgatitje universitare dhe ka së paku shtatë (7) vite përvojë pune, katër (4) vite përvojë pune në vende udhëheqëse.
6. Inspektor mund të zgjidhet, personi i cili ka përgatitje universitare dhe ka së paku tri (3) vite përvojë pune relevante.

Neni 243
Të drejtat dhe detyrat e inspektorëve

1. Ministria mbikëqyrë zbatimin e dispozitave dhe të punës profesionale të punës së insititucioneve korrektuese me qëllim të sigurimit të sistemit unik të ekzekutimit të sanksioneve penale, bartjen e përvojave, pozitive, analizimit dhe të përcjelljes së punës së disa njësive organizative të institucionit korrektues dhe të ofrimit të ndihmës profesionale atyre njësive.
2. Inspektori bënë mbikëqyrjen e zbatimit të dispozitave të këtij Ligji, akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij dhe ka autorizim:
   2.1. të hyj në çdo kohë dhe pa paralajmërim në të gjitha hapësirat dhe lokalet e Shërbimit Korrektues me qëllim të inspektimit;
   2.2. të urdhëroj që lëshimet dhe të metat e konstatuara të eliminohen në afatin të cilin ai e cakton;
   2.3. të verifikoj secilin rast veç e veç, çdo herë kur dyshohet për shkelje ligjore.

Inspektori inicion procedurën qoftë sipas detyrës zyrtare, apo me iniciativën e personit të interesuar;

2.4. t'u rekomandoj subjekteve përgjegjëse ndërmarrjen e masave disiplinore në pajtim me strukturën hierarkike.

3. Subjekti të cilit i është urdhëruar eliminimi i të metave dhe parregullsive sipas paragrafit 2. nënparagrafi 2.2. të këtij neni, është i detyruar që pas eliminimit të të metave dhe parregullsive të lajmëroj inspektorin në afatin e caktuar nga inspektori dhe i cili nuk mund të jetë më i gjatë se tetë (8) ditë.
4. Inspektori është i detyruar që:
   4.1. të hartoj procesverbal lidhur me kryerjen e mbikëqyrjes inspektuese;
   4.2. të ruaj si sekret të gjitha shënimet për të cilat njoftohet gjatë kryerjes së punëve inspektuese, e që me aktet e brendshme konsiderohen si konfidenciale. Zbulimi i këtyre informatave bëhet vetëm para autoriteteve të përcaktuara me ligj;
   4.3. të hartoj raporte të rregullta për Sekretarin e Përhershëm dhe të paktën një herë në tre (3) muaj për Ministrinë e Drejtësisë lidhur me të gjeturat e tij.
5. Mbikëqyrjen e punës së institucioneve korrektuese lidhur me kontrollin e punës financiare, marrëdhënies së punës, mbrojtjes në punë, mbrojtjes shëndetësore dhe sanitare të përsonave të dënuar dhe të paraburgosur, të kushteve dhe të mënyrës së pranimit të ushqimit e kryejnë organet e autorizuara në pajtim me dispozitat e veçanta.

Neni 244
Pavarësia dhe paanshmëria

1. Inspektorët në kryerjen e detyrës së tyre janë të pavarur dhe të paanshëm nga çdo ndërhyrje e cila mund të ndikoj në mënyrë të drejtpërdrejtë, apo të tërthortë.
2. Inspektorët duhet të kryejnë detyrën e tyre me aftësi profesionale e me përgjegjësi të plotë dhe janë të lirë nga çfarëdo ndërhyrje që mund të ndikoj në gjykimin e drejtë të tyre, ose në rezultatin e kontrollit.
3. Në kryerjen e detyrave të mbikëqyrjes inspeksionale, inspektori është i pavarur dhe ndërmerr veprime në bazë të ligjit dhe të dispozitave tjera. Për shkak të rrezikshmërisë, rëndësisë, si dhe kushteve të veçanta të punës, Ministri me vendim përcakton shumën shtesë në të ardhura personale për inspektorët.
4. Gjithashtu përmes inspektimit bëhet vlerësimi vjetorë i secilit institucioni korrektues përmes:
   4.1. përcaktimit nëse veprimet janë kryer në mënyrë efektive, në veçanti ato lidhur me procedurat e pranimit, zbatimin e dënimeve disiplinore, çështjet e sigurisë, sigurimit të shërbimeve shëndetësore, mjekësore dhe sigurimit të ndihmës edukative dhe shoqërore;
   4.2. shqyrtimit të besueshmërisë së informacioneve financiare dhe atyre drejtuese;
   4.3. vërtetimit, nëse pasuritë që i takojnë Shërbimit Korrektues të Kosovës kontrollohen dhe sigurohen nga humbjet, në veçanti mirëmbajtja dhe pastërtia e objekteve;
   4.4. vlerësimit të shfrytëzimit efektiv të burimeve njerëzore;
   4.5. mbikëqyrjes nëse janë arritur objektivat e përcaktuara të programeve.

5. Aktin nënligjor për mënyrën e kryerjes së mbikëqyrjes inspeksionale për punën e institucioneve korrektuese e nxjerrë Ministri.

Neni 245

1. Në kryerjen e mbikëqyrjes, drejtori i institucionit korrektues dhe të gjithë të punësuarit janë të detyruar që të bashkëpunojnë me inspektorët në plotësimin e autorizimeve dhe detyrimeve të tyre, të vë në disponim të tërë dokumentacionin dhe të dhënat e nevojshme dhe t`iu mundësojë punë të papengueshme.
2. Në zbatimin e mbikëqyrjes, inspektorët mund të bisedojnë me personat e dënuar pa prezencën e punëtorëve të institucionit korrektues, si dhe me të gjithë të punësuarit në institucionin korrektues pa prezencën e udhëheqësve të tyre të drejtpërdrejtë, apo të udhëheqësit të institucionit korrektues.
3. Kur vlerëson se kjo është e nevojshme, inspektori mundet personave nga paragrafi 2. i këtij neni t'iu merr deklaratë në procesverbal.

Neni 246

1. Procesverbal lidhur me kryerjen e mbikëqyrjes inspektuese i dërgohet Ministrit, Drejtorit të Përgjithshëm dhe Drejtorit të Institucionit Korrektues ku është kryer mbikëqyrja inspeksionale.
2. Institucioni korrektues është i detyruar që të veprojë sipas masave të urdhëruara dhe afateve të dhëna dhe për atë me shkrim ta informojë Inspektoratin.
3. 3.Në masat e urdhëruara dhe afatet e dhëna drejtori i Institucionit Korrektues mund t'i paraqet Ministrit kundërshtim kundër masave të urdhëruara, në afat prej tet (8)ditësh nga data e pranimit të procesverbalit. Kundërshtimi nuk e shtynë ekzekutimin e masave të urdhëruara.
4. Në pajtim me theksimet nga kundërshtimi Ministri mund të ndalojë apo të caktojë afate tjera për ekzekutimin e masave të urdhëruara apo të urdhërojë masa tjera për menjanimin e të metave të vërejtura.
5. Kundërshtimi e shtynë ekzekutimin e masave të urdhëruara përpos në rastin kur në raport është vlerësuar se në atë mënyrë nuk mënjanohet rreziku i drejtpërdrejtë për jetën dhe shëndetin apo të pasurisë dhe kur kjo është në interes të sigurisë së Institucionit Korrektues.

Neni 247

1. Në qoftë se në procedurën e mbikëqyrjes vërtetohet se Institucioni korrektues nuk i plotëson kushtet e parapara shëndetësore dhe higjienike apo nëse qenësisht është rrezikuar siguria, Ministri mund të nxjerr vendim për ndërprerjen e përkohshme të punës së Institucionit korrektues dhe të zbatojë transferimin të përsonave të dënuar apo të personave në paraburgim në institucion tjetër korrektues.
2. Nëse në Institucionin korrektues është prishë siguria, Ministri mund të shkarkojë nga detyra drejtorin e Institucionit korrektues dhe përkohësisht të caktojë personin tjetër i cili do të kryej punët e drejtorit të Institucionit korrektues.

Neni 248

1. Mbikëqyrjen lidhur me mbrojtjen dhe gjendjen e të drejtave njerëzore dhe të kushteve në të cilat ekzekutohen sanksionet penale dhe masat e tjera të shqiptuara në procedurën penale, e kryen zyrtari për të drejtat e të burgosurve i Zyrës për të Drejtat e Njeriut të Ministrisë.
2. Zyrtari për të drejtat e të burgosurve kryen mbikëqyrjen lidhur me mbrojtjen dhe gjendjen e drejtave të njeriut dhe të kushteve nën të cilat ekzekutohen sanksionet penale dhe masat e tjera të shqiptuara në procedurën penale në institucionet korrektuese në mënyrë të pavarur, apo në bashkëpunim me inspektorët kompetent, apo me institucionet ndërkombëtare, apo të institucioneve tjera të cilat janë kompetente për përcjelljen dhe realizimin e drejtave njerëzore dhe të lirive themelore, në pajtim me Ligjin dhe me dokumentet përkatëse ndërkombëtare.
3. Zyrtari për të drejtat e të burgosurve është i pavarur në punën e vet, organet kompetente dhe institucionet janë të detyruar që të sigurojnë të gjitha të dhënat me rëndësi për punën e saj.
4. Zyrtari për të drejtat e të burgosurve, për punën e vet iu paraqet raport, Udhëheqësit të Zyrës për të Drejtat e Njeriut në Minisitrinë e Drejtësisë dhe Sekretarit të Përgjithshëm.

PJESA E GJASHTË
DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

KREU XXV
DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 249
Aktet nënligjore

1. Ministri nxjerrë aktet nënligjore për zbatimin e këtij ligji brenda dymbëdhjetë (12) muajve pas hyrjes në fuqi të ligjit.
2. Deri në nxjerrjen e akteve nënligjore të parapara me këtë ligj, zbatohen dispozitat e nxjerra sipas dispozitave ekzistuese, në qoftë se nuk janë në kundërshtim me këtë ligj.
3. Ministri i Arsimit me pëlqimin e Ministrit të Drejtësisë në afat prej gjashtë (6) muajsh nga hyrja në fuqi e këtij ligji, nxjerr aktin nënligjor me të cilin rregullohet arsimimi i personave të dënuar (neni 83 paragrafi 7).

Neni 250

Ekzekutimi i dënimeve të filluara para datës së hyrjes në fuqi të këtij ligji, por të cilat nuk janë përfunduar deri në atë datë vazhdohen dhe përfundohen në pajtim me dispozitat e këtij ligji, përveç nëse dispozitat e ligjit në fuqi janë më të favorshme për personin e dënuar.

Neni 251

Pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, nëse periudha e parashikuar kohore është duke rrjedhur, kjo periudhë llogaritet në pajtim me dispozitat e këtij ligji, përveç nëse periudha e mëparshme ka qenë më e gjatë, apo nëse me dispozitat e këtij Kreu përcaktohet ndryshe.

Neni 252

1. Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, institucionet korrektuese në Republikën e Kosovës vazhdojnë me punën, dhe atë:
   1.1. Qendra Korrektuese Dubravë-institucion korrektues i tipit të mbyllur;
   1.2. Qendra Korrektuese Lipjan- institucion korrektues i tipit gjysmë të hapur;
   1.3. Qendra korrektuese Smrekovicë- institucion korrektues i tipit të hapur;
   1.4. Burgu i Sigurisë së Lart – institucion Korrektues i tipit të mbyllur me siguri fizike dhe teknike në maksimum.
   1.5. Qendra e Paraburgimit Lipjan-institucion korrektues i tipit të mbyllur gjysmë të hapur;
   1.6. Qendra e Paraburgimit Prishtinë-institucion korrektues i tipit të mbyllur;
   1.7. Qendra e Paraburgimit Prizren-institucion korrektues i tipit të mbyllur;
   1.8. Qendra e Paraburgimit Gjilan- institucion korrektues i tipit të mbyllur;
   1.9. Qendra e Paraburgimit Pejë-institucion korrektues i tipit të mbyllur;
   1.10. Qendra e Paraburgimit Mitrovicë-institucion korrektues i tipit të mbyllur.

Neni 253
Dispozitat shfuqizuese

Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, pushon të vlejë Ligji për ekzekutimin e sanksioneve penale Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 79/2010, dhe Ligji për organizimin dhe afarizmin e njësive ekonomike të institucioneve për ekzekutimin e sanksioneve penale ("Gazeta zyrtare e KSAK", nr. 46/77).

Neni 254
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ligji Nr. 04/L-149
29 korrik 2013

Shpallur me dekretin Nr. DL-035-2013, datë 16.08.2013 nga Presidentja e Republikës së Kosovës Atifete Jahjaga.

GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS / Nr. 31 / 28 GUSHT 2013, PRISHTINË

LIGJI Nr. 04/L-140
PËR KOMPETENCAT E ZGJERUARA PËR KONFISKIMIN E PASURISË SË PËRFITUAR ME VEPËR PENALE

Përmbajtja

Kapitulli I: Dispozitat e përgjithshme 636
Kapitulli II: Kompetencat e zgjeruara të konfiskimit 638
Kapitulli III: Ekzekutimi dhe administrimi i pasurisë së konfiskuar 642
Kapitulli IV: Dispozitat kalimtare 643

Kuvendi i Republikës së Kosovës;

Në bazë të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton

LIGJ PËR KOMPETENCAT E ZGJERUARA PËR KONFISKIMIN E PASURISË SË PËRFITUAR ME VEPËR PENALE

KAPITULLI I
DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

Ky ligj përcakton kompetencat e zgjeruara për konfiskimin e pasurisë së fituar nga personat që kanë kryer vepër penale, kur procedurat e përcaktuara në Kodin e Procedurës Penale nuk janë të mjaftueshme.

Neni 2
Fushëveprimi

Dispozitat e këtij ligji zbatohen për pasurinë e fituar nga personat të cilët kanë kryer vepër penale të paraparë me Kodin Penal të Republikës së Kosovës.

Neni 3
Përkufizimet

1. Për qëllime të këtij ligji, shprehjet e mëposhtme kanë këto kuptime:
   1.1. **Agjenci** - Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar ose të Konfiskuar.

1.2. **Ministri** - Ministria e Drejtësisë.
1.3. **Konfiskim** - konfiskimi i përhershëm i pasurisë, të urdhëruar me vendim të formës së prerë nga Gjykata kompetente apo organi tjetër kompetent në pajtim me ligjin në fuqi.
1.4. **Kompetencat e zgjeruara të konfiskimit** - masat për konfiskimin e pasurisë sipas procedurës së përcaktuar në këtë ligj.
1.5. **Pasuria që i nënshtrohet kompetencave të zgjeruara të konfiskimit** - pasuria që është në pronësi të të pandehurit ose që mbahet në emër të të pandehurit, e cila i nënshtrohet urdhrit ndalues nga neni 265 i Kodit të Ndryshuar të Procedurës Penale të Kosovës ose e cila i nënshtrohet konfiskimit të përkohshëm nga neni 267 i Kodit të Ndryshuar të Procedurës Penale të Kosovës.
1.6. **Blerësi *bona fide*** - personi i cili ka blerë pasurinë nga i pandehuri apo personi i dënuar pas pagesës së një çmimi të arsyeshëm të tregut për atë pasuri, duke marr parasysh nenin 97.2 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Neni 4
Vendimi i Gjykatës për zbatimin e këtij ligji

1. Prokurori i shtetit kërkon nga Gjykata në procedurë penale që të zbatojë kompetencat e zgjeruara të konfiskimit nga ky ligj vetëm nëse ai mund të provojë kushtet nga neni 6, neni 7 ose neni 8 i këtij ligji.
2. Gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues vendos nëse Prokurori i shtetit ka provuar se kushtet nga neni 6, neni 7 dhe neni 8 i këtij ligji janë të zbatueshme.
3. Gjykata mund të zbatojë kompetencat e zgjeruara të konfiskimit vetëm nëse Prokurori i shtetit ka provuar kushtet nga neni 6, neni 7 dhe neni 8 i këtij ligji.
4. Në kërkesën e Prokurorit të shtetit duhet të përshkruhet çdo pasuri që i nënshtrohet kompetencave të zgjeruara të konfiskimit me saktësi të mjaftueshme për identifikimin e qartë të pasurisë.

Neni 5
Zbatimi i kompetencave të zgjeruara të konfiskimit

1. Pasuria që i nënshtrohet kompetencave të zgjeruara të konfiskimit të cilat nuk janë dobi pasurore nga vepra penale e përshkruar në aktakuzë mund t'i nënshtrohen konfiskimit nga neni 6 i këtij ligji.
2. Pasuria që i nënshtrohet kompetencave të zgjeruara të konfiskimit, e cila është fituar nga i pandehuri i cili ka vdekur mund t'i nënshtrohet konfiskimit nga neni 7 i këtij ligji.
3. Pasuria që i nënshtrohet kompetencave të zgjeruara të konfiskimit, e cila është fituar nga i pandehuri i cili është larguar nga Republika e Kosovës mund t'i nënshtrohet konfiskimit nga neni 8 i këtij ligji.
4. Dispozitat e këtij ligji mund të zbatohen për pasurinë e cila i është bartur palës tjetër nga personi i cili është apo bëhet i pandehur apo i dënuar. Pala tjetër ka të drejtë për të provuar se është blerës *bona fide* i pasurisë. Pasuria nuk mund të konfiskohet nga blerësi *bona fide* i asaj pasurie.

KAPITULLI II
KOMPETENCAT E ZGJERUARA TË KONFISKIMIT

Neni 6
Kushtet për konfiskimin e pasurisë së fituar nga aktiviteti kriminal

1. Brenda tridhjetë (30) ditësh nga aktgjykimi i formës së prerë me të cilin i pandehuri shpallet fajtor për vepër penale nga Kapitujt XV, XXIII, XXIV, XXV ose XXXIV të Kodit Penal, dhe nëse Prokurori i shtetit mund, në një kërkesë tjetër paraqitur Gjyqtarit të vetëm gjykues apo kryetarit të trupit gjykues, të ofrojë prova për të treguar shkak të bazuar se:
   1.1. i pandehuri ka fituar pasuri tjera që nuk kanë qenë dobi pasurore nga ato vepra penale, për të cilat i pandehuri është dënuar;
   1.2. pasuritë tjera janë marrë pas 31 dhjetorit 1999;
   1.3. të hyrat legjitime të të pandehurit kanë qenë të pamjaftueshme për të mundësuar blerjen e atyre pasurive tjera;
   1.4. i pandehuri ka qenë i përfshirë në sjellje të ngjashme me ato për të cilat është shpallur fajtor; dhe
   1.5. sjellja nga nënparagrafi 1.4. i këtij paragrafi do të mundësonte blerjen e atyre pasurive tjera.
2. Nëse kërkesa nga Prokurori i shtetit sipas paragrafit 1. të këtij neni nuk vërteton shkakun e bazuar nga nënparagrafi 1.1., 1.2. ose 1.3. i paragrafit 1. të këtij neni, Gjykata nxjerr vendim të arsyetuar me të cilin e refuzon kërkesën. Në të kundërtën, Gjykata i dërgon të pandehurit kopjen e kërkesës.
3. I pandehuri ka të drejtë të ketë mbrojtës gjatë procedurës sipas këtij neni.
4. Personi i dënuar ka afat prej tridhjetë (30) ditësh pas pranimit të kopjes së kërkesës së Prokurorit të shtetit për të paraqitur prova që pasuria është blerë nga të ardhurat legjitime.
5. Për ndonjë pasuri të përvetësuar nga personi i dënuar para periudhës së kohës së veprës penale për të cilën ai është dënuar, personi i dënuar mund të paraqesë prova se shënimet kadastrale ose dokumentet tjera të cilat mund të dëshmojnë se pasuritë janë blerë me të ardhura të ligjshme nuk është në dispozicion apo nuk është e besueshme.
6. Gjyqtari i vetëm gjykues apo trupi gjykues mban shqyrtimin në të cilin:
   6.1. të pandehurit i lejohet që të shqyrtojë provat që mbështesin kërkesën e Prokurorit të shtetit nga paragrafi 1. i këtij neni;
   6.2. Prokurorit të shtetit i lejohet që të shqyrtojë provat e paraqitura nga i pandehuri sipas paragrafit 4. dhe 5. të këtij neni;
   6.3. Pala tjetër ka të drejtë për të provuar se është blerës *bona fide* i pasurisë, në pajtim me nenin 5. paragrafin 4. të këtij ligji.
7. Nëse Gjykata çmon se pasuria është fituar nga aktiviteti i ngjashëm me veprimet kriminale për të cilat i pandehuri është shpallur fajtor, Gjykata nxjerr aktgjykim të arsyetuar, në të cilin:
   7.1. përcakton se pasuria është fituar brenda periudhës së njëjtë kohore me veprat penale për të cilat i pandehuri është shpallur fajtor;
   7.2. përcakton se të ardhurat legjitime të të pandehurit kanë qenë të pamjaftueshme për të bërë blerjen e asaj pasurie;

7.3. përcakton se i pandehuri ka qenë i përfshirë në sjellje të ngjashme me ato për të cilat është shpallur fajtor;
7.4. përcakton se sjelljet e tilla do të mundësonin blerjen e asaj pasurie;
7.5. përcakton se i pandehuri kishte mundësi për të treguar se pasuritë janë fituar me anë të të ardhurave të ligjshme;
7.6. përcakton se i pandehuri nuk ka provuar se pasuria është fituar nga të ardhurat legjitime;
7.7. përcakton se konfiskimi i pasurisë nuk do të shkaktonte padrejtësi;
7.8. përcakton llojin e pasurisë dhe vlerën monetare të saj;
7.9. urdhëron që pasuria apo të drejtat pronësore të kalojnë në pronësi të Republikës së Kosovës apo të palës së dëmtuar, siç është e përshtatshme;
7.10. detyron palët tjera t'ia dorëzojnë pasurinë Republikës së Kosovës apo palës së dëmtuar, siç është e përshtatshme, nëse nuk janë dorëzuar në pajtim me nënparagrafin 7.9. të këtij paragrafi, ose për të paguar vlerën monetare të pasurisë brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita kur aktgjykimi merr formën e prerë; dhe
7.11. urdhëron që në regjistrat publik të Gjykatës apo organit tjetër të bëhen ndryshimet përkatëse të së drejtës pronësore në emër të Republikës së Kosovës apo palës së dëmtuar, siç është e përshtatshme.

8. Kundër aktgjykimit nga paragrafi 7. i këtij neni lejohet ankesë.

Neni 7
Kushtet kur mund të konfiskohet pasuria në pronësi të të pandehurit i cili ka vdekur

1. Kur procedura penale nuk mund të vazhdohet për shkak të vdekjes së të pandehurit sipas nenit 160 të Kodit të Ndryshuar të Procedurës Penale, por pasuria i nënshtrohet urdhrit ndalues nga neni 265 i Kodit të Ndryshuar të Procedurës Penale, konfiskimit të përkohshëm nga neni 267 i Kodit të Ndryshuar të Procedurës Penale, apo nëse është ngritur aktakuzë në të cilën ceket pasuria që i nënshtrohen konfiskimit nga neni 241, paragrafi 1., nënparagrafi 9. i Kodit të Ndryshuar të Procedurës Penale, Gjykata në bazë të propozimit të Prokurorit të shtetit apo të të dëmtuarit mund të vazhdojë procedurën e konfiskimit nga ky ligj nëse:
   1.1. vlera e pasurisë që i nënshtrohet konfiskimit tejkalon njëmijë (1.000) Euro; dhe
   1.2. vazhdimi i procedurës është në interes të drejtësisë.
2. Gjykata merr vendim për të vazhduar procedurën e konfiskimit pavarësisht vdekjes së të pandehurit dhe cek arsyet përse procedura penale kundër të pandehurit nuk mund të fillohet apo vazhdohet, vlerën e pasurisë që i nënshtrohet konfiskimit dhe arsyet përse është në interes të drejtësisë për të vazhduar procedurën e konfiskimit.
3. Nëse trashëgimtarët ligjor të të pandehurit të vdekur nuk kanë angazhuar mbrojtës, Gjykata cakton ose vazhdon autorizimin e mbrojtësit për të përfaqësuar interesat e të pandehurit të vdekur. Mbrojtësi vepron në interesin më të mirë të trashëgimtarëve ligjor të të pandehurit të vdekur.
4. Nëse nuk është ngritur aktakuzë, Prokurori ka afat njëqind e tetëdhjetë (180) ditë nga dita e vendimit të Gjykatës nga paragrafi 2. i këtij neni për të ngritur aktakuzë

kundër të pandehurit të vdekur *ex relatione* për pasurinë që i nënshtrohet konfiskimit. Aktakuza paraqitet përshtatshmërisht në pajtim me Kapitullin XV të Kodit të Ndryshuar të Procedurës Penale.

5. Nëse aktakuza është ngritur para vdekjes së të pandehurit, ose nëse aktakuza është ngritur sipas paragrafit 3. të këtij neni, Gjykata mban shqyrtimin gjyqësor në pajtim me Kapitullin XIX të Kodit të Ndryshuar të Procedurës Penale.
6. Gjykata merr parasysh vetëm ato pika të aktakuzës të cilat mbështesin konfiskimin e pasurisë.
7. Gjykata merr parasysh të drejtën e palës tjetër për të provuar se është blerës *bona fide* i pasurisë, në pajtim me nenin 5. paragrafin 4. të këtij ligji.
8. Nëse Gjykata çmon se i pandehuri ka kryer vepër penale dhe se pasuria që i nënshtrohet konfiskimit është dobi pasurore e fituar nga vepra penale, Gjykata nxjerr aktgjykim në të cilin:
   8.1. përcakton se i pandehuri ka kryer vepër penale;
   8.2. përcakton se pasuria është fituar nga kryerja e veprës penale nga nënparagrafi 8.1 i këtij paragrafi;
   8.3. përcakton llojin e pasurisë dhe vlerën monetare të saj;
   8.4. urdhëron që pasuria apo të drejtat të kalojnë në pronësi të Republikës së Kosovës apo të palës së dëmtuar, siç është e përshtatshme;
   8.5. detyron palët tjera t'ia dorëzojnë pasurinë Republikës së Kosovës apo palës së dëmtuar, siç është e përshtatshme, nëse nuk janë dorëzuar në pajtim me nënparagrafin 8.4 të këtij paragrafi, ose për të paguar vlerën monetare të pasurisë brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita kur aktgjykimi merr formën e prerë; dhe
   8.6. urdhëron që në regjistrat publik të Gjykatës apo organit tjetër të bëhen ndryshimet përkatëse të së drejtës pronësore në emër të Republikës së Kosovës apo palës së dëmtuar, siç është e përshtatshme.
9. Kundër aktgjykimit sipas paragrafit 8. të këtij neni, lejohet ankesë.

Neni 8
Kushtet kur mund të konfiskohet pasuria në pronësi të të pandehurit në arrati

1. Nëse Prokurori i shtetit mund të pezullon hetimin nga neni 157 i Kodit të Ndryshuar të Procedurës Penale, por nëse pasuria është e cekur në urdhrin ndalues nga neni 265 i Kodit të Ndryshuar të Procedurës Penale apo nëse i është nënshtruar konfiskimit të përkohshëm nga neni 267 i Kodit të Ndryshuar të Procedurës Penale, Prokurori i shtetit vazhdon procedurën penale kundër të pandehurit nëse:
   1.1. Prokurori i shtetit ka dyshim të bazuar se i pandehuri është në arrati;
   1.2. vlera e pasurisë që i nënshtrohet konfiskimit është më e lartë se pesëmijë (5.000) Euro; dhe
   1.3. vazhdimi i procedurës është në interes të drejtësisë.
2. Nëse është ngritur aktakuzë në të cilën ceket pasuria që i nënshtrohet konfiskimit nga neni 241, paragrafi 1., nënparagrafi 9 i Kodit të Ndryshuar të Procedurës Penale, dhe i pandehuri sipas kësaj aktakuze është në arrati apo arratiset, Gjykata në bazë të propozimit të Prokurorit të shtetit mund të vazhdojë procedurën penale nëse:
   2.1. Prokurori i shtetit ka dyshim të bazuar se i pandehuri është në arrati;

2.2. Vlera e pasurisë që i nënshtrohet konfiskimit është më e lartë se pesëmijë (5.000) Euro; dhe
2.3. vazhdimi i procedurës është në interes të drejtësisë.

3. Gjykata merr vendim për vazhdimin e procedurës penale dhe përshkruan arsyet për dyshimin e bazuar që i pandehuri është në arrati, vlerën e pasurisë që i nënshtrohet konfiskimit dhe arsyet se përse është në interes të drejtësisë për të vazhduar procedurën penale.
4. Gjykata cakton ose vazhdon autorizimin e mbrojtësit për të përfaqësuar interesat e të pandehurit.
5. Nëse nuk është ngritur aktakuzë, Prokurori ka afat njëqind e tetëdhjetë (180) ditë nga dita e vendimit të Gjykatës nga paragrafi 3. i këtij neni për të ngritur aktakuzë kundër të pandehurit të arratisur *ex relatione* për pasurinë që i nënshtrohet konfiskimit. Aktakuza paraqitet përshtatshmërisht në pajtim me Kapitullin XV të Kodit të Ndryshuar të Procedurës Penale.
6. Nëse aktakuza është ngritur sipas paragrafit 2. të këtij neni, Gjykata zbaton shqyrtimin gjyqësor në pajtim me Kapitullin XIX të Kodit të Ndryshuar të Procedurës Penale.
7. Gjykata merr parasysh vetëm ato pika të aktakuzës të cilat mbështesin konfiskimin e pasurisë.
8. Gjykata merr parasysh të drejtën e palës tjetër për të provuar se është blerës *bona fide* i pasurisë, në pajtim me nenin 5. paragrafin 4. të këtij ligji.
9. Nëse Gjykata çmon se i pandehuri ka kryer vepër penale dhe se pasuria që i nënshtrohet konfiskimit është dobi pasurore e fituar nga vepra penale, gjykata nxjerr aktgjykim në të cilin:
   9.1. përcakton se i pandehuri ka kryer vepër penale;
   9.2. përcakton se pasuria është fituar nga kryerja e veprës penale nga nënparagrafi 9.1 i këtij paragrafi;
   9.3. përcakton llojin e pasurisë dhe vlerën monetare të saj;
   9.4. urdhëron që pasuria apo të drejtat të kalojnë në pronësi të Republikës së Kosovës apo të palës së dëmtuar, siç është e përshtatshme;
   9.5. detyron palët tjera t'ia dorëzojnë pasurinë Republikës së Kosovës apo palës së dëmtuar, siç është e përshtatshme, nëse nuk janë dorëzuar në pajtim me nënparagrafin 9.4 të këtij paragrafi, ose për të paguar vlerën monetare të pasurisë brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita kur aktgjykimi merr formën e prerë; dhe
   9.6. urdhëron që në regjistrat publik të Gjykatës apo organit tjetër të bëhen ndryshimet përkatëse të së drejtës pronësore në emër të Republikës së Kosovës apo palës së dëmtuar, siç është e përshtatshme.
10. Kundër aktgjykimit nga paragrafi 9. i këtij neni lejohet ankesa.
11. I pandehuri ka të drejtë absolute për t'u gjykuar sërish nga një trup tjetër gjykues pasi të mos jetë më në arrati; sidoqoftë, aktgjykimi nga paragrafi 9. i këtij neni nuk rishikohet pasi të ketë marrë formën e prerë. Vendimi nga paragrafi 9. i këtij neni nuk është i pranueshëm në gjykimin *in personam* të të pandehurit.

Neni 9
Shfrytëzimi i urdhrit ndalues ose konfiskimit të përkohshëm gjatë pezullimit të hetimit

1. Nëse Prokurori i shtetit merr aktvendim për pezullimin e hetimit nga neni 157 i Kodit të Ndryshuar të Procedurës Penale, por nëse gjatë procedurës penale pasuria është ndaluar me urdhër ndalues nga neni 265 i Kodit të Ndryshuar të Procedurës Penale apo nëse i është nënshtruar konfiskimit të përkohshëm nga neni 267 i Kodit të Ndryshuar të Procedurës Penale, Prokurori i shtetit kërkon nga gjyqtari i procedurës paraprake për të vazhduar apo ndërprerë urdhrin ndalues apo konfiskimin e përkohshëm. Gjyqtari i procedurës paraprake autorizon urdhrin ndalues ose konfiskimin e përkohshëm kundër të pandehurit për gjashtë (6) muaj nëse:
   1.1. Prokurori i shtetit ka shkak të bazuar se i pandehuri ka kryer veprën penale dhe pasuria është e fituar me atë vepër penale;
   1.2. vlera e pasurisë që i nënshtrohet konfiskimit është më e lartë se dhjetëmijë (10,000) Euro; dhe
   1.3. vazhdimi i procedurës është në interes të drejtësisë.
2. Prokurori i shtetit mund të përsërisë kërkesën në Gjykatë edhe njëherë për gjashtë (6) muaj.
3. Nëse Prokurori i shtetit nuk rifillon hetimin deri në skadim të autorizimit të Gjykatës nga paragrafi 1. ose 2. i këtij neni, mbrojtësi i të pandehurit mund të kërkojë nga Gjyqtari i procedurës paraprake për të pushuar urdhrin ndalues ose konfiskimin e përkohshëm.

KAPITULLI III
EKZEKUTIMI DHE ADMINISTRIMI I PASURISË SË KONFISKUAR

Neni 10
Ekzekutimi i vendimeve të gjykatës lidhur me pasurinë e konfiskuar

Pasuria, konfiskimi i së cilës është urdhëruar me aktgjykim me shkrim të Gjykatës nga neni 370 i Kodit të Ndryshuar të Procedurës Penale apo me aktvendim të Gjykatës nga neni 6, 7 ose 8 i këtij ligji, zbatohet në pajtim me Kapitullin XXVIII të Kodit të Procedurës Penale.

Neni 11
Shpenzimet e procedurës

1. Shpenzimet e procedurës përfshijnë shpenzimet për sekuestrimin, konfiskimin, administrimin, tarifën e mbrojtësit dhe shpenzimet tjera të arsyeshme.
2. Në pajtim me këtë ligj, shpenzimet për sekuestrimin parapaguhen nga Qeveria dhe paguhen nga personi kundër të cilit është urdhëruar sekuestrimi i pasurisë.
3. Në vendimin përfundimtar lidhur me kërkesën për konfiskim, Gjykata përcakton detyrimin për pagesën e shpenzimeve të parapaguara nga Qeveria.
4. Shpenzimet e parapaguara nga Qeveria nuk paguhen prej personit nga paragrafi 2. i këtij neni nëse Gjykata shqipton masën e konfiskimit.

5. Për ankesat lidhur me shpenzimet e procedurës vendos Gjykata e cila ka nxjerr aktvendimin.

KAPITULLI IV
DISPOZITAT KALIMTARE

Neni 12
Aktet nënligjore

Aktet nënligjore për zbatimin e këtij ligji miratohen brenda gjashtë (6) muajsh nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

Neni 13
Shfuqizimi i dispozitave

Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, shfuqizohen dispozitat të cilat janë në kundërshtim me këtë ligj.

Neni 14
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ligji Nr. 04/L-140
11 shkurt 2013

Shpallur me dekretin Nr.DL-002-2013, datë 26.02.2013 nga Presidentja e Republikës së Kosovës Atifete Jahjaga.

GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS / Nr. 5 / 8 MARS 2013, PRISHTINË

LIGJI Nr. 04/L-043
PËR MBROJTJEN E INFORMATORËVE

Kuvendi i Republikës së Kosovës

Në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton:

LIGJ PËR MBROJTJEN E INFORMATORËVE

Neni 1
Fushëveprimi dhe qëllimi

Qëllimi i këtij ligji është krijimi i bazës ligjore për cytjen e zyrtarëve për paraqitjen e veprimeve kundërligjore.

Neni 2
Përkufizimet

1. Shprehjet e përdorura në këtë ligj kanë këtë kuptim:
   1.1. **Informator** - çdo person, i cili si qytetar apo i punësuar, informon në mirëbesim autoritetin përkatës brenda institucioneve publike në nivelin qendror apo lokal, institucione, ndërmarrje publike apo private për çdo dyshim të arsyeshëm për ekzistimin e veprimit kundërligjor;
   1.2. **Institucionet publike në nivelin qendror dhe lokal -** janë:
      1.2.1. Institucionet e larta të Republikës së Kosovës (Kuvendi i Kosovës, Presidenti i Kosovës dhe Gjykata Kushtetuese e Kosovës);
      1.2.2. Autoritetet gjyqësore dhe prokuroriale (Këshilli Gjyqësor i Kosovës, Këshilli Prokurorial i Kosovës, Gjykatat, Prokuroritë);
      1.2.3. Autoritetet e larta të administratës shtetërore (Qeveria si tërësi, Kryeministri, Zëvendës Kryeministrat dhe ministrat);
      1.2.4. Organet e larta të administratës shtetërore (Zyra e Kryeministrit dhe ministritë);
      1.2.5. Organet qendrore të administratës shtetërore (organet vartëse të administratës shtetërore të cilat kryejnë funksione jo ministrore ose funksione tjera administrative);
      1.2.6. Organet lokale të administratës shtetërore (organet komunale të administratës shtetërore);
      1.2.7. Organet e pavarura të administratës shtetërore (personat juridik që

ushtrojnë veprimtari shtetërore administrative për të cilën kërkohet shkallë e lartë e pavarësisë në interes publik);

1.2.8. Institucionet e pavarura të parapara në Kapitullin XII të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe

1.2.9. Institucionet e tjera publike të themeluara me ligj;

1.3. **Institucion -** institucioni publik apo privat arsimor, shëndetësor etj, të themeluar me ligj;

1.4. **Ndërmarrjet publike dhe private -** ndërmarrjet publike dhe private të themeluara sipas Ligjit për ndërmarrjet publike dhe Ligjit për shoqëri tregtare;

1.5. **Personi zyrtar për mbikëqyrjen e parregullsive -** personi të cilin punëdhënësi në institucionin publik të nivelit qendror dhe lokal, institucione, ndërmarrje publike apo private, me vendim të veçantë mund ta autorizojë për të vepruar lidhur me informatën e informatorit.

1.6. **Veprim kundërligjor -** çdo veprim apo mosveprim i personit me të cilin cenohen dispozitat ligjore në fuqi, qoftë në formë të veprës penale, apo kundërvajtjes.

1.7. **Informata në interes të publikut** - çfarëdo informate në lidhje me shkeljen e ligjeve, rregullave të etikës profesionale dhe parimet e administrimit të hartuara në mirëbesim në mënyrë që të ruhen interesat e shtetit apo interesi i përgjithshëm publik.

Neni 3
Parimet themelore

1. Informatori për informatën e dhënë në mirëbesim, për veprimet kundërligjore të zyrtarëve apo personave përgjegjës brenda institucioneve publike në nivelin qendror dhe lokal apo brenda institucioneve, ndërmarrjeve publike apo private, kanë të drejtë në mbrojtjen e të drejtave të tyre.
2. Informatori në informimin e veprimeve kundërligjore është i detyruar që të veproj në mirëbesim, atëherë kurr me arsye supozon se faktet dhe informacionet të cilat janë objekt i informimit janë të vërteta.
3. Ndaj informatorit për shkak të informimit qëllim mirë të veprimeve kundërligjore, nuk mund të ndërmerren masa të dënimit apo disiplinore, pushimit nga puna, largimit të përkohshëm (suspendimit) nga puna apo të ekspozimit të diskriminimit.
4. Informatori në cilësinë e të punësuarit, i cili u është nënshtruar masave diskriminuese në vendin e punës, duke përfshirë edhe pushim nga puna, ka të drejtë që t'i drejtohet gjykatës kompetente, e cila, nëse provon se informatori në cilësinë e të punësuarit ka qenë i pushuar nga puna për shkak të dhënies së informacionit, do të vendos që atë ta kthej në vendin e tij të punës dhe do ta urdhëroj institucionin publik në nivelin qendror apo lokal, institucione, ndërmarrje publike apo private që t'ia kompensoj dëmin e shkaktuar.
5. Informatorit i garantohet e drejta në mbrojtjen e anonimitetit.
6. Nëse në rastin e zbulimit të informacionit për kryerjen e një vepre të rëndë penale, ekziston rreziku i mundshëm për integritetin dhe sigurinë e informatorit apo të anëtarëve të afërt të familjes së tij dhe në masa të mëdha edhe për pasurinë, mbrojtja e informatorit bëhet në pajtim me Ligjin e veçantë për mbrojtjen e dëshmitarëve, në mënyrën e paraparë me atë ligj.

7. Institucioni publik, në kryerjen e mbikëqyrjes për parimet e ligjshmërisë dhe administrimit të mirë, kryen kontrollin në rastin e paraqitjes së informatës nga ana e informatorit për shkak të kryerjes së veprimit të kundërligjshëm.
8. Pavarësisht prej formës dhe përmbajtjes, informimi i veprimit të kundërligjshëm nga informatorët do të konsiderohet si akt i parashtresës. Në dhënien e përgjigjes informatorit lidhur me informimin përshtatshmërisht zbatohen procedurat e dhënies së përgjigjeve palëve lidhur me parashtresat e paraqitura organeve të administratës shtetërore.

Neni 4
Përgjegjësitë e institucioneve publike në nivelin qendror dhe lokal, institucionet, ndërmarrjet publike apo private

1. Institucionet publike në nivelin qendror apo lokal, institucionet, ndërmarrjet publike apo private janë përgjegjëse të:
   1.1. krijojnë kushte për punë të pavarur dhe të papengueshme të personit i cili i ka informuar veprimet potenciale të kundërligjshme;
   1.2. të krijoj kushte të mbrojtjes së integritetit, të drejtat dhe interesat e informatorëve të cilët informojnë për veprimet e kundërligjshme;
   1.3. të pranojnë informatën në lidhje me veprimet e kundërligjshme dhe të zbatojnë procedurën në pajtim me këtë ligj;
   1.4. të ruaj provat materiale dhe personale me të cilat vërtetohet veprimi i kundërligjshëm.

Neni 5
Informimi dhe vendosja për veprimin e kundërligjshëm

1. Informatorët të cilët dyshojnë për veprimet kundërligjore duhet të paraqesin informatën.
2. Punëdhënësi ose njëri prej eprorëve, informatorit, i cili ka informuar për veprim të kundërligjshëm duhet t'i sigurojë mbrojtje, anonimitet dhe integritet nga çfarëdo forme e keqtrajtimit.
3. Mbrojtja nga paragrafi 2. i këtij neni përjashtohet nëse informatori me qëllim të keq dhe më vetëdije paraqet të pavërteta.

Neni 6
Dërgimi i informatës

1. Informatori, informatën për veprim të kundërligjshëm ia dërgon personit zyrtar për mbikëqyrje të parregullsive, ose ndonjë eprori tjetër.
2. Informata duhet të jetë e kuptueshme dhe duhet të përmbaj të dhënat e personit kundër të cilit paraqitet, si dhe faktet të cilat i disponon.
3. Veprimet kundërligjore mund të paraqiten:
   3.1. me shkrim;
   3.2. me postë apo e-mail; dhe
   3.3. gojarisht.

4. Kur informata paraqitet gojarisht, zyrtari e përpilon informatën me shkrim dhe të njëjtën e nënshkruan informatori dhe zyrtari.

Neni 7
Pranimi dhe evidentimi i informatës për veprime kundërligjore

1. Çdo epror ose zyrtar evidenton informatën e pranuar për veprime kundërligjore. Evidentimi duhet të përmbajë:
   1.1. datën e pranimit;
   1.2. emrin dhe mbiemrin;
   1.3. adresën;
   1.4. institucioni i paraqitësit të informatës, dhe
   1.5. përmbajtjen e shkurtër të informatës.

Neni 8
Vërtetimi dhe përpunimi i informatës

Pas pranimit të informatës për veprim kundërligjor, eprori apo personi zyrtar informon institucionin përkatës që duhet të merret me çështjen konform ligjeve në fuqi.

Neni 9
Raportimi për informatat e veprimeve kundërligjore

1. Personi zyrtar apo eprori, për parregullsitë, është i obliguar që me shkrim ta njoftojë informatorin për procedurat e ndjekura lidhur me informatën.
2. Personi zyrtar apo eprori e informon drejtuesin e institucionit për rezultatin e procedurës së zbatuar dhe për të gjitha përfundimet.

Neni 10
Arkivimi i dokumenteve

Udhëheqësi i institucionit merr masa për arkivimin e të gjitha informatave për parregullsitë në institucionin që ai drejton. Materialet duhet të ruhen së paku pesë (5) vjet.

Neni 11
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ligji Nr. 04/L-043
31 gusht 2011

Shpallur me dekretin Nr.DL-031-2011, datë 31.08.2011 nga Presidentja e Republikës së Kosovës Atifete Jahjaga.

GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS / Nr. 14 / 9 SHTATOR 2011, PRISHTINË

LIGJI Nr. 04/L-015
PËR MBROJTJEN E DËSHMITARËVE

Përmbajtja

Kreu I: Dispozitat e përgjithshme 648
Kreu II: Masat mbrojtëse 649
Kreu III: Komisioni për mbrojtjen e deshmitarëve 652
Kreu IV: Drejtoria për mbrojtjen e dëshmitarëve 653
Kreu V: Zbatimi i programit 654
Kreu VI: Përfundimi i programit 659
Kreu VII: Bashkëpunimi ndërkombëtar dhe financimi 659
Kreu VIII: Mbrojtja e të dhënave dhe shenimeve 660
Kreu IX: Dispozitat përfundimtare dhe kalimtare 660

Kuvendi i Republikës së Kosovës;

Në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës;

Miraton:

LIGJ PËR MBROJTJEN E DËSHMITARËVE

KREU I
DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi i ligjit

Me këtë ligj rregullohen masat e posaçme dhe urgjente, mënyrat dhe procedurat për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë.

Neni 2
Fushëveprimi i ligjit

Me këtë ligj ofrohet mbrojtje për dëshmitarët dhe bashkëpunëtorët e drejtësisë vetëm për llojet e veprave penale të parapara me paragrafin 1. të nenit 4 të këtij ligji.

Neni 3
Përkufizimet

1. Shprehjet e përdorura në këtë ligj kanë këtë kuptim:
   1.1. **Person i afërm** – anëtari i familjes ashtu siç parashihet me Kodin e Procedurës Penale.

1.2. **Rrezik serioz** – frika e arsyeshme për rrezikimin e jetës, shëndeti fizik apo psikik.
1.3. **Person i mbrojtur** – personi, ndaj të cilit zbatohen masat e mbrojtjes dhe i cili, në cilësinë e dëshmitarit ose të personit të dëmtuar, bën njoftime ose dëshmon për fakte e rrethana, që përbëjnë objekt prove relevante në një procedurë penale, për vepra penale të parapara me paragrafin 1. të nenit 4 të këtij ligji dhe që për shkak të këtyre njoftimeve ose dëshmive, ndodhet në gjendje të rrezikut serioz, dhe personi, që vuan dënimin penal ose është i pandehur në një procedurë penale, ndaj të cilit zbatohen masa e posaçme të mbrojtjes, për shkak të bashkëpunimit, njoftimeve dhe deklarimeve të bëra në procedurën penale, për vepra penale të parapara me paragrafin 1. të nenit 4 të këtij ligji dhe që për këto arsye, ndodhet në gjendje të rrezikut serioz.
1.4. **Programi -** Programi për mbrojtjen e dëshmitarëve siç parashihet me këtë ligj.
1.5. **Komisioni -** Komisioni për mbrojtjen e dëshmitarëve, siç parashihet me këtë ligj.
1.6. **Drejtoria -** Drejtoria për mbrojtjen e dëshmitarëve brenda Policisë së Kosovës e themeluar me këtë ligj.
1.7. **Sekret Zyrtar -** ka kuptimin e njëjtë si në Kodin Penal të Kosovës.

Neni 4
Bazat për aplikimin e masave mbrojtëse

1. Masat e mbrojtjes mund të zbatohen para, gjatë dhe pas procedurës penale për personin e rrezikuar në lidhje me hetimet për veprat penale në vijim:
   1.1. vepër penale kundër Kosovës, shtetasve dhe banorëve të saj;
   1.2. vepër penale kundër të drejtës ndërkombëtare;
   1.3. vepër penale kundër ekonomisë;
   1.4. vepër penale kundër detyrës zyrtare;
   1.5. vepër penale për të cilën me ligj parashihet dënimi me pesë (5) ose më shumë vite burgim.
2. Masat mbrojtëse mund të zbatohen ndaj personit në lidhje me veprat penale të parapara në paragrafin 1. të këtij neni nëse:
   2.1. ekziston rrezik serioz ndaj atij personi dhe personave të afërm të tij;
   2.2. personi pranon që të bashkëpunoj ngushtë me organet e hetuesisë dhe gjyqësisë.

KREU II
MASAT MBROJTËSE

Neni 5
Llojet e masave mbrojtëse

1. Masa mbrojtëse zbatohet për të siguruar mbrojtje të personit të mbrojtur nga rreziku serioz ndaj jetës së tij, shëndetit fizik apo psikik apo ndaj personave të afërm të përcaktuar në këtë ligj.
2. Masat mbrojtëse janë si në vijim:
   2.1. mbrojtja fizike e personit të mbrojtur;
   2.2. zhvendosja e përkohshme e personit të mbrojtur në vend të sigurt;

2.3. procedurat e veçanta për qasje në të dhëna dhe dokumente në lidhje me personat e mbrojtur, nga zyrat e lëshimit të dokumenteve dhe bazës së të dhënave tjera formale;
2.4. ndërrimi i vendbanimit, punës apo shkollimit të personit të mbrojtur;
2.5. ndërrimi i identitetit të personit të mbrojtur;
2.6. ndryshimi i pamjes fizike të personit të mbrojtur duke përfshirë edhe operacionin plastik;
2.7. mbështetje financiare për personin e mbrojtur;
2.8. mbështetja sociale, ligjore dhe çfarëdo mbështetje tjetër e nevojshme për personin e mbrojtur dhe
2.9. regjim i veçantë për personin e mbrojtur në mbajtje, në institucione korrektuese.

3. Drejtoria bën propozimin për shqiptimin e një apo më shumë masave mbrojtëse, duke marr në konsideratë rrethanat specifike dhe mendimin e personit të rrezikuar. Masat mbrojtëse mund të zbatohen vetëm me pëlqimin e personit të rrezikuar. Vendosja e masave mbrojtëse të cilat nuk janë të pranuara nga personi i rrezikuar janë të ndaluara përveç rastit të paraparë me paragrafin 4. të këtij neni.
4. Nëse ekziston baza mbi të cilën mund të vendoset për masat mbrojtëse, por personi i rrezikuar nuk është në gjendje të japë pëlqimin e tij për shkak të gjendjes fizike ose mendore të tij, masat mbrojtëse urdhërohen dhe zbatohen deri në ndryshimin e rrethanave kur personi i mbrojtur do të jetë në gjendje të japë pëlqimin e tij për t'u mbrojtur, me përjashtim të masës së paraparë me nën-paragrafin 2.6. paragrafin 2. të këtij neni. Nëse personi i mbrojtur refuzon të japë pëlqimin, mbrojtja e caktuar ndërpritet.
5. Masat e parapara me këtë ligj nuk mund të zbatohen ndaj të miturve të rrezikuar, pa pëlqimin paraprak të prindërve ose kujdestarit të tyre. Për personat e privuar pjesërisht, apo plotësisht nga zotësia e veprimit, pëlqimin e jep personi i autorizuar me ligj për përfaqësimin e tyre apo kujdestari.

Neni 6
Mbrojtja fizike e personit të mbrojtur

1. Mbrojtja fizike e personit të mbrojtur bëhet në formë të hapur apo të fshehtë, e zbatuar gjatë njëzetekatër (24) orësh apo gjatë periudhave të caktuara kohore dhe vetëm brenda territorit të Republikës së Kosovës.
2. Gjatë zbatimit të mbrojtjes fizike të personit të mbrojtur përdoren masa të veçanta të sigurisë fizike.

Neni 7
Zhvendosja e përkohshme e personit të mbrojtur në vend të sigurt

1. Personi i mbrojtur mund të zhvendoset përkohësisht në vend të sigurt.
2. Gjatë zhvendosjes së përkohshme të personit të mbrojtur për në vend të sigurt, mund të përdoren masa të veçanta fizike dhe teknike të sigurisë.

Neni 8
Procedurat e veçanta për marrjen e të dhënave

1. Komisioni mund t'ia ndaloj apo kufizoj zyrave për lëshim të dokumenteve dhe menaxhueseve të tjerë të bazës së të dhënave, lëshimin e të dhënave në lidhje me personin e mbrojtur. Këto të dhëna mund të largohen nga zyrat e lëshimit të dokumenteve apo menaxhuesëve të bazës së të dhënave dhe të përcillen tek Drejtoria.
2. Të dhënat mbi personin e mbrojtur lëshohen vetëm në bazë të vendimit të Komisioni për vlerësim të programit.

Neni 9
Ndërrimi i vendbanimit, punës apo shkollimit të personit të mbrojtur

1. Personi i mbrojtur mund të zhvendoset përkohësisht apo përherë nga vendbanimi, vendi i punës apo vendi i shkollimit të tij. Zhvendosja organizohet nga Drejtoria.
2. Zhvendosja e personit të mbrojtur realizohet brenda territorit të Republikës së Kosovës apo jashtë Kosovës në bazë të marrëveshjeve ndërkombëtare apo në mënyrë të ndërsjellë.

Neni 10
Ndryshimi i identitetit të personit të mbrojtur

1. Ndryshimi i identitetit të personit të mbrojtur është ndryshim i pjesërishëm apo i tërësishëm i të dhënave personale të personit të mbrojtur dhe mund të zgjasë për një periudhë të përkohshme apo të përhershme kohore.
2. Të dhënat personale në dokumentet e reja apo në bazat e të dhënave nuk mund të jenë të dhëna të njëjta me ato të ndonjë personi tjetër të gjallë apo të vdekur.
3. Vendimi për ndryshim të identitetit të personit të mbrojtur duhet të bëhet nga Komisioni.
4. Ndryshimi i identitetit të personit të mbrojtur nuk ndikon në statusin, të drejtat dhe detyrimet tjera të personit të mbrojtur.
5. Ndryshimi i identitetit të personit të mbrojtur zbatohet vetëm atëherë kur personi i mbrojtur i përmbush detyrimet ndaj palës së tretë.
6. Dokumentet dhe të dhënat origjinale të identitetit origjinal të personit të mbrojtur mbahen në Drejtori.
7. Nëse, pas ndryshimit të identitetit të personit të mbrojtur, Drejtoria pranon kërkesë që personi i mbrojtur të përmbush një detyrim para se personi i mbrojtur të ketë pas identitet autentik, Drejtoria për mbrojtje të dëshmitarit do të kërkoj nga personi i mbrojtur të përbush detyrimin me ndihmën e Drejtorisë për mbrojtje të dëshmitarëve.

Neni 11
Ndryshimi i pamjes fizike të personit të mbrojtur duke përfshirë edhe operacionin plastik

1. Ndryshimet e vogla apo të dukshme të pamjes fizike të personit të mbrojtur përmes operacionit plastik mund të zbatohen në raste të veçanta kur masat tjera mbrojtëse nuk janë të mjaftueshme për të mbrojtur personin e mbrojtur.

2. Ndryshimet e parapara në paragrafin 1. të këtij neni duhet të kufizohen në masë sa më të madhe të mundshme për të ofruar mbrojtje të mjaftueshme të personit të mbrojtur.

Neni 12
Mbështetja financiare për personin e mbrojtur

Mbështetja financiare për personin e mbrojtur mund të sigurohet atëherë kur personi i mbrojtur nuk ka burime të mjaftueshme financiare për të siguruar një standard minimal të jetesës përderisa është nën mbrojtje, siç përcaktohet nga Komisioni për secilin rast veç e veç. Mbështetja financiare për personin e mbrojtur sigurohet për një periudhë sa më të shkurtër të mundshme kohore deri në dymbëdhjetë (12) muaj. Në rastet kur Komisioni vlerëson se vazhdimi i kësaj mase mbrojtëse është i domosdoshëm, nxirret vendim i ri.

Neni 13
Mbështetja për personin e mbrojtur

Mbështetja sociale, ligjore dhe ndihmat tjera të nevojshme për personin e mbrojtur mund të ofrohen për të garantuar sigurinë dhe mirëqenien e tij dhe një standard minimal të jetesës siç përcaktohet nga Komisioni për secilin rast veç e veç.

Neni 14
Regjimi i veçantë për personat e mbrojtur në Institucione Korrektuese

1. Me qëllim të mbrojtjes së jetës dhe shëndetit të dëshmitarit bashkëpunues përderisa ai është i privuar nga liria u ofrohet trajtim i veçantë dhe masa mbrojtëse për mbrojtjen e dëshmitarit, që mund të rezultojë në një trajtim më ndryshe por jo dukshëm më të mirë se të burgosurve tjerë.
2. Ky regjim i veçantë përfshin trajtimin e veçantë që mund të rezultojë në një trajtim më ndryshe por jo dukshëm më të mirë se të burgosurve tjerë, për dëshmitarin bashkëpunues dhe shfrytëzimin e hapësirave të ndara gjatë periudhës sa gjendet i privuar nga liria.

KREU III
KOMISIONI PËR MBROJTJEN E DESHMITARËVE

Neni 15
Komisioni për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe anëtarët e tij

1. Me këtë ligj themelohet Komision për mbrojtjen e dëshmitarëve.
2. Komisioni përbehet nga tre (3) anëtarë: Kryeprokurori i Shtetit të Republikës së Kosovës, kryesuesi i zyrës së hetuesisë së Policisë së Kosovës, dhe Drejtori i Drejtorisë për mbrojtjen e dëshmitarëve.
3. Secili anëtarë i Komisionit ka zëvendësin e tij, i cili e zëvendëson në rastet e domosdoshme.

4. Kryetari i Komisionit është Kryeprokurori i shtetit. Në rast të mungesës së tij, zëvendësi i tij udhëheqë me punën e Komisioni vlerësues të programit.
5. Komisioni merr vendime në përbërje të plotë. Vendimet merren me shumicën e votave të anëtarëve të Komisionit.

Neni 16
Funksionet e Komisionit

1. Komisioni është përgjegjës për vendosjen:
   1.1. e përfshirjes së personit të rrezikuar në program;
   1.2. për zgjatjen e qëndrimit në program;
   1.3. rreth përfundimit të programit.
2. Puna dhe të gjitha dokumentet e Komisioni vlerësues të programit janë sekret zyrtar.
3. Komisioni harton rregullat e veta të procedurës për funksionimin e tij.

KREU IV
DREJTORIA PËR MBROJTJEN E DËSHMITARËVE

Neni 17
Kompetencat e Drejtorisë për mbrojtjen e dëshmitarëve

1. Drejtoria për mbrojtjen e dëshmitareve është njësi organizative e specializuar nën vartësi të drejtpërdrejtë të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Kosovës, misioni i së cilës është zbatimi i masave të mbrojtjes së dëshmitarëve.
2. Drejtoria ka përgjegjësitë vijuese:
   2.1. sigurimin e mendimit ligjor dhe vlerësimet që kërkohen nga Komisioni.
   2.2. zbatimin e Programit;
   2.3. zbatimin e masave urgjente;
   2.4. arritjen dhe zbatimin e marrëveshjeve mbrojtëse me personat e përfshirë në Program;
   2.5. mbajtjen e dokumenteve origjinale dhe të dhënave për personat e mbrojtur;
   2.6. ofrimin e mbështetjes administrative të kërkuar nga Komisioni;
   2.7. bashkëpunimin me autoritetet kompetente të mbrojtjes së dëshmitareve në shtetet e huaja;
   2.8. menaxhimin e mjeteve financiare të ndara për zbatimin e Programit;
   2.9. zhvillimin, arsimimin dhe trajnimin e vazhdueshëm për zyrtarët, brenda Drejtorisë;
   2.10. hartimi i procedurave standarde operative për administrimin e funksioneve të Drejtorisë.
3. Drejtoria ka fondin e veçantë financiar, të cilin e menaxhon Drejtori i Drejtorisë për Mbrojtje të Dëshmitareve, sipas udhëzimit të veçantë të miratuar nga Ministri i Punëve të Brendshme dhe Ministri i Financave.
4. Drejtoria gjatë kryerjes së funksioneve të saj mund të mban të fshehtë identitetin e zyrtarëve të saj, si dhe pronësinë e mjeteve të përdorura për kryerjen e detyrave.

Neni 18
Dokumentacioni dhe të dhënat të cilat mbahen në Drejtori

1. Drejtoria duhet të mbajë të dhënat si vijon:
   1.1. kërkesat për lejimin e hyrjes në Program;
   1.2. të gjithë pyetësorët e kompletuar;
   1.3. informacionin lidhur me implementimin e masave urgjente;
   1.4. vendimet e Komisionit lidhur me lejimin e hyrjes në Program, llojin dhe kohëzgjatjen e masave mbrojtëse;
   1.5. vendimet për zgjatjen dhe përfundimin e lejes së hyrjes në Program;
   1.6. të dhënat personale të personit të mbrojtur, vendbanimin e përkohshëm apo të përhershëm të tij dhe të gjitha të dhënat e tjera të cilat janë shfaqur gjatë zbatimit të masave mbrojtëse në pajtueshmëri me këtë ligj;
   1.7. arritjen e marrëveshjeve për mbrojtje;
   1.8. informata lidhur me personin e mbrojtur tek i cili është duke u zbatuar programi në bazë të bashkëpunimit ndërkombëtar;
   1.9. informata në lidhje me personat të cilëve u është dhënë leja e qasjes në të dhënat dhe informatat.

Neni 19
Bashkëpunimi dhe mbështetja e qeverisë dhe organizatave tjera për Drejtorinë e mbrojtjes së dëshmitarëve

Autoritetet qeveritare, organizatat dhe institucionet tjera detyrohen të ofrojnë mbështetje të sigurt dhe të fshehtë në mënyrën e kërkuar nga Drejtoria.

KREU V
ZBATIMI I PROGRAMIT

Neni 20
Propozimi dhe kërkesa për përfshirje në program

1. Kërkesa me shkrim për përfshirje në program, duhet ti dorëzohet Kryeprokurorit të Shtetit. Kërkesa mund të paraqitet nga personat si vijon:
   1.1. prokurori kompetent i shtetit;
   1.2. gjykatësi që merret me atë rast, apo
   1.3. personi në rrezik serioz.
2. Kërkesa e shkruar për përfshirje në program përmban informatat si në vijim:
   2.1. të dhënat për personin e propozuar për përfshirje në program duhet të përmbajnë: emrin, emrin e babait, mbiemrin, mbiemrin e vajzërisë nëse ka mbiemër tjetër, numrin personal, vendbanimin, datën dhe vendin e lindjes, statusin martesor, profesionin, statusin pronësor, si dhe të gjitha informatat në lidhje me historinë penale;
   2.2. përshkrimin e veprës penale dhe vlerësimin e provave ekzistuese;
   2.3. rëndësia dhe vlerësimi i çfarëdo burimi për dëshminë apo informatën e siguruar nga personi i cili është propozuar për përfshirje në program dhe lidhja e dëshmisë së tillë me një rast konkret i cili është në procedurë penale;

2.4. përshkrimi dhe vlerësimi i rrezikut të personit i cili është propozuar për përfshirje në program apo të personit të tij të afërm;
2.5. kërkesa për masat urgjente, nëse është e nevojshme, si dhe
2.6. informata tjera të nevojshme.

3. Kur kërkesa me shkrim për përfshirje në program paraqitet nga personi i rrezikuar, ai nuk është i obliguar që të sigurojë informacionet e parapara në paragrafin 2. të këtij neni, por Kryeprokurori i Shtetit do të kërkojë nga prokurori, apo gjykatësi kompetent varësisht se në cilën fazë gjendet procedura për sigurimin e informatave të parapara në paragrafin 2. të këtij neni.
4. Kryeprokurori i shtetit brenda njëzetekatër (24) orëve pas pranimit të kërkesës do t'ia përcjellë të gjitha informatat e pranuara Drejtorisë që t'i mundësojë përgatitjen e mendimit dhe vlerësimit të shkallës së rrezikut të personit të propozuar për përfshirje në program ose të personit të afërm të tij dhe përshtatshmërinë e tyre për përfshirje në program dhe të ndërmarrin masa urgjente nëse është e nevojshme.
5. Kur një kërkesë pranohet nga personi i rrezikuar në përputhje me paragrafin 3. të këtij neni, Kryeprokurori i Shtetit do të ndërmarrë veprimet e menjëhershme brenda njëzetekatër (24) orëve lidhur me kërkesën. Kur sigurohet që të gjitha informacionet relevante janë në dispozicion, Kryeprokurori i Shtetit do t'ia përcjellë Drejtorisë të gjitha informatat e pranuara brenda njëzetekatër (24) orëve.
6. Drejtoria përgatitë dhe dorëzon mendimin e saj fillestar te Kryeprokurori i Shtetit brenda tridhjetë (30) ditëve duke filluar nga dita e pranimit të informatës.

Neni 21
Propozimi për përfshirje

1. Kryeprokurori i Shtetit, duhet brenda tri (3) ditëve nga pranimi i mendimit fillestar dhe vlerësimit nga Drejtoria sipas nenit 20, paragrafi 4. i këtij ligji të:
   1.1. dorëzojë propozimin me shkrim Komisionit për përfshirje në program; dhe
   1.2. organizojë mbledhjen e Komisionit.
2. Propozimi me shkrim për përfshirje në program përmban:
   2.1. informatat e specifikuara në nenin 20, paragrafi 2. të këtij ligji; dhe
   2.2. mendimin fillestar nga Drejtoria, i cili përmban përshkrimin dhe vlerësimin e rrezikut ndaj personit i cili është propozuar për përfshirje në program, propozimin lidhur me masat mbrojtëse, kohëzgjatjen e tyre si dhe rezultatet e vlerësimeve mjekësore dhe psikologjike, një vlerësim të shpenzimeve të zbatimit të masave mbrojtëse, si dhe një kopje të pyetësorit të plotësuar.

Neni 22
Kushtet për përfshirje në program

1. Kur vendoset mbi propozimin për përfshirje në program, Komisioni duhet të marrë për bazë kriteret në vijim:
   1.1. rëndësia e informatës e cila është e pranueshme si dëshmi në shqyrtim gjyqësor që nuk mund të sigurohet nga asnjë burim alternativ. Kërkesa për përfshirje në program duhet të përmbaj informata se personit i cili është propozuar për përfshirje në program lidhur me veprën penale, autorët e

kryerjes së veprës penale, si dhe të dhënat dhe informatat tjera të rëndësishme të cilat janë të nevojshme dhe qenësore për ndjekjen kryesve të veprës penale;

1.2. seriozitetin e rrezikut;

1.3. gatishmërinë e personit i cili është propozuar për përfshirje në program për të bashkëpunuar me organet e hetuesisë dhe gjyqësisë gjatë zbatimit të programit.

1.4. përshtatshmërinë e personit të propozuar për përfshirje në program që të veprojë në pajtim me programin dhe krijimi i bindjes se zhvendosja e dëshmitarit nuk do të shkaktoj ndonjë rrezik për jetën apo shëndetin e personave të tjerë.

Neni 23
Vendimi mbi propozimin për zbatimin e programit

1. Komisioni duhet të vendos në lidhje me përfshirjen apo jo në program brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve pas pranimit të propozimit me shkrim.
2. Komisioni mund të kërkoj nga prokurori apo gjyqtari, varësisht se ku gjendet procedura, të dhëna dhe informata shtesë në lidhje me propozimin për përfshirje në program.
3. Para se Komisioni vlerësues i programit të nxjerr vendim në lidhje me përfshirjen e personit në program duhet të kërkoj miratim me shkrim nga ai person, përveç rastit të paraparë me paragrafin 4. të nenit 5 të këtij ligji.
4. Nëse Komisioni vendos pozitivisht në lidhje me përfshirjen e personit në program, Drejtoria lidh marrëveshje me shkrim për mbrojtje me personin e rrezikuar.

Neni 24
Masat Urgjente

1. Në raste specifike dhe urgjente, pas kërkesës së prokurorit kompetent ose gjykatësit të rastit penal, brenda njëzetekatër (24) orëve Drejtori i Drejtorisë mund të marrë vendim për zbatimin e programit të masave urgjente të mbrojtjes. Për zbatimit e masave urgjente, duhet të lidhet marrëveshje e përkohshme e mbrojtjes në mes të drejtorit dhe personit të mbrojtur, përveç rastit të paraparë me paragrafin 4. të nenit 5 të këtij ligji.
2. Komisioni duhet të vendosë brenda tridhjetë (30) ditëve nga dita e fillimit të zbatimit të programit të masave urgjente të mbrojtjes për përfshirje të personit të mbrojtur në Programin e mbrojtjes së dëshmitarëve.
3. Masat urgjente vazhdojnë deri në vendimin e Komisionit për mbrojtjen e dëshmitareve.
4. Masat urgjente mund të zbatohen vetëm pasi që personi në rrezik të ketë dhënë pëlqimin me shkrim përveç rastit të paraparë me paragrafin 4., të nenit 5 të këtij ligji.
5. Vetëm masat mbrojtëse të parapara në nenin 5. paragrafin 2. nën-paragrafët 2.1, 2.2, 2.3 dhe 2.9 të këtij ligji, mund të zbatohen si masa urgjente.
6. Pasi vendimi për zbatimin e masave urgjente është marrë, Drejtori i Drejtorisë

kërkon pëlqimin e personit ndaj të cilit janë zbatuar masat urgjente që t'i nënshtrohet vlerësimit mjekësor dhe psikologjik dhe ta plotësoj pyetësorin me të dhëna personale, të pronës, të kaluarën e tij penale, detyrimet dhe informacione tjera. Formati dhe përmbajtja e pyetësorit përcaktohet nga Drejtori i Drejtorisë.

Neni 25
Vazhdimi i programit

1. Drejtoria mund të paraqet propozimin për vazhdimin e programit. Propozimi duhet t'i dorëzohet me shkrim Komisionit, jo më vonë se tridhjetë (30) ditë para përfundimit të programit, duke I shpjeguar arsyet e propozimit. Përjashtimisht në raste specifike, propozimi mund të bëhet edhe pas përfundimit të programit.
2. Vazhdimi i programit mund të aprovohet vetëm pasi që personi i mbrojtur e ka dhënë pëlqimin me shkrim.

Neni 26
Marrëveshja për mbrojtje

1. Pas nxjerrjes së vendimit për përfshirjen e personit të rrezikuar në program, pëlqimi me shkrim i personit të përfshirë në program do të mbrohet dhe arkivohet nga ana e Drejtorisë për mbrojtje të dëshmitarëve së bashku me pyetësorin e kompletuar. Pas lidhjes së marrëveshjes së veçantë në mes të Drejtorisë për mbrojtje të dëshmitarëve dhe secilit person në rrezik serioz, personi i tillë konsiderohet person i mbrojtur.
2. Marrëveshja për mbrojtje përmban:
   2.1. informacione të përgjithshme;
   2.2. obligimet e personit të mbrojtur të përfshirë në program, të cilat janë si në vijim:
      2.2.1. dhënia e dëshmisë së vërtetë në pajtim me dispozitat e Kodit të Procedurës Penale, të përgjigjet pyetjeve në mënyrë të qartë, të sinqertë, të saktë dhe të plotë, duke ofruar deklarata faktike të hollësishme që janë në funksion të zhvillimit të procedurës penale, vetëm për organet e hetuesisë dhe gjyqësisë;
      2.2.2. përcjelljen e të gjitha udhëzimeve dhe të dhënave nga Drejtoria për mbrojtje të dëshmitarëve dhe të marrë pjesë aktive në zbatimin e programit;
      2.2.3. moskryerja e ndonjë vepre penale;
      2.2.4. arritja e marrëveshjes për vëzhgimin dhe incizimin e mjeteve të komunikimit, incizimin e vendbanimit dhe kryerjen e vëzhgimit sekret të tij pa urdhëresën e veçantë të gjykatës, duke siguruar edhe pëlqimin e personit të mbrojtur që të pajtohet me kufizimet e disa të drejtave personale dhe lirive të tij, me qëllim të mbrojtjes, pas miratimit nga Drejtoria;
      2.2.5. telefonatat dhe komunikimet tjera elektronike të bëhen vetëm me aprovimin e Drejtorisë për mbrojtje të dëshmitarëve;
      2.2.6. ndërmarrja e të gjitha veprimeve të nevojshme për të arritur pavarësinë e tij ekonomike deri në përfundimin e marrëveshjes për mbrojtje;

2.2.7. pajtimi me kryerjen e të gjitha veprimeve jo të dëmshme për shëndetin e tij;
2.2.8. raportimi i të gjitha llogarive apo transaksioneve legale, financiare dhe detyrimet tjera të tij;
2.2.9. njoftimi pa vonesë Drejtorinë në lidhje me të gjitha rrethanat të cilat mund të ndikojnë në zbatimin e programit;
2.2.10. mos me dhënë intervista për mediat apo me lejuar fotografimin;
2.2.11. mos me përpiluar libra ose raporte mbi mbrojtjen e dëshmitarit apo mbi rastin e tij ose të mos sigurojë asnjë informatë të cilën Drejtoria e konsideron si të rëndësishme për sigurimin e mbrojtjes së personit të mbrojtur;
2.2.12. obligimet kundrejt personit të përfshirë në program janë:
2.2.13. të zbatohen vetëm masat e nevojshme kufizuese të të drejtave të lëvizjes së tij gjatë zbatimit të programit;
2.2.14. t'i siguroj personit të mbrojtur ndihmën e nevojshme psikologjike, sociale dhe ligjore gjatë zbatimit të programit;
2.2.15. t'i ofrohet ndihma e nevojshme ekonomike, duke përfshirë edhe ndihmën mjekësore për kohë të caktuar;

2.3. kohëzgjatjen e programit si dhe kushtet për përfundimin e programit;
2.4. klauzulën që marrëveshja mbrojtëse është bërë në një kopje të vetme dhe mbahet në Drejtorinë për mbrojtje të dëshmitarëve;
2.5. detyrimet e dala nga marrëveshja e mbrojtjes nuk mund të jenë objekt kontesti civil, penal apo çfarëdo konflikti tjetër gjyqësor. Të gjitha veprimet e ndërmarrura nga zyrtarët e Drejtorisë dhe Komisionit gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare nuk mund të jenë bazë për padi dhe nuk i nënshtrohen përgjegjësisë ligjore;
2.6. deklaratën me të cilën personi i mbrojtur deklaron se e kupton dhe pajtohet me përmbajtjen e marrëveshjes për mbrojtje;
2.7. deklaratën që pyetësori i plotësuar nga ana e personit të mbrojtur përbën një pjesë integrale të marrëveshjes për mbrojtje;
2.8. çdo informatë tjetër të nevojshme për zbatimin e marrëveshjes për mbrojtje;
2.9. datën dhe nënshkrimet e palëve.

3. Secili person i cili është i përfshirë në programin për mbrojtje duhet të nënshkruaj marrëveshje të veçantë për mbrojtje.
4. Marrëveshja për mbrojtje të të miturve apo personave me aftësi të kufizuara duhet të nënshkruhet nga prindi i tij, përfaqësuesi ligjor apo kujdestari kur ata nuk janë në gjendje ta bëjnë një gjë të tillë.
5. Në rast se personi i mbrojtur i cili është i përfshirë në program gjatë kësaj periudhe kohore shkakton ndonjë dëm personit tjetër, atëherë pala e dëmtuar ka të drejt që të kërkoj kompensimin e dëmit.
6. Personat që janë të përfshirë në program kanë të drejtë për mbajtjen e kontakteve dhe vizitave me fëmijët e tyre dhe personave të tjerë të afërm të cilët nuk janë të përfshirë në program, me kusht që mos të vije deri te rrezikimi i programit. Lidhur me lejimin apo mos lejimin në raste specifike vendos Komisioni.

KREU VI
PËRFUNDIMI I PROGRAMIT

Neni 27
Përfundimi i programit

1. Programi mund të përfundoj nën kushtet në vijim:
   1.1. kur marrëveshja për mbrojtje skadon;
   1.2. personi i mbrojtur apo përfaqësuesi ligjor i tij refuzon të jetë i mbrojtur;
   1.3. kur personi i mbrojtur shkel në mënyrë serioze marrëveshjen e mbrojtjes, e cila mund ta dërgojë në rrezik serioz, marrëveshja për mbrojtje pushon me një njoftim me shkrim nga drejtoria pas marrjes së pëlqimit nga komisioni;
   1.4. në rast të vdekjes së personit të mbrojtur;
   1.5. nëse personi i mbrojtur pa ndonjë arsye të fortë refuzon të pranojë ofertë pune nga drejtoria apo kur ai nuk kryen aktivitete tjera të ligjshme për fitimin e të ardhurave;
   1.6. kur vendi i jashtëm në territorin e të cilit personi i mbrojtur është zhvendosur kërkon përfundimin e marrëveshjes për mbrojtje.
2. Programi mund të përfundoj me Vendim të Komisionit apo me propozim të Drejtorit të Drejtorisë.
3. Kushtet dhe procedurat për ndërprerjen e Programit rregullohen me Procedurat Standarde të Operimit të Drejtorisë.

KREU VII
BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR DHE FINANCIMI

Neni 28
Baza për bashkëpunim ndërkombëtar

1. Bashkëpunimi ndërkombëtar për zbatimin e programit duhet të aprovohet në bazë të marrëveshjeve ndërkombëtare, marrëveshjeve bilaterale dhe multilaterale, në bazë të reciprocitetit, pas aprovimit nga Komisionit edhe në raste tjera individuale.
2. Kur kërkohet zhvendosja e personit të mbrojtur, Drejtoria për mbrojtjen e dëshmitarëve paraqet kërkesë tek autoritetet kompetente të shtetit tjetër përgjegjës për zbatimin e masave mbrojtëse në pajtim me këtë ligj, Organet kompetente duhet të bëjnë përpjekjet maksimale për të ruajtur identitetin e dëshmitarit të mbrojtur.
3. Me pranimin e kërkesës për pranimin e personit të mbrojtur nga një shtet tjetër, Drejtoria për mbrojtje të dëshmitarëve, vlerëson kërkesën dhe në rast të nxjerrjes së vlerësimit pozitiv i propozon Komisionit që të aprovojë zbatimin e masave në territorin e Kosovës, në pajtim me këtë ligj.

Neni 29
Financimi

1. Financimi për zbatimin e këtij ligji sigurohet nga Buxheti i Republikës së Kosovës.
2. Financimi i paraparë në paragrafin 1. të këtij neni mund të bëhet edhe nga burimet dhe programet ndërkombëtare.

KREU VIII
MBROJTJA E TË DHËNAVE DHE SHENIMEVE

Neni 30
Dispozitat kryesore për mbrojtjen e të dhënave dhe shënimeve

1. Komisioni, Drejtoria, autoritetet qeveritare, organizatat, mekanizmat dhe personat trajtojnë të gjitha dokumentet dhe të dhënat lidhur me zbatimin e programit për mbrojtjen e dëshmitarëve si sekret zyrtar.
2. Komisioni mund t'a zbuloj një dokument zyrtar sekret në lidhje me programin për mbrojtjen e dëshmitarëve me kërkesën e organit të prokurorisë apo gjyqësisë apo për arsye të sigurisë kombëtare.
3. Të dhënat lidhur me ndryshimin e identitetit të personit të mbrojtur si dhe dokumentacioni i personit të mbrojtur i cili përmban identitetin origjinal duhet të mbahen në Drejtori dhe duhet të shënohen si sekret zyrtar. Qasja në të dhënat dhe dokumentet e tilla duhet të aprovohet dhe të mbikëqyren nga Drejtori i Drejtorisë.
4. Zbulimi i sekretit zyrtar në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji paraqet vepër penale në pajtim me dispozitat e Kodit Penal të Kosovës.

Neni 31
Dispozita ndëshkuese

Kushdo që e mashtron dhe e vë në lajthim Komisionin dhe Drejtorinë përmes paraqitjes së provave dhe fakteve të pavërteta për të përfituar një masë mbrojtjes sipas dispozitave të këtij ligji dënohet në përputhje me dispozitat e Kodit Penal të Kosovës.

KREU IX
DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE DHE KALIMTARE

Neni 32
Dispozitat Kalimtare

1. Prej hyrjes në fuqi të këtij ligji e deri në skadimin e mandatit të Misionit të EULEX-it në Kosovë, Komisioni dhe Drejtoria vendore për mbrojtjen e dëshmitarëve kanë përgjegjësi për mbrojtjen e dëshmitarëve në pajtim me këtë ligj, përveç nëse kërkesa për përfshirje në një program të EULEX-it për mbrojtjen e dëshmitarëve është bërë dhe pranuar sipas paragrafëve 5. dhe 6. të këtij neni.
2. Njësia e EULEX-it për Siguri të dëshmitarëve do të ofrojë asistencë teknike për Drejtorinë, në mënyrë që të zhvillohet kapaciteti i saj në pajtim me standardet e njohura ndërkombëtarisht dhe praktikat më të mira Evropiane, e cila duhet të përfshijë, por nuk do të kufizohet në:
   2.1. trajnimin e personelit në Drejtori;
   2.2. asistencë në zhvillimin e strukturës organizative të Drejtorisë;
   2.3. ndihmën për zhvillimin e procedurave standarde të operimit, hartimin e rregullave dhe rregulloreve të brendshme dhe të gjithë dokumentacionit të nevojshëm për funksionimin efektiv të Drejtorisë;
   2.4. asistencë në hartimin dhe zbatimin e programeve të mbrojtjes së dëshmitarëve;

2.5. asistencë në raste të veçanta;
2.6. asistencë në vendosjen e kontakteve dhe nënshkrimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit me njësitë e mbrojtjes së dëshmitarëve në vendet e tjera.

3. Detajet e asistencës teknike nga paragrafi 2. i këtij neni duhet të rregullohen me një marrëveshje teknike.
4. Gjatë periudhës kalimtare, Njësia e EULEX-it për Siguri të Dëshmitarëve dhe Grupi i EULEX-it për Shqyrtimin e Sigurisë së Dëshmitarëve do të funksionojë e pavarur dhe e ndarë prej Drejtorisë brenda Policisë së Kosovës dhe do të funksionojë sipas procedurave dhe strukturave menaxhuese të tyre.
5. Gjatë periudhës kalimtare, Njësisë së EULEX-it për Mbrojtjen e Dëshmitarëve i paraqitet kërkesa për përfshirje në programin e EULEX-it për siguri të dëshmitarëve. Kërkesa me shkrim mund të paraqitet nga:
   5.1. kryeprokurori i Shtetit;
   5.2. policia e EULEX -it;
   5.3. prokuror i EULEX-it i caktuar në procedurë penale.
6. Kërkesa për përfshirje në programin e EULEX-it për siguri të dëshmitarëve do të shqyrtohet dhe vendoset nga Grupi EULEX-it për Shqyrtimin e Sigurisë së Dëshmitarëve.
7. Njësia e EULEX-it për Siguri të dëshmitarëve do të vendosë për masat specifike për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe do të zbatojë programin për mbrojtje pas vendimit të Grupit të EULEX-it për Shqyrtimin e Sigurisë së Dëshmitarëve për përfshirjen në Programin e EULEX-it për Siguri të Dëshmitarëve.
8. Drejtoria e Kosovës për Mbrojtje të Dëshmitarëve dhe autoritetet e Qeverisë, organizatat dhe institucionet e tjera publike do të ofrojnë mbështetje për Njësinë e EULEX-it për Siguri të Dëshmitarëve kërkuar nga Njësia e EULEX-it për Siguri të Dëshmitarëve.

Neni 33
Zbatimi i ligjit

1. Ministria e Punëve të Brendshme brenda gjashtë (6) muajsh pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, nxjerr aktet nënligjore për zbatimin e tij.
2. Drejtoria për Mbrojtjen e Dëshmitarëve dhe Komisioni për Mbrojtjen e Dëshmitarëve të parapara me këtë ligj themelohen brenda një viti (1) pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 34
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi një (1) vit pas shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ligji Nr. 04/ L-015
29 korrik 2011

Shpallur me dekretin Nr.DL-020-2011, datë 12.08.2011 nga Presidentja e Republikës së Kosovës Atifete Jahjaga.

GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS / Nr. 13 / 1 SHTATOR 2011, PRISHTINË

LIGJI Nr. 03/L-166
PËR PARANDALIMIN DHE LUFTIMIN E KRIMIT KIBERNETIKË

Kuvendi i Republikës së Kosovës;

Në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton

LIGJ PËR PARANDALIMIN DHE LUFTIMIN E KRIMIT KIBERNETIKË

Neni 1
Qëllimi

Ky ligj ka për qëllim parandalimin dhe luftimin e krimit kibernetikë me masa konkrete, parandalimin, zbulimin dhe sanksionimin e shkeljeve përmes sistemeve kompjuterike, duke ofruar respektimin e të drejtave të njeriut dhe mbrojtjen e të dhënave personale.

Neni 2
Fushëveprimi

Ky ligj aplikohet në territorin e Republikës së Kosovës në veprimtaritë e sistemeve kompjuterike. Është i aplikueshëm tërësisht në ruajtjen e të dhënave në sistemet kompjuterike si dhe sanksionon metodat dhe procedurat se si dhe nga kush këto të dhëna mund të përdoren

Neni 3
Përkufizimet

1. Shprehjet e përdorura në këtë ligj kanë këto kuptime:
   1.1. **Krimi kibernetikë -** një aktivitet kriminal të zhvilluar në rrjet që ka si objekt apo si mënyrë të kryerjes së krimit keqpërdorimin e sistemeve kompjuterike dhe të të dhënave kompjuterike.
   1.2. **Sistemi kompjuterik -** çfarëdo mjeti ose montim të mjeteve të ndërlidhura apo që janë në lidhje operative, prej të cilave një ose më shumë ofrojnë të dhëna automatike që procesohen me anë të programeve kompjuterike.
   1.3. **Procesimi automatik i të dhënave** - proces me anë të të cilit të dhënat në sistemin kompjuterik procesohen me anë të programeve kompjuterike.
   1.4. **Programi kompjuterik** - grupin e udhëzimeve që mund të zbatohen përmes sistemit kompjuterik në mënyrë që të fitohen rezultatet e caktuara.
   1.5. **Të dhënat kompjuterike** - çdo përfaqësim i fakteve, informatave apo

koncepteve në atë formë që të mund të procesohen me sisteme kompjuterike. Kjo kategori përfshin çdo program të kompjuterit që mund të inicioj sistemet kompjuterike të kryej funksione të caktuara.

1.6. **Ofrues i shërbimeve -** çdo person fizik ose juridik, që shfrytëzuesve ua ofron mundësinë e komunikimit me sistem kompjuterik, si dhe personin, që i proceson ose që i mbledh të dhënat për këta ofrues të shërbimeve dhe për shfrytëzuesit e shërbimeve të ofruara prej tyre.

1.7. **Të dhënat mbi trafikun e të dhënave** - ato të dhëna kompjuterike që kanë të bëjnë me komunikimin që bëhet përmes sistemit kompjuterik dhe prodhimeve të tij, duke përfaqësuar një pjesë të zinxhirit të komunikimit, duke treguar origjinën e komunikimit, destinimin, linjën, kohën, datën, madhësinë, vëllimin dhe kohëzgjatjen, si dhe llojin e shërbimit të shfrytëzuar për komunikim.

1.8. **Të dhënat mbi shfrytëzuesit** - çdo informatë që mund të shpijë tek identifikimi i shfrytëzuesit, duke përfshirë llojin e komunikimit dhe shërbimin e shfrytëzuar, adresën e postës, adresën gjeografike, adresën e IP-së, numrat telefonik apo çfarëdo numri tjetër të qasjes dhe mjetet e pagesës për shërbimin përkatës si dhe çfarëdo të dhëne tjetër që mund të shpijë në identifikimin e shfrytëzuesit.

1.9. **Masat e sigurisë –** shfrytëzim i procedurave të caktuara, mjeteve ose programeve të specializuara kompjuterike me anë të të cilave qasja në sistemin kompjuterik është e kufizuar ose e ndaluar për kategoritë e caktuara të shfrytëzuesve.

1.10. **Materialet pornografike me të mitur -** çdo material që paraqet një të mitur apo një person të rritur i paraqitur si i mitur me një sjellje eksplicite seksuale apo imazhe të cilat, edhe pse nuk paraqesin person real, simulon, në mënyrë të besueshme një të mitur me sjellje eksplicite seksuale.

1.11. **Interceptimi -** marrjen, nxënien pa të drejtë të të dhënave nga persona të paautorizuar.

Neni 4
Veprimet e paautorizuara

1. Sipas këtij ligji veprimet e personit cilësohen veprime të paautorizuara, nëse personi:
   1.1. nuk është i autorizuar sipas ligjit ose kontratës;
   1.2. i tejkalon kufijtë e autorizimit;
   1.3. nuk ka leje nga personi kompetent dhe i kualifikuar, sipas ligjit, për të shfrytëzuar, administruar ose kontrolluar sistemin kompjuterik apo të kryej hulumtime shkencore në një sistem kompjuterik.

Neni 5
Parandalimi, siguria dhe fushatat informative

1. Në mënyrë që të sigurohen sistemet kompjuterike dhe mbrojtja e të dhënave personale, autoritetet dhe institucionet publike me kompetenca në këtë fushë,

ofruesit e shërbimeve, organizatat joqeveritare dhe përfaqësuesit e shoqërisë civile kryejnë aktivitete dhe programe për parandalimin e krimit kibernetikë.
2. Autoritetet dhe institucionet publike me kompetencë në këtë fushë në bashkëpunim me ofruesit e shërbimeve dhe organizatat joqeveritare si dhe përfaqësuesit e tjerë të shoqërisë civile zhvillojnë politikat, praktikat, masat, procedurat dhe standardet minimale për sigurinë e sistemeve kompjuterike.
3. Autoritetet dhe institucionet publike me kompetenca në këtë fushë në bashkëpunim me ofruesit e shërbimeve, organizatat joqeveritare dhe përfaqësuesit e tjerë të shoqërisë civile organizojnë fushata informative mbi krimin kibernetikë dhe rreziqet për shfrytëzuesit e sistemeve të kompjuterit.

Neni 6
Mbajtja, plotësimi dhe shfrytëzimi i bazës së të dhënave

1. Ministria e Drejtësisë në bashkëpunim me Ministrinë e Punëve të Brendshme mbajnë dhe plotësojnë në mënyrë të vazhdueshme bazën e të dhënave mbi krimin kibernetikë.
2. Ministria e Transportit dhe Postë-Telekomunikacionit, Shërbimi i Inteligjencës së Kosovës dhe institucionet tjera relevante mundë të jenë shfrytëzues të bazës së të dhënave në përputhje me rregullat dhe procedurat e mbajtësit të bazës së të dhënave.
3. Instituti Kombëtar i Kriminalistikës kryen studime periodike në mënyrë që të identifikoj shkaktarët dhe kushtet që përcaktojnë dhe favorizojnë krimin kibernetikë.

Neni 7
Trajnimet dhe programet speciale

Ministria e Drejtësisë, Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Transportit dhe Postë-Telekomunikacionit, Ministria e Shërbimeve Publike dhe Shërbimi i Inteligjencës së Kosovës zhvillojnë programe speciale trajnuese për personelin me qëllim të parandalimit dhe luftimit të krimit kibernetikë në përputhje me kompetencat që ushtrojnë.

Neni 8
Obligimet e pronarëve dhe administratorëve

1. Për një kategori sistemesh kompjuterike, në të cilat qasja është e kufizuar ose plotësisht e ndaluar, pronarët, administratorët e këtij sistemi, detyrohen ta rregullojnë që në mënyrë të qartë dhe automatike të paralajmërohet përdoruesi: me informacion, si dhe në çfarë kushtesh mund ta përdorë, ose se është i ndaluar përdorimi i këtij sistemi kompjuterik dhe për pasojat ligjore për qasje të paautorizuar.
2. Mosrespektimi i detyrimit të përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni, është kundërvajtje dhe kryesi i saj dënohet prej pesëqind (500) deri pesëmijë (5000) Euro.

Neni 9
Veprat penale kundër konfidencialitetit, integritetit dhe disponueshmërisë së të dhënave të sistemeve kompjuterike

1. Qasja në mënyrë të paligjshme në sistemet kompjuterike është vepër penale dhe kryesi i saj dënohet me burgim prej gjashtë (6) muaj deri tre (3) vite.
2. Kur vepra penale nga paragrafi 1 i këtij neni kryhet me qëllim të marrjes së të dhënave kompjuterike kryesi i saj dënohet me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në katër (4) vite.
3. Kur vepra penale nga paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni kryhet duke i shkelur masat e sigurisë së sistemeve kompjuterike, kryesi i saj dënohet me burgim prej tri (3) vite deri në pesë (5) vite.

Neni 10
Interceptimi pa autorizim

1. Interceptimi pa autorizim i transmetimeve jopublike të të dhënave kompjuterike, nga, për, në, ose brenda një sistemi kompjuterik, është vepër penale dhe kryesi i saj dënohet me burgim prej gjashtë (6) muaj deri tre (3) vjet. Nëse kryhet nga pjesëtari i organizatës kriminale, kryesi i saj dënohet me burgim prej një (1) deri pesë (5) vite.
2. Interceptimi pa autorizim i emetimeve elektromagnetike nga sistemet kompjuterike, që mbajnë të dhëna jopublike kompjuterike, është vepër penale dhe kryesi i saj dënohet me burgim prej një (1) deri pesë (5) vite.

Neni 11
Transferi i pa autorizuar

1. Ndryshimi, shlyerja, asgjësimi i të dhënave kompjuterike ose kufizimi i tyre pa autorizim është vepër penale dhe kryesi i saj dënohet me burgim prej një (1) deri tre (3) vite.
2. Transferi i paautorizuar i të dhënave nga sistemet kompjuterike është vepër penale dhe kryesi i saj dënohet me burgim prej tre (3) deri pesë (5) vite.
3. Transferi i paautorizuar i të dhënave nga baza e tyre me sisteme kompjuterike është vepër penale dhe kryesi i saj dënohet me burgim prej tre (3) deri pesë (5) vite.

Neni 12
Pengimi i funksionimit të sistemeve kompjuterike

Pengesat serioze për funksionimin e sistemeve kompjuterike, duke futur informata, duke bartur, ndryshuar, shlyer ose duke i shkatërruar të dhënat kompjuterike ose duke e kufizuar qasjen pa autorizim në të dhënat e tilla, është vepër penale dhe kryesi i saj dënohet me burgim prej tre (3) muaj deri tre (3) vjet. Nëse kryhet nga pjesëtari i organizatës kriminale, kryesi i saj dënohet me burgim prej një (1) deri pesë (5) vite.

Neni 13
Prodhimi, posedimi dhe tentativa e pa autorizuar

1. Prodhimi, shitja, importi, distribuimi ose ofrimi në dispozicion në çfarëdo forme, pa të drejtë, i pajisjes ose programit kompjuterik i dizajnuar dhe i adaptuar për qëllim të kryerjes së ndonjë vepre penale, do të dënohet me burgim prej një (1) deri në katër (4) vite.
2. Prodhimi, shitja, importi, distribuimi ose ofrimi në dispozicion, në çfarëdo forme, pa të drejtë, të fjalëkalimit, kodit të qasjes ose të dhënave të tjera kompjuterike që lejojnë qasjen e plotë ose të pjesshme në sistemin kompjuterik për qëllim të kryerjes së ndonjë vepre penale dënohet me burgim prej një (1) deri pesë (5) vite.
3. Posedimi, pa të drejtë, i pajisjes, programit kompjuterik, fjalëkalimit, kodit të qasjes ose të dhënave kompjuterike me qëllim të kryerjes së ndonjë vepre penale, dënohet me burgim prej një (1) deri gjashtë (6) vite.
4. Kryesi, për tentativë të kryerjes së veprës penale, sipas paragrafit 2 ose 3 të këtij neni, dënohet me burgim prej tre (3) muaj deri një (1) vit.

Neni 14
Veprat penale lidhur me kompjuterë

1. Futja e informatave, ndryshimi ose shlyerja pa autorizim e të dhënave kompjuterike ose kufizimi pa autorizim i qasjes në të dhëna të tilla, që rezulton në të dhëna joautentike, me qëllim të shfrytëzimit të tyre për përvetësim të një të drejte, është vepër penale dhe kryesi i saj dënohet me burgim gjashtë (6) muaj deri tri (3) vite. Nëse kryhet nga pjesëtari i organizatës kriminale, dënohet me burgim prej një (1) deri pesë (5) vite.
2. Për tentativë të kryerjes së veprës penale, sipas këtij neni, kryesi dënohet me burgim prej tre (3) muaj deri një (1) vit.

Neni 15
Shkaktimi i humbjes së pronës

1. Shkaktimi i humbjes së pronës tek një person tjetër duke futur informata, ndryshuar apo shlyer të dhënat e kompjuterit me anë të kufizimit të qasjes në të dhënat e tilla apo me ndonjë ndërhyrje në funksionimin e sistemit kompjuterik me qëllim të sigurimit të një përfitimi ekonomik për vete apo për dikë tjetër, dënohet me burgim prej tre (3) deri në dhjetë (10) vite.
2. Për tentativë të kryerjes së veprës penale nga paragrafi 1 i këtij neni, kryesi dënohet me burgim prej tre (3) muaj deri një (1) vit.

Neni 16
Pornografia me fëmijë përmes sistemeve kompjuterike

1. Personi, që kryen vepër penale sipas nën-paragrafëve 1.1 deri 1.5 të këtij paragrafi, dënohet me burgim prej gjashtë (6) muaj deri tri (3) vite. Nëse cilësohet se është kryer në rrethana rënduese, kryesi dënohet prej një (1) deri dhjetë (10) vite.

1.1. prodhimin e pornografisë me fëmijë, me qëllim të shpërndarjes së tij nëpërmjet një sistemi kompjuterik;
1.2. ofrimin apo vënien në dispozicion të pornografisë me fëmijë nëpërmjet një sistemi kompjuterik;
1.3. shpërndarjen apo transmetimin e pornografisë me fëmijë nëpërmjet një sistemi kompjuterik;
1.4. prokurimin e pornografisë me fëmijë nëpërmjet një sistemi kompjuterik për vete apo për të tjerët;
1.5. zotërimin e pornografisë me fëmijë nëpërmjet një sistemi kompjuterik apo në mediume memoruese të të dhënave kompjuterike.

2. Kryesi i tentativës së veprës penale, nga paragrafi 1 i këtij neni, dënohet me burgim prej gjashtë (6) muaj deri tri (3) vite**.**

Neni 17
Procedura e ndjekjes

1. Në rastet urgjente dhe plotësisht të arsyetuara, apo dyshime të bazuara në lidhje me përgatitjen ose kryerjen e veprës penale me anë të sistemeve kompjuterike, me qëllim të mbledhjes së dëshmive ose identifikimit të kryerësve, ruajtjes së shpejtë të të dhënave kompjuterike ose të të dhënave që i referohen të dhënave mbi trafikun e të dhënave, duke iu nënshtruar rrezikut të shkatërrimit ose ndryshimit, zbatohen dispozitat procedurale si vijon:
   1.1. gjatë hetimit të krimit me kërkesë të organit hetues ruajtja e të dhënave urdhërohet nga prokurori, ndërsa gjatë procedurës gjyqësore me urdhër të gjykatës;
   1.2. masa që i referohet paragrafit 1 të këtij neni vlen për periudhën kohore deri nëntëdhjetë (90) ditë, me mundësi të zgjatjes edhe për tridhjetë (30) ditë;
   1.3. urdhri i prokurorit ose urdhri i gjykatës dërgohet, menjëherë, tek cilido ofrues i shërbimeve, apo tek ndonjë person që posedon të dhënat që i referohen nën-paragrafit 1.1 të këtij paragrafi, atëherë personi përkatës është i obliguar që ti ruaj shpejtë ato sipas kushteve të ruajtjes së fshehtësisë;
   1.4. në rastin kur të dhënat i referohen trafikut të të dhënave që janë nën posedimin e disa ofruesve të shërbimeve, ofruesi i shërbimeve që i referohet nën-paragrafit 1.3 të këtij paragrafi është i obliguar që menjëherë t'i ofroj organit të hetimit të krimeve informatat e nevojshme për të identifikuar ofruesit e tjerë të shërbimeve për të qenë në dijeni mbi të gjitha elementet në zinxhirin e shfrytëzuar të komunikimit;
   1.5. prokurori është i obliguar që deri në fund të hetimit t'i njoftoj me shkrim personat që janë nën hetime për krimet dhe të dhënat e të cilëve janë ruajtur.

Neni 18
Sekuestrimi, kopjimi dhe ruajtja e të dhënave

1. Për qëllimet e nenit 17 nën-paragrafi 1.2. prokurori propozon për sekuestrimin e objekteve, pajisjeve që përmbajnë të dhëna kompjuterike, të dhëna mbi trafikun e të dhënave, të dhëna mbi shfrytëzuesin, nga personi ose ofruesi i shërbimeve që i posedon ato, me qëllim të krijimit të kopjeve që mund të shërbejnë si dëshmi.

2. Nëse objektet, pajisjet që përmbajnë të dhëna i referohen të dhënave për organet e drejtësisë në mënyrë që të krijojnë kopje, sipas paragrafit 1 të këtij neni, urdhri i gjykatës për konfiskimin e detyruar i komunikohet prokurorit, i cili ndërmerr masa për ta përmbushur atë.
3. Kopjet sipas paragrafit 1 të këtij neni krijohen përmes mjeteve teknike programeve kompjuterike dhe procedurave që sigurojnë integritetin dhe sigurinë e informatave.
4. Prokurori në çdo kohë mund të urdhëroj kërkimin me qëllim të zbulimit ose mbledhjes së dëshmive të nevojshme për hulumtim të sistemit kompjuterik ose pajisjes kompjuterike për ruajtjen e të dhënave.
5. Nëse organi për hetimin e krimit ose gjykata konsideron se konfiskimi i objekteve që përmbajnë të dhëna të cilat i referohen paragrafit 1 ndikojnë shumë në aktivitetet e kryera nga personat që posedojnë këto objekte, urdhëron krijimin e kopjeve që do shërbenin si dëshmi dhe të cilat janë krijuar sipas paragrafit 3 të këtij neni.
6. Kur në rastin e hetimit të sistemit kompjuterik apo pajisjes së kompjuterit për ruajtjen e të dhënave mësohet se të dhënat e kërkuara kompjuterike janë të përfshira në një tjetër sistem kompjuterik ose në ndonjë pajisje tjetër kompjuterike për ruajtjen e të dhënave dhe që ofrohet qasja në to nga sistemi fillestar apo pajisje, mund të urdhërohet kryerja dhe kërkimi në mënyrë që të hulumtohen të gjitha sistemet kompjuterike ose pajisja kompjuterike për ruajtjen e të dhënave të kërkuara.

Neni 19
Qasja, nxënia ose incizimi i komunikimeve

1. Qasja në sistemin kompjuterik, si dhe nxënia ose incizimi i komunikimeve të kryera nga pajisjet e sistemeve kompjuterike ndërmerren kur janë të dobishme për të gjetur të vërtetën si dhe faktet ose identifikimin e kryerësve, e nuk mund të arrihen në bazë të dëshmive të tjera.
2. Masat që i referohen paragrafit 1 të këtij neni ndërmerren me propozim të prokurorit nga organet e hetimit të krimeve me ndihmën e personave të specializuar, të cilët janë të obliguar të ruajnë fshehtësinë e operacionit të kryer.
3. Autorizimi që i referohet paragrafit 2 të këtij neni jepet për tridhjetë (30) ditë, për arsye të bazuar mund të shtyhet edhe për tridhjetë (30) ditë, ndërkohë që kohëzgjatja maksimale të mos kalojë periudhën prej katër (4) muajve.
4. Prokurori është i obliguar që deri në fund të hetimit të informoj me shkrim personat kundër të cilëve janë ndërmarrë masat e referuara në paragrafin 1 të këtij neni.

Neni 20
Bashkëpunimi ndërkombëtarë

1. Autoritetet kosovare bashkëpunojnë drejtpërdrejtë sipas dispozitave të ligjit duke respektuar obligimet që dalin nga instrumentet juridike ndërkombëtare, me institucionet homologe të shteteve tjera, si dhe me organizatat ndërkombëtare të specializuara në këtë fushë.
2. Bashkëpunim sipas paragrafit 1 të këtij neni mund të konsistojë, në ndihmën ndërkombëtare ligjore në çështjet penale, ekstradimin, identifikimin, bllokimin,

konfiskimin, sekuestrimin e produkteve dhe mjeteve të kryerjes së veprës penale, kryerjen e hetimeve, shkëmbimin e informatave, ndihmën teknike apo mbledhjen e informatave, trajnimin e specializuar të personelit, si dhe aktivitete tjera.

Neni 21
Hetimet

1. Shtetet dhe organizatat tjera me kërkesën e tyre mund të kryejnë hetime në bashkëpunim me autoritetet kosovare për parandalimin dhe luftimin e krimit kibernetikë në tërë territorin e Kosovës.
2. Hetimet e përgjithshme që i referohen paragrafit 1 të këtij neni kryhen në bazë të marrëveshjeve bilaterale dhe multilaterale.
3. Përfaqësuesit e autoriteteve kompetente kosovare mund të kryejnë hetimet që kryhen në territorin e vendeve tjera në pajtim me dispozitat e marrëveshjeve ndërkombëtare.

Neni 22
Pika e kontaktit

1. Në mënyrë që të sigurohet një bashkëpunim i përhershëm ndërkombëtar në fushën e krimit kibernetikë, Qeveria e vë në dispozicion një pikë të përhershme kontakti.
2. Kjo pikë e përhershme kontakti ka kompetencat si vijon:
   2.1. ofron ndihmë të specializuar dhe informata mbi legjislacionin në fushën e krimit kibernetikë si dhe informon pikat e kontaktit të shteteve tjera;
   2.2. urdhëron ruajtjen e shpejtë të të dhënave si dhe konfiskimin e pajisjeve që përmbajnë të dhëna kompjuterike ose të dhëna që kanë të bëjnë me të dhënat mbi trafikun e të dhënave të kërkuara nga autoriteti kompetent i huaj;
   2.3. ekzekuton ose ndihmon ekzekutimin, sipas dispozitave ligjore, në rastet e luftimit të krimit kibernetikë, duke bashkëpunuar me të gjitha autoritetet kompetente kosovare.
3. Qeveria në afat prej gjashtë (6) muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji me një akt nënligjor përcakton krijimin e pikës së kontaktit të paraparë në paragrafin 1 të këtij neni.

Neni 23
Kërkesa për ruajtjen e përshpejtuar të të dhënave

1. Në kuadër të bashkëpunimit ndërkombëtar, autoritetet kompetente të huaja mund të kërkojnë nëpërmes pikës së kontaktit ruajtjen e përshpejtuar të të dhënave kompjuterike ose të dhënave që kanë të bëjnë me trafikun e të dhënave, që ekzistojnë brenda sistemit kompjuterik në territorin e Kosovës, në lidhje me të cilat autoriteti i huaj ka bërë kërkesë të ndihmës ndërkombëtare ligjore në çështjet penale.
2. kërkesa për ruajtje të përshpejtuar sipas paragrafit 1 përmban të dhënat në vijim:
   2.1. autoritetin që kërkon ruajtjen;
   2.2. një prezantim të shkurtër të fakteve që i nënshtrohet hetimit të krimit dhe baza ligjore;

2.3. të dhënat kompjuterike që kërkohen të ruhen;
2.4. çdo informatë në dispozicion, e nevojshme për identifikimin e pronarit të të dhënave kompjuterike dhe lokacionit të sistemit kompjuterik;
2.5. shërbimi i të dhënave kompjuterik dhe nevoja për ti ruajtur ato;
2.6. qëllimin e autoritetit të huaj për të formuluar një kërkesë të ndihmës ligjore ndërkombëtare në çështjet penale;

3. Kërkesa e ruajtjes ekzekutohet sipas nenit 17 për një periudhë prej gjashtëdhjetë (60) ditëve. Kjo ruajtje është e vlefshme deri sa vendimi të merret nga autoritetet kompetente kosovare, në lidhje me kërkesën e ndihmës ligjore ndërkombëtare në çështjet penale;

Neni 24
Ruajtja e të dhënave

Nëse, në ekzekutimin e kërkesës së formuluar sipas nenit 23 paragrafi 1 të këtij ligji, një ofrues i shërbimeve në një vend tjetër është kuptuar të jetë në posedim të të dhënave në lidhje me trafikun e të dhënave, shërbimi për luftimin e krimit kibernetikë do të njoftoj menjëherë autoritetin kërkues të huaj mbi këtë, duke komunikuar gjithashtu të gjitha informatat për identifikimin e ofruesit përkatës të shërbimeve.

Neni 25
Qasja në burimet e publike, të hapura

1. Autoriteti kompetent i huaj mund të ketë qasje dhe mund të pranoj, me anë të sistemit të vendosur në territorin e tij, të dhënat kompjuterike të ruajtura në Kosove, nëse ka miratimin e personit të autorizuar, sipas dispozitave ligjore, për të ofruar në dispozicion me anë të sistemit kompjuterik, pa bërë kërkesë nga autoritetet kosovare.
2. Autoriteti kompetent i huaj mund të ketë qasje në burimet publike, të hapura, kosovare të të dhënave kompjuterike duke mos bërë kërkesë tek autoritetet kosovare.

Neni 26
Dispozitat ligjore për dhënien e informatave dhe të dhënave, të nevojshme për autoritetet e huaja

Autoritetet kompetente kosovare mund të dërgojnë sipas detyrës zyrtare, tek autoritetet e huaja kompetente, duke respektuar dispozitat ligjore në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale, informatat dhe të dhënat, të nevojshme për autoritetet kompetente të huaja për të zbuluar veprat e kryera me anë të sistemit kompjuterik apo për të zgjidhur çështjet që kanë të bëjnë me këto krime.

Neni 27
Dispozitat përfundimtare

Në rast të mospërputhjes së dispozitave të këtij ligji me dispozitat e Kodit të Procedurës Penale vlejnë dispozitat e Kodit të Procedurës Penale.

Neni 28
Të hyrat

Të hyrat e krijuara sipas këtij ligji arkëtohen në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Neni 29
Hyrja në fuqi

Ky ligji hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës

Ligji Nr. 03/L-166
10 qershor 2010

Shpallur me Dekretin DL-028-2010, datë 02.07.2010 nga Presidenti i Republikës së Kosovës, Dr. Fatmir Sejdiu.

GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS / PRISHTINË: VITI V / Nr. 74 / 20 KORRIK 2010

LIGJI Nr. 04/L-213
PËR BASHKËPUNIM JURIDIK NDËRKOMBËTAR NË ÇËSHTJET PENALE

Përmbajtja

Kreu I: Dispozitat e përgjithshme 672
Kreu II: Ekstradimi 674
Kreu III: Transferimi i procedurës penale 686
Kreu IV: Transferimi i personave të dënuar 690
Kreu V: Njohja dhe ekzekutimi i aktgjykimeve 695
Kreu VI: Ndihma juridike e ndërsjellë 698
Kreu VII: Dispozitat kalimtare dhe përfundimtare 707

Kuvendi i Republikës së Kosovës,

Në bazë të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton

LIGJ PËR BASHKËPUNIM JURIDIK NDËRKOMBËTAR NË ÇËSHTJET PENALE

KREU I
DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

1. Ky ligj rregullon kushtet dhe procedurat për bashkëpunim juridik ndërkombëtar në çështje penale mes Republikës së Kosovës dhe shteteve të tjera, në qoftë se nuk është përcaktuar ndryshe me marrëveshje ndërkombëtare.
2. Bashkëpunimi juridik ndërkombëtar mund të realizohet edhe në lidhje me organizatat apo institucionet ndërkombëtare, atëherë kur është i nevojshëm.
3. Në mungesë të një marrëveshje ndërkombëtare ndërmjet Republikës së Kosovës dhe shtetit të huaj, bashkëpunimi juridik ndërkombëtar mund të ofrohet mbi bazën e parimit të reciprocitetit.
4. Procedurat gjyqësore të ofrimit të bashkëpunimit juridik ndërkombëtar rregullohen me dispozitat e procedurës penale, përveç nëse ndryshe është paraparë me këtë ligj.
5. Republika e Kosovës duhet të zbatoj formalitetet dhe procedurat e përmendura shprehimisht nga shteti kërkues, nëse formalitetet dhe procedurat e tilla nuk janë në kundërshtim me parimet themelore të së drejtës vendore.

Neni 2
Kufizimet e Bashkëpunimit

Zbatimi i këtij ligji i nënshtrohet mbrojtjes së interesave të sovranitetit, sigurisë, rendit publik dhe interesave të tjera të Republikës së Kosovës, siç janë të përcaktuara me Kushtetutë.

Neni 3
Përkufizimet

1. Shprehjet e përdorura, për qëllime të këtij ligji kanë këtë kuptim:
   1.1. **Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar në Çështjet Penale** - çdo formë e ndihmës e kërkuar apo e ofruar nga një shtet tjetër, organizatë apo institucion, me qëllim të mbështetjes së procedurave penale;
   1.2. **Kërkesë** - akti me të cilën kërkohet bashkëpunim juridik ndërkombëtar;
   1.3. **Shteti kërkues** – shteti që ka parashtruar kërkesë për bashkëpunim juridik ndërkombëtar;
   1.4. **Shteti i kërkuar** - shteti të cilit i dërgohet kërkesë për bashkëpunim juridik ndërkombëtar;
   1.5. **Ministria** - Ministria e Drejtësisë e Republikës së Kosovës;
   1.6. **Organi gjyqësor vendor** - gjykatat dhe prokuroritë e Republikës së Kosovës, siç janë të përcaktuara me ligjin në fuqi;
   1.7. **Ligji vendor** – legjislacioni i Republikë së Kosovës;
   1.8. **Organi gjyqësor i huaj** - organi i një shteti tjetër që sipas ligjit të atij shteti është kompetent të ofroj apo të kërkoj bashkëpunim juridik ndërkombëtar;
   1.9. **Urdhër Kërkim Ndërkombëtar** – vendim që lejon publikimin nga Organizata Ndërkombëtare e Policisë Kriminale – INTERPOL, të një njoftimi që kërkon arrestimin e përkohshëm të personit me qëllim të ekstradimit;
   1.10. **Vendim gjyqësor** – aktgjykim, aktvendim, urdhër apo ndonjë vendim gjyqësor i shpallur nga Organi Gjyqësor;
   1.11. **Shteti dënues** - shteti i cili ka shqiptuar dënimin ndaj personit i cili është transferuar apo mund të transferohet;
   1.12. **Shteti zbatues** - shteti në të cilin personi i dënuar është transferuar apo mund të transferohet për të vuajtur dënimin e shqiptuar;
   1.13. **Ekstradim** – për qëllim të këtij ligji nënkupton edhe dorëzimin e përkohshëm.

Neni 4
Gjuha dhe mënyra e komunikimit

1. Kërkesat për bashkëpunim juridik ndërkombëtar përcillen përmes Ministrisë. Komunikimi përmes kanaleve diplomatike nuk përjashtohet për rastet kur konsiderohet i nevojshëm.
2. Në rastet urgjente, organi gjyqësor vendor mund të ofrojë ndihmë edhe nëse kërkesa është pranuar drejtpërdrejtë, përmes INTERPOL-it apo në ndonjë mënyrë

tjetër që mund të prodhoj dëshmi në të shkruar, me kusht që shteti kërkues garanton dërgimin e kërkesës në origjinal brenda tridhjetë (30) ditëve në pajtim me paragrafin 1. të këtij neni.

3. Nëse kërkesa dhe dokumentet shoqëruese janë në gjuhë të huaj, ato duhet të shoqërohen me përkthime të verifikuara në gjuhen Shqipe ose Serbe. Përkthimet e vërtetuara në gjuhën Angleze mund të pranohen në bazë të reciprocitetit.
4. Ministri mund të lejojë bashkëpunimin e drejtpërdrejtë ndërmjet organeve gjyqësore vendore dhe të huaja, kur konsiderohet e përshtatshme.

Neni 5
Konfidencialiteti

1. Ministria, me kërkesën e autoritetit gjyqësor të huaj, ruan konfidencialitetin e kërkesës për bashkëpunim juridik ndërkombëtar dhe informatës së cekur në kërkesë.
2. Nëse kërkesa e referuar në paragrafin 1. të këtij neni nuk mund të përmbushet, Ministria njofton shtetin kërkues.

KREU II
EKSTRADIMI

NËN KREU I
EKSTRADIMI NGA REPUBLIKA E KOSOVËS TEK NJË SHTET TJETËR

Neni 6
Qëllimi

1. Personi i kërkuar nga një shtet tjetër për qëllim të zhvillimit të procedurës penale ose për ekzekutimin e dënimit mund të ekstradohet nga Republikës së Kosovës në atë shtet, sipas kushteve të parapara me këtë ligj.
2. Personat e mëposhtëm nuk mund të ekstradohen kundër vullnetit të tyre:
   2.1. Shtetasit e Republikës së Kosovës, përveç nëse parashihet ndryshe me marrëveshje ndërkombëtare ndërmjet Republikës së Kosovës dhe shtetit kërkues ose sipas së drejtës ndërkombëtare, siç parashihet në nenit 35 paragrafi 4. të Kushtetutës të Republikës së Kosovë. Një marrëveshje ndërkombëtare mund të lidhet me qëllim të ekstradimit të një individi;
   2.2. personat të cilëve iu është dhënë azil politik në Republikën e Kosovës;
   2.3. shtetasit e huaj të cilët gëzojnë imunitetin e juridiksionit në Republikën e Kosovës, brenda kufijve të detyrimeve ndërkombëtare të marra nga Republika e Kosovës.
3. Statusi i shtetasit të Republikës së Kosovës ose të një refugjati politik përcaktohet nga koha e pranimit të kërkesës për ekstradim.

Neni 7
Dorëzimi i përkohshëm

Në bazë të Marrëveshjes Ndërkombëtare, një person mund të dorëzohet përkohësisht tek një shtet tjetër me kusht që pas seancës dëgjimore para organit gjyqësor të huaj,

personi të kthehet në Republikën e Kosovës në mënyrë që të mbaj dënimin e shqiptuar kundër tij apo saj.

Neni 8
Vendi i kryerjes së veprës penale

1. Ekstradimi nuk do të lejohet për veprat penale të kryera në tërësi në territorin e Republikës së Kosovës dhe mund të mos lejohet për vepra penale të kryera pjesërisht në territorin e Republikës së Kosovës.
2. Nëse vepra penale është kryer kundër një shtetasi të Republikës së Kosovës jashtë territorit të Republikës së Kosovës, ekstradimi lejohet me kusht që organet gjyqësore vendore nuk i fillojnë ose i ndërprejnë procedurat penale për të njëjtën vepër penale.

Neni 9
Inkriminimi i dyfishtë

Ekstradimi lejohet vetëm për veprat penale të dënueshme sipas ligjit vendor dhe ligjit të shtetit kërkues.

Neni 10
Veprat penale për të cilat lejohet ekstradimi

1. Kur ekstradimi kërkohet për ndjekje penale, do të lejohet vetëm për vepra penale të dënueshme me heqje lirie për një periudhë maksimale prej të paktën një (1) viti ose me një dënim më të rëndë sipas ligjit vendor dhe ligjit të shtetit kërkues.
2. Kur ekstradimi kërkohet për ekzekutim të dënimit, mund të lejohet nëse kohëzgjatja e dënimit ose pjesa e mbetur e dënimit tejkalon periudhën prej katër (4) muajsh burgim.
3. Në rastet kur kërkesa për ekstradim përfshinë disa vepra penale të veçanta, ku secila prej tyre është e dënueshme me burgim në bazë të ligjit vendor dhe ligjit të shtetit kërkues, por disa prej tyre nuk përmbushin kushtet ne lidhje me lartësinë e dënimit qe mund të jepet apo dënimit të shqiptuar, ekstradimi mund të lejohet në lidhje me të gjitha veprat.

Neni 11
Skadimi i afatit të parashkrimit

Ekstradimi nuk lejohet në rastet kur është bërë parashkrimi i ndjekjes penale ose ekzekutimit të dënimit në pajtim me ligjin vendor ose ligjin e shtetit kërkues.

Neni 12
Dyshim i arsyeshëm

Ekstradimi lejohet kur ekzistojnë prova të mjaftueshme për të mbështetur dyshimin e arsyeshëm se personi ka kryer veprën penale për të cilën kërkohet ekstradimi, apo nëse është dënuar me aktgjykim të ekzekutueshëm.

Neni 13
Ne bis in idem

1. Ekstradimi nuk lejohet nëse është dhënë një vendim i formës së prerë nga organet gjyqësore vendore kundër personit të kërkuar për veprën apo veprat penale për të cilat kërkohet. Ekstradimi mund të lejohet nëse organet gjyqësore vendore kanë vendosur të mos fillojnë ose të ndërpresin procedurën gjyqësore në lidhje me veprën apo veprat e njëjta penale.
2. Ekstradimi nuk lejohet nëse është dhënë vendim i formës së prerë nga organet gjyqësore të një shteti të tretë kundër personit të kërkuar për veprën ose veprat penale për të cilat kërkohet ekstradimi dhe nëse ekziston një marrëveshje ndërkombëtare mes Republikës së Kosovës dhe atij shteti për njohjen dhe ekzekutimin e ndërsjellë të vendimeve penale.

Neni 14
Vepra penale politike

1. Ekstradimi refuzohet nëse vepra penale për të cilën paraqitet kërkesa është vepër penale politike apo vepër e cila është e ndërlidhur me vepër penale politike.
2. Për qëllime të këtij ligji, veprat e mëposhtme nuk konsiderohen vepra penale politike:
   2.1. vrasje apo tentim vrasje e kryetarit të shtetit, apo anëtarit të familjes së tij apo saj;
   2.2. gjenocidi, krimet kundër njerëzimit, krimet e luftës dhe terrorizmi.

Neni 15
Vepra penale ushtarake

Ekstradimi nuk lejohet për vepra penale sipas ligjit penal ushtarak të cilat nuk janë vepra penale sipas ligjit penal.

Neni 16
Dënimi me vdekje dhe burgim të përjetshëm

1. Ekstradimi nuk lejohet për vepra penale të dënueshme me dënim me vdekje sipas ligjit të shtetit kërkues, përveç nëse shteti kërkues jep garanci që konsiderohen të mjaftueshme se dënimi me vdekje nuk do te shqiptohet apo të ekzekutohet.
2. Ekstradimi mund të mos lejohet nëse vepra mbi të cilën është bazuar kërkesa sipas ligjit të Shtetit kërkues është e dënueshme me burgim të përjetshëm apo një dënim tjetër të përjetëshme ose në qoftë se personi i kërkuar është dënuar me dënim të tillë dhe nuk ka asnjë rishikim të dënimit me vdekje apo dënimit me burgim me kërkesë apo *proprio motu* pas një periudhe jo më të gjatë se njëzet (20) vite.

Neni 17
Klauzola jodiskriminuese dhe standardet e të drejtave të njeriut

1. Ekstradimi i një personi të kërkuar nuk lejohet nëse ekziston dyshimi i arsyeshëm se kërkesa është bërë për qëllime të ndjekjes penale ose të ndëshkimit për shkak të racës, fesë, gjinisë, shtetësisë, bindjes politike, etnisë, gjuhës, aftësisë së kufizuar, orientimit seksual, anëtarësimit të tij apo saj në ndonjë grup shoqëror, apo nëse pozita e tij apo saj në shoqëri mund të paragjykohet për njërën nga këto arsye.
2. Ekstradimi nuk lejohet nëse ekzistojnë shkaqe të arsyeshme se personi i kërkuar mund t'i nënshtrohet torturës apo trajtimit mizor, çnjerëzor, poshtërues ose ndëshkimit.
3. Ekstradimi nuk lejohet nëse ka arsye për të besuar se personi nuk do të pranojë garancitë minimale për një gjykim të drejtë në shtetin kërkues, siç parashihet me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.
4. Ekstradimi i kërkuar me qëllim të ekzekutimit të dënimit të shqiptuar me aktgjykim të dhënë në mungesë, lejohet vetëm nëse gjatë procedurës së zhvilluar kundër personit janë respektuar të drejtat minimale të mbrojtjes, të njohura për çdo person të akuzuar për kryerjen e një vepre penale. Ekstradimi mund të lejohet nëse shteti kërkues ofron garanci të mjaftueshme për të siguruar që personi i kërkuar ka të drejtën për rigjykim me qëllim që të sigurohen të drejtat minimale të mbrojtjes.
5. Ekstradimi nuk lejohet nëse ka dyshime se personi do të gjykohet apo është gjykuar ose dënuar në shtetin kërkues nga një gjykatë e jashtëzakonshme ose e përkohshme, përveç nëse shteti kërkues jep garanci të mjaftueshme se gjykimi ose rigjykimi do të kryhet nga një gjykatë e rregullt në pajtim me ligjin.
6. Ekstradimi nuk lejohet për çfarëdo arsye tjetër të bazuar që do të paraqiste shkelje të së drejtës ndërkombëtare ose standardeve tjera të të drejtave të njeriut.

Neni 18
Kërkesa për ekstradim

1. Procedura për ekstradim fillon në bazë të kërkesës me shkrim drejtuar Ministrisë.
2. Kërkesa për ekstradim duhet të përmbaj veprën penale për të cilën kërkohet ekstradimi dhe shoqërohet nga dokumentet e mëposhtme:
   2.1. gjeneralitetet e personit të kërkuar, së bashku me të dhëna tjera që do të ndihmonin në vërtetimin e identitetit, shtetësisë dhe vendndodhjes së personit;
   2.2. origjinalin apo kopjen e vërtetuar të urdhër arrestit të lëshuar nga organet kompetente të shtetit kërkues, ose nëse personi i kërkuar është i dënuar për ndonjë vepër, origjinalin apo kopjen e vërtetuar të aktgjykimit ose ndonjë shkrese tjetër që përmban dënimin e shqiptuar, faktin që dënimi është i ekzekutueshëm dhe kohëzgjatjen e mbetur të dënimit që do të ekzekutohet. Këto dokumente duhet të përmbajnë kohën dhe vendin e kryerjes së veprës penale, rolin e personit në kryerjen e veprës penale dhe kualifikimin ligjor të veprës penale. Nëse dokumentet nuk përmbajnë informata e tilla kërkesa duhet të shoqërohet me një deklaratë në të cilën përshkruhen të dhënat sipas këtij paragrafi;

2.3. ekstrakti nga ligji penal i shtetit kërkues, që është i zbatueshëm për çështjen në fjalë;

2.4. nëse personi i kërkuar është dënuar në mungesë, duhet të ofrohet një deklaratë me të cilën tregohet se personi është ftuar personalisht apo përmes një përfaqësuesi të autorizuar në bazë të ligjit të shtetit kërkues, për datën dhe vendin e mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor që ka sjell deri tek marrja e vendimit në mungesë, ose që personi ka deklaruar tek organi kompetent se nuk e kundërshton rastin apo një deklaratë që thekson mjetet juridike në dispozicion të personit për të përgatitur mbrojtjen apo për të kërkuar rigjykimin në prezencë të tij apo saj.

Neni 19
Veprimet e Ministrisë

1. Nëse pas shqyrtimit të kërkesës për ekstradim, Ministria konstaton se informatat dhe dokumentet e ofruara nuk janë të mjaftueshme, mund të kërkoj nga shteti kërkues të plotësoj kërkesën.
2. Nëse Ministria konsideron që kërkesa i plotëson kushtet formale e përcjell atë tek Prokuroria Themelore kompetente.
3. Ministria mund të kërkoj në çdo kohë nga organi gjyqësor vendor informata lidhur me ecurinë e procedurës së ekstradimit.

Neni 20
Roli i Prokurorisë Themelore

1. Prokuroria Themelore në territorin e së cilës personi i kërkuar besohet se banon apo mund të gjendet, është kompetente të merret me kërkesën për ekstradim. Nëse vendndodhja e personit të kërkuar është e panjohur, kërkesa për ekstradim i dërgohet Prokurorisë Themelore në Prishtinë.
2. Prokuroria Themelore menjëherë ndërmerr veprime për identifikimin dhe përcaktimin e vendndodhjes së personit të kërkuar dhe e informon atë lidhur me kërkesën e paraqitur për ekstradimin e tij apo saj.
3. Prokurori kompetent i shtetit pa vonesë dhe jo më vonë se 3 ditë nga momenti kur personi është identifikuar dhe lokalizuar, paraqet kërkesën për ekstradim në Gjykatën Themelore në territorin e të cilit gjendet Prokuroria Themelore kompetente, siç përcaktohet në paragrafin 1 të këtij neni.

Neni 21
Caktimi i masave për sigurimin e pranisë së personit në procedurën e ekstradimit

1. Në mënyrë që të sigurohet prania e personit të kërkuar gjatë procedurës së ekstradimit, Prokuroria Themelore vepron në përputhje me dispozitat e Kodit të Procedurës Penale.
2. Gjyqtari kompetent i procedurës paraprake i Gjykatës Themelore, i përcaktuar sipas nenit 20 paragrafi 3. të këtij ligji, do të lirojë menjëherë personin nëse:

2.1. ekziston njëra nga situatat e përmendura në nenin 6 paragrafi 2. të këtij Ligji dhe personi deklaron vullnetin e tij apo saj për tu mos ekstraduar;

2.2. personi nuk është i njëjti më atë të identifikuar në kërkesën për ekstradim ose në ndonjërën prej dokumenteve të përcaktuara në nenin 18 paragrafin 2. të këtij ligji;

2.3. urdhër arresti apo dokumenti qe ka sjellë deri tek arrestimi i personit është anuluar.

3. Prokuroria Themelore njofton Ministrinë për çdo vendim të marrë nga gjykata, në pajtim me këtë Nen.

Neni 22
Arrestimi i përkohshëm para pranimit të kërkesës për ekstradim

1. Edhe para pranimit të kërkesës për ekstradim, personi i kërkuar mund të arrestohet dhe paraburgoset për një periudhë maksimale prej dyzet (40) ditësh, në qoftë se shteti kërkues dorëzon tek Ministria kërkesën për arrest të përkohshëm, në të cilën ceket se dokumentet e referuara në nenin 18 paragrafi 2 të këtij ligji ekzistojnë dhe se një kërkesë për ekstradim do të paraqitet në kohën e duhur. Kërkesa për arrest të përkohshëm mund të dërgohet përmes mënyrës elektronike.
2. Njoftimet e INTERPOL-it që kërkojnë arrestimin e një personi me qëllim të ekstradimit, si dhe Urdhër Arrestet Evropiane kanë fuqi të njëjtë juridike me kërkesën për arrestim të përkohshëm.
3. Bazuar në kërkesën për arrestim të përkohshëm, prokurori i shtetit dhe policia kanë të drejtë të arrestojnë personin e kërkuar. Masa për sigurimin e pranisë së personit në procedurë duhet të konfirmohet nga gjyqtari kompetent i procedurës paraprake brenda dyzet e tetë (48) orëve prej ditës së arrestimit, duke marrë parasysh dispozitat e nenit 21 paragrafi 2. të këtij Ligji. Gjyqtari i procedurës paraprake, sipas detyrës zyrtare, e liron personin nëse kërkesa për ekstradim nuk është pranuar nga gjykata brenda dyzet (40) ditësh nga dita e arrestimit.
4. Lirimi nuk përjashton mundësinë e arrestimit të serishëm dhe ekstradimin e tij apo saj nëse kërkesa për ekstradim është pranuar më pas.
5. Kodi i Procedurës Penale zbatohet përveç nëse parashihet ndryshe me këtë ligj.

Neni 23
Procedura gjyqësore për ekstradim

1. Lejueshmëria e kërkesës për ekstradim shqyrtohet nga kolegji prej tre gjyqtarëve të Gjykatës Themelore Kompetente.
2. Nëse disa kërkesa për ekstradim janë parashtruar nga shtete të ndryshme në lidhje me personin e njëjtë, procedura do të bashkohet. Nëse procedurat janë në pritje nga gjykata të ndryshme, kompetente do të jetë gjykata që e para ka filluar procedurën për atë rast.
3. Gjykata mund të lejojë përfaqësuesin e shtetit kërkues të jetë i pranishëm në procedurë.
4. Brenda tri (3) ditësh nga data e marrjes së kërkesës për ekstradim, gjykata mban seancën dëgjimore në prani të prokurorit të shtetit, personit të kërkuar dhe mbrojtësit të tij. Nëse personi i kërkuar nuk ka mbrojtës, kryetari i trupit gjykues i emëron mbrojtësin sipas detyrës zyrtare.

5. Në fillim të seancës kryetari i trupit gjykues informon personin për të drejtat e tij/saj në bazë të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe Kodit të Procedurës Penale. Gjykata do të marr në pyetje të pandehurin në lidhje me rrethanat e tij apo të saj personale dhe në veçanti në lidhje me shtetësinë e tij/saj.
6. Gjykata do të pyes personin nëse ai ose ajo pajtohet me ekstradimin dhe do të informojë atë për pasojat ligjore të një procedure të thjeshtuar të ekstradimit. Nëse personi është dakord, gjykata do të veprojë në pajtim me nenin 24 të këtij ligji.
7. Nëse personi nuk e jep pëlqimin për ekstradimin e thjeshtuar dhe kundërshton ekstradimin, gjykata do ta shtyjë seancën dhe do të japë një afat prej dyzet e tetë (48) orësh në mënyrë që personi i kërkuar të tregoj arsyet mbi të cilat ai/ajo e kundërshton ekstradimin. Kundërshtimi mund të bazohet vetëm në faktin se personi nuk është personi i kërkuar nga shteti kërkues ose se nuk janë plotësuar kushtet që e lejojnë ekstradimin.
8. Gjykata mund të caktojë një afat tjetër prej dyzet e tetë (48) orësh për prokurorin që të jetë në gjendje të reagoj ndaj kundërshtimit të bërë nga personi i kërkuar.
9. Nëse vlerësohet se informacioni i dhënë nga shteti kërkues nuk është i mjaftueshëm për të marrë vendim, gjykata mund të paraqes kërkesë në Ministri për informata shtesë, e cila pastaj do të adreson kërkesën tek shteti kërkues. Gjykata mund të caktojë një afat kohor për pranimin e saj.
10. Gjykata mund të vlerësoj çdo provë tjetër që e konsideron si të nevojshme.
11. Në rastet kur ndaj personave që kërkohen të ekstradohen, janë duke u zhvilluar procedura penale në Republikën e Kosovës, Gjykata do ta evidentoj atë në procesverbal dhe poashtu do ta njoftoj Ministrinë. Në këto raste Gjykata do të provojë mundësitë e ngrirjes së çdo prone të të pandehurit për të siguruar shpërblimin e palës së dëmtuar sa i përket procedurës penale në Republikën e Kosovës.

Neni 24
Procedura e thjeshtësuar për ekstradim

1. Ministria mund të pajtohet që personi i kërkuar të ekstradohet nëpërmjet një procedure të thjeshtuar të ekstradimit me kusht që edhe personi të jep pëlqimin dhe që shteti kërkues pranon ekstradimin përmes procedurës së thjeshtuar.
2. Pëlqimi i paraparë në paragrafin 1. të këtij neni do të jepet para gjykatës kompetente dhe do të regjistrohet në pajtim me dispozitat e Kodit të Procedurës Penale, duke u siguruar që pëlqimi është dhënë mbi bazën vullnetare dhe se personi është në dijeni për pasojat që do të rrjedhin. Pëlqimi i dhënë nuk mund të tërhiqet.
3. Personi mund gjithashtu të deklarojë se ai/ajo heq dorë nga përfitimi prej parimit të specialitetit të paraparë në nenin 30 paragrafi 3. të këtij ligji.
4. Nëse gjykata konstaton se ekstradimi i thjeshtuar është i pranueshëm, ajo do të përmend atë në vendim, dhe do të vendos mbi masat për sigurimin e pranisë së personit deri në dorëzim. Vendimi është përfundimtar.
5. Kur personi i kërkuar është subjekt i kërkesës për arrestim të përkohshëm në pajtim me nenin 22 të këtij.ligji, kërkesa për ekstradim dhe dokumentet mbështetëse në përputhje me nenin 18 paragrafi 2. të këtij ligji nuk do të jetë e nevojshme të paraqitet në rast të ekstradimit të thjeshtësuar. Informatat e mëposhtme të ofruara nga shteti kërkues do të konsiderohen si të mjaftueshme për

qëllimin e ekstradimit të thjeshtuar:

5.1. identiteti i personit të kërkuar, përfshirë edhe shtetësinë e tij apo të saj kur është në dispozicion;
5.2. organi që kërkon arrestimin;
5.3. informata mbi ekzistencën e një urdhër arresti apo dokumenti tjetër që ka të njëjtin efekt ligjor apo të një vendimi të detyrueshëm;
5.4. natyra dhe përshkrimi ligjor i veprës penale, dënimin maksimal apo dënimin e shqiptuar në aktgjykimin e formës së prerë, duke përfshirë edhe nëse ndonjë pjesë e aktgjykimit tashmë është zbatuar;
5.5. informata në lidhje me parashkrimin;
5.6. një përshkrim të rrethanave në të cilat është kryer vepra, duke përfshirë kohën, vendin dhe shkallën e përfshirjes së personit të kërkuar;
5.7. në rastet kur kërkohet ekstradimi për zbatimin e një vendimi të formës së prerë, nëse vendimi është dhënë në mungesë, në këtë rast dispozitat e nenit 18 paragrafi 2.4. të këtij ligji zbatohen *mutatis mutandis*.

6. Gjykata, pa ndonjë vonesë, do të lajmërojë Ministrinë në lidhje me vendimin e lëshuar në pajtim me këtë nen.
7. Ekstradimi përmes procedurës së thjeshtësuar do të ketë efekte dhe pasoja të njëjta ligjore sikur ekstradimi i lejuar përmes procedurës së rregullt.

Neni 25
Dorëzimi i sendeve në procedurën e ekstradimit

1. Në kërkesën e shtetit kërkues, në përputhje me ligjin vendor, gjykata kompetente do konfiskoj dhe dorëzoj sendet që mund të përdoren si provë, apo të cilat janë fituar si rezultat i veprës penale ose janë përdorur në kryerjen e veprës penale.
2. Sendet e parapara në paragrafin 1. të këtij neni do të dorëzohen në shtetin kërkues nëse kërkesa për ekstradim është pranuar, por ekstradimi nuk është realizuar si pasojë e vdekjes ose arratisjes së personit të kërkuar.
3. Nëse sendet dhe materialet e parapara në paragrafin 1. të këtij neni i nënshtrohen sekuestrimit ose konfiskimit në Republikën e Kosovës, në lidhje me ndonjë procedurë penale që është në zhvillim e sipër, ato përkohësisht mund të mbahen ose dorëzohen me kusht që të rikthehen në Republikën e Kosovës.
4. Në rastet kur është fituar e drejta nga Republika e Kosovës ose nga palët e treta në Kosovë rreth artikujve dhe materialeve të referuara në paragrafin 1. të këtij neni, ata duhet të kthehen në Republikën e Kosovës, pa pagesë dhe sa më shpejt që të jetë e mundur pas përfundimit të gjykimit.

Neni 26
Vendimi për lejueshmërinë e ekstradimit

1. Nëse kolegji prej tre gjyqtarësh të Gjykatës Themelore kompetente gjen se kushtet ligjore për lejueshmërinë e kërkesës për ekstradim janë plotësuar, atëherë nxjerr vendim për lejueshmërinë e ekstradimit.
2. Personi i kërkuar mund të parashtrojë ankesë kundër këtij vendimi në Gjykatën e Apelit, brenda tre (3) ditëve nga marrja e vendimit.
3. Ankesa e shtynë ekzekutimin e vendimit.

Neni 27
Vendimi për mos-lejueshmërinë e ekstradimit

1. Nëse kolegji prej tre (3) gjyqtarëve të Gjykatës Themelore kompetente gjen se kërkesat ligjore për ekstradim nuk janë përmbushur, nxjerr vendim me të cilin nuk e lejon kërkesën për ekstradim.
2. Prokuroria Themelore mund të parashtrojë ankesë kundër këtij vendimi në afat prej tre (3) ditësh nga dita e dorëzimit të vendimit.
3. Nëse personi është në paraburgim, kolegji prej tre (3) gjyqtarësh, me kërkesë të Prokurorisë Themelore, mund të vendos që personi të mbetet në paraburgim derisa vendimi për refuzimin e ekstradimit bëhet i formës së prerë.

Neni 28
Vendimi për ankesë

1. Një panel prej tre gjyqtarësh në Gjykatën e Apelit do të vendos rreth ankesave, sipas dispozitave të Kodit të Procedurës Penale mbi ankesat kundër aktvendimeve.
2. Nëse Gjykata e Apelit gjen se ekstradimi është i lejueshëm, gjithashtu do të vendos për çdo masë për sigurimin e pranisë së personit deri në dorëzim.

Neni 29
Dorëzimi i vendimit në Ministri

Pas vendimit të formës së prerë, Gjykata Themelore kompetente ia dorëzon Ministrisë atë dhe çdo vendim tjetër relevant të marrë nga Gjykatat.

Neni 30
Vendimi i Ministrit

1. Në rast se Gjykata ka vendosur në favor të ekstradimit, atëherë Ministri mund të jep pëlqim për ekstradim apo të refuzoj atë.
2. Ministri mund të shtyj ekstradimin e personit të kërkuar për arsye të procedurës tjetër penale që është duke u zhvilluar para organeve gjyqësore vendore kundër personit të kërkuar ose për arsye se personi është duke vuajtur dënimin në Republikën e Kosovës. Ministri mund të vendosë që përkohësisht të dorëzojë personin apo t'a dorëzoj atë nën kushte të caktuara, që janë përcaktuar me marrëveshje të përbashkët me shtetin kërkues.
3. Ministri me vendimin me të cilin jep pëlqim për ekstradim mund të përcaktojë kushtet e mëposhtme:
   3.1. ndaj personit i cili ekstradohet nuk mund të zhvillohet procedurë tjetër penale ose të dënohet për vepër tjetër penale të kryer para ekstradimit dhe për të cilën vepër ekstradimi nuk është lejuar;
   3.2. personit nuk mund t'i shqiptohet dënim më i rëndë se sa ai që është dhënë;
   3.3. personi nuk mund të dorëzohet apo ekstradohet tek shteti i tretë pa lejen e Ministrit.
4. Ministri i Drejtësisë mund të vendos edhe kushte të tjera për ekstradim.

5. Në rastet kur gjykata vendos se ekstradimi nuk është i lejueshëm, Ministri nxjerr vendim për refuzimin e ekstradimit.
6. Vendimi i Ministrit është i përfundimtar dhe ndaj tij mund të inicohet konflikti administrativ.

Neni 31
Ndjekja penale në rast të refuzimit të ekstradimit

Nëse ekstradimi është refuzuar, Prokuroria kompetente mund të iniciojë procedurë penale në Republikën e Kosovës kundër atij personi.

Neni 32
Komunikimi i Vendimit

Ministria e Drejtësisë ia komunikon menjëherë vendimin për ekstradim Shtetit kërkues nëpërmjet kanaleve të rregullta të komunikimit. Me vendimin për ekstradim gjithashtu do të njoftohet edhe Ministria e Punëve të Brendshme.

Neni 33
Dorëzimi i personit të kërkuar

1. Ministria me shtetin kërkues pajtohen lidhur me datën dhe vendin e dorëzimit. Shteti kërkues do të marrë përsipër personin brenda tridhjetë (30) ditëve nga dita e pranimit të vendimit për ekstradim. Bazuar në kërkesën e arsyetuar të shtetit kërkues, Ministria mund ta zgjasë këtë afat edhe për pesëmbëdhjetë (15) ditë tjera.
2. Policia dorëzon personin tek autoritetet e caktuara nga shteti kërkues në kohën dhe vendin e rënë dakord për dorëzim, së bashku me të gjitha sendet dhe materialet të identifikuara në nenin 25 të këtij ligji.
3. Nëse shteti kërkues nuk e mer përsipër personin që do të ekstradohet, në pajtim me paragrafin 2. të këtij neni, personi në fjalë menjëherë do të lirohet dhe Ministri mund të refuzoj një kërkesë të përsëritur për ekstradim në lidhje me të njëjtën vepër penale.

Neni 34
Kërkesat konkurruese për ekstradim

1. Kur disa shtete kërkojnë ekstradimin e të njëjtit person, Ministri i Drejtësisë vendos në cilin shtet personi i kërkuar do të ekstradohet.
2. Duke vendosur sipas paragrafit 1. të këtij neni, Ministri do të marrë parasysh kriteret e mëposhtme:
   2.1. vendin e kryerjes së veprës penale;
   2.2. rëndësinë e veprës penale;
   2.3. datat përkatëse të kërkesave për ekstradim;
   2.4. nëse kërkesat për ekstradim është parashtruar për qëllime të ndjekjes penale apo për vuajtje të dënimit;
   2.5. shtetësinë e personit të kërkuar.

Neni 35
Përsëritja e kërkesës për ekstradim

Nëse kërkesa për ekstradim është refuzuar, një kërkesë e re për ekstradim kundër të njëjtit person dhe për të njëjtën vepër penale mund të rishqyrtohet nëse është e mbështetur në elemente të reja të cilat nuk janë shqyrtuar në bazë të kërkesës së mëparshme.

Neni 36
Transiti nëpër territorin e Republikës së Kosovës

1. Ministria, mund të jap leje për kalim transit përmes territorit të Republikës së Kosovës të personit që ekstradohet nga një shtet në një tjetër, nëse një kërkesë e tillë është parashtruar nga shteti përkatës.
2. Transiti i personave për qëllime të ekstradimit për një vepër penale të paraparë në nenet 15, 16 ose që është në kundërshtim me paragrafin 2. të nenit 55 të këtij ligji nuk është i lejuar.
3. Ministria mund të refuzojë kërkesën për transit:
   3.1. nëse personi i ekstraduar është shtetas i Republikës së Kosovës;
   3.2. në qoftë se vepra penale për të cilën personi është duke u ekstraduar nuk konsiderohet si vepër penale nga ligji vendor.
4. Personi në transit mund të mbahet në paraburgim brenda territorit të Republikës së Kosovës vetëm për kohën e nevojshme për transit.
5. Nëse një person kalon përmes transportit ajror dhe nuk është planifikuar aterimi në territorin e Republikës së Kosovës, leja e referuar në paragrafin 1. nuk është e nevojshme. Megjithatë, Ministria duhet të njoftohet lidhur me tranzitin. Në rast të aterimit të pa planifikuar, ky njoftim duhet të trajtohet si kërkesë për transit. Njoftimi duhet të përmbaj emrin dhe shtetësinë e personit të ekstraduar, shtetin ku personi ekstradohet dhe kohën e kalimit tranzit ajror.

NËNKREU II
EKSTRADIMI NGA SHTETI I HUAJ NË KOSOVË

Neni 37
Kërkesa për ekstradim

1. Ekstradimi i personit kundër të cilit është lëshuar urdhër arrest, aktvendim për caktimin e paraburgimit ose është i dënuar me vendim të formës së prerë nga organet gjyqësore vendore, mund të kërkohet nga shteti në territorin e të cilit personi është apo besohet të gjendet.
2. Deri në paraqitjen e aktakuzës, prokurori kompetent i shtetit mund të kërkojë nga Ministria të kërkoj ekstradimin nga një shtet tjetër. Pas paraqitjes së aktakuzës gjykata kompetente mund të kërkoj nga Ministria që të kërkoj ekstradimin nga një shtet tjetër.
3. Kërkesa për ekstradim së bashku me dokumentet dhe informatat e përcaktuara në nenin 18, paragrafin 2. te këtij ligji, duhet të paraqitet tek shteti i kërkuar përmes kanaleve të përcaktuara në nenin 4 të këtij ligji.

4. Kërkesa për ekstradim duhet të përmbaj poashtu një kërkesë për të gjitha të dhënat relevante, duke përfshirë të gjitha deklaratat e dhëna nga personi, ekstradimi i të cilit është kërkuar si dhe të gjitha sendet e identifikuara në nenin 22 të këtij ligji, nëse është e nevojshme.

Neni 38
Kërkesa për arrestim të përkohshëm me qëllim të ekstradimit

1. Organi kompetent gjyqësor, që është i ngarkuar me rastin, mund të kërkojë nga Ministria të dorëzoj tek shteti i huaj ku personi i kërkuar është lokalizuar, kërkesën për arrest të përkohshëm të personit në pritje të ekstradimit. Në raste urgjente Ministria mund të paraqesë kërkesën e tillë drejtpërdrejtë.
2. Kërkesa për arrestim të përkohshëm me qëllim të ekstradimit duhet të theksoj se dokumentet e parapara në nenin 18 paragrafi 2. të këtij ligji ekzistojnë dhe duhet të konfirmoj se ekstradimi do të kërkohet përmes kanaleve të rregullta në kohën e duhur.

Neni 39
Parimi i specialitetit dhe kushtet e tjera

1. Personi i ekstraduar në Republikën e Kosovës nuk do të ndiqet penalisht ose dënohet për ndonjë vepër penale të kryer para dorëzimit të tij apo saj, përveç veprës penale për të cilën është lejuar ekstradimi, me përjashtim të rasteve të mëposhtme:
   1.1. kur shteti i kërkuar jep pëlqimin. Kërkesa për pëlqim mund të dërgohet nga Ministria dhe të shoqërohet me dokumentet e përmendura në nenin 18 të këtij ligji dhe procesverbalin e çdo deklarate të dhënë nga personi i ekstraduar në lidhje me veprën penale në fjalë;
   1.2. kur ky person, pasi ka pasur mundësinë të largohet nga territori i Republikës së Kosovës, nuk e ka bërë këtë brenda dyzetepesë (45) ditëve nga lirimi përfundimtar i tij apo saj, ose pas largimit është kthyer në territorin e Republikës së Kosovës.
2. Kur ekstradimi i dhënë, është kushtëzuar në lidhje me llojin dhe peshën e dënimit, gjykata do t'i përmbahet këtyre kushteve gjatë shqiptimit të dënimit. Nëse është i përfshirë zbatimi i një dënimi tashmë të shqiptuar, gjykata e cila e ka gjykuar rastin në shkallën e fundit, do të ndryshoj vendimin dhe të shqiptoj dënim në pajtim me kushtet e ekstradimit.
3. Nëse personi i ekstraduar ka qenë në paraburgim në shtetin e huaj për veprën penale për të cilën ai apo ajo është ekstraduar, koha e kaluar në paraburgim llogaritet në dënimin e shqiptuar.
4. Autoritetet vendore respektojnë të gjitha kushtet e tjera të përcaktuara nga shteti i kërkuar.

Neni 40
Procedura pas arrestimit në bazë të urdhër kërkimit ndërkombëtar

Nëse personi i kërkuar është arrestuar në një shtet të huaj në bazë të urdhër kërkimit ndërkombëtar të lëshuar nga INTERPOL-i, Ministria menjëherë e dorëzon tek ai shtet kërkesën për ekstradim në Republikën e Kosovës.

KREU III
TRANSFERIMI I PROCEDURËS PENALE

NËNKREU I
TRANSFERIMI I PROCEDURËS PENALE NGA SHTETET E HUAJA NË REPUBLIKËN E KOSOVËS

Neni 41
Parimet

Procedura penale e filluar apo e cila pritet të filloj në një shtet tjetër mund të transferohet në Republikën e Kosovës me kërkesën e atij shteti.

Neni 42
Kushtet për pranimin e transferimit të procedurës penale

1. Transferimi i procedurës penale mund të pranohet nga Republika e Kosovës vetëm nëse vepra penale e cila është subjekt i kërkesës për transferim të procedurës penale, konsiderohet vepër penale edhe në Republikën e Kosovës.
2. Transferimi i procedurës penale mund të pranohet në një nga rastet e mëposhtme:
   2.1. personi i dyshuar është banor i përhershëm i Republikës së Kosovës;
   2.2. personi është shtetas i Republikës së Kosovës, ose Kosova është shteti i origjinës i tij apo saj;
   2.3. personi është duke vuajtur ose duhet të vuaj dënimin me heqje lirie në Republikën e Kosovës;
   2.4. kundër personit të dyshuar në Republikën e Kosovës është duke u ndërmarrë procedurë për të njëjtën apo vepër penale tjetër;
   2.5. në qoftë se konsiderohet se transferimi i procedurës është i garantuar në interes të gjetjes së të vërtetës dhe në veçanti që nëse provat më të rëndësishme gjenden në Republikën e Kosovës;
   2.6. nëse një dënim do të shqiptohej dhe nëse konsiderohet se zbatimi i tij në Republikën e Kosovës mund të përmirësojë perspektivën për rehabilitim social të personit të dënuar.

Neni 43
Refuzimi i transferimit të procedurës penale

1. Transferimi i procedurës penale mund të refuzohet në qoftë se:
   1.1. konsiderohet që vepra për të cilin është kërkuar transferimi i procedurës penale është e natyrës politike apo ushtarake;
   1.2. organet gjyqësore të shtetit të kërkuar nuk janë kompetent për të ndjekur atë vepër penale.
2. Transferimi i procedurës penale refuzohet në rastet kur ekziston ndonjë prej rrethanave që nuk lejojnë fillimin e procedurës penale të parashikuar me legjislacionin vendor.

Neni 44
Tërheqja e pranimit

1. Pranimi i transferimit mund të tërhiqet kur:
   1.1. bëhet e qartë që prania e personit të dyshuar nuk mund të sigurohet në seancat gjyqësore në Republikën e Kosovës ose që dënimi i cili mund të shqiptohet nuk do të mund të zbatohej në Kosovë;
   1.2. në qoftë se përpara se çështja të jetë paraqitur në gjykatë bëhet e qartë një prej arsyeve për refuzim, të parashikuara në nenin 43 të këtij ligji;
   1.3. në raste të tjera, në qoftë se shteti kërkues pajtohet.

Neni 45
Kërkesa për transferimin e procedurës penale

1. Kërkesa për transferim të procedurës penale duhet të paraqitet me shkrim tek Ministria dhe do të shoqërohet nga dokumente origjinale apo kopje të vërtetuara të dosjes penale, bashkangjitur me shkresa tjera të nevojshme.
2. Shteti kërkues do të njoftojë Ministrinë lidhur me çdo veprim procedural të kryer ose mbi masat e ndërmarra pas dërgimit të kërkesës që ka të bëjë me procedurën penale. Këtij komunikimi duhet bashkangjitur dokumentet përkatëse.

Neni 46
Veprimi lidhur me kërkesë

1. Pas pranimit të kërkesës për transferimin e procedurës penale, Ministria do të përcjellë menjëherë atë tek Prokuroria kompetente sipas Kodit të Procedurës Penale, me qëllim që të vendos të pranoj transferimin apo jo.
2. Vendimi i përmendur në paragrafin 1. të këtij neni përcillet menjëherë tek Ministria për përcjellje të mëtutjeshme tek shteti kërkues

Neni 47
Komunikimi i vendimit

1. Ministria do t'i komunikojë shtetit kërkues vendimin mbi pranimin apo refuzimin e kërkesës për transferim të procedurës penale.
2. Ministria njofton shtetin kërkues për vendimin final të marrë si rezultat i transferimit të procedurës penale. Shtetit kërkues i përcillet një kopje e vërtetuar e vendimit të shqiptuar.

Neni 48
Vlefshmëria e veprimeve të marra në shtetin kërkues

1. Çdo veprim që i përket procedurës që do të transferohet i ndërmarrë në shtetin kërkues në përputhje me ligjin dhe rregulloret e tij, do të jetë i barasvlershëm në Republikën e Kosovës, sikur të ishte ndërmarrë nga organet vendore, me kusht që ato veprime janë në përputhje me ligjin vendor.
2. Çdo veprim i cili ndërpret afatin e parashkrimit dhe që është ndërmarrë në mënyrë të vlefshme në shtetin kërkues do të ketë efekt të njëjtë në Republikën e Kosovës.

Neni 49
Procedura e filluar në bazë të padisë private

1. Nëse fillimi i procedurës varet nga padia private në Republikën e Kosovës dhe në shtetin kërkues, atëherë padia private e ngritur në shtetin kërkues ka efekt të njëjtë juridik sikur të ishte ngritur në Republikën e Kosovës.
2. Nëse padia private është e domosdoshme vetëm në Republikën e Kosovës, transferimi i procedurës penale mund të pranohet edhe në mungesë të saj në qoftë se personi i cili ka të drejtë ta paraqes atë nuk ka paraqitur kundërshtim brenda afatit prej një muaji nga data e pranimit të njoftimit nga organi kompetent lidhur me te drejtën e tij apo saj për të kundërshtuar.

NËN KREU II
TRANSFERIMI I PROCEDURËS NGA KOSOVA TEK NJË SHTET TJETËR

Neni 50
Parimet

Nëse dyshohet se personi ka kryer vepër penale të paraparë me ligjin në fuqi në Republikën e Kosovës, organet gjyqësore vendore, në pajtim me dispozitat e këtij ligji, mund t'i kërkojnë shtetit tjetër marrjen përsipër të procedurës penale, sipas kushteve të përcaktuara në këtë Kapitull.

Neni 51
Pezullimi i Përkohshëm i Procedurës Penale në Republikën e Kosovës

1. Organet gjyqësore në Republikën e Kosovës mund të pezullojnë përkohësisht procedurën penale kundër një personi, vetëm në rastet kur janë plotësuar kushtet e parapara me këtë ligj.
2. Çdo vendim për pezullim të procedurës penale duhet të konsiderohet si i përkohshëm derisa shteti i kërkuar të njoftoj Ministrinë për vendimin për pranimin e transferimit të procedurës penale.

Neni 52
Kushtet për transferimin e procedurës penale

1. Procedura penale mund të transferohet nëse:
   1.1. personi i dyshuar është shtetas i shtetit të kërkuar ose shteti i kërkuar është shteti i tij i origjinës;
   1.2. personi i dyshuar është duke vuajtur ose duhet të vuaj një dënim me burgim në shtetin e kërkuar;
   1.3. shteti i kërkuar ka filluar procedurën penale për të njëjtën vepër ose vepra të tjera penale kundër personit të dyshuar;
   1.4. konsiderohet se transferimi i procedurës është i arsyetuar në interes të arritjes të së vërtetës dhe në veçanti nëse provat më të rëndësishme gjenden në shtetin e kërkuar;
   1.5. nëse do të shqiptohej një dënim, ekzekutimi i dënimit në shtetin e kërkuar do t'i shërbente rehabilitimit më të mirë social të personit të dënuar;

1.6. prezenca e personit të dyshuar në shqyrtimin gjyqësor në Republikën e Kosovë nuk mund të sigurohet, ndërsa një gjë e tillë mund të bëhet në shtetin e kërkuar;
1.7. dënimi me burgim, nëse do të shqiptohej, nuk do të mund të ekzekutohej as përmes ekstradimit apo nëse është refuzuar kërkesa për ekstradim.

Neni 53
Organi gjyqësor që parashtron kërkesën për transferim

1. Para ngritjes së aktakuzës, kërkesa për transferim të procedurës penale duhet të paraqitet nga prokurori kompetent i shtetit. Pas ngritjes së aktakuzës, kërkesa duhet të paraqitet nga gjykata kompetente.
2. Kërkesat për transferimin e procedurës duhet të dërgohen në Ministri së bashku me komplet dosjen e lëndës.

Neni 54
Efektet e transferimit

1. Kur kërkesa për transferim është parashtruar, organet gjyqësore vendore nuk mund të ndjekin penalisht më tutje personin për veprën penale që është subjekt i kërkesës apo të zbatojnë një vendim të shqiptuar më parë në Republikën e Kosovës kundër tij apo saj për atë vepër penale. Megjithatë përderisa nuk është pranuar vendimi i shtetit të kërkuar lidhur me kërkesën për transferim të procedurës, organet gjyqësore vendore e ruajnë të drejtën të ndërmarrin të gjitha masat e ndjekjes, me përjashtim të sjelljes së çështjes në gjykatë.
2. E drejta e ndjekjes do t'i kthehet organeve gjyqësore vendore nëse:
   2.1. shteti i kërkuar e njofton Ministrinë rreth vendimit për të mos ndërmarrë veprime në lidhje me kërkesën;
   2.2. shteti i kërkuar e njofton Ministrinë rreth vendimit për refuzimin e pranimit të kërkesës;
   2.3. shteti i kërkuar e njofton Ministrinë rreth vendimit për tërheqjen e pranimit të kërkesës;
   2.4. shteti i kërkuar e njofton Ministrinë rreth vendimit për të mos filluar apo ndërprerë procedurën;
   2.5. organi vendor që ka bërë kërkesën e tërheq atë para se shteti i kërkuar të njoftoj rreth ndonjë vendimi për të vepruar në lidhje me kërkesën.
3. Vendimi i formës së prerë i shpallur në shtetin e kërkuar prodhon të njëjtat efekte si të ishte vendim i shpallur në Republikën e Kosovës.

KREU IV
TRANSFERIMI I PERSONAVE TË DËNUAR

NËNKREU I
TRANSFERIMI I PERSONAVE TË DËNUAR NGA REPUBLIKA E KOSOVËS TEK SHTETI TJETËR

Neni 55
Parimet

Personi i cili është dënuar me burgim në Republikën e Kosovës mund të transferohet në shtetin tjetër, me qëllim të mbajtjes së dënimit apo pjesës së mbetur të dënimit.

Neni 56
Kushtet për Transferim

1. Në përputhje me këtë.igj, personi i dënuar mund të transferohet vetëm pas plotësimit të kushteve në vijim:
   1.1. personi është shtetas i shtetit zbatues;
   1.2. aktgjykimi është i formës së prerë;
   1.3. në kohën e pranimit të kërkesës për transferim, personi i dënuar ka ende të paktën gjashtë (6) muaj të dënimit për të vuajtur apo nëse dënimi është i pacaktuar;
   1.4. personi i dënuar pajtohet me transferimin, ose duke marrë parasysh moshën ose gjendjen e tij apo saj fizike apo mendore, një pëlqim i tillë jepet nga përfaqësuesi i autorizuar;
   1.5. shteti zbatues pajtohet për transferim.
2. Transferimi i personit të dënuar nuk lejohet nëse:
   2.1. ka dyshime se personi i kërkuar për transferim mund t'i nënshtrohet torturës, dënimeve apo trajtimeve tjera mizore, çnjerëzore ose poshtëruese.
   2.2. ka arsye serioze për të besuar se, nëse personi i kërkuar transferohet, ai apo ajo do të ndiqet penalisht ose të dënohet për shkak të racës, fesë, shtetësisë, përkatësisë në një grup të caktuar shoqëror ose bindjeve politike, ose që gjendja e tij apo saj do të vështirësohej edhe më shumë për shkak të njërës nga këto arsye.
3. Në raste të veçanta, Ministria mund ta miratoj kërkesën për transferim edhe nëse kohëzgjatja e dënimit të mbetur për tu vuajtur është më e shkurtër se ajo e përcaktuar në paragrafin 1.3. të këtij neni.
4. Ministria në pranimin e kërkesës për transferim mund të përcaktojë kushtet e mëposhtme:
   4.1. personi që do të transferohet nuk do të ndiqet penalisht ose të dënohet për një vepër tjetër penale të kryer para transferimit;
   4.2. personit nuk mund t'i shqiptohet dënim më i rëndë se sa ai që është dhënë;
   4.3. personi nuk mund të dorëzohet apo ekstradohet tek shteti i tretë pa lejen e Ministrisë;
5. Ministria mund të vendos edhe kushte të tjera për transferim.

Neni 57
Obligimi për dhënie të informatave

1. Shtetasi i huaj i dënuar me vendim të formës së prerë në Republikën e Kosovës duhet të informohet për dispozitat e këtij Kapitulli.
2. Nëse personi i dënuar me aktgjykim të formës së prerë ka shprehur interes për t'u transferuar në pajtim me këtë Ligj, Ministria mund të njoftoj shtetin tjetër përkatës
3. Njoftimi përmban:
   3.1. emrin, datën dhe vendin e lindjes së personit të dënuar;
   3.2. adresën e tij apo saj, nëse ka në territorin e shtetit zbatues;
   3.3. përshkrimin e fakteve mbi të cilat është bazuar dënimi; dhe
   3.4. natyrën dhe kohëzgjatjen e dënimit dhe datën e fillimit të zbatimit të dënimit.
4. Nëse personi i dënuar i ka shprehur interesimin për transferim shtetit zbatues, Ministria në bazë të kërkesës së shtetit zbatues i komunikon atij Shteti të dhënat e përmendura në paragrafin 3. të këtij neni.
5. Personi i dënuar njoftohet me shkrim në gjuhën të cilën ai apo ajo e kupton, për çdo veprim të ndërmarrë nga autoritetet e Republikës së Kosovës ose nga shteti zbatues në përputhje me paragrafin 4. të këtij neni, si edhe çdo vendim nga secili shtet lidhur me kërkesën për transferim.

Neni 58
Pëlqimi dhe Konfirmimi

Organi korrektues apo zyrtari i autorizuar duhet te sigurojë që personi i cili jep pëlqimin për transferim, këtë e bën në mënyrë vullnetare dhe me vetëdije të plotë për pasojat ligjore.

Neni 59
Kërkesa për transferim dhe dokumentet mbështetëse

1. Kërkesa për transferim e Ministrisë tek shteti tjetër duhet të bëhet në mënyrë të shkruar.
2. Kërkesa duhet të mbështetet nga dokumentet ne vijim:
   2.1. origjinali apo kopja e vërtetuar e Aktgjykimit dhe ekstrakti i ligjit relevant;
   2.2. deklaratën nga institucioni korrektues mbi masën e dënimit të mbajtur, përfshirë informatat e kohës se kaluar në paraburgim apo çdo informatë tjetër lidhur me zbatimin e dënimit;
   2.3. deklaratë me shkrim për dhënien e pëlqimit për transferim nga i dënuari;
   2.4. kur është e nevojshme, raport mjekësor apo social mbi të dënuarin, informata lidhur me trajtimin e tij apo saj në Republikën e Kosovës, dhe çdo rekomandim tjetër lidhur me trajtimin e tij në shtetin zbatues.
3. Para dërgimit të kërkesës për transferim, Ministria mund të kërkojë nga shteti zbatues të sigurojë:
   3.1. dokument apo deklaratë me të cilën vërtetohet se personi i dënuar është shtetasi i atij shteti;
   3.2. deklaratë mbi procedurën e zbatimit të dënimit, në vazhdimin e ekzekutimit të dënimit apo përmes përshtatjes së dënimit.

Neni 60
Transferimi i personave të dënuar në bazë të urdhrit për deportim apo dëbim

1. Ministria mund të jap pëlqimin për transferimin e personit të dënuar pa pëlqimin e tij apo saj, kur është i shqiptuar urdhri për dëbim apo deportim apo ndonjë masë tjetër, sipas së cilit personi nuk lejohet të qëndrojë në territorin e Republikës së Kosovës pasi që ai apo ajo të lirohet.
2. Ministria mund të lejoj transferimin në bazë të paragrafit 1. të këtij neni vetëm pasi të jetë njoftuar me mendimin e personit të dënuar.
3. Ministria i ofron shtetit zbatues dokumentet në vijim:
   3.1. deklaratë që përmban mendimin e personit të dënuar lidhur me transferimin e tij apo saj; dhe
   3.2. kopjen e urdhrit për deportim apo dëbim apo ndonjë urdhri tjetër me të cilin personit i ndalohet qëndrimi në territorin e Republikës së Kosovës pasi që ai apo ajo është liruar nga burgu.
4. Kur një person është transferuar pa pëlqimin e tij apo saj, siç parashihet në këtë nen, Ministria në bazë të kërkesës së shtetit zbatues mund të autorizoj atë shtet që të ndjek penalisht, dënoj apo të mbajë personin e transferuar për një vepër penale të kryer para transferimit. Autorizimi i tillë mund të jepet vetëm kur vepra penale për të cilën është kërkuar do t'i nënshtrohej ekstradimit sipas ligjit vendor ose kur ekstradimi do të përjashtohej vetëm për lartësinë e dënimit.

Neni 61
Efektet e Transferimit

1. Transferimi i personit të dënuar tek autoritetet e shtetit zbatues suspendon ekzekutimin e dënimit në Republikën e Kosovës.
2. Autoritetet e Republikës së Kosovës nuk do të ekzekutojnë dënimin nëse shteti zbatues konsideron se ekzekutimi i dënimit është përfunduar.

NËNKREU II
TRANSFERIMI I PERSONAVE TË DËNUAR NGA SHTETET TJERA NË REPUBLIKËN E KOSOVËS

Neni 62
Qëllimi dhe kushtet për transferim

1. Ministria mund të lejoj transferimin e personit të dënuar nga shteti tjetër, në institucionet korrektuese të Republikës së Kosovës me qëllim të vuajtjes së dënimit apo pjesës së mbetur të dënimit, me kusht që vepra penale për kryerjen e të cilës personi është dënuar në shtetin dënues është vepër penale edhe në bazë të ligjit vendor.
2. Transferi mund të lejohet në bazë të kërkesës në të shkruar së paraqitur tek Ministria nga shteti dënues apo personi i dënuar ose nga një person i autorizuar nga ai apo ajo, nëse shteti dënues jep pëlqimin për transfer.
3. Nenet 56, 59 dhe 60 të këtij ligji zbatohen *mutatis mutandis.*

Neni 63
Procedura e Ekzekutimit

1. Personat që transferohen në bazë të këtij ligji i nënshtrohen njërës nga procedurave të e mëposhtme:
   1.1. vazhdimit të ekzekutimit dënimit, kur shteti dënues është shtet anëtar i Bashkimit Europian, apo shtet me të cilin Republika e Kosovës ka marrëveshje ndërkombëtare me të cilat parasheh vazhdimin e dënimit;
   1.2. konvertimit të dënimit, kur shteti dënues është shtet tjetër nga ata të përmendur në paragrafin 1.1. të këtij neni.
2. Gjykata Themelore e Prishtinës është gjykata kompetente për të vendosur lidhur me procedurën e përmendur sipas paragrafit 1. të këtij neni. Vendimet nuk mund të ankimohen.

Neni 64
Vazhdimi i ekzekutimit të dënimit

1. Në rastet e referuara në paragrafin 1.1. të nenit 63 të këtij ligji, gjykata kompetente do të lëshoj vendim me të cilin vazhdon ekzekutimin e dënimit të shqiptuar në Shtetin dënues. Gjykata është e detyruar t'i përmbahet natyrës ligjore dhe kohëzgjatjes së dënimit të shqiptuar në Shtetin dënues.
2. Në rast se dënimi i shqiptuar në Shtetin dënues, për nga natyra ose kohëzgjatja nuk përputhet me ligjin vendor, dënimi duhet të konvertohet në përputhje me nenin 65 të këtij ligji.

Neni 65
Konvertimi i Dënimit

1. Në rastet e referuara në paragrafin 1.2. të nenit 63 të këtij ligji, gjykata kompetente lëshon vendim me të cilin shqipton dënim në pajtim me ligjin vendor.
2. Gjykata gjatë konvertimit të dënimit duhet:
   2.1. t'i përmbahet gjetjeve të paraqitura në gjykimin e shqiptuar nga shteti dënues;
   2.2. të mos konvertojë dënimin me burgim në dënim me gjobë;
   2.3. të llogaris në dënimin final kohën e mbajtur të dënimit në shtetin dënues nga personi i dënuar, dhe
   2.4. të mos rëndoj statusin penal të personit të dënuar dhe nuk është e lidhur me dënimin minimal të përcaktuar për atë vepër penale me ligjin e shtetit dënues.
3. Procedura e konvertimit duhet të përfundojë para transferimit të personit të dënuar.

Neni 66
Personat e arratisur nga shteti dënues

1. Në rastet kur shtetasi i Republikës së Kosovës është dënuar në shtetin e huaj me aktgjykim të formës së prerë, përmes arratisjes në Republikën e Kosovës tenton t'i ikë ekzekutimit të mëtejmë të dënimit në atë shtet, me kërkesë të organit kompetent të huaj Ministria mund të pajtohet të merr përsipër ekzekutimin e dënimit në Republikën e Kosovës.

2. Me kërkesë të shtetit dënues, organi gjyqësor në Republikën e Kosovës mund që para pranimit të dokumenteve mbështetëse të kërkesës ose para vendimit mbi kërkesën, të arrestojë personin e dënuar apo të marrë çfarëdo mase tjetër për të siguruar që personi i dënuar të mbetet në territorin e Republikës së Kosovës, në pritje të vendimit lidhur me kërkesën. Kërkesa për arrest të përkohshëm duhet të përmbaj të dhënat e parapara në paragrafin 3. të nenit 60 të këtij ligji. Pozita juridike e personit të dënuar nuk duhet të rëndohet si rezultat i çfarëdo qoftë periudhe të kaluar në mbajtje, në pajtim me këtë paragraf.
3. Pëlqimi i personit të dënuar nuk kërkohet për transferimin e ekzekutimit të dënimit.

Neni 67
Garancia për personat e dënuar të transferuar pa pëlqimin e tyre

1. Çdo person i transferuar në Republikën e Kosovës pa vullnetin e tij apo saj sipas nenit 60 të këtij ligji, nuk do të ndiqet penalisht, dënohet apo mbahet për një vepër penale të kryer para transferimit te tij apo saj, përveç asaj për të cilën është shqiptuar dënimi që do të ekzekutohet, si dhe nuk do të privohet nga liria për ndonjë arsye tjetër përveç për veprën për të cilën është lejuar transferimi, përjashtimisht nëse shteti dënues e autorizon një gjë të tillë. Kërkesa për autorizim duhet të dorëzohet, e shoqëruar nga dokumentet përkatëse dhe procesverbalin e çdo deklarate të bërë nga personi i dënuar.
2. Pavarësisht prej dispozitës së paragrafit 1. të këtij neni, organet gjyqësore vendore mund të marrin masa të nevojshme sipas ligjit vendor për të parandaluar parashkrimin.

Neni 68
Ndërprerja e ekzekutimit të dënimit

Ekzekutimi i dënimit përfundon kur Ministria njoftohet nga shteti dënues se ai shtet ka nxjerr vendim apo ndonjë veprim tjetër me të cilën dënimi pushon të jetë i ekzekutueshëm.

Neni 69
Informata mbi ekzekutimin e dënimit

1. Ministria duhet të njoftoj shtetin dënues në lidhje me ekzekutimin e dënimit:
   1.1. kur e konsideron të përfunduar ekzekutimin e dënimit;
   1.2. nëse personi i dënuar është arratisur nga mbajtja para se të përfundojë vuajtjen e dënimit.

Neni 70
Leja për kalim transit të personit të dënuar

1. Ministria, mund të lejoj kalimin transit të një personi të dënuar nga një shtet tek një tjetër përmes territorit të Republikës së Kosovës, në bazë të kërkesës të cilido shtet.

2. Kalimi transit i një personi për të vuajtur dënim për një vepër penale të parashikuar në nenet 15, 16 paragrafi 1., ose që do të ishte në kundërshtim me paragrafin 2. të nenit 55 të këtij ligji nuk është i lejuar.
3. Ministria mund të refuzojë kërkesën për të kaluar transit nëse:
   3.1. personi i dënuar është shtetas i Republikës së Kosovës;
   3.2. vepra për kryerjen e se cilës është shqiptuar dënimi nuk është paraparë si vepër penale në bazë të ligjit vendor.
4. Personi i dënuar mund të mbahet në mbajtje në territorin e Republikës së Kosovës vetëm për aq kohë sa nevojitet për kalimin transit.
5. Nëse një person do të transportohet në rrugën ajrore dhe nuk është planifikuar të ketë aterim në territorin e Republikës së Kosovës, leja e referuar në paragrafin 1 nuk është e nevojshme. Megjithatë Ministria duhet të njoftohet lidhur me transitin. Në rast të aterimit të paplanifikuar ky njoftim do të konsiderohet si kërkesë për transit. Njoftimi duhet të përmbaj emrin dhe shtetësinë e personit të transferuar, shtetin ku personi transferohet dhe kohën e kalimit tranzit ajror.

KREU V
NJOHJA DHE EKZEKUTIMI I AKTGJYKIMEVE

NËNKREU I
NJOHJA DHE EKZEKUTIMI I AKTGJYKIMEVE TË HUAJA NË REPUBLIKËN E KOSOVËS

Neni 71
Parimet e përgjithshme

1. Aktgjykimet e formës së prerë të lëshuara nga gjykatat e huaja kundër qytetarëve ose banorëve të përhershëm të Republikës së Kosovës, mund të njihen dhe ekzekutohen në Republikën e Kosovës, sipas kushteve të parapara në këtë Kapitull, nëse aktgjykimi përmban lloje të dënimeve të parapara me ligj vendor.
2. Procedura për njohje dhe ekzekutim mund të fillohet vetëm në bazë të një kërkese me shkrim të pranuar nga Ministria. Kërkesa duhet të shoqërohet nga origjinali apo kopja e vërtetuar e aktgjykimit që do të ekzekutohet si dhe nga dokumente tjera të nevojshme.
3. Pas shqyrtimit të kushteve formale të kërkesës, Ministria do të transmetojë atë së bashku me dokumentet mbështetëse të pranuara tek gjykata kompetente. Gjykata Themelore, në territorin e së cilës personi i dënuar banon ose ndodhet, do të jetë kompetente për të vendosur mbi kërkesën për njohjen dhe ekzekutimin. Nëse qëndrimi ose vendndodhja e personit nuk mund të përcaktohet, Gjykata Themelore e Prishtinës do të jetë kompetente.

Neni 72
Kushtet për njohje dhe ekzekutim

1. Gjykata kompetente do të refuzojë njohjen dhe ekzekutimin e një aktgjykimi të huaj vetëm në një nga situatat e mëposhtme:

1.1. ekzekutimi do të ishte në kundërshtim me parimet themelore të sistemit juridik të Republikës së Kosovës;
1.2. vepra penale për të cilën dënimi është dhënë është e një natyre politike apo e natyrës ushtarake;
1.3. ekzistojnë arsye serioze për të besuar se aktgjykimi është shqiptuar duke marrë parasysh kombësinë, racën, fenë, apo bindjen politike;
1.4. vepra penale për të cilën është shqiptuar aktgjykimi në shtetin tjetër, është subjekt i një aktgjykimi final apo i një procedure në Republikën e Kosovës;
1.5. në bazë të ligjit vendor dënimi i shqiptuar nuk mund të ekzekutohet për shkak të parashkrimit, ose për shkak se është falur;
1.6. Aktgjykimi është dhënë në mungesë, përveç atëherë kur shteti kërkues ofron informata që dëshmojnë se në bazë të ligjit të vet, personi është njoftuar personalisht apo përmes një përfaqësuesi kompetent për vendin dhe kohën e gjykimit që ka rezultuar në dhënien e aktgjykimit në mungesë, apo nëse personi ka deklaruar tek autoriteti kompetent i shtetit kërkues që ai apo ajo nuk e kundërshton rastin, ose nuk ka kërkuar rigjykim apo nuk ka parashtruar ankesë.

2. Nëse shteti kërkues nuk i ofron informatat e përmendura në paragrafin 1.6. të këtij neni, personit të dënuar në mungesë do t'i ofrohet mundësia të paraqes kundërshtim për njohjen dhe ekzekutim në afatin prej njëzet (20) ditëve. Nëse brenda këtij afati personi nuk ka kundërshtuar njohjen dhe ekzekutimin aktgjykimi i dhënë në mungesë mund të njihet dhe ekzekutohet
3. Në të gjitha rastet e tjera aktgjykimi i huaj do të njihet dhe deklarohet i ekzekutueshëm nga gjykata kompetente, nëse vepra penale për të cilën është dhënë aktgjykimi do të konsiderohej vepër penale nëse do të kryhej në territorin e Republikës së Kosovës dhe personi do të konsiderohej penalisht i përgjegjshëm.

Neni 73
Procedura gjyqësore

1. Gjykata, në kolegj prej tre gjyqtarësh, do të jep aktgjykim lidhur me njohjen e aktgjykimit të huaj dhe ekzekutimin e dënimit të shqiptuar.
2. Para shpalljes së aktgjykimit, gjykata do të dëgjoj mendimin e personin dhe të prokurorit kompetent. Gjykata do t'i përmbahet gjendjes faktike siç paraqitet në përmbajtjen e vendimit të huaj.
3. Në dispozitiv të aktgjykimit gjykata shënon në tërësi dispozitivin e aktgjykimit të gjykatës së huaj dhe emrin e gjykatës së huaj.
4. Gjykata shqipton dënim sipas ligjit vendor. Në arsyetim të aktgjykimit, gjykata do të ofroj arsyet në bazë të të cilave dënimi është shqiptuar. Nëse dënimi nuk është i përputhshëm me ligjin vendor, Gjykata mund të përshtatë dënimin vetëm kur ai dënim tejkalon maksimumin e dënimit të paraparë nga ligji vendor për vepra penale të ngjashme. Nëse dënimi i shqiptuar nga gjykata e huaj është nën minimumin e dënimit që mund të shqiptohet në bazë të ligjit vendor, Gjykata nuk do të jetë e lidhur me atë minimum dhe do të shqiptoj dënim që korrespondon me dënimin e shqiptuar në shtetin kërkues.
5. Çdo pjesë e dënimit të shqiptuar nga gjykata e huaj dhe koha e kaluar në

paraburgim që është mbajtur nga personi në shtetin kërkues apo në Republikën e Kosovës do të llogaritet në dënimin final.

6. Kundër aktgjykimit vendor mund të ushtrohet ankesë nga prokurori, personi i dënuar apo mbrojtësi i tij apo saj, në përputhje me dispozitat e Kodit të Procedurës Penale.
7. Personi për të cilin është paraqitur në Ministri kërkesa për njohje dhe ekzekutim të aktgjykimit, mund të arrestohet dhe të mbahet në përputhje me dispozitat e Kodit të Procedurës Penale.

Neni 74
Ekzekutimi i dënimit me gjobë dhe konfiskimi i parave

1. Kur është pranuar kërkesa për ekzekutim të dënimit me gjobë ose për konfiskim të parave, Gjykata konverton këtë shumë në valutën që është në qarkullim në Republikën e Kosovës sipas kursit të këmbimit të regjistruar nga banka qendrore e vlefshme në ditën kur është marrë vendimi. Në këtë mënyrë, Gjykata do të caktojë vlerën e dënimit me gjobë apo shumën që do të konfiskohet, e cila nuk mund të tejkalojë maksimumin e përcaktuar me ligj vendor për veprën e njëjtë penale.
2. Kur kërkesa për konfiskim ka të bëjë me një send të veçant, atëherë Gjykata mund të urdhërojë konfiskimin e atij sendi vetëm nëse konfiskimi i tillë për atë vepër penale lejohet në bazë të ligjit vendor apo në rastet kur ligji lejon shqiptimin e një dënimi më të rëndë. Nëse konfiskimi i një sendi të veçantë nuk është i mundur, Gjykata mund të vendos të konfiskoj vlerën monetare të barazvlefshme me vlerën e atij sendi, nëse shteti kërkues pajtohet. Në raste të tilla kursi i këmbimit i përmendur në paragrafin 1. të këtij neni zbatohet *mutatis mutandis.*

Neni 75
Arkëtimi i i dënimit me gjobë dhe konfiskimi

1. Të ardhurat nga ekzekutimi i dënimit me gjobë dhe konfiskimi derdhen në buxhetin e Republikës së Kosovës, përveç nëse është vendosur ndryshe me shtetin kërkues dhe pa cënuar të drejtat që mund të ketë pala e tretë.
2. Pasuria e konfiskuar, e cila është e interesit të veçantë, mund t'i kthehet shtetit kërkues nëse ai e kërkon atë.

Neni 76
Ekzekutimi i dënimit plotësues

1. Kur kërkesa për ekzekutim ka të bëjë me një dënim plotësues, një dënim i tillë mund të ekzekutohet në Republikën e Kosovës vetëm nëse ligji vendor lejon shqiptimin e një dënimi të tillë për veprën penale të njejtë.
2. Kur gjykata urdhëron ekzekutimin e një dënimi plotësues, përcakton kohëzgjatjen e dënimit plotësues brenda kufijve të përcaktuara me ligj vendor, por nuk mund të tejkalojë kufizimet e parapara në dënimin e shqiptuar nga shteti kërkues.

NËNKREU II
EKZEKUTIMI I AKTGJYKIMEVE VENDORE NË NJË SHTET TJETËR

Neni 77
Kushtet për paraqitjen e kërkesës për njohje dhe ekzekutim

1. Njohja dhe ekzekutimi i aktgjykimit të formës së prerë të dhënë nga një gjykatë në Republikën e Kosovës mund të kërkohet nga një shtet tjetër në një nga rastet e mëposhtme:
   1.1. në qoftë se personi i dënuar është shtetas ose banor i përhershëm i shtetit të kërkuar;
   1.2. nëse personi i dënuar tashmë është duke vuajtur dënimin me burgim për një vepër tjetër në shtetin e kërkuar;
   1.3. zbatimi i dënimit në shtetin e kërkuar ka gjasa të përmirësojë perspektivën për rehabilitim social të personit të dënuar;
   1.4. në pajtim me ligjin e shtetit të kërkuar, ekstradimi i personit në Republikën e Kosovës nuk është i lejueshëm.
2. Njohja dhe ekzekutimi i aktgjykimeve të gjykatave vendore mund të kërkohet nga një shtet tjetër në të gjitha rastet kur konsiderohet se ekzekutimi i vendimit në Republikën e Kosovës nuk është i mundur.

Neni 78
Paraqitja e kërkesave për njohje dhe ekzekutim

1. Kërkesat për njohje dhe ekzekutim të aktgjykimeve të gjykatave vendore do t'i dorëzohen shtetit të kërkuar nga Ministria, me kërkesë të gjykatës që ka shpallur aktgjykimin.
2. Kërkesa duhet të bëhet me shkrim dhe duhet të shoqërohet nga origjinali ose kopja e vërtetuar e aktgjykimit, ekzekutimi i të cilit kërkohet dhe dokumentet e tjera të nevojshme sipas ligjit të shtetit të kërkuar.

Neni 79
Efektet e kërkesës për ekzekutim

1. Nëse shteti i kërkuar pranon të ekzekutoj aktgjykimin në territorin e vet, autoritetet e Republikës së Kosovës nuk kanë më të drejtë të ekzekutojnë atë aktgjykim.
2. E drejta e ekzekutimit të aktgjykimit i kthehet organeve të Republikës së Kosovës, nëse personi i shmanget ekzekutimit të dënimit.

KREU VI
NDIHMA JURIDIKE E NDËRSJELLË

Neni 80
Parimet

1. Me kërkesën e organit gjyqësor të shtetit tjetër organet gjyqësore vendore ofrojnë ndihmë në lidhje me procedurat penale për vepra penale ndjekja e të cilave në

kohën e kërkesës për ndihmë bie brenda juridiksionit të organeve gjyqësore të shtetit kërkues.

2. Ndihmë juridike brenda kuptimit të paragrafit 1 të këtij neni do të jetë çdo lloj i ndihmës së dhënë për organet e huaja, pavarësisht nëse procedurat penale të huaja zhvillohen nga gjykata apo prokuroria, apo nëse ndihma juridike duhet të ofrohet nga një gjykatë apo prokurori.
3. Ndihma juridike nën këtë Kapitull mund të kërkohet dhe ofrohet edhe lidhur me marrjen e masave të përkohshme me qëllim të ruajtjes së dëshmisë, ruajtjes së një situate ekzistuese apo mbrojtjes së interesave juridike të rrezikuara.
4. Organet gjyqësore vendore i japin përparësi ekzekutimit të kërkesave për ndihmë juridike të ndërsjellë dhe marrin në konsideratë afatet procedurale dhe kushtet tjera të përmendura shprehimisht nga shteti kërkues.

Neni 81
Ndihma juridike e ndërsjellë e zgjeruar

Ndihma e ndërsjellë ofrohet edhe në përkrahje të procedurave pranë autoriteteve administrative në lidhje me vepra të dënueshme sipas ligjit vendor apo të shtetit kërkues, për shkak se paraqesin shkelje të ligjeve dhe që mund të shpien në fillimin e procedurës penale.

NËNKREU I
KËRKESAT VENDORE PËR NDIHMË JURIDIKE TË NDËRSJELLË TË DREJTUAR SHTETIT TJETËR

Neni 82
Autoriteti që parashtron kërkesë për ndihmë juridike

1. Gjatë procedurës paraprake deri në ngritjen e aktakuzës, kërkesa për ndihmë juridike të ndërsjellë paraqitet nga prokurori i shtetit i cili udhëheq procedurën për të cilën kërkohet ndihmë. Në rastet kur veprimi apo masa që kërkohet të ndërmerret po të ishte ndërmarrë në Republikën e Kosovës në bazë të Kodit të Procedurës Penale do të kërkonte një urdhër nga gjykata, atëherë kërkesa duhet të parashtrohet nga gjykata në bazë të kërkesës së prokurorit të shtetit.
2. Pas ngritjes së aktakuzës, kërkesa për ndihmë juridike duhet të paraqitet nga gjykata që zhvillon procedurën për të cilën kërkohet ndihmë.
3. Kërkesa për ndihmë juridike i dorëzohet Ministrisë e cila e shqyrton dhe transmeton atë së bashku me çdo dokument tjetër mbështetës tek autoriteti kompetent i shtetit të kërkuar.

Neni 83
Përmbajtja e Kërkesës

1. Kërkesa për ndihmë bëhet me shkrim dhe përfshin informatat e mëposhtme:
   1.1. emrin e organit që zhvillon procedurën penale lidhur me të cilën bëhet kërkesa;
   1.2. përshkrimin e fakteve të çështjes, kohën dhe vendin e kryerjes së veprës penale dhe çdo dëm të shkaktuar, si dhe emërtimin ligjor të veprës penale;

1.3. ekstraktin e dispozitave ligjore të zbatueshme, duke përfshirë dispozitat për parashkrimin dhe dënimin që mund të shqiptohet;
1.4. identitetin e personave kundër të cilëve zhvillohet procedura penale për të cilën kërkohet ndihma;
1.5. përshkrimin e veprimeve të kërkuara dhe shpjegimin se si lidhen ato me faktet e rastit;
1.6. kur është e nevojshme, të dhëna rreth afatit kohor brenda të cilit duhet të ekzekutohet kërkesa dhe arsyetimin e urgjencës;
1.7. kur është e nevojshme, identifikimin e personave që do të autorizohen të jenë të pranishëm gjatë ekzekutimit të kërkesës;
1.8. kur është e nevojshme, informata mbi kompensimin që i takon personit që ftohet për tu paraqitur me qëllim të dhënies së dëshmisë;
1.9. kur është e nevojshme, të dhënat teknike të nevojshme për marrjen e dëshmive përmes video-konferencës.

2. Kërkesa për ndihmë, për aq sa është e nevojshme dhe e mundur, gjithashtu do të përfshijë:
2.1. informata mbi identitetin e personit subjekt i kërkesës dhe vendndodhjen e tij apo saj;
2.2. informata mbi identitetin dhe vendbanimin e personit ku duhet të shërbehen dokumentet dhe statusin e tij apo saj në procedurë, si dhe mënyrën në të cilën duhet të bëhet shërbimi;
2.3. informata mbi identitetin dhe vendbanimin e personit që duhet të jap dëshmi apo të bëj deklaratë;
2.4. vendndodhjen dhe përshkrimin e vendit apo sendit që do të inspektohet apo ekzaminohet;
2.5. vendndodhjen dhe përshkrimin e vendit që duhet kontrolluar dhe evidentimin e sendeve që duhet sekuestruar apo konfiskuar;
2.6. evidentimi e një procedure të veçantë që kërkohet të zbatohet gjatë ekzekutimit të kërkesës dhe arsyet përkatëse për të;
2.7. vënien në dijeni për nevojën për konfidencialitet;
2.8. çdo informatë tjetër që mund të lehtësojë ekzekutimin e kërkesës.

NËNKREU II
KËRKESAT PËR NDIHMË JURIDIKE TË NDËRSJELLË TË ADRESUARA NGA SHTETI TJETËR PËR REPUBLIKËN E KOSOVËS

Neni 84
Pranimi i kërkesës për ndihmë juridike të ndërsjellë

1. Pas marrjes së kërkesës për ndihmë juridike të ndërsjellë dhe pas konfirmimit të lejueshmërinë së saj, Ministria e dërgon atë për ekzekutim në Prokurorinë Themelore kompetente në territorin e së cilës banon ose mund të gjendet personi, apo ku gjendet objekti në fjalë. Në rast se vendbanimi i personit është i panjohur kompetente është Prokuroria Themelore në Prishtinë.
2. Kur kërkesa për ndihmë të ndërsjellë juridike ndërlidhet me procedurë penale në zhvillim në Republikën e Kosovës, prokurori i shtetit i ngarkuar me rastin do të jetë kompetent të ekzekutoj atë kërkesë.

3. Nëse kërkesa nuk është e plotë, Ministria mund ta kthejë atë mbrapa tek shteti kërkues për informata shtesë.

Neni 85
Refuzimi i ofrimit të ndihmës

1. Ofrimi i ndihmës mund të refuzohet nëse:
   1.1. kërkesa ka të bëjë me një vepër politike;
   1.2. ekzekutimi i kërkesës rrezikon të cenojë sovranitetin, sigurinë, rendin publik ose interesat tjera themelore të Republikës së Kosovës.
   1.3. kërkesa është në kundërshtim me sistemin juridik të Republikës së Kosovës.
2. Ministria njofton shtetin kërkues me shkrim nëse kërkesa është refuzuar plotësisht apo pjesërisht.

Neni 86
Organi që ekzekuton kërkesat

1. Prokurori kompetent ndërmerr veprimin apo masën e kërkuar në përputhje me ligjin vendor.
2. Nëse prokurori përgjegjës për ekzekutimin e kërkesës për ndihmë juridike konsideron që kërkesa nuk i plotëson kushtet e parapara me ligjin vendor, përmes Ministrisë e kthen tek shteti kërkues së bashku me arsyetimin për refuzim.

Neni 87
Shtyrja ose ekzekutimi i pjesshëm i kërkesave

1. Nëse ekzekutimi i kërkesës për ndihmë të ndërsjellë juridike do të pengonte hetimet, ndjekjen penale apo procedurën gjyqësore në Republikën e Kosovës, ekzekutimi i kërkesës mund të shtyhet. Shteti kërkues duhet të njoftohet për shtyrjen.
2. Nëse është e nevojshme, Ministria mund që pas konsultimit me shtetin kërkues në vend të shtyrjes së ekzekutimit, të shqyrtoj nëse kërkesa mund të ekzekutohet pjesërisht apo të ekzekutohet duke përcaktuar disa kushte që i konsideron të nevojshme.

Neni 88
Pjesëmarrja e zyrtarëve të huaj

1. Në bazë të kërkesës së shtetit kërkues Ministria mund të jap leje që zyrtarët e autorizuar të atij shteti të jenë të pranishëm gjatë ekzekutimit të kërkesës për ndihmë të ndërsjellë juridike. Organi gjyqësor vendor i ngarkuar me ekzekutimin e kërkesës duhet të njoftoj Ministrinë për datën dhe vendin e ekzekutimit të kërkesës. Në këtë drejtim Ministria njofton shtetin kërkues.
2. Ministria veçanërisht mund të lejojë pjesëmarrjen e zyrtarëve të huaj në ekzekutimin e kërkesës në qoftë se pjesëmarrja e tillë do të lehtësonte ekzekutimin e kërkesës në përputhje me nevojat e shtetit kërkues dhe gjithashtu do të shmangej nevoja për ndonjë kërkesë shtesë për ndihmë juridike.

Neni 89
Dëgjimi përmes video konferencës

1. Në rastet kur një person që gjendet në territorin e Republikës së Kosovës duhet të dëgjohet si dëshmitar ose ekspert nga organi gjyqësor i huaj, ky i fundit mund të kërkojë dëgjimin e personit përmes video konferencës, nëse nuk është e dëshirueshme ose e mundshme që personi të paraqitet personalisht në territorin e tij.
2. Kërkesa për dëgjim përmes video konferencës duhet të përmbajë arsyen pse nuk është e mundshme apo e dëshirueshme që personi të paraqitet personalisht, emrin e organit gjyqësor dhe personave që do të udhëheqin seancën dëgjimore.
3. Kërkesat për dëgjim përmes video konferencës ekzekutohet nga Gjykata Themelore në territorin e së cilës banon apo mund të gjendet personi që do të dëgjohet. Gjykata në përputhje me ligjin vendor e fton personin në fjalë.
4. Dëgjimi përmes video konferencës realizohet në pajtim me rregullat e më poshtme:
   4.1. dëgjimi duhet të bëhet në prani të Gjyqtarit, i cili është përgjegjës për verifikimin e identitetit të personit që do të dëgjohet dhe duhet të siguroj respektimin e të drejtave të tij apo saj të përcaktuara me ligj vendor dhe parimeve themelore të ligjit vendor;
   4.2. kur është e nevojshme shteti kërkues dhe Ministria pajtohen lidhur me masat për mbrojtjen e personit që do të dëgjohet;
   4.3. dëgjimi udhëhiqet drejtpërdrejtë apo nën direktivat e organit gjyqësor të shtetit kërkues në përputhje me ligjin e vet;
   4.4. me kërkesë te shtetit kërkues apo personit që do të dëgjohet, gjykata sigurohet qe gjatë marrjes në pyetje të ofrohet përkthimi; dhe
   4.5. personi që do të dëgjohet mund të shfrytëzojë çdo të drejtë për të mos dëshmuar, që i takon sipas ligjit vendor apo të shtetit kërkues.
5. Duke mos cënuar asnjë nga masat e ndërmarra me qëllim të mbrojtjes së personit në fjalë, duhet të hartohet procesverbal në të cilin do të përfshihet data dhe vendi i mbajtjes së dëgjimit, identiteti i personit të dëgjuar, identiteti dhe funksioni i të gjithë personave të tjerë që kanë marrë pjesë në dëgjim në Republikën e Kosovës, çdo betim të dhënë si dhe kushtet teknike të dëgjimit. Dokumenti duhet t'i dërgohet autoriteteve kompetente të shtetit kërkues.
6. Në bazë të kërkesës së shtetit kërkues, organet gjyqësore vendore mund të zbatojnë dispozitat e këtij Neni në dëgjimin e të pandehurit përmes video konferencës. Në këtë rast, vendimi për mbajtjen dhe mënyra e mbajtjes së dëgjimit bëhet në përputhje me ligjin vendor.

Neni 90
Kontrollimi, ngrirja dhe konfiskimi

1. Kërkesa për kontrollim, ngrirje dhe konfiskim të pasurisë duhet t'i plotësoj kushtet në vijim:
   1.1. vepra që ka shkaktuar paraqitjen e kërkesës të jetë e dënueshme në bazë të ligjit të shtetit kërkues dhe ligjit vendor; dhe
   1.2. ekzekutimi i kërkesës është konsistent me ligjin vendor.

Neni 91
Dorëzimi i pasurisë

1. Çdo pasuri, si dhe dokumentet origjinale, të dorëzuara gjatë ekzekutimit të kërkesës do të kthehen në Republikën e Kosovës nga shteti kërkues sa më shpejt që të jetë e mundur, përveç nëse organi gjyqësor vendor heq dorë nga kthimi i tyre.
2. Dorëzimi i pasurisë, materialeve gjyqësore ose dokumenteve të kërkuara mund të vonohet në rastet kur materialet e tilla janë të nevojshme në Republikën e Kosovës në lidhje me procedurat penale në pritje.

Neni 92
Shkëmbimi spontan i informatave

1. Pa cenuar zhvillimin e hetimeve ose procedurës penale, organet gjyqësore vendore munden që pa kërkesë paraprake, t'ia përcjellin organit kompetent të një shteti tjetër informatat e siguruara në kuadër të hetimeve të tyre, kur konsiderojnë se zbulimi i informatave të tilla mund të ndihmojë shtetin pranues në inicimin apo zhvillimin e hetimeve ose të procedurës penale, ose mund të shpien në një kërkesë për ndihmë juridike të ndërsjellë nga shteti pranues.
2. Ministria mund të caktoj kushte për përdorimin e informatave të referuara në paragrafin 1 të këtij Neni.

Neni 93
Shërbimi i letërthirrjeve dhe dokumenteve gjyqësore

1. Dega kompetente e Gjykatës Themelore do të ofroj ndihmë lidhur me shërbimin e letërthirrjeve dhe dokumenteve gjyqësore që janë dërguar nga shteti kërkues për këtë qëllim.
2. Shërbimi bëhet në mënyrë të njëjtë me atë të rregulluar nga ligji vendor për shërbimin e dokumenteve të ngjashme, ose, në bazë të kërkesës së shtetit kërkues në përputhje me procedurën e përmendur në kërkesë në qoftë se nuk është në kundërshtim me ligjin vendor.
3. Dëshmia për dorëzim jepet me vërtetimin e nënshkruar nga personi që ka pranuar dokumentet dhe që përmban datën e pranimit,ndërsa kur nuk është e mundur, me anë të deklaratës që shërbimi është realizuar dhe që përmban formën dhe datën e këtij dorëzimi. Nëse dorëzimi nuk mund të realizohet, gjykata do të cekë arsyet pse shërbimi nuk ka mundur te realizohet dhe te njëjtat përmes Ministrisë do t'i komunikohen shtetit kërkues sa më parë që është e mundur.

NËNKREU III
PARAQITJA E DËSHMITARËVE, EKSPERTËVE DHE TË PANDEHURVE

Neni 94
Shërbimi i letërthirrjes për dëshmitarët, ekspertët, të pandehurit që të paraqiten para organeve gjyqësore të shtetit kërkues

1. Në rastet kur shteti tjetër konsideron të nevojshme paraqitjen personale të dëshmitarit ose ekspertit para organeve gjyqësore të tij, ose kërkon paraqitje vullnetare të të pandehurit dhe për këtë qëllim kërkon shërbimin e letërthirrjes në Republikën e Kosovës, organi gjyqësor fton të pandehurin, dëshmitarin ose ekspertin që të paraqitet.
2. Ministria do të njoftoj shtetin kërkues lidhur me përgjigjen nga dëshmitari, eksperti ose i pandehuri.
3. Nëse dëshmitarët, ekspertët ose të pandehurit të cilëve iu është kërkuar që të paraqiten para organeve kompetente nuk i janë përgjigjur ftesës që të paraqiten, ndaj tyre nuk do të ndërmerret ndonjë ndëshkim apo masë tjetër e detyrueshme.

Neni 95
Garancitë për dëshmitarin, ekspertin dhe të pandehurin kur ftohet para organeve gjyqësore vendore

1. Dëshmitari ose eksperti i cili paraqitet para organeve gjyqësore vendore, pa marrë parasysh shtetësinë, nuk do të ndiqet penalisht, të mbahet ose t'i nënshtrohet asnjë kufizimi të lirisë personale në territorin e Republikës së Kosovës në lidhje me veprat penale të kryera para largimit nga territori i shtetit të kërkuar.
2. Pa marrë parasysh shtetësinë, një person që paraqitet në bazë të thirrjes para organeve gjyqësore vendore në cilësinë e të akuzuarit, nuk do të ndiqet penalisht, arrestohet ose t'i nënshtrohet ndonjë kufizimi të lirisë së tij apo saj personale për një vepër penale të kryer para largimit nga territori i shtetit kërkues dhe kur një gjë e tillë nuk është specifikuar në letërthirrje.
3. Imuniteti i dhënë në këtë Nen do të pushojë nëse dëshmitari, eksperti ose i pandehuri nuk largohet nga territori i Republikës së Kosovës brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga data kur prania e tij apo saj nuk është më e nevojshme nga autoritetet gjyqësore vendore ose pasi është larguar nga ky territor është kthyer përsëri.

Neni 96
Transferimi i përkohshëm i personave të ndaluar për të dëshmuar para organeve gjyqësore në shtetin kërkues

1. Personi i ndaluar, paraqitja personale e të cilit kërkohet nga një shtet tjetër me qëllim të dëgjimit si si dëshmitar apo për qëllim të ballafaqimit, mund të transferohet përkohësisht në territorin ku dëgjimi është paraparë të mbahet, me kusht që ai apo ajo të kthehet në Republikën e Kosovës brenda periudhës së përcaktuar nga Ministria.
2. Transferimi mund të refuzohet në qoftë se:
   2.1. personi i ndaluar nuk pajtohet;

2.2. prezenca e tij apo saj në Republikën e Kosovës është e nevojshme për shkak të procedurës penale në pritje;
2.3. transferimi i tij apo saj do të zgjaste paraburgimin, ose
2.4. ekzistojnë rrethana të tjera që pengojnë transferimin e tij apo saj në shtetin kërkues.

3. Kalimi transit i personit të ndaluar përmes territorit të Republikës së Kosovës mund të lejohet nëse shteti kërkues paraqet në Ministri kërkesë për leje për kalim transit të shoqëruar me të gjitha dokumentet e nevojshme.

NËNKREU IV
FORMA TJERA TË BASHKËPUNIMIT

Neni 97
Dispozitatë përgjithshme

1. Ndihmë nën këtë Kapitull ofrohet në përputhje me Protokollin e Dytë Shtesë të Konventës për Ndihmë të Ndërsjellë në Çështjet Penale të vitit 1959 përveç nëse rregullohet ndryshe me ligj vendor.
2. Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit është kompetente për të vendosur për kërkesat nën këtë Kapitull.

Neni 98
Njësitë e përbashkëta të hetimit

1. Autoritetet kompetente të Republikës së Kosovës me marrëveshje të ndërsjellë me një apo më shumë shtete mund të formojnë njësi të përbashkëta të hetimit për një qëllim të caktuar dhe për një periudhë kohe të kufizuar me qëllim të kryerjes së hetimeve në një apo më shumë shtete që kanë formuar njësinë. Periudha kohore mund të zgjatet me marrëveshje mes palëve.
2. Njësia e përbashkët e hetimit mund të formohet posaçërisht nëse:
   2.1. hetimi në një shtet për një vepër penale përfshin hetime të vështira dhe kërkuese të cilat kanë lidhje me shtetet e tjera;
   2.2. disa shtete janë duke zhvilluar hetime për vepra penale dhe rrethanat kërkojnë veprim të koordinuar dhe të bashkuar të shteteve të përfshira.
3. Njësitë e përbashkëta të hetimeve mund të formohen me kërkesë të cilido nga shtetet e përfshira.
4. Antarët e njësisë së përbashkët të hetimit, që janë të deleguar nga shteti i tyre mund të lejohen të kryejnë hetime në territorin e Republikës së Kosovës nën udhëheqjen e anëtarit të njësisë së Republikës së Kosovës, në përputhje me marrëveshjen mes Republikës së Kosovës dhe shtetit delegues.
5. Antarët e njësisë së përbashkët të hetimit duhet të lejohen të jenë prezent gjatë ndërmarrjes së çdo veprimi hetimor në Republikën e Kosovës. Megjithatë udhëheqësi i njësisë mund të vendos ndryshe për arsye të veçanta dhe në përputhje me ligjin vendor.
6. Anëtarët vendor të njësisë së përbashkët të hetimit, në përputhje me ligjin vendor dhe brenda kompetencave të tyre, mund t'i ofrojnë njësisë informatat e siguruara në Republikën e Kosovës, për qëllime të hetimeve penale që kryehen nga njësia.

7. Kur njësia e përbashkët e hetimit ka nevojë për veprime hetimore që duhet të ndërmerren në Republikën e Kosovës, anëtarët vendor të deleguar në atë njësi mund të kërkojnë nga organet gjyqësore vendore marrjen e atyre veprimeve. Ato veprime duhet të trajtohen në Republikën e Kosovës nën kushtet e njëjta që do të zbatoheshin nëse ato veprime do të kërkoheshin gjatë hetimeve vendore.
8. Informatat e siguruara ligjërisht nga antarët vendor të njësisë së përbashkët të hetimit, të cilat nuk do të ishin të arritshme ndryshe për autoritetet vendore, mund të përdoren për qëllimet e mëposhtme:
   8.1. për qëllim për të cilin njësia është formuar;
   8.2. për zbulimin, hetimin dhe ndjekjen e veprave penale tjera, pas marrjes paraprakisht të pëlqimit nga shteti ku janë siguruar ato informata;
   8.3. për parandalimin e kërcënimit serioz dhe të menjëhershëm të sigurisë publike;
   8.4. për qëllime të tjera, siç mund të pajtohen shtetet që kanë formuar njësinë.
9. Persona tjerë nga përfaqësuesit e organeve kompetente të shteteve që formojnë njësinë e përbashkët të hetimit, mund të lejohen të marrin pjesë në veprimet e njësisë. Të drejtat e dhëna antarëve të njësisë sipas këtij Neni, nuk do të jepen këtyre personave, përveç nëse shtetet pajtohen ndryshe shprehimisht.

Neni 99
Hetimet e fshehta

Autoritetet e Republikës së Kosovës, në bazë të kërkesës, mund t'i ofrojnë ndihmë një shteti tjetër që të zhvilloj hetime përmes hetuesve të fshehtë apo me identitet të rremë, në përputhje me ligjin vendor.

NËNKREU V
TË DHËNAT GJYQËSORE DHE TË DHËNAT TJERA

Neni 100
Kërkesa për të dhëna penale

Me kërkesë të shtetit tjetër, ekstraktet dhe informatat lidhur me të dhënat gjyqësore do t'i komunikohen atij shteti, me kusht që ajo informatë është e nevojshme për një çështje penale në shtetin kërkues.

Neni 101
Ofrimi i informatave lidhur me të dhënat gjyqësore

Ministria mund të informoj shtetet e huaja për të gjitha dënimet penale të ndaj qytetarëve të tyre të regjistruara në të dhënat gjyqësore, pa kërkesë për atë qëllim. Kur personi në fjalë është shtetas i dy apo më shumë shteteve, informata mund t'i ofrohet secilit nga këto shtete.

KREU VII
DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 102
Shpenzimet

1. Shpenzimet lidhur me ekstradimin nga Republika e Kosovës në shtetin tjetër, të shkaktuara jashtë territorit të Republikës së Kosovës, do të barten nga shteti kërkues.
2. Shpenzimet lidhur me ekstradimin nga shtetet tjera për në Republikën e Kosovës, do të mbulohen nga buxheti i Republikës së Kosovës.
3. Në bazë të këtij ligji, shpenzimet tjera të kryera gjatë ofrimit të bashkëpunimit juridik ndërkombëtar, të kryera brenda territorit të Republikës së Kosovës do të barten nga buxheti i Republikës së Kosovës.

Neni 103
Mbrojtja e të Dhënave Personale

1. Në bazë të këtij ligji, të dhënat personale të transferuara në Republikën e Kosovës më qëllim të ekzekutimit të një kërkese, mund të përdoren nga autoritetet gjyqësore vetëm:
   1.1. për qëllime të procedurave që përcakton ky ligj;
   1.2. për procedura tjera gjyqësore dhe administrative që ndërlidhen drejtpërdrejtë me procedurat e përmendura në paragrafin 1. te këtij neni;
   1.3. për parandalimin e ndonjë rreziku serioz te sigurisë publike.
2. Në bazë të këtij Ligji, transferimi ose zbulimi i të dhënave personale nga Republika e Kosovës tek një shtet tjetër me qëllim të ekzekutimit të një kërkese duhet të jetë në përputhje të plotë me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Neni 104
Kompetencat për aktet nënligjore

Ministria e Drejtësisë mund të nxjerr akte nënligjore për zbatimin e këtij ligji.

Neni 105
Dispozitat shfuqizuese

Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, shfuqizohet Ligji nr. 04/L-031 për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar në Çështjet Penale.

Neni 106
Hyrja në Fuqi

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ligji nr. 04/L-213
31 korrik 2013

Shpallur me dekretin Nr. DL-047-2013, datë 19.08.2013 nga Presidentja e Republikës së Kosovës Atifete Jahjaga.

GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS / Nr. 33 / 2 SHTATOR 2013, PRISHTINË

LIGJI Nr. 04/L-218
PËR PARANDALIMIN DHE LUFTIMIN E TRAFIKIMIT ME NJERËZ DHE MBROJTJEN E VIKTIMAVE TË TRAFIKIMIT

Përmbajtja

Kreu I: Dispozitat e përgjithshme 709
Kreu II: Autoritetet për parandalimin dhe luftimin e trafikimit me njerëz dhe mbrojtjen e viktimave të trafikuara 713
Kreu III: Hetimi dhe ndjekja penale 716
Kreu IV: Ndihma dhe mbrojta e viktimave të trafikuara me njerëz 721
Kreu V: Parandalimi dhe luftimi i trafikimit me fëmijë 727
Kreu VI: Kompensimi i viktimave të trafikimit 730
Kreu VII: Bashkëpunimi 732
Kreu VIII: Dispozitat kalimtare 733

Kuvendi i Republikës së Kosovës,

Në bazë të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton

LIGJ PËR PARANDALIMIN DHE LUFTIMIN E TRAFIKIMIT ME NJERËZ DHE MBROJTJEN E VIKTIMAVE TË TRAFIKIMIT

KREU I
DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

1. Qëllimi i këtij ligji është përcaktimi i dispozitave juridike përmes të cilave, autoriteteve kompetente vendore iu jepen të drejta, obligime dhe përgjegjësi, për:
   1.1. parandalimin dhe luftimin trafikimit me njerëz në të gjitha format e tij;
   1.2. mbrojtjen e viktimave të trafikuara, përfshirë sigurimin e të drejtave, si ndihmë juridike, ndihmë mjekësore, mbështetje psiko- sociale, sigurimi i kompensimit dhe të drejtave të tjera, për të gjithë personat që supozohen të jenë ose që identifikohen si të trafikuar, pavarësisht gjinisë, moshës, gjendjes martesore, gjuhës, paaftësisë fizike apo mendore, orientimit seksual, kombit, mendimit apo bindjes politike, religjionit apo besimit, përkatësisë etnike apo sociale racës, pronës, lindjes ose statuseve tjera, përmes një qasje te bazuar ne të drejtat e njeriut, në përputhje të plotë me instrumentet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut dhe standardeve.

1.3. bashkëpunimin kombëtar dhe ndërkombëtar me qëllim të parandalimit dhe luftimit të trafikimi më njerëz, dhe sigurimit të ndihmës dhe mbrojtjes së viktimave të trafikuara.

1.4. Asgjë në këtë ligj nuk do të cenoj të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë e autoriteteve dhe të individëve sipas të drejtës ndërkombëtare, duke përfshirë të drejtën ndërkombëtare humanitare dhe të drejtat ndërkombëtare të njeriut dhe, në veçanti, Konventën e vitit 1951 dhe Protokollit të vitit 1967 lidhur me Statusin e Refugjatëve, parimin e mos dëbimit (non-refoulement) dhe të drejtën për të kërkuar azil të përfshira aty.

Neni 2
Fushëveprimi

Dispozitat e këtij ligji duhet të zbatohen për të gjitha format e trafikimit me njerëz, qoftë kombëtar, ose trans-nacional dhe pavarësisht se a lidhet a jo me krimin e organizuar, duke përfshirë veprat e kryera për qëllime të shfrytëzimit të viktimave përderisa ato përmbajnë elementet e trafikimit me njerëz.

Neni 3
Përkufizimet

1. Me qëllim të zbatimit të këtij ligji, shprehjet dhe shkurtesat e përdorura në këtë ligj, kanë kuptimin si në vijim:

1.1. **Trafikimi me njerëz** - rekrutimi, transportimi, transferimi, strehimi ose pranimi i personave, përfshirë shkëmbimin ose transferimin e kontrollit mbi këta persona, me anë të kanosjes ose të përdorimit të forcës apo me forma të tjera të shtrëngimit, rrëmbimit, mashtrimit, lajthimit, keqpërdorimit të pushtetit apo të keqpërdorimit të një pozite të ndjeshme ose me anë të dhënies ose marrjes së pagesave apo përfitimeve për të arritur pëlqimin e personit që ka kontroll mbi personin tjetër, me qëllim të shfrytëzimit.

1.2. **Fëmijë** - personi i cili nuk i ka mbushur tetëmbëdhjetë (18) vjet.

1.3. **Viktimë e ndjeshme** - fëmijë, person me aftësi të kufizuara fizike apo mendore, person me aftësi të zvogëluar, grua shtatzënë ose partner familjar, siç përcaktohet me Kodin Penal të Republikës së Kosovës;

1.4. **Punë e detyruar** - çfarëdo lloj pune apo shërbimi i kërkuar nga një individ nëpërmjet kërcënimit me një ndëshkim, për kryerjen e së cilës individi nuk ka shprehur dëshirën e tij;

1.5. **Adoptim i paligjshëm** - çdo institucion apo praktik ku një fëmijë dorëzohet nga njeri ose të dy prindërit e tij natyral ose nga kujdestari i tij te një person tjetër, qoftë për shpërblim apo jo, me qëllim të shfrytëzimit të fëmijës apo personit të ri ose të punës së tij.

1.6. **Martesë e detyruar** – një formë servile apo fiktive e martesës së personave përderisa ato përmbajnë elementet konstituive të trafikimit me njerëz, në pajtim me Kodin Penal të Kosovës. Kur një fëmijë është në pyetje, nuk do të merret parasysh asnjë pëlqim i fëmijës për ndonjërin nga veprimet e mësipërme;

1.7. **Viktimë e trafikimit** - çdo person që ka qenë subjekt i një veprimi apo praktike siç përcaktohet në paragrafin 1, nen paragrafi 1 te këtij neni.
1.8. **Shfrytëzim i viktimës** - përfshin, por nuk kufizohet në, shfrytëzimin e prostitucionit të tjerëve, pornografisë ose formave tjera të shfrytëzimit seksual, lëmoshës, shërbimeve ose punës së detyruar, skllavërisë ose veprimeve të ngjashme me skllavërinë, robërisë ose heqjes së organeve apo qelizave.
1.9. **Autoritet** - çdo institucion shtetëror i përcaktuar në nenin 6 të këtij ligji.
1.10. **Qeveria** – Qeveria e Republikës së Kosovës;
1.11. **OJQ** - Organizatat Joqeveritare si përcaktohet me Ligjin për Lirinë e Asocimit në Organizatat Joqeveritare;
1.12. **Periudhë e reflektimit** - periudhë që iu vihet në dispozicion viktimave apo dëshmitarëve të trafikimit për tu rimëkëmbur nga përvoja e përjetuar dhe për të marrë vendim nëse do të bashkëpunojnë apo jo me autoritetet kompetente.
1.13. **Mekanizmi kombëtar i referimit**- strukturë bashkëpunuese nëpërmjet së cilës institucionet shtetërore i përmbushin obligimet për t'i mbrojtur dhe promovuar të drejtat e viktimës së trafikimit me njerëz dhe koordinojnë përpjekjet e tyre në një partneritet strategjik me shoqërinë civile;
1.14. **Komisioni** - komision për pranimin, shqyrtimin dhe vendosjen e kërkesave për kompensim, të viktimave të trafikimit me njerëz.
1.15. **Personi juridik** – cilindo entitet që sipas ligjit të zbatueshëm ka personalitet juridik, përveç organeve shtetërore publike gjatë ushtrimit të autoritetit shtetëror, dhe organizatave publike ndërkombëtare;
1.16. **Autoriteti kombëtar -** autoritetin kombëtar siç përcaktohet me nenin 7 të këtij ligji;
1.17. **Viktimë e supozuar** - person që supozohet të jetë viktimë e trafikimit me njerëz, por që nuk është identifikuar formalisht nga autoritetet relevante, ose që ka refuzuar të identifikohet formalisht si e tillë. Një person i supozuar si i trafikuar gëzon të njëjtat të drejta dhe trajtim si edhe viktimat e identifikuara që nga fillimi i procesit identifikues.

2. Përkufizimet që gjenden në këtë nen, kanë për qëllim mes tjerash identifikimin e llojeve të abuzimit dhe nuk e penalizojnë sjelljen e përshkruar. Kodi Penal paraqet bazën ligjore për penalizimin e sjelljeve të ndaluara.
3. Shprehjet dhe shkurtesat e tjera të përdorura në këtë ligj kanë kuptimin e shprehjeve të përdorura në legjislacionin përkatës, që është në fuqi.

Neni 4
Parimet themelore për luftimin e trafikimit me njerëz

1. Luftimi i trafikimit me njerëz bëhet në bazë të këtyre parimeve:
1.1. respektimit të të drejtave dhe lirive të njeriut, në veçanti të viktimave të ndjeshme;
1.2. njohja e trafikimit me njerëz si vepër penale që prek të drejtat themelore të njeriut, dinjitetin, lirinë dhe integritetin e njerëzve;
1.3. pashmangshmërinë e ndëshkimit të trafikantëve me qenie njerëzore;
1.4. ligjshmërisë;

1.5. qasja e lirë në drejtësi, qasje në këshillim ligjor dhe në përfaqësim ligjor pa pagesë, përfshirë për qëllim të parashtrimit të kërkesës për kompensim;
1.6. Qasje ne shërbimet dhe trajtimet mjekësore pa pagese për demet e shkaktuara nga abuzimi i/ose trafikimit.
1.7. ndihma dhe mbështetja për viktimën nuk kushtëzohen me gatishmërinë e viktimës për të bashkëpunuar për hetimin, ndjekjen apo gjykimin penal.
1.8. ofrimit të sigurisë dhe qasjes së drejtë- të paanshme për viktimat e trafikimit;
1.9. përdorimi gjithëpërfshirës të masave parandaluese: ligjore, socio-ekonomike dhe ndërkombëtare;
1.10. partneriteteve sociale, bashkëpunimit të autoriteteve, organizatat joqeveritare dhe përfaqësuesit tjerë të shoqërisë civile me organizatat ndërkombëtare;
1.11. proporcionalitetit ndërmjet respektimit të të drejtave themelore të viktimave të trafikimit me njerëz dhe kushteve të ndjekjes penale, në mënyrë që nuk shkel të drejtat e të pandehurit;
1.12. sigurohet që të gjitha aktivitetet kundër trafikimit me njerëz të kenë parasysh aspektin gjinor, promovimin e barazisë gjinore dhe fuqizimin e viktimave gra dhe vajza.
1.13. trajtimit të barabartë të gjitha formave dhe llojeve të trafikimit kombëtar dhe transnacional me njerëz, pavarësisht se a është apo jo i ndërlidhur me krimin e organizuar;
1.14. bashkëpunimin e autoriteteve vendore me institucionet e shteteve tjera dhe organizatat ndërkombëtare me qëllim të arritjes së objektivave të parandalimit dhe luftimit të trafikimit me njerëz;
1.15. zbatimi i dispozitave të këtij ligji, veçanërisht masave për mbrojtjen e të drejtave të viktimave të trafikuara, bëhet pa diskriminim mbi çfarëdo baze: gjinisë, racës, gjuhës, fesë, mendimit politik apo ndryshe, origjinës sociale apo nacionale, shtetësisë, asocimit, përkatësisë me një pakicë etnike etj.

Neni 5
Elementet e veprës penale të trafikimit me njerëz

1. Siç është përcaktuar në nenin 171 të Kodit Penal, elementet e trafikimit me njerëz përbëhen nga:
   1.1. rekrutimi,
   1.2. transportimi,
   1.3. transferimi,
   1.4. strehimi apo pranimi i personave, me anë të kanosjes dhe përdorimit të forcës apo formave tjera të shtrëngimit,
   1.5. rrëmbimit,
   1.6. mashtrimit,
   1.7. lajthimit,
   1.8. keqpërdorimit të pushtetit apo keqpërdorimit të pozitës së ndjeshme dhe
   1.9. dhënia apo marrja e pagesave apo përfitimeve për të arritur pëlqimin e personit që ka kontroll mbi personin tjetër, për qëllim të shfrytëzimit.
2. Shtytja, dhënia e ndihmës ose tentativa për të kryer vepër penale nga ky ligj, është gjithashtu e dënueshme siç përcaktohet me Kodin Penal të Republikës së Kosovës.

3. Kur sjellja e cekur në paragrafin 1 të këtij neni përfshinë fëmijë, atëherë ajo është vepër e dënueshme e trafikimit me njerëz edhe nëse nuk është përdorur asnjëri nga mjetet e parapara në paragrafin 1 të këtij neni, siç përcaktohet me Kodin Penal të Republikës së Kosovës.
4. Pëlqimi i viktimës së trafikimit me njerëz për qëllime shfrytëzimi nuk merret parasysh kur cilado prej mjeteve të përcaktuara më lart në paragrafin 1 të këtij neni, është përdorur kundër viktimës së tillë, siç përcaktohet me Kodin Penal të Republikës së Kosovës.

KREU II
AUTORITETET PËR PARANDALIMIN DHE LUFTIMIN E TRAFIKIMIT ME NJERËZ DHE MBROJTJEN E VIKTIMAVE TË TRAFIKUARA

Neni 6
Autoritetet

1. Autoritetet kompetente për parandalimin dhe luftimin e trafikimit më njerëz, dhe ofrimin e ndihmës dhe mbrojtjes së viktimave të trafikuara janë:
   1.1. Ministria e Punëve të Brendshme;
   1.2. Policia e Kosovës;
   1.3. Këshilli Gjyqësor i Kosovës;
   1.4. Këshilli Prokurorial i Kosovës;
   1.5. Ministria e Drejtësisë;
   1.6. Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë;
   1.7. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal;
   1.8. Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit;
   1.9. Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale;
   1.10. Ministria e Shëndetësisë;
   1.11. Ministria e Punëve të Jashtme;
   1.12. Ministria e Financave;
   1.13. Agjencia për Barazi Gjinore;
   1.14. Prokurori i Shtetit;
   1.15. Gjykatat;
   1.16. Zyra për Mbrojte dhe Ndihmë Viktimave
   1.17. Komunat, dhe
   1.18. Çdo ofrues i shërbimeve në kuadër të këtyre institucioneve, i cili në bazë të këtij ligji apo ndonjë ligj tjetër përkatës është i autorizuar që të merret me parandalimin dhe luftimin e trafikimit me njerëz dhe sigurimin e ndihmës dhe mbrojtjes së viktimave të trafikuara.

Neni 7
Autoriteti Kombëtar kundër Trafikimit me Njerëz

1. Autoriteti Kombëtar kundër trafikimit me njerëz (në tekstin e mëtejmë autoriteti kombëtar), përbëhet nga autoritetet e përcaktuara ne nenin 6 të këtij ligji si dhe institucionet e tjera relevante nga fushëveprimet e ndryshme shtetërore, përfshirë edhe përfaqësuesit e ofruesve të shërbimeve vendore qeveritare dhe joqeveritare.

2. Autoriteti Kombëtar brenda Strategjisë Kombëtare dhe Planit të Veprimit Kundër Trafikimit me Njerëz, procedurave standarde të veprimit për viktimat e trafikimit, standardeve minimale të kujdesit për viktimat e trafikimit dhe të gjitha dokumenteve të tjera relevante përcakton detyrat dhe përgjegjësitë e secilit institucion në parandalimin dhe luftimin e trafikimit me njerëz dhe mbrojtjen e viktimave, për të mundësuar luftimin efektiv dhe efikas të trafikimit me njerëz dhe ofrimin e ndihmës dhe mbrojtjes së viktimave të trafikuara në Kosovë, siç është e definuar me mandatin legjislativ të secilit institucion.
3. Përfaqësuesit e organizatave joqeveritare dhe organizatave ndërkombëtare që i kanë përfaqësitë e tyre në Kosovë dhe që janë të përfshirë në aktivitete të luftimit të trafikimit me njerëz, dhe të cilët japin ndihmë dhe mbrojtje për viktimat e trafikimit me njerëz, mund të marrin pjesë nëpër takimet e Autoriteti Kombëtar, në cilësinë e këshillëdhënësve.
4. Çështjet organizative dhe koordinuese të Autoriteti Kombëtar sigurohen nga sekretariati për Monitorim dhe Evaluim të Strategjive Nacionale, që funksionon në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme.
5. Autoriteti Kombëtar i paraqet Qeverisë raport për aktivitetet e tij, në baza periodike, por jo më pak se një herë në vit, si dhe sipas kërkesës. Në çfarëdo kohe tjetër institucionet qendrore të shtetit mund të kërkojnë informata nga Autoriteti Kombëtar lidhur me respektimin e legjislacionit për parandalimin dhe luftimin e trafikimit me njerëz dhe mbrojtjen e viktimave të trafikuara, si dhe ne implementimin e Strategjisë Kombëtare dhe planit te veprimit kundër trafikimit me njerëz.
6. Qeveria nxjerr akt nënligjor për përbërjen formale, kompetencat, përgjegjësitë dhe mënyrën e funksionimit të Autoriteti Kombëtar.

Neni 8
Emërtimi dhe kompetencat e Koordinatorit Kombëtar kundër Trafikimit me Njerëz

1. Qeveria emëron një Koordinator Kombëtar Kundër Trafikimit me Njerëz (në tekstin e mëtejmë Koordinator/i).
2. Koordinatori kryeson Autoritetin Kombëtar. Koordinatori bashkëpunon vazhdimisht me autoritetet e përcaktuara në nenin 6 të këtij ligji, dhe me autoritetet e tjera të zbatimit të ligjit, më qëllim të parandalimit dhe luftimit të trafikimit me njerëz dhe mbrojtjes së viktimave të trafikuara.
3. Koordinatori me mbështetjen e Sekretariatit për Monitorim dhe Evaluim të Strategjive Nacionale, që funksionon në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme zhvillon, koordinon dhe monitoron zbatimin e mekanizmit kombëtar të referimit për të siguruar identifikimin e duhur, referimin, ndihmën dhe mbrojtjen e viktimave të trafikimit me njerëz, përfshirë viktimat fëmijë, dhe për të siguruar se ata pranojnë ndihmën adekuate duke mbrojtur të drejtat e tyre njerëzore.
4. Qeveria siguron burime të mjaftueshme financiare dhe resurse të mjaftueshme njerëzore për Koordinatorin, Autoriteti Kombëtar dhe sekretarinë, për të kryer aktivitetet në vazhdim:
   4.1. koordinimin e zbatimit të këtij ligji, përfshirë hartimin e udhëzimeve, rregulloreve, e akteve nënligjore të tjera, për t'u miratuar nga Qeveria;

4.2. hartimin dhe zbatimin e vazhdueshëm të Strategjisë Nacionale dhe Planit të Veprimit, që përmban një pako gjithëpërfshirëse të masave për parandalim dhe luftimin e trafikimit me njerëz si dhe të koordinojë dhe të monitorojë implementimin e tij;

4.3. promovimin e hulumtimeve dhe caktimin e procedurave për të analizuar shkallën, natyrën dhe format e reja si të trafikimit vendor ashtu edhe atë ndërkufitar dhe identifikimin e praktikave më të mira për parandalimin dhe luftimin e trafikimit me njerëz dhe ri-integrimin e viktimave të trafikuara, përfshirë mbledhjen dhe ofrimin e të dhënave për numrin e viktimave të ndara sipas gjinisë si dhe të dhëna të tjera të rëndësishme për të analizuar shkallën, natyrën dhe formën e trafikimit.

4.4. lehtësimin e bashkëpunimit mes autoriteteve dhe akterëve të ndryshëm qeveritar dhe mes akterëve qeveritar dhe joqeveritar, përfshirë inspektorët e punës, Odës Ekonomike të Kosovës dhe palëve të tjera relevante të tregut të punës;

4.5. lehtësimin e bashkëpunimit mes vendeve të origjinës, transitit dhe destinimit;

4.6. veprimin si pikë qendrore për institucionet kombëtare dhe palëve të tjera shtetërore e jo-shtetërore dhe organeve ndërkombëtare për përpjekjet e Qeverisë kundër trafikimit me njerëz;

4.7. sigurimin që masat kundër trafikimit të jenë në harmoni me normat ekzistuese dhe standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut që parashihen me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe ligjet e tjera relevante.

5. Kordinatori Kombëtar do të veprojë si Raportuesi Kombëtar në mënyrë që të kryejnë vlerësime të trendeve të trafikimit me njerëz dhe të masë rezultatet e veprimeve antitrafikim, duke përfshirë mbledhjen e statistikave në bashkëpunim të ngushtë me organizatat relevante të shoqërisë civile, aktive në këtë fushë.

Neni 9
Parandalimi dhe luftimi i trafikimit me njerëz

1. Parandalimi, luftimi dhe mbrojtja e viktimave të trafikuara me njerëz bëhet nga të gjitha autoritetet përfshirë edhe përfaqësuesit e ofruesve të shërbimeve vendore qeveritare dhe joqeveritare duke u bazuar në legjislacionin përkatës në fuqi.
2. Autoritetet bëjnë identifikimin e viktimave të trafikimit me njerëz kur ka bazë të arsyeshme për të besuar se një person i caktuar është viktimë e trafikimit.
3. Autoritetet duhet të marrin masat e nevojshme, si edukimi dhe trajnimi, me qëllim të reduktimit të kërkesës që favorizon të gjitha format e shfrytëzimit lidhur me trafikimin me njerëz.
4. Autoritetet, në bashkëpunim me organizatat përkatëse dhe shoqërinë civile ndërmarrin veprimet e përshtatshme, përfshirë internetin, fushatat informuese dhe të sensibilizimit, programe shkencore dhe edukuese, me qëllim të sensibilizimit të opinionit për trafikimin me njerëz dhe reduktimit të rrezikut që personat e ndryshëm, veçanërisht fëmijët, dhe viktimat e ndjeshme të jenë viktima të trafikimit.
5. Autoritetet do të favorizojnë trajnimet e rregullta të zyrtarëve të cilët mund të jenë

në kontakt me viktimat apo viktimat e mundshme të trafikimit, përfshirë zyrtarët e policisë, rojat kufitare, zyrtarët e imigrimit, prokurorët publikë, avokatët, anëtarët e gjyqësorit dhe zyrtarët e gjykatës, inspektorët e punës, personeli i kujdesit social, të fëmijëve dhe atij shëndetësor dhe stafi konsullor, por varësisht nga rrethanat vendore, mund të përfshijë edhe grupet tjera të zyrtarëve publikë, të cilët kanë gjasë që gjatë punës së tyre të hasin në viktima të trafikimit, me qëllim që të mundësohet identifikimi, referimi dhe trajtimi i dinjitetshëm i viktimave të trafikimit me njerëz.

6. Me qëllim të dekurajimit të kërkesës, dhe rritjes së efikasitetit të parandalimit dhe të luftimit të trafikimit të njerëzve, autoritetet do të ndërmarrin veprimet e nevojshme me qëllim që përdorimi i shërbimeve që janë objekt shfrytëzimi të konsiderohen shkelje penale siç përcaktohet me Kodin Penal të Republikës së Kosovës.

KREU III
HETIMI DHE NDJEKJA PENALE

Neni 10
Veprat që ndërlidhen me trafikimin me njerëz dhe bashkimi i procedurës

1. Në rastet kur një vepër penale përmban ndonjë nga elementet e veprës së trafikimit me njerëz nga nenin 5 i këtij ligji, vepra e tillë do të konsiderohet si vepër që ndërlidhet me trafikimin me njerëz.
2. Viktimat e veprave penale nga paragrafi 1 i këtij neni konsiderohen viktima të trafikimit dhe si të tilla i gëzojnë të gjitha të drejtat e parapara me këtë ligj.
3. Nëse kryesi gjatë procesit të trafikimit me njerëz, me veprimet e veta kryen njëkohësisht edhe vepra penale të tjera që ndërlidhen me veprën e trafikimit, i njëjti do të gjykohet për bashkim të veprave penale në pajtim me dispozitat e Kodit Penal dhe Kodin e Procedurës Penale të Republikës së Kosovës.
4. Me qëllim të ruajtjes së rrjedhës dhe tërësisë së procesit, për veprën e trafikimit me njerëz dhe të gjitha veprat që ndërlidhen me veprën e trafikimit, çdo herë kur provat janë të përbashkëta, do të zhvillohet procedurë e përbashkët në pajtim me dispozitat e Kodit të Procedurës Penale.
5. Kur për shkak të ruajtjes së efikasitetit apo shkaqeve të tjera të rëndësishme, nuk është e mundur bashkimi i procedurës sipas paragrafit 4 të këtij neni, çështjet do të procedohen ndaras në pajtim me dispozitat e Kodit të Procedurës Penale.
6. Çështjet rreth bashkimit apo veçimit të procedurës, si dhe çështjet rreth kompetencës (juridiksionit) së gjykatës për veprat sipas këtij ligji rregullohen në pajtim me Kodin e Procedurës Penale.

Neni 11
Hetimi dhe ndjekja

1. Kur është e nevojshme, mjetet hetimore të parapara në Kodin e Procedurës Penale, si ato që përdoren për krimin e organizuar apo veprat tjera të rënda penale, i vihen në dispozicion autoriteteve të zbatimit të ligjit për hetimin apo ndjekjen e veprave të trafikimit me njerëz dhe veprave tjera që përmbajnë elemente të veprës së trafikimit.

2. Me qëllim që hetimit dhe ndjekjes penale efektive të rasteve të trafikimit me njerëz në Kosovë, Prokuroria e Shtetit dhe Policia, krijojnë ekipe të përbashkëta hetimore.
3. Autoritetet e zbatimit të ligjit dhe prokurorët identifikojnë dhe bëjnë ngrirjen, sekuestrimin apo konfiskimin e mjeteve të përdorura dhe dobisë pasurore të fituar nga vepra e trafikimit me njerëz dhe çfarëdo pasurie tjetër të paligjshme siç përcaktohet në Kapitullin VII të Kodit Penal.
4. Ndjekja dhe hetimi i veprave kundër trafikimit me njerëz nuk varet nga raportimi apo akuza e një viktime të trafikuar, dhe procedura penale duhet të vazhdoj edhe nëse viktima e trafikuar e tërheq qëndrim e tij/saj,
5. Gjykatat dhe organet për ndjekje penale u njohin viktimave të trafikimit me njerëz masat për garantimin e të drejtave dhe sigurisë së tyre fizike, ashtu siç përcaktohet me Kodin e Procedurës Penale dhe Ligjin për Mbrojtjen Dëshmitarëve dhe legjislacioni tjetër përkatës në Kosovë.
6. Autoritetet organizojnë trajnime të duhura për personat, njësitë apo shërbimet përgjegjëse të cilët/at merren me hetimin ose ndjekjen penale të veprave të trafikimit me njerëz.

Neni 12
Identifikimi zyrtar i viktimave të trafikuara

1. Identifikimin zyrtar të viktimave të trafikimit me njerëz e bëjnë njësitë përkatëse të policisë, prokurorisë, mbrojtësi i viktimave dhe qendrat për punë sociale bazuar në nenin 5 të këtij ligji, kur kanë dyshim të bazuar për të besuar se një person i caktuar është viktimë e trafikimit në pajtim me Procedurat Standarde të Veprimit të hartuara nga autoritetet përkatëse.
2. Ministria e Drejtësisë në bashkëpunim me autoritetet përkatëse hartojnë listën e treguesve lidhur me trafikimin e me njerëz, me qëllim të lehtësimit të identifikimit të viktimave nga autoritetet policore, penale, gjyqësore dhe sociale të cilët mund të jenë në kontakt me viktimat apo viktimat e mundshme. Lista e treguesve miratohet nga Qeveria e Republikës së Kosovës.
3. Qeveria me propozimin e Ministrisë së Punëve të Brendshme, Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Ministrisë së Punës dhe e Mirëqenies Sociale, nxjerr udhëzues specifik për shërbimet konsullore, policinë kufitare dhe inspektorët e punës me qëllim të identifikimit të hershëm të viktimave të trafikimit.

Neni 13
Përjashtimi i përgjegjësisë së viktimave të trafikimit

1. Viktimat e trafikimit nuk duhet të arrestohen dhe nuk mund të ndiqen penalisht për vepra penale dhe kundërvajtje, të kryera nga ai /ajo/si rezultat i drejtpërdrejtë i veprës së trafikimit me njerëz, përfshirë:
   1.1. hyrjen dhe daljen e paligjshme të personit të trafikuar, në/nga shteti;
   1.2. blerjen apo posedimin e dokumenteve të falsifikuara të udhëtimit apo identifikimit të cilat ai i ka marrë, apo të cilat iu janë dhënë atij, me qëllim të hyrjes apo daljes nga shteti në lidhje me veprën penale të trafikimit me njerëz;

1.3. përfshirjen e viktimës në veprimtari tjera të paligjshme deri në atë masë që kjo përfshirje është pasojë direkte e situatës së tyre të trafikimit;

2. Fëmijët të cilët janë viktima të trafikimit nuk i nënshtrohen procedurave apo sanksioneve penale për veprat penale që ndërlidhen me situatën e tyre si viktima të trafikuara.

Neni 14
Përgjegjësia e personave juridik

1. Personat juridik mbahen përgjegjës për veprat e trafikimit me njerëz, të kryera për përfitim të tyre nga një person, i cili vepron qoftë individualisht ose si pjesë e një organi të personit juridik, e që ka një pozitë udhëheqëse në kuadër të personit juridik, duke u mbështetur në:
   1.1. kompetencën për ta përfaqësuar personin juridik;
   1.2. autoritetin për të marrë vendime në emër të personit juridik.
   1.3. autoritetin për të ushtruar kontroll përbrenda personit juridik.
2. Personat juridik mbahen përgjegjës edhe në rastin kur mungesa e mbikëqyrjes apo kontrollit nga një person i cekur në paragrafin 1 të këtij neni ka bërë të mundur kryerjen e veprës së trafikimit me njerëz, për përfitime të atij personi juridik, nga ana e një personi nën autoritetin e tij.
3. Përgjegjësia e një personi juridik sipas paragrafit 1 dhe 2 të këtij neni, nuk do ta përjashtoj zhvillimin e procedurës penale kundër personave fizik, që janë kryes, nxitjes ose ndihmës në veprat e trafikimit me njerëz.
4. Sanksionet penale kundër personave juridik për rastet e trafikimit me njerëz do të zbatohen sipas Ligjit për Përgjegjësinë e Personave Juridik për Vepra Penale.

Neni 15
Trajtimi i viktimave të trafikimit me njerëz gjatë hetimit dhe procedurës penale

1. Viktimat e trafikimit me njerëz e pranojnë mbrojtjen e duhur në bazë të vlerësimit individual të rrezikut.
2. Në rastet kur para gjykatës shqyrtohen çështjet lidhur me veprat sipas këtij ligji, për persona të identifikuar si viktimë, prokurori dhe palet e tjera të autorizuara duhet të kërkojnë dhe gjykata lejojn aplikimin e mundësisë hetuese të veçantë, në pajtim me Kodin e Procedurës Penale. Deklaratat do të incizohen dhe do të jenë plotësisht të pranueshme gjatë gjykimit. Deklaratat nga ky paragraf mund të përdoret për viktimat vendore dhe viktimat të cilat gjenden jashtë Kosovës.
3. Pa paragjykim ndaj të drejtave të mbrojtjes, dhe në pajtim me vlerësimin individual të bërë nga autoritetet, viktimat pranojnë trajtim specifik që synon parandalimin e viktimizimit të serishëm posaçërisht viktimat e ndjeshme duke shmangur, për aq sa është e mundshme situatat si në vijim:
   3.1. përsëritjen e panevojshme të intervistave gjatë hetimit, ndjekjes apo gjykimit;
   3.2. kontaktin (ballafaqim) vizual ndërmjet viktimave dhe të pandehurve, gjatë dhënies së dëshmisë si intervistat dhe marrjet e tërthorta në pyetje, përmes mjeteve të duhura përfshirë përdorimin e teknologjive të përshtatshme të komunikimit;

3.3. dhënien e dëshmisë në seancë të hapur për publikun; dhe
3.4. marrjen e panevojshme në pyetje lidhur me marrëdhëniet intime të viktimës gjatë kohës sa ai/ajo ka qenë e trafikuar.

Neni 16
Trajtimi i viktimave fëmijë të trafikimit me njerëz gjatë hetimeve dhe procedurave penale

1. Pa paragjykim ndaj të drejtave të mbrojtjes, dhe në pajtim me vlerësimin individual të bërë nga autoritetet, viktimat fëmijë pranojnë trajtim të veçantë që synon parandalimin e viktimizimit të serishëm duke shmangur, për aq sa është e mundshme situatat si në vijim:
   1.1. intervistat me viktimat fëmijë të bëhen pa vonesë të paarsyeshme pas raportimit të fakteve tek autoritetet kompetente;
   1.2. intervistat me viktimat fëmijë të bëhen, në ndërtesa të dizajnuara dhe përshtatura për atë qëllim;
   1.3. intervistat me viktimat fëmijë të bëhen çdo herë nga apo përmes profesionistëve të trajnuar për atë qëllim;
   1.4. nëse është e mundshme, zyrtarët e njëjtë i kryejnë të gjitha intervistat me viktimën fëmijë;
   1.5. intervistimi i viktimës fëmijës behet vetëm një herë. Numri i intervistave mund të jetë me shumë se një vetëm për qëllime të hetimeve të veçanta dhe të komplikuara, në pajtim me Kodin e Drejtësisë për të Mitur, Kodin Penal dhe Kodin e Procedurës Penale;
   1.6. Viktima fëmijë shoqërohet nga një përfaqësues i autorizuar, ose kur është e përshtatshme, nga një i rritur sipas zgjedhjes së fëmijëve, përveç rasteve kur është marrë vendim i arsyetuar që e kundërshton zgjedhjen e atij personi.
2. Dispozitat nga neni 15, paragrafi 2, do të aplikohen mutatis mutandis (përshtatshmërisht) gjatë marrjes së deklaratës së fëmijëve viktima.
3. Gjykata ndërmerr masat e nevojshme për të siguruar që në procedurat që ndërlidhen me cilëndo nga veprat e trafikimit me njerëz, kur një fëmijë viktimë është i përfshirë, mund të urdhëroj që:
   3.1. seanca të mbahet pa praninë e publikut; dhe
   3.2. viktima fëmijë të dëgjohet në gjykatë pa qenë e pranishme, veçanërisht, përmes përdorimit të teknologjive të përshtatshme të komunikimit.

Neni 17
Mbyllja e objekteve dhe bizneseve afariste që janë të përfshira dhe e mundësojnë trafikimin me njerëz

Në rastet kur ekziston dyshimi i bazuar se një objekt apo biznes afarist, që vepron në mënyrë të ligjshme ose të paligjshme, është i përfshirë, në çështjet e trafikimit me njerëz, sipas këtij ligji dhe Kodit të Procedurës Penale prokurori i kërkon gjyqtarit mbylljen e menjëhershme të atij objekti apo biznesi afarist.

Neni 18
Mbrojtja e të dhënave /Personale dhe privatësisë

1. Të dhënat personale, jeta private dhe identiteti i viktimave të trafikimit me njerëz mbrohet nga autoritetet e zbatimit të ligjit gjatë procedurës penale. Regjistrimi, mirëmbajtja, dhe shfrytëzimi i të dhënave personale të viktimës së trafikimit bëhet në pajtim me kushtet e përcaktuara me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.
2. Në pajtim me paragrafin 1 të këtij neni, duhet të hartohet një marrëveshje për shkëmbimin e informacioneve ndërmjet autoriteteve që merren me identifikimin dhe ndihmën e viktimës, si dhe me hetimin penal duke respektuar në tërësi mbrojtjen e të dhënave personale dhe privatësisë dhe sigurisë së viktimave.
3. Të gjitha informacionet e shkëmbyera ndërmjet viktimës dhe profesionistit që ofron shërbime mjekësore, psikologjike, juridike apo ndihmë tjetër janë konfidenciale dhe nuk shkëmbehen me personat e tretë pa pëlqimin e viktimës, e në rastet e viktimës fëmijë pa pëlqimin e përfaqësuesit ligjor.
4. Ndalohet zbulimi i të dhënave që kanë të bëjnë me masat e mbrojtjes shtetërore për viktimat e trafikimit me njerëz, personat të cilët ofrojnë mbrojtjen e tillë, si dhe personat të cilët ofrojnë ndihmë në luftimin e trafikimit me njerëz.
5. Në rast se jeta dhe shëndeti i viktimës së trafikimit me njerëz është e kanosur nga rreziku real, atëherë asaj i mundësohet, sipas kërkesës së saj, në bazë të vendimit të gjykatës të nxjerrë sipas kërkesës së prokurorit, mundësia për të ndryshuar emrin e tij/saj, mbiemrin, datën dhe vendin e lindjes, në pajtim me kushtet e përcaktuara me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe legjislacionin përkatës në fuqi.
6. Zbulimi i informacioneve mbi masat e sigurisë dhe të dhënave konfidenciale të viktimës së trafikimit, si dhe zbulimi i informacionit që ka të bëjë me ndjekjen penale dhe masat e ofruara për sigurinë e pjesëmarrësve në procedurë penale, dënohet në pajtim me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe legjislacionin për vepra penale dhe administrative.

Neni 19
Sigurimi i viktimave apo dëshmitarëve

1. Organi kompetent i përcaktuar me Ligjin për Mbrojtjen e Dëshmitarëve, ndërmerr të gjitha masat e nevojshme për të siguruar që viktimës apo dëshmitarit të trafikimit me njerëz, dhe familjes së tij, t'i ofrohet mbrojtje adekuate në rast se siguria e tij është në rrezik, përfshirë masat për mbrojtjen e tij nga frikësimi dhe hakmarrja e trafikantëve dhe bashkëpunëtorëve të tyre.
2. Kur është e nevojshme për garantimin e sigurisë fizike të viktimës apo dëshmitarit, në bazë të kërkesës së viktimës apo dëshmitarit apo në konsultim me të, organi kompetent ndërmerr të gjitha masat e nevojshme për zhvendosjen e tij brenda apo jashtë Kosovës në pajtim me nën-kreu H të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe kufizimin e zbulimit të emrit, adresës dhe informatave tjera identifikuese personale deri në atë shkallë që është e mundur.
3. Viktimat dhe dëshmitarët e trafikimit me njerëz kanë qasje në masat apo programet ekzistuese të mbrojtjes së dëshmitarëve në pajtim me Ligjin për Mbrojtjen e Dëshmitarëve dhe Kodin e Procedurës Penale.

4. Në rastet para gjykatës të cilat kanë të bëjnë me veprat penale sipas këtij ligji, gjykata mund t'ua lejojë viktimave të supozuara dhe dëshmitarëve të paraqesin dëshmitë e tyre në kamera ose përmes mjeteve të tjera elektronike ose speciale, siç shihet e përshtatshme nga gjykata.
5. Një viktimë e trafikimit ose një dëshmitari jashtë Kosovës që mund të jetë në gjendje të ofrojë informata gjatë hetimit të rasteve që kanë të bëjnë me trafikimin me njerëz, mund t'i jepet autorizim i përkohshëm të mbetet në Kosovë dhe mbrojtje e duhur gjatë atyre periudhave dhe sipas kushteve të cilat konsiderohen të përshtatshme nga institucionet përgjegjëse.
6. Asgjë në këtë ligj nuk ua ndalon viktimave dhe përfaqësuesit ose përfaqësuesit të autorizuar të tij/saj që të kërkojë kompensim të urdhëruar nga gjykata sipas procedurës civile dhe penale që garantohet me ligjet në fuqi.

KREU IV
NDIHMA DHE MBROJTA E VIKTIMAVE TË TRAFIKUARA ME NJERËZ

Neni 20
Ndihma dhe mbrojtja e viktimave të trafikuara me njerëz

1. Viktimave të trafikimit me njerëz u jepet mbrojtje dhe ndihmë nga autoritetet e përcaktuara në nenin 6 të këtij ligji**,** në kuadër të kompetencave të tyre dhe në pajtim me këtë ligj dhe aktet tjera normative.
2. Në pajtim me Kodin e Procedurës Penale, viktima e trafikimit, ka të drejtat themelore si në vijim:
   2.1. të drejtën në informim mbi rrjedhën e procedurës si dhe për të gjitha të drejtat që i takojnë sipas këtij ligji dhe legjislacionit tjetër në fuqi.
   2.2. të drejtën për tu trajtuar si palë në procedurë;
   2.3. të drejtën për qasje në shërbime ligjore pa pagesë;
   2.4. të drejtën për shërbime të përkthimit me shkrim dhe gojor, gjatë të gjitha fazave të procedurës, në gjuhë në të cilën ai/ajo e kupton;
   2.5. të drejtën në mbrojtje për viktimat dhe dëshmitarët, dhe në raste të caktuara edhe për familjet e tyre, të cilat ballafaqohen me kërcënime apo frikësime në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e Dëshmitarëve;
   2.6. të drejtën për privatësi dhe konfidencialitet;
   2.7. të drejtën në parashtrimin e mjeteve juridike, përfshirë edhe ndihmën juridike në këtë çështje;
   2.8. të drejtën në strehim të përkohshëm;
   2.9. të drejtën në një periudhë reflektimi prej tridhjetë (30) deri në nëntëdhjetë (90) ditësh me qëllim të rimëkëmbjes;
   2.10. të drejtën në ndihmë mjekësore, psikologjike, dhe shërbime për mirëqenie sociale, pagesë, siç mund të jetë e nevojshme për t'i përmbushur nevojat e tyre dhe në pajtim me legjislacionin në fuqi;
   2.11. të drejtën në dëmshpërblim dhe kompensim;
   2.12. të drejtën e pjesëmarrjes në seancat mbi caktimin e dënimit apo informimin mbi vendimet lidhur me dënimin;
   2.13. të drejtën mbi informimin mbi lirimin apo arratisjen e të pandehurit nga qendrat e paraburgimit.

3. Të drejtat nga ky nen i ofrohen viktimave para, gjatë dhe, pas përfundimit të procedurave penale.
4. Shërbimet e ndihmës të parapara me këtë nen, janë në dispozicion edhe të viktimave të cilat riatdhesohen nga një shtet tjetër në Republikën e Kosovës dhe për vartësit shoqërues të viktimës.
5. Ndihma dhe mbështetja e viktimave të trafikimit vihet në dispozicion porsa autoritetet kompetente të kenë bazë të arsyeshme për të besuar që personi mund t'iu ketë nënshtruar ndonjë vepre të paraparë të trafikimit me njerëz.
6. Ndihma dhe mbështetja e viktimës nuk kushtëzohen me gatishmërinë e viktimës për të bashkëpunuar gjatë hetimeve, ndjekjes apo gjykimit.
7. Masat për ndihmë dhe mbështetje sigurohen në bazë të pëlqimit dhe informimit të duhur dhe duke marrë parasysh nevojat e veçanta të fëmijëve dhe viktimave të tjera të ndjeshme.
8. Mbrojtësi i Viktimave ofron ndihmë dhe mbështetje ligjore për viktimën e trafikimit me njerëz, që nga kontaktet e para me organet kompetente. Mbrojtësi i viktimave merr pjesë në të gjitha fazat procedurale dhe përfaqëson viktimën e trafikimit në të gjitha seancat gjyqësore.
9. Çdo herë kur organi kompetent, organizatat ndërkombëtare dhe joqeveritare te cilat janë aktive në këtë fushë ka bazë të arsyeshme për të besuar se një person është viktimë e trafikimit me njerëz, atëherë personit të tillë i ofrohen të gjitha masat mbrojtëse dhe ndihma e përcaktuar më këtë ligj.

Neni 21
Rehabilitimi i viktimave të trafikimit

Rehabilitimi i viktimave të trafikimit me njerëz bëhet me qëllim të rehabilitimit dhe rikthimit të tyre në një jetë normale duke përfshirë dhënien e ndihmës mjekësore, psikologjike, juridike dhe materiale.

Neni 22
Ri-integrimi i viktimave të trafikuara

Ri-integrimi i viktimave të trafikimit me njerëz bëhet pas rehabilitimit me qëllim të përfshirjes së suksesshme shoqërore të viktimave të trafikimit me njerëz, në jetë normale dhe të lirë, duke ofruar qasje adekuate në shërbime edukuese, trajnime profesionale, mundësi për banim të përhershëm dhe të sigurt dhe pavarësi financiare përmes ofrimit të mundësive të ndryshme për (vetë) punësim.

Neni 23
Sigurimi dhe mbështetja e qendrave dhe strehimoreve për strehim të përkohshme për viktimat e trafikimit

1. Qeveria siguron mbështetjen e qendrave dhe strehimoreve të përkohshme dhe mbrojtjen e viktimave të trafikimit me njerëz, me qëllim që qendrat apo strehimoret e specializuara të kenë mundësi për të ofruar kushte të akomodimit dhe higjienës personale, ushqimit, kujdesit urgjent dhe ndihmës ligjore, psikologjike dhe

mjekësore, sigurisë dhe mbrojtjes, si dhe ndihmës në ndërmjetësimin dhe kontaktimin e familjes dhe të afërmeve.

2. Qendrat dhe strehimoret e përkohshme mund të themelohen nga:
   2.1. Qeveria, sipas propozimit të Autoritetit Kombëtar;
   2.2. Autoritetit Kombëtar, sipas propozimit të autoriteteve të përcaktuara në nenin 6 të këtij ligji;
   2.3. Organizatat joqeveritare dhe ndërkombëtare, pas pëlqimit të Autoritetit Kombëtar;
   2.4. Autoritetet e përcaktuara në nenin 6 të këtij ligji në bazë të marrëveshjes për aktivitete të përbashkëta dhe pas pëlqimit të Autoritetit Kombëtar.
3. Shpenzimet e ndërlidhura me aktivitetet e përbashkëta të qendrave dhe strehimoreve do të mbulohen nga buxhetet e përbashkëta të tyre.
4. Rregullimi i organizimit dhe veprimit të qendrave dhe strehimoreve miratohet nga themeluesit, bazuar në legjislacionin përkatës në fuqi në Kosovë.
5. Me qëllim të garantimit të sigurisë së qendrave dhe strehimoreve në të cilat akomodohen viktimat e trafikimit me njerëz, qendrat dhe strehimoret sipas kërkesës së tyre u sigurohet ndihmë dhe siguri nga policia.
6. Qendrat i sigurojnë akomodim viktimave të trafikimit me njerëz në bazë të nevojave të vlerësuara për një periudhë tridhjetë (30) ditë deri në nëntëdhjete (90) ditë.
7. Kohëzgjatja e akomodimit të përcaktuar në paragrafin 6 të këtij neni mund të vazhdohet:
   7.1. në bazë të rekomandimit të mjekut gjatë periudhës së trajtimit, por jo më gjatë se 6 muaj;
   7.2. në bazë të kërkesës së organeve të ndjekjes penale apo të gjykatës gjatë periudhës së procedurës penale, dhe kur jeta apo shëndeti i viktimës janë të kanosur nga rreziku real, kohëzgjatja e akomodimit mund të vazhdohet edhe pas përfundimit të procedurës penale për një periudhë e cila konsiderohet e nevojshme për mbrojtjen e viktimës, bazuar në kërkesën e prokurorit;
   7.3. në bazë të kërkesës së viktimës së trafikimit me njerëz, në të cilën jepet arsyetimi, për një periudhë deri në nëntëdhjetë (90) ditë.
8. Gratë shtatzëna, të cilat janë viktima të trafikimit me njerëz, kanë të drejtë të akomodimit në qendër për një periudhë deri në një (1) vit, me mundësi vazhdimi.

Neni 24
Aftësimi profesional i viktimave të trafikimit

Autoritetet bëjnë aftësimin profesional të viktimave të trafikimit me njerëz, sipas kushteve të përcaktuara me legjislacionin në fuqi, duke iu ofruar shërbime falas me prioritet në fushën e ndërmjetësimit në punësim, informacioneve, këshillimit profesional, orientimit profesional dhe trajnimeve profesionale, si dhe duke u siguruar të drejtën që të marrin pjesë në kursin e trajnimit profesional të financuar nga programi i papunësisë. Përfituesit e shërbimeve të përcaktuara në këtë paragraf janë viktimat e trafikuara të moshës mbi 16 vjet.

Neni 25
Informimi lidhur me procedurën për lëshimin e lejeve për qëndrim

Nga momenti që autoritetet kompetente janë në dijeni se një person i huaj bie nën fushën e zbatimit të këtij ligji, ato e informojnë dhe e ndihmojnë personin në fjalë lidhur me mundësitë që i ofrohen në fushën e qëndrimit.

Neni 26
Periudha e reflektimit për viktimat dhe dëshmitarët e trafikimit me njerëz

1. Nëse konsiderohet se një i huaj, qëndrimi i të cilit në Kosovë nuk është i rregullt, është viktimë apo dëshmitar i trafikimit me njerëz, autoritetet kompetente për zbatimin e Ligjit për të Huaj, i ofrojnë një periudhë reflektimi, gjatë së cilës personi në fjalë rimëkëmbet, i largohet influencës dhe cenimeve të keqbërësve dhe pa marrë parasysh nëse dëshiron apo jo të bashkëpunoj me autoritetet përkatëse.
2. Kohëzgjatja, data e fillimit të periudhës së reflektimit dhe kushtet e përfundimit të kësaj periudhe rregullohen sipas dispozitave të legjislacionit të zbatueshëm për të huajt dhe dispozitave të këtij ligji. Respektimi i parimit të mos kthimit merret në konsideratë.

Neni 27
Shërbimet e ofruara përpara lëshimit të lejes për qëndrim

1. Autoritetet e Kosovës iu ofrojnë personave të huaj të cilët nuk kanë mjete të mjaftueshme financiare, ndihmën e nevojshme për jetesë dhe për qasjen në shërbimin mjekësor emergjent dhe për personat e ndjeshëm kur është e mundur dhe ndihmën psikologjike.
2. Në përputhje me legjislacionin përkatës, autoritetet duhet të marrin në konsideratë nevojat për mbrojtje dhe siguri të personave të huaj.
3. Nëse është e nevojshme, autoritetet duhet t'ju sigurojnë shërbime përkthimi.
4. Autoritetet mund të sigurojnë ndihmë ligjore falas, nëse kjo është e parashikuar në legjislacionin vendor përkatës në fuqi.

Neni 28
Qëndrimi i viktimave dhe dëshmitarëve të trafikimit me njerëz

1. Nëse prania e një viktime apo dëshmitari të trafikimit është e domosdoshme, autoritetet hetuese informojnë autoritetet që zbatojnë legjislacionin për të huaj, duke përcaktuar kohëzgjatjen e periudhës së reflektimit.
2. Autoritetet që zbatojnë legjislacionin për të huaj, lëshojnë një leje për qëndrim afatshkurtër për aq kohë sa zgjat procedura hetimore apo gjyqësore.
3. Në rastet humanitare, viktimave apo dëshmitareve të trafikimit me njerëz mund t'ju jepet mbrojtje plotësuese, sipas kushteve të parashikuara në legjislacionin për të huaj.
4. Në të gjitha veprimet lidhur me fëmijët, të ndërmarra qoftë nga institucionet publike ose private të mirëqenies sociale, nga gjykatat, autoritetet administrative apo organet legjislative, interesat më të mirë të fëmijës duhet të jenë preokupim parësor,

Neni 29
Kthimi viktimave të trafikimit nga Kosova

1. Kthimi i sigurt i viktimave të trafikimit organizohet nëse:
   1.1. viktimat e trafikimit dëshirojnë të kthehen në vendin e origjinës apo të rivendosen në një shtet tjetër;
   1.2. Autoritetet e Kosovës i ofrojnë viktimave të trafikimit informata lidhur me kthimin e sigurt në fillim të periudhës së reflektimit, gjatë gjithë periudhës që i jepet ndihmë dhe menjëherë sapo viktima shpreh dëshirën për t'u kthyer në vendin e origjinës apo për tu rivendosur në një shtet të tretë.
2. Viktimat apo dëshmitarët fëmijë nuk kthehen në vendin e tyre të origjinës nëse pas vlerësimit të rrezikut dhe sigurisë vlerësohet se kthimi i tyre nuk do të ishte në interesin e tyre më të mirë.
3. Kthimi i viktimave të trafikimit rregullohet sipas legjislacionit për të huaj, marrëveshjeve ndërkombëtare apo bilaterale. Parimi i moskthimit duhet të merret në konsideratë.
   3.1. Procedurat për kthimin e viktimave të trafikimit ose të viktimave të supozuara të trafikimit duhet të jene në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, Konventën e vitit 1951 si dhe Protokollin e vitit 1967 lidhur me statusin e refugjatëve

Neni 30
Bashkëpunimi ndërkombëtar në fushën e kthimit

1. Në rast të kthimit të një viktime të huaj, shteti pritës dhe shteti, shtetas i të cilit është viktima e trafikimit, apo në të cilën viktima ka leje qëndrimi, duhet të parashikojnë dispozita të veçanta lidhur me bashkëpunimin në mes tyre.
2. Pas kërkesës së parashtruar nga shteti kërkues, shtetit i kërkuar duhet të lehtësoj kthimin e viktimës duke verifikuar nëse viktima është shtetas i tij apo ka të drejtë qëndrimi në territorin e tij dhe nëse është e nevojshme duhet ta pajis me dokumentet e udhëtimit.
3. Riatdhesimi dhe ripranimi i viktimave të trafikimit me njerëz bëhet në përputhje me legjislacionin që e rregullon çështjen e ripranimit në Kosovë dhe në përputhje me këtë ligj.

Nenin 31
Ofrimi i ndihmës dhe mbrojtjes së viktimave të trafikimit

1. Ofrimin e ndihmës dhe mbrojtjes së viktimave të trafikimit me njerëz realizohet duke dhënë ndihmë shëndetësore, psikologjike, sociale dhe ligjore përmes masave të specializuara përkatëse.
2. Viktimat e trafikimit dhe viktimat e supozuara përfitojnë shërbime shëndetësore falas nga autoritetet përkatëse shëndetësore, siç është e rregulluar me legjislacionin përkatës për shëndetësi.
3. Shteti, përmes autoriteteve dhe organizatave të tij, ndërmerr masa të menjëhershme adekuate për identifikimin dhe referimin e viktimave të trafikimit me njerëz në

shërbimet për mbrojtje dhe ndihmë, duke u mundësuar atyre një periudhë reflektuese prej tridhjetë (30) deri në nëntëdhjetë (90) ditë. Gjatë kësaj periudhe, ndalohet zbatimi i çfarëdo urdhri dëbues kundër personit të tillë.

4. Viktimave të trafikimit me njerëz u jepet ndihmë dhe mbrojtje nga autoritetet e përcaktuara në nenin
5. të këtij ligji, në kuadër të kompetencave të tyre dhe në pajtim me këtë ligj dhe aktet tjera normative.

Nenin 32
Dhënia e ndihmës dhe mbrojtjes viktimave të trafikimit njerëz nga misionet diplomatike dhe zyrat konsullore të Republikës së Kosovës

1. Misioneve diplomatike dhe zyrat konsullore të Republikës së Kosovës, me rastin e dhënies së ndihmës dhe mbrojtjes së viktimave të trafikimit me njerëz kanë këto detyrime:
   1.1. të zbatojnë aktivitete për mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të qytetarëve të Republikës së Kosovës të cilët janë bërë viktimë e trafikimit me njerëz në shtetin e qëndrimit apo, në shtetet në të cilat kanë misione të akredituara, dhe të kontribuojnë në riatdhesimin e tyre në pajtim me legjislacionin e Republikës së Kosovës dhe legjislacionin e shtetit të qëndrimit;
   1.2. në rast të humbjes apo pamundësisë për të rimarrë dokumentet identifikuese nga trafikantët me njerëz, të lëshojnë falas dhe në mënyrë të shpejtë për viktimat e trafikimit, së bashku me divizionet e ministrisë përkatëse, dokumentet apo aktet tjera të nevojshme për riatdhesim në Republikën e Kosovës të qytetarëve të Republikës së Kosovës,
   1.3. t'iu shpërndajnë të interesuarve materiale informative lidhur me të drejtat e viktimave të trafikimit me njerëz, në pajtim me legjislacionin e Republikës së Kosovës dhe legjislacionin e shtetit të qëndrimit;
   1.4. t'i sigurojnë autoriteteve dhe organeve gjyqësore të shtetit të qëndrimit apo në shtetet në të cilat kanë misione të akredituara informata lidhur me legjislacionin e Republikës së Kosovës në fushën e parandalimit dhe luftimit të trafikimit me njerëz, lidhur me të drejtat e viktimave ndihmën dhe mbrojtjen e tyre, përfshirë adresat e Qendrave për Mbrojtjen dhe Ndihmën e Viktimave të Trafikimit me Njerëz.
   1.5. krerët e misioneve diplomatike dhe zyrave konsullore caktojnë një diplomat nga misionet e tyre në krye të procedurave të aplikimit për riatdhesim për qytetarët e Kosovës, të cilët janë viktima të trafikimit me njerëz, për mbrojtjen dhe ndihmën e tyre gjatë qëndrimit në shtetin e transitit apo të destinacionit, si dhe për bashkëpunim në këtë fushë me organet dhe trupat nga Republika e Kosovës.

Neni 33
Roli i sektorit joqeveritar

1. Autoriteti Kombëtar mbështet, inkurajon dhe orienton organizatat joqeveritare vendore dhe organizatat ndërkombëtare që të ndihmojnë autoritetet nga nenin 6 i

këtij ligji, në parandalimin dhe luftimin e trafikimit më njerëz, dhe mbrojtjen e viktimave të trafikuara.

2. Organizatat joqeveritare vendore dhe ndërkombëtare ofrojnë shërbime përkatëse për viktimat e trafikimit, qoftë me nismën e tyre, në emër të drejtoratit komunal në rastin e shërbimeve lokale, ose në emër të autoritetit kombëtar në rastin e shërbimeve në nivel të Kosovës.
3. Çdo organizatë joqeveritare që ofron shërbime për viktimat e trafikimit duhet të licencohet nga institucioni përkatës, si edhe t'u përmbahet rregulloreve, udhëzimeve dhe procedurave lidhur me aktivitetet e tyre siç përcaktohen nga institucionin përkatës.
4. Institucionet në kuadër të autoritetit kombëtar mund të ndajnë fonde dhe të ofrojnë çfarëdo ndihmë tjetër materiale, duke përfshirë lokalet, ose këshillat për organizatat joqeveritare që ofrojnë shërbime përkatëse (në strehimore, rehabilituese ose të reintegrimit) për viktimat e trafikimit në nivel të Kosovës.
5. Në pamundësi të ofrimit të shërbimeve të caktuara për viktimat, komunat dhe institucionet qendrore mund të blejnë shërbime për viktimat e trafikimit nga organizatat joqeveritare vendore duke respektuar rregullat e prokurimit publik.
6. Organizatat joqeveritare vendore dhe organizatat ndërkombëtare janë të obliguara që të respektojnë legjislacionin në fuqi dhe standardet minimale për mbrojtjen e viktimave të trafikimit dhe gjithmonë të pranojnë monitorimin dhe inspektimin e kualitetit te shërbimeve të ofruara për viktimat.

KREU V
PARANDALIMI DHE LUFTIMI I TRAFIKIMIT ME FËMIJË

Neni 34
Dispozita të përgjithshme lidhur me ndihmën dhe mbrojtjen e fëmijëve viktima të trafikimit me njerëz

1. Fëmijët që janë viktimë e trafikimit përfitojnë ndihmë dhe mbrojtje. Interesat më të mira të fëmijës duhet të merret në konsideratë gjatë zbatimit të legjislacionit.
2. Autoritetet për kujdesin social, shëndetësor edukim, organizatat joqeveritare, institucionet tjera, dhe përfaqësuesit e shoqërisë civile, pa vonesë, kontaktojnë autoritetet për zbatimin e ligjit kur kanë njohuri ose kur dyshojnë se një fëmijë është shfrytëzuar apo trafikuar, apo i është ekspozuar rrezikut të shfrytëzimit apo trafikimit.

Neni 35
Parimet e posaçme të luftimit të trafikimit me fëmijë

1. Përveç parimeve themelore të përcaktuara në nenin 4, parimet e posaçme të përcaktuara më poshtë do të merren parasysh në aktivitetin e parandalimit dhe luftimit të trafikimit me fëmijë dhe mbrojtjen apo ndihmën e fëmijëve që janë viktimë e trafikimit të tillë:
   1.1. respektimi strikt i të drejtave të fëmijës të përcaktuara në Konventën e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës dhe në Kodin i Drejtësisë për të Mitur në Kosovë si dhe ndonjë legjislacionin tjetër përkatës;

1.2. ndërmarrja e masave për mbrojtje dhe ndihmë të posaçme të fëmijëve që janë viktimë e trafikimit me njerëz;
1.3. Kurdo që një fëmijë viktimë e trafikimit është i aftë të formojë pikëpamjet e tij apo të saj, duke i dhënë rëndësinë e duhur mendimit të fëmijës, në përputhje me moshën e tij / saj dhe pjekurinë e tij / saj dhe interesat më të mira të tij/saj;
1.4. informimi i fëmijës që është viktimë e trafikimit me njerëz në një mënyrë të përshtatshme për fëmijë lidhur me gjendjen dhe të drejtat e tij/saj, masat e mbrojtjes dhe ndihmës, shërbimet në dispozicion, procedurat e riatdhesimit, dhe procesin për bashkim familjar;
1.5. sigurimi që identiteti, si dhe çfarëdo detajesh që mund të bëjnë të mundur identifikimin e fëmijës viktimë të trafikimit, të mos bëhen publike në asnjë rrethanë.

Neni 36
Prezumimi i moshës

Kur mosha e viktimës së trafikimit me njerëz nuk është e njohur por ka shkaqe për të besuar se viktima ende nuk ka mbushur 18 vjet, prezumohet se viktima është fëmijë, dhe, deri në verifikimin final të moshës, viktima trajtohet si fëmijë, duke i njohur atij/asaj të gjitha masat për mbrojtje të posaçme të përcaktuara në këtë ligj dhe në aktet tjera normative.

Neni 37
Riatdhesimi i fëmijëve që janë viktimë e trafikimit me qenie njerëzore

1. Fëmija që është viktimë e trafikimit me njerëz riatdhesohet në shtetin e tij/saj të origjinës me kusht që, para kthimit të tij/saj, prindi, i afërmi, apo kujdestari ligjor të ketë dhënë pëlqimin për pranimin e fëmijës në kujdesin e tij/saj, apo që autoritetet qeveritare apo institucioni për mbrojtjen e fëmijëve nga vendi i origjinës të ketë dhënë pëlqimin që është në gjendje të merr përsipër përgjegjësinë për kujdesin e fëmijës dhe për t'i dhënë atij/asaj ndihmën dhe mbrojtjen adekuate.
2. Marrja e deklaratës nga fëmija lidhur me mënyrën e trafikimit nga ana e organit për ndjekje penale apo gjykata nuk pengon apo vonon bashkimin familjar apo rikthimin e fëmijës në vendin e tij/saj të origjinës, me kusht që kjo të jetë në interesin më të mirë të fëmijës.
3. Kur rikthimi i fëmijës në vendin e tij/saj të origjinës apo integrimi i tij/saj në vendin e destinacionit nuk është i mundur, apo kur këto zgjidhje nuk janë në interesin më të mirë të fëmijës, organet e të dyja vendeve sigurojnë zhvendosjen e fëmijës viktimë të trafikimit në një shtet të tretë, me miratimin e këtij të fundit.
4. Kurdo që një fëmijë viktimë e trafikimit është i aftë të formojë pikëpamjet e tij apo të saj, duke i dhënë rëndësinë e duhur mendimit të fëmijës, në përputhje me moshën e tij / saj dhe pjekurinë e tij / saj dhe interesat më të mira të tij/saj;
5. Fëmija që është viktimë e trafikimit nuk mund të rikthehet në vendin e tij/saj të origjinës apo të transferohet në shtetin e tretë, nëse, pas vlerësimit të rrezikut dhe sigurisë, ka shkaqe për të besuar se siguria e fëmijës apo familjes së tij/saj është në rrezik.

6. Fëmijët që janë viktimë e trafikimit me njerëz të cilët janë shtetas të huaj apo persona pa shtetësi kanë të drejtë në marrjen e leje qëndrim të përkohshëm e cila atyre iu garanton të drejtën për qëndrim të ligjshëm në territorin e Kosovës, deri në arritjen e një zgjidhjeje të qëndrueshme lidhur me kthimin e tyre në vendin e origjinës.

Neni 38
Dhënia e ndihmës dhe mbrojtja e fëmijëve që janë viktimë e trafikimit me njerëz

1. Autoritetet sigurojnë mbrojtjen dhe ndihmën e fëmijëve që janë viktimë e trafikimit me njerëz nga momenti kur ka arsye për të besuar se fëmija është viktimë e trafikimit deri në identifikimin, integrimin dhe shërimin e plotë të fëmijës, pavarësisht bashkëpunimit të tyre me organet, siç përcaktohet në këtë ligj.
2. Mbështetja dhe ndihma për viktimat fëmijë të trafikimit në shërimin tyre fizik dhe psikosocial, ndërmerren pas vlerësimit individual të rrethanave të veçanta të secilës viktimë fëmijë, duke i marrë para sysh pikëpamjet, nevojat dhe brengat e fëmijës me qëllim të gjetjes së një zgjidhjeje afatgjatë për fëmijën
3. Pas identifikimit si viktimë e supozuar e trafikimit me njerëz, fëmija menjëherë dërgohet në shërbimet kompetente për mbrojtjen, ndihmën dhe rehabilitimin e fëmijëve.
4. Autoriteti Kombëtar**,** autoritetet e përcaktuara në nenin 6 të këtij ligji përfshirë organet për zbatimin e ligjit, qendrat apo strehimoret, organizatat joqeveritare, dhe organizatat tjera kompetente detyrohen që menjëherë të njoftojnë institucionet e mbikëqyrjes dhe kujdestarisë nëse kanë informacion lidhur me një fëmijë që është viktimë e trafikimit me njerëz, ashtu që të sigurohet mbrojtja e të drejtave të fëmijës.
5. Kur fëmija që është viktimë e trafikimit me njerëz privohet nga kujdesi prindëror, institucionet e mbikëqyrjes dhe kujdestarisë caktojnë, ashtu siç përcaktohet me ligj, një kujdestar ligjor, i cili siguron që të gjitha vendimet e marra të jenë në interes të fëmijës, i cili jep deklarata në emër të fëmijës, dhe i cili merr pjesë së bashku me fëmijën në të gjitha procedurat penale dhe veprimet gjyqësore, derisa të arrihet një zgjidhje në pajtim me interesat më të mira të fëmijës.
6. Fëmijës i cili identifikohet si viktimë e trafikimit me njerëz duhet t'i jepet mundësia e një periudhe reflektuese prej tridhjetë (30) deri në nëntëdhjetë (90) ditësh, në mënyrë që ai/ajo të vendos personalisht, përmes përfaqësuesit apo kujdestarit të tij ligjor, me mbështetje të psikologut ose këshillëdhënësit, nëse ai/ajo do të dëshmojë kundër trafikantit.
7. Në rast të akomodimit të fëmijëve viktimë të trafikimit në qendra apo strehimore, ata duhet të akomodohen ndaras nga të rriturit.
8. Fëmijët që janë viktimë e trafikimit me njerëz kanë të drejtë në akomodim në qendër për një periudhë deri në 6 muaj apo gjatë tërë kohëzgjatjes së procedurave ligjore.
9. Të gjitha institucionet apo autoritetet aktiviteti i të cilave ndërlidhet me fëmijët që janë viktimë e trafikimit me njerëz themelojnë praktika dhe programe të veçanta për identifikimin, referimin, mbrojtjen dhe ndihmën, derisa në të njëjtën kohë ruajnë konfidencialitetin e informacionit që ka të bëjë me të dhënat personale dhe statusin e fëmijës si viktimë.

10. Fëmijëve që janë viktimë e trafikimit me njerëz dhe fëmijëve të viktimave u garantohet e drejta për të vijuar arsimin në institucionet shtetërore të edukimit në pajtim me kushtet e përcaktuara në Ligjin për Arsim.
11. Kur fëmijët që janë viktimë e trafikimit me njerëz lihen pa kujdes prindëror apo kur nuk e dinë vendndodhjen e prindërve të tyre, atyre u jepet mundësia e kërkimit urgjent të familjes së tyre apo institucionit mbikëqyrës apo kujdestar, ashtu siç përcaktohet me legjislacion përkatës.
12. Fëmijët të cilët kanë pësuar nga trafikimi me njerëz kanë të drejtë në kujdes dhe mbrojtje afatgjatë deri në shërimin e plotë të tyre. Fëmijët e privuar nga ambienti familjar kanë të drejtë në kujdes alternativ të ngjashëm me atë familjar apo të komunitetit.

KREU VI
KOMPENSIMI I VIKTIMAVE TË TRAFIKIMIT

Neni 39
Llojet e kompensimeve

1. Viktimat e trafikimit, përfshirë edhe viktimat fëmijë, kurdo që është e mundur, marrin kompensimin në mënyrë që të bëhet ri-integrimi dhe rimëkëmbja e plotë e tyre. Procedurat për marrjen dhe zbatimin e kompensimit duhet të jenë të qasshme për fëmijët.
2. Kompensimi përfshinë:
   2.1. Dëmshpërblimin nga kryerësi të cilin e urdhëron gjykata;
   2.2. Dëmet të cilat urdhërohen të paguhen në procedurë civile; dhe
   2.3. Akti juridik për Kompensimin e viktimave të krimit.

Neni 40
Dëmshpërblimi i urdhëruar nga gjykata

1. Dëmshpërblimi i urdhëruar nga gjykata i nënshtrohet dispozitave të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës.
2. Gjykatat sigurojnë që urdhrat për kompensim të zbatohen në mënyrë efikase dhe u japin prioritet atyre në krahasim me pagesat e tjera siç janë gjobat.

Neni 41
E drejta për të iniciuar padi civile

1. Viktima e trafikimit me njerëz ka të drejtë të inicioj procedurë civile për të kërkuar kompensimin e dëmeve materiale, fizike dhe emocionale që i janë shkaktuar si rezultat i veprimeve të përcaktuara si vepra penale me këtë ligj, nëse këtë të drejtë nuk ka mundur ta realizoj në procedurë penale.
2. E drejta për të paraqitur kërkesë civile për kompensimin e dëmeve materiale, fizike dhe emocionale nuk ndikohet nga ekzistimi i procedurës penale në lidhje me të njëjtat veprime nga të cilat rrjedh kërkesa civile.
3. Mungesa e viktimës gjatë procedurës nuk e pengon gjykatën që të urdhëroje pagesën e kompensimit nga ky nen.

Neni 42
Kompensimi nga shteti

1. Kompensimi i viktimave të trafikimit me njerëz, nga ana e Shtetit, do të rregullohet me një akt juridik përkatës për kompensimin e të gjitha viktimave të krimeve.
2. Në pajtim me Kodin e Procedurës Penale, kur kompensimi nuk është krejtësisht i mundur nga burimet tjera, shteti kontribuon për të kompensuar viktimat e trafikimit apo anëtarin e familjes së fëmijës viktimë e trafikimit me njerëzore, apo vartësin e viktimës e cila ka vdekur si rezultat i krimit të tillë.
3. Qeveria e Kosovës, do të siguroj që në kuadër të aktit juridik përkatës për kompensimin e viktimave të krimeve të parasheh edhe kompensimin e viktimave të trafikimit me njerëz.
4. Kompensimi jepet si:
   4.1. kompensim shtesë kur i pandehuri vetëm pjesërisht demëshpërblen viktimën;
   4.2. kompensim i plotë në rastet e pamundësisë së pagesës në tërësi nga i pandehuri; apo
   4.3. kompensim i plotë kur i pandehuri nuk është identifikuar, nuk është ndjekur penalisht apo nuk është dënuar. Në këtë rast aktit juridik përkatës për kompensimin e viktimave të trafikimit mbetet e vetmja mënyrë për zhdëmtim të viktimës.
5. Statusi i migrimit ose kthimi i viktimës në vendin e tij ose saj të origjinës, nuk do të parandalojë institucionin e caktuar të urdhërojë pagesën e kompensimit sipas këtij ligji.
6. Kompensimi mbulon kompensimin për dëmin material, fizik dhe emocional.
7. Me propozimin e Autoritetit Kombëtar, Qeveria nxjerr vendim për themelimin e komisionit për pranimin, shqyrtimin dhe vendosjen e kërkesave për kompensim të viktimave të trafikuara me njerëz.
8. Qeveria siguron që edhe autoritetet kryesore përgjegjëse sipas këtij ligji të jenë të përfaqësuara në komisionin për pranimin, shqyrtimin dhe vendosjen e kërkesave për kompensim.
9. Qeveria e Kosovës nxjerr akt nënligjor për funksionimin e komisionit duke përcaktuar edhe kompetencat e tij, si dhe kriteret dhe procedurat për dhënien e kompensimit viktimave te trafikimit me njerëz, përfshirë por pa u kufizuar në:
   9.1. rrethanat në të cilat mund të zbatohet pagesa e kompensimit;
   9.2. bazën sipas së cilës llogaritet kompensimi dhe shuma e kompensimit e cila duhet të paguhet duke marrë parasysh çfarëdo kompensimi apo shume të pranuar nga personat tjerë.
   9.3. procedurën e aplikimit për pagesën e kompensimit; dhe
   9.4. procedurën për shqyrtimin e aplikacioneve dhe ankesave kundër vendimeve lidhur me kërkesat për kompensim.
10. Komisioni siguron që viktimat e trafikimit të kenë mundësi të aplikojnë për pagesën e kompensimit nga ky nen edhe në rastet kur kryerësi nuk është i njohur, i ndaluar apo i dënuar.

Neni 43
Kompensimi i viktimave fëmijë

1. Viktimat fëmijë kanë të drejtë në kompensim.
2. Kërkesa për kompensimin fëmijës bëhet siç përcaktohet me legjislacionin përkatës në fuqi.
3. Qasja në kompensim të fëmijës viktimë e trafikimit rregullohet në pajtim me legjislacionin në fuqi.

Neni 44
Kërkesa për kompensim nga shteti

1. Kërkesa për kompensim bëhet brenda afateve të përcaktuara me Kodin e Procedurës Penale.
2. Kompensimi refuzohet për shkak të konstatimit të përfshirjes së viktimës apo të parashtruesit të kërkesës në krim të organizuar apo për shkak të anëtarësisë në organizatën e cila është e përfshirë në krime të dhunës.
3. Me qëllim të shmangies së kompensimit të dyfishtë, komisioni mund të zvogëlojë kompensimin e dhënë apo të kërkojë kthimin e kompensimit të çfarëdo shume të pranuar nga personi si kompensim për lëndimin apo vdekjen, nëse ai është kompensuar nga kryerësi, kompania e sigurimit apo nëse kompensimi është bërë nga ndonjë burim tjetër.

KREU VII
BASHKËPUNIMI

Neni 45
Bashkëpunimi në mes të autoriteteve

1. Autoritetet për zbatim të ligjit, migrimit, punës dhe autoritetet tjera relevante, sipas nevojës, bashkëpunojnë me njëra tjetrën për parandalimin dhe ndjekjen e krimeve të trafikimit dhe mbrojtjen e viktimave të trafikimit, pa paragjykuar të drejtën e viktimave në privatësi, duke shkëmbyer dhe ndarë informacione dhe duke marrë pjesë në programe trajnimi, me qëllim që, ndër të tjera:
   1.1. të identifikojnë viktimat dhe trafikantët duke përfshirë dokumentet e identifikmit të shfrytëzuara gjatë kalimit të kufirit për qëllim të trafikimit me njerëz;
   1.2. të identifikojnë mënyrat dhe metodat e përdorura nga grupet kriminale për qëllim të trafikimit me njerëz;
   1.3. të identifikojnë praktikat më të mira për të gjitha aspektet e parandalimit dhe luftimit të trafikimit me njerëz;
   1.4. t'u ofrojnë ndihmë dhe mbrojtje viktimave dhe dëshmitarëve.
2. Për të zhvilluar dhe zbatuar politikat, programet dhe masat për parandalimin dhe luftimin e trafikimit me njerëz dhe ofrimin e ndihmës dhe mbrojtjes për viktimat e trafikimit, autoritetet bashkëpunojnë, sipas nevojës, me organizata joqeveritare, institucione tjera të shoqërisë civile dhe organizata ndërkombëtare.

3. Nëse Policia e Kosovës ose Prokuroria e Shtetit kanë informata në dispozicion ose bazë të arsyeshme për të besuar se jeta, liria dhe integriteti fizik i një personi, viktimë e supozuar e trafikimit, është në rrezik në territorin e ndonjë shteti tjetër, autoritetet, në raste të tilla, i shkëmbejnë informatat pa vonesë tek shteti në fjalë me qëllim që të ndërmerren masat e duhura për mbrojtje.
4. Autoritetet obligohen të forcojnë bashkëpunimin e tyre në kërkim të personave të zhdukur, në veçanti fëmijëve të zhdukur, nëse informacionet në dispozicion i bëjnë ato të mendojnë se ai/ajo është viktimë e trafikimit me njerëz.
5. Me qëllim që të luftohet në mënyrë efektive trafikimi me njerëz dhe të rritet bashkëpunimi ndërshtetëror, institucioni përgjegjës sipas ligjeve të Kosovës, do të nënshkruajë marrëveshje dhe traktate dypalëshe ose shumëpalëshe me shtetet e tjera.
6. Me qëllim të rritjes së efikasitetit të aktiviteteve për parandalimin dhe luftimin e trafikimit me njerëz, dhe mbrojtjen e tyre, autoritetet e përcaktuara në nenin 6 të këtij ligji angazhohen ndarazi ose në koordinim me njëra tjetrën, për aktivitete të tilla.
7. Gjatë kryerjes së aktiviteteve për parandalimin e trafikimit me njerëz, autoritetet bashkëpunojnë ndërmjet vete me qëllim të shkëmbimit të ekspertëve, kryerjes së aktiviteteve të përbashkëta për identifikimin e hershëm, dhe intervistimin e viktimave të trafikuara, realizimit të nismave socio-ekonomike, identifikimit, kapjes dhe dënimit të personave të cilët merren me trafikimin e njerëzve**,** dhe përmes aktiviteteve tjera në këtë fushë.

KREU VIII
DISPOZITAT KALIMTARE

Neni 46

Të gjitha provat e marra në rastet e trafikimit me njerëz para miratimit të këtij ligji, do të konsiderohen të pranueshme sipas procedurave të aplikueshme në kohën e marrjes së provës.

Neni 47
Shfuqizimi

Me hyrjen në fuqi të këtij ligji shfuqizohet Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2001/4 mbi Ndalimin e Trafikimit me Njerëz në Kosovë dhe Urdhëresa Administrative Nr. 2005/3 për zbatimin e Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/4.

Neni 48
Zbatimi

1. Përgjegjës për zbatimin e këtij ligji janë të gjitha autoritetet kompetente të përcaktuara në nenin 6 të këtij ligji, si dhe institucionet e tjera vendore edhe ndërkombëtare të cilat janë të interesuara të ndihmojnë luftën kundër trafikimit më njerëz.
2. Obligohen institucionet shtetërore, çdo ofrues i shërbimeve në kuadër të këtyre

institucioneve, OJQ-të dhe organizatat ndërkombëtare, t'i zbatojnë Strategjinë Nacionale dhe Planin e Veprimit kundër Trafikimit me Qenje Njerëzore, Procedurat Standarde të Veprimit, Strategjinë afatgjate për Ri-integrim të viktimave të trafikimit, Standardet minimale për kujdesin ndaj viktimave të trafikimit dhe aktet tjera përkatëse të nxjerra nga autoritetet kompetente, të cilat e trajtojnë parandalimin dhe luftimin e trafikimit me njerëz dhe mbrojtjen e viktimave të trafikuara.

3. Të drejtat e viktimave të trafikimit ose të viktimave të supozuara të trafikimit që kërkojnë, ose është e arsyeshme të besohet se mund të kërkojnë azil ose çfarëdo formë të mbrojtjes plotësuese të përcaktuara me Ligjin për Azil në Kosovë, gjithmonë duhet të garantohen në përputhje me dispozitat e atij ligji.
4. Qeveria mund të nxjerr vendime apo akte nënligjore të tjera për zbatimin e këtij ligji.

Neni 49
Nxjerrja e akteve nënligjore

Aktet nënligjore për zbatimin e këtij ligji nxirren në afat prej gjashtë (6) muajve nga hyrja në fuqi të këtij ligji.

Neni 50
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ligji Nr. 04/L-218
31 korrik 2013

Shpallur me dekretin Nr. DL-043-2013, datë 19.08.2013 nga Presidentja e Republikës së Kosovës Atifete Jahjaga.

GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS / Nr. 34 / 4 SHTATOR 2013, PRISHTINË

LIGJI Nr. 04/L-209 PËR AMNISTINË

Përmbajtja

Kreu I: Dispozitat e përgjithshme 735
Kreu II: Kushtet për amnistinë 736
Kreu III: Procedura për dhënien e amnistisë 739
Kreu IV: Dispozitat kalimtare dhe përfundimtare 741

Kuvendi i Republikës së Kosovës;

Në bazë të nenit 65 (1 dhe 15) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton

LIGJ PËR AMNISTINË

KREU I
DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi dhe fushëveprimi

Ky ligj rregullon kushtet dhe procedurën me të cilën jepet amnisti për personat të cilën janë dënuar për një vepër penale, personat të cilët janë nën ndjekje penale për vepra penale, apo personat të cilët mund të jenë objekt i ndjekjes penale për veprat penale të kryera para 20 qershorit 2013 brenda territorit që tani përbën Republikën e Kosovës.

Neni 2
Amnistia

1. Të gjithë kryesve të veprave penale të listuara në nenin 3 të këtij ligji të cilat janë kryer para datës 20 qershor 2013 u jepet lirim i plotë nga ndjekja penale apo nga ekzekutimi i dënimit, në përputhje me kushtet e parapara me nenin 3 të këtij ligji.
2. Amnistia sipas këtij ligji mund të jepet vetëm në përputhje me procedurat e parapara në Kapitullin III të këtij ligji.

KREU II
KUSHTET PËR AMNISTINË

Neni 3
Kushtet për dhënien e Amnistisë nga ndjekja penale dhe vuajtja e plotë e dënimit

1. Lirohen plotësisht nga ndjekja penale apo vuajtja e plotë e dënimit, kryesit e veprave të mëposhtme penale:
   1.1. veprat penale sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 19/13 Korrik 2012) dhe atë:
      1.1.1. Sulmi kundër rendit Kushtetues të Republikës së Kosovës (neni 121), përveç në rastet kur kryerja e kësaj vepre penale ka rezultuar në kryerjen e një vepre tjetër penale për të cilën nuk është dhënë amnisti;
      1.1.2. Kryengritja e armatosur (neni 122);
      1.1.3. Rrezikimi i tërësisë territoriale të Republikës së Kosovës (neni 125);
      1.1.4. Rrezikimi i rendit Kushtetues me shkatërrimin apo dëmtimin e instalimeve dhe pajisjeve publike (neni 129);
      1.1.5. Spiunazhi (neni 131);
      1.1.6. Bashkimi për veprimtari kundër Kushtetuese (neni 134);
      1.1.7. Kalimi i paautorizuar i vendkalimeve kufitare ose i vijës kufitare (neni 146, paragrafët 1, 2, 3.1 dhe 3.3);
      1.1.8. Nxitja e urrejtjes, përçarjes ose mos durimit kombëtar, racor, fetar apo etnik (neni 147);
      1.1.9. Ushtrimi i kundërligjshëm i veprimtarisë mjekësore ose farmaceutike (neni 262, paragrafi 1);
      1.1.10. Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve (neni 374);
      1.1.11. Moslajmërimi i veprave penale apo kryesve të veprave (neni 386, vetëm ndërlidhur me moslajmërimin e veprave penale për të cilat jepet amnisti me këtë nen);
      1.1.12. Dhënia e ndihmës kryesve pas kryerjes së veprave penale (neni 388, vetëm ndërlidhur me dhënien e ndihmës kryesve pas kryerjes së veprave penale për të cilat jepet amnisti me këtë nen);
      1.1.13. Thirrja për rezistencë (neni 411) përveç në rastet kur kryerja e kësaj vepre penale ka rezultuar në kryerjen e një vepre tjetër penale. Lirohen nga ndjekja penale apo vuajtja e dënimit edhe kryesit e këtyre veprave penale në vijim të cilat janë kryer me qëllim të kryerjes së veprës penale thirrja për rezistencë:
         1.1.13.1. Kanosja e kandidatit (neni 211);
         1.1.13.2. Parandalimi i ushtrimit të së drejtës për të votuar (neni 212);
         1.1.13.3. Keqpërdorimi i autorizimeve ekonomike (neni 290, nënparagrafët 1.1, 1.2, 1.3, dhe 1.4 të paragrafit 1);
         1.1.13.4. Tregtia e ndaluar (neni 305);
         1.1.13.5. Shmangia nga tatimi (neni 313);

1.1.13.6. Kontrabandimi i mallrave (neni 317, paragrafët 1 dhe 2);
1.1.13.7. Shmangia nga pagesa e tarifave të detyrueshme doganore (neni 318);
1.1.13.8. Asgjësimi, dëmtimi ose heqja e instalimeve publike (neni 366, paragrafët 1 dhe 2);
1.1.13.9. Rrezikimi i trafikut publik me veprime apo mjete të rrezikshme (neni 380, paragrafët 1, 2 dhe 5);
1.1.13.10. Pengimi i personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare (neni 409, paragrafët 1, 2 dhe 3);
1.1.13.11. Sulmi ndaj personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrës zyrtare (neni 410, paragrafi 1) përveç në rastet kur kryerja e kësaj vepre penale ka rezultuar me lëndim të rëndë trupor ose vdekje, dhe
1.1.13.12. Dispozitat penale të Kodit Doganor dhe Akcizave të Kosovës:
1.1.13.12.1. Pengimi i lëvizjes së Automjeteve të Doganës (neni 296);
1.1.13.12.2. Dhënia e deklaratës së pavërtetë (neni 297);
1.1.13.12.3. Shmangia Mashtruese nga Taksa e Importit dhe Akciza (neni 298);
1.1.13.12.4. Shmangiet Mashtruese nga Zbatimi i Ndalesave dhe Kufizimeve mbi Mallra (neni 299);
1.1.13.12.5. Veprat penale në lidhje me Produktet me Akcizë (neni 300).
1.1.14. Pjesëmarrja në turmë që kryen vepër penale dhe huliganizmi (neni 412), përveç në rastet kur kryerja e kësaj vepre penale ka rezultuar me lëndim të rëndë trupor ose vdekje.

1.2. Veprat penale sipas Kodit Penal të Kosovës (Rregullore e UNMIK-ut 2003/25, datë 6 korrik 2003, Gazeta Zyrtare e Kosovës nr. 2003/25) dhe Rregullores së UNMIK-ut nr. 2004/19 mbi ndryshimin e Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës:
1.2.1. Sulmi kundër rendit juridik të Kosovës (neni 108);
1.2.2. Kalimi i paautorizuar i vendkalimeve kufitare ose vijës kufitare (neni 114 paragrafët 1 dhe 2, nënparagrafi 3.1, 3.3 dhe paragrafi 4);
1.2.3. Nxitja e urrejtjes, përçarjes ose mosdurimit kombëtar, racor, fetar apo etnik (neni 115);
1.2.4. Ushtrimi i kundërligjshëm i veprimtarisë mjekësore (neni 221, paragrafi 1);
1.2.5. Mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve (neni 328, paragrafi 2); si dhe Zotërimi, kontrollimi, posedimi apo përdorimi i armës nga cilido person që nuk ka Leje për armëmbajtje (Neni 8.6 në lidhje me nenin 8.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2001/7, datë 21 shkurt 2001, Gazeta Zyrtare e Kosovës nr. 2003/7) ;
1.2.6. Moslajmërimi i veprave penale apo moslajmërimi i kryesit të saj (neni 303, vetëm ndërlidhur me veprat penale për të cilat jepet amnisti me këtë ligj);

1.2.7. Dhënia e ndihmës kryesve pas kryerjes së veprës penale (neni 305, vetëm ndërlidhur me veprat penale për të cilat jepet amnisti me këtë ligj);

1.2.8. Thirrja për rezistencë (neni 319) përveç në rastet kur kryerja e kësaj vepre penale ka rezultuar në kryerjen e një vepre tjetër penale. Lirohen nga ndjekja penale apo vuajtja e dënimit edhe kryesit e këtyre veprave penale më poshtë të cilat janë kryer me qëllim të kryerjes së veprës penale thirrja për rezistencë:

1.2.8.1. Keqpërdorimi i autorizimeve në ekonomi (neni 236 paragrafi 1, nënparagrafët 1.1; 1.2; 1.3 dhe 1.4);

1.2.8.2. Tregtia e ndaluar (neni 246);

1.2.8.3. Shmangia nga tatimi (neni 249);

1.2.8.4. Kontrabandimi i mallërave (neni 273);

1.2.8.5. Asgjësimi, dëmtimi apo heqja e instalimeve publike (neni 292 paragrafët 1 dhe 2);

1.2.8.6. Rrezikimi i trafikut publik me veprime apo mjete të rrezikshme (299 paragrafët 1 dhe 2);

1.2.8.7. Pengimi i personit zyrtar ne kryerjen e detyrave zyrtare (neni 316);

1.2.8.8. Sulmi ndaj personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrës zyrtare (neni 317), përveç në rastet kur kryerja e kësaj vepre penale ka rezultuar me lëndim të rëndë trupor ose vdekje;

1.2.9. Pjesëmarrja në grup që kryen vepër penale (neni 320), përveç në rastet kur kryerja e kësaj vepre penale ka rezultuar me lëndim të rëndë trupor ose vdekje.

1.3. Veprat penale të Ligjit Penal të KSAK G. Zyrtare nr. 20/77 lidhur me Rregulloret e UNMIK-ut nr. 1999/24 dhe 2000/59 për ligjin në fuqi në Kosovë, në vijim:

1.3.1. Mbajtja e palejuar e armëve dhe materialit eksploziv (neni 199, paragrafi 1);

1.3.2. Moslajmërimi i veprës penale dhe kryesit (neni 173, vetëm ndërlidhur me veprat penale për të cilat jepet amnisti me këtë ligj);

1.3.3. Ndihma kryesit pas kryerjes së veprës penale (neni 174, vetëm ndërlidhur me veprat penale për të cilat jepet amnisti me këtë ligj);

1.3.4. Nxitja për rezistencë (neni 186) përveç në rastet kur kryerja e kësaj vepre penale ka rezultuar në kryerjen e një vepre tjetër penale. Lirohen nga ndjekja penale apo vuajtja e dënimit edhe kryesit e këtyre veprave penale më poshtë të cilat janë kryer me qëllim të kryerjes së veprës penale thirrja për rezistencë:

1.3.4.1. Keqpërdorimi i autorizimeve në ekonomi (neni 108 paragrafët 1, 2, 3, 4, dhe 5);

1.3.4.2. Tregtia e palejuar (neni 116);

1.3.4.3. Fshehja e tatimit (neni 123);

1.3.4.4. Asgjësimi ose dëmtimi i pajisjeve publike (neni 158);

1.3.4.5. Rrezikimi i trafikut publik me veprime ose mjete të rrezikshme (neni 167);

1.3.4.6. Pengimi i personit zyrtar në kryerjen e detyrës zyrtare (neni 183);
1.3.4.7. Sulmi ndaj personit zyrtar gjatë kryerjes se detyrës zyrtare (neni 184 paragrafët 1, 2 dhe 4), përveç në rastet kur kryerja e kësaj vepre penale ka rezultuar me lëndim të rëndë trupor ose vdekje.
1.3.5. Pjesëmarrja në grup që kryen vepra penale (neni 200, përveç në rastet kur kryerja e kësaj vepre penale ka rezultuar me lëndim të rëndë trupor ose vdekje).
1.4. Veprat penale të parapara me Kodin Penal të Republikës Socialiste Federale të Jugosllavisë, Gazeta zyrtare Nr. 44 e datës 8 tetor 1976:
1.4.1. Cenimi i tërësisë territoriale (neni 116);
1.4.2. Spiunazhi (neni 129);
1.4.3. Nxitja e urrejtjes, përçarjes ose mosdurimit kombëtar, racor, fetar apo etnik (neni 134).

Neni 4
Përjashtimet nga Amnistia

1. Amnistia nga cilado vepër penale e përmendur në këtë ligj nuk do të aplikohet për:
1.1. veprat kundër akterëve ndërkombëtar dhe forcave ndërkombëtare të sigurisë në Kosovë. Anëtarët e forcave ndërkombëtare të sigurisë janë gjithmonë nën jurisdiksionin e shtetit dërgues;
1.2. veprat të cilat përbëjnë shkelje të rëndë të së drejtës ndërkombëtare humanitare përfshirë ato vepra penale të Kapitullit XV të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, Kapitullit XIV të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës dhe Kapitullit XVI të Kodit Penal të RSFJ 1976;
1.3. vepat penale që kanë rezultuar me lëndim të rëndë trupor ose me vdekje.

Neni 5

Me dhënien e amnistisë nuk preken të drejtat e personave të tretë, të cilat bazohen në dënimin apo aktgjykimin.

KREU III
PROCEDURA PËR DHËNIEN E AMNISTISË

Neni 6
Njoftimi për gjendjen e personave në mbajtjen e dënimit të cilët i nënshtrohen amnistisë

1. Shërbimi Korrektues i Kosovës është i detyruar që në afat prej shtatëdhjetë e dy (72) orëve pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, të njoftojë me shkrim gjykatën e cila ka gjykuar në shkallë të parë për personat e dënuar të cilët gjenden në mbajtjen e dënimit dhe që përfshihen me ligjin e amnistisë.
2. Njoftimi duhet të përmbaj përveç informatave tjera, informatat për datën e fillimit të ekzekutimit dhe të skadimit të dënimit.

3. Gjykata sipas detyrës zyrtare nxjerr vendim për zbatimin e amnistisë në afat prej shtatë (7) ditësh nga dita e pranimit të njoftimit, ndërsa për personin e dënuar i cili nuk ka filluar mbajtjen e dënimit, vendimin për zbatimin e amnistisë gjykata duhet ta nxjerr në afat prej pesë (5) ditësh nga dita e pranimit të kërkesës.
4. Nëse i dënuari mbanë dënimin në shtetin tjetër njoftimi duhet të bëhet përmes Ministrisë së Drejtësisë.

Neni 7
Vendosja për zbatimin e amnistisë nga ekzekutimi i dënimit

1. Për zbatimin e amnistisë vendos gjykata e cila ka vendos në shkallën e parë, me ndihmën e EULEX-it, përkatësisht gjykata që ka kompetencë lëndore dhe territoriale që të gjykojë çështjen e caktuar që i është adresuar asaj:
   1.1. sipas detyrës zyrtare; apo
   1.2. sipas kërkesës të personit të dënuar, kryesit të veprës penale, prokurorit të shtetit apo të personave të cilët sipas Kodit për Procedurën Penale mund të ushtrojnë ankesë kundër vendimit gjyqësor.
2. Gjykata vendos me vendim me të cilin përcakton pjesën e dënimit nga ekzekutimi i së cilës i dënuari është liruar, nëse me këtë ligj nuk është përcaktuar ndryshe.

Neni 8
Vendosja për zbatimin e amnistisë nga ndjekja penale

1. Në rastet kur është bërë kallëzim penal, është nisur një hetim, apo është ngritur aktakuzë, prokurori kompetent merr vendim për të dhënë amnisti nga ndjekja penale, në përputhje me këtë ligj.
2. Brenda tridhjetë (30) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, prokurori kompetent do të marrë vendim sipas detyrës zyrtare në përputhje me Kodin e Procedurës Penale të Republikës së Kosovës, për të hedhur poshtë kallëzimet penale ose të pushojë hetimet për veprat penale të përcaktuara në këtë ligj.
3. Brenda gjashtëdhjetë (60) ditësh nga hyrja në fuqi e këtij ligji, dënimet e formës së prerë që bien në fushëveprimin e nenit 3 të këtij ligji do të fshihen nga evidenca penale në përputhje me ligjet relevante të aplikueshme.

Neni 9
Plotëfuqishmëria e konfiskimit

Pavarësisht aplikueshmërisë së amnistisë ndaj çfarëdo vepre penale sipas këtij ligji, nëse një send është konfiskuar në përputhje me ligjin gjatë procedurës penale bazuar plotësisht apo pjesërisht në atë vepër penale, personi i cili përfiton nga amnistia nuk ka të drejtë që ta kërkoj kthimin e sendit të konfiskuar.

Neni 10
Ankesa ndaj vendimeve për Amnistinë

1. Kundër vendimeve për amnisti, mund të paraqitet ankesë Gjykatës së Apelit në afat prej shtatë (7) ditësh nga dita e pranimit të vendimit. Gjykata e Apelit nxjerr vendim

sipas ankesës në afat prej tre (3) ditësh nga dita e pranimit të shkresave.
2. Ankesa e ndalon ekzekutimin e vendimit.
3. Nëse për shkak të zbatimit të amnistisë i dënuari do të lirohet nga mbajtja e dënimit me burg, gjykata me vendimin e njëjtë do të vendos edhe për lirimin, i cili vendim pa shtyrje i dërgohet Shërbimit Korrektues të Kosovës.

KREU IV
DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 11
Zbatimi subsidiar

Për zbatimin e amnistisë përshtatshmërisht aplikohen dispozitat e Kodit Nr. 04/L-123 të Procedurës Penale, në qoftë se me këtë ligj nuk është përcaktuar ndryshe.

Neni 12
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ligji nr. 04/L-209
11 korrik 2013

Shpallur me dekretin Nr. DL-051-2013, datë 17.09.2013 nga Presidentja e Republikës së Kosovës Atifete Jahjaga.

GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS / Nr. 39 / 19 SHTATOR 2013, PRISHTINË